

**KOMBET
E BASHKUARA**



Tribunali Ndërkombëtar për
Ndjekjen Penale të Personave
Përgjegjës për Shkelje të Rënda të
Së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare
Të Kryera në Territorin e
ish-Jugosllavisë që prej vitit 1991

Lënda Nr. IT-05-87-T
Data: 26 shkurt 2009
Original: Anglisht

NË DHOMËN GJYQËSORE

Para: Gjykatësit Iain Bonomy, Kryegjykatës
Gjykatësit Ali Nawaz Chowhan
Gjykatëses Tsvetana Kamenova
Gjykatëses Janet Nosworthy, Gjykatëse Rezervë

Ushtrues i Detyrës së Sekretarit: Z. John Hocking

Aktgjykim: 26 SHKURT 2009

PROKURORI

k.

**MILLAN MILLUTINOVIQIT
NIKOLLA SHAINOVIQIT
DRAGOLUB OJDANIQIT
NEBOJSHA PAVKOVIQIT
VLADIMIR LLAZAREVIQIT
SRETEN LLUKIQIT**

PUBLIK

AKTGJYKIM

Vëllimi 1 prej 4

Zyrës së Prokurorit:

Z. Thomas Hannis
Z. Chester Stamp

Avokatëve të të Akuzuarve:

Z. Eugene O'Sullivan dhe Z. Sillobodan Zeçeviq për Z. Millan Millutinoviq
Z. Toma Fila dhe Z. Vladimir Petrovich për Z. Nikolla Shainoviq
Z. Tomislav Vishnjq dhe Z. Norman Sepenuk për Z. Dragolub Ojdaniq
Z. John Ackerman dhe Z. Aleks Aleksiq për Z. Nebojsa Pavkoviq
Z. Mihajlo Bakrač dhe Z. Gjuro Çepiq për Z. Vladimir Llazarevich
Z. Branko Llukiq dhe Z. Dragan Ivetic për Z. Sreten Llukiq

| | |
|--|-----------|
| I. HYRJE | 7 |
| A. AKTAKUZA | 8 |
| B. HISTORIA PROCEDURALE | 11 |
| C. METODOLOGJIA NË LIDHJE ME PROVAT | 17 |
| D. TERMINOLOGJIA KONKRETE E PËRDORUR..... | 28 |
| II. LIGJI PËRKATËS..... | 32 |
| A. STANDARDET LIGJORE PËR PËRGJEGJËSINË PENALE INDIVIDUALE | 32 |
| 1. Hyrje | 32 |
| 2. Planifikimi | 34 |
| 3. Nxitja | 35 |
| 4. Urdhërimi..... | 36 |
| 5. Ndihma dhe inkurajimi | 37 |
| 6. Ndërmarrja e përbashkët kriminale | 40 |
| a. Elementët fizikë..... | 41 |
| i. Ndërmarrja e përbashkët kriminale përbëhej prej dy a më shumë individësh | 41 |
| ii. Ekzistenca e një plani, projekti ose qëllimi të përbashkët që konsistonte ose përfshinte kryerjen e një krimi apo shkeljeje bazë të përcaktuar në Statut | 43 |
| iii. I Akuzuari mori pjesë në planin, projektin ose qëllimin e përbashkët..... | 44 |
| b. Elementët mendorë..... | 46 |
| iv. Elementët mendorë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale | 46 |
| v. Elementët mendorë të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale | 47 |
| 7. Përgjegjësia e eprorit | 48 |
| a. Midis të akuzuarit dhe individit ose individëve që kryen krimin ose shkeljen bazë, ekzistonte lidhja epror-vartës..... | 50 |
| b. I akuzuari duhet të ketë ditur ose kishte arsye të dinte se krimi ose shkelja bazë do të kryhej, po kryhej ose ishte kryer | 50 |
| c. I akuzuari nuk mori masa të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin dhe/ose ndëshkimin e krimeve ose shkeljeve bazë të vartësit ose vartësve..... | 52 |
| B. KUSHTET DHE ELEMENTËT E KRIMEVE STATUTORE | 53 |
| 1. Neni 3 i Statutit të Tribunalit..... | 53 |
| a. Kushte për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës..... | 53 |
| i. Gjatë periudhës përkatëse të aktakuzës ekzistonte konflikt i armatosur i brendshëm ose ndërkombëtar..... | 54 |
| ii. Ekzistonte lidhje midis krimeve të pretenduara dhe konfliktit të armatosur..... | 55 |
| iii. Veprimet duhet të shkelin një rregull të së drejtës humanitare ndërkombëtare, zakone apo të traktateve..... | 55 |
| iv. Shkelja e të drejtës ndërkombëtare duhet të përmbajë përgjegjësi penale individuale dhe duhet të jetë e rëndë (“kushti i peshës së shkeljes”)..... | 56 |
| b. Vrasja si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës | 57 |
| i. Elementë të vrasjes si shkelje bazë | 58 |
| 2. Neni 5 i Statutit të Tribunalit..... | 59 |
| a. Kushtet juridiksionale të Nenit 5 | 59 |
| b. Kushte të përgjithshme për krimet kundër njerëzimit | 59 |
| i. Duhet të ekzistojë sulm | 60 |
| ii. Sulmi duhet të jetë kundër popullatës civile | 60 |
| iii. Sulmi duhet të jetë gjerësisht i përhapur ose sistematik | 62 |
| iv. Veprimet e autorit fizik duhet të jenë pjesë e sulmit..... | 63 |
| v. Kryesi duhet të dijë se po kryhet sulm kundër popullatës civile dhe të dijë ose të rrezikojë që veprimet e tij të jenë pjesë e sulmit | 64 |
| vi. Konkluzion | 67 |
| c. Elementë të shpërnguljes së dhunshme si shkelje bazë: zhvendosje e dhunshme dhe dëbim | 68 |

| | |
|--|------------|
| i. Dëbimi si krim kundër njerëzimit | 70 |
| ii. Veprime të tjera çnjerëzore si krime kundër njerëzimit: zhvendosje e dhunshme..... | 70 |
| d. Elementë të vrasjes si krim kundër njerëzimit..... | 71 |
| e. Kushte konkrete të përndjekjes si krim kundër njerëzimit | 71 |
| i. Elementi fizik i përndjekjes..... | 71 |
| ii. Elementi mendor i përndjekjes: synimi diskriminues | 73 |
| f. Elementë të akuzave për forma të përndjekjes mbi baza politike, fetare ose racore | 73 |
| i. Vrasja si formë përndjekjeje | 73 |
| ii. Dhuna seksuale si formë përndjekjeje..... | 74 |
| (A) Mohimi ose shkelja e një të drejte themelore | 75 |
| (B) Kushti i peshës së barabartë..... | 77 |
| (C) Elementët | 77 |
| (D) Përdhunimi si një ndër llojet e dhunës seksuale | 80 |
| iii. Dëmtimi ose shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturore si formë përndjekjeje..... | 81 |
| III. RRETHANAT HISTORIKE | 84 |
| A. NDRYSHIMET KUSHTETUESE TË VITIT 1989..... | 84 |
| B. ECURIA E KRIZËS | 88 |
| C. ORVATJET PËR ZGJIDHJEN E KRIZËS | 92 |
| D. KONKLUSIONE | 94 |
| IV. STRUKTURA DHE FUNKSIONIMI POLITIK DHE KUSHTETUES I RFJ-SË DHE SERBISË NË 1998 DHE 1999..... | 96 |
| A. STRUKTURA KUSHTETUESE E RFJ-SË DHE REPUBLIKËS SË SERBISË | 96 |
| 1. Struktura kushtetuese e Republikës së Serbisë..... | 96 |
| 2. Struktura kushtetuese e RFJ-së..... | 100 |
| 3. Statusi kushtetues dhe statutor i UJ-së | 102 |
| B. KOMPETENCAT E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SERBISË..... | 104 |
| C. FUNKSIONIMI POLITIK I RFJ-SË DHE SERBISË NË 1998 DHE 1999 | 116 |
| D. ADMINISTRIMI I KOSOVËS | 119 |
| 1. Vetëqeverisja vendore | 120 |
| 2. Grupi i Punës për Kosovën..... | 121 |
| 3. Këshilli Ekzekutiv i Përkohshëm | 124 |
| V. PËRPJEKJET DIPLOMATIKE..... | 127 |
| A. KARAKTERI I PËRGJITHSHËM I PËRPJEKJEVE DIPLOMATIKE GJATË KONFLIKTIT TË KOSOVËS..... | 127 |
| B. PËRPJEKJET DIPLOMATIKE PARA RAMBUJESË..... | 128 |
| 1. Përpjekje e para për një zgjidhje politike | 128 |
| 2. Misioni i Vëzhguesve Diplomatikë për Kosovën (“KDOM”) | 133 |
| 3. Tetor 1998: Marrëveshja Holbrooke-Milloshëviq..... | 135 |
| C. MISIONI VERIFIKUES I KOSOVËS | 138 |
| D. TAKIMET ME PËRFAQËSUESIT E NATO-S..... | 141 |
| E. SHKURT 1999: KONFERENCAT E RAMBUJESË DHE PARISIT..... | 145 |
| F. TËRHEQJA E KVM-SË | 167 |
| G. KONKLUSIONE..... | 168 |
| VI. KONFLIKTI I ARMATOSUR..... | 171 |
| A. FORCAT E RFJ-SË DHE SERBISË..... | 171 |
| 1. Ushtria Jugosllave 1998–1999..... | 171 |
| a. Kuadri kushtetues dhe ligjor i UJ-së..... | 171 |
| b. Struktura e UJ-së | 172 |
| c. Uniformat e UJ-së..... | 174 |
| i. Uniformat e rregullta të UJ-së..... | 174 |

| | |
|---|-----|
| ii. Rezervistët e UJ-së..... | 175 |
| iii. Policia ushtarake e UJ-së | 176 |
| iv. Shiritat..... | 176 |
| d. Komanda dhe kontrolli..... | 177 |
| i. Kontrolli politik: Presidenti i RFJ-së dhe Këshilli i Lartë i Mbrojtjes..... | 177 |
| (A) Përbërja e KLM-së..... | 178 |
| (B) Kompetencat e KLM-së..... | 179 |
| (C) Mbledhjet e KLM-së pas 23 marsit 1999 dhe ekzistenca e Komandës së Lartë | 184 |
| ii. Komanda dhe kontrolli ushtarak: Shtabi i Përgjithshëm..... | 190 |
| (A) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm | 191 |
| (B) Përbërja e Shtabit të Përgjithshëm | 192 |
| (C) Shtabi i Komandës së Lartë | 193 |
| iii. Hierarkia komanduese dhe komunikimi në UJ | 195 |
| e. Sistemi i drejtësisë ushtarake të UJ-së..... | 201 |
| i. Struktura e sistemit të drejtësisë ushtarake | 202 |
| ii. Procedura e diktimit, hetimit dhe procedimit të krimeve në UJ..... | 205 |
| iii. Legjislacioni përkatës | 208 |
| iv. Gjykatat ushtarake në praktikë..... | 209 |
| (A) Funkcionimi i sistemit të drejtësisë ushtarake | 210 |
| (B) Hetimi dhe procedimi i krimeve në UJ..... | 214 |
| (C) Anëtarët e UJ-së ndërhynë në sistem ose e penguan atë..... | 219 |
| (1) Shembuj konkretë të korrupsionit | 220 |
| v. Konkluzione | 227 |
| 2. Forcat e UJ-së në Kosovë më 1998–1999 | 227 |
| a. Mobilizimi i përgjithshëm brenda UJ-së para bombardimit të NATO-s..... | 231 |
| b. Armata e Tretë | 232 |
| i. Postëkomanda të ndryshme | 232 |
| ii. Struktura..... | 234 |
| c. Korpusi i Prishtinës | 236 |
| i. Komanda e Korpusit të Prishtinës..... | 237 |
| (A) Postëkomandat..... | 238 |
| (B) Shtabi i Korpusit të Prishtinës | 240 |
| ii. Struktura e Korpusit të Prishtinës | 243 |
| (A) Njësitë në varësi të Korpusit të Prishtinës | 243 |
| (1) Brigada e Motorizuar 549 | 244 |
| (2) Brigada e Mekanizuar 243 | 245 |
| (3) Brigada 52 e Raketave Artilerike | 246 |
| (B) Forcat e atashuara Korpusit të Prishtinës në kohë lufte..... | 246 |
| iii. Organet Territoriale Ushtarake në Kosovë | 248 |
| (A) Qarku Ushtarak i Prishtinës..... | 248 |
| (B) Degët Ushtarake..... | 249 |
| (C) Detachmentet Territoriale Ushtarake | 250 |
| iv. Vullnetarët..... | 253 |
| (A) Pranimi i vullnetarëve në Armatën e Tretë, në Korpusin e Prishtinës dhe në njësitë vartëse | 255 |
| d. Njësi të tjera në Kosovë..... | 257 |
| i. Njësitë e Ndërlidhjes | 258 |
| 3. Forcat e Ministrisë së Brendshme të Serbisë..... | 258 |
| a. Organet e MPB-së | 259 |
| i. Drejtoria e Sigurimit Publik (RJB)..... | 259 |
| (A) Sekretariatet e Brendshme | 259 |
| (B) Sektorët e Brendshëm dhe stacionet policore | 260 |
| (C) Policia rezerviste apo rezervistët policorë | 260 |
| (D) Njësitë e posaçme policore të RJB-së: PJP dhe SAJ | 261 |

| | |
|---|-----|
| (1) PJP..... | 261 |
| (2) Njësitë e Posaçme Kundër Terrorit | 264 |
| ii. Drejtoria e Sigurimit Shtetëror (RDB)..... | 265 |
| iii. Shtabi i MPB-së për Kosovën..... | 268 |
| iv. Stacionet e policisë kufitare | 269 |
| v. Administrata e Policisë për Krime | 270 |
| b. Uniformat e MPB-së..... | 272 |
| i. Uniformat e policisë së rregullt dhe rezerviste..... | 273 |
| ii. Uniformat e PJP-së..... | 274 |
| iii. Uniformat e SAJ-së..... | 275 |
| iv. Uniformat e JSO-së..... | 275 |
| v. Shiritat | 276 |
| vi. Përfundim..... | 276 |
| c. Disiplina në MPB | 277 |
| d. Forcat e MPB-së të angazhuara në operacione në Kosovë..... | 279 |
| e. Forcat e PJP-së në Kosovë..... | 279 |
| f. Forcat e SAJ-së në Kosovë..... | 281 |
| g. Forcat e JSO-së në Kosovë..... | 282 |
| h. Paraushtarakët/vullnetarët | 283 |
| 4. Forca të tjera | 287 |
| a. Njësitë e Mbrojtjes dhe Ruajtjes Civile | 287 |
| i. Përbërja | 287 |
| ii. Struktura Komanduese | 290 |
| b. Popullata e armatosur joshqiptare..... | 293 |
| i. Përbërja | 293 |
| ii. Struktura komanduese..... | 299 |
| B. EKZISTENCA E KONFLIKTIT TË ARMATOSUR NË 1998–1999 | 303 |
| 1. Ushtria Çlirimtare e Kosovës..... | 304 |
| a. Dhuna e armatosur e zgjatur..... | 305 |
| i. Veprimet e UÇK-së..... | 305 |
| ii. Planet për të luftuar UÇK-në dhe ofensiva verore e RFJ-së/Serbisë | 310 |
| iii. Periudha midis Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq dhe fushatës ajrore të NATO-s .. | 313 |
| iv. Konkluzion në lidhje me dhunën e armatosur të zgjatur..... | 316 |
| b. UÇK-ja si grup i armatosur i organizuar | 317 |
| i. Origjina, struktura, dhe fuqia | 317 |
| ii. Furnizimet dhe përkrahja nga Shqipëria | 320 |
| iii. Armët dhe furnizimet..... | 322 |
| iv. Uniformat | 323 |
| v. Konkluzion për UÇK-në si grup i organizuar i armatosur | 324 |
| c. Konkluzionet | 324 |
| C. PËRDORIMI I FORCËS NGA FORCAT E RFJ-SË/SERBIË MË 1998..... | 325 |
| 1. Akuzat për përdorim të tepruar dhe pa dallim të forcës nga forcat e RFJ-së/Serbisë | 325 |
| 2. Argumentet e palëve | 326 |
| 3. Incidentet konkrete të pretenduara..... | 327 |
| a. Drenicë – shkurt dhe mars | 327 |
| b. Prekaz i Poshtëm – fillimi i marsit | 329 |
| c. Qyteti i Deçanit – prill..... | 330 |
| d. Ofensiva e verës..... | 334 |
| i. Duhël dhe Bllacë – fundi i korrikut..... | 334 |
| ii. Fshatrat në Kosovën perëndimore, përfshirë Junikun, Jabllanicën, dhe Prejlepin..... | 335 |
| iii. Malishevë – fundi i korrikut..... | 338 |
| iv. Drenicë – fillimi i gushtit | 340 |
| v. Lugina e Suharekës – shtator..... | 342 |
| vi. Abri e Epërme – shtator | 343 |

| | |
|--|-----|
| e. Personat e shpërngulur..... | 348 |
| 4. Konkluzione..... | 350 |
| D. SHKELJET E MARRËVESHJEVE TË TETORIT..... | 350 |
| 1. Komisioni Federal për Bashkëpunim | 351 |
| 2. Shkeljet e pretenduara..... | 354 |
| a. "Incidenti i Podujevës" | 354 |
| i. Rrethanat | 354 |
| ii. "Stërvitja" rezultoi në prishjen e armëpushimit dhe u shndërrua në dislokim | 355 |
| iii. Pasojat e stërvitjes në mbledhjen e 30 dhjetorit 1998 e Kolegjiumit të UJ-së..... | 356 |
| iv. Rifortifikimi dhe tensionet e vazhdueshme në Podujevë | 357 |
| v. Konkluzionet | 358 |
| b. Mbledhjet javore dhe shkëputja e komunikimit | 359 |
| c. Inspektimi i kazermave dhe liria e lëvizjes në tërë Kosovën..... | 362 |
| d. Shtimi i pranisë së UJ-së në Kosovë | 368 |
| e. Rritja e pranisë së MPB-së në Kosovë dhe moskthimi i armëve..... | 375 |
| 3. Kontaktet e KVM-së me NATO-n dhe UÇK-në | 377 |
| 4. Konkluzion | 379 |
| E. KONTROLLIMI I OPERACIONEVE TË UJ-SË DHE MPB-SË NË KOSOVË..... | 380 |
| 1. Mbledhjet në Beograd..... | 380 |
| a. Mbledhjet në vitin 1998..... | 380 |
| i. Plani Kundër Terrorizmit në Kosovë | 380 |
| ii. Zanafilla e Komandës së Përbashkët..... | 385 |
| b. Mbledhjet në vitin 1999 dhe përpilimi i planeve të përmasave të mëdha | 388 |
| 2. Bashkërendimi midis UJ-së dhe MPB-së në lidhje me operacionet luftarake..... | 394 |
| a. Sistemi i bashkërendimit në përgjithësi..... | 394 |
| i. Bashkërendimi i planifikimit të operacioneve të përbashkëta të UJ/MPB-së | 394 |
| (A) Bashkërendimi në vitin 1998..... | 394 |
| (B) Bashkërendimi në vitin 1999 | 400 |
| b. Komanda e Përbashkët | 405 |
| i. Komanda e Përbashkët në vitin 1998..... | 409 |
| (A) Mbledhjet e Komandës së Përbashkët | 409 |
| (B) Natyra e Komandës së Përbashkët..... | 415 |
| (C) Pushteti i Komandës së Përbashkët mbi MPB-në dhe UJ-në | 422 |
| (D) Konkluzionet në lidhje me Komandën e Përbashkët në vitin 1998..... | 439 |
| ii. Komanda e Përbashkët në vitin 1999..... | 440 |
| (A) Ekzistenca dhe pushteti i Komandës së Përbashkët në vitin 1999 | 440 |
| (B) Mbledhja e mbajtur më 1 qershor 1999 | 456 |
| (C) Përfundime në lidhje me Komandën e Përbashkët në 1999 | 458 |
| 3. Vënia e njërive dhe organeve të MPB-së në varësinë e UJ-së nga prilli 1999..... | 459 |
| a. Argumentet e palëve | 459 |
| b. Procesi i rivartësimit | 461 |
| c. Urdhrat për rivartësim | 463 |
| d. Respektimi i urdhrave për rivartësim | 467 |
| i. Mosrespektim i përgjithshëm i urdhrave për rivartësim | 467 |
| ii. Rastet kur UJ-ja drejtoi forcat e MPB-së | 474 |
| iii. Operacionet e kryera pas urdhrave për rivartësim..... | 476 |
| e. Përfundim | 480 |
| F. BOMBARDIMET E NATO-S | 480 |
| 1. Preludi i bombardimeve të NATO-s..... | 480 |
| 2. Pasqyrë e fushatës së NATO-s | 482 |
| 3. Marrëveshja e Kumanovës | 484 |
| G. PËRFUNDIME | 485 |

I. HYRJJE

1. Aktakuza kundër Slllobodan Millosheviqit, Millan Millutinoviqit, Nikolla Shainoviqit, Dragolub Ojdaniqit dhe Vllajko Stojilkoviqit (Lënda Nr. IT-99-37-I) u konfirmua më 24 maj 1999, ku secili prej të Akuzuarve u akuzua për përgjegjësi në lidhje me akuzat për krime të kryera në Kosovë në vitin 1999. Pas transferimit të Slllobodan Millosheviqit në paraburgim të Tribunalit më 29 qershor 2001, procesi gjyqësor kundër tij nisi më 12 shkurt 2002 në lidhje me aktakuzën e ndryshuar për Kosovën, si dhe në lidhje me aktakuzat për krime të kryera në Bosnjë-Hercegovinë dhe Kroaci.

2. Më pas, Dragolub Ojdaniqi u transferua në paraburgimin e Tribunalit më 25 prill 2002 i pasuar prej Nikolla Shainoviqit më 2 maj 2002, dhe Millan Millutinoviqit më 20 janar 2003. Vllajko Stojilkoviqi kreu vetëvrasje më 13 prill 2002. Më 2 tetor 2003 u konfirmua aktakuza kundër Nebojshta Pavkoviqit, Vladimir Llazareviqit, Vllastimir Gjorgjeviqit dhe Sreten Llukiqit (Lënda Nr. IT-03-70-I), ku ata akuzohen për përgjegjësi në lidhje me të njëjtat krime që pretendohet se u kryen në Kosovë. Vladimir Llazareviqi u transferua në paraburgimin e Tribunalit më 3 shkurt 2005, pasuar prej Sreten Llukiqit më 4 prill 2005, dhe Nebojshta Pavkoviqit më 25 prill 2005.

3. Më 8 korrik 2005 Dhoma Gjyqësore III nxori një vendim që miratonte mocionin e Zyrës së Prokurorit (“Prokuroria”) për bashkimin e çështjeve IT-99-37-PT dhe IT-03-70-PT dhe urdhëronte Prokurorinë që të dorëzonte aktakuzën e përbashkët brenda 15 gushtit 2005.¹ Më tej çështja e përbashkët u numërtua IT-05-87-PT.² Meqenëse në qershor 2006, Vllastimir Gjorgjeviqi ishte në arrati, ai u nda prej procedurës gjyqësore dhe për procesin gjyqësor kundër Millan Millutinoviqit, Nikolla Shainoviqit, Dragolub Ojdaniqit, Nebojshta Pavkoviqit dhe Vladimir Llazareviqit (së bashku, “të Akuzuarit”) Aktakuza e Përbashkët e Ndryshuar për Herë të Tretë (“Aktakuza”) u konfirmua si aktakuza në fuqi. Gjykimi filloi më 10 korrik 2006.³

4. Gjatë procesit gjyqësor dhe në përfundimin e këtij Aktgjykimi, detyrimi thelbësor i Dhomës Gjyqësore ishte: të përcaktonte nëse Prokuroria kishte provuar fajësinë e secilit prej të Akuzuarve në lidhje me secilën prej akuzave. Standardi i vërtetimit, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, përbën një pengesë të lartë për t’u kapërcyer prej Prokurorisë. Gjatë shqyrtimit të provave Dhoma

¹ *Prokurori kundër Millutinoviqit, Shainoviqit dhe Ojdaniqit*, Lënda Nr. IT-99-37-PT dhe *Prokurori kundër Pavkoviqit, Llazareviqit, Gjorgjeviqit dhe Llukiqit*, Lënda Nr. IT-03-70-PT, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Bashkimin e Çështjeve, 8 korrik 2005.

² Vendim i Sekretarit, Lënda Nr. IT-05-87-PT, 11 korrik 2005.

³ Urdhër Zëvendësues i Aktakuzës së Përbashkët të Ndryshuar për Herë të Tretë dhe për Veçimin e Çështjes së Vllastimir Gjorgjeviqit, 26 qershor 2006.

Gjyqësore shpenzoi mjaft energji në analizimin e këtij kushti. Rastësisht, rrëfimi në këtë aktgjykim përmban informacion që mund të ndihmojë në një kuptim më të plotë të ngjarjeve në 1998 dhe 1999. Mirëpo ky aktgjykim nuk është veçse një ndër elementët e një tërësie materialesh prej të cilave historianët do të nxjerrin një dëshmi të plotë historike.

5. Në Vëllimin I të Aktgjykimit, Dhoma parashtron ligjin përkatës për këtë çështje dhe përfundimet e Dhomës në lidhje me strukturat politike dhe kushtetuese të RFJ-së dhe Serbisë, konfliktin e armatosur si subjekt të këtij Aktgjykimi dhe përpjekjet diplomatike për zgjidhjen e konfliktit. Në Vëllimin 2, Dhoma parashtron përfundimet e veta në lidhje me krimet që pretendohet të jenë kryer gjatë periudhës mars-qershor 1999 prej forcave të RFJ-së dhe Serbisë. Në Vëllimin 3, Dhoma nxjerr përfundime në lidhje me përgjegjësinë penale individuale të gjashtë të Akuzuarve. Në Vëllimin 4 përfshihen shtojcat e Aktgjykimit, ndër të cilat një analizë e provave lidhur me viktima konkrete të vrasjeve, të identifikuara me emër.

A. AKTAKUZA

6. Të Akuzuarit akuzohen në bazë të Neneve 7(1) dhe 7(3) të Statutit të Tribunalit (“Statuti”) për rolin e tyre të pretenduar në krimet që thuhet se janë kryer gjatë periudhës 1 janar – 20 qershor 1999 prej forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë (“RFJ”) dhe Republikës së Serbisë (“Serbia”). Konkretisht, të Akuzuarit akuzohen për përgjegjësi në lidhje me dëbimin, krim kundër njerëzimit (pika 1); zhvendosje të dhunshme si “veprime të tjera çnjerëzore”, krim kundër njerëzimit (pika 2); vrasje, krim kundër njerëzimit dhe shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës (pikat 3 dhe 4); dhe përndjekje, krim kundër njerëzimit (pika 5). Sipas Aktakuzës, të Akuzuarit morën pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale për ndryshimin e përbërjes etnike, me qëllim garantimin e vazhdimësisë së kontrollit të autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë mbi krahinën. Më tej Prokuroria pretendon se qëllimi i ndërmarrjes së përbashkët kriminale do të arrihej nëpërmjet një fushate të gjerë ose sistematike terrori ose dhune që përfshinte krime të ndryshme të konkretizuara në secilin prej pikave të Aktakuzës.

7. Aktakuza ndahet në gjashtë kapituj të titulluar përkatësisht: Të Akuzuarit; Pozita e të Akuzuarve; Përgjegjësia Penale Individuale; Akuzat; dhe Akuza të Përgjithshme dhe Konteksti i Akuzave. Gjithashtu Aktakuzës i bashkëngjiten shtatë shtojca me listat e njerëzve që sipas Prokurorisë dihen se janë vrarë në vende të ndryshme në Kosovë.

8. Në kapitullin e titulluar “Të Akuzuarit” jepen hollësi për secilin prej të Akuzuarve dhe një pasqyrë e shkurtër dhe mjaft e saktë e posteve që pretendohet se kishin gjatë periudhës së Aktakuzës: Millutinoviqi ishte President i Republikës së Serbisë prej dhjetorit 1997 deri në dhjetor

2002; Shainoviqi ishte zëvendëskryeministër i RFJ-së prej shkurtit 1994 deri në nëntor 2000; Ojdaniqi ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave (“UJ”) prej nëntorit 1998, dhe në vitin 2000 u emërua ministër i Mbrojtjes Federale; Pavkoviqi ishte komandant i Armatës së Tretë të UJ-së prej dhjetorit 1998 deri në fillim të vitit 2000, dhe pastaj u bë shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së; Llazareviqi ishte komandant i Korpusit të Prishtinës të UJ-së në 1999, dhe në dhjetor 1999 u bë komandat i Armatës së Tretë; dhe Llukiqi ishte shef i Shtabit të Ministrisë së Brendshme serbe (“MPB”) për Kosovën prej majit 1999, dhe pas qershorit 1999 u bë ndihmësshef i Drejtorisë së Policisë për Sigurinë Publike dhe shef i Administratës Kufitare të Policisë Kufitare të Ministrisë së Brendshme serbe në Beograd.

9. Kapitulli vijues i titulluar “Pozita e të Akuzuarve,” ofron më shumë hollësi jo vetëm në lidhje me postet zyrtare të të Akuzuarve, por edhe një përmbledhje të pushtetit dhe kompetencave që pretendohet se u ushtruan nga secili prej tyre.

10. Kapitulli i titulluar “Përgjegjësia Penale Individuale” përmban disa nënndarje. Në të parën Prokuroria qartëson se secili prej të Akuzuarve akuzohet për planifikim, nxitje, urdhërim, kryerje ose ndryshe ndihmë dhe inkurajim në kryerjen e krimeve të përmendura në Aktakuzë. Më tej pohohet se nuk pretendohet se ndonjëri prej të Akuzuarve kreu fizikisht krime, por se nëpërmjet termit “kryerje” është fjala për pjesëmarrjen e tyre në një ndërmarrje të përbashkët kriminale. Sipas Aktakuzës, ndërmarrja e përbashkët kriminale ekzistonte jo më vonë se tetor 1998, dhe përfshiu një numër individësh, ndër të cilët të Akuzuarit. Pretendohet se ndër pjesëmarrësit e ndërmarrjes së përbashkët kriminale përfshiheshin edhe autorët fizikë të krimeve të akuzuara (konkretisht “persona të pidentifikuar të cilët ishin anëtarë të organeve komanduese dhe bashkërenduese dhe anëtarë të forcave të RFJ-së dhe Serbisë”), ose pjesëmarrësit e ndërmarrjes së përbashkët kriminale i zbatuan objektivat e tyre nëpërmjet anëtarëve të forcave të RFJ-së dhe Serbisë ndaj të cilëve kishin kontroll.⁴ Deklarohet se në këto “forca” përfshiheshin si ushtria (UJ), po ashtu edhe policia (MPB), dhe në Aktakuzë argumentohet se së paku një njësi ushtarake dhe një njësi e MPB-së morën pjesë në secilin prej krimeve të akuzuara.⁵ Së fundi, Prokuroria gjithashtu argumenton se të Akuzuarit

⁴ Gjatë argumentimeve të veta në përgjigje të mocioneve të të Akuzuarve për shpallje pafajësie, Prokuroria deklaroi se “duke marrë parasysh vendimin e apelit në çështjen Bërgjanin ... *tani synojmë të procedojmë vetëm mbi bazën e argumentit alternativ*, se këta gjashtë anëtarë të [ndërmarrjes së përbashkët kriminale] përdorën anëtarë të forcave të RFJ-së dhe Serbisë të cilët i kishin në kontroll për kryerjen e dëbimeve, transferimeve të dhunshme, vrasjeve dhe përndjekjeve.” T. 12577 (3 maj 2007) (shkrimi kursiv i shtuar). *Shih edhe* diskutimin më të plotë të kësaj çështjeje në pjesën mbi elementin e dytë fizik të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

⁵ Në paragrafin 20 të Aktakuzës lexohet, “Së paku një njësi e UJ-së dhe një e MPB-së morën pjesë në secilin prej krimeve të renditura në Pikat 1 – 5 të kësaj Aktakuze.” Kjo fjali u shtua në Aktakuzë në përgjigje të vendimeve të Dhomës dhe për tu dhënë të Akuzuarve paralajmërimin e duhur në lidhje me akuzat me të cilat do të përballeshin. *Prokurori kundër Millutinoviqit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-PT, Vendim në lidhje me Mocionet e Mbrojtjes që Pretendojnë Mangësi në Formën e Aktakuzës së Përbashkët të Ndryshuar të Propozuar, 11 maj 2006, paragrafët. 5–6. Mirëpo nuk është e nevojshme që çdo pretendim faktik në aktakuzë të vërtetohet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm për të

janë përgjegjës në bazë të paragrafit 3 të Nenit 7 të Statutit për mosparandalimin ose mosndëshkimin e autorëve të krimeve të cilët ishin vartës të tyre.

11. Kapitulli i mëtejshëm titullohet “Përmbledhje e Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale” dhe ravijëzon pozitat komanduese që pretendohet se kishin të Akuzuarit në strukturat politike, ushtarake dhe/ose të forcave të sigurisë të RFJ-së dhe Serbisë. Aty përsëritet pretendimi për një fushatë të qëllimshme dhe të gjerë ose sistematike të dëbimit të shqiptarëve kosovarë, për krijimin e një atmosfere frike dhe shtypjeje dhe për një fushatë të qëllimshme të shkatërrimit të pronave. Nënndarjet e mëtejshme trajtojnë secilin prej të Akuzuarve në veçanti, duke parashtruar pretendimet për rolet dhe përgjegjësitë e tyre, dhe duke paraqitur disa “fakte” prej të cilëve, sipas pretendimit të Prokurorisë, i vetmi konkluzion që mund të nxirret është pjesëmarrja e të Akuzuarve në krimet e pretenduara. Për secilin prej të Akuzuarve, Aktakuza gjithashtu rendit faktorët prej të cilëve mund të deduktohet se ata kishin synimin e kërkuar kriminal për forma të ndryshme të përgjegjësisë bazuar në paragrafët 1 dhe 3 të Nenit 7.

12. Kapitulli “Akuzat” shtjellon pretendimet kundër të Akuzuarve në pesë pika. Në pikën 1 të Aktakuzës, Prokuroria përshkruan mënyrën e dëbimit të shqiptarëve kosovarë në fillim të vitit 1999 prej 13 komunave dhe qyteteve e fshatrave konkrete të këtyre komunave. Duhet theksuar se këto përshkrime përfshijnë edhe informacion për vrasje, shkatërrim të pronave, vjedhje, dhunë seksuale, rrahje dhe forma të tjera dhune të cilat sipas Prokurorisë kontribuuan në krijimin e një atmosfere frike dhe shtypjeje prej forcave të RFJ-së dhe Serbisë për të lehtësuar dëbimin e popullsisë shqiptare kosovare. Pika 2 “veprime të tjera çnjerëzore” (zhvendosje e dhunshme) u kthehet pretendimeve faktuale të pikës së parë. Pikat 3 dhe 4, vrasje, ofrojnë gjithashtu hollësi faktike thelbësore të një numri akuzash për vrasje në vende të ndryshme në Kosovës. Shumë prej këtyre vendeve dhe incidenteve të veçanta përkohë me ato të përshkruara në pikat 1 dhe 2. Së fundi, në pikën e pestë, përndjekje, Aktakuza pretendon se forcat e RFJ-së dhe Serbisë ndërmorën një fushatë përndjekjesh kundër popullsisë shqiptare kosovare, ndër të tjera, nëpërmjet zhvendosjeve dhe dëbimeve të dhunshme, vrasjeve, dhunës seksuale dhe shkatërrimit pa cak ose dëmtimit të objekteve fetare. Në lidhje me vrasjet, Aktakuza “riakuzon dhe përfshin nëpërmjet referimit” paragrafët e mëparshëm në lidhje me pikat 3 dhe 4, duke i cilësuar këto vrasje konkrete edhe si

konkluduar fajësinë kundër të akuzuarit dhe “faktet materiale” që duhen argumentuar në aktakuzë për t’i ofruar të akuzuarit informacionin e nevojshëm për përgatitjen e mbrojtjes së tij, jo gjithmonë janë domosdoshmërisht fakte që duhen vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm në aktgjykimin përfundimtar. *Shih Prokurori kundër Ntagerura-s dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-99-46-A, Aktgjykim, 7 korrik 2006, f. 58, shënim 356. Rrjedhimisht prania e së paku një njësie të UJ-së dhe së paku një njësie të MPB-së (d.m.th., si MPB po ashtu dhe UJ) në çdo vend krimi nuk është fakt që duhet të ishte vërtetuar prej Prokurorisë për fajësinë në lidhje me çdo vend krimi. Përgjegjësia e çdo të Akuzuari për krime të kryera vetëm prej MPB-së ose vetëm prej UJ-së në një vendndodhje konkrete është shqyrtuar rast pas rasti në Aktgjykim.

përndjekje.⁶ Mirëpo çuditërisht një gjë e tillë nuk është bërë në lidhje me “dëbimin” dhe “zhvendosjen e dhunshme” si formë përndjekjeje dhe rrjedhimisht dëbimet dhe zhvendosjet e dhunshme konkrete të pikave 1 dhe 2 dhe të parashtruara në paragrafin 72, nuk figurojnë në akuza si forma përndjekjeje; por vetëm akuzat e përgjithshme të dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme të afërsisht 800,000 shqiptarëve kosovarë figurojnë si akuzë për përndjekje në pikën 5.⁷ Ndër akuzat e përndjekjes nuk ka akuza konkrete të dhunës seksuale, veç atyre që përmenden përgjithësisht në paragrafin 27 dhe në paragrafin 72. Në lidhje me shkatërrimin pa shkak ose dëmtimin e objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë si formë përndjekjeje, në paragrafin 77(d) të Aktakuzës renditen dëmtimi ose shkatërrimi i xhamive në 14 vendndodhje anembanë Kosovës.

13. Në kapitullin e parafundit të titulluar “Akuza të Përgjithshme”, thjesht pretendohet se gjatë gjithë periudhës përkatëse të Aktakuzës në Kosovë ekzistonte konflikt i armatosur dhe se veprimet e mosveprimet e akuzuara si krime kundër njerëzimit, ishin pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik kundër popullsisë civile shqiptare kosovare.

14. Së fundi, në kapitullin e titulluar “Rrethanat dhe Konteksti i Akuzave”, Aktakuza ofron të dhëna historike, gjeografike, kushtetuese dhe politike si dhe një përshkrim të gjerë të konfliktit midis Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe forcave të RFJ-së dhe sulmeve ajrore të NATO-s.

B. HISTORIA PROCEDURALE

15. Në maj dhe qershor 2006 palët dorëzuan dosjet e tyre paragjyqësore. Prokuroria gjithashtu dorëzoi listat e dëshmitarëve dhe të provave të saj materiale në maj 2006. Pas një periudhe të paraburgimit paragjyqësor, për të Akuzuarit u miratua lirim i përkohshëm në 2005. Më 26 maj 2006 Dhoma pezulloi lirimimin e përkohshëm të të Akuzuarve dhe u kërkoi të ktheheshin në Njësinë e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara brenda 4 korrikut 2006, në pritje të fillimit të gjykimit.⁸

16. Më 7 korrik 2006, Dhoma mbajti një konferencë paragjyqësore për çështjen. Pas konferencës paragjyqësore, më 11 korrik 2006, Dhoma nxori “Vendimin në lidhje me Zbatimin e

⁶ Aktakuza, paragrafi 76.

⁷ T. 12778–12779 (18 maj 2007) (“Së fundi, në pikën e pestë, ‘Përndjekje,’ në paragrafin 77 të aktakuzës lexohet se të akuzuarit janë përgjegjës për një fushatë përndjekjesh kundër popullatës shqiptare kosovare. Megjithëse ky paragraf përgjithësisht përmend dëbimin dhe transferimin e dhunshëm si mënyra të kryerjes së përndjekjes së bashku me vrasjen, dhunën seksuale dhe shkatërrimin pa cak ose dëmtimin e objekteve kulturore, Dhoma thekson se akuzat konkrete të transferimit të dhunshëm dhe dëbimit që janë në paragrafin 72, nuk përfshihen nëpërmjet referimit në pikën 5. Dhoma ia kujtoi këtë fakt Prokurorisë në gjyq më 30 tetor, mirëpo Prokuroria nuk ndërmoi asnjë veprim, dhe rrjedhimisht akuzat për përndjekje në pikën 5 nuk përfshihen nëpërmjet përshkrimit të dëbimit dhe transferimit të dhunshëm të shqiptarëve kosovarë në paragrafin 72.”).

⁸ Urdhër për Pezullimin e Lirimit të Përkohshëm të Çdo të Akuzuari, 26 maj 2006

Rregullës 73bis” në të cilin duke zbatuar paragrafin (D) të Rregullës 73bis të Rregullores së Procedurës dhe Provave të Tribunalit (“Rregullorja”), urdhëroi si vijon:

Deri në një urdhër tjetër të Dhomës, Prokuroria mund të paraqesë prova në lidhje me të gjitha vendet e krimeve dhe incidentet e renditura në paragrafin 72; dhe të gjitha vendet e krimeve dhe incidentet e renditura në paragrafin 75, përveç nënparagrafëve (a), (e), dhe (j), (duke përfshirë paragrafin (j)(i) ku parashtrihen akuzat në lidhje me Reçakun, Padalishtën dhe burgun e Dubravës.⁹

Në këtë mënyrë Dhoma nuk lejoi paraqitjen e provave në lidhje me secilin prej vendeve të krimeve në Reçak, Padalishtë dhe burgun e Dubravës, me arsyetimin se çfarë pretendohet se ndodhi atje, në ndryshim nga vendet e tjera të vrasjeve, nuk kishte lidhje me vendet prej të cilave pretendohet se njerëzit u shpërngulën forcërisht, dhe rrjedhimisht nuk bën pjesë në “llojin ose subjektin” e aktakuzës së Prokurorisë.¹⁰ Rezultati ligjor i këtij vendimi është se akuzat e Aktakuzës në lidhje me paragrafët 75(a), (e) dhe (j) ende ekzistojnë dhe të Akuzuarit janë ende të akuzuar në lidhje me to. Në fund të Aktgjykimit, Dhoma do t’i urdhërojë palët të paraqesin parashtrimet e duhura në lidhje me mënyrën e procedimit për sa u përket akuzave ekzistuese.

17. Gjykimi filloi më 10 korrik 2006. Të nesërmen Dhoma lëshoi një urdhër për rregullimin e disa aspekteve procedurale dhe të provave.¹¹ Kushti i përkohshëm i urdhrit që nxjerrja e materialeve të bëhej gjatë pyetjeve nga pala kundërshtarë, më vonë u ndryshua bazuar në marrëveshjen e palëve që nxjerrja e një materiali të tillë të bëhej me nisjen e marrjes në pyetje të një dëshmitari prej palës për të cilën ai dëshmon.¹²

18. Të Akuzuarit u liruan përkohësisht gjatë pushimeve verore më 2006.¹³ Megjithëse Dhoma refuzoi lirimin e përkohshëm të të Akuzuarve gjatë pushimeve dimërore më 2006,¹⁴ më vonë miratoi lirim të përkohshëm për disa të Akuzuar, për arsye humanitare.¹⁵ Gjatë procesit gjyqësor u

⁹ Vendim në lidhje me Zbatimin e Rregullës 73bis, 11 korrik 2006, para. 13(a).

¹⁰ Vendim në lidhje me Zbatimin e Rregullës 73bis, 11 korrik 2006, para. 10-13, *shih edhe* Vendim që Rrëzon Kërkesën e Prokurorisë për Lejimin e Paraqitjes së Apelit të Rregullës 73 bis 30 gusht 2006.

¹¹ Urdhër mbi Procedurën dhe Provat, 11 korrik 2006.

¹² Vendim mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Urdhrit mbi Procedurën dhe Provat, 16 gusht 2006.

¹³ Vendim mbi Mocionin e Përbashkët për Lirimin e Përkohshëm me Kusht Gjatë Pushimeve Verore, 1 qershor 2006.

¹⁴ Vendim mbi Mocionin e Përbashkët për Lirim të Përkohshëm Gjatë Pushimeve Dimërore, 5 dhjetor 2006.

¹⁵ *Shih për shembull*, Vendim mbi Mocionin e Millutinoviçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 7 dhjetor 2007; Vendim mbi Mocionin e Llazareviçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 18 qershor 2007; Vendim mbi Mocionin e Pavkoviçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht 18 qershor 2007, paragrafi. 6; Vendim mbi Mocionin e Shainoviçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 7 qershor 2007; Vendim mbi Mocionin e Ojdaniçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 4 korrik 2007; Vendim mbi Mocionin e Pavkoviçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 14 mars 2008; Vendim mbi Mocionin e Shainoviçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 4 prill 2008; Vendim mbi Mocionin e Llazareviçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 15 prill 2008; Vendim mbi Mocionin e Ojdaniçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, 10 korrik 2008; *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-AR65-6, Vendim në lidhje me “Apelin e Prokurorisë mbi Mocionin e Llazareviçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht me Datë 26 shtator 2008”, 23 tetor 2008

dorëzuan disa apele kundër refuzimit të lirimit të përkohshëm, të cilët Dhoma e Apelit i hodhi poshtë, me përjashtim të një rasti.¹⁶

19. Në disa raste, Dhoma mori në shqyrtim dhe rrëzoi mocione për pezullimin e procedurës ose për veçimin e çështjes së një të Akuzuari konkret, Pavkoviçit, prej procedurës.¹⁷ Gjithashtu Dhoma rrëzoi tri mocione të Mbrojtjes së Ojdaniqit për pezullimin e procedurës për shkak të pretendimit të saj të pamundësisë për hetime në terren në Kosovë. Pas përpjekjeve të konsiderueshme nga ana e Dhomës dhe Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (“UNMIK”) për mundësimin e këtyre hetimeve, Mbrojtja e Ojdaniqit refuzoi njëanshmërisht të vazhdonte dialogun me UNMIK-un në lidhje me masa të tjera për kryerjen e hetimeve.¹⁸

20. Dhoma bëri përpjekje si gjatë fazës paragyqësore, po ashtu edhe gjatë gjykimit për mundësimin e marrëveshjeve midis palëve lidhur me faktet materiale të Aktakuzës. Megjithëse nuk u arritën marrëveshje lidhur me faktet materiale, palët në fakt ranë dakord për pranimin e dokumenteve të shumta.¹⁹

21. Gjatë paraqitjes së çështjes prej Prokurorisë, Dhoma mori dëshmi prej 117 dëshmitarëve *viva voce* dhe/ose sipas Rregullave 92 *bis*, *ter*, dhe *quater*. Gjithashtu Dhoma pranoi dokumente të shumta në sallën gjyqësore me kërkesë të Prokurorisë.²⁰ Dhoma lëshoi shumë vendime për ecurinë e paraqitjes së çështjes prej Prokurorisë, lidhur me urdhërparaqitjet, dëshmitë e marra nëpërmjet videokonferencave, masat mbrojtëse, publikimin e materialit, dhe ndryshimin e listës së

¹⁶ *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-AR65.2, Vendim mbi Apelimin e Ndërkohshëm të Refuzimit të Lirimit të Përkohshëm Gjatë Pushimeve Dimërore 14 dhjetor 2007; *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-AR65.5, Vendim mbi “Apelin e Mbrojtjes së Llazareviçit Bazuar në Rregullën 116 *bis* Kundër Refuzimit të Lirimit të Përkohshëm me Kusht prej Dhomës Gjyqësore” 18 dhjetor 2007; *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda nr. IT-05-87-AR65.4, Vendim mbi “Apelin e Sreten Lluqiçit Bazuar në Rregullën 116 *bis* Kundër Refuzimit të Lirimit të Përkohshëm me Kusht prej Dhomës Gjyqësore 18 dhjetor 2007; *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-AR65.3, Vendim mbi “Apelin e Pavkoviçit Bazuar në Rregullën 116 *bis* Kundër Vendimit të lidhje me Mocionin e Pavkoviçit për Lirim të Përkohshëm me Kusht, me datë 12 dhjetor 2007,” 18 dhjetor 2007.

¹⁷ *Shih për shembull.*, *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-PT, Vendim mbi Mocionin e Pavkoviçit për Shfuqizimin e Bashkimit të Çështjeve ose Ndryshe për Miratimin e Veçimit të Çështjes, 7 shtator 2005, f. 4; *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-PT, Vendim mbi Mocionin e Nebojsa Pavkoviçit për Shtyrjen e Nisjes së Procesit Gjyqësor ose Ndryshe për Rishikimin dhe Miratimin e Mocionit për Veçimin e Çështjes, 2 dhjetor 2005, f. 2; *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-PT, Vendim i Dytë mbi Mocionet për Shtyrjen e Datës së Propozuar për Nisjen e Procesit Gjyqësor, 28 prill 2007, paragrafët 2, 6; Vendim mbi Mocionin e Pavkoviçit për Veçim të Pjesshëm të Çështjes, 27 shtator 2007.

¹⁸ Vendim mbi Mocionin e Ojdaniqit për Pezullimin e Procesit, 9 qershor 2006, para. 4–6; Vendim mbi Mocionin e Dytë të Ojdaniqit për Pezullimin e Procesit, 19 tetor 2006, para 9–11; Vendim mbi Mocionin e Tretë të Ojdaniqit për Pezullimin e Procesit, 27 gusht 2007, para 38-44.

¹⁹ *Shih për shembull.*, Urdhër i Dytë mbi Fakte të Pranuara, 15 shkurt 2007; Urdhër për Parashtrime mbi Njoftimin e Përbashkët të Prokurorisë dhe Mbrojtjes Lidhur me Përkthimin e Provave Materiale të Pranuara si Prova me Marrëveshje, 31 korrik 2007.

²⁰ *Shih* Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranim Dëshmie në Lidhje me Philip Coe, 23 mars 2007; Vendim mbi Mocionin e Tretë të Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 23 mars 2007; Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave Dokumentare, 10 tetor 2006.

dëshmitarëve dhe provave materiale të Prokurorisë. Dy prej këtyre shumë vendimeve diskutohen përmbledhtazi në paragrafin vijues.

22. Që prej fillimit të procesit Prokuroria kërkoi pranimin si prova të dy raporteve mbi të drejtat e njeriut—*As Seen, As Told*(*Siç kemi parë dhe dëgjuar*) dhe *Under Orders*(*Nën Urdhra*)—të cilët u përpiluan prej organizatave ndërkombëtare dhe ku përfshiheshin rrëfime bazuar në thëniet e të tretëve në lidhje me ngjarjet në Kosovë gjatë periudhës së Aktakuzës. Raportet bazoheshin në deklaratat të shqiptarëve kosovarë të paidentifikuar dhënë punonjësve në terren të organizatave, të cilët i dokumentuan deklaratat dhe ua dorëzuan eprorëve të tyre, të cilët i redaktuan dhe i përshtatën për t'i përfshirë në raporte. Dhoma ushtroi kompetencën e saj gjyqësore duke mos i pranuar si prova, me arsyetimin se Prokuroria nuk kishte provuar në masë të mjaftueshme treguesin e besueshmërisë së tyre si prova dokumentare mbi bazë thëniesh prej të tjerëve. Dhoma gjithashtu vuri re se disa prej materialeve të raporteve bazoheshin mbi dokumente të tjera që ishin burim më i mirë dhe më i drejtpërdrejtë informacioni, disa prej të cilave do të paraqiteshin gjatë procesit gjyqësor.²¹

23. Afër fundit të paraqitjes së provave prej Prokurorisë, Dhoma rrëzoi mocionin e Prokurorisë për përfshirjen e Wesley Clark-ut në listën e vet të dëshmitarëve të Rregullës 65 *ter*; refuzimi u bazua mbi faktin se kufizimet e përcaktuara prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës në lidhje me mënyrën e dhënies së dëshmisë prej Clark-ut – p.sh kufizime në aspekte të marrjes në pyetje nga pala kundërshtarë, bënë që vlera provuese e dëshmisë së tij të propozuar të zhvlerësohej ndjeshëm prej nevojës së garantimit të të drejtës së të Akuzuarve për gjykim të drejtë.²² Në këtë pikë Dhoma e Apelit mbështeti vendimin e Dhomës e Gjyqësore.²³

24. Dhoma vendosi të administronte fazën e paraqitjes së provave prej Prokurorisë duke i caktuar asaj një afat kohor për paraqitjen e provave të saj kryesore. Megjithëse iu caktuan 260 orë për paraqitjen e provave,²⁴ Prokuroria shfrytëzoi vetëm 166 orë.²⁵

²¹ Vendim mbi Dëshmitë e Paraqitura Nëpërmjet Sandra Mitchell-it dhe Frederick Abrahams-it, 1 shtator 2006, para 19-25.

²² Vendim i Dytë mbi Mocionin e Prokurorisë për Leje për Ndryshimin e Listës së vet Të Dëshmitarëve sipas Rregullës 65 *ter* për Shtimin e Wesley Clark-ut, 16 shkurt 2007.

²³ *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-AR73.1, Vendim mbi Apelimin e Ndërkohshëm Kundër Vendimit të Dytë që Rrëzon Kërkesën e Prokurorisë për Shtimin e Gjeneralit Wesley Clark në Listën e vet të Dëshmitarëve të Rregullës 65 *ter* 20 prill 2007; Vendim mbi Kërkesën e Prokurorisë për Lejimin e Apelimit të Ndërkohshëm të Vendimit të Dytë mbi Shtimin e Wesley Clark-ut në Listën e Rregullës 65 *ter*, 14 mars 2007.

²⁴ Vendim mbi Shfrytëzimin e Kohës. 9 tetor 2006, f. 6; Raport mbi Kohën për nëntorin 2006, 11 dhjetor 2006, f 1-2, shënim 3.

²⁵ *Shih* Raport mbi Shfrytëzimin e Kohës për mars 2007, prill 2007; Raport mbi Shfrytëzimin e Kohës për maj 2007. 18 qershor 2007.

25. Më 1 maj 2007, Prokuroria përfundoi paraqitjen e provave dhe Dhoma ftoi menjëherë Mbrojtjen që të paraqiste parashtrimet bazuar në Rregullën 98 *bis*. Gjatë datave 1–7 maj Dhoma dëgjoi parashtrime gojore prej secilit të Akuzuar ku u kërkua që Dhoma t'i shpallte të pafajshëm për të pesë pikat në Aktakuzë, dhe përgjigjet e Prokurorisë ndaj këtyre kërkesave. Dhoma u tërhoq për shqyrtimin e çështjes dhe u rikthye në seancë më 18 maj 2007 për të dhënë verdiktin gojor në lidhje me mocionet. Dhoma rrëzoi secilin mocion për verdiktin e pafajësisë në lidhje me çdo pikë.²⁶

26. Bazuar në një urdhër të Dhomës, të Akuzuarit dorëzuan listat e tyre të dëshmitarëve dhe provave materiale të Rregullës 65 *ter* më 15 qershor 2007.²⁷ Ata gjithashtu bënë disa kërkesa të cilat u miratuan, për zgjatjen e afateve për përmbushjen e detyrimeve të tyre në lidhje me publikimin e materialit përsa u përket aktekspertizave të dëshmitarëve ekspertë.²⁸

27. Në konferencë para fillimit të paraqitjes së çështjes prej Mbrojtjes, mbajtur më 22 qershor 2007, Dhoma pasi parashtroi mënyrat e mundshme nëpërmjet të cilave Mbrojtja mund të zvogëlonte përlllogaritjen e saj kohore në lidhje me paraqitjen e provave, si për shembull shfrytëzimi i Rregullave 92 *bis* dhe *ter*, dorëzimi i dokumenteve në sallën gjyqësore, dhe marrëveshje për pranimin e dokumenteve, shqiptoi vendimin gojor duke i caktuar Mbrojtjes 240 orë për paraqitjen e provave.²⁹

28. Më 6 gusht 2007 filloi paraqitja e provave prej Mbrojtjes së Millutinoviçit³⁰ dhe ekipet e tjera të Mbrojtjes i paraqitën provat sipas renditjes së të Akuzuarve në Aktakuzë. Dhoma dëgjoi 123 dëshmitarë gjatë paraqitjes së provave prej Mbrojtjes, dhe i Akuzuari Llazareviç ishte i vetmi që kreu mbrojtjen e vet. Gjithashtu Dhoma pranoi dokumente të shumta në sallën gjyqësore bazuar në mocionet e Mbrojtjes.³¹

²⁶ T. 12771–12808 (18 maj 2007).

²⁷ Urdhër mbi Përfundimin e Paraqitjes së Provave prej Prokurorisë, Bazuar në Rregullën 98 *bis*, dhe Parashtrimet e Mbrojtjes Bazuar në Rregullën 65 *te*, 5 mars 2007.

²⁸ *Shih për shembull*, Urdhër Lidhur me Publikimin e Aktekspertizave, 3 gusht 2007; Urdhër i Dytë Lidhur me Publikimin e Aktekspertizave, 11 shtator 2007.

²⁹ T. 12821–12848 (22 qershor 2007). Gjatë procedimit të çështjes, Mbrojtja e Millutinoviçit harxhoi afërsisht 23 orë në paraqitjen e argumenteve të veta, Mbrojtja e Shainoviçit 20 orë, Mbrojtja e Ojdaniçit 40 orë, dhe Mbrojtja e Pavkoviçit më pak se katër orë. Vendim mbi Shfrytëzimin e Kohës së Mbetur për Fazën e Mbrojtjes në Procesin Gjyqësor, 21 nëntor 2007. Dhoma shprehu shpresën se të Akuzuarit do të arrinin në marrëveshje midis tyre për ndarjen përfundimtare të kohës për përdorim. T. 12847–12848 (22 qershor 2007), T. 17629–17639 (25 tetor 2007). Mirëpo më 21 nëntor 2007, Dhoma lëshoi një urdhër për caktimin e kohës për përdorim për ekipet e Llazareviçit dhe Llukiqit, të cilët shpenzuan përkatësisht 75 dhe 79 orë. Vendim mbi Shfrytëzimin e Kohës së Mbetur për Fazën e Mbrojtjes në Procesin Gjyqësor, 21 nëntor 2007; Raport mbi Shfrytëzimin e Kohës në Periudhën e Procesit Gjyqësor deri më 30 prill 2008, 16 maj 2008.

³⁰ Vendim mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Shtyrjen e Datës së Procesit Gjyqësor, 23 maj 2007.

³¹ *Shih për shembull*, Vendim mbi Kërkesën e Millutinoviçit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore 19 shtator 2007; Vendim mbi Kërkesën e Shainoviçit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 4 shtator 2007; Vendim mbi Kërkesën e Ojdaniçit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 25 tetor 2007; Vendim mbi Mocionin e Parë të Përsëritur të Pavkoviçit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 27 shtator 2007;

29. Gjatë paraqitjes së provave prej Mbrojtjes, Mbrojtja e Ojdaniqit paraqiti kundërshtime konkrete në lidhje me dy raporte që pretendohet se i ishin dërguar Shtabit të Komandës së Lartë prej Armatës së Tretë gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Këto raporte mbanin datat 25 maj dhe 4 qershor 2009 dhe kishin të bënin me veprime kriminale të anëtarëve të MPB-së në Kosovë; thelbi i kundërshtimeve ishte se raportet ishin falsifikuar dhe ishin përfshirë në mënyrë mashtrore në ditarin e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe arkivat e UJ-së. Më në fund Dhoma lejoi paraqitjen e provave të hollësishme në lidhje me këtë çështje, ndër të cilat edhe dëshminë e një eksperti grafik.³²

30. Pas përfundimit të paraqitjes së provave prej Mbrojtjes së Llukiqit më 21 prill 2008,³³ Dhoma dëgjoi disa dëshmitarë të përbashkët ekspertë, dëshmitë e të cilëve përfunduan më 16 maj 2008.³⁴

31. Gjatë 19 - 21 majit, Dhoma dëgjoi dëshminë e Millan Gjakoviqit, të cilin e ftoi për dhënie dëshmie duke u bazuar në Rregullën 98.³⁵ Më 8 dhe 9 korrik 2008 dëshmoi Aleksandar Dimitrijeviqi në bazë të një thirrjeje për paraqitje, por vetëm pasi Kryetari i Tribunalit e raportoi Republikën e Serbisë në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara për mosdorëzimin e thirrjes dëshmitarit.³⁶ Dhoma ftoi Christopher Hill-in dhe Boris Mayorski-n, dy prej anëtarëve të treshes negociues në bisedimet e paqes në Rambujé/ Rambouillet dhe Paris në shkurt dhe mars 1999, për të dëshmuar me qëllim që të përvijohet një tablo sa më e plotë e rrethanave të dështimit të bisedimeve; gjithsesi Dhoma nuk mundi të sigurojë praninë e tyre.³⁷

Vendim mbi Mocionin e Llazareviqit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 16 janar 2008; Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Llukiqit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 11 qershor 2008; Vendim mbi Mocionin e Llukiqit për Rishikim të Vendimit të Dhomës Gjyqësore mbi Mocionin për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore dhe Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjeve Gjyqësore Përfundimtare, 2 korrik 2008.

³² Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Ojdaniqit dhe Llukiqit për Thirrjen e Zhivoin Aleksiqit dhe Dushan Mlladenovskit, 3 prill 2008; Vendim mbi Kundërshtimin Bazuar në Rregullën 94 *bis* ndaj Ekspertit Grafik Zhivoin Aleksiq, 17 prill 2008; Vendim mbi Mocionin e Pavkoviqit për Thirrjen e Ekspertit Grafik; *shih edhe* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (varianti publik), paragrafët. 245, 246; P1725 Kërkesë e Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 4 qershor 1999); P1459 (Raport i Armatës së Tretë mbi mosbindjen e organeve të MPB-së, 25 maj 1999), gjithashtu e pranuar si 3D1106

³³ T. 25754–25755 (21 prill 2008)

³⁴ T. 26346 (16 maj 2008)

³⁵ Letër e Kryegjykatësit për Millan Gjakoviqin, 18 mars 2008.

³⁶ Thirrje Bazuar në Rregullat 54 dhe 98, 13 maj 2008; Urdhër për qeverinë e Republikës së Serbisë; Letër e Kryetarit të Tribunalit për Kryetarin e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, 17 qershor 2008 (dorëzuar më 23 qershor 2008); Thirrje Bazuar në Rregullat 54 dhe 98, 25 qershor 2008; Urdhër për qeverinë e Republikës së Serbisë, 25 qershor 2008; Urdhër për të Dëshmuar nëpërmjet Videokonferencës për Aleksandar Dimitrijeviqin dhe Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për t'a intervistuar Para Dhënies së Dëshmisë prej tij, 1 korrik 2008.

³⁷ T. 26573 (21 maj 2008); Letër e Kryegjykatësit për Christopher Hill-in, 16 prill 2008 (dorëzuar më 18 prill 2008); Letër e Kryegjykatësit për Boris Mayorski-n, 16 prill 2008 (dorëzuar më 18 prill 2008).

32. Palët nuk paraqitën kërkesë për paraqitjen e kundërprovave prej Prokurorisë dhe Mbrojtjes³⁸ Ata i dorëzuan dosjet e tyre përfundimtare më 15 korrik 2008.³⁹ Dhoma dëgjoi argumentet përmbyllëse gjatë periudhës 19-27 gusht 2008.⁴⁰

C. METODOLOGJIA NË LIDHJE ME PROVAT

33. *Dëshmitarët.* Në këtë Tribunal, Dhoma Gjyqësore nuk është organ hetimor. Hetimi është në duar të Prokurorisë. Megjithëse gjykatësit kanë kompetencë që të urdhërojnë palët për paraqitjen e provave shtesë, dhe ata vetë të thërresin dëshmitarë, kjo kompetencë mund të ushtrohet vetëm në një nivel të kufizuar prej Dhomës Gjyqësore në mungesë të një komponenti hetimor nën kontrollin e saj. Vetëm në rastet kur Dhoma mendon se çështjet e ngritura prej palëve mund të shqyrtohen në mënyrë të efektshme nëpërmjet marrjes në pyetje të një dëshmitari që nuk është thirrur prej palëve, ajo mund ta përdorë këtë kompetencë. Thuajse nuk ka të ngjarë që nëpërmjet ushtrimit të kësaj kompetence, Dhoma të shtronte themelin e përfundimeve më të qenësishme për çdo procedim penal në këtë Tribunal. Në rastin konkret, përfundimet në këtë Aktgjykim bazohen thuajse tërësisht në provat që palët kanë vendosur t'i paraqesin Dhomës.

34. Prova të dobishme plotësuese u ofruan prej dy dëshmitarëve të thirrur prej Dhomës; Millan Gjakoviq dhe Aleksandar Dimitrijeviq. Gjakoviqi u thirr prej kësaj Dhome Gjyqësore për shkak të një kundërshtimi ndaj autenticitetit dhe besueshmërisë së procesverbaleve të mbajtura me shkrim dore të takimeve të një grupi figurash të shquara politike dhe oficerëve të lartë të ushtrisë dhe policisë që quhej “Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë”. Komanda e Përbashkët diskutohet në hollësi në një pjesë vijuese të këtij Aktgjykimi. Gjakoviqi mbajti një procesverbal me shkrim dore të ngjarjeve dhe deklaratave në këto mbledhje. Ky nuk është veçse një prej një sasive të habitshme dokumentesh vërtetësia dhe besueshmëria e të cilve u vu në pikëpyetje gjatë procesit gjyqësor. Dimitrijeviqi ishte oficer i lartë i UJ-së i cili sipas dokumentacionit, veçanërisht sipas procesverbalit të Kolegjiumit të shefit të Shtabit të UJ-së, herë pas here kishte shprehur kritika në lidhje me veprimet e Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë në Kosovë dhe në lidhje me ndërhyrjet e pretenduara të politikanëve të lartë në komandimin e ushtrisë. Ai u hoq nga posti i tij si shef i Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së në vigjilje të fillimit të bombardimeve të NATO-s, më 23 mars 1999. Duke marrë parasysh dijenitë e tij të disa aspekteve

³⁸ Urdhër mbi Dorëzimin e Kërkesave për Kundërprova të Prokurorisë Bazuar në Rregullën 85, 18 prill 2008; Urdhër mbi Procedurën e Mbylljes së Procesit, 2 maj 2008, paragrafi 4.

³⁹ *Shih për shembull.*, Njoftim konfidencial i Mbrojtjes së Llukiqit për Dorëzimin e Korrigjuesit të Dosjes Gjyqësore Përfundimtare të Mbrojtjes, 18 korrik 2008; Mocion i Mbrojtjes së Llukiqit për Zëvendësimin e Variantit Publik të Redaktuar të Dosjes Gjyqësore Përfundimtare, 7 gusht 2008.

⁴⁰ Urdhër mbi Procedurën e Mbylljes së Procesit, 2 maj 2008. Ky urdhër u shfuqizua dhe u caktuan data të reja. T. 26767 (9 korrik 2008).

kundërthënëse që kanë lidhje me thelbin e çështjes, Dhoma gjykoi se dhënia e dëshmisë prej tij do të ndihmonte vlerësimin e provave të paraqitura në lidhje me implikimin e tij në këto çështje.

35. *Rregullat themelore.* Gjatë tërë procesit gjyqësor Dhoma ka zbatuar Rregullën 89 të Rregullores si dhe tërësinë e konsiderueshme të jurisprudencës në lidhje me çështjet e provave, zhvilluar prej Tribunalit që prej themelimit të tij. Në rastin e zbrazëtisë ligjore, Dhoma ka zbatuar ato rregulla provash që i përshtaten më së miri zgjidhjes së drejtë të problemeve shqyrtuar prej saj, në përputhje me frymën e Statutit dhe parimet e përgjithshme të së drejtës. Dhoma pranoi prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta, të tilla si dëshmi gojore, prova dokumentare, dhe deklaratat me shkrim në vend të dëshmime gojore, bazuar në Rregullat 92 *bis*, 92 *ter*, dhe 92 *quater*.

36. *Pranueshmëria dhe pesha.* Provat janë relevante ose kanë lidhje nëqoftëse prirjen të bëjnë pak a shumë të ngjarë ekzistencën e një fakti ndikues në vërtetimin e një aspekti, krahasuar me rastin e mungesës së këtyre provave.⁴¹ Pesha ose rëndësia konsiston në vlerësimin cilësor të vlerës provuese që Dhoma Gjyqësore i atribuon një prove të veçantë në lidhje me faktet që diskutohen në këtë çështje. Pesha që u atribuohet provave përcaktohet prej një sërë faktorësh dhe Dhoma mund t'u japë provave peshën që gjykon të përshtatshme. Gjithashtu duhet theksuar se pranimi i një prove natyrisht përçon kumtin se Dhoma e gjykoi relevante dhe me vlerë provuese. Në diskutimin e vet përfundimtar sipas Rregullës 87, Dhoma u akordoi peshën e duhur provave të pranuar gjatë procesit gjyqësor në kuadrin e krejt dokumentacionit gjyqësor, pavarësisht prej paraqitësve të provave.⁴²

37. *Konfirmimi.* Dhoma e Apelit ka konkluduar se dëshmia e një dëshmitari të vetëm në lidhje me një fakt material nga pikëpamja ligjore nuk ka nevojë për konfirmim.⁴³ Mirëpo në rrethana të tilla Dhoma Gjyqësore ka shqyrtuar imtësisht dëshminë para se ta përdorë në një masë vendimtare. Dëshmitë e pranuar pa u ballafaquar me pyetje të palës kundërshtare, si p.sh. dëshmitë e pranuar

⁴¹ *Shih Prokurori k. Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-AR73.2, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm Bazuar në Rregullën 92*bis*(C), 7 qershor 2002, paragrafi 35. ("provat janë të pranueshme vetëm nëse janë relevante dhe janë relevante vetëm nëse kanë vlerë provuese, premisa të përgjithshme të nënkuptuara në Rregullën 89(C)"); *shih edhe Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Urdhër mbi Procedurën dhe Provat, 11 korrik 2006 (ndryshuar prej "Vendim mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Urdhrit mbi Procedurën dhe Provat," 16 gusht 2007).

⁴² *Shih Prokurori k. Limajt dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-03-66-T, Aktgjykim, 30 nëntor 2005, para. 10; *Prokurori k. Haliloviqit*, Lënda Nr. IT-01-48-T, Aktgjykim, 16 nëntor 2005, para. 14; *Prokurori k. Bllagojeviqit dhe Jokiqit*, Lënda Nr. IT-02-60-T, Aktgjykim, 17 janar 2005, para. 20; *mirëpo shih Prokurori k. Simiqit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-95-9-T, Aktgjykim, 17 tetor 2003, para. 18; *Prokurori k. Naletiliqit dhe Martinoviqit*, Lënda Nr. IT-98-34-A, Aktgjykim, 3 maj 2006, para. 9; *Prokurori k. Vasileviqit*, Lënda Nr. IT-98-32-T, Aktgjykim, 29 nëntor 2002, para. 13; *Prokurori k. Kërnojelacit*, Lënda Nr. IT-97-25-T, Aktgjykim, 15 mars 2002, para. 68; *Prokurori k. Kunaracit dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-96-23-T & IT-96-23/1-T, Aktgjykim, 22 shkurt 2001, para. 560; *shih. Prokurori k. Haxhihasanoviqit dhe Kuburës*, Lënda Nr. IT-01-47-A, Aktgjykim, 22 prill 2008, para. 71

⁴³ *Shih Prokurori k. Tadiqit*, Lënda Nr. IT-94-1-T, Arsyetim dhe Aktgjykim, 7 maj 1997, paragrafët. 535–539; *Prokurori k. Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-A, Aktgjykim, 24 mars 2000, para. 62

në bazë të Rregullës 92 *quater*, u përdorën vetëm nëqoftëse konfirmoheshin prej provave të tjera të paraqitura në gjyq.⁴⁴ Në konfirmim përfshihen dëshmi të dhëna nga dëshmitarë të tjerë, prova dokumentare ose prova zanore apo filmike.

38. *Dëshmitë e bazuara në thënie të dëgjuara prej të tjerëve.* Dëshmia bazuar në thënie të dëgjuara prej të tjerëve, tradicionalisht përkufizohet si deklaratë jashtë gjyqit që ofrohet si provë dhe mund të jetë në formën e dëshmisë së dhënë me gojë ose dokument. Thëniet e dëgjuara janë të pranueshme bazuar në Rregullën 89(C), me kusht që të jenë relevante dhe të kenë vlerë provuese dhe gjithashtu që vlera provuese të mos zhvlerësohet ndjeshëm prej nevojës për garantimin e një gjykimi të drejtë sipas kushteve të Rregullës 89(D). Pamundësia e palëve për t'i bërë pyetje dhënësit të deklaratës së thënieve, niveli i zbehjes së efektit të deklaratës (për shembull, thënie nga burim i dytë apo i tretë), dhe “rrethanat pafundësisht të ndryshueshme të dëshmimeve mbi bazën e thënieve” janë marrë të tëra parasysht prej Dhomës në përcaktimin e peshës së dëshmimeve të tilla.⁴⁵ Dhoma i ka gjykuar dëshmitë mbi bazën e thënieve, me më shumë rezervë se dëshmitë shqisore. Ky faktor ndër të tjera kishte lidhje me provat e nxjerra prej deklaratave të katër dëshmitarëve të mundshëm, të cilët vdiqën para se të mund të dëshmonin në gjyq: Antonio Russo, Ibrahim Rugova, Halil Morina, dhe Sadik Januzi. Për më tepër, Dhoma nuk u mbështet në deklaratat e Momçillo Perishiqit mbi bazën e thënieve të të tjerëve, kur ato u raportuan nëpërmjet dëshmitarit Ratimir Taniq.⁴⁶

39. *Prova rrethanore.* Prokuroria mund të përmbushë detyrimin e vërtetimit nëpërmjet provave të drejtpërdrejta dhe rrethanore, në përputhje me parimin e parashtuar në *Prokurori k. Delalijit dhe të tjerëve*:

⁴⁴ *Shih Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Vendim mbi Mocionin e Dytë të Prokurorisë për Pranimin e Provave Bazuar në Rregullën 92 *quater*, 5 mars 2007, para. 11; Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave Bazuar në Rregullën 92 *quater*, 16 shkurt 2007, para. 7; *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-PT, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë të Rregullës 92 *bis*, 4 korrik 2006, para. 22; *Prokurori k. Galiqit*, Lënda Nr. IT-98-29-AR73.2, Vendim mbi Apelin e Ndërkohshëm Bazuar në Rregullën 92*bis*(C), 7 qershor 2002, f. 9, shënim 34; *Prokurori k. Haliloviçit*, Lënda Nr. IT-01-48-T, Aktgjykim, 16 nëntor 2005, para. 19; *Prokurori k. Bllagojeviçit dhe Jokiçit*, Lënda Nr. IT-02-60-T, Aktgjykim, 17 janar 2005, para. 26.

⁴⁵ *Prokurori k. Aleksovskit*, Lënda Nr. IT-95-14/1-AR73, Vendim Mbi Apelin e Prokurorit në lidhje me Pranueshmërinë e Provave, 16 shkurt 1999, para 15. (“Duke qenë se dëshmia [mbi bazën e thënieve të të tjerëve] pranohet për të provuar vërtetësinë e përmbajtjes së saj, Dhoma Gjyqësore duhet të bindet se ajo është e përdorshme për atë qëllim në kuptimin që është me vullnet të lirë, e vërtetë, e besueshme; dhe për këtë qëllim mund të shqyrtoje si përmbajtjen e deklaratës mbi bazën e thënieve po ashtu edhe rrethanat e kësaj dëshmie; ose, . . . vlera provuese e një deklaratë mbi bazën e thënieve të të tjerëve do të kushtëzohet prej kontekstit dhe natyrës së dëshmisë në fjalë.”); *Prokurori k. Tadiçit*, Lënda Nr. IT-94-1-T, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Dëshmi të Dorës së Dytë, 5 gusht 1996; *Prokurori k. Bllashkiçit*, Lënda Nr. IT-95-14-T, Vendim mbi Kundërshtimin e Përhershëm të Mbrojtjes në lidhje me Pranimin e Dëshmimeve të Dorës së Dytë pa Verifikimin e Besueshmërisë së tyre, 21 janar 1998, paragrafët 10, 12.

⁴⁶ *Shih* T. 24308–24310 (17 mars 2008) (seancë private). Pas diskutimit të pasqyruar në poshtëshënime në këtë transkript, Dhoma nuk e gjykoi të përshtatshme të shfrytëzonte këto deklaratat bazuar në thëniet e të tjerëve.

Provat rrethanore përfshijnë një numër rrethanash të ndryshme të cilat të marra së bashku tregojnë fajësinë e të akuzuarit sepse ekzistenca e tyre e ndërvarur buron vetëm prej asaj që pretendohet se kreu i akuzuari ... ky konkluzion duhet vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm. Nuk mjafton që të jetë konkluzion i arsyeshëm ekzistues. Duhet të jetë i vetmi konkluzion i arsyeshëm ekzistues dalë prej këtyre provave. Nëqoftëse ekziston një konkluzion tjetër i cili logjikisht mund të nxirret prej provave, dhe që nuk përputhet me fajësinë e të akuzuarit, ai duhet të shpallet i pafajshëm.⁴⁷

40. *Prova të ekspertëve.* Dhoma pranoi dhe shqyrtoi dëshmi gojore dhe aktekspertiza të disa dëshmitarëve ekspertë dhe gjatë shqyrtimit mori parasysh faktorë si kompetenca profesionale, metodologjitë e shfrytëzuara prej ekspertëve, dhe besueshmëria e përfundimeve bazuar në këta faktorë dhe prova të tjera pranuar prej Dhomës.⁴⁸ Gjithashtu Dhoma mori parasysh afërsinë e ekspertit me palën që e paraqiti si ekspert si dhe përfshirjen e ekspertit në ngjarjet e pretenduara në Aktakuzë.⁴⁹

41. *Dëshmitë e të Akuzuarve.* Prej gjashtë të Bashkakuarve, vetëm Llazareviqi vendosi të dëshmonte gjatë gjykimit. Në përputhje me Nenin 21(4)(g) të Statutit, Dhoma nuk nxori përfundime në dëm të të Akuzuarve të tjerë, lidhur me vendimin e tyre për të mos dëshmuar. Gjithashtu Dhoma i ka kushtuar dëshmisë së Llazareviqit të njëjtën rëndësi që u ka kushtuar dëshmime të gjithë dëshmitarëve të tjerë.

42. Secili prej të Akuzuarve, me përjashtim të Ojdaniqit, u intervistua prej Prokurorisë në përputhje me kushtet e Rregullës 43. Këto intervista u pranuan si prova gjatë paraqitjes së çështjes prej Prokurorisë. Meqenëse i Akuzuari Llazareviqi dha dëshmi dhe ishte i disponueshëm për pyetje nga pala kundërshtare si përfaqësues i të Bashkakuarve të tjerë, intervista e tij u konsiderua si dëshmi pa kufizime në gjyq. Nga ana tjetër, intervistat e çdo të Akuzuari u konsideruan dëshmi në lidhje me të Akuzuarin që dha intervistë për çfarëdo aspekti që ndikonte në mbrojtjen ose akuzat kundër tij, por u morën parasysh në lidhje me të Bashkakuarit vetëm për aspekte pa lidhje me sjelljen dhe veprimet ose synimin kriminal të të Bashkakuarve.⁵⁰

⁴⁷ *Shih Prokurori k. Delaliqit dhe të tjerëve* Lënda Nr IT-96-21-A, Aktgjykim, 20 shkurt 2001, para. 458 (theksi në origjinal)

⁴⁸ *Shih Prokurori k. Martiqit*, Lënda Nr. IT-95-11-T, Aktgjykim, 12 qershor 2007, para. 29; *Prokurori k. Vasileviqit*, Lënda Nr. IT-98-32-T, Aktgjykim, 29 nëntor 2002, para. 20; *Prokurori k. Bllagojeviqit dhe Jokiqit*, Lënda Nr. IT-02-60-T, Aktgjykim, 17 janar 2005, para. 27.

⁴⁹ *Shih për shembull., Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-PT, Vendim mbi Kundërshtimet e Prokurorisë Bazuar në Rregullën 94 bis ndaj Dëshmisë Eksperte të Ratko Markoviqit, 3 gusht 2007, para 3-6.

⁵⁰ *Shih Prokurori k. Millutinoviqit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-PT, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave Dokumentare, 10 tetor 2006, para 44 (pranimi i intervistave si prova); *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-04-74-AR73.6, Vendim mbi Apelet Kundër Vendimit të Pranimit si Provë të Transkriptit të Marrjes në Pyetje të Jadranko Përliqit, 23 nëntor 2007 (ku konkludohet se deklarata të tilla duhen konfirmuar nëqoftëse do të përdoren kundër një të bashkakuar për vërtetimin e çfarëdo “elementi kyç” të aktakuzës së Prokurorisë); Vendim mbi Përdorimin e Intervistave të të Akuzuarve prej Prokurorinë, 20 mars 2008.

43. Kjo qasje është më e dobishme për të Akuzuarit krahasuar me çfarë u përkufizua e përshtatshme prej Dhomës Gjyqësore në *Prokurori k. Përliqit dhe të tjerëve*. Vendimi *Përliq* u bë i njohur më 23 nëntor 2007, pasi Prokuroria në *Millutinoviq dhe të tjerët* kishte bërë të qartë se në lidhje me veprimet dhe sjelljen e të Akuzuarve dhe synimin e tyre kriminal, ajo kërkoi të kufizonte efektin e deklaratave të përfshira në intervista, veç asaj të Llazareviqit, mbi të Akuzuarin konkret të intervistuar. Në këto rrethana, ishte Dhoma Gjyqësore ajo që duhej të vendoste cilat pjesë të intervistës kishin lidhje me veprimet dhe sjelljen ose synimin kriminal të të Akuzuarve, dhe cilat nuk kishin.

44. Bazuar në paragrafin A të Rregullës 84 *bis*, i Akuzuari Ojdaniq, bëri një deklaratë pa betim në nisje të procesit gjyqësor më 10 korrik 2006;⁵¹ dhe bazuar në paragrafin B të Rregullës 84 *bis*, Dhoma Gjyqësore e mori parasysh këtë deklaratë në diskutimin e vet përfundimtar.

45. *Gjerësia e aktakuzës*. Prokuroria vendosi të paraqiste një aktakuzë të bazuar në një mori pretendimesh për ngjarje të ndodhura në 15 komuna të ndryshme, numri i të cilave më vonë u pakësua në 13 prej Dhomës. Prokuroria paraqiti prova prej një numri të vogël njerëzish në lidhje me secilën prej komunave, por i bëri thirrje Dhomës të nxirrte konkluzione përgjithësuese në lidhje me kryerjen e krimeve dhe lëvizjen e qindra mijëra njerëzve dhe vrasjen e qindra e qindra njerëzve. Në fund të fundit, ka të ngjarë që dëshmitarët në numër të kufizuar, ishin gjithë çka Prokuroria kishte në dispozicion, duke mbajtur parasysh se ajo nuk shfrytëzoi plotësisht kohën në dispozicion për paraqitjen e provave të saj. Rezultati neto është se Dhomës i ra barra e rëndë e vlerësimit të kujdesshëm nëse dëshmitarët e paraqitur ishin të besueshëm në atë masë sa të mundësohej nxjerrja e konkluzioneve përgjithësuese duke u bazuar në dëshmitë e tyre.

46. Si Prokuroria, po ashtu edhe Mbrojtja hasën në problemin e organizimit të provave të tyre në atë mënyrë që do t'u mundësonte efektshmërinë e paraqitjes së tyre brenda një periudhe të arsyeshme. Duke qenë e vetëdijshme për këtë rrethanë dhe për faktin se në një çështje gjyqësore të një niveli dhe mase të tillë, është jorealiste të pritët që të gjitha provat të paraqiten nëpërmjet ballafaqimit gojor në sallën e gjyqit, fizikisht, Dhoma Gjyqësore, gjatë gjithë kohës ishte e gatshme të merrte parasysh marrjen e dëshmimeve me shkrim, qoftë pjesërisht (madje edhe pjesën më të madhe) të dëshmisë së një dëshmitari, ose dokumente të veçanta për të cilat ishte provuar se ishin relevante dhe kishin vlerë provuese, pa u përmendur konkretisht nga një dëshmitar. Si rrjedhojë, të tëra palët patën kohë të mjaftueshme për paraqitjen e argumenteve të tyre përkatëse.

⁵¹ Dragolub Ojdaniq, T. 478–492 (10 korrik 2006).

47. *Deklaratat e pranuar sipas kushteve të Rregullës 92 ter.* Për t'iu mundësuar dëshmitarëve dhënien prej tyre të dëshmive në lidhje me të tëra aspektet për të cilat ata kishin informacion relevant, Dhoma gjykoj se ishte në interes të drejtësisë që palët të lejoheshin të paraqisnin pjesë të konsiderueshme të dëshmive të dëshmitarëve, në formën e deklaratave me shkrim. Dëshmitarë të tillë u paraqitën në gjykatë, konfirmuan saktësinë e deklaratës së dorëzuar dhe ishin të disponueshëm për pyetje nga pala kundërshtare. Mirëpo një dëshmitar i Mbrojtjes së Millutinoviçit dëshmoi nëpërmjet Rregullës 92 ter pa u paraqitur për pyetje nga pala kundërshtare, pas tërheqjes së Prokurorisë nga marrja në pyetje; dhe dëshmia e Zoran Gjingjiçit u pranua nëpërmjet Rregullës 92 quater me pëlqimin e Prokurorisë.⁵²

48. Në lidhje me paraqitjen e dëshmive me shkrim në vend të dëshmive gojore, Dhomës Gjyqësore i krijoi probleme një praktikë veprimi. Në më të shumtën e rasteve deklaratat e paraqitura të dëshmitarëve u përgatitën në formën e tyre përfundimtare nga Prokuroria ose ekipet e Mbrojtjes pikërisht në ditët para dhënies së dëshmisë prej dëshmitarit. Çuditërisht thuajse nuk kishte shenja që veçanërisht Prokuroria të ishte përpjekur të qartësonte kushtet e marrjes së deklaratave prej dëshmitarëve afërsisht rreth kohës së ngjarjeve në fjalë ose pak kohë pas tyre që prej asaj kohe. Edhe kur dëshmitari më pas kishte dëshmuar në një çështje tjetër, thuajse nuk kishte sqarim të mëtejshëm me dëshmitarin. Si rezultat u bënë ndryshime të minutës së fundit, përfshirë edhe disa ndryshime në deklarata mjaft të hershme. Disa ndryshime ishin të konsiderueshme. Përgjithësisht palët ua bënë të njohura menjëherë këto ndryshime njëra-tjetrës; gjithsesi, në disa raste lindi problemi se njëri prej palëve mund t'i duhej më shumë kohë për përgatitjen e pyetjeve për dëshmitarin e palës tjetër. Gjatë gjithë kohës Dhoma ishte e prirur nga mundësia e shtyrjes së procesit për këtë qëllim. Në fund asnjë palë nuk pretendoi të ishte dëmtuar prej kësaj në atë masë sa të kërkohej masë ndreqëse prej Dhomës. Mirëpo për Dhomën mbetet problemi se përgjithësisht është e papëlqyeshme të konstatohet ndryshimi i deklaratës së dëshmitarit në momentin e fundit, veçanërisht kur ofrohet shpjegim jobindës në lidhje me këtë rrethanë. Kur vendosi se pranimi i deklaratave, ndër të cilat edhe ato të ndryshuara në fazën e fundit, ishte në interes të drejtësisë, Dhoma ishte e ndërgjegjshme për vëmendjen që u duhej kushtuar këtyre rrethanave në diskutimin e saj të fundit.

49. *Deklaratat mospërputhëse.* Gjatë gjithë procesit gjyqësor palët u orvatën të dëmtonin besueshmërinë e dëshmitarëve nëpërmjet pretendimit për mospërputhje midis deklaratave të hershme dhe dëshmive gojore ose deklaratave të mëvonshme. Kjo dukuri u vu re veçanërisht për dëshmitarët e thirrur prej Prokurorisë për të dëshmuar në lidhje me shkeljet bazë të përmendura në

⁵² T. 12809–12812 (22 qershor 2007).

Aktakuzë. Dhoma shqyrtoi një nga një të gjitha mospërputhjet e mundshme dhe e shfrytëzoi shqyrtimin në vlerësimin e besueshmërisë së dëshmisë së dëshmitarit në çdo aspekt. Në vlerësimin e rëndësisë së çdo mospërputhjeje, Dhoma mori parasysh largësinë kohore, ndryshimet në pyetjet e bëra dëshmitarëve në faza të ndryshme të hetimit dhe në gjyq, dhe rrethanat tronditëse me të cilat u përballën dëshmitarët gjatë ngjarjeve për të cilat dëshmuuan. Dhoma nuk përjashtoi automatikisht si të pabesueshme dëshmitë mbi bazën e mospërputhjeve të vogla midis deklaratave të mëparshme dhe dëshmimeve në sallën gjyqësore. Nuk mund të pritet që dëshmitarë të cilët dëshmojnë në këto rrethana, të rikujtojnë rrjedhën e saktë dhe hollësitë e ngjarjeve, dhe gjithashtu mospërputhjet nuk çuan automatikisht në përfundime për mungesën e besueshmërisë. Në rastet kur mund të kujtohej thelbi i ngjarjeve me hollësi të pranueshme, mospërputhjet ose pasaktësitë e vogla nuk u konsideruan pengesë për përdorimin e tyre si prova.

50. Në disa raste dëshmitarët u ballafaquan me deklaratat e tjera që kishin dhënë apo me deklaratat e dëshmitarëve të tjerë që kishin dijeni për të njëjtën ngjarje, por pretendimet për deklaratat mospërputhëse nuk u provuan mjaftueshëm dhe nuk u paraqitën dëshmitarë kundërthënës. Në këto raste, Dhoma Gjyqësore përgjithësisht ka lënë jashtë rrëfimit çfarëdo mospërputhje apo kundërthënie të deklaratës që nuk u pranua prej dëshmitarit të ballafaquar, por ka marrë parasysh dëshmitë e tjera të pranuar që kishin ndikim ndaj pikës në fjalë.

51. *Pyetjet nga pala kundërshtare.* Është gjithashtu jorealiste që në një çështje të kësaj madhësie të pritet që pala pyetëse të verifikojë çdo pikë të kundërshtimit të ngritur prej saj. Për një qasje realiste është e nevojshme që pala pyetëse t'u japë përparësi pyetjeve më thelbësore dhe të verifikojë dëshmitë më të rëndësishme kundër saj dhe, kur është e mundur për dëshmitarin që të japë dëshmi relevante në lidhje me argumentin e pyetësit, t'i bëjë të qartë dëshmitarit kontradiktën midis llojit të akuzës dhe dëshmisë së dhënë prej dëshmitarit, sipas Rregullës 90(H)(ii). Pa dyshim që nuk mund të trajtohet çdo aspekt dhe do të ketë raste kur pikat për të cilat një palë do të dëshironte të bënte pyetje, do të jenë anashkaluar. Dhoma ka qenë tepër e vetëdijshme për këtë mundësi.

52. Vështirësia shtohet prej faktit se Mbrojtjes nuk i kërkohet t'i bëjë të njohur Prokurorisë hollësi të dëshmitarëve dhe provave të saj materiale deri në mbylljen e paraqitjes së çështjes prej Prokurorisë. Çuditërisht duket se kjo e ka bërë Mbrojtjen të kryejë hetime të konsiderueshme në një fazë të vonshme dhe me gjasë të jetë vënë në dijeni pas paraqitjes së dëshmitarëve të Prokurorisë, për informata që duhej t'u paraqiteshin dëshmitarëve për të reaguuar. Në lidhje me këtë aspekt, në tri raste, dëshmitarë të thirrur nga Mbrojtja kundërshtuan dëshmitarët e thirrur nga Prokuroria, mirëpo gjatë paraqitjes së çështjes prej Prokurorisë dëshmitarëve në fjalë nuk iu paraqit për koment

kundërshtimi konkret, me gjasë i rëndësishëm. Në raste të tilla, gjatë vlerësimit të provave Dhoma ka marrë parasysh se dëshmitarit të Prokurorisë nuk iu dha mundësia për të komentuar.

53. *Veçori të dukshme të dëshmime gojore.* Dhoma Gjyqësore vuri re te disa dëshmitarë një prirje për mbitheksim ose teprim në lidhje me ngjarjet për të cilat folën dhe për ndikimin ose pasojat e këtyre ngjarjeve. Është e kuptueshme për dy palë kundërshtare në një konflikt që të vazhdojnë të ruajnë një dozë armiqësie kundrejt njëra-tjetrës. Komprometimi i provave në atë masë sa të bëhen të pabesueshme ka të bëjë me rrethanat dhe masën. Në shumë raste të tilla Dhoma ka mundur të identifikojë informacion të besueshëm.

54. Problem më të madh Dhomës i shkaktuan disa veçori të mënyrës së dhënies së dëshmisë prej disa dëshmitarëve. Zyrtarë të lartë të qeverisë, partive politike, ushtrisë dhe policisë të cilët ishin pjesëmarrës aktivë në funksionimin rutinor të organizatave të tyre, shpesh i bazonin përgjigjet e tyre në përmbajtjen e një dokumenti si mbi diçka të shenjtë deri aty sa përjashtonin madje edhe gjasën se ngjarjet faktikisht u zhvilluan ndryshe nga parashikimi në kohën kur ishte shkruar dokumenti. Në disa raste dëshmitarë të tillë e kishin të vështirë madje edhe të kalonin në mend se një fakt i ndodhur ishte ashtu siç ishte përmendur nga një dëshmitar tjetër, ndryshe nga çfarë ishte shkruar në dokument. Ky besim në dukje në ndershmërinë absolute burokratike dhe njëtrajtshmërinë e funksionimit dhe punës së një organizate here pas here dukej se shërbente si strehë e sigurtë kundrejt ballafaqimit me realitetin e ashpër të veprimeve të forcave që duhej të ishin disiplinuar.

55. Një numër dëshmitarësh shqiptarë kosovarë që jetonin në zonat ku Ushtria Çlirimtare e Kosovës (“UÇK”) ishte e pranishme dhe dihej gjerësisht se vepronte, mohuan se kishin dijeni për veprimtari të UÇK-së në atë zonë, madje edhe për praninë e saj. Në disa raste edhe kur u përball me material në dukje të besueshëm që tregonte se dëshmitari duhej të kishte ditur diçka për UÇK-në, dëshmitari ishte këmbëngulës në mohimin e tij, deri në kufijtë e absurditetit.

56. *Besueshmëria dhe vlera provuese e provave dokumentare.* Dhoma mori parasysh burimin e dokumenteve për aq sa dihej, dhe nuk pranoi dokumente nëse ekzistonin dyshime të konsiderueshme për vërtetësinë e tyre. Dhoma shqyrtoi imtësisht mijëra dokumente të paraqitura, disa prej të cilave u paraqitën prej dëshmitarëve, të tjerat prej përfaqësuesve ligjorë të palëve në sallën gjyqësore,⁵³ dhe të tjera me pëlqimin e palëve.⁵⁴ Mirëpo Dhoma nuk pranoi automatikisht që

⁵³ *Shih për shembull.*, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dëshmisë në Lidhje me Philip Coe, 23 mars 2007; Vendim mbi Kërkesën e Tretë të Prokurorisë për Pranimin e Provave Dokumentare në Sallën Gjyqësore, 23 mars 2007; Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Provave Dokumentare, 10 tetor 2006; Vendim mbi Kërkesën e Millutinoviçit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore 19 shtator 2007; Vendim mbi Kërkesën e Shainoviçit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 4 shtator 2007; Vendim mbi Kërkesën e Ojdaniçit për

deklaratat në këto dokumente përbënin një pasqyrim të saktë të fakteve. Dhoma i shqyrtoi një nga një dokumentet e pranuar si prova në kuadrin e tërë dokumentacionit gjyqësor.⁵⁵ Gjatë tërë procesit gjyqësor, Dhoma pranoi disa dokumente vetëm për një qëllim të kufizuar dhe rrjedhimisht i vlerësoi vetëm në lidhje me atë qëllim. Për më tepër në përputhje me “Urdhrin për Procedurën dhe Provat,”⁵⁶ ku u përkthye vetëm një pjesë e një dokumenti të gjatë që u paraqit si provë, Dhoma gjykoi se vetëm pjesa e përkthyer e dokumentit ishte pranuar si provë.

57. Në një numër rastesh, dëshmitarët pretenduan se dokumentet e autoriteteve të Republikës së Serbisë ose RFJ-së nuk ishin autentike, ishin të pasakta, ose nuk nënkuptonin atë që ishte shkruar. Disa herë thelbi i dëshmimeve të tilla ishte sugjerimi se zyrtarët në të vërtetë nuk kishin pozita të rëndësishme në të cilat dukej se ishin emëruar. Si pasojë analiza e përgjegjësive zyrtare/*de jure* rezultoi më e ndërlkuar se çdo të pritej normalisht prej një praktike burokratike ku emërimet zakonisht bëhen nëpërmjet urdhrave me shkrim.

58. Në këtë çështje një prej kërkesave të sistemit elektronik gjyqësor të letërkëmbimit është që palët vendosin titullin e një dokumenti kur e dërgojnë në sistemin elektronik gjyqësor. Në disa raste Dhoma e ka gjykuar të përshtatshme të përdorë për një dokument një titull të ndryshëm nga ai i dhënë prej palëve. Titulli i një dokumenti nuk ka ndikuar në peshën e atribuar atij dokumenti prej Dhomës dhe nuk ka ndikuar në vendimin e Dhomës në lidhje me atë dokument.

59. *Vlerësimi i provave.* Pas marrjes së dosjeve përfundimtare dhe pas dëgjimit të argumenteve përmbyllëse, Dhoma shqyrtoi me kujdes dokumentacionin e procesit gjyqësor. Dhoma ka shqyrtuar veçazi për çdo të Akuzuar provat pro dhe kundër tij, dhe ka nxjerrë verdikt të veçantë në lidhje me çdo akuzë për çdo të Akuzuar. Dhoma u ka kushtuar vëmendje si dëshmisë së çdo dëshmitari, qoftë i Prokurorisë, Mbrojtjes apo Dhomës, po ashtu dhe të tëra parashtrimeve të të gjitha palëve.

60. Gjatë krejt shqyrtimit të provave, Dhoma ka mbajtur parasysh largësinë kohore prej ngjarjeve dhe ndikimin e mundshëm të këtij faktori në besueshmërinë e provave. Gjithashtu, në

Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 25 tetor 2007; Vendim mbi Mocionin e Parë të Përsëritur të Pavkoviçit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 27 shtator 2007; Vendim mbi Mocionin e Llazareviçit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 16 janar 2008; Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes së Llukiqit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 11 qershor 2008; Vendim mbi Mocionin e Llukiqit për Rishikim të Vendimit të Dhomës Gjyqësore mbi Mocionin për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore dhe Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Zgjatjen e Afatit për Dorëzimin e Dosjeve Gjyqësore Përfundimtare, 2 korrik 2008.

⁵⁴ *Shih për shembull., Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-T, /Urdhër i Dytë mbi Fakte të Pranuar; Urdhër për Parashtrime mbi Njoftimin e Përbashkët të Prokurorisë dhe Mbrojtjes Lidhur me Përkthimin e Provave Materiale Pranuar me Marrëveshje si Prova, 31 korrik 2007.

⁵⁵ *Shih Prokurori k. Martiqit*, Lënda Nr. IT-95-11-T, Aktgjykim, 12 qershor 2007, para. 30.

⁵⁶ *Prokurori k. Millutinoviçit dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-05-87-T, Urdhër mbi Procedurën dhe Provat, 11 korrik 2006, para. 6 (ndryshuar në “Vendim mbi Mocionin e Përbashkët të Mbrojtjes për Ndryshimin e Urdhrit mbi Procedurën dhe Provat,” 16 gusht 2007)

vlerësimin e besueshmërisë së dëshmisë së një dëshmitari të caktuar, Dhoma ka mbajtur parasysh qëndrimin, sjelljen dhe rrethanat e atij dëshmitari. Thuajse për çdo dëshmitar, Dhoma ka pasur mundësinë të vëzhgojë dhënien e dëshmisë prej dëshmitarit në praninë e saj, të këqyrë qëndrimin dhe sjelljen e dëshmitarit në sallën gjyqësore dhe të krijojë një përshtypje nëse dëshmitari u përpoq të jepte dëshmi të besueshme.

61. Megjithëse përdorshmëria dhe besueshmëria shpesh përmenden si koncepte të veçanta, besueshmëria është pak a shumë element i përdorshmërisë. Në fund të fundit çështja shtrohet nëse prova/dëshmia është e përdorshme. Ajo mund të jetë e papërdorshme për një numër arsyesh, ndër të cilat fakti se nuk është e saktë. Gjithashtu Dhoma mori parasysh njëanësinë e mundshme të dëshmitarëve dhe nëse dëshmitarët kanë pasur motiv për dhënie dëshmie të rreme, kurdoherë që rrethanat nxorën një prej këtyre mundësive. Disa dëshmitarë demonstuan mungesë të tillë çiltërsie para Dhomës saqë dëshmia e tyre pak a shumë u hodh poshtë. Për disa dëshmitarë u konstatua se ishin të besueshëm për disa aspekte, por më pak të besueshëm (madje të pabesueshëm) në të tjera; kurdoherë që Dhoma konstatoi se një dëshmitar nuk ishte i besueshëm në një pikë, ajo nuk e hodhi poshtë automatikisht tërë dëshminë e tij ose të saj, por e vlerësoi besueshmërinë e dëshmitarit duke mbajtur parasysh tërësinë e provave në procesin gjyqësor.⁵⁷ Kurdoherë që Dhoma shfrytëzoi dëshminë e një dëshmitari gjatë Aktgjykimit, ajo e ka gjykuar dëshmitarin të besueshëm në lidhje me problemin në fjalë. Sa herë që gjatë Aktgjykimit, Dhoma mbështetet në dokumente, arsyeja është se ajo i gjykon këto dokumente autentike dhe të besueshme për pikën në fjalë. Kurdoherë që Dhoma e ka gjykuar të arsyeshme dhe të nevojshme të shpjegojë pranimin ose refuzimin e dëshmisë së një dëshmitari në lidhje me një pikë konkrete, ajo e ka parashtruar këtë shpjegim, dhe të njëjtën gjë ka bërë edhe për dokumentet. Mirëpo në shumë raste ajo nuk e ka gjykuar të nevojshme të ofrojë shpjegim të arsyeve të pranimin ose refuzimit të provave prej saj. Arsyeja përgjithësisht është se anëtarët e Dhomës krijuan mendimin se dëshmitari ose dokumenti ishte i

⁵⁷ *Shih Prokurori k. Tadiqit*, Lënda Nr. IT-94-1-T, Arsyetim dhe Gjykim, 7 maj 1997, para. 541 (“Për çdo dëshmitar duhet bërë një vlerësim i besueshmërisë së tij/saj, përfshirë edhe motive të mundshme për dhënie dëshmie të rreme. Nuk është as e përshtatshme dhe as e drejtë të konkludohet se një dëshmitar është automatikisht jo i besueshëm vetëm për shkakun se ai ishte viktimë e një krimi të kryer prej një individi i të njëjtit besim, grup etnik, forcë të armatosur apo çfarëdo veçorie tjetër të të akuzuarit. Kjo nuk do të thotë se urrejtja etnike edhe pa ndikimin keqësues të konfliktit të dhunshëm midis grupeve etnike, nuk mund të jetë asnjëherë arsye për të dyshuar në besueshmërinë e një dëshmitari konkret. Një konkluzion i tillë mund të nxirret gjithsesi vetëm duke u bazuar në rrethanat e çdo dëshmitari, dëshminë e dëshmitarit dhe aspekte të tjera që Mbrojtja mund të provojë ose kur merr dëshmitarët në pyetje, ose nëpërmjet paraqitjes së provave prej saj.”); *Prokurori k. Limajt dhe të tjerëve.*, Lënda Nr. IT-03-66-T, Aktgjykim, 30 nëntor 2005, para. 15 (“Dhoma gjithashtu ka qenë në dijeni se shumë dëshmitarë-viktima me prejardhje shqiptare kishin lidhje familjare të shkallëve të ndryshme me njëri-tjetrin ose ishin prej fshatrave afër fshatit të një apo disa dëshmitarëve. Gjithashtu dëshmitë e tyre për ngjarjet mund të jenë ndikuar prej faktorëve kulturorë të besnikërisë dhe nderit, përmendur më lart dhe për këtë arsye Dhomës i është dashur ta marrë parasysh. ... Për më tepër Dhoma ka konstatuar se një numër i konsiderueshëm dëshmitarësh kërkuan masa mbrojtëse gjatë procesit dhe shprehën shqetësim për jetën e tyre dhe të familjeve të tyre. Gjatë gjyqit gjendja e frikës ishte tepër e dukshme, veçanërisht te dëshmitarët ende me banim në Kosovë. ... Gjatë detyrës tepër të vështirë të vlerësimit të dëshmimeve për këtë rast, Dhoma është përpjekur ndër të tjera që t’u japë këtyre çështjeve peshën e duhur.”).

besueshëm në lidhje me pikën në fjalë. Kurdoherë që provat u pranuan prej marrëveshjes midis palëve, përgjithësisht Dhoma i ka pranuar.

62. *Detyrimi dhe standardi i vërtetimit.* Kushti i paragrafit A të Rregullës 87, se “verdikti i fajësisë mund të jepet vetëm kur shumica e Dhomës Gjyqësore binden se fajësia është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm”, lidhet me pandehmën e pafajësisë së një të akuzuari parashtruar në paragrafin 3 të Nenit 21 të Statutit.⁵⁸ Që i akuzuari të shpallet fajtor për një krim të akuzuar në Aktakuzë, Prokuroria duhet të vërtetojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm (a) çdo element të krimit statutor (ndër të cilat *synimi kriminal dhe veprimi kriminal* i shkeljes bazë dhe kushtet e përgjithshme të krimit statutor) dhe (b) elementët mendorë dhe fizikë të së paku njëres prej formave të përgjegjesisë për të cilat akuzohet i akuzuari.⁵⁹

63. Kushti që një Dhomë Gjyqësore të nxjerrë përfundime në lidhje me elementët e shkeljeve bazë, krimeve statutore dhe formave të përgjegjesisë, nënkupton se “pandehma e pafajësisë kërkon vërtetimin jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm të çdo fakti ku bazohet verdikti i fajësisë”.⁶⁰ Kjo nuk do të thotë se çdo pretendim faktual në një aktakuzë, duhet të vërtetohet jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm për shpalljen e verdiktit të fajësisë së të akuzuarit. “Faktet materiale” që duhen argumentuar në Aktakuzë për t’i ofruar të akuzuarit informacionin e nevojshëm në përgatitje të mbrojtjes së tij, jo domosdoshmërisht janë në çdo rast fakte që duhen vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm në Aktgjykimin përfundimtar.⁶¹ Mirëpo nëqoftëse Dhoma Gjyqësore shfrytëzon një fakt për nxjerrjen e një përfundimi në lidhje me një element të shkeljes bazë, krimit statutor ose formës së përgjegjesisë, atëherë ky fakt duhet vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.⁶² Natyrisht Dhoma ka shfrytëzuar fakte të tilla kur është bindur se janë vërtetuar, por nuk përsërit pafundësisht gjatë Aktgjykimit frazën “jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm”.

64. *Kushti i përfundimeve ligjore dhe faktuale.* Megjithëse i akuzuari gëzon të drejtën që t’i jepet një mendim i arsyetuar në përputhje me Nenin 23 të Statutit dhe Rregullën 98 *ter* të Rregullores, Dhomës Gjyqësore nuk i kërkohet të diskutojë çdo pretendim faktual paraqitur në Aktakuzë apo çdo argument ligjor të parashtruar. Në dëshmitë gojore të dëshmitarëve dhe dokumentet e tyre shpesh hasen mospërputhje të vogla, të cilat nuk i bëjnë të pabesueshme, dhe është në kompetencën gjyqësore të Dhomës, që të vlerësojë provat dhe të gjykojë nëse provat në

⁵⁸ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Martiq*. 55–63.

⁵⁹ *Shih, p.sh., Prokurori k. Mlilosheviqit*, Lëndët Nr. IT-99-37-AR73, IT-01-50-AR73, IT-01-51-AR73, Arsyet e Vendimit mbi Apelin e Ndërkohshëm të Prokurorisë kundër Refuzimit të Bashkimit të Çështjeve, 18 prill 2002, para. 31; *Prokurori k. Bllashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14-A, Aktgjykim, 29 korrik 2004, para. 484

⁶⁰ *Shih Prokurori k. Ntagerura-s dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-99-46-A, Aktgjykim, 7 korrik 2006, para. 175.

⁶¹ *Shih Prokurori k. Ntagerura-s dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-99-46-A, Aktgjykim, 7 korrik 2006, f.58, shënim 356.

tërësi janë të besueshme, pa diskutuar çdo mospërputhje apo pa shpjeguar çdo hollësi, ose pa shqyrtuar të gjitha provat që nuk përputhen me një përfundim të Dhomës. Në raste të tilla, Dhoma, në diskutimin e vet konkludues ka vlerësuar dhe peshuar me kujdes provat dhe ka konstatuar se ato nuk kanë penguar për nxjerrjen e konkluzionit përkatës, edhe kur provat nuk janë diskutuar konkretisht në Aktgjykim.⁶³ Gjithashtu Dhoma thekson se në rastet kur një provë nuk përmendet në Aktgjykim, kjo nuk do të thotë se nuk është marrë në shqyrtim.

D. TERMINOLOGJIA KONKRETE E PËRDORUR

65. Këtu Dhoma shpjegon përdorimin prej saj të një numri shprehjesh në Aktgjykim. Probleme të tjera gjuhësore dhe të terminologjisë trajtohen aty ku janë shfaqur. Që një individ të shpallet fajtor për një krim që figuron në Statut, Prokuroria duhet të provojë tri ose në disa raste katër grupe elementesh jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm, konkretisht veprimin kriminal dhe synimin kriminal të shkeljes bazë, çfarëdo kushtesh të veçanta të shkeljes bazë, kushtet e përgjithshme të krimeve statutore dhe elementët fizikë dhe mendorë të formës përkatëse të përgjegjësisë.

66. “Shkelja bazë” e krimit përfshin veprim të ngjashëm me çfarë do të përbënte krim në juridiksionin e një vendi, si p.sh. vrasja, dhe rrjedhimisht çdo shkelje bazë përmban elementët e vet të veprimit dhe synimit kriminal. Disa prej shkeljeve bazë kanë “kushte konkrete” shtesë; për shembull në rastin e përndjekjes kërkohet synimi diskriminues. “Kushtet e përgjithshme” të krimit ndonjëherë të quajtura “elementët *ombrellë*”, janë konkretë në lidhje me Nenin në fjalë dhe shërbejnë për cilësimin e një shkeljeje bazë si krim ndërkombëtar në lidhje me të cilin Tribunali ka juridiksion. Së fundi, i akuzuari mund të ngarkohet me përgjegjësi për një krim përmendur në Statut, nëpërmjet njëres prej formave të përgjegjësisë penale individuale në paragrafët 1 dhe 3 të Nenit 7 të Statutit, dhe secila prej këtyre formave të përgjegjësisë ka si elementë fizikë po ashtu edhe mendorë që duhen provuar para atribuimit të përgjegjësisë.

67. Shpesh, elementëve të një shkeljeje bazë dhe elementëve të një forme përgjegjësie u atribuohet e njëjta terminologji “*mens rea*”/synimi kriminal dhe “*actus reus*”/veprimi i fajshëm në jurisprudencën e Tribunalit; mirëpo kjo mund të shkaktojë paqartësi kur është e nevojshme që elementët e një shkeljeje bazë të analizohen veçazi prej elementëve të një forme përgjegjësie. Kjo ndodh kur i akuzuari nuk është autori fizik i krimit, si në rastin në fjalë. Rrjedhimisht termat “*mens*

⁶² *Shih Prokurori k. Ntagerura-s dhe të tjerëve*, Lënda Nr. ICTR-99-46-A, Aktgjykim, 7 korrik 2006, para. 174; *Prokurori k. Kvočkës dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2005, para. 23

⁶³ *Shih Prokurori k. Kvočkës dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-98-30/1-A, Aktgjykim, 28 shkurt 2005, para. 23; *Prokurori k. Naletiliqit dhe Martinoviqit*, Lënda Nr. IT-98-34-A, Aktgjykim, 3 maj 2006, para. 603; *Prokurori k. Bërgjaninit*, Lënda Nr. IT-99-36-A, Aktgjykim, 3 prill 2007, para. 11.

rea” dhe “*actus reus*” në këtë Aktgjykim përdoren për elementët e një shkeljeje bazë dhe termat “element mendor” dhe “element fizik” përdoren për elementët e një forme përgjegjësie, ku termi i dytë ka të bëjë me veprimet e të akuzuarit dhe pasojat e tyre në kryerjen e një krimi që duhen provuar për një formë konkrete përgjegjësie, kurse termi i parë ka të bëjë me gjendjen mendore të të akuzuarit në lidhje me përgjegjësinë penale.

68. Në lidhje me përgjegjësinë penale individuale të kryerjes së krimit, nuk kërkohet që i akuzuari të ketë kryer fizikisht krimin. Siç del qartë në formulimin e Neneve 4(3), 7(1), dhe 7(3) të Statutit, ekzistojnë disa mënyra, ndër të cilat kryerja fizike është vetëm njëra prej tyre, në lidhje me të cilat i akuzuari mund të gjykohet përgjegjës për kryerjen e një krimi. Megjithëse në jurisprudencë këto mënyra përmenden përkëmbyeshmërisht si “forma”, “kre” dhe “mënyra” të përgjegjësisë, përgjithësisht Dhoma ka përdorur frazën “forma përgjegjësie” gjatë gjithë Aktgjykimit.

69. Format e përgjegjësisë, veç kryerjes fizike, përcaktojnë marrëdhënien midis të akuzuarit dhe personave të tjerë të implikuar në kryerjen e krimit. Në jurisprudencë personi që kryen fizikisht krimin cilësohet alternativisht si “autori kryesor”,⁶⁴ “shkelësi kryesor”,⁶⁵ “autori i drejtpërdrejtë”,⁶⁶ dhe “autori fizik”.⁶⁷ Për hir të qartësisë dhe përputhshmërisë së brendshme, Dhoma ka përdorur termin “autor fizik/kryes fizik” gjatë gjithë Aktgjykimit. Për më tepër në rastin kur një person i implikuar në krim i cili në hierarkinë komanduese është midis kryesit fizik dhe të akuzuarit, ai cilësohet “kryes i ndërmjetëm”, për të bërë dallimin e saktë në marrëdhëniet e ndryshme midis të gjithë individëve përkatës në lidhje me përgjegjësinë e tyre penale individuale.⁶⁸

70. Në Aktgjykim, Dhoma ka bërë një dallim midis termave “pikë” dhe “akuzë”. Akuza përbën bazën e mundshme për nxjerrjen e përgjegjësisë, e cila është faktikisht dhe/ose ligjërish e

⁶⁴ *Shih për shembull*, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët.*, para. 90; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 48; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 84.

⁶⁵ *Shih për shembull*, Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerët.*, para. 251; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 75; Aktgjykim *Bllagojeviq*, para. 702.

⁶⁶ *Shih p.sh.*, *Prokurori k. Ademit dhe Noracit* Lënda Nr. IT-04-78-PT Vendim për Referim të Çështjes Autoriteteve Kroate Bazuar në Rregullën 11bis; 14 shtator 2005, para 36 *Prokurori k. Martiqit*, Lënda Nr. IT-95-11-PT, Vendim mbi Mocionin Paraprak Kundër Aktakuzës së Ndryshuar, 2 qershor 2003, para 29.

⁶⁷ *Shih për shembull*, Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 334 shënim 881; Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 261

⁶⁸ *Krahaso*. Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 362 (“Ky aspekt i mundëson Dhomës së Apelit të ngrejë edhe problemin e terminologjisë. Palët dhe Dhoma Gjyqësore kanë përdorur shprehje të ndryshme për identifikimin e njerëzve “në terren” të cilët “tërhoqën këmbëzën” ose ndryshe kryen veprimin e fajshëm të krimeve të identifikuara në aktakuzë. Ndër këto shprehje përfshihen “kryes materialë”, kryes fizikë”, ose Kryer Fizikë Përkatës’ (gjithashtu KFP) në lidhje me ushtarakë ose paraushtarakë serbë. Mirëpo në disa raste, ka të ngjarë që krimet të jenë kryer nëpërmjet mosveprimit, pa veprime “fizike” ose “materiale”. Për më tepër këta individë mund të mos kenë pasur synimin e nevojshëm kriminal në kryerjen e veprimit kriminal. Rrjedhimisht Dhoma e Apelit në diskutimin e mëposhtëm i cilëson këta individë si persona që kryen veprimin e fajshëm të krimit/krimeve, ose më thjesht si “autorë kryesorë.”) (poshtëshënim i nuk përfshihet).

dallueshme prej çfarëdo akuze tjetër në aktakuzë,⁶⁹ kurse pika akuzon për kryerjen e krimit statutor mbi bazën e një ose më shumë akuzave, dhe mund të përfshijë akuza që kanë lidhje me shumë viktima të ndryshme të identifikuara me emër, me shumë vendndodhje të ndryshme gjeografike, dhe me disa forma përgjegjësie. Pika nuk është gjë tjetër veçse një mënyrë e organizimit të akuzave në aktakuzë prej Prokurorisë dhe i akuzuari mund të shpallet fajtor për një pikë nëqoftëse vetëm një prej akuzave të asaj pike vërtetohet. Rrjedhimisht i akuzuari ballafaqohet me mundësinë e përgjegjësisë penale individuale për çdo akuzë.

71. Tribunali i referohet gjuhës së përdorur në Republikën e Serbisë, Bosnjë-Hercegovinës dhe Kroacisë si “BCS(BKS)”.⁷⁰ Mirëpo gjuha e folur në Serbi dhe e përshkruar nga dëshmitarët në këtë çështje, është serbisht, dhe gjatë diskutimit të dëshmimeve të dëshmitarëve në Aktgjykim është përdorur termi “serbisht”. Në lidhje me toponimet në Kosovë, të cilat ndryshojnë në shqip dhe “BKS”, jepen të dy variantet të ndarë prej një vije të pjerrë si p.sh “Priština/Prishtina”.

72. Gjatë gjithë Aktgjykimit, Dhoma përdor emërtimin “Maqedonia” për t’iu referuar “Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë”. Emërtimi i parë është përdorur gjerësisht prej dëshmitarëve, dhe ky përdorim nuk mbart asnjë ngjyrim sociopolitik prej Dhomës.

73. Gjithashtu Dhoma thekson se gjatë procesit gjyqësor, një numër dëshmitarësh ushtarakë, ndër të cilët edhe Llazareviqi, bënë dallim midis “aksionit” dhe “operacionit” ndërmarrë prej UJ-së. Për shembull, Llazareviqi shpjegoi se “aksioni” është “formë e veprimtarisë luftarake në nivelin më të ulët taktik në kuadrin e njësive operative dhe njësive të përbashkëta operative, dhe përbërja numerike shkon nga 100 deri në më pak se disa qindra ose disa mijëra vetë” Nga ana tjetër, “operacioni” është “forma më komplekse e luftimit që shtrihet në një zonë të madhe sipas një plani të caktuar dhe ka si synim një objektiv operativ ose strategjik”. Llazareviqi konkludoi se angazhimi i përgjithshëm i Korpusit të Prishtinës për tri muaj në mbrojtje të vendit gjatë bombardimeve të NATO-s, u konsiderua operacion, dhe ishte i vetmi operacion në atë kohë. Çdo gjë tjetër në kuadër të këtij operacioni ishte “aksion”, “luftim” ose “betejë”.⁷¹ Dhoma e pranon këtë dëshmi por njëkohësisht thekson se në anglisht kuptimi i thjeshtë i termit “operacion” përcakton lëvizjen strategjike të trupave në përgjithësi.⁷² Rrjedhimisht, Dhoma nuk e kufizon përdorimin e termit “operacion” në Aktgjykim në përkufizimin e dhënë prej dëshmitarëve ushtarakë.

⁶⁹ *Shih Prokurori k. Halilovićit*, Lënda Nr. IT-01-48-PT, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë që Kërkon Leje për Ndryshimin e Aktakuzës, 17 dhjetor 2004, para. 30.

⁷⁰ *Shih. Aktgjykimi Limaj dhe të tjerë*, para. 9

⁷¹ Vladimir Llazareviq, T. 18295–18296 (14 nëntor 2007). *Shih edhe* Lubisha Diković, T. 19987 (11 dhjetor 2007); Tomislav Milladenović, T. 17611 (25 tetor 2007); Kërsman Jeliq, T. 19059 (26 nëntor 2007).

⁷² *Shih The Oxford English Dictionary*, 2nd ed., 1989, vol. X, f. 849.

74. Për hir të lehtësisë së leximit dhe në përputhje me qasjen e adoptuar në paragrafin 2 të Rregullës 2 të Rregullores së Procedurës dhe Provave, Dhoma ka përdorur gjininë mashkullore për të përfshirë femëroren, kurdoherë që ka qenë e përshtatshme.

II. LIGJI PËRKATËS

A. STANDARDET LIGJORE PËR PËRGJEGJËSINË PENALE INDIVIDUALE

1. Hyrje

75. Secili prej gjashtë të Akuzuarve akuzohet përgjegjës për krimet e përmendura në Aktakuzë, në përputhje me paragrafët 1 dhe 3 të Nenit 7 të Statutit. Më poshtë citohet në tërësi Neni 7:

Neni 7 **Përgjegjësia penale individuale**

1. Një person që ka planifikuar, nxitur, urdhëruar, kryer ose ndryshe që ka ndihmuar dhe inkurajuar, planifikimin, përgatitjen ose kryerjen e një krimi të përmendur në nenet 2 deri në 5 të këtij Statuti, është individualisht përgjegjës për krimin.

2. Pozita zyrtare e një të akuzuari, qoftë si kryetar shteti apo qeverie, ose si zyrtar qeveritar përgjegjës, nuk e çliron atë person nga përgjegjësia penale dhe nuk lehtëson ndëshkimin..

3. Fakti që cilido prej veprimeve të përmendura në nenet 2 deri në 5 të këtij Statutit u kryer prej një vartësi, nuk e liron eprorin e tij nga përgjegjësia penale, nëqoftëse ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësi do të kryente veprime të tilla ose i kishte kryer, dhe eprori nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e veprimeve të tilla ose për ndëshkimin e kryesve të tyre.

4. Fakti që i akuzuari veproi në bazë të urdhrave të një qeverie ose të një eprori, nuk e liron atë nga përgjegjësia penale, por mund të merret parasysh në lehtësimin e ndëshkimit, nëqoftëse Tribunali Ndërkombëtar përcakton se këtë e kërkon drejtësia.

76. Për arsye se në lidhje me secilën akuzë, Prokuroria akuzon për të gjitha format e mundshme të përgjegjësisë, Dhoma ka kompetencën gjyquese, dhe në fakt detyrimin, për të zgjedhur formën apo format e përgjegjësisë për vlerësimin e provave në lidhje me secilin prej të Akuzuarve.⁷³ Dhoma nuk është e detyruar të nxjerrë përfundime faktuale tërësore për çdo formë të akuzuar të përgjegjësisë, dhe mund të vendosë të shqyrtojë vetëm ato që përshkruajnë më saktë sjelljen e të akuzuarit.⁷⁴ Gjithsesi, në ushtrimin e kompetencës së vet gjyquese Dhoma është e detyruar t'u përmbahet disa parimeve udhëzuese në lidhje me fajësinë dhe format e njëkohshme të përgjegjësisë.⁷⁵

⁷³ Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 602; Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 189; Aktgjykimi *Semanza*, para. 397.

⁷⁴ *Shih* Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 602; Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 388-389.

⁷⁵ Dhoma do të ndjekë praktikën e Dhomës së Apelit në përdorimin e termit “fajësime të përbashkëta” për përshkrimin e fajësimeve të njëkohshme bazuar në forma të ndryshme të përgjegjësisë sanksionuar në paragrafët 1 dhe 3 të Nenit 7, duke e rezervuar termin “fajësi e shumëfishtë” për të përshkruar fajësi të njëkohshme për më shumë se një krim material në lidhje me të njëjtën sjellje. *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Jokiq*, para. 24; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 35, 1030; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 89–93; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, para. 81; *gjithsesi shih* Aktgjykimi

77. Së pari, në rastin kur Prokuroria vërteton elementët e kryerjes dhe të një forme tjetër të përgjegjesisë për një krim bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7, Dhoma duhet të identifikojë formën më të përshtatshme të përgjegjesisë. Nëqoftëse Dhoma vendos ta shpallë të akuzuarin fajtor për kryerjen e krimit, ajo mund të gjykojë si faktor rëndues në dhënien e dënimit, çfarëdo implikimi në urdhërimin, nxitjen ose planifikimin e krimit.⁷⁶ Mirëpo i akuzuari nuk mund të shpallet fajtor për një krim nëpërmjet më shumë se një forme përgjegjësie në lidhje me të njëjtin veprim.

78. Së dyti, Dhoma nuk mund të fajësojë një të akuzuar njëkohësisht për cilëndo prej formave të përgjegjesisë së paragrafit 1 të Nenit 7, dhe nga ana tjetër, për një të akuzuar prej dy formave të përgjegjesisë së paragrafit 3 të Nenit 7 në lidhje me të njëjtën sjellje. Dhoma e Apelit ka konkluduar,

Kur në të njëjtën pikë përfshihen përgjegjësia e paragrafit 1 dhe paragrafit 3 të Nenit 7 dhe kur plotësohen kushtet ligjore përkatëse për të dyja këto kategori përgjegjësie, Dhoma Gjyqësore duhet të shpallë verdikt fajësie vetëm në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7, dhe ta konsiderojë pozitën eprore të të akuzuarit si faktor rëndues në dhënien e dënimit.⁷⁷

Mirëpo nëqoftëse përfundimet faktuale të Dhomës plotësojnë kushtet e të dyja formave të përgjegjesisë të paragrafit 3 të Nenit 7, mosparandalimin dhe mosndëshkimi, por nuk plotësojnë kushtet e çfarëdo forme përgjegjësie të paragrafit 1 Nenit 7, Dhoma shpall verdikt fajësie duke u bazuar në një të akuzuar ose të dyja format e përgjegjesisë.⁷⁸

79. Dhoma e Apelit në *Bllashkiq* përcaktoi se format e përgjegjesisë së paragrafit 1 të Nenit 7 përgjithësisht kanë përparësi ndaj formave të paragrafit 3 të Nenit 7, ku të dyja format e përgjegjesisë përbëjnë akuzë në lidhje me një sjellje të caktuar.⁷⁹ Përgjithësisht paragrafi 1 i Nenit 7

Gacumbtsi, para. 266 (ku termi “fajësi e shumëfishtë” përdoret për fajësinë e njëkohshme bazuar në forma të ndryshme të përgjegjesisë). Në një pjesë të mëtejshme të këtij Aktgjykimi Dhoma diskuton ligjin mbi fajësinë e shumëfishtë.

⁷⁶ *Shih* Aktgjykimi *Bërgjanin* para. 268; Aktgjykimi *Stakiq* para. 443.

⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 91–92; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para 104; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 33–35 (pas Aktgjykimit të Apelit *Bllashkiq*); Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, para. 81–82, 91 (ku rrëzohet fajësia e të akuzuarit sipas paragrafit 3 të Nenit 6 për gjenocid pas konkluzionit se Dhoma Gjyqësore e kishte fajësuar gabimisht bazuar në paragrafët 1 dhe 3 të Nenit 6 mbi bazën e të njëjtave fakte, por gjithsesi lihet në fuqi dënimi i Dhomës Gjyqësore duke qenë se pasqyron saktësisht rrethanën rënduese të pozitës eprore të të akuzuarit); Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para 745.

⁷⁸ Aktgjykimi *Strugar*, para 373; Aktgjykimi *Bllagojeviq* para 793.

⁷⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 91; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kamuhanda*, Mendim Pjesërisht Mospajtuës i Gjykatësit Shahabuddeen, para 410 (origjinali i nënvizuar, shkrim kursiv që është përdorur për theksim)

Rregulli *Bllashkiq* bazohet në jologjikshmërinë e konkluzionit bazuar në paragrafin 1 të nenit 7 të Statutit të TPNJ-së se krimi i kryer prej një vartësi ishte para së gjithash urdhëruar nga vetë i akuzuari dhe njëkohësisht konkludohet në bazë të paragrafit 3 të nenit 7, se i akuzuari si epror nuk parandaloi kryerjen e krimit prej vartësit ose nuk ndëshkoi vartësin për krimin e kryer. Pandehma e urdhërdhënies në bazë të paragrafit 1 të nenit 7 është se i akuzuari *ndihmoi aktivisht* në kryerjen e krimit; pandehma e përgjegjesisë komanduese e paragrafit 3 të nenit 7 është se ai nuk *ndihmoi aktivisht*. Efektivisht Dhoma e Apelit konkludoi se në vend të verdiktit të fajësisë së njëkohshme (mbi bazën e të dy dispozitave) bazuar në këto pandehma, lidhja epror/vartës duhet

ka lidhje me përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të të akuzuarit, kurse paragrafi 3 i Nenit 7 trajton përgjegjësinë e tij të tërthortë.⁸⁰ Mirëpo disa forma përgjegjësie të paragrafit 1 të Nenit 7 mund të klasifikohen më përshtatshëm si forma të paragrafit 3 të Nenit 7, si përgjegjësi e tërthortë.⁸¹ Duke qenë se përgjegjësia e paragrafit 3 të Nenit 7 është forma standarde e përgjegjesisë së mosveprimit të eprorëve,⁸² Dhoma Gjyqësore gjykon se Dhoma e Apelit në *Bllashkiq* nuk synoi që një formë e përgjegjesisë së mosveprimit dalë prej paragrafit 1 të Nenit 7, të kishte përparësi ndaj përgjegjesisë së eprorit të paragrafit 3 të Nenit 7. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore interpreton se në çështjen *Bllashkiq* thjesht jepet parapëlqimi për ato shfaqje të formave të përgjegjesisë së paragrafit 1 të Nenit 7 që përfshijnë realizimin aktiv të krimit-për shembull ndihmë dhe inkurajim nëpërmjet veprimit—dhe nuk përjashtohet shpallja e fajësisë bazuar në paragrafin 3 të Nenit 7, kur të vetmet forma të përgjegjesisë së paragrafit 1 të Nenit 7 realizohen nëpërmjet mosveprimit.⁸³

80. Duke mbajtur parasysh këta faktorë, Dhoma do të diskutojë elementët dhe veçori të tjera përkatëse të formave të përgjegjesisë së akuzuar.

2. Planifikimi

81. Prokuroria vërteton elementët fizikë dhe mendorë të planifikimit duke provuar se të akuzuarit qëllimisht planifikuan një veprim ose mosveprim⁸⁴ me synim që në zbatimin e atij plani të kryhej një krim ose shkelje bazë, ose me dijeninë e gjasës thelbësore⁸⁵ të kryerjes së një krimi ose shkeljeje bazë në zbatimin e planit.⁸⁶

konsideruar rrethanë rënduese në dhënien e dënimit për urdhërim prej të akuzuarit, dhe vetëm mbi bazën e kësaj rrethane ai duhet shpallur fajtor.

Dhoma Gjyqësore në *Kërstiq* pohoi se përgjegjësia në paragrafin 3 të Nenit 7 gjithashtu përfshihet në përgjegjësinë penale të eprorit në bazë të doktrinës së ndërmarrjes së përbashkët kriminale për veprimet e vartësve të tij. Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 605

⁸⁰ *Shih Prokurori k. Bllashkiqit*, Lënda Nr. IT-95-14, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes për Rrëzimin e Aktakuzës Bazuar në Mangësitë në Formë (Paqartësi/Shpjegim i Pamjaftueshëm i Akuzave), 4 prill 1997, para 31; Aktgjykim i Apelit *Bllashkiq*, para. 91; Aktgjykim *Bllagojeviq*, para. 683.

⁸¹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq* para 664; Aktgjykim *Mërkshiq dhe të tjerë*, para. 555 (ku pohohet se përgjegjësia për mosveprim e paragrafit 1 të Nenit 7 “i përngjan përgjegjesisë së një komandanti në paragrafin 3 të Nenit 7 të Statutit”)

⁸² *Shih* Vendimi *Haxhihasanoviq* i Përgjegjesisë Komanduese mbi Apelin e Ndërkohshëm, para 16.

⁸³ Në *Strugar*, duke mbajtur parasysh se i akuzuari ishte orvatur të ndalonte veprimet e paligjshme të vartësve të vet dhe se jurisprudenca e Tribunalit ishte e papërcaktuar nëse mosveprimi mund të përbënte veprim të fajshëm të ndihmës dhe inkurajimit dhe në çfarë mënyre, Dhoma Gjyqësore konkludoi se “mosmarrja e masave më të efektshme prej të akuzuarit për të ndaluar granatimin e paligjshëm të Qytetit të Vjetër gjykohet më mirë në kontekstin e përgjegjesisë së të Akuzuarit si epror bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit.” Aktgjykim *Strugar*, para. 355.

⁸⁴ Duhet vetëm që i akuzuari të planifikojë një “veprim ose mosveprim”—dhe jo domosdoshmërisht një krim apo shkelje bazë—nëqoftëse ai ka synimin që gjatë zbatimit të planit të kryhet krim apo shkelje bazë, ose nëqoftëse ai është i vetëdijshëm për gjasën e konsiderueshme të kryerjes së krimit ose të shkeljes bazë. Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, paragrafët. 31, 976.

⁸⁵ Standardi i “dijënisë së gjasës së mundshme u shtjellua për herë të parë prej Dhomës së Apelit në *Bllashkiq* në lidhje me urdhërimin sipas paragrafit 1 të Nenit 7. Pas analizës krahasuese të standardeve të shpërfilljes dhe *dolus eventualis/synimit të tërthortë* të disa sistemeve juridike shtetërore, Dhoma e Apelit konkludoi si më poshtë:

82. Megjithëse nuk është e nevojshme që Prokuroria të provojë se krimi ose shkelja bazë për të cilën akuzohet i akuzuari, nuk do të ishte kryer pa planin e të akuzuarit, Dhoma e Apelit ka konkluduar se plani duhet të ketë qenë faktor “thelbësisht kontribuues në...sjelljen kriminale që përfshin një ose më shumë krime statutores të kryera më vonë.”⁸⁷

3. Nxitja

83. Prokuroria vërteton elementët fizikë dhe mendorë të nxitjes duke provuar se i akuzuari, nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi, qëllimisht shtyu dikë tjetër të vepronte në një mënyrë të caktuar,⁸⁸ me synim kryerjen e krimit ose shkeljes bazë si rezultat i nxitjes, ose me dijeninë e gjasës së konsiderueshme se si rezultat i nxitjes do të kryhej krim ose shkelje bazë.⁸⁹ Përgjegjësia e nxitjes mund të burojë prej nxitjes së pashprehur, me shkrim ose nëpërmjet formave të tjera jogojore prej të akuzuarit⁹⁰, dhe nuk është e nevojshme që i akuzuari të ketë “kontroll efektiv” mbi shkelësin ose shkelësit.⁹¹ Gjithashtu nxitja prej të akuzuarit mund të ndodhë jo vetëm nëpërmjet veprimeve, por edhe nëpërmjet mosveprimeve.⁹²

84. Megjithëse Dhoma e Apelit ka konkluduar se nxitja prej të akuzuarit duhet të ketë qenë faktor “që kontribuon thelbësisht në sjelljen e një tjetri që kryen krimin”, nuk është e nevojshme që Prokuroria të provojë se krimi ose shkelja bazë nuk do të ishte kryer pa nxitjen e të akuzuarit.⁹³

duket se në bazë të standardit të Dhomës Gjyqësore komandanti ushtarak që lëshon një urdhër është penalisht përgjegjës për shkak se ekziston gjithmonë mundësia e shkeljes. Dhoma gjykon se standardi ligjor duhet të përfshijë dijeninë e *gjasës më të madhe të rrezikut* dhe të vullnetshmërisë.

⁸⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 26, 31; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerë*, para. 479; Aktgjykimi *Semanza* para. 380 (planifikimi “përfytyron një ose më shumë individë që formulojnë një metodë të planit, aksionit, procedurës ose masës për kryerjen e një krimi konkret”).

⁸⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 26.

⁸⁸ Duhet vetëm që i akuzuari të nxisë dikë që “të veprojë në një mënyrë konkrete” dhe jo domosdoshmërisht të kryejë krim ose shkelje bazë, nëqoftëse ai ka synim që si reagim i nxitjes të kryhet krim ose shkelje bazë, ose nëqoftëse ai është i vetëdijshëm për gjasën e konsiderueshme të kryerjes së krimit ose shkeljes bazë. Aktgjykimi *Kvočka dhe të tjerë*, para. 252.

⁸⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 27, 32; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 269.

⁹⁰ Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 269; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 280-281.

⁹¹ Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, para 257. Me “kontroll efektiv” kuptohet zotërimi i aftësisë materiale për parandalimin dhe ndëshkimin e kryerjes së krimeve ose shkeljeve bazë të nxitura. Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para 197

⁹² Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 269; Aktgjykimi *Galiq*, para. 168.

⁹³ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 27; Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerë*, para. 480; Aktgjykimi *Kvočka dhe të tjerë*, para. 252 (ku konkludohet se duhet provuar se “sjellja e të akuzuarit ishte faktor qartësisht kontribuues në sjelljen e personit/personave të tjerë”); Aktgjykimi *Kordiq*, para. 387 (ku konkludohet se “kontributi i të akuzuarit duhet të ketë ndikuar faktikisht në kryerjen e krimit”); Aktgjykimi *Tadiq*, para. 674 (ku konkludohet se “prokuroria duhet të provojë se kishte pjesëmarrje në kuptimin që sjellja e të akuzuarit kontribuoi në kryerjen e veprimit të paligjshëm”).

4. Urdhërimi

85. Prokuroria vërteton elementët fizikë dhe mendorë të urdhërimit duke provuar se i akuzuari qëllimisht udhëzoi një tjetër që të kryente një veprim ose që të mos vepronte,⁹⁴ me synim që nëpërmjet zbatimit të këtyre udhëzimeve, të kryej krim ose shkelje bazë, ose i vetëdijshëm për gjasën e konsiderueshme të kryerjes së një krimi apo shkeljeje bazë në zbatimin e këtyre udhëzimeve.⁹⁵

86. Megjithëse nuk është e nevojshme që Prokuroria të provojë lidhjen formale epror-vartës midis të akuzuarit dhe kryesit fizik ose kryesit të ndërmjetëm,⁹⁶ ajo duhet të ofrojë “prova të një pozitive pushteti të të akuzuarit që do të detyronte dikë tjetër të kryente krim në zbatim të urdhrit të të akuzuarit.”⁹⁷ Kjo pozitë pushteti mund të jetë joformale dhe e përkohshme,⁹⁸ dhe si pasojë nuk është e nevojshme që urdhri i dhënë prej të akuzuarit të jetë ligjrisht detyrues ndaj kryesit fizik ose kryesit të ndërmjetëm.

87. Nuk është e nevojshme që urdhri të ketë formë të përcaktuar; nuk është e nevojshme të jetë me shkrim.⁹⁹ Mirëpo për urdhërimin kërkohet veprim; ai nuk mund të kryhet nëpërmjet mosveprimit.¹⁰⁰ Për arsye se Dhoma e Apelit ka konkluduar se është e nevojshme vetëm që i akuzuari “të udhëzojë një person tjetër për kryerjen e një shkeljeje”,¹⁰¹ është e qartë se përgjegjësia e urdhërimit shfaqet në rastet kur i akuzuari nxjerr, përcjell ose ndryshe transmeton urdhrin, dhe se ai nuk ka nevojë të përdorë pushtetin e tij “për të bindur” kryesin fizik ose të ndërmjetëm për kryerjen e krimit ose shkeljes bazë.¹⁰² Për më tepër, nuk është e nevojshme që i akuzuari ta urdhërojë drejtpërsëdrejti kryesin fizik,¹⁰³ dhe një ndërmjetës i cili është më poshtë të akuzuarit në hierarkinë komanduese i cili ia përcjell urdhrin kryesit fizik, gjithashtu mund të konsiderohet

⁹⁴ Duhet vetëm që i akuzuari të udhëzojë dikë tjetër që të kryejë veprim ose të mos veprojë, dhe jo domosdoshmërisht të kryejë krim ose shkelje bazë, nëqoftëse ai ka synim që në zbatimin e urdhrit të kryhet krim ose shkelje bazë, ose nëqoftëse është i vetëdijshëm për gjasën e konsiderueshme të kryerjes së krimit ose shkeljes bazë. Aktgjykimi i Apelit *Semanza*. 359–364.

⁹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 28, 30; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 221–222.

⁹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 28; Aktgjykimi i Apelit *Semanza* para. 361.

⁹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, para. 361; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 28.

⁹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Semanza*, para. 363, 364 (ku konkludohet se i akuzuari, kryebashkiak duke mos pasur pozitë formale në hierarkinë ushtarake të Ruandës, kishte pushtetin e nevojshëm mbi luftëtarët Interahamwe që e bënte përgjegjës për urdhërimin prej tij të ushtarëve për vrasjen e tutsive në kishën Murcha dhe se Dhoma Gjyqësore kishte gabuar që nuk e kishte shpallur fajtor për këtë formë përgjegjësie).

⁹⁹ Aktgjykimi *Strugar*, para. 331; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 281.

¹⁰⁰ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 176.

¹⁰¹ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 28.

¹⁰² Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 601; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 281

¹⁰³ Aktgjykimi *Kordiq*, para. 388; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 282.

përgjegjës për krimin e kryer si urdhërues i krimit ose shkeljes bazë të kryer, nëqoftëse ka synimin e nevojshëm kriminal.¹⁰⁴

88. Megjithëse lëshimi i urdhrin prej të akuzuarit duhet të ketë qenë faktor që kontribuon në masë të konsiderueshme në kryerjen fizike të krimit ose shkeljes bazë,¹⁰⁵ nuk është e nevojshme që Prokuroria të provojë se krimi ose shkelja bazë nuk do të ishte kryer pa urdhrin e të akuzuarit.¹⁰⁶

5. Ndhimja dhe inkurajimi

89. Prokuroria i vërteton elementët fizikë të ndihmës dhe inkurajimit duke provuar (a) se i akuzuari dha ndihmesë konkrete, inkurajim ose mbështetje morale në kryerjen e krimit ose shkeljes bazë¹⁰⁷ dhe (b) se ndihmesa konkrete, inkurajimi ose mbështetja morale patën ndikim thelbësor në kryerjen e krimit ose të shkeljes bazë.¹⁰⁸

90. I Akuzuari mund të ndihmojë dhe inkurajojë jo vetëm nëpërmjet veprimit, por edhe nëpërmjet mosveprimit.¹⁰⁹ Dhoma Gjyqësore në *Mërkshiq dhe të tjerë* konkludoi se përveç përgjegjësisë së ndihmës dhe inkurajimit nëpërmjet formës së mosveprimit të “shikuesit miratues”,¹¹⁰ përgjegjësia e kryerjes së krimit mund të shfaqet edhe kur i akuzuari kishte detyrim të parandalonte kryerjen e krimit ose të shkeljes bazë dhe ai nuk e plotësoi këtë detyrim, me kusht që mosveprimi i tij të ketë patur ndikim thelbësor në kryerjen e krimit apo shkeljes bazë dhe se i akuzuari kishte synimin e kërkuar kriminal.¹¹¹ Në *Ntagerura dhe të tjerë.*, Dhoma e Apelit gjykoj se i akuzuari mund të konsiderohej përgjegjës për mosveprime të fajshme,¹¹² dhe e përsëriti këtë

¹⁰⁴ Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 827, 862.

¹⁰⁵ Aktgjykimi *Strugar*, para. 332; Aktgjykimi *Galiq*, para. 169; Aktgjykimi *Tadiq*, para. 674.

¹⁰⁶ Aktgjykimi *Strugar*, para. 332.

¹⁰⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para 45; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102. Faktikisht ndihma dhe inkurajimi janë dy veprime të ndryshme. “Ndhimja” konsiston në dhënie të ndihmesës praktike për kryesin fizik ose të ndërmjetëm, dhe “inkurajim” konsiston “në lehtësimin e kryerjes së një veprimi nëpërmjet shprehjes së simpatisë për veprimin”, me fjalë të tjera dhënie inkurajimi ose mbështetje morale për kryesin fizik ose të ndërmjetëm. Aktgjykimi *Akayesu*, para. 484; *shih edhe* Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 254; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 284 shënim 510.

¹⁰⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para 46; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102.

¹⁰⁹ Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerë*, para 482.

¹¹⁰ Dhoma Gjyqësore *Aleksovski* në paragrafin 87 e përshkroi këtë formë të ndihmës dhe inkurajimit si vijon:

Duke qenë i pranishëm gjatë keqtrajtimit dhe duke mos shfaqur kundërshtim ndaj keqtrajtimit me gjithë karakterin sistematik të tij dhe për shkak të autoritetit që ai kishte ndaj kryesve, i akuzuari ishte pashmangshmërisht i vetëdijshëm se ky miratim i heshtur do të interpretohej si shenjë e mbështetjes dhe inkurajimit të tij. Rrjedhimisht i akuzuari duhet ngarkuar me përgjegjësi për ndihmë dhe inkurajim në keqtrajtimin fizik dhe mendor të të burgosurve në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7.

¹¹¹ Në çështjen *Mërkshiq dhe të tjerë*, Dhoma Gjyqësore analizoi Aktgjykimin e Apelit *Bllashkiq* dhe konkludoi se fajësia e apellesit për shkelje në detyrë në lidhje me mosparandalimin prej tij të përdorimit të të burgosurve si mburoja njerëzore, duhej të kishte qenë ndihmë dhe inkurajim. Aktgjykimi *Mërkshiq dhe të tjerë*, para. 553–554. Në çështjen *Bllashkiq*, Dhoma e Apelit deklaroi set “mbetet e hapur mundësia që në rrethanat e një çështjeje konkrete, mosveprimi mund të përbëjë veprimin e fajshëm të ndihmës dhe inkurajimit”. Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para 47.

¹¹² Dhoma Gjyqësore në çështjen *Ntagerura dhe të tjerë*, pohoi se për vërtetimin e mosveprimit të fajshëm nevojiten këta elementë: “(a) i akuzuari ka qenë i detyruar të veprojë në bazë të një rregulle të të drejtës penale; (b) i akuzuari

konkluzion pas disa muajsh në çështjen *Galiq*.¹¹³ Dhoma ndjek këtë qasje dhe gjykon se së bashku me doktrinën e “shikuesit miratues”, edhe kjo formë përgjegjësie përfshin mosveprime të fajshme kur (a) ekziston detyrimi ligjor për të vepruar, (b) i akuzuari ka aftësinë për të vepruar, (c) ai nuk vepron ose duke synuar pasoja kriminale, ose i vetëdijshëm dhe në pajtim me faktin e ndodhisë së pasojave, dhe (d) mosveprimi rezulton në kryerjen e krimit.

91. I Akuzuari mund të ndihmojë dhe inkurajojë në një ose më shumë prej tri fazave të mundshme të krimit ose të shkeljes bazë, “planifikim, përgatitje, ose zbatim”¹¹⁴—dhe dhënia e ndihmës konkrete, inkurajimit ose mbështetjes morale mund të ndodhë para, gjatë ose pas krimit ose shkeljes bazë.¹¹⁵ Nuk kërkohen prova të një plani apo marrëveshjeje midis ndihmuesit dhe inkurajuesit dhe kryesit fizik apo të ndërmjetëm.¹¹⁶

92. Megjithëse ndihmesa konkrete, inkurajimi ose mbështetja morale dhënë prej të akuzuarit duhet të kenë ndikim thelbësor në kryerjen e krimit apo të shkeljes bazë,¹¹⁷ nuk është e nevojshme që Prokuroria të provojë se krimi apo shkelja bazë nuk do të ishte kryer pa kontributin e të akuzuarit.¹¹⁸ Për më tepër, përgjegjësia e ndihmës dhe inkurajimit sipas Statutit nuk mund të jetë e paqartë: I akuzuari nuk mund të konsiderohet përgjegjës bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7 për ndihmë dhe inkurajim, nëqoftëse krimi apo shkelja bazë faktikisht nuk është kryer me ndihmesën, inkurajimin apo mbështetjen e tij morale.¹¹⁹ Me gjithë kushtin që në fund të fundit të jetë kryer krimi apo shkelja bazë, gjithsesi nuk është e nevojshme që kryesi fizik apo i ndërmjetëm të jetë gjykuar, madje as identifikuar,¹²⁰ edhe kur krimi apo shkelja bazë kërkon synim konkret

duket të ketë pasur aftësinë për të vepruar; (c) i akuzuari nuk veproi duke pasur synim shkaktimin e pasojave penale ose i vetëdijshëm dhe miratues për ndodhinë e pasojave; dhe (d) mosveprimi rezultoi në kryerjen e krimit.” Aktgjykimi *Ntagerura dhe të tjerë*, para. 659. Duke e mbështetur këtë qasje të përgjithshme, Dhoma e Apelit shprehimisht shtroi pyetjen nëse në bazë të kushtit (a) detyrimi duhej të bazohej në një rregull të së drejtës penale, dhe jo detyrim ligjor. Aktgjykimi i Apelit *Ntagerura dhe të tjerë*, para. 334

¹¹³ Duke konfirmuar këtë formë përgjegjësie për mosveprim të fajshëm, Dhoma e Apelit në çështjen *Galiq* nënvizoi paragrafin 334 të Aktgjykimit të Apelit *Ntagerura dhe të tjerë*, dhe thjesht e cilësoi detyrim ligjor për të vepruar, dhe jo detyrim ligjor na bazë të një rregulle të së drejtës penale. Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 175; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 43.

¹¹⁴ Paragrafi 1 i nenit 7 të Statutit.

¹¹⁵ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para 48.

¹¹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para 229; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para 263; Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 162.

¹¹⁷ Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 90; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para 46; Aktgjykimi *Naletiliq*, para 63, 507.

¹¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para 48; Aktgjykimi i Apelit *Simiq dhe të tjerë*., para. 85.

¹¹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para 165.

¹²⁰ Aktgjykimi *Bërgjanin*, para 273; Aktgjykimi *Stakiq*, para 533.

kriminal,¹²¹ dhe nuk kërkohet që kryesi apo kryesit të kenë qenë të vetëdijshëm për kontributin e të akuzuarit.¹²²

93. Prokuroria vërteton elementët fizikë dhe mendorë të ndihmës dhe inkurajimit duke provuar (a) se i akuzuari qëllimisht kreu një veprim me dijeninë se ky veprim do të ofronte ndihmë konkrete, inkurajim ose mbështetje morale në kryerjen e krimit apo shkeljes bazë,¹²³ dhe (b) se i akuzuari ishte i vetëdijshëm për elementët kyç të krimit ose shkeljes bazë për të cilën akuzohet, ndër të cilët gjendja mendore e kryesit fizik ose të ndërmjetëm.¹²⁴

94. Megjithëse dhënia e ndihmës konkrete, inkurajimit ose mbështetjes morale në vetvete duhet të jetë e qëllimshme, nuk kërkohet ekzistenca e synimit për kryerjen e krimit apo shkeljes bazë.¹²⁵ Çfarë kërkohet është se i akuzuari duhet të ketë patur dijeni se veprimet ose mosveprimet e tij ndihmojnë kryesin fizik ose të ndërmjetëm në kryerjen e krimit ose të shkeljes bazë.¹²⁶ Nuk është e nevojshme që kjo dijeni të jetë shprehur hapët, dhe ajo mund të deduktohet prej rrethanave.¹²⁷ Më tej, megjithëse i akuzuari duhet të jetë i vetëdijshëm së paku për elementët kyç të krimit material ose shkeljes bazë për të cilën akuzohet si ndihmës dhe inkurajues,¹²⁸ nuk është e nevojshme që ai të dijë për mendimet dhe ndjenjat e padukshme të personit ose personave që faktikisht kryen krimin ose shkeljen bazë.¹²⁹ Kushti që ndihmësi dhe inkurajuesi duhet të dijë vetëm për synimin e kryesit fizik ose të ndërmjetëm, dhe duke mos patur domosdoshmërisht të njëjtin synim, vlen njëlloj edhe për krimet ose shkeljet bazë me një synim të përcaktuar si në rastin e përndjekjes, si krim kundër njerëzimit.¹³⁰

¹²¹ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para 143; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para 489-490. (ku i akuzuari gjykohet fajtor për ndihmë dhe inkurajim në përndjekje dhe kryesi fizik ose i ndërmjetëm i krimit nuk u identifikua).

¹²² Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para 229; Aktgjykimi *Simiç dhe të tjerë*, para. 161.

¹²³ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para 49; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102.

¹²⁴ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para 162; Aktgjykimi i Apelit *Simiç dhe të tjerë*, para. 86.

¹²⁵ *Shih* Aktgjykim *Kunarac dhe të tjerë*, para. 392; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, Mendimi Pjesërisht Mospajtues i gjykatësit Shahabuddeen, para. 66:

Synimi duhet provuar gjithmonë, mirëpo synimi i kryesit të gjenocidit nuk është i njëjtë me synimin e ndihmuesit dhe inkurajuesit. Synimi i kryesit është të kryejë gjenocid. Synimi i ndihmuesit dhe inkurajuesit nuk është kryerja e gjenocidit; synimi i tij është të ofrojë mjetet dhe mënyrat nëpërmjet të cilave kryesi mund të realizojë synimin e tij për kryerjen e gjenocidit nëse dëshiron.

¹²⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para 49; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102.

¹²⁷ Aktgjykim *Strugar*, para. 350; Aktgjykimi *Martiq*, para. 451. *Shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 237; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 120, 128.

¹²⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para 50; Aktgjykimi i Apelit *Simiç dhe të tjerë*, para. 86; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para 229.

¹²⁹ Aktgjykimi i Apelit *Aleksovski*, para 162; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 727.

¹³⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 140, 143; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 142-143; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 489.

6. Ndërmarrja e përbashkët kriminale

95. Dhoma e Apelit ka konkluduar se forma e përgjegjësisë e cilësuar “kryerje” në paragrafin 1 të Nenit 7 të Statutit, nënkupton edhe bashkëpjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale.¹³¹

Së pari dhe mbi të gjitha, kjo dispozitë mbulon kryerjen fizike të krimit prej vetë shkelësit, ose moskryerjen e fajshme të një veprimi të detyrueshëm prej një rregulle të drejtës penale. Mirëpo kryerja e njërit prej krimeve të parashtruara në Nenet 2, 3, 4 ose 5 të Statutit, mund të ndodhë edhe nëpërmjet pjesëmarrjes në realizimin e planit apo qëllimit të përbashkët.¹³²

Rrjedhimisht, i akuzuari që ngarkohet me përgjegjësi penale për shkak të pjesëmarrjes së tij në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, logjikisht konsiderohet bashkëkryes, ose bashkëpjesëmarrës në kryerjen e krimit ose shkeljes bazë për të cilën është akuzuar.¹³³ Përgjegjësia penale nëpërmjet pjesëmarrjes në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, mund të ekzistojë në lidhje me çfarëdo krimi apo shkeljeje bazë brenda juridiksionit të Tribunalit,¹³⁴ ndër të cilat krimet ose shkeljet bazë që kërkojnë synim të përcaktuar, si p.sh. përndjekje si krim kundër njerëzimit.¹³⁵

96. Dhoma e Apelit ka konkluduar se në kohën e ngjarjeve në ish-Jugosllavi, në të drejtën zakonore ndërkombëtare ekzistonin tri kategori të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹³⁶ Në

¹³¹ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 79; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para 73; *Prokurori k. Millutinoviçit, Shainoviçit dhe Ojdaniçit*, Lënda Nr. IT-99-37-AR72, Vendim mbi Mocionin e Dragolub Ojdaniçit kundër Juridiksionit mbi Ndërmarrje të Përbashkët Kriminale, 21 maj 2003. para 20; Aktgjykimi i Apelit *Tadiç*, para 188; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para 410. Gjithsesi duhet patur parasysh se në Aktgjykimin e Apelit *Bërgjanin* gjykatësi Meron në një arsyetim të veçantë argumentoi se kur një anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale urdhëron një joanëtar për kryerjen e një krimi që nuk përfshihet në qëllimin e përbashkët kriminal, atëherë anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale do të jenë përgjegjës për urdhërim, por jo për kryerjen e këtij krimi. Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, Mendim i Veçantë i gjykatësit Meron, para 8. Dhoma të ndryshme e kanë cilësuar ndërmarrjen e përbashkët kriminale me fraza të ndryshme si “plan i përbashkët kriminal”, “qëllim i përbashkët kriminal”, “projekt ose qëllim i përbashkët”, “projekt i përbashkët kriminal”, “qëllim i përbashkët”, “projekt i përbashkët”, dhe “projekt i përbashkët i koordinuar”. *Shih për shembull* Aktgjykimi i Apelit *Tadiç*, para . 185, 187-188; 191, 193, 195. 202-204, 225; *Prokurori kundër Bërgjaninit dhe Tadiçit*, Lënda Nr. IT-99-36-PT, Vendim mbi Formën e Aktakuzës së Ndryshuar Sërisht dhe mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshim, 26 qershor 2001, para 24; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviç*, para. 100; *Prokurori k. Millutinoviçit, Shainoviçit dhe Ojdaniçit*, Lënda Nr. IT-99-37-AR72, Vendim mbi Mocionin e Dragolub Ojdaniçit kundër Juridiksionit mbi Ndërmarrje të Përbashkët Kriminale, 21 maj 2003, para 36.

¹³² Aktgjykimi i Apelit *Tadiç*, para 188.

¹³³ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviç*, para. 102; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para 73 (ku rrëzohet konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se ndërmarrja e përbashkët kriminale është formë përgjegjësie e bashkëfajësisë).

¹³⁴ Aktgjykimi i Apelit *Tadiç*, para 188.

¹³⁵ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 240; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para 111.

¹³⁶ Aktgjykimi i Apelit *Tadiç*, para 195-226 (hulumtim i çështjeve gjyqësore për krime lufte pas Luftës së Dytë Botërore; the International Convention for the Suppression of Terrorist Bombing/Konventa Ndërkombëtare për Ndalimin e Sulmeve Terroriste me Bomba hyri në fuqi më 23 maj 2001, UN Doc. A/52/49 (1998); Statuti i Romës; dhe legjislacioni shtetëror përkatës si dhe precedentët gjyqësorë); Aktgjykimi i Apelit *Vasileviç*, para. 96; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para 30-32; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para 364 (citohen Aktgjykimet e Apelit *Tadiç*, *Vasileviç* dhe *Kërnojelac*).

kategorinë e parë ose “bazë” të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, të gjithë anëtarët, që veprojnë në bazë të një qëllimi të përbashkët, kanë të njëjtin synim për kryerjen e krimit ose shkeljes bazë, dhe krimi ose shkelja bazë kryhet prej një ose më shumë prej tyre ose prej të tjerëve që veprojnë me komandën e tyre.¹³⁷ Kategoria e dytë, ndërmarrja e përbashkët kriminale “sistimore” ka si veçori ekzistencën e një sistemi të organizuar kriminal, si p.sh. kampet e burgimit ku të burgosurit keqtrajtohen në bazë të një qëllimi të përbashkët.¹³⁸ Kategoria e tretë, ndërmarrja e përbashkët kriminale “e zgjeruar” përbëhet prej rasteve ku i akuzuari ose cilido anëtar tjetër i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, për realizmin e synimit të përbashkët kriminal përdor persona të cilët veç (ose në vend të) kryerjes së veprimit të fajshëm të krimeve ose shkeljeve bazë që janë pjesë e qëllimit të përbashkët, kryejnë krime ose shkelje bazë që janë jashtë këtij qëllimi. Në një rast të tillë i akuzuari mund të ngarkohet me përgjegjësi për këto krime ose shkelje bazë me kusht që ai të ketë marrë pjesë në qëllimin e përbashkët kriminal me synim realizmin e këtij qëllimi, dhe se në rrethanat e çështjes, (a) logjikisht ishte e parashikueshme për të se personi ose personat e përdorur prej tij (ose prej cilitdo anëtar tjetër të ndërmarrjes së përbashkët kriminale) do të kryenin krimin ose shkeljen bazë për të kryer veprimin e fajshëm të krimeve ose shkeljeve bazë që ishin pjesë e qëllimit të përbashkët dhe (b) ai e mori përsipër këtë rrezik me dëshirën e tij (*dolus eventualis*).¹³⁹

a. Elementët fizikë

97. Dhoma e Apelit ka identifikuar tre elementë të gjerë fizikë të përbashkët për të tri kategoritë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale: (a) një shumësi individësh; (b) ekzistenca e një plani, projekti ose qëllimi të përbashkët që konsiston ose përfshin kryerjen e një krimi ose shkeljeve bazë të përcaktuar në Statut; dhe (c) pjesëmarrja e të akuzuarit në planin, projektin ose qëllimin e përbashkët.¹⁴⁰

i. Ndërmarrja e përbashkët kriminale përbëhet prej dy a më shumë individësh

98. Për ekzistencën e përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale, i akuzuari duhet të bashkëveprojë së paku me një individ tjetër,¹⁴¹ mirëpo nuk është e nevojshme që dy a më shumë individë të cilët përbëjnë ndërmarrjen e përbashkët kriminale, të jenë të organizuar në ndonjë farë strukture ushtarake, politike apo administrative.¹⁴² Dhoma e Apelit ka konkluduar se është e nevojshme “të identifikohet shumësia e individëve që bëjnë pjesë në [ndërmarrjen e përbashkët

¹³⁷ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 197, 220; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365.

¹³⁸ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 202-203, 220; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 89.

¹³⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365, 411; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 33; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 204.

¹⁴⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 364 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*); Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227.

¹⁴¹ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë.*, para. 81; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 364, 439.

kriminale] (edhe pse nuk është i nevojshëm identifikimi me emër i çdo pjesëmarrësi).”¹⁴³ Nuk ekziston kufi i sipërm në lidhje me madhësinë ose shtrirjen e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁴⁴ Në çështjen *Bërgjanin*, Dhoma e Apelit sqaroi se nuk është e nevojshme që kryesi fizik ose i ndërmjetëm i krimit ose shkeljes bazë, të jetë anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁴⁵ Mbi bazën e disa çështjeve gjyqësore të pasluftës së dytë botërore dhe analizës së jurisprudencës së Tribunalit, në çështjen *Bërgjanin* Dhoma e Apelit konkludoi se

Në [ndërmarrjen e përbashkët kriminale] të kategorisë së parë, nuk ka rëndësi që individ i cili kreu veprimin e fajshëm të një krimi konkret të jetë anëtar i [ndërmarrjes së përbashkët kriminale], por që krimi në fjalë të jetë pjesë e qëllimit të përbashkët. Në rastet kur autori kryesor i një krimi konkret nuk është anëtar i [ndërmarrjes së përbashkët kriminale], ky element kyç mund të deduktohet prej rrethanave të ndryshme, përfshirë edhe faktin se i akuzuari apo cilido anëtar tjetër i ndërmarrjes së përbashkët kriminale bashkëpunoi ngushtë me autorin kryesor për realizimin e qëllimit të përbashkët kriminal. Në lidhje me këtë aspekt, kur një anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale përdor një individ jashtë ndërmarrjes së përbashkët kriminale për kryerjen e veprimit të fajshëm të krimit, fakti se individ i në fjalë di për ekzistencën e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, pa u vërtetuar se ai ose ajo ka të njëjtin synim kriminal të nevojshëm për t’u bërë anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, mund të merret parasysh si faktor gjatë përcaktimit nëse krimi është pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal. Mirëpo kjo nuk përbën *sine qua non/domosdoshmëri* për të ngarkuar me përgjegjësinë e krimit atë anëtar të [ndërmarrjes së përbashkët kriminale].¹⁴⁶

99. Dhoma e Apelit në çështjen *Bërgjanin* gjithashtu konkludoi se për shpalljen fajtor të një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, për krime ose shkelje bazë të kryera nga individë të cilët nuk janë anëtarë, duhet provuar (a) se krimi ose shkelja e bazë mund t’i atribuohet një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët kriminale (jo domosdoshmërisht të akuzuarit) dhe (b) se ky anëtar, kur përdori kryesin fizik ose të ndërmjetëm, veprimi në përputhje me planin e përbashkët. Ekzistenca e kësaj lidhjeje duhet përcaktuar rast pas rasti.¹⁴⁷

¹⁴² Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227.

¹⁴³ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para 430. Dhoma Gjyqësore *Bërgjanin* në Aktgjykimin e vet nuk e mori parasysh përgjegjësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale të të akuzuarit dhe disa individëve të tjerë për të cilët Prokuroria kishte argumentuar në gjyq se ishin të tjerë, ndër të cilët anëtarë të policisë serbe, civilë serbë të armatosur dhe individë të pidentifikuar, sepse aktakuza nuk i deklaroi identitetet e këtyre individëve ose grupin të cilit i përkisnin. Aktgjykim *Bërgjanin*, para 346. Gjithsesi Dhoma Gjyqësore mori parasysh mundësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale me pjesëmarrjen e të akuzuarit dhe ushtarakëve ose paraushtarakëve serbë, identitetet e të cilëve nuk njiheshin por grupi të cilit i përkisnin ishte deklaruar në Aktakuzë. Aktgjykim *Bërgjanin*, para 347-355. Ky u la në fuqi prej apelit. Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para 237, 444-449.

¹⁴⁴ *Prokurori k. Karemera-s, Ngirumpatse-s, dhe Nzirorera-s*, Lënda Nr. ICTR-98-44, Vendim mbi Apelimet për Juridiksionin mbi Ndërmarrje të Përbashkët Kriminale, 12 prill 2006, para. 15-16.

¹⁴⁵ Rrjedhimisht nuk është e nevojshme që Prokuroria të provojë se kryesi fizik ose kryesi i ndërmjetëm kishte të njëjtin synim me anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale për kryerjen e krimit që është objekt i ndërmarrjes së përbashkët kriminale. Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 410.

¹⁴⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 410 (poshtëshënimi nuk është përfshirë).

¹⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 413; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 168-169.

ii. *Ekzistenca e një plani, projekti ose qëllimi të përbashkët që konsistonte ose përfshinte kryerjen e një krimi apo shkeljeje bazë të përcaktuar në Statut*

100. Për të tri kategoritë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, Prokuroria duhet të provojë se ekzistonte një “plan, projekt apo qëllim i përbashkët”, që konsistonte ose përfshinte kryerjen e një krimi konkret, ose ndryshe një shkeljeje bazë konkrete të parashtruar në Statutin e Tribunalit.¹⁴⁸

101. Për kategorinë e parë dhe të tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale që kanë lidhje me çështjen aktuale, kushti i vërtetimit të ekzistencës së një plani, projekti apo qëllimi të përbashkët për kryerjen e një krimi apo shkeljeje bazë, plotësohet kur Prokuroria provon se i akuzuari dhe së paku një individ tjetër, i cili mund të jetë ose të mos jetë /kryesi fizik ose i ndërmjetëm, kanë rënë dakord shprehimisht ose në mënyrë nënkuptuese për kryerjen e një krimi ose shkeljeje bazë konkrete.¹⁴⁹ Lidhur me formën e parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, kushti kyç për atribuimin e përgjegjësisë së ndërmarrjes së përbashkët kriminale një anëtar i saj për një krim të kryer nga një individ tjetër, është se krimi ose shkelja bazë në fjalë është pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal. Në rastet kur individi i cili kreu veprimin e fajshëm të krimit ose shkeljes bazë në fjalë nuk është anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, pika kyçe është përcaktimi nëse krimi ose shkelja bazë në fjalë është pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal.¹⁵⁰ Ky përcaktim mund të deduktohet prej faktit se i akuzuari ose cilido anëtar tjetër i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, bashkëpunoi ngushtë me kryesin fizik ose të ndërmjetëm për realizimin e ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁵¹

102. Për të tri kategoritë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, nuk është e nevojshme që qëllimi i përbashkët të jetë formuluar ose miratuar më parë, mjafton të sendërtohet spontanisht.¹⁵² Dhoma mund të konkludojë se ka ekzistuar një plan apo qëllim i përbashkët nëpërmjet shqyrtimit të tërësisë së rrethanave të kryerjes së krimit ose shkeljes bazë.¹⁵³ Për shembull, mënyra e kryerjes së krimit

¹⁴⁸ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227; Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 81.

¹⁴⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 80; *Shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 415.

¹⁵⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 418; Aktgjykimi *Martiq*, para. 438.

¹⁵¹ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 410; Aktgjykimi *Martiq*, para. 438.

¹⁵² Dhoma e Apelit në çështjen *Bërgjanin* konkludoi si vijon:

Dhoma e Apelit nuk gjykon se çfarëdo forme e përgjegjësisë së NPK-së dikton mirëkuptim ose marrëveshje shtesë midis të Akzuarit dhe autorit kryesor për kryerjen e një krimi konkret. Gjithsesi NPK-ja dikton ekzistencën e një qëllimi të përbashkët i cili përbën ose përfshin kryerjen e një krimi. Nuk është e nevojshme që qëllimi i përbashkët të jetë miratuar ose formuluar më parë; ai mund të sendërtohet spontanisht.

Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 418 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227(iii)); *shih* Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 123.

¹⁵³ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100; Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*, para. 466; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para 699, 721 (ku ekzistenca e një plani të përbashkët për vrasje, shfarosje dhe përndjekje në Srebrenicë deduktohet prej faktit se mbi 7.000 burra dhe djem myslimanë, u kapën, u burgosën, u vranë dhe u varrosën në pesë ditë dhe pohohet se “kjo nuk do të kishte qenë e mundshme pa një plan dhe bashkërendim midis anëtarëve të ndërmarrjes së përbashkët kriminale”).

ose shkeljes bazë mund të çojë në konkluzionin se duhet të jetë bërë në përputhje me një plan të përbashkët.¹⁵⁴ Në këto raste, Prokurorisë nuk i kërkohet të paraqesë prova dokumentare ose prova të tjera të qarta për ekzistencën e planit.¹⁵⁵

iii. *I Akuzuari mori pjesë në planin, projektin ose qëllimin e përbashkët*

103. Për ngarkimin me përgjegjësi të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, i akuzuari duhet të ketë marrë pjesë së paku në një aspekt të planit, projektit ose qëllimit të përbashkët që ka lidhje me kryerjen e krimit ose shkeljes bazë të përcaktuar në Statut.¹⁵⁶ Për plotësimin e këtij kushti, nuk është e nevojshme që i akuzuari të ketë kryer fizikisht krimin ose shkeljen bazë që është objekt i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, ose çfarëdo shkelje tjetër.¹⁵⁷ Në fakt, nuk është e nevojshme madje as që ai të ketë qenë i pranishëm në kohën dhe vendin e kryerjes fizike të krimit ose shkeljes bazë.¹⁵⁸ Për më tepër, në ndryshim nga ndihma dhe inkurajimi, nuk është e nevojshme që i akuzuari i cili akuzohet për përgjegjësi për një krim ose shkelje bazë për shkak të pjesëmarrjes së tij në një ndërmarrje të përbashkët kriminale, të veprojë ose të mos veprojë në një mënyrë që ndihmon, inkurajon ose ofron mbështetje morale një individ tjetër në kryerjen e krimit ose shkeljes bazë.¹⁵⁹ Kërkohet vetëm që i akuzuari të veprojë ose të mos veprojë “në një farë mënyre ... përqëndruar në realizimin e planit ose qëllimit të përbashkët.”¹⁶⁰ Në çështjen *Galiq*, Dhoma e Apelit deklaroi se mosveprimi mund të çojë në përgjegjësi bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7, kur ekziston detyrim ligjor për të vepruar.¹⁶¹ Në përputhje me këtë qasje, në çështjen *Kvoçka dhe të tjerët*, Dhoma e Apelit konkludoi se i akuzuari mund të marrë pjesë në një ndërmarrje të përbashkët kriminale nëpërmjet mosveprimit në vend të veprimit.¹⁶² Megjithatë në atë çështje Dhoma e Apelit diskutoi kategorinë e dytë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duke mbajtur parasysht se kushti i

¹⁵⁴ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100, 109; Aktgjykimi i Apelit *Furunxhija*, para. 119; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 227; Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*, para. 466; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 699; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 262; Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 158; Aktgjykimi *Kërnojelac* para. 80 (“*Rrethanat në të cilat dy ose më shumë persona marrin pjesë bashkërisht në kryerjen e një krimi konkret në vetvete mund të provojnë një mirëkuptim apo organizim të heshtur që përbën marrëveshje midis tyre në atë vend dhe në atë kohë për të kryer krimin në fjalë*”) (theksi është shtuar); Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 611.

¹⁵⁵ *Shih* Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 353.

¹⁵⁶ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 100, 119; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 197, 227; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

¹⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 99; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

¹⁵⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 81; *shih edhe* Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 158.

¹⁵⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 45, 50 (ku konkludohet se ndihmuesi dhe inkurajuesi duhet të ketë ditur se veprimet ose mosveprimet e tij ndihmuan në kryerjen e krimit konkret për të cilin akuzohet në bazë të paragrafit 1 të Nenit 7; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 102.

¹⁶⁰ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 229; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 187 (qartësohet se kontributi i nevojshëm mund të realizohet nëpërmjet një veprimi apo mosveprimi); Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427.

¹⁶¹ Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 175.

¹⁶² Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 309; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427; Aktgjykimi *Mpambara*, para. 24 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 195).

pjesëmarrjes së të akuzuarit në planin, projektin ose qëllimin e përbashkët, është i përbashkët për të tri kategoritë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, Dhoma gjykon se pjesëmarrja nëpërmjet mosveprimit mund të vlejë edhe për dy format e tjera të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, me kusht që mosveprimi i të akuzuarit të përbëjë kontribut të konsiderueshëm në planin e përbashkët kriminal.

104. Në çështjen *Bërgjanin*, Dhoma e Apelit gjykoj se “jo çdo lloj veprimi përbën kontribut të konsiderueshëm në atë masë sa i akuzuari të mbajë përgjegjësi penale për krimin në fjalë”.¹⁶³ Konkluzioni vijon më tej se, “megjithëse nuk është e nevojshme që kontributi i të akuzuarit të jetë i domosdoshëm ose thelbësor, kontributi duhet të jetë së paku i konsiderueshëm për krimet për cilat i akuzuari konsiderohet përgjegjës.”¹⁶⁴

105. Për më tepër, veprimet dhe mosveprimet e të akuzuarit “duhet të formojnë një hallkë në zinxhirin e shkakësisë”,¹⁶⁵ dhe rëndësia e kontributit të tij ndikon në përcaktimin e ekzistencës ose mosekzistencës së kësaj hallke. Kryerja faktuale fizike e një krimi apo shkeljeje bazë prej të akuzuarit, megjithëse nuk është kusht për përgjegjësinë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale, priret të mbështesë konkluzionin se pjesëmarrja e tij ishte e konsiderueshme nëqoftëse krimi ose shkelja bazë shkoi në dobi të qëllimit të përbashkët. Gjithashtu në dobi të konkluzionit se pjesëmarrja e tij ishte e konsiderueshme kontribuojnë edhe pozita udhëheqëse e të akuzuarit dhe heshtja e tij miratuese,¹⁶⁶ dhe ndonëse figurat e nivelit të ulët dhe të mesëm mund të mbajnë përgjegjësi të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, në shumicën e rasteve i akuzuari nuk është dikush që mund të zëvendësohet lehtësisht.¹⁶⁷ Ndër faktorë të tjerë që merren parasysh në përcaktimin e mjaftueshmërisë së nivelit të pjesëmarrjes së të akuzuarit në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, janë madhësia e ndërmarrjes kriminale, funksionet e kryera prej të akuzuarit dhe efektshmëria e kryerjes së tyre, dhe përpjekjet prej të akuzuarit për të penguar funksionimin e efektshëm të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁶⁸

106. Meqenëse bazuar në paragrafin 1 të Nenit 7, ndërmarrja e përbashkët kriminale është një formë e “kryerjes”, i akuzuari i fajësuar për pjesëmarrje në ndërmarrjen e përbashkët kriminale, është fajtor për krimin material ose shkeljen bazë të kryer, pavarësisht prej rolit që luajti në

¹⁶³ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 427 (poshtëshënimi nuk përfshihet).

¹⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 430.

¹⁶⁵ Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 702 (citohet Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 263).

¹⁶⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 101, 192 (ku theksohet se megjithëse pozita e pushtetit të të akuzuarit është relevante për të provuar dijeninë e tij për sistemin dhe pjesëmarrjen e tij për vazhdimin e qëllimit kriminal të sistemit, ajo është vetëm një ndër faktorët që Dhoma shqyrton kur konkludon nëse i akuzuari mori pjesë në qëllimin e përbashkët); Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 292, 309.

¹⁶⁷ Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 309.

¹⁶⁸ Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 311.

ndërmarrjen e përbashkët kriminale.¹⁶⁹ Gjithsesi në përcaktimin e dënimit për një të akuzuar konkret, mund të merret parasysh rëndësia relative e rolit të atij të akuzuari në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.¹⁷⁰

b. Elementët mendorë

107. Varësisht prej pak përjashtimeve të lartpërmendura, tri kategoritë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale kanë të njëjtët elementë fizikë. Ndryshimet më të mëdha midis kategorive gjenden në elementët mendorë.¹⁷¹ Duke marrë parasysh faktin se në çështjen në fjalë të Akuzuarit akuzohen për përgjegjësi në krimet e përmendura në Aktakuzë vetëm në lidhje me kategorinë e parë dhe të tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, këtu nuk janë shtjelluar elementët mendorë të kategorisë së dytë.

iv. Elementët mendorë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale

108. Prokuroria duhet të provojë se i akuzuari mori pjesë vullnetarisht së paku në një aspekt të qëllimit të përbashkët¹⁷² dhe për më tepër, se i akuzuari kishte të njëjtin synim të kryerjes së krimit ose shkeljes bazë me anëtarë të tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁷³ Megjithëse Dhomat përgjithësisht bëjnë dallim midis kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe kategorisë së tretë nëpërmjet pohimit se në lidhje me kategorinë e parë të gjithë anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët duhet të kenë të njëjtin synim,¹⁷⁴ nuk është e nevojshme që Prokuroria të provojë si element të kategorisë së parë se çdo individ për të cilin pretendohet të ketë qenë anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, kishte të njëjtin synim të kryerjes së krimit ose shkeljes bazë që është objekt i ndërmarrjes së përbashkët kriminale.¹⁷⁵

¹⁶⁹ Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 111; Aktgjykim *Bllagojeviq*, para. 702; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 64.

¹⁷⁰ Vendimi *Babiq* mbi Apelimin e Dënimit, para. 40; *shih edhe* Aktgjykim *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 282 (miratues ndaj dallimit bërë prej Tribunalit Ushtarak të SHBA-së në çështjen *The United States of America v. Otto Ohlenforf et al.*, Trials of War Criminals Before the Nuremberg Military Tribunals under Control Council Law No. 10 (1950), vol. IV, p. 373 (“*Einsatzgruppen* case”), midis kontribuuesve të qenësishëm dhe jo të qenësishëm në ndërmarrjen e përbashkët kriminale nëpërmjet dhënies së dënimeve më të rënda për fajtorët më të mëdhenj në aspektin moral).

¹⁷¹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 228; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 365.

¹⁷² Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 119; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 196; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para 365; Aktgjykim *Bllagojeviq*, para 703.

¹⁷³ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 110; Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para 365, 429.

¹⁷⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para 82; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 84; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 196; Aktgjykimi i Apelit *Ntakirutimana*, para. 467; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para 703; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 264; Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 156, 157, 160; Aktgjykimi *Vasileviq*, para. 64; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 65; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 879, 883.

¹⁷⁵ *Shih* Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 995-997, 1009-1011, 1017-1019 (ku përcaktohet nëse plotësoheshin elementët mendorë të kategorisë së parë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale duke shqyrtuar vetëm synimin e të Akuzuarit dhe kryesit fizik ose të ndërmjetëm).

109. Lidhur me ndërmarrjen kriminale të kategorisë së parë, ku objekti kriminal është krimi me synim të përcaktuar, Prokuroria jo vetëm duhet të provojë se i akuzuari kishte synim të përbashkët me të tjerët për kryerjen e shkeljes bazë, për shembull synimi për të vrarë në kuadrin e “vrasjes” si shkelje bazë për përndjekjen si krim kundër njerëzimit, ose “vrasja e anëtarëve të grupit” si shkelje bazë për gjenocid, por gjithashtu edhe se ai kishte synim të përcaktuar të përbashkët me anëtarët e tjerë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale për kryerjen e krimit ose shkeljes bazë.¹⁷⁶ Rrjedhimisht, në lidhje me përndjekjen, i akuzuari duhet të ketë patur të njëjtin synim për të diskriminuar një grup nën mbrojtje.¹⁷⁷

v. Elementët mendorë të kategorisë së tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale

110. Që i akuzuari të mbajë përgjegjësi për një krim apo shkelje bazë që nuk përfshihet në qëllimin e përbashkët të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, Prokuroria duhet të provojë se ai synonte të merrte pjesë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe të realizonte objektivat e saj kriminale,¹⁷⁸ por nuk është e nevojshme të provojë se i akuzuari kishte synim—të përgjithshëm ose konkret¹⁷⁹—për kryerjen e krimit ose shkeljes bazë të kryer. Dhoma e Apelit ka konkluduar se, “kategoria e tretë e ndërmarrjes së përbashkët kriminale nuk është e ndryshme prej formave të tjera të ndërmarrjes së përbashkët kriminale që nuk kërkojnë të provohet synimi i të akuzuarit për kryerjen e një krimi para atribuimit të përgjegjësisë penale.”¹⁸⁰

111. Veç synimit për pjesëmarrje në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe synimit për realizimin e objektivave të saj, Prokuroria duhet të provojë një nënelement të tretë mendor, përshkruar si më poshtë prej Dhomës së Apelit në *Kvoçka dhe të tjerë*:

Për fajësimin me përgjegjësi për krime të cilat nuk ishin pjesë e qëllimit të përbashkët kriminal, por gjithsesi ishin pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme e tij, i akuzuari duhet gjithashtu të dijë se një krim i tillë mund të kryhet prej një anëtari tjetër të grupit, dhe të marrë përsipër me vullnet të lirë rrezikun e gjasës së krimit nëpërmjet pjesëmarrjes

¹⁷⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 110.

¹⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 110; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 111; Aktgjykimi *Simiqi dhe të tjerë*, para 156 (konkludohet se një i akuzuar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale të kategorisë së parë i akuzuar për përndjekje, duhet të ketë pasur synim diskriminues), para. 997 (ku Simiqi gjykohet fajtor për përndjekje pas konkluzionit se ai “kishte të njëjtin synim me pjesëmarrësit e tjerë në ndërmarrjen e përbashkët kriminale për të arrestuar dhe burgosur civilë joserbë në Bosanski Shamac, Bërçko, dhe Bijelinë, dhe pas deduksionit se ai “nuk mund të ketë pranuar vazhdimin e arrestimeve dhe burgimeve të civilëve joserbë ... pa patur synim diskriminues”); Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 487 (konkludohet se Prokuroria nuk kishte provuar si duhej “synimin e vetëdijshëm diskriminues” të të akuzuarit, se “I Akuzuari nuk kishte synim të përbashkët për kryerjen e çfarëdo krimi bazë të akuzuar si përndjekje në kuadrin e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale, dhe se rrjedhimisht “krimi i përndjekjes nuk mund të vërtetohet mbi bazën e ndonjërit prej këtyre krimeve bazë në kuadrin e një ndërmarrjeje të përbashkët kriminale në të cilën mori pjesë i Akuzuari”).

¹⁷⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 83; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 220.

¹⁷⁹ Vendimi *Bërgjanin* i Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 6.

¹⁸⁰ Vendimi *Bërgjanin* i Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 7; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 232-237.

së tij ose vazhdimet të pjesëmarrjes së tij në ndërmarrjen kriminale.¹⁸¹

Në Aktgjykimet e ndryshme të Dhomave Gjyqësore dhe të Apelit është konkluduar se i akuzuari duhet të jetë i vetëdijshëm se një krim apo shkelje bazë e tillë (a) ishte “pasojë e natyrshme dhe e parashikueshme” e qëllimit të përbashkët,¹⁸² (b) ishte pasojë e ndodhshme e ndërmarrjes së përbashkët kriminale,¹⁸³ (c) kishte “shumë të ngjarë” të ndodhte,¹⁸⁴ ose (d) thjesht ishte pasojë e mundshme sesa kishte gjasë të konsiderueshme të ndodhte.¹⁸⁵ Dhoma Gjyqësore do të adoptojë formulimin e Dhomës së Apelit se mbi bazën e informacionit që disponon i akuzuari, duhet të jetë logjikisht e parashikueshme se do të kryhej krim ose shkelje bazë.¹⁸⁶

112. Dhoma e Apelit ka konkluduar se krimi ose shkelja bazë përshkruar më sipër, për të cilën i akuzuari akuzohet bazuar në kategorinë e tretë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duhet të jetë kryer faktikisht.¹⁸⁷ Rrjedhimisht fajësia për këtë lloj përgjegjësie nuk mund të jetë e paqartë: i akuzuari nuk mund të gjykohet përgjegjës edhe po të ketë qenë i vetëdijshëm se krimi ose shkelja bazë ishte logjikisht e parashikueshme, nëqoftëse në fund të fundit krimi ose shkelja bazë nuk u krye.

7. Përgjegjësia e eprorit

113. Parimi i përgjegjësisë penale individuale të eprorëve për mosparandalimin ose mosndëshkimin e krimeve ose shkeljeve bazë kryer prej vartësve të tyre, ishte më së miri e sanksionuar në të drejtën zakonore dhe në të drejtën e traktateve ndërkombëtare, në kohën e ngjarjeve në ish-Jugosllavi,¹⁸⁸ i vlefshëm jo vetëm për konfliktet e armatosura ndërkombëtare, por edhe për jondërkombëtare.¹⁸⁹ Që i akuzuari të gjykohet përgjegjës bazuar në paragrafin 3 të Nenit 7, vartësi i tij duhet të ketë kryer një veprim që sipas Statutit të Tribunalit përbën krim apo shkelje

¹⁸¹ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 83; Aktgjykimi *Mërkshiq dhe të tjerë*, para. 546.

¹⁸² Aktgjykim *Bërgjanin*, para. 265; *shih edhe Prokurori k. Bërgjaninit dhe Taliqit*, Lënda Nr. IT-99-36-PT, Vendim mbi Formën e Aktakuzës së Ndryshuar Sërish dhe mbi Kërkesën e Prokurorisë për Ndryshim, 26 qershor 2001, para. 30; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq. Shih* Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 204.

¹⁸³ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 150.

¹⁸⁴ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 220.

¹⁸⁵ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 33.

¹⁸⁶ Vendimi *Bërgjanin* i Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale mbi Apelin e Ndërkohshëm, para 5; Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 83.

¹⁸⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 150; Vendimi *Bërgjanin* i Ndërmarrjes së Përbashkët Kriminale mbi Apelin e Ndërkohshëm, para 5.

¹⁸⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 78, 85; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 63; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, para. 195.

¹⁸⁹ Vendimi *Haxhihasanoviq* i Përgjegjësisë Komanduese mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 31; *shih edhe* Aktgjykimi *Strugar*, para. 357.

bazë, dhe i akuzuari, ose duhet të mos ketë parandaluar vartësin prej kryerjes së krimit ose shkeljes bazë, ose të mos e ketë ndëshkuar vartësin pas kryerjes së krimit ose shkeljes bazë.¹⁹⁰

114. Dhoma e Apelit ka konkluduar se eprori mund të mbajë përgjegjësi kur vartësi planifikon, nxit, urdhëron, kryen, ose ndihmon dhe inkurajon një krim nën juridiksionin e Tribunalit, me kusht që të plotësohen elementët e tjerë të përgjegjësive së eprorit.¹⁹¹ Përgjegjësia penale e eprorit për krime ose shkelje bazë të kryera prej vartësve përfshin edhe kryerjen nëpërmjet mosveprimit.¹⁹² Si pasojë, megjithëse Dhoma Gjyqësore do të përdorë termin “kryerje” në deklarata të përgjithshme në diskutimet për paragrafin 3 të Nenit 7, kjo nuk duhet konsideruar si mbështetje e pikëpamjes se përgjegjësia e eprorit ka të bëjë vetëm me mosparandalimin dhe/ose mosndëshkimin e vartësve përgjegjës për kryerjen e krimeve ose shkeljeve bazë nëpërmjet veprimeve të tyre.

115. Që i akuzuari të gjykohet përgjegjës për kryerjen e një krimi apo shkeljeje bazë sipas paragrafit 3 të Nenit 7, duhen plotësuar tre elementë: (a) duhet të ketë ekzistuar lidhje epror-vartës midis të akuzuarit dhe individit ose individëve që kryen krimin ose shkeljen bazë; (b) eprori duhet të ketë ditur ose kishte arsye të dinte se do të kryhej, po kryhej ose ishte kryer krimi ose shkelja bazë; dhe (c) i akuzuari nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e vartësit ose vartësve prej kryerjes së krimit ose shkeljes bazë, dhe/ose për ndëshkimin e tyre pas kryerjes së krimit ose shkeljes bazë.¹⁹³ Dhoma Gjyqësore diskuton secilin prej këtyre tre elementëve më poshtë.

116. Detyrimi për parandalim dhe detyrimi për ndëshkim janë përgjegjësi të ndryshme dhe të ndara në të drejtën ndërkombëtare dhe mospërbushja e cilitdo prej këtyre dy detyrimeve mund të çojë në akuzën përkatëse në një aktakuzë.¹⁹⁴ Eprori i akuzuar nuk mund të kompensojë mosparandalimin e kryerjes së krimit ose shkeljes bazë thjesht nëpërmjet ndëshkimit të keqbërësve më pas. Me fjalë të tjera, edhe sikur eprori të përmbushë detyrimin e tij ligjor për ndëshkimin e keqbërësve, gjithsesi ai mund të shpallet fajtor për krimet ose shkeljet bazë që ata kryen, sepse në radhë të parë ai nuk e parandaloi kryerjen.¹⁹⁵ Me gjithë faktin se mosparandalimi dhe

¹⁹⁰ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 900.

¹⁹¹ Aktgjykimi i Apelit *Nahimana dhe të tjerë* para. 485–486 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Bllagojeviq*, para. 280-282); *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 47.

¹⁹² Aktgjykimi i Apelit *Oriq*, para. 21, 43.

¹⁹³ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 839; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 59.

¹⁹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 259; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 83.

¹⁹⁵ Aktgjykimi *Strugar*, para. 373 (ku konkludohet se, “nëqoftëse ka dijeni ose ka arsye të dijë se po kryhet ose do të kryhet krim, ai ka detyrë ta parandalojë kryerjen e krimit dhe nuk ka të drejtë të presë dhe të ndëshkojë pas ndodhisë”); Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 793 (ku konkludohet se “mosmarrja e masave të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e një shkeljeje për të cilën eprori dinte ose kishte arsye të dinte nuk mund të kompensohet thjesht duke e ndëshkuar vartësin për kryerjen e shkeljes më pas”); Aktgjykimi *Semanza*, para. 407 (nëqoftëse eprori është në dijeni për një krim që është në prag të kryerjes ose po kryhet, ai duhet të marrë masa të nevojshme dhe të arsyeshme për ta

mosndëshkimi janë forma të veçanta përgjegjësie, shumica e kushteve të përgjegjësive për këto dy forma janë të njëjta, përfshirë edhe kushtet e ekzistencës së lidhjes epror-vartës, se i akuzuari duhet të ketë ditur ose kishte arsye të dinte për krimet ose shkeljet bazë të vartësit, dhe se i akuzuari nuk mori masa të nevojshme dhe të arsyeshme.

- a. Midis të akuzuarit dhe individit ose individëve që kryen krimin ose shkeljen bazë, ekzistonte lidhja epror-vartës

117. Në lidhje me përgjegjësinë bazuar në paragrafin 3 të Nenit 7, nuk është i nevojshëm caktimi formal si komandant ose epror: një përgjegjësi e tillë mund të burojë prej pushtetit *de facto* dhe *de jure* të eprorit mbi autorët e krimin ose shkeljes bazë.¹⁹⁶ Thelbi i vërtetimit të ekzistencës së lidhjes epror-vartës, *de facto* apo *de jure*, ushtarak apo civil, është ushtrimi i kontrollit efektiv prej tij ndaj veprimeve të personave për të cilët pretendohet se ishin vartës.¹⁹⁷ Me fjalë të tjera, i akuzuari duhet të ketë patur aftësinë materiale për parandalimin ose ndëshkimin e shkeljeve të kryera prej personave që pretendohet se ishin vartës të tij.¹⁹⁸

118. Rrjedhje e rëndësishme e standardit të kontrollit efektiv është se përgjegjësia bazuar në paragrafin 3 të Nenit 7, mund të ekzistojë si prej lidhjes së drejtpërdrejtë, po ashtu edhe të tërthortë të varësisë; çdo person në hierarkinë komanduese i cili ushtron kontroll efektiv mbi vartësit, është përgjegjës për krimet ose shkeljet bazë të këtyre vartësve, me kusht që të plotësohen edhe kushtet e tjera të paragrafit 3 të Nenit 7, pavarësisht prej rangut hierarkik të vartësve.¹⁹⁹

- b. I akuzuari duhet të ketë ditur ose kishte arsye të dinte se krimi ose shkelja bazë do të kryhej, po kryhej ose ishte kryer

119. Koncepti se i akuzuari duhet të ketë patur dijeni ose arsye të dinte për kryerjen e krimin ose shkeljes bazë për të cilën akuzohet, përmban në vetvete kushtin se ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit e tij kanë përmbushur, po përmbushin ose do të përmbushin të gjithë elementët e atij

ndaluar ose parandaluar kryerjen. Eprori që ka dijeninë dhe aftësinë materiale për parandalimin e kryerjes së krimin, nuk e përmbush përgjegjësinë thjesht nëpërmjet ndëshkimit të mëpasshëm të vartësit”) (poshtëshënimi nuk përfshihet)

¹⁹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 191-192; Aktgjykimi i Apelit *Kajelijeli*, para. 85.

¹⁹⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bagilishema*, para. 56 (ku konkludohet se “bazuar në jurisprudencën e Tribunalëve Ndërkombëtarë bëhet i detyrueshëm kushti i kontrollit efektiv për eprorët *de jure* dhe *de facto*”).

¹⁹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 840; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 67, 375; Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 59 (ku konkludohet se “bazuar në pozitën e tij, i akuzuari duhet të jetë epror ndaj keqbërësit në një farë hierarchie formale ose joformale”).

¹⁹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 67; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 252; Aktgjykimi *Strugar*; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 791; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 276.

krimi ose shkeljes përkatëse.²⁰⁰ Si pasojë, në lidhje me përndjekjen i akuzuari duhet të ketë patur dijeni ose kishte arsye të dinte se vartësit përkatës kishin synim diskriminues.²⁰¹

120. I akuzuari ka “arsye të dijë” në qoftë se ai ka në dispozicion informacion që e bën të vetëdijshëm për nevojën e hetimit të mëtejshëm,²⁰² për të qartësuar nëse vartësit e tij do të kryenin, po kryenin ose kishin kryer veprime që përbëjnë krim ose shkelje bazë parashtuar prej Statutit të Tribunalit.²⁰³ Nuk është e nevojshme që informacioni të jetë konkret; për shembull në qoftë se një komandant ushtarak ka marrë informacion se disa prej ushtarëve në komandën e tij kanë karakter të dhunshëm ose të paqëndrueshëm, ose se kanë qenë duke pirë para se të dërgohen me mision, mund të gjykohet se ai ka dijeninë e kërkuar.²⁰⁴ Nuk kërkohet që ai vetë të jetë njohur me këtë informacion: mjafton që informacioni të jetë në dispozicion të tij.²⁰⁵ Dhomat Gjyqësore kanë konkluduar se në këtë aspekt ndaj eprorëve joushtarakë duhet imponuar kusht më i rreptë se ndaj ushtarakëve,²⁰⁶ mirëpo kjo Dhomë i qëndron qasjes së Dhomës së Apelit në çështjen *Çelebiqi* e cila nuk bëri dallim midis dy kategorive të eprorëve.²⁰⁷ Gjithashtu nëqoftëse eprori qëllimisht tërhiqet prej marrjes së informacionit të mëtejshëm, me gjithë mundësinë që ka, ai gjykohet se ka patur “arsye të dinte”.²⁰⁸ Mirëpo detyrimi i të akuzuarit për të hetuar më tej, fillon vetëm prej momentit kur ai ka në dispozicion informacion paralajmërues, dhe thjesht moskërkimi i një informacioni të tillë, në vetvete nuk shkakton përgjegjësi bazuar në paragrafin 3 të Nenit 7.²⁰⁹

²⁰⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac* para. 155; *shih edhe* Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 393.

²⁰¹ *Shih* Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 721; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 187-188.

²⁰² Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 238; Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviç*, para. 28 (ku konkludohet se “informacioni mund të jetë i përgjithshëm dhe nuk është e nevojshme të përfshihen hollësi konkrete në lidhje me veprimet e paligjshme që janë kryer ose janë në prag të kryerjes”, por gjithsesi “duhet të jetë mjaftueshmërisht alarmues për të përligjur hetim të mëtejshëm” (poshtëshënimi nuk përfshihet); Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 304 (ku konkludohet se kushti ka të bëjë me faktin nëse “ekziston informacion mjaftueshmërisht alarmues që e paralajmëron eprorin për *gjasën* e kryerjes së mëvonshme të krimeve prej vartësve të tij” (është shtuar theksi)

²⁰³ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiç*, para. 62; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac* para. 154; Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 298.

²⁰⁴ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 238; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac* para. 154.

²⁰⁵ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 239; Aktgjykimi *Mërkshiq dhe të tjerë*, para. 564.

²⁰⁶ Aktgjykimi *Muvunyi* para. 473 (ku citohet dhe miratohet Aktgjykimi *Kayishema*, para. 227–228). Në të dy aktgjykimet citohet neni 28 i Statutit të Romës.

²⁰⁷ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 239.

²⁰⁸ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 226; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiç*, para. 406; Aktgjykimi *Mërkshiq dhe të tjerë*, para. 564.

²⁰⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiç*, para. 62–64 (ku rrëzohet konkluzioni i Dhomës Gjyqësore se eprori ka “arsye të dijë” në qoftë se mungesa e dijenisë është pasojë e shkujdesjes së tij në përmbushjen e detyrimeve); Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 226 (ku konkludohet se paragrafi 3 i Nenit 7 ka të bëjë me përgjegjësinë e eprorit prej mosveprimit pavarësisht dijenisë, mirëpo pakujdesia në detyrën për marrjen e dijenisë nuk figuron në dispozitë si shkelje e veçantë dhe rrjedhimisht në bazë të kësaj dispozite eprori nuk është përgjegjës për mosmarrjen e dijenisë por vetëm për mosmarrjen e masave të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalim ose ndëshkim); Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 317 (“Paragrafi 3 i Nenit 7 nuk imponon detyrim ndaj eprorit që ai të bëjë të pamundurën për të marrë informacion për krime të kryera nga vartësit, në qoftë se ai nuk paralajmërohet në një ndonjë mënyre se po ndodhin veprime kriminale.”).

- c. I akuzuari nuk mori masa të nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin dhe/ose ndëshkimin e krimeve ose shkeljeve bazë të vartësit ose vartësve

121. Për cilëndo prej formave të përgjegjësive në paragrafin 3 të Nenit 7, Prokuroria duhet të provojë se i akuzuari nuk mori masa të nevojshme dhe të arsyeshme.²¹⁰ Meqenëse vlerësimi se çfarë masash përbëjnë masa të nevojshme dhe të arsyeshme “nuk ka të bëjë me të drejtën materiale, por me provat”,²¹¹ Dhoma nuk duhet të abstragojë në lidhje me këto masa, por duhet të marrë parasysh të tëra rrethanat e çështjes konkrete që gjykon.²¹²

122. Në përcaktimin nëse masat e marra prej të akuzuarit në rrethanat ekzistuese, ishin të nevojshme dhe të arsyeshme, Dhoma mbështetet kryesisht në nivelin e kontrollit efektiv ushtruar prej të akuzuarit, me fjalë të tjera në aftësinë e tij materiale për parandalimin dhe/ose ndëshkimin e krimeve ose shkeljeve bazë të vartësve të tij.²¹³ Masa “të nevojshme” janë masat e marra prej eprorit, të përshtatshme për kryerjen e detyrimit ligjor, që tregojnë përpjekje të njëmendtë për parandalim ose ndëshkim, dhe masa “të arsyeshme”, janë masat që logjikisht përfshihen në kompetencat materiale të eprorit.²¹⁴ Megjithëse eprori “nuk është i detyruar të bëjë të pamundurën”,²¹⁵ Dhoma e Apelit ka konkluduar se ai është i detyruar të marrë të gjitha masat brenda mundësisë së tij materiale.²¹⁶ Gjithashtu, eprori nuk mund ta përmbushë detyrimin nëpërmjet nxjerrjes së urdhrave “rutinorë”, dhe çfarëdo mase e marrë prej tij, duhet të jetë konkrete dhe e lidhur ngushtë me veprimet që synohet të parandalohen.²¹⁷ Meqenëse paragrafi 3 i Nenit 7 nuk përmban kushte të shkakësisë, nuk kërkohet që mosmarrja e masave të nevojshme dhe të arsyeshme prej eprorit për parandalimin e krimeve ose shkeljeve bazë të vartësve të tij, të ketë shkaktuar krimet ose shkeljet bazë.²¹⁸

²¹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 72; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 461; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 294; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi* para. 346.

²¹¹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 72.

²¹² Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 417; Aktgjykimi *Strugar* para. 378 (renditen lloje rrethanash që mund të jenë të vlefshme për një hulumtim “të nevojshëm dhe të arsyeshëm”, i përqëndruar ndër të tjera në faktin nëse u lëshuan urdhra konkretë për ndalimin ose që ndalonin veprime kriminale; çfarë masash u morën ose nuk u morën për zbatimin e këtyre urdhrave; dhe, pas kryerjes së krimit, çfarë hapash u ndërmorën për garantimin e një hetimi të përshtatshëm dhe për nxjerrjen e keqbërësve para drejtësisë); Aktgjykimi *Kordiq*, para. 445.

²¹³ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 72; Aktgjykimi i Apelit *Kayishema*, para. 302; Aktgjykimi *Strugar* para. 372.

²¹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Haliloviq*, para. 63.

²¹⁵ Aktgjykimi *Kërnojelac* para. 95; Aktgjykimi *Oriq* para. 329.

²¹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 417; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Bagilishema*, para. 35; Aktgjykimi i Apelit *Kayishema*, para. 302.

²¹⁷ Aktgjykimi *Haxhihasanoviq*, para. 153, 155; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Haxhihasanoviq*, para. 33 (ku pohohet se përkufizimi i masave “të nevojshme dhe të arsyeshme” ka të bëjë me provat dhe jo me të drejtën materiale, dhe hidhet poshtë argumenti i Prokurorisë se Dhoma Gjyqësore gaboi në konkluzionin se eprori e përmbush detyrimin për ndëshkimin e krimeve nëpërmjet marrjes së masave disiplinore).

²¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 77; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 832.

123. Veç vërtetimit të ekzistencës së të gjithë elementëve të përbashkët të diskutuar më lart, për të provuar formën e parë të përgjegjësisë bazuar në paragrafin 3 të Nenit 7 Prokuroria duhet të provojë se i akuzuari nuk mori masat e nevojshme dhe të arsyeshme për parandalimin e kryerjes së krimeve ose shkeljeve bazë prej vartësve të tij, pavarësisht aftësisë materiale përkatëse.²¹⁹ Për shembull, nëqoftëse aftësia materiale e të akuzuarit mundëson vetëm kallëzimin prej të tij te instancat kompetente, të krimeve ose shkeljeve bazë që janë në prag të kryerjes ose po kryhen, për të cilat ai është në dijeni ose ka arsye të dijë, atëherë ky kallëzim mund të jetë i mjaftueshëm në plotësimin e detyrimit të tij për parandalim.²²⁰ Për vërtetimin e formës së dytë të përgjegjësisë së paragrafit 3 të Nenit 7, mosndëshkimin, Prokuroria duhet të provojë se i akuzuari nuk mori masa të nevojshme dhe të arsyeshme që janë brenda aftësisë së tij materiale për të mundësuar zbatimin e ndëshkimit të vartësve të tij për kryerjen e krimeve ose shkeljeve bazë për të cilat akuzohet i akuzuari.²²¹ Nëqoftëse kompetencat faktuale dhe ligjore të të akuzuarit në pozitën e eprorit i mundësojnë atij imponimin e ndëshkimeve ndaj vartësve të tij, ai ballafaqohet me përgjegjësinë e paragrafit 3 të Nenit 7. Mirëpo nëqoftëse ai nuk ka kompetencë për ndëshkim, i akuzuari mund të shmangë përgjegjësinë e paragrafit 3 të Nenit 7, thjesht nëpërmjet ndërmarrjes së një hetimi, ose duke ia përcjellë informacionin eprorit të tij ose instancave të ndjekjes penale.²²²

B. KUSHTET DHE ELEMENTËT E KRIMEVE STATUTORE

1. Neni 3 i Statutit të Tribunalit

a. Kushte për shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës

124. Paragrafi hyrës i Nenit 3 të Statutit të Tribunalit parashtron se “Tribunali Ndërkombëtar ka kompetencë të procedojë penalisht individë që shkelin ligjet ose zakonet e luftës”, dhe nënparagrafët e Nenit ofrojnë një listë jogjithëpërfshirëse të veprimeve që cilësohen shkelje.²²³ Neni 3 është dispozitë plotësuese që akordon juridiksion në lidhje me çfarëdo shkeljesh të rënda të papërmendura në Nenet 2, 4, ose 5 - veç shkeljeve të renditura shprehimisht në nënparagrafët e Nenit.²²⁴ Statuti nuk përmban një përkufizim të shkeljeve të ligjeve ose zakoneve të luftës, mirëpo jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar kushtet e përgjithshme si më poshtë:

²¹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Halilović*, para. 63; Aktgjykimi *Strugar*, para. 374.

²²⁰ *Shih* Aktgjykimi *Bllagojević*, para. 793; Aktgjykimi *Stakić*, para. 461.

²²¹ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Bllashkić*, para. 417; Aktgjykimi *Mërkshiq dhe të tjerë*, para. 568.

²²² *Shih* Aktgjykimi *Kvočka dhe të tjerë*, para. 316.

²²³ Vendimi *Tadić* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 91.

²²⁴ Vendimi *Tadić* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 91; *shih edhe* Aktgjykimi *Halilović*, para. 23; Aktgjykimi *Haxhihasanović*, para. 17; Aktgjykimi *Orić*, para. 252; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 842; Aktgjykimi *Martić*, para. 40.

- (a) ekzistenca e një konflikti të armatosur ndërkombëtar ose të brendshëm;
- (b) ekzistenca e një lidhjeje midis veprimeve të kryesit fizik dhe konfliktit të armatosur;
- (c) veprimet e kryesit fizik shkelin një rregull të së drejtës humanitare ndërkombëtare, si zakonore po ashtu edhe të traktateve;
- (d) shkelja e rregullës përkatëse duhet të përmbajë përgjegjësinë penale individuale të shkelësit të rregullës; dhe
- (e) shkelja duhet të jetë “e rëndë”.²²⁵

i. Gjatë periudhës përkatëse të aktakuzës ekzistonte konflikt i armatosur i brendshëm ose ndërkombëtar

125. Një prej kushteve të Nenit 3 është ekzistenca e një konflikti të armatosur.²²⁶ Megjithëse historikisht nuk ka patur përkufizim të saktë të dyfjalëshit “konflikt i armatosur” në të drejtën ndërkombëtare,²²⁷ Tribunali ka përdorur formulimin e shprehur prej Dhomës së Apelit në çështjen *Tadiq* në vitin 1995, sipas të cilës “konflikt i armatosur ekziston sa herë që përdoret forcë e armatosur midis shteteve ose dhunë e armatosur e zgjatur midis organeve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara ose midis vetë grupeve të tilla brenda një shteti.”²²⁸ Ekzistenca e një konflikti të armatosur nuk varet prej pikëpamjeve të palëve në konflikt.²²⁹

126. Në vlerësimin e konflikteve të armatosura të brendshme, Dhoma Gjyqësore duhet të shqyrtojë si ashpërsinë e konfliktit, po ashtu edhe organizimin e palëve në konflikt,²³⁰ për të përjashtuar banditizmin, trazirat civile dhe kryengritjet e paorganizuara dhe jetëshkurtra, të cilat nuk janë objekt i të drejtës humanitare ndërkombëtare.²³¹ Nuk është e nevojshme që konflikti i armatosur i brendshëm “të përgjithësohet” në kuptimin e përfshirjes së krejt territorit në konflikt;

²²⁵ Dhoma diskuton kushtet (d) dhe (e) në të njëjtën nënpjesë të mëposhtme.

²²⁶ Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 67; Aktgjykim *Çelebiqi*, para. 182; Aktgjykim *Furunxhija*, para. 59; Aktgjykim *Haxhihasanoviq*, para. 13; Aktgjykim *Martiq*, para. 40.

²²⁷ *Shih* Jean Pictet (ed.), *Commentary, Geneva Convention for the Amelioration of the Condition of the Wounded and Sick in Armed Forces in the Field* (1952, 1st reprint 1995) (“ICRC Commentary to First Geneva Convention”), p. 49/*Shpjegues, Konventa e Gjenevës për Përmirësimin e Kushteve për Të Plagosurit dhe të Sëmurët në Forcat e Armatosura në Terren* (1952, rishtypja e parë 1995) (“Shpjegues i KNKK-së për Konventën e Parë të Gjenevës)

²²⁸ Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 70; *shih edhe* Aktgjykimi *Haliloviq*, para. 24; Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 84; Aktgjykimi *Haxhihasanoviq*, para. 14; Aktgjykimi *Oriq*, para. 254; Aktgjykimi *Martiq*, para. 41.

²²⁹ Aktgjykimi *Akayesu*, para. 603.

²³⁰ *Shih* Aktgjykimi *Tadiq*, para. 562; *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 89; (ku konkludohet se për vërtetimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur mjafton një farë organizimi i palëve) Në Aktgjykimin *Limaj dhe të tjerë* u konkludua se përcaktimi i ashpërsisë së konfliktit dhe organizimit të palëve janë çështje faktike për të cilat duhet vendosur në bazë të provave konkrete dhe rast pas rasti. Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 90.

²³¹ Aktgjykimi *Tadiq*, para. 562; *shih edhe* Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 184; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 341; Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 84, 87.

kushti i dhunës së armatosur të zgjatur mund të plotësohet prej provave të zonave të përcaktuara në të cilat ndodhën “luftime të ashpra për një periudhë të zgjatur.”²³²

ii. *Ekzistonte lidhje midis krimeve të pretenduara dhe konfliktit të armatosur*

127. Megjithëse duhet të ekzistojë një lidhje midis krimeve të pretenduara dhe konfliktit të armatosur, nuk është e nevojshme që Prokuroria të vërtetojë se luftimet faktuale ndodhën në zonën ku pretendohet se janë kryer shkeljet; “mjafton që krimet e pretenduara lidheshin ngushtësisht me luftimet në pjesë të tjera të territoreve të kontrolluara prej palëve në konflikt.”²³³ Dhoma Gjyqësore në çështjen *Kordiq* theksoi gjithashtu se “që normat e të drejtës humanitare ndërkombëtare të zbatohen në një vendndodhje konkrete ... duhet provuar vetëm që ekzistonte konflikt i armatosur në një territor më të madh, ku ajo zonë bën pjesë.”²³⁴

128. Dhoma Gjyqësore në çështjen *Bllashkiq* duke adoptuar qëndrimin e Dhomave Gjyqësore në çështjet *Tadiq* dhe *Çelebiciq* për kushtin e ekzistencës së lidhjes, gjithashtu konkludoi se “nuk është e nevojshme që krimi të jetë pjesë e një praktike të mbështetur ose toleruar zyrtarisht prej njëres nga palët në konflikt, ose ... të jetë zbatim faktual i një praktike të lidhur me zhvillimin e luftës ose me interesat faktike të njëres palë të konfliktit”.²³⁵ Mirëpo duhet provuar se konflikti luajti rol thelbësor në aftësinë e keqbërësit për kryerjen e kimit, në vendimin e tij për kryerjen, mënyrën e kryerjes, ose qëllimin e kryerjes.²³⁶

iii. *Veprimet duhet të shkelin një rregull të së drejtës humanitare ndërkombëtare, zakonore apo të traktateve*²³⁷

129. Rregullat burimore që përbëjnë ngrehinën e së drejtës humanitare ndërkombëtare, gjenden kryesisht në Konventat e Hagës të viteve 1899 dhe 1907 dhe Konventat e Gjenevës të vitit 1949.

²³² *Shih* Aktgjykimi *Kordiq*, para 31 (konfirmuar në Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 333-341); *shih edhe* Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 70; Aktgjykimi *Naletiliq*, para. 177.

²³³ Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 70; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 342; Aktgjykimi *Martiq*, para. 43.

²³⁴ Aktgjykimi *Kordiq*, para. 27 (konfirmuar në Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 314, 320-321); *shih edhe* Aktgjykimi *Oriq*, para. 255 (ku konkludohet se normat e të drejtës humanitare ndërkombëtare janë në fuqi pavarësisht faktit nëse veprimet luftarake kryhen në një vendndodhje konkrete).

²³⁵ Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 70; *shih* Aktgjykimi *Tadiq*, para. 573; Në kontekstin e Nenit 3 nuk është e nevojshme që palët e konfliktit në fjalë të jenë shtete, dhe është e qartë prej formulimit në Aktgjykimin *Tadiq* se konkluzioni i saj është i barasvlershëm edhe për konfliktet e armatosura të brendshme. Aktgjykimi *Tadiq*, para. 573. *Shih edhe* Aktgjykimi *Haliloviq*, para 29; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 342 (ku konkludohet se për vërtetimin e lidhjes, mjafton të provohet që krimet e akuzuara të jenë të lidhura ngushtë me luftime në pjesë të tjera të territoreve të kontrolluara prej palëve të konfliktit).

²³⁶ Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 846; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 58; Aktgjykimi *Haxhihasanoviq*, para. 16; Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 342.

²³⁷ Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 94(i)-(ii).

Neni i përbashkët 3 i katër Konventave të Gjenevës (“Neni i Përbashkët 3”) konsiderohet bërthama e të drejtës zakonore ndërkombëtare. Dhoma e Apelit në çështjen *Çelebiqi* konkludoi,

Është e pakundërshtueshme se Neni i përbashkët 3 i cili parashtron një bazë rregullash detyruese, pasqyron parimet themelore humanitare mbi të cilat mbështetet tërë e drejta humanitare ndërkombëtare dhe mbi të cilat bazohen në tërësi Konventat e Gjenevës. Këto parime që kanë si objekt respektin për dinjitetin e qenies njerëzore, evoluuan përmes luftërave shekullore dhe në kohën e miratimit të Konventave të Gjenevës kishin fituar statusin e të drejtës zakonore, sepse ato pasqyrojnë parime humanitare të pranuar botërisht. Këto parime u kodifikuan në Nenin e përbashkët 3 i cili përbën themelin ligjor për konflikte të brendshme, mirëpo janë aq thelbësore saqë konsiderohen se vlejnjë si për konflikte të brendshme, po ashtu edhe për ndërkombëtare.²³⁸

130. Veç këtyre rregullave zakonore, veprimet e ndaluara të palëve në një konflikt të armatosur, mund të gjenden edhe në traktatet ose marrëveshjet ndërkombëtare. Mirëpo në këto rrethana duhen plotësuar dy kushte shtesë: marrëveshja duhet të ketë qenë “kategorikisht detyruese mbi palët në kohën e shkeljes së pretenduar”, dhe marrëveshja nuk mund “të bjerë ndesh me normat aksiomatike të së drejtës ndërkombëtare, ose t’i shfuqizojë ato pjesërisht”.²³⁹

iv. Shkelja e të drejtës ndërkombëtare duhet të përmbajë përgjegjësi penale individuale dhe duhet të jetë e rëndë (“kushti i peshës së shkeljes”)

131. Që Tribunali të ushtrojë juridiksionin e vet, i cili kufizohet “në shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare”²⁴⁰, ndaj një të akuzuari për shkelje të pretenduar të një rregulle të së drejtës humanitare ndërkombëtare, (a) shkelja e rregullës konkrete duhet të përmbajë përcaktimin e përgjegjesisë penale individuale dhe duhet të përbëjë shkelje të një rregulle që mbron vlera të rëndësishme, dhe (b) shkelja duhet të shkaktojë pasoja të rënda për viktimën.²⁴¹

132. Vrasja, e vetmja shkelje bazë në Aktakuzë bazuar në Nenin 3, i përket kësaj kategorie, siç përshkruhet më poshtë.

²³⁸ Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para 143 (nuk përfshihet poshtëshënimi); *shih edhe* Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para 89, 134; Aktgjykimi *Haxhihasanoviq*, para. 29; Aktgjykimi *Oriq*, para. 261; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 843; Aktgjykimi *Martiq*, para. 45; *Case Concerning Military and Paramilitary Activities in and Against Nicaragua (Nicaragua v U.S.)* (Merits), 1986 I.C.J. Reports 14, para. 218.

²³⁹ Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 143.

²⁴⁰ Neni 1 i Statutit; *shih edhe* Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 94 dhe para 90 (ku ka përmendje të Hyrjes së Statutit si dhe Nenin 1, paragrafit 1 të Nenin 10, paragrafit 2 të Nenin 10, paragrafit 1 të Nenin 23, dhe paragrafit 1 të Nenin 29).

²⁴¹ Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 94(iii), 129–130; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 179-180 (ku konfirmohet konkluzioni i Dhomës Gjyqësore *Çelebiqi* se përcaktimi i përgjegjesisë penale për shkelje të nenit të përbashkët 3 nuk shkel parimin e ligjshmërisë ose *nullum crimen sine lege*) *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 92 (ku konkludohet se ndër të tjera përgjegjësia penale individuale mund të deduktohet prej praktikës shtetërore që demonstroi synim për penalizimin e ndalimit, ndër të cilat deklarata të zyrtarëve shtetërorë dhe të organizatave ndërkombëtare si dhe ndëshkimet e shkeljeve prej gjykatave shtetërore dhe Tribunalëve ushtarakë).

b. Vrasja si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës

133. Neni 3 është dispozitë plotësuese,²⁴² dhe rrjedhimisht lista e shkeljeve në Nenin 3 është ilustruese dhe jo e plotë.²⁴³ Në çështjen aktuale, akuzat e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, bazohen në Nenin e Përbashkët 3.²⁴⁴ Duke qenë se kjo dispozitë kyçe e Konventave të Gjenevës është kodifikim i parimeve themelore të së drejtës humanitare ndërkombëtare,²⁴⁵ shkeljet e ndalimeve të saj përfshihen në juridiksionin e Neni 3 të Statutit.²⁴⁶ Në fakt, në jurisprudencën e Tribunalit është sanksionuar se akuza e vrasjes si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës përmbush tri kushte të përgjithshme ligjore, kushtet (c), (d), dhe (e), për zbatueshmërinë e Neni 3.²⁴⁷ Neni i Përbashkët 3 është pjesë e korpusit të së drejtës zakonore ndërkombëtare, dhe vrasja “shkel një rregull që mbron vlera të rëndësishme dhe shkakton pasoja të rënda për viktimat ... dhe se përmban përgjegjësi penale individuale.”²⁴⁸

134. Rrjedhimisht, megjithëse vrasja nuk përmendet konkretisht në Nenin 3, ajo përbën krim për juridiksionin e Tribunalit. Mirëpo për t’u cilësuar shkelje e rëndë e të drejtës humanitare ndërkombëtare, duhet provuar se vrasja si shkelje bazë, u krye kundër individëve që nuk merrnin pjesë aktive në konfliktin e armatosur.²⁴⁹ Në kuadër të akuzave bazuar në Nenin 3, nuk është me rëndësi nëse konflikti është ndërkombëtar apo i brendshëm.²⁵⁰ Mirëpo autori i krimit duhet të ketë ditur ose duhet të ketë qenë i vetëdijshëm se viktima nuk merrte pjesë aktive në luftime; në

²⁴² Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 91; *shih edhe* Aktgjykimi *Martiq*, para. 40.

²⁴³ Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 87, 91-92; Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 131-133; Aktgjykimi *Kordiq*, para. 167.

²⁴⁴ Aktakuza, Pika 4. Neni i Përbashkët 3 parashtron në pjesën përkatëse:

Në rastin e një konflikti të armatosur, jondërkombëtar që ndodh në territorin e një pale kontraktuese, çdo palë e konfliktit është e detyruar t’u përmbahet së paku këtyre dispozitave:

1. Personat që nuk marrin pjesë aktivisht në luftime, ndër të cilët anëtarë të forcave të armatosura që kanë dorëzuar armët dhe ata *jashtë luftimit* për shkak sëmundjeje, lëndimesh, ndalim ose për shkaqe të tjera trajtohen njerëzisht në çfarëdo rrethane

Për këtë qëllim ndalohen dhe mbeten të ndaluara veprimet e mëposhtme në çfarëdo kohe dhe vendi në lidhje me personat e lartpërmendur:

(a) Dhuna ndaj jetës dhe individit, veçanërisht të gjitha llojet e vrasjes, gjymtimi, trajtimi mizor dhe torturimi[.] (është shtuar nënvizimi)

²⁴⁵ Aktgjykimi *Haliloviq*, para. 31.

²⁴⁶ Aktgjykim *Krajishnik*, para. 843; Aktgjykimi *Haxhihasanoviq*, para 18; Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 89; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 133-136

²⁴⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 68 (ku konkludohet se shkeljet e rënda të neni të përbashkët 3 përmbushin automatikisht kriteret juridiksionale *Tadiq*)

²⁴⁸ Aktgjykimi *Strugar*, para. 219; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Çelebiqi*, para. 147, 153-174; Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 128-136; Aktgjykimi *Haliloviq*, para. 31.

²⁴⁹ Aktgjykimi *Tadiq*, para. 615-616; Aktgjykimi *Martiq*, para. 47; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 847; Aktgjykimi *Oriq*, para. 258; Aktgjykimi *Haliloviq*, para. 32; *shih edhe* Aktgjykimi *Haliloviq*, para. 33-34 (ku diskutohet mënyra e përcaktimit të pjesëmarrjes ose mospjesëmarrjes së viktimës në konfliktin e armatosur).

²⁵⁰ *Shih Prokurori k. Deliqit*, Lënda Nr: IT-04-83-PT, Vendim mbi Mocionin e Mbrojtjes që Pretendon Mangësi në Formën e Aktakuzës dhe Urdhër mbi Mocionin e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës, 13 dhjetor 2005, para 4; Aktgjykimi *Haliloviq*, para. 25; Aktgjykimi *Haxhihasanoviq*, para 18; Aktgjykimi *Oriq*, para. 252; Aktgjykimi *Martiq*, para. 42.

përcaktimin nëse viktimë gëzon mbrojtje prej Nenit të Përbashkët 3, duhen marrë parasysh rrethanat konkretet të viktimës në kohën e kryerjes së krimit.²⁵¹

135. Në lidhje me akuzat konkrete të vrasjes në Aktakuzë, Dhoma do të diskutojë nëse plotësohen ose nuk plotësohen kushtet e tjera të përgjithshme për krimet e Nenit 3, përkatësisht ekzistenca e konfliktit të armatosur dhe lidhja midis vrasjeve të akuzuara dhe konfliktit të armatosur, në pjesët vijuese ku analizohen ngjarjet që pretendohet se ndodhën në Kosovë nga marsi deri në qershor 1999.

i. Elementë të vrasjes si shkelje bazë

136. Pasi ka trajtuar kushtet e përgjithshme, tani Dhoma Gjyqësore do të shqyrtojë elementët konkretë të shkeljes bazë të vrasjes. Në Aktakuzë akuzat për vrasje janë përfshirë bazuar si në Nenin 3, po ashtu edhe në Nenin 5 të Statutit, dhe elementët e vrasjes të shtjelluar këtu, janë të barasvlershëm për të dy nenet.

137. Vepra e fajshme e vrasjes është vdekja e një individi si pasojë e një veprimi ose mosveprimi të autorit fizik.²⁵² Në lidhje me kushtin e shkakësisë, nuk është e nevojshme që shkak i vetëm i vdekjes së viktimës të ketë ndodhur “si rezultat i” veprimit ose mosveprimit të kryesit fizik; mjafton që “veprimet e keqbërësit të kenë kontribuar thelbësisht në vdekjen e individit”.²⁵³ Megjithatë shkakësia mund të deduktohet prej rrethanave të çështjes, ajo duhet të jetë konkluzioni i vetëm i arsyeshëm i nxjerrë prej provave të paraqitura në gjyq.²⁵⁴

138. Synimi kriminal i vrasjes vërtetohet kur Prokuroria provon jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm njëherë nga dy gjendjet mendore alternative: ose kryesi fizik nëpërmjet veprimit ose mosveprimit synoi të shkaktonte vdekjen e viktimës, ose synoi të shkaktonte lëndim të rëndë ose dëmtim të rëndë trupor në shpërfillje të plotë për pasojat ndaj jetës së njeriut.²⁵⁵ Synimi kriminal mund të vërtetohet edhe për kryesin e ndërmjetëm ose të akuzuarin.

²⁵¹ Aktgjykimi *Martiq*, para. 47; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 847; Aktgjykimi *Haliloviq*, para. 36.

²⁵² Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 261.

²⁵³ Aktgjykimi *Martiq*, para. 58; Aktgjykimi *Oriq*, para. 347; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 261; Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 149; Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, para. 423; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 37.

²⁵⁴ *Shih* Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 326 (në lidhje me Nenin 3 dhe paragrafin a të Nenit 5); *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 260; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 380, 385 dhe 388 (në lidhje me paragrafin a të Nenit 2, Nenin 3 dhe paragrafët a-b të Nenit 5); Aktgjykimi *Oriq*, para. 347.

²⁵⁵ Aktgjykimi *Galiq*, para. 150 (ku diskutohet Neni 5); Aktgjykimi *Çelebiq*, para. 439 (ku diskutohen paragrafi a i Nenit 2 dhe Neni 3); Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 561 (në lidhje me paragrafin a të Nenit 5); *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 261; Aktgjykimi *Martiq*, para. 58 (në lidhje me Nenin 3 dhe paragrafin a të Nenit 5) Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 36-37 (në lidhje me paragrafin a të Nenit 2 dhe Nenin 3); Aktgjykimi i Apelit *Çelebiq*, para. 422-423 (në lidhje me paragrafin a të Nenit 2 dhe Nenin 3); Aktgjykimi *Oriq*, 30 qershor 2006,

139. Në pjesët ku analizohen akuzat konkrete për vrasje, do të shqyrtohet vërtetimi i synimit kriminal dhe veprës së fajshme.

2. Neni 5 i Statutit të Tribunalit

a. Kushtet juridiksionale të Nenit 5

140. Neni 5, i titulluar “Krimet kundër njerëzimit”, i akordon Tribunalit kompetencë “të procedojë penalisht individë përgjegjës për krime [të caktuara], kur kryhen gjatë një konflikti të armatosur, ndërkombëtar ose të brendshëm, dhe të drejtuara kundër çfarëdo popullsie civile”. Po ashtu si Neni 3, Neni 5 përmban një kusht që shkelja “të kryhet në konflikt të armatosur”.²⁵⁶ Ky kufizim juridiksional vlen vetëm për Tribunalin. Kushti i konfliktit të armatosur përbëhet prej dy pjesësh, prova se (a) ekzistonte konflikt i armatosur dhe (b) shkeljet e akuzuara në aktakuzë lidhen objektivisht, si në aspektin gjeografik, po ashtu edhe atë kohor, me konfliktin e armatosur.²⁵⁷

141. Prova e ekzistencës së një konflikti të armatosur në kuadër të këtij kushti juridiksional është e njëjtë me atë të përdorur në kontekstin e Nenit 3: ose përdorimi i forcës së armatosur midis shteteve, ose dhunë e armatosur e zgjatur midis organeve qeveritare dhe grupeve të armatosura të organizuara, ose midis grupeve të tilla brenda një shteti.²⁵⁸

b. Kushte të përgjithshme për krimet kundër njerëzimit

142. Meqenëse, në ndryshim nga Neni 3, lista e krimeve në Nenin 5 është e plotë, shkelja e akuzuar duhet të jetë brenda nënparagrafëve të Nenit 5, që të konsiderohet krim kundër njerëzimit brenda juridiksionit të Tribunalit. Mirëpo, një kategori e shkeljeve të ndëshkueshme bazuar në Nenin 5, veprime çnjerëzore, përcaktohet si dispozitë plotësuese e brendshme për Nenin 5.²⁵⁹

143. Dhoma e Apelit ka përcaktuar këto pesë kushte të përgjithshme në lidhje me krimet kundër njerëzimit:

para. 346 (në lidhje me Nenet 2, 3 dhe 5); Aktgjykimi *Kordiq*, para. 229, 233 (në lidhje me paragrafin a të Nenit 2 dhe Nenin 3); Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 495 (në lidhje me Nenin 3 dhe paragrafët a-b të Nenit 5).

²⁵⁶ Neni 5 i Statutit vlen për veprimet e kryera si në konfliktet e armatosura të brendshme po ashtu dhe ato ndërkombëtare. *Shih* Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 141-142; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 251.

²⁵⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 83; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 239, 249, 251; Aktgjykimi *Martiq*, para. 48; Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 546.

²⁵⁸ Vendimi *Tadiq* i Juridiksionit mbi Apelin e Ndërkohshëm, para. 70.

²⁵⁹ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 117 (citohet dhe mbështetet arsyetimi i paragrafit 563 në Aktgjykim *Kupreshkiq dhe të tjerë* se “veprimet çnjerëzore si krime kundër njerëzimit u formuluan qëllimisht si kategori plotësuese sepse nuk u konsiderua e dëshirueshme që kjo kategori të formulohej në mënyrë gjithëpërfshirëse”) (janë hequr shenjat e citimit origjinal).

- (a) Duhet të ekzistojë sulm.
- (b) Sulmi duhet të jetë kundër një popullate civile.
- (c) Sulmi duhet të jetë i gjerë ose sistematik.
- (d) Veprimet e shkelësit duhet të jenë pjesë e sulmit.
- (e) Shkelësi duhet të dijë se ekziston një sulm kundër popullatës civile dhe të dijë ose të rrezikojë që veprimet e tij të jenë pjesë e sulmit.²⁶⁰

i. Duhet të ekzistojë sulm

144. Koncepti i “sulmit” nuk është i njëjtë me “konflikt të armatosur”, duke marrë parasysh se sulmi mund t’i paraprijë, të shkojë më tej ose të vazhdojë gjatë konfliktit të armatosur, por jo domosdoshmërisht si pjesë e konfliktit.²⁶¹ “Në kontekstin e një krimi kundër njerëzimit sulmi mund të përkufizohet si një varg veprimesh ku përfshihet kryerja e akteve të dhunës, i cili nuk kufizohet vetëm në përdorimin e forcës së armatosur, por përfshin edhe çfarëdo keqtrajtimi të popullatës civile.”²⁶² Gjithashtu nuk është kusht që sulmi kundër një popullate civile të jetë i lidhur me konfliktin e armatosur.²⁶³

ii. Sulmi duhet të jetë kundër popullatës civile

145. Dhoma e Apelit ka konkluduar se statusi civil i grupit të sulmuar është një prej elementëve që karakterizojnë një krim kundër njerëzimit.²⁶⁴ Për më tepër, në Aktgjykimin e Apelit *Kunarac* u shpjegua se “mjafton të provohet se gjatë sulmit u sulmuan një numër i mjaftueshëm individësh, ose se ata u sulmuan në mënyrë të tillë që e bind Dhomën se në fakt sulmi është i përqendruar kundër një “popullate” civile, dhe jo kundër një numri të kufizuar individësh të përzgjedhur arbitrarisht.”²⁶⁵

146. “Popullatë civile” konsiderohet popullata që ka karakter mbizotërues civil.²⁶⁶ Prania e luftëtarëve brenda popullatës në fjalë nuk e ndryshon karakterin e saj civil.²⁶⁷ Duke qenë se në të

²⁶⁰ *Shih përgjithësisht* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 85, 102.

²⁶¹ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 86; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 251; Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 182.

²⁶² Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 543 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 86, dhe Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 89, që mbështesin arsyetimin në Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 415) (nuk përfshihen poshtëshënimi dhe shenjat e citimit origjinal); *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 182.

²⁶³ Vendimi *Sheshel* i Apelit të Juridiksionit, para. 13.

²⁶⁴ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 107.

²⁶⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 90; *shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 95; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 105; *shih edhe* Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 424 (jepen shembuj të “një shteti, një komune ose një zone tjetër të përkufizuar” si ilustrime të termit “tërësi gjeografike”, popullata e të cilës sulmohet); Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 187; Aktgjykimi i Apelit *Stakij*, para. 247.

drejtën zakonore ndërkombëtare, ndryshe nga rasti konkret i përkufizimit statutor që zbatohet në Tribunal, një krim kundër njerëzimit jo domosdoshmërisht ndodh gjatë një konflikti të armatosur, Dhoma nuk kufizohet prej përkufizimit të statusit të civilëve në të drejtën humanitare ndërkombëtare, mirëpo kuadri ligjor mund të ofrojë udhëzime për identifikimin e viktimave të një krimi kundër njerëzimit.²⁶⁸

147. Për të konkretizuar plotësisht objektin dhe qëllimin e të drejtës zakonore ndërkombëtare për ndalimin e krimeve kundër njerëzimit, bëhet i nevojshëm adoptimi i një përkufizimi të gjerë të termave kryesore, i cili e zgjeron sa më shumë mbrojtjen.²⁶⁹ “Civil” është dikush i cili nuk është as anëtar i forcave të armatosura dhe as i ndonjë pale në konflikt,²⁷⁰ dhe as anëtar i një grupi “banorësh të një territori të papushtuar, të cilët me afrimin e armikut marrin spontanisht armët për t’u rezistuar forcave pushtuese, pa patur kohë të organizohen në njësi të rregullta të armatosura”.²⁷¹ Për më tepër Dhoma e Apelit ka konkluduar se përkufizimet e termit “civil” në Nenet 3 dhe 5 janë të njëjta dhe se

në Nenin 5 të Statutit, individi *hors de combat/mospjesëmarrës në luftim* mund ... të jetë viktimë e një veprimi që përbën krim kundër njerëzimit, me kusht që të plotësohen të tëra kushte e tjera të nevojshme, në veçanti se veprimi në fjalë është pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik kundër çfarëdo popullate civile.²⁷²

²⁶⁶ Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 544 (citohet Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 56; Aktgjykim *Tadiq*, para. 638); *shih edhe* Aktgjykim *Limaj dhe të tjerë*, para. 186.

²⁶⁷ Në aktgjykimet e mëhershme ky koncept shprehet në mënyrë paksa të ndryshme, nëpërmjet konkluzionit se “prania e anëtarëve të grupeve të qëndrësës ose ish-luftëtarëve të cilët kanë dorëzuar armët brenda një popullate nuk e ndryshon karakterin civil të popullatës.” Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 113 (është shtuar theksi) (vijon në Aktgjykim *Bllagojeviq*, para. 544). Dhoma e Apelit *Bllashkiq* shqyrtoi masën e pranisë së luftëtarëve brenda popullatës civile që ndryshon karakterin e asaj popullate, dhe çështjen nëse ekzistonte kufiri ku popullata e humbte karakterin civil. U konkludua se për të përcaktuar nëse popullata civile e humbte karakterin civil prej pranisë së ushtarëve brenda saj, duhej marrë parasysh numri i ushtarëve të pranishëm si dhe fakti nëse janë me leje. Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 113–115; *shih edhe* Aktgjykimi *Martiq*, para. 50–55.

²⁶⁸ *Shih për shembull*, Aktgjykimi *Tadiq*, para. 639:

Përkufizimi i civilëve në Nenin e Përbashkët 3 nuk është drejtpërsëdrejti i zbatueshëm për krimet kundër njerëzimit sepse është pjesë e ligjeve ose zakoneve të luftës dhe mund të zbatohet vetëm nëpërmjet analogjisë. I njëjti arsyetim vlen edhe për përkufizimin në Protokollin I dhe Shpjeguesin e Konventës së Gjenevës IV për trajtimin e civilëve, në të cilat mbështetet interpretim i gjerë i termit “civil”.

Shih edhe Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 110; Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 223 (citohet Aktgjykimi *Tadiq*, para. 639); Aktgjykimi i Apelit *Galiq*, para. 144..

²⁶⁹ Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 547; Aktgjykimi *Jelisiq*, para. 54; Aktgjykimi *Tadiq*, para. 639; *shih edhe* Aktgjykimi *Kayishema*, para. 127.

²⁷⁰ *Shih* Konventa e Tretë e Gjenevës, neni 4(A)(1)–(3) (përkufizohen kategoritë e robërve të luftës); *shih edhe* Protokollin Shtesë I, neni 43(1) (“Forcat e armatosura të një pale në konflikt përbëhen prej të gjitha forcave, grupeve dhe njësisive të armatosura të organizuara të cilat janë nën një komandë përgjegjëse para palës në fjalë për veprimet ose vartësit, edhe sikur ajo palë të jetë e përfaqësuar prej një qeverie ose instance që nuk njihet nga pala kundërshtarë.”).

²⁷¹ Konventa e Tretë e Gjenevës, neni 4(A)(6). Përgjithësisht konsiderohet se kjo dispozitë ka të bëjë me një *levée en masse/mobilizim masiv*. *Shih* Aktgjykimi *Haliloviq*, para. 34, shënim 79.

²⁷² Aktgjykimi i Apelit *Martiq*, para. 272–321 (i tërë diskutimi), 299, 313, 302 (konkludohet se përkufizimi i civilëve në nenin 50 të Protokollit Shtesë I pasqyron përkufizimin e civilëve në kontekstin e zbatimit të Nenit 5 të Statutit).

148. Megjithëse nuk ekziston një rregull numerik që përcakton qartësisht kufirin në të cilin popullata e humbet karakterin civil, Dhoma gjykon se kushti që popullata e sulmuar të jetë “kryesisht civile”, ofron një standard në lidhje me të cilin mund të gjykohen faktet e një çështjeje konkrete.

149. Shprehja “drejtuar kundër” kushtëzon se në kontekstin e një krimi kundër njerëzimit, popullata civile është objektivi parësor i sulmit. Për të përcaktuar nëse sulmi ishte drejtuar kundër një popullate të tillë, Dhoma Gjyqësore ndër të tjera do të marrë në shqyrtim këta faktorë:

mjetet dhe metodat e përdorura gjatë sulmit; statusin e viktimave; numrin e tyre; karakterin diskriminues të sulmit; llojin e krimeve të kryera gjatë sulmit; qëndresën ndaj sulmuesve në atë kohë; dhe nivelin e mundshëm të përmbushjes ose të përpjekjeve për përmbushjen e kushteve paraprake të ligjeve të luftës. Në qoftë se krimet e pretenduara të luftës kundër njerëzimit u kryen gjatë konfliktit të armatosur, ligjet e luftës shërbejnë si tregues të cilët Dhoma mund t'i shfrytëzojë për vlerësimin e llojit të sulmit dhe ligjshmërinë e veprimeve të kryera gjatë tij.²⁷³

iii. Sulmi duhet të jetë gjerësisht i përhapur ose sistematik

150. Bazuar në jurisprudencën e Tribunalit, sulmi duhet të konsistojë në ‘një praktikë të përhapur ose sistematike krimesh’ për të bërë dallimin midis krimeve kundër njerëzimit dhe veprimeve të izoluara ose të palidhura kundër individëve.²⁷⁴ Kushti që sulmi të jetë i gjerë ose sistematik është veçues.²⁷⁵ Vetëm sulmi duhet të jetë i përhapur gjerësisht ose sistematik, jo veprimet individuale për të cilat është përgjegjës i akuzuari.²⁷⁶ Termi “i përhapur gjerësisht” ka të bëjë me shtrirjen e gjerë të sulmit dhe numrin e personave të sulmuar,²⁷⁷ kurse termi “sistematik” ka të bëjë me karakterin e organizuar të veprimeve të dhunës dhe pamundësinë e ndodhisë së rastësishme të

²⁷³ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 91 (vijon me Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 96; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 106); *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 185 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 91).

²⁷⁴ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 248; *shih edhe* Vendimi *Mërkshiq* i Rregullës 61, para 30; Report of the Secretary-General Pursuant to Paragraph 2 of Security Council Resolution 808, UN Doc. No. S/25704, 3 maj 1993, para. 48/Raport i Sekretarit të Përgjithshëm Bazuar në Paragrafin 2 të Rezolutës 808, të Këshillit të Sigurimit, 3 maj 1993, para 48 (“Krimet kundër njerëzimit janë veprime të rënda çnjerëzore, si vrasje, torturim, përdhunim i qëllimshëm, të kryera në kontekstin e një sulmi të gjerë ose sistematik kundër një popullate civile mbi baza kombëtare, politike, etnike, racore ose fetare.”) (theksi është shtuar).

²⁷⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 93 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 248); Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 183.

²⁷⁶ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 94; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 96; *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 189.

²⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 94; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 94.

tyre.²⁷⁸ Rregullsia e krimeve, në kuptimin e përsëritjes jorastësore të rregullt të një sjelljeje të ngjashme kriminale, është shprehje normale e ndodhisë sistematike.²⁷⁹

151. Në fund të fundit vlerësimi në lidhje me përcaktimin “gjerësisht i përhapur” ose “sistematik” është relativ, varësisht prej popullatës civile që sulmohet.²⁸⁰ Rrjedhimisht Dhoma “së pari duhet të identifikojë popullatën që është objektiv i sulmit dhe duke marrë parasysh, mjetet, metodat, burimet dhe rezultatit e sulmit kundër popullatës, të përcaktojë nëse sulmi ishte me të vërtetë i gjerë ose sistematik”.²⁸¹ Pasojat e sulmit kundër popullatës së sulmuar, numri i viktimave, lloji i veprimeve, pjesëmarrja e mundshme e zyrtarëve ose autoriteteve, ose çfarëdo praktike e identifikueshme krimesh, mund të merren të gjitha parasysh në përcaktimin nëse sulmi përmbush njërin apo të dy kushtet e sulmit “gjerësisht i përhapur” apo “sistematik” në lidhje me një popullatë të caktuar civile.²⁸² Ekzistenca e një plani apo praktike nuk është element i nevojshëm ligjor i një krimi kundër njerëzimit,²⁸³ megjithëse mund të jetë i rëndësishëm në vlerësimin e provave të paraqitura për të provuar se kundër popullatës civile u ndërmor sulm i cili ishte i gjerë ose sistematik.²⁸⁴

iv. Veprimet e autorit fizik duhet të jenë pjesë e sulmit

152. Sjellja e autorit fizik duhet të jetë pjesë e sulmit. Jo domosdoshmërisht veprimet e kryesit fizik duhet të kryhen gjatë sulmit kundër një popullate civile, që të konsiderohen pjesë e sulmit. Shkelja e kryer para ose pas sulmit kryesor kundër popullatës civile ose larg tij, gjithsesi mund të jetë pjesë e sulmit nëse ekziston lidhje e mjaftueshme.²⁸⁵ Identifikimi i lidhjes së mjaftueshme midis një shkeljeje dhe sulmit varet prej fakteve të çështjes, shkelja nuk duhet të jetë veprim i veçuar: nuk duhet të jetë e distancuar prej sulmit në atë masë sa pas shqyrtimit të kontekstit dhe rrethanave në të cilat u krye, nuk mund të konkludohet logjikisht se ka qenë pjesë e sulmit.²⁸⁶ Në

²⁷⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 94; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 94.

²⁷⁹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 94; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 94; *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 183.

²⁸⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 95 (citohet Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 430); *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 183 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 95).

²⁸¹ Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 430 (konfirmuar në Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 95).

²⁸² Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 95; *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 183 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 95).

²⁸³ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 98 shënim 114; *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 184, 212.

²⁸⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 98; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 120; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 98; *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 184, 212.

²⁸⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 100; *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 189.

²⁸⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 100; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 706(d); Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 550; *shih edhe* Aktgjykimi *Kërmojelac*, para. 55 (“Një krim i kryer disa muaj pas sulmit kryesor

rast se plotësohen të tëra kushtet e tjera, një veprim i vetëm ose një numër i kufizuar veprimesh të kryesit fizik cilësohen krim kundër njerëzimit, nëqoftëse nuk mund të thuhet se këto veprime kanë qenë të veçuara ose rastësore.²⁸⁷

v. *Kryesi duhet të dijë se po kryhet sulm kundër popullatës civile dhe të dijë ose të rrezikojë që veprimet e tij të jenë pjesë e sulmit*

153. Ky kusht ka të bëjë me lidhjen midis shkeljes dhe sulmit kundër popullatës civile. Mirëpo termi “kryes” paraqet një element paqartësie përse i përket çështjes nëse Dhoma duhet të shqyrtojë sjelljen dhe dijeninë e kryesit fizik, apo të një të akuzuari i cili nuk është kryesi fizik, apo madje të një personi tjetër si p.sh. kryesi i ndërmjetëm. Për faktin se jurisprudenca e mëhershme e Tribunalit nuk e ka ezauruar tërësisht këtë aspekt dhe për shkak të zbatueshmërisë së tij në këtë çështje, tani Dhoma Gjyqësore do të diskutojë shkurtimisht kushtin e përgjithshëm të një krimi kundër njerëzimit dhe lidhjen e tij me kryesin fizik ose të ndërmjetëm dhe të akuzuarin.

154. Në jurisprudencën e Tribunalit për këtë pikë, termat “kryes/autor” dhe “i akuzuar” janë përdorur përkëmbëshëmrisht.²⁸⁸ Diskutimi ligjor më i hershëm dhe i cituar më shpesh i dy kushteve të lidhjes gjendet në Aktgjykimin e Apelit *Tadiq*. Në lidhje me diskutimin e Dhomës Gjyqësore të “motiveve tërësisht personale” në kontekstin e krimeve kundër njerëzimit, Dhoma e Apelit deklaroi si më poshtë:

Dhoma e Apelit pranon se prej shprehjes “drejtuar kundër një popullate civile” në Nenin 5 të Statutit mund të deduktohet se veprimet e të akuzuarit duhet të jenë pjesë e një praktike krimesh të përhapura gjerësisht ose sistematike drejtuar kundër një popullate civile dhe se i akuzuari duhet të ketë ditur se veprimet e tij përputhen me këtë praktikë.²⁸⁹

Megjithëse nuk citohet asnjë burim për pohimin se i akuzuari duhet të dijë se sjellja e akuzuar përputhet me praktikën e krimeve, konkluzioni se veprimet e të akuzuarit duhet të jenë pjesë e

kundër popullatës civile, ose disa kilometra larg tij gjithsesi mund të jetë pjesë e sulmit në qoftë se provohet lidhja e mjaftueshme.”) (citohet Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 417 dhe më tej.).

²⁸⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 101; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 94; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 96.

²⁸⁸ *Shih p.sh.*, Aktgjykimi *Tadiq*, para. 248 (përmendet termi “i akuzuar”); Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 85 (përmendet “i akuzuar” dhe “kryes”) dhe para. 99 (përmendet “dijenja e të akuzuarit se ekziston sulm kundër popullatës civile dhe se veprimi i tij është pjesë e sulmit”) (theksi i shtuar); Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 124 (“Dhoma e Apelit gjykon se synimi kriminal i krimeve kundër njerëzimit vërtetohet kur i akuzuari ka synimin e nevojshëm për kryerjen e veprës/veprave penale për të cilat akuzohet, dhe kur di se ekziston sulm kundër popullatës civile dhe gjithashtu di se veprimet e tij janë pjesë e sulmit.”) (theksi i shtuar); *shih edhe* Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 257 (termat përdoren përkëmbëshëmrisht në të njëjtin paragraf); Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 544 (“Më poshtë janë identifikuar elementët kyç të krimeve kundër njerëzimit: ... se kryesi kishte dijeni për kontekstin e gjerë brenda të cilit ndodhin veprimet e tij) (theksi i shtuar); Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 410 (përdoret termi “kryes”, mirëpo citohet Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 248, ku përdoret termi “i akuzuar”), para. 418 (ripohohen kushtet e lidhjes midis “të akuzuarit dhe sulmit”) (theksi i shtuar), para. 433–435 (përdorim i përkëmbëshëm i termave).

²⁸⁹ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 248 (nuk përfshihen poshtëshënimi dhe theksi origjinal) (theksi i shtuar).

praktikës cilësohet në poshtëshënimin përkatës si “tashmë ... i pranuar prej Tribunalit në Vendimin e Rregullës 61 *Spitali i Vukovarit*”.²⁹⁰ Mirëpo duket se në formulimin e Vendimit të Rregullës 61 bëhet fjalë për kryesin fizik ose së paku për një të akuzuar i cili është edhe kryesi fizik i krimeve në fjalë, dhe jo për një të akuzuar, implikimi i të cilit në kryerjen e krimeve ose shkeljeve bazë është më i nuancuar.²⁹¹

155. Gjithashtu praktika aktuale e Tribunalit e pasqyruar në Aktgjykimet e Dhomave Gjyqësore dhe të Apelit tregon se kushti i lidhjes midis sjelljes së akuzuar dhe sulmit kundër popullatës civile plotësohet duke provuar se shkeljet bazë janë pjesë e sulmit, pavarësisht nëse janë kryer fizikisht prej të akuzuarit ose thjesht prej individëve për veprimet e të cilëve ai mban përgjegjësi.²⁹²

156. Për aq sa i përket dijenisë së kontekstit të shkeljes bazë,²⁹³ diskutimi i mëhershëm i Dhomës për ligjin në lidhje me përgjegjësinë penale individuale bën të qartë se në qoftë se kryesi fizik i një shkeljeje bazë nuk është i akuzuari, jo domosdoshmërisht gjendja e tij mendore është përcaktuese nëse shkelja përbën krim të juridiksionit të Tribunalit, megjithëse është e rëndësishme për të vërtetuar se faktikisht sjellja e tij përbën shkelje. Rrjedhimisht në qoftë se kryesi fizik jo i akuzuar nuk është i vetëdijshëm për kontekstin e krimeve të tij, mirëpo eprori i tij ose kryesi i ndërmjetëm është, këto krime gjithsesi do të përbëjnë krime kundër njerëzimit nëqoftëse plotësohen edhe kushtet e tjera të përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit.

157. Megjithëse formulimi i rrethanave mund të jetë më i thjeshtë kur sjellja përbën krim kundër njerëzimit nëpërmjet pohimit se kushti plotësohet në qoftë se *i akuzuari*, qoftë kryesi fizik ose një individ nën komandën e të cilit vepron autori fizik, di se sjellja për të cilën ai mban përgjegjësi është pjesë e sulmit, Dhoma Gjyqësore gjykon se ky formulim është njëkohësisht tepër i ngushtë

²⁹⁰ Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 248, shënim. 311.

²⁹¹ Vendimi *Mërshiq* i Rregullës 61, para. 15 (theksohet se “përgjegjësia e të akuzuarve për veprime për të cilat janë akuzuar nuk mund të provohet vetëm nëpërmjet pozitës së tyre eprore, por edhe nëpërmjet *pjesëmarrjes së tyre të drejtpërdrejtë në kryerjen e këtyre veprimeve*”) (theks i shtuar); *shih po aty*. para. 30.

²⁹² *Shih p.sh.*, Aktgjykimi *Kupreshiq dhe të tjerë*, para. 544 (“Më poshtë janë identifikuar elementët kyç të krimeve kundër njerëzimit: ... së dyti, se veprimet ishin pjesë e një ndodhie të përhapur gjerësisht ose sistematike krimesh kundër popullatës civile”); Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 429, f. 267 (ku theksohet se i akuzuari nuk i kreu fizikisht veprat penale për të cilat akuzohet, dhe fajësohet për “urdhërimin e një krimi kundër njerëzimit” për pesë kategori shkeljesh bazë) (theks i shtuar); Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 98 (konfirmohet përshkrimi i Dhomës Gjyqësore *Bllashkiq* i kushtit të parë të lidhjes, ku nuk përmendet autori i veprave penale që përbëjnë krime kundër njerëzimit, edhe pse vetë Dhoma e Apelit në të njëjtin paragraf pohoi se “veprimet e të akuzuarit” duhet të jenë pjesë e sulmit), para. 102 (“Dhoma e Apelit konkludon se Dhoma Gjyqësore kishte të drejtë kur deklaroi se veprimet që përbëjnë krime kundër njerëzimit duhet të jenë pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik kundër civilëve.”); *krahaso*. Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 117 (duke pranuar në kontekstin e veprimeve çnjerëzore si krime kundër njerëzimit, se shkeljet bazë mund kryhen ose prej të akuzuarit ose prej vartësve të tij).

²⁹³ Dhoma Gjyqësore thekson se Dhoma e Apelit heshturazi nuk ka miratuar përdorimin e termit “kontekst” në kuadër të diskutimit të kushteve të përgjithshme të Nenit 5, së paku në lidhje me përmendjen e këtyre elementëve. *Krahaso* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 85, me Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 410. Mirëpo për hir të saktësisë, Dhoma shpesh do të përmendë “sulm” si kontekst i sjelljes bazë të kryesit fizik. Më poshtë vijon formulimi i plotë i kushteve të përgjithshme të Nenit 5.

dhe tepër i gjerë. Është tepër i ngushtë sepse duke iu referuar vetëm të akuzuarit, përjashton prej cilësimit krime kundër njerëzimit, rrethana kur një epror jo i akuzuar i kryesit fizik ose të ndërmjetëm plotëson kushtin e dijenisë. Vetëm një interpretim tejet i ngushtë i ligjit do të shpinte në konkluzionin se në një rast të tillë shkelja që gjithsesi plotëson kushtet e përgjithshme, nuk përbën krim kundër njerëzimit. Nga ana tjetër, përkufizimi i mësipërm mund të jetë tepër i gjerë në rrethana kur kryesi fizik, ose ai i ndërmjetëm, nuk është i vetëdijshëm për kontekstin e krimeve të tij dhe individit në dijeni të këtij konteksti është kaq larg kryerjes së krimit sa që kjo dijeni nuk mund të konsiderohet relevante, si p.sh ndihmësi dhe inkurajuesi, ose gjendja mendore e individit ligjërisht nuk ka lidhje me vërtetimin e krimit si rasti i një eprori i cili mund të jetë përgjegjës në bazë të Nenit 7(3). Dhoma gjykon se në rrethana të tilla shkelja nuk duhet cilësuar krim kundër njerëzimit.²⁹⁴

158. Dhoma rithekson se që një shkelje bazë të kategorizohet krim kundër njerëzimit bazuar në dijeninë individuale të kontekstit të ndodhisë së saj, lidhja midis individit dhe kryerjes së shkeljes duhet të jetë e drejtpërdrejtë ose e afërt në masë të mjaftueshme. Dhoma Gjyqësore gjykon se drejtpërdrejtshmëria ose afërsia e mjaftueshme e lidhjes së përmendur pasqyrohet më së miri prej kushtit se individit *synoi* kryerjen e shkeljes, e brendaqenësishme në katër format e përgjegjësive përcaktuar në Statut: kryerje, planifikim, urdhërim dhe nxitje. Në bazë të të gjitha këtyre formave të përgjegjësive, dijenia e kontekstit të një shkeljeje është pjesë e procesit mendor që rezulton në kryerjen e shkeljes në fjalë. Nga ana tjetër në rastet kur vetëm individë gjendja mendore e të cilëve jo domosdoshmërisht arrin nivelin e nevojshëm të synimit, si ndihmësi ose inkurajuesi ose eprori i cili nuk parandalon ose ndëshkon, kanë këtë dijeni, shkelja nuk duhet kategorizuar krim kundër njerëzimit, pavarësisht nëse individit është ose nuk është i akuzuar. Shprehur më thjeshtë, për aq sa dikush ka dijeni të kontekstit të ndodhisë së shkeljeve dhe ai individ nuk është thjesht ndihmës ose inkurajues ose nuk parandalon apo ndëshkon shkeljet, atëherë janë kryer krime kundër njerëzimit. Rrjedhimisht shkelja bazë mund të cilësohet krim kundër njerëzimit së paku në dy raste: së pari kur plotësohen të dy kushtet e lidhjes prej kryesit fizik, sepse nga një anë kryen veprime dhe mosveprime që janë pjesë e sulmit dhe di se sjellja e tij është pjesë e sulmit; dhe së dyti, në qoftë se planifikuesi, urdhëruesi, nxitësi i kësaj sjelljeje ose anëtari i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, di se është pjesë e sulmit, edhe pse kryesi fizik nuk ka dijeni për kontekstin e sjelljes së tij.

²⁹⁴ Dhoma thekson se analiza e mësipërme është kryer duke mbajtur parasysh vetëm dy elementë, konkretisht kryesi fizik dhe personi nën pushtetin e të cilit ai vepron. Mirëpo kjo është forma më e thjeshtë e hierarkisë komanduese ose pushtetore dhe midis këtyre dy personave mund të ketë një numër ndërmjetësish.

159. Dhoma thekson se kjo analizë nuk duhet ngatërruar me problemin nëse i akuzuari mban përgjegjësi penale për një krim konkret kundër njerëzimit. Faktikisht analiza e mësipërme ka të bëjë me faktin nëse u krye apo nuk u krye krim.

160. Duke iu kthyer kushtit të përgjithshëm, Dhoma rrjedhimisht thekson se ai mund të ndahet në dy nënelementë: kryesi fizik ose individi i cili planifikoi, urdhëroi ose nxiti sjelljen e tij (a) di se ka sulm të gjerë ose sistematik kundër popullatës civile dhe (b) di që sjellja e kryesit fizik është pjesë e sulmit ose rrezikon një gjë të tillë.²⁹⁵ Ky kusht nuk kërkon që dijenia për sulmin të jetë e hollësishme.²⁹⁶

161. Nga pikëpamja ligjore, ky kusht nuk duhet ngatërruar me motivet e autorit fizik, ose individit nën komandën e të cilit ai vepron, sepse një krim kundër njerëzimit mund të kryhet për motive “tërësisht personale”.²⁹⁷ Jo domosdoshmërisht kryesi fizik, ose individi nën komandën e të cilit ai vepron, duhet të ketë të njëjtin synim të sulmit, dhe nuk ka rëndësi nëse ai kishte synimin që shkeljet bazë të ishin të drejtuara kundër popullatës së sulmuar, ose thjesht kundër viktimës ose viktimave në fjalë.²⁹⁸ Kundër popullatës civile duhet të ekzistojë sulmi dhe jo shkeljet bazë, dhe kryesi fizik ose individi nën komandën e të cilit ai vepron, duhet të dijë ose të rrezikojë vetëm se veprimet për të cilat është përgjegjës janë pjesë e sulmit.²⁹⁹

vi. Konkluzion

162. Duke marrë parasysh jurisprudencën dhe praktikën e Tribunalit, dhe për arsyet e shtjelluara më lart, Dhoma Gjyqësore gjykon se shprehja më e qartë e kushteve të përgjithshme të Nenit 5 vijon si më poshtë:

- (a) Duhet të ketë sulm.
- (b) Sulmi duhet të jetë kundër një popullate civile.
- (c) Sulmi duhet të jetë i përhapur gjerësisht ose sistematik.
- (d) Veprimet e autorit fizik duhet të jenë pjesë e sulmit.

²⁹⁵ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 99; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 124–125; Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 99, 102–103.

²⁹⁶ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 102; *shih edhe* Aktgjykimi *Limaj dhe të tjerë*, para. 190.

²⁹⁷ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 103; Aktgjykimi i Apelit *Tadiq*, para. 248, 252, 272. Megjithëse në Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë* gjithashtu u konkludua se, “më së shumti, provat se [i akuzuari] kreu veprime për motive thjesht personale mund të ndihmojnë një pandehmë të diskutueshme se ai nuk ishte i vetëdijshëm që veprimet e tij ishin pjesë e sulmit”, ky konkluzion tingëllon i përshtatshëm vetëm në rastin e kryesit fizik që është edhe i akuzuar. Duke mbajtur parasysh dallimin që bën Dhoma Gjyqësore midis kryesit fizik dhe të akuzuarit që nuk është kryes fizik, fakti se shkelja u krye fizikisht për motive thjesht personale nuk ka ndikim në çështjen nëse shkelja përbën krim kundër njerëzimit.

²⁹⁸ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 103.

²⁹⁹ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 102, 103; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 121–127.

- (e) Kryesi fizik ose planifikuesi, urdhëruesi ose nxitësi i veprimeve të kryesit fizik ose një anëtar i ndërmarrjes së përbashkët kriminale, duhet të dijë se ka sulm kundër popullatës civile dhe të dijë që veprimet e tij janë pjesë e sulmit ose të rrezikojë një gjë të tillë.

- c. Elementë të shpërnguljes së dhunshme si shkelje bazë: zhvendosje e dhunshme dhe dëbim

163. Secili prej të Akuzuarve akuzohet për dëbim dhe veprime të tjera çnjerëzore (zhvendosje e dhunshme) si krime kundër njerëzimit. Një numër elementesh të këtyre shkeljeve janë të njëjtë dhe diskutohen në kreun “shpërngulje e dhunshme”,³⁰⁰ togfjalësh përgjithësues i volitshëm, i përdorur prej Dhomës në tërë Aktgjykimin për t’iu referuar si dëbimit po ashtu edhe zhvendosjes së dhunshme.

164. Veprimi i fajshëm i shpërnguljes së dhunshme është (a) shpërngulja e personave nëpërmjet dëbimit ose veprimeve të tjera shtrënguese, (b) prej një zone ku prania e tyre është e ligjshme, (c) e pabazuar në të drejtën ndërkombëtare.³⁰¹ Synimi kriminal konkretizohet nëpërmjet synimit të shpërnguljes së përhershme apo ndryshe të viktimave, ose brenda kufijve përkatës shtetërorë (në zhvendosjen e dhunshme), ose përtej kufijve përkatës shtetërorë (në dëbim).³⁰²

165. Në një sërë aktgjykimesh të Tribunalit është konkluduar se:

Si dëbimi po ashtu edhe zhvendosja e dhunshme konsistojnë në evakuim të paligjshëm dhe kundër dëshirës të individëve, prej territorit ku banojnë. Mirëpo në të drejtën zakonore ndërkombëtare këto koncepte nuk janë të njëjta. Dëbimi nënkupton zhvendosje jashtë kufijve shtetërorë, kurse zhvendosja e dhunshme konsiston në shpërngulje brenda shtetit.³⁰³

Element thelbësor është se shpërngulja është kundër dëshirës.³⁰⁴ Dhomat Gjyqësore dhe ajo e Apelit vazhdimisht kanë konkluduar se veprimi i shpërnguljes bëhet i paligjshëm nëpërmjet mungesës së “lirisë së njëmendtë të zgjedhjes”.³⁰⁵ Në këtë kontekst, Dhoma e Apelit ka konkluduar se liria e njëmendtë e zgjedhjes nuk mund të deduktohet prej faktit të dhënies së pëlqimit në rrethana të cilat e zhvlerësojnë tërësisht dhënien e pëlqimit.³⁰⁶ Gjithashtu, Dhomat Gjyqësore dhe

³⁰⁰ *Shih* Aktgjykimi *Simiç dhe të tjerë*, para. 123–124; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 473.

³⁰¹ Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 474.

³⁰² Aktgjykimi *Martiç*, para. 111; Aktgjykimi i Apelit *Stakiç*, para. 278, 307, 317; *krahaso* Vendimi *Milloseviç* i Rregullës 98 bis, para. 78; *gjithsesi shih* Aktgjykimi i Apelit *Naletiliç*, Arsyetimi Mospajtuës i Gjykatësit Schomburg, para. 24.

³⁰³ Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 521; *shih edhe* Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 474, 476; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 218, 222–224; Aktgjykimi *Simiç dhe të tjerë*, para. 129; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 540; Aktgjykimi *Bllagojeviç*, para. 595.

³⁰⁴ Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 543; Aktgjykimi *Simiç dhe të tjerë*, para. 125.

³⁰⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 229; Aktgjykimi *Bllagojeviç*, para. 596; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 543; Aktgjykimi i Apelit *Stakiç*, para. 279.

³⁰⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 229. *Shih edhe* Vendimi *Milloseviç* i Rregullës 98 bis, para. 72; Aktgjykimi *Simiç dhe të tjerë*, para. 125; Aktgjykimi i Apelit *Stakiç*, para. 279.

ajo e Apelit kanë konkluduar për mungesën e lirisë së njëmendtë të zgjedhjes, bazuar në veprime kërcënuese dhe frikësuese që synojnë të privojnë popullatën civile prej ushtrimit të vullnetit të saj të lirë, p.sh granatimi i objekteve civile, djegia e pronave të civilëve dhe kryerja ose kërcënimimi për kryerjen e krimeve të tjera “me synim që të terrorizohet popullata dhe të detyrohet të largohet prej zonës pa shpresë kthimi”.³⁰⁷

166. Në të drejtën ndërkombëtare ekzistojnë dy arsye të cilat e legjitimojnë shpërnguljen e individëve: ajo mund të kryhet ose për hir të sigurisë së popullatës civile, ose për arsye të domosdoshme ushtarake.³⁰⁸ Sido që të jetë rasti, dallimi kryesor midis shpërnguljes së dhunshme ilegjitime dhe evakuimit të lejueshëm është se, “individët e evakuuar për arsye legjitime, kthehen në shtëpitë e tyre me mbarimin e luftimeve në zonën në fjalë.”³⁰⁹ Rrjedhimisht është i paligjshëm përdorimi i masave të evakuimit si pretekst për shpërnguljen e dhunshme të popullatës dhe marrjen nën kontroll të një territori.³¹⁰

167. Dhoma e Apelit ka konkluduar se shkeljet si dëbimi dhe zhvendosja e dhunshme nuk diktojnë ekzistencën e synimit të shpërnguljes së përhershme të viktimave, por vetëm synimin e shpërnguljes.³¹¹ Sa për kushtin e dijenisë në lidhje me të tëra krimet kundër njerëzimit dhe kushtin e synimit konkret të përndjekjes, Dhoma thekson se synimi i shpërnguljes së viktimave mund të jetë si i autorit fizik apo planifikuesit, urdhëruesit ose nxitësit të sjelljes së autorit fizik, po ashtu edhe i një anëtari të ndërmarrjes së përbashkët kriminale.

³⁰⁷ Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 126.

³⁰⁸ *Shih* Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 597; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 556. Protokollin Shtesë II i cilëson sigurinë e popullatës dhe arsye shumë të rëndësishme ushtarake si justifikimi i vetëm për evakuimin e popullatës civile. Protokollin Shtesë II, paragrafi 1 i nenit 7. Përveç këtyre dy përjashtimeve Dhoma Gjyqësore *Bllagojeviq* konkludoi se ligji lejon evakuimin për arsye humanitare. Dhoma e bazoi këtë konkluzion në nenin 17 të Protokollit Shtesë II, ku parashtrohet se “shpërngulja e popullatës civile nuk urdhërohet për arsye që kanë lidhje me konfliktin[.]” Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 600. Shpjeguesi i nenit 17 bën të qartë se për arsye të tjera, si p.sh, përhapja ose rreziku i përhapjes së epidemive, katastrofa natyrore, ose ekzistenca e kushteve të padurueshme dhe vdekjeprurëse të jetesës, palët e konfliktit mund të kryejnë në mënyrë të ligjshme evakuimin e popullatës. *Shih* Shpjeguesi i KNKK-së për Protokollin Shtesë II, para. 4855; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 600.

³⁰⁹ Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 556 (citohet neni 49 i Konventës së Katërt të Gjenevës). Në shpjeguesin zyrtar theksohet se “evakuimi nuk duhet të përfshijë lëvizjen e personave në mbrojtje jashtë territorit të pushtuar, me përjashtim të rastit kur nuk është fizikisht e mundur të veprohet ndryshe. Rrjedhimisht si rregull, evakuimi duhet të bëhet në qendrat e pritjes brenda territorit.” Shpjeguesi i KNKK-së për Konventën e Katërt të Gjenevës, f. 280 (nuk përfshihet poshtëshënimimi); *shih edhe* Protokollin Shtesë II, neni 17(2); Shpjeguesi i KNKK-së për Protokollin Shtesë II, para. 4858–4865.

³¹⁰ Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 597; *shih edhe* Shpjeguesi për Protokollin Shtesë II, para. 4854.

³¹¹ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 307, 317; *mirëpo shih* Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq*, Arsyetimi Mospajtuës i Gjykatësit Schomburg, para. 24.

i. Dëbimi si krim kundër njerëzimit

168. Veç vërtetimit të veprimit të fajshëm dhe synimit kriminal të shkeljes bazë të përndjekjes, Prokuroria duhet të provojë edhe kushtet e përgjithshme të Nenit 5, në mënyrë që përndjekja të cilësohet krim kundër njerëzimit bazuar në paragrafin d të Nenit 5.

169. Megjithëse jo drejtpërsëdrejti i lidhur me këtë çështje, Dhoma shkurtimisht përmend se ndryshimi midis dëbimit dhe zhvendosjes së dhunshme është zvogëluar prej Dhomës së Apelit e cila në çështjen *Stakiq* konkludoi se në rrethana të veçanta shpërngulja përtej një kufiri *de facto* mund të konsistojë mjaftueshëmrisht në dëbim.³¹²

ii. Veprime të tjera çnjerëzore si krime kundër njerëzimit: zhvendosje e dhunshme

170. Që veprimi ose mosveprimi i autorit fizik të cilësohet krim kundër njerëzimit bazuar në paragrafin i të Nenit 5, në jurisprudencën e Tribunalit janë identifikuar katër kushte konkrete: (a) sjellja duhet t'i shkaktojë vuajtje të rëndë mendore ose fizike ose të jetë sulm i rëndë ndaj dinjitetit njerëzor të viktimës;³¹³ (b) sjellja duhet të ketë të njëjtën peshë me sjelljen e përmendur në Nenin 5;³¹⁴ dhe (c) kryesi fizik duhet të ketë kryer qëllimisht veprimin ose mosveprimin³¹⁵ (d) me synimin e shkaktimit të dëmit të rëndë fizik ose mendor viktimës ose për kryerjen e një sulmi të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor³¹⁶, ose i vetëdijshëm se veprimi ose mosveprimi i tij kishte të ngjarë t'i shkaktonte viktimës dëm të rëndë mendor ose fizik ose sulm të rëndë ndaj dinjitetit njerëzor.³¹⁷

171. Jurisprudenca e Tribunalit tregon se shkelja bazë e zhvendosjes së dhunshme, është krimi statutor “veprime të tjera çnjerëzore”.³¹⁸

172. Në përdorimin e analizës së mësipërme për të vërtetuar kryerjen e zhvendosjes së dhunshme si krim kundër njerëzimit “veprime të tjera çnjerëzore”, Prokuroria duhet të provojë (a) veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të shpërnguljes së dhunshme, (b) kushtin e përgjithshëm të krimeve

³¹² Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 300; *shih edhe Prokurori k. Dragan Nikoliqit*, Lënda Nr. IT-94-2, Rishikim i Aktakuzës Bazuar në Rregullën 61 të Rregullores së Procedurës dhe Provave, 20 tetor 1995, para. 23.

³¹³ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 117; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 130; Aktgjykimi *Tadiq*, para. 729.

³¹⁴ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 671; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 580; Aktgjykimi *Galiq*, para. 152; Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 74; Aktgjykimi *Vasileviq*, para. 234; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 130; Aktgjykimi *Kordiq*, para. 269; Aktgjykimi *Tadiq*, para. 729; Aktgjykimi *Kajelijeli*, para. 932; Aktgjykimi *Kayishema*, para. 154.

³¹⁵ Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 626; Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 74; Aktgjykimi *Vasileviq*, para. 234; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 130.

³¹⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 117; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 627–628; Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 75–76; Aktgjykimi *Galiq*, para. 154; Aktgjykimi *Vasileviq*, para. 235–236; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 131–132.

³¹⁷ *Shih* Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 627–628; Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 75–76; Aktgjykimi *Galiq*, para. 154; Aktgjykimi *Vasileviq*, para. 235–236; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 131–132.

³¹⁸ Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 317; Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 629; Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 566.

kundër njerëzimit, dhe (c) katër kushte konkrete për veprime të tjera çnjerëzore të parashtruara më lart.

d. Elementë të vrasjes si krim kundër njerëzimit

173. Më lart u parashtruan elementët e vrasjes si shkelje bazë në juridiksionin e Nenit 3 të Statutit. Këta elementë janë të barasvlershëm edhe kur akuza për vrasje figuron si shkelje bazë e krimeve kundër njerëzimit bazuar në paragrafin (a) të Nenit 5. Rrjedhimisht për të provuar kryerjen e vrasjes si krim kundër njerëzimit, Prokuroria duhet të provojë (a) veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të vrasjes dhe (b) kushtet e përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit të parashtruara më sipër.

e. Kushte konkrete të përndjekjes si krim kundër njerëzimit

174. Veç kushteve të lartrenditura të krimeve kundër njerëzimit, që shkelja bazë të cilësohet përndjekje sipas paragrafit (h) të Nenit 5, duhen plotësuar edhe disa kushte konkrete.

i. *Elementi fizik i përndjekjes*

175. Akuza e përndjekjes përfshin disa shkelje bazë. Sjellja bazë përndjekëse në jurisprudencën e Tribunalit përgjithësisht përshkruhet si veprim ose mosveprim që (a) diskriminon në fakt dhe (b) mohon ose shkel një të drejtë themelore e sanksionuar në të drejtën zakonore ndërkombëtare ose në të drejtën e traktateve.³¹⁹

176. Dhomat Gjyqësore dhe e Apelit e Tribunalit vazhdimisht kanë theksuar se përndjekja si krim kundër njerëzimit duhet të ketë synimin e diskriminimit mbi baza politike, racore ose fetare. Për më tepër në praktikë është pranuar se diskriminimi etnik plotëson kushtin.³²⁰ Dhoma Gjyqësore konkludon se popullata shqiptare kosovare përbënte grup etnik, që mbulohet prej paragrafit (h) të Nenit 5 të Statutit dhe rrjedhimisht se diskriminimi kundër shqiptarëve kosovarë për shkak të përkatësisë së tyre në këtë grup, përmbush kushtin e synimit përndjekës.

177. Në lidhje me kushtin e parë, që të jetë “veprim diskriminues” sjellja bazë duhet të “diskriminojë faktikisht”.³²¹ Veprimi është diskriminues kur viktima sulmohet për shkak të

³¹⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 185; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 131; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 113.

³²⁰ *Shih* Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 636, 589, 591, 780; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 111; Aktgjykimi *Kërstiq*, para. 538; Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë.*, para. 366, 455; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 185; Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 56; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 992, shënim 2484, 993.

³²¹ *Shih* Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 583; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 992; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 431; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 732; Aktgjykimi *Vasileviq*, para. 244.

përkatësisë së tij në një prej grupeve të mbrojtura.³²² Çështja nëse “diskriminimi faktik” duhet vlerësuar objektivisht ose subjektivisht ka shkaktuar mospajtime në disa aktgjykime të Dhomave Gjyqësore. Dhoma e Apelit ka vendosur në dobi të analizës subjektive.³²³

178. Në lidhje me kushtin e dytë, jo çdo mohim ose shkelje e një të drejte themelore është aq e rëndë sa me gjasë të cilësohet krim kundër njerëzimit.³²⁴ Veprimi ose mosveprimi i përndjekjes bazë si krim kundër njerëzimit i marrë veçazi ose në lidhje me veprime të tjera, mund të përfshihet në nënparagrafë të tjerë të Nenit 5 dhe sido që të jetë, duhet të ketë të njëjtën peshë si krimet e renditura në Nenin 5 të Statutit.³²⁵

179. Në përcaktimin nëse një veprim ose mosveprim bazë përmbush kushtin e peshës së barabartë, Dhoma Gjyqësore mund të shqyrtojë nëse sjellja përbën një shkelje konkrete që buron prej neneve të Statutit,³²⁶ pa u përmendur shprehimisht në Statut.³²⁷ Megjithëse përndjekja u referohet një sërë veprimesh, mjafton një veprim apo mosveprim.³²⁸ Mirëpo në zbatimin e kushtit të peshës veçanërisht në lidhje me sjelljen që nuk përbën shkelje në bazë të Statutit ose krim në bazë të së drejtës ndërkombëtare, “veprimet nuk duhen shqyrtuar veçazi, por në kontekst bazuar në efektin e tyre të gjithsejtë.”³²⁹

³²² Aktgjykimi *Bllagojeviq*, para. 583.

³²³ Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 185:

Dhoma e Apelit gjykon se një serb i marrë gabimisht për mysliman gjithsesi mund të jetë viktimë e krimit të përndjekjes. Dhoma e Apelit gjykon se veprimi i kryer kundër tij përbën diskriminim faktik, në lidhje me serbë të tjerë të cilët nuk ishin subjekt i veprimeve të tilla, të kryera me qëllimin e diskriminimit të një grupi mbi baza etnike.

Shih Aktgjykimi *Naletiliq*, para. 636 shënim 1572:

Dhoma mendon se një interpretim teleologjik i elementit “bazë diskriminuese” kërkon marrjen në konsideratë të faktit se përgjegjësia e përkufizimit të “grupit të vënë në shenjë” është vetëm e grupit keqbërës. Në qoftë se keqbërësi përcakton përkatësinë e një personi në grupin e shënuar, atëherë ky përkufizim bëhet “diskriminim faktik për viktimitë sepse nuk mund të kundërshtohet edhe sikur një cilësim i tillë mund të jetë i pasaktë sipas kriterëve objektive.

³²⁴ *Shih p.sh.*, Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 621; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 434; Aktgjykimi *Naletiliq*, para. 635; Aktgjykimi *Simiq dhe të tjerë*, para. 48; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 995.

³²⁵ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 321; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 135; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 199, 221; Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq*, para. 574.

³²⁶ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 323.

³²⁷ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 323; Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 434; Aktgjykimi *Naletiliq*, para. 635; Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 614. Megjithëse në disa Aktgjykime të Dhomave Gjyqësore pohojnë se veprimet që përbëjnë krime në bazë të Neneve 2 dhe 3 të Statutit janë të rënda në atë masë sa të cilësohen përndjekje, në Aktgjykime të tjera Gjyqësore demonstron se shkeljet e përmendura në këto nene duhen shqyrtuar pavarësisht për të vendosur nëse janë aq të rënda sa krimet e përmendura në Nenin 5. *Krahaso* Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 439, *me* Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 995. Katër Aktgjykimet e mëpasme të Apelit ku u diskutua elementi fizik i përndjekjes, as nuk e theksuan ndryshimin në arsyetim dhe as shprehën qëndrim në lidhje me këtë pikë. *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 321–323; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 102; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 135; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 199.

³²⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 135 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 113).

³²⁹ Aktgjykimi i Apelit *Kvočka dhe të tjerë*, para. 321 (ndër të tjera citohet, Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 615(e), 622 (diskutohen veprime të cilat në vetvete nuk janë aq të rënda sa të përbëjnë krim kundër njerëzimit); Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 434 (përmenden veprime që si rregull nuk janë aq të rënda sa të përbëjnë krim kundër njerëzimit); *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq*, para. 574.

ii. *Elementi mendor i përndjekjes: synimi diskriminues*

180. Që të cilësohet përndjekje, veprimi ose mosveprimi bazë duhet të jetë kryer qëllimisht, me synimin e diskriminimit mbi një prej bazave të përmendura në paragrafin (h) të Nenit 5, politik, racor ose fetar.³³⁰ Megjithëse kushti i synimit diskriminues mund të mos plotësohet vetëm prej përmendjes së pretendimit për karakterin diskriminues të sulmit, “ai mund të deduktohet prej këtij konteksti për sa kohë që bazuar në faktet e çështjes, rrethanat e kryerjes së veprimeve të pretenduara vërtetojnë ekzistencën e synimit.”³³¹

181. Në lidhje me çështjen kush duhet të ketë synimin diskriminues, konkretisht kryesi fizik apo i akuzuari i cili planifikoi, urdhëroi ose nxiti sjelljen e kryesit fizik, Dhoma Gjyqësore gjykon se për sa kohë që një prej këtyre individëve ka synim diskriminues, ky element përmbushet. Dhoma pohon këtu se kjo analizë nuk duhet ngatërruar me aspektin nëse i akuzuari mbart përgjegjësi penale për përndjekje. Ajo thjesht konsiston në përcaktimin nëse u krye apo nuk u krye përndjekje.

f. Elementë të akuzave për forma të përndjekjes mbi baza politike, fetare ose racore

i. *Vrasja si formë përndjekjeje*

182. Kushti i parë konkret i përndjekjes, që sjellja në fjalë mohon ose shkel një të drejtë themelore dhe përbën shkelje me peshë të njëjtë si krimet e përmendura në Nenin 5, është aspekt ligjor dhe është i sanksionuar në jurisprudencën e Tribunalit, se shkelja bazë e vrasjes përmbush këtë kusht.³³² Për të vërtetuar se vrasja u krye si formë përndjekjeje, Prokuroria duhet të provojë (a) veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të vrasjes, (b) kushtet konkrete të përndjekjes, dhe (c) kushtet e përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit, të gjitha këto të parashtruara më lart.

³³⁰ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 320; Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 185; Aktgjykimi i Apelit *Vasileviq*, para. 113; Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 131; *shih edhe* Aktgjykimi *Kërnojelac*, para. 431 shënim 1290 (“Megjithëse në Statut arsyet përmenden në mënyrën lidhore, jurisprudenca e Tribunalit ka përcaktuar se ekzistenca e synimit diskriminues për cilëndo prej këtyre arsyeve është e mjaftueshme për plotësimin e kushtit të synimit kriminal të përndjekjes [.]”) (citohet Aktgjykimi *Tadiq*, para. 713); Aktgjykimi i Apelit *Stakiq*, para. 328 (konkludohet se synimi kriminal i përndjekjes konsiston në synimin për kryerjen e shkeljes bazë dhe synimin e diskriminimit mbi baza politike, racore dhe fetare).

³³¹ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 164 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Kërnojelac*, para. 184). Në një çështje tjetër, Dhoma e Apelit ka konkluduar se bazuar në faktet e çështjes që kishte në administrim, “synimi për të kontribuar në ndërmarrjen e përbashkët kriminale dhe synimi diskriminues është e njëjta gjë.” Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 347; *shih edhe* Aktgjykimi i Apelit *Naletiliq*, para. 129, 146.

³³² *Shih p.sh.*, Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 106 (citohet Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 143; Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 615).

ii. *Dhuna seksuale si formë përndjekjeje*

183. Ndër akuzat e përndjekjes në Pikën 5 të Aktakuzës përfshihet “dhunë seksuale prej forcave të RFJ-së dhe Serbisë kundër shqiptarëve kosovarë, veçanërisht kundër grave”.³³³ Në Aktakuzë nuk përdoret fjala “përdhunim” dhe nuk shpjegohet nëse me shprehjen “dhunë seksuale” nënkuptohet edhe përdhunimi. Për më tepër, megjithëse prej jurisprudencës së Tribunalit duket se si përdhunimi, po ashtu edhe dhuna seksuale janë të ndëshkueshme në Statut, është më pak e qartë nëse “dhunë seksuale” përfaqëson terminologji që ka të bëjë me një krim seksual që nuk është përdhunim, apo term i përgjithshëm ku përfshihet edhe përdhunimi.³³⁴ Në këtë çështje, interpretimi i Dhomës për pikën 5 ku përfshihet forma e përndjekjes e quajtur “dhunë seksuale”, do të përfshijë edhe përdhunimin në rastet kur ka prova të penetrimit seksual si dhe forma të tjera të dhunës seksuale, elementët e të cilave diskutohen më poshtë.

184. Megjithëse në Statut “dhuna seksuale” nuk përmendet ndër krimet në juridiksionin e Neneve 2, 3, 4, ose 5, një numër burimesh provojnë juridiksionin e Tribunalit në lidhje me dhunën seksuale. Së pari, raporti i Sekretarit të Përgjithshëm i vitit 1993 i titulluar ““Rape and Abuse of Women in the Territory of the Former Yugoslavia/Përdhunimi dhe Keqtrajtimi i Grave në Territorin e ish-Jugosllavisë”, në të cilin disa herë përmendet dhuna seksuale, bën të qartë se synimi ishte që Tribunali të kishte juridiksion për krime seksuale, përfshirë edhe përdhunimin.³³⁵ Gjithashtu në Shtojcën II të Raportit Përfundimtar të Komisionit të Ekspertëve ngritur prej Këshillit të Sigurimit me Rezolutën 780 (1992) përfshihej një studim ligjor i përdhunimit dhe dhunës seksuale: në këtë Shtojcë shprehimisht shkruhet se forma të dhunës seksuale që nuk janë përdhunim, si p.sh “prostitucioni me detyrim dhe syneti i dhimbshëm”, “konsiderohen krime shumë të rënda me një sërë pasojash të dhimbshme për viktimat”.

185. Rregullorja e Tribunalit përfshin dispozita konkrete për viktimat e dhunës seksuale, si Rregulla 34 e cila përsërit rëndësinë e përbushjes së nevojave të viktimave dhe dëshmitarëve në lidhje me këtë shkelje. Nga ana e saj Rregulla 96 bën fjalë konkretisht për provat e dhunës seksuale

³³³ Aktakuzë, para. 77(c).

³³⁴ *Krahaso* Aktgjykimi *Bërgjanin*, Pjesa IX.F.2.b (përdhunimi dhe dhuna seksuale diskutohen në dy kre të ndryshme, dhe kategoria e dytë ndër të tjera përshkruhet si, “çfarëdo dhune seksuale që nuk është përdhunim”), *me* Aktgjykimi *Stakiq*, para. 757 (ku bëhet dallimi në kreun “Përdhunime dhe dhunë seksuale”, midis përdhunimit dhe “çfarëdo dhune tjetër seksuale që nuk përfshin penetrimin faktik”) (theks i shtuar), Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë.*, Pjesa IV.D (diskutohet Rregulla 96 dhe aspekti i provave në çështjet e dhunës seksuale në kreun “Përdhunim”), dhe Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 186 (ku bëhet dallimi midis përdhunimit dhe “çfarëdo dhune tjetër seksuale që nuk përfshin penetrimin faktik”); *shih edhe* Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 182, 184 (ku në kontekstin e diskutimit të legjislacionit shtetëror bëhet dallimi midis dhunës seksuale dhe përdhunimit).

³³⁵ Report of the Secretary-General Pursuant to Paragraph 2 of Security Council Resolution 808/Raport i Sekretarit të Përgjithshëm Bazuar në Paragrafin 2 të Rezolutës 808 të Këshillit të Sigurimit, UN Doc. No. S/25704, 3 maj 1993, para. 48 (“Krimet kundër njerëzimit janë veprime të një karakteri shumë të rëndë ... Në konfliktin në territorin e ish-Jugosllavisë, veprime të tilla çnjerëzore, janë shfaqur në formën e të ashtuquajturit ‘spastrim etnik’, përdhunimeve të përhapura gjerësisht dhe sistematike dhe forma të tjera të dhunës seksuale, ndër të cilat prostitucioni i detyruar.”).

dhe konfirmon synimin e Tribunalit për procedimin penal jo vetëm të përdhunimeve, po edhe kategorive të tjera të dhunës seksuale.

186. Konfirmim i shprehur i juridiksionit të Tribunalit në lidhje me dhunën seksuale si veprë penale e dallueshme prej përdhunimit gjendet në Aktgjykimin *Furunxhija*, ku shkruhet se “rregullat penale ndërkombëtare dënojnë jo vetëm përdhunimin, por edhe çfarëdo dhune të rëndë seksuale që nuk përfshin penetrimin seksual.”³³⁶ Një deklaratë e ngjashme gjendet edhe në Aktgjykimin *Stakiq*.³³⁷ Mirëpo këto vendime nuk parashtrojnë qartësisht veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të “dhunës seksuale”, dhe as nuk sqarojnë në cilat kategori të krimeve të parashtruara të parashtruara në Statutin e Tribunalit, përfshihet.

187. Siç u theksua më lart, për të vërtetuar kryerjen e përndjekjes, Dhoma Gjyqësore duhet të konkludojë se “dhuna seksuale” përbën mohim ose shkelje të një të drejte themelore dhe ka të njëjtën peshë si krimet e tjera të përmendura në Nenin 5 të Statutit. Megjithatë si formë përndjekjeje, nuk është e nevojshme të tregohet se “dhuna seksuale” në vetvete ishte krim sipas të drejtës ndërkombëtare në kohën e kryerjes së veprimeve në fjalë.³³⁸

(A) Mohimi ose shkelja e një të drejte themelore

188. Shprehja “dhunë seksuale” nuk përdoret shprehimisht në asnjë traktat ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.³³⁹ Konventa mbi Eliminimin e Çdo Forme Diskriminimi Kundër Grave nuk e përmend dhunën seksuale, megjithëse përmendet ndalimi i “shfrytëzimit të prostitucionit”.³⁴⁰ Mirëpo e drejta për të mos u dhunuar seksualisht është përfshirë në të drejta të përgjithshme themelore në lidhje me paprekshmërinë fizike të individit.³⁴¹

189. Në një numër aktgjykimesh të Tribunalit dhe TPNR-së bëhet e qartë se dhuna seksuale mund të konsiderohet edhe si formë torture ose trajtim mizor, çnjerëzor ose poshtërues.³⁴² Kjo

³³⁶ Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 186.

³³⁷ Aktgjykimi *Stakiq*, para. 757.

³³⁸ Aktgjykimi i Apelit *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 323 (ku tërthorazi rrëzohet Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 139; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 103).

³³⁹ Në Nenin 27 të Konventës së Gjenevës parashtrohet se për gratë “ofrohet veçanërisht mbrojtje kundër çfarëdo sulmi ndaj nderit të tyre, sidomos kundër përdhunimit, prostitucionit të detyruar ose çfarëdo forme e cënimit të nderit.” Protokollin Shtesë II i Konventës së Gjenevës ndalon “dhunimin e dinjitetit personal, sidomos trajtimin poshtërues dhe turpërues, përdhunimin, prostitucionin e detyruar dhe çfarëdo forme veprimesh të turpshme”.

³⁴⁰ Konventa mbi Eliminimin e Të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Grave (CEDAW), *hyri në fuqi më 3 shtator 1981*, 1249 U.N.T.S. 13, neni 6.

³⁴¹ Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 170 (“Asnjë dokument ndërkombëtar i të drejtave të njeriut nuk i ndalon shprehimisht përdhunimin ose forma të tjera të dhunës së rëndë seksuale. Gjithsesi këto shkelje ndalon nëpërmjet dispozitave që garantojnë paprekshmërinë fizike, të cilat janë pjesë e të gjitha traktateve ndërkombëtare përkatëse.”)

³⁴² Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 495–496 (konkludohet se përdhunimi dhe forma të tjera të dhunës seksuale mund të përbëjnë torturë); Aktgjykimi *Kvoçka dhe të tjerë*, para. 144–145 (rikonfirmohet cilësimi i përdhunimit si torturë dhe konkludohet se forma të tjera të dhunës seksuale dhe kërcënimi për përdhunim gjithashtu mund të përbëjnë torturë);

pikëpamje përputhet me konkluzionin e Komisionit të Ekspertëve se në të drejtën humanitare ndërkombëtare, përdhunimi dhe forma të tjera të dhunës seksuale mund të kategorizohen si “torturë ose ... forma të tjera të trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues”, ‘që shkaktojnë qëllimisht vuajtje të madhe’ ose përcaktime të tjera të ngjashme”.³⁴³

190. Gjithashtu në një numër aktgjykimesh mbështetet pikëpamja se dhuna seksuale mund të jetë shkelje që përbën “veprim çnjerëzor” ose “dhunim të dinjitetit personal”.³⁴⁴ Në çështjen *Akayesu* TPNR-ja konkludoi shprehimisht se “dhuna seksuale nuk kufizohet vetëm në sulmin fizik ndaj trupit njerëzor dhe mund të përfshijë veprime që nuk kanë të bëjnë me penetrimin apo madje as me kontakt fizik” ndër të cilat lakuriqësi e detyruar.³⁴⁵ Në aktgjykim më tej u konkludua se lakuriqësia e detyruar përbënte veprim çnjerëzor,³⁴⁶ dhe e fajësoi të akuzuarin ndër të tjera për veprime çnjerëzore si krim kundër njerëzimit.³⁴⁷

191. Në çështjen *Tadiq*, Dhoma Gjyqësore konkludoi se gjymtimet e natyrës seksuale po ashtu si edhe format e tjera të lëndimit të rëndë trupor përbëjnë “veprime çnjerëzore” që i shkaktojnë “lëndim qenies njerëzore në mirëqenien fizike dhe mendore, në shëndet ose dinjitet njerëzor”,³⁴⁸ dhe në aktgjykimin *Çelebiqi* u theksua se dhuna seksuale përbën shkelje të “dinjitetit natyral dhe të së drejtës së paprekshmërisë fizike të qenies njerëzore”.³⁴⁹

192. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore konkudon se “dhuna seksuale” është brenda juridiksionit të dispozitave të ndryshme që garantojnë paprekshmërinë fizike dhe siç pohohet shprehimisht në çështjen *Furunxhija*, “e drejta e paprekshmërisë fizike është ndër të drejtat themelore dhe është pamohueshmërisht pjesë e të drejtës zakonore ndërkombëtare.”³⁵⁰ Shkelja në fjalë mund të përbëjë edhe “dhunim të dinjitetit personal”, cenim i një të drejte themelore.

Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 711, 816 (konkludohet se përdhunimet e përfshira në aktakuzë përbënin një formë torture, sepse ishin kryer me synim diskriminimin e “myslimanëve në përgjithësi” dhe “viktimën në veçanti”); Aktgjykimi *Akayesu*, para. 687, 731 (konkludohet se përdhunimi mund të përbëjë torturë në kontekstin e përgjegjësisë penale, nëpërmjet pranimit se është i rëndë aq sa të përbëjë “dhimbje ose vuajtje të rëndë” në kuadër të përkufizimit të torturës, dhe shprehimisht pohohet se veprimet e përdhunimit dhe dhunës seksuale mund të përbëjnë gjenocid).

³⁴³ Final Report of the United Nations Commission of Experts Established Pursuant to Security Council Resolution 780 (1992), UN Doc. No. S/1994/674, 28 dhjetor 1994, Shtojca II, f. 5./Raport Përfundimtar i Komisionit të Ekspertëve të Kombeve të Bashkuara Krijuar Sipas Rezolutës 780 të Këshillit të Sigurimit

³⁴⁴ *Shih p.sh.*, Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 272; Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*. 766–774; Aktgjykimi *Akayesu*, para. 688.

³⁴⁵ Aktgjykimi *Akayesu*, para. 688.

³⁴⁶ Aktgjykimi *Akayesu*, para. 697.

³⁴⁷ Aktgjykimi *Akayesu*, p. 179.

³⁴⁸ Aktgjykimi *Tadiq*, para. 729.

³⁴⁹ Aktgjykimi *Çelebiqi*, para. 491.

³⁵⁰ Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 170.

(B) Kushti i peshës së barabartë

193. Pasi është klasifikuar se bën pjesë ndër krime si “tortura” dhe “veprime çnjerëzore”, dhuna seksuale mund të plotësojë kushtin e peshës njëloj si krimet e tjera të përmendura në Nenin 5 të Statutit, sidomos për arsyen se “tortura” dhe “veprimet çnjerëzore” përmenden shprehimisht brenda juridiksionit të Nenit 5. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se “dhuna seksuale” është formë përndjekjeje dhe si pasojë është e ndëshkueshme si krim kundër njerëzimit, në qoftë se plotësohet kushti i peshës së barabartë.³⁵¹ Në nxjerrjen e konkluzioneve të mëposhtme lidhur me elementët e “dhunës seksuale”, Dhoma ka mbajtur parasysh gjatë gjithë kohës kushtin e peshës së barabartë e cila e kualifikon shkeljen cilësisht si formë përndjekjeje.

(C) Elementët

194. Pas vërtetimit se “dhuna seksuale” përmbush kriteret e formës së përndjekjes, tani duhen qartësuar elementët e veprës penale në fjalë.

195. Siç përshkruhet më lart, TPNR-ja konkludoi shprehimisht në *Akayesu* se “dhuna seksuale nuk kufizohet vetëm në sulmin fizik ndaj trupit njerëzor dhe mund të përfshijë veprime që nuk kanë të bëjnë me penetrimin apo madje as me kontakt fizik” ndër të cilat lakuriqësi e detyruar.³⁵² Në çështjen *Bërgjanin*, Dhoma Gjyqësore konkludoi se vepra penale e dhunës seksuale “përfshin të tëra keqtrajtimet e rënda të natyrës seksuale të shkaktuara ndaj mirëqenies së një individi nëpërmjet shtrëngimit, kërcënimit për dhunë ose frikësimit në një mënyrë poshtëruese dhe ulëse ndaj dinjitetit të viktimës.”³⁵³

196. Këto çështje ofrojnë tregues të llojeve të sjelljes që nuk përfshin penetrim seksual, që mund të konsiderohet “dhunë seksuale”, në vend të përdhunimit si vepër penale më e përkufizuar ku kërkohet penetrim. Mirëpo asnjë traktat ndërkombëtar nuk parashtron elementët e dhunës seksuale si vepër penale e njohur në të drejtën ndërkombëtare.³⁵⁴ Po ashtu elementët e dhunës seksuale nuk janë shtjelluar asnjëherë në të drejtën zakonore ndërkombëtare.³⁵⁵

³⁵¹ *Shih* Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 1012.

³⁵² Aktgjykimi *Akayesu*, para. 688.

³⁵³ Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 1012; *shih edhe* Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 186; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 757.

³⁵⁴ Dhoma thekson se Elementët e Krimeve për Gjykatën Penale Ndërkombëtare përcaktojnë se “krimi i dhunës seksuale si krim kundër njerëzimit” është i ndëshkueshëm bazuar në nenin 7(1)(g) të Statutit të Romës si më poshtë: “[Kryerja e] një veprimi të natyrës seksuale kundër një apo më shumë personave ose [detyrimi] i personave të tillë për kryerjen e një veprimi të natyrës seksuale nëpërmjet forcës ose kërcënimit të forcës ose shtrëngimit, si p.sh shkaktuar prej frikës së dhunës, shtrëngimit, izolimit, presionit psikologjik ose shpërdorimit të pushtetit kundër personit ose personave të tillë ose një personi tjetër, ose duke përfutur prej atmosferës mbytëse ose pamundësisë së këtij personi/këtyre personave për dhënien e pëlqimit të njëmendtë.” *Shih* Assembly of State Parties to the Rome Statute of the International Criminal Court, 1st session, 3–10 September 2002, Part II.B. Elements of Crimes, ICC-ASP/1/3, article 7(1)(g)-6, para. 1. Dhoma e Apelit në [çështjen] *Kërstiq* se Elementët e Krimeve nuk janë rregulla detyruese,

197. Analiza e rrethanave të një numri juridiksionesh të së drejtës anglosaksone dhe të drejtës kontinentale çon në konkluzionin se megjithëse në shumicën e rasteve nuk ekziston përkufizim i kodifikuar i bazuar në elementë të dyfjalëshit “dhunë seksuale”, përgjithësisht ekzistojnë dispozita në lidhje me procedimin penal dhe ndëshkimin e shkeljeve të ngjashme me dhunë seksuale. Në këto sisteme shtetërore shpesh ofrohet një spektër i llojeve të shkeljeve që mund të përfshihen në kategorinë më të përgjithshme të dhunës seksuale që diskutohet më poshtë.³⁵⁶

198. Në tërësi, analiza e metodave shtetërore në lidhje me dhunën seksuale nxjerr disa elementë të përbashkët. Përgjithësisht kërkohet që dhuna seksuale të jetë kryer nëpërmjet ushtrimit të dhunës, forcës, detyrimit ose formave të tjera të shtrëngimit ndaj viktimës. Kërcënimi për përdorimin e dhunës kundër viktimës ose në disa raste kundër një individi të tretë, mund të jetë gjithashtu i mjaftueshëm.³⁵⁷ Mirëpo në një numër juridiksionesh theksi vihet në mungesën e pëlqimit të viktimës, në vend të theksimit të përdorimit të dhunës ose kërcënimeve prej keqbërësit.³⁵⁸ Gjithsesi Dhoma konstaton se mospërputhja në dukje midis qëndrimeve është vetëm e karakterit formal. Siç u theksua më lart, Dhoma Gjyqësore në *Bërgjanin* konkludoi se për nxjerrjen e konkluzionit të dhunës seksuale, një individ duhet të jetë “shtrënguar, kërcënuar me forcë ose frikësuar”.³⁵⁹ Në çështjen *Akayesu*, TPNR-ja adoptoi një qasje të gjerë të konceptit të shtrëngimit duke konkluduar se

por vetëm mjete ndihmëse për interpretimin e përkufizimeve materiale të krimeve të Statutit të Romës. *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kërstiq*, para. 224 shënim 366.

³⁵⁵ Termi dhunë seksuale nuk figuron në ndonjë prej Konventave të Gjenevës apo Protokolleve Shtesë; në fakt frazeologjia e Konventës është e gjerë ku ndër të tjera kërkohet respekt për individin dhe nderin e personave në mbrojtje, trajtimin e tyre njerëzor, dhe mbrojtjen e grave prej sulmeve ndaj “nderit” të tyre, sidomos “përdhunimi, prostituimi i detyruar, ose çfarëdo forme veprimesh të turpshme.” Konventa e Katërt e Gjenevës, neni 27. Neni i Përbashkët 3 ndalon gjithashtu “dhunimin e dinjitetit personal, veçanërisht trajtimin poshtëruës dhe turpërues”.

³⁵⁶ Për shembull në legjislacionin skocez, ndër të tjera ekzistojnë ligje kundër veprimeve të turpshme, shkeljeve kundër të rinjve dhe praktikave të turpshme dhe epshore. *Shih* Akti i Shkeljeve Seksuale për Anglinë dhe Uellsin 2003, Lista 3. Akti i Shkeljeve Seksuale për Anglinë dhe Uellsin 2003 përfshin dispozita që ndër të tjera mbulojnë shkelje si shpërdorimi i mirëbesimit, incesti, zhveshje e turpshme, vuajerizëm, vepra penale kundër të miturve, seks me shtazë dhe nekrofilia. Kodi Penal i Francës përmend “agresionin seksual” në nenet 222-22. Kodi Penal i Gjermanisë i 13 nëntorit 1998 (*Strafgesetzbuch, StGB*) trajton “krime kundër pavarësisë seksuale” në Kapitullin 13. Neni 521 i Kodit Penal i Italisë përmend “veprime të dhunshme epshi”. Termat “shtrëngim seksual” dhe “shfrytëzim seksual” përfshihen në Kapitullin 6 të Kodit Penal të Suedisë të vitit 1962, ndryshuar më 1 maj 1999. Kodi Penal i Federatës Ruse përfshin “veprime të dhunshme të karakterit seksual” në nenin 132. Kodi Penal i Kenias, pjesa 144, përmend “veprime të turpshme ndaj femrave”. Kodi Penal i Kanadasë, pjesa 265, e përkufizon dhunën seksuale si prekje e qëllimshme pa pëlqim. Në shqyrtimin nëse sjellja e akuzuar ka natyrën e kërkuar seksuale për t’u cilësuar “dhunë seksuale” dhe nëse duke marrë parasysh të gjitha rrethanat, konteksti seksual ose epshor i veprimit është i dukshëm për një vëzhgues të arsyeshëm, zbatohet një kusht objektiv. Gjykata e Lartë e Kanadasë në *R. v. S. (P.L.)*, [1991] 1 S.C.R. 909.

³⁵⁷ *Shih p.sh.*, Kodi Penal i Francës, neni 222-22; Kodi Penal i Gjermanisë i 13 nëntorit 1998 (*Strafgesetzbuch, StGB*), pjesa 177(1); Kodi Penal i Holandës i 3 marsit 1881, ndryshuar prej Aktit të 7 tetorit 1996, neni 246; Kodi Penal i Suedisë i vitit 1962, ndryshuar më 1 maj 1999, kapitull 6, pjesa 2; Kodi Penal i Federatës Ruse, nenet 132–133; Kodi Penal i Republikës Socialiste të Serbisë i vitit 1977, ndryshuar prej Aktit Nr. 44/1998, neni 103(1); Kodi Penal i Kanadasë, pjesa 265(1); Kodi Penal i Egjiptit, neni 268; Kodi Penal i Japonisë, neni 176; Kodi Penal i Republikës Popullore të Kinës i 1 korrikut 1979, ndryshuar më 14 mars 1997, neni 237; Kodi Penal i Indisë, pjesa 351.

³⁵⁸ *Shih p.sh.*, Akti i Shkeljeve Seksuale për Anglinë dhe Uellsin 2003, pjesa 3–4.

³⁵⁹ Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 1012; *shih edhe* Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 186; Aktgjykimi *Stakiq*. 757; Gjykata e Posaçme për Sierra Leone-n, *Prokurori k. Brima, Kamara, dhe Kanu*, Lënda Nr. SCSL-04-16-T, Aktgjykim, 20 qershor 2007, para. 720.

ai mund të provohet nëpërmjet “kërcënimeve, frikësimit, zhvatjes dhe formave të tjera të shtrëngimit të cilat shfrytëzojnë frikën ose dëshpërimin” si dhe është i vetëkuptueshëm “në rrethana të konfliktit të armatosur”.³⁶⁰ Bazuar në sa më sipër, në qoftë se viktimja kreu një veprim pa dhënë pëlqim të njëmendtë, konkluzioni i paevitueshëm është se ai individ është shtrënguar të veprojë në atë mënyrë. Rrjedhimisht në lidhje me këtë pikë, qëndrimet e juridiksioneve shtetërore janë në përputhje me jurisprudencën ekzistuese ndërkombëtare.

199. Statuti dhe jurisprudenca e Tribunalit përmendin vetëm përdhunimin dhe dhunën seksuale në vend të kategorive të tjera të shkeljeve të natyrës seksuale. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore ka mendimin se qasja e gjerë ndaj elementëve të nevojshëm është e përshtatshme në qoftë se merret parasysh kushti i peshës së barabartë për kategorizimin si formë përndjekjeje.³⁶¹ Si rezultat, Dhoma Gjyqësore gjykon se “dhuna seksuale” mund të kryhet në rrethana ku nuk kryhet asnjë kontakt fizik midis keqbërësit dhe viktimës, në qoftë se veprimet e keqbërësit gjithsesi poshtërojnë dhe ulin viktimën në aspektin seksual. Në fakt kufizimi i dhunës seksuale vetëm në prekjen pa dhënien e pëlqimit do të binte ndesh me jurisprudencën ekzistuese si në çështjen *Akayesu*, ku u konkludua se “dhuna seksuale nuk kufizohet vetëm në sulmin fizik të trupit njerëzor dhe mund të përfshijë veprime që nuk kanë të bëjnë me penetrim dhe madje as kontakt fizik” ndër të cilat lakuriqësi e detyruar.³⁶² Për më tepër Dhoma gjykon se do të ishte e papërshtatshme që në përkufizimin e “dhunës seksuale” t’i mëshohej kënaqësisë seksuale të keqbërësit. Në kuadrin e një konflikti të armatosur, poshtërimi dhe çnderimi seksual i viktimës ka më shumë rëndësi se kënaqësia e keqbërësit, dhe ky element përcakton veçantinë e shkeljes.

200. Çfarëdo forme e shtrëngimit ndër të cilat dhuna, kërcënimi për dhunë, ndalimi dhe përgjithësisht atmosfera mbytëse, përbëjnë prova që tregojnë mungesën e pëlqimit. Gjithashtu Dhoma Gjyqësore mendon se kur një individ mbahet i izoluar veçanërisht gjatë një konflikti të armatosur, shtrëngimi dhe mungesa e pëlqimit mund të deduktohen prej këtyre rrethanave. Në këtë aspekt, forca e nevojshme për dhunë seksuale nuk është vetëm forca e nevojshme për kryerjen e veprimeve të një natyre seksuale dhe shtrëngimi aktual nuk është element i domosdoshëm.

³⁶⁰ Aktgjykimi *Akayesu*, para. 688 (theks i shtuar):

Tribunali e konsideron dhunën seksuale ku përfshihet edhe përdhunimi, si veprim të një natyre seksuale që kryhet ndaj një personi në rrethana shtrënguese. ... Në këtë kontekst Tribunali thekson se nuk është e nevojshme që ekzistenca e rrethanave shtrënguese të vërtetohet nëpërmjet forcës fizike. Shtrëngim mund të përbëjnë kërcënimi, frikësimi, zhvatja dhe forma të tjera të detyrimit, dhe shtrëngimi mund të jetë i nënkuptuar në rrethana të caktuara si konflikt i armatosur ose prania ushtarake e Interahamwe-ve ndërmjet grave refugjate të etnisë Tutsi në zyrën e komunës.

³⁶¹ Kryegjykatësi në konferencën paragjyqësore, shprehu pikëpamjen se përdhunimi ishte krim i rëndë dhe rrjedhimisht ishte e panevojshme që Prokuroria të ftonte dëshmitar ekspert në lidhje me këtë pikë. *Shih* T. 287–290 (7 korrik 2006).

³⁶² Aktgjykimi *Akayesu*, para. 688.

201. Rrjedhimisht Dhoma Gjyqësore gjykon se veç kushteve të përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit, dhe kushteve konkrete të përndjekjeve, Prokuroria duhet të provojë plotësimin e kushteve të mëposhtme jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm për të vërtetuar kryerjen e shkeljes bazë të dhunës seksuale si formë përndjekjeje, krim kundër njerëzimit:

- (a) Shkelësi fizik kryen një veprim të natyrës seksuale ndaj një tjetri duke kërkuar ndër të tjera që ai person të kryejë veprim të ngjashëm.
- (b) Veprimi çënon paprekshmërinë fizike të viktimës ose përbën dhunim të dinjitetit personal të viktimës.
- (c) Viktima nuk jep pëlqimin për veprimin.
- (d) Shkelësi fizik e kryen qëllimisht veprimin.
- (e) Shkelësi fizik është i vetëdijshëm se veprimi ndodhi pa pëlqimin e viktimës.

(D) Përdhunimi si një ndër llojet e dhunës seksuale

202. Siç është theksuar më sipër, Dhoma Gjyqësore gjykon se përdhunimi mund të klasifikohet si dhunë seksuale konkrete dhe rrjedhimisht provat për përdhunim mund të merren parasysh si prova për akuzat e dhunës seksuale si formë përndjekjeje. Në fakt provat për përdhunimin në këtë çështje, u paraqitën duke mos hasur në kundërshtimin e Mbrojtjes se “përdhunimi” nuk ishte akuzë në pikën 5. Kjo Dhomë Gjyqësore gjykon se përdhunimi është provë e dhunës seksuale si formë përndjekjeje, krim kundër njerëzimit.

203. Në lidhje me këtë, Dhoma Gjyqësore rikujton se pas një shqyrtimi të gjerë të ligjit për përdhunimet në marrëveshjet ndërkombëtare dhe juridiksionet shtetërore, Dhomat Gjyqësore në çështjet *Furunxhija* dhe *Kunarac dhe të tjerë* formuluan këtë përkufizim të përdhunimit në të drejtën ndërkombëtare:

Veprimi i fajshëm i krimit të përdhunimit në të drejtën ndërkombëtare përbëhet prej: penetrimit seksual, sado i pakët: (a) të vaginës ose anusit të viktimës prej penisit të keqbërësit ose një objekti tjetër përdorur prej keqbërësit; ose (b) të gojës së viktimës prej penisit të keqbërësit ku penetrimi seksual kryhet pa pëlqimin e viktimës. Pëlqimi në këtë kontekst duhet dhënë me vullnet të lirë, si rezultat i dëshirës së lirë të viktimës vlerësuar në kontekstin e rrethanave. Synimi kriminal konsiston në konkretizimin e penetrimit seksual dhe dijeninë se ndodh pa pëlqimin e viktimës.³⁶³

³⁶³ Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 460 (duke e zhvilluar përkufizimin bazuar në përkufizimin e parashtruar në Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 185), *konfirmuar në* Aktgjykimi i Apelit *Kunarac dhe të tjerë*, para. 127–128. Për analizat përkatëse të ligjeve ndërkombëtare dhe shtetërore, shih Aktgjykimi *Furunxhija*, para. 165–185, dhe Aktgjykimi *Kunarac dhe të tjerë*, para. 436–460.

iii. *Dëmtimi ose shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturore si formë përndjekjeje*

204. Në akuzat për përndjekje të parashtruara në pikën 5 të Aktakuzës përfshihet edhe “shkatërrim ose dëmtim pa shkak i objekteve fetare të shqiptarëve kosovarë [,] ... monumenteve kulturore dhe vendeve të shenjta myslimane”.³⁶⁴ Megjithëse “shkatërrimi ose dëmtimi i qëllimshëm i institucioneve fetare, bamirëse, arsimore, artistike dhe shkencore, monumenteve historike dhe veprave artistike dhe shkencore” është shprehimisht i dënueshëm si shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës bazuar në paragrafin (d) të Nenit 3 të Statutit, cilësime të tilla nuk ekzistojnë në Nenin 5. Gjithsesi Dhoma e Apelit ka konkluduar tashmë se “shkatërrimi i pronave”, të një popullate të caktuar civile mund të dënohet bazuar në paragrafin (h) të Nenit 5, varësisht prej masës dhe llojit të shkatërrimit dhe varësisht prej plotësimit të të gjithë elementëve të paragrafit (h) të Nenit 5.³⁶⁵ Dhoma e Apelit në çështjen *Bllashkiq* e bazoi analizën e saj në pandehmën se shkatërrimi i objekteve fetare ose kulturore përfshihet në kategorinë më të gjerë të “shkatërrimit të pronës”.³⁶⁶ Pas nxjerrjes së këtij konkluzioni, Dhoma e Apelit në *Bllashkiq* vazhdoi me pandehmën se shkatërrimi i objekteve fetare ose kulturore përfshihet në kategorinë më të gjerë të “shkatërrimit të pronës”; ka të ngjarë që kjo qasje të jetë ndikuar prej mënyrës sesi aktakuza e asaj çështjeje ishte konceptuar, ku të gjitha pronat, përfshirë edhe objektet fetare u përfshinë në kapitullin “shkatërrim ose plaçkitje e pronës”.³⁶⁷ Nga ana tjetër disa Dhoma Gjyqësore e kanë trajtuar shkatërrimin e objekteve fetare ose kulturore, si kategori përndjekjeje e veçantë prej kategorisë së gjerë të shkatërrimit të pronës civile. Për këtë arsye, Dhoma Gjyqësore në çështjen *Stakiq* për shembull diskutoi dy kategori të shkatërrimit të pronave si përndjekje, konkretisht, “shkatërrim ose dëmtim i qëllimshëm i ndërtesave fetare dhe kulturore”,³⁶⁸ dhe “shkatërrim, dëmtim i qëllimshëm dhe plaçkitje e pronave tregtare dhe banesave”.³⁶⁹ Dhoma e Apelit nuk ka përcaktuar nëse shkatërrimi i objekteve fetare dhe kulturore plotëson kushtin e një shkeljeje bazë të veçantë prej kategorisë më të gjerë të shkatërrimit të pronave civile.

205. Mirëpo Dhoma Gjyqësore në çështjen *Kordiq* ka konkluduar dhe Dhoma Gjyqësore pajtohet me konkluzionin se shkatërrimi i objekteve fetare përbën “sulm kundër vetë identitetit fetar të një populli” dhe rrjedhimisht është “shprehje thujtë e qartë” e konceptit të krimeve kundër

³⁶⁴ Aktakuza, para. 77(d).

³⁶⁵ Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 144–149; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 108.

³⁶⁶ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 145 (mbështetet konstatimi se dokumente të ndryshme ligjore ndërkombëtare mbrojnë të drejtën e pronës duke iu referuar nenit 53 të Protokollit Shtesë I, objekti i së cilës është mbrojtja e objekteve kulturore dhe fetare).

³⁶⁷ *Shih* Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 227–233.

³⁶⁸ Aktgjykimi *Stakiq*, para. 765–768, 811–813; *shih edhe* Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 773–783, 829–840 (ku përmenden dy kategori të veçanta të shkatërrimit të popullatës civile, konkretisht “shkatërrim i pronës private” dhe “shkatërrim i objekteve kulturore dhe të shenjta”).

³⁶⁹ Aktgjykimi *Stakiq*, para. 761–764.

njerëzimit.³⁷⁰ Për këtë arsye, Dhoma gjykon se në jurisprudencën e Tribunalit është shprehimisht i ndaluar shkatërrimi i objekteve fetare dhe monumenteve kulturore si përndjekje, krim kundër njerëzimit.

206. Duke shfrytëzuar jurisprudencën e Tribunalit lidhur me elementët e paragrafit (d) të Nenit 3 të Statutit si dhe jurisprudencën e shkatërrimit të pronës si shkelje bazë e përndjekjes, krim kundër njerëzimit, Dhoma Gjyqësore konkludon se veç kushteve të përgjithshme të krimeve kundër njerëzimit, dhe kushteve konkrete të përndjekjes, Prokuroria duhet të provojë veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal të shkatërrimit pa shkak ose dëmtimit të objekteve fetare dhe monumenteve kulturore si formë përndjekjeje, krim kundër njerëzimit. Veprimi i fajshëm i kësaj shkeljeje bazë është si më poshtë: (a) objekti fetar ose kulturor duhet të shkatërrohet ose të dëmtohet në masë të madhe; (b) objekti fetar ose kulturor nuk duhet të përdoret ushtarakisht në kohën e veprimit; dhe (c) shkatërrimi ose dëmtimi duhet të jetë rezultat i një veprimi kundër këtij objekti.³⁷¹ Synimi kriminal i veprës penale është se kryesi fizik, kryesi i ndërmjetëm ose i akuzuari veproi me synim për të shkatërruar ose dëmtuar gjerësisht objektin në fjalë ose krejtësisht shpërfillës ndaj gjasës së shkatërrimit ose dëmtimit.³⁷²

207. Në lidhje me elementin e parë të veprimit të fajshëm, as dëmtimi dhe as shkatërrimi i objektit nuk përmenden shprehimisht si krime në Nenin 5. Për një kufi më të lartë të kushtit të peshës së barabartë të krimeve të përmendura në Nenin 5 të Statutit që rrjedhimisht arrin nivelin e përndjekjes, Dhoma Gjyqësore kanë konkluduar se privimi prej pronës së shkatërruar duhet të jetë i rëndë si p.sh kur prona është e pazëvendësueshme, është kapital jetik për pronarët ose mjet ekzistence për një popullatë të caktuar.³⁷³ Për të njëjtat arsye Dhoma Gjyqësore konkludon se në qoftë se prona në fjalë nuk shkatërrohet, dëmtimi duhet të jetë i gjerë për përmbushjen e kushtit të peshës së barabartë.³⁷⁴ Në këtë kontekst, termat “shkatërrim” dhe “dëmtim” përdoren në kuptimin

³⁷⁰ Aktgjykimi *Kordiq*, para. 206–207; *shih edhe* Aktgjykimi *Stakiq*, para. 766.

³⁷¹ Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 144–149 (ndër të tjera citohen neni 51–53 të Protokollit Shtesë I dhe neni 147 i Konventës së Parë të Gjenevës); Aktgjykimi *Kordiq*, para. 206, 362; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 765–7; Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 227–234; Aktgjykimi *Bërgjanin*, para. 596–599, 1021, 1023; Aktgjykimi *Strugar*, para. 308; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 782.

³⁷² Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 277; Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 74; Aktgjykimi *Krajishnik*, para. 782; Aktgjykimi *Stakiq*, para. 761.

³⁷³ Aktgjykimi *Naletiliq*, para. 699; Aktgjykimi *Kupreshkiq dhe të tjerë*, para. 631; *shih*. Aktgjykimi *Stakiq*, para. 763 (“Kur pasoja e shkatërrimit të pronës rezulton në largimin e civilëve prej shtëpive të tyre mbi baza diskriminuese, shkatërrimi dhe/ose plaçkitja pa shkak dhe e gjerë e banesave, ndërtesave, njërive tregtare, pronave vetjake dhe bagëtime të civilëve myslimanë bosnjakë mund të përbëjë krimin e përndjekjes.”) (nuk janë përfshirë shenjat e citimit dhe poshtëshënimi).

³⁷⁴ *Shih* Aktgjykimi i Apelit *Kordiq*, para. 108 (“Dhoma e Apelit gjykon se shkatërrimi i pronës, *varësisht prej llojit dhe masës* së shkatërrimit, mund të përbëjë krim përndjekjeje i të njëjtës peshë si krimet e tjera të përmendura në Nenin 5 të Statutit.”) (theks i shtuar) (citohet Aktgjykimi i Apelit *Bllashkiq*, para. 149).

e thjeshtë dhe të përbashkët, ku termi i parë nënkupton shembje ose shndërrim në një formë të papërdorshme,³⁷⁵ dhe i dyti do të thotë dëmtim fizik i një objekti që cenon dobinë ose vlerën e tij.³⁷⁶

208. Sa i përket elementit të dytë të veprimit të fajshëm, që shkatërrimi ose dëmtimi të përbjë krim kundër njerëzimit, objekti në fjalë nuk duhet të jetë përdorur për qëllim ushtarak në kohën e veprimit agresiv kundër objektit. Dhoma e Apelit në çështjen *Bërgjanin* konkludoi se i takon Prokurorisë të vërtetojë se shkatërrimi ose dëmtimi në fjalë nuk justifikohet prej domosdoshmërisë ushtarake. Me fjalë të tjera kjo nuk duhet marrë si pandehmë.³⁷⁷ Gjithashtu Dhoma e Apelit konkludoi se në përcaktimin nëse shkatërrimi ose dëmtimi ndodhi për shkak të domosdoshmërisë ushtarake përfshihet edhe çështja e përkufizimit të një objekti ushtarak dhe më tej iu referua Nenit 52 të Protokollit Shtesë I që përmban përkufizimin gjerësisht të pranuar të objektivave ushtarake.³⁷⁸ Fakti se ndërtesa në fjalë ndodhej shumë pranë objektivave ushtarake nuk e përligj shkatërrimin e saj meqenëse është përdorimi dhe jo vendndodhja e saj që përcakton mosprekjen e saj.³⁷⁹

209. Në lidhje me elementin e tretë të veprimit të fajshëm, kushti i shkakësisë plotësohet kur shkatërrimi ose dëmtimi i pronës shkaktohet prej një veprimi kundër pronës.³⁸⁰ Për këtë arsye, për shembull dëmtimi i pronës së mbrojtur shkaktuar prej luftimit ekzistues në afërsi të saj ose madje edhe brenda saj nuk përbën krim kundër njerëzimit.³⁸¹

210. Synimi kriminal i kësaj shkeljeje bazë vërtetohet kur autori fizik kreu veprimin që rezultoi në shkatërrim me synim shkatërrimin ose dëmtimin e objektit fetar ose kulturor në fjalë, ose krejtësisht shpërfillës ndaj gjasës së shkatërrimit ose dëmtimit.

³⁷⁵ *Shih The Oxford English Dictionary*, 2nd ed., 1989, vol. IV, f. 538–539.

³⁷⁶ *Shih The Oxford English Dictionary*, 2nd ed., 1989, vol. IV, f. 224.

³⁷⁷ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 337. Dhoma Gjyqësore se diskutimi në *Bërgjanin* u zhvillua në kontekstin e Nenit 3(d); mirëpo siç pohohet më lart, Dhoma gjithsesi gjykon se konkluzionet e atyshme vlejné në lidhje me shkatërrimin e ndërtesave fetare ose kulturore si formë përndjekjeje, krim kundër njerëzimit. *Shih edhe* Aktgjykim *Strugar*, para. 309–310 (konkludohet se mbrojtja që i akordohet objekteve kulturore humbet kur një objekt i tillë përdoret për qëllime ushtarake; dhe konkludohet se përjashtimi “qëllime ushtarake” përputhet me Rregullat e Hagës 1907(1907 Hague Regulations) dhe Protokollin Shtesës. Dhoma e Apelit e konfirmoi këtë konkluzion joshprehimisht, e më tej konkludoi se Dhoma Gjyqësore konkludoi logjikisht se sulmi kundër Qytetit të Vjetër nuk përligjet prej domosdoshmërisë ushtarake. Aktgjykimi i Apelit *Strugar*, para. 279.

³⁷⁸ Aktgjykimi i Apelit *Bërgjanin*, para. 337.

³⁷⁹ Aktgjykimi *Strugar*, para. 310; Aktgjykimi *Naletiliq*, para. 604; Aktgjykimi *Martiq*, para. 98; *gjithsesi shih* Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 185.

³⁸⁰ Aktgjykimi *Strugar*, para. 308.

³⁸¹ *Shih p.sh.*, Aktgjykimi *Bllashkiq*, para. 419 (pranohet si argument me gjasë shfajësues se arsyeja për shkatërrimin e një shkolle dhe një kishe ishte se ato “u bënë shesh beteje pas sulmit prej Batalionit të Katërt të Policisë Ushtarake”) (nuk janë përfshirë shenjat e citimit).

III. RRETHANAT HISTORIKE

211. Në paragrafët 80-99 të Aktakuzës parashtrohet qëndrimi i Prokurorisë në lidhje me rrethanat dhe kontekstin e pretendimeve të krimeve, para fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s në gjithë RFJ-në më 24 mars 1999. Në këta paragrafë parashtrohet se duke filluar nga fundi i viteve '80 Kosova iu nënshtrua kontrollit të rreptë të organeve qeveritare federale dhe të Serbisë në një sistem mjaft shtypës dhe diskriminues kundër popullatës shqiptare kosovare. Aty jepet në hollësi dalja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës si reagim ndaj këtyre ngjarjeve dhe fillimi i konflikt të armatosur midis saj dhe forcave qeveritare. Janë përshkruar incidente konkrete duke filluar prej shkurtit 1998 dhe përpjekjet e bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e krizës pasqyrohen shkurtimisht duke përfunduar me dështimin e këtyre përpjekjeve fill para nisjes së fushatës së NATO-s.

212. Nëpërmjet këtyre parashtrimeve është synuar të jepet konteksti i krimeve të akuzuara në aktakuzës (dhe përgjegjësisë së çdo të Akuzuari për këto krime) dhe të tregohet fillesa e ndërmarrjes së përbashkët kriminale të pretenduar, e cila sipas pretendimit të Prokurorisë filloi jo më vonë se tetor 1996. Përkundrajt këtyre rrethanave, Dhoma mund të nxjerrë konkluzione të nevojshme në lidhje me ecurinë historike të krizës së Kosovës deri në vitin 1998, pa hyrë në hollësi të krejt historisë së debatueshme të krejt rajonit. Në pjesët e mëtejshme diskutohet formimi dhe funksionimi i UÇK-së, përgjigjja e forcave të sigurisë dhe ushtarake serbe dhe të RFJ-së në 1998 dhe përpjekjet e brendshme dhe të jashtme për zgjidhjen e krizës përmes negociatave në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999.

A. NDRYSHIMET KUSHTETUESE TË VITIT 1989

213. Bazuar në Kushtetutën e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ("RSFJ"), shpallur në shkurt 1974, RSFJ-ja kishte gjashtë republika dhe dy krahina autonome. Të dyja krahinat, Kosova dhe Vojvodina, ishin pjesë e Republikës Socialiste të Serbisë. Kushtetuta u dha krahinave autonomi në një nivel të konsiderueshëm ku përfshiheshin kompetenca e hartimit të kushtetutave krahinore, gjykatat krahinore, një përfaqësues në Kryesinë e RFJS-së në Beograd dhe e drejta e procedimit në Gjykatën Kushtetuese të Jugosllavisë dhe atë të Serbisë.³⁸² Gjithashtu ato ishin të përfaqësuara së bashku me republikat në Dhomën e Republikave dhe Krahinave dhe në Dhomën Federale, organ ligjvënës me kompetencë ndryshimin e kushtetutës së RSFJ-së.³⁸³

³⁸² P1623 (Kushtetuta e RSFJ-së, 1974), nenet 4, 206, 321, 375(3), 375(6); Ratko Marković, T. 13446 (13 gusht 2007); Radomir Llukiq, T. 26240–26241 (15 maj 2008).

³⁸³ P1623 (Kushtetuta e RSFJ-së, 1974), nenet 284–285, 400–401; Radomir Llukiq, T. 26314–26315 (16 maj 2008).

214. Megjithëse nuk përfshihet në prova, Dhoma thekson se Kushtetuta e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës gjithashtu hyri në fuqi në vitin 1974, ku Kosova njihet si pjesë e Serbisë.

215. Nga ana e saj Kushtetuta e Serbisë e vitit 1974 parashtronte se “populli punonjës dhe kombet e kombësitë e Serbisë ushtrojnë të drejtat e tyre sovrane në Republikën Socialiste të Serbisë dhe në krahinat socialiste autonome në përputhje me të drejtat e tyre kushtetuese”.³⁸⁴ Gjithashtu aty sanksionohej barazia e “kombeve dhe kombësive” në Serbi dhe garantohej e drejta e përdorimit të gjuhës së vet prej çdo “kombësie” dhe për “kombet dhe kombësitë” në pakicë garantohej e drejta e arsimimit në gjuhën e tyre në shkolla dhe institucione të tjera arsimore.³⁸⁵

216. Sipas ekspertëve kushtetues Radomir Llukiq dhe Ratko Markoviq që u paraqitën përkatësisht prej Mbrojtjes së Shainoviçit dhe Mbrojtjes së Millutinoviçit, rasti i krahinave ishte i pazakontë sepse ato ishin të përfaqësuara në Federatë pavarësisht prej Serbisë, si subjekte të Federatës, dhe jo të Republikës së Serbisë.³⁸⁶ Për shembull atyre iu akordua *Kompetenz Kompetenz*, që do të thotë kompetenca për të gjykuar në lidhje me juridiksionin e tyre, fakt që sipas Llukiqit ishte pjesa më e rëndësishme e “të drejtës së vetëqeverisjes”.³⁸⁷ Gjithashtu në këtë sistem Kosova gëzonte edhe një farë autonomie gjyqësore. Rrjedhimisht sipas Llukiqit, krahina kishte gjykatat e veta dhe proceset ligjore përfundonin brenda krahinës. Gjykatat shtetërore nuk kishin kompetencë ndaj vendimeve të gjykatave të krahinave autonome.³⁸⁸ Gjithsesi në Kushtetutën e Serbisë përcaktohej se në qoftë se një ligj ose akt krahinor nuk përputhej me ligjet e Republikës, ligji republikan do të ishte ligji në zbatim deri në zgjidhjen e çështjes prej Gjykatës Kushtetuese të Serbisë.³⁸⁹

217. Ky sistem shkaktoi pakënaqësi të disa ekspertëve kushtetues në Serbi. Në vitin 1977 ata hartuan një dokument konfidencial me porosi të Presidencës së Serbisë, ku kritikohesh sistemi kushtetues republikan i vitit 1974 i cili u akordonte kompetenca të tepruara krahinave autonome.³⁹⁰

218. Më tej në fillim të viteve ‘80, pas vdekjes së Presidentit të RSFJ-së, Josip Broz “Tito”, filluan demonstratat në të cilat shqiptarët kosovarë kërkuan njohjen e plotë të Kosovës si republikë brenda RSFJ-së. Disa prej këtyre demonstratave u bënë të dhunshme dhe policia e ushtria

³⁸⁴ P1848 (Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë, 1974), Parime Themelore, I.

³⁸⁵ P1848 (Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë, 1974), nenet 145, 147.

³⁸⁶ Ratko Markoviq, T. 13074–13075, 13077–13078 (8 gusht 2007); Radomir Llukiq, T. 26243 (15 maj 2008).

³⁸⁷ Radomir Llukiq, T. 26242–26243 (15 maj 2008).

³⁸⁸ Radomir Llukiq, T. 26302 (16 maj 2008).

³⁸⁹ P1848 (Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë, 1974), neni 229.

³⁹⁰ Ratko Markoviq, T. 13074–13084 (8 gusht 2007), diskutohet 1D125 (“Libri i Kaltër” i Grupit të Punës së Presidencës së Republikës Socialiste të Serbisë, 11 mars 1977).

jugosllave hynë në veprim.³⁹¹ Në anën tjetër nga serbët kishte gjithnjë e më shumë thirrje për pakësim të autonomisë së Kosovës. Këto thirrje bënë që në mars të vitit 1989, Kuvendi i RSFJ-së të miratonte ndryshim të Kushtetutës së Serbisë nëpërmjet “konkluzioneve” të cilat identifikuan nevojën për “normalizimin” e “gjendjes së përkeqësuar” në Kosovë, dhe ndër të tjera “marrjen e masave të menjëhershme për identifikimin e përgjegjësive penale dhe çfarëdolloj përgjegjësie tjetër të frymëzuesve ose organizatorëve të veprimtarive kundërrevolucionare në Kosovë” dhe ndalimin e largimit të serbëve dhe malazezëve prej Kosovës.³⁹² Në këto konkluzione u përmendën “masa të veçanta” që tashmë kishin gjetur zbatim në Kosovë të cilat u përshkruan edhe prej hulumtuesit të Human Rights Watch, Frederick Abrahams, i cili pohoi se organet federale kishin marrë përsipër përgjegjësinë e sigurimit në krahinë.³⁹³ Kuvendi i RSFJ-së gjithashtu konkludoi se procesi i ndryshimit të Kushtetutës së Serbisë “duhet të përfundojë sa më shpejt.”³⁹⁴

219. Para miratimit prej Kuvendit të Serbisë, ndryshimet e propozuara të Kushtetutës së Serbisë duhej të miratoheshin prej Kuvendit të Kosovës, i cili u mbledh më 23 mars 1989. Si Veton Surroi, gazetar shqiptar kosovar, po ashtu edhe Frederick Abrahams, dëshmuar se sesioni i Kuvendit të Kosovës u mbajt në ndërtesën e Kuvendit rrethuar prej automjeteve ushtarake dhe policore, megjithëse Abrahams nuk ishte i pranishëm në atë kohë.³⁹⁵ Surroi gjithashtu pohoi se kishte parë një fotografi ku tregohet se një prej pjesëmarrësve në votim, faktikisht nuk ishte anëtar i Kuvendit. Gjithashtu ai deklaroi se kishte dëgjuar se para votimit ishte ushtruar presion ndaj anëtarëve të Kuvendit për të mbështetur ndryshimet, megjithëse nuk kishte biseduar me anëtarë të Kuvendit që pretendonin se kishin votuar pro ndryshimeve për shkak të presionit.³⁹⁶ Gjithashtu Dhoma mori prova në formën e deklaratës së tij si dëshmitar dhe transkriptit të dëshmisë së tij gojore në procesin gjyqësor *Milloseviq*, prej të ndjerit Ibrahim Rugova, udhëheqësit të Lidhjes Demokratike të Kosovës, “LDK”, se ishte ushtruar presion për të ndikuar në votim dhe se dhjetë anëtarët e Kuvendit të cilët votuan kundër ndryshimeve, më vonë pësuan ndëshkime.³⁹⁷

³⁹¹ Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë dëshmitari me datë 10 dhjetor 2000), p. 3; Adnan Merovci, P2588 (deklaratë dëshmitari me datë 13 prill 2000), para. 4; Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4310. *Shih edhe* Miroslav Mijatoviq, 6D1492 (deklaratë dëshmitari me datë 29 janar 2008), para. 3.

³⁹² 1D751 (Konkluzione të Kuvendit të RSFJ-së, 3 mars 1989), f. 1.

³⁹³ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari me datë 24 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 13.

³⁹⁴ 1D751 (Konkluzione të Kuvendit të RSFJ-së, 3 mars 1989), f. 2.

³⁹⁵ Veton Surroi, T. 4534 (10 tetor 2006); Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari me datë 24 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14.

³⁹⁶ Veton Surroi, T. 4534–4535 (10 tetor 2006).

³⁹⁷ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Milloseviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4191.

220. Pas miratimit prej Kuvendit të RSFJ-së dhe votimit pro të kuvendeve krahinore, më 28 mars 1989 Kuvendi i Serbisë miratoi ndryshimet e propozuara kushtetuese.³⁹⁸ Gjatë tërë dëshmisë së tij Ratko Markoviqi pretendoi se ndryshimet nuk prekën statusin autonom të dy krahinave sanksionuar prej Kushtetutës së RSFJ-së, por thjesht bënë “rishpërndarje të kompetencave”.³⁹⁹ Edhe Llukiqi megjithëse pranoi se këto ndryshime ndryshuan pozitën e krahinës së Kosovës brenda republikës duke u akorduar organeve republikane kompetenca legjislativë dhe kontroll gjyqësor ndaj ligjeve krahinore dhe duke iu hequr krahinave disa kompetenca, gjithashtu deklaroi se ndryshimet nuk shkaktuan pakësimin e autonomisë së Kosovës.⁴⁰⁰ Mirëpo Llukiqi pranoi se pas ndryshimeve kushtetuese të vitit 1990, Kosova nuk gëzonte më autonomi të plotë gjyqësore sepse nuk kishte kompetencë ligjvënës, por vetëm organe ekzekutive dhe nuk kishte më Gjykatën e vetë të lartë ose Gjykatë Kushtetuese.⁴⁰¹

221. Dhoma nuk ka dyshim se shqiptarët kosovarë i konsideruan ndryshimet si eliminim i autonomisë së konsiderueshme, së gëzuar më parë prej Kosovës dhe Vojvodinës dhe se kjo ishte pasojë e tyre. Për shembull administrimi i sistemit arsimor dhe tatimor u përfshi në kompetencat e qeverisë së Serbisë dhe përgjegjësia e sigurisë publike u vendos nën kontrollin republikan.⁴⁰² Më parë, të tëra ishin brenda kompetencave vetëm të instancave krahinore. Dy ndryshime ishin mjaft domethënëse: eliminimi i kërkesës për pëlqimin e kuvendeve krahinorë në lidhje me ndryshime të tjera kushtetuese që ndiknin krejt republikën; dhe kompetencë më e madhe e Presidencës së Serbisë në përdorimin e forcave të MPB-së në Kosovë, “në mbrojtje të rendit kushtetues”.⁴⁰³

222. Pas këtyre ndryshimeve kushtetuese gjendja në Kosovë u përkeqësua me protesta publike që u shndërruan në dhunë rruge.⁴⁰⁴

³⁹⁸ P858 (Vendimi për Miratimin e Amendamenteve IX - XLIX të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë, 28 mars 1989), f. 1.

³⁹⁹ Ratko Markoviqi, T. 13085 (8 gusht 2007).

⁴⁰⁰ Radomir Llukiq, T. 26244–26245 (15 maj 2008); 2D393 (Aktespertizë e Radomir Llukiqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 21. Sipas Llukiqit dokumenti më autoritativ ligjor i një krahine ishte statute i saj siç parashihej në Kushtetutë. Mirëpo autonomia territoriale nuk u konstituua asnjëherë në Kosovë sepse qytetarët shqiptarë kosovarë nuk e njohën rendin kushtetues të Serbisë. Në të kundërt, statusi i Vojvodinës u përcaktua më 1991 dhe nuk u vu asnjëherë në pikëpyetje. 2D393 (Aktespertizë e Radomir Llukiqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 26–27.

⁴⁰¹ Radomir Llukiq, T. 26305 (16 maj 2008).

⁴⁰² *Krahaso* P1848 (Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë, 1974), nenet 299(10), 300–301, *me* P858 (Vendimi për Miratimin e Amendamenteve IX - XLIX të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë, 28 mars 1989), Amendamente XXXII pika 4, XXXIII pikat 4, 11, 13. *Shih edhe* Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4191–4192.

⁴⁰³ *Krahaso* P1848 (Kushtetuta e Republikës Socialiste të Serbisë, 1974), nenet 363, 427, 430, *me* P858 (Vendimi për Miratimin e Amendamenteve IX - XLIX të Kushtetutës së Republikës Socialiste të Serbisë, 28 mars 1989), Amendamente XLIII, Pika 3, XLVII Pikat 1, 6.

⁴⁰⁴ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari me datë 24 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14; Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T) T. 4190–4191.

B. ECURIA E KRIZËS

223. Gjatë vitit 1990 kriza në Kosovë u ashpërsua. Më 26 qershor Kuvendi i Serbisë deklaroi ekzistencën e “rrethanave të jashtëzakonshme” në Kosovë për shkak të “veprimtarive të përqendruara në përmbysjen e rendit kushtetues dhe tërësinë territoriale”.⁴⁰⁵ Më 2 korrik anëtarët e Kuvendit të Kosovës u ndaluan të hynin në ndërtesën e Kuvendit dhe ata lëshuan një “deklaratë kushtetuese” duke e shpallur Kosovën republikë të pavarur. Kuvendi i Serbisë e pezulloi Kuvendin e Kosovës formalisht më 5 korrik.⁴⁰⁶ Kuvendi jozyrtar hartoi “Kushtetutën e re të Kosovës” e cila më pas u mbështet prej një referendumi krahinor.⁴⁰⁷ Në shtator 1990, Kushtetuta e re e Serbisë e kufizoi më shumë autonominë e kufizuar të Kosovës.⁴⁰⁸ Më vonë Gjykata Kushtetuese e Kosovës praktikisht u suprimua nëpërmjet një dekreti të Kuvendit të Kosovës.⁴⁰⁹

224. Frederick Abrahams e cilësoi Kosovën e asaj kohe “shtet policor”.⁴¹⁰ Në një raport të vitit 1992, Raportuesi i Posaçëm i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut në ish-Jugosllavi, shprehu shqetësim për diskriminimin e popullatës shqiptare, akuzat për torturim dhe keqtrajtim të të arrestuarve dhe kufizimin e lirisë së informimit.⁴¹¹ Veton Surroi dhe Ibrahim Rugova deklaruan se pati kufizime të radiotelevizionit shqiptar dhe mbyllje të gazetave në shqip.⁴¹² Raportuesi i Posaçëm gjithashtu përshkroi mënyrën e heqjes nga puna që prej fillimit të viteve ‘90 të një numri

⁴⁰⁵ P1855 (Vendim që Përcakton Shfaqjen e Rrethanave të Veçanta në Territorin e Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, 26 qershor 1990), neni 1; P1854 (Ligji mbi Funksionimin e Institucioneve Republikane në Rrethana të Veçanta), neni 2 para. 1.

⁴⁰⁶ P1857 (Ligj mbi Përfundimin e Veprimtarisë së Kuvendit të KSA të Kosovës, 5 korrik 1990); Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4193; Ratko Marković, T. 13283 (10 gusht 2007). Shpallja e pavarësisë u deklarua e pavlefshme dhe u shfuqizua prej Gjykatës Kushtetuese të RSFJ-së në shkurt 1991. P1870 (Vendim për Vlerësimin e Kushtetutshmërisë së Deklaratës Kushtetuese të Kosovës, 20 maj 1991), f. 2–4.

⁴⁰⁷ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari me datë 24 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14; Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4193–4194. *Shih edhe* Petar Damjanac T. 23701–23702 (5 mars 2008).

⁴⁰⁸ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), nenet 73, 109, 100.

⁴⁰⁹ P875 (Vendim për Lirimin nga Detyra të Gjykatësit [si në origjinal] të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të Gjykatësve të Gjykatave Komunale të Gjykatësve dhe Zyrtarëve të Organeve Komunale për Shkelje, dhe për Zgjedhjen e Gjykatësve të Gjykatave të Qarqeve dhe Komunave në Kosovë, 28 dhjetor 1990); *shih* P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), nenet 125, 130 (ku Gjykatës Kushtetuese të Serbisë i jepet kompetenca për të gjykuar në lidhje me kushtetutshmërinë e krahinave autonome).

⁴¹⁰ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari me datë 24 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14.

⁴¹¹ P808 (Raport në lidhje me gjendjen e të drejtave të njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë përgatitur nga Tadeusz Mazowiecki, Raportuesi i Posaçëm i Komisionit për Të Drejtat e Njeriut, 17 nëntor 1992), para. 99–113.

⁴¹² Veton Surroi, T. 4538–4539 (10 tetor 2006); Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4197. *Shih edhe* P864 (Vendime të ndryshme të Kuvendit të Serbisë në lidhje me marrjen e kontrollit mbi organet e medias, 19 korrik 1990) (vendosja e kontrollit shtetëror mbi tri gazeta në Kosovë); P884 (Ligji mbi Informacionin Publik, 28 mars 1991) (që krijoi kushte kufizuese për funksionimin e shtypit).

të madh shqiptarësh kosovarë në ndërmarrjet dhe institucionet publike, ndër të cilat banka, spitale, posta dhe shkolla.⁴¹³

225. Dhoma dëgjoi disa dëshmitarë të cilët dëshmuuan se mësuesit shqiptarë kosovarë refuzuan zbatimin e programit të ri shkollor të paraqitur në vitin 1990 ose 1991, me pasojë pushimin e shumë mësuesve.⁴¹⁴ Mësuesi shqiptar kosovar Sabit Kadriu dëshmoi se mësuesit shqiptarë kosovarë u ndaluan të hynin në ambientet e shkollave në fillimin e vitit të ri shkollor, në shtator 1991.⁴¹⁵ Nxënësit shqiptarë kosovarë të cilët dëshironin të shkolloheshin në gjuhën shqipe, nuk mund të ndiqnin mësimet.⁴¹⁶ Si pasojë LDK-ja dhe parti të tjera politike shqiptare kosovare krijuan një sistem jozyrtar arsimor duke përdorur banesa private për organizmin e orëve mësimore për fëmijët shqiptarë kosovarë.⁴¹⁷ Në qershor 1991 Kuvendi i Serbisë lëshoi një vendim me anë të të cilit u hoqën prej punës një numër zyrtarësh dhe profesorësh në Universitetin e Prishtinës, të cilët u zëvendësuan me joshqiptarë. U shpërndanë Këshilli i Universitetit dhe këshillat e disa fakulteteve dhe u zëvendësuan me organe të përkohshme në përbërje të të cilëve mbizotëronin serbët. Organet e reja kontrollonin pagimin e rrogave dhe ishin të detyruar t'i raportonin rregullisht Ministrisë serbe të Arsimit.⁴¹⁸ Studentët shqiptarë kosovarë nuk mund të shkonin në mësim në atë kohë dhe si pasojë shqiptarët kosovarë organizuan një sistem paralel universitar ku ligjëratat mbaheshin në banesa private.⁴¹⁹

226. Në maj 1992 zgjedhjet parlamentare jozyrtare konfirmuan LDK-në si shumicë politike dhe udhëheqësi i saj Ibrahim Rugova u shpall “president”. Shqiptarët kosovarë bojkotuan zgjedhjet e mëpasshme për Kuvendin Kombëtar të Serbisë. Rrjedhimisht u krijua i ashtuquajtur “sistem paralel” që konsistonte në një “qeveri” jozyrtare që ofronte shërbime publike për popullatën

⁴¹³ P808 (Raport në lidhje me gjendjen e të drejtave të njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë përgatitur nga Tadeusz Mazowiecki, Raportues i Posaçëm i Komisionit për Të Drejtat e Njeriut, 17 nëntor 1992), para. 100, 105–106, 113. *Shih edhe* Adnan Merovci, P2588 (deklaratë dëshmitari me datë 13 prill 2000), f. 4–5.

⁴¹⁴ Baton Haxhiu, T. 6073 (8 nëntor 2006); Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari me datë 24 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik p. 14. *Shih edhe* P808 (Raport në lidhje me gjendjen e të drejtave të njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë përgatitur nga Tadeusz Mazowiecki, Raportues i Posaçëm i Komisionit për Të Drejtat e Njeriut, 17 nëntor 1992), para. 105 (ku pohohet se “mijëra mësues [ishin] pushuar nga puna sepse kishin refuzuar të punonin me programin e ri të caktuar prej qeverisë së Republikës së Serbisë në 1990,” dhe përlogaritet se si pasojë 400.000 fëmijë nuk kishin ndjekur shkollën afërsisht për dy vjet).

⁴¹⁵ Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë dëshmitari me datë 10 dhjetor 2000), f. 4.

⁴¹⁶ Fuat Haxhibeqiri, T. 1127–1132 (8 gusht 2006); Merita Deda, T. 1418–19 (10 gusht 2006).

⁴¹⁷ Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë dëshmitari me datë 10 dhjetor 2000), f. 4; Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklaratë dëshmitari me datë 28 gusht 2001), f. 2 (ku përshkruhet konkretisht gjendja në komunën e Gjakovës); Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4198–4199.

⁴¹⁸ P889 (Vendim mbi Marrjen e Masave të Përkohshme për Mbrojtjen Shoqërore të Të Drejtave të Vetadministrimit dhe të Pronës Shoqërore të Universitetit të Prishtinës dhe Fakulteteve të Tij, 27 qershor 1991), f. 3–14. *Shih edhe* Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari me datë 24 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14.

⁴¹⁹ Baton Haxhiu, P2478 (deklaratë dëshmitari me datë 22 gusht 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9; Rahim Latifi, P2382 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3637–3640 (përshkruan përvojat e tij, duke filluar në 1992, me fakultetin bujqësor të Universitetit të Prishtinës).

shqiptare kosovare financiar prej diasporës së konsiderueshme dhe taksës vullnetare të solidaritetit.⁴²⁰

227. Autoritetet serbe vazhduan të inkurajonin imigrimin ose kthimin në Kosovë të serbëve dhe malazezëve, kurse shqiptarët kosovarë filluan të largoheshin prej krahinës në masë.⁴²¹ Në nëntor 1992 Kuvendi i Serbisë nxori një Deklaratë mbi Të Drejtat e Pakicave Kombëtare që pasqyron gjendjes e nderë dhe të polarizuar në atë kohë.⁴²² Ky dokument bënte fajtor për gjendjen e të drejtave të njeriut “ndryshimin e përbërjes etnike ... i imponuar dhunshëm prej lëvizjes separatiste shqiptare në dekadat e fundit.”⁴²³ Historia e kohëve të fundit e Kosovës u përshkrua si “spastrim etnik” i serbëve dhe si proces i “shqiptarizimit” ku synohej shkëputja e Kosovës dhe krijimi i “Shqipërisë së Madhe”. Republika e Shqipërisë përmendej si vendi i prejardhjes së popullatës shqiptare kosovare dhe u akuzua si mbështetëse e orvatjeve për shkëputje. Duket se toni i krejt deklaratës synonte ngjalljen e frikës së popullatës serbe të Kosovës kundrejt fqinjëve të tyre shqiptarë kosovarë, të cilët u karakterizuan si grup ideologjikisht kompakt dhe i rrezikshëm.

228. Dhoma dëgjoji dëshmi në lidhje me sistemin diskriminues kundër punëtorëve shqiptarë kosovarë gjatë viteve ‘90. Disa dëshmitarë dëshmuar në lidhje me largime masive nga puna të shqiptarëve kosovarë prej vendeve të tyre të punës në industri dhe sektorin publik dhe zëvendësimin e tyre me serbë.⁴²⁴ Të tjerë pohuan se punëtorëve shqiptarë kosovarë iu dha një dokument për të nënshkruar, për të dëshmuar besnikërinë e tyre ndaj autoriteteve shtetërore dhe ata

⁴²⁰ Fuat Haxhibeqiri, T. 1180 (8 gusht 2006); Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari me datë 24 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 15; Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4198–4199; Ratko Markoviq, T. 13285 (10 gusht 2007).

⁴²¹ P901 (Program i Fondit për Zhvillimin e Republikës së Serbisë deri në fund të vitit 1992, 9 korrik 1992), f. 1; Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari me datë 24 janar 2002), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 15; P808 (Raport në lidhje me gjendjen e të drejtave të njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë përgatitur nga Tadeusz Mazowiecki, Raportues i Posaçëm i Komisionit për Të Drejtat e Njeriut, 17 nëntor 1992), para. 100, 104.

⁴²² P1348 (Deklaratë mbi Të Drejtat e Njeriut dhe Të Drejtat e Pakicave Kombëtare, 27 nëntor 1992).

⁴²³ P1348 (Deklaratë mbi Të Drejtat e Njeriut dhe Të Drejtat e Pakicave Kombëtare, 27 nëntor 1992), pikat 3–4.

⁴²⁴ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklaratë dëshmitari me datë 28 gusht 2001), f. 2 (ku përshkruhet konkretisht gjendja në komunën e Gjakovës); Bedri Hyseni, P2270 (deklaratë dëshmitari me datë 8 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2, P2270 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7; K63, P2443 (deklaratë dëshmitari me datë 28 maj 2003), para. 2 (ku deklarohet se ai dhe të tjerë u pushuan nga puna sepse refuzuan të anëtarësoheshin në Partinë Socialiste të Serbisë); Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë dëshmitari me datë 10 dhjetor 2000), f. 4; Adnan Merovci, P2588 (deklaratë dëshmitari me datë 13 prill 2000), f. 4–5; Ibrahim Rugova, P2613 (deklaratë dëshmitari me datë 3 nëntor 2001), f. 3, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4194–4195 (përlllogaritet se gjatë periudhës 1989 - 1993, u pushuan nga puna 150.000 shqiptarë kosovarë prej krejt fuqisë punëtore prej 240.000 vetësh). *Gjithsesi shih*. Adnan Merovci, P2588 (deklaratë dëshmitari me datë 13 prill 2000), f. 5 (ku thotë se disa policë “u larguan” prej presionit, duke nënkuptuar ndoshta se ishte deri diku vendim personal); Petar Damjanac T. 23699–23702 (5 mars 2008) (deklarohet se në fillim të viteve ‘90 shqiptarët kosovarë që punonin në Ministrinë e Brendshme organizuan një grevë); Momir Pantiq, 6D1604 (deklaratë dëshmitari me datë 26 mars 2008), para. 4 (deklarohet se disa prej kolegëve të tij shqiptarë kosovarë në Ministrinë e Brendshme u detyruan të lëshonin vendet e tyre punës nga “udhëheqja politike shqiptare”).

që nuk nënshkruan, u pushuan nga puna.⁴²⁵ Gjithashtu dy dëshmitarë përshkruan vështirësitë që ata dhe shqiptarë kosovarë të tjerë hasnin në punësim, për të cilat gjykonin se vinin thjesht prej faktit se ishin shqiptarë kosovarë.⁴²⁶

229. Disa dokumente zyrtare mbështesin dëshmitë e diskriminimit të organizuar dhe të mbështetur nga shteti në vendet e punës. Në korrik 1991 Kuvendi i Serbisë miratoi disa vendime në lidhje me heqjen kryesisht të zyrtarëve shqiptarë kosovarë në ndërmarrje të ndryshme tregtare në Kosovë dhe zëvendësimin e tyre me joshqiptarë.⁴²⁷ Për shembull në Vushtrri drejtori shqiptar kosovar i firmës *Poles*, bashkë me Këshillin Punëtor, Komitetin Disiplinor dhe Komitetin e Kontrollit Punëtor Vetëqeverisës, u zëvendësuan krejtësisht me joshqiptarë. Arsyet e dhëna për pushimin e tyre ndër të tjera ishin “incidente të paligjshme” në ndërmarrje si dhe një peticion i “punëtorëve të kombësisë serbe dhe malazeze”, dhe shpërdorimi prej punëtorëve shqiptarë kosovarë i pozitës së tyre dominuese në Këshillin Punëtor. Gjithashtu u përmend pjesëmarrja e punëtorëve shqiptarë kosovarë në një grevë të përgjithshme mbajtur më 3 shtator 1990.⁴²⁸ Arsyet e ngjashme u dhanë për pushimin e drejtorëve shqiptarë kosovarë dhe këshillave punëtorë në ndërmarrje, ndër të tjera në Podujevë (punëtorët shqiptarë kishin dëmtuar marrëdhëniet ndëretnike), “Gričar” (ku deklarohet se ndërmarrja *Separacija Bentokos* kishte punësuar “një numër të madh punëtorësh joprodhimtarë të kombësisë shqiptare gjë që kishte keqësuar më tej marrëdhëniet dhe gjendjen e keqe në ndërmarrje”), Vushtrri (ku pretendohet se në ndërmarrjen *Kosova-Trans*, kualifikimet e punëtorëve shqiptarë kosovarë ishin “tejet të papërshtatshme”, dhe theksohet se ata “nuk njihnin organet komunale, krahinore dhe republikane, as kushtetutën dhe ligjet e Serbisë”), Gjakovë (që akuzonte drejtuesit e ndërmarrjes pyjore se shisnin lëndë drusore duke i përdorur fitimet për financimin e “separatizmit shqiptar”), Deçan, Pejë (ku deklarohet se për shkak të “sjelljes tejet miqësore të drejtorit kundrejt punëtorëve me kombësi shqiptare, ishin prishur marrëdhëniet ndëretnike dhe ndërpersonale”), dhe Malishevë.⁴²⁹

230. Siç u përmend më lart, në 1992, Raportuesi i Posaçëm për të drejtat e njeriut në ish-Jugosllavi shprehu shqetësim në lidhje me diskriminimin e popullatës shqiptare kosovare duke përfshirë diskriminimin në punë, pushimin nga puna të mijëra punëtorëve shqiptarë kosovarë dhe hyrjen në fuqi të Ligjit të Punës në Rrethana të Jashtëzakonshme. Gjithashtu ai përmendi kushtin e

⁴²⁵ Fuat Haxhibeqiri, T. 1124–1126 (8 gusht 2006); Bedri Hyseni, P2270 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7; Veton Surroi, T. 4536–4537 (10 tetor 2006).

⁴²⁶ Nazlie Bala, P2262 (deklaratë dëshmitari me datë 30 qershor 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5; Bedri Hyseni, P2270 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7.

⁴²⁷ P893 (Vendime të botuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë, 31 korrik 1991).

⁴²⁸ P893 (Vendime të botuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë, 31 korrik 1991), f. 1, 4–5

⁴²⁹ P893 (Vendime të botuara në Fletoren Zyrtare të Republikës së Serbisë, 31 korrik 1991), f. 17, 26, 30–31, 40, 44–45, 49, 59–60.

imponuar ndaj punëtorëve shqiptarë kosovarë për nënshkrimin e një dokumenti me anë të së cilit ata të mbështesnin masat e ndërmarra nga autoritetet serbe në Kosovë, fakt që u dëshmuar prej dëshmitarëve Veton Surroi, Fuat Haxhibeqiri, dhe Bedri Hyseni.⁴³⁰

C. ORVATJET PËR ZGJIDHJEN E KRIZËS

231. Dhoma dëgjoi dëshmi në lidhje me përpjekjet për t'i dhënë fund krizës, kryesisht prej Ratomir Taniqit. Taniqi dëshmoi se nga mesi i viteve '90 ai kishte marrëdhënie pune prej një kohe të gjatë me Sigurimin e shtetit serb dhe gjithashtu kishte pranuar funksionin e këshilltarit të kryetarit të partisë Demokracia e Re (në atë kohë pjesë e koalicionit qeveritar të Serbisë) në 1994 ose 1995.⁴³¹ Ai mori pjesë personalisht në negociatat me shqiptarët kosovarë gjatë periudhës 1995 – 1997 si përfaqësues i Demokracisë së Re me udhëzim të Slllobodan Millosheviqit.⁴³² Taniqi deklaroi se Millosheviqi dhe shqiptarët kosovarë ranë dakord për përfshirjen e një pale të tretë në negociata dhe si pasojë u zgjodhën Fondacioni Shkencor Bertelsmann dhe Monsinjor Paglia i Bashkësisë San Egidio.⁴³³

232. Sipas Taniqit, nën kujdestarinë e Fondacionit Shkencor Bertelsmann u përgatit një raport i një projekti bashkëpunimi, *Exploring Futures for Kosovo: Kosovo Albanians and Serbs in Dialogue/Hulumtimi i të ardhmes në Kosovë: Shqiptarët dhe serbët e Kosovës në dialog*, i cili “shërbeu si bazë negociatash me pjesëmarrjen e bashkësisë ndërkombëtare.”⁴³⁴ Gjatë negociatave shqiptarët kosovarë përfaqësoheshin prej Fehmi Aganit, i caktuar prej Ibrahim Rugovës. Megjithëse negociatat u kryen “në mënyrë fragmentare”, ato prodhuan një dokument të cilin Taniqi e cilësoi “marrëveshje” ku theksohej nevoja për dialog, ndihmë ndërkombëtare dhe respekt për parimet demokratike dhe të drejtat e njeriut.⁴³⁵ Mirëpo sipas Taniqit, negociatat dështuan kur Millosheviqi e ndërpreu mbështetjen në vitin 1997.⁴³⁶

233. Megjithëse Dhoma ka rezerva në lidhje me disa aspekte të dëshmisë së dhënë prej Radomir Taniqit, pjesëmarrja e tij në negociata me shqiptarët kosovarë konfirmohet prej Veton Surroit dhe

⁴³⁰ P808 (Raport në lidhje me gjendjen e të drejtave të njeriut në territorin e ish-Jugosllavisë përgatitur nga Tadeusz Mazowiecki, Raportues i Posaçëm i Komisionit për Të Drejtat e Njeriut, 17 nëntor 1992), para. 99–113.

⁴³¹ Ratomir Taniq, T. 6279–6283 (10 nëntor 2006). *Shih edhe* P695 (Konferencë Shtypi e Demokracisë së Re e pasqyruar në *Politika*, 16 shtator 1994).

⁴³² Ratomir Taniq, 1D44 (deklaratë dëshmitari me datë 19 korrik 2000), para. 1, 4–5; Ratomir Taniq, T. 6285, 6289 (10 nëntor 2006).

⁴³³ Ratomir Taniq, 1D44 (deklaratë dëshmitari me datë 19 korrik 2000), para. 12.

⁴³⁴ Ratomir Taniq, T. 6308–6309 (10 nëntor 2006). *Shih përgjithësisht* P704 (*Exploring Futures for Kosovo: Kosovo Albanians and Serbs in Dialogue*, gusht 1997) (ku trajtohen një sërë problemesh të atëhershme në Kosovë dhe ka artikuj nga politikanë dhe akademikë, ndër të cilët edhe Veton Surroi).

⁴³⁵ P2481 (dokument pa datë bashkëngjitur deklaratës së Taniqit si dëshmitar, me titullin “Qëndrime të Pranuara Bashkërisht”).

Baton Haxhiut. Surroi përshkroi pjesëmarrjen e tij në negociatat e kryera nën kujdestarinë e Fondacionit Shkencor Bertelsmann që rezultuan në një dokument të titulluar “Joint Recommendations on the Kosovo Conflict/Rekomandime të Përbashkëta për Konfliktin në Kosovë”, i cili paraqiste kuadrin e bisedimeve të ardhshme në lidhje me statusin e Kosovës⁴³⁷ Haxhiu gjithashtu dëshmoi se kishte dëgjuar se Fehmi Agani kishte marrë pjesë në negociata me anëtarë të partisë “Demokracia e Re”, ndër të cilët Ratomir Taniq.⁴³⁸ Megjithëse Surroi shprehu dyshime për Taniqin dhe sinqeritetin e tij veçanërisht për marrëdhëniet e tij me Millosheviqin,⁴³⁹ dhe Haxhiu vuri në pikëpyetje qëndrimin dhe pozitën e Taniqit,⁴⁴⁰ dëshmitë e të dyve konfirmojnë se u ndërmorën procese me pjesëmarrjen e palës shqiptare kosovare dhe serbe në kërkim të mënyrave për zgjidhjen e gjendjes në Kosovë në mes të viteve '90.

234. Pjesëmarrja e MonsinJOR Paglia-s së Bashkësisë së San Egidio-s çoi në nënshkrimin e marrëveshjes së San Egidio-s. Kjo marrëveshje synonte të “normalizonte sistemin arsimor për rininë shqiptare në Kosovë” dhe kthimin e mësuesve dhe studentëve shqiptarë në shkolla. Ajo krijoi edhe një “grup të përzierë” për zbatimin.⁴⁴¹ Sipas Veton Surroit kjo marrëveshje u bë e njohur publikisht vetëm pas nënshkrimit të saj prej Slobodan Millosheviqit dhe Ibrahim Rugovës më 1 shtator 1996.⁴⁴² Në procesin *Millosheviq*, Rugova dëshmoi se si gjest vullnetmirë ai e nënshkroi marrëveshjen vetëm në emrin e tij dhe jo si President i Kosovës, duke qenë ky funksion nuk njihej prej autoriteteve të RFJ-së/Serbisë.⁴⁴³

235. Kur nuk u ndërmor asnjë hap konkret për realizimin e marrëveshjes, studentët shqiptarë kosovarë morën pjesë në demonstrata, si më 1997 po ashtu edhe më 1998.⁴⁴⁴ Sipas Baton Haxhiut këto demonstrata u shtypën me dhunë prej policisë serbe e cila përdori gaz lotsjellës dhe rrahu shumë studentë demonstrues.⁴⁴⁵ Më 23 mars 1998 u nënshkrua një marrëveshje dytësore ku parashikohej rihapja graduale e universitetit dhe shkollave dhe përdorimi i përbashkët i objekteve

⁴³⁶ Ratomir Taniq, T. 6312–6314 (10 nëntor 2006).

⁴³⁷ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 9–10. *Shih përgjithësisht* P712 (Rekomandime të Përbashkëta në lidhje me Konfliktin në Kosovë, Fondacioni Shkencor Bertelsman, 1997).

⁴³⁸ Baton Haxhiu, P2478 (deklaratë dëshmitari me datë 22 gusht 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 11.

⁴³⁹ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 9.

⁴⁴⁰ Baton Haxhiu, T. 6135 (8 nëntor 2006).

⁴⁴¹ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4207, P2613 (deklaratë dëshmitari me datë 3 nëntor 2001), f. 5.

⁴⁴² Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 9. *Shih përgjithësisht* P715 (Marrëveshja Millosheviq-Rugova për Arsimin, 1 shtator 1996); 1D559 (Marrëveshja Millosheviq-Rugova për Arsimin, 1 shtator 1996) (me përkthim rezervë).

⁴⁴³ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4209.

⁴⁴⁴ Velko Odallovic, T. 14465–14466 (27 gusht 2007) (deklaroi se kishte shumë vështirësi në negociimin mbi formulimin e tekstit të zbatimit të marrëveshjes dhe rrjedhimisht nuk u mor asnjë masë konkrete); Baton Haxhiu, P2478 (deklaratë dëshmitari me datë 22 gusht 2001), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 9.

⁴⁴⁵ Baton Haxhiu, T. 6076–6078 (8 nëntor 2006).

prej studentëve serbë dhe shqiptarë.⁴⁴⁶ Instituti i Albanologjisë u hap i pari më 31 mars 1998, por vetëm pak fakultete pasuan.⁴⁴⁷ Në qershor 1998 Monsinor Paglia i cili kishte marrë pjesë në negociimin e marrëveshjes së parë, i dërgoi një letër Presidentit serb Millutinoviç, ku shprehte pakënaqësi për procesin e zbatimit dhe i cilësonte diskutimet “të pafrytshme për shkak të paragjykitimit serb”, i cili sipas tij kundërshtonte dhënien e hapësirës studentëve shqiptarë në Universitet.⁴⁴⁸ Ai theksoi se afati i 31 majit për rihapjen e ambienteve të Universitetit nuk ishte respektuar dhe deklaroi se pala shqiptare ishte e gatshme për plotësimin e kushteve të marrëveshjes.⁴⁴⁹

236. Pavarësisht prej disa episodeve të tjera në mes të vit 1998, marrëveshja nuk u zbatua kurrë dhe thellimi i krizës e bëri më të pamundur zbatimin e njëmendtë.⁴⁵⁰

D. KONKLUSIONE

237. Dhoma konkludon se afërsisht prej vitit 1989, hendeku midis aspiratës së shumicës së popullatës shqiptare kosovare dhe planeve të autoriteteve shtetërore të RFJ-së dhe Serbisë krijoi një gjendje të nderë dhe të paqëndrueshme. Përpjekjet e autoriteteve për kontroll më të rreptë në krahinë dhe për pakësimin e ndikimit të shqiptarëve kosovarë në qeverisjen krahinore, sektorin publik dhe jetën ekonomike e polarizuan popullatën. Në fakt u hartuan ligje dhe praktika diskriminuese kundër shqiptarëve të cilat shtuan pakënaqësinë dhe ndjenjën e përndjekjes. Nga ana tjetër u shtua frika midis pakicës joshqiptare në Kosovë për shkak të ashpërsimit të retorikës shtetërore dhe krijimit të institucioneve “paralele.” Frika u shtua më tej me daljen e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në 1996 dhe veprimet e saj të mëvonshme që diskutohen më poshtë. Pavarësisht disa përpjekjeve të bëra në mes të viteve '90 për zgjidhjen e kësaj gjendjeje në Kosovë, asnjë prej palëve nuk bëri përpjekje të njëmendta për daljen nga kriza që thellohej, deri në angazhimin e bashkësisë ndërkombëtare. Më poshtë diskutohen nismat diplomatike dhe pjesëmarrja e disa të Akuzuarve në to.

⁴⁴⁶ 2D1 (Masat e pranuar për zbatimin e marrëveshjes për arsimin, 23 mars 1998); Veton Surroi, T. 4583 (10 tetor 2006).

⁴⁴⁷ Veton Surroi, T. 4582 (10 tetor 2006) (deklaroi se u hapën dy ose tri kolegje si dhe fakulteti i filozofisë dhe ai teknik); Baton Haxhiu, T. 6076 (8 nëntor 2006) (deklarohet se nuk u hap asnjë prej fakulteteve të Universitetit për studentët shqiptarë, dhe se i vetmi institut që u lejua ishte Instituti i Albanologjisë); Ibrahim Rugova, P2613 (deklaratë dëshmitari me datë 3 nëntor 2001), f. 6 (deklarohet se u rihapën Instituti i Albanologjisë dhe një fakultet).

⁴⁴⁸ P2885 (Letër e Monsinor Paglia-s për Millan Millutinoviçin, 4 qershor 1998).

⁴⁴⁹ P2885 (Letër e Monsinor Paglia-s për Millan Millutinoviçin, 4 qershor 1998). Mirëpo Millomir Miniç dhe Zoran Angjelkoviç dëshmuar se qeveria ishte e vendosur të zbatonte marrëveshjen. Millomir Miniç, T. 14783 (31 gusht 2007); Zoran Angjelkoviç, T. 14653–14654 (30 gusht 2007).

⁴⁵⁰ Veton Surroi, T. 4582–4583 (10 tetor 2006), P2362 (transkript i *Prokurori k. Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3403; Wolfgang Petritsch, T. 10781 (1 mars 2007); Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4211.

238. Pas paraqitjes së rrethanave të konfliktit në Kosovë i cili u ashpërsua në vitet 1998 dhe 1999, dhe para analizimit të hollësishëm të ngjarjeve të atyre viteve, Dhoma tani do të diskutojë kuadrin politik dhe kushtetues të RFJ-së dhe Serbisë dhe do të analizojë në veçanti, kompetencat e Presidentit të Serbisë, që në atë kohë ishte i Akuzuari Millan Millutinoviç.

IV. STRUKTURA DHE FUNKSIONIMI POLITIK DHE KUSHTETUES I RFJ-SË DHE SERBISË NË 1998 DHE 1999

A. STRUKTURA KUSHTETUESE E RFJ-SË DHE REPUBLIKËS SË SERBISË

239. Njëherazi me keqësimin e gjendjes në Kosovë në fund të viteve '80 dhe fillim të viteve '90, filloi shpërbërja e RSFJ-së. Më 1989, Republika Socialiste e Sllovenisë miratoi disa ndryshime të Kushtetutës së saj të cilat bënë të pavlefshme disa prej dispozitave kushtetuese të RSFJ-së, pasuar së fundi prej shpalljes së pavarësisë së Sllovenisë në dhjetor 1990. Afërsisht në të njëjtën periudhë Kroacia bëri të njëjtën gjë.⁴⁵¹ Pasi një periudhë e paqartë politike. Më pas, më 28 shtator 1990, Kuvendi i Republikës Socialiste të Serbisë shpalli Kushtetutën e Republikës së Serbisë ("Kushtetuta serbe").⁴⁵² Kjo kushtetutë siç do të shihet më poshtë, përmbante dispozita të pazakonta për një njësi federale të cilat u hartuan duke i paraprirë krijimit të shtetit të pavarur serb. Pas tetëmbëdhjetë muajsh, më 27 prill 1992, pas shkëputjes së njërive të tjera federale, Këshilli Federal i RSFJ-së nxori një vendim në lidhje me shpalljen e Kushtetutës së RFJ-së.⁴⁵³ Kjo federatë që përbëhej prej Republikës së Serbisë dhe Republikës së Malit të Zi, ekzistoi deri në vitin 2003. Në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën ishin në fuqi Kushtetuta serbe e vitit 1990 dhe Kushtetuta e RFJ-së e vitit 1992.

1. Struktura kushtetuese e Republikës së Serbisë

240. Në nenin 9 të Kushtetutës serbe, Kuvendit Kombëtar i ishte besuar "kompetenca kushtetuese dhe ligjvënëse", qeverisë "kompetenca ekzekutive"; dhe Presidenti i Serbisë përfaqësonte Republikën e Serbisë dhe "unitetin e vendit."⁴⁵⁴ Në lidhje me organizimin territorial të Republikës së Serbisë, Kushtetuta parashtronte se krahinat autonome të Vojvodinës dhe Kosovës e Metohisë do të kishin kuvendet, këshillat ekzekutivë dhe institucionet e tyre qeverisëse.⁴⁵⁵ Siç u përmend më parë, këto kompetenca ishin më të pakta se ato të Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974.⁴⁵⁶

⁴⁵¹ Ratko Marković, T. 13115–13116 (8 gusht 2007).

⁴⁵² P855 (Vendim mbi Shpalljen e Kushtetutës së Republikës së Serbisë, 28 shtator 1990).

⁴⁵³ P856 (Vendim mbi Shpalljen e Kushtetutës së Republikës Federale të Jugosllavisë, 27 prill 1992).

⁴⁵⁴ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 9.

⁴⁵⁵ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 111; 1D330 (Ligji mbi Organizimin Territorial të Republikës së Serbisë dhe Vetëqeverisjen Lokale), neni 14.

⁴⁵⁶ *Shih* Kapitulli III.

241. Gjithashtu Kushtetuta e Republikës së Serbisë përmbante dispozita në lidhje me tërësinë e saj territoriale dhe marrëdhëniet me shtetet e tjera, mbrojtjen dhe sigurinë e saj dhe marrjen e masave të jashtëzakonshme.⁴⁵⁷ Mirëpo në të njëjtën kohë neni 135 parashtronte si më poshtë:

Të drejtat dhe detyrimet e sanksionuara në Kushtetutën ekzistuese të Republikës së Serbisë e cila është pjesë e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe të cilat bazuar në Kushtetutën Federale ushtrohen në Federatë, ushtrohen në përputhje me Kushtetutën Federale.⁴⁵⁸

Kushtetuta federale në fjalë ishte Kushtetuta e RSFJ-së.⁴⁵⁹

242. Çdo organ shtetëror kishte një numër kompetencash dhe përgjegjësisish konkrete për t'i mundësuar plotësimin e rolit përkatës kushtetues. Për shembull Kuvendi Kombëtar serb ndër të tjera mund të vendoste për ndryshimin e Kushtetutës, miratonte ligje dhe akte të përgjithshme, përcaktonte organizmin territorial të Republikës, vendoste në lidhje me paqen dhe luftën dhe ushtronte kontroll ndaj punës së qeverisë dhe organeve të tjera.⁴⁶⁰ Gjithashtu Kuvendi kombëtar zgjidhte kryetarin dhe zëvendëskryetarët e vet, ministrat e Republikës dhe zëvendëskryeministrat, prej deputetëve të Kuvendit.⁴⁶¹

243. Qeveria e Republikës së Serbisë e përbërë prej Kryeministrit, zëvendëskryeministrave dhe ministrave,⁴⁶² zbatonte politikën e Republikës dhe ligjet e Kuvendit Kombëtar në përputhje me Kushtetutën serbe.⁴⁶³ Gjithashtu ajo mbikëqyrte funksionimin e ministrive dhe organizatave të

⁴⁵⁷ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 72.

⁴⁵⁸ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 135.

⁴⁵⁹ Ratko Markoviqi, ekspert i të drejtës kushtetuese i cili si anëtar i komisionit kushtetues mori pjesë në hartimin e Kushtetutës serbe, u pyet gjerësisht në lidhje me këtë nen. Ai shpjegoi se ishte produkt i komisionit kushtetues. Ratko Markoviq, T. 13311–13326 (10 gusht 2007), T. 13632–13633 (14 gusht 2007). Kur u pyet nga Dhoma sa kohë duhej për ndryshimin e Kushtetutës serbe në rast të shpërbërjes së RSFJ-së në vend të lëvizjes parapritëse të krijimit të ministrive, Markoviqi u përgjigj se do të kishte zgjatur së paku dy muaj. Ratko Markoviq, T. 13279 (9 gusht 2007). Gjithashtu Markoviqit iu tha se një vendim për nenin 135 ishte më shumë politik se juridik, dhe si pasojë ai u pyet sa politikanë bënin pjesë në komision. Markoviqi komentoi se shumë prej vendimeve në lidhje me Kushtetutën ishin politike mirëpo këmbënguli se vendimi në lidhje me nenin 135 nuk u mor nëpërmjet anashkalimit të komisionit kushtetues dhe ishte thjesht produkt i rrethanave të atëhershme, ndër të cilat fakti se Republika Socialiste e Kroacisë kishte një dispozitë të ngjashme në kushtetutën e vetë. Gjithashtu në atë kohë asnjë prej anëtarëve të komisionit nuk parashikoi rëndësinë që kjo dispozitë do të merrte më vonë gjatë proceseve në Tribunal. Ratko Markoviq, T. 13320–13326 (10 gusht 2007), T. 13629–13671 (15 gusht 2007).

⁴⁶⁰ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 73.

⁴⁶¹ Ratko Markoviq, T. 12994–12995 (7 gusht 2007); P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 78; 1D413 (Vendim në lidhje me zgjedhjen e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Brendshëm të qeverisë së Republikës së Serbisë, 15 prill 1997).

⁴⁶² P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 91; 1D375 (Ligji mbi Amendamentet në Ligjin mbi Qeverinë e Republikës së Serbisë), neni 2. Më 1 korrik 1993, u krijua posti i zëvendësministrit që do të bënte të mundur që dikush të ishte në dispozicion të Kuvendit Kombëtar në mungesë të ministrit. *Shih* Ratko Markoviq, T. 12993–12994 (7 gusht 2007); 1D376 (Ligji mbi Ndryshimet dhe Amendamentet në Ligjin për Administratën Shtetërore (Republikane), neni 44(a); 1D413 (Vendim në lidhje me zgjedhjen e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Brendshëm të qeverisë së Republikës së Serbisë, 15 prill 1997).

⁴⁶³ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 90(1).

posaçme.⁴⁶⁴ Me kërkesë të Presidentit të Serbisë, qeveria ishte e detyruar të miratonte një qëndrim në lidhje me çështje të ndryshme brenda juridiksionit të vet dhe në lidhje me këtë të informonte Presidentin brenda një periudhe të përcaktuar nga Presidenti, jo më pak se 48 orë.⁴⁶⁵

244. Sa për kompetencat dhe përgjegjësitë e Presidentit të Republikës së Serbisë, ato pasqyroheshin në nenet 83, 85, 89 dhe 132 të Kushtetutës serbe. Në bazë të nenit 83, ndër të tjera Presidenti mund t'i propozonte Kuvendit Kombëtar një kandidat për postin e Kryeministrit, pasi kishte dëgjuar mendimin e shumicës së Kuvendit Kombëtar;⁴⁶⁶ dekretonte ligje;⁴⁶⁷ merrej me çështje të marrëdhënieve midis Republikës së Serbisë dhe shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare;⁴⁶⁸ udhëhiqte forcat e armatosura në kohë lufte dhe paqeje dhe organizonte përgatitjet për mbrojtje në përputhje me ligjin;⁴⁶⁹ përcaktonte rrezikun e luftës së afërt, ose shpallte gjendje lufte, në qoftë se Kuvendi Kombëtar do ta kishte pamundur të mblidhej dhe pasi të ishte këshilluar me Kryeministrin,⁴⁷⁰ dhe gjatë gjendjes së luftës ose rrezikut të luftës së afërt, nxirrte dekrete në lidhje me çështje që ishin kompetenca të Kuvendit Kombëtar.⁴⁷¹ Gjithashtu Presidenti, me propozim të qeverisë dhe kur kërcënohej siguria e Republikës, kishte detyrim të shpallte gjendjen e jashtëzakonshme dhe përcaktonte mjetet dhe mënyrat për marrjen e masave të nevojshme në rrethana të tilla.⁴⁷² Neni 85 përcaktonte se Presidenti mund t'i kërkonte qeverisë “të qartësonte qëndrimin e saj në çështje brenda juridiksionit të vet,”⁴⁷³ kurse neni 89 i jepte Presidentit kompetencën për shpërndarjen e Kuvendit Kombëtar mbi bazën e një propozimi formal dhe të arsyetuar prej qeverisë.⁴⁷⁴ Gjithashtu, bazuar në nenin 132 të Kushtetutës serbe, Presidenti mund të propozonte ndryshime të Kushtetutës, të cilat votoheshin prej Kuvendit Kombëtar.⁴⁷⁵ Betimi i marrjes së detyrës përbante zotimin e Presidentit për ruajtjen e sovranitetit dhe tërësisë së

⁴⁶⁴ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 90(7).

⁴⁶⁵ P1862 (Ligji mbi Qeverinë Serbe), neni 19; 1D374 (Rregullorja e Procedurës së Qeverisë së Republikës së Serbisë), neni 47.

⁴⁶⁶ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(1); 1D372 (Rregullorja e Procedurës së Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë), neni 117.

⁴⁶⁷ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), nenet 83(3), 84; 1D372 (Rregullorja e Procedurës së Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë), neni 119; IC132 (ilustrim me Power Point i ndryshimeve midis një dekreti dhe një urdhërese).

⁴⁶⁸ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(4).

⁴⁶⁹ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(5).

⁴⁷⁰ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(6).

⁴⁷¹ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(7). Në lidhje me kompetencën e nxjerrjes së ligjeve. çfarëdo ligji i nxjerrë në këtë mënyrë i duhet paraqitur Kuvendit Kombëtar për miratim menjëherë sapo Kuvendi Kombëtar të ketë mundësi për t'u mbledhur.

⁴⁷² P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(8). *Shih edhe* 1D349 (Vendim mbi formimin e shërbimeve ndihmëse të Presidentit të Republikës, 17 korrik 1992).

⁴⁷³ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 85.

⁴⁷⁴ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 89.

⁴⁷⁵ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 132.

Republikës së Serbisë, dhe jetësimin e të drejtave qytetare dhe njerëzore si dhe për ruajtjen e paqes dhe mirëqenies së të gjithë qytetarëve.⁴⁷⁶

245. Më 11 shkurt 1991, në përgatitje për shpërbërjen e RSFJ-së, Kuvendi Kombëtar nxori Ligjin për Ministrinë. Neni 5 i ligjit sanksiononte krijimin e 20 ministrive për kryerjen e funksioneve qeverisëse të përditshme në sferat e tyre të përgjegjësisë, disa prej të cilave ishin rezervuar për organet federale, dhe ku përfshiheshin Ministria e Mbrojtjes, e Brendshme, e Marrëdhënieve Ekonomike Ndërkombëtare dhe Bashkëpunimit Ekonomik dhe e Punëve të Jashtme.⁴⁷⁷ Gjithashtu Ligji për Mbrojtjen i 18 korrikut 1991 për të drejtat dhe përgjegjësitë e Republikës së Serbisë në sferën e Mbrojtjes, përmbante dispozita për çështje të juridiksionit të qeverisë federale.⁴⁷⁸ Për shembull neni 5 përcaktonte detyrat e Presidentit serb në organizimin e përgatitjeve për mbrojtje, ndër të tjera “udhëheqjen e forcave të armatosura” në kohë paqeje dhe lufte;⁴⁷⁹ dekretimin e planeve për mbrojtjen e Republikës së Serbisë;⁴⁸⁰ urdhërimin e zbatimit të masave për gjendjen e gatishmërisë;⁴⁸¹ dhe kompetencën e urdhërimit të policisë në luftë, në kohën e rrezikut të luftës së afërt, në gjendje lufte dhe në gjendje të jashtëzakonshme, në mbrojtje të të drejtave dhe detyrimeve të Republikës së Serbisë dhe qytetarëve të saj përcaktuar prej Kushtetutës serbe.⁴⁸² Mirëpo pavarësisht dispozitës ku përmendeshin “forcat e armatosura” të Serbisë, në periudhën që ka lidhje me aktakuzën, nuk ekzistonte ushtria serbe. Faktikisht Ushtria Jugosllave (“UJ”) ishte e vetmja forcë zyrtare e armatosur, që përfaqësonte gjithë RFJ-në.

246. Pas krijimit të Federatës së re më 1992, u miratua një ligj që suprimonte Ministrinë e Mbrojtjes, Punëve të Jashtme dhe Marrëdhëniet Ekonomike Ndërkombëtare dhe Bashkëpunimin Ekonomik, të gjithë këto të konsideruara ministri federale. Ministrinë e tjera, ndër të cilat Ministria e Brendshme serbe, vazhduan të funksiononin.⁴⁸³ Çuditërisht as Ligji për Mbrojtjen dhe as neni 83 të Kushtetutës serbe nuk iu bënë ndryshimet përkatëse, duke e lënë në këtë mënyrë Presidentin serb në krye të “forcave të armatosura” dhe çështjeve të mbrojtjes.

247. Sa për lidhjet e Presidentit serb me Ministrinë e Brendshme serbe (“MPB-ja serbe”), Ligji serb për Punët e Brendshme parashtronte se, “me kërkesë të Kuvendit Kombëtar dhe Presidentit të Republikës”, ministri i Brendshëm duhej të paraqiste një raport për punën e Ministrisë dhe për

⁴⁷⁶ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 86; 1D372 (Rregullorja e Procedurës së Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë), neni 116.

⁴⁷⁷ 1D456 (Ligji mbi Ministrinë), neni 5.

⁴⁷⁸ P1874 (Ligji serb mbi Mbrojtjen).

⁴⁷⁹ P1874 (Ligji serb mbi Mbrojtjen), neni 5(1).

⁴⁸⁰ P1874 (Ligji serb mbi Mbrojtjen), neni 5(2).

⁴⁸¹ P1874 (Ligji serb mbi Mbrojtjen), neni 5(3).

⁴⁸² P1874 (Ligji serb mbi Mbrojtjen), neni 5(5).

⁴⁸³ 1D142 (Ligji për Ndryshimin e Ligjit mbi Ministrinë), neni 5, i pranuar edhe si 1D457.

gjendjen e sigurisë në çfarëdo kohë.⁴⁸⁴ Gjithashtu, bazuar në nenin 6 të Ligjit të Gradave të Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme, Presidenti mund të gradonte zyrtarë të lartë me gradën e gjeneralit ose mund t'u jepte gjeneralëve një gradë më të lartë gjenerali brenda MPB-së.⁴⁸⁵ Gjithashtu ai mund të miratonte gradime të veçanta për gjeneralë dhe zyrtarë të lartë me rekomandim të ministrit të Brendshëm.⁴⁸⁶

2. Struktura kushtetuese e RFJ-së

248. Kushtetuta e RFJ-së e cila pasoi Kushtetutën e mëparshme të RSFJ-së në prill 1992, e përkufizonte RFJ-në si shtet sovran, federal bazuar në barazinë e republikave të veta përbërëse, Serbisë dhe Malit të Zi.⁴⁸⁷ Sipas nenit 6, republikat anëtare ishin sovraane për çështje të cilat Kushtetuta e RFJ-së nuk i kishte rezervuar për juridiksionin e RFJ-së.⁴⁸⁸ Gjithashtu brenda kompetencave të veta, republika anëtare mund të zhvillonte marrëdhënie me shtete të tjera, të anëtarësohej në organizata ndërkombëtare dhe të nënshkruante marrëveshje ndërkombëtare në qoftë se këto marrëveshje nuk dëmtonin RFJ-në.⁴⁸⁹ Së fundi, neni 115 i Kushtetutës së RFJ-së parashtronte se kushtetutat dhe legjislacionet e Serbisë dhe Malit të Zi duhej të ishin në përputhje me Kushtetutën e RFJ-së.⁴⁹⁰

249. Kapitulli IV i Kushtetutës së RFJ-së trajtonte juridiksionin e RFJ-së. Neni 77 i këtij kapitulli përcaktonte se RFJ-ja nëpërmjet organeve të veta nxjerr dhe zbaton ligje federale ndër të tjera në aspekte lidhur me marrëdhëniet ndërkombëtare dhe mbrojtjen e sigurinë e RFJ-së.⁴⁹¹

250. Po ashtu si në Serbi, organet kryesore shtetërore ishin Kuvendi, qeveria dhe Presidenti. Kuvendi Federal përbëhej prej Dhomës së Qytetarëve dhe Dhomës së Republikave. Megjithëse Serbia kishte popullsi më të shumtë se Mali i Zi, Dhoma e Republikave përbëhej prej një numri të barabartë përfaqësuesish prej secilës republikë në kuadrin e sistemit të kontroleve dhe balancave, për mundësimin e përfaqësimit të duhur të dy republikave.⁴⁹² Ndër kompetencat dhe përgjegjësitë e saj përfshiheshin vendimi për luftë dhe paqe dhe shpallja e gjendjes së luftës, gjendja e rrezikut të

⁴⁸⁴ P1737 (Ligji serb për Punët e Brendshme), neni 9.

⁴⁸⁵ P1015 (Ligji për Gradat e Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme), neni 6, gjithashtu pranuar si 1D237.

⁴⁸⁶ P1015 (Ligji për Gradat e Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme), neni 10, gjithashtu pranuar si 1D237. *Shih edhe* nenin 13 të të njëjtit ligj.

⁴⁸⁷ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), nenet 1, 2.

⁴⁸⁸ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 6.

⁴⁸⁹ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 7.

⁴⁹⁰ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 115.

⁴⁹¹ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 77.

⁴⁹² 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 80; Ratko Marković, T. 12977 (7 gusht 2007).

afërt të luftës ose gjendja e jashtëzakonshme,⁴⁹³ si dhe emërimi i Presidentit dhe Kryeministrit të RFJ-së.⁴⁹⁴

251. Qeveria federale përbëhet prej Kryeministrit, zëvendëskryeministrit dhe ministrave federalë.⁴⁹⁵ Ndër detyrat e saj përfshiheshin formulimi dhe jetësimi i politikës së brendshme dhe të jashtme;⁴⁹⁶ kultivimi i marrëdhënieve midis RFJ-së dhe shteteve të tjera dhe organizatave ndërkombëtare;⁴⁹⁷ drejtimi dhe bashkërendimi i punës së ministrive federale;⁴⁹⁸ thirrje për mobilizimin e përgjithshëm dhe organizimin e përgatitjeve të mbrojtjes;⁴⁹⁹ në rastin e pamundësisë së mbledhjes së Kuvendit Federal, shpallja e rrezikut të luftës së afërt, shpallja e luftës, e gjendjes së jashtëzakonshme varësisht prej qëndrimit të Presidentit të RFJ-së dhe Kryetarëve të Dhomave të Kuvendit Federal;⁵⁰⁰ dhe në të njëjtat rrethana, miratimi i masave në lidhje me çështje brenda juridiksionit të Kuvendit Federal.⁵⁰¹ Kryeministri i RFJ-së kishte kompetencë të emëronte dhe hiqte ministrat, ndër të cilët zëvendëskryeministrat, por për këtë nevojitej mbështetja në Kuvendin Federal.⁵⁰² Kushtetuta nuk përcaktonte numrin e zëvendëskryeministrave ose numrin e gjithsejtë të ministrave të qeverisë, por i ishte lënë kryeministrit të vendoste. Kjo vlente edhe për kompetencat e zëvendëskryeministrave dhe ministrave pa portofol.⁵⁰³ Sipas Radomir Llukiqit, në kushtetutën e RFJ-së, roli i Kryeministrit ishte absolutisht mbizotërues në lidhje me pozitën e ministrive të tjera saqë anëtarë të tjerë të qeverisë federale ishin pak a shumë këshilltarë pa kompetenca për vetëveprim dhe vendimmarrje.⁵⁰⁴

252. Ndër detyrat e Presidentit të RFJ-së ishin përfaqësimi i brendshëm dhe i jashtëm i RFJ-së;⁵⁰⁵ shpallja e ligjeve federale me dekret,⁵⁰⁶ dhe, pas marrjes së mendimit të zëdhënësve të grupeve parlamentare në Kuvendin Federal, propozimi i kandidatit për Kryeministër të RFJ-së.⁵⁰⁷ Në

⁴⁹³ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 78(3).

⁴⁹⁴ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 78(7).

⁴⁹⁵ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 100. *Shih edhe* 1D254 (Dekret për Krijimin e shërbimeve të Qeverisë Federale); 1D266 (Vendim mbi Emërimin e Kryetarit dhe Anëtarëve të Këshillit të Ligjeve të Qeverisë Federale).

⁴⁹⁶ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 99(1).

⁴⁹⁷ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 99(2); 1D246 (Ligji për Punët e Jashtme, 4 dhjetor 1998).

⁴⁹⁸ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 99(7).

⁴⁹⁹ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 99(9).

⁵⁰⁰ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 99(10).

⁵⁰¹ Momir Bullatović, T. 13900–13901 (17 gusht 2007); 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 102.

⁵⁰²

⁵⁰³ 2D393 (Aktekspertizë e Radomir Llukiqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 82–83.

⁵⁰⁴ 2D393 (Aktekspertizë e Radomir Llukiqit), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 84.

⁵⁰⁵ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 96(1); 1D223 (Rregullorja e Procedurës së Qeverisë Federale, 14 shtator 1994), nenet 3 dhe 16; 1D261 (Vendim për Ndryshimin e Rregullores së Procedurës së Qeverisë Federale, 5 qershor 1998).

⁵⁰⁶ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 96(2); IC132 (Ilustrim me Power Point në lidhje me ndryshimin midis një dekreti dhe një urdhërese).

⁵⁰⁷ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 96(3).

ndryshim nga Presidenti i Republikës së Serbisë, Presidenti i RFJ-së zgjidhej prej Kuvendit Federal, struktura e të cilit parashtrohet në paragrafin 250, dhe jo prej votës popullore për arsye se numri i zgjedhësve në Serbi ishte shumë i madh se në Mal të Zi.⁵⁰⁸

253. Sipas Radomir Llukiqit, sistemi kushtetues i RFJ-së kishte në themel llojin “kryeministor” të qeverisjes dhe siç përmendet më lart, roli kyç në kabinetin federal i akordohej Kryeministrit të RFJ-së.⁵⁰⁹ Ai deklaroi se Presidenti i Republikës Federale kishte pushtet dhe kompetenca “shumë të dobëta” në Kushtetutën e RFJ-së, përveç ushtrisë. Më vonë ai pranoi se mbante mend që kishte lexuar gazeta ku shkruhej se Slobodan Millosheviqi ishte individ i pushtetshëm në Jugosllavi gjatë mandatit të tij si President i RFJ-së, por refuzoi të shprehej në lidhje me aspektin nëse kjo thënie ishte përsëritje e saktë e realitetit ose si përputhej kjo thënie me shtjellimin teorik parashtruar prej tij.⁵¹⁰

254. Llukiqi gjithashtu dëshmoi se për shkak se republikat përbërëse të RFJ-së gëzonin sovranitet për të tëra aspektet që nuk trajtoheshin shprehimisht në Kushtetutën e RFJ-së, asnjë instancë qeveritare e RFJ-së, përfshirë edhe Presidentin e RFJ-së, nuk kishte pushtet sipas ligjit ndaj Ministrive të Brendshme të republikave.⁵¹¹ Kur u ballafaqua me shembujt ku Millosheviqi kishte urdhëruar përfshirjen e MPB-së serbe (republikane) në Kosovë, Llukiqi përsëriti se nuk ekzistonin dispozita kushtetuese që mundësonin këtë gjë.⁵¹²

3. Statusi kushtetues dhe statutor i UJ-së

255. Pjesa VIII e Kushtetutës së RFJ-së trajtonte Ushtrinë e RFJ-së (“*Vojska Jugosllavije/Ushtria Jugosllave*” ose “UJ”). Neni 135 përcaktonte se si në kohë lufte, po ashtu dhe në kohë paqeje, UJ-ja ishte nën komandën e Presidentit të RFJ-së, “në përputhje me vendimet” e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes (“KLM”). Po në të njëjtin nen parashtrohet se Këshilli i Lartë i Mbrojtjes përbëhej prej Presidentit të RFJ-së dhe Presidentëve të republikave anëtare dhe se Presidenti i RFJ-së ishte

⁵⁰⁸ Ratko Marković, T. 12977 (7 gusht 2007).

⁵⁰⁹ Radomir Llukiq, T. 26214–26217 (15 maj 2008).

⁵¹⁰ Radomir Llukiq, T. 26217–26218, 26258–26263 (15 maj 2008). Në përgjigje të pyetjeve nga Dhoma, Llukiqi shpjegoi se Millosheviqi si President i RFJ-së ishte në gjende të arrinte marrëveshje me Holbrooke-un mbi pakësimin e forcave të MPB-së serbe në Kosovë sepse si ai, po ashtu edhe Kryeministri dhe ministri i Punëve të Jashtme të RFJ-së, kishin kompetenca kushtetuese bazuar në paragrafin 1 të nenit 96 të Kushtetutës së RFJ-së për konkludimin e traktateve dhe marrëveshjeve me bashkësinë ndërkombëtare. Me fjalë të tjera, sipas Llukiqit, nuk ishte Presidenti i Serbisë, por Presidenti i RFJ-së ai që personifikonte kompetencën kontraktuese të RFJ-së. Radomir Llukiq, T. 26280 (15 maj 2008), T. 26293–26297 (16 maj 2008).

⁵¹¹ Radomir Llukiq, T. 26220–26221 (15 maj 2008).

⁵¹² Radomir Llukiq, T. 26339–26343 (16 maj 2008).

Kryetar i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes.⁵¹³ Më tej neni 136 i akordonte Presidentit të RFJ-së kompetencë për të emëruar, graduar ose pushuar nga detyra oficerë të UJ-së.⁵¹⁴

256. Më 18 maj 1994, pas miratimit prej Kuvendit Federal, Presidenti i atëhershëm i RFJ-së, Zoran Liliq, shpalli Ligjin Federal për Mbrojtjen.⁵¹⁵ Neni 8 i këtij ligji përcaktonte se në rast të rrezikut të luftës së afërt, të gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, Presidenti i RFJ-së vepron “në përputhje me vendimet e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, urdhëron masa gatishmërie, mobilizimin dhe përdorimin e UJ-së për parandalimin dhe eliminimin e rrezikut ndaj mbrojtjes dhe sigurisë së vendit.⁵¹⁶

257. Siç diskutohet në hollësi më poshtë në Ndarjen VI.A.1.d, neni 40 i Ligjit Federal për Mbrojtjen parashtronte kompetencat dhe përgjegjësisë e Presidentit të RFJ-së në fushën e mbrojtjes. Ai kishte kompetencë, “në përputhje me vendimet e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes”, të urdhëronte zbatimin e planit për mbrojtjen e vendit;⁵¹⁷ të komandonte UJ-në në kohë lufte dhe paqeje;⁵¹⁸ dhe të vendoste për ndarjen territoriale të vendit në zona ushtarake.⁵¹⁹ Nga ana tjetër Këshilli i Lartë i Mbrojtjes kishte kompetencë të miratonte planin për mbrojtjen e vendit;⁵²⁰ të nxirrte vendime në përputhje me të cilat Presidenti i RFJ-së komandon UJ-në;⁵²¹ të vlerësonte gjasën e luftës dhe të kërcënimeve të tjera ndaj mbrojtjes dhe sigurisë së vendit;⁵²² të përcaktonte nevojat për pajisje dhe armatimin për mbrojtjen e vendit;⁵²³ të vendoste në lidhje me organizimin e territorit për mbrojtjen e vendit;⁵²⁴ të përcaktonte strategjinë e konfliktit të armatosur dhe rregullat në përdorimin e forcës në mbrojtje të RFJ-së dhe mënyrën e luftimit;⁵²⁵ të miratonte elementët themelorë të programeve dhe planeve stërvitore për mbrojtjen e RFJ-së;⁵²⁶ dhe të kryente detyra të tjera të përcaktuara prej ligjit federal.⁵²⁷ Kryetari i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, me fjalë të tjera Presidenti i RFJ-s, ishte garantues i zbatimit të vendimeve të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes.⁵²⁸

⁵¹³ ID139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 135.

⁵¹⁴ ID139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 136.

⁵¹⁵ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen).

⁵¹⁶ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 8.

⁵¹⁷ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 40(1).

⁵¹⁸ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 40(2).

⁵¹⁹ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 40(3).

⁵²⁰ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41(1).

⁵²¹ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41(2).

⁵²² P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41(3).

⁵²³ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41(4).

⁵²⁴ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41(5).

⁵²⁵ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41(6).

⁵²⁶ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41(7).

⁵²⁷ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41(8).

⁵²⁸ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41.

258. Gjithashtu më 18 maj 1994, Liliqi shpalli Ligjin për UJ-në.⁵²⁹ Neni 4 i këtij ligji përcaktonte se Presidenti i RFJ-së duhet të komandojë UJ-në në luftë dhe në paqe, “në përputhje me vendimet e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes”, duke reflektuar kushtet e paragrafit 1 të nenit 40 të Ligjit Federal për Mbrojtjen.⁵³⁰ Ndër të tjera Presidenti i RFJ-së kishte për detyrë të vendoste në lidhje me dislokimin e UJ-së dhe miratimin e planit për përdorimin e saj;⁵³¹ të mbikëqyrte dhe urdhëronte gatishmërinë e UJ-së në rastet e rrezikut të një lufte të afërt, gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme;⁵³² të lëshonte urdhra për mobilizimin e ushtrisë,⁵³³ dhe të lëshonte rregulla dhe akte të tjera themelore në lidhje me dislokimin e UJ-së.⁵³⁴ Presidenti i RFJ-së kishte gjithashtu kompetencë për emërimin e gjeneralëve të UJ-së, t’u jepte grada nderi joshtetasve të cilët i kishin ofruar shërbime të veçanta UJ-së,⁵³⁵ kompetencë për dhënien e gradës së gjeneralit oficerëve të karrierës me propozimin e shefit të shtabit të përgjithshëm,⁵³⁶ dhe të vendoste për gradime të tjera si dhe pushimit prej detyrës.⁵³⁷

259. Radomir Llukiqi dëshmoi se qeveria e RFJ-së nuk kishte pushtet komandues ndaj UJ-së ose strukturës së saj të brendshme organizative, veç drejtimit të politikës së jashtme.⁵³⁸ Përsa i përket “kontrollit civil” ndaj UJ-së, ky aspekt mbikëqyrej prej Kuvendit Federal i cili miratonte legjisllacion në lidhje me UJ-në nëse ishte i nevojshëm.⁵³⁹

B. KOMPETENCAT E PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS SË SERBISË

260. Shkalla e kompetencave të Millutinoviçit si President i Republikës së Serbisë ka qenë pikë mjaft e debatueshme në këtë çështje. Pikëpamja e Prokurorisë është se Presidenti i Serbisë ishte i pushtetshëm, po të merren parasysh kompetencat që i akordoheshin prej Kushtetutës së Serbisë dhe Kushtetutës së RFJ-së, si dhe prej Ligjit për UJ-në, Ligjit për Mbrojtjen, Ligjit për Punët e Brendshme dhe Ligjit për Gradat e Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme.⁵⁴⁰ Mirëpo Prokuroria nuk paraqiti dëshmitarë në lidhje me kompetencat e akorduara Presidentit të Serbisë prej Kushtetutës Serbe, por i përqendroi provat e veta në rolin kushtetues dhe *de facto* të Millutinoviçit

⁵²⁹ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në).

⁵³⁰ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 4.

⁵³¹ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 4(3).

⁵³² P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 4(4).

⁵³³ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 4(5).

⁵³⁴ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 4(6).

⁵³⁵ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 28.

⁵³⁶ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 46.

⁵³⁷ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 151. *Shih edhe* nenin 208 ku Presidenti ka kompetencë të rivendosë gradën e një oficeri e hequr si masë disiplinore.

⁵³⁸ Radomir Llukiq, T. 26219 (15 maj 2008).

⁵³⁹ Radomir Llukiq, T. 26219 (15 maj 2008).

gjatë mbajtjes së funksionit prej tij. Ky aspekt trajtohet më poshtë në pjesën e aktgjykimit mbi rolin dhe përgjegjësitë e Millutinoviçit.

261. Nga ana e saj, Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se krahasuar me Presidentin e RFJ-së, pushteti dhe kompetencat akorduar Presidentit të Republikës së Serbisë ishin të kufizuara dhe kufizuese, veçanërisht përsa u përket marrëdhënieve midis Presidentit dhe qeverisë serbe si dhe midis Presidentit dhe Kuvendit Kombëtar.⁵⁴¹ Në shqyrtimin e hollësive konkrete të kompetencave të Presidentit në Kushtetutën serbe, Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se Presidenti i Serbisë nuk mund të zhvillojë marrëdhënie ndërkombëtare me shtete të tjera sepse kjo ishte kompetencë e organeve federale,⁵⁴² dhe veçanërisht se ai nuk kishte kompetencë të kërkonte raporte prej qeverisë ose MPB-së serbe.⁵⁴³ Mbrojtja e Millutinoviçit paraqiti gjithashtu si provë një intervistë të dhënë prej Zoran Gjingjiçit, në atë kohë një prej opozitarëve më të spikatur në Serbi, ku ai deklaroi se Presidenti i Serbisë kishte shumë pak kompetenca dhe se funksioni i tij ishte simbolik.⁵⁴⁴

262. Prokuroria nuk thirri dëshmitarë ekspertë për çështje kushtetuese. Mbrojtja e Millutinoviçit ftoi një ekspert të së drejtës kushtetuese, Ratko Markoviç, për shpjegimin e nuancave të shumë dispozitave kushtetuese. Markoviç i cili kishte marrë pjesë personalisht në hartimin e Kushtetutës serbe,⁵⁴⁵ dëshmoi gjerë e gjatë dhe ofroi mendimin e tij si ekspert në lidhje me kompetencat e Presidentit.⁵⁴⁶ Gjithsesi, duke marrë parasysh pjesëmarrjen e Markoviçit në krijimin e kushtetutës serbe, Dhoma gjykon se rëndësia që i duhet akorduar dëshmisë së tij si ekspert është disi e pakësuar. Nga njëra anë, duke qenë se Kushtetuta serbe ishte pjesërisht vepër e tij, mund të thuhet se Markoviç kishte njohuri të gjera për qëllimin e dispozitave të ndryshme kushtetuese të renditura. Nga ana tjetër, ai ofroi mendim në një çështje në të cilën kishte marrë pjesë personalisht, në ndryshim nga rrethanat kur ai nuk do të kishte patur rol dhe do të kishte qenë i pavarur prej çështjes. Gjithashtu Dhoma dëgjoi dëshmi për lidhjen e ngushtë të Markoviçit me regjimin në Serbi, ku ai kishte funksionin zëvendëskryeministër, dhe sugjerimin se ai kishte lidhje të ngushtë me Slobodan Millosheviçin.⁵⁴⁷ Këta faktorë të marrë së bashku çojnë në konkluzionin se Dhoma nuk ka aq besim në paanësinë e mendimeve të tij, sa do të kishte në rastin e një eksperti vërtet të

⁵⁴⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 562–568.

⁵⁴¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 20–24.

⁵⁴² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 25–26.

⁵⁴³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 28–38.

⁵⁴⁴ 1D635 (Intervistë e Zoran Gjingjiçit me Blic, 30 tetor 1997).

⁵⁴⁵ Ratko Markoviç, T. 13269–13275 (9 gusht 2007).

⁵⁴⁶ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë).

⁵⁴⁷ Për shembull, Wolfgang Petritsch, i cili pati kontakte me Markoviçin gjatë negociatave në Rambuje dhe Paris, e cilësoi Markoviçin si “puthador” të lindur. Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 3. Gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare, Markoviçi kategorikisht mohoi sugjerimin se Millosheviçi ndikoi punën e

pavarur. Rrjedhimisht siç dëshmohet më poshtë, Dhoma gjykon se Markoviçi është i besueshëm në disa pika, por jo në të tjera. Dhoma do të analizojë dëshminë e Markoviçit dhe do të saktësojë pjesët që konsideron jobindëse.

263. Markoviçi e filloi dhënien e dëshmisë me pohimin se Kushtetuta serbe kishte qëllim dhe domethënie të dyfishtë: synimi i saj ishte shmangia e zbrazëtisë kushtetuese në Serbi në rast të shpërbërjes së RSFJ-së, por gjithashtu edhe reformë e thellë e sistemit kushtetues, me përfshirjen e parimeve dhe institucioneve të reja.⁵⁴⁸ Me miratimin e Kushtetutës së RFJ-së, duhej bërë harmonizimi midis saj dhe Kushtetutës së Serbisë.⁵⁴⁹ Në lidhje me kompetencat e Presidentit, Markoviçi dëshmoi se edhe pse mandati i tij buronte prej zgjedhësve, kompetencat e tij ishin dukshëm më të pakta se ato të një kreu shteti në një sistem presidencial “tipik”, ku si rezultat i zgjedhjeve të drejtpërdrejta, kreu i shtetit përfaqëson organin e vetëm ekzekutiv të qeverisjes.⁵⁵⁰ Në fakt, kompetencat e Presidentit në Serbi përcaktoheshin vetëm prej neneve 83 - 85, 89 dhe 132(1) të Kushtetutës serbe dhe sipas Markoviçit, atij nuk mund t’i akordoheshin kompetenca shtesë me ligj.⁵⁵¹

264. Markoviçi dëshmoi se kompetencat e Presidentit mund të ndaheshin në tri kategori, përkatësisht në lidhje me: (a) Presidentin si përfaqësues i “shtetit të Serbisë”; (b) Presidentin si përfaqësues i “ekzekutivit të qëndrueshëm joveprues”; dhe (c) kompetenca të posaçme që i akordohen Presidentit në rrethana të pazakonta, në rast se ekziston bllokim midis pushtetit ligjvënës dhe atij ekzekutiv.⁵⁵² Mirëpo shumë prej këtyre kompetencave prekeshin prej nenit tejet të pazakontë të lartpërmendur të Kushtetutës serbe. Kjo dispozitë u shtua si kundërpeshë ndaj disa dispozitave të Kushtetutës serbe të cilat u akordonin organeve republikane kompetenca federale, me synim përgatitjen e Serbisë në rast të shpërbërjes së RSFJ-së. Ato quheshin “kompetenca të rezervuara”, që do të zbatoheshin në rast se Serbia do të bëhej shtet i pavarur.⁵⁵³

tij në komision për të paraqitur kompetencat e Presidentit mbi ushtrinë. Ratko Markoviç, T. 13310–13319 (10 gusht 2007).

⁵⁴⁸ Ratko Markoviç, T. 12877–12878 (6 gusht 2007).

⁵⁴⁹ Ratko Markoviç, T. 12879 (6 gusht 2007).

⁵⁵⁰ Ratko Markoviç, T. 13261–13264 (9 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.1.

⁵⁵¹ Ratko Markoviç, T. 12876–12877 (6 gusht 2007), T. 13268–13269 (9 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.2.

⁵⁵² Ratko Markoviç, T. 12887–12890, 12894–12909 (6 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.3; IC131 (Ilustrim me Power-Point i tri kategorive të kompetencave të Presidentit).

⁵⁵³ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.7–2.8, 2.30. Markoviçi pranoi se bazuar në Kushtetutën e RSFJ-së ky ishte veprim jokushtetues, mirëpo theksoi se Serbia duhej të përgatitej për shpërbërjen e RSFJ-së, T. 13304–13306 (10 gusht 2007).

265. Gjithashtu Markoviqi vuri në dukje se Republika e Serbisë nuk kishte ushtrinë e vet dhe se rrjedhimisht lidhja e Presidentit të Serbisë me UJ-në mund të përcaktohej vetëm nëpërmjet anëtarësisë së tij *ex officio* në KLD.⁵⁵⁴ Rrjedhimisht, paragrafi 5 i nenit 83 të Kushtetutës serbe ku përcaktohej se Presidenti serb “udhëhiqte forcat e armatosura”, nuk kishte kuptim në mungesë të forcave të armatosura serbe dhe ishte ilustrim i kompetencave të rezervuara.⁵⁵⁵ Mirëpo siç u theksua më lart, në ndryshim nga Ligji për Ministrinë, kjo dispozitë nuk u ndryshua asnjëherë për ta harmonizuar Kushtetutën serbe me Kushtetutën e RFJ-së.

266. E para nga tri kategoritë e kompetencave të përshkruara nga Markoviqi, përkatësisht përfaqësimi i Serbisë, përfshinte kompetencën e Presidentit në marrëdhëniet e jashtme,⁵⁵⁶ dhënien e faljeve,⁵⁵⁷ dhe dekorimet e shpërblimet sipas ligjit.⁵⁵⁸ Në lidhje me marrëdhëniet e jashtme, u përfshi paragrafi 4 i nenit 83 si bazë kushtetuese për marrjen e këtij roli prej Presidentit, në rast se Serbia bëhej shtet i pavarur. Duke qenë se kjo nuk ndodhi, praktikisht Presidenti serb nuk mundi të ushtronte kompetencën e tij në marrëdhëniet e jashtme.⁵⁵⁹ Mirëpo Dhoma thekson se kjo dispozitë mbeti në fuqi dhe i dha një farë legjitimiteti pranisë së Millutinoviçit në Rambuje dhe Paris në 1999, siç diskutohet më poshtë.⁵⁶⁰

267. Në lidhje me kategorinë e dytë të kompetencave të parashtruara më lart, Markoviqi shpjegoi se shprehja e tij “ekzekutiv joveprues” kishte të bënte me faktin se megjithëse afër krahut ekzekutiv të qeverisjes, Presidenti i Serbisë nuk gëzonte kompetenca ekzekutive operative.⁵⁶¹ Presidenti mund (a) t’i propozonte Kuvendit Kombëtar një kandidat për Kryeministër pas marrjes së mendimit prej shumicës së Kuvendit;⁵⁶² (b) t’i propozonte Kuvendit Kombëtar kandidatë për kryetar dhe

⁵⁵⁴ Ratko Markoviq, T. 13002–13003 (7 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë) para. 3.44.

⁵⁵⁵ Ratko Markoviq, T. 12902, 12905–12906, 12931–12932, 12935–12939 (6 gusht 2007); 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), nenet 99(9) dhe 135. *Shih edhe* Radomir Llukiq, T. 26324–26325 (16 maj 2008).

⁵⁵⁶ Ratko Markoviq, T. 12940–12944 (6 gusht 2007); P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(4).

⁵⁵⁷ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(9).

⁵⁵⁸ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(10); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.4. Markoviqi shpjegoi se asnjëherë nuk u miratua një ligj i tillë, T. 12907 (6 gusht 2007).

⁵⁵⁹ Markoviqi, T. 12900, 12909–12913 (6 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.5–2.6, 2.8; 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 96(1).

⁵⁶⁰ *Shih* Kapitulli V dhe Pjesa 5 e Kapitullit VIII.

⁵⁶¹ Ratko Markoviq, T. 12889 (6 gusht 2007).

⁵⁶² P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(1).

gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese;⁵⁶³ (c) të dekretonte ligje;⁵⁶⁴ dhe (d) të parashtronte propozime për ndryshimin e Kushtetutës.⁵⁶⁵

268. Në lidhje me tri kompetencat e para, sipas Markoviqit Presidenti nuk kishte asnjë lloj autonomie. Për shembull në lidhje me propozimin e kandidatëve për funksione të ndryshme, ai ishte i kushtëzuar prej mendimit të shumicës së Kuvendit Kombëtar, duke qenë se vendimi përfundimtar i emërimit merrej prej Kuvendit Kombëtar.⁵⁶⁶ Markoviqi pranoi se në qoftë se shumica e Kuvendit Kombëtar përfaqësonte të njëjtën parti si Presidenti dhe kandidati i tij për funksionin e Kryeministrit, emërimi i kandidatit ishte thuajse i sigurt. Gjithsesi në vijim ai shpjegoi se që prej vitit 1992 në Kuvendin Kombëtar nuk kishte patur një shumicë partiake homogjene.⁵⁶⁷

269. Në lidhje me kompetencën e dekretimit të ligjeve, Markoviqi dëshmoi se Presidenti ishte i detyruar të dekretonte ligjet e miratuara prej Kuvendit Kombëtar. Megjithëse ai mund të ushtronte të drejtën e vetos pezulluese duke ia kthyer ligjin Kuvendit Kombëtar për një raund të dytë votimi, kjo duhej bërë gjatë periudhës shtatëditore pas miratimit të ligjit. Pasoja e vetme reale ishte se Kuvendi do të votonte dy herë për ligjin. Votimi i dytë duhej kryer pa diskutime të mëtejshme dhe miratohej në rast se arrihej e njëjta shumicë si në miratimin e parë. Në rast rimiratimi të ligjit, Presidenti ishte i detyruar ta dekretonte ligjin. Për të gjitha këto arsye, kjo ishte një nga format më të dobëta të mundshme të pjesëmarrjes së Presidentit në procesin ligjvënës.⁵⁶⁸ Gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare, kur Markoviqi u pyet nëse vendimi i Presidentit për pezullimin e një ligji mund të kishte faktikisht ndikim të konsiderueshëm, veçanërisht në rrethanat e parashpalljes së gjendjes së luftës, Markoviqi u përgjigj se në këto rrethana, ligji do të pezullohej deri në sesionin e ardhshëm të Kuvendit Kombëtar, pavarësisht sa mund të zgjaste pezullimi.⁵⁶⁹ Dhoma mendon se ushtrimi i kësaj kompetence mund të kishte ndikim të konsiderueshëm në rast të gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme. Gjithsesi Dhoma nuk dëgjoi asnjë dëshmi për ushtrimin e vetos pezulluese prej Millutinoviqit para luftës në RFJ.

⁵⁶³ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(2).

⁵⁶⁴ Ratko Markoviq, T. 12940–12944 (6 gusht 2007); P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(3).

⁵⁶⁵ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 132(1); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.16.

⁵⁶⁶ Ratko Markoviq, T. 12898–12899, 12932–12934 (6 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.17–2.20, 3.14–3.17.

⁵⁶⁷ Ratko Markoviq, T. 12890–12891 (6 gusht 2007).

⁵⁶⁸ Ratko Markoviq, T. 12899–12900, 12953–12955 (6 gusht 2007), T. 12984 (7 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.21–2.22, 3.1–3.9.

⁵⁶⁹ Ratko Markoviq, T. 13339–13341 (10 gusht 2007).

270. Së fundi, Presidenti kishte kompetencë të propozonte ndryshim të Kushtetutës, dhe rrjedhimisht kishte kompetencën e “nismës kushtetuese” siç e quajti Markoviqi. Mirëpo vendimi përfundimtar për ndryshimin i takonte Kuvendit Kombëtar.⁵⁷⁰

271. Sa për kategorinë e tretë të kompetencave, sipas Markoviqit, kompetencat që Presidenti kishte në rast nevojë ishin si vijon: udhëheqja e forcave të armatosura në kohë lufte dhe paqeje, si dhe organizimi, mobilizimi dhe përgatitjet për mbrojtje;⁵⁷¹ shpallja e rrezikut të luftës së afërt, e gjendjes së luftës, në qoftë se Kuvendi Kombëtar e kishte të pamundur të mblidhej dhe pas marrjes së mendimit prej kryeministrit;⁵⁷² nxjerrja prej tij e akteve ligjore me nismën e tij ose me propozim të qeverisë në lidhje me kompetencën e Kuvendit Kombëtar, të cilat më tej ai duhej t’i paraqiste sa më parë për ratifikim kur Kuvendi do të mund të mblidhej,⁵⁷³ dhe me propozim të qeverisë shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme dhe nxjerrja e akteve për marrjen e masave të diktuar prej rrethanave në rast kërcënimi ndaj sigurisë së Republikës së Serbisë.⁵⁷⁴ Për më tepër Markoviqi dëshmoi se thujse të tëra kompetencat që Presidenti gëzonte në rrethana të pazakonta, bënë pjesë në kategorinë e kompetencave të rezervuara, që përdorshin vetëm në qoftë se Republika e Serbisë bëhej shtet i pavarur.⁵⁷⁵ Përrjashtimi i vetëm ishte kompetenca e nxjerrjes së akteve ligjore në lidhje me kompetencën e Kuvendit Kombëtar serb.⁵⁷⁶ Mirëpo edhe kjo mund të cilësohej kompetencë e rezervuar në lidhje me kushtin se Presidenti nuk do të mund të lëshonte dekrete në rast se dhe deri kur organet federale të mos kishin shpallur një prej tri gjendjeve të jashtëzakonshme dhe gjithashtu, nuk mund të lëshonte akte në lidhje me çështje të juridiksionit të RFJ-së.⁵⁷⁷

272. Në lidhje me kompetencën e lëshimit të dekretëve, Markoviqi shpjegoi se pas shpalljes së gjendjes së luftës prej qeverisë së RFJ-së, më 24 mars 1999, Presidenti i Republikës së Serbisë

⁵⁷⁰ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.23–2.24; P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 132.

⁵⁷¹ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(5). Mirëpo vlen të theksohet se pavarësisht mendimit të Markoviqit se kompetenca e Presidentit për udhëheqjen e forcave të armatosura ekzistonte vetëm në rast nevojë, kur cenohej ndarja e kompetencave midis organeve ligjvënëse dhe ekzekutive)—neni 83(5) nuk përmbante kufizime të tilla të përcaktuara dhe madje përcaktonte se Presidenti i udhëhiqte forcat e armatosura si në kohë paqeje po ashtu edhe në kohë lufte.

⁵⁷² P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(6).

⁵⁷³ Ratko Markoviq, T. 12951–12952 (6 gusht 2007); P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(7).

⁵⁷⁴ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 83(8).

⁵⁷⁵ Kompetencat e Presidentit të Serbisë të renditura në paragrafët 6 dhe 8 të nenit 83 i ishin besuar Kuvendit dhe Qeverisë Federale dhe rrjedhimisht ishin kompetencat e tij rezervë; *shih* Ratko Markoviq, T. 12900, 12919–12921 (6 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.33–2.34; 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), nenet 78(13), 99(10) dhe (11). *Shih edhe* P1664 (Vendimi për shpalljen e rrezikut të luftës së afërt, 23 mars 1999); P1311 (Vendimi për përfundimin e gjendjes së luftës, 25 qershor 1999).

⁵⁷⁶ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.25–2.28.

⁵⁷⁷ Ratko Markoviq, T. 12902–12905, 12922–12923 (6 gusht 2007).

lëshoi 16 të tilla.⁵⁷⁸ Pas mbarimit të gjendjes së luftës, ato iu paraqitën Kuvendit Kombëtar për ratifikim dhe më pas u shpallën të pavlefshme për shkak se u gjykuan të panevojshme në kohë paqeje.⁵⁷⁹ Për më tepër të 16 aktet u propozuan prej qeverisë dhe nuk ishin nisma të Presidentit.⁵⁸⁰ Rrjedhimisht Markoviç konkludoi se bazuar në nenin 135 të Kushtetutës serbe, gjatë ekzistencës së shtetit federal, “të tëra kompetencat e lartpërmendura kushtetuese të Presidentit të Republikës u ushtruan prej organit federal përkatës”. Ai konkludoi se konkretisht në mars 1999 ishin organet federale përkatëse ato që ushtruan komandë mbi UJ-në, dhe jo Presidenti serb.⁵⁸¹

⁵⁷⁸ 16 dekretet janë: P993 (Dekreti për Punët e Brendshme Gjatë Gjendjes së Luftës, 31 mars 1999; Dekret mbi Grumbullimin e Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës, 1 prill 1999; Dekreti mbi Vendbanimin e Përherëshëm dhe Vendbanimin Aktual të Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës, 1 prill 1999; Dekreti mbi Letërnjoftimet Gjatë Gjendjes së Luftës, 31 mars 1999); 1D158 (Dekreti mbi Përlllogaritjen, Pagesën dhe Kontrollin e Të Ardhurave Publike Gjatë Gjendjes së Luftës, 19 prill 1999); 1D161 (Dekret mbi Buxhetin e Shpenzimeve Publike të Republikës së Serbisë për prillin, majin dhe qershorin 1999 dhe Masa për Mostejkalimin e Buxhetit Gjatë Gjendjes së Luftës, 20 prill 1999); 1D163 (Dekret mbi Fondet e Solidaritetit për Punonjësit Përkohësisht Pa Punë Për Shkak të Veprimeve Luftarake, 23 prill 1999); 1D166 (Dekret mbi Punësimin dhe Kompensimin Paguar Punonjësve të Firmave, Objektet, Mjetet e Prodhimit dhe Pajisjet e të Cilave u Shkatërruan në Operacionet Luftarake, 23 prill 1999); 1D169 (Dekret mbi Pagesat e Kontributeve Bazuar në Sigurimin e Detyrueshëm Social për Punonjësit e Ndërmarrjeve të Caktuara, 15 maj 1999); 1D172 (Dekret mbi Tregtinë në Mallra, Shërbime dhe Inspektimin Gjatë Gjendjes së Luftës, 21 maj 1999); 1D175 (Dekret mbi Buxhetin Vjetor për vitin 1998 të Republikës së Serbisë, 21 maj 1999); 1D178 (Dekret mbi Raportin Përfundimtar të Buxhetit të Krahinës Autonome të Kosovës për 1998, 26 maj 1999); 1D181 (Dekret mbi Kushtet e Veçanta për Organizimin e Lojërave të Fatit Gjatë Gjendjes së Luftës, 29 maj 1999); 1D187 (Dekret mbi Amendamentet e Dekretit mbi Livrimin e Fondeve të Solidaritetit për Punonjësit Përkohësisht pa Punë Për Shkak të Veprimeve Luftarake, 9 qershor 1999); 1D189 (Dekret mbi Përbërjen e Qeverisë, 15 qershor 1999); dhe 1D478 (Dekret për Ndryshimin e Dekretit mbi Përlllogaritjen, Pagesën dhe Kontrollin e Të Ardhurave Publike Gjatë Gjendjes së Luftës, 4 qershor 1999).

⁵⁷⁹ Ratko Markoviç, T. 12925–12931 (6 gusht 2007), T. 13243–13261 (9 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.29; 1D190 (Letër e të Akuzuarit Millutinoviç drejtuar Kuvendit Kombëtar në lidhje me verifikimin e Dekreteve të nënshkruara gjatë gjendjes së luftës, 25 qershor 1999); 1D192 (Ligj që konfirmon dekretet e nxjerra nga Presidenti i Republikës gjatë gjendjes së luftës).

⁵⁸⁰ Ratko Markoviç, T. 13291–13295 (10 gusht 2007); P1862 (Ligj mbi Qeverinë), neni 18. Mbrojtja paraqiti 15 prej 16 projekt-dekreteve të cilat iu dërguan Presidentit të Republikës për miratim, shih 1D144 (Projekt-tekst i një Dekreti mbi Letërnjoftimet Gjatë Gjendjes së Luftës, 6 prill 1999); 1D147 (Projekt-tekst i një Dekreti mbi Grumbullimin e Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës, 6 prill 1999); 1D150 (Projekt-tekst i një Dekreti mbi Vendbanimin e Përherëshëm dhe Vendbanimin Aktual të Qytetarëve Gjatë Gjendjes së Luftës, 6 prill 1999); 1D153 (Projekt-tekst i një Dekreti mbi Punët e Brendshme Gjatë Gjendjes së Luftës, 6 prill 1999); 1D156 (Projekt-tekst i një Dekreti mbi Përlllogaritjen, Pagesën dhe Kontrollin e Të Ardhurave Publike Gjatë Gjendjes së Luftës, 14 prill 1999); 1D159 (Projekt-Dekret mbi Buxhetin e Shpenzimeve Publike të Republikës së Serbisë për prillin, majin dhe qershorin 1999 dhe Masat për Mostejkalimin e Buxhetit Gjatë Gjendjes së Luftës, 20 prill 1999); 1D162 (Projekt-Dekret mbi Fondet e Solidaritetit për Punonjësit Përkohësisht Pa Punë për Shkak të Veprimeve Luftarake, 23 prill 1999); 1D164 (Projekt-Dekret mbi Punësimin dhe Kompensimin Paguar Punonjësve të Firmave, Objektet, Mjetet e Prodhimit dhe Pajisjet e të Cilave u Shkatërruan në Operacionet Luftarake, 23 prill 1999); 1D167 (Projekt-Dekret mbi Pagesat e Kontributeve Bazuar në Sigurimin e Detyrueshëm Social për Punonjësit e Ndërmarrjeve të Caktuara, 15 maj 1999); 1D173 (Projekt-Dekret mbi Buxhetin Vjetor për vitin 1998 të Republikës së Serbisë, 25 maj 1999); 1D176 (Projekt-Dekret mbi Raportin Përfundimtar të Buxhetit të Krahinës Autonome të Kosovës për 1998, 25 maj 1999); 1D179 (Tekst i një Dekreti mbi Kushtet e Veçanta për Organizimin e Lojërave të Fatit Gjatë Gjendjes së Luftës, 29 maj 1999); 1D182 (Dekret për Ndryshimin e Dekretit mbi Përlllogaritjen, Pagesën dhe Kontrollin e Të Ardhurave Publike Gjatë Gjendjes së Luftës, 4 qershor 1999); 1D185 (Projekt-Dekret mbi Amendamentet për Dekretin e Livrimit të Fondeve të Solidaritetit për Punonjësit Përkohësisht Pa Punë për Shkak të Veprimeve Luftarake, 9 qershor 1999); 1D479 (Projekt-Dekret mbi Tregtinë në Mallra, Shërbime dhe Inspektimin Gjatë Gjendjes së Luftës, 21 maj 1999).

⁵⁸¹ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.30.

273. Kur u pyet nëse kompetenca e lëshimit të dekretëve prej Presidentit nënkuptonte faktin se Presidenti ishte “ekzekutiv veprues” në rrethana të pazakonta, Markoviqi pranoi se gjatë gjendjes së luftës, Presidenti bashkë me kabinetin vepronin në vend të Kuvendit Kombëtar, por përsëriti se dekretet e tyre duhej të ratifikoheshin me kthimin në normalitet.⁵⁸² Ai nuk u pajtua me sugjerimin se në rrethana të pazakonta Presidenti mund të refuzonte të nxirrte dekrete të propozuara prej qeverisë dhe deklaroi se në të vërtetë ishte qeveria ajo që zëvendësonte Kuvendin Kombëtar, dhe se Presidenti thjesht jepte pëlqimin si në kohë paqeje.⁵⁸³

274. Neni 89 i Kushtetutës të cilin Markoviqi nuk e përfshiu në ndonjë prej tri kategorive të kompetencave të Republikës së Serbisë trajtonte marrëdhënien e Presidentit me Kuvendin Kombëtar. Aty parashtrohej se Presidenti kishte kompetencë të shpërndante Kuvendin Kombëtar pas marrjes së një propozimi formal dhe të arsyetuar prej qeverisë.⁵⁸⁴ Sipas Markoviqit procesi i shpërndarjes bëhej me nismën e qeverisë, megjithëse Presidenti duhej të jepte miratimin para shpërndarjes dhe gëzonte të drejtën e refuzimit.⁵⁸⁵

275. Neni 85 i Kushtetutës trajtonte lidhjen midis Presidentit dhe qeverisë serbe. Aty përcaktohej se Presidenti mund t’i kërkonte qeverisë “të shprehte qëndrimin e saj në lidhje me çështje të juridiksionit të saj”.⁵⁸⁶ Sipas Markoviqit, kjo ishte kompetenca e vetme e pavarur kushtetuese që Presidenti kishte në lidhje me qeverinë. Mirëpo Presidenti nuk mund ta urdhëronte qeverinë të vepronte në lidhje me këto çështje dhe nuk mund të ndikonte që qeveria të hiqte dorë ose ndryshonte qëndrimin.⁵⁸⁷ Rrjedhimisht Markoviqi kishte pikëpamjen se Kushtetuta e kishte eliminuar plotësisht lidhjen e Presidentit me administratën shtetërore.⁵⁸⁸

⁵⁸² Ratko Markoviq, T. 13288–13289 (10 gusht 2007).

⁵⁸³ Ratko Markoviq, T. 13289–13291, 13295–13296 (10 gusht 2007), T. 13628–13629 (15 gusht 2007). Gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare, Markoviqi u pyet nëse Kuvendi Kombëtar mund të refuzonte ratifikimin e dekretëve të nxjerra nga Presidenti, dhe në një rast të tillë çfarë pasojash do të kishte. Ai u përgjigj se kjo ishte e mundur, duke qenë se këto çështje përfshihen në kompetencat e Kuvendit Kombëtar. Në një rast të tillë, i përkiste deputetëve të vendosnin çfarë të bënin dhe të hetonin se kush kishte bërë gabim. Në lidhje me pasojat praktike mbi statusin e dekretit në fjalë dhe gjërave të kryera bazuar në të, Markoviqi deklaroi se Kuvendi Kombëtar mund të konkludonte se ligji nuk ishte më në fuqi dhe, në qoftë se kishte mendimin se ishte jokushtetues, i drejtohej Gjykatës Kushtetuese për ta përcaktuar. Kjo do të kishte ndikim mbi përdorimin e ardhshëm të dekretit dhe jo të kaluarën. Ratko Markoviq, T. 13302–13304 (10 gusht 2007).

⁵⁸⁴ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 89.

⁵⁸⁵ Ratko Markoviq, T. 12973–12974, 12983–12984 (7 gusht 2007), T. 13334–13336 (10 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.11–3.13.

⁵⁸⁶ P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), neni 85; P1862 (Ligji mbi Qeverinë), neni 19.

⁵⁸⁷ Ratko Markoviq, T. 12956–12957 (6 gusht 2007), T. 13327–13329 (10 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.18–3.19; P1862 (Ligji mbi Qeverinë e Serbisë), neni 19.

⁵⁸⁸ Ratko Markoviq, T. 12984–12990 (7 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.20–3.21; P1823 (Ligji mbi Administratën Shtetërore).

276. Kur u pyet nga Dhoma mbi synimin e nenit 85, Markoviçi shpjegoi se ky synim kishte të bënte me nevojën e Presidentit për t'u informuar për punën e qeverisë dhe ishte gjithashtu instrument të cilin Presidenti mund ta përdorte si mjet presioni ndaj qeverisë për të tërhequr vëmendjen e publikut për çështje të ndryshme.⁵⁸⁹ Markoviçi pranoi se në qoftë se Presidenti gëzonte popullaritet në periudhën përkatëse dhe për shkak të legjitimitetit të tij të madh demokratik, ai mund të mobilizonte median dhe opinionin publik dhe efektivisht mund të sillte në jetë ndryshime në politikën e qeverisë. Mirëpo ai mendonte se një ndryshim i tillë politik do të ndodhte vetëm në qoftë se Presidenti ishte edhe udhëheqës i një partie të rëndësishme politike.⁵⁹⁰ Prej dëshmisë së Markoviçit del qartë se Presidenti i tillë ishte Slobodan Millosheviçi duke qenë se kompetencat dhe statusi kushtetues i Presidentit serb ishin çështjet më të debatueshme më 1990, sepse në atë kohë kishte të ngjarë që funksioni t'i besohej Slobodan Millosheviçit, politikan karizmatik dhe popullor “pushteti real i të cilit ... nuk bazohej në Kushtetutë”. Sipas Markoviçit vetëm pasi Millosheviçi nuk ishte më në atë funksion, u kuptuan si duhej statusi i Kushtetutës serbe dhe mungesa e peshës së kompetencave të akorduara Presidentit serb.⁵⁹¹

277. Markoviçi gjithashtu deklaroi se kompetenca “e dobët” e nenit 85 të Kushtetutës me pasojë mungesën e lidhjes kushtetuese midis Presidentit të Serbisë dhe administratës shtetërore, përkthehej në faktin se kjo lidhje administrohej prej ligjeve të ndryshme. Në këtë kontekst Markoviçi përmendi MPB-në, ku lidhja midis saj dhe Presidentit trajtohej prej Ligjit mbi Punët e Brendshme dhe Ligjit mbi Gradat e Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme.⁵⁹² Në Ligjin mbi Punët e Brendshme Presidenti i Republikës përmendej në dy prej 74 neneve. Neni 9 përcaktonte:

Me kërkesë të Kuvendit Kombëtar dhe Presidentit të Republikës, Ministri duhet të paraqesë një raport për punën e Ministrisë së Brendshme dhe gjendjen e sigurisë në Republikë.

Markoviçi e gjykoj këtë kompetencë pa vlerë vetëm në lidhje me Presidentin sepse në ndryshim nga Kuvendi Kombëtar, ai nuk kishte mandat për të vënë para përgjegjësisë ndonjë anëtar të qeverisë, përfshirë edhe ministrin e Brendshëm. Gjithashtu përdorimi i lidhëses “dhe” në nen nënkuptonte se kërkesa duhej të ishte e përbashkët dhe e njëkohshme prej Presidentit dhe Kuvendit

⁵⁸⁹ Ratko Markoviçi, T. 12985–12988 (7 gusht 2007).

⁵⁹⁰ Ratko Markoviçi, T. 13328–13334, 13336–13338 (10 gusht 2007). *Shih edhe* Radomir Llukiçi, T. 26327–26328 (16 maj 2008).

⁵⁹¹ Ratko Markoviçi, T. 13266–13267 (9 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para 1.1, 4.9–4.17.

⁵⁹² 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para 3.22.

Kombëtar.⁵⁹³ Po ashtu ai shpjegoi se kjo kompetencë nuk ishte e nevojshme duke qenë se neni 85 i akordonte Presidentit kompetencën e mbikëqyrjes së qeverisë. Ai nuk shpjegoi arsyen e miratimit të Nenit 9.⁵⁹⁴

278. Siç u theksua më herët, Presidenti përmendej edhe në nenin 17 të Ligjit për Punët e Brendshme ku përcaktohej se në rast gjendjeje të jashtëzakonshme në pjesë të territorit të Republikës së Serbisë, MPB-ja duhej të merrte masa për garantimin e sigurisë, përcaktuar prej urdhrave dhe dokumenteve të tjera lëshuar prej Presidentit, me synim heqjen e gjendjes së jashtëzakonshme.⁵⁹⁵ Markoviqi shpjegoi se kjo dispozitë nuk i akordonte kompetenca shtesë Presidentit, por thjesht i referohej nenit 83 të Kushtetutës serbe.⁵⁹⁶

279. Në lidhje me Ligjin mbi Gradat e Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme, Presidenti mund të dekretonte gradimin si gjeneral ose më lart, të një zyrtari të autorizuar që mbante gradën kolonel ose më lart.⁵⁹⁷ Sipas Markoviqit, ky ishte vetëm formalitet duke qenë se kandidatët përkatës duhej të plotësonin kushtet e neneve 7 dhe 8.⁵⁹⁸ Bazuar në nenin 10 të të njëjtit ligj, Presidenti gjithashtu, me sugjerimin e ministrit të Brendshëm, mund të miratonte gradimin e shpejtuar si gjeneral të një oficeri me gradë të lartë. Kjo nuk mund të bëhej pavarësisht, pa rekomandimin e ministrit të Brendshëm.⁵⁹⁹ Së fundi, Presidenti përsëri me rekomandim të ministrit të Brendshëm, mund të zbuste ose shfuqizonte masa disiplinore që blloktonin gradimin e personave që kishin momentin për t'u graduar.⁶⁰⁰ Individëve të graduar gjeneral nuk iu kërkohej t'i raportonin Presidentit, por përgjigjeshin vetëm para ministrit të Brendshëm ose qeverisë.⁶⁰¹

⁵⁹³ Ratko Markoviq, T. 12991–12992 (7 gusht 2007), T. 13345–13347 (10 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.23–3.28; P1737 (Ligj mbi Punët e Brendshme), neni 9.

⁵⁹⁴ Ratko Markoviq, T. 13350–13352 (10 gusht 2007). Gjithashtu, Markoviqi mendonte se neni 9 ishte jokushtetues duke qenë se u akordonte kompetenca Presidentit dhe Kuvendit Kombëtar të cilat nuk ishin të shprehura në Kushtetutë. Ratko Markoviq, T. 13345–13350 (10 gusht 2007). Mirëpo Radomir Llukiqi nuk u pajtua me qëndrimin e Markoviqit dhe dëshmoi se nuk kishte asgjë jokushtetuese në kërkesën për bashkëpunim prej organeve republikane. Radomir Llukiqi, T. 26335–26337, 26345 (16 maj 2008).

⁵⁹⁵ P1737 (Ligj mbi Punët e Brendshme), neni 17.

⁵⁹⁶ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.29–3.30.

⁵⁹⁷ P1015 (Ligj mbi Gradat e Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme), neni 6(1).

⁵⁹⁸ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.32–3.33.

⁵⁹⁹ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.34–3.35.

⁶⁰⁰ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.36; P1015 (Ligj mbi Gradat e Anëtarëve të Ministrisë së Brendshme), neni 13.

⁶⁰¹ Ratko Markoviq T. 12996–12998 (7 gusht); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviqit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 3.40. Ky ligj më vonë u anulua duke qenë se i zgjeronte kompetencat e Presidentit të Serbisë në mënyrë jokushtetuese. Ratko Markoviq, T. 12942–12948 (6 gusht 2007), T. 12965–12967 (7 gusht 2007); 1D639 (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, 1 korrik 2003).

280. Gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare, Markoviçit iu kërkua nëse fraza gjithëpërfshirëse në paragrafin 12 të nenit 83 të Kushtetutës serbe, ku përcaktohej se Presidenti “1 ... merret me çështje të tjera në përputhje me Kushtetutën”, linte të kuptohej se ai mund të bënte çdo gjë, mjafton që të përputhej me Kushtetutën serbe. Ai u përgjigj se kjo frazë ishte thjesht shprehje e kompetencave të përmendura gjetiu në Kushtetutë, përkatësisht kompetencat e neneve 84, 85, 89, dhe 132 (1). Ai qartësoi se Presidenti mbante përgjegjësi vetëm në qoftë se shkelte Kushtetutën dhe kryerja e një shkeljeje të tillë përcaktohej vetëm prej Kuvendit Kombëtar në qoftë se kompetencat përmendeshin shprehimisht në Kushtetutë.⁶⁰² Në 2003, Gjykata Kushtetuese e Serbisë vendosi në lidhje me këtë çështje duke konkluduar se kompetencat e Presidentit buronin vetëm prej Kushtetutës dhe nuk mund të zgjeroheshin nëpërmjet legjislacionit. Sipas Gjykatës, paragrafi 12 i nenit 83 thjesht u referohej dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe jo paragrafëve 1-11 të nenit 83.⁶⁰³

281. Përsa i përket heqjes së Presidentit nga posti, Markoviçi dëshmoi se kjo mund të bëhej me dëshirën e Presidentit ose të zgjedhësve. Lidhur me opsionin e dytë, ishte e domosdoshme që një shumicë prej dy të tretash të Kuvendit të përcaktonte se Presidenti kishte shkelur Kushtetutën serbe dhe vetëm në këtë rast heqja do t'i nënshtrohej votës popullore. U argumentua se në këtë mënyrë Presidenti ishte përgjegjës para qytetarëve të Republikës së Serbisë.⁶⁰⁴

282. Bazuar në gjithë sa më sipër, Markoviçi konkludoi se Presidenti i Republikës së Serbisë kishte pozitë të dobët, meqenëse nuk i ishin besuar kompetenca vendimmarrëse, pavarësisht faktit se ai ishte institucion përfaqësues ligjërishit i barabartë me Kuvendin Kombëtar. Rrjedhimisht, ai nuk ushtronte pushtet ligjvënës, ekzekutiv apo gjyqësor, por thjesht përfaqësonte Republikën e Serbisë dhe personifikonte unitetin shtetëror sanksionuar në nenin 9 të Kushtetutës serbe.⁶⁰⁵

283. Sipas mendimit të Markoviçit, arsyeja e funksionimit të sistemit në këtë mënyrë diktohej prej nevojave historike dhe jo logjikës. Meqenëse Kushtetuta serbe, pas dhjetëvjeçarëve të sistemit njëpartiak, sanksionoi sistemin shumëpartiak, u mendua se sistemi i ri shumëpartiak i demokracisë parlamentare nuk do të funksiononte pa kriza dhe ndërprerje. Gjithashtu Kushtetuta serbe u hartua në një kohë kur RSFJ-ja po përjetonte një krizë të rëndë politike. Rrjedhimisht ishte jetike qenia e një Presidenti që gëzonte një nivel të lartë legjitimiteti demokratik, por gjithsesi në pamundësi për të vepruar si autokrat. Ai ishte thjesht personifikim i unitetit shtetëror dhe për rrjedhojë garantues i

⁶⁰² Ratko Markoviç, T. 13268–13269, 13275–13277 (9 gusht 2007). *Shih edhe* Radomir Llukiq, T. 26328–26330 (16 maj 2008).

⁶⁰³ 1D639 (Vendim i Gjykatës Kushtetuese të Serbisë, 1 korrik 2003), f. 2.

⁶⁰⁴ Ratko Markoviç, T. 12967–12973 (7 gusht 2007); P855 (Kushtetuta e Republikës së Serbisë, 1990), nenet 87 dhe 88.

⁶⁰⁵ Ratko Markoviç, T. 12979–12980 (7 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 2.38.

stabilitetit.⁶⁰⁶ Brenda e funksionit të tij thuhet se përmbledhet në betimin e tij i cili nuk përfaqësonte normë ligjore e rrjedhimisht prej së cilës nuk buronin ndëshkime ligjore, por morale dhe politike.⁶⁰⁷

284. Dhoma pranon se një numër kompetencash të Presidentit në Kushtetutën serbe ishin në fakt kompetenca rezervë ose kompetenca që do të përdreshin në rast se Serbia bëhej shtet i pavarur. Mirëpo Dhoma ka gjithashtu mendimin se në kushtetutën serbe ekzistonin dispozita që mund të ishin përdorur prej një Presidenti karizmatik dhe me mbështetje popullore për të ndikuar ndaj ministrive dhe politikave të qeverisë. Për shembull, kompetenca e nenit 5 siç u pranua edhe prej Markoviçit, në fund të fundit kushtëzohej prej mbështetjes politike dhe popullore që gëzonte Presidenti dhe rrjedhimisht me gjasë mund të arrinte në nivel të konsiderueshëm. Faktikisht, Slobodan Millosheviç, i cili ishte President i Serbisë deri në vitin 1997, udhëheqës i një partie kryesore politike në Serbi gjatë presidencës së tij dhe konsiderohej individ shumë karizmatik, arriti të ushtronte mjaft ndikim në organe dhe institucione republikane, madje edhe federale.⁶⁰⁸

285. Në lidhje me ndikimin e Presidentit ndaj personelit të Ministrisë së Brendshme, Dhoma pranon se Presidenti mund të gradonte oficerë të lartë policorë vetëm me rekomandimin e ministrit të Brendshëm. Mirëpo duke u bazuar sërish në pandehmën se në rast se Presidenti do të ishte i pëlqyeshëm dhe me ndikim politik, ai do të kishte ndikuar nëpërmjet postit të tij emërimet e larta në Ministri. Në lidhje me nenin 9 të Ligjit mbi Punët e Brendshme, Dhoma pranon dëshminë e Markoviçit dhe ka mendimin se fraza hapëse e atij neni dikton që kërkesa të jetë e përbashkët dhe e njëkohshme prej Kuvendit Kombëtar dhe Presidentit. Mirëpo siç pranoi edhe Markoviç, kjo kompetencë tashmë ishte e konkretizuar në nenin 85 të Kushtetutës serbe i cili i akordonte Presidentit kompetenca mbikëqyrëse mbi qeverinë.⁶⁰⁹

286. Si konkluzion, Dhoma ka mendimin se kompetencat e Presidentit të Serbisë ndaj ministrive dhe organeve të tjera qeveritare, përfshirë edhe Ministrinë e Brendshme, me gjasë mundësonin mbikëqyrje të konsiderueshme. Mirëpo shfrytëzimi i plotë i mundshëm i tyre varej prej funksionmbajtësit. Sa për “forcat e armatosura” të federatës, Dhoma pranon dëshminë e Markoviçit se paragrafi 5 i nenit 83 nuk kishte kuptim duke marrë parasysh nenin 135 të Kushtetutës së RFJ-së.

⁶⁰⁶ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 4.1–4.8.

⁶⁰⁷ Ratko Markoviç, T. 12957–12963 (6 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 4.5; 1D752 (Ligji Themeltar i Republikës Federale të Gjermanisë), neni 56.

⁶⁰⁸ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë), para. 4.16–4.17. *Shih edhe* Branislav Simonoviç, T. 25647–25648 (17 prill 2008).

⁶⁰⁹ Ratko Markoviç, T. 13351 (10 gusht 2007).

C. FUNKSIONIMI POLITIK I RFJ-SË DHE SERBISË NË 1998 DHE 1999

287. Siç u shtjellua më lart, dy kushtetutat dhe legjislacioni tjetër shtruan themelin e strukturës politike dhe kushtetuese të RFJ-së dhe Serbisë. Në vitet 1998 dhe 1999 sistemi kishte tetë-nëntë vjet në funksionim. Tani Dhoma do të shqyrtojë provat mbi mënyrën e funksionimit praktik të këtij sistemi në periudhën përkatëse të Aktakuzës.

288. Partia më e fuqishme politike në periudhën përkatëse të Aktakuzës ishte Partia Socialiste e Serbisë (“SPS”) udhëhequr prej Sllobodan Millosheviqit. Kjo parti në vetvete arriti të formonte qeverinë në Serbi vetëm një herë pas zgjedhjeve të para në 1990; prej zgjedhjeve pasuese ajo mbeti në pushtet nëpërmjet koalicioneve qeveritare. Pas zgjedhjeve të vitit 1993, partneri i saj në koalicion ishte partia e quajtur Demokracia e Re. Pas zgjedhjeve të vitit 1997 SPS-ja formoi qeveri koalicioni me Partinë Radikale serbe udhëhequr prej Vojislav Sheshelit dhe Partinë e Majtë Jugosllave (“JUL”) udhëhequr prej Mira Markoviqit, bashkëshortja e Sllobodan Millosheviqit.⁶¹⁰ Në nivelin federal gjatë tërë periudhës kishte qeverisje me koalicione.⁶¹¹

289. Millan Jovanoviqi i cili gjatë periudhës 1993 - 2000 punoi si sekretar në seksionin e shërbimeve teknike të Këshillit Kryesor të SPS-së, dëshmoi se “organi më i lartë” në parti ishte Kongresi i cili mblidhej çdo katër vjet ose më shpesh nëse ishte e nevojshme. Kongresi nga ana e tij zgjidhte Këshillin Kryesor të SPS-së, i cili ishte “organi më i lartë” në periudhën midis dy Kongreseve dhe mund të shkonte deri në 250 anëtarë. Këshilli Kryesor zgjidhte Komitetin Ekzekutiv, i cili ishte organi ekzekutiv i SPS-së që kishte deri në 35 anëtarë, si dhe Sekretarin e Përgjithshëm, gjithë zëvendëskryetarët dhe anëtarë të komisioneve dhe këshillave të ndryshme. Kryetari i SPS-së kishte kompetencë të propozonte kandidatë për detyrën e zëvendëskryetarit të SPS-së, dhe gjithashtu kishte kompetencë të propozonte edhe heqjen e tij.⁶¹² Jovanoviqi dëshmoi se si kryetar i SPS-së, Millosheviqi kryesonte mbledhjet e Këshillit Kryesor dhe gjithashtu gëzonte një nivel të lartë pushteti dhe ndikimi në veprimtarinë e SPS-së.⁶¹³

290. Në mars 1996 u mbajt Kongresi i SPS-së në të cilin Shainoviqi u zgjodh zëvendëskryetar i SPS-së, kurse Millutinoviqi u zgjodh në Këshillin Kryesor, anëtar i të cilit mbeti gjatë gjithë periudhës së Aktakuzës.⁶¹⁴ Mirëpo më 24 prill 1997, me propozim të Sllobodan Millosheviqit dhe me vendim të Këshillit Kryesor, Shaninoviqi u hoq nga posti i zëvendëskryetarit. Gjatë së njëjtës

⁶¹⁰ Millan Jovanoviqi, T. 14144–14145 (21 gusht 2007), T. 14221 (22 gusht 2007).

⁶¹¹ Millan Jovanoviqi, T. 14145 (21 gusht 2007).

⁶¹² Millan Jovanoviqi, T. 14141–14144 (21 gusht 2007).

⁶¹³ Millan Jovanoviqi, T. 14143 (21 gusht 2007).

⁶¹⁴ Millan Jovanoviqi, T. 14197 (22 gusht 2007); P2875 (Faqja në Internet e SPS-së: Raport mbi Kongresin e tretë të SPS-së, 3 mars 1996).

seancë ai u emërua anëtar i Komitetit Ekzekutiv të SPS-së që sipas Millan Jovanoviqit, ishte ulje në strukturën hierarkike nga një post i lartë, në anëtarësi të një organi kolektiv.⁶¹⁵

291. Më 15 korrik 1997, Kuvendi Federal zgjodhi Slobodan Millosheviqin si President të RFJ-së për një mandat katërvjeçar.⁶¹⁶ Më 21 dhjetor 1997, Millutinoviqi u zgjodh President i Republikës së Serbisë me votim të drejtpërdrejtë nga populli,⁶¹⁷ dhe e mbajti atë detyrë deri më 29 dhjetor 2002.⁶¹⁸ President i Republikës së Malit të Zi ishte Millo Gjukanoviqi i cili kishte fituar ndaj Momir Bullatoviqit në zgjedhjet e zhvilluara në fillim të vitit 1998.⁶¹⁹ Rrjedhimisht Millosheviqi, Millutinoviqi dhe Gjukanoviqi ishin anëtarë të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes në vitet 1998 dhe 1999.⁶²⁰

292. Më 24 mars 1998 Kuvendi Kombëtar i Serbisë zgjodhi si Kryeministër të Republikës së Serbisë, Mirko Marjanoviqin, dhe gjithashtu pesë zëvendëskryeministra, ndër të cilët edhe Ratko Markoviqin.⁶²¹ Po atë ditë Kuvendi Kombëtar zgjodhi edhe ministrat, ndër të cilët Vllajko Stojilkoviq (ministër i Brendshëm), Zhivota Qosiq (ministër për Minierat dhe Furnizimin me Energji), dhe Zoran Angjelkoviq (ministër i Rinisë dhe Sporteve).⁶²² Më vonë atë vit, Radomir Markoviqi u emërua ndihmësinistër i Brendshëm.⁶²³

293. Në lidhje me organet federale, më 9 janar 1998, Kryeministri i atëhershëm Federal, Dadoje Kontiq, emëroi Zhivadin Jovanoviqin si ministër Federal për Punë të Jashtme.⁶²⁴ Qeveria e atëhershme e RFJ-së përbëhej prej partnerësh koalicioni nga Mali i Zi dhe Serbia. Gjithsesi qeveria

⁶¹⁵ Millan Jovanoviq, T. 14197–14199 (22 gusht 2007); 2D25 (Procesverbal i sesionit të dhjetë të Këshillit Kryesor të SPS-së, 24 prill 1997), f. 2.

⁶¹⁶ P476 (Vendim mbi zgjedhjen e Presidentit të RFJ-së, 15 korrik 1997).

⁶¹⁷ 1D421 (Raport mbi Rezultatet Përfundimtare të Zgjedhjeve Presidenciale të Republikës së Serbisë, 23 dhjetor 1997). *Shih edhe* 1D415 (Vendim për Organizimin e Raundit të Dytë të Zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Serbisë, 26 shtator 1997); 1D416 (Vendim mbi Kandidatët për Zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Serbisë në Zgjedhje të Përsëritura më 5 tetor 1997, 26 shtator 1997); 1D417 (Vendim mbi Caktimin e Datës së Zgjedhjeve të Presidentit të Republikës së Serbisë, 21 tetor 1997); 1D418 (Raport mbi Rezultatet e Plota të Zgjedhjeve për Presidentin e Republikës së Serbisë Mbajtur më 21 shtator dhe 5 tetor 1997, 22 tetor 1997); dhe 1D420 (Vendim mbi Përsëritjen e Zgjedhjeve për Presidentin e Republikës së Serbisë, 9 dhjetor 1997) në kontekst të këtyre zgjedhjeve, Ratko Markoviqi gjithashtu shpjegoi se ishin dy zgjedhje presidenciale në 1997; I Akuzuari Millutinoviq u zgjodh në raundin e dytë të zgjedhjeve të dyta. Ratko Markoviq, T. 12855 (6 gusht 2007). Dragan Tomiq ishte Ushtrues i Funkcionit të Presidentit të Serbisë nga korriku deri në dhjetor 1997. 1D417 (Vendim mbi Caktimin e Datës së Zgjedhjes së Presidentit të Republikës së Serbisë, 21 tetor 1997).

⁶¹⁸ Ratko Markoviq, T. 12885 (6 gusht 2007).

⁶¹⁹ Momir Bullatoviq, T. 13799 (16 gusht 2007), T. 13866 (17 gusht 2007).

⁶²⁰ Momir Bullatoviq, T. 13866 (17 gusht 2007); Ratko Markoviq, T. 13353 (10 gusht 2007); Aleksandar Vasilevqi, T. 8635–8636 (18 janar 2007), P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 7; P1000 (Procesverbal i sesionit të tetë të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, 25 dhjetor 1998).

⁶²¹ Pesë zëvendësit ishin Millovan Bojiq, Ratko Markoviq, Tomisllav Nikoliq, Dragomir Tomiq, dhe Vojislav Sheshel.

⁶²² P909 (Vendim mbi Zgjedhjen e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrave dhe Ministrave të Tjerë, 24 mars 1998).

⁶²³ 1D437 (Vendim për Emërimin e Ndihmësinistrit të Brendshëm, 5 nëntor 1998).

⁶²⁴ Zhivadin Jovanoviq, T. 13984, 13986 (20 gusht 2007); 1D258 (Vendim për Emërimin e Ministrit Federal të Punëve të Jashtme, 9 janar 1998).

u rrëzua për shkak të mosmarrëveshjeve të brendshme politike në Mal të Zi. Faktikisht partia qeverisëse në Mal të Zi u nda në dy fraksione, një i udhëhequr prej Gjukanoviçit dhe tjetri prej Bullatoviçit. I pari përkrahte pavarësinë e Malit të Zi prej Serbisë kurse i dyti ishte për federatën. Fraksioni i Bullatoviçit formoi një parti të re, Partia Popullore Socialiste e Malit të Zi dhe pas rënies së qeverisë së RFJ-së, u bë partner në koalicion me SPS-në në përpjekje për ruajtjen e federatës.⁶²⁵ Si pasojë më 20 maj 1998, pas mandatimit të Bullatoviçit prej Presidentit të RFJ-së për formimin e qeverisë, Kuvendi Federal zgjodhi Momir Bullatoviçin si Kryeministër të ri të RFJ-së.⁶²⁶ Nga ana e tij, ai në të njëjtën datë lëshoi një vendim në lidhje me përbërjen e qeverisë së RFJ-së. Bazuar në këtë vendim, Bullatoviçi mbajti praktikisht të gjithë anëtarët serbë të qeverisë së mëparshme, ndër të cilët Shainoviçi, i cili ishte njëri ndër pesë zëvendëskryeministrat. Rrjedhimisht përgjegjësitë e tij ishin në fushën e politikës së jashtme.⁶²⁷ Kabineti i qeverisë së re mbliidhej çdo të enjte dhe nxirrte vendime.⁶²⁸

294. Bullatoviçi dëshmoi se prej krijimit të RFJ-së në 1992, qeveritë e ndryshme të RFJ-së nuk patën kohë për zhvillimin e kapaciteteve të disa organeve dhe institucioneve federale, kryesisht për shkak të negociatave në lidhje me konfliktet në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, dhe gjithashtu për shkak të sanksioneve të vendosura kundër RFJ-së. Sipas Bullatoviçit, megjithëse RFJ-ja ushtronte sovranitet të plotë në punët e jashtme, aspekti i sigurimit të vendit në nivel federal nuk ishte përcaktuar asnjëherë. Ministria e Brendshme Federale kishte afërsisht vetëm 1000 policë që shërbenin vetëm për sigurimin e ambasadave dhe ndërtesave të tjera diplomatike në Beograd. Qeveria federale nuk kishte pushtet ndaj MPB-së serbe.⁶²⁹ Radomir Llukiqi dëshmoi se asnjë organ i RFJ-së, përfshirë edhe Presidentin e RFJ-së, nuk kishte kompetenca ligjore ndaj MPB-ve të republikave, mirëpo pohoi se ligjërisht ishte e lejueshme që organet e RFJ-së të bashkëpunonin nëpërmjet shkëmbimit të informacionit me organet republikane për zgjidhjen e trazirave në pjesë të territorit të RFJ-së.⁶³⁰ Në fund të fundit, pavarësisht teorisë kushtetuese në lidhje me këto rrethana,

⁶²⁵ Momir Bullatoviç, T. 13799–13800 (16 gusht 2007), T. 13866–13868 (17 gusht 2007); Millan Jovanoviç, T. 14145 (21 gusht 2007).

⁶²⁶ Momir Bullatoviç, T. 13868–13869 (17 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviç, T. 13986 (20 gusht 2007); 1D249 (Vendim mbi Zgjedhjen e Kryeministrit Federal, 20 maj 1998).

⁶²⁷ Momir Bullatoviç, T. 13869–13870 (17 gusht 2007); Matkoviç T. 14589 (29 gusht 2007); 1D260 (Vendim mbi Përbërjen e Qeverisë Federale, 22 maj 1998).

⁶²⁸ Momir Bullatoviç, T. 13838–13839 (16 gusht 2007); Andreja Millosavleviç, T. 14310–14311 (23 gusht 2007).

⁶²⁹ Momir Bullatoviç, T. 13801–13803 (16 gusht 2007), T. 13856, 13870–13871 (17 gusht 2007). Bullatoviçi dëshmoi se Ministër i Brendshëm Federal ishte Petar Graçanin. Ai u zëvendësua më vonë nga Pavlle Bullatoviçi. Ministri Federal i Punëve të Brendshme pasues ishte Zoran Sokoloviç, kurse Pavlle Bullatoviçi u bë Ministër Federal i Mbrojtjes. Momir Bullatoviçi gjithashtu konfirmoi se në 1993, Jovica Stanishiçi, kreu i RDB-së në atë kohë, dhe anëtarë të tjerë të MPB-së serbe morën në kontroll ambientet e MPB-së Federale. Si pasojë të gjitha burimet kryesore teknike të MPB-së Federale u përfshinë në juridiksionin e MPB-së serbe, duke shënuar fillimin e prishjes së shpejtë të MPB-së Federale. *Shih edhe* Momir Bullatoviç, T. 13872–13875 (17 gusht 2007); Radomir Llukiq, T. 26225 (15 maj 2008).

⁶³⁰ Radomir Llukiq, T. 26277–26279 (15 maj 2008), T. 26291 (16 maj 2008).

faktikisht MPB-ja republikane kishte më shumë kompetenca se MPB-ja federale. Mënyra e ushtrimit të këtyre kompetencave analizohet më vonë.⁶³¹

295. Gjithashtu Bullatoviçi dëshmoi se gjatë krizës së Kosovës në 1998 dhe 1999, Ministria Federale e Punëve të Jashtme ngriti selinë e saj në Kosovë për të qenë në kontakt me diplomatët e shumtë që vinin në atë zonë.⁶³² Zhivadin Jovanoviçi, ministri i atëhershëm Federal i Punëve të Jashtme e konfirmoi dëshminë dhe dëshmoi se në maj 1998 ai vendosi të hapte një zyrë në Prishtinë dhe pak kohë pas kësaj, dy zyra në Ranllug dhe Mitrovicë. Ai pohoi se kjo ishte e nevojshme për t'iu ofruar ndihmë profesionale përfaqësuesve të autoriteteve vendore të cilët nuk kishin përvojë në mbajtjen e marrëdhënieve ndërkombëtare dhe gjithashtu për të ndihmuar përfaqësuesit civilë diplomatikë të huaj që vizitonin Kosovën. Këto zyra funksiononin në përputhje me udhëzimet e Ministrisë Federale për Punë të Jashtme ose të vetë ministrit. Punonjësit e këtyre zyrave e informonin çdo ditë Ministrinë për veprimtarinë e tyre.⁶³³ Jovanoviçi u pyet gjerësisht prej palës kundërshtarë në lidhje me financimin e Ministrisë dhe pranoi se Mihal Kertes, drejtori i atëhershëm i Administratës Federale të Doganës, u dha tri herë gjithsej së paku 1,4 milion marka. Sipas Jovanoviçit, këto të holla u përdorën për (a) riparimin e ndërtesave të Ministrisë pas bombardimeve të NATO-s; (b) riparimin e një ndërtese shtetërore për diplomatë të huaj; dhe (c) dërgimin e një numri të madh diplomatësh në Rambuje.⁶³⁴

296. Pas ngritjes së këtyre zyrave në Kosovë, Bullatoviçi i nxitur prej Millosheviçit,⁶³⁵ vendosi që Shainoviçi i cili kishte përvojë me Marrëveshjet e Dayton-it, të dërgohej në Kosovë në krye të “bashkërendimit politik dhe diplomatik”.⁶³⁶ Pas caktimit të tij në Kosovë, Shainoviçi ishte i pranishëm në mbledhjet e përjavshme të kabinetit ku ai informonte Bullatoviçin dhe qeverinë e RFJ-së për gjendjen në Kosovë.⁶³⁷

D. ADMINISTRIMI I KOSOVËS

297. Siç përmendet më lart në Kapitullin III, qeverisja vendore në Kosovë përballej me një sërë problemesh për shkak të mosgatishmërisë së popullatës shqiptare kosovare për të mbështetur

⁶³¹ *Shih* Nën pjesa 3, Pjesa A, Kapitulli VI.

⁶³² Momir Bullatoviçi, T. 13817–13819 (16 gusht 2007).

⁶³³ Zhivadin Jovanoviçi, T. 13995–13996 (20 gusht 2007), T. 14105 (21 gusht 2007). *Shih edhe* Velko Odaloviçi, T. 14389–14390 (24 gusht 2007), 14414 (27 gusht 2007).

⁶³⁴ Zhivadin Jovanoviçi, T. 14096–14102 (21 gusht 2007).

⁶³⁵ *Shih* Nën pjesa 3, Pjesa D, Kapitulli VIII.

⁶³⁶ Momir Bullatoviçi, T. 13817–13819 (16 gusht 2007), T. 13891–13898 (17 gusht 2007). *Shih edhe* Zhivadin Jovanoviçi, T. 13997 (20 gusht 2007); Dushko Matkoviçi, T. 14589 (29 gusht 2007); Zoran Angjelkoviçi, T. 14652 (30 gusht 2007); Millomir Miniçi, T. 14743–14744 (31 gusht 2007).

organet vendore të qeverisë. Si rezultat prej qeverisë u bënë përpjekje për organizimin e krahinës dhe krijimin e organeve vendore që do të zbatonin ligjet e Republikës së Serbisë në krahinë.

1. Vetëqeverisja vendore

298. Në 1992, Republika e Serbisë u nda në disa njësi gjeografike në bazë të kriterit të qeverisjes vendore. Si pasojë Kosova u nda në pesë qarqe, përkatësisht, Qarku i Kosovës, Qarku i Pejës, Qarku i Prizrenit, Qarku i Mitrovicës dhe Qarku i Luginës së Moravës së Kosovës. Secili prej këtyre qarqeve përfshinte një numër komunash.⁶³⁸ Qarku i Kosovës përfshinte dhjetë komuna dhe ishte një prej qarqeve më të mëdhenj në Republikën e Serbisë. Më 17 prill 1998, Velko Odaloviqi, anëtar i SPS-së, u emërua Kryetar i Qarkut të Kosovës prej qeverisë serbe.⁶³⁹ Odaloviqi shpjegoi se qarqet ishin organe të krijuara prej qeverisë serbe për kryerjen e veprimtarisë administrative të qeverisë në terren. Gjithashtu ato shërbenin për zbatimin e ligjeve serbe anembanë republikës, përfshirë edhe Kosovën, dhe nuk kishin kompetencë për çështje të sigurisë. Odaloviqi e informonte rregullisht qeverinë për krejt veprimtarinë e tij si Kryetar i Qarkut të Kosovës.⁶⁴⁰

299. Gjithashtu Andreja Millosavleviqi, i cili ishte ministër për vetëqeverisjen vendore në qeverinë serbe prej vitit 1994 deri në mars 1998,⁶⁴¹ dëshmoi se një prej detyrave të tij gjatë funksionit të tij ishte trajtimi i çështjeve në lidhje me funksionimin e organeve administrative. Ai shpjegoi se qeveria serbe në bazë të Ligjit të Organizmit Territorial të Republikës së Serbisë ishte e detyruar të ngrinte këshilla komunale të cilët do të zëvendësonin punën e kuvendeve komunale dhe komiteteve të tyre ekzekutive, duke mundësuar në këtë mënyrë funksionimin e komunave.⁶⁴²

300. Në fund të vitit 1997 dhe gjatë tërë vitit 1998, pesë qarqet në Kosovë përjetuan ardhjen e një numri të madh diplomatësh dhe gazetarësh të huaj. Vetë Odaloviqi pati një numër të madh kontaktesh me përfaqësuesit e huaj dhe ndeshi vështirësi për shkak të mungesës së shërbimit të përshtatshëm për mbajtjen e të tëra kontakteve. Si rezultat, në një prej raporteve të tij për qeverinë serbe, Odaloviqi tërhoqi vëmendjen ndaj faktit se kishte nevojë për më shumë mbështetje. Duke

⁶³⁷ Momir Bullatoviq, T. 13820–13821 (16 gusht 2007), T. 13898–13900 (17 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviq, T. 13998–14000 (20 gusht 2007).

⁶³⁸ Velko Odaloviq, T. 14387–14389 (24 gusht 2007); Andreja Millosavleviq, T. 14269 (23 gusht 2007); P966 (Dekret mbi Kryerjen e Detyrave të Ministrive dhe Organizatave të Posaçme Jashtë Tyre, 30 janar 1992), neni 4.

⁶³⁹ Velko Odaloviq, T. 14382–14384, 14836 (24 gusht 2007), T. 14452–14456, 14482–14483 (27 gusht 2007); P978 (Vendim për Emërimin e Kryetarit të Qarkut të Kosovës, 17 prill 1998).

⁶⁴⁰ Velko Odaloviq, T. 14385–14387 (24 gusht 2007), T. 14424 (27 gusht 2007); Zoran Angjelkoviq, T. 14652 (30 gusht 2007).

⁶⁴¹ Andreja Millosavleviq, T. 14325 (24 gusht 2007); Zoran Angjelkoviq, T. 14652 (30 gusht 2007); 1D385 (Vendim mbi Zgjedhjen e Kryeministrit, Zëvendëskryeministrit dhe Ministrave të Qeverisë së Republikës së Serbisë, 18 mars 1994).

⁶⁴² Andreja Millosavleviq, T. 14257–14259 (23 gusht 2007).

marrë parasysh edhe ardhjet e shumë diplomatëve të rangut të lartë, Odaloviqi informoi ministrin Federal të Punëve të jashtme, Zhivadin Jovanoviçin, në lidhje me nevojën e tij për ndihmë.⁶⁴³ Siç është përmendur më parë, autoritetet reagues duke emëruar Millosavleviçin si bashkërendues të organeve shtetërore në Kosovë,⁶⁴⁴ nëpërmjet hapjes së një zyre me punonjës të Ministrisë së Jashtme, si dhe dy zyra shtesë; dhe nëpërmjet dërgimit të Shainoviçit në Prishtinë.⁶⁴⁵

301. Millosavleviçi do të bashkërendonte punën e organeve shtetërore civile të Kosovës dhe zbatimin e masave dhe praktikave të qeverisë serbe nëpërmjet akteve të nxjerra nënligjore të miratuara ose që mund të miratoheshin. Më konkretisht, ai do të bashkërendonte midis ministrive serbe, kryetarëve të pesë qarqeve të Kosovës, dhe kryetarëve të komunave në Kosovë. Gjithashtu ai i raportonte për punën e tij individit që e kishte emëruar, pikërisht Kryeministrit serb, Mirko Marjanoviçi, së paku një herë në javë.⁶⁴⁶ Me ardhjen e Shainoviçit në Kosovë, ata të dy shkëmbenin rregullisht informacion në lidhje me punën e tyre.⁶⁴⁷ Millosavleviçi u vendos në Prishtinë në të njëjtën ndërtesë me oficerët e Korpusit të UJ-së për Prishtinën, ndër të cilët edhe Pavkoviçi.⁶⁴⁸ Gjatë mandatit të tij, në Beograd u ngrit selia në nivel republike për shpërndarjen e ndihmës humanitare për popullatën e Kosovës, si dhe qendrat paralele në qarqet dhe komunat e Kosovës.⁶⁴⁹ Millosavleviçi u largua prej Kosovës më 28 shtator 1998 për shkak sëmundjeje.⁶⁵⁰

2. Grupi i Punës për Kosovën

302. Veç pranisë së organeve të qeverisjes vendore në Kosovë, partia më e madhe politike, SPS-ja, vendosi se edhe ajo duhej të ishte e pranishme në Kosovë. Për këtë arsye, në sesionin e 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së mbajtur më 10 qershor 1998, Millosheviçi propozoi formimin e një grupi pune me detyrë bashkërendimin e veprimtarisë politike të SPS-së në Kosovë. Në këtë takim morën pjesë anëtarë të Këshillit Kryesor, ndër të cilët Millutinoviçi dhe Shainoviçi,⁶⁵¹ Zhivadin

⁶⁴³ Velko Odaloviçi, T. 14389–14390 (24 gusht 2007), T. 14414 (27 gusht 2007).

⁶⁴⁴ Andreja Millosavleviçi, T. 14321 (23 gusht 2007); 2D356 (Vendim mbi Emërimin e Millosavleviçit si Bashkërendues i Punës së Organeve Shtetërore në Kosovë, 3 qershor 1998).

⁶⁴⁵ Velko Odaloviçi, T. 14415 (27 gusht 2007); Zoran Angjelkoviçi, T. 14652 (30 gusht 2007); Dushko Matkoviçi, T. 14588–14589 (29 gusht 2007); Millomir Miniçi, T. 14743–14744 (31 gusht 2007); 2D99 (Memorandum i Ministrisë së Jashtme Federale mbi Personelin e Zyrave në Terren, 11 nëntor 1998). *Shih edhe* Andreja Millosavleviçi, T. 14304–14306, 14308 (23 gusht 2007), T. 14358 (24 gusht 2007).

⁶⁴⁶ Andreja Millosavleviçi, T. 14262–14266, 14268–14272, 14311–14312 (23 gusht 2007), T. 14336–14338 (24 gusht 2007).

⁶⁴⁷ Andreja Millosavleviçi, T. 14304–14306, 14308 (23 gusht 2007), T. 14358 (24 gusht 2007).

⁶⁴⁸ Andreja Millosavleviçi, T. 14294–14296 (23 gusht 2007), T. 14345, 14372–14374 (24 gusht 2007); IC138 (Hartë e Prishtinës ku Millosavleviçi ka shënuar vendndodhjen e zyrës së tij në Prishtinë)

⁶⁴⁹ Andreja Millosavleviçi, T. 14285–14287 (23 gusht 2007), T. 14340–14341, 14364–14367 (24 gusht 2007).

⁶⁵⁰ Andreja Millosavleviçi, T. 14267 (23 gusht 2007).

⁶⁵¹ Zoran Angjelkoviçi, T. 14651, 14713 (30 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviçi, T. 14075–14079 (21 gusht 2007); Matkoviçi, T. 14586–14587 (29 gusht 2007); Millomir Miniçi, T. 14742–14743 (31 gusht 2007); P1012 (Procesverbal i Sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998).

Jovanoviçi si njëri prej zëvendëskryetarëve të Këshillit Kryesor të SPS-së,⁶⁵² Zoran Angjelkoviçi, anëtar i Këshillit Kryesor të SPS-së dhe ministër për Rininë dhe Sportin në qeverinë serbe,⁶⁵³ Dushko Markoviçi, zëvendëskryetar i SPS-së i ngarkuar për çështje ekonomike dhe zëvendëskryetar i Kuvendit Kombëtar të Serbisë,⁶⁵⁴ dhe Millomir Mimiçi, anëtar i Këshillit Kryesor dhe zëvendëskryetar i Kuvendit të RFJ-së.⁶⁵⁵ Ishte i pranishëm edhe Millan Jovanoviçi si sekretar i shërbimit teknik.⁶⁵⁶

303. Në lidhje me Kosovën, SPS-ja miratoi një platformë bazuar në këto parime themelore; të gjitha problemet duhej të zgjidheshin me mjete paqësore nëpërmjet dialogut të drejtpërdrejtë midis të gjitha grupeve etnike në Kosovë; ky dialog duhej nisur menjëherë; zgjidhja për Kosovën duhej të kishte në themel një autonomi sa më të gjerë që do të përfshinte të gjitha standardet në lidhje me të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave kombëtare; duhej dënuar dhuna si mjet për realizimin e synimeve politike; dhe bashkësia ndërkombëtare duhej të përfshinte sa më shpejt Serbinë dhe RFJ-në në proceset e integritimit ndërkombëtar, për t'iu dërguar “një sinjal terroristëve” në Kosovë se dhuna nuk do të tolerohej.⁶⁵⁷

304. Këshilli Kryesor pranoi propozimin e Millosheviçit për një grup pune prej tre individësh për Kosovën. U vendos që grupi të kryesohej prej Miniçit dhe në përbërje të ishin edhe Matkoviçi dhe Angjelkoviçi.⁶⁵⁸ Sipas Millan Jovanoviçit, qëllimi kryesor i Grupit të Punës ishte gjetja e zgjidhjes politike për Kosovës dhe qetësimi i gjendjes.⁶⁵⁹ Angjelkoviçi dëshmoi se financimi vinte prej një shoqërie tregtare në pronësi të SPS-së, e cila në atë kohë drejtohej prej Angjelkoviçit dhe se Këshilli Kryesor, si themelues i kësaj shoqërie, pagoi të tëra shpenzimet e Grupit të Punës.⁶⁶⁰ Gjithsesi Millan Jovanoviçi dëshmoi se një anëtar i Këshillit Kryesor të SPS-së, Mihal Kertes, i dorëzoi atij afërsisht 2 milion marka gjermane në të holla për financimin e SPS-së në tërësi. Përgjithësisht mjaft dredhues në këtë pikë, Millan Jovanoviçi shpjegoi se kjo shumë të hollash nuk

⁶⁵² Në këtë cilësi, Zhivadin Jovanoviçi ishte përgjegjës për marrëdhëniet ndërkombëtare në emër të partisë. Zhivadin Jovanoviçi, T. 14075–14076 (21 gusht 2007); P1012 (Procesverbal i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998).

⁶⁵³ Zoran Angjelkoviçi, T. 14650–14651 (30 gusht 2007); P1012 (Procesverbal i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998).

⁶⁵⁴ Dushko Matkoviçi, T. 14585 (29 gusht 2007); P1012 (Procesverbal i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998).

⁶⁵⁵ Millomir Mimiçi, T. 14741 (31 gusht 2007); P1012 (Procesverbal i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998). Mimiçi gjithashtu ishte kryetar i Dhomës së Qytetarëve në Kuvendin Federal.

⁶⁵⁶ Millan Jovanoviçi, T. 14145–14148 (21 gusht 2007); P1012 (Procesverbal i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998).

⁶⁵⁷ Millan Jovanoviçi, T. 14148–14149 (21 gusht 2007).

⁶⁵⁸ Zoran Angjelkoviçi, T. 14721 (31 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviçi, T. 14077–14079 (21 gusht 2007); Dushko Matkoviçi, T. 14587 (29 gusht 2007); Millomir Mimiçi, T. 14743 (31 gusht 2007); Millan Jovanoviçi, T. 14149 (21 gusht 2007); P1012 (Procesverbal i sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998), f. 6.

⁶⁵⁹ Millan Jovanoviçi, T. 14150 (21 gusht 2007).

⁶⁶⁰ Zoran Angjelkoviçi, T. 14721–14724 (31 gusht 2007).

vinte prej doganave, por ishte mbledhur prej dhuruesve të ndryshëm.⁶⁶¹ Në këtë pikë Dhoma thekson se megjithëse Prokuroria përmendi pjesëmarrjen e Kertesit në financimin e disa organeve dhe ministrive gjatë procesit gjyqësor, ajo nuk paraqiti argumente konkrete në dosjen e saj përfundimtare ose në argumentet përmbyllëse në lidhje me rëndësinë e këtij aspekti për çështjen.

305. Shpejt pas ardhjes në Kosovë, dikur në mesqershor të vitit 1998, Grupi i Punës mori pjesë në një takim të këshillit krahinor të SPS-së. Sipas Matkoviqit, atmosfera në atë takim ishte e pakëndshme dhe gjendja mjaft e tensionuar. Anëtarë të SPS-së, ndër të cilët sipas Matkoviqit duhet të kenë qenë përfaqësues të grupeve joserbe, i thanë grupit se gjendja në Kosovë ishte problematike, se jeta normale ishte çrregulluar, se serbët po i lëshonin shtëpitë, dhe se UÇK-ja kishte marrë disa zona në kontroll. Partia dhe kryetari i saj, Sllobodan Millosheviqi u kritikuan ashpër. Pas këtij takimi Grupi i Punës u kthye në Beograd dhe i raportoi Millosheviqit shqetësimet e anëtarëve të partisë.⁶⁶²

306. Sipas anëtarëve të tij, të cilët dëshmuar të gjithë para Dhomës, veprimtaria e Grupit të Punës konsistonte në mbledhjen e informacionit, mbajtjen e takimeve me aktorët politikë dhe biseda me njerëzit. Anëtarët e grupit takoheshin rregullisht me kryetarë komunash dhe përfaqësues të organeve shtetërore, ndër të cilët edhe ushtarakë dhe policë. Ata dëshmuar se këto takime kryesisht kishin të bënin me shkëmbim informacioni.⁶⁶³ Miniqi ishte i ngarkuar për biseda politike me udhëheqësit krahinorë; Matkoviqi inspektoi firmat në Kosovë për të garantuar vazhdimësinë e prodhimit dhe bashkëpunoi ngushtë me Millosajeviqin, bashkërenduesin e organeve shtetërore në Kosovë, dhe Angjelkoviqi vizitoi zona të ndryshme në Kosovë në përpjekje për të biseduar dhe për t'i bindur njerëzit të mos largoheshin prej shtëpive të tyre. Në këtë kontekst Angjelkoviqi bashkëpunoi me Millosajeviqin në çështje humanitare si shpërndarja e ndihmave për t'i nxitur njerëzit që të ktheheshin në shtëpi.⁶⁶⁴ Sipas Angjelkoviqit, Matkoviqit dhe Miniqit, as Millosavleviqi, as Shainoviqi nuk ishin eprorë apo vartës të Grupit të Punës.⁶⁶⁵ Grupi i Punës i paraqiste raporte të rregullta selisë së SPS-ë në lidhje me punën e tij dhe pikëpamjet e shprehura

⁶⁶¹ Millan Jovanoviq, T. 14201–14203 (22 gusht 2007).

⁶⁶² Dushko Matkoviq, T. 14590–14591 (29 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14744–14745 (31 gusht 2007).

⁶⁶³ Zoran Angjelkoviq, T. 14654–14656 (30 gusht 2007); Dushko Matkoviq, T. 14591–14595 (29 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14747–14751 (31 gusht 2007); Millan Jovanoviq, T. 14150–14151 (21 gusht 2007).

⁶⁶⁴ Zoran Angjelkoviq, T. 14653 (30 gusht 2007); T. 14358–14359 (24 gusht 2007); Velko Odaloviq, T. 14416–14417 (27 gusht 2007); Dushko Matkoviq, T. 14587 (29 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14745–14746 (31 gusht 2007); Millan Jovanoviq, T. 14156–14157, 14159–14162 (22 gusht 2007); 2D53 (Procesverbal i sesionit të 87-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 11 shtator 1998), f. 2–4. Sipas Millosavleviqit, tre personat nuk kishin kontakte me diplomatët e huaj, megjithëse Angjelkoviqi mund të ketë patur kontakte për arsytet e pozitës së tij si ministër në qeverinë serbe. Andreja Millosavleviq, T. 14307–14308 (23 gusht 2007). Në të vërtetë, Angjelkoviqi konfirmoi se ai kishte kontakte me përfaqësues të huaj, mirëpo në cilësinë si Kryetar i KEP-it; Zoran Angjelkoviq, T. 14671 (30 gusht 2007).

⁶⁶⁵ Zoran Angjelkoviq, T. 14654 (30 gusht 2007); Matkoviq, T. 14588 (29 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14752 (31 gusht 2007).

prej qytetarëve dhe veprimtarëve me të cilët kontaktuan. Miniqi ishte në kontakt telefonik të përditshëm me sekretarin e Këshillit Ekzekutiv.⁶⁶⁶

307. Grupi i Punës qëndroi në Kosovë deri në qetësimin e gjendjes pas një “operacioni të suksesshëm kundër terroristëve” kryer prej forcave të RFJ-së dhe Serbisë, i cili do të diskutohet më vonë.⁶⁶⁷ Më 10 shtator 1998, anëtarët e tij takuan Millosheviqin. Matkoviqi shpjegoi se qëllimi i takimit ishte diskutimi i mënyrës më të përshtatshme për kthimin e normalitetit të jetës në Kosovë. Grupi i Punës paraqiti një propozim për një këshill të përkohshëm ekzekutiv në Kosovë, të cilin Millosheviqi e pranoi.⁶⁶⁸ Më 22 shtator 1998, Komiteti Ekzekutiv i SPS-së mbajti një mbledhje, dhe ndër pjesëmarrësit ishte edhe Millutinoviqi në cilësinë si President i Serbisë. U konkludua se gjendja në Kosovë po normalizohej.⁶⁶⁹ Ky sesion shqyrtoi punën e kryer bazuar në konkluzionet e Këshillit Kryesor më 10 qershor 1998. Pas kësaj mbledhjeje veprimtaria e Grupit të Punës në Kosovë u pakësua.⁶⁷⁰ Më 29 tetor 1998, pas takimit të tij me këshillin krahinor të SPS-së në Kosovë dhe një takim tjetër me Millosheviqin, veprimtaria e Grupit të Punës përfundoi tërësisht.⁶⁷¹ Angjelkoviqi qëndroi në Kosovë në funksionin e tij të ri si Kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm.⁶⁷²

3. Këshilli Ekzekutiv i Përkohshëm

308. Më 28 shtator 1998, Kuvendi Kombëtar i Serbisë në Sesionin e Dytë të Jashtëzakonshëm dhe bazuar në nenin 3 të Kushtetutës serbe, miratoi vendimin për formimin e Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm të Krahinës Autonome të Kosovës dhe Metohisë (“KEP”), për kryerjen e funksioneve ekzekutive të parashikuara në nenin 111 të Kushtetutës serbe.⁶⁷³ Kuvendi Kombëtar gjithashtu zgjodhi Kryetar të KEP-it, Zoran Angjelkoviqin.⁶⁷⁴ Nga ana e tij, Angjelkoviqi emëroi 16 anëtarët e

⁶⁶⁶ Millan Jovanović, T. 14151 (21 gusht 2007), T. 14157–14158 (22 gusht 2007).

⁶⁶⁷ Millan Jovanović, T. 14151 (21 gusht 2007). *Shih edhe* Pjesa C, Kapitulli VI.

⁶⁶⁸ Dushko Matković, T. 14638–14639 (30 gusht 2007).

⁶⁶⁹ Millan Jovanović, T. 14163–14165 (22 gusht 2007); 2D56 (Procesverbal i sesionit të 88-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 22 shtator 1998).

⁶⁷⁰ Millan Jovanović, T. 14166–14167 (22 gusht 2007).

⁶⁷¹ Millomir Minić, T. 14787–14794 (31 gusht 2007); Millan Jovanović, T. 14152 (21 gusht 2007), T. 14219–14221 (22 gusht 2007). Më 14 tetor 1998 u mblodh Komiteti Ekzekutiv i cili konkludoi se Grupi i Punës do të vazhdonte punën me këshillin krahinor të SPS-së për t’i shpjeguar kushtet e marrëveshjes Millosheviq-Holbrooke. Kjo mbledhje u zhvillua në fund të muajit tetor dhe ishte hera e fundit që këta tre individë funksionuan si një ekip. Millan Jovanović, T. 14168–14169 (22 gusht 2007); 2D77 (Procesverbal i sesionit të 89-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 14 tetor 1998), f. 3.

⁶⁷² Millan Jovanović, T. 14152 (21 gusht 2007).

⁶⁷³ Zoran Angjelković, T. 14656–14657 (30 gusht 2007); Millan Jovanović, T. 14155–14156 (22 gusht 2007); P907 (Vendim për Formimin e KEP-it, 28 shtator 1998); 2D63 (Procesverbal i Sesionit të Kuvendit Kombëtar të Serbisë). Dhoma thekson se gjatë gjithë gjykimit se ky organ u quajt përkëmbeshmërisht [në anglisht] si Temporary Executive Council dhe Provisional Executive Council/Këshilli Ekzekutiv i Përkohshëm. Dhoma do të përdorë formën e pare [në anglisht] me shkurtimin (“TEC”), [në shqip (“KEP”)] në Aktgjykim.

⁶⁷⁴ Zoran Angjelković, T. 14651 (30 gusht 2007); P908 (Vendim për emërimin e Kryetarit të KEP-it, 28 shtator 1998).

Këshillit.⁶⁷⁵ Në një sesion të zhvilluar në Prishtinë më 15 tetor 1998, KEP-i vendosi në lidhje me organizimin dhe funksionimin e vet,⁶⁷⁶ dhe gjithashtu miratoi Rregulloren e Procedurës së KEP-it në tetor 1998.⁶⁷⁷

309. Sipas nenit 2 të vendimit të krijimit të KEP-it, ndër objektivat e tij ishin zbatimi i ligjeve, rregulloreve dhe akteve të tjera të përgjithshme të Republikës së Serbisë në përgjegjësinë e tij; përcaktimi i parimeve të organizimit të brendshëm të organeve dhe shërbimeve; emërimi dhe zëvendësimi i zyrtarëve ekzekutivë në organet e administrimit krahinor; dhe krijimi i shërbimeve profesionale dhe shërbimeve të tjera që kishin lidhje me funksionimin e tij.⁶⁷⁸ Ai kishte kompetencë të lëshonte vendime, urdhra, udhëzime, dekrete, dhe konkluzione.⁶⁷⁹ Ai u shpërndante ndihmë humanitare të gjithë qytetarëve të Kosovës,⁶⁸⁰ dhe Angjelkoviqi, si Kryetar i KEP-it kishte kontakte të shumta me diplomatë të huaj.⁶⁸¹ KEP-i gjithashtu u dërgonte raporte, kur e gjykonte të nevojshme, instancave të ndryshme, ndër të cilat Kabinetit të Presidentit të Serbisë dhe Kabinetit të Kryeministrit të Serbisë.⁶⁸² Zoran Angjelkoviqi dhe Millan Jovanoviqi dëshmuuan se qëllimi këtij organi ishte mbajtja sa më shpejt e zgjedhjeve në Kosovë, dhe në këtë mënyrë krijimi i autoriteteve të duhura si kuvendi krahinor dhe këshilli ekzekutiv krahinor.⁶⁸³ Siç do të diskutohet më poshtë në Pjesën V, ky ishte një prej kushteve të Marrëveshjes Holbrooke- Millosheviq.

310. Ish-kryetari i Qarkut të Kosovës, Velko Odaloviqi, dëshmoi se nuk kishte përplasje juridiksioni midis KEP-it dhe qarqeve, pavarësisht bashkëpunimit të ngushtë. KEP-i synonte të vazhdonte deri në krijimin e kushteve për mbajtjen e zgjedhjeve. Rrjedhimisht veprimtaria e tij ishte planifikuar të përfundonte brenda nëntë muajve.⁶⁸⁴ Më 19 prill 1999, KEP-i krijoi personelin humanitar për të ndihmuar kthimin e të shpërngulurve në shtëpitë e tyre.⁶⁸⁵ Si anëtar i këtij personeli, Odaloviqi u ftua të merrte pjesë në mbledhjet e KEP-it, gjë që ai e bëri sa herë kishte mundësi. Gjithashtu KEP-i u kërkonte kryetarëve të qarqeve të merrnin pjesë në takime për ta

⁶⁷⁵ Zoran Angjelkoviq, T. 14657 (30 gusht 2007); P976 (Vendim për emërimin e anëtarëve të KEP-it, 3 tetor 1998), f. 1.

⁶⁷⁶ P976 (Vendim mbi Organizimin dhe Funksionimin e KEP-it, 15 tetor 1998), f. 2, gjithashtu pranuar si 1D454.

⁶⁷⁷ P1205 (Rregullorja e Procedurës së Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm, tetor 1998).

⁶⁷⁸ P976 (Vendim mbi Organizimin dhe Funksionimin e KEP-it, 15 tetor 1998), neni 2, gjithashtu pranuar si 1D454.

⁶⁷⁹ P976 (Vendim mbi Organizimin dhe Funksionimin e KEP-it, 15 tetor 1998), neni 17, gjithashtu pranuar si 1D454.

⁶⁸⁰ Zoran Angjelkoviq, T. 14668–14670 (30 gusht 2007); 5D412 (Letër e Llazareviqit drejtuar KEP-it, 13 maj 1999), gjithashtu pranuar si 1D454.

⁶⁸¹ Zoran Angjelkoviq, T. 14671 (30 gusht 2007).

⁶⁸² Zoran Angjelkoviq, T. 14724–14728 (31 gusht 2007); P2900 (Raport i KEP-it dërguar Kabinetit të Presidentit të Serbisë, 16 prill 1999).

⁶⁸³ Zoran Angjelkoviq, T. 14657 (30 gusht 2007); Millan Jovanoviq, T. 14156 (22 gusht 2007).

⁶⁸⁴ Velko Odaloviq, T. 14387–14389 (24 gusht 2007).

⁶⁸⁵ Velko Odaloviq, T. 14426–14427 (27 gusht 2007); 2D375 (Vendim për Ngritjen e Shtabit për Çështje Humanitare, 19 prill 1999). KEP- formoi gjithashtu një shtab për bashkërendimin e strukturave civile me UJ-në dhe MPB-në. *Shih* 2D375 (Vendim për Formimin e Shtabit Bashkërendues Midis Strukturave Civile dhe UJ-së e MPB-së, 19 prill 1999).

informuar KEP-in në lidhje me çështje të ndryshme, si p.sh, arsimi, dhe për të ndihmuar KEP-in në realizimin e misionit të tij.⁶⁸⁶

311. Në diskutimin e ligjshmërisë së KEP-it, eksperti i të drejtës kushtetuese, Ratko Markoviqi dëshmoi se neni 73 i Kushtetutës serbe nuk i akordonte Kuvendit Kombëtar kompetencë për krijimin e një organi të tillë. Ai shpjegoi së pari se neni 111 i Kushtetutës përmendte një këshill ekzekutiv ndërmjet organeve të krahinës autonome. Mirëpo më tej ai shpjegoi se sipas Kushtetutës, ky organ duhej të zgjidhej prej kuvendit krahinor. Duke qenë se një gjë e tillë nuk ishte e mundur në vitin 1998 (sepse kuvendi në Kosovë nuk funksiononte), Kuvendi Kombëtar formoi KEP-in. Mirëpo si pasojë ky ishte vetëm organ i përkohshëm.⁶⁸⁷ Markoviqi konkludoi se neni 13 i Ligjit mbi Zbatimin e Kushtetutës, i cili përcaktonte se Kuvendi Kombëtar mund të zëvendësonte organet krahinore deri në zgjedhjen e tyre të duhur, përbënte bazën për krijimin e KEP-it.⁶⁸⁸ Rrjedhimisht kushtetutshmëria e krijimit të KEP-it varej prej interpretimit të përbashkët të Kushtetutës serbe dhe Ligjit Kushtetues mbi Zbatimin e Kushtetutës.⁶⁸⁹ Pavarësisht teorisë kushtetuese në mbështetje të formimit të këtij organi, Dhoma ka mendimin se ky mekanizëm u ofrua për të garantuar plotësimin e kushteve të Marrëveshjes Holbrooke-Millosheviq e cila kërkonte që autoritetet e RFJ-së/Serbisë “të krijojnë rregullat dhe procedurat” për zgjedhje në Kosovë brenda 9 nëntorit 1998.⁶⁹⁰

⁶⁸⁶ Velko Odaloviq, T. 14450–14452 (27 gusht 2007).

⁶⁸⁷ Ratko Markoviq, T. 13500–13504 (14 gusht 2007).

⁶⁸⁸ Ratko Markoviq, T. 13504–13506 (14 gusht 2007).

⁶⁸⁹ Ratko Markoviq, T. 13506–13517 (14 gusht 2007).

⁶⁹⁰ *Shih* Kapitulli V.

V. PËRPJEKJET DIPLOMATIKE

A. KARAKTERI I PËRGJITHSHËM I PËRPJEKJEVE DIPLOMATIKE GJATË KONFLIKTIT TË KOSOVËS

312. Me përkeqësimin e krizës në Kosovë në 1998,⁶⁹¹ u kristalizuan aspektet kryesore të kundërshtisë midis përfaqësuesve të bashkësisë shqiptare kosovare dhe autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë. Thelbi i qëndrimit të autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë ishte se zgjidhja për Kosovën duhej të respektonte tërësinë territoriale, sovranitetin dhe kufijtë e njohur ndërkombëtarisht të RFJ-së dhe Serbisë, dhe duhej bazuar në respektin e plotë për barazinë e të gjithë qytetarëve dhe pakicave kombëtare në Kosovë. Për pakicat kombëtare në Kosovë u mendua një farë forme e vetëqeverisjes së gjerë, kurse opsioni i pavarësisë së drejtpërdrejtë u refuzua vendosmërisht. Gjithashtu ekzistonte një mungesë e theksuar vullneti për praninë e trupave të huaja në territorin e RFJ-së.⁶⁹² Nga ana tjetër, qëndrimi i përfaqësuesve shqiptarë kosovarë ishte se duhej mbajtur referendum popullor i cili do të shpinte në pavarësinë e Kosovës. Gjithashtu ata kërkuan sigurime për mosshpërndarjen e UÇK-së.⁶⁹³

313. Duke qenë se gjatë vitit 1998 u bë gjithnjë e më e qartë se negociatat e drejtpërdrejta midis shqiptarëve kosovarë dhe autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë nuk kishin të ngjarë të zhvilloheshin, dhe se nuk do të arrihej në një zgjidhje, vëmendja ndërkombëtare u kthye te ndërmjetësimi ndërkombëtar.⁶⁹⁴ Përpjekjet për një zgjidhje politike midis palëve u shoqëruan me zbatimin e sanksioneve kundër RFJ-së dhe kërcënimeve të vazhdueshme për veprim ushtarak të NATO-s, të dy këto taktika synonin të ushtronin presion ndaj palëve për të negociuar një zgjidhje paqësore.⁶⁹⁵

314. Organi kryesor ndërkombëtar i përfshirë në negociatat për Kosovën në 1998 dhe në 1999 ishte “Grupi i Kontaktit” që fillimisht u formua si reagim ndaj krizës në Bosnjë - Hercegovinë gjatë gjysmës së parë të viteve ‘90 dhe përbëhej prej përfaqësuesve nga Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Italia, Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara dhe Rusia.⁶⁹⁶ Siç diskutohet më poshtë, që prej fillimit Grupi i Kontaktit e kundërshtoi vendosmërisht idenë e pavarësisë së Kosovës, duke bërë të qartë ndërkaq se krahina duhej të gëzonte autonomi më të gjerë.

⁶⁹¹ P455 (Rezoluta 1160 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së).

⁶⁹² 1D204 (Mbështetje e Marrëveshjes Holbrooke–Millosheviq prej Qeverisë së Serbisë, 14 tetor 1998); 1D91 (Propozim i Përbashkët i Marrëveshjes mbi Kornizën Politike të Vetëqeverisjes në Kosovë, 20 nëntor 1998). *Shih edhe* Wolfgang Petritsch, T. 10870–10871 (2 mars 2007).

⁶⁹³ Wolfgang Petritsch, T. 10870–10872 (2 mars 2007).

⁶⁹⁴ Wolfgang Petritsch, T. 10872 (2 mars 2007).

⁶⁹⁵ *Shih* Pjesa F, Kapitulli VI.

⁶⁹⁶ Wolfgang Petritsch, T. 10710 (28 shkurt 2007). Politikanët e rangut të lartë që morën pjesë në Grupin e Kontaktit ishin: Madeleine Albright, Sekretarja amerikane e Shtetit; Robin Cook, Sekretari i jashtëm britanik; Hubert Vedrine, Ministri i jashtëm francez; Joshka Fischer, Ministri i jashtëm gjerman; Lamberto Dini, Ministri i jashtëm italian, Igor Ivanovi i Federatës Ruse, dhe Wolfgang Petritsch, përfaqësues i BE-së. Veton Surroi, T. 4549 (10 tetor 2006).

B. PËRPIEKJET DIPLOMATIKE PARA RAMBUJESË

1. Përpijekje e para për një zgjidhje politike

315. Ndërkohë që kërkoheshin mënyrat për gjetjen e zgjidhjes, bashkësia ndërkombëtare e intensifikoi pjesëmarrjen në negociata gjatë vitit që i parapriu Konferencës së Rambujesë në shkurt 1999. Veçanërisht Shtetet e Bashkuara ishte më aktive në ushtrimin e presionit ndaj shqiptarëve kosovarë për të shkuar në tryezën e bisedimeve. Pak kohë pas zgjedhjeve të organizuara për parlamentin “hije” në Kosovë në mars 1998, i Dërguari i Posaçëm i SHBA-së, Robert Gelbard i nxiti shqiptarët kosovarë të formonin një ekip negociatorësh, më vonë i quajtur “G15,” për përfaqësimin e interesave të tyre në diskutimet me autoritetet shtetërore.⁶⁹⁷

316. Profesori Ratko Marković, i cili ishte njëri prej pesë zëvendëskryeministrave të Republikës së Serbisë në atë kohë, shpjegoi se bashkësia ndërkombëtare i kishte paraqitur kërkesa të ngjashme palës jugosllave/serbe. Duke marrë parasysh edhe intensifikimin e aksioneve të UÇK-së, qeveria serbe u nxit për të emëruar një grup negociatorësh që do të negocionin me shqiptarët kosovarë. Si rezultat, më 10 mars 1998, qeveria emëroi Markovićin në krye të këtij grupi për negociimin me udhëheqësit e partive politike shqiptare kosovare, si dhe përfaqësuesit e “jetës publike dhe kulturore” të Kosovës.⁶⁹⁸ Më 11 mars 1998, qeveria lëshoi një deklaratë që informonte publikun për këto zhvillime dhe ftonte përfaqësuesit shqiptarë kosovarë të merrnin pjesë në bisedimet e planifikuara ditën e nesërme, më 12 mars në Prishtinë.⁶⁹⁹ Gjithashtu udhëheqësve shqiptarë kosovarë iu dërguan ftesa në adresat e tyre vetjake.⁷⁰⁰ Një ngjarje që vlen të përmendet në atë kohë dhe që ndodhi pikërisht para emërimit të Ratko Markovićit, ishte operacioni i autoriteteve të RFJ-së/Serbisë kundër Adem Jasharit, anëtar i mirënjohur i UÇK-së, që rezultoi në vdekjen e një numri të madh të familjarëve të tij dhe u bë shkak për dënimin nga bashkësia ndërkombëtare.⁷⁰¹

317. Përfaqësuesit e ftuar të shqiptarëve kosovarë nuk morën pjesë në takimin e 12 marsit 1998. Delegacioni serb planifikoi një takim tjetër për të nesërmen, dhe më tej planifikoi takime për çdo ditë të javës vijuese, por çdo herë përfaqësuesit e partive kryesore politike të shqiptarëve kosovarë

⁶⁹⁷ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 3.

⁶⁹⁸ Ratko Marković, T. 13124–13128, 13135–13136 (8 gusht 2007); 1D78 (Deklaratë e Qeverisë së Republikës së Serbisë, 11 mars 1998). Në delegacion merrnin pjesë edhe Ratomir Vico, Andreja Millosavleviq, dhe Ivan Sedllak. Më vonë delegacioni u zgjerua me Millovan Bojiqin dhe Tomisllav Nikoliqin. Gjithashtu Presidenti i RFJ-së emëroi të dërguarin e tij të posaçëm, konkretisht Vlladan Kutleshiq. *Shih edhe* Andreja Millosavleviq, T. 14261–14262 (23 gusht 2007), T. 14332–14335 (24 gusht 2007). Në lidhje me këtë pike veprimtaritë në nivel republike u mbështetën prej qeverisë së RFJ-së. 2D32 (Dokument i Ministrisë së Punëve të Jashtme për sesionin e 76-të të qeverisë së RFJ-së, 25 mars 1998).

⁶⁹⁹ 1D78 (Deklaratë e Qeverisë së Republikës së Serbisë, 11 mars 1998).

⁷⁰⁰ Ratko Marković, T. 13128 (8 gusht 2007).

⁷⁰¹ *Shih* Nënpyesa 3, Pjesa C, Kapitulli VI.

nuk morën pjesë.⁷⁰² Të vetmit të ftuar të cilët u paraqitën, ishin përfaqësuesit e dy partive më të vogla të shqiptarëve kosovarë, përkatësisht Faik Jashari dhe Sokol Qusa si dhe përfaqësuesit e etnive të tjera në Kosovë.⁷⁰³ Duke marrë parasysh mosardhjen e shqiptarëve kosovarë, Presidenti i Republikës së Serbisë shprehu gatishmërinë të bëhej garantues i bisedimeve.⁷⁰⁴

318. Më 31 mars 1998 Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1160 me synim inkurajimin e ecjes më tej të procesit negociues. Këshilli i Sigurimit kritikoi përdorimin e “forcës së tepruar prej forcave policore serbe” kundër civilëve në Kosovë dhe dënoi fuqimisht të tëra veprimet terroriste të UÇK-së. Gjithashtu u konfirmua angazhimi i të gjithë shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara ndaj sovranitetit dhe tërësisë territoriale të RFJ-së dhe iu bë thirrje të dy palëve të fillonin menjëherë negociatat, duke theksuar gatishmërinë e Grupit të Kontaktit për ndihmë. Veç pranimit se parimet e zgjidhjes së problemit duhet të kenë si bazë paprekshmërinë tokësore të RFJ-së, rezoluta gjithashtu pohonte se në këto parime duhej parashikuar një autonomi më e gjerë dhe vetëqeverisje më thelbësore për Kosovën.⁷⁰⁵

319. Gjatë periudhës prill-nëntor 1998 delegacioni serb në të cilin bënte pjesë edhe Millutinoviqi bëri përpjekje të tjera për nisjen e dialogut politik dhe organizimin e takimeve me përfaqësuesit e partive kryesore politike të shqiptarëve kosovarë. Konkretisht, afërsisht në 16 raste këtyre përfaqësuesve iu dërguan ftesa, të cilat vazhduan të shpërfilleshin prej udhëheqësve të partive kryesore politike shqiptare kosovare. Sërisht të pranishëm në këto takime ishin përfaqësuesit e pakicave etnike në Kosovë dhe partive më të vogla politike të shqiptarëve kosovarë.⁷⁰⁶

⁷⁰² Ratko Markoviç, T. 13128–13131 (8 gusht 2007), T. 13479 (13 gusht 2007). Markoviçi dëshmoi se shqiptarët ishin njoftuar si duhet, nëpërmjet njoftimeve publike dhe ftesave vetjake dërguar në adresat e tyre vetjake të bisedimeve të nxitura prej delegacionit serb. Ratko Markoviç, T. 13135, 13144–13152 (8 gusht 2007). Jovan Kojiçi gjithashtu dëshmoi se shumë herë në 1998 ai i shkroi ftesat për takime/bisedime në emër të Millutinoviçit dhe ua dërgoi udhëheqësve shqiptarë, mirëpo ata nuk u përgjigjën. Vetëm Adem Demaçi u përgjigj fakt që sipas Kojiçit tregonte se udhëheqësit shqiptarë “nuk kishin aspak dëshirë për të arritur marrëveshje.” Jovan Kojiçi, T. 13744–13745 (16 gusht 2007), 1D741 (deklaratë dëshmitari me datë 27 korrik 2007), para. 37. *Shih edhe* 1D67 (Letër e Rexhep Qosjes dhe Hydajet Hysenit drejtuar Millutinoviçit, 20 nëntor 1998). Velko Odaloviçi, Kryetari i Qarkut të Kosovës në 1998 dëshmoi se ftesat dërguar udhëheqësve të partive politike shqiptare kosovare u dorëzuan nëpërmjet qarkut të Kosovës. Një korrier i zyrës së tij ua dorëzonte ftesat udhëheqësve shqiptarë në adresat e tyre. Velko Odaloviçi, T. 14399–14400 (24 gusht 2007).

⁷⁰³ Ratko Markoviçi, T. 13133 (8 gusht 2007), T. 13479–13480 (13 gusht 2007).

⁷⁰⁴ 1D79 (Deklaratë e Presidentit të Republikës së Serbisë Millan Millutinoviçi mbi Procesin Politik në Kosovë); Jovan Kojiçi, 1D741 (deklaratë dëshmitari me datë 27 korrik 2007), para. 34.

⁷⁰⁵ P455 (Rezoluta 1160 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara).

⁷⁰⁶ Ratko Markoviçi, T. 13143–13160 (8 gusht 2007), T. 13482–13483, 13485–13488 (13 gusht 2007); 1D82 (Deklarata e Qeverisë së Republikës së Serbisë mbi Kosovën, 31 mars 1998); 1D83 (Deklarata e Presidentit të Republikës së Serbisë, 7 prill 1998); 1D18 (Marc Weller, *The Crisis in Kosovo 1989–1999*), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 349, nënpjesa 7; 1D64 (Letër e Aganit drejtuar Markoviçit, 17 gusht 1998); 1D61 (Letër e Markoviçit drejtuar Aganit, 17 gusht 1998). Më 2 tetor 1998 Markoviçi i dërgoi një ftesë tjetër Fehmi Aganit për të filluar sa më shpejt bisedimet, mirëpo kjo përpjekje nuk dha rezultat. 1D63 (Letër e Markoviçit për Aganin, 2 tetor 1998). *Shih edhe* 2D163 (Raport i Ministrisë së Drejtësisë së RFJ-së drejtuar qeverisë së RFJ-së mbi gjendjen në Kosovë), f. 11.

320. Dhoma thekson se rrethanat e organizimit të këtyre takimeve dhe pjesëmarrja e vetëm disa të ftuarve u analizuan disa herë gjatë shqyrtimit të provave. Pati debate në lidhje me faktin nëse njoftimi i vonuar në disa raste tregonte se këto nuk ishin përpjekje të njëmendta për organizimin e negociatave dobiprurëse, dhe një farë vëmendje iu kushtua mospërputhjeve në datën e një ftese.⁷⁰⁷ Pas shqyrtimit të të gjitha provave, Dhoma konkludon se megjithëse përpjekjet fillestare në kushte mjaft imponuese, nuk ishin inkurajuese për bashkëpunimin e shqiptarëve kosovarë dhe mund të ishin trajtuar më diplomatikisht, në fund të fundit arsyeja e vërtetë e mosafritit të të dy palëve ishte se qëndrimet e tyre përkatëse ishin shumë të ndryshme. Gjithashtu këto përpjekje duhen parë në kontekstin e zhvillimit të ngjarjeve në terren në Kosovë, ku përfshihet incidenti Jashari në pranverë dhe veprime të gjera luftarake të forcave të MPB-së dhe UJ-së prej fillimit të verës deri në shtator 1998, bazuar në Planin për Luftimin e Terrorizmit, që diskutohet më poshtë.⁷⁰⁸

321. Takimet e zhvilluara me pjesëmarrjen e delegacionit serb dhe përfaqësuesve të pakicave etnike të Kosovës dhe partive të vogla të shqiptarëve të Kosovës, në fund të nëntorit rezultuan në një “Propozim i Përbashkët për Marrëveshje mbi Kornizën Politike të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe Metohi”.⁷⁰⁹ Mirëpo megjithëse ky dokument u mbështet më 25 nëntor 1998 nga të gjithë pjesëmarrësit në negociata, në fund të fundit ata përfaqësonin vetëm një përqindje të vogël të popullatës së Kosovës. Dokumenti u nënshkrua nga Vlladan Kutilleshiq, zëvendëskryeministër, në emër të RFJ-së, kurse Markoviqi nënshkroi në emër të Republikës së Serbisë. Në lidhje me shqiptarët kosovarë, vetëm përfaqësuesit e dy partive më të vogla politike nënshkruan.⁷¹⁰ Sipas Millan Jovanoviqit, thelbi i marrëveshjes së propozuar të përbashkët ishte vendosja e barazisë së plotë të të drejtave të të gjitha etnive në Kosovë nëpërmjet krijimit të një procedure të posaçme për Kuvendin e Kosovës që do të eliminonte mundësinë e një grupi etnik të mposhtte me votim një grup tjetër etnik.⁷¹¹

⁷⁰⁷ *Shih për shembull*. Ratko Markoviq, T. 13476–13478, 13490–13491 (13 gusht 2007); Wolfgang Petritsch, T. 10786–10788 (1 mars 2007), T. 10956–10957 (2 mars 2007).

⁷⁰⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10956–10957 (2 mars 2007). Rrjedha e ngjarjeve që çuan në Planin për Luftimin e Terrorizmit trajtohet në Nënnpjesa 1, Pjesa E, Kapitulli VI.

⁷⁰⁹ 1D91 (Propozim i Përbashkët për Marrëveshje mbi Kornizën Politike të Vetëqeverisjes në Kosovë, 20 nëntor 1998). *Shih edhe* Ratko Markoviq, T. 13175–13180 (9 gusht 2007); Millan Jovanoviq, T. 14183 (22 gusht 2007).

⁷¹⁰ Sipas Markoviqit marrëveshja u bazuar mbi bisedimet ku morën pjesë Hill dhe O’Brien. Marrëveshja u nënshkrua edhe prej përfaqësuesve të këtyre pakicave etnike: serbë dhe malazezë, turq, goranë, myslimanë, romë, dhe egjiptianë. Ratko Markoviq, T. 13175–13180 (9 gusht 2007); T. 13532 (14 gusht 2007). *Shih edhe* Millan Jovanoviq, T. 14183–14184 (22 gusht 2007); 1D91 (Propozim i Përbashkët për Marrëveshje mbi Kornizën Politike të Vetëqeverisjes në Kosovë); 1D603 (Deklaratë për Shtypin e Millan Millutinoviqit, 20 nëntor 1998); 1D620 (Deklaratë e nënshkruarve të Marrëveshjes, 25 nëntor 1999); 1D671 (Buletin shtypi në Politika mbi Marrëveshjen, 26 nëntor 1998); 2D163 (Raport i Ministrisë së Drejtësisë së RFJ-së drejtuar qeverisë së RFJ-së mbi gjendjen në Kosovë, 29 dhjetor 1998), f. 13–14.

⁷¹¹ Millan Jovanoviq, T. 14184–14186 (22 gusht 2007). *Shih edhe* 1D91 (Propozim i Përbashkët për Marrëveshje mbi Kornizën Politike të Vetëqeverisjes në Kosovë), Kapitulli IV. Pas nënshkrimit të Deklaratës së Prishtinës Millutinoviqit u takua sërish me nënshkruarët më 9 dhjetor 1998 për vazhdimin e negociatave mbi veprimtari të tjera për arritjen e zgjidhjes politike në Kosovë. Pjesëmarrësit diskutuan edhe projektin e fundit paraqitur nga Christopher Hill dhe e

322. Veç përpjekjeve të lartpërmendura, ambasadori amerikan në Maqedoni, Christopher Hill, me ndihmën e ekspertit të tij ligjor, James O'Brien, veproi si moderator dhe ndërmjetës midis dy palëve në vitin 1998 dhe më 1999, në përpjekje për të ndihmuar në hartimin e një plani për autonominë e Kosovës. Markoviqi dhe Millutinoviqi morën pjesë në këto bisedime, të cilat u mbajtën paralelisht me përpjekjet e pasuksesshme për zhvillimin e negociatave të drejtpërdrejta. Hill dhe O'Brien i paraqitën delegacionit serb propozimet e tyre për komente. Më tej Hill dhe O'Brien ua përcollën komentet shqiptarëve kosovarë dhe i përcollën delegacionit serb pikëpamjet e shqiptarëve.⁷¹² Përpjekjet ndërmjetësuese rezultuan në një numër projekt-marrëveshjesh ndër të cilat disa propozime të cilat më vonë u përfshinë në projekt-marrëveshjen e Rambujesë.⁷¹³ Përmbledhtazi, këto projekte parashtruan mënyrën politike ndaj dhënies fund të krizës me dispozita për mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe sovranitetit të RFJ-së, duke mundësuar barazi dhe respektim të të drejtave të të gjitha pakicave kombëtare në Kosovë dhe krijimin e kuadrit ligjor për vetëqeverisje për shqiptarët kosovarë.⁷¹⁴ Ambasadori austriak në RFJ, Wolfgang Petritsch, i cili gjithashtu kishte marrë pjesë në negociata, konfirmoi se nga dhjetori 1998 udhëheqës të UÇK-së si Adem Demaçi, po bëheshin pengues veçanërisht nëpërmjet kritikizmit të Hill-it dhe Holbrooke-ut, mirëpo duke qenë se ata përfaqësonin një përqindje të konsiderueshme të popullatës shqiptare kosovare, lipsej të përfshiheshin në negociata.⁷¹⁵

hodhën poshtë duke qenë se ndryshonte në masë të konsiderueshme prej projekt-marrëveshjes. Në këtë takim mori pjesë edhe Shainoviqi. Shih 1D605 (Deklaratë e Millan Millutinoviqit për Shtypin, 9 dhjetor 1998).

⁷¹² Ratko Markoviq, T. 13165–13167 (8 gusht 2007); Jovan Kojiq, 1D741 (deklaratë dëshmitari me datë 27 korrik 2007), para. 34–35; Zhivadin Jovanoviq, T. 13997 (20 gusht 2007). *Shih* 1D625 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim amerikan, 7 korrik 1998); 1D610 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim jugosllav, 11 korrik 1998); 1D611 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim jugosllav, 13 korrik 1998); 1D612 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim jugosllav, 14 korrik 1998); 1D626 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim amerikan, 20 korrik 1998); 1D613 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim jugosllav, 26 korrik 1998); 1D614 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – Propozim jugosllav, 27 korrik 1998); 1D615 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – Propozim jugosllav, 28 korrik 1998); 1D616 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – Propozim jugosllav, 29 korrik 1998); 1D730 (Komente të shqiptarëve kosovarë mbi projekt-dokumentin amerikan, 16 shtator 1998); 1D617 (Koment dhe vërejtje mbi projekt-dokumentin amerikan, 25 shtator 1998), gjithashtu pranuar si 1D728; 1D701 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim amerikan, 29 shtator 1998); 1D618 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim jugosllav, 30 shtator 1998); 1D702 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim amerikan, 6 tetor 1998); 1D694 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – Propozim amerikan, 9 tetor 1998); 1D695 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim jugosllav, 29 tetor 1998); 1D703 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim amerikan, 29 tetor 1998); 1D696 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim jugosllav, 1 nëntor 1998); 1D627 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim amerikan, 2 nëntor 1998); 1D628 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim amerikan, 13 nëntor 1998).

⁷¹³ Ratko Markoviq, T. 13166 (8 gusht 2007), T. 13175 (9 gusht 2007); Wolfgang Petritsch, T. 10711 (28 shkurt 2007).

⁷¹⁴ *Shih për shembull* 1D695 (Marrëveshje mbi të drejtat e grupeve kombëtare në Kosovë – propozim jugosllav, 29 tetor 1998); 1D604 (Deklaratë e Millan Millutinoviqit për Shtypin, 23 nëntor 1998).

⁷¹⁵ Wolfgang Petritsch, T. 10829–10830 (1 mars 2007). *Shih edhe* 1D18 (Marc Weller, Kriza në Kosovë 1989–1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 373–379.

323. Gjithashtu Dhoma dëgjoi dëshmi të një takimi kokë më kokë midis delegacionit serb dhe udhëheqësve të partive kryesore politike të shqiptarëve kosovarë më 22 maj 1998.⁷¹⁶ Ambasadori amerikan Richard Holbrooke bashkëpunoi me të dy palët gjatë majit 1998 për negociimin e një zgjidhjeje dhe me inkurajimin e tij, më 15 maj 1998 u mbajt një takim midis Presidentit Millosheviq dhe një grupi prej pesë përfaqësuesish të shqiptarëve kosovarë prej G15-ës (“G5”). Anëtarët e G5-ës ishin: Ibrahim Rugova, udhëheqës i LDK-së; Veton Surroi, gazetar shqiptar kosovar; Fehmi Agani, ndihmësi më i afërt i Rugovës; Mahmut Bakalli, ish-udhëheqësi komunist partiak i Kosovës; dhe Pajazit Nushi, Kryetari i Këshillit për Mbrojtjen e Të Drejtave dhe Lirive të Njeriut.⁷¹⁷ Gjatë këtij takimi biseda u përqëndrua kryesisht në problemet mbi të drejtat e njeriut dhe veprimet e policisë në Kosovë; statusi i Kosovës nuk u diskutua.⁷¹⁸ Pastaj Millosheviqi dhe anëtarët e G5-ës ranë dakord për nisjen e takimeve të përjavshme midis përfaqësuesve të shqiptarëve kosovarë dhe autoriteteve serbe. Takimi i parë u planifikua për datën 22 maj.⁷¹⁹

324. Kur më vonë delegacioni i shqiptarëve kosovarë kërcënoi me mospjesëmarrje në takimin e 22 majit për shkak të shtimit të veprimeve ushtarake sipas tyre të forcave të RFJ-së/Serbisë në Kosovë, ambasadori Holbrooke i telefonoi Surroit dhe i tha se në qoftë se delegacioni shqiptar kosovar nuk merrte pjesë në bisedime, ata do të “humbnin besimin e Shteteve të Bashkuara.”⁷²⁰ Në fund delegacioni shqiptar kosovar pranoi të merrte pjesë në takim dhe sipas Surroit, mundën t’i shprehnin delegacionit serb pikëpamjet e tyre në lidhje me gjendjen e sigurisë në Kosovë.⁷²¹ Mirëpo Ratko Markoviqi e konsideroi këtë takim si ceremonial ose si nisje e bisedimeve të ardhshme dhe dëshmoi se në atë kohë nuk pati diskutime thelbësore. Kur delegacioni shqiptar kosovar kërkoi që Markoviqi të takonte ambasadorin Hill i cili me gjasë ndodhej aty, Markoviqi refuzoi të takohej me të dhe jo me ta.⁷²² Ai dëshmoi se të dy palët shprehën parimisht gatishmërinë për bisedime të ardhshme por nuk diskutuan infrastrukturën dhe mënyrën e bisedimeve.⁷²³

⁷¹⁶ Ratko Markoviq, T. 13154 (8 gusht 2007).

⁷¹⁷ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 3–4. G15 u reduktua në një ekip prej pesë vetësh sepse u mendua se prania e pesëmbëdhjetë njerëzve do të ishte “shumë e pavolitshme për negociatën.” Në deklaratën e tij Surroi theksoi se anëtarët e delegacionit kosovar menduan se ishte e nevojshme të veprohej në përputhje me dëshirat e Holbrooke-ut dhe qeverisë amerikane, një ndër dëshirat e të cilëve ishte “të mposhte mendimi se nuk mund të kishte ndërmjetësim ndërkombëtar”.

⁷¹⁸ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 4–6. Konkretisht Surroi theksoi se pjesëmarrësit diskutuan vdekjet në familjen Jashari dhe operacionet policore në Prekaz.

⁷¹⁹ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 7.

⁷²⁰ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 7.

⁷²¹ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 7. Për të arritur marrëveshje në takim u kërkua kompromis midis përfaqësuesve serbë të cilët nuk dëshironin prani ndërkombëtare dhe shqiptarëve kosovarë të cilët dëshironin ndërmjetësim ndërkombëtar zyrtar. Palët ranë dakord ta lejonin Hill-in të ulej në dhomën përmbri dhe të ndiqte diskutimet. Shqiptarët kosovarë përfaqësueshin ndër të tjerë prej Fehmi Aganit, Veton Surroit, Blerim Shalës, Mahmut Bakallit, dhe Bajram Kelmendit. *Shih edhe* Ratko Markoviq, T. 13154, 13159 (8 gusht 2007).

⁷²² Ratko Markoviq, T. 13154, 13159 (8 gusht 2007), T. 13489–13490 (13 gusht 2007).

⁷²³ Ratko Markoviq, T. 13160 (8 gusht 2007).

325. Takimet e propozuara javore nuk u kryen. Disa anëtarë të delegacionit shqiptar kosovar shkuan në Shtetet e Bashkuara më 29 maj për të takuar Presidentin Clinton dhe zyrtarë të tjerë të lartë amerikanë.⁷²⁴ Në lidhje me atë vizitë u raportua se Clinton-i i tha delegacionit se “nuk do të përsëritej Bosnja.”⁷²⁵ Gjatë qëndrimit në Shtetet e Bashkuara, delegacioni u informua se forcat e RFJ-së dhe Serbisë kishin filluar një ofensivë të madhe rreth Deçanit në perëndim të Kosovës.⁷²⁶

2. Misioni i Vëzhguesve Diplomatikë për Kosovën (“KDOM”)

326. Gjatë kohës së kryerjes së negociatave të lartpërmendura, më 16 qershor 1998 u arrit një marrëveshje midis Presidentit të RFJ-së Millosheviq dhe Presidentit të Republikës Ruse, Boris Yeltsin, që u akordoi përfaqësuesve të huaj diplomatikë në RFJ si dhe përfaqësuesve të KNKK-së dhe UNHCR-së autorizim të plotë për vëzhgimin dhe monitorimin e ngjarjeve në terren në Kosovë si masë për stabilizimin e një gjendjeje gjithnjë e më të dhunshme dhe të mundësonte kohë për gjetjen e një zgjidhjeje politike. Gjithashtu në marrëveshje RFJ-ja shprehte gatishmërinë për nisjen e negociatave me OSBE-në dhe se e mirëpriste misionin e saj në Kosovë.⁷²⁷ Ky hap shënoi ndryshim në qëndrimin rezistues të RFJ-së ndaj ndërkombëtarizimit të konfliktit në Kosovë dhe u konsiderua nga bashkësia ndërkombëtare si “hap shumë inkurajues” i Millosheviqit.⁷²⁸ Mirëpo vazhdimi i dhunës gjatë qershorit 1998 bëri që ambasadori amerikan Holbrooke të shkonte në Beograd për të takuar Millosheviqin, në përpjekje për gjetjen e zgjidhjes. Këshilli i Sigurimit i OKB-së realizoi krijimin e një misioni vëzhgues ndërkombëtar formal i njohur me shkurtesën KDOM, dhe më vonë e mbështeti këtë mision.⁷²⁹ Si rezultat i kësaj marrëveshjeje, prania e përfaqësuesve të huaj në Kosovë u shtua ndjeshëm.⁷³⁰

327. Shaun Byrnes, i cili merrte pjesë në KDOM-in e organizuar nga ambasada amerikane, dëshmoi se KDOM-i përfshinte tre misione të vëzhguesve ndërkombëtarë. Njëri ishte organizuar prej Rusisë (“Ru-KDOM”), Bashkimi Evropian (“EU-KDOM”), dhe Shtetet e Bashkuara (“US-

⁷²⁴ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), p. 7. Anëtarët ishin Ibrahim Rugova, Bujar Bukoshi, Fehmi Agani, dhe Veton Surroi.

⁷²⁵ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 8.

⁷²⁶ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 8. Surroi e interpretoi këtë si përgjigje të Millosheviqit ndaj takimit të tyre me Clinton-in. *Shih gjithashtu* më poshtë Pjesa C, Kapitulli VI.

⁷²⁷ 2D371 (Deklaratë e Përbashkët e Sllobodan Millosheviqit dhe Boris Yeltsin-it, 16 qershor 1996); 2D359 (Mbështetje e marrëveshjes Millosheviq-Yeltsin prej qeverisë së Serbisë, 17 qershor 1998); Shaun Byrnes, T. 12129–12130, 12133–12134 (16 prill 2007); Ratko Marković, T. 13155 (8 gusht 2007); Momir Bullatović, T. 13814 (16 gusht 2007); Zhivadin Jovanović, T. 13990–13991 (20 gusht 2007).

⁷²⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10789–10791 (1 mars 2007).

⁷²⁹ Shaun Byrnes, T. 12130, 12132–12133 (16 prill 2007). *Shih edhe* Momir Bullatović, T. 13814–13816 (16 gusht 2007); Zhivadin Jovanović, T. 13991–13993 (20 gusht 2007).

⁷³⁰ Zhivadin Jovanović, T. 13993–13996 (20 gusht 2007); 2D367 (Letër drejtuar Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme në lidhje me Listën e Diplomatëve të Huaj aktualisht në Prishtinë).

KDOM”).⁷³¹ Misioni monitorues pararendës i Komisionit Evropian,⁷³² i cili kishte qenë atje që prej majit 1998, u shndërrua në EU-KDOM. US-KDOM filloi funksionimin në fund të korrikut 1998, dhe Ru-KDOM u krijua në fillim të shtatorit 1998.⁷³³ Byrnes dëshmoi se misioni parësor i KDOM-it ishte raportimi i ngjarjeve në Kosovë për bashkësinë ndërkombëtare. Mendohej se prania ndërkombëtare e dukshme në terren mund të ndihmonte në qetësimin e situatës. Krerët e tre misionëve i paraqisnin një raport të përbashkët javor Ambasadorëve të Grupit të Kontaktit në Beograd.⁷³⁴ Karol John Drewienkiewicz, ish-shef i Misionit Verifikues për Kosovën dhe zëvendës-shef i Misionit dëshmoi se “vëzhguesit e KDOM-it kishin mandat shumë të kufizuar dhe thjesht ishin kontakte në terren të ambasadave të tyre përkatëse në Beograd”.⁷³⁵ Joseph Maisonneuve, Kreu i Qendrës Rajonale të Misionit Verifikues në Prizren, shpjegoi se roli i KDOM-it bazohej më së shumti në marrëveshjet dypalëshe midis autoriteteve të RFJ-së dhe vendeve të caktuara dhe përmendi si shembull një marrëveshje midis Shaun Byrnes-it, si përfaqësues i SHBA-së, dhe Vllastimir Gjorgjeviqit.⁷³⁶

328. Më 23 shtator 1998 Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1199, bazuar në raportet e KDOM-it dhe duke iu referuar Rezolutës 1160 në mbështetje të “hapave të ndërmarra për mundësimin e monitorimit efektiv ndërkombëtar të gjendjes në Kosovë”, dhe përshëndeti krijimin e KDOM-it. Mirëpo gjithashtu Këshilli theksoi shqetësimin e vet të thellë në lidhje me “keqësimin e shpejtë të gjendjes humanitare anembanë Kosovës” dhe “raportet për shtimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut dhe të së drejtës humanitare ndërkombëtare”. Rezoluta kërkonte ndërprerjen e luftimeve nga të gjitha palët; ndalimin e veprimeve të forcave të sigurisë prej autoriteteve të RFJ-së dhe urdhërimin e tërheqjes së tyre dhe dënimin e veprimeve terroriste prej udhëheqjes shqiptare kosovare. Aty bëhej thirrje për dialog thelbësor midis palëve, “pa kushte dhe me pjesëmarrje ndërkombëtare”, dhe kërkoi që autoritetet e RFJ-së “të mundësojnë monitorim efektiv dhe të vazhdueshëm” në Kosovë.⁷³⁷ Pas kësaj rezolute. Millutinoviqi takoi Hill-in për të diskutuar çështje në lidhje me paqen dhe qëndrueshmërinë në Kosovë. Në takim u përcaktua se nevojitej rifillimi i

⁷³¹ Shaun Byrnes, T. 12130 (16 prill 2007). Karol John Drewienkiewicz gjithashtu përmendi KDOM francez prej 15 vetësh të stacionuar në Mitrovicë dhe KDOM kanadez (“Ca-KDOM”) prej nëntë vetësh të stacionuar në Prishtinë, kur ai filloi të ndihmonte KVM-në për shkrirjen e KDOM-it brenda saj në nëntor 1998. Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 41.

⁷³² Ky mision vepronte anembanë ish-Jugosllavisë, përfshirë edhe RFJ-në, dhe e kishte selinë në Sarajevë dhe gjithashtu ishte i pranishëm në Kosovë që prej majit 1998. Jan Kickert, T. 11202–11203, 11210–11211 (7 mars 2007).

⁷³³ Shaun Byrnes, T. 12134 (16 prill 2007).

⁷³⁴ Shaun Byrnes, T. 12132–12133, 12137 (16 prill 2007). Duhan Lopçari, anëtar i Komisionit të Qeverisë Federale për Bashkëpunim me Misionin për Verifikim në Kosovë, dëshmoi se KDOM-i gjithashtu monitoronte lëvizjet e ushtrisë dhe inventarizonte armët para mbërritjes së KVM-së. Dushan Lonçar, T. 7602 (30 nëntor 2006).

⁷³⁵ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 40.

⁷³⁶ Joseph Maisonneuve, P2772 (deklaratë dëshmitari me datë 10 mars 2000), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 14, para. 11.

ngutshëm dhe intensifikimi i dialogut midis delegacionit shtetëror dhe përfaqësuesve të partive politike shqiptare kosovare për zgjidhjen e çështjeve të mbetura.⁷³⁸ Afërsisht në të njëjtën kohë siç është theksuar më herët, autoritetet e RFJ-së/Serbisë po bënë përpjekje për të negociuar me shqiptarët kosovarë të cilët vazhduan të këmbëngulnin në refuzimin e tyre për pjesëmarrje në procesin e negociatave.

3. Tetor 1998: Marrëveshja Holbrooke-Milloshëviq

329. Në fillim të tetorit 1998 Shtetet e Bashkuara me mbështetjen e Grupit të Kontaktit e dërgoi ambasadorin Holbrooke-un në Beograd, në përpjekje për të siguruar respektimin prej autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë të Rezolutave 1160 dhe 1190.⁷³⁹ Holbrooke-u nuk ishte dëshmitar në këtë proces gjyqësor, mirëpo ai u përmend në dëshmitë e një numri dëshmitarësh në provat dokumentare. Holbrooke-u i shpjegoi Petritsch-it se ai kishte "udhëzime të qarta" nga Uashingtoni, së pari për ta paralajmëruar Millosheviqin për pasojat në rast bisedimesh jo të frytshme dhe më tej të këmbëngulte për veprim ushtarak në rast të dështimit të bisedimeve.⁷⁴⁰

330. Më 12 dhe 13 tetor 1998 Holbrooke-u i raportoi NATO-s dhe i kërkoi Këshillit të NATO-të jepte "urdhërin aktivizues" ose ACTORD, për t'i mundësuar Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s përdorimin e forcës kundër RFJ-së, pas plotësimit të disa kushteve, pa qenë nevoja t'u drejtohej shteteve anëtare. Këshilli i NATO-s dhe Holbrooke-u shkuan në Beograd me ACTORD-in si mjet presioni.⁷⁴¹ Si rezultat, ai mundi të përcaktonte "kornizën për një marrëveshje formale me RFJ-në, duke i lënë për më vonë hollësitë."⁷⁴² Në Marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq përmendet gjerësisht kjo kornizë, megjithëse nuk ekziston asnjë dokument me shkrim që e pasqyron.⁷⁴³

⁷³⁷ P456 (Rezoluta 1199 e Këshillit të Sigurimit e Kombeve të Bashkuara, 23 shtator 1998). *Shih edhe* Wolfgang Petritsch, T. 10760–10761 (1 mars 2007).

⁷³⁸ 1D86 (Deklaratë publike e Kabinetit të Presidentit, 29 shtator 1998). *Shih edhe* Wolfgang Petritsch, T. 10800–10804 (1 mars 2007); P556 (Mesazh i ambasadës austriake, 30 shtator 1998).

⁷³⁹ Siç raportohet Millosheviqi i tha Holbrooke-ut se "ishin përmbushur të gjitha dispozitat e rezolutës [1199] të Kombeve të Bashkuara P2654, (Mesazh i ambasadës austriake, 7 tetor 1998), f. 1. Mirëpo ekzistojnë prova që tregojnë se RFJ-ja ishte në shkelje të Rezolutës 1199 në mënyrë të vetëdijshme. *Shih* P926 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 28 tetor 1998), f. 12, ku udhëheqja e UJ-së pranon se "nuk është zbatuar diçka nga Rezoluta 1199," konkretisht se numri i trupave të MPB-së nuk ishte pakësuar dhe se disa njësi të UJ-së nuk ishin tërhequr siç kërkohet në Rezolutë. Në një mbledhje të Kolegjiumit të UJ-së më 24 dhjetor 1998, Ojdaniqi pranoi kishin ndodhur "disa shkelje të marrëveshjes dhe deklaratave të nënshkruara në kohën që [ai] kishte marrë postin." P924 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 24 dhjetor 1998), f. 26. *Shih edhe* P560 (Mesazh i ambasadës austriake, 7 tetor 1998), f. 1.

⁷⁴⁰ P2654 (Mesazh i ambasadës austriake, 7 tetor 1998), f. 1.

⁷⁴¹ Këshilli i NATO-s i merr vendimet me unanimitet.

⁷⁴² Klaus Naumann, T. 8246–8247 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 9–10.

⁷⁴³ Klaus Naumann, P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 10.

331. Adnan Merovci, sekretari personal i udhëheqësit të LDK-së, Ibrahim Rugova, dëshmoi se Marrëveshja Holbrooke-Milloshëviq kërkonte tërheqjen prej Kosovës të një pjese të forcave të RFJ-së/Serbisë, por shtoi se dijenia që ai kishte ishte prej medias dhe shpjegoi se ai nuk e pa Marrëveshjen me sytë e tij.⁷⁴⁴ Zhivadin Jovanović, ministër i Punëve të Jashtme, i cili nënshkroi një marrëveshje të mëvonshme në lidhje me Misionin Verifikues të Kosovës (“KVM”), gjithashtu dëshmoi se nuk e kishte parë asnjëherë Marrëveshjen dhe për pasojë nuk mund të thoshte saktësisht çfarë kushtesh ekzistonin në lidhje me tërheqjen e forcave dhe ndërprerjen e luftimeve.⁷⁴⁵ Duke marrë në konsideratë marrëveshjet vijuese dhe dëshmitë e një numri dëshmitarësh, del qartë se mendohej që së paku tërheqja e pjesëve të forcave të RFJ-së/Serbisë nga Kosova do të respektonte Rezolutën 1199 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.⁷⁴⁶

332. Në mes të tetorit 1998 Marrëveshja Holbrooke – Milloshëviq u mbështet veçazi prej qeverive të Serbisë dhe RFJ-së.⁷⁴⁷ Autoritetet e RFJ-së/Serbisë ftuan një mision verifikimi të OSBE-së për monitorimin e gjendjes në Kosovë.⁷⁴⁸ Që prej Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq ishte hera e dytë që autoritetet e RFJ-së/Serbisë lejuan përfshirjen e bashkësisë ndërkombëtare, që ishte një hap vërtet shumë i rëndësishëm.⁷⁴⁹

333. Në miratimin e Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq qeveria serbe deklaroi se ishte rënë dakord për një numër parimesh, ndër të cilat respektimi i tërësisë tokësore dhe sovranitetit të RFJ-së dhe barazi e plotë për të gjithë qytetarët e Kosovës. Gjithashtu u ravigjzua një plan kohor për arritjen e zgjidhjes politike. Sipas këtij plani: (a) brenda 19 tetorit 1998, duhej arritur marrëveshje në lidhje me statusin e pranisë ndërkombëtare në Kosovë, përfshirë edhe OSBE-në; (b) brenda 2 nëntorit duhej arritur një marrëveshje që përmbante elementët bazë për zgjidhjen politike bazuar në

⁷⁴⁴ Adnan Merovci, T. 8540 (17 janar 2007); P2588 (deklaratë dëshmitari e Merovcit me datë 12 prill 2000), para. 31.

⁷⁴⁵ Zhivadin Jovanović, T. 14023–14024 (20 gusht 2007). *Shih edhe* Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 8, ku ai pohon se marrëveshja Holbrooke-Milloshëviq nuk u nënshkrua asnjëherë.

⁷⁴⁶ *Shih p.sh.*, John Crosland T. 9867–9869 (8 shkurt 2007) i cili dëshmoi se ishte përgjegjës për mbikëqyrjen e tërheqjes. *Shih edhe* P658 (Marrëveshja e KVM-së, 16 tetor 1998), e cila i referohet qartësisht Rezolutës 1199 dhe nevojës që të tëra palët ta respektonin.

⁷⁴⁷ P656 (Mbështetje e qeverisë serbe 13 tetor 1998 dhe Deklaratë e qeverisë së RFJ-së, 14 tetor 1998). *Shih edhe* 1D204 (Mbështetje e Marrëveshjes midis Të Dërguarit të Posaçëm amerikan Richard Holbrooke dhe Presidentit të RFJ-së Slllobodan Milloshëviq nga qeveria e Serbisë, 14 tetor 1998).

⁷⁴⁸ Zhivota Çosiq, T. 13698 (15 gusht 2007). *Shih edhe* 2D318 (Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së në lidhje me bisedimeve midis Shainovićit dhe De Mistura-s, Shef i Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, zhvilluar më 19 tetor 1998); 2D77 (Procesverbal i Sesionit të 90-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së); Millan Jovanović, T. 14167–14168 (22 gusht 2007).

⁷⁴⁹ Wolfgang Petritsch, T. 10826–10827 (1 mars 2007).

një dokument të Grupit të Kontaktit të 2 tetorit 1998; dhe (c) brenda 9 nëntorit duhej të përfundonte hartimi i rregullave dhe procedurave për zgjedhjet në Kosovë.⁷⁵⁰

334. Si pasojë, më 14 tetor 1998, qeveria e RFJ-së autorizoi ministrin e atëhershëm të Jashtëm, Zhivadin Jovanoviçin, që të konkludonte një marrëveshje me kryetarin e OSBE-së, Bronislaw Geremek, për ngritjen dhe funksionimin e një misioni verifikues.⁷⁵¹ Më 16 tetor 1998, Jovanoviçi dhe Geremek-u nënshkruan një marrëveshje për krijimin e KVM-së (“Marrëveshja për KVM-në”).⁷⁵² Marrëveshja për KVM-në ndër të tjera parashtroi se qëllimi i misionit ishte garantimi prej të tëra palëve i respektimit të Rezolutës 1199; verifikuesit e KVM-së do të mund të udhëtonin anembanë Kosovës për të hetuar njoftimet për shkeljet e armëpushimit; forcat ushtarake dhe policore do t’u dërgonin raporte javore verifikuesve në lidhje me lëvizjen e trupave në Kosovë ose jashtë Kosovës; KVM-ja do të merrte aktualizime prej autoriteteve përkatëse të RFJ-së/Serbisë në lidhje me akuzat për “veprime keqtrajtuese” prej personelit ushtarak dhe policor, dhe statusin e masave ligjore kundër këtyre individëve; dhe në rast se do të ftohej apo do t’i kërkohej, KVM-ja do të shoqëronte forcat e UJ-së dhe MPB-së.⁷⁵³ Më 15 tetor 1998, Momçillo Perishiq, shef i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, dhe Wesley Clark Kryekomandanti i Forcave Aleate të NATO-s, nënshkruan një marrëveshje që lejonte NATO-n të ofronte survejim nga ajri në ndihmë të misionit të KVM-së, si mënyrë e zbatimit të Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq.⁷⁵⁴ Në këtë marrëveshje gjithashtu përcaktohej që NATO-ja të kontrollonte objekte dhe pajisje të ndryshme të Forcave Ajrore dhe të Mbrojtjes Ajrore të RFJ-së brenda zonave të përcaktuara të Kosovës, ndër të cilat edhe objektet e magazinimit.

335. Pas Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq, Millutinoviçi nisi një sërë letrash më 14 nëntor 1998, duke ftuar sërish përfaqësuesit e partive kryesore shqiptare kosovare, si dhe përfaqësuesit e pakicave në Kosovë, për një takim në Prishtinë, duke iu referuar si bazë për bisedime Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq.⁷⁵⁵ Gjithashtu ai lëshoi një deklaratë për shtyp ku njoftonte se këto ftesa

⁷⁵⁰ 1D204 (Mbështetje e Marrëveshjes midis Të Dërguarit të Posaçëm amerikan Richard Holbrooke dhe Presidentit të RFJ-së Slobodan Millosheviq nga qeveria e Serbisë, 14 tetor 1998), f. 3–4. *Shih edhe* 1D601 (Deklaratë e Millan Millutinoviçit për Shtypin), pranuar gjithashtu si 2D354; 2D163 (Raport i Ministrisë së Drejtësisë së RFJ-së për qeverinë e RFJ-së mbi gjendjen në Kosovë, 29 dhjetor 1998), f. 12.

⁷⁵¹ Zhivadin Jovanoviç, T. 14007 (20 gusht 2007); 2D78 (Caktimi prej qeverisë së RFJ-së i datës së sesionit të 25-të të saj për të diskutuar projekt-marrëveshjen me OSBE-në, 14 tetor 1998).

⁷⁵² P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), pranuar gjithashtu si P432. *Shih edhe* Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 8; 2D81 (Letërkëmbim i qeverisë së RFJ-së në lidhje me tekstin e marrëveshjes midis RFJ-së dhe OSBE-së).

⁷⁵³ P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), pjesa III, para. 1–2, 4–5, 8, pranuar gjithashtu si P432.

⁷⁵⁴ P454 (Marrëveshja Clark-Perishiq, 15 tetor 1998), pranuar gjithashtu si P440 mirëpo përfshin gjithashtu një letër shoqëruese rezervë. *Shih edhe* Klaus Naumann, T. 8248–8249, 8258 (13 dhjetor 2006).

⁷⁵⁵ 1D62 (Letra të Millan Millutinoviçit për përfaqësuesit shqiptarë kosovarë, 14 nëntor 1998), pranuar gjithashtu si 1D621. Millutinoviçi gjithashtu u dërgoi letër tre shqiptarëve kosovarë të njohur, Rexhep Qosjes, Adem Demaçit, dhe Hydajet Hysenit, ku kërkonte takime si mjet për inkurajimin e bisedimeve; Ratko Markoviç, T. 13172–13173 (8 gusht

ishin dërguar dhe ndërmjet diplomatëve të tjerë të huaj përfshiu Hill-in dhe Petritsch-in.⁷⁵⁶ Ky takim u zhvillua më 18 nëntor 1998, dhe sërish udhëheqësit e partive kryesore shqiptare kosovare nuk morën pjesë, kurse të pranishëm ishin vetëm përfaqësuesit e pakicave të ndryshme që jetonin në Kosovë dhe të partive më të vogla shqiptare kosovare.⁷⁵⁷ Megjithëse Petritsch-i nuk ishte i pranishëm në këtë takim, ai deklaroi se e konsideroi si hap të madh pasi për herë të parë autoritetet serbe përfshinë negociatorët ndërkombëtarë dhe shqiptarët kosovarë.⁷⁵⁸

336. Më 20 nëntor, Millutinoviqi takoi përfaqësues të partive të ndryshme politike në Serbi. Diskutimi u përqëndrua në pikëpamjet dhe propozimet e këtyre partive dhe në mënyrën e arritjes së një “platforme botërisht të pranueshme” për zgjidhjen e problemit të Kosovës. U ra dakord që zgjidhja politike të bazohej në Marrëveshjen Holbrooke-Milloshviq. Gjithashtu u theksua vetëqeverisja demokratike e Kosovës brenda kornizës kushtetuese të RFJ-së/Serbisë.⁷⁵⁹

C. MISIONI VERIFIKUES I KOSOVËS

337. Marrëveshja për KVM-në kushtëzonte se “KDOM-i do të veprojë në vend të Misionit Verifikues të OSBE-së deri në krijimin e tij. Pas aktivizimit të OSBE-së, KDOM-i do të shkrihet brenda Misionit Verifikues.”⁷⁶⁰ Gjithsesi EU-KDOM dhe US-KDOM mbajtën një “përfaqësi të vogël” në Prishtinë në mbështetje të përpjekjeve diplomatike të Hill-it dhe Petritsch-it deri në dështimin e bisedimeve të Rambujesë.⁷⁶¹

338. Roli i parashikuar për KVM-në ishte “verifikimi i respektimit të Rezolutës 1199 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së prej të gjitha palëve, dhe raportimi i rasteve të përparimit dhe/ose

2007); 1D66 (Letër e Millan Millutinoviqit për Rexhep Qosjen, Hydajet Hysenin, dhe Adem Demaçin, 19 nëntor 1998). Më 20 nëntor 1998, Rexhep Qosja dhe Hydajet Hyseni i dërguan përgjigje Millutinoviqit ku pohonin se ata nuk besonin se diskutimet e improvizuara ngutshëm dhe private nuk mund të kontribuonin në zgjidhjen e problemit në Kosovë dhe për këtë arsye ata nuk mund të merrnin pjesë në diskutime të tilla. Ratko Markoviq, T. 13530–13531 (14 gusht 2007); 1D67 (Letër e Rexhep Qosjes dhe Hydajet Hysenit dërguar Millutinoviqit, 20 nëntor 1998).

⁷⁵⁶ 1D88 (Deklaratë e Millan Millutinoviqit për Shtypin, 14 nëntor 1998).

⁷⁵⁷ Ratko Markoviq, T. 13172 (8 gusht 2007); 1D622 (Deklaratë hapëse e Millutinoviqit në bisedimet me përfaqësuesit e grupeve kombëtare në Kosovë); 1D623 (Komente përmbyllëse të Millutinoviqit në bisedimet me përfaqësuesit e grupeve kombëtare në Kosovë); 1D92 (Letër e Millutinoviqit për Adem Demaçin, 24 nëntor 1998). *Shih edhe* 2D117 (Memorandum i zyrës në terren të Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së në lidhje me negociatat e 18 nëntorit, 17 nëntor 1998).

⁷⁵⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10810–10811 (1 mars 2007); 1D68 (Notë e Petritsch-it për Millutinoviqin, dorëzuar më 17 nëntor 1998).

⁷⁵⁹ 1D602 (Deklaratë e Millan Millutinoviqit për Shtypin, 20 nëntor 1998).

⁷⁶⁰ P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), para. 5, pranuar gjithashtu si P432.

⁷⁶¹ Zhivadin Jovanoviq, T. 14009 (20 gusht 2007); Shaun Byrnes, T.12170–12172 (16 prill 2007); Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 42. Gjithashtu sipas Drewienkiewicz-it, UK-KDOM-i që kishte afërsisht 40 vetë, u përfshi në KVM në “fillim të dhjetorit” 1998, dhe Ru-KDOM dhe Ca-KDOM, që kishin afërsisht nga 8 u përfshinë në KVM janar 1999. Një pjesë e US-KDOM-it që vepronte në Pejë, me afërsisht 30 vetë, u përfshi në KVM “pikërisht në prag të Krishtlindjes në 1998, kurse efektivit kryesor i US-KDOM-it, prej afërsisht 60 vetëve u përfshi në KVM në janar 1999.

mosrespektimit, Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, Këshillit të Sigurimit të OKB-së dhe organizatave të tjera”.⁷⁶² Gjithashtu, ndër të tjera KVM-ja do të mbikëqyrte zgjedhjet në Kosovë,⁷⁶³ raportonte ruajtjen e armëpushimit prej të gjitha palëve,⁷⁶⁴ dhe verifikonte numrin, lëvizjet dhe vendndodhjet e forcave ushtarake dhe policore të RFJ-së/Serbisë.⁷⁶⁵ Për këtë qëllim anëtarët e tij do të mund të udhëtonin anembanë Kosovës dhe do të merrnin aktualizime prej autoriteteve përkatëse të RFJ-së/Serbisë në lidhje me akuzat për “veprime keqtrajtuese” prej personelit ushtarak dhe policor, dhe statusin e masave ligjore marrë kundër këtyre individëve.⁷⁶⁶ Ambasadori amerikan William Walker u emërua kreu i Misionit KVM më 22 tetor 1998,⁷⁶⁷ kurse Karol John Drewienkiewicz ishte zëvendësi i tij.⁷⁶⁸

339. Marrëveshja për KVM-në përcaktonte se KVM-ja do të funksiononte për një vit, me mundësi të zgjatjes së mandatit.⁷⁶⁹ Ajo parashikonte 2000 “verifikues” të paarmatosur, të dërguar prej vendeve të OSBE-së, që kryesisht do të vendoseshin në Prishtinë, me “prani në terren” në vende të ndryshme rreth Kosovës, dhe një zyrë kontakti në Beograd.⁷⁷⁰ Marrëveshja për KVM-në gjithashtu parashikonte “ekspertë të tjerë teknikë”.⁷⁷¹ Duke qenë se OSBE-ja nuk kishte personel të vet të mjaftueshëm, shtetet anëtare të OSBE-së të cilët kontribuonin financimin, ofruan personel për KVM-në.⁷⁷² Veçori spikatëse e marrëveshjes për KVM-në është se u konkludua midis instancave qeveritare dhe OSBE-së. Rrjedhimisht prej saj dilnin detyrime ndaj RFJ-së dhe Serbisë, mirëpo marrëveshja nuk e përfshiu UÇK-në si palë dhe as nuk impononte detyrime ndaj kësaj organizate.

340. Gjatë periudhës 17 - 21 tetor 1998, një delegacion nga Sekretariati i OSBE-së në Vjenë udhëtoi nëpër Kosovë në një “mision faktmbledhës”,⁷⁷³ ku zhvilloi disa takime me autoritetet

⁷⁶² P658 (Marrëveshja e KVM-së, 16 tetor 1998), pjesa II, para. 1, pranuar gjithashtu si P432. Hollësitë e krijimit, mbarimit të mandatit, rregullat konkrete të funksionimit, përbërja, mjetet dhe prania në terren e KVM-së u parashtruan në Marrëveshje.

⁷⁶³ P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), pjesa II, para. 4, pranuar gjithashtu si P432.

⁷⁶⁴ P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), pjesa III, para. 1, pranuar gjithashtu si P432.

⁷⁶⁵ P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), pjesa III, para. 2–5, pranuar gjithashtu si P432.

⁷⁶⁶ P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), pjesa III, para. 1–2, 4–5, 8, pranuar gjithashtu si P432.

⁷⁶⁷ P634 (Kronologji e ngjarjeve më të rëndësishme në Kosovë gjatë periudhës 15 tetor 1998 – 15 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2.

⁷⁶⁸ Joseph Maisonneuve, P2772 (deklaratë dëshmitari me datë 10 mars 2000), para. 8; Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 32; P634 (Kronologji e ngjarjeve më të rëndësishme në Kosovë gjatë periudhës 15 tetor 1998 – 15 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2.

⁷⁶⁹ P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), para I, para. 10, pranuar gjithashtu si P432.

⁷⁷⁰ Sandra Mitchell, T. 526 (10 korrik 2006); P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), pjesa IV, para. 2–5, pranuar gjithashtu si P432.

⁷⁷¹ P658 (Marrëveshja për KVM-në, 16 tetor 1998), pjesa IV, para. 2, pranuar gjithashtu si P432.

⁷⁷² Sandra Mitchell, T. 499 (10 korrik 2006).

⁷⁷³ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 11; P634 ((Kronologji e ngjarjeve më të rëndësishme në Kosovë gjatë periudhës 15 tetor 1998 – 15 prill 1999), f. 2. *Shih edhe* 2D87 (Raport i Ministrisë së Jashtme të RFJ-së mbi vizitën e Ekipit Teknik të OSBE-së, 23 tetor 1998).

përkatëse të RFJ-së, ndër të cilat një delegacion serb në Beograd, për diskutimin e kushteve të ndryshme për KVM-në.⁷⁷⁴ Më 19 tetor 1998, qeveria e RFJ-së krijoi “Komisionin e Qeverisë Federale për Bashkëpunim me Misionin Verifikues të OSBE-së në Kosovë dhe Metohi”, kryesuar prej zëvendëskryeministrit të RFJ-së, Nikolla Shainoviq dhe në përbërje të të cilit ishin politikanë të lartë dhe zyrtarë të UJ-së dhe MPB-së.⁷⁷⁵ Funkzionimi i këtij Komisioni përshkruhet me hollësi në Pjesën e mëposhtme D të Kapitullit VI.

341. KVM-ja ishte organizatë e madhe e ndarë në disa degë përgjegjësie. Më 5 nëntor 1998 disa zëvendëshefa të Misionit u ngarkuan me përgjegjësi në fusha të ndryshme.⁷⁷⁶ KVM-ja e ngriti selinë në Prishtinë më 11 nëntor 1998, e cila u pasua me hapjen e pesë qendrave rajonale të KVM-së në Prizren (RC1), Mitrovicë (RC2), Pejë (RC3), Gjilan (RC4), dhe Prishtinë (RC5).⁷⁷⁷ Secila prej këtyre qendrave kishte punonjës që ishin caktuar si pika kontakti me UJ-në, MPB-në dhe UÇK-në. Në tërësi qendrat rajonale të KVM-së kishin përgjegjësi të 42 qendrave koordinuese për monitorimin më efektiv të një zone më të madhe.⁷⁷⁸ Këto zyra në terren u ngritën brenda 90 ditësh pas nënshkrimit të Marrëveshjes, mirëpo KVM-ja nuk arriti asnjëherë në numrin e punonjësve që kishte planifikuar.⁷⁷⁹

342. Raportet e kontakteve, raportet ditore dhe raportet e misioneve (nga aspekti operativ) shpërndaheshin rregullisht brenda tërë strukturës hierarkike të KVM-së.⁷⁸⁰ Vëzhguesit e KVM-së monitoronin dhe raportonin thujse përditë në lidhje me lëvizjen dhe operacionet e forcave të RFJ-së/Serbisë, luftimet midis forcave të RFJ-së/Serbisë dhe UÇK-së, incidentet e dhunës dhe “ngjarje të tjera të rëndësishme” anembanë Kosovës.⁷⁸¹

343. Më 5 nëntor Presidenti serb Millutinoviq bëri një deklaratë publike ku afirmoi angazhimin e Serbisë për zgjidhjen e konfliktit të Kosovës me mjete politike dhe në mbështetje të misionit të

⁷⁷⁴ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 12, 18–19.

⁷⁷⁵ Zhivadin Jovanoviq, T. 14026–14029 (20 gusht 2007); 2D8 (Vendim i qeverisë së RFJ-së për krijimin e Komisionit Federal për Bashkëpunim me KVM-në, 19 tetor 1998); 2D9 (Plotësues i vendimit të qeverisë së RFJ-së për krijimin e Komisionit Federal për Bashkëpunim me KVM-në, 29 tetor 1998); 2D81 (Letërkëmbim i qeverisë së RFJ-së në lidhje me tekstin e marrëveshjes midis RFJ-së dhe OSBE-së). *Shih edhe* Velko Odaloviq, T. 14423–14424 (27 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14756–14757 (31 gusht 2007).

⁷⁷⁶ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 34; P763 (Plan Operativ i Seksionit për Të Drejtat e Njeriut i KVM-së, 17 dhjetor 1998).

⁷⁷⁷ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 49; P634 ((Kronologji e ngjarjeve më të rëndësishme në Kosovë gjatë periudhës 15 tetor 1998 – 15 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2.), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2. Joseph Maisonneuve shef i RC1-it. *Shih* Joseph Maisonneuve, P2772 (deklaratë dëshmitari me datë 10 mars 2000), para. 6.

⁷⁷⁸ Karol John Drewienkiewicz, T. 7741, 7745–7749 (4 dhjetor 2006), P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 44, 49; Sandra Mitchell, T. 498–499 (10 korrik 2006); Joseph Maisonneuve, P2772 (deklaratë dëshmitari me datë 10 mars 2000), para. 6.

⁷⁷⁹ Sandra Mitchell, T. 498–499 (10 korrik 2006).

⁷⁸⁰ Karol John Drewienkiewicz, T. 7738–7748 (4 dhjetor 2006).

⁷⁸¹ P407 (Libri i Kaltër i OSBE-së/KVM-së).

KVM-së. Millutinoviçi deklaroi se ishte arritur marrëveshje për KVM-në, për verifikimin e së vërtetës dhe eliminimin e thashethemeve, spekulimeve dhe nxitjen e organizuar të medias.⁷⁸² Sipas Momir Bullatoviçit, ish-Kryeministër i RFJ-së, autoritetet e RFJ-së/Serbisë e mbështetën këtë përpjekje për të ndihmuar verifikuesit, nëpërmjet investimit të madh në personel dhe burime gjatë mandatit të KVM-së.⁷⁸³

D. TAKIMET ME PËRFAQËSUESIT E NATO-S

344. Gjenerali Klaus Naumann dhe gjenerali Wesley Clark patën tri takime me Presidentin e RFJ-së Millosheviq, në periudhën prej arritjes së Marrëveshjes Holbrooke-Millosheviq më 13 tetor 1998 deri në janar 1999. Takimi i parë u zhvillua më 15 tetor 1998 dhe në të morën pjesë edhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Momçillo Perishiq si dhe Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana. Qëllimi i këtij takimi ishte që Millosheviqit t'i bëhej i qartë serioziteti i synimeve të NATO-s në lidhje me veprimet e RFJ-së në Kosovë dhe mostërheqjen e forcave të saj.⁷⁸⁴ Takimi zgjati afërsisht pesë orë dhe më së shumti biseda u zhvillua midis Solanës dhe Millosheviqit. Millosheviqit iu përmend ekzistenca e ACTORD-it dhe iu tha se RFJ-ja mund të bombardohej në rast se forcat e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë nuk pakësoheshin ndjeshëm. Sipas Naumann-it, më tej Millosheviqi pyeti Perishiqin për numrin e forcave në Kosovë, i cili u përgjigj se raportet e zbulimit të NATO-s në lidhje me forcat “e tepërta” të UJ-së ishin të sakta. Më tej Naumann-i dëshmoi se ai dhe kolegët e tij menduan se Millosheviqi ishte qendra e pushtetit në RFJ dhe për këtë arsye në fund të takimit Solana foli vetëm për vetëm me Millosheviqin dhe i tha se kërcënimet e NATO-s ishin serioze dhe nuk kishte më kohë për lojëra.⁷⁸⁵

345. Naumann-i dëshmoi se më pas u mbajtën një sërë mbledhjesh, i pari prej të cilëve u zhvillua në Beograd më 24 tetor 1998, ku morën pjesë Millosheviqi, Clark-u dhe Naumann-i. Të pranishëm ishin edhe Perishiqi, Millutinoviçi dhe Shainoviçi dhe një numër gjeneralësh të MPB-së. Ky takim zgjati 90 minuta, dhe qëllimi ishte sërish të paralajmërohej Millosheviqi që të pakësonte praninë e MPB-së dhe UJ-së në Kosovë dhe të nxiteshin forcat e RFJ-së dhe Serbisë të ndalonin përdorimin e forcës së tepruar kundër popullatës civile. Millosheviqit i rikujtuan ACTORD-in dhe faktin se

⁷⁸² Ratko Markoviç, T. 13170–13172 (8 gusht 2007); 1D45 (Deklaratë e Millan Millutinoviçit për Shtypin, 5 nëntor 1998). *Shih edhe* Zhivadin Jovanoviç, T. 14008 (20 gusht 2007); Momir Bullatoviç, T. 13816–13817, 13834 (16 gusht 2007); Millan Jovanoviç, T. 14168 (22 gusht 2007); 2D67 (Konkluzione të Kuvendit Federal të RFJ-në), para. 11; 2D77 (Procesverbal i Sesionit të 90-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së), f. 2.

⁷⁸³ Momir Bullatoviç, T. 13816–13819 (16 gusht 2007).

⁷⁸⁴ Klaus Naumann, T. 8247–8248 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 3–4; P2512 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda nr. IT-02-54-T), T. 6965–6973.

⁷⁸⁵ Klaus Naumann, T. 8250–8251 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 5–7.

NATO-ja mund ta sulmonte RFJ-në brenda 48 orësh. Mirëpo ai mohoi përdorimin e forcës së tepruar dhe ushtrimin e saj kundër popullatës civile.⁷⁸⁶

346. Menjëherë pas këtij takimi u zhvilluan një sërë takimesh teknike me delegacione më të mëdha, ku mori pjesë edhe Shaun Byrnes nga US KDOM.⁷⁸⁷ Nga pala jugosllave merrnin pjesë Millutinoviqi, Shainoviqi dhe disa oficerë ushtarakë dhe policorë, ndër të cilët Vllastimir Gjorgjeviqi dhe dy gjeneralë të tjerë të MPB-së emrat e të cilëve Naumann-i nuk i mbante mend. Çështja themelore që u diskutua ishte numri i forcave të RFJ-së/Serbisë që duhej të ishin të pranishme në Kosovë.⁷⁸⁸

347. Po atë ditë më vonë, më 24 tetor 1998 me këshillë të Perishiqit përfaqësuesit e NATO-s takuan sërish Millosheviqin në praninë e të njëjtëve individë. Gjatë dy orëve u ushtrua presion ndaj Millosheviqit dhe në fund pasi bisedoi me këshilltarët e tij, ndër të cilët Millutinoviqi dhe Perishiqi, ai pranoi të plotësonte kërkesat e NATO-s dhe kërkoi që hollësitë e marrëveshjes për numrin e forcave të UJ-së dhe MPB-së të negocioheshin me Millutinoviqin, Perishiqin dhe Gjorgjeviqin. Negociatat zgjatën afërsisht gjashtë orë deri në 5 të mëngjesit të 25 tetorit. Marrëveshja u hartua në atë formë që Millutinoviqi të ishte i gatshëm t'ia paraqiste Millosheviqit.⁷⁸⁹ Sipas Millorad Obradoviqit, i cili gjithashtu mori pjesë në këto negociata, Perishiqi e pranoi marrëveshjen por u tha Naumann-it dhe Clark-ut se edhe UÇK-ja duhej ta respektonte marrëveshjen, dhe se, po të mos ndodhte kështu, ai do të detyrohej t'i kthente njësitë e UJ-së në territorin prej të cilit ishin tërhequr. Clark-u dhe Naumann-i e pranuan këtë kërkesë dhe premtuan se do të plotësohej.⁷⁹⁰ Pastaj të gjitha palët takuan Millosheviqin në orën 10 të mëngjesit, më 25 tetor 1998. Marrëveshja, shpesh e përmendur si Marrëveshja Clark-Naumann, u nënshkrua prej negociatorëve, mirëpo sipas Naumann-it, ai dhe Clark-u ndeshën në shumë vështirësi për ta bindur Millosheviqin që ta nënshkruante. Përfundimisht pasi u këshillua me Millutinoviqin, Millosheviqi e nënshkroi marrëveshjen.⁷⁹¹ Mbrojtja e Shainoviqit argumentoi se ajo nuk ishte marrëveshje, por deklaratë

⁷⁸⁶ Klaus Naumann, T. 8249–8257 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 11–13, P2512 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6974–6980.

⁷⁸⁷ Shaun Byrnes, T. 12142, 12155–12157 (16 prill 2007). Byrnes nuk ishte i sigurtë nëse ishte Millutinoviqi ai që drejtoi seancën plenare.

⁷⁸⁸ Shaun Byrnes, T. 12142, 12155–12157 (16 prill 2007), Klaus Naumann, P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 14–16, P2512 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6980–6981.

⁷⁸⁹ Klaus Naumann, T. 8251–8252 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 17–21, P2512 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6981–6984; P395 (Marrëveshja Clark-Naumann, 25 tetor 1998).

⁷⁹⁰ Millorad Obradoviq, T. 14933–14936 (4 shtator 2007). *Shih edhe* P928 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 17.

⁷⁹¹ Klaus Naumann, T. 8252–8253 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 22–23, P2512 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6985–6989.

politike.⁷⁹² Duke marrë parasysh deklaratën e masave që duheshin marrë prej RFJ-së, nënshkrimet në dokument dhe dëshminë e Naumann-it,⁷⁹³ del qartë se pavarësisht fjalës së përdorur për cilësimin e dokumentit, ai përmbante një sërë kushtesh të cilat duheshin plotësuar prej udhëheqjes së RFJ-së.

348. Kushtet e Marrëveshjes Clark-Naumann për aq sa kishin të bënin me UJ-në, pohojnë se forcat dhe pajisjet do të pakësoheshin deri në nivelin para fillimit të “veprimeve terroriste” në shkurt 1998.⁷⁹⁴ Forcat e UJ-së do të ktheheshin në kazermë përveç “tri ekipeve në madhësinë e një kompanie”, për mbrojtjen e linjave të komunikimit. Rojet kufitare të UJ-së do të qëndronin në pozicion gjatë kufirit shtetëror.⁷⁹⁵ Çfarëdo pajisje apo armatim i rëndë ose special që UJ-ja i kishte dhënë MPB-së, do të hiqej prej Kosovës ose do t’i kthehej UJ-së. Në lidhje me MPB-në, njësitë e posaçme policore do të largoheshin prej Kosovës, dhe forcat do të pakësoheshin deri në nivelin e shkurtit 1998.⁷⁹⁶ Pajisjet e rënda ende në kontrollin e MPB-së, do të ktheheshin në objektet e magazinimit.

349. Ridislokimi do të kryhej brenda mesditës, më 27 tetor 1998. Në garantimin e zbatimit të dispozitave, Marrëveshja ofronte që autoritetet e RFJ-së/Serbisë ndër të tjera të mbështeteshin në ndihmën e KVM-së. Për verifikimin e zbatimit të dispozitave të Marrëveshjes, komandantët ushtarakë dhe policorë do t’u jepnin monitoruesve ndërkombëtarë raporte të hollësishme javore për numrin, armatimin dhe veprimet e forcave të tyre dhe njoftim të menjëhershëm për çfarëdo dislokimi në kundërshtim të dispozitave të Marrëveshjes.⁷⁹⁷ Së fundi Marrëveshja përcaktonte se si mjet të fundit, RFJ-ja ruante të drejtën e përgjigjes proporcionale dhe vetëmbrojtëse kundrejt “veprimeve terroriste” ose shkeljeve të ligjit që rrezikonin jetën e qytetarëve dhe përfaqësuesve të saj.⁷⁹⁸

350. Sipas Naumann-it, Marrëveshja synonte edhe pakësimin e numrit të policëve në Kosovë nga 14.000–15.000 vetë deri në numrin në kohë paqeje, 10.000 vetë.⁷⁹⁹ Rezultat tjetër i këtyre takimeve teknike ishte edhe “Marrëveshja midis KDOM-it dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë” nënshkruar prej Shaun Byrnes-it dhe Vllastimir Gjorgjeviqit më 25 tetor

⁷⁹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 302.

⁷⁹³ Klaus Naumann P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 22.

⁷⁹⁴ P395 (Marrëveshja Clark-Naumann, 25 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2.

⁷⁹⁵ P395 (Marrëveshja Clark-Naumann, 25 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2–3; Shaun Byrnes, T. 12161–12164 (16 prill 2007).

⁷⁹⁶ P395 (Marrëveshja Clark-Naumann, 25 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2–3.

⁷⁹⁷ P395 (Marrëveshja Clark-Naumann, 25 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3.

⁷⁹⁸ P395 (Marrëveshja Clark-Naumann, 25 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 4; Shaun Byrnes, T. 12198 (16 prill 2007).

⁷⁹⁹ Klaus Naumann, P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 16.

1998, duke u dhënë verifikuesve dhe pajisjeve të tyre lirinë e lëvizjes për kryerjen e misioneve të tyre.⁸⁰⁰

351. Pas këtij takimi, Clark-u dhe Naumann-i udhëtuan për në Bruksel dhe takuan Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Solana. Gjithashtu ata i raportuan Këshillit të NATO-s, i cili vendosi të mos fillonte sulmet ajrore në qoftë se RFJ-ja e respektonte marrëveshjen.⁸⁰¹ Sipas Naumann-it, RFJ-ja e respektoi marrëveshjen afërsisht deri në mes të nëntorit. Nga Kosova u tërhoqën 5.000 – 6.000 policë serbë. Më tej, në gjysmën e dytë të nëntorit dhe në dhjetor 1998, NATO-ja konstatoi shtimin e numrit të incidenteve në Kosovë, shumica e tyre nxitur prej UÇK-së e cila po përpiqej të mbushte zbrazëtinë e krijuar pas tërheqjes së forcave të RFJ-së/Serbisë. Naumann-i pranoi se gabimi më i madh i NATO-s ishte mungesa e marrëveshjes me UÇK-në dhe se kjo ndodhi për shkak se më herët NATO-ja e kishte etiketuar UÇK-në organizatë terroriste dhe rrjedhimisht nuk mund të bënte marrëveshje me të. Si rezultat, NATO-ja mori një sërë raportesh mbi keqësimin e gjendjes në Kosovë, ndër të tjera në lidhje me ridislokimin e forcave të RFJ-së, postblloqe shtesë dhe përdorimin e forcës së tepruar.⁸⁰²

352. Duke marrë parasysh keqësimin e gjendjes, dhe pas një incidenti në fshatin Reçak (komuna e Shtimes) më 15 janar 1999, Këshilli i NATO-s vendosi të organizonte një takim të tretë midis Clark-ut dhe Naumann-it nga njëra palë dhe Millosheviqit nga pala tjetër. Takimi u zhvillua më 19 janar 1999 dhe zgjati shtatë orë. Ndër pjesëmarrësit e tjerë ishin edhe Millutinoviqi dhe Shainoviqi. Sërish qëllimi ishte të paralajmërohej Millosheviqi që incidentet e llojit të Reçakut të mos përsëriteshin më dhe të bindej që të respektonte kushtet e Marrëveshjes Clark-Naumann. Pastaj Millosheviqit iu paraqit një listë prej pesë-dhjetë incidentesh ku KVM-ja kishte konstatuar përdorimin e forcës së tepruar. Millosheviqi i mohoi të tëra akuzat dhe mbrojti veprimet e forcave të RFJ-së/Serbisë.⁸⁰³ Pas këtij takimi Clark-u dhe Naumann-i i paraqitën një raport Këshillit të NATO-s, duke pranuar se asnjë prej incidenteve për të cilat kishin informacion, nuk ishte nxitur prej forcave të RFJ-së por gjithsesi duke rekomanduar rihyrjen në fuqi të ACTORD-it.⁸⁰⁴ Naumann-i dëshmoi se në atë pikë “ishte marrë vendim politik” se NATO-ja “nuk duhej ishte më në pararojë” të negociatave dhe se Grupi i Kontaktit duhej të dilte në rol të parë. Vetëm më vonë,

⁸⁰⁰ Shaun Byrnes, T. 12159–12160 (16 prill 2007); P394 (Marrëveshje mirëkuptimi midis KDOM-it dhe Ministrisë së Brendshme së Republikës së Serbisë, 25 tetor 1998).

⁸⁰¹ Klaus Naumann, T. 8263 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 27.

⁸⁰² Klaus Naumann, T. 8263–8266, 8277–8280 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 28.

⁸⁰³ Klaus Naumann, T. 8268–8270 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 30–38, P2512 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6998–7009.

⁸⁰⁴ Klaus Naumann, T. 8270–8271 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë së Tribunalit), para. 39.

pas dështimit të procesit diplomatik në Francë, u rikthye NATO-ja.⁸⁰⁵ Gjithsesi, më 30 janar Solana u dërgoi një letër autoriteteve të RFJ-së duke i informuar për vendimin e Këshillit të NATO-s që e autorizonte të miratonte sulmet ajrore kundër RFJ-së.⁸⁰⁶

E. SHKURT 1999: KONFERENCAT E RAMBUJESË DHE PARISIT

353. Më 29 janar 1999, duke përmendur dhunën e pandalshme midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së/Serbisë si dhe incidentin e kohëve të fundit në Reçak, Grupi i Kontaktit bëri thirrje për një konferencë paqeje në Rambuje, Francë, me datë nisjeje 6 shkurt 1999 dhe i kërkoi Sekretarit të jashtëm britanik Robin Cook, të shkonte në Beograd dhe Prishtinë për t'u kërkuar Presidentit të RFJ-së Slllobodan Millosheviq dhe shqiptarëve kosovarë që të merrnin pjesë në konferencë e cila do të bashkëkryesohej prej Cook-ut dhe Ministrit të jashtëm francez Hubert Védrine. Bashkëkryetarët ishin edhe zëdhënës të konferencës, si dhe pika kontakti midis delegacioneve dhe Grupit të Kontaktit.⁸⁰⁷

354. Më 30 janar 1999, Grupi i Kontaktit formuloi “parimet e panegociueshme” mbi bazën e të cilave do të zhvilloheshin bisedimet në Rambuje. Ndër këto parime ishin ruajtja e tërësisë tokësore të RFJ-së dhe vendeve fqinje dhe harmonizimi i kuadrit ligjor të RFJ-së dhe Serbisë me çfarëdo marrëveshje kalimtare. Aty përfshihej edhe një kërkesë për një mekanizëm për zgjidhjen përfundimtare dhe përcaktohej “angazhimi ndërkombëtar dhe bashkëpunimi i plotë i palëve për zbatimin”.⁸⁰⁸ Ratko Markoviqi dëshmoi se delegacioni i RFJ-së/Serbisë kishte mendimin që këto parime të miratoheshin siç ishin dhe mundësisht të pasqyroheshin në çfarëdo dokumenti që mund të dilte si rezultat i bisedimeve midis delegacioneve në Rambuje.⁸⁰⁹

355. Më 4 shkurt 1999, Kuvendi Kombëtar serb pranoi ftesën e Grupit të Kontaktit për pjesëmarrje në negociata dhe autorizoi qeverinë serbe që të caktonte delegacionin.⁸¹⁰ Kuvendi Kombëtar gjithashtu formuloi një numër parimesh mbi bazën e të cilëve mund të zgjidhej kriza, të cilat ishin: (a) mjetet dhe dialogu politik si e vetmja mënyrë për zgjidhje paqësore dhe demokratike të krizës në Kosovë, (b) respektim i plotë i tërësisë territoriale dhe sovranitetit të Serbisë dhe RFJ-

⁸⁰⁵ Klaus Naumann, T. 8274–8275 (13 dhjetor 2006).

⁸⁰⁶ 2D204 (Njoftim i qeverisë së RFJ-së, 1 shkurt 1999).

⁸⁰⁷ P979 (Deklaratë e Grupit të Kontaktit, 29 janar 1999), f. 2; Ratko Markoviqi, T. 13195 (9 gusht 2007), T. 13546 (14 gusht 2007); Wolfgang Petritsch, T. 10921 (2 mars 2007).

⁸⁰⁸ 1D18 (Marc Weller, The crisis in Kosovo 1989–1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 414. *Shih edhe* Ratko Markoviqi, T. 13181–13184 (9 gusht 2007); Momir Bullatoviqi, T. 13846 (17 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviqi, T. 14050–14051, 14054–14055 (20 gusht 2007).

⁸⁰⁹ Ratko Markoviqi, T. 13181 (9 gusht 2007).

⁸¹⁰ 1D443 (Konkluzione të Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë), f. 5; Ratko Markoviqi, T. 13184–13185 (9 gusht 2007). *Shih edhe* Millan Jovanoviqi, T. 14173–14175, 14179–14180 (22 gusht 2007); 2D206 (Procesverbal i Sesionit të 95-të të Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Kryesor të STP-së, zhvilluar më 3 shkurt 1999).

së, (c) barazi e plotë për të gjithë qytetarët dhe bashkësitë e grupet etnike në Kosovë, (d) zgjidhje të harmonizuara me Kushtetutat e Serbisë dhe RFJ-së dhe me standardet ndërkombëtare në fushën e të drejtave qytetare dhe njerëzore, (e) Kosovës nuk mund t'i jepej status i Republikës, por vetëm autonomi brenda Serbisë dhe RFJ-së bazuar në standardet më të larta, (f) kundërshtim i çdo mase e cila do të prekte tërësinë tokësore dhe sovranitetin dhe i përpjekjeve për konkretizimin e shkëputjes së Kosovës prej Serbisë, dhe (g) kundërshtim ndaj pranisë së trupave të huaja në territorin e RFJ-së me çfarëdo preteksti për zbatimin e marrëveshjes së arritur.⁸¹¹

356. Markoviqi dëshmoi se delegacionit serb nuk i ishte dhënë dorë e lirë, por ishte nën detyrimin e respektimit të këtyre parimeve gjatë negociatave dhe çfarëdo marrëveshjeje të formuluar në Rambuje. Ai deklaroi se veç parimit të fundit, përkatësisht mospranimit të trupave të huaja, të gjitha parimet ishin të njëjta si dhjetë parimet e panegociueshme të bashkësisë ndërkombëtare përdorur prej saj në thirrjen për zgjidhjen e Kosovës me mjete paqësore.⁸¹² Momir Bullatoviqi konfirmoi se RFJ-ja kishte problem me pranimin e parimit të panegociueshëm të Grupit të Kontaktit në lidhje me angazhimin ndërkombëtar në RFJ, në qoftë se me këtë nënkuptohej prani ushtarake e huaj.⁸¹³ Qëndrimi i RFJ-së/Serbisë ishte se në territorin e RFJ-së nuk duhej të kishte prani ushtarake të huaj veç pranisë ndërkombëtare përcaktuar prej Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq dhe Marrëveshjes për KVM-në.⁸¹⁴ Zhivadin Jovanoviqi, ministri i atëhershëm i Jashtëm, gjithashtu dëshmoi se delegacioni nuk kishte mandat të diskutonte tërësinë territoriale të vendit.⁸¹⁵ Millan Jovanoviqi, anëtar i SPS-së, shprehu pikëpamjen se nga njëra anë delegacioni i RFJ-së/Serbisë kishte mandat të përcaktuar, dhe nga ana tjetër kishte hapësirë të mjaftueshme manovrimi për gjetjen e zgjidhjeve institucionale.⁸¹⁶ Pas shqyrtimit të parimeve të panegociueshme, si dhe parimeve të përcaktuara prej Kuvendit Kombëtar të Serbisë, Dhoma pranon se ndryshimi më i rëndësishëm midis këtyre dy grupeve ishte interpretimi i angazhimit ndërkombëtar në RFJ. Mirëpo gjithashtu del se parimet e Grupit të Kontaktit parashikonin harmonizim të kuadrit ligjor të RFJ-së/Serbisë me marrëveshjen e përkohshme, duke përcaktuar në këtë mënyrë përparësinë e marrëveshjes ndaj kuadrit ligjor të vendit. Përkundrazi, Kuvendi Kombëtar i Serbisë sanksionoi se çfarëdo marrëveshje në të ardhmen, duhej të harmonizohej me Kushtetutat e RFJ-së dhe Serbisë, duke përcaktuar kështu përparësinë e dy kushtetutave ndaj marrëveshjes.

⁸¹¹ 1D443 (Konkluzione të Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë), f. 5; Ratko Markoviq, T. 13184–13187 (9 gusht 2007). Qeveria e RFJ-së krijoi edhe një grup pune që do të monitoronte dhe mbështeste negociatat në Rambuje; 2D209 (Ministria e Punëve të Jashtme e RFJ-së – Notë prej takimit të tretë të grupit të punës, 8 shkurt 1998).

⁸¹² Ratko Markoviq, T. 13188 (9 gusht 2007).

⁸¹³ Momir Bullatoviq, T. 13846–13847 (17 gusht 2007).

⁸¹⁴ 2D221 (Qëndrimi i Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme mbi çështjen e dislokimit të trupave të huaja në Kosovë më kuadër të takimit në Rambuje); Momir Bullatoviq, T. 13846–13847 (17 gusht 2007).

⁸¹⁵ Zhivadin Jovanoviq, T. 14054 (20 gusht 2007).

⁸¹⁶ Millan Jovanoviq, T. 14180 (22 gusht 2007).

357. Në zbatim të vendimit të Kuvendit Kombëtar, qeveria serbe emëroi një delegacion prej dymbëdhjetë anëtarësh që përfaqësonin RFJ-në dhe Republikën e Serbisë. Në delegacion ishin, Shainoviqi, Vlladan Kutleshiqi, i cili ishte zëvendëskryeministër i RFJ-së në atë kohë dhe i dërguari personal i Millosheviqit; dhe Vladimir Shtambuk, në atë kohë zëvendëskryetar i Kuvendit Kombëtar dhe një përfaqësues i JUL-it (partia e majtë jugosllave). Ratko Markoviqi u caktua kreu i delegacionit dhe gjithashtu në ekipin qeveritar ishin të përfaqësuar po ata shqiptarë kosovarë që nënshkruan deklaratën e Prishtinës si dhe pakica të tjera etnike.⁸¹⁷ Sipas Petrirtsch-it kontributi i këtyre pakicave në diskutime ishte i papërfillshëm.⁸¹⁸ Gjithsesi Markoviqi dëshmoi se delegacioni punoi si një ekip dhe vendimet merreshin me konsensus.⁸¹⁹

358. Zyrtarisht konferenca e Rambujesë filloi më 6 shkurt 1999 dhe ishte planifikuar të mbyllet më 13 shkurt 1999. Gjatë zhvillimit të konferencës data e mbylljes u shty dy herë, një herë deri më 20 shkurt dhe pastaj më 23 shkurt.⁸²⁰

359. Delegacioni i RFJ-së/Serbisë arriti në Rambuje më 6 shkurt. Petrirtsch-i dëshmoi se Shainoviqi konsiderohej si kreu politik i delegacionit, megjithëse zyrtarisht ishte Markoviqi.⁸²¹ Markoviqi shpjegoi se megjithëse Shainoviqi ishte një ndër anëtarët e delegacionit, në të njëjtën kohë ai ishte zëvendëskryeministër i qeverisë së RFJ-së dhe rrjedhimisht individi me rangun më të lartë politik në delegacion.⁸²² Edhe Zhivadin Jovanoviqi dëshmoi se Shainoviqi mori pjesë në bisedime sepse ai ishte personi më i informuar në lidhje me diplomacinë dhe veprimtaritë e ndryshme ndërkombëtare në lidhje me problemin e Kosovës dhe për shkak se ishte individi me më shumë kontakte ndërkombëtare, prej funksionit të tij si Kryetar i Komisionit të Bashkëpunimit me KVM-në.⁸²³ Millutinoviqi nuk ishte zyrtarisht anëtar i delegacionit të RFJ-së/Serbisë, por mori pjesë në bisedime prej 10 shkurtit 1999,⁸²⁴ dhe dukej se ishte zëdhënësi *de facto* i delegacionit.⁸²⁵

⁸¹⁷ P967 (Vendim i qeverisë serbe për emërimin e delegacionit të Rambujesë, 4 shkurt 1999). Veç Shainoviqit, Kutleshiqit dhe Shtambukut në delegacionin bënë pjesë edhe Vojislav Zhivkoviqi, kryetar i këshillit krahinor të SPS-së në atë kohë; Gulbehar Shaboviq, anëtar i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm; Refik Senadoviq, përfaqësuesi i bashkësisë së myslimanëve etnikë; Zejnelabidin Kurejsh, përfaqësues i bashkësisë së turqve etnikë dhe i Partisë Demokratike Turke; Ibro Vait, përfaqësues i bashkësisë së goranëve etnikë; Farik Jashari, kryetar i Nismës Demokratike të Kosovës; Sokol Qusa, kryetar i Partisë shqiptare për Reforma Demokratike; Luan Koka, përfaqësues i bashkësisë së romëve etnikë dhe kryetar i Këshillit Bashkërendues së Lidhjes së Romëve të Jugosllavisë; dhe Qerim Abazi, përfaqësues i bashkësisë së egjiptianëve etnikë. *Shih edhe* Momir Bullatoviq, T. 13845–13846 (17 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviq, T. 14053 (20 gusht 2007).

⁸¹⁸ Wolfgang Petrirtsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 2–3.

⁸¹⁹ Ratko Markoviq, T. 13538 (14 gusht 2007).

⁸²⁰ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 6.

⁸²¹ Wolfgang Petrirtsch, T. 10717 (28 shkurt 2007); T. 10717 (1 mars 2007). *Shih edhe* P967 (Vendim i qeverisë serbe për emërimin e delegacionit të Rambujesë, 4 shkurt 1999).

⁸²² Ratko Markoviq, T. 13545 (14 gusht 2007). *Shih edhe* Zoran Angjelkoviqi, T. 14661 (30 gusht 2007).

⁸²³ Zhivadin Jovanoviq, T. 14053 (20 gusht 2007).

⁸²⁴ Ratko Markoviq, T. 13194, 13222 (9 gusht 2007). *Shih edhe* 1D94 (Letër e Ratko Markoviqit drejtuar Ambasadorëve Hill, Petrirtsch, dhe Mayorski, ku kërkon takim me të dy delegacionet dhe bën të ditur se Millutinoviqi ishte i disponueshëm për të marrë pjesë).

Markoviqi shpjegoi se Millutinoviqi mori pjesë në takim me nismën e tij sepse ai “përfaqësonte Serbinë dhe simbolizonte unitetin e saj”.⁸²⁶

360. Delegacioni shqiptar kosovar ishte më homogjen duke patur në përbërje vetëm shqiptarë etnikë. Në të njëjtën kohë ishte problematik dhe përfshinte figura politike si udhëheqësi i LDK-së Ibrahim Rugova, i cili ishte zgjedhur “President’ i Kosovës më 1992, botuesit Veton Surroi dhe Blerim Shala, dhe udhëheqësit e UÇK-së, Hashim Thaçi dhe Jakup Krasniqi.⁸²⁷ Lubivoje Joksiq i cili punonte për sigurimin e MPB-së serbe bazuar në Kosovë dëshmoi se dega e tij kishte “informacion” në lidhje me anëtarë të UÇK-së që refuzuan të shkonin në Rambuje, dhe në lidhje me mosdëshirën e udhëheqësit të LDK-së Rugova për praninë e tyre si vendimmarrës dhe negociatorë të barabartë në proces. Joksiqi deklaroi se përfaqësues të huaj, ndër të cilët Shaun Byrnes, e bindën UÇK-në të merrte pjesë në negociata, kundrejt premtimit se SHBA-ja do të mbështeste kauzën e tyre.⁸²⁸ Mirëpo Shaun Byrnes, dëshmoi se nuk mbante mend të kishte bërë biseda të tilla me ndonjë anëtar të UÇK-së.⁸²⁹ Dhoma e gjykon të habitshme mungesën e kujtesës prej Byrnes-it dhe gjykon se duke marrë parasysh angazhimin e SHBA-së në procesin negociues nëpërmjet të dërguarve të vet të ndryshëm, prania e përfaqësuesve të UÇK-së në delegacionin shqiptar kosovar ishte me miratimin e SHBA-së.

361. Dy delegacionet u takuan drejtpërsëdrejti vetëm një herë gjatë gjithë konferencës, konkretisht më 14 shkurt 1999.⁸³⁰ Në fakt negociatat u kryen nëpërmjet “diplomacisë së ecejakeve,” ku delegacionet diskutonin projektin e tekstit veçazi në pjesë të ndryshme të pallatit. Tre negociatorët kryesorë, ambasadori austriak Petritsch, si i Dërguar i Posaçëm i Bashkimit Evropian për Kosovën, i dërguari rus, ambasadori Boris Mayorski, dhe ambasadori amerikan Hill, të quajtur rëndom “trashja”, shpesh merrnin ndryshime prej të dy palëve dhe i përfshinin në marrëveshje para se t’ia paraqisnin palës tjetër për komente.⁸³¹ Petritsch-i dhe Mayorski ishin kryesisht përgjegjës për negociimin e aspekteve politike të zgjidhjes, kurse Hill-i merrej me

⁸²⁵ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 3. Sipas ambasadorit Petritsch, Millutinoviqi erdhi në Rambuje rreth 11 shkurtit 1999 dhe u përfshi gjithnjë e më shumë në diskutime; Wolfgang Petritsch, T. 10848 (2 mars 2007); P2793 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7221.

⁸²⁶ Ratko Markoviq, T. 13194 (9 gusht 2007), T. 13541 (14 gusht 2007).

⁸²⁷ Wolfgang Petritsch, T. 10735–10736, 10838 (1 mars 2007); P2658 (Mesazh i ambasadës austriake, 25 shkurt 1998), f. 3; Shaun Byrnes, T. 12265 (17 prill 2007). Profesi Mark Weller dhe juristi e ambasadori amerikan Morten Abramovich e ndihmuan delegacionin shqiptar kosovar nëpërmjet dhënies së këshillave. Wolfgang Petritsch, T. 10776–10777 (1 mars 2007), 10865 (2 mars 2007). *Shih edhe* Veton Surroi, T. 4551–4553 (10 tetor 2006).

⁸²⁸ Lubivoje Joksiq, T. 21968–21969, 21971 (8 shkurt 2008); 6D206 (Notë zyrtare e RDB-së, 26 shkurt 1999).

⁸²⁹ Shaun Byrnes, T. 12222–12228 (17 prill 2007).

⁸³⁰ Veton Surroi, T. 4553–4554 (10 tetor 2006); Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 2–3.

⁸³¹ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4324; Wolfgang Petritsch, T. 10710–10712 (28 shkurt 2007); Ratko Markoviq, T. 13183, 13192–13193 (9 gusht 2007); Veton Surroi, T.

dispozitat zbatuese, ndër të cilat prania e trupave të NATO-s për zbatimin e dispozitave të ndryshme të marrëveshjes.⁸³² Jan Kickert, sekretari i dytë i Petritsch-it, mbante kontakte me delegacionin shqiptar kosovar dhe i raportonte qeverisë austriake në lidhje me ngjarjet në përgjithësi në Rambuje.⁸³³

362. Në lidhje me nivelin dhe llojin e angazhimit të delegacionit të RFJ-së/Serbisë në negociatat e Rambujesë ekzistojnë prova kundërthënëse. Disa pjesëmarrës të konferencës dëshmuuan se Millosheviqi kontrollonte qëndrimin jugosllav/serb, sepse anëtarët e delegacionit ishin në kontakt të vazhdueshëm me Beogradin, pavarësisht faktit se rregullat bazë të konferencës ndalonin kontaktimin e jashtëm.⁸³⁴ Në të vërtetë, në një rast Shainoviqi kërkoi dhe mori leje të largohej prej Rambujesë për t'u konsultuar me Millosheviqin. Zhivadin Jovanoviqi dhe Ratko Markoviqi shpjeguan se Shainoviqi shkoi në Beograd për shkak se delegacionit iu kërkua të shprehte qëndrimin e vet dhe të pranonte zgjidhje që nuk përputheshin me dhjetë parimet e panegociueshme të Grupit të Kontaktit.⁸³⁵

363. Sipas Veton Surroit, delegatët shqiptarë kosovarë krijuan përshtypjen se ekipi i RFJ-së/Serbisë nuk ishte serioz sepse doli se vetëm pak prej tyre kishin dijeni për përmbajtjen e dokumenteve në tryezë, dhe ata nuk dhanë komente ose përgjigje në “projekt-dokumentet e para” por thjesht këmbëngulën që delegacioni shqiptar kosovar të nënshkruante “parimet e panegociueshme” të Grupit të Kontaktit. Surroi gjithashtu shpjegoi se delegacioni i RFJ-së/Serbisë nuk paraqiti asnjë propozim të rëndësishëm.⁸³⁶ Mirëpo ky pohim nuk përputhet me deklaratën publike të Grupit të Kontaktit të 16 shkurtit se treshja kishte marrë “komente të plota” prej të dy delegacioneve.⁸³⁷

4549 (10 tetor 2006). Dhoma thekson se gjatë gjykimit bëri një përpjekje për thirrjen e ambasadorëve Mayorski dhe Hill për të dëshmuar në gjyq, por pa sukses. *Shih gjithashtu* Pjesa B, Kapitulli I më sipër.

⁸³² Wolfgang Petritsch, T. 10710 (28 shkurt 2007). Kickert-i theksoi se një prej arsyeve që çështjet e sigurisë u diskutuan me SHBA-në ishte se BE-ja konsiderohej prej udhëheqjes serbe “si fuqi e dobët, që nuk merrej seriozisht dhe pa dyshim jo në nivelin e amerikanëve”. Jan Kickert, T. 11236 (7 mars 2007).

⁸³³ Jan Kickert, T. 11239 (7 mars 2007).

⁸³⁴ Wolfgang Petritsch, T. 10714 (28 shkurt 2007); P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 2, P2793 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 7219-7220; P2662 (Mesazh i ambasadës austriake, 10 shkurt 1999), f. 1 ku shkruhet se delegacioni i RFJ-së/Serbisë tashmë ka përfunduar hartimin e komenteve të veta për një prej projekt-propozimeve dhe ishte në pritje të “udhëzimeve nga Beogradi”. *Shih edhe* Ibrahim Rugova, P2613 (deklaratë dëshmitari me datë 24 prill 1999), f. 7, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4219.

⁸³⁵ Zhivadin Jovanoviq, T. 14055 (20 gusht 2007), 14120–14121 (21 gusht 2007); Ratko Markoviq, T. 13542–13546, 13553–13554 (14 gusht 2007). Petritsch-i dëshmoi se si rezultat i këtyre kontakteve midis delegacionit të RFJ-së dhe Beogradit, delegacioni shqiptar kosovar nguli këmbë që të kishte të njëjtin trajtim. Si pasojë, negociatorëve iu desh ta lejonin Thaçin që të largohej nga Franca për një takim me Demaçin. Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 2–3; P562 (Mesazh i ambasadës austriake, 20 shkurt 1997), f. 2.

⁸³⁶ Veton Surroi, T. 4558–4559, 4594–4595 (10 tetor 2006), P2361 (deklaratë dëshmitari me datë 27 gusht 2001), f. 8.

⁸³⁷ Veton Surroi, T. 4558–4559 (10 tetor 2006); 1D18 (Marc Weller, Kriza në Kosovë 1989-1999, Konferencë Shtypi e Zëdhënësit të Grupit të Kontaktit, 16 shkurt 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 429.

364. Provat tregojnë se delegacioni i RFJ-së/Serbisë mori pjesë aktivisht në negociatat e Rambujesë, mirëpo qëndrimi i tyre ndryshoi më vonë. Petritsch-i shprehu mendimin se herët në negociata “ekipi ... serb ... kishte mandat të bënte kompromis dhe të arrinte marrëveshje për aspektet politike të propozimit ... ata ishin kompetentë dhe të gatshëm për gjetjen e një zgjidhjeje të pranuar prej të dy palëve.”⁸³⁸ Mirëpo duket se më vonë rrethanat ndryshuan dhe duke qenë se në periudhën midis konferencës së Rambujesë dhe raundit të dytë të bisedimeve në Paris, nuk pati sesion parlamentar që do t’i kishte akorduar mandat të ri ekipit negociues, çdo ndryshim taktike ose qëndrimi do të duhej të vinte prej vetë Presidentit Millosheviq.⁸³⁹ Dhoma thekson se në bazë të Kushtetutës së RFJ-së, Presidenti i RFJ-së përfaqësonte RFJ-në brenda dhe jashtë vendit.⁸⁴⁰

365. Mundësia e sulmit të NATO-s kundër territorit të RFJ-së u diskutua hollësisht në konferencën e Rambujesë; gjithsesi, ambasadori Petritsch dëshmoi se nuk ishte e qartë nëse Millosheviqi besonte se kjo mund të ndodhte me të vërtetë.⁸⁴¹

366. Në përgatitje për konferencën, Hill-i kishte hartuar një projekt-marrëveshje njëzetekatërfaqëshe bazuar në projekte të mëparshme, ku jepeshin në hollësi elementë të zgjidhjes politike që i akordonte më shumë autonomi dhe kompetenca vetëqeverisëse Kosovës, duke ruajtur njëkohësisht tërësinë territoriale dhe sovranitetin e RFJ-së.⁸⁴² Ky variant, i quajtur “pjesa politike” e marrëveshjes së Rambujesë,⁸⁴³ e cila përmbante marrëveshjen kuadër dhe anekset 1 (Kushtetuta e Kosovës), 3 (Zgjedhjet), dhe 6 (Avokati i Popullit), iu dha delegacionit të RFJ-së/Serbisë në mëngjesin e 7 shkurtit. Fillimisht delegacioni ngriti dy kundërshtime. Konstatimi i parë ishte se disa prej dhjetë parimeve të panegociueshme nuk ishin pasqyruar plotësisht në dokument. Rrjedhimisht delegacioni i RFJ-së/Serbisë i propozoi delegacionit shqiptar kosovar të takoheshin dhe nënshkruanin deklaratat që pranonin këto parime. Shqiptarët kosovarë refuzuan.⁸⁴⁴ Gjithsesi, më 11 shkurt 1999, pas një rekomandimi të Bashkëkryetarëve të konferencës, delegacioni i RFJ-së/Serbisë

⁸³⁸ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), p. 2. Negociatorët serbë e përmendur konkretisht prej Petritsch-it janë Vlladan Kutleshiqi, Ratko Markoviqi, dhe Nikolla Shainoviqi.

⁸³⁹ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 2.

⁸⁴⁰ ID139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 96(1).

⁸⁴¹ Wolfgang Petritsch, T.10718 (28 shkurt 2007), P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 8, ku ai pohoi se “[i]t dukej se Millosheviqi nuk priste që NATO-ja të bombardonte Serbinë” Zhivota Çosiqi dëshmoi se qeveria e Serbisë dhe në përgjithësi popullsia nuk besonin se NATO-ja do të bombardonte. Ata ishin të bindur se “do të gjendej një zgjidhje paqësore e krizës”. Zhivota Çosiqi, T. 13664 (15 gusht 2007).

⁸⁴² *Shih* ID18 (Marc Weller, Kriza në Kosovë 1989-1999, Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë, Projekt-Propozimi fillestar, 6 shkurt 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 418–425.

⁸⁴³ Ratko Markoviq, T. 13214 (9 gusht 2007).

⁸⁴⁴ Ratko Markoviq, T. 13189–13193 (9 gusht 2007); 13549 (14 gusht 2007); ID122 (Letër e Ratko Markoviqit drejtuar ambasadorëve Hill, Petritsch, dhe Mayorski ku kërkonte që të nënshkruheshin parimet e përgjithshme, 9 shkurt 1999); ID123 (Letër e Ratko Markoviqit drejtuar ambasadorëve Hill, Petritsch, dhe Mayorski ku kërkonte një takim me të gjitha palët e angazhuara, 9 shkurt 1999); ID32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 6. *Shih edhe* Zhivadin Jovanoviq, T. 14056 (20 gusht 2007).

lëshoi një deklaratë të nënshkruar që pranonte parimet.⁸⁴⁵ Delegacioni shqiptar kosovar sërisht refuzoi të nënshkruante parimet. Atëherë negociatorët përfshinë në parathënien e projektit të ri të marrëveshjes dhe në parathënien e Kushtetutës së propozuar të Kosovës në aneksin 1, parimet e panegociueshme të përkufizuara nga Grupi i Kontaktit.⁸⁴⁶ Megjithëse Petritsch-i dhe Surroi dëshmuar se nënshkrimi i parimeve të Grupit të Kontaktit nuk ishte i nevojshëm, duke qenë se thjesht prania e të tëra palëve dëshmoi pranimin e këtyre parimeve prej tyre,⁸⁴⁷ Dhoma ka mendimin se ky arsyetim është kundërtshënës dhe faktikisht konfirmon qëndrimin e palës së RFJ-së/Serbisë. Në qoftë se prania e thjeshtë automatikisht nënkuptonte pranimin e parimeve, atëherë shqiptarët kosovarë nuk do të kishin problem t’i nënshkruanin.

367. Kundërshtimi i dytë i delegacionit të RFJ-së/Serbisë kishte të bënte me faktin se nuk u ishte dhënë teksti i plotë i projekt-marrëveshjes, siç dukej prej numërtimit të anekseve. Markoviqi dëshmoi se pavarësisht kërkesave të vazhdueshme të delegacionit të RFJ-së/Serbisë për marrjen e tekstit të plotë, vetëm në ditën e fundit të afatit të vendosur prej Grupit të Kontaktit për përfundimin e bisedimeve të para, pikërisht më 13 shkurt 1999, delegacioni i RFJ-së/Serbisë mori aneksin 4 të titulluar “Çështje Ekonomike”.⁸⁴⁸

368. Më 14 shkurt 1999, Sekretarja amerikane e Shtetit, Madeleine Albright, arriti në Rambuje për të nxitur përparimin e negociatave. Menjëherë ajo kryesoi takimin kokë më kokë të dy delegacioneve. Më tej i takoi delegacionet veçazi. Ajo i tha delegacionit shqiptar kosovar se do të “braktisej” prej SHBA-së dhe bashkësisë ndërkombëtare, në rast se nuk nënshkruante marrëveshjen e propozuar.⁸⁴⁹ Delegacionit serb ajo i tha se në qoftë se nuk pranonte, RFJ-ja do të

⁸⁴⁵ Markoviqi dëshmoi se ideja e nënshkrimit të marrëveshjes me dhjetë parime ishte nxitur prej bashkëkryetarëve të takimit, Robin Cook, Ministër i Punëve të Britanisë së Madhe, gjë që pasqyrohet edhe në deklaratë. Gjithashtu ai konkludoi se Cook-u ishte anëtar i Grupit origjinal të Kontaktit dhe se ai vazhdoi të kishte të njëjtin qëndrim të një organi të cilit i përkiste. Ratko Markoviqi, T. 13193, 13195 (9 gusht 2007). *Shih edhe* 1D124 (Deklaratë e nënshkruar prej delegacionit të RFJ-së/Serbisë në Takimin e Rambujesë më 11 shkurt 1999); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 5–6.

⁸⁴⁶ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), p. 6. *Shih edhe* Wolfgang Petritsch, T. 10712–10713 (28 shkurt 2007); P2662 (Mesazh i ambasadës austriake, 10 shkurt 1999), f. 1, ku shkruhet se delegacioni i RFJ-së/Serbisë hoqi dorë nga kërkesa për nënshkrimin e elementëve të përgjithshme pas sigurimeve të negociatorëve për ruajtjen e “soveranitetit dhe tërësisë territoriale të RFJ-së”.

⁸⁴⁷ Wolfgang Petritsch, T. 10712–10713 (28 shkurt 2007), T. 10846–10847 (2 mars 2007); Veton Surroi, T. 4562–4564 (10 tetor 2006).

⁸⁴⁸ Ratko Markoviqi, T. 13196–13198 (9 gusht 2007). *Shih* 1D96 (Letër e Ratko Markoviqit drejtuar ambasadorëve Hill, Petritsch, dhe Mayorski ku kërkonte të gjitha dokumentet përkatëse për diskutime, Rambuje); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 6.

⁸⁴⁹ Veton Surroi, T. 4553–4554 (10 tetor 2006). *Shih edhe* Ibrahim Rugova, P2612 (transkript i *Prokurori k. Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4218, P2613 (deklaratë dëshmitari me datë 3 nëntor 2001), f. 8; 6D1670 (Raport amerikan mbi bisedimet në Rambuje).

bombardohej.⁸⁵⁰ Petritsch-i iu ankua qeverisë së tij në Vjenë se prania e saj ishte orvatje e SHBA-së për marrjen e kontrollit të negociatave.⁸⁵¹

369. Delegacioni i RFJ-së/Serbisë mori aneksin 4(A) të marrëveshjes titulluar “Çështje Humanitare, Rindërtimi dhe Zhvillimi”, më 15 shkurt 1999.⁸⁵² Në atë pikë negociatorët konfirmuan se të tëra anekset e miratuara prej Grupit të Kontaktit u ishin dhënë. Më 16 shkurt 2009, delegacioni i RFJ-së/Serbisë iu paraqiti negociatorëve komentet në lidhje me projekt-marrëveshjen të cilat siç është përmendur më parë, Grupi i Kontaktit i cilësoi “të plota”.⁸⁵³

370. Petritsch-i dëshmoi se Grupi i Kontaktit kishte pranuar prej fillimit që t’i paraqiste anekset një nga një për të shmangur pështjellim dhe për adoptimin e një strategjie “hap pas hapi”, duke konfirmuar në këtë mënyrë se asnjë delegacion nuk i mori anekset menjëherë.⁸⁵⁴ Gjithashtu ai shpjegoi se pati raste kur Grupi i Kontaktit pati mosmarrëveshje të brendshme në disa pjesë të marrëveshjes dhe si pasojë nuk mund t’ua paraqiste si propozim palëve.⁸⁵⁵

371. Dhoma thekson se u pranuan si prova një numër mesazhesh të përgatitura nga ambasada austriake në Beograd për Ministrinë e Jashtme austriake në Vjenë në lidhje me ecurinë e negociatave në Rambuje.⁸⁵⁶ Dhoma i konsideroi përgjithësisht si pasqyrim i besueshëm i ngjarjeve të asaj kohe. Sipas një mesazhi të 18 shkurtit 1999, më 16 shkurt, në mes të negociatave, Hill-i shkoi në Beograd dhe pati një takim triorësh me Millosheviqin dhe Millutinoviqin. Diskutimet u përqëndruan në çështjet më delikate për palën jugosllave/serbe, ndër të cilat kushti i paprekshmërisë së sovranitetit dhe tërësisë territoriale të Serbisë dhe RFJ-së, dhe mosdislokimi i forcave të huaja ushtarake.⁸⁵⁷ Më 18 shkurt 1999, Millutinoviqi e takoi sërish Hill-in, këtë herë në Paris. Petritsch-i shpjegoi se Hill-i dhe negociatorë të tjerë ndërkombëtarë përshëndetën praninë e Millutinoviqit në Rambuje si njëri prej vendimmarrësve politikë dhe dëshironin të flisnin me të për arritjen sa më shpejt të një marrëveshjeje. Mirëpo në një mesazh raportohej se ky takim pati rezultat negativ dhe ishte “absolutisht joproduktiv”, sepse mbetën të hapura pikat më të

⁸⁵⁰ Veton Surroi, T. 4554 (10 tetor 2006). *Shih edhe* 6D1670 (Raport amerikan mbi bisedimet në Rambuje).

⁸⁵¹ Wolfgang Petritsch, T. 10752 (1 mars 2007); P2658 (Mesazh i ambasadës austriake, 25 shkurt 1999), f. 1–2.

⁸⁵² Ratko Markoviç, T. 13196–13198 (9 gusht 2007). *Shih* 1D96 (Letër e Ratko Markoviçit drejtuar Hill-it, Petritsch-it, dhe Mayorski-t ku kërkonte të gjitha dokumentet përkatëse për diskutime, Rambuje); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 6.

⁸⁵³ Ratko Markoviç, T. 13198–13200 (9 gusht 2007); 1D589 (Letër e Ratko Markoviçit drejtuar Hill-it, Petritsch-it, dhe Mayorski-t ku parashtrohet një tekst i vetëm i marrëveshjes mbi vetëqeverisjen në Kosovë, 16 shkurt 1999); 1D18 (Marc Weller, Kriza në Kosovë 1989-1999, Konferencë Shtypi e Zëdhënësit të Grupit të Kontaktit, 16 shkurt 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 429; 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 6.

⁸⁵⁴ Wolfgang Petritsch, T. 10843 (2 mars 2007).

⁸⁵⁵ Wolfgang Petritsch, T. 10842–10843 (2 mars 2007); P2658 (Mesazh i ambasadës austriake, 25 shkurt 1999), f. 1.

⁸⁵⁶ Wolfgang Petritsch, T. 10712 (28 shkurt 2007).

⁸⁵⁷ Wolfgang Petritsch, T. 10718 (28 shkurt 2007); P2661 (Mesazh i ambasadës austriake, 18 shkurt 1999), f. 1. *Shih edhe* Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 4.

debatueshme si aspektet ushtarake të marrëveshjes. Millutinoviqi adoptoi një qëndrim më aktiv gjatë pjesës së mbetur të negociatave në Rambuje.⁸⁵⁸

372. Më 18 shkurt, pas shqyrtimit të komenteve të të dy palëve në lidhje me variantin fillestar, Grupi i Kontaktit paraqiti variantin e ri të marrëveshjes, i cili përfshinte anekset 1, 3, 4, 4(A), 6, dhe aneksin e ri 8 ku shkruhej si vijon:

Tre vjet pas hyrjes në fuqi të marrëveshjes, do të bëhet vlerësim i gjithanshëm i marrëveshjes nën kujdestarinë ndërkombëtare me synim përparimin e zbatimit dhe për të përcaktuar nëse duhen zbatuar propozime të Palëve për masa shtesë.⁸⁵⁹

Në këtë variant gjithashtu shkruhej se “prania e trupave paraushtarake dhe të parregullta në Kosovë” nuk përputhej me kushtet e Marrëveshjes.⁸⁶⁰

373. Delegacioni shqiptar kosovar e kundërshtoi projektin, duke shprehur mospajtime me aspektin politik dhe me “ndryshimin e njëanshëm të parimeve më themelore të cilat janë bazë e marrëveshjes politike”, dhe problemi më i madh ishte përfshirja e fjalës “sovrانيتet” ngjitur me “tërësinë territoriale” të RFJ-së.⁸⁶¹ Në një deklaratë shtypi delegacioni shqiptar kosovar ravijëzoi qëndrimin e vet për mbajtjen e një referendumi në lidhje me statusin e ardhshëm të Kosovës pas mbarimit të një periudhe kalimtare dhe deklaroi se çdo përmendje e sovranitetit do ta kufizonte atë në këtë aspekt; kundërshtoi vetë procesin me argumentin se bazohej në negociata të veçuara dhe ndryshime të njëanshme. Mirëpo Veton Surroi pranoi se vetë delegacioni shqiptar kosovar kishte këmbëngulur për këtë proces dhe kishte refuzuar të nënshkruante parimet e panegociueshme.⁸⁶²

374. Petritsch-i dëshmoi se megjithëse edhe delegacioni i RFJ-së/Serbisë e kritikoi dokumentin për shkak se i akordonte vetëqeverisje të gjerë Kosovës dhe dukej se kishte përparësi kundrejt kuadrit ligjor të RFJ-së/Serbisë, gjithsesi ishte i gatshëm ta pranonte.⁸⁶³ Mirëpo të nesërmen, më 19 shkurt, delegacioni paraqiti mendimin me shkrim në lidhje me propozimin duke kërkuar heqjen e

⁸⁵⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10724 (28 shkurt 2007); P563 (Mesazh i ambasadës austriake, 19 shkurt 1999), f. 2.

⁸⁵⁹ 1D18 (Marc Weller, *The Crisis in Kosovo 1989-1999, Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë*, projekt-propozim i dytë, 18 shkurt 2007), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 431–438. *Shih edhe* Veton Surroi, T. 4559–4560 (10 tetor 2006); Wolfgang Petritsch, T. 10721–10722 (28 shkurt 2007); P2661 (Mesazh i ambasadës austriake, 18 shkurt 1999), f. 2.

⁸⁶⁰ 1D18 (Marc Weller, *Kriza në Kosovë 1989-1999, Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë*, projekt-propozim i dytë, 18 shkurt 2007), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 431, Korniza, neni 2, pjesa 2.

⁸⁶¹ 1D18 (Marc Weller, *Kriza në Kosovë 1989-1999, Deklaratë e Delegacionit Kosovar mbi Propozimin e Ri për Marrëveshje*, 18 shkurt 2007), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 441–442; Veton Surroi, T. 4560–4561 (10 tetor 2006). *Shih edhe* P563 (Mesazh i ambasadës austriake, 19 shkurt 1999), f. 1–2.

⁸⁶² 1D18 (Marc Weller, *Kriza në Kosovë 1989-1999, Deklaratë e Delegacionit Kosovar mbi Propozimin e Ri për Marrëveshje*, 18 shkurt 2007), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 441–442; Veton Surroi, T. 4561–4565 (10 tetor 2006).

⁸⁶³ Wolfgang Petritsch, T. 10722–10723 (28 shkurt 2007), T. 10856 (2 mars 2007); P563 (Mesazh i ambasadës austriake, 19 shkurt 1999), f. 1.

pjesëve të tëra. Si pasojë u mbajtën takime të gjata midis Markoviqit, Kutlesiqit dhe juristëve të negociatorëve.⁸⁶⁴ Edhe delegacioni shqiptar kosovar paraqiti komente me shkrim.⁸⁶⁵

375. Më 19 shkurt udhëheqësit të UÇK-së, Hashim Thaçit, iu dha leje të largohej prej Rambujesë. Ai shkoi në Lubjanë, Slloveni, ku takoi Adem Demaçin, i cili ishte përfaqësues politik i UÇK-së në atë kohë. Pas kthimit, ai i bëri të ditur treshes se takimi kishte qenë pozitiv dhe se ai mund të nënshkruante projekt-marrëveshjen. Po atë ditë anëtarët e delegacionit shqiptar kosovar takuan Wesley Clark-un, i cili kishte ardhur në Rambuje dhe u përpoq t'i bindte të nënshkruanin marrëveshjen. Clark-u informoi delegacionin shqiptar kosovar në lidhje me anekset që mungonin, 2, 5, dhe 7 të cilët trajtonin pjesën zbatuese të marrëveshjes, ndër të cilat edhe aspektin ushtarak. Petritsch-i dëshmoi se në atë kohë anekset ishin hartuar nga brenda prej ekspertëve të NATO-s, por nuk ishin qarkulluar në konferencë,⁸⁶⁶ që duket se bie ndesh me dëshminë e tij të mëparshme se “praktikisht i tërë teksti” u ishte bërë i njohur palëve që prej 18 shkurtit.⁸⁶⁷ Më vonë gjatë pyetjeve nga pala kundërshtarë, Petritsch-i shpjegoi se Hill-i i kishte thënë se anekset e zbatimit i ishin dorëzuar delegacionit të RFJ-së/Serbisë më 18 shkurt, por ishin kundërshtuar.⁸⁶⁸ Për çudi në mesazhin elektronik të ambasadës austriake të 19 shkurtit shkruhet se anekset i ishin dhënë delegacionit shqiptar kosovar, por nuk përmendet se ato i ishin dorëzuar delegacionit të RFJ-së/Serbisë.⁸⁶⁹ Petritsch-i e shpjegoi këtë me arsyetimin se prania ushtarake mund të negociohej vetëm me aktorë shtetërorë, kurse aktorët joshetërorë si shqiptarët kosovarë nuk kishin asnjë ndikim. Sipas Petritsch-it në mesazh ishte më e rëndësishme të theksohej se shqiptarët kosovarë u informuan për ekzistencën e anekseve dhe jo të shënohej i njëjti informacion në lidhje me palën e RFJ-së/Serbisë.⁸⁷⁰ Dhoma thekson se në një prej dispozitave të aneksit 7 përmendet çmilitarizimi i forcave, me përjashtim të UJ-së, MPB-së dhe forcave policore të atjeshme, duke nënkuptuar shpërndarjen e UÇK-së, çështje që natyrisht do të duhej të negociohej me delegacionin e UÇK-së.⁸⁷¹

376. Duket se delegacioni i RFJ-së/Serbisë së paku kishte njoftim, me gjasë vetëm prej informimit në media, për brendinë e propozimit në këtë pjesë të marrëveshjes, meqenëse më 18 shkurt Ministria e Jashtme e RFJ-së lëshoi një deklaratë për të gjithë anëtarët e qeverisë federale, ku

⁸⁶⁴ Wolfgang Petritsch, T. 10726–10727 (28 shkurt 2007); P562 (Mesazh i ambasadës austriake, 20 shkurt 1999), f. 1.

⁸⁶⁵ P562 (Mesazh i ambasadës austriake, 20 shkurt 1999).

⁸⁶⁶ Veton Surroi, T. 4565–4566 (10 tetor 2006); Wolfgang Petritsch, T. 10866–10868 (2 mars 2007), P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 2–3; P562 (Mesazh i ambasadës austriake, 20 shkurt 1999), f. 2.

⁸⁶⁷ Wolfgang Petritsch, T. 10701 (28 shkurt 2007).

⁸⁶⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10921–10926 (2 mars 2007).

⁸⁶⁹ P563 (Mesazh i ambasadës austriake, 19 shkurt 1999), f. 1.

⁸⁷⁰ Wolfgang Petritsch, T. 10926 (2 mars 2007).

⁸⁷¹ P474 (Dokument i titulluar Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë (Marrëveshja e Rambujesë, 23 shkurt 1999), Kapitulli 7, neni V.

deklarohej se delegacioni i RFJ-së/Serbisë “nuk mori ndonjë ‘aneks ushtarak’ ose propozime të ngjashme ushtarake në Rambuje”, se Grupi i Kontaktit nuk diskutoi asnjëherë të njëjtat çështje me delegacionin, dhe se RFJ-ja nuk do të pranonte trupa të huaja në territorin e vet.⁸⁷² Zhivadin Jovanoviç dëshmoi se kjo korrespondencë u përgatit në përgjigje të deklaratave në media në lidhje me nevojën e lejimit të pranisë së NATO-s në Kosovë.⁸⁷³ Mirëpo Momir Bullatoviç dëshmoi se korrespondenca ishte “përgjigje diplomatike” e ministrisë ndaj “aneksit ushtarak ofruar negociatorëve në Rambuje.”⁸⁷⁴

377. Gjatë diskutimeve intensive të zhvilluara natën e 19 shkurtit, delegacioni i RFJ-së/Serbisë dhe negociatorët e Grupit të Kontaktit ia dolën të përfundonin negociatat për pjesët politike të projekt-marrëveshjes, ndër të cilat anekset 1, 3, dhe 6. Markoviç dëshmoi se delegacioni i RFJ-së/Serbisë ishte i përgatitur të pranonte marrëveshjen politike me kusht që në tekstin e propozuar të bëheshin disa korrigjime. Konkretisht u kërkua që kushtetuta të pasqyronte faktin se Kosova ishte pjesë përbërëse e Republikës së Serbisë dhe se Serbia kishte të tëra kompetencat shtetërore në Kosovë. Natën midis 19 dhe 20 shkurtit 1999, në prani të Petritsch-it dhe O’Brien-it, delegacioni i RFJ-së/Serbisë i pranoi këto ndryshime dhe ia doli të arrinte “një shkallë të lartë marrëveshjeje”. Mirëpo të gjitha këto ndryshime duhej të miratoheshin edhe prej delegacionit shqiptar kosovar. Sipas Markoviçit, edhe në afatin e dytë më 20 shkurt, delegacioni i RFJ-së/Serbisë ende nuk kishte marrë tekstin e plotë të marrëveshjes, pavarësisht sigurimeve të dhëna prej negociatorëve më 15 shkurt.⁸⁷⁵

378. Më 20 shkurt 1999, dita e fundit planifikuar për takime, të dy palët u takuan veçazi me anëtarë të Grupit të Kontaktit ndër të cilët edhe Madeleine Albright. Thaçi, në emër të delegacionit shqiptar kosovar u pyet nëse delegacioni do ta pranonte projekt-marrëveshjen, mirëpo ai nuk dha as përgjigje pohuese dhe as mohuese, që binte në kundërshtim me përgjigjen pozitive që i kishte dhënë Petritsch-it para takimit. Si pasojë takimi u shty.⁸⁷⁶ Pas shtyrjes, delegacioni i RFJ-së/Serbisë dhe Millutinoviç u thirrën në takim me Grupin e Kontaktit. Kur u pyet nëse ishte i gatshëm ta pranonte variantin e 18 shkurtit, Millutinoviç dha përgjigje pohuese.⁸⁷⁷

379. Si rezultat i refuzimit të pranimit të projekt-marrëveshjes prej Thaçit, konferenca e Rambujesë u shty edhe për tri ditë, deri më 23 shkurt. Më 21 shkurt, Thaçi, Rugova dhe Rexhep

⁸⁷² 2D221 (Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së adresuar Momir Bullatoviçit, 18 shkurt 1999).

⁸⁷³ Zhivadin Jovanoviç, T. 14061 (20 gusht 2007).

⁸⁷⁴ Momir Bullatoviç, T. 13847 (17 gusht 2007).

⁸⁷⁵ Ratko Markoviç, T. 13197–13198, 13213–13215 (9 gusht 2007).

⁸⁷⁶ Wolfgang Petritsch, T. 10864–10865, 10869 (2 mars 2007); Veton Surroi, T. 4566–4568 (10 tetor 2006).

⁸⁷⁷ Wolfgang Petritsch, T. 10873–10874 (2 mars 2007).

Qosja⁸⁷⁸ patën një drekë pune me Madeleine Albright-in. Gjatë drekës ata bënë të ditur se dëshironin që marrëveshja të përfshinte një referencë për referendum për pavarësinë e Kosovës. Si option alternativ, ata dëshironin një “letër shoqëruese” prej SHBA-së, e cila do të përmendte “shprehjen e vullnetit prej popullit” si faktor në përcaktimin përfundimtar të statusit të Kosovës dhe do të ofronte garanci se SHBA-ja do ta interpretonte këtë frazë si referencë për referendum.⁸⁷⁹ Më 22 shkurt deri në orën 4:15 të mëngjesit ishte arritur marrëveshje për të gjitha pikat me shqiptarët kosovarë përveç klauzolës rishikuese në aneksin 8. Edhe delegacioni i RFJ-së/Serbisë bëri të ditur pranimin, por gjithashtu kundërshtoi klauzolën rishikuese. Rreth orës 5:25 të mëngjesit shqiptarët kosovarë u informuan për një klauzolë të re rishikuese që përfshinte të tëra propozimet e shqiptarëve kosovarë me përjashtim të referencës për referendum. Faktikisht u përmend vetëm “shprehja e vullnetit të popullit”.⁸⁸⁰ Sipas Petritsch-it, fjala “shprehje” u hoq më vonë prej variantit përfundimtar të klauzolës 8, për të zbutur efektin e frazës “vullneti i popullit”.⁸⁸¹ Gjatë asaj nate, SHBA-ja paraqiti letrën shoqëruese që kishte premtuar, duke ofruar garanci se kjo frazë do të interpretohej si referencë për referendumin në lidhje me statusin e Kosovës.⁸⁸² Delegacioni i RFJ-së/Serbisë nuk ishte në dijeni të kësaj letre.⁸⁸³ Në të vërtetë Markoviqi dëshmoi se ai mësoi për ekzistencën e letrave dhe mesazheve midis SHBA-së dhe delegacionit shqiptar kosovar në Rambuje vetëm pasi kishte lexuar librat për negociatat.⁸⁸⁴

380. Më tej Veton Surroi informoi Petritsch-in se ai dëshironte një zotim të ngjashëm prej Bashkimit Evropian. Petritsch-i e kundërshtoi këtë kërkesë fuqimisht.⁸⁸⁵ Pas një diskutimi midis negociatorëve amerikanë dhe të BE-së, Albright u pajtua me qëndrimin e BE-së dhe bashkë me negociatorë të tjerë i thanë delegacionit shqiptar kosovar se referendumi popullor për pavarësinë

⁸⁷⁸ Në atë kohë, Rexhep Qosja ishte udhëheqës i partisë Lëvizja e Bashkuar Demokratike, në të cilën bënin pjesë një numër anëtarësh të pakënaqur të LDK-së që gjithashtu kishin lidhje me UÇK-në; Veton Surroi, T. 4551–4552 (10 tetor 2006).

⁸⁷⁹ Veton Surroi, T. 4568–4569, 4571 (10 tetor 2006).

⁸⁸⁰ Wolfgang Petritsch, T. 10736–10737 (1 mars 2007); P2660 (Mesazh i ambasadës austriake, 22 shkurt 1999), f. 1.

⁸⁸¹ Wolfgang Petritsch, T. 10739–10741 (1 mars 2007); P474 (Dokument i titulluar Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë (Marrëveshja e Rambujesë, 23 shkurt 1999), Kapitulli 8.

⁸⁸² 1D18 (Marc Weller, Kriza në Kosovë 1989-1999, Projekt-aneks 8, neni 1(3) dhe projekt i letrës shoqëruese, 22 shkurt 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 449. Teksti i propozuar i klauzolës rishikuese ishte si më poshtë:

Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshjeje, do të organizohet një takim ndërkombëtar për përcaktimin e një mekanizmi për Zgjidhjen Përfundimtare për Kosovën bazuar në shprehjen e vullnetit të popullit, mendimet e autoriteteve përkatëse, përpjekjet e çdo pale në lidhje me zbatimin e Marrëveshjes, dhe Aktin Përfundimtar të Helsinkit, dhe për kryerjen e një vlerësimi të gjithanshëm të zbatimit të kësaj Marrëveshjeje dhe shqyrtimin e propozimeve prej cilësdo palë për masa shtesë.

⁸⁸³ Wolfgang Petritsch, T. 10737 (1 mars 2007).

⁸⁸⁴ Ratko Markoviq, T. 13212 (9 gusht 2007).

⁸⁸⁵ Wolfgang Petritsch, T. 10741–10742 (1 mars 2007), T. 10890, 10894–10897 (2 mars 2007); P2660 (Mesazh i ambasadës austriake, 22 shkurt 1999), f. 1–2; Veton Surroi, T. 4571–4572 (10 tetor 2006). Surroi kundërshtoi sugjerimin e Mbrojtjes se letra shoqëruese u bllokua prej vetos së BE-së dhe Rusisë. Shpjegimi i tij ishte se letra shoqëruese u tërhoq pas mosnënshkrimit në kohë të marrëveshjes prej delegacionit shqiptar kosovar.

dhe vazhdimësia e ekzistencës së UÇK-së “ishin jashtë diskutimit.”⁸⁸⁶ Përfundimisht oferta e letrës shoqëruese u tërhoq kur delegacioni shqiptar kosovar nuk e nënshkroi marrëveshjen në kohë.⁸⁸⁷ Petritsch- i shënoi këto ngjarje në informacionin e tij ditor për Vjenën, ku ai komentoi se “qëndrimi kokëfortë” i shqiptarëve kosovarë në lidhje me referendumin nuk ishte arsyeja e vërtetë e mosgatishmërisë së tyre për pranimin e projekt-marrëveshjes, por problemi kryesor ishte fakti se marrëveshja parashihte shpërndarjen e UÇK-së, dhe Thaçi si një prej udhëheqësve të UÇK-së, nuk pajtohej me këtë.⁸⁸⁸

381. Gjatë pasdites së 22 shkurtit, u bë e qartë se Thaçi nuk e kishte pranuar projekt-marrëveshjen. Duke qenë se të dy palët e përcillnin njëra-tjetrën me vëmendje, refuzimi i projekt-marrëveshjes prej Thaçit e nxiti edhe delegacionin e RFJ-së/Serbisë të bënte të njëjtën gjë. Sipas Petritsch-it, delegacioni i RFJ-së/Serbisë kundërshtoi shumicën e korigjimeve të bëra dhe madje kundërshtoi edhe disa prej pjesëve tashmë të pranura të marrëveshjes.⁸⁸⁹ Markoviqi shpjegoi se arsyeja e kundërshtimit të marrëveshjes më 22 shkurt, ishte se vetëm në shtatë të mëngjesit, më 22 shkurt, delegacioni i RFJ-së/Serbisë mori më së fundi aneksin 2 (Policia dhe Siguria Publike Civile), 5 (Zbatim I), 7 (Zbatim II), dhe variantin e ri të klauzolës rishikuese në aneksin 8. Sipas Markoviqit, aneksi 8 ishte lëshim i madh për delegacionin shqiptar kosovar. Gjithashtu, delegacioni mësoi prej ambasadorit Mayorski se anëtarët e Grupit të Kontaktit nuk kishin arritur marrëveshje për anekset 2, 5, dhe 7 në ndryshim nga anekset e tjera; treshja nuk kishte patur asnjë diskutim për anekset 2 dhe 7; dhe aneksi 5 ishte diskutuar, por nuk ishte marrë asnjë vendim në lidhje me të.⁸⁹⁰ Pasi u këshillua me krejt delegacionin, Markoviqi nuk i pranoi, duke deklaruar se treshja i kishte siguruar më 15 shkurt se në atë kohë ata kishin krejt projektin e marrëveshjes.⁸⁹¹

382. Gjithsesi, procesi vazhdoi dhe dokumentit iu bënë ndryshime të vogla gjatë natës së 22-23 shkurtit. Në orën 9:30 të mëngjesit të 23 shkurtit, të dy delegacionet morën tekstin përfundimtar të marrëveshjes, e cila veç marrëveshjes kuadër, përfshinte “kapituj” në ndryshim nga anekset 1, 2, 3, 4, 4A, 5, 6, 7, dhe 8.⁸⁹² Projekt-marrëveshja përfundimtare u nënshkrua prej tre anëtarëve të treshes

⁸⁸⁶ Wolfgang Petritsch, T. 10741–10742 (1 mars 2007); P2660 (Mesazh i ambasadës austriake, 22 shkurt 1999), f. 1.

⁸⁸⁷ Veton Surroi, T. 4572, 4574 (10 tetor 2006); *mirëpo shih* Wolfgang Petritsch, T. 10896 (2 mars 2007) ku sugjerohet se hartimi i një letre shoqëruese ishte i papërshtatshëm dhe kjo mund të ketë qenë arsyeja që u tërhoq.

⁸⁸⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10733–10735 (1 mars 2007); P2660 (Mesazh i ambasadës austriake, 22 shkurt 1999), f. 1.

⁸⁸⁹ Wolfgang Petritsch, T. 10745–10747 (1 mars 2007); P2659 (Mesazh i ambasadës austriake, 23 shkurt 1999), f. 1; P2658 (Mesazh i ambasadës austriake, 25 shkurt 1999).

⁸⁹⁰ Ratko Marković, T. 13201–13204 (9 gusht 2007), 13550–13551 (14 gusht 2007); 1D97 (Letër e Ratko Markoviqit drejtuar Hill-it, Petritsch-it, dhe Mayorski-t); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 6.

⁸⁹¹ 1D97 (Letër e Ratko Markoviqit drejtuar Hill-it, Petritsch-it, dhe Mayorski-t, 22 shkurt 1999).

⁸⁹² Wolfgang Petritsch, T. 10700–10701 (28 shkurt 2007), 10756 (1 mars 2007); P474 ((Dokument i titulluar Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë (Marrëveshja e Rambujesë, 23 shkurt 1999), P2659 (Mesazh i ambasadës austriake, 23 shkurt 1999), f. 1; 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 7.

në emër të Grupit të Kontaktit. Mirëpo Mayorski nuk i nënshkroi kapitujt 2 dhe 7, siç u përmend më parë, sepse nuk ishin diskutuar nga Grupi i Kontaktit.⁸⁹³ Në lidhje me kapitullin 5, Markoviçi shpjegoi se Mayorski, në prani të dy negociatorëve të tjerë, deklaroi se nuk ishte miratuar dhe madje as nuk ishte votuar për të.⁸⁹⁴ Mirëpo duket se gjithsesi ai e kishte nënshkruar.

383. Delegacioneve iu kërkua të dorëzonin përgjigjet e tyre në lidhje me të gjitha këto dokumente jo më vonë se ora 1:00 pasdite atë ditë.⁸⁹⁵ Delegacioni i RFJ-së/Serbisë nuk e pranoi marrëveshjen për shkak të dispozitave që trajtonin praninë e huaj ushtarake në RFJ (kapitulli 7, shtojca B) të cilin e konsideroi se u jepte shumë kompetencë forcave të NATO-s në RFJ.⁸⁹⁶ U shpreh pikëpamja se dislokimi i trupave të huaja në Kosovë as nuk ishte shqyrtuar dhe, as nuk ishte pranuar brenda Grupit të Kontaktit dhe rrjedhimisht nuk mund të ishte temë bisedimesh apo marrëveshjeje në lidhje me Kosovën.⁸⁹⁷ Nga ana e tij Petritsch-i shpjegoi se forcat e NATO-s do të ishin të pranishme vetëm në Kosovë dhe se kapitulli 7 gjithashtu lejonte praninë e 1500 ushtarëve të UJ-së në brezin kufitar dhe 1.000 ushtarë në zona të tjera të Kosovës. Sipas Petritsch-it kjo tregonte se bashkësia ndërkombëtare ishte e angazhuar për ruajtjen e tërësisë territoriale dhe sovranitetit të RFJ-së.⁸⁹⁸ Mirëpo Rade Çuçak, oficer i UJ-së, përgjegjës për sigurinë e kufirit, dëshmoi se numri 1.500 ushtarë ishte jorealit dhe vuri në dukje një përlllogaritje të KVM-së të messhkurtit 1999 ku përmendej se për mbrojtjen e duhur të kufirit nevojiteshin së paku 6.600 ushtarë.⁸⁹⁹

384. Arsyeja tjetër për refuzimin e dokumentit kishte të bënte me afatet kohore. Markoviçi theksoi se kapitujt e paraqitur rishtazi 2, 5, dhe 7 përbënin thujse gjysmën e tekstit të plotë të marrëveshjes dhe rrjedhimisht ishte e pamundur një përgjigje brenda një kohe kaq të shkurtër.⁹⁰⁰ Nga ana e tij Petritsch-i shpjegoi se në atë kohë negociatorët e dinin se palët nuk do të praninin

⁸⁹³ 1D98 (Letër e negociatorëve në emër të Grupit të Kontaktit nënshkruar prej Hill-it, Mayorski-t (veç Kapitujve 2 dhe 7), dhe Petritsch-it, 23 shkurt 1999); Ratko Markoviçi, T. 13204–13205 (9 gusht 2007).

⁸⁹⁴ Ratko Markoviçi, T. 13203–13204, 13207–13208 (9 gusht 2007). *Shih edhe* Wolfgang Petritsch, T. 10694–10695 (28 shkurt 2007).

⁸⁹⁵ Ratko Markoviçi, T. 13204 (9 gusht 2007); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 7.

⁸⁹⁶ Zhivadin Jovanoviçi, T. 14059–14060 (20 gusht 2007). *Shih edhe* 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 8, 11–12.

⁸⁹⁷ 2D241 (Raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për qeverinë e RFJ-së në lidhje me bisedimet midis Zhivadin Jovanoviçit dhe Joschka Fischer-it), f. 6.

⁸⁹⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10704–10709 (28 shkurt 2007); P474 ((Dokument i titulluar Marrëveshje e Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë (Marrëveshja e Rambujesë, 23 shkurt 1999), Kapitulli 7.

⁸⁹⁹ Rade Çuçak, T. 14853–14854 (4 shtator 2007); Karol John Drewienkiewicz, T. 7803–7805 (4 dhjetor 2006), P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 176; P640 (Raport i KVM-së i titulluar “Çështje të kufirit të Kosovës”, 21 qershor 2000). *Shih edhe* Millan Kotur, T. 20650–20651 (21 janar 2008). Dhoma thekson se provës materiale i është vënë datë e gabuar dhe se ky raport në fakt ishte përpiluar në mes të shkurtit 1999, pas takimit dhe inspektimit të kufirit prej Drewienkiewicz-it dhe Kotorit.

⁹⁰⁰ Ratko Markoviçi, T. 13208 (9 gusht 2007); Wolfgang Petritsch, T. 10921–10924 (2 mars 2007). *Shih edhe* 1D99 (Letër e Millan Millutinoviçit dhe Ratko Markoviçit drejtuar Madeleine Albright-it, 5 mars 1999); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 8. *Shih edhe* Zhivadin Jovanoviçi, T. 14062 (20 gusht 2007).

duke qenë se të dy bënë të ditur se kishin nevojë për më shumë kohë. Për këtë arsye, treshja u kërkoi palëve vetëm që të bënin të ditur nëse do të ishin të gatshëm të vazhdonin negociatat pas një pushimi prej dy javësh e gjysmë. Gjithashtu Petritsch-i tha se mendohej që pjesa politike e marrëveshjes ishte pak a shumë e pranuar, kurse pjesa në lidhje me zbatimin do të shqyrtohej pas pushimit.⁹⁰¹

385. Duke marrë parasysh që Markoviçi këmbënguli se delegacioni i RFJ-së/Serbisë nuk kishte marrë anekse ushtarake ose zbatuese deri më 22 shkurt dhe si prova paraqiti letra të cilat iu dërguan treshes si ankesë për gjendjen dhe duke marrë parasysh se dëshmia e Petritsch-it në lidhje me shpërndarjen e pjesës së zbatimit bazohej në çfarë iu tha prej Hill-it, i cili nuk ishte i disponueshëm për të dëshmuar në gjyq, Dhoma nuk është në gjendje të konkludojë me qartësi të mjaftueshme se në të vërtetë delegacionit të RFJ-së/Serbisë iu dhanë pjesët në lidhje me zbatimin e marrëveshjes që më 18 shkurt. Në fakt vetë Petritsch-i i raportoi qeverisë së tij se disa anekse/kapituj iu dhanë palëve në një fazë të mëvonshme, duke qenë se treshja kishte mosmarrëveshje të brendshme.⁹⁰² Dhoma thekson se anekset/kapitujt në lidhje me të cilët kishte mosmarrëveshje të brendshme, në fakt ishin anekset 2, 5, dhe 7. Gjithashtu duke marrë parasysh se aneksi/kapitulli 7 kryesisht përmbante një dispozitë për çmilitarizimin e UÇK-së, që ishte gjithmonë pikë e kundërshtuar prej Thaçit, ka mundësi që Clark-u dëshironte të garantonte pranimin prej delegacionit shqiptar kosovar para se këto anekse/kapituj t'i dorëzoheshin palës së RFJ-së/Serbisë.

386. Më 23 shkurt, Ratko Markoviçi dërgoi një letër që sipas Petritsch-it, Grupi i Kontaktit e interpretoi se negociatat kishin dështuar. Më tej Petritsch-i takoi Shainoviçin dhe i përcolli mesazhin se letra do të interpretohej se shënonte fundin e bisedimeve të Rambujesë. Pas disa orësh erdhi letra e dytë, ku bëhej e ditur se delegacioni i RFJ-së/Serbisë do të ishte i gatshëm të vazhdonte negociatat, dhe madje edhe të diskutonte praninë ndërkombëtare, pa e kufizuar në prani civile. Pas pak orësh erdhi letra e tretë ku shprehej sërish gatishmëria për vazhdimin e negociatave dhe pranohej të diskutohej kuadri i pranisë ndërkombëtare në Kosovë, mirëpo njëkohësisht duke e vënë theksin mbi sovranitetin dhe tërësinë territoriale të RFJ-së.⁹⁰³ Delegacioni i RFJ-së/Serbisë deklaroi se “në bisedimet e Rambujesë ishte bërë përparim i madh në përcaktimin e zgjidhjes politike në lidhje me vetëqeverisjen e konsiderueshme të Kosovës duke respektuar sovranitetin dhe tërësinë

⁹⁰¹ Wolfgang Petritsch, T. 10700–10701 (28 shkurt 2007), T. 10927–10928 (2 mars 2007).

⁹⁰² P2658 (Mesazh i ambasadës austriake, 25 shkurt 1999), f. 1.

⁹⁰³ Wolfgang Petritsch, T. 10747–10748 (1 mars 2007), T. 10928–10934 (2 mars 1999), P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 4; P625 (Letër drejtuar Hill-it, Petritsch-it, dhe Mayorski-t nënshkruar prej Ratko Markoviçit, 23 shkurt 1999), pranuar gjithashtu si 1D582. *Shih edhe* 1D18 (Marc Weller, Kriza në Kosovë 1989-1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 466. Sipas Petritsch-it, gjatë negociatave të mëvonshme në Paris, Millutinoviçi bëri të ditur se këtë letër e kishte hartuar ai. Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 4.

territoriale të Republikës së Serbisë dhe RFJ-së”. Në veçanti u theksua “se nuk mund të ketë Kosovë dhe Metohi dhe as republikë të tretë.” U shpreh gatishmëria e plotë “për vazhdimin e punës në përputhje me frymën pozitive të këtij takimi” duke theksua se “bisedimet e drejtpërdrejta midis dy delegacioneve do të ishin të dobishme.”⁹⁰⁴ Qëndrimi i RFJ-së/Serbisë se ishte i gatshëm të pranonte marrëveshjen politike të Rambujesë, u përsërit në një konferencë shtypi mbajtur prej Millutinoviçit në Paris më 23 shkurt 1999. Ndër të tjera ai pranoi se “ata bënë përpjekje të konsiderueshme për arritjen e disa rezultateve në konferencë që me gjasë do të shërbejnë si pikënisje për takimin e ardhshëm”.⁹⁰⁵

387. Sa i përket delegacionit shqiptar kosovar, edhe ata e morën marrëveshjen e plotë mëngjesin e 23 shkurtit dhe duhej të përgjigjej pasdite. Me afrimin e afatit, Hill-i iu bashkua delegacionit shqiptar kosovar për drekë i shqetësuar për mosardhjen e përgjigjes. Gjatë drekës doli ideja që delegacioni shqiptar kosovar t’i dërgonte letër Albright-it si dhe negociatorëve të tjerë me pikëpamjet e tyre për kapitullin 8.⁹⁰⁶ Si pasojë në letrën dërguar vetëm Madeleine Albright-it, delegacioni shqiptar kosovar shprehu gatishmërinë për pranimin e marrëveshjes, por shprehu vlerësimin se marrëveshja nuk përjashtonte referendumin në Kosovë. Aty shkruhej se rezultatet e këtij referendumi do t’i përcilleshin një takimi ndërkombëtar të organizuar për përcaktimin e mekanizmit të zgjidhjes përfundimtare siç bëhej thirrje në kapitullin 8.⁹⁰⁷ Petritsch-i pranoi se letra e dërguar Albright-it ishte pikërisht lloji i marrëveshjes së njëanshme midis shqiptarëve kosovarë dhe SHBA-së e cila ishte kundërshtuar më parë prej negociatorëve të BE-së. Ai deklaroi se ajo nuk u bë asnjëherë pjesë e procesit të Rambujesë megjithëse iu dorëzua Albright-it.⁹⁰⁸

388. Po atë ditë, në orën 4:30 pasdite, delegacioni shqiptar kosovar gjithashtu lëshoi një deklaratë publike ku njoftohej se do të nënshkruante marrëveshjen për dy javë dhe se në fund të një periudhe trevjeçare kalimtare, do të organizonte një referendum në Kosovë për plotësimin e vullnetit të popullit, siç përcaktohej në kapitullin 8 të marrëveshjes. Gjithashtu delegacioni shqiptar kosovar deklaroi se priste “dislokim të shpejtë të NATO-s në terren si pjesë thelbësore e Marrëveshjes.”⁹⁰⁹ Hill-i dhe Petritsch-i bashkëpunuan me delegacionin shqiptar kosovar në lidhje me këtë

⁹⁰⁴ Ratko Markoviç, T. 13209 (9 gusht 2007); P625 (Letër drejtuar Hill-it, Petritsch-it, dhe Mayorski-t nënshkruar prej Ratko Markoviçit, 23 shkurt 1999), pranuar gjithashtu si 1D582; 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 7.

⁹⁰⁵ Ratko Markoviç, T. 13215 (9 gusht 2007); 1D586 (Konferencë Shtypi e Millutinoviçit në Paris, 23 shkurt 1999), f. 1. *Shih edhe* 2D288 (Njoftim i sesionit të qeverisë së RFJ-së, 25 shkurt 1999).

⁹⁰⁶ Veton Surroi, T. 4574–4578 (10 tetor 2006).

⁹⁰⁷ 1D18 (Marc Weller, Kriza në Kosovë 1989–1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 467.

⁹⁰⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10906–10911, 10916–10918 (2 mars 2007); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 7–8. *Shih edhe* 1D206 (Fragment videofilmimi i BBC-së nga Rënia e Millosheviçit); 1D205 (Transkript i fragmentit të videofilmimit të BBC-së nga Rënia e Millosheviçit); Branko Kërka, T. 16790–16791 (3 tetor 2007); P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 24 shkurtin 1999), f. 4.

⁹⁰⁹ 1D18 (Marc Weller, Kriza në Kosovë 1989–1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 467.

deklaratë.⁹¹⁰ Petritsch-i shpjegoi se kjo u bë për shkak se bashkësia ndërkombëtare pranoi se nuk mund të pengonte askënd të organizonte referendum, por vendimtar ishte statusi i një referendumi të tillë. Bashkësia ndërkombëtare dëshironte që ky referendum ose vullneti i popullit të ishte vetëm një ndër faktorët për tu shqyrtuar gjatë marrjes së një vendimi të tillë dhe jo faktor vendimtar.⁹¹¹

389. Duke u bazuar në letrën e dërguar Madeleine Albright-it nga delegacioni shqiptar kosovar dhe pavarësisht letrës pozitive që delegacioni i RFJ-së/Serbisë i dërgoi treshes, një zëdhënës i departamentit amerikan të Shtetit njoftoi publikisht se shqiptarët kosovarë e kishin pranuar marrëveshjen “dhe kishin zgjedhur paqen”, kurse delegacioni i RFJ-së/Serbisë nuk kishte bërë të njëjtën gjë.⁹¹² Mirëpo Dhoma mendon se provat nuk ofrojnë bazë për konkluzionin se delegacioni i RFJ-së/Serbisë ishte më pak i angazhuar në arritjen e paqes në këtë fazë të negociatave. Kjo konfirmohet prej konkluzionit të Grupit të Kontaktit në fund të konferencës se megjithëse negociatat ishin të vështira, palët kishin arritur konsensus për autonomi të konsiderueshme në Kosovë me mekanizma të gatshëm për zgjedhje demokratike, mbrojtjen e të drejtave njerëzore dhe pakicave kombëtare dhe një sistem të drejtë ligjor.⁹¹³ Gjithashtu Petritsch-i dëshmoi se të dy palëve u duhej më shumë kohë dhe kishin rënë dakord për një raund të dytë bisedimesh në Paris, të planifikuara për 15 mars 1999, ku do të finalizohesh pjesa e zbatimit të marrëveshjes.⁹¹⁴

390. Gjatë periudhës midis bisedimeve të Rambujesë dhe takimit vijues në Paris, shtete anëtarë të Grupit të Kontaktit, veçanërisht SHBA-ja, lobuan drejtpërsëdrejti Presidentin e RFJ-së Millosheviqin për pranimin e projekt-marrëveshjes dhe u përpoqën t’u bindnin për nevojën e pranisë monitoruese ndërkombëtare në Kosovë.⁹¹⁵ Petritsch-i dhe ministri i Jashtëm gjerman, Joschka Fischer, shkuan në Beograd rreth datës 27 shkurt për të takuar Millosheviqin dhe Millutinoviqin. Në një kohë që Fischer-i takoi privatisht Millosheviqin, Petritsch-i bisedoi me Millutinoviqin i cili refuzoi të diskutonte tekstin e propozuar apo aspektet politike të marrëveshjes. Sipas Petritsch-it, kjo ishte shenja e parë që pala jugosllave/serbe përfundimisht nuk do ta nënshkruante marrëveshjen.⁹¹⁶ Më 1 mars Knut Vollebaek takoi Millosheviqin në Beograd për t’u bindur që të pranonte një forcë ushtarake udhëhequr prej NATO-s në Kosovë. Millosheviqi refuzoi.

⁹¹⁰ P2659 (Mesazh i ambasadës austriake, 23 shkurt 1999), f. 1–2.

⁹¹¹ Wolfgang Petritsch, T. 10897–10901, 10904–10905 (2 mars 2007); P2659 (Mesazh i ambasadës austriake, 23 shkurt 1999), f. 1–2.

⁹¹² 1D206 (Fragment videofilmimi i BBC-së nga Rënia e Millosheviqit); 1D205 (Transkript i fragmentit të videofilmimit të BBC-së nga Rënia e Millosheviqit).

⁹¹³ Wolfgang Petritsch, T. 10756–10758 (1 mars 2007); P2814 (Deklaratë e Grupit të Kontaktit, 23 shkurt 1999), para. 1, 3, 4.

⁹¹⁴ Wolfgang Petritsch, T. 10700–10701 (28 shkurt 2007); P2814 Deklaratë e Grupit të Kontaktit, 23 shkurt 1999), para. 4.

⁹¹⁵ Wolfgang Petritsch, T. 10724–10726 (28 shkurt 2007).

⁹¹⁶ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 5.

Pas takimit, zyra e tij lëshoi një deklaratë publike ku thuhej se prania ndërkombëtare në Kosovë duhej të përputhej me çfarë ishte përcaktuar në marrëveshjen për KVM-në.⁹¹⁷ Më 2 mars Millutinoviqi takoi Hill-in në Beograd kurse Vollebaek-u shkoi në Kosovë për të takuar disa anëtarë të delegacionit shqiptar kosovar si dhe Zoran Angjelkoviqin, kreun e KEP-it në atë kohë. Vollebaek-u ishte optimist në lidhje me bisedimet me shqiptarët kosovarë të cilët bënë të ditur se do ta nënshkruanin marrëveshjen e Rambujesë. Nga ana tjetër Hill-i raportoi se kishte dallime të konsiderueshme midis mendimit të autoriteteve të RFJ-së/Serbisë dhe bashkësisë ndërkombëtare në lidhje me zbatimin dhe praninë ushtarake ndërkombëtare.⁹¹⁸

391. Ratko Markoviqi dëshmoi se më 5 mars 1999 ai dhe Millutinoviqi patën një takim me delegacionin e RFJ-së/Serbisë dhe se delegacioni ishte i gatshëm të vazhdonte bisedimet.⁹¹⁹ Wolfgang Petritsch-i, nga ana e tij dëshmoi se Millutinoviqi lëshoi një deklaratë publike më 5 mars ku tregohet qartë ndryshimi i qëndrimit në emër të delegacionit të RFJ-së/Serbisë për procesin e Rambujesë, me gjithë gatishmërinë e shprehur për vazhdimin e bisedimeve.⁹²⁰ Duket se autoritetet e RFJ-së/Serbisë kanë gjykuar se ndërkombëtarët pjesëmarrës në procesin e negociatave po nguteshin së tepërmi në përpjekjet e tyre. Në letrat e 5 marsit 1999, drejtuar Sekretares amerikane të Shtetit, Madeleine Albright dhe shumë zyrtarëve të tjerë të huaj, Millutinoviqi dhe Markoviqi shprehën shqetësimin në lidhje me “fushatën e pashembullt për sigurimin e nënshkrimit të tekstit të ‘Marrëveshjes’ së paqenë të 23 shkurtit, (më 9:30 të mëngjesit) prej përfaqësuesve politikë të lëvizjes separatiste shqiptare, madje edhe para 15 marsit dhe vazhdimin të bisedimeve të pranuar. Gjithashtu ata deklaruan se “fushata e tanishme për nënshkrimin e ‘dokumentit’ të paqenë i habit dhe shkakton indinjatë sepse duket qartë se ata po orvaten të imponojnë politikën e faktit të kryer, që mund të sabotojë seriozisht vazhdimin e procesit të negociatave.”⁹²¹

392. Delegacioni i RFJ-së/Serbisë shkoi në Paris më 14 mars 1999 dhe bisedimet rifilluan më 15 mars. Këtë herë Millutinoviqi ishte i pranishëm që prej fillimit.⁹²² Në një përpjekje për përfshirjen e elementëve të autonomisë së konsiderueshme në projekt-marrëveshje dhe për harmonizimin e krejt tekstit me dhjetë parimet e panegociueshme të Grupit të Kontaktit, delegacioni i RFJ-së/Serbisë i

⁹¹⁷ P460 (Raport i KVM-së për 1 mars 1999), para. 1.

⁹¹⁸ P461 (Raport i KVM-së për 2 mars 1999), para 1–2.

⁹¹⁹ Ratko Markoviq, T. 13219–13220 (9 gusht 2007).

⁹²⁰ Wolfgang Petritsch, T. 10758 (1 mars 2007).

⁹²¹ Ratko Markoviq, T. 13218–13219 (9 gusht 2007); 1D99 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Madeleine Albright-it, 5 mars 1999); 1D595 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Hubert Vedrine, 5 mars 1999); 1D594 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Joschka Fischer-it, 5 mars 1999); 1D593 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Lamberto Dini-t, 5 mars 1999); 1D592 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Robin Cook-ut, 5 mars 1999); 1D591 (Letër e Millan Millutinoviqit dhe Ratko Markoviqit drejtuar Igor Ivanov-it, 5 mars 1999); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 8.

⁹²² Ratko Markoviq, T. 13222 (9 gusht 2007).

dërgoi treshes variantin e rishikuar të projekt-marrëveshjes së Rambujesë, prej së cilës hoqi të tëra dispozitat që “cenonin parimin e deklaruar të sovranitetit dhe tërësisë së territorit” të RFJ-së, konkretisht “gjithçka që bie ndesh me barazinë e pakicave kombëtare, që del jashtë dhe mbi ndihmën ndërkombëtare në zgjidhjen e çështjes së Kosovës ... dhe që përbën protektorat ndërkombëtar”.⁹²³ Të nesërmen, Millutinoviçi bëri një deklaratë ku deklaroi se “delegacioni i qeverisë së Republikës së Serbisë është i gatshëm të pranojë pjesën politike të Marrëveshjes për Kosovën dhe Metohinë, në qoftë se pranohen kundërshtimet e shprehura dje nga delegacioni.”⁹²⁴ Gjithashtu ai deklaroi se marrëveshja duhej nënshkruar para diskutimeve për zbatimin e saj dhe konkludoi se kuadri dhe lloji i zbatimit duheshin diskutuar në një datë të mëvonshme.⁹²⁵ Bashkëkryetarët u përgjigjën se Grupi i Kontaktit, në një takim më 15 mars, kishte konkluduar njëzëri se në pjesët politike të tekstit të 23 shkurtit 1999 nuk ishte i pranueshëm asnjë ndryshim; vetëm rregullime teknike mund të merreshin parasysh. Njëkohësisht Grupi i Kontaktit nënvizoi se ishte e nevojshme të fillohej menjëherë diskutimi i elementëve të zbatimit të marrëveshjes, dhe se palët duhej ta miratonin marrëveshjen tërësisht, përfshirë edhe dispozitat zbatuese.⁹²⁶

393. Petritsch-i dëshmoi se ishte e qartë dhe e dukshme për treshen në atë moment se Millutinoviçi kishte ardhur me udhëzime prej Millosheviqit për të refuzuar çfarëdo aspekti të marrëveshjes. Delegacioni i RFJ-së/Serbisë u tërhoq plotësisht prej çdo kompromisi që kishin pranuar në shkurt. Negociatat ishin të vdekura.⁹²⁷ Petritsch-i mendonte se arsyeja ishte ndryshimi i mendjes prej Millosheviqit i cili kishte vendosur të kundërshtonte marrëveshjen e propozuar tërësisht. Ishte vendim i papërshtatshëm sepse marrëveshja e propozuar “ishte mjaft e mirë për serbët”: ajo mbështeste shprehimisht mbrojtjen e kufijve të RFJ-së, dhe bënte të ditur se lloji dhe karakteri i forcës ushtarake që do të dislokohej në Kosovë me gjasë do të autorizohet prej Këshillit të Sigurimit të OKB-së.⁹²⁸ Megjithëse kur u pyet nga pala kundërshtare ai pranoi se pas Rambujesë mbetën disa çështje të pazgjidhura në aspektin politik të marrëveshjes, Petritsch-i përsëriti se delegacionit të RFJ-së/Serbisë në Paris iu tha se do të diskutohej vetëm zbatimi. Ai shpjegoi se kjo ishte bërë për arsye praktike, për të mbyllur pjesën e vështirë të negociatave, pikërisht zbatimin para se palët t’i ktheheshin diskutimit për nuancat e marrëveshjes politike.⁹²⁹ Ky qëndrim ishte i

⁹²³ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 9. *Shih edhe* Millan Jovanović, T. 14187–14192, 14213–14214 (22 gusht 2007); 2D384 (Marrëveshje mbi Vetëqeverisjen në Kosovë e 15 marsit 1999).

⁹²⁴ 1D587 (Deklaratë e Millan Millutinoviçit për Shtypin, 16 mars 1999).

⁹²⁵ 1D587 (Deklaratë e Millan Millutinoviçit për Shtypin, 16 mars 1999); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 7–9.

⁹²⁶ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 9.

⁹²⁷ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 5.

⁹²⁸ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 6.

⁹²⁹ Wolfgang Petritsch, T. 10930–10936 (2 mars 2007); 1D18 (Marc Weller, *The Crisis in Kosovo 1989–1999*, Tri letra dërguar negociatorëve prej delegacionit të RFJ-së/Serbisë më 23 shkurt 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 466.

kundërt me atë të delegacionit të RFJ-së/Serbisë që bisedimet për zbatimin të zhvilloheshin vetëm pas arritjes së marrëveshjes për zgjidhjen politike.⁹³⁰

394. Më 17 mars 1999 Markoviçi u dërgoi një letër negociatorëve ku iu kërkonte të organizonin një takim të përbashkët të dy delegacioneve me qëllim që ata dëgjonin drejtpërsëdrejti prej palës tjetër komentet për propozimet e delegacionit të RFJ-së/Serbisë.⁹³¹ Po atë ditë Nikolla Çiçanoviçi, sekretar i delegacionit të RFJ-së/Serbisë u dërgoi kërkesë Bashkëkryetarëve të negociatave të Parisit ku kërkonte informacion për planin e punës së negociatave.⁹³² Markoviçi shpjegoi se në takimet e Parisit nuk kishte një plan ose rend dite të përcaktuar apo rregulla procedurale, dhe se ata këmbëngulën në miratimin e një procedure të përcaktuar të takimit.⁹³³

395. Si përgjigje delegacioni i RFJ-së/Serbisë mori një rekomandim për të filluar diskutimin e kapitullit 5 për zbatimin, mirëpo për shkak se ky propozim binte ndesh me qëndrimin se së pari duhej përkufizuar zbatimi, dhe vetëm pas kësaj mund të diskutoheshin mënyrat e zbatimit, delegacioni e kundërshtoi propozimin.⁹³⁴

396. Më 18 mars 1999 përfaqësuesit e pakicave etnike që jetonin në Kosovë, të cilët ishin pjesë e delegacionit të RFJ-së/Serbisë, u dërguan letër Robin Cook-ut dhe Hubert Vedrine-s, Bashkëkryetarë të Grupit të Kontaktit. Në letër ata ankoreshin se teksti i marrëveshjes së propozuar ndryshonte prej parimeve të Grupit të Kontaktit sepse favorizonte vetëm shqiptarët kosovarë duke e përcaktuar procesin vendimmarrës bazuar në shumicë.⁹³⁵ Po atë ditë delegacioni shqiptar kosovar nënshkroi projekt-marrëveshjen e Rambujesë të 23 shkurtit.⁹³⁶ Menjëherë më pas delegacioni i RFJ-së/Serbisë u dërgoi variantin e vet të “marrëveshjes mbi vetëqeverisjen në Kosovë dhe Metohi” bashkëkryetarëve të takimit, e cila përfshinte elementë të marrëveshjes së Rambujesë, pa kapitujt e zbatimit.⁹³⁷ Ambasadori Petritsch gjithashtu dëshmoi se më 18 mars 1999 Hill-i takoi Millutinoviçin në Paris. Hill-i e karakterizoi këtë takim si “absolutisht joproduktiv.”⁹³⁸

⁹³⁰ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 9.

⁹³¹ Ratko Markoviç, T. 13222–13223 (9 gusht 2007); 1D110 (Letër e Ratko Markoviçit drejtuar ambasadorëve Hill, Petritsch, dhe Mayorski ku kërkonte një takim të përbashkët, 17 mars 1999).

⁹³² 1D111 (Letër e Nikolla Çiçanoviçit drejtuar Bashkëkryetarëve të Konferencës së Parisit ku kërkohet plan pune, 17 mars 1999)

⁹³³ Ratko Markoviç, T. 13223 (9 gusht 2007); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 8.

⁹³⁴ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999, f. 9.

⁹³⁵ 1D114 (Letër drejtuar Hubert Vedrine-it dhe Robin Cook-ut, lidhur me mospajtimin me procesin e Rambujesë, 18 mars 1999).

⁹³⁶ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 9.

⁹³⁷ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 10.

⁹³⁸ Wolfgang Petritsch, T. 10723–10724 (28 shkurt 2007); P563 (Mesazh i ambasadës austriake, 19 shkurt 1999), f. 2.

397. Më 19 mars 1999, Bashkëkryetarët lëshuan një deklaratë ku thuhej se marrëveshja e Rambujesë përfaqësonte “të vetmen zgjidhje politike të problemit të Kosovës”, dhe se “delegacioni kosovar në Paris e kishte shfrytëzuar këtë mundësi dhe ishte angazhuar tërësisht për marrëveshjen duke e nënshkruar,” kurse delegacioni i RFJ-së/Serbisë ishte përpjekur ta debatonte sërish marrëveshjen. Për këtë arsye, pas këshillimeve me Grupin e Kontaktit, ata arritën në konkluzionin “se nuk ka kuptim zgjatja e bisedimeve.” Ata i shtynë negociatat dhe nuk do të vazhdonin bisedimet “deri kur serbët të deklarojnë se e pranojnë marrëveshjen.” Ata deklaruan se do të nisnin pa vonesë konsultimet me partnerët dhe aleatët për të qenë gati për veprim; se do të ishin në kontakt me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s dhe se i kërkonin OSBE-së marrjen e masave të nevojshme për sigurinë e KVM-së.⁹³⁹

398. Mayorski, Hill-i, dhe Petritsch-i takuan Millosheviqin më 22 mars 1999 për të theksuar dobritë e marrëveshjes për RFJ-në dhe Serbinë. Petritsch-i dëshmoi se dukej se Millosheviqi nuk i dinte hollësitë e marrëveshjes dhe për diplomatët ishte e qartë se “ai kishte vendosur të mos angazhohej në asnjë lloj diskutimi.”⁹⁴⁰ Mayorski ofroi të organizonte një raund të ri negociatash në të cilat çdo mundësi ishte “sërish në tryezë”, ofertë e cila ishte tërësisht jashtë mandatit të negociatorëve, por Millosheviqi e refuzoi këtë opsion.⁹⁴¹ Pas një orvatjeje të fundit për marrëveshje me Millosheviqin në Beograd, më 23 mars 1999 Holbrooke-u njoftoi dështimin e negociatave. Po atë ditë Sekretari i Përgjithshëm, Solana udhëzoi, Wesley Clark-un që të fillonte sulmet ajrore, të cilat nisën të nesërmen.⁹⁴² Kur u pyet prej trupit gjykues për bombardimet, Naumann-i mohoi se vendimi për nisjen e sulmeve ajrore kundër RFJ-së ishte marrë prej NATO-s që në janar 1999, dhe shpjegoi se vendimi përfundimtar u nxit prej dështimit të bisedimeve të marsit 1999 në Francë, dhe shtimit të dhunës në terren në Kosovë.⁹⁴³

399. Delegacioni i RFJ-së/Serbisë paraqiti një raport në Kuvendin Kombëtar të Republikës së Serbisë gjatë sesionit të 23 marsit 1999.⁹⁴⁴ Si kryetar i delegacionit, Markoviqi i shpjegoi Kuvendit Kombëtar arsyet kryesore për refuzimin e marrëveshjes duke përfshirë edhe faktin se në vijimësinë

⁹³⁹ 2D242 (Procesverbal i Sesionit të 52-të të Qeverisë së RFJ-së zhvilluar më 19 mars 1999 dhe Njoftim i Bashkëkryetarëve i 19 marsit 1999 në aneks), f. 3–5; Zhivadin Jovanoviq, T. 14064–14066 (20 gusht 2007).

⁹⁴⁰ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 8.

⁹⁴¹ Wolfgang Petritsch, P2792 (deklaratë dëshmitari me datë 9 qershor 1999), f. 8.

⁹⁴² Klaus Naumann, T. 8339 (14 dhjetor 2006). *Shih edhe* 2D244 (Zyra në terren e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së në Kosovë – Memorandum në lidhje me rrezikun e afërt të sulmit, 24 mars 1999); 2D293 (Shpallje e gjendjes së luftës prej qeverisë së RFJ-së, 23 mars 1999); 2D295 (Deklaratë e Ministrisë së Informacionit të RFJ-së, 25 mars 1999).

⁹⁴³ Klaus Naumann, T. 8338–8340 (14 dhjetor 2006). Naumann-i u pyet gjithashtu në lidhje me deklarata të ndryshme të bëra në 1998 prej Clark-ut dhe Solana-s, në lidhje me ruajtjen e besueshmërisë së NATO-s dhe “shtyrjen e gjërave para”, gjithsesi ai shpjegoi se, edhe pse këto shqetësime ekzistonin, bombardimi nuk do të kryhej bazuar vetëm në këto aspekte. Klaus Naumann, T. 8346–8348 (14 dhjetor 2006).

⁹⁴⁴ Ratko Markoviq, T. 13228–13229 (9 gusht 2007); 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999).

e takimit në Paris, u mbyllën të tëra pikat thelbësore të pjesës politike të marrëveshjes, me gjithë mbetjen pazgjidhur të disa çështjeve; se delegacioni nuk mori asnjë përgjigje për kundërshtimin se më shumë se gjysma e tekstit të marrëveshjes nuk ishte përcaktuar prej Grupit të Kontaktit; se marrëveshja veçonte sovranitetin shtetëror prej tërësisë territoriale të Serbisë dhe RFJ-së; se në marrëveshje “autonomia e konsiderueshme” në Kosovë merrte trajtën e një shteti për shumicën shqiptare, dhe mbrojtje të pakicave për pakicat e tjera etnike; se në Paris ishin të disponueshme dy tekste të ndryshme, një prej të cilëve ishte miratuar pjesërisht prej Grupit të Kontaktit, kurse tjetri ishte hartuar prej delegacionit të RFJ-së/Serbisë bazuar në elementët e vetëqeverisjes së konsiderueshme dhe dhjetë parimet bazë të Grupit të Kontaktit; dhe se nuk ekzistonin rregulla për procedurën dhe nuk pati negociata të drejtpërdrejta midis palëve.⁹⁴⁵

400. Edhe Millutinoviçi foli në Kuvendin Kombëtar dhe shprehu mendimet e tija për bisedimet e Rambujesë/Parisit, që sipas Markoviçit pasqyruan objektivisht rrethanat e bisedimeve. Millutinoviçi deklaroi se delegacioni bëri çmos në rrethanat ekzistuese, por u përball me “presion të pashembullt”, meqenëse kyçi i bisedimeve ishte dislokimi i trupave të huaja në territorin e tyre.⁹⁴⁶ Pas shqyrtimit të raportit të delegacionit të RFJ-së/Serbisë, Kuvendi Kombëtar miratoi njëzëri konkluzionet të cilat u botuan në Fletoren Zyrtare dhe në të cilën Kuvendi ndër të tjera dënoi sulmin e pritshëm të NATO-s; i kërkoi Këshillit të Sigurimit të OKB-së t’u parandalonte; u kërkoi të gjitha qeverive të shteteve anëtarë të OKB-së dhe OSBE-së të përkrahnin rifillimin e procesit politik; dhe miratoi veprimtarinë e delegacionit të RFJ-së/Serbisë gjatë negociatave.⁹⁴⁷

401. Bazuar në përvojën e tij të negociatave në Prishtinë, Rambuje dhe Paris, Markoviçi gjykoi se për shqiptarët kosovarë nuk kishte zgjidhje alternative për pavarësinë e Kosovës.⁹⁴⁸ Shqiptarët kosovarë e nënshkruan marrëveshjen vetëm pas përfshirjes së kapitullit 8, ku u formulua mundësia se statusi përfundimtar i Kosovës do të vendosej duke marrë parasysh së pari dhe para së gjithash vullnetin e popullit të Kosovës.⁹⁴⁹ Markoviçi dëshmoi se pavarësisht të gjitha problemeve të shtjelluara më lart, delegacioni i RFJ-së/Serbisë i konsideroi negociatat si përparim. Sipas tij kishte patur përparim drejt një zgjidhjeje politike në lidhje me autonominë e Kosovës, veçanërisht në lidhje me Kushtetutën, Zgjedhjet dhe Avokatin e Popullit në Kosovë.⁹⁵⁰ Mirëpo që prej fillimit të

⁹⁴⁵ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 11; Ratko Markoviç, T. 13551–13553 (14 gusht 2007).

⁹⁴⁶ 1D32 (Procesverbal i sesionit të Kuvendit Kombëtar, 23 mars 1999), f. 29–30. *Shih edhe* Ratko Markoviç, T. 13576 (14 gusht 2007).

⁹⁴⁷ Ratko Markoviç, T. 13229–13231 (9 gusht 2007); 1D33 (Konkluzione të Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë pas shqyrtimit të raportit të delegacionit në bisedimet e Rambujesë dhe Parisit, 23 mars 1999). Qeveria e RFJ-së bëri të njëjtën gjë; 2D245 (Raport i qeverisë së RFJ-së, 26 mars 1999).

⁹⁴⁸ Ratko Markoviç, T. 13227 (9 gusht 2007).

⁹⁴⁹ Ratko Markoviç, T. 13228 (9 gusht 2007).

⁹⁵⁰ Ratko Markoviç, T. 13208–13209 (9 gusht 2007).

negociatave qëndrimi i treshes dhe Grupit të Kontaktit ishte se ishte e mundshme të pranohej dhe nënshkruhej e tërë marrëveshja dhe jo vetëm pjesë të veçanta; rrjedhimisht marrëveshja ishte “gjithçka ose asgjë”.⁹⁵¹ Gjithashtu Markoviçi shpjegoi se ndaj delegacionit serb u ushtrua presion i madh që ta pranonte marrëveshjen nën kërcënimin e bombardimit.⁹⁵² Ai deklaroi se ishte i bindur se qeveria e Republikës së Serbisë dëshironte sinqerisht zgjidhjen e problemit në Kosovë me mjete paqësore në vend të konfliktit të armatosur.⁹⁵³ Zhivadin Jovanoviçi shprehu bindjen se në Rambuje nuk pati bisedime të njëmendta, dhe qëllimi i konferencës ishte që RFJ-ja dhe Serbia të cilësoheshin jobashkëpunuese, për ta përdorur si pretekst të përgatitjeve të mëtejshme të sulmit të NATO-s kundër RFJ-së.⁹⁵⁴ Momir Bullatoviçi gjithashtu shprehu mendimin se negociatat në Rambuje faktikisht nuk ishin negociata.⁹⁵⁵ Edhe Millan Jovanoviçi shprehu pikëpamjen se ftesa për bisedime në Rambuje ishte “ultimatum”, dhe se Grupi i Kontaktit thjesht po kërkonte pretekst për ndërhyrje në Kosovë.⁹⁵⁶

F. TËRHEQJA E KVM-SË

402. Kur u bë e qartë se nuk do të kishte marrëveshje midis palëve, më 19 mars 1999, Kryetari në Detyrë i OSBE-së Knut Vollebaek urdhëroi tërheqjen e menjëhershme të KVM-së nga Kosova.⁹⁵⁷ Sandra Mitchell dëshmoi se KVM-ja u tërhoq për shkak të sjelljes dhe shtimit të pranisë së forcave serbe të sigurisë dislokuar në Kosovë; përkeqësimi i gjendjes së sigurisë e pengonte KVM-në të kryente funksionin në bazë të mandatit që i ishte akorduar.⁹⁵⁸ Brenda mesditës, më 20 mars 1999, KVM-ja që në atë kohë numëronte afërsisht 1.300 vetë në personelin e vet ndërkombëtar,⁹⁵⁹ ishte evakuuar në Maqedoni.⁹⁶⁰

403. Tërheqja nga Kosova shënoi fundin e mandatit të KVM-së, por jo punën e OSBE-së në rajon. Më 27 mars 1999, u njoftua se personeli i KVM-ja do të zbriste në 250 vetë në Maqedoni.

⁹⁵¹ Ratko Markoviçi, T. 13205–13207 (9 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviçi, T. 14062–14063 (20 gusht 2007); 2D241 (Raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për qeverinë e RFJ-së në lidhje me bisedimet midis Zhivadin Jovanoviçit dhe Joschka Fischer-it), f. 6–7.

⁹⁵² Ratko Markoviçi, T. 13577 (14 gusht 2007).

⁹⁵³ Ratko Markoviçi, T. 13220–13222 (9 gusht 2007); T. 13556 (14 gusht 2007).

⁹⁵⁴ Zhivadin Jovanoviçi, T. 14061–14066 (20 gusht 2007); 2D241 (Raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për qeverinë e RFJ-së në lidhje me bisedimet midis Zhivadin Jovanoviçit dhe Joschka Fischer-it); 2D242 (Procesverbal i Sesionit të 52^{-të} të Qeverisë së RFJ-së zhvilluar më 19 mars 1999 dhe Njoftimi i Bashkëngjitur i Bashkëkryetarëve në Rambuje dhe Paris).

⁹⁵⁵ Momir Bullatoviçi, T. 13846 (17 gusht 2007).

⁹⁵⁶ Millan Jovanoviçi, T. 14174 (22 gusht 2007).

⁹⁵⁷ Knut Vollebaek, P2634 (deklaratë dëshmitari me datë 8 janar 2002), para. 72–78. *Shih edhe* 2D247 (Projekt-konkluzione të qeverisë së RFJ-së mbi tërheqjen e KVM-së).

⁹⁵⁸ Sandra Mitchell, T. 561 (11 korrik 2006). *Shih edhe* Richard Ciaglinski, T. 6818–6819 (17 nëntor 2006).

⁹⁵⁹ Sandra Mitchell, T. 499 (10 korrik 2006); Richard Ciaglinski, T. 6821 (17 nëntor 2006); P460 (Dokument i OSBE-së: Raport i misionit KVM-së për 1 mars 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3.

Më 1 prill 1999, një ekip i posaçëm i KVM-së u urdhërua të ndihmonte UNHCR-në në Shqipëri. Më 3 prill 1999, një ekip tjetër i posaçëm i KVM-së prej 80 vetësh që përfundimisht u zgjerua në 110 vetë filloi të ndihmonte UNHCR-në në Maqedoni.⁹⁶¹

G. KONKLUZIONE

404. Dhoma ka mendimin se në vitin 1998 autoritetet e RFJ-së/Serbisë bënë përpjekje për të negociuar me shqiptarët kosovarë, por këto përpjekje nuk morën përgjigje për shkak të mungesës së angazhimit ndërkombëtar. Nga ana tjetër këto përpjekje duhen gjykuar në kontekstin e ngjarjeve në terren në Kosovë, sidomos operacionet e mëdha të forcave të MPB-së dhe RFJ-së. Rrjedhimisht, siç vuri në dukje Wolfgang Petritsch-it, nuk është e habitshme mungesa e dëshirës së shqiptarëve kosovarë për të kontaktuar drejtpërsëdrejti me autoritetet e RFJ-së/Serbisë.⁹⁶² Gjithsesi autoritetet e RFJ-së/Serbisë kishin përgjegjësi për ta kapërcyer këtë pengesë, për krijimin e besimit dhe për trajtimin e barabartë të shqiptarëve kosovarë si qytetarë të RFJ-së, dhe për zbutjen e pakënaqësisë së tyre në lidhje me ndryshimet kushtetuese të vitit 19898 nëpërmjet dialogut politik.

405. Provat e parashtruara më lart tregojnë se mosgatishmëria fillestare këmbëngulëse e autoriteteve të RFJ-së/Serbisë për praninë ndërkombëtare civile, ose ushtarake në territorin e vet, u zbut disi duke çuar në Marrëveshjet e tetorit dhe në fazat më të vonshme të bisedimeve të Rambujesë, ku pranuan nevojën e negociatave të mëtejshme për praninë ndërkombëtare në Kosovë, jo vetëm në aspektin civil. Dhoma është e bindur se pas Marrëveshjeve të tetorit ekzistonte mundësia e një zgjidhjeje të negociuar. Në këtë pikë forcat e RFJ-së/Serbisë ndërprejnë veprimtarinë e tyre dhe u tërhoqën. UÇK-ja i kishte pakësuar veprimet e veta dhe filloi kthimi i civilëve të shpërngulur. Fatkeqësisht këto marrëveshje nuk imponuan detyrime ndaj UÇK-së, duke qenë se nuk ishte palë në marrëveshje dhe rrjedhimisht nuk kishte marrë përsipër zotime. Përgjithësisht gjendja në Kosovë mbeti e nderë dhe e brishtë.

406. Në lidhje me Rambujenë dhe Parisin, në dosjen e vetë përfundimtare Prokuroria argumenton se shkak i dështimit të bisedimeve ishte delegacioni i RFJ-së/Serbisë. Sipas Prokurorisë e vetmja arsye për qëndrimin destabilizues të delegacionit serb ishte se ata synonin të nxirrnin procesin negociues nga binarët dhe shkatërronin gjasën e një zgjidhjeje paqësore të krizës së Kosovës.⁹⁶³ Nga ana e saj, Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se provat tregojnë se

⁹⁶⁰ P634 (Kronologji e ngjarjeve më të rëndësishme në Kosovë gjatë periudhës 15 tetor 1998 – 18 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7.

⁹⁶¹ P634 (Kronologji e ngjarjeve më të rëndësishme në Kosovë gjatë periudhës 15 tetor 1998 – 18 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 7–8; P764 (Plani Monitorues i KVM-së për Refugjatët).

⁹⁶² Wolfgang Petritsch, T. 10956–10957 (2 mars 2007).

⁹⁶³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 260.

pretendimet për Rambujenë dhe Parisin janë të pabaza dhe të pasakta, dhe se përkundrazi faktet tregojnë se delegacioni shtetëror erdhi në Francë për vazhdimin e procesit të një marrëveshjeje për vetëqeverisjen e Kosovës.⁹⁶⁴

407. Dhoma ka mendimin se delegacioni i RFJ-së/Serbisë shkoi në Rambuje me të vërtetë për gjetjen e zgjidhjes. Kjo u konfirmua prej Wolfgang Petritsch-it i cili dëshmoi se delegacioni erdhi në Rambuje i përgatitur dhe i gatshëm për punë. Mirëpo negociatat u ndeshën me probleme që përfundimisht shkaktuan dështimin e tyre. Për shembull, megjithëse nuk ka dyshim se delegacioni shqiptar kosovar ishte po aq i interesuar për rezultatin e bisedimeve, përbërja e tij e fragmentarizuar tregonte se pikëpamjet e anëtarëve nuk ishin të njëtrajtshme dhe ata ishin të pavendosur dhe të prirur për ndryshim mendimesh. Këmbëngulja e treshes për një qasje fragmentare në shpërndarjen e projekt-anekseve të marrëveshjes nuk e forcoi besimin në këtë proces. Pjesëmarrja e Sekretares amerikane të Shtetit Madeleine Albright, në mes të zhvillimit të konferencës, megjithëse shërbeu si shtysë në procesin e negociatave, gjithashtu shkaktoi pështjellim dhe paqartësi në qëndrimin e negociatorëve ndërkombëtarë. Si rezultat të tëra këto probleme sollën vetëm marrëveshje për ndërprerjen e bisedimeve dhe rifillimin e tyre në mars në Paris. Kishte vend për optimizëm për shkak se delegacioni i RFJ-së/Serbisë, i vetëdijshëm për seriozitetin e kërcënimit të NATO-s për sulm, kishte bërë të ditur angazhimin e vet në lidhje me pjesën politike të marrëveshjes.

408. Me mbërritjen në Paris delegacioni i RFJ-së/Serbisë ishte dyshues ndaj treshes dhe procesit të negociatave në tërësi, siç del prej letrave të 5 marsit ku ankohej për “fushatë” në emër të bashkësisë ndërkombëtare për nënshkrimin e projekt-tekstit të 23 shkurtit prej shqiptarëve kosovarë, madje para vazhdimin të negociatave më 15 mars. Faktikisht delegacioni u kthye me dëshirën për përcaktimin e qëndrimit përfundimtar të cilin e kishte miratuar në Rambuje. Pavarësisht qëndrimeve individuale të anëtarëve të ekipit negociues, Millosheviqi bëri të qartë se ai nuk kishte aspak interes në një përfundim të suksesshëm që do të ndryshonte pushtetin serb në Kosovë. Gjithashtu pas mbërritjes u tha se marrëveshjes politike nuk mund t’i bëhej asnjë ndryshim thelbësor dhe çfarëdo çështje e mbetur teknike do të diskutohej vetëm pas arritjes së marrëveshjes për zbatimin.

409. Në të vërtetë negociatat nuk rifilluan. Shqiptarët kosovarë në atë moment kishin siguruar çfarë mund të siguronin prej negociatorëve dhe ishin pajtuar me këtë. Negociatorët ndërkombëtarë të përballur me kokëfortësinë e autoriteteve të RFJ-së/Serbisë në lidhje me praninë ndërkombëtare, në fund hoqën dorë prej negociatave dhe paqes dhe u mbështetën në fushatën ajrore të NATO-s.

⁹⁶⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 183.

410. Megjithëse duke marrë parasysh qëndrimin përfundimtar të Millosheviqit, është tunduese të fajsohet ai për dështimin e përpjekjeve diplomatike në kërkim të zgjidhjes së problemit të Kosovës, shkaku i vërtetë i dështimit është shumë më i ndërlikuar. Megjithëse delegacioni i RFJ-së/Serbisë nuk ishte në dijeni të lëshimeve që po diskutoheshin me shqiptarët kosovarë, këto lëshime në fakt kishin të bënin me çështjen që ishte shkaku i ngecjes së diskutimit për të dy palët, konkretisht shkalla e ruajtjes së sovranitetit dhe tërësisë territoriale të RFJ-së dhe Serbisë dhe në fakt garantimi i tyre për të ardhmen. Pikat kyçe ishin mënyra e përcaktimit të statusit përfundimtar të Kosovës dhe karakteri i pranisë ndërkombëtare në territorin e saj. Shqyrtimi i mësipërm i ngjarjeve tregon se negociatorët ndërkombëtarë nuk adoptuan një qëndrim tërësisht të paanshëm në lidhje me qëndrimet përkatëse të palëve dhe u prirën të favorizonin shqiptarët kosovarë.

411. Një dëshmi është domethënëse për gjendjen. Obrad Kesiqi dëshmoi se më 14 prill 1999 ai mori pjesë në një takim të iniciuar prej Shtëpisë së Bardhë me përfaqësuesit e bashkësisë serbe. Në takim Presidenti Clinton deklaroi se dispozita e lejimit të referendumit të shqiptarëve në Kosovë shkonte shumë larg dhe po të kishte qenë në vend të Millosheviqit, me gjasë as ai nuk do ta kishte nënshkruar projekt-marrëveshjen.⁹⁶⁵ Megjithëse fillimisht Presidenti Clinton e përmendi ndërhyrjen e NATO-s në kuadrin e përgjigjes ndaj krizës humanitare, ai gjithashtu tha se shkaku i bombardimit nuk kishte më rëndësi dhe se shqetësimet kyçe që mundësuan vazhdimin e pakufizuar të bombardimit ishin se këtu ishte në lojë besueshmëria e SHBA-së, NATO-s dhe besueshmëria e tij si President i Shteteve të Bashkuara.⁹⁶⁶

412. Rrjedhimisht, Dhoma ka mendimin se përpjekjet diplomatike për zgjidhjen e problemit të Kosovës dështuan për një sërë arsyesh që kishin të bënin me kokëfortësinë e të dy palëve dhe mënyrën e organizimit të negociatave. Siç është pohuar më herët, qëndrimet e të dy palëve ishin tërë kohën kaq larg njëri-tjetrit saqë është tejet e vështirë të përfytyrohet marrëveshje. Në analizën e provave Dhoma është përpjekur të tregojë sesi secila prej tri palëve ndikoi në dështimin e procesit të Rambujesë/Parisit dhe negociatave paraprirëse gjatë viteve 1998 dhe 1999.

⁹⁶⁵ Obrad Kesiq, T. 14489 (27 gusht 2007).

⁹⁶⁶ Obrad Kesiq, T. 14489 (27 gusht 2007).

VI. KONFLIKTI I ARMATOSUR

A. FORCAT E RFJ-SË DHE SERBISË

1. Ushtria Jugosllave 1998–1999

a. Kuadri kushtetues dhe ligjor i UJ-së

413. Struktura dhe funksionimi i Ushtrisë së Republikës Federale të Jugosllavisë (*Vojska Jugoslavije* “VJ”) gjatë viteve 1998 dhe 1999 ndër të tjera trajtohej prej: (a) Kushtetutës së RFJ-së miratuar më 27 prill 1992;⁹⁶⁷ (b) Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen miratuar në 1994;⁹⁶⁸ (c) Ligjit për UJ-në miratuar në 1994, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 134 të Kushtetutës së RFJ-së, ku përcaktohej se “... [a] miratohet ligji federal për Ushtrinë e Jugosllavisë”; dhe (d) Rregullorja e Shërbimit të UJ-së.⁹⁶⁹ Prej këtyre, Ligji për UJ-në ishte i destinuar të shërbente si korpusi kryesor i rregullave të organizimit dhe funksionimit të UJ-së.⁹⁷⁰

414. Neni 133 i Kushtetutës së RFJ-së përcaktonte se “Ushtria e RFJ-së mbron sovranitetin, territorin, pavarësinë dhe rendin kushtetues të vendit”.⁹⁷¹ Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen e karakterizonte UJ-në “forca kryesore e armatosur dhe organizatore e luftës së armatosur dhe të tëra formave të tjera të qëndresës së armatosur kundër armikut” në mbrojtje të vendit dhe pohonte se “ushtria bashkon të gjithë pjesëmarrësit në luftë të armatosur dhe komandon të gjitha veprimet luftarake”.⁹⁷²

415. Neni 8 i Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen përcaktonte se në rast të rrezikut të një lufte të afërt, gjendjeje lufte, ose gjendjes së jashtëzakonshme, Presidenti i RFJ-së, “në përputhje me vendimet e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes”, urdhëron masa për gatishmërinë, mobilizimin dhe përdorimin e UJ-së, për parandalimin dhe eliminimin e kërcënimit ndaj mbrojtjes dhe sigurisë së vendit.⁹⁷³ Detyrat e sigurisë dhe mbrojtjes për mbrojtjen e RFJ-së i takonin UJ-së, kurse detyrat e posaçme do të kryheshin prej “Ministrisë së Brendshme Federale”.⁹⁷⁴

⁹⁶⁷ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992).

⁹⁶⁸ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 1.

⁹⁶⁹ P1085 (Rregullorja e Shërbimit të Ushtrisë Jugosllave, 27 dhjetor 1993) (“Rregullorja e Shërbimit të UJ-së”), f. 1, 4; 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të Ushtrisë Jugosllave, 1996) (“Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996”).

⁹⁷⁰ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 1; 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 134.

⁹⁷¹ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 133; *shih edhe* 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), rregulla 1.

⁹⁷² P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 16.

⁹⁷³ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 8.

⁹⁷⁴ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 11.

416. Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen gjithashtu përcaktonte të drejtat dhe detyrat e qeverisë federale⁹⁷⁵ dhe Ministrisë Federale të Mbrojtjes.⁹⁷⁶ E dyta kryente detyra administrative dhe të specializuara në lidhje me zbatimin e politikës së mbrojtjes së vendit dhe zbatimin e sistemit të mbrojtjes.⁹⁷⁷

b. Struktura e UJ-së

417. UJ-ja ndahej në tri shërbime: Forcat Tokësore, Forca Ajrore dhe Mbrojtja Kundërajrore, dhe Marina Luftarake.⁹⁷⁸ Nga ana e tyre këto shërbime ndaheshin në armë luftarake dhe armët e prapavijës të cilat vetë ndaheshin në njësi dhe shërbime të specializuara.⁹⁷⁹ “Organi më i lartë profesional dhe hierarkik” për përgatitjen dhe përdorimin e UJ-së ishte Shtabi i Përgjithshëm i cili përbëhej prej shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe ndihmësve të tij, si dhe personelit mbështetës.⁹⁸⁰

418. Forcat Tokësore ishin elementi më i madh dhe më i rëndësishëm i UJ-së dhe ishin organizuar në Armata.⁹⁸¹ Në vitet 1998–1999 ishin tri Armata: Armata e Parë (me selinë e shtabit në Beograd, Serbi), Armata e Dytë (selia e shtabit në Podgoricë, Mal i Zi), dhe Armata e Tretë (selia e shtabit në Nish, Serbi).⁹⁸²

419. Njësitë Operative ishin në majën e hierarkisë së njësive në UJ, më poshtë vinin Njësitë e Përbashkëta Taktike, dhe Njësitë Taktike Bazë.⁹⁸³ Njësia Operative përbëhej prej korpuseve si p.sh. Korpusi i Prishtinës, i cili bashkonte forcat në një zonë luftimesh dhe ishte në komandë të operacioneve të armatosura luftarake.⁹⁸⁴ Secili korpus kishte Njësi të Përbashkëta Taktike të ndryshme dhe/ose Njësi Taktike Bazë vartëse, varësisht prej objektivave të bashkërenduara operative.⁹⁸⁵

⁹⁷⁵ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 42.

⁹⁷⁶ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), nenet 43–47.

⁹⁷⁷ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 43.

⁹⁷⁸ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 2; *shih edhe*, 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 80–81.

⁹⁷⁹ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 2.

⁹⁸⁰ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 5; P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), f. 97; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 88–89; P1739 (Listë e Anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së).

⁹⁸¹ P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), f. 99.

⁹⁸² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 10; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 80–81.

⁹⁸³ Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 16; *shih edhe* 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 81.

⁹⁸⁴ P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), f. 99; Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 16.

⁹⁸⁵ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 42–46; *shih edhe* Dragan Zhivanoviç, T. 20532–20534 (18 janar 2008); P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll I), f. 99–100; Vladimir Llazareviç, T. 17829–17830 (7 nëntor 2007), T. 18743–18744 (21 nëntor 2007).

420. Njësitë Taktike Bazë ishin formacione të përhershme të UJ-së të cilat formonin bërthamën e Njërive Operative dhe Njërive të Përbashkëta Taktike. Në shkallë zbritëse këto njësi ishin batalionet, kompanitë dhe togat.⁹⁸⁶ Togat përbëheshin prej skuadrave që zakonisht përbëheshin prej tri vetësh.⁹⁸⁷

421. Në bazë të Ligjit për UJ-në, UJ-ja përbëhej nga ushtarakë profesionistë, ushtarakë të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, studentë të akademive ushtarake dhe shkollave të mesme ushtarake, studentë të shkollave për oficerë rezervistë, dhe individë të forcave rezerviste gjatë kryerjes së detyrës së tyre ushtarake në ushtri.⁹⁸⁸ Forcat rezerviste kryesisht përbëheshin prej meshkujve të moshave 18 – 60 vjeç të cilët kishin kryer shërbimin ushtarak.⁹⁸⁹ Gjatë gjendjes së luftës, UJ-ja mund të përforcohej me vullnetarë.⁹⁹⁰

422. Të tërë qytetarët e RFJ-së kishin detyrimin e kryerjes së shërbimit ushtarak në kohë lufte dhe paqeje.⁹⁹¹ Shërbimi i detyrueshëm ushtarak organizohej prej Organeve Ushtarake Territoriale dhe përbëhej nga tri faza: (a) rekrutimi, (b) shërbimi i detyrueshëm ushtarak, dhe (c) detyrat në forcat rezerviste.⁹⁹² Çdokush që mobilizohej në ushtri quhej rekrut ushtarak, para, gjatë dhe pas kryerjes së shërbimit të detyrueshëm.⁹⁹³ Pas kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak, rekrutët liroheshin nga UJ-ja dhe përfshiheshin automatikisht në forcat rezerviste.⁹⁹⁴

423. Gjithsesi Dhoma ka dëgjuar se në vitet 1998-199 shqiptarët kosovarë dhe pakicat e tjera ishin të nënpërfaqësuar në UJ.⁹⁹⁵ Bazuar në dokumentacionin e mbajtur në UJ, shkruhej se shumë shqiptarë etnikë nuk ishin paraqitur dhe kishin refuzuar shërbimin ushtarak;⁹⁹⁶ Tomisllav Mitiqi konfirmoi se në Degën Ushtarake të Prizrenit afërsisht 26.000 shqiptarë kosovarë nuk iu përgjigjën thirrjes për mobilizim.⁹⁹⁷ Sipas Sllobodan Kosovacit i cili prej 1 prillit 1999 ishte shef i Administratës për Rekrutimin, Mobilizimin dhe Sistemimin në Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë të UJ-së, një prej arsyeve të mosparaqitjes ishte se shqiptarët kosovarë që i

⁹⁸⁶ P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), f. 99–100; *shih edhe* Vllatko Vuković, 5D1401 (deklaratë dëshmitari me datë 5 janar 2008), para. 3.

⁹⁸⁷ Sllobodan Kosovac, T. 15836–15837 (18 shtator 2007).

⁹⁸⁸ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 9; *shih edhe* 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), rregulla 2.

⁹⁸⁹ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), nenet 315–316.

⁹⁹⁰ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 15; P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen i vitit 1995), neni 18.

⁹⁹¹ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 279.

⁹⁹² P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 282.

⁹⁹³ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 284; Radovan Radinović, T. 17346–17347 (19 tetor 2007); Zharko Kostiq, T. 17524–17525 (23 tetor 2007).

⁹⁹⁴ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 314; *shih edhe* Radovan Radinović, T. 17347 (19 tetor 2007).

⁹⁹⁵ Millivoje Novković, T. 16261–16262 (24 shtator 2007); Sllobodan Kosovac, T. 15792 (17 shtator 2007).

⁹⁹⁶ Sllobodan Kosovac, T. 15795–15796 (17 shtator 2007); Kërsman Jelliq, T. 19072–19073 (26 nëntor 2007); *shih edhe* 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinovićit), f. 37.

⁹⁹⁷ Tomisllav Mitiqi, 5D1390 (deklaratë dëshmitari me datë 27 dhjetor 2007), para. 5.

bindeshin thirrjes për shërbim të detyrueshëm ushtarak. shpesh kërcënoheshin prej njerëzve të tyre.⁹⁹⁸

424. Forcat rezerviste përbëheshin prej rekrutëve ushtarakë, të cilët e kishin kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak ose e kishin përbushur detyrimin në ndonjë mënyrë tjetër dhe prej rekruteve femra.⁹⁹⁹ Zllatomir Peshiqi i cili ishte komandant i Qarkut Ushtarak të Prishtinës më 1999 shpjegoi se pas kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak prej një rekruti, emri i tij përfshihej në listën e forcave rezerviste dhe ai caktohej prej Qarkut Ushtarak, ose në një njësi të MPB-së, ose të UJ-së.¹⁰⁰⁰ Rekrutët mund të caktoheshin në një njësi të rregullt të UJ-së ose në një Detachment Ushtarak Territorial (që mund të aktivizohej gjatë kohës së luftës).¹⁰⁰¹

425. Gjatë gjendjes së luftës, rrezikut të luftës së afërt, ose gjendjes së jashtëzakonshme, UJ-ja autorizohet të përforcohet me vullnetarë të cilët ishin “individë të cilët nuk i nënshtrohen shërbimit të detyrueshëm ushtarak dhe rekrutë ushtarakë që nuk kanë funksione në kohë lufte”.¹⁰⁰² Rrjedhimisht në lidhje me të drejtat dhe detyrat, vullnetarët konsideroheshin të barabartë me efektivin e UJ-së.¹⁰⁰³

c. Uniformat e UJ-së

426. Efektivat ushtarakë ishin të detyruar të mbanin uniformë në kryerjen e detyrave zyrtare.¹⁰⁰⁴ Sipas Rregullores së Shërbimit të UJ-së uniforma e përcaktuar ushtarake përshkruhej në “Rregullat për Uniformën Ushtarake”, mirëpo ky dokument nuk është në provat e kësaj çështjeje.¹⁰⁰⁵

i. Uniformat e rregullta të UJ-së

427. Sipas K73-shit dhe K82-shit, modeli kamuflim i uniformës standarde përdorur prej UJ-së ishte përzierje e ngjyrave kafe, të zezë dhe tri nuanca të gjelbra.¹⁰⁰⁶ Përdorimi i vijave të shumta të gjelbra e bënte uniformën të dukej kryesisht e gjelbër. U krijuan dy modele të ngjashme të

⁹⁹⁸ Sllobodan Kosovac, T. 15795–15796 (17 shtator 2007).

⁹⁹⁹ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 315.

¹⁰⁰⁰ Zllatomir Peshiq, T. 7151, 7168 (22 nëntor 2006).

¹⁰⁰¹ Zllatomir Peshiq, T. 7151 (22 nëntor 2006).

¹⁰⁰² P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 15.

¹⁰⁰³ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 15; 3D481 (Urdhër i Komandës së Lartë, 14 prill 1999), f. 2; *shih edhe* Sllobodan Kosovac, T. 15859 (18 shtator 2007); Gjorgje Çurçin, 3D1121 (deklaratë dëshmitari me datë 24 gusht 2007), para. 30.

¹⁰⁰⁴ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 32; 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), para. 24.

¹⁰⁰⁵ *Shih* 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), para. 24.

¹⁰⁰⁶ K73, T. 3310–3311 (13 shtator 2006); K82, P2863 (deklaratë dëshmitari me datë 14 shtator 2006), para. 2; *shih edhe* P1599 (Fotografi që tregon veprimtari të organizatave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë) (si K73 po ashtu edhe K82 i cilësojnë se duken si uniforma të rregullta të UJ-së); K90, T. 9297 (29 janar 2007) (identifikon në provën materiale IC42 djathtas poshtë, modelin kamuflazh si modelin e uniformave të rregullta të UJ-së).

uniformës së kamuflimit, të etiketuara M-89 dhe M-93, dhe duke iu referuar vitit të miratimit të modelit, përkatësisht në 1989 dhe 1993.¹⁰⁰⁷ Në supin e djathtë të uniformës anëtarët e UJ-së mbanin një emblemë me një shqiponjë dykrerëshe sipër flamurit të RFJ-së.¹⁰⁰⁸ Mbrojtja e Llazareviqit argumentoi se anëtarët e Korpusit të Prishtinës faktikisht vishnin uniforma në ngjyrë ulliri, duke argumentuar se ky fakt “konfirmohet prej shumë provave në këtë çështje”.¹⁰⁰⁹ Dhoma thekson se uniformat e rezervistëve të UJ-së ishin në ngjyrë ulliri të gjelbër siç përshkruhet më poshtë, mirëpo pranon dëshmitë se anëtarët e UJ-së mbanin edhe uniformë kamuflimi, përzierje e ngjyrave kafe, të zezë dhe tri nuancave të gjelbra siç u përshkrua më lart.

428. Ushtarakët ishin të detyruar të paraqiteshin gjithmonë “të rruar” dhe të qethur në mënyrë të parashkruar.¹⁰¹⁰ Ky fakt u konfirmua prej K73-it që dëshmoi se ushtarët e UJ-së nuk lejoheshin të mbanin mjekër dhe në qoftë se dikush kishte mjekër, ky mund të ishte tregues se individi në fjalë ishte rezervist.¹⁰¹¹

429. Megjithëse ekzistonin rregulla për veshjen e përshtatshme të personelit të UJ-së, Dhoma ka dëgjuar disa dëshmi se gjatë fushatës ajrore të NATO-s, këto rregulla nuk u zbatuan përpikmërisht.¹⁰¹²

ii. Rezervistët e UJ-së

430. Zllatomir Peshiqi dëshmoi se rezervistët u pajisën me uniforma të ndryshme për shkak të numrit të pakët të uniformave në vitin 1999. Dy prej këtyre llojeve të uniformave ishin uniforma kamuflimi dhe përkitnin me uniformat e lartpërshkruara M-89 dhe M-93 të UJ-së. Modeli i tretë ishte uniforma M-77 e njohur gjerësisht si SMB, shkurtesë e “*sido maslinasta boja*” ose “ngjyrë e

¹⁰⁰⁷ Zllatomir Peshiq, T. 7280, 7293 (24 nëntor 2007).

¹⁰⁰⁸ K73, T. 3298, 3310–3311 (13 shtator 2006); K82, P2863 (deklaratë dëshmitari me datë 14 shtator 2006), para. 2; K90, T. 9285–9286 (29 janar 2007); P1323 (Provë materiale që përmban lloje të ndryshme emblemash të përdorura nga njësitë e UJ-së dhe MPB-së), emblema 3; *shih edhe* P1592 (Fotografi që tregon veprimtari të organizatave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë); P1599 (Fotografi që tregon veprimtari të organizatave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë); P1605 (Fotografi që tregon veprimtari të organizatave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë); P2586 (Fotografi që tregon operacione të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 5.

¹⁰⁰⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 398.

¹⁰¹⁰ 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), para. 25.

¹⁰¹¹ K73, T. 3310–3311 (13 shtator 2006).

¹⁰¹² 3D692 (Raport mbi inspektimin e Korpusit të Prishtinës, 29 maj 1999), f. 3; 5D563 (Raport Luftimi i Brigadës 175 të Këmbërorisë për Korpusin e Prishtinës, 19 maj 1999), f. 1; K89, T. 9129 (24 janar 2007); Radojko Stefanoviq, T. 21705 (5 shkurt 2008).

gjelbër ulliri”, meqë ishte nuancë shquese e gjelbër ulliri.¹⁰¹³ Rezervistët nuk mbanin emblema në uniformat e tyre, por kishin emblemën e UJ-së në bereta.¹⁰¹⁴

iii. Policia ushtarake e UJ-së

431. Efektivat e Policisë Ushtarake të UJ-së mbanin uniforma të rregullta të UJ-së me shirita të bardha dhe emblemën e policisë ushtarake të UJ-së.¹⁰¹⁵ Njësitë e stërvitura posaçërisht për operacione kundërterroriste kishin më shumë pajisje. K73 dëshmoi se anëtarët e një njësie të tillë ishin më të pajisur dhe më të armatosur se pjesa tjetër e batalionit. Rrjedhimisht efektivat e njësisë vishnin mbi uniformat e tyre të zakonshme të kamuflimit edhe jelekë luftarakë të gjelbër ose të hirtë.¹⁰¹⁶ Uniformat e tyre mbanin emblemën e zakonshme të UJ-së.¹⁰¹⁷ Varësisht prej operacionit ku luftonin, ata mbanin edhe maska të zeza, kamuflimi ose të bardha si dhe bereta të zeza ose helmata të llojit amerikan “Panama”.¹⁰¹⁸

iv. Shiritat

432. Ka prova se në disa raste uniformat e UJ-së u përdorën nga civilë dhe anëtarë të UÇK-së për kryerjen e veprimeve të paligjshme.¹⁰¹⁹ Për minimizimin e përdorimit të paligjshëm të uniformave të UJ-së, në disa raste u përdorën shirita si identifikues shtesë të uniformës. Ndër provat ekzistojnë dy urdhra në lidhje me këtë praktikë. Në korrik 1998 njësitë e MPB-së dhe UJ-së në Kosovë u udhëzuan që të përdornin shirita të bardhë, të verdhë dhe të kuq ose kombinime të këtyre ngjyrave,¹⁰²⁰ në përgjigje të një incidenti kur uniformat e policisë u përdorën paligjshëmrisht prej UÇK-së për kapjen e një polici.¹⁰²¹ Në mes të prillit 1999 të gjithë anëtarët e Brigadës së Motorizuar 37 u urdhëruan “të shënoheshin” si duhej me shirita të kuq.¹⁰²² Mbrojtjet e Pavkoviçit

¹⁰¹³ Zllatomir Peshiq, T. 7156–7157 (22 nëntor 2006), 7248 (23 nëntor 2006), 7280, 7293 (24 nëntor 2006); *shih edhe* Abdylhaqim Shairi, T. 2808–2809 (5 shtator 2006); Avdullah Salih, P2255 (deklaratë dëshmitari me datë 12 mars 2002), f. 7.

¹⁰¹⁴ Zllatomir Peshiq, T. 7324–7325 (24 nëntor 2006).

¹⁰¹⁵ K73, T. 3297 (13 shtator 2006); K90, T. 9285–9286 (29 janar 2007); *shih edhe* P1323 (Provë materiale që përmban lloje të ndryshme emblemash të përdorura nga njësitë e UJ-së dhe MPB-së), emblema 3; *shih edhe* P1592 (Fotografi që tregon veprimtari të organizatave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë), emblema 4.

¹⁰¹⁶ K73, T. 3295–3298 (13 shtator 2006); *shih edhe* P1592 (Fotografi që tregon veprimtari të organizatave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë).

¹⁰¹⁷ *Shih* P1323 (Provë materiale që përmban lloje të ndryshme emblemash të përdorura nga njësitë e UJ-së dhe MPB-së), emblema 3; *shih edhe* P1592 (Fotografi që tregon veprimtari të organizatave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë), emblema 2.

¹⁰¹⁸ K73, T. 3297–3298, 3301–3303 (13 shtator 2006), T. 3424 (14 shtator 2006); *shih edhe* P1592 (Fotografi që tregon veprimtari të organizatave të armatosura të RFJ-së dhe Serbisë) (duken ushtarë me helmata të cilat dëshmitari i përshkroi si kopje jugosllave të të ashtuquajturës helmata të amerikanëve).

¹⁰¹⁹ Dushan Gavranic, T. 22730–22731 (19 shkurt 2008); 5D549 (Raport i Brigadës 175 të Këmbëorisë së Lehtë, 27 prill 1999); 4D248 (Mesazh i Komandës së Armatës së Tretë, 12 prill 1999).

¹⁰²⁰ 6D667 (Plan për pajisjen me shenja identifikuese të njësisë të MPB-së dhe UJ-së, 25–31 korrik 1998).

¹⁰²¹ Radojica Nikçević, T. 23237–23238 (26 shkurt 2008); Dragan Paunović, T. 21856–21857 (8 shkurt 2008).

¹⁰²² 6D1473 (Urdhër i Brigadës së Motorizuar 37 për masa të veçanta sigurie, 15 prill 1999), f. 2.

dhe Llazareviqit pretenduan se anëtarët e UJ-së nuk mbajtën asnjëherë shirita në uniforma,¹⁰²³ duke iu referuar një dokumenti të MPB-së të prillit 1999 që përmendte këtë gjë.¹⁰²⁴ Mirëpo pavarësisht këtij dokumenti, Petar Damjanac konfirmoi se kishte parë UJ-në në terren me shirita të tillë.¹⁰²⁵ Fakti se së paku disa anëtarë të UJ-së mbajtën shirita në disa raste gjatë periudhës së Aktakuzës, u konfirmua edhe nga tregimet e dëshmitarëve të tjerë okularë.¹⁰²⁶

d. Komanda dhe kontrolli

i. Kontrolli politik: Presidenti i RFJ-së dhe Këshilli i Lartë i Mbrojtjes

433. Në bazë të nenit 135 të Kushtetutës së RFJ-së, UJ-ja komandohej nga Presidenti i RFJ-së në përputhje me vendimet e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes (KLM), përbërja e të cilit diskutohet më poshtë.¹⁰²⁷ Presidenti i RFJ-së shpesh përmendej si “Kryekomandant”.¹⁰²⁸

434. Neni 40 i Ligjit Federal për Mbrojtjen përcaktonte të drejtat dhe detyrat e Presidentit të RFJ-së në lëmin e mbrojtjes. Ai ose ajo, “në përputhje me vendimet e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes”, urdhëronte zbatimin e planit të mbrojtjes; komandonte UJ-në në kohë lufte dhe paqeje; dhe vendoste për ndarjen e vendit në zona ushtarake.¹⁰²⁹ Mbi bazën e Ligjit për UJ-në, detyra për komandimin e UJ-së “në përputhje me vendimet e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes” ndër të tjera përfshinte vendimin për dislokimin e UJ-së dhe miratimin e planit për përdorimin e saj, nxjerrjen e rregullave dhe urdhërimin për gatishmërinë e UJ-së në rast të rrezikut të luftës së afërt, gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, nxjerrjen e urdhrave për mobilizimin e ushtrisë dhe nxjerrjen e rregulloreve bazë dhe akteve të tjera në lidhje me dislokimin e UJ-së.¹⁰³⁰

435. Nga ana tjetër KLM-ja kishte përgjegjësinë e miratimit të planit për mbrojtjen e vendit, nxjerrjen e vendimeve në bazë të të cilave Presidenti i RFJ-së komandonte UJ-në, e vlerësimit të rrezikut të luftës dhe rreziqeve të tjera ndaj mbrojtjes dhe sigurisë së vendit, përcaktonte pajisjet dhe armatimin e nevojshëm për mbrojtjen e vendit, vendoste për organizimin territorial të vendit për mbrojtje, vendoste për strategjinë e konfliktit të armatosur dhe rregullat e përdorimit të forcës në mbrojtje të RFJ-së, dhe kryerjen e luftës, miratonte elementët themelorë të programeve dhe

¹⁰²³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 375; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 398.

¹⁰²⁴ 6D237 (Tabelë me shiritat identifikues mbajtur prej njërive policore gjatë mesit të vitit 1999, 13 prill 1999), f. 1.

¹⁰²⁵ Petar Damjanac, T. 23778–23779, 23832 (6 mars 2008).

¹⁰²⁶ *Shih p.sh.*, K24, T. 4772–4773 (12 tetor 2006), T. 4791 (13 tetor 2006) (seancë private); K25, P2439 (deklaratë dëshmitari me datë 12 shtator 2001), f. 20; Dragan Paunoviç, T. 21859 (7 shkurt 2008).

¹⁰²⁷ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 135.

¹⁰²⁸ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 99; Millorad Obradoviç, T. 15042 (5 shtator 2007).

¹⁰²⁹ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 40(1)–(3).

¹⁰³⁰ P984 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 4(3)–(6).

planeve stërvitore për mbrojtjen e RFJ-së, kryente detyra të tjera përcaktuar prej ligjit federal.¹⁰³¹ Kryetari i KLM-së (njëkohësisht edhe President i RFJ-së) duhej të garantonte zbatimin e vendimeve të KLM-së.¹⁰³²

436. Në këtë çështje, Prokuroria dhe Mbrojtja e Millutinoviçit kanë patur veçanërisht mospajtime në lidhje me përbërjen, kompetencat dhe funksionimin e KLM-së pas 23 marsit 1999.

(A) Përbërja e KLM-së

437. Në bazë të dispozitave të nenit 135 të Kushtetutës së RFJ-së, KLM-ja kishte tre anëtarë, përkatësisht Presidentin federal si kryetar si dhe Presidentët e Republikave të Serbisë dhe Malit të Zi.¹⁰³³ Rregullorja e parë e Procedurës së KLM-së u miratua më 23 korrik 1992.¹⁰³⁴ Aty përcaktohej se KLM-ja merrte “vendime të formës së prerë” me “praninë e shumicës së anëtarëve të Këshillit”,¹⁰³⁵ dhe se mbledhjet mund të kërkoheshin prej kryetarit të KLM-së ose me nismën e anëtarëve të tjerë.¹⁰³⁶ Të gjithë anëtarët e KLM-së mund të propozonin rend dite për mbledhjet.¹⁰³⁷ Gjithashtu, KLM-ja mund të miratonte vendime dhe konkluzione pa u mbledhur, “mbi bazën e këshillimeve midis anëtarëve të Këshillit.”¹⁰³⁸

438. Më 23 mars 1999, në vigjilje të fushatës ajrore të NATO-s, u miratua Rregullorja e re e Procedurës së KLM-së e cila ndryshoi kuorumin e nevojshëm dhe zgjeroi rrethin e individëve që kishin të drejtë të kërkonin mbledhje të KLM-së. Rrjedhimisht veç kryetarit dhe anëtarëve të KLM-së, për mbajtjen e një mbledhjeje tani kërkoheshin edhe prania e shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe ministrit federal të Mbrojtjes ose përfaqësuesve të tyre; gjithsesi anëtarët shtesë nuk kishin të drejtë vote.¹⁰³⁹ Mbledhjet mund të organizoheshin edhe me propozim të anëtarëve shtesë,¹⁰⁴⁰ të cilët mund të propozonin rend dite.¹⁰⁴¹ Të gjitha vendimet duheshin miratuar me konsensus ndër të

¹⁰³¹ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), nenet 41(1)–(8). Fakti që KLM-ja duhej të miratonte planin e mbrojtjes së vendit konfirmohet në P1011 (Ivan Markoviç, ed., *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts/Zbatimi i Rregullave të së Drejtës Ndërkombëtare për Konfliktet e Armatosura* (2001)), f. 72 (përshkruhen aspekte të këtij plani dhe deklarohet se plani u miratua në bazë të një vendimi të KLM-së).

¹⁰³² P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 41.

¹⁰³³ ID139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 135.

¹⁰³⁴ P2622 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 korrik 1992).

¹⁰³⁵ P2622 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 korrik 1992), NENI 7. Mirëpo Mbrojtja thekson se paragrafi vijues i atij nenin përmend miratimin si të “vendimeve” po ashtu edhe të “konkluzioneve”, po ashtu si neni 8.

¹⁰³⁶ P2622 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 korrik 1992), neni 4.

¹⁰³⁷ P2622 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 korrik 1992), neni 5.

¹⁰³⁸ P2622 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 korrik 1992), neni 7.

¹⁰³⁹ P1738 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 mars 1999), neni 3; Ratko Markoviç, T. 13352–13354 (10 gusht 2007).

¹⁰⁴⁰ P1738 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 mars 1999), neni 3.

¹⁰⁴¹ P1738 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 mars 1999), neni 5.

cilat edhe vendimet për emërimet, gradimet dhe daljen në pension të gjeneralëve dhe admiralëve të UJ-së bazuar në propozimin e shefit të Shtabit të Përgjithshëm.¹⁰⁴²

(B) Kompetencat e KLM-së

439. Një pikë qendrore e argumentit të Prokurorisë kundër Millutinoviçit është se KLM-ja ishte organ kolektiv i cili mund të merrte (dhe mori) vendime në lidhje me përdorimin ose dislokimin e UJ-së në Kosovë. Në mbështetje të këtij argumenti Prokuroria u mbështet në dispozita të ndryshme kushtetuese të përmendura më lart, procesverbalet e mbledhjeve të KLM-së, dhe dëshminë e gjeneralit Aleksandar Vasileviç, i cili më parë kishte qenë zëvendësues i Administratës së Sigurimit të UJ-së.¹⁰⁴³ Mbrojtja e Millutinoviçit nga ana tjetër argumentoi se UJ-ja komandohej vetëm prej Presidentit të RFJ-së, i quajtur jozyrtarisht “Kryekomandant”, dhe se KLM-ja ishte thjesht organ këshillimor i cili më së shumti merrej me mbrojtjen kombëtare dhe aspektet buxhetore të UJ-së.¹⁰⁴⁴ Në mbështetje të këtij qëndrimi, Mbrojtja e Millutinoviçit u mbështet edhe në dispozitat kushtetuese përkatëse dhe në procesverbalet e KLM-së. Dëshmitari i saj ekspert, Ratko Markoviç i diskutoi këto çështje gjatë dëshmisë së tij dhe informoi në lidhje me kompetencat e Presidentit të Republikës së Serbisë.¹⁰⁴⁵

440. Dhoma i ka analizuar me kujdes procesverbalet dhe shënimet stenografike të mbledhjeve të KLM-së për periudhën 28 tetor 1997– 23 mars 1999 si prova në këtë çështje, për të përcaktuar mënyrën e funksionimit të këtij organi dhe llojin e vendimeve të marra.¹⁰⁴⁶ Në tetë prej nëntë mbledhjeve të KLM-së morën pjesë Presidenti i RFJ-së, Slobodan Millosheviç, Presidenti i Malit të Zi (Momir Bullatoviç dhe më vonë Milo Gjukanoviç), dhe Presidenti i Serbisë (Dragan Tomiç dhe më tej Millutinoviç). Të tjerë pjesëmarrës të rregullt ishin shefi i Shtabit të Përgjithshëm, Kryeministri i RFJ-së dhe ministri federal i Mbrojtjes. Veç gjendjes ushtarake dhe politike në RFJ,

¹⁰⁴² P1738 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 mars 1999), neni 4. Neni 4 i Rregullores së re të Procedurës përcaktonte se “Këshilli i Lartë e zhvillon veprimtarinë nëpërmjet sesioneve dhe i merr të gjitha vendimet me konsensus”. Është e paqartë nëse këto vendime mund të merreshin pa zhvillimin e sesioneve, si në nenin 7 të rregullores së mëparshme.

¹⁰⁴³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 130–136.

¹⁰⁴⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 64–66.

¹⁰⁴⁵ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë).

¹⁰⁴⁶ 1D691 (Procesverbal i sesionit të 1-rë të KLM-së, 28 tetor 1997); 1D692 (Procesverbal i sesionit të 2-të të KLM-së, 10 nëntor 1997); P1573 (Procesverbal i sesionit të 3-të të KLM-së, 24 dhjetor 1997); 1D550 (Procesverbal i sesionit të 4-të të KLM-së, 8 janar 1998); P1574 (Procesverbal i sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998); P1575 (Procesverbal i sesionit të 6-të të KLM-së, 4 tetor 1998); P1576 (Procesverbal i sesionit të 7-të të KLM-së, 24 nëntor 1998); P1000 (Procesverbal i sesionit të 8-të të KLM-së, 25 dhjetor 1998); P1577 (Procesverbal i sesionit të 9-të të KLM-së, 23 mars 1999). Shënimet stenografike përkohë me shtatë prej këtyre nëntë sesioneve: 1D756 (Shënime stenografike të sesionit të 1-rë të KLM-së, 28 tetor 1997); 1D757 (Shënime stenografike të sesionit të 2-të të KLM-së, 10 nëntor 1997); 1D758 (Shënime stenografike të sesionit të 3-të të KLM-së, 24 dhjetor 1997); 1D759 (Shënime stenografike të sesionit të 4-të të KLM-së, 8 janar 1998); 1D760 (Shënime stenografike të sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998); P2831 (Shënime stenografike të sesionit të 6-të të KLM-së, 4 tetor 1998); 1D761 (Shënime stenografike të sesionit të 8-të të KLM-së, 25 dhjetor 1998).

ndër pikat kryesore të diskutuara në këto mbledhje ishin buxheti ushtarak po ashtu si dhe ndryshime të zyrtarëve të lartë të UJ-së. Hollësitë e këtyre mbledhjeve diskutohen në Pjesën VIII për përgjegjësinë individuale penale të Millutinoviqit, Ojdaniqit dhe Pavkoviqit.

441. Sipas Aleksandar Vasileviqit, komanda e përgjithshme e UJ-së i ishte besuar ligjërisht KLM-së në kohë paqeje dhe “Komandës së Lartë” në kohë lufte, të dyja të udhëhequra prej Presidentit të RFJ-së Millosheviq në periudhat përkatëse.¹⁰⁴⁷ Vasileviqi më tej qartësoi se në kohë paqeje, KLM-ja ishte organ kolektiv që nxirrte vendime për hyrjen në veprim të forcave të armatosura dhe duke vepruar në këtë mënyrë nëpërmjet Shtabit të Përgjithshëm, KLM-ja komandonte UJ-në në përputhje me “direktivat shtetërore”.¹⁰⁴⁸

442. Dëshmitarët e paraqitur prej Mbrojtjes gjithashtu ofruan një përshtetë të natyrës dhe kompetencave të KLM-së. Gjenerali Branko Gajiq, i cili ishte paraardhësi i Vasileviqit në Administratën e Sigurimit, dëshmoi se KLM-ja ishte organ politik, i cili merrte vendime në fushën e mbrojtjes. Pas marrjes së vendimeve, Presidenti i RFJ-së në cilësinë e Kryekomandantit i përcillte më poshtë në hierarkinë komanduese nëpërmjet urdhrave për shefin e Shtabit të Përgjithshëm.¹⁰⁴⁹

443. Eksperti ushtarak i sjellë prej Mbrojtjes së Ojdaniqit, Radovan Radinoviqi, pohoi në aktekspertizën e tij se KLM-ja ishte në krye të UJ-së në kohë lufte dhe paqeje. Me fjalë të tjera sipas Radinoviqit, KLM-ja ishte “Kryekomandanti” i UJ-së *gjithë kohën* dhe, edhe pse kjo fjalë nuk figuronte shprehimisht në ligjet përkatëse, ajo nënkuptohej prej nenit 135 të Kushtetutës së RFJ-së dhe nenit 41 të Ligjit për Mbrojtjen.¹⁰⁵⁰ Duke përmendur gjendjen e luftës në vitin 1999, Radinoviqi deklaroi se Presidenti i RFJ-së ishte në krye të hierarkisë komanduese të UJ-së, por gjithsesi në varësi të vendimeve të KLM-së.¹⁰⁵¹ Mirëpo ai e kushtëzoi këtë lidhje duke thënë se ishte ekzistuese për sa kohë që KLM-ja funksiononte me anëtarësi të plotë, me fjalë të tjera, “deri kur Presidenti i Republikës së Malit të Zi të tërhiqej me dëshirën e vet”.¹⁰⁵² Gjithsesi sipas Radinoviqit edhe pse Presidenti i Malit të Zi nuk ishte më i disponueshëm, për komandimin e besueshëm të UJ-së Presidenti i RFJ-së mund të përdorte vendimin e njëzëshëm të KLM-së marrë

¹⁰⁴⁷ Aleksandar Vasileviq, T. 8635 (18 janar 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 7.

¹⁰⁴⁸ Aleksandar Vasileviq, T. 8640 (18 janar 2007).

¹⁰⁴⁹ Branko Gajiq, T. 15296 (7 shtator 2007).

¹⁰⁵⁰ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 80–84.

¹⁰⁵¹ Në të vërtetë më vonë Radinoviqi konkludoi se kjo nënkuptonte në fakt se në majën e hierarkisë komanduese ishte KLM-ja, më tej Presidenti i RFJ-së dhe vetëm i treti Shtabi i Përgjithshëm. 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 96–99; *shih edhe* Radovan Radinoviq, T. 17261 (18 tetor 2007).

¹⁰⁵² 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 94.

në mbledhjen e tetorit 1998, me praninë e të gjithë anëtarëve, se në rast se do të sulmohej, RFJ-ja do të vetëmbrohej me të gjitha mënyrat dhe mjetet.¹⁰⁵³

444. Gjenerali Miodrag Simiq i cili ishte ndihmës i ministrit federal të Mbrojtjes dhe më 2 prill 1999 mori detyrën e ndihmëshefit të Shtabit të Komandës së Lartë për Forcat Tokësore,¹⁰⁵⁴ deklaroi se KLM-ja merrej me mbrojtjen e vendit, që mbulonte të tëra aspektet përkatëse për mbrojtjen si ekonomia, qarkullimi, bujqësia dhe ushtria.¹⁰⁵⁵

445. Gjithsesi në mbështetje të qëndrimit të Mbrojtjes së Millutinoviçit se roli i KLM-së në komandimin e UJ-së ishte i kufizuar, Ratko Markoviç dëshmoi se komandanti më i lartë i UJ-së ishte Presidenti i RFJ-së dhe jo KLM-ja.¹⁰⁵⁶ Gjithashtu sipas Markoviçit, UJ-ja nuk mund të komandohej nga një organ kolegjal si KLM-ja, por vetëm prej një individi, konkretisht Presidenti i RFJ-së. Markoviç gjithashtu theksoi se Presidenti i Serbisë ishte thjesht njëri ndër anëtarët e KLM-së që përfaqësonte një votë të vetme dhe nuk mund të merrte individualisht vendime detyruese.¹⁰⁵⁷ Sipas Markoviçit, arsyeja e përfshirjes së dispozitës për KLM-në në Kushtetutën e RFJ-së ishte “federalizimi” i një funksioni të rëndësishëm në lidhje me UJ-në, dhe në këtë mënyrë të simbolizonte statusin e barabartë të dy republikave anëtare të RFJ-së. Kjo arsye vlente edhe për faktin se anëtarët e KLM-së nuk zgjidheshin por bëheshin anëtarë *ex officio*, për arsye të pozitës së tyre.¹⁰⁵⁸ Mbrojtja e Millutinoviçit në fakt thekson se KLM-ja ishte njësi federale, dhe se mbrojtja dhe siguria ishin tërësisht kompetencë e RFJ-së dhe jo e republikave përbërëse.¹⁰⁵⁹ Sipas Kushtetutës së RFJ-së, Presidenti i RFJ-së ishte një prej organeve federale përgjegjëse për hartimin e politikës së mbrojtjes dhe sigurisë.¹⁰⁶⁰

446. Markoviç argumentoi se KLM-ja nuk i kreu detyrat e veta përpikmërisht në përputhje me Kushtetutën e RFJ-së, sepse ky organ nuk miratonte “vendime”, por “konkluzione” të një natyre politike, dhe këto vetëm në dy raste, në qershor dhe tetor 1998.¹⁰⁶¹ Sipas mendimit të tij, fakti se

¹⁰⁵³ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 94–97; P1575 (Procesverbal i sesionit të 6-të të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 9.

¹⁰⁵⁴ Miodrag Simiq, T. 15470–15471 (12 shtator 2007).

¹⁰⁵⁵ Miodrag Simiq, T. 15600–15603 (13 shtator 2007).

¹⁰⁵⁶ 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë) para. 3.60.

¹⁰⁵⁷ Ratko Markoviç, T. 12936 (6 gusht 2007); 1D682 (Ekspertizë e Ratko Markoviçit mbi Kompetencat dhe Pozitën e Presidentit të Republikës së Serbisë) para. 3.59–3.60.

¹⁰⁵⁸ Ratko Markoviç, T. 13013–13015 (7 gusht 2007).

¹⁰⁵⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit,, 15 korrik 2008, para. 64.

¹⁰⁶⁰ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), nenet 77, 96–98.

¹⁰⁶¹ Ratko Markoviç, T. 13021–13022 (7 gusht 2007); P1574 (Procesverbal i sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998), P1575 (Procesverbal i sesionit të 6-të të KLM-së, 4 tetor 1998); *shih edhe* Ratko Markoviç, T. 13036–13037 (7 gusht 2007) (shpjegohet kuptimi i fjalës “konkluzion”).

nuk kishte akte për formën e këtyre “vendimeve” dhe se nuk u publikuan askund në asnjë rast, tregon se ishin konkluzione politike.¹⁰⁶²

447. Markoviqi konkludoi se pozita e Presidentit të RFJ-së si organ federal dhe kryetar i KLM-së, kishte më shumë peshë se Presidentët e republikave, veçanërisht për faktin se ai duhej të mbante parasysh interesat e të dy përbërësve federalë.¹⁰⁶³ Mirëpo kur u pyet prej Dhomës se kush do të kishte fituar në rast se dy anëtarët e tjerë do të votonin kundër Presidentit të RFJ-së, Markoviqi pranoi se bazuar në Rregulloren e Procedurës së KLM-së të vitit 1992,¹⁰⁶⁴ dy Presidentët e tjerë fitonin votimin.

448. Për ta konkretizuar pikëpamjen e tij, Markoviqi iu referua procesverbalit të mbledhjes së KLM-së mbajtur më 9 qershor 1998, ku një prej konkluzioneve të “miratuara” ishte që UJ-ja të ndërhynte, në rast të “përshkallëzimit të veprimtarisë terroriste të lëvizjes separatiste shqiptare”.¹⁰⁶⁵ Ai ritheksoi se ky konkluzion kushtëzues nuk mund të përbënte vendim mbi bazën e të cilit mund të komandohej UJ-ja dhe se nevojitej vendim i mëtejshëm prej ekspertëve.¹⁰⁶⁶ Në mbështetje të këtij argumenti Mbrojtja e Millutinoviçit i referohet urdhrin operativ për të luftuar terrorizmin në Kosovë, lëshuar prej Presidentit të RFJ-së më 21 korrik 1998,¹⁰⁶⁷ dhe deklaroi se ky provon se konkluzionet e KLM-së në vetvete nuk përbënin urdhra detyruese.¹⁰⁶⁸ Markoviqi kreu të njëjtën analizë në lidhje me mbledhjen e gjashtë të KLM-së, mbajtur më 4 tetor 1998, ku u konkludua se në rast sulmi, RFJ-ja do të mbrohej me të gjitha mjetet dhe mënyrat.¹⁰⁶⁹ Mirëpo kur u pyet për mënyrën e dislokimit të UJ-së në Kosovë, Markoviqi pranoi se duhet të ketë qenë ky konkluzion që çoi në dislokimin e UJ-së në Kosovë dhe përdorimin e saj pas 23 marsit 1999, kur nuk pati më mbledhje të KLM-së. Markoviqi në fund pranoi se “konkluzionet” u përdorën dhe u shfrytëzuan si “vendime”.¹⁰⁷⁰

449. Më tej Markoviqi përqasi “konkluzionet” e miratuara prej KLM-së me nenin 4 të Ligjit për UJ-në, ku deklarohet se Presidenti i RFJ-së komandon UJ-në në përputhje me vendimet e KLM-së,

¹⁰⁶² Ratko Markoviç, T. 13021–13023 (7 gusht 2007).

¹⁰⁶³ Ratko Markoviç, T. 13024–13025 (7 gusht 2007).

¹⁰⁶⁴ Ratko Markoviç, T. 13405–13416 (13 gusht 2007).

¹⁰⁶⁵ P1574 (Procesverbal i sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 4.

¹⁰⁶⁶ Ratko Markoviç, T. 13037–13038 (7 gusht 2007).

¹⁰⁶⁷ *Shih* 4D100 (Raport i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë në lidhje me pjesëmarrjen në luftime të njëjësive, 22 korrik 1998), p. 1; 4D101 (Plan i Korpusit të Prishtinës për pjesëmarrjen në luftime të njëjësive në Kosovë, 23 korrik 1998), f. 1.

¹⁰⁶⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 87.

¹⁰⁶⁹ Ratko Markoviç, T. 13029–13030, 13038–13039 (7 gusht 2007); P1575 (Procesverbal i sesionit të 6-të të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 9.

¹⁰⁷⁰ Ratko Markoviç, T. 13363–13366 (10 gusht 2007); *shih edhe* Ratko Markoviç, T. 13420–13422 (13 gusht 2007).

nëpërmjet lëshimit të “urdhrave, komandave, vendimeve”,¹⁰⁷¹ dhe konkludoi se të marrë së bashku të dy tregojnë qartësisht rolin e pavarur të Presidentit të RFJ-së në komandimin e UJ-së.¹⁰⁷² Markoviçi shtjelloi një numër aspektesh akademike e teknike në lidhje me zbatimin e Kushtetutës së RFJ-së dhe ligjeve në lidhje me rolin e Kryekomandantit dhe të KLM-së, por një diskutim i mëtejshëm në lidhje me to nuk është i nevojshëm.¹⁰⁷³

450. Pikëpamja e Markoviçit se KLM-ja nuk merrte vendime u kundërshtua prej Momir Bullatoviçit, ish-President i Malit të Zi dhe ish-Kryeministër i RFJ-së. Sipas mendimit të tij mbledhjet e KLM-së do të ishin “tërësisht të pakuptimta” në qoftë se nuk merreshin vendime.¹⁰⁷⁴ Ai i cilësoi tre konkluzionet në procesverbalin e 9 qershorit 1998, vendime të marra në përputhje me propozimet e paraqitura prej ekspertit përkatës, në këtë rast Perishiçit.¹⁰⁷⁵

451. Si rezultat, pas shqyrtimit të të gjitha materialeve të KLM-së si prova, Dhoma bindet se KLM-ja kishte kompetencë vendimmarrëse dhe në fakt mori vendime në lidhje me përdorimin e UJ-së. Ajo nuk bindet prej argumentit të Markoviçit se KLM-ja miratonte vetëm konkluzione politike, argument që kundërshtohet prej të gjitha provave të tjera, ndër të cilat edhe dëshmia e Momir Bullatoviçit. Vendime si ai i 4 tetorit 1998 në lidhje me mbrojtjen e vendit, më tej u shfrytëzuan prej Presidentit të RFJ-së, i njohur prej disa individëve si “Kryekomandanti”, në komandimin e UJ-së dhe në udhëzimin e Shtabit të Përgjithshëm për lëshimin e urdhrave konkrete për njësi të ndryshme.¹⁰⁷⁶ Në fakt siç u confirmua prej Markoviçit dhe Radinoviçit, ishte pikërisht vendimi i 4 tetorit 1998 që u përdor si bazë prej Presidentit të RFJ-së për komandimin e UJ-së prej 23 marsit 1999 dhe gjatë gjendjes së mëvonshme të luftës. Gjithashtu, megjithëse Presidenti i RFJ-së kryesonte KLM-në dhe ishte përgjegjës për zbatimin e vendimeve të veta nëpërmjet komandave për UJ-në, anëtarët e tjerë të KLM-së nuk ishin pa kompetenca ose përgjegjësi. Presidentët e Serbisë dhe Malit të Zi mund të kërkonin mbajtjen e mbledhjeve të KLM-së, mund të propozonin çështje të rendit të ditës, dhe mund të paraqisnin kundërshtime ndaj veprimeve të propozuara prej Millosheviçit. Gjithashtu të dy ata mund ta anashkalonin me votim deri në ndryshimin e rregullave

¹⁰⁷¹ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 4.

¹⁰⁷² Ratko Markoviç, T. 13039–13041 (7 gusht 2007).

¹⁰⁷³ *Shih* Ratko Markoviç, T. 13028–13032, 13050–13053, 13060–13063, 13044–13047 (7 gusht 2007); T. 13404, 13416, 13428–13430, 13433–13435 (13 gusht 2007), T. 13641–13643 (15 gusht 2007)

¹⁰⁷⁴ Momir Bullatoviç, T. 13859–13862 (17 gusht 2007).

¹⁰⁷⁵ P1574 (Procesverbal i sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 4; Momir Bullatoviç, T. 13861–13864 (17 gusht 2007).

¹⁰⁷⁶ Fakti që Millosheviçi cilësohej Komandanti i Lartë konfirmohet në dokumentet vijuese në lidhje me rolin e tij si Kryekomandant: 1D459 (Vojska 1, 27 mars 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2; 1D460 (Vojska 4, 5 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2; 1D461 (Vojska 5, 7 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3; 1D462 (Vojska 6, 10 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 1; 1D463 (Vojska 8–9, 14 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3; 1D467 (Vojska 16, 29 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 1; 1D468 (Vojska 20–21, 10 maj 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2.

të 23 marsit 1999 dhe më pas ata mund të bllokoni çdo vendim me të cilin nuk pajtoheshin nëpërmjet nevojës për konsensus.

(C) Mbledhjet e KLM-së pas 23 marsit 1999 dhe ekzistenca e Komandës së Lartë

452. Veç pretendimit se KLM-ja vazhdoi të funksiononte pas 23 marsit 1999, Prokuroria argumenton edhe se me shpalljen e luftës filloi së funksionuari një organ i quajtur Komanda e Lartë ku bënin pjesë anëtarët e KLM-së dhe ky organ mori funksionet e KLM-së.¹⁰⁷⁷ Nga ana tjetër, Mbrojtja e Millutinoviçit argumenton se KLM-ja zhvilloi mbledhje edhe pas 23 marsit 1999,¹⁰⁷⁸ dhe hedh poshtë si ekzistencën e Komandës së Lartë, po ashtu dhe anëtarësinë e saj për aq sa ka lidhje me pretendimin e pjesëmarrjes së Millutinoviçit.¹⁰⁷⁹ Pavarësisht emërimit të këtij organi, pika themelore e kundërshtisë është ekzistenca dhe funksionimi i këtij organi gjatë gjendjes së luftës, i cili ushtroi formalisht komandë gjatë gjendjes së luftës dhe në të cilin morën pjesë Millosheviqi, Millutinoviçi dhe të tjerë. Duke marrë parasysh ndërvarësinë e argumenteve dhe provave në lidhje me ekzistencën e Komandës së Lartë dhe vazhdimin e mbledhjeve të KLM-së gjatë gjendjes së luftës, Dhoma Gjyqësore do t'i shqyrtojë bashkërisht këto dy çështje.

453. Një numër dëshmitarësh pohuan se KLM-ja zhvilloi mbledhje edhe pas 23 marsit 1999, por Dhoma nuk ka marrë prova shpresore të ndonjë mbledhjeje të tillë.¹⁰⁸⁰ Sidoqoftë Simiqi dëshmoi se postëkomanda e KLM-së ndodhej në të njëjtin strehim nëntokësor si Shtabi i Komandës së Lartë. Gjatë luftës dhe pas emërimit të tij në Shtabin e Komandës së Lartë, ai pa një herë në atë objekt Millosheviqin dhe Millutinoviqin.¹⁰⁸¹ Gjenerali Lubomir Angjelkoviç, i cili më 1998 dhe 1999 ishte Shefi i Seksionit për Komunikimin, Informatikën dhe Operacionet Elektronike në UJ, deklaroi se postëkomanda e KLM-së që prej 9 prillit 1999, ishte në të njëjtën ndërtesë ku bëheshin mbledhjet e kolegjiut të UJ-së, në Rrugën Drayzer në Beograd.¹⁰⁸² Gjeneralmajori Spasoje Muçibabiq, shef i Administratës për Operacione të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së në periudhën përkatëse, gjithashtu dëshmoi se kishte parë disa herë Millosheviqin dhe Millutinoviqin, por

¹⁰⁷⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 142.

¹⁰⁷⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 66.

¹⁰⁷⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 88.

¹⁰⁸⁰ Branko Kërça, T. 16841–16842, 16896–16899 (4 tetor 2007); 3D898 (Raport i Degës së Zbulimit të Shtabit të Komandës së Lartë, 28 mars 1999), f. 2; Radovan Radinoviç, T. 17260–17263 (18 tetor 2007); Miodrag Simiq, T. 15628 (14 shtator 2007).

¹⁰⁸¹ Miodrag Simiq, T. 15634–15635 (14 shtator 2007).

¹⁰⁸² Lubomir Angjelkoviç, T. 16423–16426 (26 shtator 2007).

asnjëherë Gjukanoviqin në ndërtesën në Rrugën Dražer në Beograd, gjatë bombardimit të NATO-s.¹⁰⁸³

454. Gjenerali Millorad Obradoviq, shef i Seksionit për Çështje Operative dhe të Personelit deri më 3 mars 1999, dhe më tej komandant i Armatës së Dytë, theksoi se në tërësi KLM-ja funksiononte mirë mirëpo kishte diskutime në lidhje me mungesën e pranisë së Presidentit të Malit të Zi Gjukanoviq gjatë luftës.¹⁰⁸⁴ Kur atij iu tha se KLM-ja nuk ishte mbledhur pas 23 marsit 1999 dhe gjatë kohës së gjendjes së luftës, Obradoviqi tha se në mes të prillit 1999 ai dëgjoji se urdhri për vënien e MPB-së në varësi të UJ-së nuk mund të zbatohet për faktin se Gjukanoviqi nuk merrte pjesë në veprimtarinë e KLM-së. Sidoqoftë ai nuk kishte dijeni të drejtpërdrejtë për mbajtjen e mbledhjeve të KLM-së pas 23 marsit 1999.¹⁰⁸⁵

455. Ndër provat sugjeruese për mbledhje të KLM-së pas 23 marsit 1999, janë vendime për emërime dhe gradime në UJ të miratuara pas asaj date,¹⁰⁸⁶ edhe pse prej atij momenti e në vijim supozohet që këto vendime të kenë qenë kompetencë e KLM-së dhe jo vetëm e Presidentit të RFJ-së.¹⁰⁸⁷

456. Provat e tjera për vijimësinë e ekzistencës së KLM-së ofrohen nëpërmjet përmendjes së KLM-së në raportimet e shefit të Shtabit të Komandës së Lartë më 26 dhe 28 mars 1999. Në mbledhjen e mëparshme Ojdaniqi urdhëroi përgatitjen e një harte për KLM-në.¹⁰⁸⁸ Në mbledhjen e mëtejshme, Branko Gajiqi e përkrahu idenë e paraqitjes së një vlerësimi të gjendjes së UJ-së dhe dislokimit të saj, anëtarëve të KLM-së.¹⁰⁸⁹ Lubomir Saviqi, zëvendësshef i Degës Stërvitore të Korpusit të Prishtinës kur iu përgjigj pyetjeve në lidhje me hierarkinë në UJ, dëshmoi se pas fillimit të luftës, KLM-ja ishte organi më i lartë komandues.¹⁰⁹⁰ Gjithashtu në direktivën e përgjithshme për përdorimin e UJ-së në Kosovë lëshuar prej Ojdaniqit më 9 prill 1999, merret e mirëqenë vazhdimësia e funksionimit të KLM-së.¹⁰⁹¹

457. Aleksandar Vasileviqi deklaroi se në kohë lufte KLM-ja do të vazhdonte të miratonte vendime, mirëpo Presidenti i RFJ-së ishte instanca më e lartë ose “Kryekomandant”, i cili do t’ia

¹⁰⁸³ Spasoje Muçibabiq, T. 16578–16580 (28 shtator 2007).

¹⁰⁸⁴ Millorad Obradoviq, T. 15127–15128 (6 shtator 2007).

¹⁰⁸⁵ Millorad Obradoviq, T. 15154–15156 (6 shtator 2007).

¹⁰⁸⁶ Miodrag Simiq, T. 15709–15711 (14 shtator 2007).

¹⁰⁸⁷ P1738 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 mars 1999), neni 4; Branko Fezer, 3D1118 (deklaratë dëshmitari me datë 3 shtator 2007), para. 1–3.

¹⁰⁸⁸ 3D581 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 28 mars 1999), f. 3.

¹⁰⁸⁹ 3D581 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 28 mars 1999), f. 3.

¹⁰⁹⁰ Lubomir Saviqi, T. 21028–21029 (24 janar 2008).

¹⁰⁹¹ P1481 (Direktivë e Shtabit të Komandës së Lartë për përdorimin e UJ-së në mbrojtjen kundër NATO-s, 9 prill 1999), f. 11.

përcillte vendimet e KLM-së shefit të Shtabit të Përgjithshëm që në kohën e luftës u bë shtabi i Komandës së Lartë. Vasileviqi shpjegoi se termi “Kryekomandant” ishte trashëguar jozyrtarisht nga koha e RSFJ-së.¹⁰⁹² Kur u pyet më tej në lidhje me dallimin midis kohës së luftës dhe paqes në lidhje me hierarkinë e UJ-së, duket se Vasileviqi la të kuptohej se nuk kishte dallim dhe se KLM-ja u bë “Komandë e Lartë”, kështu që funksioni i saj nuk pushoi së ekzistuari në kohë lufte.¹⁰⁹³

458. Millorad Obradoviqi gjithashtu shpjegoi se Komanda e Lartë ekzistonte në luftë dhe përbëhej nga tre anëtarë të KLM-së si dhe nga Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së që në kohë lufte përmendej si Shtabi i Komandës së Lartë.¹⁰⁹⁴ Mirëpo Obradoviqi konfirmoi se nuk ekzistonin dispozita kushtetuese ose ligjore në lidhje me ekzistencën e Komandës së Lartë. Kjo dëshmi u mbështet prej disa dëshmitarëve të paraqitur prej Mbrojtjes.¹⁰⁹⁵ Millovan Vllajkoviqi i cili ishte *shef kabineti* i shefit të Shtabit të Përgjithshëm në atë kohë, dëshmoi se termi “Komandë e Lartë” u përdor në komunikime mes “nesh”, mirëpo nuk ishte veçse një emër në kohë lufte për KLM-në. Vllajkoviqi shpjegoi se në fillim të luftës zyra e tij i adresonte dokumentet “Z. President” dhe “Kryetarit të KLM-së”, por se kjo ndryshoi në fillim të prillit 1999 pas të cilit dokumentet i adresoheshin “Kryekomandantit”. Sidoqoftë Vllajkoviqi nuk shpjegoi sesi zyra e tij arriti në konkluzionin se KLM-ja u bë “Komanda e Lartë” gjatë kohës së luftës.¹⁰⁹⁶

459. Siç u diskutua më sipër, Radovan Radinoviqi dëshmoi se KLM-ja ishte “Komanda e Lartë” e UJ-së gjatë gjithë kohës, dhe, edhe pse ky term nuk figuronte shprehimisht në ligjet përkatëse, ai nënkuptohej prej nenit 135 të Kushtetutës së RFJ-së dhe nenit 41 të Ligjit për Mbrojtjen.¹⁰⁹⁷ Megjithëse ai nuk gjeti dokumentacion të ndonjë mbledhjeje të KLM-së zhvilluar gjatë bombardimit të NATO-s, Shtabi i Komandës së Lartë përgatiste raporte operative ditore të cilat ishin një përmbledhje e të tëra raporteve të luftimeve prej komandave vartëse, të cilat u dërgoheshin “Kryekomandantit”, Presidentit të Serbisë, ministrit të Mbrojtjes, shefit të Shtabit të Komandës së Lartë dhe personave të tjerë.¹⁰⁹⁸ Për më tepër kur iu treguan dokumente të një raportimi para Ojdaniqit më 11 prill 1999, Radinoviqi pranoi se aty bëhej e ditur se ishte planifikuar një mbledhje

¹⁰⁹² Aleksandar Vasileviq, T. 8640–8641 (18 janar 2007);

¹⁰⁹³ Aleksandar Vasileviq, T. 8641–8643 (18 janar 2007); P2592 (Pjesë nga ditari i Vasileviqit, 17 maj 1999), f. 1.

¹⁰⁹⁴ Millorad Obradoviq, T. 15127–15129 (6 shtator 2007).

¹⁰⁹⁵ Zllatoje Terziq, T. 15929–15935 (19 shtator 2007); Lubomir Angjelkoviq, T. 16426 (26 shtator 2007); Spasoje Muçibabiq, T. 16578–16580 (28 shtator 2007).

¹⁰⁹⁶ Millovan Vllajkoviq, T. 16089–16093 (20 shtator 2007); *shih edhe* 3D581 (Procesverbali i raportimit, 28 mars 1999), f. 3.

¹⁰⁹⁷ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 80–84.

¹⁰⁹⁸ Radovan Radinoviq, T. 17263 (18 tetor 2007), 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 121.

e figurave të larta politike dhe ushtarake për të nesërmen, mirëpo ai nuk e dinte nëse kjo u mbledhje u zhvillua.¹⁰⁹⁹

460. Kjo mbledhje përmendet në procesverbalin e shefit të Shtabit të Komandës së Lartë më 11 prill 1999.¹¹⁰⁰ Në atë mbledhje Ojdaniqi deklaroi se në orën 9 të mëngjesit të së nesërmes do të ishte një mbledhje tjetër me “Kryekomandantin” dhe përmendi si të pranishëm Millosheviqin, Millutinoviçin, Lluqiçin,¹¹⁰¹ Shainoviçin, dhe Pavkoviçin, së bashku me Smilaniçin, Kërgën, dhe atë vetë.¹¹⁰² Në procesverbal lexohet se këta individë do të informoheshin në lidhje me një projekt-plan të nesërmen në mëngjes. Ky plan përmendet në një dokument tjetër, një urdhër prej Ojdaniqit për komandantin e Armatës së Tretë për përgatitjen e një propozimi për vendim, i cili do t’i paraqitej Kryekomandantit dhe Shtabit të Komandës së Lartë më 11 prill 1999.¹¹⁰³ Më 12 prill Millosheviqi mori pjesë në një mbledhje të Komandës së Lartë dhe nxori një urdhër për shpartallimin e forcave të UÇK-së, bazuar në projekt-planin e hartuar një ditë më parë.¹¹⁰⁴

461. Branko Gajiçi dëshmoi se Komanda e Lartë ishte e ndryshme prej KLM-së dhe përbëhej prej Presidentit të RFJ-së dhe Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, por në të nuk merrnin pjesë dy Presidentët e republikave përbërëse. Gjithashtu ai deklaroi se Komanda e Lartë nuk ishte rregulluar me ligj dhe se terminologjia ishte trashëguar prej kohës së RSFJ-së.¹¹⁰⁵ Mirëpo kur u pyet për vendimet e “Kryekomandantit” prej 24 marsit 1999 dhe më tej, Gajiçi deklaroi se ato u morën në përputhje me vendimet e KLM-së.¹¹⁰⁶ Gjithashtu Gajiçi mohoi të kishte dijeni në lidhje me anëtarësinë në Komandën e Lartë të ministrave dhe/ose politikanëve, përveç Presidentit të RFJ-së.¹¹⁰⁷

462. Gjenerali Branko Kërگا, i cili ishte shef i Administratës së Zbulimit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së prej janarit 1999, dëshmoi se “Komanda e Lartë” nuk ekzistonte në kuptimin “normativ”, në kuptimin se nuk ishte e përcaktuar në Kushtetutë ose në ligje.¹¹⁰⁸ Ky pohim mbështetet në një parashtrim në procesin kundër Sllobodan Millosheviqit ofruar prej Serbisë dhe

¹⁰⁹⁹ Radovan Radinoviç, T. 17329–17331 (19 tetor 2007); *shih edhe* 3D728 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 11 prill 1999), f. 3; Millovan Vllajkoviç, T. 16099–16100 (20 shtator 2007).

¹¹⁰⁰ 3D728 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 11 prill 1999).

¹¹⁰¹ Ai përshkruhet si “Sreteni, ndihmësi i njësisë së MPB-së nga Kosova” dhe Branko Gajiçi pranoi se ishte fjala për Sreten Lluqiçin, T. 15416 (11 shtator 2007).

¹¹⁰² 3D728 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 11 prill 1999), f. 3.

¹¹⁰³ P1480 (Urdhër për përgatitjen e planeve për mbrojtjen kundër agresionit terrorist, 9 prill 1999).

¹¹⁰⁴ 4D420 (Komunikim i Pavkoviçit për Shtabin e Komandës së Lartë në lidhje me Rivënien në Varësi të MPB-së, 20 prill 1999), f. 1.

¹¹⁰⁵ Branko Gajiçi, T. 15296–15297 (7 shtator 2007), T. 15434–15436 (12 shtator 2007).

¹¹⁰⁶ Branko Gajiçi, T. 15436 (12 shtator 2007).

¹¹⁰⁷ Branko Gajiçi, T. 15437 (12 shtator 2007).

¹¹⁰⁸ Branko Kërگا, T. 16841–16843, 16906–16908 (4 tetor 2007).

Malit të Zi, ku shkruhej se në kohën që ka lidhje me Aktakuzën, në instrumentet ligjore përkatëse nuk ekzistonte asnjë organ me emrin “Komanda e lartë”.¹¹⁰⁹ Sipas Kërgës, në rast se do të kishte ekzistuar Komandë e Lartë, në të duhej të kishin marrë pjesë anëtarët e KLM-së, Kryeministri i RFJ-së, ministri federal i Mbrojtjes, ministri i Brendshëm, ministri i Financave si dhe disa zyrtarë të lartë shtetërorë.¹¹¹⁰ Më vonë ai konkludoi se jo domosdoshmërisht ekzistenca dhe ose/funksionimi i Komandës së Lartë kushtëzoheshin prej pasqyrimit me shkrim të përbërjes dhe kompetencave të saj.¹¹¹¹

463. Miodrag Simiqi dëshmoi se Komanda e Lartë përbëhej prej Kryekomandantit dhe Shtabit të Komandës së Lartë.¹¹¹² Kjo mbështetet prej dëshmisë së Aleksandar Dimitrijeviqit, i cili dëshmoi se gjatë luftës KLM-ja pushoi së ekzistuari dhe se UJ-ja komandohej vetëm prej Kryekomandantit dhe Shtabit të Komandës së Lartë.¹¹¹³ Po ashtu Simiqi pohoi se në kohë luftime UJ-ja komandohej prej Kryekomandantit, mirëpo ai duhej t’ua përcillte informacionin përkatës anëtarëve të KLM-së si dhe individëve të tjerë si Kryeministrit Federal. Ky informacion dërgohej në gjithsej 15-16 adresa.¹¹¹⁴ Kur ai u ballafaqua me pohimin se në kohë luftime KLM-ja vepronte me emrin “Komanda e Lartë”, Simiqi e mohoi dhe u përgjigj se kjo cenonte parimin themelor fillestar të hierarkisë dhe ekzistencës së një komande të vetme.¹¹¹⁵ Pastaj atij iu tregua një pjesë nga procesverbali i një mbledhjeje të Kolegjiumit të Shtabit të Komandës së Lartë, zhvilluar më 9 prill 1999, ku del se “Komanda e Lartë” ishte diçka tjetër dhe jo thjesht një kombinim i “Kryekomandantit” dhe Shtabit të Komandës së Lartë.¹¹¹⁶ Simiqi mohoi se 15-16 të adresuarit që merrnin informacion prej “Kryekomandantit” siç u lartpërmend, përbënin “Komandën e Lartë”. Ai shpjegoi se sipas procedurës së rregullt shefi i Komandës së Lartë kishte mbledhje në mbrëmje me personelin e tij. Bazuar në konkluzionet e këtyre mbledhjeve, hartohej një raport i cili i dërgohej jo vetëm Presidentit të RFKJ-së, por edhe 15-16 adresave, ndër të cilët edhe dy anëtarë të KLM-së.¹¹¹⁷ Simiqi u ballafaqua edhe më dëshminë e dhënë më parë nga Obradoviqi.¹¹¹⁸ Ai pranoi dëshminë e

¹¹⁰⁹ ID35 (Parashtrim i Serbisë dhe Malit të Zi në çështjen *Prokurori k. Millosheviqit*, 29 dhjetor 2003), f. 3.

¹¹¹⁰ Branko Kërگا, T. 16841–16843, 16906–16908 (4 tetor 2007).

¹¹¹¹ Branko Kërگا, T. 16909–16910 (4 tetor 2007).

¹¹¹² Miodrag Simiq, T. 15599–15600 (13 shtator 2007).

¹¹¹³ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26645 (8 korrik 2008).

¹¹¹⁴ Miodrag Simiq, T. 15600–15603, 15610 (13 shtator 2007).

¹¹¹⁵ Miodrag Simiq, T. 15602–15603 (13 shtator 2007).

¹¹¹⁶ P929 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shefit të Shtabit të Komandës së Lartë, 9 prill 1999), f. 38–39.

¹¹¹⁷ Miodrag Simiq, T. 15604–15612 (13 shtator 2007).

¹¹¹⁸ Millorad Obradoviqi, T. 15128 (6 shtator 2007).

Obradoviçit në lidhje me pikën se Presidenti i RFJ-së komandonte UJ-në në përputhje me vendimet e KLM-së, por nuk u pajtua me idenë se KLM-ja u bë “Komanda e Lartë”.¹¹¹⁹

464. Gjeneralkoloneli Spasoje Smilaniq, shef i Administratës së Parë të UJ-së në 1998 dhe më tej komandant i Forcave Ajrore dhe Mbrojtjes Ajrore prej fillimit të vitit 1999, gjithashtu dëshmoi se “Komanda e Lartë” përbëhej prej Presidentit të RFJ-së i cili ishte “Kryekomandant” dhe “shtabit” të tij, d.m.th Shtabit të Komandës së Lartë. Sipas Smilaniqit kjo ishte mënyra e vetme për ekzistencën e një komande të vetme. Smilaniqi mohoi praninë e civilëve në shtabin e “Komandës së Lartë”.¹¹²⁰

465. Në lidhje me deklaratën se në kohë lufte KLM-ja u bë Komandë e Lartë, por me më shumë anëtarë me qëllim që të përfshihej edhe personeli përkatës ushtarak, eksperti i të drejtës kushtetuese, Ratko Markoviçi, tha se zgjerimi i KLM-së do të kishte qenë i pamundur për shkak të kufizimeve të vendosura prej Kushtetutës së RFJ-së, por se në mbledhje mund të merrnin pjesë edhe individë të tjerë si të ftuar. Kur dëgjoi sugjerimin se Rregullorja e Procedurës së KLM-së ndryshoi në të njëjtën ditë me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në RFJ, në mars 1999, dhe se kjo mbështeste pretendimin se Komanda e Lartë filloi ekzistencën me shpalljen e gjendjes së luftës, Markoviçi pranoi se gjatë gjendjes së luftës ishte e nevojshme ekzistenca e një organi funksionues për mbrojtjen e vendit,¹¹²¹ por theksoi se termat “Kryekomandant” dhe “Komandë e Lartë” nuk figuronin në Kushtetutën e RFJ-së.¹¹²²

466. Në intervistën me Prokurorinë, Llazareviçi shpjegoi se sipas tij termi “Komandë e Lartë” nënkuptonte anëtarët e KLM-së, ministrin e Mbrojtjes, Kryeministrin Federal dhe ministrin e Brendshëm.¹¹²³

467. Dëshmitë tregojnë se një anëtar i KLM-së, konkretisht Presidenti i Malit të Zi, Gjukanoviçi, nuk mori më pjesë në mbledhjet e KLM-së pas dhjetorit 1998, por gjithsesi ky organ zhvilloi mbledhje më 23 mars 1999 dhe ndryshoi rregulloren e procedurës, duke lënë të kuptohej se anëtarët e tij parashikonin mbledhje të tjera pas asaj date. Megjithëse nuk ka prova të drejtpërdrejta për mbledhje të tilla pas 23 marsit 1999, KLM-ja ruajti komandën *de jure* të UJ-së në kohë lufte. Pavarësisht faktit nëse anëtarët e mbetur të KLM-së funksionuan gjatë fushatës ajrore të NATO-s

¹¹¹⁹ Kjo shpjegohet me faktin se në një rast të tillë “Kryekomandanti” nuk do të ishte në gjendje të ushtronte komandë mbi dy anëtarë të tjerë të KLM-së, faktor që do të minonte parimin e një komande të vetme. Miodrag Simiq, T. 15625–15627 (14 shtator 2007).

¹¹²⁰ Spasoje Smilaniq, T. 15782–15784 (17 shtator 2007).

¹¹²¹ Ratko Markoviçi, T. 13438–13443 (13 gusht 2007).

¹¹²² Ratko Markoviçi, T. 13653–13654 (15 gusht 2007); *shih edhe* P1319 (Intervistë e Pavkoviçit në stacionin televiziv RTS të Beogradit), f. 4.

¹¹²³ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 241–243.

nën mbulesën apo emërtimin “Komanda e Lartë”, është e qartë se ata ruajtën rolet e tyre përkatëse *de jure* në komandën e UJ-së siç parashkruhet në rregulloren e rishikuar të procedurës së KLM-së. Megjithëse nuk ka dyshim se Millosheviqi si “Kryekomandant”, ishte në majë të hierarkisë ekzekutive komanduese të UJ-së gjatë konfliktit, është po ashtu e qartë se Millutinoviqi ishte marrës plotësisht i informuar i raporteve operative përmbledhëse të Shtabit të Komandës së Lartë dhe kishte kompetencë të mbledhte Këshillin e Lartë të Mbrojtjes për shqyrtimin e çështjeve të rëndësishme brenda mandatit të këtij organi.

ii. Komanda dhe kontrolli ushtarak: Shtabi i Përgjithshëm

468. Gjatë periudhës përkatëse të Aktakuzës organi komandues ushtarak në varësi të drejtpërdrejtë të udhëheqjes civile të UJ-së ishte Shtabi i Përgjithshëm.¹¹²⁴ Ligji për UJ-në e përshkruan Shtabin e Përgjithshëm si organin më të lartë profesional dhe administrativ për përgatitjen dhe përdorimin e UJ-së në kohë lufte dhe paqeje.¹¹²⁵ Në mënyrë më të përgjithshme ai ishte përgjegjës për stërvitjen e oficerëve dhe ushtarëve, mbushjen e radhëve të UJ-së, krijimin e planeve për zhvillimin e UJ-së dhe për përdorimin e UJ-së në rrethana të një luftimi të mundshëm dhe informimin e udhëheqjes civile të UJ-së me të dhëna dhe propozime në ndihmë të procesit vendimmarrës.¹¹²⁶

469. Siç u diskutua më sipër, gjatë gjendjes së luftës Shtabi i Përgjithshëm u bë i njohur si Shtabi i Komandës së Lartë.¹¹²⁷ Radovan Radinoviqi dëshmoi se ky ndryshim në emërtim, dhe efektet e tij praktike të cilat jepen në hollësi më poshtë, ndodhën në mars 1999, nën kontrollin e Ojdaniqit si shef i Shtabit të Përgjithshëm. Sipas Radinoviqit ky ndryshim nuk u rregullua me ligj, por u harmonizua në përputhje me standardet profesionale ekzistuese në Shtabin e Përgjithshëm.¹¹²⁸

¹¹²⁴ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 5; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 9.

¹¹²⁵ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 5; *shih edhe*, P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), f. 97; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 84.

¹¹²⁶ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 84.

¹¹²⁷ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 89; Spasoje Muçibabiq, T. 16578 (28 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 9, T. 8643 (18 janar 2007); Miodrag Simiq, T. 15599 (13 shtator 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 241–245. Ka prova se në disa raste Shtabi i Përgjithshëm u cilësua edhe si Komanda e Grupit Strategjik. Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 16.

¹¹²⁸ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 89.

(A) Shefi i Shtabit të Përgjithshëm

470. Sipas Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen, shefi i Shtabit të Përgjithshëm ishte oficeri ushtarak me gradën më të lartë në UJ, megjithëse në varësi të organeve komanduese civile të UJ-së.¹¹²⁹ Momçillo Perishiçi e mbajti këtë post prej 26 gushtit 1993 deri më 24 nëntor 1998, kur u hoq prej detyrës pas një diskutimi në KLM, dhe u zëvendësua prej Ojdaniqit, i cili e mbajti këtë post deri në shkurt të vitit 2000.¹¹³⁰

471. Detyra parësore e shefit të Shtabit të Përgjithshëm ishte komandimi i UJ-së nëpërmjet lëshimit të urdhrave për njësitë strategjike dhe oficerët e tjerë të UJ-së drejtpërsëdrejti në varësinë e tij, brenda kufizimeve të përcaktuara prej ligjeve federale, për përmbushjen e udhëzimeve të Presidentit të RFJ-së.¹¹³¹ Rrjedhimisht, shefi i Shtabit të Përgjithshëm ishte përgjegjës për komandimin e Forcave Tokësore, Forcës Ajrore dhe Mbrojtjes Ajrore dhe Marinës Luftarake.¹¹³²

472. Neni 6 i Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen përcaktonte se shefi i Shtabit të Përgjithshëm duhet të lëshojë urdhra, rregulla, komanda, udhëzime, dhe “dokumente të tjera” për UJ-në, për zbatimin e “dokumenteve të lëshuara prej Presidentit të RFJ-së”.¹¹³³ Shefi i Shtabit të Përgjithshëm gjithashtu mund të lëshonte urdhra, adresuar nivelit të dytë të vartësve si p.sh. Korpusit të Prishtinës, mirëpo në raste të tilla komandanti urdhërmarrës ishte i detyruar të informonte eprorin e tij.¹¹³⁴ Ai kishte gjithashtu kompetencë të kërkonte raporte të posaçme, jashtë linjës së zakonshme të raportimit, drejtpërsëdrejti prej nivelit të dytë të varësisë, përfshirë Korpusin e Prishtinës.¹¹³⁵

473. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm kishte kompetencë të emëronte oficerë, nënoficerë dhe ushtarë në të gjitha postet në UJ, veç postit të gjeneralit ose të eprorëve detyra e të cilëve kërkonte gradën e gjeneralit dhe që duhej miratuar prej Kryekomandantit.¹¹³⁶ Ai mund të bënte propozime të veçanta për miratim prej Presidentit të RFJ-së, të gradimit si gjeneral të një oficeri karriere.¹¹³⁷

¹¹²⁹ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 6; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 9, T. 8639–8643 (18 janar 2007).

¹¹³⁰ P796 (Dokument mbi dorëzimin e detyrës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, ndërmjet Momçillo Perishiçit dhe Dragolub Ojdaniqit, 27 nëntor 1998).

¹¹³¹ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 6, P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll I), f. 97.

¹¹³² P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 5; P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), f. 97; P1319 (Intervistë e Pavkoviçit në stacionin televiziv RTS të Beogradit), f. 3.

¹¹³³ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 6; *shih edhe* P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), f. 97.

¹¹³⁴ Vladimir Lazareviq, T. 17939 (8 nëntor 2007)

¹¹³⁵ Vladimir Lazareviq, T. 17939 (8 nëntor 2007).

¹¹³⁶ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), nenet 16, 152. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm mund të gradonte oficerë vetëm për grada më të larta se kolonel për arsye të veçanta, P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 46.

¹¹³⁷ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 46.

474. Siç u theksua më sipër, më 23 mars 1999 u miratua Rregullorja e re e Procedurës së KLM-së e cila diktonte pjesëmarrjen e shefit të Shtabit të Përgjithshëm në mbledhjet e KLM-së.¹¹³⁸ Në bazë të rregullores së re ai mund të kërkonte mbajtjen e mbledhjeve dhe të propozonte pika për rendin e ditës.¹¹³⁹ Gjithashtu ai mund të paraqiste propozime në KLM për emërimë, gradime dhe dalje në pension të gjeneralëve dhe admiralëve të UJ-së, të cilat më tej miratoheshin me konsensusin e anëtarëve të KLM-së.¹¹⁴⁰ Mirëpo sipas Radinoviqit, shefi i Shtabit të Përgjithshëm në asnjë moment nuk kishte të drejtë vote ose kompetenca vendimmarrëse brenda KLM-së dhe rrjedhimisht nuk ishte anëtar i këtij organi.¹¹⁴¹

475. Në përmbushjen e përgjegjësive të tij, shefi i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë mbështetej prej kabinetit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe në kohë lufte prej Shtabit të Komandës së Lartë me materiale, logjistikë dhe struktura organizative. Në vitet 1998 dhe 1999, shef i kabinetit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm/Komandës së Lartë ishte Millovan Vllajkoviqi.¹¹⁴²

(B) Përbërja e Shtabit të Përgjithshëm

476. Ndër grupet operative të luftimit në varësinë e Shtabit të Përgjithshëm ishin Armata e Parë, e Dytë dhe e Tretë.¹¹⁴³ Gjithashtu Shtabi i Përgjithshëm kishte në varësi një numër seksionesh dhe administratash të pavarura të UJ-së që mbulonin detyra në prapavijë si planifikim operacionesh dhe zbulim.¹¹⁴⁴ Lloji dhe përbërja e organeve në varësi të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së nuk ndryshoi konsiderueshëm kur u shndërrua në Shtabin e Komandës së Lartë.¹¹⁴⁵

477. Dhoma dëgjoi një masë të konsiderueshme dëshmish në lidhje me seksionet e ndryshme dhe administratat e pavarura të Shtabit të Përgjithshëm, kryesisht prej dëshmitarëve të Mbrojtjes. Ajo i ka analizuar me kujdes të tëra këto dëshmi të cilat hedhin dritë mbi mënyrën e funksionimit të UJ-së në vitet 1998 dhe 1999, mirëpo e gjykon të panevojshme të hyjë në hollësi.¹¹⁴⁶ Çfarë vlen të

¹¹³⁸ P1738 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 mars 1999), neni 3; Ratko Markoviq, T. 13353 (10 gusht 2007).

¹¹³⁹ P1738 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 mars 1999), nenet 3, 5.

¹¹⁴⁰ P1738 (Rregullorja e Procedurës së KLM-së, 23 mars 1999), neni 4.

¹¹⁴¹ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 82. Markoviqi dëshmoi se anëtarët shtesë nuk kishin të drejtë vote duke qenë se do ishte në shkelje të drejtpërdrejtë të Kushtetutës së RFJ-së. Ratko Markoviq, T. 13353–13354 (10 gusht 2007).

¹¹⁴² Millovan Vllajkoviqi, 3D1112 (deklaratë dëshmitari me datë 17 gusht 2007), para. 2.

¹¹⁴³ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 10.

¹¹⁴⁴ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 85; P1739 (Listë e Anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së).

¹¹⁴⁵ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 85–88; Spasoje Smilaniq, T. 15783 (17 shtator 2007). *Shih* diagramet që skicojnë strukturën e Shtabit të Përgjithshëm dhe Shtabit të Komandës së Lartë, përkatësisht në faqet. 85 dhe 87.

¹¹⁴⁶ *Shih p.sh.*, Miodrag Simiq, T. 15481–15482 (12 shtator 2007), 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 7; Millorad Obradoviq, T. 14918–14919 (4 shtator 2007); Gjorgje Çurçin, 3D1121 (deklaratë dëshmitari

përmendet është se organi më i lartë për administrimin e çështjeve të sigurisë në UJ ishte Administrata e Sigurimit e Shtabit të Përgjithshëm,¹¹⁴⁷ e cila ishte përgjithësisht përgjegjëse për zbulimin, kundërzbulimin dhe mbrojtjen e UJ-së prej rreziqeve nga elementë terroristë dhe kriminalë dhe përdorte policinë ushtarake.¹¹⁴⁸ Brenda UJ-së ekzistonin organe të sigurisë në çdo nivel komandimi, të cilat i raportonin Administratës së Sigurimit, përfshirë edhe krimet e kryera prej efektivit të UJ-së.¹¹⁴⁹ Funkzioni i organeve të sigurimit u përcaktua si i barasvlershëm me atë të policisë në një sistem civil siç diskutohet më poshtë në hollësi.¹¹⁵⁰

478. Kolegjiumi i UJ-së ishte organ i përbërë prej ndihmësve dhe vartësve më të afërt të shefit të Shtabit të Përgjithshëm.¹¹⁵¹ Ndër ta përfshiheshin krerët e seksioneve të Shtabit të Përgjithshëm, të njohur edhe si ndihmëshefa dhe krerët e administratave të pavarura.¹¹⁵² Para fushatës ajrore të NATO-s dhe deri më 18 mars 1999, kolegjiumi zhvilloi mbledhje të shpeshta.¹¹⁵³ Herë pas herë në këto mbledhje ishte i pranishëm edhe Presidenti i RFJ-së.¹¹⁵⁴ Në mbledhjet e kolegjiumit udhëheqja e Shtabit të Përgjithshëm diskutonte çështje të përgjithshme ose të një rëndësie afatgjatë si çështje të personelit dhe aspekte në lidhje me materialet dhe financën.¹¹⁵⁵ Gjatë fushatës së NATO-s në vend të mbledhjeve të kolegjiumit u zhvilluan raportime para shefit të Shtabit të Komandës së Lartë.¹¹⁵⁶

(C) Shtabi i Komandës së Lartë

479. Disa dëshmitarë dëshmuar se Shtabi i Komandës së Lartë ndryshoi vendndodhjen nga ndërtesa e selisë së Shtabit të Përgjithshëm në postëkomandën bazë 124 metra nën tokë në Rrugën

me datë 24 gusht 2007), f. 3; Millan Uzelac, T. 16157 (21 shtator 2007); Branko Kërğa, 3D1120 (deklaratë dëshmitari me datë 13 gusht 2007), f. 4; Lubomir Angjelkoviç, T. 16386–16387 (26 shtator 2007); Negovan Jovanoviç, T. 14893 (4 shtator 2007); Sllobodan Kosovac, T. 15795–15796 (17 shtator 2007).

¹¹⁴⁷ Branko Gajiç, 3D1084 (deklaratë dëshmitari me datë 8 gusht 2007), para. 4; Aleksandar Dimitrijeviç, T. 26582 (8 korrik 2008) (dëshmoi se Dega e Sigurimit njihej edhe si “shërbimi i kundërzbulimit”).

¹¹⁴⁸ Branko Gajiç, 3D1084 (deklaratë dëshmitari me datë 8 gusht 2007), para. 4.

¹¹⁴⁹ Geza Farkash, T. 16293, 16304, 16306, 16318, 16322 (25 shtator 2007).

¹¹⁵⁰ Llakiç Gjoroviç, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 9.

¹¹⁵¹ Aleksandar Vasileviç, T. 8795 (22 janar 2007); Gjorgje Qurçin, T. 16939 (5 tetor 2007).

¹¹⁵² Radovan Radinoviç, T. 17326–17327 (19 tetor 2007).

¹¹⁵³ Radovan Radinoviç, T. 17327–17328 (19 tetor 2007); Gjorgje Qurçin, T. 17004 (5 tetor 2007). *Shih edhe.*, P934 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 11 shkurtin 1999); P937 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 18 shkurtin 1999); P940 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 21 shkurtin 1999); P941 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 24 shkurtin 1999); P933 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 4 marsin 1999); P935 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 11 marsin 1999); dhe P938 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 18 marsin 1999).

¹¹⁵⁴ Gjorgje Qurçin, T. 16937–16938 (5 tetor 2007).

¹¹⁵⁵ Radovan Radinoviç, T. 17328–17329 (19 tetor 2007); Spasoje Muçibabiç, T. 16552 (27 shtator 2007).

¹¹⁵⁶ Mirëpo procesverbal i një kolegjiumi të zhvilluar në atë periudhë është pranuar si provë. *Shih* P929 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 9 prillin 1999).

Drajzer, gjatë bombardimit të NATO-s.¹¹⁵⁷ Shefi i Shtabit të Komandës së Lartë dhe disa prej administratave u zhvendosën që prej fillimit të bombardimit të NATO-s më 24 mars 1999.¹¹⁵⁸ Seksione të tjera, përfshirë dhe Qendrën e Operacioneve mbetën në ndërtesën e selisë së Shtabit të Përgjithshëm deri më 4 prill 1999.¹¹⁵⁹ Mirëpo ekzistojnë gjithashtu prova se gjatë bombardimit të NATO-s anëtarët e Shtabit të Komandës së Lartë u vendosën në ndërtesa të ndryshme në Beograd dhe rreth tij.¹¹⁶⁰

480. Gjatë bombardimit Ojdaniqi organizonte mbledhje të përditshme me anëtarët e lartë të Shtabit të Komandës së Lartë në lidhje me gjendjen në Kosovë në postëkomandën bazë të Shtabit të Komandës së Lartë.¹¹⁶¹ Këto mbledhje zhvilloheshin zakonisht mbrëmjeve,¹¹⁶² por në raste kur duheshin diskutuar çështje konkrete, ato zhvilloheshin në mëngjes.¹¹⁶³ Gjatë mbledhjeve shefi i Komandës së Lartë ose zëvendësi i tij jepnin detyra dhe shefi i kabinetit të shefit të Shtabit të Komandës së Lartë mbante shënime.¹¹⁶⁴ Dhoma i ka analizuar me kujdes shënimet për të kuptuar funksionimin e Shtabit të Komandës së Lartë dhe përgjegjësitë e anëtarëve të tij.¹¹⁶⁵

481. Shënimet e mbledhjeve të përfshira në prova tregojnë se shefi i Shtabit të Komandës së Lartë merrte informacion të aktualizuar të rregullt për çështje që kishin lidhje me UJ-në, duke filluar prej operacioneve të luftimit dhe humbjet e pësuar deri në pajisjen e njësive të ndryshme dhe furnizimet e prapavijës për njësitë. Mbi këtë bazë mund të shihet se gjatë sulmeve ajrore të NATO-s, Shtabi i Komandës së Lartë punoi në mënyrë kolegjiale por gjithsesi hierarkike. Rrjedhimisht anëtarët e kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë shkëmbyen lirisht informacion.

¹¹⁵⁷ Lubomir Angjelković, T. 16422–16426 (26 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 8; Stanisha Ivković, T. 16519–16520 (27 shtator 2007).

¹¹⁵⁸ Stanisha Ivković, T. 16520 (27 shtator 2007).

¹¹⁵⁹ Stanisha Ivković, T. 16520 (27 shtator 2007).

¹¹⁶⁰ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 8; Gjorgje Qurçin, T. 17006–17008 (5 tetor 2007).

¹¹⁶¹ Radovan Radinović, T. 17328 (19 tetor 2007); Branko Kërğa, T. 16782–16783 (3 tetor 2007); Millovan Vllajković, 3D1112 (deklaratë dëshmitari me datë 17 gusht 2007), para. 18, T. 16085–16086 (20 shtator 2007); Millan Radoiçiq, 3D1111 (deklaratë dëshmitari me datë 17 gusht 2007), para. 11, T. 16133 (21 shtator 2007); Gjorgje Qurçin, T. 17006–17008 (5 tetor 2007).

¹¹⁶² Branko Kërğa, T. 16891 (4 tetor 2007); Spasoje Muçibabiq, T. 16552 (27 shtator 2007); Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 7.

¹¹⁶³ Branko Kërğa, T. 16891 (4 tetor 2007).

¹¹⁶⁴ Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 7; Millan Radoiçiq, 3D1111 (deklaratë dëshmitari me datë 17 gusht 2007), para. 11.

¹¹⁶⁵ Branko Gajiç, T. 15384–15385 (11 shtator 2007); Millovan Vllajković, T. 16085–16086 (20 shtator 2007). Branko Kërğa dëshmoi se në këto mbledhje nuk u mbajt procesverbal. Branko Kërğa, T. 16891 (4 tetor 2007). Mirëpo, Spasoje Muçibabiq dëshmoi se në këto takime ai dhe koloneli Pashkash mbanin shënime në një bllok shënimesh. Spasoje Muçibabiq, T. 16553 (27 shtator 2007).

iii. *Hierarkia komanduese dhe komunikimi në UJ*

482. Siç u diskutua më lart, KLM-ja dhe Presidenti i RFJ-së ushtronin kontroll politik mbi UJ-në. Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë ishte vartësi i parë i drejtpërdrejtë i udhëheqjes civile të UJ-së në hierarkinë komanduese.¹¹⁶⁶ Në kuadër të forcave tokësore, në varësi të Shtabit të Përgjithshëm ishte Armata e Tretë, zona e përgjegjesisë së të cilës përfshinte Serbinë jugore.¹¹⁶⁷ Armata e Tretë ndahej në dy korpuse, Korpusi i Nishit dhe Korpusi i Prishtinës, zona e përgjegjesisë së të cilit ishte Kosova.¹¹⁶⁸ Për këto njësi diskutohet në hollësi më poshtë.

483. Sipas udhëzuesit të saj, UJ-ja vepronte në bazë të parimit të një komande të vetme dhe të bashkuar. Parimi i një komande të bashkuar diktonte që të gjitha pjesët përbërëse të UJ-së dhe organizatat partnere, të bashkëpunonin për arritjen e synimit të përbashkët dhe të funksiononin sipas standardeve të përbashkëta ligjore, metodike dhe doktrinare. Parimi i një komande të vetme diktonte që për çdo nivel të hierarkisë komanduese të ishte vetëm një komandant përgjegjës për detyrën e caktuar. Komandanti mund t'u delegonte pushtet vartësve, por në çdo rast mbante përgjegjësi për çdo vendim të marrë dhe çdo veprim të kryer prej njësisë ose seksionit të tij.¹¹⁶⁹ Sidoqoftë, ashtu siç u përmend më sipër, shefi i Shtabit të Përgjithshëm mund të urdhëronte drejtpërsëdrejti nivelin e dytë të hierarkisë.¹¹⁷⁰

484. Komandantët vartës kishin detyrim të zbatonin urdhrat e eprorëve pa kundërshtim, plotësisht, saktësisht dhe në kohë.¹¹⁷¹ Mirëpo në të njëjtën kohë oficerët kishin detyrim të mos zbatonin urdhra që përbënin krime.¹¹⁷² Urdhrrat mund të lëshoheshin gojarisht ose me shkrim dhe duhej të ishin “të plotë, të shkurtër dhe të qartë”,¹¹⁷³ si edhe “realistë dhe të realizueshëm”.¹¹⁷⁴

¹¹⁶⁶ P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 5; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 9.

¹¹⁶⁷ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 17, T. 17643 (26 tetor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 14–15; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 12.

¹¹⁶⁸ Lubisha Stojimiroviq, T. 17646 (26 tetor 2007); Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari me datë 30 janar 2004), para. 6–9; *shih edhe* 4D240 (Struktura, Dislokimi dhe Përbërja Numerike e Komponentit Ushtarak-Territorial të Armatës së Tretë, 14 Janar 1999), f. 1.

¹¹⁶⁹ P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), f. 61–62.

¹¹⁷⁰ Vladimir Llazareviq, T. 17939 (8 nëntor 2007).

¹¹⁷¹ P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), p. 62; P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 3.

¹¹⁷² P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 37; 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), rregullat 33, 35; *shih edhe* P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 74–75; Gjura Bllagojeviq, 5D1402 (deklaratë dëshmitari me datë 27 dhjetor 2007), para. 32.

¹¹⁷³ 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), rregulla 34.

¹¹⁷⁴ 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), rregulla 35.

Urdhrat që kishin lidhje me “çështje thelbësore” si “mbrojtja e jetëve njerëzore, duhej të jepeshin me shkrim.¹¹⁷⁵

485. Gjatë fushatës së NATO-s shefi i Shtabit të Komandës së Lartë, Ojdaniqi e informonte Presidentin e RFJ-së, Millosheviqin, rregullisht për operacionet në terren të UJ-së, dhe më tej i paraqiste raportet ditore të luftimeve.¹¹⁷⁶ Millosheviqi si Kryekomandant i jepte detyra bazë Ojdaniqit,¹¹⁷⁷ në lidhje me kryerjen e të cilave Ojdaniqi raportonte në Shtabin e Komandës së Lartë në mbledhjet e mbrëmjes.¹¹⁷⁸ Në mbyllje të mbledhjeve të kryesuara prej tij, Ojdaniqi zakonisht u jepte detyra të pranishmëve, ndër të tjera detyra në lidhje me operacione ushtarake.¹¹⁷⁹ Ojdaniqi dhe shtabi i tij e ndihmonin Kryekomandantin nëpërmjet hartimit të urdhrave.¹¹⁸⁰ Gjithashtu edhe Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë lëshonte urdhra me miratimin e Ojdaniqit.¹¹⁸¹

486. Gjatë bombardimit të NATO-s hartimi i urdhrave bëhej në postëkomandën e Shtabit të Komandës së Lartë në Beograd.¹¹⁸² Urdhrat e Shtabit të Komandës së Lartë formuloheshin mbi bazën e një “harte operative”, ku tregoheshin vendndodhja e të gjitha njësive të UJ-së dhe veprimet e tyre për 24 orët e mëparshme.¹¹⁸³ Të dhënat e hartës aktualizoheshin vazhdimisht bazuar në raportet e luftimit që vinin prej njësive vartëse.¹¹⁸⁴ Urdhrat dërguar njësive vartëse prej Shtabit të Komandës së Lartë nga ana e tyre ishin në formën e një bashkësie urdhrash konkretë bashkëngjitur një harte topografike ku tregoheshin njësitë në zonën përkatëse dhe detyrat e tyre.¹¹⁸⁵ Millorad Obradoviqi dëshmoi se në praktikë shefi i Shtabit të Komandës së Lartë nënshkruante hartën shoqëruese të urdhrave.¹¹⁸⁶ Në fakt, në dokumentacion janë urdhra të shumtë nënshkruar prej

¹¹⁷⁵ Në raste urgjente urdhrat mund të jepeshin gojarisht, por më pas duhej të paraqiteshin me shkrim, e shumta ditën e nesërme të punës. 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), rregulla 34.

¹¹⁷⁶ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 16; Radovan Radinoviq, T. 17238–17239 (18 tetor 2007). Gjorgje Qurçini dëshmoi se këto mbledhje u zhvilluan çdo ditë gjatë konfliktit; Gjorgje Qurçini, T. 16979–16980 (5 tetor 2007).

¹¹⁷⁷ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 15; Branko Gajiq, T. 15417 (11 shtator 2007).

¹¹⁷⁸ Gjorgje Qurçini, T. 16979–16980 (5 tetor 2007).

¹¹⁷⁹ *Shih p.sh.*, 3D721 (Raportim për Shtabin e Komandës së Lartë, 3 prill 1999), f. 4–5; 3D728 (Raportim për Shefin e Shtabit të Komandës së Lartë, 11 prill 1999), f. 3–5.

¹¹⁸⁰ Radovan Radinoviq, T. 17248 (18 tetor 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 15.

¹¹⁸¹ Miodrag Simiq, T. 15480–15481 (12 shtator 2007), 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 28–29; Millorad Obradoviq, T. 14919, 14924 (4 shtator 2007); Lubomir Angjelkoviq, T. 16403–16404 (26 shtator 2007); Radovan Radinoviq, T. 17238–17239 (18 tetor 2007).

¹¹⁸² Lubomir Angjelkoviq, T. 16403–16404, 16422 (26 shtator 2007).

¹¹⁸³ Miodrag Simiq, T. 15473–15474 (12 shtator 2007).

¹¹⁸⁴ Miodrag Simiq, T. 15476 (12 shtator 2007); Vllade Nonkoviq, T. 16216–16217 (24 shtator 2007).

¹¹⁸⁵ Millorad Obradoviq, T. 15080–15082 (6 shtator 2007); *shih edhe* Millan Gjakoviq, T. 26398 (19 maj 2008).

¹¹⁸⁶ Millorad Obradoviq, T. 15080–15081 (6 shtator 2007).

Ojdaniqit si shef i Shtabit të Komandës së Lartë dhe raportet e tjera përmenden si të marra ose të përgatitura prej anëtarëve të Shtabit të Komandës së Lartë.¹¹⁸⁷

487. Kjo metodologji krijimi urdhrash ishte praktikë standarde në nivel armate, korpusi dhe brigade.¹¹⁸⁸ Pas marrjes së urdhrave prej grupeve vartëse përkatëse, komandantët e tyre hartonin plane dhe urdhra konkrete për t'u zbatuar prej njërive të tyre vartëse.¹¹⁸⁹ Në nivelet vartëse të hierarkisë komanduese, urdhrave me shkrim zakonisht u bashkëngjiteshin harta topografike të zonave, skema dhe grafikë.¹¹⁹⁰ Sipas Millovan Gjakoviqit urdhrat me shkrim dhe hartat “ishin të pandashme ... nuk shkonin njëri pa tjetrin”.¹¹⁹¹ Parimisht pritej që të tëra operacionet e luftimit të planifikoheshin prej Armatës së Tretë me autorizim të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, veç rasteve kur kishte patur sulm të befasishtë kundër një prej njërive të saj.¹¹⁹² Në raste të tilla njësisë në fjalë të Armatës së Tretë nuk i duhej të priste miratimin e Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë për operacione mbrojtëse, për arsye se në bazë të “praktikës ushtarake” ata ishin të autorizuar për vetëmbrojtje.¹¹⁹³

488. Si element plotësues i rrjedhës së urdhrave me kah nga lart-poshtë në hierarkinë komanduese ekzistonte një sistem raportimi në kahun e kundërt i cili përfundonte në Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë. Udhëzuesi i UJ-së mbi Komandën dhe Kontrollin kërkonte që rrjedha e informacionit midis komandantëve eprorë dhe vartës të ishte e vazhdueshme.¹¹⁹⁴ Përgjithësisht sistemi raportues për forcat e UJ-së në Kosovë funksiononte si vijon. Brigadat që kryenin operacione në terren, i paraqisnin Komandës së Korpusit të Prishtinës raporte ditore në lidhje me veprimet e armikut, rezultatet e luftimit dhe problemet me njësitë dhe

¹¹⁸⁷ *Shih p.sh.*, P1479 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë në lidhje me Vullnetarët, 7 prill 1999), f. 3; P1488 (Urdhër për rivënien e forcave të MPB-së në varësi të komandantëve ushtarakë dhe të marinës luftarake, 18 prill 1999), f. 1–2; dhe P1920 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 29 maj 1999), f. 2; P1493 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë të UJ-së, 13 maj 1999), f. 2. Të gjitha këto urdhra janë nënshkruar nga Ojdaniqit si Shef i Shtabit të Komandës së Lartë. *Shih edhe* P1899 (Përmbledhje e personave të dënuar, 30 maj 1999), f. 2–3 (me vulën e administratës juridike të Shtabit të Komandës së lartë, urdhëruar nga Shefi i Komandës i Shtabit të Komandës së Lartë, dhe shpërndarë nga Shtabi i Komandës së Lartë); P1951 (Urdhër në lidhje me vizitën e delegacionit rus, 30 mars 1999), f. 1–2 (nënshkruar nga Ojdaniqit si Shef i Shtabit të Komandës së Lartë, dhe dërguar nga Shtabi i Komandës së Lartë, mirëpo në vulë shkruhet përpiluar nga Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së).

¹¹⁸⁸ Millorad Obradoviq, T. 15081–15082 (6 shtator 2007); Velimir Obradoviq, T. 17368–17369 (22 tetor 2007).

¹¹⁸⁹ Millorad Obradoviq, T. 15080–15081 (6 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 15. *Shih edhe* Velimir Obradoviq, T. 17369–17370 (22 tetor 2007).

¹¹⁹⁰ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 74–76; *shih edhe* Tomisllav Mlladenoviq, T. 17591–17593 (25 tetor 2007); Kërsman Jelliq, T. 18957, 18960 (23 nëntor 2007); Mihajlo Gergar, T. 21487–21488 (31 janar 2008); 5D1329 (Vendim hartografik i Brigadës së Blinduar 211).

¹¹⁹¹ Millan Gjakoviq, T. 26397–26398 (19 maj 2008).

¹¹⁹² P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 415–418.

¹¹⁹³ Branko Kërger, T. 16889 (4 tetor 2007).

¹¹⁹⁴ P1041 (Udhëzues për Komandë dhe Kontroll), f. 63.

territorin.¹¹⁹⁵ Më tej këto raporte përfshiheshin në një raport të vetëm i cili i përcillej më lart Komandës së Armatës së Tretë. Komanda e Armatës së Tretë bënte një përmbledhje të raporteve të marra dhe i paraqiste Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë raportin e saj. Së fundi Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë përmbledhonte raportet e Armatave të ndryshme dhe ua përcillte ndër të tjerë, Kryekomandantit, shefit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë dhe ministrit federal të Mbrojtjes në formën e raporteve ditore për luftimet.¹¹⁹⁶

489. Ekzistojnë prova se para dhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s shefi i Shtabit të Përgjithshëm kërkonte që raportet prej disa njësive vartëse t'i dërgoheshin drejtpërsëdrejti Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë. Për shembull, pas incidentit në Reçak në janar 1999, Ojdaniqi urdhëroi që Korpusi i Prishtinës t'i paraqiste raporte ditore veç atyre që merrte prej Armatës së Tretë.¹¹⁹⁷ Në shkurt Ojdaniqi urdhëroi një raport të posaçëm drejtpërsëdrejti prej Korpusit të Prishtinës në lidhje me një incident në Suharekë.¹¹⁹⁸ Më vonë gjatë fushatës së NATO-s, Ojdaniqi sërish kërkoi që Korpusi i Prishtinës t'i dërgonte raporte si Komandës së Armatës së Tretë, po ashtu edhe Shtabit të Komandës së Lartë.¹¹⁹⁹ Llazareviqi dëshmoi se kjo praktikë vazhdoi prej 12 prillit deri në fund të konfliktit.¹²⁰⁰

490. Marrja dhe përpilimi i raporteve ditore të luftimit për shpërndarje kryhej prej një Ekipi të Gatishmërisë Operative.¹²⁰¹ Bazuar në këtë informacion u krijua një regjistër i përhershëm i njohur si “ditar lufte”.¹²⁰² Në qoftë se një raport prej Armatës së Tretë merrej shumë vonë dhe nuk mund të përmbledhej, atëherë ai përcillej në formën e plotë.¹²⁰³

491. Ekipi i Gatishmërisë Operative i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së lartë mbështetej prej Qendrës Operative të Administratës së Parë të Seksionit Operativ dhe Administrativ që funksiononte 24 orë në ditë dhe nëpërmjet linjave telefonike të siguruara dhe të

¹¹⁹⁵ Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 14; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para 15–18, T. 8659 (18 janar 2007). Kur njësitë vartëse që vepronin në terren, sulmoheshin dhe për pasojë reagonin pa patur urdhra konkrete sikundër u përmend më sipër, kjo gjithmonë u raportojë niveleve me të larta të hierarkisë komanduese. Branko Kërga, T. 16888–16889 (4 tetor 2007).

¹¹⁹⁶ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 15–18, T. 8659 (18 janar 2007); Millorad Obradoviç, T. 15016 (5 shtator 2007); Branko Gajiq, 3D1084 (deklaratë dëshmitari me datë 8 gusht 2007), para. 146.

¹¹⁹⁷ P939 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 21 janarin 1999), f. 31; Millorad Obradoviç, T. 15016 (5 shtator 2007).

¹¹⁹⁸ 5D251 (Raport i Korpusit të Prishtinës mbi Përleshjet e Armatosura, 23 shkurt 1999); Vladimir Llazareviq, T. 17939 (8 nëntor 2007).

¹¹⁹⁹ Vladimir Llazareviq, T. 18156 (13 nëntor 2007), T. 18782 (22 nëntor 2007). Urdhrit të mëparshëm drejtuar Korpusit të Prishtinës për të dërguar raporte duhet t'i ketë mbaruar afati dikur para ose gjatë sulmit të NATO-s.

¹²⁰⁰ Vladimir Llazareviq, T. 18637 (20 nëntor 2007).

¹²⁰¹ Stanisha Ivkoviç, 3D1117 (deklaratë dëshmitari me datë 20 gusht 2007), para. 6–8; Gjorgje Qurçin, 3D1121 (deklaratë dëshmitari me datë 24 gusht 2007), para. 25–26.

¹²⁰² Vllade Nonkoviç, T. 16216–16217 (24 shtator 2007).

pasiguruara lidhej me të tëra njësitë në vartësi të drejtpërdrejtë të armatave, me shërbimet e specializuara dhe më vonë në konflikt, me komandat e korpuseve.¹²⁰⁴ Veç marrjes së raporteve nga organet vartëse, Shtabi i Përgjithshëm/Shtabi i Komandës së Lartë mblidhte të dhëna nëpërmjet dërgimit të ekipeve për kontroll dhe dhënie udhëzimesh në njësitë e UJ-së në terren.¹²⁰⁵

492. Oficerët e sigurimit të caktuar në njësitë ushtarake dhe njësitë e policisë ushtarake kishin detyrime paralele raportimi, nëpërmjet linjës së rregullt të raportimit dhe nëpërmjet raporteve të veçanta për Administratën e Sigurimit. Raportet e kategorisë së parë ishin pjesë e raporteve të përgjithshme për luftimet e njërive ku ata ishin caktuar. Rrjedhimisht brenda Armatës së Tretë, Sasha Antiq, shefi i degës së sigurimit ndihmonte në përgatitjen e pjesës së raportit të përgjithshëm luftarak në lidhje me çështje të sigurimit, që i dërgohej Shtabit të Komandës së Lartë.¹²⁰⁶ Raportet e veçanta prej oficerëve të sigurimit në njësi të ndryshme për Administratën e Sigurimit, përfshiheshin në një raport të vetëm prej Administratës së Sigurimit, raport që u shpërndahej anëtarëve të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹²⁰⁷ Struktura të ngjashme të raportimit paralel ekzistonin për të gjithë ndihmëskomandantët specialistë të caktuar në nivele poshtë Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë si p.sh. Sektori i Logjistikës,¹²⁰⁸ dhe personeli i sistemit të drejtësisë ushtarake, të cilës i raportonin Administratës Juridike.¹²⁰⁹ Mirëpo këto procese të raportimit paralel ndryshuan gjatë bombardimit të NATO-s siç përshkruhet më poshtë. Veç informacionit në raportet e luftimit, ndihmëskomandantët, veçanërisht për Udhëheqje Morale, Sigurimin, Zbulimin, Komunikacionin dhe Logjistikën, në ndonjë rast i dërgonin raportet nëpërmjet linjës së tyre të specializuar funksionale komanduese në Sektorët dhe Administratat përkatëse të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹²¹⁰

493. Pas valës së parë të bombardimit të NATO-s, në një raport luftimesh të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë raportohej se pavarësisht dëmeve, sistemi komunikues i

¹²⁰³ Gjorgje Qurçin, T. 16955 (5 tetor 2007).

¹²⁰⁴ Stanisha Ivkoviq, 3D1117 (deklaratë dëshmitari me datë 20 gusht 2007), para. 5–6, T. 16521 (27 shtator 2007).

¹²⁰⁵ Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 12; Gjorgje Qurçini, 3D1121 (deklaratë dëshmitari me datë 24 gusht 2007), para. 40–41; Lubomir Saviq, 5D1392 (deklaratë dëshmitari me datë 27 dhjetor 2007), para. 6.

¹²⁰⁶ Lubisha Stojimiroviq, T. 17675–17677 (26 tetor 2007), 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 46. Për shembull, Komanda e Armatës së Tretë së Bashku me Komandën e Korpusit të Prishtinës ishin ngarkuar me operacionin e kundërzbulimit kundër UÇK-së. Administrata e Sigurimit e Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë të UJ-së ishte e ngarkuar me mbikëqyrjen e zbatimit të planit nëpërmjet raporteve të luftimit dërguar drejtpërsëdrejti organeve të sigurimit të Komandës së Armatës së Tretë dhe asaj të Korpusit të Prishtinës. Rrjedhimisht Komanda e Tretë kishte vetëm detyrim të raportonte drejtpërsëdrejti Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë në rrethana të jashtëzakonshme. Geza Farkash, T. 16362–16363 (25 shtator 2007); Branko Gajiq, 3D1084 (deklaratë dëshmitari me datë 8 gusht 2007), para. 13.

¹²⁰⁷ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 15–18, T. 8661 (18 janar 2007).

¹²⁰⁸ Stanimir Radosavleviq, T. 17456–17457 (23 tetor 2007).

¹²⁰⁹ Stanimir Radosavleviq, T. 17456–17457 (23 tetor 2007).

¹²¹⁰ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 46.

UJ-së ishte funksionues.¹²¹¹ Miodrag Simiqi dëshmoi se gjatë konfliktit Shtabi i Komandës së Lartë pati “komunikim komandues të pandërprerë” me komandat e njësisve vartëse që kryenin operacione në Kosovë.¹²¹² Velimir Obradoviç, i cili ishte shef i Qendrës Operative të Komandës së Armatës së Tretë dëshmoi se komunikimi funksionoi si duhej gjatë tërë luftës.¹²¹³ Bozhidar Deliqi, komandant i atëhershëm i Brigadës së Motorizuar 549 dëshmoi se sistemi komandues funksionoi si zakonisht gjatë asaj kohe, por komunikimi u pengua për shkak të bombardimit të qendrave komunikuese prej NATO-s.¹²¹⁴ Miodrag Jankoviç i cili ishte shef i Departamentit të Komunikimit të Armatës së Tretë tha se gjatë fushatës ajrore të NATO-s u ruajt komunikimi midis Armatës së Tretë dhe Shtabit të Komandës së Lartë, duke mundësuar marrjen e raporteve dhe përcjelljen e urdhrave, mirëpo u hasën vështirësi në komunikimin midis niveleve më të ulëta si p.sh. prej “komandës së korpusit për komandat e brigadave, prej brigadës në batalion, prej batalionit në kompani” dhe kështu me radhë.¹²¹⁵ Vështirësitë e hasura në nivelet më të ulëta komanduese u konfirmuan dhe përshkruan nga dëshmitarë të tjerë.¹²¹⁶

494. Mirëpo edhe në rastin e çrregullimit të komunikimit elektronik, për komandimin e njësisve të UJ-së në Kosovë ishin në dispozicion edhe mjete të tjera dhe komandat vartëse vazhduan të merrnin urdhra dhe të dërgonin raporte luftimi nëpërmjet sistemit të hierarkisë komanduese. Millosh Mandiqi dëshmoi se komunikimi kabllor dhe me korrierë ishte vënë në funksionim me njësitë vartëse, mirëpo “komunikimi kabllor ndërpritej vazhdimisht prej terroristëve”.¹²¹⁷ Llazareviç në intervistën e tij me Prokurorinë pohoi se për shkak të bombardimit të NATO-s, në përgatitjen e raporteve me shkrim në nivelet më të ulëta komanduese u hasën vështirësi.¹²¹⁸ Kur u pyet si e merrte informacionin e mjaftueshëm në lidhje me veprimtarinë e Korpusit të Prishtinës, për të vendosur në lidhje me mënyrën e dislokimit të këtyre njësisve në detyra të ardhshme, ai shpjegoi se “shumë shpesh” ai vizitonte njësitë në terren dhe këtë e bënte shpesh së bashku me komandantin e Armatës së Tretë.¹²¹⁹ Lubomir Saviç, zëvendësshef i Degës Stërvitore të Korpusit

¹²¹¹ 3D801 (Raport Luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 27 mars 1999), f. 5.

¹²¹² Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë dëshmitari me datë 15 gusht 2007), para. 11; *shih edhe* 3D813 (Raport Luftimi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 8 prill 1999), f. 8; 3D814 (Raport Luftimi i Shtabit të Komandës së Lartë, 9 prill 1999), f. 8.

¹²¹³ Velimir Obradoviç, T. 17360–17361 (22 tetor 2007).

¹²¹⁴ Bozhidar Deliq, T. 19289 (29 nëntor 2007).

¹²¹⁵ Miodrag Jankoviç, T. 17550–17558 (25 tetor 2007); Miodrag Jankoviç, 4D504 (deklaratë dëshmitari me datë 1 tetor 2007), para. 28–52; Lubomir Angjelkoviç, T. 16402–16403 (26 shtator 2007).

¹²¹⁶ Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari me datë 8 janar 2008), para. 23, 25; Lubomir Saviç, 5D1392 (deklaratë dëshmitari me datë 27 dhjetor 2007), para. 12; Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklaratë dëshmitari me datë 24 dhjetor 2007), para. 27; *shih edhe* P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 81–82.

¹²¹⁷ Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari me datë 8 janar 2008), para. 23.

¹²¹⁸ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 81–82.

¹²¹⁹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 84–85.

të Prishtinës konfirmoi se oficerë të lartë të Korpusit të Prishtinës e vizituan shpesh njësinë e tij “për kontroll dhe dhënie ndihme”.¹²²⁰

e. Sistemi i drejtësisë ushtarake të UJ-së

495. Dhoma dëgjoi nga disa dëshmitarë për sistemin funksionues brenda UJ-së në vitet 1998 dhe 1999 për hetimin dhe procedimin penal të personelit të UJ-së që dyshoheshin për kryerje të veprave penale. Provat në lidhje me tërë strukturën e sistemit të drejtësisë ushtarake nuk kundërshtohen prej palëve. Mirëpo pikë kundërshtish të konsiderueshme midis Prokurorisë dhe Mbrojtjes së Pavkoviqit, Ojdaniqit dhe Llazareviqit, mbetet funksionimi në praktikë i sistemit gjatë bombardimit të NATO-s dhe nëse u manipulua apo u keqpërdor.

496. Prokuroria paraqiti dëshmi nëpërmjet një dëshmitari kryesor në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë ushtarake, Llakiq Gjoroviq ish-prokuror ushtarak i atashuar në Qarkun Ushtarak të Beogradit prej datës 24 mars deri më 20 maj 1999, dhe prej asaj kohe deri më 5 qershor 1999 i atashuar në Qarkun Ushtarak të Prishtinës. Pas kësaj periudhe ai u kthye në Gjykatën e Lartë Ushtarake në Beograd, ku kishte funksionin e paraluftës si ndihmëspecialist deri më 1 mars 2000.¹²²¹ Dëshmia e Gjoroviqit në lidhje me mënyrën e strukturimit të sistemit dhe të funksionimit të tij të supozuar përgjithësisht nuk e kundërshtua nga Mbrojtja dhe në fakt u konfirmua nga disa dëshmitarë të paraqitur prej Mbrojtjes.¹²²² Mirëpo ai shprehu një sërë pretendimesh mbi mënyrën e shpërdorimit të sistemit në 1999, të cilat Mbrojtja u përpoq t'i përgënjeshtrohte nëpërmjet dëshmitarëve të saj për aspekte të veçanta të dëshmisë së tij dhe përgjithësisht për besueshmërinë e tij.

497. Mbrojtja u orvat ta dëmtonte besueshmërinë e Gjoroviqit nëpërmjet paraqitjes së raporteve zyrtare konfidenciale në lidhje me sjelljen e tij.¹²²³ Këto raporte përgjithësisht janë të natyrës konkluduese. Dhoma nuk është në gjendje të shqyrtojë materialin mbi bazën e të cilët janë përpiluar këto raporte anonime, por gjykon se përmbajtja e tyre nuk e cenon aspak besueshmërinë ose saktësinë e Gjoroviqit si dëshmitar në këtë proces. Dhoma thekson veçanërisht se në dy prej tri

¹²²⁰ Lubomir Saviq, 5D1392 (deklaratë dëshmitari me datë 27 dhjetor 2007), para. 14.

¹²²¹ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 3.

¹²²² *Shih p.sh.*, Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 4–10; Radomir Mlladenoviq, T. 21247–21248 (28 janar 2008); Geza Farkash, T. 16308–16309 (25 shtator 2006).

¹²²³ 3D1137 (Njoftim i Këshillit Kombëtar serb për Bashkëpunim, 25 shkurt 2008) (e mbyllur me vulë); 3D1079 (Letër e Ministrisë së Mbrojtjes së Serbisë, 6 shkurt 2007) (e mbyllur me vulë). *Shih* Vendim mbi Kërkesën e Ojdaniqit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 25 tetor 2007; Vendim mbi Mocionin e Përsëritur të Ojdaniqit për Pranimin e Dokumenteve 3D1080, 3D1081 dhe 3D1137 në Sallën Gjyqësore, 3 prill 2008 (konfidencial).

vlerësimeve zyrtare të ecursisë profesionale të Gjoroviqit në periudha të ndryshme midis 1995 dhe 2004, ai u vlerësua “shkëlqyeshëm” dhe në të tretin “shumë mirë”.¹²²⁴

498. Megjithëse ka prova se Gjoroviqi kishte temperament disi të paqëndrueshëm, Dhoma gjykon se jo domosdoshmërisht kjo cenon besueshmërinë e tij si dëshmitar.¹²²⁵ Sjellja e tij shfaq pavarësi mendimi dhe karakteri dhe shprehja e hapët e pikëpamjeve të tij për disa probleme të personelit brenda UJ-së duket se ka qenë shkaku i uljes së tij në detyrë në shërbimin juridik të UJ-së në fund të vitit 2003.¹²²⁶

499. Në vitin 2000 kundër Gjoroviqit nisi një hetim disiplinor për refuzim të zbatimit të urdhrave.¹²²⁷ Ky hetim është tërësisht i dokumentuar, prej nisjes deri në vendimin e Ojdaniqit për nxjerrjen e Gjoroviqit para Gjykatës Ushtarake Disiplinore.¹²²⁸ Në prova përfshihet edhe një notë zyrtare e Gjoroviqit ku ai shpjegon arsyen e mosbindjes ndaj urdhrave në fjalë.¹²²⁹ Pas shqyrtimit të dokumenteve të ndryshme në lidhje me këtë çështje, Dhoma gjykon se ato nuk çenojnë besueshmërinë e tij si dëshmitar. Në fakt ato dëshmojnë sërish për pavarësinë e mendimit dhe natyrën e tij të hapët.

500. Më poshtë do të diskutohet sa herë të jetë e nevojshme nëse dëshmia e Gjoroviqit është e saktë në lidhje me mënyrën e funksionimit të sistemit të drejtësisë ushtarake gjatë fushatës së NATO-s dhe shembujt konkretë të shpërdorimit të sistemit cituar prej tij.

i. Struktura e sistemit të drejtësisë ushtarake

501. Neni 138 i Kushtetutës së RFJ-së përcaktonte se “gjykatat dhe prokurorët ushtarakë krijohen në bazë të ligjit federal”.¹²³⁰ Kushtetuta gjithashtu përcaktonte se gjykatat ushtarake “janë të pavarura dhe gjykojnë në bazë të legjislacionit federal”.¹²³¹ Rregullat organizative dhe procedurale të gjykatave ushtarake pasqyroheshin në Dekretin mbi Organizimin dhe Punën e

¹²²⁴ P2771 (Vlerësim Personal i Llakiq Gjoroviqit, 24 nëntor 1998), f. 4; P2773 (Vlerësim Personal i Llakiq Gjoroviqit, 1 mars 2000), f. 3; P2774 (Vlerësim Personal i Llakiq Gjoroviqit, 1 mars 2004), f. 2.

¹²²⁵ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 31; Millosh Spasojeviq, 3D532 (deklaratë dëshmitari me datë 9 janar 2007), para. 6; Stanimir Radosavleviq, T. 17462–17464 (23 tetor 2007); Gjura Bllagojeviq, T. 21555 (1 shkurt 2008).

¹²²⁶ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 5–7, 9–20, 40–45; *gjithsesi shih* Branko Kërqa, T. 16838–16839 (4 tetor 2007).

¹²²⁷ P2743 (Vendim për Nisjen e Hetimit Disiplinor kundër Llakiq Gjoroviqit, 26 shtator 2000), f. 1.

¹²²⁸ P2743 (Vendim për Nisjen e Hetimit Disiplinor kundër Llakiq Gjoroviqit, 26 shtator 2000); P2742 (Raport i Hetimit Disiplinor në lidhje me Llakiq “Qoroviq”, 9 tetor 2000); P2741 (Letër shoqëruese bashkëngjitur dosjes disiplinore të Llakiq “Qoroviqit”, 11 tetor 2000).

¹²²⁹ P2745 (Kopje e shtypur e shpjegimit të Llakiq Gjoroviqit për mosbindje ndaj urdhrave, 1 shtator 2000).

¹²³⁰ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 138.

¹²³¹ 1D139 (Kushtetuta e RFJ-së, 1992), neni 138; Llakiq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 1.

Prokurorit Ushtarak,¹²³² Ligjin për Gjykatat Ushtarake,¹²³³ Dekretin mbi Zbatimin e Kodit të Procedurës Penale gjatë Gjendjes së Luftës,¹²³⁴ dhe Ligjin për Prokurorin Ushtarak.¹²³⁵ Dhoma i ka analizuar të tëra këto dispozita ligjore gjatë nxjerrjes së konkluzioneve në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë ushtarake, por e gjykon të panevojshme t'i shtjellojë në hollësi.

502. Ligji për Gjykatat Ushtarake përcaktonte se gjykatat ushtarake do të gjykonin çështje për vepra penale të kryera nga ushtarakë, vepra penale konkrete që kishin lidhje me mbrojtjen dhe sigurinë e vendit kryer prej individëve të tjerë dhe mosmarrëveshjet lidhur me shërbimin në UJ.¹²³⁶ Gjykatat ushtarake mund të gjykonin civilë për disa krime të parashtruara në Kodin Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë, krime kundër pronës në qoftë se objekt i krimit ishte një pajisje e përdorur për mbrojtjen e vendit dhe për krime të kryera në bashkëpunim me ushtarakë.¹²³⁷

503. Gjykatat ushtarake nuk kishin juridiksion ndaj oficerëve të MPB-së.¹²³⁸ Personeli i mbrojtjes civile dhe ruajtjes civile konsiderohej personel joushtarak në kuadër të juridksionit të gjykatës ushtarake.¹²³⁹ Kryetari, gjykatësit dhe gjykatësit anëtarë të jurive të gjykatave ushtarake të shkallës së parë emëroheshin prej Presidentit të RFJ-së me propozim të ministrit federal të Mbrojtjes.¹²⁴⁰

504. Prokurori ushtarak procedonte penalisht autorët e krimeve të juridksionit të gjykatave ushtarake,¹²⁴¹ dhe ishte organ i pavarur shtetëror.¹²⁴² Prokurorët ushtarakë të shkallës së parë ishin caktuar në çdo gjykatë ushtarake të shkallës së parë dhe kryeprokurori ushtarak ishte caktuar në gjykatën e lartë ushtarake.¹²⁴³

¹²³² 1D228 (Dekret mbi Strukturën dhe Veprimtarinë e Prokurorit Ushtarak gjatë Gjendjes së Luftës).

¹²³³ P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake).

¹²³⁴ 1D301 (Dekret mbi Zbatimin e Ligjit të Procedurës Penale gjatë Gjendjes së Luftës).

¹²³⁵ P1309 (Ligji për Prokurorin Ushtarak); *shih edhe* Radomir Gojoviq, T. 16657 (2 tetor 2007).

¹²³⁶ P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 1; Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 20 shtator 2007), para. 9; Llakiq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 14–19.

¹²³⁷ P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 10; *shih edhe* Stanimir Radosavleviq, T. 17489–17490 (23 tetor 2007).

¹²³⁸ Stanimir Radosavleviq, T. 17483 (23 tetor 2007); *shih edhe* Aleksandar Vasilevq, T. 8745 (19 janar 2007); Radomir Mlladenoviq, T. 21295 (29 janar 2008).

¹²³⁹ Radomir Mlladenoviq, T. 21295 (29 janar 2008).

¹²⁴⁰ P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 26.

¹²⁴¹ P1309 (Ligji për Prokurorin Ushtarak), neni 1; Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 3.

¹²⁴² Stanimir Radosavleviq, 4D502 (Radosavleviq 29 shtator 2007), para. 3. Dispozitat ligjore në lidhje me Prokurorin ushtarak përfshiheshin në Ligjin për Prokurorin Ushtarak dhe në Dekretin mbi Strukturën dhe Veprimtarinë e Prokurorit Ushtarak Gjatë Gjendjes së Luftës; P1309 (Ligji për Prokurorin Ushtarak); 1D228 (Dekret mbi Strukturën dhe Veprimtarinë e Prokurorit Ushtarak gjatë Gjendjes së Luftës, 13 shkurt 1998); *shih edhe* Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 7.

¹²⁴³ P1309 (Ligji për Prokurorin Ushtarak), neni 2.

505. Neni 6 i Ligjit për Prokurorët Ushtarakë i autorizonte prokurorët: (a) të vepronin për zbulimin e krimeve dhe gjetjen e autorëve të tyre (b) të kërkonin hetime, (c) të paraqisnin aktakuza ose mocione akuzuese dhe t'i paraqisnin në gjykatën ushtarake kompetente, dhe (d) të përdornin mekanizmat e rregullt dhe të jashtëzakonshëm ligjorë kundër vendimeve të gjykatave ushtarake.¹²⁴⁴ Prokurorët ushtarakë dhe zëvendësit e tyre emëroheshin ose liroheshin prej detyrës së tyre nga Presidenti i RFJ-së me propozim të ministrit federal të Mbrojtjes,¹²⁴⁵ dhe mund të hiqeshin vetëm për arsye konkrete.¹²⁴⁶

506. Gjykatat dhe prokurorët ushtarakë e shkallës së parë që funksiononin në kohë paqeje e ndërprisnin veprimtarinë në kohë lufte.¹²⁴⁷ Në vend të tyre caktoheshin gjykata ushtarake dhe prokurorë ushtarakë të shkallës së parë në komandat e qarqeve ushtarake, divizioneve, korpuseve, armatave. Komandës së Forcës dhe Mbrojtjes Ajrore dhe Komandës së Marinës Luftarake. Gjykata e lartë ushtarake dhe kryeprokurori ushtarak vazhdonin punën në selinë e Shtabit të Komandës së Lartë, kurse në komandat e armatave krijoheshin degët e prokurorisë ushtarake.¹²⁴⁸ Gjatë kohës së luftës, Presidenti i RFJ-së autorizonte të tëra emërimet dhe heqjet nga detyra të prokurorëve ushtarakë dhe zëvendësve të tyre me rekomandim të shefit të Shtabit të Komandës së Lartë.¹²⁴⁹ Gjykatat ushtarake të shkallës së parë në kohë lufte kishin juridiksion për proceset gjyqësore të individëve në njësitë apo komandat ku ishin caktuar.¹²⁵⁰

507. Kur Stanimir Radosavleviqi, zëvendësprokuror ushtarak në zyrën e kryeprokurorit ushtarak në Armatën e Tretë në Nish, u emërua në fund të marsit 1999, prokurorët ushtarakë e pesë gjykatave ushtarake të shkallës së parë të juridiksionit të tij i raportonin atij çdo ditë me telefon.¹²⁵¹ Më tej raportet i përcilleshin kryeprokurorit ushtarak dhe më tej ministrit të Mbrojtjes dhe Presidentit të RFJ-së.¹²⁵² Radosavleviqi dëshmoi se ai përgjigjej para kryeprokurorit ushtarak të atashuar në Shtabin e Komandës së lartë në Beograd, gjeneralit Svetomir Obrençeviq, dhe se

¹²⁴⁴ P1309 (Ligji për Prokurorin Ushtarak), neni 6. Një dekret që ndryshoi Ligjin për Prokurorin Ushtarak në 1998, u ofroi prokurorëve shtetërorë federalë mundësinë për “procedimin penal ose marrjen e drejtpërdrejtë” të çështjeve për krimet kundër njerëzimit dhe të drejtës ndërkombëtare gjatë gjendjes së luftës. 1D301 (Dekret mbi Zbatimin e Ligjit të Procedurës Penale gjatë Gjendjes së Luftës, 4 prill 1999), neni 3; Llakuq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 36–37.

¹²⁴⁵ P1309 (Ligji për Prokurorin Ushtarak), neni 27.

¹²⁴⁶ P1309 (Ligji për Prokurorin Ushtarak), nenet 33–35.

¹²⁴⁷ P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 74; Llakuq Gjoroviq, T. 11430–11431 (12 mars 2007).

¹²⁴⁸ P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 74; 1D228 (Dekret mbi Strukturën dhe Veprimtarinë e Prokurorit Ushtarak gjatë Gjendjes së Luftës, 13 shkurt 1998), neni 1.

¹²⁴⁹ Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 6.

¹²⁵⁰ 1D228 (Dekret mbi Strukturën dhe Veprimtarinë e Prokurorit Ushtarak gjatë Gjendjes së Luftës, 13 shkurt 1998), neni 4.

¹²⁵¹ Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 14.

¹²⁵² Llakuq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 39.

gjithashtu ai kishte detyrë t'i raportonte edhe kreut të degës juridike të Shtabit të Komandës së Lartë, Gjeneralit Gojoviq.¹²⁵³

ii. Procedura e diktimit, hetimit dhe procedimit të krimeve në UJ

508. Ligji për Gjykatat Ushtarake pohonte se detyrat policore në lidhje me krime të juridiksionit të gjykatave civile kryheshin prej organeve të sigurimit ushtarak dhe të policisë ushtarake në lidhje me krime të juridiksionit të gjykatave ushtarake, të barasvlershme me detyrat dhe kompetencat e policisë në lidhje me krimet.¹²⁵⁴ Gjoroviqi dëshmoi se funksioni i organeve të sigurimit ishte i barasvlershëm me policinë në një sistem civil.¹²⁵⁵

509. Gjoroviqi dëshmoi se zakonisht ishte siguri ushtarak që kryente arrestime sepse ata ishin të stërvitur dhe pajisur për këtë qëllim.¹²⁵⁶ Bazuar në nenin 64 të Ligjit për Gjykatat Ushtarake oficeri në postin e komandantit të kompanisë ose më lart, ose zyrtari i autorizuar i organeve të punëve të brendshme ose të një organi të sigurimit të UJ-së ose MPB-së, mund të arrestonte një ushtarak të kapur duke kryer krim *ex officio*, në rast se ekzistonte rreziku i arratisjes së tij, ose në qoftë se ai individ përbënte rrezik për jetën e të tjerëve ose për objekte të rëndësishme.¹²⁵⁷

510. Në qoftë se oficeri i sigurimit vihej në dijeni të një krimi të rëndë të kryer brenda njësisë ku ishte atashuar, ai ishte i detyruar t'i raportonte komandantit të asaj njësie dhe eprorit të tij të sigurimit.¹²⁵⁸ Në qoftë se komandanti i njësisë ishte implikuar në krim, atëherë oficeri i sigurimit i raportonte organit të sigurimit atashuar korpusit, i cili informonte komandantin e korpusit për krimin. Nga ana e tij komandanti i korpusit thërriste komandantin e njësisë në raport dhe në qoftë se krimi ishte i rëndë, vinte në dijeni organet ligjore që nisin hetimin e plotë.¹²⁵⁹

511. Vasileviqi deklaroi se detyrimi i kallëzimit të krimeve nuk i takonte vetëm sigurimit të UJ-së, por çdo oficeri, veçanërisht ata të cilët vepronin në atë sektor ku ishin kryer këto krime.¹²⁶⁰ Neni 61 i Ligjit për Gjykatat Ushtarake impononte detyrim mbi çdo oficer të UJ-së "që të marrë masa për parandalimin e fshehjes apo arratisjes së autorit të krimit që procedohet *ex officio*, të ruajë gjurmët

¹²⁵³ Stanimir Radosavleviq, T. 17455–17457 (23 tetor 2007).

¹²⁵⁴ Kompetencat dhe detyrat e policisë civile parashtraheshin në Ligjin e Procedurës Penale. Policia ushtarake kishte të njëjtat kompetenca dhe detyra në lidhje me krime që i përkisnin juridiksionit të gjykatave ushtarake; P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 52; Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 9. *Shih edhe* P984 (Ligji I RFJ-së për UJ-në), neni 30.

¹²⁵⁵ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 9.

¹²⁵⁶ Llakiq Gjoroviq, T. 11662 (14 mars 2007).

¹²⁵⁷ P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 64.

¹²⁵⁸ Aleksandar Vasileviq, T. 8665 (18 janar 2007).

¹²⁵⁹ Aleksandar Vasileviq, T. 8666 (18 janar 2007).

¹²⁶⁰ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 51; *shih edhe* Radomir Mlladenoviq, T. 21274, 21300 (29 janar 2008); Lubisha Stojimiroviq, T. 17677–17678 (26 tetor 2007).

e krimit dhe objektet që mund të përdoren si prova dhe të mbledhë çdo të dhënë që mund të vlejë për procedimin e suksesshëm.”¹²⁶¹ Për më tepër kërkohet që oficeri të informonte prokurorin ushtarak, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet një eprori, për veprimet e tij.¹²⁶² Radomir Mlladenoviçi i cili ishte kryetar i Gjykatës Ushtarake të Korpusit të Prishtinës gjatë bombardimit të NATO-s, dëshmoi se pas kallëzimit të një krimi, oficeri nuk kishte detyrime të tjera lidhur me procedimin e krimit prej sistemit të drejtësisë ushtarake dhe se ishte e papërshtatshme që oficeri të hetonte më tej në lidhje me trajtimin e kallëzimit.¹²⁶³

512. Vasileviçi dëshmoi se organet e sigurimit të Korpusit të Prishtinës në Kosovë kishin detyrim t’ia raportonin të dhënat për krimet komandantit të Korpusit të Prishtinës, i cili nga ana e tij e përcillte këtë raport më lart në hierarkinë komanduese te komandanti i Armatës së Tretë, dhe më lart shefit të Shtabit të Komandës së Lartë.¹²⁶⁴ Po ashtu Radojko Stefanoviçi i cili ishte Shef i Degës Stërvitore dhe të Operacioneve në Komandën e Korpusit të Prishtinës, dëshmoi se çdo anëtar i UJ-së ishte i detyruar t’ua kallëzonte krimin e kryer eprorit dhe organit përkatës të sigurimit.¹²⁶⁵ Vasileviçi gjithashtu dëshmoi se në rrethana kur MPB-ja kishte të dhëna se kryerja e një krimi i përkiste juridiksionit ushtarak, ata ishin të detyruar të informonin autoritetet ushtarake, po ashtu si UJ-ja ishte e detyruar të informonte MPB-në për incidente të juridiksionit të tyre.¹²⁶⁶

513. Kur prokurori ushtarak merrte kallëzim penal për veprimtari kriminale, i takonte atij të vendoste për nisjen e procedimit penal, të kërkonte të dhëna shtesë prej policisë ushtarake, të ngrinte menjëherë aktakuzë kundër të dyshuarit ose të hidhte poshtë kallëzimin penal.¹²⁶⁷ Gjatë gjendjes së luftës e cila filloi më 24 mars 1999, në rastet urgjente gjykatësit u autorizuan të kryenin hetime dhe veprime hetimore edhe pa kërkesë të prokurorit.¹²⁶⁸

514. Gjykatësi hetues mund të mbyllte çështjen vetëm me propozim të prokurorit ushtarak. Radomir Gojoviçi shpjegoi se prokurori kishte kompetencë të mos paraqiste aktakuzë apo të mos procedonte penalisht dhe rrjedhimisht vetëm ai kishte kompetencë për mbylljen e çështjes.

¹²⁶¹ P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 61; *shih edhe* Radomir Gojoviçi, T. 16706 (2 tetor 2007).

¹²⁶² P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 61.

¹²⁶³ Radomir Mlladenoviçi, T. 21247 (28 janar 2008).

¹²⁶⁴ Aleksandar Vasileviçi, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 52. *Shih edhe* Lubisha Stojimiroviçi, T. 17681 (26 tetor 2007).

¹²⁶⁵ Radojko Stefanoviçi, T. 21728 (6 shkurt 2008). *Shih edhe* Millosh Mandiq, T. 20924 (23 janar 2008); Aleksandar Vasileviçi, T. 8666 (18 janar 2007), *krahaso* Radomir Gojoviçi, T. 16706 (2 tetor 2007).

¹²⁶⁶ Aleksandar Vasileviçi, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 52. *Shih* Stanimir Radosavleviçi, T. 17477–17478 (23 tetor 2007); Radomir Gojoviçi, T. 16765 (3 tetor 2007).

¹²⁶⁷ Stanimir Radosavleviçi, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 18.

¹²⁶⁸ 1D301 (Dekret mbi Zbatimin e Ligjit të Procedurës Penale gjatë Gjendjes së Luftës, 4 prill 1999), neni 6(2).

Gjithashtu ai dëshmoi se në qoftë se çështja mbyllet dhe më vonë prokurori merrte prova të reja, ai mund ta rihapte çështjen.¹²⁶⁹

515. Me heqjen e gjendjes së luftës, një sërë gjykatash ushtarake të kohës së luftës u shpërndanë.¹²⁷⁰ Prokurorët ushtarakë të shkallës së parë për kohën e luftës i përcollën të tërë çështjet e papërfunduara penale te prokurorët dhe gjykatat ushtarake të shkallës së parë për kohën e paqes me juridiksion territorial mbi çështjen.¹²⁷¹ Rrjedhimisht në fund të qershorit 1999 gjykata ushtarake për kohë paqeje në Nish mori çështjet për Kosovën që do të mbeteshin në sistemin e drejtësisë ushtarake.¹²⁷²

516. Pas përfundimit të gjendjes së luftës gjykatat ushtarake vazhduan të kishin juridiksion mbi ushtarët dhe oficerët e rregullt të UJ-së të cilët mbetën në shërbim ose mbi ushtarët e çmobilizuar kundër të cilëve gjykatat ushtarake kishin konfirmuar aktakuza.¹²⁷³ Gjithsesi ushtarët rezervistë të UJ-së ishin subjekt i organeve proceduese ushtarake për aq kohë sa zgjati gjendja e luftës; pas mbarimit të gjendjes së luftës, në rast të mospërfundimit të çështjeve apo moskonfirmimit të aktakuzave, atëherë këto transferoheshin në sistemin e drejtësisë civile.¹²⁷⁴ Sipas Gjura Bllagojeviqit i cili ishte zëvendësprokuror ushtarak në komandën e Qarkut Ushtarak të Prishtinës në qershor 1999, gjykatave civile iu përcollën 300-400 çështje në përfundim të gjendjes së luftës.¹²⁷⁵ Mirëpo këto çështje iu transferuan gjykatave civile në pjesë të tjera të Serbisë për arsye se pas përfundimit të gjendjes së luftës, në Kosovë nuk ekzistonin institucione shtetërore funksionuese.¹²⁷⁶

517. Radomir Mlladenoviç dëshmoi se prej 24 marsit deri më 14 qershor 1999 u arrestuan mbi 300 individë prej gjykatës së atashuar në Komandën e Korpusit të Prishtinës. Pas luftës ata u udhëzuan t'i transferonin këta individë në objektin e burgimit në Nish. Mirëpo prej tyre u transferuan vetëm ata për të cilët gjykohej se duheshin mbajtur në paraburgim, numri i të cilëve shkonte afërsisht 70 vetë, kurse të burgosurit e tjerë u liruan.¹²⁷⁷

¹²⁶⁹ Radomir Gojoviç, T. 16760–16761 (3 tetor 2007).

¹²⁷⁰ Çështjet e papërfunduara iu dorëzuan gjykatës ushtarake rajonale përkatëse. Llakiq Gjoroviç, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), p. 27; *shih edhe* Geza Farkash, T. 16308–16309 (25 shtator 2007).

¹²⁷¹ ID228 (Dekret mbi Strukturën dhe Veprimtarinë e Prokurorit Ushtarak gjatë Gjendjes së Luftës, 13 shkurt 1998), neni 7; ID228 (Rregullorja e Procedurës së Funksionimit të Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 13 shkurt 1998), neni 7.

¹²⁷² Radomir Gojoviç, T. 16728–16730 (2 tetor 2007).

¹²⁷³ Aleksandar Vasileviç, T. 8747 (19 janar 2007); Radomir Gojoviç, T. 16689 (2 tetor 2007) (gjithashtu dëshmoi se këto raste ishin shumë të pakta).

¹²⁷⁴ Stanimir Radosavleviç, T. 17488 (23 tetor 2007), 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 21.

¹²⁷⁵ Gjura Bllagojeviç, T. 21560 (1 shkurt 2008).

¹²⁷⁶ Radomir Gojoviç, T. 16728 (2 tetor 2007).

¹²⁷⁷ Radomir Mlladenoviç, T. 21263 (29 janar 2008).

iii. *Legjislacioni përkatës*

518. Sistemi i drejtësisë ushtarake nuk kishte kod penal të veçantë; gjykatat ushtarake zbatonin kodet penale të RFJ-së dhe republikave të saj përbërëse për ushtarakët.¹²⁷⁸

519. Krimet e luftës kundër popullatës civile parashkruheshin prej nenit 142 të Kodit Penal të RFJ-së. Dënimi më i paktë për këto krime ishte pesë vjet burgim, kurse dënimi më i rëndë ishte me vdekje.¹²⁷⁹ Neni 38 i Kodit Penal të RFJ-së përcaktonte se dënimi me burgim nuk mund të jetë më shumë se 15 vjet, mirëpo alternativisht mund të jepej dënim me 20 vjet burgim për vepra penale për të cilat parashkruhej dënim me vdekje.¹²⁸⁰ Vrasja trajtohej prej nenit 47 të Kodit Penal të Serbisë për të cilën dënimi më i paktë ishte pesë vjet burgim dhe për vrasje në rrethana rënduese dhjetë vjet burgim ose dënim me vdekje.¹²⁸¹ Kushtetuta e RFJ-së e vitit 1992 anuloi dënimin me vdekje për shkelje të ndaluara prej Kodit Penal të RFJ-së. Në vitet ‘90 Gjykata Kushtetuese e Serbisë e deklaroi dënimin me vdekje jokushtetues, duke e përjashtuar prej proceseve të brendshme penale.¹²⁸²

520. Gojoviqi tha se vrasjet procedoheshin penalisht në bazë të nenit 142 kur eprori urdhëronte vartësin të kryente krimin. Kur eprori nuk ishte i implikuar, zakonisht prokurori vendoste të procedonte në bazë të nenit 47, si vrasje ose vrasje e shumëfishtë, e cila përballej me dënimin të rëndë.¹²⁸³

521. Grabitja dhe grabitja në rrethana rënduese e përkufizuar si grabitje me pasojë vdekjen e viktimës, trajtoheshin në nenet 168 dhe 169 të Kodit Penal të Serbisë. Dënimi më i rëndë për grabitjen në rrethana rënduese ishte dënimi me vdekje dhe dënimi më i paktë ishte dhjetë vjet.¹²⁸⁴ Dhuna trajtohej në nenet 53 dhe 54 të Kodit Penal të Serbisë në nëntitujt “Lëndim Trupor i Rëndë” dhe “Lëndim Trupor i Lehtë”. Kur viktima vdiste si pasojë e lëndimit, dënimi shkonte nga një deri në dymbëdhjetë vjet burgim.¹²⁸⁵

¹²⁷⁸ Llakiq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 7–8, 15. Dhoma ka dëgjuar dëshmi vetëm mbi zbatimin e Kodit Penal të Republikës së Serbisë në lidhje me ushtarakët, mirëpo teorikisht edhe Kodi Penal i Republikës së Malit të Zi ishte i zbatueshëm.

¹²⁷⁹ P1736, neni 142(1) i Kodit Penal të RFJ-së; *shih edhe* Radomir Gojoviq, T. 16651–16652 (2 tetor 2007).

¹²⁸⁰ P1736, nenet 38(1)–(2) të Kodit Penal të RFJ-së.

¹²⁸¹ P1020, neni 47 i Kodit Penal të Republikës së Serbisë; *shih edhe* Radomir Gojoviq, T. 16651–16652 (2 tetor 2007).

¹²⁸² Radomir Gojoviq, T. 16651–16652 (2 tetor 2007).

¹²⁸³ Radomir Gojoviq, T. 16651–16652, 16688, 16720–16723 (2 tetor 2007).

¹²⁸⁴ Radomir Gojoviq, T. 16704–16705 (2 tetor 2007).

¹²⁸⁵ P1020 (Kodi Penal i Serbisë, 1994).

522. Terrorizimi dhe grupimi me synime armiqësore ishin shkelje të neneve 125 dhe 136 të Kodit Penal të RFJ-së, në qoftë se veprime të tilla cenonin aftësinë mbrojtëse dhe sigurinë e vendit.¹²⁸⁶

523. Gjykatat ushtarake gjykonin civilë për krime kundër pronës dhe krimin e shpërdorimit zyrtar në qoftë se objekti i krimit ishte pajisje luftarake ose armatim i UJ-së.¹²⁸⁷ Gjithashtu gjykatat ushtarake gjykonin civilë në Forcat e Armatosura për krime në lidhje me shpërdorime zyrtare dhe për të tëra krimet e kryera në bashkëpunim me ushtarakë.

iv. Gjykatat ushtarake në praktikë

524. Në kohë paqeje, Gjykata Ushtarake e Nishit kishte juridiksion territorial mbi krejt territorin e Kosovës.¹²⁸⁸ Më 25 mars 1999 Ojdaniqi lëshoi një urdhër drejtuar të gjithë komandave për mobilizimin e gjykatave ushtarake dhe prokurorëve ushtarakë të kohës së luftës në strukturën organizative të komandave dhe njësisë përfshirë edhe gjykatën e lartë ushtarake dhe kryeprokurorin ushtarak dhe për fillimin e menjëhershëm të punës.¹²⁸⁹ Rrjedhimisht u ngritën 24 gjykata ushtarake dhe 24 zyra të prokurorëve ushtarakë në qarqet ushtarake, komandat e korpuseve dhe komandat e grupimeve strategjike anembanë Serbisë.¹²⁹⁰

525. Radomir Mlladenoviçi konfirmoi se gjatë konfliktit në 1999, në Kosovë kishte dy gjykata ushtarake, një e atashuar në Komandën e Korpusit të Prishtinës dhe tjetra në Komandën e Qarkut Ushtarak të Prishtinës.¹²⁹¹

¹²⁸⁶ Stanimir Radosavleviq, T. 17485–17486 (23 tetor 2007).

¹²⁸⁷ P1309 (Ligj për Gjykatat Ushtarake), neni 10; Radomir Gojoviq, T. 16735 (2 tetor 2007). Bëhet fjalë për këto krime: neni 118 – Pengim i luftës kundër armikut; neni 119 – Shërbim në forcat e armatosura armike; neni 120 – Dhënie e ndihmës armikut; neni 121 – Dobësim i fuqisë ushtarake dhe mbrojtëse; neni 124 – Rebelim i armatosur; neni 125 – Terrorizëm (në rast se është kundër objekteve ose personelit të UJ-së); neni 126 – diversion [shkatërrim i infrastrukturës] (në rast se është kundër objekteve të UJ-së); neni 127 – Sabotim (në rast se është kundër objekteve të UJ-së); neni 128 – Spiunazh (në rast se ka lidhje me mbrojtjen e RFJ-së); neni 129 – Nxjerrja e sekreteve shtetërore (në rast se ka lidhje me mbrojtjen e RFJ-së); neni 135 – dhunimi i sovranitetit territorial; neni 136 – Krijimi i një ndërmarrjeje të përbashkët për kryerjen e veprimeve armiqësore (marrë së bashku me shkeljen e neneve 118-121 ose 125-127); neni 201 – Moskryerja e një urdhri ose mosbindje ndaj tij; neni 202 – Refuzim i pranimit ose përdorimit të armës; neni 203 – Mosbindje; neni 204 – Mosbindje ndaj rojës, oficerit operativ ose anëtarëve të tjerë të Forcave të Armatosura në një detyrë të ngjashme; neni 205 – Shtërëngim i një anëtari të Forcave të Armatosura gjatë kryerjes së detyrës; neni 206 – Sulm kundër një anëtari të Forcave të Armatosura gjatë kryerjes së detyrës; *shih* P1736 (Kodi Penal i RSFJ-së).

¹²⁸⁸ Llakiq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 12.

¹²⁸⁹ 4D217 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm/Ojdaniqit për Mobilizimin e Të Gjitha Gjykatave dhe Prokurorëve Ushtarakë, 25 mars 1999).

¹²⁹⁰ P953 (Raport mbi punën e organeve gjyqësore ushtarake, 21 qershor 1999), f. 2; Radomir Gojoviq, T. 16656 (2 tetor 2007); *shih edhe* Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 40–42; 4D153 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë në lidhje me Kalimin në Gjykatat në Kohë Luftë, nënshkruar nga Lubisha Stojimiroviq, 28 mars 1999).

¹²⁹¹ Radomir Mlladenoviçi, T. 21241 (28 janar 2008).

526. Prokuroria argumenton se sistemi i drejtësisë ushtarake të UJ-së ishte plotësisht funksional dhe i aftë për procedimin e krimeve të kryera prej UJ-së gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Mirëpo ajo pretendon se kjo nuk ndodhi në praktikë dhe se anëtarët e UJ-së të cilët kryen krime të rënda nuk u nxorën para drejtësisë, për shkak të moskallëzimit ose moshetimit të këtyre krimeve, ose nëpërmjet një praktike të qëllimshme brenda UJ-së ose për shkak të shpërfilljes të komandantëve të saj.¹²⁹² Gjithashtu, duke u bazuar kryesisht në dëshminë e Gjoroviqit, Prokuroria argumenton se individë brenda UJ-së penguan qëllimisht funksionimin e sistemit.¹²⁹³

527. Veç mohimit të pjesës më të madhe të dëshmisë së Gjoroviqit, Mbrojtjet e Ojdaniqit, Pavkoviqit dhe Llazareviqit argumentojnë se gjatë konfliktit në 1999, sistemi i drejtësisë ushtarake përgjithësisht procedoi krime të kryera nga anëtarë të UJ-së, mirëpo u shfaqën vështirësi të ndryshme sistematike të cilat shkaktuan mangësi në dënimin e shkelësve.¹²⁹⁴ Mbrojtjet e Ojdaniqit dhe Pavkoviqit argumentojnë se krimet e kryera prej UJ-së procedoheshin; u depozituan kallëzime penale; krimet u hetuan; të dyshuarit u arrestuan, u akuzuan dhe u dënuan, për aq sa ishte e mundur gjatë luftës.¹²⁹⁵ Sa i përket mangësive, këto mund t'u atribuoheshin dy faktorëve jashtë kontrollit të të Akuzuarve. Së pari gjykatat ushtarake vepronin në kushte larg ideale në një zonë lufte, dhe së dyti periudha “bazë e krimi” ishte shumë e shkurtër, pas së cilës UJ-së nuk iu lejua prania në Kosovë për hetimin e krimeve dhe nxjerrjen e keqbërësve para drejtësisë.¹²⁹⁶ Gjithashtu Mbrojtja e Pavkoviqit thekson se ashtu siç pohon ligji, gjykatat ushtarake ishin të pavarura dhe rrjedhimisht të Akuzuarit nuk ishin në gjendje të ndikonin në punën e tyre.¹²⁹⁷

(A) Funksionimi i sistemit të drejtësisë ushtarake

528. Siç u theksua më sipër, Llakiq Gjoroviqi dëshmoi se korniza ligjore e ofruar prej sistemit të drejtësisë ushtarake ishte e mjaftueshme për të mundësuar hetimin dhe procedimin efikas të krimeve kryer prej ushtarakëve në Kosovë në 1999.¹²⁹⁸ Gjithashtu në një raport të Degës për Çështje Juridike të Shtabit të Komandës së Lartë shkruhej se organet gjyqësore ushtarake, pas

¹²⁹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 272–275.

¹²⁹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 275, 278–290.

¹²⁹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 284–288; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 322; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 664, 695.

¹²⁹⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 328–333; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 308–310.

¹²⁹⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 305–306.

¹²⁹⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 321.

¹²⁹⁸ Llakiq Gjoroviq, T. 11452–11453 (12 mars 2007); *shih edhe* P2826 (Informacion mbi Punën e Organeve Gjyqësore në Kohë Lufte, 12 maj 1999), f. 2. Dhoma konstaton se data e këtij dokumenti në dokumentacionin gjyqësor elektronik është e pasaktë. Radomir Gojoviq, T. 16663 (2 tetor 2007); 5D1290 (Informacion mbi Punën e Gjykatës Ushtarake dhe Komandës së Korpusit të Prishtinës, 14 maj 1999), f. 1 (deklarohet se personeli gjyqësor “po mundëson funksionimin dhe punën normale të organeve gjyqësore”).

kapërcimit të vështirësive fillestare, ishin plotësisht funksionale dhe të afta për kryerjen e detyrave të tyre.¹²⁹⁹ Mirëpo Gjoroviqi dëshmoi se dispozitat ligjore nuk u zbatuan.¹³⁰⁰

529. Mbrojtjet e Ojdaniqit, Pavkoviqit dhe Llazareviqit u referohen një numri dokumentesh të cilat provojnë se sistemi funksiononte megjithëse deri diku me pengesa për shkak të rrethanave mbizotëruese. Këtu përfshihen deklaratat se po ndërmerreshin masa dhe veprime ligjore kundër autorëve të krimeve dhe raporti për depozitimin e kallëzimeve penale. Ndër këto përfshihen raporte luftimi të Komandës së Korpusit të Prishtinës për Komandën e Armatës së Tretë, me datat 3 prill, 13 prill dhe 25 prill 1999, ku shënohet numri i kallëzimeve penale të marra në atë periudhë.¹³⁰¹ Pastaj janë edhe raporte luftimi të Armatës së Tretë, me data, 4 prill, 20 prill, 27 prill, 29 prill dhe 20 maj 1999, ku përgjithësisht raportohet për numrin e kallëzimeve penale, numrin e individëve të nxjerrë para gjykatave ushtarake të shkallës së parë dhe numrin e hetimeve të nisura.¹³⁰²

530. Aleksandar Vasileviqi dëshmoi se gjatë luftës kishte vështirësi në thirrjen e dëshmitarëve dhe palëve në procese penale.¹³⁰³ Edhe Stanimir Radosavleviqi e konfirmoi këtë duke deklaruar se kushtet e punës së prokurorëve dhe gjykatave ushtarake ishin shumë të vështira. Puna e tyre ndërpritej disa herë në ditë prej sirenavë paralajmëruese dhe ndërprerjes së energjisë elektrike. Seancat para gjykatësve hetues hasën probleme të njëjta. Për më tepër vendndodhja e gjykatës dhe prokurorëve në Nish ndryshoi disa herë gjatë luftës për arsye sigurie.¹³⁰⁴

531. Gjatë fushatës së NATO-s Radomir Gojoviqi inspektoi të 24 gjykatat dhe zyrat e prokurorëve ushtarakë të kohës së luftës anembanë RFJ-së. Ai e konfirmoi tablonë e ravijëzuar më parë dhe gjithashtu përmendi probleme të shkaktuara prej veprimtarisë së UÇK-së. Në Prishtinë puna u çrregullua prej rrethanave të atëhershme mbizotëruese dhe plotësimi i vendeve të punës ishte i vështirë për shkak të luftimit të ashpër në atë zonë.¹³⁰⁵ Vetë atij dhe punonjësve të tij iu desh të shpërnguleheshin pesë-gjashtë herë.¹³⁰⁶

¹²⁹⁹ P1917 (Informacion mbi Punën e Organeve Gjyqësore në Kohë Luftë, 7 maj 1999), f. 5.

¹³⁰⁰ *Shih më poshtë*, ndarja (c) (1).

¹³⁰¹ 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999), f. 1; P2004 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 13 prill 1999), f. 3; P2016 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 25 prill 1999), f. 2.

¹³⁰² P2617 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 4 prill 1999), f. 2; P1945 (Raport i Nebojsa Pavkoviqit, 20 prill 1999), f. 3; P2005 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 27 prill 1999), f. 2; P2017 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 29 prill 1999), f. 2; P2008 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 20 maj 1999), f. 2.

¹³⁰³ Aleksandar Vasileviq, T. 8881–8882 (22 janar 2007); *shih edhe* 3D986 (Raport përmbledhës mbi punën e degës juridike ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 6 shtator 1999), f. 10–11.

¹³⁰⁴ Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 12.

¹³⁰⁵ Radomir Gojoviq, T. 16660–16661 (2 tetor 2007).

¹³⁰⁶ Radomir Gojoviq, T. 16661 (2 tetor 2007).

532. Gojoviqi gjithashtu dëshmoi për raportin e tij të titulluar Informacion mbi Punën e Organeve Gjyqësore në Kohë Luftë, me datë 12 shtator 1999,¹³⁰⁷ ku përfshihej informacion për çështje penale të ndërlukuara (si terrorizëm, vrasje, grabitje dhe vjedhje) të cilat zgjasnin më shumë për shkak të vështirësisë. Më tej Gojoviqi dëshmoi se edhe organet gjyqësore ushtarake brenda Armatës së Tretë ndeshën në probleme.¹³⁰⁸

533. Në një raport dërguar Komandës së Korpusit të Prishtinës prej Degës për Çështje Juridike të Shtabit të Komandës së Lartë me datë 25 maj 1999, shënohej se ngarkesa dhe vështirësia e çështjeve për këtë qark ishin të konsiderueshme dhe personeli nuk ishte i mjaftueshëm.¹³⁰⁹ Aty shkruhej se organet gjyqësore po hasnin vështirësi sepse disa komanda nuk u ofronin strehim, siguri materiale dhe mbrojtje të policisë ushtarake.¹³¹⁰ Aty shkruhej se megjithëse organet ushtarake gjyqësore të Komandës së Korpusit të Prishtinës po “ndeshnin” çështje shumë të ndërlukuara për krime të rënda, organet gjyqësore në Komandën e Qarkut Ushtarak të Prishtinës kishin më pak vështirësi në funksionim sepse shumica e krimeve të shqyrtuara prej tyre ishte shmangie e shërbimit ushtarak. Gjithsesi edhe këto organe nuk funksionin në mënyrë të efektshme.¹³¹¹

534. Në një raport të përgatitur nga Radomir Gojoviqi në shtator dhe tetor 2001 kur ai punonte në departamentin juridik të Ministrisë së Mbrojtjes jepet një pasqyrë përmbledhëse e proceseve penale nisur kundër anëtarëve të UJ-së të cilët kryen krime gjatë periudhës 24 mars – 10 qershor 1999 në Kosovë, dhe të dhënat japin hollësi për numrin e viktimave të një kategorie krimi, të akuzuarit si individë dhe hetimet.¹³¹² Aty renditen gjashtë individë të akuzuar për krime kundër civilëve, një për shkaktim të vullnetshëm vdekjeje, tetë vetë për shkaktim të pavullnetshëm të vdekjes, dhe shtatë për "incidente të rënda grabitjeje dhe dhunë për mbajtjen e sendeve të vjedhura me vrasje (neni 169, paragrafi. 2)". Raporti evidenton aktgjykime për kryerjen e disa krimeve gjatë fushatës ajrore të NATO-s: tre për shkaktim të pavullnetshëm vdekjeje, një për orvatje përdhunimi, pesë për incidente të rënda grabitjeje dhe dhunë për mbajtjen e sendeve të vjedhura, gjashtë për grabitje, 59 për vjedhje të rënda, dhe disa të tjera. Dhoma thekson se viktimat e vdekjeve të shkaktuara për të cilat pati aktgjykime ishin të gjithë anëtarë të UJ-së, dhe viktimat e orvatjes së përdhunimit për të cilin kishte aktgjykim kishte emër serb.¹³¹³ Për më tepër pasqyra përmbledhëse e

¹³⁰⁷ P2826 (Informacion mbi Punën e Organeve Gjyqësore në Kohë Luftë, 12 maj 1999), f. 2 (pohohet se organet gjyqësore ushtarake atashuar Komandës së Korpusit të Prishtinës, gjatë punës së tyre ndeshën në “çështje shumë të ndërlukuara penale për krime të rënda”).

¹³⁰⁸ Radomir Gojoviq, T. 16665–16666 (2 tetor 2007).

¹³⁰⁹ P2818 (Informacion mbi Veprimtarinë e Organeve Gjyqësore gjatë Gjendjes së Luftës, 25 maj 1999), f. 3.

¹³¹⁰ P2818 (Informacion mbi Veprimtarinë e Organeve Gjyqësore gjatë Gjendjes së Luftës, 25 maj 1999), f. 5.

¹³¹¹ P2818 (Informacion mbi Veprimtarinë e Organeve Gjyqësore gjatë Gjendjes së Luftës, 25 maj 1999), f. 4.

¹³¹² P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake), f. 1–82; *shih edhe* Radomir Gojoviq, T. 16682 (2 tetor 2007).

¹³¹³ P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake), f. 14, 15, 18.

raportit tregon se gjatë së njëjtës periudhë nuk pati aktakuza për krime lufte (bazuar në nenin 142 të Kodit Penal të RFJ-së),¹³¹⁴ ndonjë lloj vrasjeje (bazuar në nenin 47 të Kodit Penal të Serbisë) ose përdhunim (bazuar në nenin 103 të Kodit Penal të Serbisë).¹³¹⁵

535. Interpretimi i Gojoviqi për Raportin e tij të vitit 2001 mbi Proceset Penale ishte se u proceduan 372 individë për krime tipike lufte kundër popullatës, nga vrasjet deri te vjedhjet e thjeshta. Më vonë ai deklaroi se për vrasje u proceduan gjithsej 39 vetë.¹³¹⁶ Mirëpo në kohën kur përfundoi raporti në vitin 2001, nuk ishte dënuar askush.¹³¹⁷ Megjithëse në raport nuk ka informacion për dënime për vrasje, Gojoviqi dëshmoi se më pas ai kishte dëgjuar për disa dënime të dhëna për vrasje të kryera gjatë konfliktit të përfshira në raportin e tij, dhe se dënimi më i rëndë për të cilin ishte në dijeni, ishte 14 vjet burgim.¹³¹⁸

536. Gojoviqi dëshmoi se gjatë periudhës së shkurtër të gjendjes së luftës, kur funksiononin gjykatat ushtarake të kohës së luftës, gjykatat nuk arritën të përfundonin çështjet e përmendura në këtë raport. Pas mbarimit të konfliktit, procedimi penal i individëve të cilët kryen krime si efektiva të UJ-së ishte i vështirë sepse gjykatat ushtarake kishin juridiksion vetëm mbi individët të cilët mbetën në ushtri dhe ata ishin shumë pak.¹³¹⁹ Gjithashtu pas përfundimit të operacioneve luftarake, UJ-ja kishte problem gjetjen e individëve të kërkuar për krime të cilët në atë kohë ishin çmobilizuar, duke qenë se shumë prej tyre u fshehën ose u arratisën jashtë vendit.¹³²⁰ Për më tepër pas mbarimit të konfliktit, kryerja e hetimeve në Kosovë nuk ishte e mundshme sepse forcat e UJ-së nuk kishin leje të hynin në atë territor.¹³²¹ Gjithsesi Branko Gajiqi, ish-Zëvendëseshëf i Administratës së Sigurimit të UJ-së, dëshmoi se pas ndërprerjes së luftimeve, UJ-ja vazhdoi të hetonte krimet e luftës të kryera gjatë luftimeve.¹³²²

¹³¹⁴ *Shih* Radomir Gojoviq, T. 16651–16652, 16688, 16720–16723 (2 tetor 2007).

¹³¹⁵ P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake), f. 2.

¹³¹⁶ Radomir Gojoviq, T. 16719–16720 (2 tetor 2007). P954 (Raport mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001), P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake).

¹³¹⁷ Radomir Gojoviq, T. 16693 (2 tetor 2007).

¹³¹⁸ Radomir Gojoviq, T. 16720 (2 tetor 2007).

¹³¹⁹ Radomir Gojoviq, T. 16689 (2 tetor 2007); *shih edhe* Geza Farkash, T. 16308–16309 (25 shtator 2007).

¹³²⁰ Branko Gajiq, T. 15303 (10 shtator 2007); *krahaso*. Radomir Mlladenoviq, T. 21252 (28 janar 2008).

¹³²¹ Geza Farkash, T. 16308, 16328 (25 shtator 2007); Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator), para. 22.

¹³²² Branko Gajiq, T. 15301 (10 shtator 2007); *shih edhe* 3D1056 (Raport i Komandës së Armatës së Tretë, 21 qershor 1999), 3D1057 (Raport i Komandës së Armatës së Tretë, 25 qershor 1999), 3D1058 (Ndryshim në Raportin e Komandës së Armatës së Tretë, 25 qershor 1999), 3D1059 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 25 qershor 1999), 3D1062 (Vendim për hetimin e krimeve të mundshme kundër civilëve prej anëtarëve të Korpusit të Prishtinës, 3 gusht 1999), 3D1061 (Letër shoqëruese në lidhje me vrasjen e 20 shqiptarëve kosovarë, 14 korrik 1999).

(B) Hetimi dhe procedimi i krimeve në UJ

537. K82, ushtar i UJ-së në Korpusin e Prishtinës, pranoi gjatë procesit gjyqësor se kishte zbatuar urdhrin për vrasjen e 15 shqiptarëve kosovarë në fshatin Tërm (komuna e Suharekës). Mirëpo ai dëshmoi se nuk u ndëshkua apo u disiplinua asnjëherë për këtë apo për incidente të tjera të përmendura në dëshminë e tij, dhe se në fakt “po të zbatoje këto urdhra, ishe hero”.¹³²³ Rrjedhimisht Dhoma i kthehet çështjes nëse një mosveprim i tillë ishte përjashtim nga rregulli apo praktikë e përhapur në sistemin e drejtësisë ushtarake të RFJ-së.

538. Gjoroviqi deklaroi se në një numër të madh rastesh gjatë konfliktit prokurorët u penguan të procedonin autorët e krimeve të rënda dhe u detyruan të procedonin anëtarë të pafajshëm të UJ-së ose qytetarë të tjerë të RFJ-së nëpërmjet sajimit të krimeve dhe proceseve gjyqësore të rreme.¹³²⁴ Gjithashtu ai deklaroi se në praktikë ishin organet e sigurimit ushtarak që vendosnin kush do të procedohej dhe kush jo në rastet e krimeve më të rënda, dhe jo vetë prokurorët ushtarakë.¹³²⁵

539. Prokuroria përmendi raporte për punën e gjykatave dhe zyrave të prokurorëve ushtarakë në kohë lufte, përgatitur prej Organit për Çështje Juridike të Komandës së Armatës së Tretë, për të treguar se ato pak çështje penale që u proceduan brenda sistemit të drejtësisë ushtarake nuk përfshinin krime të rënda, me përjashtim të vjedhjes dhe se gjykatat ushtarake e përqëndruan vëmendjen në procedimin e krimeve të kryera kundër UJ-së.¹³²⁶ Këto raporte përmbajnë shifra për hetime, aktakuza, verdikte, procese ekzistuese, dënime dhe ndalime prej organeve gjyqësore të Armatës së Tretë për periudhën 23 prill – 30 maj 1999.¹³²⁷ Në raportin e parë, me datë 23 prill 1999, ndër çështjet e diskutuara përfshihen krimet e shmangies së shërbimit ushtarakë, vjedhjes së armëve të UJ-së, moszbatimit të urdhrave, grabitjes, korruptimit nëpërmjet shpërblimit në të holla, hyrjes së paautorizuar në ambientet ushtarake dhe vizatimit të ambienteve ushtarak si dhe sulm kundër oficerëve të ushtrisë.¹³²⁸ Në raporte të ngjashme me datë 30 prill dhe 1 maj 1999, shumica e krimeve të diskutuara përfshinte shmangien e shërbimit ushtarak dhe dezertimin; gjithashtu ka disa

¹³²³ K82, P2863 (deklaratë dëshmitari me datë 14 shtator 2006), para. 17–19, 39.

¹³²⁴ Llakiq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 2.

¹³²⁵ Llakiq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 2.

¹³²⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 274, 833.

¹³²⁷ P1912 (Raport mbi Punën e Prokurorisë Ushtarake dhe Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 1 maj 1999); P1939 (Raport mbi Punën e Prokurorisë Ushtarake dhe Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 23 prill 1999); P1940 (Raport mbi Punën e Prokurorisë Ushtarake dhe Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 30 prill 1999); P1941 (Raport mbi Punën e Organeve Gjyqësore Ushtarake, 30 maj 1999).

¹³²⁸ P1939 (Raport mbi Punën e Prokurorisë Ushtarake dhe Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 23 prill 1999), f. 1–3.

referenca për dënimin e disa individëve për grabitje.¹³²⁹ Në një raport tjetër me datë 30 maj 1999, përshkruheshin aktgjykime dhe fajësime për krimet e dezertimit, shmangies së shërbimit ushtarak, dhe vjedhje të rënda si dhe krimi i uljes së moralit, mbajtjes së paautorizuar të armës dhe mosbindje ndaj urdhrave.¹³³⁰

540. Në një raport mbi veprat penale dhe punën e organeve gjyqësore në Korpusin e Prishtinës që Komanda e Korpusit të Prishtinës u dërgoi disa njësive të veta vartëse që vepronin në Kosovë më 2 maj 1999, shkruhej se vrasja ishte një prej krimeve më të kallëzuara.¹³³¹ Në atë raport deklarohet se përqindja më e madhe e të tëra veprave penale të kryera dhe kallëzuara në Korpusin e Prishtinës ishin, vrasje, vjedhje të dhunshme, marrja të mjeteve motorike dhe braktisje e dezertim i vullnetshëm.¹³³²

541. Më 4 maj në Beograd u mbajt një takim për diskutimin e ngjarjeve në Kosovë, përfshirë krimet që po kryheshin dhe reagimin e gjykatave ushtarake, siç diskutohet në Kapitullin VIII në lidhje me përgjegjësinë penale individuale të Millutinoviqit, Shainoviqit, Ojdaniqit, Pavkoviqit dhe Lluqiçit.¹³³³ Sipas një raporti për përmbajtjen e takimit, u paraqitën të dhëna se forcat e sigurimit të UJ-së kishin shqyrtuar raste të shumta të dhunës, vrasjeve, plaçkitjeve dhe krime të tjera dhe kishin arrestuar disa qindra keqbërës krimet e të cilëve përbënin rrezik të madh për popullatën.¹³³⁴ Në takim u konkludua se puna e gjykatave ushtarake e kishte bërë “të pamundur” ndodhinë e krimeve të tilla në të ardhmen duke qenë se ato kishin proceduar shumë çështje për krime kundër popullatës civile dhe kishin dhënë një “numër të madh” dënimesh me burgim nga 5 deri në 20 vjet për këto krime.¹³³⁵ Mirëpo kjo deklaratë nuk përputhet me raportet mbi punën e sistemit të drejtësisë ushtarake. Në asnjë prej këtyre raporteve nuk përmendet dhënie dënimesh nga 5 deri në 20 vjet

¹³²⁹ P1940 (Raport mbi Punën e Prokurorisë Ushtarake dhe Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 30 prill 1999), f. 1–2; P1912 (Raport mbi Punën e Prokurorisë Ushtarake dhe Gjykatave Ushtarake gjatë Gjendjes së Luftës, 1 maj 1999), f. 1–3.

¹³³⁰ P1941 (Raport mbi Punën e Organeve Gjyqësore Ushtarake, 30 maj 1999), f. 1–2.

¹³³¹ P2830 (Raport për Komandën mbi Veprat Penale dhe Punën e Organeve Gjyqësore në Korpusin e Prishtinës, 2 maj 1999), f. 1.

¹³³² P2830 (Raport për Komandën mbi Veprat Penale dhe Punën e Organeve Gjyqësore në Korpusin e Prishtinës, 2 maj 1999), f. 1–2.

¹³³³ P1696 (“Krerët e ushtrisë, policisë e informojnë Millosheviqin për Mbrojtje të Suksesshme”, Lajm i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1. 4D406 (“Gjendja e Sigurisë në Kosovë”, Lajm në Politika, 6 maj 1999). Këto dokumente u kundërshtuan, T. 16105-16106 (21 shtator 2007); T. 22547 (15 shkurt 2008). Mirëpo ato konfirmohen nga 5D1289 (Raport i Sreten Lluqiçit në lidhje me lajmin në Politika, 6 maj 1999); Dushan Gavranic, T. 22722 (19 shkurt 2008); Millosh Vojnoviq, T. 24188 (12 mars 2008).

¹³³⁴ P1696 (“Krerët e ushtrisë, policisë e informojnë Millosheviqin për Mbrojtje të Suksesshme”, Lajm i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1.

¹³³⁵ P1696 (“Krerët e ushtrisë, policisë e informojnë Millosheviqin për Mbrojtje të Suksesshme”, Lajm i RTS-së, 5 maj 1999), f. 1–2.

burgim prej gjykatave ushtarake për krime kundër civilëve deri më 4 maj 1999, siç shkruhet këtu.¹³³⁶

542. Raportet e dërguara prej njërive vartëse të Korpusit të Prishtinës në Komandën e Korpusit të Prishtinës bënin të ditur se organeve kompetente po u paraqiteshin disa kallëzime penale. Më 18 prill 1999 një raport i një Poste Luftarake në zonën e Gjakovës informonte Komandën e Korpusit të Prishtinës se ishin arrestuar katër ushtarë për përdhunimin e një civili, të cilët u ishin dorëzuar hetuesve të Gjykatës Ushtarake të Prishtinës.¹³³⁷ Gjithashtu më 25 prill 1999, Komanda e Brigadës së Motorizuar 37 i raportoi Komandës së Korpusit të Prishtinës për një grup prej pesë anëtarësh të kësaj brigade të cilët dyshoheshin se kishin kryer krime kundër popullatës civile në Gllogoc. Raporti bënte të ditur se ata ishin mbaheshin të arrestuar në postëkomandë dhe çështja e tyre po procedohej.¹³³⁸ Më 1 maj 1999 Komanda e Brigadës 354 së Këmbëtorisë i raportoi Komandës së Korpusit të Prishtinës për një vepër të kryer prej një rekruti të UJ-së kundër një civili. Raporti bënte të ditur se rekruti ishte arrestuar dhe ishte shoqëruar në burgun ushtarak të Prishtinës, dhe kundër tij ishin formuluar akuza.¹³³⁹ Më 10 maj 1999 Saviqi i raportoi Komandës së Korpusit të Prishtinës në lidhje me zbatimin e operacionit të dytë në zonën e Bajgorës. Në raportin e tij ai theksoi se ishin arrestuar dy ushtarë pasi ishin kapur duke plaçkitur shtëpi.¹³⁴⁰ Gjithashtu në raportin e vet të rregullt të 20 majit 1999, Komanda e Brigadës së Motorizuar 37 informoi Komandën e Korpusit të Prishtinës për vrasjen e dy civilëve në Fushë-Kosovë prej një anëtari të kësaj brigade, konkretisht Nenad Bullatoviçit.¹³⁴¹ Raporti bënte të ditur se Bullatoviçit mbahej në burg dhe kundër tij ishte depozituar kallëzim penal. Dikoviçi, komandant i Brigadës së Motorizuar 37, dëshmoi se Bullatoviçi i ishte dorëzuar gjykatës hetimore ushtarake në Prishtinë.¹³⁴² Më 21 maj 1999 u mor vendim për nisjen e procesit dhe hetimi iu përcoll Gjykatës së Qarkut të Krlevës.¹³⁴³ Mirëpo në lidhje me këtë individ nuk është shënuar asgjë tjetër.

¹³³⁶ P1912 (Raport mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 1 maj 1999); P1940 (Raport mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 30 prill 1999), P1182 (Informacion dërguar Brigadës 52 Artilerike të Raketave nga Korpusi i Prishtinës, 15 maj 1999), 3D986 (Raport përmbledhës mbi punën e degës juridike ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 6 shtator 1999), P962 (Raport mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, Brigada e Motorizuar 549), P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002), P954 (Raport mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001), P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake), P845 (Raport mbi çështjet penale në gjykatat ushtarake për dhunë seksuale, 10 shtator 2002).

¹³³⁷ Bozhidar Deliq, T. 19410 (4 dhjetor 2007); 5D1148 (Raport i Postës Luftarake 1936, 18 prill 1999); 5D889 (Kallëzim penal dorëzuar Prokurorit Ushtarak, 17 prill 1999).

¹³³⁸ 5D1057 (Raport Luftimi i Brigadës së Motorizuar 37 për Korpusin e Prishtinës, 25 prill 1999), f. 2.

¹³³⁹ 5D509 (Raport Luftimi i Brigadës 354 të Këmbëtorisë për Korpusin e Prishtinës, 1 maj 1999).

¹³⁴⁰ Lubomir Saviq, T. 20972–20973 (24 janar 2008); 5D1132 (Raport Luftimi i Brigadës 58 të Këmbëtorisë së Lehtë, 10 maj 1999), f. 2.

¹³⁴¹ 5D1061 (Raport Luftimi i Brigadës së Motorizuar 37 për Korpusin e Prishtinës, 20 maj 1999), f. 2.

¹³⁴² Lubisha Dikoviç, T. 19916 (10 dhjetor 2007).

¹³⁴³ P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake), f. 7.

543. “Lista e kallëzimeve penale të depozituara kundër shkelësve në Brigadën e Motorizuar 37 për periudhën maj 1998 -qershor 1999” gjithashtu bën të ditur se u proceduan disa anëtarë të Korpusit të Prishtinës. Vujadin Shteković, kapiten, u akuzua për vrasje; Zllatan Mançiq dhe Rade Radojeviq, përkatësisht major dhe kapiten, u burgosën për disa vjet për “krim lufte kundër civilëve”; dhe Zhelko Jokiq u akuzua për përdhunim.¹³⁴⁴ Dokumenti i titulluar “Informacion për disa krime dhe incidente negative” dërguar prej Komandës së Brigadës së Motorizuar 549 njësive të veta vartëse gjithashtu tregon se policia ushtarake arrestoi vullnetarë të dyshuar për kryerjen e krimit të përdhunimit më 26 maj 1999 dhe ua dorëzoi Gjykatës Ushtarake të Korpusit të Prishtinës.¹³⁴⁵ Më vonë kjo çështje iu përcoll një gjykate komunale mirëpo nuk ka prova për dhënie dënimesh.

544. Një dokument dërguar prej Komandës së Korpusit të Prishtinës njësive të veta vartëse më 15 maj 1999 bënte të ditur se në atë kohë gjykatat ushtarake të kohës së luftës po procedonin 91 ushtarakë profesionistë, mirëpo asnjë prej këtyre proceseve nuk kishte lidhje me shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare.¹³⁴⁶ Në një raport tjetër në lidhje me krimet e kryera në Kosovë dhe përgatitur prej kryeprokurorit ushtarak në prill 2002 dhe dërguar Misionit të OSBE-së në Serbi dhe Mal të Zi në qershor 2003,¹³⁴⁷ shkruhej se gjatë periudhës 1 qershor 1998 – 27 qershor 1999 organet gjyqësore ushtarake nisën procedim penal gjithsej kundër 305 anëtarëve të UJ-së për shkelje të standardeve të së drejtës humanitare. Të tëra këto procese u nisën prej prokurorëve ushtarakë të shkallës së parë. Mirëpo vetëm një hetim, kundër Slobodan Stoshiqit, u përqendrua në shkelje të përsëritura të së drejtës ndërkombëtare dhe u ndërpre për mungesë provash.¹³⁴⁸ Rastet e tjera kishin të bënin me incidente të veçuara kryer prej individëve ose grupeve shumë të vogla të personelit të UJ-së. Veç rastit të Stoshiqit, nisën 11 hetime për krime lufte kundër civilëve, vrasje të paligjshme të armikut, vrasje dhe përdhunim; prej këtyre 10 çështje iu kaluan gjykatave civile ose u ndërpre dhe në çështjen e mbetur nuk ka prova për rezultatin.¹³⁴⁹ Gjithashtu u nxorën 10 aktakuza të veçanta për vrasje, përdhunim ose orvatje për përdhunim; prej këtyre shtatë iu kaluan gjykatave të tjera ose u ndërpre dhe për tri çështjet e tjera nuk ka prova me shkrim për

¹³⁴⁴ Bozhidar Deliq, T. 19407 (4 dhjetor 2007); P962 (Listë e kallëzimeve penale të depozituara kundër shkelësve në Brigadën e Motorizuar 549 gjatë periudhës maj 1998 – korrik 1999), f. 24–28; Vlatko Vuković, 5D1401 (deklaratë dëshmitari me datë 5 janar 2008), para. 77 (mbyllur me vullë).

¹³⁴⁵ 5D1351 (Informacion dërguar nga Komanda e Brigadës së Motorizuar 549 në lidhje me disa krime dhe incidente, 27 maj 1999), f. 2.

¹³⁴⁶ P1182 (Informacion dërguar Brigadës 52 Artilerike të Raketave nga Korpusi i Prishtinës, 15 maj 1999), f. 1–4.

¹³⁴⁷ P829 (Letër e Ministrisë së Mbrojtjes së Serbisë dhe Malit të Zi për OSBE-në, 30 qershor 2003).

¹³⁴⁸ P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002), f. 1–2. Dyshohej se në tri raste, në prill 1999, Stoshiqi kishte urdhëruar vartësit e tij që të vrisnin afërsisht 20 civilë shqiptarë kosovarë.

¹³⁴⁹ P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002), f. 1–4.

rezultatit.¹³⁵⁰ Në këtë raport nuk paraqiten prova për dënimin e ndonjë anëtari të UJ-së për krime të rënda.

545. Ky raport gjithashtu përshkruan procedimin e krimeve kundër pronës, kundër 267 individëve.¹³⁵¹ Hetimet kundër 45 individëve iu kaluan organeve gjyqësore civile. Prej 222 çështjeve të mbetura në gjykatat ushtarake, 18 njerëz u akuzuan për grabitje, pesë u akuzuan për incidente të rënda të grabitjes dhe dhunës për mbajtjen e sendeve të vjedhura, 124 u akuzuan për vjedhje të dhunshme, dhe 75 u akuzuan për vjedhje. Raporti bën të ditur se u dënuan 101 individë, dhe dënimi më i rëndë ishte burgim me 3 vjet dhe gjashtë muaj.¹³⁵² Raporti nuk përmend hollësi të çështjeve, mirëpo paraqet “një shembull të skajshëm të brutalitetit”: një hetim i ndërmarrë kundër shtatë ushtarëve për incidente të rënda të grabitjes dhe dhunës për mbajtjen e sendeve të vjedhura, ndër të cilat vrasjen e gjashtë shqiptarëve kosovarë në Zhegër, komuna e Gjilanit.¹³⁵³ Sipas raporteve të UJ-së këto incidente kishin të bënin me vrasjen e gjashtë shqiptarëve kosovarë në të njëjtën ditë prej rezervistëve të UJ-së të cilët vepruan në ujdi me njëri-tjetrin. Autori fizik ishte njëri prej rezervistëve kurse të tjerët e shoqëronin.¹³⁵⁴ Autori fizik u dënua me 20 vjet kurse të tjerët nga një vit “ose më shumë”.¹³⁵⁵

546. Sipas një raporti tjetër për punën e organeve gjyqësore ushtarake gjatë gjendjes së luftës lëshuar prej Administratës për Rekrutim, Mobilizim dhe Çështje Sistemore të Shtabit të Komandës së Lartë më 21 qershor 1999, prokurorët ushtarakë kishin marrë gjithsej 18.541 kallëzime penale, depozituan kërkesa për hetimin e 5.370 individëve dhe akuzuan 6.708 individë. Në raport gjithashtu shkruhej se gjykatat ushtarake kishin përfunduar 2.852 hetime dhe kishin shqiptuar 2.811 vendime. Shtatëdhjetë për qind e çështjeve kishin të bënin me mosparaqitjen për mobilizim dhe shmangie të shërbimit ushtarak, 18 për qind kishin të bënin me braktisje dhe dezertim të vullnetshëm të UJ-së, dhe 12 për qind mbulonte krime të tjera. Mirëpo në raport është e paqartë nëse këto përqindje kanë lidhje me kallëzimet penale, hetimet, aktakuzat ose aktgjykimet.¹³⁵⁶

547. Gojoviqi dëshmoi se pas mbarimit të luftës dhe përpilimit të krejt të dhënave, ai përgatiti një raport tjetër përmbledhës për punën e organeve gjyqësore ushtarake gjatë luftës, me datë 6 shtator

¹³⁵⁰ P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002), f. 4–6.

¹³⁵¹ P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002), f. 6–7.

¹³⁵² P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002), f. 6.

¹³⁵³ P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002), f. 7.

¹³⁵⁴ P954 (Raport mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake, 21 gusht 2001), f. 57; P955 (Pasqyrë përmbledhëse e raporteve mbi çështje penale, prokurorinë dhe gjykatat ushtarake), f. 6.

¹³⁵⁵ Branko Gajiq, T. 15332–15333 (11 shtator 2007).

¹³⁵⁶ P953 (Raport mbi punën e organeve gjyqësore ushtarake, 21 qershor 1999), f. 2; *shih edhe* Radomir Gojoviqi, T. 16743–16745 (3 tetor 2007).

1999.¹³⁵⁷ Në këtë raport shkruhet se 88 për qind e rasteve ishin mosparaqitje për mobilizim dhe mungesë pa leje prej repartit dhe 12 për qind përfshinin vepra penale kundër individëve, jetës ose paprekshmërisë fizike,¹³⁵⁸ dhe vepra penale kundër pronës.¹³⁵⁹ Sërish raporti nuk qartëson se cilën fazë të procedimit mbulojnë këto përqindje, kallëzimet penale, kërkesat për hetim, aktakuzat apo aktgjykimet. Sipas Gjoroviqit, i cili dëshmoi se nuk kishte arsye për vënien në dyshim të shifrave të raportit, shifrat tregojnë se shumica e çështjeve kishin lidhje me veprime të kryera kundër UJ-së prej anëtarëve të vetë, që tregon se krimet e kryera kundër civilëve nga anëtarë të UJ-së nuk ishin proceduar në numër të mjaftueshëm.¹³⁶⁰

548. Së fundi në një letër dërguar në maj 2003 prej Ministrisë së Brendshme të Serbisë për Misionin e OSBE-së në Serbi dhe Mal të Zi, shkruhej se në vitet 1998 dhe 1999 në Kosovë ishin kryer disa qindra krime, dhe për të gjitha krimet e regjistruara ishin depozituar kallëzime penale. Gjithsesi nuk jepen hollësi të tjera në lidhje me ecurinë e këtyre çështjeve.¹³⁶¹

(C) Anëtarët e UJ-së ndërhyjnë në sistem ose e penguan atë

549. Gjoroviqi dëshmoi se në praktikë pavarësisht nga formulimi i përdorur në Kushtetutë mbi pavarësinë dhe ligjshmërinë, gjykatat ushtarake nuk ishin as të pavarura dhe as nuk gjykonin në bazë të ligjit. Në çështjet më të rënda gjykatat ushtarake gjykuan dhe shqiptuan dënime në bazë të udhëzimeve prej ekzekutivit.¹³⁶² Organet e sigurimit të UJ-së ushtruan presion të madh mbi zyrat e prokurorëve ushtarakë. Megjithëse supozohej që organet e sigurimit të vepronin në përputhje me kërkesat e Gjoroviqit si prokuror, në praktikë ata e penguan Gjoroviqin që të kryente si duhej detyrat e tij.¹³⁶³ Konkretisht Gjoroviqi deklaroi se organet ushtarake të sigurimit nën drejtimin e udhëheqjes shtetërore dhe ushtarake, ushtronin kontroll të plotë mbi krejt organizatën dhe rekrutimin individual brenda sistemit përfshirë përzgjedhjen, zëvendësimin, heqjen dhe lirimimin nga detyra të gjykatësve dhe prokurorëve ushtarakë, sidomos në pozita drejtuese dhe udhëheqëse.¹³⁶⁴

¹³⁵⁷ Radomir Gojoviq, T. 16677 (2 tetor 2007); *shih edhe* 3D986 (Raport përmbledhës mbi punën e degës ligjore ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 6 shtator 1999).

¹³⁵⁸ Me termin “jetën dhe paprekshmërinë fizike” ai e kishte fjalën për të gjitha format e dëmtimit ose keqtrajtimit fizik, ndër të cilat vrasje, përdhunim dhe krime lufte. Radomir Gojoviq, T. 16681 (2 tetor 2007).

¹³⁵⁹ 3D986 (Raport përmbledhës mbi punën e degës ligjore ushtarake të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 6 shtator 1999), f. 16–17.

¹³⁶⁰ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 52.

¹³⁶¹ P831 (Letër mbi veprimet e ndërmarra nga MPB-ja e Republikës së Serbisë për zbulimin e krimeve të luftës, 12 maj 2003), f. 2.

¹³⁶² Llakiq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 2.

¹³⁶³ Llakiq Gjoroviq, T. 11454 (12 mars 2007).

¹³⁶⁴ Llakiq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 2.

550. Gjoroviqi gjithashtu dëshmoi se disa vepra penale të rënda nuk iu kallëzuan fare prokurorëve ushtarakë kompetentë.¹³⁶⁵ Organet gjyqësore ushtarake shërbyen si mburojë për paligjshmërinë dhe shpërdorimin e detyrës prej organeve ushtarake të sigurimit dhe udhëheqjes ushtarake të vendit. Megjithëse organet ushtarake të sigurimit në bazë të ligjit kishin kompetencë për identifikimin dhe kallëzimin e autorëve të krimeve, në praktikë nuk e bënë këtë dhe madje edhe mbuluan krime dhe mbrojtën kriminelët prej ndjekjes penale.¹³⁶⁶ Gjoroviqi dëshmoi më konkretisht se si prokuror ushtarak në Prishtinë, ai ishte në dijeni të shumë rasteve të vrasjeve dhe vrasjeve masive. Mirëpo sipas tij nga zyra e tij u zhdukën 1.400 kallëzime penale, përfshirë edhe deklarata në lidhje me këto vrasje, përpjekje e sigurimit të UJ-së për mbulimin e krimeve.¹³⁶⁷ Nga ana tjetër Radomir Gojoviqi dëshmoi se ai nuk kishte dijeni për asnjë krim të vetëm (përfshirë edhe krime lufte) që ishte kallëzuar dhe nuk ishte hetuar dhe proceduar.¹³⁶⁸

551. Mirëpo Geza Farkash, ish-shef i Administratës së Sigurimit dëshmoi se menjëherë pasi çështja i kalonte sistemit gjyqësor, Administrata e Sigurimit nuk kishte më kontroll ndaj saj, me përjashtim të rastit kur zyra e prokurorit dhe organet hetimore të gjykatave u kërkonin hetime ose të dhëna shtesë.¹³⁶⁹ Gjithashtu Stanimir Radosavleviqi dëshmoi se prej përvojës së tij vetjake si zëvendësprokuror ushtarak në zyrën e kryeprokurorit ushtarak në Armatën e Tretë në Nish gjatë luftës, askush përfshirë edhe organet e sigurimit të Korpusit të Prishtinës dhe Armatës së Tretë, nuk ushtroi presion mbi të për të prapësuar një kallëzim penal apo për ndërprerjen e procedimit penal të një të dyshuari. Gjithashtu Radosavleviqi dëshmoi se askush prej prokurorëve të gjykatave ushtarake nuk e kishte informuar se kishte patur presion ndaj tyre.¹³⁷⁰

(1) Shembuj konkretë të korrupsionit

552. Gjoroviqi ofroi disa shembuj në mbështetje të qëndrimit tij mbi mënyrën e funksionimit të sistemit të drejtësisë ushtarake. Konkretisht ai dëshmoi se kur ishte prokuror ushtarak i Qarkut Ushtarak të Prishtinës, afër Rahovecit u zbulua një varr i përbashkët ku u zhvarrosën afërsisht 47 kufoma. Gjoroviqi kërkoi që t'i transferohej çështja; Millosh Spasojeviq, prokurori ushtarak i kohës së luftës për Korpusin e Prishtinës në atë kohë, i dorëzoi një dosje me 150 dokumente.¹³⁷¹ Pastaj Gjoroviqi kërkoi prej organeve ushtarake të sigurimit që të kryenin një hetim në vend dhe t'i

¹³⁶⁵ Llakiq Gjoroviq, T. 11452–11453 (12 mars 2007).

¹³⁶⁶ Llakiq Gjoroviq, P2672 (deklaratë dëshmitari me datë 14 gusht 2006), f. 3.

¹³⁶⁷ Llakiq Gjoroviq, T. 11504–11505 (12 mars 2007).

¹³⁶⁸ Radomir Gojoviq, T. 16686 (2 tetor 2007).

¹³⁶⁹ Geza Farkash, T. 16374–16375 (25 shtator 2007); *shih edhe* Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26585 (8 korrik 2008).

¹³⁷⁰ Stanimir Radosavleviq, 4D502 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 17.

¹³⁷¹ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 35.

paraqisnin një raport. Kjo ishte çështja më e rëndë që ai pati në Kosovë.¹³⁷² Më 2 qershor 1999, kryeprokurori ushtarak, Svetomir Obrençević, urdhëroi që dosja t'i kthehej Spasojeviqit sepse ai e dinte se Spasojeviqi nuk do të procedonte çështje të tilla.¹³⁷³ Mirëpo kur dëshmoi gojarisht dhe në deklaratën e tij me shkrim, Spasojeviqi mohoi të kishte dijeni për dosjen e një çështjeje në lidhje me një varr të përbashkët në Rahovec, ose për dhënie apo marrje dosjeje prej Gjoroviqit.¹³⁷⁴ Spasojeviqi deklaroi se prokurorët e Komandës së Korpusit të Prishtinës dhe të Qarkut Ushtarak të Prishtinës nuk bashkëpunonin sepse kishin kompetenca të ndryshme.¹³⁷⁵ Gjithashtu ai deklaroi fillimisht se për shkak të kodit të veçantë të çështjes për të cilin Gjoroviqi deklaroi se ishte në dosje, ajo nuk mund të ishte në duar të një prokurori ushtarak.¹³⁷⁶ Mirëpo kur u pyet nga pala kundërshtarë ai tha se kjo dosje “sigurisht që mund të jetë në zyrën e prokurorit në një fazë të procedimit pasi dhoma penale [e UJ-së] merr vendim në lidhje me një çështje të caktuar.”¹³⁷⁷

553. Prokuroria kërkoi dokumentacion prej qeverisë serbe në lidhje me çështjen e varrit të përbashkët në Rahovec.¹³⁷⁸ Në përgjigjen e vetë Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë konfirmoi se dosja gjyqësore e pajisur me kodin e përcaktuar prej Gjoroviqit ishte transferuar prej Zyrës së Prokurorit të Qarkut Ushtarak të Prishtinës në Zyrën e Prokurorit të Komandës së Korpusit të Prishtinës.¹³⁷⁹ Meqenëse Spasojeviqi u emërua prokuror ushtarak për Komandën e Korpusit të Prishtinës në maj 1999, ai duhej të ishte marrësi i dosjes në fjalë.¹³⁸⁰ Mirëpo pa dhënë hollësi të tjera Ministria e Punëve të Jashtme deklaroi se dosja në fjalë “nuk ka lidhje me nisjen e hetimit të ngjarjeve” të një varri të përbashkët në Rahovec.¹³⁸¹

554. Dhoma Gjyqësore gjykon se mohimi në një masë të madhe prej Spasojeviqit i dëshmisë së Gjoroviqit në lidhje me vendin e varrit në Rahovec nuk është i besueshëm, veçanërisht po të merret parasysh se Ministria e Punëve të Jashtme të Serbisë konfirmoi se midis zyrave të tyre qarkulloi një dosje me numrin e dhënë prej Gjoroviqit. Ai nuk krijoi mbresën e një dëshmitari të besueshëm për Dhomën, kurse Gjoroviqi po. Dhoma e konsideron të besueshme dhe bindëse dëshminë e Gjoroviqit në lidhje me çështjen të cilën ai e mbante mend në hollësi për shkak të rëndësisë.¹³⁸²

¹³⁷² Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 35–36.

¹³⁷³ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 36.

¹³⁷⁴ Millosh Spasojeviq, T. 15994 (19 shtator 2007), 3D532 (deklaratë dëshmitari me datë 9 janar 2007), para. 4.

¹³⁷⁵ Millosh Spasojeviq, T. 15994 (19 shtator 2007).

¹³⁷⁶ Millosh Spasojeviq, 3D532 (deklaratë dëshmitari me datë 9 janar 2007), para. 5.

¹³⁷⁷ Millosh Spasojeviq, T. 15997 (19 shtator 2007).

¹³⁷⁸ P2761 (Material i bashkëngjitur përgjigjes serbe ndaj Kërkesës për Ndihmë/KPN/ 1309, 8 dhjetor 2006).

¹³⁷⁹ P2761 (Përgjigjja serbe ndaj Kërkesës për Ndihmë 1309, 8 dhjetor 2006), f. 1.

¹³⁸⁰ Millosh Spasojeviq, T. 15987 (19 shtator 2007), 3D532 (deklaratë dëshmitari me datë 9 janar 2007), para. 2.

¹³⁸¹ P2761 (Përgjigjja serbe ndaj Kërkesës për Ndihmë 1309, 8 dhjetor 2006), f. 1.

¹³⁸² Llakiq Gjoroviq, T. 11712 (14 mars 2007).

555. Gjoroviqi gjithashtu dëshmoi se gjatë kohës në Prishtinë ai mori të dhëna inkriminuese për anëtarët e UJ-së, nënkolonelin Sllobodan Stoshiq dhe kolonelin Miodrag Gjorgjeviq. Ai pati shumë presion për të ndërprerë hetimin kundër Stoshiqit për një numër krimesh të rënda, nga plaçkitjet deri në vrasje.¹³⁸³ Gjatë hetimit të tij, ai pa deklarata prej dy rezervistëve të UJ-së ku thuhej se ata kishin marrë pjesë në dëbimin dhe plaçkitjen e shqiptarëve kosovarë bashkë me “njerëzit” e Stoshiqit dhe disa prej atyre të Frenki Simatoviqit.¹³⁸⁴ Një oficer i organit të sigurimit të Korpusit të Prishtinës shkoi te Gjoroviqi me tre ushtarë të armatosur rëndë dhe të maskuar dhe i kërkoi të ndalonte hetimin e Stoshiqit.¹³⁸⁵ Atij i thanë gjithashtu se çështja do t’i përcillej Spasojeviqit.¹³⁸⁶ Kundër Stoshiqit nisi një procedim në Beograd i cili përfundoi brenda 9 prillit 2002 për mungesë provash.¹³⁸⁷ Dhoma thekson se hetimi kundër Stoshiqit dhe fakti se ishte ndërprerë për mungesë provash, janë shënuar në raportin e vitit 2002 mbi procedimin penal përgatitur prej kryeprokurorit ushtarak, dërguar Misionit të OSBE-së në Serbi dhe Mal të Zi në 2003.¹³⁸⁸ Gjatë dhënies së dëshmisë Spasojeviqi nuk u pyet në lidhje me çështjen. Mirëpo në përgjigje të një kërkese për dosjen e gjykatës prej Prokurorisë, Ministria e Mbrojtjes së Serbisë u përgjigj se nuk mund të gjente asnjë dokument në lidhje me hetime të veprimeve të “njerëzve” të Stoshiqit dhe Frenki Simatoviqit.¹³⁸⁹

556. Gjoroviqi gjithashtu përshkroi se si filloi hetimin kundër një oficeri rezervist në degën e prokurimit në Korpusin e Prishtinës, Millovan Tijaniq, dhe e arrestoi për shpërdorim detyre dhe kompetencash.¹³⁹⁰ Tijaniqi ishte implikuar në blerjen ilegale të mallrave në Kosovë dhe ngritjen e një rrjeti shitjeje. Gjithashtu Gjoroviqi pretendoi se Tijaniqi e kryente këtë operacion me urdhër të Pavkoviqit dhe Ojdaniqit.¹³⁹¹ Sërish ai u ndodh nën presionin e anëtarëve të Administratës së Sigurimit, Branko Zhigiq, Gjakonoviqit (emri nuk dihet), dhe Obrençeviqit, kryeprokurorit ushtarak, për mbylljen e hetimit. Kur refuzoi, atij iu mor dosja e cila iu kalua gjykatësit hetues

¹³⁸³ Llakiq Gjoroviq, T. 11455–11457 (12 mars 2007); *shih edhe* Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 24.

¹³⁸⁴ Llakiq Gjoroviq, T. 11423 (12 mars 2007), P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 24.

¹³⁸⁵ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 24.

¹³⁸⁶ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 25.

¹³⁸⁷ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 26; P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002), f. 2.

¹³⁸⁸ P830 (Raport mbi proceset penale nisur prej organeve gjyqësore ushtarake, 9 prill 2002), f. 1–2. Dyshohej se në tri raste, në prill 1999, Stoshiqi kishte urdhëruar vartësit e tij që të vrisnin afërsisht 20 civilë shqiptarë kosovarë. *Shih edhe* Stanimir Radosavleviq, T. 17492 (23 tetor 2007); 4D171 (Raport i Prokurorit Ushtarak, 6 prill 2001), f. 1.

¹³⁸⁹ P2758 (Përgjigje e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Serbisë), f. 1.

¹³⁹⁰ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 17–20.

¹³⁹¹ Dhoma thekson se megjithëse në deklaratën e tij me shkrim Gjoroviqi deklaroi se “Pavkoviqi dhe Llazareviqi e autorizuan ... Tijaniqin ... të Sigurimit e mallrave ... me gjasë të dobishme për Korpusin e Prishtinës”, ai e ndryshoi deklaratën në gjyq dhe dëshmoi se ishin Pavkoviqi dhe Ojdaniqi ata që autorizuan Tijaniqin. Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 17; T. 11625–11628 (13 mars 2007).

Arsenije Kataniq.¹³⁹² Gjoroviqi pohoi se Millosh Gojkoviqi, Kryetari i Gjykatës së Lartë Ushtarake, urdhëroi Kataniqin që t'i kryente hetimet në një mënyrë të tillë që të rezultonte në mbylljen e tyre.¹³⁹³

557. Branko Zhigiqi, shefi i organit të sigurimit për Qarkun Ushtarak të Beogradit gjatë periudhës së aktakuzës, konfirmoi se Tijaniqi ishte spekulator në kohë lufte dhe se ishte urdhëruar arrestimi i tij, mirëpo ai nuk u arrestua asnjëherë.¹³⁹⁴ Prokuroria e ballafaqoi Zhigiqin me dokumentacionin që tregonte se Tijaniqi ishte subjekt i hetimit të kryer prej zyrës së prokurorit ushtarak me datë fillimi 25 prill 1999, për veprat penale të shkeljes së detyrës dhe falsifikim. Zhigiqi deklaroi se nuk ishte në dijeni të këtij hetimi.¹³⁹⁵ Arsenije Kataniqi konfirmoi se ai ishte përfshirë në çështjen Tijaniq, megjithëse nuk mbante mend për çfarë u akuzua Tijaniqi, apo për hollësitë e provave kundër tij; gjithë çfarë mbante mend ishte se ato nuk ishin thelbësore dhe të bazuara. Për më tepër Kataniqi deklaroi se ai punoi me çështjen që prej fillimit, pra nuk ishte marrë prej Gjoroviqit, dhe se askush nuk kishte ushtruar presion që ai ta procedonte çështjen jo si duhej.¹³⁹⁶

558. Përsëri Dhoma gjykon se dëshmia e Gjoroviqit për hetimin e Tijaniqit, përfshirë edhe faktin se çështja iu hoq prej duarve sepse ai nuk do ta ndërpriste, është e besueshme. Pretendimi i Kataniqit se nuk mbante mend hollësitë e çështjes, megjithëse mbante mend që kishte punuar që prej fillimit, dhe se nuk e kishte marrë prej Gjoroviqit duket i shterpët. Edhe pretendimi i Zhigiqit se nuk ishte në dijeni të arrestimit dhe hetimit të Tijaniqit nuk është i besueshëm. Mirëpo vetëm dëshmia e Gjoroviqit nuk provon jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se Pavkoviqi ose Ojdaniqi ishin implikuar në prokurimin dhe shpërndarjen e paligjshme të mallrave.

559. Gjoroviqi gjithashtu pretendoi se në prill ose maj 1999 dy kolonelë të UJ-së organizuan shantazhimin e ushtarakëve shqiptarë etnikë të cilët jetonin në Beograd dhe gjetiu në Serbi. Koloneli Gjorgje Strunjash ishte kreu i këtij rrjeti që merrte 2000-2500 marka prej çdo ushtari shqiptar me kërcënimin e transferimit në njësitë ushtarake që luftonin.¹³⁹⁷ Gjoroviqi tha se pati një takim me kolonelin Branko Zhigiq, shefi i organit të sigurimit për Qarkun Ushtarak të Beogradit në 1999, në lidhje me akuzat e shantazhimit, dhe se Zhigiqi dinte për implikimin e Strunjashit por nuk bëri asgjë. Gjatë takimeve të tyre Zhigiqi tha se ai dinte për skemën, por ajo ishte organizuar prej

¹³⁹² Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 19–20.

¹³⁹³ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 20.

¹³⁹⁴ Branko Zhigiq, 3D528 (deklaratë dëshmitari me datë 5 janar 2007), para. 5–6, T. 15949–15952 (19 shtator 2007).

¹³⁹⁵ Branko Zhigiq, T. 15953–15954 (19 shtator 2007); *shih edhe* P2864 (Kërkesë e Prokurorisë së Tribunalit drejtuar Beogradit për dokumentacion të Sistemit të Drejtësisë Ushtarake, 30 janar 2006), f. 5.

¹³⁹⁶ Arsenije Kataniq, T. 15968–15969 (19 shtator 2007), 3D530 (deklaratë dëshmitari me datë 18 janar 2007), para. 3–4.

një koloneli në Shtabin e Përgjithshëm dhe ata nuk duhej të hetonin. Më vonë Gjoroviqit i shkuan tetë oficerë të organeve të sigurimit përfshirë edhe Zhigiqin, të cilët ai i përmendi një nga një me emër, që e urdhëruan të ndërpriste çfarëdolloj hetimi të skemës ndryshe “do ‘t’i hiqnin kokën”. Pastaj Gjoroviqi shkoi te Obrençeviçi, kryeprokurori ushtarak për të kallëzuar kërcënimet dhe kërkoi të lirohej nga detyra si prokuror ushtarak në Beograd.¹³⁹⁸

560. Gjorgje Strunjashi, i cili u paraqit si dëshmitar prej Mbrojtjes së Ojdaniqit pretendoi se nuk kishte dijeni për akuzat dhe mohoi vërtetësinë e tyre.¹³⁹⁹ Mirëpo ai konfirmoi se në vitin 1999 kishte punuar në Shtabin e Përgjithshëm, dhe sektorët ushtarakë për të cilët Gjoroviqi pretendoi se ekzistonte skema e zhvatjes, përfshiheshin në Qarkun e Beogradit ku ai punonte.¹⁴⁰⁰ Mirëpo Zhigiqi dëshmoi se nuk ishte në dijeni të akuzave për ekzistencën e një sistemi të tillë zhvatës të parave prej shqiptarëve etnikë.¹⁴⁰¹ Gjithashtu ai pohoi se një prej oficerëve të organeve të sigurimit të cilin Gjoroviqi e përmendi si një nga oficerët që erdhën për ta kërcënuar, faktikisht ishte civil që punonte për “grupin e kundërzbulimit.”¹⁴⁰²

561. E vetmja dëshmi për sistemin zhvatës vjen prej Gjoroviqit dhe e pakonkretizuar në hollësi. Rrjedhimisht Dhoma nuk është në gjendje të konkludojë për ekzistencën reale të kësaj skeme, mirëpo Dhoma nuk dyshon që Gjoroviqi të jetë kërcënuar nga individë për të cilët ai mendonte se ishin të organeve të sigurimit ushtarak në lidhje me përpjekjet e tij hetimore për ekzistencën e kësaj skeme.

562. Gjoroviqi gjithashtu dëshmoi se kur arriti në Prishtinë më 22 maj 1999 për marrjen e detyrës së re, ai dhe Spasojeviçi i cili gjithashtu sapo ishte emëruar prokuror për Komandën e Korpusit të Prishtinës, u thirrën prej degës së Sigurimit Shtetëror të MPB-së (“RDB”). Gjoroviqi pa se RDB-ja kishte marrë një apartament të shqiptarëve kosovarë të dëbuar, mirëpo ai refuzoi të qëndronte atje. Atë e çuan në një shtëpi serbe e cila përdorej si depo për mallrat e vjedhura.¹⁴⁰³

563. Gjoroviqi dëshmoi konkretisht se anëtarët e shtabit të tij, si dhe të UJ-së në përgjithësi, “konfiskuan” makina për përdorim prej UJ-së gjatë periudhës së Aktakuzës.¹⁴⁰⁴ Gjoroviqit iu kërkua të merrte pjesë në një takim për të diskutuar shpërndarjen e këtyre automjeteve UJ-së dhe

¹³⁹⁷ Llakiq Gjoroviç, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 10.

¹³⁹⁸ Llakiq Gjoroviç, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 11–12.

¹³⁹⁹ Gjorgjije Strunjash, T. 15978 (19 shtator 2007).

¹⁴⁰⁰ Gjorgjije Strunjash, T. 15974, 15976 (19 shtator 2007).

¹⁴⁰¹ Branko Zhigiq, 3D528 (deklaratë dëshmitari me datë 5 janar 2007), para. 3.

¹⁴⁰² Branko Zhigiq, T. 15948 (19 shtator 2007).

¹⁴⁰³ Llakiq Gjoroviç, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 32.

MPB-së. Më parë atij i ishin dhënë dokumente në lidhje me dy takime të mëparshme për këtë temë. Prej tyre ai konkludoi se takimi i parë për mënyrën e shpërndarjes së këtyre mallrave midis UJ-së dhe MPB-së dhe fshehja e faktit se ishin të vjedhura, u urdhërua prej Pavkoviqit.¹⁴⁰⁵ Procesverbali i takimit të dytë tregonte se ishte mbajtur në zyrën e Kryetarit të Gjykatës së Lartë Ushtarake në fund të tetorit ose fillim të nëntorit 1999, dhe në të morën pjesë të njëjtët individë.¹⁴⁰⁶ U raportua se Pavkoviqi u zemërua kur dëgjoi për përmbajtjen e takimit të parë, sepse mendonte se për këtë çështje nuk duhej marrë mendimi i njerëzve të ligjit dhe se automjetet e konfiskuara thjesht duhej t'i kalonin, MPB-së, Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes.¹⁴⁰⁷ Në takimin e tretë ku mori pjesë Gjoroviqi, ishin të pranishëm së paku 30 oficerë të Shtabit të Përgjithshëm dhe Ministrisë së Mbrojtjes. Milan Uzelac, ish-shefi i Drejtorisë së Qarkullimit në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së dhe oficerë të tjerë të pranishëm në mbledhje përmendën se Pavkoviqi dhe Ojdaniqi ishin të zemëruar se mjetet ende nuk ishin shpërndarë.¹⁴⁰⁸

564. Pas takimit, Gjoroviqi bashkë me Grigoriye Spasojeviqin nga Shtabi i Përgjithshëm u udhëzuan të hartonin një urdhër që të tëra mallrat në zotërim të UJ-së pas tërheqjes së forcave nga Kosova do të trajtoheshin si plaçkë lufte dhe mbeteshin në zotërim të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe MPB-së. Kur Gjoroviqi nuk e hartoi vendimin siç iu kërkua, Gojoviqi “u tërbua”.¹⁴⁰⁹ Si pasojë, Pavkoviqi dhe Ojdaniqi vendosën kundër lëshimit të urdhrit dhe thjesht vendosën t'i mbanin automjetet dhe mallrat.¹⁴¹⁰

565. Spasojeviqi mohoi se ai dhe Gjoroviqi u thirrën prej organeve të sigurimit shtetëror pas mbërritjes së tyre ose se atyre iu ofrua një apartament i shqiptarëve kosovarë.¹⁴¹¹ Ai gjithashtu deklaroi se kur ishte në Kosovë, ai nuk ngau asnjëherë paligjshmërisht makina të konfiskuara, përkundrazi ai dhe të gjithë anëtarët e tjerë të zyrës së tij përdorën automjete të cilët kishin dokumente dhe regjistrim të rregullt në UJ në kohë paqeje.¹⁴¹²

¹⁴⁰⁴ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 40–41; Llakiq Gjoroviq, T. 11470–11474, 11479–11480 (12 mars 2007). *Krahaso.* Millan Uzelac, T. 16158 (21 shtator 2007); Millosh Spasojeviq, 3D532 (deklaratë dëshmitari me datë 9 janar 2007), para. 7.

¹⁴⁰⁵ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 41. *Krahaso.* Millan Uzelac, T. 16162, 16172–16173 (21 shtator 2007).

¹⁴⁰⁶ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 42.

¹⁴⁰⁷ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 42. *Krahaso.* Millan Uzelac, T. 16164 (21 shtator 2007).

¹⁴⁰⁸ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 43; T. 11476–11477 (12 mars 2007). *shih* P2752 (Tabelë me të dhënat e makinave të konfiskuara përkohësisht, 23 nëntor 1999). *Krahaso.* Millan Uzelac, T. 16164 (21 shtator 2007).

¹⁴⁰⁹ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 45.

¹⁴¹⁰ Llakiq Gjoroviq, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 45.

¹⁴¹¹ Millosh Spasojeviq, 3D532 (deklaratë dëshmitari me datë 9 janar 2007), para. 3.

¹⁴¹² Millosh Spasojeviq, 3D532 (deklaratë dëshmitari me datë 9 janar 2007), para. 7.

566. Millan Uzelaci dëshmoi se në gjysmën e dytë të vitit 1999 Shtabi i Përgjithshëm bëri përpjekje për zgjidhjen e problemit të automjeteve të cilat nuk ishin pjesë e “strukturës dikasteriale.” Ndërkohë që origjina e tyre e saktë nuk mund të përcaktohej, përgjithësisht këto automjete ishin konfiskuar prej doganës dhe i ishin dhënë përkohësisht UJ-së, ishin konfiskuar prej autoriteteve gjyqësore gjatë kryerjes së krimeve, ose ishin konfiskuar në zona ku kishte patur luftime.¹⁴¹³ Gjithashtu ai deklaroi se organeve ligjore të UJ-së iu kërkua të ndihmonin në gjetjen e zgjidhjeve për këtë problem. Në korrik ose gusht 1999 u mbajt takimi i parë ku merrnin pjesë zyrtarë të ndryshëm, përfshirë shërbimet ligjore dhe gjykatat, për diskutimin e çështjes.¹⁴¹⁴ Takimi i dytë u mbajt në nëntor 1999 në ndërtesën e Shtabit të Përgjithshëm, me pjesëmarrjen e më shumë njerëzve.¹⁴¹⁵ Uzelaci gjithashtu dëshmoi se megjithëse u bënë përpjekje të menjëhershme për kthimin e automjeteve te pronarët e tyre pas luftës, UJ-ja nuk bëri asnjë njoftim publik nëpërmjet të cilit t’u bënte thirrje pronarëve që të paraqiteshin për të marrë automjetet e tyre.¹⁴¹⁶

567. Një çështje të cilën Gjoroviqi trajtoi pas ardhjes në Prishtinë në maj 1999, ishte një kallëzim penal depozituar kundër dy oficerëve të sigurimit nga Korpusi i Prishtinës, Zoran Ristevski dhe Aleksandar Stefanoviqi, ku përshkruhej mënyra e organizimit të vjedhjes së pronave të shqiptarëve kosovarë në Prishtinë dhe rrethinë. Në kallëzim deklarohet se këta oficerë kishin dëbuar shqiptarë kosovarë, kishin rrahur tre romë, dhe kishin vjedhur mallra si televizorë dhe makina të shtrenjta dhe i kishin sjellë në Çaçak, fshat në Serbinë qendrore.¹⁴¹⁷ Major Neshiqi i degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës i konfirmoi Gjoroviqit se këta individë kishin kryer veprat e pretenduara në kallëzimin penal, por kërkoi që ai të tërhiqte aktakuzën kundër tyre.¹⁴¹⁸ Sipas Gjoroviqit, më vonë u zhdukën 17 dosje çështjesh prej gjykatës në Prishtinë, përfshirë dosjen e çështjeve kundër kapitenit Zoran Ristevski dhe rreshterit Aleksandar Stefanoviqi.¹⁴¹⁹ Momir Stojanoviqi, ish-shef i degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës këmbënguli se, as ai, as Neshiqi nuk ushtruan presion mbi organet gjyqësore, duke argumentuar se nuk ishte logjike të arrestoheshin këta individë dhe pastaj të ushtrohej presion mbi organet gjyqësore për tërheqjen e akuzave.¹⁴²⁰

568. Gjatë kohës si prokuror ushtarak në Prishtinë, Gjoroviqi gjithashtu u informua se majori Neshiq kishte organizuar një rrjet njerëzish të cilët plaçkitnin dyqane dhe ndërmarrje shqiptare kosovare dhe fitimet kriminale i transportonin në Serbi. Të implikuar ishin tre anëtarë të MPB-

¹⁴¹³ Millan Uzelac, T. 16158 (21 shtator 2007).

¹⁴¹⁴ Millan Uzelac, T. 16162 (21 shtator 2007).

¹⁴¹⁵ Millan Uzelac, T. 16172–16173 (21 shtator 2007).

¹⁴¹⁶ Millan Uzelac, T. 16177–16178 (21 shtator 2007).

¹⁴¹⁷ Llakiq Gjoroviqi, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 29.

¹⁴¹⁸ Llakiq Gjoroviqi, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 30.

¹⁴¹⁹ Llakiq Gjoroviqi, T. 11605–11606 (13 mars 2007); P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 27.

¹⁴²⁰ Momir Stojanoviqi, T. 19792 (7 dhjetor 2007).

së/RDB-së në Prishtinë si dhe anëtarë të organeve të sigurimit ushtarak të Korpusit të Prishtinës. Gjoroviqi urdhëroi zëvendësin e tij të përgatiste një kërkesë për nisjen e hetimit duke propozuar arrestimin e major Neshiqit dhe të të dyshuarve të tjerë, dhe informoi Obrençeviqin dhe Radosavleviqin. Gjithashtu ai kërkoi këshillë në lidhje me juridiksionin e tij për civilët e implikuar. Duket se ai nuk mori asnjë përgjigje prej eprorëve. Më pas çështja iu transferua Degës Ushtarake të Gjykatës së Qarkut të Beogradit. Në kohën që Gjoroviqi dha deklaratën me shkrim, çështja nuk kishte përfunduar.¹⁴²¹

v. *Konkluzione*

569. Dhoma është bindur se në UJ ekzistonte një sistem funksionues i drejtësisë ushtarake, i cili ishte në veprim gjatë konfliktit në Kosovë që filloi më 24 mars 1999. Prokurorët dhe gjykatësit ushtarakë të kohës së luftës ishin në gjendje dhe në disa raste proceduan një numër çështjesh, kryesisht krime të lehta dhe ato të kryera kundër vetë UJ-së, si shmangia e shërbimit ushtarak ose dezertimi. Mirëpo sistemi nuk ishte efektiv në hetimin, procedimin dhe ndëshkimin e përgjegjësve të krimeve të rënda kundër popullatës civile. Në këtë aspekt sistemi dështoi për shkak të një sërë problemesh të brendshme mbi të cilat komandantët e UJ-së mund të kenë patur kontroll, dhe faktorë të jashtëm jashtë kontrollit të tyre. Ndër problemet e brendshme përfshihen pengimi i procesit në faza të ndryshme prej anëtarëve të UJ-së dhe parandalimi i procedimit të individëve që kryen krimet. Për më tepër, dallimi midis numrit të vogël të krimeve të rënda të kallëzuara në organet gjyqësore dalë prej hulumtimit të raporteve të ndryshme mbi punën e sistemit të drejtësisë ushtarake dhe numrit të madh të krimeve që po ndodhnin siç përshkruhet ndër të tjera në Vëllimin 2 të këtij Aktgjykimi tregon se kallëzimi i veprave penale në sistemin e drejtësisë ushtarake ishte në një masë konsiderueshmërisht të pakët. Problemet e brendshme përfshijnë me faktorë të jashtëm që e bënte të vështirë procedimin penal, si p.sh. periudha e shkurtër e punës së gjykatave në kohë lufte, vështirësitë e funksionimit në një zonë lufte, dhe prani e kufizuar në Kosovë pas luftës.

2. Forcat e UJ-së në Kosovë më 1998–1999

570. Pas paraqitjes së strukturës së UJ-së dhe niveleve të larta komanduese në vitet 1998 dhe 1999, si dhe funksionimit të sistemit të drejtësisë ushtarake, tani i vjen radha analizës së forcave të UJ-së që vepronin në atë kohë në Kosovë.

571. Prokuroria ka nxjerrë në pah ankesat e shprehura nga Momçillo Perishiçi në vitin 1998, kur ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm, dhe nga ish-kreu i Administratës së Sigurimit Aleksandar Dimitrijeviç, në lidhje me mënyrën e përdorimit të UJ-së në Kosovë dhe kërkesat e tyre të

¹⁴²¹ Llakiq Gjoroviç, P2671 (deklaratë dëshmitari me datë 1 shtator 2006), para. 34.

vazhdueshme për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme ose diçka të ngjashme në mënyrë që ushtria të përdorej në mënyrë legjitime.

572. Perishiqi bëri disa herë të ditur në forume të ndryshme se pa shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme, roli i UJ-së ishte i kufizuar. Në mbledhjen e pestë të KLM-së, mbajtur më 9 qershor 1998, ai bëri një ekspozé të rreziqeve të mundshme që i kanoseshin vendit prej vendeve fqinje, veçanërisht Shqipëria, si dhe pozicionet e trupave të UJ-së në Kosovë.¹⁴²² Gjatë ekspozesë së tij, ai shpjegoi se UJ-ja ishte e përqëndruar vetëm në brezin kufitar dhe këtu si “ushtri në kohë paqeje”. Ai pohoi se UJ-ja nuk mund të angazhohej brenda Kosovës, veçse në rast sulmi; ndryshe bashkësia ndërkombëtare do të kishte një pretekst për të ndërhyrë në RFJ. Pas kësaj ekspozije, KLM-ja e pranoi njëzëri raportin e Perishiqit dhe konkludoi se, në qoftë se “veprimtaria terroriste” përshkallëzohej, UJ-ja “do të ndërhynte siç duhej”.¹⁴²³ Gjatë një takimi të kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së më 20 korrik 1998, Perishiqi përmendi një urdhër të lëshuar prej tij ku shprehimisht ndalohej përdorimi i UJ-së me përjashtim të mbrojtjes së kufirit, mbrojtjes së objekteve ushtarake, dhe në mbrojtje të personelit ushtarak, dhe deklarohet se në çfarëdo rrethanash të tjera, përdorimi i UJ-së do të autorizohet me vendim të veçantë.¹⁴²⁴ Më pas, më 23 korrik 1998 Perishiqi i dërgoi një letër Presidentit të RFJ-së, Millosheviqit, ku ankohej se në qoftë se UJ-ja do të përdorej brenda Kosovës dhe jashtë brezit kufitar, në ato rrethana duhej shpallur gjendje e jashtëzakonshme. Perishiqi argumentonte se pa gjendje të jashtëzakonshme, “çfarëdo angazhimi i UJ-së në operacione luftimi jashtë zonës kufitare dhe më tej ishte përsëri i paligjshëm”¹⁴²⁵

573. Në mbledhjen e gjashtë të KLM-së, zhvilluar më 4 tetor 1998, Perishiqi ndër të tjera propozoi që Kuvendi Federal të deklaronte rrezikun e një lufte të afërt duke marrë parasysh kërcënimin e NATO-s për ndërhyrje në atë kohë. Gjulkanoviçiqi nuk u pajtua me këtë propozim me arsyetimin se mund të provokonte sulm të NATO-s. Gjithsesi Millosheviçiqi deklaroi se për shpalljen e rrezikut të luftës, duhej kontaktuar Kuvendi Federal, për të cilin ishte planifikuar të mblidhej të nesërmen.¹⁴²⁶ Dhoma nuk ka dëgjuar dëshmi nëse kjo çështje u ngrit në Kuvendin Federal, mirëpo në atë kohë nuk u deklarua rrezik i një lufte të afërt.

574. Në mbledhjen e tetë të KLM-së, më 25 dhjetor 1998, kur u paraqit propozimi i Ojdaniçiqit për emërimin e Pavkoviçiqit si komandant i Armatës së Tretë, Presidenti i Malit të Zi deklaroi se pati informacion kundërthënës në lidhje me rolin e Korpusit të Prishtinës në Kosovë, duke bërë të ditur

¹⁴²² 1D760 (Shënime stenografike të sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 9–10.

¹⁴²³ 1D760 (Shënime stenografike të sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 9–10.

¹⁴²⁴ P922 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 20 korrik 1998), f. 3.

¹⁴²⁵ P717 (Letër e Momçillo Perishiqit drejtuar Sllobodan Millosheviçiqit, 23 korrik 1998), f. 2.

¹⁴²⁶ P1575 (Procesverbal i sesionit të 6-të të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 3–4, 10.

se jo gjithmonë ai vepronte në përputhje me rolin kushtetues të UJ-së në Kosovë dhe vendimet e KLM-së.¹⁴²⁷ Aleksandar Dimitrijeviqi gjithashtu ngriti problemin e përdorimit të UJ-së në Kosovë në mbledhjen e kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së më 17 dhjetor 1998.¹⁴²⁸ Në një mbledhje tjetër të të njëjtit organ më 30 dhjetor 1998, Dimitrijeviqi sërish renditi problemet e brendshme të sigurisë për RFJ-në dhe më tej këshilloi që UJ-ja t'i përmbahej detyrës së saj parësore të mbrojtjes së kufirit.¹⁴²⁹ Gjatë dhënies së dëshmisë kur iu tregua letra e 23 korrikut 1998 e Perishiqit për Millosheviqin në lidhje me përdorimin e UJ-së jashtë detyrave të saj dhe në lidhje me nevojën e shpalljes së gjendjes së luftës, Dimitrijeviqi pranoi se ai pajtohej me këtë qëndrim për arsye se mendonte që shteti duhej ta përdorte UJ-në në mënyrë kushtetuese.¹⁴³⁰

575. John Crosland, i cili ishte Atashé për Mbrojtjen në ambasadën britanike në Beograd, dëshmoi se Shërbimi për Kontakte të Jashtme i UJ-së i kishte shpjeguar se roli kushtetues i UJ-së ishte siguria e kufirit shtetëror.¹⁴³¹ Crosland-i gjithashtu deklaroi se Perishiqi dhe Dimitrijeviqi i "kishin lënë të kuptonte" se nuk pajtoheshin me përdorimin prej Pavkoviqit të UJ-së jashtë kufizimeve kushtetuese, për operacione kundër UÇK-së në brendësi të Kosovës në 1998.¹⁴³²

576. Mirëpo Mbrojtjet e Pavkoviqit dhe Llazareviqit argumentojnë se UJ-ja u përdor ligjërisht në Kosovë kundër UÇK-së kurdoherë që ishte e nevojshme.¹⁴³³ Veçanërisht, Mbrojtja e Pavkoviqit argumenton se shpallja e gjendjes së jashtëzakonshme ose e gjendjes së luftës, nuk ishte parakusht i nevojshëm për përdorimin e UJ-së brenda Kosovës në operacione kundër UÇK-së. Në mbështetje të këtij qëndrimi, Mbrojtja e Pavkoviqit i referohet Rregullores së Shërbimit të UJ-së, ku shkruhet se njësitë e UJ-së "mund të përdoren në luftë kundër grupeve të jashtëligjshme, sabotuese, terroriste dhe grupeve të tjera të armatosura armiqësore ose për të parandaluar dhe eliminuar gjendjen e jashtëzakonshme në përputhje me një vendim të Presidentit të RFJ-së ose Këshillit të Lartë të Mbrojtjes", dhe se "urdhri për përdorimin e njërive të ushtrisë për kryerjen e këtyre detyrave ...

¹⁴²⁷ P1000 (Procesverbal i sesionit të 8-të të KLM-së, 25 dhjetor 1998), f. 9.

¹⁴²⁸ 3D494 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 17 dhjetorin 1998), f. 19. Ai deklaroi se "Unë ende mbështes vendosmërisht idenë se ne, dhe këtu kemi raportet më të fundit, se ne duhet të përqëndrohemi në detyrën që na është ngarkuar në Kushtetutë, mbrojtjen e kufirit. As komandanti i Korpusit dhe as komandanti i Armatës së Tretë nuk mund të vazhdojnë të na thonë se kanë marrë të gjitha masat, ndërkaq forcat në terren shtohen gjithnjë e më shumë, faji për këtë do të bjerë sërish mbi ne." Më tej ai deklaroi se UJ-ja duhej të mbyllte kufirin sa të ishte e mundur për t'i mundësuar MPB-së të luftonte terrorizmin në brendësi duke qenë se kjo "nuk ishte detyra e UJ-së".

¹⁴²⁹ P928 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 30 dhjetorin 1998), f. 8.

¹⁴³⁰ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26686–26687 (9 korrik 2008); P717 (Letër e Momçillo Perishiqit drejtuar Sllobodan Millosheviqit, 23 korrik 1998), f. 1.

¹⁴³¹ John Crosland, T. 9972 (8 shkurt 2007).

¹⁴³² John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari me datë 31 tetor 2006), para. 48. *Shih edhe* Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26670-26671 (9 korrik 2008); P684 (Raport Konfidencial mbi Situatën e Përfaqësuesit Ushtarak britanik, 6 nëntor 1998), para. 5.

¹⁴³³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 155; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 549.

lëshohet prej shefit të Shtabit të Përgjithshëm”.¹⁴³⁴ Interpretimi i kësaj dispozite prej Mbrojtjes është se UJ-ja mund të përdorej në mënyrë të ligjshme kundër UÇK-së me udhëzim të Presidentit të RFJ-së ose KLM-së. Ratko Markoviqi dëshmoi se në bazë të nenit 133 të Kushtetutës, UJ-ja kishte detyrë mbrojtjen e sovranitetit, territorit, pavarësisë dhe rendit kushtetues të RFJ-së. Ai deklaroi se UJ-ja mund të vendoste vetë për ekzistencën e kërcënimit kundër këtyre elementëve dhe për ndërmarrjen e operacioneve ushtarake në përballimin e rreziqeve të tilla.¹⁴³⁵

577. Argumenti i Prokurorisë se UJ-ja nuk mund të angazhohej brenda Kosovës pa gjendje të jashtëzakonshme mbështetet prej faktit se në vitin 1998 dhe fillim të vitit 1999 gjerësia e brezit kufitar në Kosovë u zmadhua disa herë. Në brezin kufitar, me përjashtim të zonave të populluara dhe pikave të kalimit kufitar siguria e të cilave ishte në ngarkim të MPB-së, UJ-ja kishte kompetenca të ngjashme me ato policore.¹⁴³⁶ Neni 48 i Ligjit mbi Kalimin e Kufirit dhe Lëvizjen në Brezin Kufitar i përkufizonte detyrat e UJ-së në kufi në këtë mënyrë: “Njësitë ushtarake kufitare mbrojnë kufirin shtetëror dhe kontrollojnë lëvizjen dhe qëndrimin në zonën kufitare jashtë vendeve të populluara dhe pikave të kalimit kufitar për të parandaluar kalimin e paautorizuar të kufirit shtetëror dhe shkeljen e vijës kufitare”.¹⁴³⁷

578. Sipas Rade Çuçakut, i cili ishte shef i Degës për Çështje Kufitare brenda Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, brezi kufitar rreth RFJ-së normalisht ishte 100 metër i gjerë;¹⁴³⁸ mirëpo në Kosovë u zmadhua tri herë në 1998 dhe 1999, më 23 prill 1998,¹⁴³⁹ 21 korrik 1998,¹⁴⁴⁰ dhe 5 mars 1999,¹⁴⁴¹ dhe arriti gjerësinë dhjetë¹⁴⁴² kilometra.¹⁴⁴³ Çuçaku shpjegoi se zgjerimi i brezit kufitar nuk ishte i njëjtë përgjatë shtrirjes së tij, vetëm zonat veçanërisht të ashpra ose të padepërtueshme

¹⁴³⁴ 4D532 (Rregullorja e Shërbimit të UJ-së e vitit 1996), rregulla 473.

¹⁴³⁵ Ratko Markoviq, T. 13003-13010, 13013 (7 gusht 2007).

¹⁴³⁶ Rade Çuçak, 3D1083 (deklaratë dëshmitari me datë 17 gusht 2007), para. 5–6, T. 14831–14832 (31 gusht 2007), 14841 (4 shtator 2007); Miodrag Simiq, T. 15503–15504 (12 shtator 2007); Branko Gajiq, T. 15220 (7 shtator 2007); Momir Bullatoviq, T. 13925 (17 gusht 2007).

¹⁴³⁷ 3D1122 (Ligj për Kalimin e Kufirit Shtetëror), neni 48; *shih edhe* Rade Çuçak, 3D1083 (deklaratë dëshmitari me datë 17 gusht 2007), para. 5.

¹⁴³⁸ Rade Çuçak, T. 14833 (31 gusht 2007).

¹⁴³⁹ Rade Çuçak, T. 14877 (4 shtator 2007); *shih edhe* 4D323 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës bazuar në Vendimin Federal për Zgjerimin e Zonës Kufitare, 7 maj 1998), f. 1.

¹⁴⁴⁰ 1D230 (Vendim mbi Krijimin e Zonave Kufitare Përgjatë Segmenteve të Kufirit Shtetëror të RFJ-së, 21 korrik 1998), gjithashtu pranuar si 3D740 (brezi kufitar u zgjerua deri në afërsisht dy kilometra).

¹⁴⁴¹ Më 5 mars 1999 brezi kufitar u zgjerua sërish në një thellësi afërsisht pesë kilometra, si kundërmasë ndaj “sulmeve të ashpra në brezin kufitar dhe në zonat kufitare me Shqipërinë dhe Maqedoninë ... si nga Shqipëria po ashtu edhe nga territori i zonës kufitare”. Rade Çuçak, 3D1083 (deklaratë dëshmitari me datë 17 gusht 2007), f. 6–7; 1D312 (Vendim që Ndryshon Vendimin e Përcaktimit të Zonës Kufitare në Disa Segmente të Kufirit Shtetëror të RFJ-së, 5 mars 1999), gjithashtu pranuar si 3D406.

¹⁴⁴² Karol John Drewienkiewicz, T. 7809–7812 (4 dhjetor 2006) (dëshmoi se “zona kufitare” u zgjerua në një thellësi nga 5 në 10 kilometra më 16 mars 1999), P2508 (deklaratë dëshmitari me datë 23 qershor 2000), para. 188.

¹⁴⁴³ Momir Bullatoviq, T. 13823 (16 gusht 2007).

(p.sh. rajonet malore), ose zonat me numër të lartë incidentesh u zgjeruan më shumë se zonat e depërtueshme dhe/ose më pak aktive.¹⁴⁴⁴

579. Dhoma nuk mund të përcaktojë ligjshmërinë ose paligjshmërinë e dislokimit të forcave të UJ-së në Kosovë jashtë zonës kufitare, para shpalljes së një gjendjeje të jashtëzakonshme, dhe as nuk është e nevojshme ta bëjë këtë. Pavarësisht nga pikëpamjet ligjore, brenda UJ-së ekzistonin njerëz të rëndësishëm që shprehën shqetësim në lidhje me rregullsinë e përdorimit të UJ-së brenda Kosovës në vitet 1998 dhe në fillim të vitit 1999, në mungesë të gjendjes së jashtëzakonshme.

a. Mobilizimi i përgjithshëm brenda UJ-së para bombardimit të NATO-s

580. Pas shpalljes së gjendjes së luftës në RFJ në mars 1999, dhe me vendim të Presidentit të RFJ-së, shefi i Shtabit të Përgjithshëm vendosi të mobilizonte komandat, njësitë dhe institucionet e UJ-së.¹⁴⁴⁵

581. Plani për mbrojtjen e RFJ-së në rast sulmi nga jashtë njihej si plani *Grom 3*, i cili ishte udhëzim për mbrojtjen e shtetit kundër kërcënimit prej sulmeve të NATO-s dhe UÇK-së, lëshuar më 15 janar 1999.¹⁴⁴⁶ Llazareviqi dëshmoi ky plan ishte baza e angazhimit të Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës në Kosovë.¹⁴⁴⁷ Millorad Obradoviqi dëshmoi se kjo direktivë ishte hartuar për angazhimin e UJ-së në masa mbrojtëse anembanë Kosovës për përbalimin e rrezikut të sulmit të jashtëm prej kufirit maqedonas.¹⁴⁴⁸

582. Sipas Sllobodan Kosovacit, afërsisht 300.000 rekrutë brenda UJ-së u mobilizuan para nisjes së bombardimit të NATO-s, dhe paraqitja ishte 90 për qind.¹⁴⁴⁹ Deri më 20 prill 1999, brenda UJ-së u mobilizuan 150.000 rezervistë.¹⁴⁵⁰ Prej këtyre, afërsisht 35.000 shërbenin në Korpusin e Prishtinës.

¹⁴⁴⁴ Rade Çuçak, T. 14853, 14877 (4 shtator 2007); *shih edhe* 3D739 (Hartë e kufirit Kosovë-Shqipëri dhe Kosovë-Maqedoni) (tregohet se zgjerimi i brezit kufitar i 21 korrikut 1998 ishte i dukshëm, dhe vendimi i 5 marsit 1999 kontribuoi në zgjerim të konsiderueshëm në disa vende).

¹⁴⁴⁵ Sllobodan Kosovac, T. 15797–15799, 15813 (17 shtator 2007); *shih edhe* 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 64.

¹⁴⁴⁶ 3D690 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për Angazhimin e UJ-së, Direktiva *Grom 3*, 16 janar 1999), f. 3–5.

¹⁴⁴⁷ Vladimir Llazareviq, T. 17894 (8 nëntor 2007).

¹⁴⁴⁸ Millorad Obradoviq, T. 15020 (5 shtator 2007); *shih edhe* 3D704 (Notë informuese për Presidentin e RFJ-së, 12 shkurt 1999).

¹⁴⁴⁹ Sllobodan Kosovac, T. 15800 (17 shtator 2007).

¹⁴⁵⁰ Sllobodan Kosovac, T. 15808 (17 shtator 2007); *shih edhe* Geza Farkash, T. 16302 (25 shtator 2007).

b. Armata e Tretë

583. Zona e përgjegjesisë së Armatës së Tretë mbulonte Serbinë jugore, përfshirë tërë Kosovën.¹⁴⁵¹ Popullata që jetonte brenda kësaj zone përgjegjësie arrinte 3.7 milion banorë, të shpërndarë në më shumë se 70 komuna.¹⁴⁵² Dushan Samarxhiqi ishte komandant i Armatës së Tretë gjatë vitit 1998 deri më 13 janar 1999 kur ai u zëvendësua prej Pavkoviqit.¹⁴⁵³ Miodrag Simiqi ishte shef i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës së Tretë gjatë vitit 1998; në janar 1999 ai u zëvendësua prej Lubisha Stojimiroviqit.¹⁴⁵⁴

584. Armata e Tretë kishte në varësi Korpusin e Prishtinës, Korpusin e Nishit si dhe Qarqet Ushtarake të Prishtinës dhe Nishit së bashku me Degët e tyre Ushtarake.¹⁴⁵⁵ Komandat, njësitë dhe institucionet e Armatës së Tretë ishin grupuar në garnizone dhe qytete-garnizone.¹⁴⁵⁶

585. Konkretisht, gjatë bombardimit të NATO-s u mobilizuan plotësisht rreth 40 njësi të Armatës së Tretë dhe pjesërisht 36 njësi të kësaj Armate.¹⁴⁵⁷ Në një raport luftimesh të Komandës së Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së informohej për efektivin e gjithsejtë të Armatës së Tretë që numëronte 67.225 vetë më 2 prill 1999 dhe përbënte 51 për qind të efektivit të plotë në kohë lufte që numëronte 130.771 vetë.¹⁴⁵⁸

i. Postëkomanda të ndryshme

586. Armata e Tretë e kishte selinë në qytetin Nish, në Serbinë jugore.¹⁴⁵⁹ Gjatë periudhës së Aktakuzës, kishte një Postëkomandë, një Postëkomandë Pararojë, një Postëkomandë Praparojë dhe Një Postëkomandë Lufte ose Rezervë.¹⁴⁶⁰ Prej 24 marsit deri në fillim të korrikut 1999,

¹⁴⁵¹ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 17, T. 17643 (26 tetor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Lazareviqit me Prokurorinë), f. 14–15; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 12.

¹⁴⁵² Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 17, T. 17643 (26 tetor 2007).

¹⁴⁵³ P800 (Raport mbi marrjen e detyrës së Komandantit të Armatës së Tretë prej Nebojsa Pavkoviqit, 13 janar 1999), gjithashtu pranuar si 4D36; P802 (Raport mbi dorëzimin e detyrës së Komandantit të Armatës së Tretë prej Dushan Samarxhiqit, 13 janar 1999).

¹⁴⁵⁴ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 8, T. 17642, 17658 (26 tetor 2007).

¹⁴⁵⁵ Lubisha Stojimiroviq, T. 17646 (26 tetor 2007); Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari me datë 30 Janar 2004), para. 6–9; *shih edhe* 4D240 (Struktura, Dislokimi dhe Madhësia Numerike e Komponentit Ushtarak-Territorial të Armatës së Tretë, 14 Janar 1999), f. 1.

¹⁴⁵⁶ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 14, T. 17645 (26 tetor 2007); *shih edhe* 4D240 (Struktura, Dislokimi dhe Madhësia Numerike e Komponentit Ushtarak-Territorial të Armatës së Tretë), f. 5. Lazareviqi sqaroi se shtatë garnizone të Korpusit të Prishtinës ndodheshin në territorin e Kosovës dhe një jashtë territorit. Vladimir Lazareviq, T. 17776–17777 (6 nëntor 2007).

¹⁴⁵⁷ Sllobodan Kosovac, T. 15814 (17 shtator 2007); *shih edhe* 5D261 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 13 mars 1999), f. 1.

¹⁴⁵⁸ 4D275 (Raport Luftimi i Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 2 prill 1999), f. 2.

¹⁴⁵⁹ Velimir Obradoviq, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 24.

¹⁴⁶⁰ Miodrag Jankoviq, 4D504 (deklaratë dëshmitari me datë 1 tetor 2007), para. 4, 6, 20.

Postëkomanda e saj u vendos në objekte të ndryshme të garnizonit të Nishit.¹⁴⁶¹ Shefi i atëhershëm i Shtabit të Përgjithshëm, Perishiq, vendosi të ngrinte një Postëkomandë Pararojë për Armatën e Tretë në kazermën *Kosovski Junaci*, Prishtinë, më 27 korrik 1998 në përgjigje të përshkallëzimit të veprimeve të UÇK-së.¹⁴⁶² Postëkomanda Pararojë ishte përgjegjëse për nxjerrjen e urdhrave prej komandantit të Armatës së Tretë, miratimin e vendimeve prej komandantëve të njëjësive vartëse, përgatitjen e raporteve ditore të luftimit që i dërgoheshin për informim Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dhe Komandës së Armatës së Tretë në Nish, dhe hartimin e planeve dhe analizave.¹⁴⁶³

587. Komandanti i Armatës së Tretë, Samarxhiqi, ishte në Postëkomandën Pararojë prej fundit të korrikut deri në fund të tetorit 1998,¹⁴⁶⁴ në krye të një ekipi prej afërsisht 10 oficerësh nga degë të ndryshme. Në atë kohë në Postëkomandën Pararojë punonte edhe Miodrag Simiqi, shefi i atëhershëm i Shtabit të Armatës së Tretë.¹⁴⁶⁵ Sipas Zharko Kostiqit, i cili gjithashtu ishte në postëkomandë prej fundit të korrikut deri në fund të gushtit 1998, Pavkoviqi, komandant i atëhershëm i Korpusit të Prishtinës, dhe Millan Gjakoviqi, ndihmësshef i atëhershëm i Shtabit për Operacionet dhe Stërvitjen në Komandën e Korpusit të Prishtinës,¹⁴⁶⁶ e vizitonin çdo ditë Postëkomandën Pararojë.¹⁴⁶⁷ Mlladenoviqi i cili gjithashtu punoi në Postëkomandën Pararojë prej 27 korrikut 1998, deri në suprimimin e saj,¹⁴⁶⁸ shpjegoi se Postëkomanda u suprimua në fund të tetorit 1998 sepse Armata e Tretë i kishte kryer detyrat themelore, dhe për arsye se ekzistenca e kësaj pike nuk ishte më e nevojshme.¹⁴⁶⁹

588. Për shkak të shtimit të vështirësive në gjendjen e sigurisë në zonën e përgjegjësisë së Armatës së Tretë gjatë vitit 1999, Pavkoviqi, në atë kohë komandant i Armatës së Tretë, vendosi të

¹⁴⁶¹ Lubisha Stojimiroviq, T. 17667 (26 tetor 2007).

¹⁴⁶² 3D697 (Dokument nga Pasanaliza e Postëkomandës Pararojë të Armatës së Tretë mbi realizmin e detyrave në Kosovë, 2 tetor 1998), f. 2; *shih edhe* Zharko Kostiq, T. 17524 (23 tetor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 104–105; Miodrag Jankoviq, 4D504 (deklaratë dëshmitari me datë 1 tetor 2007), para. 16; Velimir Obradoviq, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 24; Tomisllav Mlladenoviq, 4D505 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 8–10, T. 17598 (25 tetor 2007).

¹⁴⁶³ Tomisllav Mlladenoviq, 4D505 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 13.

¹⁴⁶⁴ Velimir Obradoviq, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 24.

¹⁴⁶⁵ Tomisllav Mlladenoviq, 4D505 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 9. Sipas Llazareviqit, Postëkomanda Pararojë e Armatës së Tretë përbëhej nga një grup shumë i fortë komande dhe në disa raste atje ishin të pranishëm edhe shefi i Shtabit, madje edhe komandanti i Armatës së Tretë; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 104–105.

¹⁴⁶⁶ Zllatomir Peshiq, T. 7203 (23 nëntor 2006); Aleksandar Vasileviq, T. 8799 (22 janar 2007); Momir Stojanoviq, T. 19761 (7 dhjetor 2007).

¹⁴⁶⁷ Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë dëshmitari me datë 28 shtator 2007), para. 22; *shih edhe* Zharko Kostiq, T. 17502–17503, 17524 (23 tetor 2007).

¹⁴⁶⁸ Tomisllav Mlladenoviq, T. 17568, 17598 (25 tetor 2007). *Shih edhe* Velimir Obradoviq, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 24; Lubisha Stojimiroviq, T. 17661 (26 tetor 2007).

¹⁴⁶⁹ Tomisllav Mlladenoviq, T. 17598–17599 (25 tetor 2007).

ngrinte sërish një Postëkomandë Pararojë në Prishtinë më 1 shkurt 1999.¹⁴⁷⁰ Fillimisht Postëkomanda u vendos në kazermën *Kosovski Junaci* dhe në të u caktuan 10-15 oficerë të Komandës së Armatës së Tretë.¹⁴⁷¹ Vendndodhja fillestare e postëkomandës ishte 100-200 metra prej Komandës së Korpusit të Prishtinës.¹⁴⁷² Gjithsesi Mirko Starçeviqi dëshmoi se kjo vendndodhje ndryshoi disa herë gjatë bombardimit të NATO-s. Një herë Postëkomanda u vendos në “Gërmijë, Kishnicë” dhe një herë tjetër në Graçanicë.¹⁴⁷³ Gjatë sulmeve ajrore të NATO-s Pavkoviqi ishte vazhdimisht i pranishëm në Prishtinë,¹⁴⁷⁴ siç përshkruhet me hollësi në pjesën mbi përgjegjësinë e tij penale individuale më poshtë.

ii. Struktura

589. Komanda e Armatës së Tretë kishte organe të specializuara detyra e të cilave ishte planifikimi dhe zbatimi i detyrave bazuar në vendimet e komandantit të Armatës së Tretë. Këto organe ishin: Seksioni i Informacionit dhe Udhëheqjes Morale, Seksioni i Çështjeve Ligjore, Seksioni i Personelit, Dega e Sigurimit, Organi i Logjistikës, dhe Shtabi i Komandës.¹⁴⁷⁵ Dhoma dëgjoi dëshmi në lidhje me secilin prej këtyre organeve, të cilat i ka mbajtur parasysht gjatë analizës së funksionimit të Armatës së Tretë në vitet 1998 dhe 1999.¹⁴⁷⁶

590. Dega e sigurimit të Armatës së Tretë me në krye kolonel Antiqin në periudhën përkatëse, mori masa për mbrojtjen e njësisë prej veprimtarisë armiqësore dhe për zbatimin e masave vetëmbrojtëse, si p.sh. shqyrtimi i informacionit për kryerje krimesh të juridiksionit të gjykatave ushtarake.¹⁴⁷⁷ Ajo mund të përdorte edhe njësitë e policisë ushtarake dhe ishte përgjegjëse për gatishmërinë e tyre luftarake, nivelin e stërvitjes dhe të pajisjes. Gjithashtu ajo mund t'i bënte propozime komandantit të Armatës së Tretë, në lidhje me llojin e detyrave për të cilat duheshin

¹⁴⁷⁰ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 35; *shih edhe* Miodrag Simiq, T. 15527, 15553 (13 shtator 2007); Miodrag Jankoviq, 4D504 (deklaratë dëshmitari me datë 1 tetor 2007), para. 6.

¹⁴⁷¹ Miodrag Jankoviq, 4D504 (deklaratë dëshmitari me datë 1 tetor 2007), para. 16, 20; Lubisha Stojimiroviq, T. 17667 (26 tetor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 84–85, 214–215; *shih edhe* Mirko Starçeviq, T. 17436 (22 tetor 2007).

¹⁴⁷² P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 84–85, 214–215.

¹⁴⁷³ Mirko Starçeviq, 4D500 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 15. Starçeviqi shpjegoi se vendndodhja fizike e Postëkomandës Pararojë të Armatës së Tretë ndryshoi shpesh për shkak të rrezikut të sulmeve të UÇK-së dhe NATO-s. Ai përmendi si vendndodhje “Kishnica, Gërmia, Graçanica në disa raste vetëm për një natë”, dhe më vonë listë të iu shtua “Ajvalija”. Mirko Starçeviq, T. 17436, 17438 (22 tetor 2007).

¹⁴⁷⁴ Vladimir Llazareviq, T. 18080 (12 nëntor 2007). *Shih edhe* Dushan Lonçar, P2521 (deklaratë dëshmitari me datë 3–4 shkurt, 3 mars 2004), para. 21, T. 7578 (30 nëntor 2006).

¹⁴⁷⁵ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 10, T. 17658–17659 (26 tetor 2007).

¹⁴⁷⁶ *Shih p.sh.*, Mirko Starçeviq, 4D500 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 2–4; Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para 11–13; Tomisllav Mlladenoviq, 4D505 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 46; Novica Stamenkoviq, T. 20097–20098 (12 dhjetor 2007).

¹⁴⁷⁷ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 12, T. 17675 (26 tetor 2007).

përdorur këto njësi.¹⁴⁷⁸ Dega e sigurimit i dërgonte raporte ditore Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë të UJ-së, por kjo mënyrë veprimi përfundoi më 20 mars 1999, kur këto raporte u përfshinë në raportet e rregullta të luftimit të Armatës së Tretë për Shtabin e Përgjithshëm/Shtabin e Komandës së Lartë.¹⁴⁷⁹ Edhe organet e sigurimit në varësi të Armatës së Tretë dërgonin telegrame në të cilat raportonin në lidhje me probleme konkrete për sigurimin.¹⁴⁸⁰

591. Qendra Operative mbledhte vazhdimisht të dhëna dhe vëzhgonte pozicionet e njërive të UJ-së, veprimtarinë e tyre, gjendjen e objektivave të sulmuara prej NATO-s dhe veprimtarinë e forcave të UÇK-së.¹⁴⁸¹ Ajo ndodhej në selinë e Komandës së Armatës së Tretë në Nish deri më 4 prill 1999, kur u zhvendos në vendndodhjen e saj për kohë luftime që ishte shumë pranë vendndodhjes origjinale, brenda një ndërtese që i përkiste një firme ndërtimi.¹⁴⁸² Obradoviçi dëshmoi se më 5 prill 1999 një aeroplan i NATO-s shkatërroi ambientet e Qendrës Operative dhe Gjykatën Ushtarake fqinje dhe rrjedhimisht shumë prej dokumenteve të mbetura të Qendrës Operative u asgjësuan.¹⁴⁸³

592. Ekipi i Gatishmërisë Operative i Armatës së Tretë ishte organi më i lartë i sistemit të gatishmërisë operative dhe ishte drejtpërsëdrejti dhe vazhdimisht i lidhur me Qendrën Operative e Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë. Një prej funksioneve të Ekipit të Gatishmërisë Operative ishte monitorimi i gjendjes brenda njërive në zonën e përgjegjësisë së Armatës së Tretë.¹⁴⁸⁴ Ekipi i Gatishmërisë Operative i Armatës së Tretë mbështetej prej Qendrës Operative të Armatës së Tretë dhe punonte atje.¹⁴⁸⁵ Qendra Operative e Armatës së Tretë ndodhej në ambientet e Armatës së Tretë në Nish deri më 4 prill 1999 kur u zhvendos në vendndodhjen e saj për kohë luftime në qytetin e Nishit.¹⁴⁸⁶ Gjatë bombardimit të NATO-s, në mënyrë të pazakontë dhe

¹⁴⁷⁸ Lubisha Stojimiroviq, T. 17674 (26 tetor 2007). *Shih edhe* Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 13.

¹⁴⁷⁹ Branko Gajiç, T. 15188–15189 (7 shtator 2007); Geza Farkash, T. 16292 (25 shtator 2007).

¹⁴⁸⁰ Branko Gajiç, 3D1084 (deklaratë dëshmitari me datë 8 gusht 2007), para. 11. *Shih edhe* Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 12–13, T. 17674–17676 (26 tetor 2007); Branko Gajiç, 3D1084 (deklaratë dëshmitari me datë 8 gusht 2007), para. 11.

¹⁴⁸¹ Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 3, 10, T. 17360 (22 tetor 2007).

¹⁴⁸² Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 13, T. 17392 (22 tetor 2007); Mirko Starçeviç, T. 17436 (22 tetor 2007).

¹⁴⁸³ Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 13, T. 17363–17364 (22 tetor 2007).

¹⁴⁸⁴ Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 6–7.

¹⁴⁸⁵ Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 3, 7. Gjatë bombardimit të NATO-s detyra kryesore e Qendrës Operative ishte mbledhja e informacionit dhe monitorimi i situatës në njësitë e UJ-së në Kosovë dhe veprimtaria e tyre, situata e objektivave civile dhe ushtarake të sulmuara nga NATO-ja dhe veprimtaria e forcave të UÇK-së. Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 10, T. 17360, 17401–17402 (22 tetor 2007).

¹⁴⁸⁶ Velimir Obradoviç, 4D499 (deklaratë dëshmitari me datë 27 shtator 2007), para. 7, 13.

për shkak të urgjencës së disa ngjarjeve, komandanti i Armatës së Tretë i dërgonte Shtabit të Komandës së Lartë raporte të posaçme luftimi drejtpërsëdrejti nga Postëkomanda Pararojë.¹⁴⁸⁷

c. Korpusi i Prishtinës

593. Korpusi i Prishtinës përfshinte brigada të shumta në varësi të vet dhe batalione të pavarura.¹⁴⁸⁸ Prej 5 janarit 1998 deri më 15 janar 1999 komandant ishte Pavkoviqi i cili u pasua prej Llazareviqit.¹⁴⁸⁹ Llazareviqi ishte komandant i Korpusit të Prishtinës deri në vitin 2000 kur u emërua komandant i Armatës së Tretë.¹⁴⁹⁰

594. Llazareviqi shpjegoi se teorikisht efektiv i plotë i Korpusit të Prishtinës në kohë paqeje numëronte 12.000 – 15.000 vetë, dhe në kohë lufte ishte afërsisht 35.000 vetë.¹⁴⁹¹ Gjatë vitit 1998 dhe fillimit të vitit 1999, Korpusi i Prishtinës kishte afërsisht 9.000 vetë.¹⁴⁹² Prej efektivit 15.000-vetësh në kohë paqeje të Korpusit të Prishtinës, afërsisht 4.500 duhej të ishin ushtarakë profesionistë; gjithsesi në një raport në lidhje me përbërjen e njësive të Korpusit të Prishtinës me datë 28 shkurt 1999, numri i ushtarakëve profesionistë jepet 2.253.¹⁴⁹³ Efektiv i Korpusit të Prishtinës u zgjerua prej kalimit në varësi të Korpusit të Prishtinës të forcave të Korpusit të Nishit para fushatës të NATO-s.¹⁴⁹⁴ Gjithashtu Korpusi i Prishtinës u organizua mbi bazën e të ashtuquajturit parim jashtëterritorial,¹⁴⁹⁵ dhe për pasojë shumë individë që nuk ishin nga Kosova u mobilizuan në njësi të ndryshme në varësi të Korpusit të Prishtinës.¹⁴⁹⁶ Gjithsesi në intervistën e tij me Prokurorinë, Llazareviqi shpjegoi se dikur gjatë fushatës ajrore të NATO-s ishin deri në 15.000 ushtarë të cilët nuk ishin në varësinë e Korpusit të Prishtinës, plus 15.000 “efektiva policore” dhe disa mijëra “anëtarë të Mbrojtjes Civile” në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Sipas Llazareviqit,

¹⁴⁸⁷ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari me datë 2 tetor 2007), para. 48–49, T. 17669 (26 tetor 2007).

¹⁴⁸⁸ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari me datë 14 janar 2007), para. 13. *Shih edhe* P2601 (Struktura e Forcave Ushtarake të RFJ-së për Kosovën).

¹⁴⁸⁹ Vladimir Llazareviq, T. 17744–17745 (6 nëntor 2007); P801 (Raport mbi marrjen e detyrës së Komandantit të Korpusit të Prishtinës prej Vladimir Llazareviqit, në zbatim të Dekretit të lëshuar nga Presidenti i RFJ-së, 28 dhjetor 1998); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 14–15; *Shih edhe* Nikë Peraj, P2248 (deklaratë dëshmitari me datë 18 prill 2000), para. 6; P2253 (deklaratë dëshmitari me datë 8–9 gusht 2006), para. 6.

¹⁴⁹⁰ Vladimir Llazareviq, T. 17740 (6 nëntor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 14–15. *Shih edhe* P801 (Raport mbi marrjen e detyrës së Komandantit të Korpusit të Prishtinës prej Vladimir Llazareviqit, 28 dhjetor 1998); 5D1324 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së që emëron Llazareviqin si Shef të Shtabit të Korpusit të Prishtinës, 12 janar 1998); Nikë Peraj, P2253 (deklaratë dëshmitari me datë 8–9 gusht 2006), para. 6.

¹⁴⁹¹ Vladimir Llazareviq, T. 17777 (6 nëntor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 37–38, 40–45.

¹⁴⁹² P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 37–38. Sipas Radinoviqit efektiv i gjithsejtë në kohë paqeje numëronte 10.000–12.000 vetë. 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 26

¹⁴⁹³ Millutin Filipoviq, T. 19159 (27 nëntor 2007); 5D690 (Raport për Armatën e Tretë në lidhje me madhësinë numerike të efektivave në Korpusin e Prishtinës, 28 shkurt 1999).

¹⁴⁹⁴ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 44–45.

¹⁴⁹⁵ Vladimir Llazareviq, T. 17894 (8 nëntor 2007).

¹⁴⁹⁶ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 324.

numri i efektivit jo në varësi të Korpusit të Prishtinës ishte i njëjtë me efektin në varësi dhe ka të ngjarë që kjo shifër të përfshijë “popullatën e armatosur serbe” dhe “formacionet paraushtarake”.¹⁴⁹⁷

595. Fill para bombardimit të NATO-s dhe gjatë tij numri i efektivit të Korpusit të Prishtinës u rrit në 35.000 vetë nëpërmjet mobilizimit.¹⁴⁹⁸ Në një raport të Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë me datë 31 mars 1999 efektivit i gjithsejtë i Korpusit të Prishtinës figuronte 17.971 vetë dhe sipas raportit ky numër përfaqësonte 52 për qind të efektivit të plotë të Korpusit të Prishtinës.¹⁴⁹⁹ Mirëpo në një raport luftimi që Korpusi Prishtinës ia dërgoi Komandës së Armatës së Tretë dhe Shtabit të Komandës së Lartë më 13 prill 1999, numri i efektivit jepej 61.892.¹⁵⁰⁰ Gjatë dhënies së dëshmisë, Filipoviqi u pyet në lidhje me këtë raport dhe konfirmoi informacionin e raportit, konkretisht se në atë kohë Korpusi i Prishtinës kishte afërsisht 62.000 vetë. Mirëpo ai dëshmoi se megjithëse në raport nuk dilte qartë, kjo shifër përfshinte njësitë që kishin ndërruar varësinë hierarkike dhe në kontekst të “efektivit në kohë lufte” ishin gjithsej vetëm 30.000 – 35.000 vetë në Korpusin e Prishtinës.¹⁵⁰¹ Sipas Radinoviqit, deri në fund të majit 1999, Korpusi i Prishtinës kishte në varësi afërsisht 70.000 ushtarë.¹⁵⁰²

i. Komanda e Korpusit të Prishtinës

596. Komandanti i korpusit kishte detyrë “të komandojë dhe kontrollojë njësitë dhe institucionet vartëse brenda sektorit të përgjegjësive të besuara”,¹⁵⁰³ dhe këtë mund ta realizonte ose drejtpërdrejtë ose “nëpërmjet shefit të Shtabit të tij, ndihmësit të tij ose krerëve të degëve”. Komandanti i korpusit kishte detyrë të kontrollonte punën e komandës së korpusit, t’u caktonte detyra vartësve dhe të garantonte kryerjen e detyrave.¹⁵⁰⁴

¹⁴⁹⁷ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 425–427.

¹⁴⁹⁸ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqi), f. 26; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 37–38, 40–45.

¹⁴⁹⁹ P1929 (Raport i Armatës së Tretë, 31 mars 1999), f. 3. Llazareviqi kujtoi se pasi efektivit i Korpusit të Prishtinës u shtua deri në shifrën në kohë lufte 35.000 vetë, pati përsëri shtim të tij. Dikur nga fundi i majit 1999, numëroheshin rreth 70.000 vetë. P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 42–45.

¹⁵⁰⁰ P2004 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë dhe Shtabin e Komandës së Lartë, 13 prill 1999); f. 2.

¹⁵⁰¹ Millutin Filipoviq, T. 19221–19223 (28 nëntor 2007).

¹⁵⁰² 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqi), f. 66; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 37–38, 40–45.

¹⁵⁰³ P987 (Statut mbi kompetencën e komandantit të forcave tokësore të korpusit në kohë paqeje, 1990), neni 9.

¹⁵⁰⁴ P982 (Udhëzime për Komandën e Korpusit të Katërt, 1991), f. 14.

(A) Postëkomandat

597. Korpusi i Prishtinës e kishte Postëkomandën kryesore në Prishtinë gjatë vitit 1998;¹⁵⁰⁵ gjithsesi ekzistojnë edhe prova që tregojnë se vendndodhja ishte në fshatin fqinj të Dishnicës në një moment të caktuar gjatë asaj periudhe.¹⁵⁰⁶ Postëkomanda Pararajë ishte vendosur në fshatin Graçanicë, gjithashtu afër Prishtinës, dhe drejtohej prej ndihmëskomandantit për logjistikën.¹⁵⁰⁷

598. Më 1 prill 1998 në qytetin e Gjakovës u ngrit një Postëkomandë Pararajë e Korpusit të Prishtinës.¹⁵⁰⁸ Postëkomanda Pararajë përbëhej prej afërsisht dhjetë vetësh nga Komanda e Korpusit të Prishtinës me në krye shefin e atëhershëm të Shtabit, Llazareviqin. Detyra kryesore e Postëkomandës Pararajë ishte monitorimi i situatës në kufirin shtetëror dhe propozimi i masave për sigurimin e kufirit dhe parandalimin e përshkallëzimit të “veprimtarisë terroriste” me burim Shqipërinë. Llazareviqi ishte i pranishëm në Postëkomandën Pararajë dhe qëndroi atje deri në tetor të vitit 1998.¹⁵⁰⁹ Në fund të vitit 1998, Postëkomanda Pararajë në Gjakovë u riemërtua dhe u bë “Grup Komandues”, për shkak të pakësimit të numrit të oficerëve të atashuar. Grupi Komandues vazhdoi deri në fillim të prillit 1999.¹⁵¹⁰

599. Më 1999, Postëkomanda e Korpusit të Prishtinës ndodhej në qytetin e Prishtinës, në një ndërtesë rreth 500 metra larg Ndërtesës së Shtabit të MPB-së.¹⁵¹¹ Në kohë paqeje ajo përbëhej prej 100 vetësh.¹⁵¹² Në fillim të fushatës ajrore të NATO-s, Llazareviqi e ndau Komandën e Korpusit të Prishtinës në disa Grupe Komanduese.¹⁵¹³ Prej 29 marsit pjesë të Komandës së Korpusit të Prishtinës u zhvendosën jashtë ndërtesës dhe Llazareviqi formoi një grup me anëtarë të Komandës së Korpusit të Prishtinës të cilët do të vendoseshin “në zonën e përgjithshme të komunës së Prishtinës, Gjykatës Komunale dhe në ambientet e Komandës së Korpusit të Prishtinës, përfshirë

¹⁵⁰⁵ *Shih* Vladimir Llazareviq, T. 17815–17816 (7 nëntor 2007).

¹⁵⁰⁶ Vladimir Llazareviq, T. 17959–17960 (8 nëntor 2007); *shih* 5D175 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 6 prill 1998), f. 16.

¹⁵⁰⁷ Vladimir Llazareviq, T. 17960 (8 nëntor 2007); 5D175 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 6 prill 1998), f. 16; Zllatomir Peshiq, T. 7201 (23 nëntor 2006).

¹⁵⁰⁸ 4D380 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë drejtuar Korpusit të Prishtinës për Marrjen në Kontroll të Postëkomandës Pararajë, 20 prill 1998); *shih edhe* Vladimir Llazareviq, T. 17808 (6 nëntor 2007); 3D697 (Dokument nga Pasantizimi i Postëkomandës Pararajë të Armatës së Tretë mbi realizimin e detyrave në Kosovë, 2 tetor 1998), f. 2; Goran Jevtoviq, 5D1385 (deklaratë dëshmitari me datë 24 dhjetor 2007), para. 4; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), p. 92.

¹⁵⁰⁹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 92; *shih edhe* Vladimir Llazareviq, T. 17809 (6 nëntor 2007), 17823 (7 nëntor 2007); Millorad Obradoviq, T. 15044 (5 shtator 2007); Dragan Zhivanoviq, T. 20617–20618 (18 janar 2008); Millan Kotur, T. 20629 (18 janar 2007); Goran Jevtoviq, 5D1385 (deklaratë dëshmitari me datë 24 dhjetor 2007), para. 4.

¹⁵¹⁰ Goran Jevtoviq, 5D1385 (deklaratë dëshmitari me datë 24 dhjetor 2007), para. 3, 19.

¹⁵¹¹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 210–212.

¹⁵¹² Millutin Filipoviq, T. 19204 (28 nëntor 2007).

¹⁵¹³ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 202.

edhe Grand Hotelin.”¹⁵¹⁴ Urdhri i lëshuar prej Llazareviqit shërbente si bazë për kuadrin dhe përbërjen e grupit, por pa konkretizuar detyrat e tij.¹⁵¹⁵ Millutin Filipoviqi u emërua kreu i grupit dhe komandant i garnizonit të Prishtinës, i selisë së shtabit, dhe rrjedhimisht ai qëndroi në Prishtinë dhe në rrethina gjatë periudhës së bombardimit të NATO-s.¹⁵¹⁶ Sipas Filipoviqit, ai kishte nën komandën e tij rreth 100-150 anëtarë të grupit, dhe ata ishin të caktuar për sigurimin e objekteve në Prishtinë. Sidoqoftë ai deklaroi se në garnizonin e Prishtinës nuk mbeti asnjë njësi luftarake sepse të gjitha u zhvendosën në pozicione të paracaktuara.¹⁵¹⁷

600. Filipoviqi shpjegoi se çfarëdo pajisjesh komunikimi që ndodheshin në ndërtesën e Komandës së Korpusit të Prishtinës para fushatës së NATO-s, u hoqën që andej për gjithë kohëzgjatjen e fushatës dhe shtoi se Qendra 52 për Komunikime u zhvendos prej ndërtesës origjinale të Komandës së Korpusit të Prishtinës. “Qendra e informacionit” e Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës në atë kohë ndodhej në bodrumin në Grand Hotel, që ndër të tjera shërbente si vend për marrjen e postës. Mirëpo sipas Filipoviqit vetë Komanda e Korpusit të Prishtinës nuk u zhvendos në Grand Hotel.¹⁵¹⁸ Kur u pyet në lidhje me një urdhër të Komandës së Korpusit të Prishtinës ku siç dukej Grand Hoteli përmendej si pjesë e ndërtesës së Komandës së Korpusit të Prishtinës, ai deklaroi se hoteli nuk ishte përdorur për këtë qëllim, megjithëse ishte afër ndërtesës ku ndodheshin elementë të Korpusit të Prishtinës.¹⁵¹⁹ Në kundërshtim me këtë dëshmi, K73 dëshmoi se Komanda e Korpusit të Prishtinës ndodhej në Grand Hotel dikur gjatë prillit dhe majit 1999, dhe se Llazareviqi dhe Momir Stojanoviqi ishin të pranishëm thuajse çdo ditë.¹⁵²⁰ Gjithashtu në ditarin e luftës së Batalionit 52 të Policisë Ushtarake ka një shënim për datën 30 prill 1999 ku shkruhet se një toger i UJ-së “u transferua në postin e sigurimit në Grand Hotel në Prishtinë”, që sugjeron se në Grand Hotel kishte forca të tjera, veç qendrës së informacionit.¹⁵²¹ Adnan Merovci shtoi se në atë kohë në Grand Hotel gjendeshin njerëz të Arkanit dhe se “[Grand Hotel ishte vend i

¹⁵¹⁴ 5D348 (Urdhër i Komandës së Korpusit të Prishtinës për organizimin e jetës dhe punës në ndërtesën e Komandës së Korpusit të Prishtinës dhe në garnizonin e Prishtinës, 30 mars 1999).

¹⁵¹⁵ Millutin Filipoviqi, T. 19224–19225 (28 nëntor 2007).

¹⁵¹⁶ 5D348 (Urdhër i Komandës së Korpusit të Prishtinës për organizimin e jetës dhe punës në ndërtesën e Komandës së Korpusit të Prishtinës dhe në garnizonin e Prishtinës, 30 mars 1999); Millutin Filipoviqi, T. 19151 (27 nëntor 2007), T. 19209 (28 nëntor 2007).

¹⁵¹⁷ Millutin Filipoviqi, T. 19153–19154 (27 nëntor 2007), T. 19211–19212, 19215–19218 (28 nëntor 2007).

¹⁵¹⁸ Millutin Filipoviqi, T. 19205–19207 (28 nëntor 2007). *Shih edhe* P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 212–214.

¹⁵¹⁹ Millutin Filipoviqi, T. 19162 (27 nëntor 2007); T. 19240–19242 (28 nëntor 2007), i referohet 5D348 (Urdhër i Komandës së Korpusit të Prishtinës për organizimin e jetës dhe punës në ndërtesën e Komandës së Korpusit të Prishtinës dhe në garnizonin e Prishtinës, 30 mars 1999).

¹⁵²⁰ K73, T. 3336 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur), P2440 (deklaratë dëshmitari me datë 2 dhjetor 2005), para. 50.

¹⁵²¹ P2297 (Ditar Luftë i Batalionit 52 të Policisë Ushtarake), f. 12.

ndaluar për shqiptarët. Në fakt thuhej se në Grand Hotel nuk lejohet të hyjnë qentë dhe shqiptarët”.¹⁵²²

601. Rreth datave 9-10 prill 1999, u mor vendimi për ringritjen e Postëkomandës Pararojë në Gjakovë.¹⁵²³ e cila nuk kishte vendndodhje të fiksuar sepse e ndryshoi vendndodhjen disa herë gjatë fushatës ajrore të NATO-s.¹⁵²⁴ Shefi i atëhershëm i Shtabit të Korpusit të Prishtinës, gjeneral Verolub Zhivkoviqi, ishte në Postëkomandën Pararojë gjatë tërë bombardimit të NATO-s,¹⁵²⁵ dhe mori komandën e forcave të Korpusit të Prishtinës në atë zonë.¹⁵²⁶ Gjithashtu, gjatë bombardimit të NATO-s në Postëkomandën Pararojë punuan shumë oficerë të tjerë të lartë të Korpusit të Prishtinës.¹⁵²⁷

602. Veç Postëkomandës kryesore të Korpusit të Prishtinës dhe Postëkomandës së tij Praparojë, në vende të tjera të Kosovës qendrore u ngritën një Postëkomandë Pararojë dhe disa Grupe Komanduese.¹⁵²⁸ Llazareviqi dhe ekipi i tij zhvendoseshin vazhdimisht nga një vend në tjetrin dhe ushtronin komandë e kontroll mbi njësitë e Korpusit të Prishtinës kudo që ndodheshin.¹⁵²⁹

(B) Shtabi i Korpusit të Prishtinës

603. Shtabi i Korpusit të Prishtinës ishte “organi themelor i komandës së korpusit i cili ndërlidhte dhe bashkërendonte punën e të tëra organeve komanduese”.¹⁵³⁰ Ai përbëhej prej shefit të Shtabit dhe degëve/seksioneve të ndryshme të specializuara, si Zbulimi, Operacionet dhe Stërvitja,¹⁵³¹ Personeli dhe Strehimi,¹⁵³² Logjistika,¹⁵³³ Informacioni dhe Morali,¹⁵³⁴ Sigurimi,¹⁵³⁵ dhe një Qendër

¹⁵²² Adnan Merovci, T. 8433–8434 (16 janar 2007). *Shih edhe* SD3, T. 20827–20828, 20830–20831 (22 janar 2008) (seancë private).

¹⁵²³ Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklaratë dëshmitari me datë 24 dhjetor 2007), para. 3, 19; *shih edhe* P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 204–205.

¹⁵²⁴ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 202–203, 206–210.

¹⁵²⁵ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 204–205; Goran Jevtoviç, T. 20355 (16 janar 2008), 5D1385 (deklaratë dëshmitari me datë 24 dhjetor 2007), para. 19.

¹⁵²⁶ Goran Jevtoviç, T. 20360 (16 janar 2008) (seancë private), 5D1385 (deklaratë dëshmitari me datë 24 dhjetor 2007), para. 19.

¹⁵²⁷ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 204–205; Goran Jevtoviç, 5D1385 (deklaratë dëshmitari me datë 24 dhjetor 2007), para. 3.

¹⁵²⁸ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 202–203, 458–459.

¹⁵²⁹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 203.

¹⁵³⁰ P982 (Udhëzime për Komandën e Korpusit të Katërt, 1991), f. 15.

¹⁵³¹ Lubomir Saviq, T. 20963 (24 janar 2008), 5D1392 (deklaratë dëshmitari me datë 27 dhjetor 2007), para. 3.

¹⁵³² Millutin Filipoviç, T. 19151 (27 nëntor 2007).

¹⁵³³ Millutin Filipoviç, T. 19230 (28 nëntor 2007).

¹⁵³⁴ Millutin Filipoviç, T. 19231–19232 (28 nëntor 2007); Dragisha Marinkoviç, 5D1379 (deklaratë dëshmitari me datë 6 dhjetor 2007), para. 3; Mirko Starçeviç, 4D500 (deklaratë dëshmitari me datë 29 shtator 2007), para. 16.

¹⁵³⁵ Momir Stojanoviç, T. 19683 (6 dhjetor 2007). *Shih edhe* Millutin Filipoviç, T. 19231–19232 (28 nëntor 2007); Vladimir Marinkoviç, T. 20287–20288 (14 dhjetor 2007); Nikë Peraj, P2253 (deklaratë dëshmitari me datë 8–9 gusht 2006), para. 57; Branko Gajiq, 3D1084 (deklaratë dëshmitari me datë 8 gusht 2007), para. 7.

Operative.¹⁵³⁶ Disa prej këtyre organeve kanë një rëndësi të veçantë për operacionet e UJ-së në Kosovë në periudhën që ka lidhje me Aktakuzën dhe do të analizohen në paragrafët e mëposhtëm.

604. Shefi i Shtabit të Korpusit të Prishtinës varej prej komandantit të Korpusit së bashku me ndihmësit e shumtë të specializuar në fusha të ndryshme.¹⁵³⁷ Ai shërbente si urë lidhëse midis ndihmësve dhe komandantit e zëvendëskomandantit.¹⁵³⁸

605. Dega e sigurimit të Korpusit të Prishtinës u raportonte çdo ditë komandantit të Korpusit të Prishtinës, degës së sigurimit të Armatës së Tretë dhe Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁵³⁹ Mirëpo kur filloi fushata ajrore e NATO-s, Stojanoviçi, me urdhër të Administratës së Sigurimit, ishte i detyruar t'i raportonte vetëm Komandës së Armatës së Tretë. Rrjedhimisht telegramet që dega e sigurimit të Korpusit të Prishtinës i dërgonte degës së sigurimit të Armatës së Tretë gjatë bombardimit të NATO-s përbëheshin nga tri pjesë: (a) gjendja e sigurimit në kufi; (b) siguria e territorit dhe (c) siguria në njësitë dhe komandant e Korpusit të Prishtinës.¹⁵⁴⁰

606. Në vitet 1998 dhe 1999 të tëra njësitë përbërëse të Korpusit të Prishtinës, deri në nivelin e batalioneve të pavarura, kishin organet e tyre të sigurimit.¹⁵⁴¹ Organet e sigurimit brenda njërive vartëse zakonisht përbëheshin prej dy vetësh, sidomos në njësitë më të vogla; mirëpo për shkak të gjendjes së vështirë të sigurimit në Kosovë, Administrata e Sigurimit përforcoi organet e sigurimit të Korpusit të Prishtinës.¹⁵⁴² Si shef i degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës, Stojanoviçi ishte në komandë të organeve të sigurimit të njërive vartëse të Korpusit të Prishtinës.¹⁵⁴³ Vladimir Marinkoviçi, shefi i sigurimit për Brigadën e 15-të të Blinduar, më tej shpjegoi se ai i raportonte Stojanoviçit “dy herë në ditë dhe në rast se kishte ndodhur diçka, më shumë se dy herë, varësisht prej urgjencës dhe për aq sa duhej ditur”; raportimet ishin gojore dhe me shkrim.¹⁵⁴⁴

¹⁵³⁶ P982 (Udhëzime për Komandën e Korpusit të Katërt, 1991), f. 16.

¹⁵³⁷ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 20–21.

¹⁵³⁸ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 20–21; P982 (Udhëzime për Komandantin e Korpusit të Katërt, 1991), f. 16.

¹⁵³⁹ Momir Stojanoviçi, T. 19688–19690 (6 dhjetor 2007).

¹⁵⁴⁰ Momir Stojanoviçi, T. 19688 (6 dhjetor 2007). Kur u pyet pse në raporte përmendej edhe gjendja e sigurisë në Kosovë, Stojanoviçi sqaroi se megjithëse organet e sigurimit nuk ishin të ngarkuar për gjendjen e sigurisë në Kosovë, duke qenë se ishte përgjegjësi e organeve të MPB-së dhe Sigurimit Shtetëror, ajo përmendej në telegrame për arsye se përshkallëzimi i terrorizmit në Kosovë përbente kërcënim për komandat, njësitë, instalimet dhe anëtarët e UJ-së e pikërisht këta supozohej të kishin mbrojtjen e organeve të sigurisë. Momir Stojanoviçi, T. 19689–19691 (6 dhjetor 2007).

¹⁵⁴¹ Momir Stojanoviçi, T. 19685 (6 dhjetor 2007); Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari me datë 8 janar 2008), para. 49.

¹⁵⁴² Momir Stojanoviçi, T. 19685 (6 dhjetor 2007); Vladimir Marinkoviçi, T. 20289–20290 (14 dhjetor 2007).

¹⁵⁴³ Momir Stojanoviçi, T. 19683–19684 (6 dhjetor 2007); Vladimir Marinkoviçi, T. 20287–20288 (14 dhjetor 2007).

¹⁵⁴⁴ Vladimir Marinkoviçi, T. 20288 (14 dhjetor 2007).

607. Njësitë e policisë ushtarake u ishin atashuar brigadave në varësi të Korpusit të Prishtinës dhe gjithashtu vareshin nga Komanda e Korpusit të Prishtinës.¹⁵⁴⁵ Dega e sigurimit mund t'i propozonte komandantit të njësisë mënyrën e përdorimit të njërive të policisë ushtarake dhe mund të sugjeronte masa disiplinore dhe procedim penal.¹⁵⁴⁶

608. Qendra Operative e Korpusit të Prishtinës ishte vendosur në Komandën e Korpusit të Prishtinës. Korpusi i Prishtinës kishte dy qendra operative gjatë viteve 1998 dhe 1999, një në Postëkomandën kryesore dhe një në Postëkomandën Pararojë, kur ai post ishte në funksionim.¹⁵⁴⁷ Qendra Operative përbëhej prej një ekip njerëzish të cilët mund të shikonin dokumente, urdhra dhe plane të lëshuara prej Komandantit të Korpusit të Prishtinës; ata përcillnin gjendjen në të tëra njësitë në varësi të Korpusit të Prishtinës,¹⁵⁴⁸ dhe kishin për detyrë t'u raportonin niveleve më të larta komanduese.¹⁵⁴⁹

609. Si në të gjitha organet më të larta të UJ-së, personeli kryesor në Shtabin e Korpusit të Prishtinës formoi një organ të quajtur kolegji. Para fillimit të bombardimit të NATO-s kolegji zhvillonte përditë mbledhje me praninë e oficerëve nga Korpusi i Prishtinës dhe në disa raste me praninë e komandantit të Armatës së Tretë ose oficerëve të tjerë nga Komanda e Armatës së Tretë.¹⁵⁵⁰ Kur pjesë të Komandës së Korpusit të Prishtinës u zhvendosën prej postëkomandës në kohë paqeje, kolegji nuk ishte më në përbërje të plotë në mbledhjet e mëtejshme; në fakt komandanti i Korpusit të Prishtinës kishte takime vetëm për vetëm me një rreth të ngushtë anëtarësh.¹⁵⁵¹

610. Filipoviqi dëshmoi se edhe ai e takoi Llazareviqin kokë më kokë për t'a informuar në lidhje me gjendjen në komandën e garnizonit të Prishtinës dhe brenda grupit të tij. Çdo përgjegjës dege e informonte Llazareviqin në lidhje me atë degë dhe nga ana e tij Llazareviqi informonte Shtabin e

¹⁵⁴⁵ Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari me datë 8 janar 2008), para. 49; *shih edhe* Sasha Antiq, 5D1443 (deklaratë dëshmitari me datë 5 janar 2008), para. 7.

¹⁵⁴⁶ Momir Stojanoviç, T. 19686–19687 (6 dhjetor 2007); Sasha Antiq, 5D1443 (deklaratë dëshmitari me datë 5 janar 2008), para. 7. Shih për shembull ditarin e luftës të Batalionit 52 të Policisë Ushtarake në të cilin është shënuar se më 13 prill 1999, një kompani e formuar posaçërisht e këtij batalioni faktikisht “ u ngarkua” prej Shefit të Degës së Sigurimit të Korpusit të Prishtinës, që në atë kohë ishte Stojanoviçi, që të merrte në kontroll një postë kufitare në Kamenicë. P2297 (Ditar Luftë i Batalionit 52 të Policisë Ushtarake), f. 6.

¹⁵⁴⁷ Millan Gjakoviç, T. 26400 (19 maj 2008).

¹⁵⁴⁸ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 79–81.

¹⁵⁴⁹ Millan Gjakoviç, T. 26400 (19 maj 2008).

¹⁵⁵⁰ Momir Stojanoviç, T. 19733–19734 (6 dhjetor 2007); Dragisha Marinkoviç, 5D1379 (deklaratë dëshmitari me datë 6 dhjetor 2007), para. 9.

¹⁵⁵¹ Momir Stojanoviç, T. 19733–19734 (6 dhjetor 2007); Dragisha Marinkoviç, 5D1379 (deklaratë dëshmitari me datë 6 dhjetor 2007), para. 9.

Komandës së Korpusit për zhvillimet me të fundit.¹⁵⁵² Si shef i degës së sigurimit, Stojanoviçi e informonte Llazareviçin rregullisht në lidhje me të gjitha çështjet e sigurisë në njësi dhe që ndikonin mbi to; gjithashtu ai e informonte për madhësinë numerike, vendndodhjen, planet, synimin dhe procesin e armatimit si dhe veprimtarinë e UÇK-së dhe në lidhje me të dhënat e zbulimit me interes për sigurinë për Korpusin e Prishtinës.¹⁵⁵³

ii. Struktura e Korpusit të Prishtinës

611. Në vitin 1999, Korpusi i Prishtinës përbëhej nga një sërë njësish.¹⁵⁵⁴

(A) Njësitë në varësi të Korpusit të Prishtinës

612. Në bazë të organizimit në kohë paqeje Korpusi i Prishtinës kishte këto njësi: Brigada e Motorizuar 549 (komanduar prej kolonelit Bozhidar Deliq); Brigada 52 e Raketave Artilerike për Mbrojtjen Kundërajrore (komanduar prej kolonelit Millosh Gjoshan); Brigada e Mekanizuar 243 (komanduar prej kolonelit Kërsmen Jeliq); Brigada e Blinduar 15 (komanduar prej kolonelit Çirkoviç)¹⁵⁵⁵; Brigada e Motorizuar 125 (komanduar prej kolonelit Dragan Zhivanoviç)¹⁵⁵⁶; Brigada 58 e Këmbërorisë së Lehtë (komanduar prej Dragutin Milentjeviçit deri më 16 prill 1999 kur u zëvendësua prej Lubomir Saviçit)¹⁵⁵⁷; dhe Brigada 52 e Artilerisë së Përzierë (komanduar prej kolonelit Stefanoviçit i cili më vonë u zëvendësua prej kolonelit Millinoviçit).¹⁵⁵⁸

¹⁵⁵² Millutin Filipoviç, T. 19232–19233 (28 nëntor 2007). Dragisha Marinkoviçi gjithashtu dëshmoi se vijoi me mbajtjen e mbledhjeve të rregullta gjatë të cilave Llazareviçi nxirrte urdhra gjatë bombardimit të NATO-s. Dragisha Marinkoviçi, 5D1379 (deklaratë dëshmitari me datë 6 dhjetor 2007), para. 9.

¹⁵⁵³ Momir Stojanoviçi, T. 19734 (6 dhjetor 2007).

¹⁵⁵⁴ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 33–35; 5D1370 (Organigrama e Korpusit të Prishtinës: komanda dhe bashkërendimi në kohë lufte); 4D240 (Struktura, Dislokimi dhe Madhësia Numerike e Komponentit Ushtarak-Territorial të Armatës së Tretë, 14 Janar 1999), f. 2.

¹⁵⁵⁵ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 33–34. Vladimir Marinkoviçi, anëtar i Brigadës së Blinduar 15 gjatë periudhës përkatëse të Aktakuzës, dëshmoi se zona e përgjithshme e përgjegjësisë së Brigadës së Blinduar 15 ishte në veri të Kosovës dhe përfshinte komunat e Prishtinës, Vushtrrisë, Fushë-Kosovës, pjesë të Lipjanit dhe pjesë të Glligocit. Vladimir Marinkoviçi, T. 20252 (13 dhjetor 2007); T. 20302 (14 dhjetor 2007).

¹⁵⁵⁶ Dragan Zhivanoviçi, T. 20439 (17 janar 2008). Millosh Mandiqi dëshmoi se Batalioni i Mekanizuar i Brigadës së Blinduar 252 ishte i pranishëm në Kosovë që prej 16 marsit 1999, ku përfshiheshin edhe shtatë tanke dhe se rikaloj në varësinë e komandës së Brigadës së Motorizuar 125 në Mitrovicë. Millosh Mandiqi, T. 20909–20911 (23 janar 2008). Lubomir Saviçi shtoi se Batalioni 2 i Këmbërorisë së Lehtë u rivu në varësinë e Brigadës së Motorizuar 125, “e cila ndodhej në rajonin e mbrojtjes së Grykës së Rugovës”. Lubomir Saviçi, 5D1392 (deklaratë dëshmitari me datë 27 dhjetor 2007), para. 10. Sasha Antiçi dëshmoi se rreth datës 12 ose 13 prill 1999, nga Batalioni 52 i Policisë Ushtarake u formua një kompani e cila u dërgua në postat kufitare të Koshares dhe të Morinës, ku rikaloj në varësinë e Brigadës së Motorizuar 125. Antiçi u dërgua në atë zonë më 21 prill 1999 dhe u bë komandanti i kompanisë e cila kishte ndryshuar varësinë komanduese ditë më parë. Sasha Antiçi, 5D1443 (deklaratë dëshmitari me datë 5 janar 2008), para. 15, 17, 19.

¹⁵⁵⁷ Saviçi dëshmoi se Brigada 58 e Këmbërorisë së Lehtë “u dislokua në zonën më të gjerë të Mitrovicë” dhe ishte “njësi taktike e caktuar për kryerjen e aksioneve luftarake në terren malor dhe të manovrueshëm”. Lubomir Saviçi, 5D1392 (deklaratë dëshmitari me datë 27 dhjetor 2007), para. 7.

¹⁵⁵⁸ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 25; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 33–34, 57–60; *Shih edhe* Dragan Zhivanoviçi, T. 20534 (18 janar 2008); P1929 (Raport i Armatës së Tretë, 31 mars 1999), f. 3–4.

613. Në kohë paqeje Korpusi i Prishtinës kishte edhe dy njësi të tjera, Brigada 354 e Këmbërorisë¹⁵⁵⁹ dhe Regjimenti Xhenier 192.¹⁵⁶⁰

614. Gjithashtu ishin tetë njësi më të vogla, në nivelin e batalioneve ose më poshtë, të atashuara në Korpusin e Prishtinës: Batalioni Kufitar 53; Batalioni Kufitar 55; Batalioni Kufitar 57; Batalioni 52 i Policisë Ushtarake (komanduar prej Stevo Kopanjës); Batalioni 52 i Komunikimit; Kompania 52 për Rikonicion dhe Sabotim; Batalioni 52 i Mbrojtjes Atomike, Biologjike dhe Kimike; dhe Qendra 52 e Spiunazhit dhe Sabotimit Elektronik.¹⁵⁶¹

(1) Brigada e Motorizuar 549

615. Bozhidar Deliqi dëshmoi gjerë e gjatë në lidhje me veprime të ndryshme të brigadës në vitet 1998 dhe 1999.¹⁵⁶² Në zonën e përgjegjësive së brigadës përfshiheshin komunat e Prizrenit, Suharekës, Rahovecit dhe Dragashit në jug të Kosovës.¹⁵⁶³ Në vitet '80, Zllatomir Peshiqi ishte komandant i batalionit të artilerisë të Brigadës së Motorizuar 549.¹⁵⁶⁴ Dëshmitarët K82, K54, Pavlle Gavrilloviqi, dhe Vllatko Vukoviqi ishin gjithashtu anëtarë të Brigadës së Motorizuar 549 në periudha të ndryshme.¹⁵⁶⁵ Franjo Gllonçaku me kërkesë të tij u transferua prej Batalionit 175 në prill 1999.¹⁵⁶⁶

616. Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve dhe disa dokumente të UJ-së të pranura si prova tregojnë se Brigada e Motorizuar 549 ishte aktive në një zonë relativisht të madhe kufitare të Kosovës prej majit 1998 e më tej, për ruajtjen “në thellësi” përgjatë kufirit.¹⁵⁶⁷ Ndër vendndodhjet e

¹⁵⁵⁹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 35–36; Mihajllo Gergari dëshmoi se Brigada 354 e Këmbërorisë përbëhej kryesisht nga rezervistë; Mihajllo Gergar, T. 21510 (31 janar 2008). Më tej ai shtoi se brigada mori pjesë në operacionin në Pollatë në fund të majit 1999 dhe se ai ishte përgjegjës për planifikim dhe drejtimin e Brigadës së Blinduar 211 dhe Brigadës 354 të Këmbërorisë në atë operacion; Mihajllo Gergar, T. 21492–21496 (31 janar 2008); 6D709 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 22 maj 1999), f. 3; *shih edhe* 5D1070 (Raport Luftimi i Brigadës së Blinduar 211 për Korpusin e Prishtinës, 25 maj 1999) mbi operacionin në Pollatë.

¹⁵⁶⁰ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 35. *Shih edhe* P1929 (Raport i Armatës së Tretë, 31 mars 1999) f. 3–4.

¹⁵⁶¹ Batalioni 52 i Policisë Ushtarake ishte njësi e pavarur dhe drejtpërsëdrejti në varësinë dhe komandën e Korpusit të Prishtinës. 5D1370 (Organigrama e Korpusit të Prishtinës: komanda dhe bashkërendimi në kohë lufte); 3D1116 (Akt ekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 25–26; Momir Stojanoviq, T. 20082 (12 dhjetor 2007); Sasha Antiq, 5D1443 (deklaratë dëshmitari me datë 5 janar 2008), para. 5, 7. *Shih edhe* P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 37.

¹⁵⁶² Bozhidar Deliq, T. 19269 (28 nëntor 2007); *shih edhe* K82, P2863 (deklaratë dëshmitari), para. 2; K90, P2640 (deklaratë dëshmitari me datë 8 dhjetor 2002), para. 28.

¹⁵⁶³ K82, P2863 (deklaratë dëshmitari), para. 2; *shih edhe* K54, P2883 (deklaratë dëshmitari me datë 26 prill 2002), f. 2.

¹⁵⁶⁴ Zllatomir Peshiq, T. 7312 (24 nëntor 2006).

¹⁵⁶⁵ K82, P2863 (deklaratë dëshmitari), para. 1; Pavlle Gavrilloviq, 5D1445 (deklaratë dëshmitari me datë 9 janar 2008), para. 3–4; Vllatko Vukoviq, 5D1442 (deklaratë dëshmitari me datë 5 janar 2008), para. 2, *shih* K54, P2883 (deklaratë dëshmitari me datë 26 prill 2002), f. 2.

¹⁵⁶⁶ K90, P2391 (deklaratë dëshmitari me datë 8 dhjetor 2002), para. 28 (e mbyllur me vulë); Franjo Gllonçak, 5D1395 (deklaratë dëshmitari me datë 26 dhjetor 2007), para. 5.

¹⁵⁶⁷ P1401 (Raport i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 13 maj 1998), f. 2.

operacioneve përfshihen Juniku,¹⁵⁶⁸ Rahoveci,¹⁵⁶⁹ Gramaçeli,¹⁵⁷⁰ Retia e Poshtme,¹⁵⁷¹ Studençani,¹⁵⁷² Suhareka,¹⁵⁷³ Jeshkova, dhe Kabashi.¹⁵⁷⁴ Gjatë vitit 1999 Brigada e Motorizuar 549 kreu operacione në komunat e Suharekës,¹⁵⁷⁵ Prizrenit,¹⁵⁷⁶ Gjakovës,¹⁵⁷⁷ dhe Rahovecit.¹⁵⁷⁸

(2) Brigada e Mekanizuar 243

617. Ekzistojnë prova se Brigada e Mekanizuar 243 e komanduar prej Kërsman Jeliqit mori pjesë në operacione të ndryshme në Kosovë gjatë vitit 1998.¹⁵⁷⁹ Sipas një dokumenti të Korpusit të Prishtinës, Brigada e Mekanizuar 243 kishte detyrë të garantonte siguri “në thellësi” të kufirit shtetëror.¹⁵⁸⁰ Jeliqi dëshmoi se brigada ishte në kufirin maqedonas prej Vitisë deri në Malin e Jezercës.¹⁵⁸¹ Që prej gushtit 1998 ajo përbëhej prej tri Grupesh Luftimi, dy prej të cilëve u angazhuan në mbështetje të operacioneve të MPB-së në Qafën e Dules dhe në zonën e Shtimës, kurse i treti vepronte veçazi.¹⁵⁸² Më 8 janar 1999 misioni i OSBE-së pa kur njësi të brigadës përdorën armë tankesh kundër një fshati.¹⁵⁸³

618. Jeliqi dëshmoi se Brigada e Mekanizuar 243 u largua prej kazermës më 24 mars 1999, fill para bombardimit të NATO-s, dhe u dislokua në pozicione mbrojtëse përgjatë kufirit.¹⁵⁸⁴ Ai shpjegoi se zona e përgjegjësisë së brigadës së tij përfshinte qytetet dhe fshatrat Ferizaj, Bibë,

¹⁵⁶⁸ 4D101 (Plan i Korpusit të Prishtinës për pjesëmarrjen në luftime të njëjive në Kosovë, 23 korrik 1998).

¹⁵⁶⁹ P1425 (Letër e Brigadës së Motorizuar 549 drejtuar Korpusit të Prishtinës në lidhje me cilësinë e punës së trupave të MPB-së, 8 gusht 1998).

¹⁵⁷⁰ P1427 (Vendim i Korpusit të Prishtinës, 10 gusht 1998).

¹⁵⁷¹ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999).

¹⁵⁷² P1613 (Urdhër i nënshkruar nga Pavkoviqi, 27 gusht 1998).

¹⁵⁷³ Vladimir Llazareviq, T. 17940 (8 nëntor 2007).

¹⁵⁷⁴ Vladimir Llazareviq, T. 18374 (15 nëntor 2007).

¹⁵⁷⁵ P2000 (Urdhër i Brigadës së Motorizuar 549, 29 mars 1999), f. 2, 4; P2002 (Analizë e Operacioneve të Brigadës së Motorizuar 549, 30 mars 1999); P1981 (Urdhër i Brigadës së Motorizuar 549, 23 mars 1999); P2575 (Ditar Luftë i Batalionit të Raketave Artillerike të Mbrojtjes së Lehtë Kundërajrore të Brigadës së Motorizuar 549), f.2.

¹⁵⁷⁶ P2574 (Ditar Luftë i Batalionit të Blinduar të Brigadës së Motorizuar 549), f. 1; P2575 (Ditar Luftë i Batalionit të Raketave Artillerike të Mbrojtjes së Lehtë Kundërajrore të Brigadës së Motorizuar 549), f.2.

¹⁵⁷⁷ K90, T. 9297–9298 (29 janar 2007), P2652 (deklaratë dëshmitari me datë 8 dhjetor 2002), para. 43–44.

¹⁵⁷⁸ Bozhidar Deliq, T. 19642–19643 (6 dhjetor 2007); P1981 (Urdhër i Brigadës së Motorizuar 549, 23 mars 1999); P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999), f. 7–8; P1995 (Analizë e Operacioneve të Brigadës së Motorizuar 549, 30 mars 1999); P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999), f. 3; P2000 (Urdhër i Brigadës së Motorizuar 549, 29 mars 1999), f. 1–2; P2002 (Analizë e Operacioneve të Brigadës së Motorizuar 549, 30 mars 1999).

¹⁵⁷⁹ P1424 (Raport i Brigadës së Mekanizuar 243, 8 gusht 1998); P1613 (Urdhër i nënshkruar nga Pavkoviqi, 27 gusht 1998); P1101 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 5 shtator 1998), p. 3; P1429 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 9 shtator 1998), f. 2; P1441 (Kërkesë e Komandës së Korpusit të Prishtinës për të dhëna mbi forcat e MPB-së në zonat përkatëse të përgjegjësisë, 8 tetor 1998).

¹⁵⁸⁰ P1401 (Raport i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 13 maj 1998), f. 2–3.

¹⁵⁸¹ Kërsman Jeliq, T. 19125 (27 nëntor 2007).

¹⁵⁸² P1424 (Raport i Brigadës së Mekanizuar 243, 8 gusht 1998); *shih edhe* P1613 (Urdhër i nënshkruar nga Pavkoviqi, 27 gusht 1998).

¹⁵⁸³ 5D651 (Raport javor i komitetit koordinues të OSBE-së, 25 shkurt 1999) f. 7.

¹⁵⁸⁴ Kërsman Jeliq, T. 18846–18847 (22 nëntor 2007). *Shih edhe* 5D1337 (Hartë e njëjive të Korpusit të Prishtinës).

Prelezi i Muhaxherëve, Rakaj, Staro Selo, Papaz, Varosh, dhe Mirosalë.¹⁵⁸⁵ Bazuar në një urdhër me datë 28 mars 1999, zona e përgjegjësisë së Brigadës së Mekanizuar 243 në bashkëpunim me Brigadën e Motorizuar 549, ishte komuna e Suharekës.¹⁵⁸⁶

(3) Brigada 52 e Raketave Artilerike

619. Novica Stamenkoviqi dëshmoi se Brigada 52 e Raketave Artilerike ndryshe quhej Brigada 52 e Mbrojtjes Kundërajrore.¹⁵⁸⁷ Koloneli Millosh Gjoshan ishte komandant i brigadës gjatë kohës kur pretendohet se ndodhën krimet e akuzuara në Aktakuzë dhe shef i Shtabit ishte nënkoloneli Stankoviqi.¹⁵⁸⁸

620. Sergej Peroviqi, shef i organit të sigurimit të Brigadës 52 të Raketave Artilerike,¹⁵⁸⁹ dëshmoi se ajo ishte e vendosur në garnizonin e Gjakovës.¹⁵⁹⁰ Kjo u konfirmua prej Nikë Perajt i cili u caktua atje më 21 dhjetor 1998.¹⁵⁹¹

(B) Forcat e atashuara Korpusit të Prishtinës në kohë lufte

621. Kur qeveria e RFJ-së shpalli gjendjen e rrezikut të luftës së afërt dhe me pas gjendjen e luftës,¹⁵⁹² Korpusi i Prishtinës aktivizoi disa njësi të tij për kohë lufte, si Batalionin e 52-të Mjekësor dhe Bateria të 52-të Artilerike.¹⁵⁹³ Për më tepër, gjatë fushatës së NATO-s, ai u përforcua me njësi të rivartësuara dhe formacione nga grupe të tjera strategjike si dhe formacione operative të UJ-së, përshkruar më poshtë.

622. Në parim njësitë e rivartësuara ishin një nivel më poshtë njësisë në varësi të së cilës viheshin dhe ishin të detyruara të respektonin urdhrat e oficerit komandues nën vartësinë e të cilit ishin vënë. Rrjedhimisht, “njësia amë nuk kishte të drejtë të ndërhynte në komandimin e” njësisë së

¹⁵⁸⁵ Kërsman Jeliq, T. 18966 (23 nëntor 2007). *Shih edhe* 5D1337 (hartë që tregon zonën e përgjegjësisë së Brigadës 243).

¹⁵⁸⁶ P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999), f. 6–8; *shih edhe* P2000 (Urdhër i Brigadës së Motorizuar 549, 29 mars 1999), f. 2–4.

¹⁵⁸⁷ Novica Stamenkoviqi, T. 20121–20122 (12 dhjetor 2007).

¹⁵⁸⁸ Nikë Peraj, P2248 (deklaratë dëshmitari me datë 18 prill 2000), para. 6, P2253 (deklaratë dëshmitari me datë 8–9 gusht 2006), para. 6; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 33–34; Millan Kotur, T. 20687 (21 janar 2008).

¹⁵⁸⁹ Sergej Peroviqi, 5D1396 (deklaratë dëshmitari me datë 8 janar 2008), para. 4–5.

¹⁵⁹⁰ Sergej Peroviqi, 5D1396 (deklaratë dëshmitari me datë 8 janar 2008), para. 4.

¹⁵⁹¹ Nikë Peraj, T. 1585 (14 gusht 2006), P2248 (deklaratë dëshmitari me datë 18 prill 2000), para. 5, P2253 (deklaratë dëshmitari me datë 8–9 gusht 2006), para. 4.

¹⁵⁹² P992 (Vendim për shpalljen e gjendjes së rrezikut të luftës së afërt, 23 mars 1999); P991 (Vendim për shpalljen e gjendjes së luftës, 24 mars 1999).

¹⁵⁹³ 5D1370 (Organigramë e Korpusit të Prishtinës: komandimi dhe bashkërenditja në kohë lufte).

rivartësuar gjatë kryerjes së detyrave luftarake. Megjithatë, njësitë e rivartësuar kishin për detyrë t'i raportonin për veprimtarinë e tyre si komandës së tyre të re, po ashtu edhe të vjetrës.¹⁵⁹⁴

623. Sipas Miodrag Simiqit, përforcimi i njësive me njësi të tjera, ose ndryshe, rivartësimi i njësive nën komanda më të ulëta, ishte “e drejtë e ligjshme dhe vetëm e komandantit përgjegjës “të njësive.¹⁵⁹⁵ Ndonëse për rivartësimin e njësive vendoste shefi i Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë, vetë rivartësimi i një njësie nga një formacion në një tjetër kryhej në bazë të një urdhri të komandës së nivelit më të lartë, siç shpjegoi Mandiqi.¹⁵⁹⁶

624. Brigada 175 e Këmbësoresë, Brigada 7 e Këmbësoresë,¹⁵⁹⁷ dhe Brigada 211 e Blinduar (e komanduar nga Mihajlo Gergari),¹⁵⁹⁸ të gjitha të Korpusit të Nishit, Brigada e 37-të e Motorizuar e Korpusit të Uzhicës të Armatës së Dytë (e komanduar nga Lubisha Dikoviqi),¹⁵⁹⁹ Brigada e 63-të Parashutiste,¹⁶⁰⁰ dhe Brigada e 252-të e Blinduar dhe Grupi i 252-të Taktik i Korpusit të Kragujevcit të Armatës së Parë,¹⁶⁰¹ Baza Logjistike e 202-të e Armatës së Tretë,¹⁶⁰² Kompania e Policisë Ushtarake të Armatës së Parë, dhe disa Njësi Speciale të Shtabit të Përgjithshëm (si Brigada e 72-të Speciale e Korpusit të Njësive Speciale të UJ-së),¹⁶⁰³ ishin ndër njësitë që kaluan në vartësi të Korpusit të Prishtinës gjatë fushatës së NATO-s

¹⁵⁹⁴ Millosh Mandiq, T. 20909–20911 (23 Janar 2008), 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 8 Janar 2008), para. 13, 15.

¹⁵⁹⁵ Miodrag Simiq, 3D1089 (deklaratë dëshmitari e datës 15 gusht 2007), para. 20; *shih gjithashtu* Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 8 janar 2008), para. 13.

¹⁵⁹⁶ Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 8 janar 2008), para. 13; *shih gjithashtu* Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 8 janar 2008), para. 14.

¹⁵⁹⁷ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari e datës 2 tetor 2007), para. 54; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 65; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 42–45. *Shih gjithashtu* 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999), f. 2.

¹⁵⁹⁸ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari e datës 2 tetor 2007), para. 54; Millutin Filipoviq, T. 19266 (28 nëntor 2007); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 65–66; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 42–45. *Shih gjithashtu* 5D84 (Raport Luftimi i Korpusit të Prishtinës për Armatën e Tretë, 3 prill 1999), f. 2.

¹⁵⁹⁹ Lubisha Dikoviq, T. 19870 (10 dhjetor 2007); Lubisha Stojimiroviq, T. 17700 (26 tetor 2007), 4D506 (deklaratë dëshmitari e datës 2 tetor 2007), para. 54; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 65–66; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 42–45.

¹⁶⁰⁰ Nikë Peraj dëshmoi se Brigada e 63-të Parashutiste mori pjesë në operacionin e Luginës së Carragojës më 27 dhe 28 prill 1999. Nikë Peraj, P2253 (deklaratë dëshmitari e datës 8–9 gusht 2006), para. 65. *Shih gjithashtu* Lubisha Stojimiroviq, T. 17656–17657 (26 tetor 2007), 4D506 (deklaratë dëshmitari e datës 2 tetor 2007), para. 2, 4, 19, 28, 54; K73, T. 3327 (13 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁶⁰¹ Millosh Mandiq, T. 20906, 20916–20917 (23 janar 2008), 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 8 janar 2008), para. 3, 7; Millutin Filipoviq, T. 19266 (28 nëntor 2007); Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari e datës 2 tetor 2007), para. 54; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 65–66; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 42–45.

¹⁶⁰² Vladimir Llazareviq, T. 17970 (9 nëntor 2007); 5D180 (Urdhër për kalimin e një pjese të njësive të Armatës së Tretë në varësi të Korpusit të Prishtinës, 8 prill 1999); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 31; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 326.

¹⁶⁰³ Lubisha Stojimiroviq, T. 17656–17657 (26 tetor 2007), 4D506 (deklaratë dëshmitari e datës 2 tetor 2007), para. 4, 6, 54, 65.

625. Si rezultat, në një moment gjatë bombardimeve të NATO-s, më shumë se 30 njësi u vunë nën vartësinë e drejtpërdrejtë të komandantit të Korpusit të Prishtinës, Llazareviq.¹⁶⁰⁴

iii. Organet Territoriale Ushtarake në Kosovë

626. Qëllimi i sistemit territorial ushtarak ishte përkufizuar në kontekstin e administrimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak sipas nenit 280 të Ligjit për UJ-në: “organet ushtarake territoriale garantojnë zbatimin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak në territorin për të cilin janë krijuar...[dhe] mbajnë regjistrin e rekrutëve ushtarak.”¹⁶⁰⁵ Rrjedhimisht organet ushtarake territoriale ishin përgjegjëse për ruajtjen e numrit të efektivave të njësive dhe personelit institucioneve të UJ-së nëpërmjet rekrutimit, dhe detyrat e Qarkut Ushtarak dhe nënsektorëve të tij në kohë paqeje kishin të bënin kryesisht me qarkullimin e rekrutëve gjatë shërbimit të detyrueshëm ushtarak dhe kalimin në forcat rezerviste, siç u përshkrua shkurtimisht më lart.¹⁶⁰⁶

627. Në fillim të vitit 1999 në Kosovë ekzistonin tri nivele të organizimit të organeve territoriale ushtarake. Qarku Ushtarak (*Vojni Okrug*) ndahej në disa Degë Ushtarake (*Vojni Odsek*). Këto degë kontrollonin disa Detashmente Territoriale Ushtarake që u aktivizuan gjatë kohës së luftës si dhe një Batalion Artilerik Territorial Ushtarak.¹⁶⁰⁷ Çdo Degë Ushtarake kishte nga një togë të policisë ushtarake kurse Qarku Ushtarak kishte një kompani të policisë ushtarake.¹⁶⁰⁸

(A) Qarku Ushtarak i Prishtinës

628. I gjithë territori i Kosovës ishte nën kontrollin e Qarkut Ushtarak të Prishtinës i cili mbulonte territorin e 29 komunave.¹⁶⁰⁹ Në kohë paqeje, Qarku Ushtarak i Prishtinës ishte në varësi të Armatës së Tretë. Mirëpo me urdhër të Komandës së Armatës së Tretë, nga 7 prilli 1999 ai u vu nën varësinë e Korpusit të Prishtinës.¹⁶¹⁰

¹⁶⁰⁴ 5D1370 (Organigrama e Korpusit të Prishtinës: komandimi dhe bashkërenditja në kohë lufte).

¹⁶⁰⁵ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 280. *Shih gjithashtu* 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 28.

¹⁶⁰⁶ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 16.

¹⁶⁰⁷ Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 6; P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 279. *Shih gjithashtu* Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 22–23.

¹⁶⁰⁸ Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 17.

¹⁶⁰⁹ Tomislav Mitiq, T. 20879–20880 (23 janar 2008); 4D240 (Struktura, Dislokimi dhe Madhësia Numerike e Komponentit Ushtarak-Territorial të Armatës së Tretë), f. 1.

¹⁶¹⁰ 5D180 (Urdhër për kalimin e një pjese të njësive të Armatës së Tretë në varësi të Korpusit të Prishtinës, 8 prill 1999); Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 6; Miodrag Simiq, T. 15591 (13 shtator 2007); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 30; Radojko Stefanoviç, T. 21729 (6 shkurt 2008); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 326–329, 391–394. *Shih gjithashtu* P991 (Vendim për shpalljen e gjendjes së luftës, 24 mars 1999).

629. Koloneli Zllatomir Peshiq ishte komandant i Qarkut Ushtarak të Prishtinës nga janari i vitit 1999 kur zëvendësoi Vojkan Saviqin.¹⁶¹¹ Duke qenë se Qarku Ushtarak i Prishtinës udhëhiqej nga një kolonel, ai përfaqësonte një komandë ushtarake që për nga madhësia përkonte me një regjiment ose një brigadë; për këtë arsye, kishte nevojë për një shtab dhe komandë më vete.¹⁶¹²

630. Detyra kryesore e Qarkut Ushtarak të Prishtinës dhe Degëve Ushtarake të tij në kohë lufte ishte mbikëqyrja e mobilizimit të rezervistëve dhe rekrutëve në Korpusin e Prishtinës.¹⁶¹³ Që të dy luanin rol në planifikimin, organizimin dhe zbatimin e shërbimit të detyrueshëm ushtarak në territorin e Kosovës si dhe në mobilizimin e njësisve dhe në mbështetjen e mobilizimit të përgjithshëm që po kryhej në Kosovë.¹⁶¹⁴

631. Përfundimisht më 7 prill 1999 i gjithë Qarku Ushtarak i Prishtinës u vu nën vartësinë e Korpusit të Prishtinës.¹⁶¹⁵

(B) Degët Ushtarake

632. Qarku Ushtarak i Prishtinës kishte nën kontrollin e tij pesë Degë Ushtarake: në Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjilan dhe Mitrovicë.¹⁶¹⁶ Çdo Degë Ushtarake në Kosovë kishte një komandë e përbërë nga komandanti i Degës dhe njësitë e tjera që ishin drejtpërsëdrejti nën vartësinë e tij, si për shembull administrata e shtabit, toga e ndërlidhjes, toga e policisë ushtarake dhe toga për rikonicion dhe sabotim.¹⁶¹⁷

633. Tomisllav Mitiqi, komandant i atëhershëm i Degës Ushtarake të Prizrenit, dëshmoi se në kohë paqeje Degët Ushtarake kryenin “detyra lidhur me shërbimin e detyrueshëm ushtarak, ndër të tjera ekzaminimet ushtarake, dërgimin e rekrutëve në shërbim dhe më pas caktimin e tyre nëpër njësi luftarake të UJ-së dhe mbajtjen e regjistrit qendror të personave që i nënshtroheshin shërbimit

¹⁶¹¹ Vojkan Saviqi më pas u bë shef i kabinetit të Pavkoviqit. Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 5.

¹⁶¹² Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 8.

¹⁶¹³ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 22; Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 9.

¹⁶¹⁴ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 29.

¹⁶¹⁵ 4D85 (Urdhër i Armatës së Tretë për vënien e Qarkut Ushtarak të Prishtinës në varësi të Korpusit të Prishtinës, 7 prill 1999).

¹⁶¹⁶ 4D240 (Struktura, Dislokimi dhe Madhësia Numerike e Komponentit Ushtarak-Territorial të Armatës së Tretë), f. 1; Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 6; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 24; Tomisllav Mitiqi, T. 20880 (23 janar 2008). Sllobodan Kosovaci konfirmoi se një nga Degët ishte në Mitrovicë. Sllobodan Kosovaci, T. 15831 (18 shtator 2007). *Shih*. P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 46–47; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 28.

¹⁶¹⁷ Tomisllav Mitiqi, 5D1390 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 3, 18–19; *shih gjithashtu* 5D1076 (Dokument i Degës Ushtarake të Prizrenit, 15 maj 1998), f. 2 (përmend “togat e pavarura” si pjesë të Degëve Ushtarake dhe si “forca për kontrollin e territorit”).

ushtarak.”¹⁶¹⁸ Sipas Mitiqit, Degët Ushtarake nuk kishin për detyrë mbrojtjen e popullatës dhe komanda e Degës Ushtarake të Prizrenit nuk angazhoi forca për kryerjen e kësaj detyre madje edhe kur “operacionet terroriste u përshkallëzuan në vitin 1998”.¹⁶¹⁹ Mirëpo kjo është në kundërshtim me një dokument të Degës Ushtarake të Prizrenit ku thuhet se një pjesë e forcave të komanduara nga kjo Degë do të angazhoheshin në “kontrollin luftarak të territorit, [dhe] shpartallimin dhe shkatërrimin e kryengritjes së armatosur”, për të “siguruar” objektet e UJ-së, dhe për t’u bashkërenduar me njësitë e tjera të UJ-së në shpartallimin dhe shkatërrimin e “forcave të kryengritjes së armatosur”.¹⁶²⁰

634. Zllatomir Peshiqi dëshmoi se efektiviteti maksimal i Qarkut Ushtarak të Prishtinës “gjatë vitit 1999” numëronte rreth 12.000 vetë dhe përfshinte forcat që vepronin drejtpërsëdrejti për Qarkun Ushtarak, Degët Ushtarake, Detashmentet Territoriale Ushtarake, dhe forcat e një batalioni artilerie të mbrojtjes kundërajrore gjithashtu u vunë nën varësinë e Qarkut Ushtarak të Prishtinës.¹⁶²¹

(C) Detashmentet Territoriale Ushtarake

635. Detashmentet Territoriale Ushtarake ishin njësi vartëse të Degëve Ushtarake¹⁶²² dhe rrjedhimisht ishin nën varësinë e komandës së UJ-së.¹⁶²³ Në fillim të vitit 1999, Degët Ushtarake të Qarkut Ushtarak të Prishtinës kishin në varësi 24 Detashmente Territoriale Ushtarake.¹⁶²⁴ Sipas Peshiqit, çdo Detashment Territorial Ushtarak përbëhej nga 200 deri në 400 rezervistë.¹⁶²⁵ Mirëpo, Millosh Mandiqi dëshmoi se Detashmenti Territorial Ushtarak që ishte vënë nën varësinë e brigadës së tij gjatë bombardimeve të NATO-s, numëronte rreth 100 vetë.¹⁶²⁶ Po ashtu edhe Saviqi dëshmoi se dy nga Detashmentet Territoriale Ushtarake që ishin vënë nën varësinë e brigadës së tij kishin 200 deri në 300 anëtarë dhe dy të tjerat “100 deri në 120 apo ndoshta 150 anëtarë”.¹⁶²⁷

¹⁶¹⁸ Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 4.

¹⁶¹⁹ Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 10, 17; 5D1010 (Mesazh i Degës Ushtarake të Prizrenit për Qarkun Ushtarak të Prishtinës, 24 qershor 1998).

¹⁶²⁰ 5D1076 (Dokument i Degës Ushtarake të Prizrenit, 15 maj 1998), f. 2–3.

¹⁶²¹ Zllatomir Peshiq, T. 7287 (24 nëntor 2006).

¹⁶²² Zllatomir Peshiq, T. 7161–7162 (22 nëntor 2006); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 31; Vladimir Marinkoviq, T. 20281 (14 dhjetor 2007).

¹⁶²³ Miodrag Simiq, T. 15591 (13 shtator 2007).

¹⁶²⁴ 4D240 (Struktura, Dislokimi dhe Madhësia Numerike e Komponentit Ushtarak-Territorial të Armatës së Tretë), f. 1, ku thuhet se deri më 14 janar 1999, Dega Ushtarake e Prishtinës kishte shtatë Detashmente Ushtarake Territoriale; Degët Ushtarake të Prizrenit, të Pejës dhe të Gjilanit kishin nga katër Detashmente Ushtarake Territoriale; dhe Dega Ushtarake e Mitrovicës kishte pesë Detashmente Ushtarake Territoriale.

¹⁶²⁵ Zllatomir Peshiq, T. 7159 (22 nëntor 2006); P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 10. *Shih.* Bozhidar Deliq, T. 19466 (4 dhjetor 2007).

¹⁶²⁶ Millosh Mandiq, T. 20945–20947 (24 janar 2008).

¹⁶²⁷ Lubomir Saviq, T. 20982 (24 janar 2008).

636. Ka dëshmi që sugjerojnë se Detashmentet Territoriale Ushtarake u vunë në veprim vetëm gjatë kohës së luftës;¹⁶²⁸ mirëpo, dëshmi të tjera sugjerojnë se Detashmente të ndryshme Territoriale Ushtarake u vunë në veprim dikur gjatë vitit 1998, kur ende nuk ishte shpallur gjendje e jashtëzakonshme ose gjendje lufte. Sipas një dokumenti të Degës Ushtarake të Prizrenit dërguar Qarkut Ushtarak të Prishtinës në maj 1998, Komandës së Degës Ushtarake të Prizrenit i ishte caktuar për detyrë mobilizimi i një pjese të forcave rezerviste të Brigadës së 549-të të Motorizuar dhe të Batalionit të 55-të Kufitar, si edhe “mundësimi i mobilizimit të Detashmenteve Territoriale Ushtarake 68, 70, 101 dhe 108”; këto detyra do të kryheshin nëpërmjet angazhimit të organeve rekrutuese dhe nëpërmjet rekrutimit dhe plotësimit të njësive rezerviste të Komandës së Degës Ushtarake. Mirëpo dokumenti thotë se mobilizimi “ishte sugjeruar” dhe do të zbatohet në rast “agresioni” dhe për këtë arsye nuk është e qartë nëse mobilizimi me të vërtetë u krye.¹⁶²⁹ Gjithsesi deri më 18 korrik 1998 gjendja u bë e qartë. Një raport operativ i kësaj date vë në dukje se njëra nga detyrat e Degës për ditën e nesërme ishte që të “ndihmonte komandat e Detashmenteve Territoriale Ushtarake që ishin vënë nën varësinë e Degës,”¹⁶³⁰ gjë që tregon se Detashmentet Territoriale Ushtarake vepronin që atëherë. Mbetet e paqartë se sa të tillë kishte.

637. Ajo që është e qartë është se të 24 Detashmentet Territoriale Ushtarake që ishin nën varësinë e Qarkut Ushtarak të Prishtinës, u vunë në veprim në fillim të vitit 1999.¹⁶³¹ Ato plotësoheshin me njerëz nga territori i Degës përkatëse të cilit i përkisnin detashmentet.¹⁶³² Meqë shqiptarët kosovarë i “shmangeshin shërbimit ushtarak”, shpeshherë njësitë luftarake nuk e arrinin numrin e plotë të efektivit.¹⁶³³ Peshiqi konfirmoi se asnjë prej 24 detashmenteve nuk e arriti ndonjëherë numrin e plotë të efektivit për shkak të “mungesës së joshqiptarëve” për plotësimin e tyre dhe për arsye se shqiptarët kosovarë nuk u përfshinë në këto Detashmente.¹⁶³⁴ Sipas

¹⁶²⁸ Zllatomir Peshiq, T. 7151–7152 (22 nëntor 2006). *Shih* P1925 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 23 mars 1999), në të cilin Komandanti i Armatës së Tretë u urdhërua të mobilizonte deri më 25 mars 1999 këto Detashmente Ushtarake Territoriale: Detashmentet 64 dhe 174 të Degës Ushtarake të Prishtinës; Detashmentin 54 të Degës Ushtarake të Mitrovicës; Detashmentin 113 të Degës Ushtarake të Pejës; dhe Detashmentet 70 dhe 185 të Degës Ushtarake të Prizrenit. Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 17, 23.

¹⁶²⁹ 5D1076 (Dokument i Degës Ushtarake të Prizrenit, 15 maj 1998); f. 1–2; Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 17.

¹⁶³⁰ 5D1011 (Raport operativ i Degës Ushtarake të Prizrenit, 18 korrik 1998), f. 2.

¹⁶³¹ Zllatomir Peshiq, T. 7287 (24 nëntor 2006); 4D240 (Struktura, Dislokimi dhe Madhësia Numerike e Komponentit Ushtarak-Territorial të Armatës së Tretë), f. 1.

¹⁶³² Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 21; *shih gjithashtu* Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 8 janar 2008), para. 42.

¹⁶³³ Tomisllav Mitiq, 5D1390 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 21.

¹⁶³⁴ Zllatomir Peshiq, T. 7159 (22 nëntor 2006), P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 10. Në mbledhjen e Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë u diskutua lidhur me formimin e Detashmentit të 9-të Ushtarak Territorial. Ky ishte një detashment i porsaformuar i ushtrisë bazuar në propozimin e Komandës së Armatës së Tretë; ai u formua me qëllim ngritjen e një njësie të vetme në të cilën oficerët (nënoficerët dhe oficerët) do të ishin shqiptarë kosovarë. Qëllimi i kësaj nisme ishte “rritja e besimit të popullatës shqiptare të Kosovës” për UJ-në. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm e pranoi këtë propozim; mirëpo krijimi i kësaj njësie nuk u realizua dhe të gjitha dokumentet përkatëse u hodhën. Sillobodan Kosovac, T. 15815 (17 shtator 2007).

Llazareviqit, numri i përgjithshëm i efektivave të Detashmenteve Territoriale Ushtarake në kohë lufte ishte 9.000 vetë.¹⁶³⁵

638. Detyrat e Detashmenteve Territoriale Ushtarake në kohë lufte ishin: sigurimi/mbrojtja e rrugëve, kalimeve, kryqëzimeve dhe objekteve; kontrolli i luftarak i territorit dhe ndonjëherë kryerja e operacioneve të vogla luftarake kundër UÇK-së.¹⁶³⁶ Millosh Mandiqi shtoi se me qëllim sigurimin e objekteve “pozicionet e tyre shikonin mbi rrugët”.¹⁶³⁷

639. Detashmentet Territoriale Ushtarake zakonisht ishin nën komandën e qarkut të tyre; megjithatë, ato mund të viheshin nën varësinë e një Dege Ushtarake tjetër brenda Qarkut Ushtarak të Prishtinës, ose nën varësinë e njësisive të UJ-së jashtë Qarkut Ushtarak të Prishtinës, përfshirë batalionet e Korpusit të Prishtinës.¹⁶³⁸ Ka prova të konsiderueshme se dikur gjatë bombardimeve të NATO-s shumica e Detashmenteve Territoriale Ushtarake u vunë nën varësinë e njësisive të ndryshme të Korpusit të Prishtinës;¹⁶³⁹ gjithsesi disa të tjera mbetën nën varësinë e komandës bazë të tyre gjatë gjithë periudhës së bombardimeve të NATO-s.¹⁶⁴⁰

640. Sipas Llazareviqit, në rrethana të veçanta Detashmentet Territoriale Ushtarake që nuk ishin vënë nën varësinë e ndonjë njësie tjetër dhe që kishin mbetur nën hierarkinë komanduese të Degës Ushtarake të tyre mund të angazhoheshin për kontrollimin e territorit dhe në kryerjen e operacioneve të vogla luftarake.¹⁶⁴¹ Llazareviqi shtoi se edhe në rastet kur Detashmentet

¹⁶³⁵ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 45–46.

¹⁶³⁶ Millosh Mandiq, T. 20945–20947 (24 janar 2008); Zllatomir Peshiq, P2515 (fletë me informacion shtesë, 21 nëntor 2006), para. 31; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 28; *shih gjithashtu* 5D1076 (Dokument i Degës Ushtarake të Prizrenit, 15 maj 1998); f. 2; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 45–46.

¹⁶³⁷ Millosh Mandiq, T. 20946 (24 janar 2008).

¹⁶³⁸ Zllatomir Peshiq, T. 7162–7163 (22 nëntor 2006); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 45–46. *Shih gjithashtu* 5D1076 (Dokument i Degës Ushtarake të Prizrenit, 15 maj 1998), f. 2, ku përcaktohet se Detashmenti i 68-të Ushtarak Territorial do t'i bashkohej Brigadës së Motorizuar 549 dhe se Detashmenti i 101-të Ushtarak Territorial do t'i bashkohej Brigadës së Motorizuar 354 në maj 1998.

¹⁶³⁹ *Shih* Lubisha Stojimiroviq, T. 17654–17655 (26 tetor 2007); Millutin Filipoviq, T. 19266 (28 nëntor 2007); Kërsman Jeliq, T. 18973 (26 nëntor 2007); Bozhidar Deliq, T. 19466 (4 dhjetor 2007); Vladimir Marinkoviq, T. 20273 (14 dhjetor 2007); Lubomir Saviq, T. 20980–20981 (24 janar 2008); 4D198 (Urdhër i Armatës së Tretë me Listë Udhëzimesh, 7 maj 1999), para. 13; P1925 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 23 mars 1999); Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 8 janar 2008), para. 42; P2806 (Mesazh lidhur me varësinë e qarqeve ushtarake, 29 mars 1999).

¹⁶⁴⁰ Vladimir Llazareviq, T. 17828 (7 nëntor 2007). Peshiqi ishte i mendimit se Detashmentet Territoriale Ushtarake u mobilizuan në mënyrë përzgjedhëse dhe sipas preferencës (dhe nuk u vunë në varësi) në zonat ku “prania e UJ-së ... nuk ishte aq e madhe krahasuar me vise të tjera të Kosovës”; Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 23.

¹⁶⁴¹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 45–47. Këtë e mbështet një dokument i Degës Ushtarake të Prizrenit dërguar Qarkut Ushtarak të Prishtinës në maj 1998 ku thuhet se Detashmenti Territorial Ushtarak 108 [do të marrë] rolin e forcave që sigurojnë territorin”; 5D1076 (Dokument i Degës Ushtarake të Prizrenit, 15 maj 1998), f. 2.

Territoriale Ushtarake kryenin operacione luftarake gjatë kohës që nuk ishin nën varësinë e njërive të Korpusit të Prishtinës, gjithsesi duhej të kishte bashkërendim me Korpusin e Prishtinës.¹⁶⁴²

641. Dhoma konstaton se gjatë fushatës ajrore të NATO-s, detashmentet territoriale ushtarake numëronin 9.000 - 12.000 pjesëtarë. Ndonëse të gjitha detashmentet ishin nën varësinë e Armatës së Tretë gjatë gjithë konfliktit, disa nga këto njësi u vunë në varësi të Korpusit të Prishtinës. Dhoma analizon vënien e disa detashmenteve territoriale në varësi të te Korpusi i Prishtinës më poshtë kur i vjen radha kësaj teme.

*iv. Vullnetarët*¹⁶⁴³

642. UJ-ja ishte e autorizuar të përforcohej me vullnetarë gjatë gjendjes së luftës, rrezikut të luftës së afërt ose gjendjes së jashtëzakonshme.¹⁶⁴⁴ Me regjistrimin e tyre në regjistrat e UJ-së dhe caktimin e tyre në njësi të UJ-së, vullnetarët bëheshin anëtarë të UJ-së me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që përmbante anëtarësia.¹⁶⁴⁵

643. Vullnetarë mund të bëheshin personat që nuk kishin detyra luftarake në ndonjërin nga strukturat e sistemit të mbrojtjes dhe sigurisë së RFJ-së, përkatësisht në UJ, MPB, ose në njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile.¹⁶⁴⁶ Vlen të përmendet se edhe shtetas të huaj mund të merrnin statusin e vullnetarit në UJ.¹⁶⁴⁷

644. Administrata për Rekrutim, Mobilizim dhe Çështje Ssitemore në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së ishte përgjegjëse për organizimin dhe mobilizimin e vullnetarëve.¹⁶⁴⁸ Më 1999, në RFJ u ngritën tri qendra të pranimit të vullnetarëve, për pranimin dhe vlerësimin e vullnetarëve të mundshëm: një në komandën e Armatës së Parë në Qarkun Ushtarak të Beogradit, e dyta në komandën e Armatës së Dytë në Qarkun Ushtarak të Podgoricës dhe e treta në komandën e

¹⁶⁴² P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 46–48.

¹⁶⁴³ Gjatë procesit gjyqësor, fjala “vullnetar” u përdor në kontekste të ndryshme për të përshkruar detashmentet ushtarake rezerviste, rezervistët e policisë dhe të tjerë. Kjo nënndarje trajton vetëm çështjen e vullnetarëve sipas kuptimit të nenit 15 të Ligjit të RFJ-së për UJ-në.

¹⁶⁴⁴ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 15.

¹⁶⁴⁵ P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 15; 3D481 (Urdhër i Komandës së Lartë, 14 prill 1999), f. 2. *Shih gjithashtu* 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 166; Sllobodan Kosovac, T. 15859 (18 shtator 2007); Vladimir Marinkoviq, T. 20272 (14 dhjetor 2007); Gjorgje Qurçin, 3D1121 (deklaratë dëshmitari e datës 24 gusht 2007), para. 30.

¹⁶⁴⁶ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 163.

¹⁶⁴⁷ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 164; P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), neni 8. Peshiqi shpjegoi se gjatë kohës që mbulon Aktakuza, pjesa më e madhe e personave të aftë për shërbim ushtarak në RFJ, deri në atë kohë ishin caktuar nëpër Detashmente Territoriale Ushtarake, pasi kishin kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Zllatomir Peshiq, T. 7152 (22 nëntor 2006). Rrjedhimisht të vetmit që mund të paraqiteshin si vullnetarë, ishin ata që nuk ishin caktuar me detyrë në ndonjë Detashment Territorial Ushtarak rezervë, apo që ishin caktuar me detyrë në Detashmente Ushtarake Territoriale rezervë të cilat nuk ishte thirrur në shërbim. Aleksandar Vasileviq, T. 8860 (22 janar 2007).

Armatës së Tretë në Qarkun Ushtarak të Nishit.¹⁶⁴⁹ Sipas një urdhri të Shtabit të Komandës së Lartë të datës 7 prill 1999, qendrat e pranimit duhej t'u kushtonin vëmendje të veçantë vullnetarëve që donin të shkonin në njësitë e Korpusit të Prishtinës për të garantuar respektimin e legjislacionit përkatës sipas të cilit personat që tanimë kishin detyra luftarake, nuk mund të paraqiteshin si vullnetarë.¹⁶⁵⁰ Sipas një urdhri të mëtejshëm, qendrat e pranimit kishin për detyrë të kryenin vlerësimin psikologjik të vullnetarëve, regjistrimin e të dhënave të tyre në regjistër, pajisjen e tyre me armë dhe pajisje ushtarake dhe dërgimin e tyre në njësitë për stërvitje.¹⁶⁵¹

645. Mirëpo Vasileviqi dëshmoi se urdhri i 7 prillit nuk u respektua nga të gjithë.¹⁶⁵² Këtë e mbështet edhe një raport pune mbi çështjen e vullnetarëve i Armatës së Tretë dërguar Shtabit të Komandës së Lartë më 10 prill 1999, në të cilin Armata e Parë fajësohet për dërgimin e shumë vullnetarëve të cilët nuk kishin kaluar procesin e verifikimit dhe shumica e të cilëve ishin dukshëm të paaftë nga ana shëndetësore për të kryer shërbimin ushtarak apo ishin anëtarë të grupeve paraushtarake.¹⁶⁵³ Sipas këtij dokumenti, nga 1.517 vullnetarë të pranuar, 849 u dislokuan; mirëpo, për shkak se nuk kishte njerëz të mjaftueshëm për të kryer kontrollet e sigurisë, në mesin e vullnetarëve kishte dhe disa të tillë me të kaluar kriminale.¹⁶⁵⁴ Për më tepër, vendosja e vullnetarëve në grupe brenda njërive të UJ-së vazhdoi edhe pas daljes së këtyre urdhrave siç diskutohet më poshtë në Pjesën VIII.G lidhur me përgjegjësinë penale individuale të Llazareviqit.

646. Kosovaci dëshmoi se gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s, rreth 6.000 vullnetarë u paraqitën në UJ: 20 për qind prej tyre nuk e kaluan procesin e verifikimit në qendrat e pranimit dhe 20 për qind të tjerë u hoqën nga njësitë ku ishin dërguar; pjesa tjetër e vullnetarëve mbetën në forcat e UJ-së deri në përfundimin e luftës. Rreth 150 të huaj nga vende të ndryshme erdhën në RFJ për t'u bashkuar si vullnetarë dhe 140 prej tyre u pranuar.¹⁶⁵⁵

¹⁶⁴⁸ Sllobodan Kosovac, T. 15802–15803 (17 shtator 2007), 3D481 (Urdhër i Komandës së Lartë, 14 prill 1999).

¹⁶⁴⁹ P1479 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë në lidhje me Vullnetarët, 7 prill 1999), f. 1; Branko Gajiç, T. 15310 (10 shtator 2007).

¹⁶⁵⁰ P1479 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë në lidhje me Vullnetarët, 7 prill 1999), f. 1.

¹⁶⁵¹ 3D481 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë, 14 prill 1999), f. 1.

¹⁶⁵² Aleksandar Vasileviq, T. 8855 (22 janar 2007).

¹⁶⁵³ P1938 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999), f. 1–2. Zharko Kostiq, T. 17504–17505 (23 tetor 2007), 4D501 (deklaratë dëshmitari e datës 28 shtator 2007), para. 35–36.

¹⁶⁵⁴ P1938 (Raport i Armatës së Tretë për Shtabin e Komandës së Lartë, 10 prill 1999), f. 1–2.

¹⁶⁵⁵ Sllobodan Kosovac, T. 15810 (17 shtator 2007), T. 15858 (18 shtator 2007).

(A) Pranimit i vullnetarëve në Armatën e Tretë, në Korpusin e Prishtinës dhe në njësitë vartëse

647. Në fillim të bombardimeve të NATO-s, “disa qindra” vullnetarë nga i gjithë territori i RFJ-së shkuan në Nish për t’u regjistruar dhe për t’u bashkuar me UJ-në.¹⁶⁵⁶ Pavkoviqi caktoi Zharko Kostiqin dhe disa oficerë të tjerë që të krijojnë një qendër pranimit për të organizuar testimin, pranimin, stërvitjen dhe armatosjen e vullnetarëve. Pas stërvitjes disaditore vullnetarët u dërguan nëpër njësi luftarake të Korpusit të Prishtinës dhe të Korpusit të Nishit në përputhje me përgatitjen e tyre ushtarake dhe profesionale.¹⁶⁵⁷

648. Sllobodan Kosovaci dëshmoi se vullnetarët e parë u paraqitën në qendrat e pranimi natën e 23 marsit 1999.¹⁶⁵⁸ Mirëpo, menjëherë pas pranimi të vullnetarëve në radhët e UJ-së u vërejtën probleme. Gjatë periudhës 24 mars - 14 prill u lëshuan tri urdhra dhe një shtojcë, siç pretendohet për të zgjidhur çështjen e pranimi të vullnetarëve dhe për pakësimin e problemeve.¹⁶⁵⁹ Këto urdhra themeluan një sistem verifikimi të shumë faktorëve, si nënshtetësia, gjendja shëndetësore dhe përshtatshmëria “nga pikëpamja e sigurisë”.¹⁶⁶⁰ Vullnetarët mund të ishin deri 40 vjeç nëse do të caktoheshin “në armët e ndryshme të shërbimit ushtarak”, dhe deri 60 vjeç nëse do të caktoheshin në ndonjë nga sektorët teknikë të UJ-së.¹⁶⁶¹ Ndalohej dërgimi në grupe të vullnetarëve nëpër njësi për shkak të “përvojave negative në të kaluarën.”¹⁶⁶² Branko Gajiqi dhe Zharko Kostiqi dëshmuan se për t’iu shmangur problemeve, në një njësi nuk duheshin caktuar më shumë se pesë vullnetarë.¹⁶⁶³

649. Vullnetarët vazhduan të paraqisnin problem. Më 6 maj 1999, Komanda e Armatës së Tretë lëshoi një direktivë me anë të së cilës u ndalonte njësitë luftarake rekrutimin e vullnetarëve që nuk

¹⁶⁵⁶ Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë dëshmitari e datës 28 shtator 2007), para. 27.

¹⁶⁵⁷ Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë dëshmitari e datës 28 shtator 2007), para. 28–33; *shih gjithashtu* Kërsman Jeliq, T. 18879 (23 nëntor 2007); Bozhidar Deliq, T. 19667 (6 dhjetor 2007); Franjo Gllonçak, 5D1395 (deklaratë dëshmitari e datës 26 dhjetor 2007), para. 4.

¹⁶⁵⁸ Sllobodan Kosovaci, T. 15802 (17 shtator 2007).

¹⁶⁵⁹ Sllobodan Kosovaci, T. 15803 (17 shtator 2007). *Shih* P1479 (Urdhër i Komandës së Lartë, 7 prill 1999), f. 3. Radinoviqi dëshmoi se Urdhri i 7 prillit prapësoi një urdhër të datës 24 mars 1999 dhe shtojcën e tij të datës 29 mars 1999. 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 167; 3D490 (Telegram dërguar nga Ojdaniqi, 4 maj 1999), f. 1. *Shih gjithashtu* Zillatoje Terziq, 3D1093 (deklaratë dëshmitari e datës 18 gusht 2007), para. 8.

¹⁶⁶⁰ “Pikëpamja e Sigurisë” supozohet se i referohet ekzistencës apo mungesës së precedentëve penalë; P1479 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë në lidhje me Vullnetarët, 7 prill 1999), f. 1–3.

¹⁶⁶¹ Sllobodan Kosovaci, T. 15825, 15859 (18 shtator 2007).

¹⁶⁶² P1479 (Urdhër i Shtabit të Komandës së Lartë në lidhje me Vullnetarët, 7 prill 1999), f. 3. *Shih gjithashtu* Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë dëshmitari e datës 28 shtator 2007), para. 33; Miodrag Simiq, T. 15667 (14 shtator 2007); 3D481 (Urdhër i Komandës së Lartë, 14 prill 1999); Aleksandar Vasileviq, T. 8854 (22 janar 2007).

¹⁶⁶³ Branko Gajiq, T. 15266–15267 (7 shtator 2007); Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë dëshmitari e datës 28 shtator 2007), para. 33.

ishin dërguar nëpërmjet qendrës së pranimit të Armatës së Tretë.¹⁶⁶⁴ Më 7 maj, komandanti i Armatës së Tretë lëshoi edhe një urdhër ku kërkonte që njësitë të largonin menjëherë nga radhët e tyre vullnetarët që nuk i respektonin urdhrat, të organizonin kthimin e tyre në Nish dhe t'i detyronin që të kthenin armët dhe pajisjet personale ushtarake.¹⁶⁶⁵

650. Kostiqi pohoi se gjatë bombardimeve të NATO-s Armata e Tretë nuk kishte nevojë të pranonte vullnetarë meqë kishte ushtarë të mjaftueshëm dhe humbjet që kishin pësuar njësitë e saj ishin minimale. Mirëpo vullnetarët prapëseprapë pranoreshin për shkak të “traditës luftarake serbe”.¹⁶⁶⁶ Ai deklaroi se afërsisht 2.500 vullnetarë kaluan nëpër qendrën e pranimit të Armatës së Tretë, dhe se 1.800 u caktuan në njësitë luftarake të Korpusit të Prishtinës dhe të Nishit.¹⁶⁶⁷ Llazareviqi tha se Korpusi i Prishtinës pranoi rreth 1.400 vullnetarë si ushtarë prej të cilëve 120 u larguan shumë shpejt sepse pavarësisht nga të gjitha verifikimet që kishin kaluar, Korpusi nuk ishte i kënaqur me dukjen dhe sjelljen e tyre në njësi.¹⁶⁶⁸

651. Deliqi dëshmoi se kishte “mjaft” vullnetarë në Brigadën e Motorizuar 549,¹⁶⁶⁹ në brigadë vullnetarët u ndanë nëpër njësi të ndryshme dhe ata ishin të kombësive të ndryshme, ndër të tjerë rusë dhe ukrainas.¹⁶⁷⁰ Deliqi sqaroi se ndonëse Brigadës së Motorizuar 549 iu bashkuan vullnetarë të huaj, ata e bënë këtë në mënyrë të organizuar duke ndjekur procedurën për pranimin e vullnetarëve.¹⁶⁷¹ Së fundi ai tha se e kishte respektuar urdhrin për ndalimin e formimit të njësive “tërësisht vullnetare” për shkak të përvojës së keqe me plaçkitjet dhe krimet e tjera.¹⁶⁷²

652. Vladimir Marinkoviqi dëshmoi se Brigada e Blinduar 15 pranoi disa herë grupe vullnetarësh që kishin kaluar procesin e verifikimit në qendrën e rekrutimit në Beograd por që si individë kishin refuzuar t'u bashkoheshin njësive vartëse të brigadës duke dashur të formonin njësitë e tyre “vullnetare”. Sipas Marinkoviqit, meqë kjo lloj njësie nuk ishte e pranueshme, këta vullnetarë u kthyen mbrapsht në qendrat nga kishin ardhur.¹⁶⁷³ Mirëpo kur u pyet lidhur me inspektimin e Brigadës të Motorizuar 175 që kishte kryer nga mesi i prillit 1999, Dragisha Marinkoviqi, i cili asokohe ishte zëvendëskomandanti për Informim dhe Moral në Komandën e Korpusit të Prishtinës,

¹⁶⁶⁴ 4D353 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë lidhur me pranimin e vullnetarëve, 6 maj 1999). *Shih gjithashtu* Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë dëshmitari e datës 28 shtator 2007), para. 39; T. 17505 (23 tetor 2007); 5D936 (Urdhër i Komandës së Brigadës së Blinduar 15 lidhur me pranimin e vullnetarëve, 12 maj 1999).

¹⁶⁶⁵ 4D198 (Urdhër i Armatës së Tretë me Listë Udhëzimesh, 7 maj 1999), para. 11.

¹⁶⁶⁶ Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë dëshmitari e datës 28 shtator 2007), para. 40.

¹⁶⁶⁷ Zharko Kostiq, 4D501 (deklaratë dëshmitari e datës 28 shtator 2007), para. 38.

¹⁶⁶⁸ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 42–45.

¹⁶⁶⁹ Bozhidar Deliq, T. 19582 (5 dhjetor 2007).

¹⁶⁷⁰ Bozhidar Deliq, T. 19596–19597 (5 dhjetor 2007).

¹⁶⁷¹ Bozhidar Deliq, T. 19667 (6 dhjetor 2007).

¹⁶⁷² Bozhidar Deliq, T. 19600 (5 dhjetor 2007).

¹⁶⁷³ Vladimir Marinkoviqi, T. 20272–20273, 20327–20328 (14 dhjetor 2007).

dëshmoi se në brigadë kishte hasur në një grup që përbëhej vetëm nga vullnetarë. Ai i përshkroi vullnetarët si persona “që nuk kishin paraqitje të rregullt ushtarake dhe nuk ishin të pastër” dhe shtoi se ata vishnin pjesë të uniformave të ndryshme, dukeshin si të lënë pas dore dhe nuk respektonin protokollet.

653. Branko Gajiqi dëshmoi se një grup prej 23 personash që ishin anëtarë të grupit të Jugosllav Petrushiqit i njohur si “Pauk” (Merimanga) iu bashkuan Brigadës së Motorizuar 125 si vullnetarë, pa kaluar nëpër procedurën që kishte përcaktuar Shtabi i Komandës së Lartë. Sipas Gajiqit, ata kishin “anashkaluar” procedurat e rregullta për pranimin e vullnetarëve sepse kishin bashkëpunëtorë në UJ të cilët kishin dhënë garanci të rreme se këta persona e kishin kaluar procedurën zyrtare.¹⁶⁷⁴ Mirëpo ky rast kishte qenë vetëm një gabim në pjesën e procedurës që kryhej në qendrat e pranimit,¹⁶⁷⁵ dhe këta persona shumë shpejt u zbuluan dhe u kthyen mbrapsht para se të kryenin ndonjë krim.¹⁶⁷⁶ Momir Stojanoviç shtoi se këta burra kishin ardhur në Korpusin e Prishtinës si grup duke ndjekur procedurën e rregullt për pranimin e vullnetarëve, dhe se ata u caktuan në Brigadën e Motorizuar 125. Vetëm pas pranimit të tyre, ai u vu në dijeni se ata njiheshin si Pauk.¹⁶⁷⁷

d. Njësi të tjera në Kosovë

654. Gjatë kohës që mbulon Aktakuza, në Kosovë kishte dhe disa njësi të tjera që ishin jashtë hierarkisë komanduese të Armatës së Tretë, përkatësisht njësitë e Forcave Ajrore dhe të Mbrojtjes Kundërajrore,¹⁶⁷⁸ të cilat ishin nën varësinë e komandës së Forcave Ajrore dhe Mbrojtjes Kundërajrore.¹⁶⁷⁹ Ndonëse komandantët e Armatës së Tretë dhe Korpusit të Prishtinës nuk i komanduan këto njësi në asnjë moment gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s, ata mbanin kontakte me përfaqësuesit e këtyre njërive në Komandën e Korpusit të Prishtinës.¹⁶⁸⁰

655. E vetmja provë në zotërim të Dhomës që lidhet drejtpërsëdrejti me çështjen nëse dhe sa kohë ishin aktive Forcat Ajrore të UJ-së gjatë konfliktit, është dëshmia e Smilaniqit se “aviacioni” i tyre i ndërpreu fluturimet në Kosovë më 4 prill 1999, se pati vetëm një fluturim më 4 maj, “kur një MiG-29 u ngrit nxitimthi për t’u ballafaquar me një grup aeroplanësh që ishin nisur në drejtim të

¹⁶⁷⁴ Branko Gajiq, T. 15308–15312 (10 shtator 2007).

¹⁶⁷⁵ Branko Gajiq, T. 15325–15327 (10 shtator 2007).

¹⁶⁷⁶ Branko Gajiq, T. 15311 (10 shtator 2007).

¹⁶⁷⁷ Momir Stojanoviç, T. 19778–19779 (7 dhjetor 2007).

¹⁶⁷⁸ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 31; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 45.

¹⁶⁷⁹ Spasoje Smilaniq, T. 15762 (17 shtator 2007); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 136–137; Lubisha Stojimiroviç, T. 17645 (26 tetor 2007).

¹⁶⁸⁰ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 230–231.

Serbisë”, dhe se deri më 4 prill NATO-ja kishte rrëzuar gjithsej pesë ose gjashtë aeroplanë të UJ-së.¹⁶⁸¹

656. Ka edhe tri dokumente që lidhen me këtë çështje. Mirëpo në një prej tyre që mban datën 15 maj 1999, lexohet vetëm se në atë kohë nuk fluturonin aeroplanë të UJ-së kurse dy raporte luftimi të Brigadës së Motorizuar 125 të datave 28 mars 1999 dhe 1 prill 1999, sugjerojnë se aeroplanë të UJ-së ende fluturonin gjatë kësaj kohe. Ndonëse autori i këtyre dokumenteve, komandant brigade Dragan Zhivanoviq tha se aeroplanët e UJ-së nuk fluturuan gjatë këtyre datave, Dhoma e gjykon dëshminë e tij vetëm si një pohim se gjatë periudhës së bombardimeve të NATO-s, aeroplanët e UJ-së nuk fluturuan mbi zonën e tij të përgjegjesisë.¹⁶⁸²

i. Njësitë e Ndërlidhjes

657. Përveç njërive të Forcave Ajrore dhe të Mbrojtjes Kundërajrore të cilat ruajtën hierarkinë e tyre komanduese, në Kosovë kishte edhe njësi të ndërlidhjes që ishin nën varësinë e drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së/Shtabit të Komandës së Lartë.¹⁶⁸³ Sipas Radinoviçit, këto njësi ishin “njësi të palëvizshme të ndërlidhjes të vendosura në çdo garnizon dhe në objektet e ndërlidhjes në nivel batalioni” dhe efektivi i tyre gjatë kohës që mbulon Aktakuza arriti në rreth 600 vetë. Këto njësi asnjëherë nuk u vunë nën varësinë e Armatës së Tretë apo Korpusit të Prishtinës dhe ruajtën hierarkinë e tyre komanduese dhe i kryen detyrat në përputhje me planet dhe urdhrat e Komandës së Lartë.¹⁶⁸⁴

3. Forcat e Ministrisë së Brendshme të Serbisë

658. Ministria e Brendshme e Serbisë ose MPB-ja u formua bazuar në Ligjin për Ministrinë në shkurt 1991,¹⁶⁸⁵ dhe detyrat e saj lidheshin me sigurinë e shtetit dhe qytetarëve të tij.¹⁶⁸⁶ Ministri i Brendshëm i Serbisë ishte Vllajko Stojilkoviç i cili u caktua në këtë post më 15 prill 1997.¹⁶⁸⁷ Mbrojtja e Llukiqit paraqiti Branisllav Simonoviçin si dëshmitar ekspert për MPB-në dhe strukturën e saj. Mirëpo Dhoma konstaton se në bazë të rekomandimeve dhe përgatitjes

¹⁶⁸¹ P2038 (Raport Luftimi i Brigadës së Motorizuar 125 për Korpusin e Prishtinës, 1 prill 1999), f. 2; Spasoje Smilaniq, T. 15769, 15785 (17 shtator 2007).

¹⁶⁸² P2033 (Raport Luftimi i Brigadës së Motorizuar 125 për Korpusin e Prishtinës, 28 mars 1999), f. 4; 5D424 (Dokument i Shtabit të Komandës së Lartë, 15 maj 1999). *Shih gjithashtu* Dragan Zhivanoviq, T. 20576–20578 (18 janar 2008).

¹⁶⁸³ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 45.

¹⁶⁸⁴ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 31, 136–137.

¹⁶⁸⁵ 1D456 (Ligji për Ministrinë), neni 5.

¹⁶⁸⁶ 1D456 (Ligji për Ministrinë), neni 7.

¹⁶⁸⁷ 1D413 (Vendim në lidhje me Zgjedhjen e Zëvendëskryeministrit dhe Ministrit të Brendshëm të Qeverisë së Republikës së Serbisë, 16 prill 1997).

profesionale të Simonoviqit, ai nuk ishte i kualifikuar që të fliste në cilësinë e një eksperti për strukturën organizative të MPB-së; ekspertiza e tij lidhej me fushën e krimeve dhe shërbimit policor vendor dhe jo me strukturën e MPB-së.

a. Organet e MPB-së

659. Njësitë kryesore organizative të MPB-së ishin Drejtoria e Sigurimit Publik (*Resor Javne Bezbednosti*) (“RJB”) dhe Drejtoria e Sigurimit Shtetëror (*Resor Državne Bezbednosti*) (“RDB”).¹⁶⁸⁸ RJB-ja kishte për detyrë ruajtjen e rendit publik kurse RDB-ja ishte përgjegjëse për ruajtjen e sigurisë shtetërore dhe kishte për detyrë t’i përgjigjej çdo kërcënimi ndaj shtetit në tërësi, edhe nëpërmjet spiunazhit.¹⁶⁸⁹ Njësitë organizative të RJB-së përfshinin Administratën e Policisë, Administratën e Sigurisë në Qarkullim, Administratën e Policisë për Krimet dhe Administratën e Policisë Kufitare për të Huaj dhe për Çështje Administrative.¹⁶⁹⁰ Gjatë gjithë periudhës që mbulon Aktakuza, Shefi i RJB-së ishte gjenerallejtënant Vlastimir Gjorgjeviq.¹⁶⁹¹ Gjatë 1998, shef i RDB-së ishte Jovica Stanishiqi i cili më 5 nëntor 1998 u zëvendësua nga Radomir Markoviqi.¹⁶⁹²

i. Drejtoria e Sigurimit Publik (RJB)

(A) Sekretariatet e Brendshme

660. Republika e Serbisë, përfshirë Kosovën, ishte e ndarë në zona gjeografike. Çdo zonë gjeografike kishte Sekretariatit e vet për Punë të Brendshme (“SPB”) të udhëhequr nga “shefi i sekretariatit”. Nga 33 SPB-të e ngritura në territorin e Serbisë, shtatë ndodheshin në Kosovë.¹⁶⁹³ Sipas nenit 4 të Rregullores mbi Organizimin e MPB-së, SPB-të e Kosovës ishin të vendosura në komunat e Gjilanit, Gjakovës, Mitrovicës, Pejës, Prizrenit, Prishtinës dhe Ferizajt.¹⁶⁹⁴

¹⁶⁸⁸ P2555 (Diagram me titullin “Struktura e Komandës së Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Serbisë”). Sipas Lubinko Cvetiqit, P2555-në e kishte hartuar Philip Coe i Ekipit të Analistëve Ushtarakë të Zyrës së Prokurorisë dhe Cvetiqi konfirmoi se prova P2555 ishte e saktë për sa i përket RDB-së, me përjashtim të faktit se sipas mendimit të tij SAJ-ja nuk ishte vënë në vendin e duhur në diagram dhe se JSO-ja nuk ishte nën varësinë e drejtpërdrejt të Shtabit të MPB-së. Lubinko Cvetiq, T. 8034 (6 dhjetor 2006). Dhoma vëren se RDB-ja ndryshe quhej edhe DB, SDB dhe RSDB. *Shih* Ratomir Taniq, T. 6279 (10 nëntor 2006).

¹⁶⁸⁹ K84, T. 5207 (19 tetor 2006) (seancë e mbyllur). *Shih gjithashtu* 6D1305 (Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Ministrisë së Brendshme, 31 dhjetor 1997), nenet 1–2.

¹⁶⁹⁰ 6D1305 (Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Ministrisë së Brendshme, 31 dhjetor 1997), neni 13.

¹⁶⁹¹ 1D399 (Njoftim mbi emërimin e gjeneralëve në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë, 28 mars 1996); *shih* P1251 (Vendim mbi Formimin e Shtabit të Ministrisë në Prishtinë), nënshkruar nga Gjorgjeviq si Shef i RJB-së.

¹⁶⁹² Lubinko Cvetiq, T. 8037 (6 dhjetor 2006); Zoran Mijatoviq, T. 14565 (29 gusht 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë e dëshmitarit e datës 14 janar 2007), para. 33.

¹⁶⁹³ Lubinko Cvetiq, T. 8044 (7 dhjetor 2006); 6D1305 (Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Ministrisë së Brendshme), neni 3; 6D668 (Aktekspertizë e Branisllav Simonoviqit), f. 63.

¹⁶⁹⁴ 6D1305 (Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Ministrisë së Brendshme), neni 4.

(B) Sektorët e Brendshëm dhe stacionet policore

661. Çdo SPB përbëhet nga disa Sektorë të Brendshëm (*Odeljenja Unutrašnjih Poslova*) (“OUP”) dhe stacione policore.¹⁶⁹⁵ Për shembull, Lubinko Cvetiqi, ish-shefi i SPB-së së Mitrovicës, shpjegoi se SPB-ja e tij kishte nën përgjegjësinë e vet OUP-të e Vushtrrisë, Skënderajt, dhe Leposaviqit, si dhe stacionet e policisë në Zveçan dhe Zubin Potok.¹⁶⁹⁶ Petar Damjanaci, shefi i OUP-së së Glllogocit, dëshmoi se OUP-ja e tij ishte në zonën e përgjegjësisë së SPB-së së Prishtinës dhe për këtë arsye raportet mbi ngjarjet më të rëndësishme i dërgoheshin çdo ditë SPB-së së Prishtinës.¹⁶⁹⁷

(C) Policia rezerviste apo rezervistët policorë

662. Përveç personelit të rregullt të MPB-së, në SPB-të, OUP-të dhe stacionet policore, MPB-ja mund të plotësohet edhe me rezervistë.¹⁶⁹⁸ Rezervistët mund të përdoren në rast të rrezikut të luftës së afërt dhe gjithashtu mund të mobilizohen me urdhër të ministrit të Brendshëm për të kryer detyra të caktuara në kohë paqeje.¹⁶⁹⁹

663. K25, që ishte vetë rezervist i policisë deri në vitin 1998, tha se për shkak të numrit të vogël të njerëzve të gatshëm për të punuar për MPB-në në Kosovë, të gjithë burrat serbë të Kosovës konsideroheshin rezervistë dhe ata pranoheshin në forcat rezerviste pa e kaluar paraprakisht procesin e verifikimit të cilit i nënshtroheshin të gjithë rezervistët e tjerë në Serbi.¹⁷⁰⁰ Rezervistët në Kosovë i mbanin armët e tyre automatike në shtëpi.¹⁷⁰¹

664. Përveç rezervistëve të rregullt të policisë, në korrik të 1998, në territorin e Kosovës u formuan dhe Detashmente Policore Rezerviste (*Rezervna Policijska Odeljenja*) (“RPO”), të cilat njiheshin edhe me emrin “Skuadra Rezerviste të Policisë”, si përgjigje ndaj veprimtarive gjithnjë e më të shpeshta “terroriste” të UÇK-së.¹⁷⁰² Këto trajtohen në hollësi më poshtë.

¹⁶⁹⁵ 6D1305 (Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Ministrisë së Brendshme, 31 dhjetor 1997), neni 4; Lubinko Cvetiq, T. 8046 (7 dhjetor 2006).

¹⁶⁹⁶ Lubinko Cvetiq, T. 8046 (7 dhjetor 2006).

¹⁶⁹⁷ Petar Damjanac, T. 23747–23748 (5 mars 2008); T. 23789–23790 (6 mars 2008).

¹⁶⁹⁸ Lubinko Cvetiq, T. 8047 (7 dhjetor 2006).

¹⁶⁹⁹ P1737 (Ligji për Punë të Brendshme), nenet 27–28.

¹⁷⁰⁰ K25, T. 4678–4683 (11 tetor 2006); P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 20.

¹⁷⁰¹ K25, T. 4681–4683 (11 tetor 2006).

¹⁷⁰² Bozhidar Filiq, T. 24013 (10 mars 2008); Lubinko Cvetiq, T. 8050-8055 (7 dhjetor 2006); *shih* P2804 (Telegram i Shtabit të MPB-së dërguar komandantëve të njëjësive organizative të MPB-së në Kosovë, 10 korrik 1998).

(D) Njësitë e posaçme policore të RJB-së: PJP dhe SAJ

665. Njësitë e Posaçme Policore¹⁷⁰³ (*Posebne Jedinice Policije*) (“PJP”) dhe Njësia e Posaçme Kundër Terrorit (*Specijalna Antiteroristička Jedinica*) (“SAJ”) u formuan në bazë të nenit 6 të Rregullores mbi Organizimin e MPB-së.

(1) PJP

666. PJP-së i ishte besuar kryerja e “detyrave të posaçme të sigurisë në rrethana normale dhe në rast të gjendjes së jashtëzakonshme”.¹⁷⁰⁴ Fillimisht quhej Njësia e Posaçme e Milicisë ose “PJM” (*“Posebne Jedinice Milicije”*). Gjithsesi në janar 1997, emri u ndryshua në PJP (*“Posebne Jedinice Policije”*).¹⁷⁰⁵ Gjeneralletenant Obrad Stevanoviç kryente detyrën e shefit të përgjithshëm të PJP-së.¹⁷⁰⁶ Shefat e SPB-ve ishin përgjegjës për njësitë e PJP-së në zonën që mbulonin SPB-të e tyre.¹⁷⁰⁷ Komandantët e PJP-së ishin anëtarë të kolegjiemeve të SPB-ve.¹⁷⁰⁸

667. Ish-pjesëtarë të PJP-së që dëshmuuan në këtë çështje shpjeguan se PJP-ja merrej me kontrollin e turmave dhe protestave dhe se kishte hyrë në veprim gjatë demonstratave të mëdha në Beograd dhe Prishtinë.¹⁷⁰⁹ K25 shtoi se në situata të jashtëzakonshme PJP-ja gjithashtu thirrej për të ndërhyrë gjatë incidenteve me armë zjarri nga ana e qytetarëve.¹⁷¹⁰

668. Me përjashtim të Detashmentit të 21-të të PJP-së, detashmentet e PJP-së nuk kishin efektiv të përhershëm.¹⁷¹¹ Detashmentet e PJP-së zakonisht përbëheshin nga pjesëtarë të forcave aktive dhe

¹⁷⁰³ Dhoma vëren se Mbrojtja e Llukiqit kundërshton përkthimin në anglisht të “*Posebne Jedinica Policije/Njësia e Posaçme Policore*” si “Special Police Unit” /Njësi e Posaçme Policore/, *shih* T. 7339–7341 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur). Sipas Mbrojtjes së Llukiqit, fjala “*posebna*” do të thotë “të ndara/veçanta” në BKS, kurse fjala “*special*” në anglisht do të thotë “*specijalna*” në BKS. Lubinko Cvetiqi dëshmoi se vetëm SAJ-ja dhe JSO-ja ishin njësi “të posaçme” të policisë. Lubinko Cvetiq, T. 8039 (6 dhjetor 2006). Duke qenë se Mbrojtja e Llukiqit nuk kundërshton ekzistencën e një njësie të njohur si “PJP”, Dhoma nuk do të përqëndrohet në emërtimin e saktë të kësaj njësie dhe thjesht do t’i referohet asaj me “PJP” në këtë pjesë të Aktgjykimit.

¹⁷⁰⁴ Më 31 dhjetor 1992, MPB-ja miratoi “Vendim mbi Formimin e Njësive të Posaçme Policore”, duke përcaktuar detyrat, regjimin sttërvitor dhe strukturën e këtyre njësive, P1507 (Vendim mbi Formimin e Njësive të Posaçme Policore, 31 dhjetor 1992). Më 1 gusht 1993, ministri i Brendshëm lëshoi dokumentin me titull “Baza për Formimin e Njësive të Posaçme Policore të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë”, duke qartësuar më tej detyrat, efektivin dhe strukturën e këtyre njësive. P1508 (Formimi i Njësive të Posaçme Policore, 1 gusht 1993).

¹⁷⁰⁵ Dragan Paunoviç, T. 21845 (7 shkurt 2008); 1D408 (Udhëzues për ndërrimin e emblemave dhe uniformave të Ministrisë së Brendshme, 18 janar).

¹⁷⁰⁶ 1D579 (Deklaratë e Qeverisë së Serbisë, Emërimi i Rade Markoviçit dhe të tjerëve, 28 tetor 1988); Aleksandar Vasileviç, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 28; K25, T. 4732 (12 tetor 2006) (seancë private); Dragan Paunoviç, T. 21916 (8 shkurt 2008); Dragan Zhivaleviç, T. 24846–24847 (3 prill 2008), 6D1606 (deklaratë dëshmitari e datës 31 mars 2008), para. 7.

¹⁷⁰⁷ K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 20–21.

¹⁷⁰⁸ *Shih* P3122 (Procesverbali i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 2 dhjetor 1998), f. 8.

¹⁷⁰⁹ K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 3; K79, T. 9578 (1 shkurt 2007), 6D1327 (deklaratë dëshmitari e datës 7 maj 2006), para. 3.

¹⁷¹⁰ K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 3.

¹⁷¹¹ P1508 (Formimi i Njësive të Posaçme Policore, 1 gusht 1993), f. 1.

rezerviste të policisë së një SPB-je të cilët në disa raste thirreshin për të kryer detyra të caktuara që përbënin rrezik më të madh.¹⁷¹² Kur nuk dërgoheshin për të kryer detyrat e tyre të veçanta, pjesëtarët e PJP-së kryenin detyrat e tyre të zakonshme. Përzgjedhja e tyre në PJP bazohej në aftësinë e tyre fizike, moshën, rezultatet e punës dhe vitet e shërbimit.¹⁷¹³ K25 vazhdoi të punonte si polic i rregullt dhe vetëm në raste të veçanta ai u caktua me detyrë në detashmentin e tij të PJP-së.¹⁷¹⁴ Ai shpjegoi se kishte të njëjtën gradë, pavarësisht nëse kryente detyrat e tij të zakonshme ose punonte si pjesëtar i PJP-së.¹⁷¹⁵ Dallimi në rrogë midis policëve të rregullt dhe pjesëtarëve të PJP-së ishte shumë i vogël.¹⁷¹⁶ Gjithsesi pjesëtarët e PJP-së kryenin stërvitje speciale.¹⁷¹⁷

669. Detashmenti i 21-të i PJP-së ishte formacion i përhershëm në kuadër të Policisë së Beogradit të SPB-së së Beogradit.¹⁷¹⁸ Në tetor 1998, Detashmentet 21 dhe 22 të PJP-së u shkrinë në një njësi të vetme – në Brigadën e 122-të të PJP-së për Ndërhyrje.¹⁷¹⁹ Në kuadër të kësaj brigade, Boshko Buha ishte komandanti i Detashmentit 21 të PJP-së kurse Vladimir Iliqi ishte zëvendësi i tij. Thuajse nga fundi i vitit 1998, Dragan Zhivaleviqi komandoi Detashmentin 22 të PJP-së.¹⁷²⁰ Zhivaleviqi gjithashtu u emërua komandant i përgjithshëm i Brigadës 122 të Ndërhyrjes.¹⁷²¹

670. Çdo detashment i PJP-së duhej të përbëhej nga katër deri në shtatë kompani policore të cilat vetë ndaheshin në toga dhe skuadra.¹⁷²² Kishte edhe kompani rezervë të PJP-së.¹⁷²³ Çdo detashment numëronte 450 - 600 pjesëtarë.¹⁷²⁴ Çdo kompani e një detashmenti përbëhej nga rreth 150–180

¹⁷¹² P1508 (Formimi i Njësisë të Posaçme Policore, 1 gusht 1993), f. 2–3; Lubinko Cvetiq, T. 8040 (6 dhjetor 2006); K86, T. 7345 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁷¹³ K79, T. 9577–9578 (1 shkurt 2007).

¹⁷¹⁴ K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 2, T. 4723 (12 tetor 2006).

¹⁷¹⁵ K25, T. 4725–4726 (12 tetor 2006).

¹⁷¹⁶ K25, T. 4730–4731 (12 tetor 2006), P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 3.

¹⁷¹⁷ K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 2–3; K79, T. 9578 (1 shkurt 2007). *Shih gjithashtu* K25, T. 4755 (12 tetor 2006).

¹⁷¹⁸ P1508 (Formimi i Njësisë të Posaçme Policore, 1 gusht 1993), f. 1.

¹⁷¹⁹ Vladimir Iliq, T. 24349 (17 mars 2008); Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklaratë dëshmitari e datës 31 mars 2008), para. 6.

¹⁷²⁰ Dragan Zhivaleviq, T. 24895 (3 prill 2008), 6D1606 (deklaratë dëshmitari e datës 31 mars 2008), para. 6.

¹⁷²¹ Dragan Zhivaleviq, T. 24908–24909 (3 prill 2008), 6D1606 (deklaratë dëshmitari e datës 31 mars 2008), para. 6; Vladimir Iliq, T. 24349 (17 mars 2008). Dragan Zhivaleviqi shpjegoi se pas shkrirjes së Detashmenteve 21 dhe 22 në Brigadën e 122-të të Ndërhyrjes, shpeshherë gabimisht përmendeshin si Detashmentet 121 dhe 122. Dragan Zhivaleviq, T. 24894 (3 prill 2008).

¹⁷²² P1508 (Formimi i Njësisë të Posaçme Policore, 1 gusht 1993).

¹⁷²³ K79, 6D1327 (deklaratë dëshmitari e datës 7 maj 2006), para. 5; Lubinko Cvetiq, T. 8039 (6 dhjetor 2006).

¹⁷²⁴ Lubinko Cvetiq, T. 8039 (6 dhjetor 2006).

pjesëtarë.¹⁷²⁵ Skuadra ishte njësia më e vogël e cila përbëhej nga tetë pjesëtarë, në mesin e të cilëve ishin komandanti, një snajperist, një mitraljer, një qitës i granatahedhësit dhe katër pushkatarë.¹⁷²⁶

671. Detashmentet e PJP-së përbëheshin nga dy lloje formacionesh: formacioni “A”, apo detashmentet manovruese, dhe formacioni “B” apo detashmentet territoriale.¹⁷²⁷ Detashmentet manovruese angazhoheshin në veprimtari luftarake kurse ato territoriale shërbenin si rezervë dhe nuk merrnin pjesë në veprimtari të tilla.¹⁷²⁸

672. Pjesëtarët e PJP-së mbanin armë brezi dhe pushkë automatike.¹⁷²⁹ Sipas K79-ës, gjatë operacioneve në shtator dhe tetor 1998, secilës kompani të PJP-së iu dhanë nga tri Praga (topa kundërajrorë vetështytës) dhe tre tanke.¹⁷³⁰ K25 dëshmoi se në mars 1999, PJP-ja e tij ishte e armatosur me minahedhës 80 dhe 60-milimetërsh, me granata dore, armë kundërtanke *zolja*, pushkë të prodhimit *Zastava* dhe pistoleta gjysmëautomatike të tipit CZ. Ata gjithashtu kishin edhe një automjet UAZ të prodhimit rus i cili ishte i pajisur me mitraloz 7.9-milimetërsh. Përveç këtyre armëve, ata kishin edhe “110 kamionë”, një Pincgauer, tre xhipa dhe tre kamionë civilë që ishin vënë në dispozicion të MPB-së.¹⁷³¹ Sipas Dragan Zhivaleviqit, Brigada e 122-të e Ndërhyrjes përdorte kamionë të tipit Land Rover, Lada Niva, UAZ, dhe automjete të blinduara këmbësorie si BOV, Praga, BVP, dhe M-90.¹⁷³²

673. Dhoma gjithashtu dëgjoi se në kuadër të PJP-së kishte Grupe Operative Ndjekëse (*Operativne Poterne Grupe*) (“OPG”).¹⁷³³ Pjesëtarët e OPG-së ishin të stërvitur për të luftuar incidente të rënda të “terrorizmit në zona urbane me forca më të vogla por më të lëvizshme dhe më efektive”.¹⁷³⁴ Miroslav Mijatoviqi, zëvendës shefi i Shtabit të MPB-së, dëshmoi se Goran Radosavleviqi, i cili ishte gjithashtu anëtar i Shtabit të MPB-së, ishte përgjegjës për këtë lloj

¹⁷²⁵ K79, T. 9585 (1 shkurt 2007); K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 7.

¹⁷²⁶ P1508 (Formimi i Njërive të Posaçme Policore, 1 gusht 1993). Disa dëshmitarë dëshmuan se në praktikë numri i personave në një skuadër ishte katër - dhjetë vetë. K79, T. 9586 (1 shkurt 2007), T. 9717 (2 shkurt 2007); K86, T. 7346–7348 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁷²⁷ Dushko Adamoviç, 6D1613 (deklaratë dëshmitari e datës 30 mars 2008), para. 52.

¹⁷²⁸ Dragan Milenkoviç, T. 22988–22989 (21 shkurt 2008); Dushko Adamoviç, 6D1613 (deklaratë dëshmitari e datës 30 mars 2008), para. 52.

¹⁷²⁹ K86, T. 7349 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁷³⁰ K79, 6D1327 (deklaratë dëshmitari e datës 7 maj 2006), para. 30.

¹⁷³¹ K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 13.

¹⁷³² Dragan Zhivaleviç, 6D1606 (deklaratë dëshmitari e datës 31 mars 2008), para. 9; Vladimir Iliç, T. 24327 (17 mars 2008).

¹⁷³³ Aleksandar Vasileviç, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 28.

¹⁷³⁴ Miroslav Mijatoviç, 6D1492 (deklaratë dëshmitari e datës 6 shkurt 2008), para. 37. *Shih gjithashtu* Radojica Nikçeviç, T. 23229 (26 shkurt 2008); Lubinko Cvetiç, T. 8039 (6 dhjetor 2006); Aleksandar Vasileviç, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 31.

stërvitjeje.¹⁷³⁵ Mirëpo, Cvetiqi dëshmoi se në të vërtetë Radosavleviqi ishte komandanti i përgjithshëm i OPG-ve.¹⁷³⁶

674. OPG-të vepronin si grupe të veçanta në kuadër të çdo SPB-je. Radojica Nikçeviqi shpjegoi se pjesëtarët e OPG-ve dhe PJP-ve kishin të njëjtën uniformë, përdornin të njëjtat pajisje dhe merrnin të njëjtën rrogë.¹⁷³⁷ Sipas K86-ës, njësitë e OPG-ve kishin komandantët e vetë të cilët ishin nën varësinë e drejtpërdrejtë të shefave të SPB-ve përkatëse.¹⁷³⁸ K86 deklaroi se OPG-të ishin njësitë e para të MPB-së që angazhoheshin në aksion konkret, meqë ata ishin të stërvitur më së miri për kapjen e kriminelëve dhe vrasësve.¹⁷³⁹

(2) Njësitë e Posaçme Kundër Terrorit

675. Njësitë e Posaçme Kundër Terrorit (“SAJ”) ishin një grup tjetër në kuadër të RJB-së, që ishte ngritur për të luftuar terrorizmin, për t’iu përgjigjur situatave të pengmarrjes dhe për të bërë arrestime të grupeve të mëdha kriminale.¹⁷⁴⁰ Gjatë kohës së Aktakuzës, komandant i SAJ-së ishte Zhivko Trajkoviqi kurse zëvendëskomandant Zoran Simatoviqi (i njohur si Tutinac).¹⁷⁴¹

676. SAJ ishte e ndarë në tri njësi që ishin nën SPB-në e Beogradit, Novi Sadit dhe Prishtinës.¹⁷⁴² Pjesëtarët e SAJ-së përzgjidheshin nga radhët e policisë së rregullt nëpërmjet një procesi verifikimi i cili zakonisht përqendrohej në aftësitë fizike dhe mendore të kandidatit.¹⁷⁴³ Ekzistonte një qendër stërvitore e SAJ-së në Batajnicë afër Beogradit.¹⁷⁴⁴ Njëra nga tri njësitë e SAJ-së ishte e stacionuar aty¹⁷⁴⁵ por thuajse menjëherë pas fillimit të fushatës së NATO-s, ajo u zhvendos nga Batajnica në Kosovë.¹⁷⁴⁶

¹⁷³⁵ Miroslav Mijatoviç, 6D1492 (deklaratë dëshmitari e datës 6 shkurt 2008), para. 37; Dragan Zhivaleviç, T. 24941 (8 prill 2008); Dushko Adamoviç, 6D1613 (deklaratë dëshmitari e datës 30 mars 2008), para. 11.

¹⁷³⁶ Lubinko Cvetiq, T. 8039 (6 dhjetor 2006);

¹⁷³⁷ Radojica Nikçeviq, T. 23261–23263 (26 shkurt 2008). *Shih gjithashtu* K86, T. 7352–7353 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur); Aleksandar Vasileviç, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 29.

¹⁷³⁸ K86, T. 7353 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁷³⁹ K86, T. 7345 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁷⁴⁰ K88, P2800 (deklaratë dëshmitari e datës 21 janar 2006), para. 4; 6D1355 (Vendim mbi Formimin e Njësieve Speciale Antiterroriste, 5 prill 1996).

¹⁷⁴¹ Aleksandar Vasileviç, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 38; *shih* Miroslav Mijatoviç, T. 22427 (14 shkurt 2008).

¹⁷⁴² Lubinko Cvetiq, T. 8038 (6 dhjetor 2006); 6D1355 (Vendim mbi Formimin e Njësieve të Posaçme Antiterroriste, 5 prill 1996), f. 1.

¹⁷⁴³ K86, T. 7346 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁷⁴⁴ K87, P2756 (deklaratë dëshmitari e datës 3 qershor 2005), para. 7 (e vulosur).

¹⁷⁴⁵ K87, P2756 (deklaratë dëshmitari e datës 3 qershor 2005), para. 5 (e vulosur).

¹⁷⁴⁶ K87, P2756 (deklaratë dëshmitari e datës 3 qershor 2005), para. 8 (e vulosur).

677. Goran Stopariqi dëshmoi se asokohe ai ishte pjesëtar i një grupi të njohur si “Akrepat”, i cili më herët kishte qenë me RDB-në.¹⁷⁴⁷ Në fillim të vitit 1999, pak para fillimit të fushatës së NATO-s, Sllobodan Mediqi (i njohur si Boca) i kishte thënë se njësia e Akrepave po riformohej, por se ajo do t'i bashkohej SAJ-së dhe jo RDB-së.¹⁷⁴⁸ Stopariqi u ribashkua me njësinë në atë kohë.¹⁷⁴⁹ Këtë dëshmi e konfirmoi edhe Aleksandar Vasileviqi.¹⁷⁵⁰

678. Një grup tjetër i veçantë që mund të ketë pasur lidhje apo t'i ketë qenë atashuar SAJ-së, në disa prova shkresore përmendet si “Grupi i Brazilit,” të cilin ish-komandanti i Brigadës së Motorizuar 125 të UJ-së, Dragan Zhivanoviqi, e përshkroi si një nga njësitë e MPB-së me përgatitje më të mirë dhe si pjesë e SAJ-së.¹⁷⁵¹ Një dokument nga provat me titullin “Plan Pune i Stacionit të Ndërlidhjes” vë në dukje se fjala “Brazil” përdorej si kod identifikimi i forcave “F” të SAJ-së.¹⁷⁵²

679. Mirëpo në një raport me datë 8 gusht 1998 mbi angazhimin e njërive në Kosovë, Zhivanoviqi përmend Grupin Brazil si pjesë të njësisë së RDB-së për operacione të posaçme, e njohur si JSO, e cila trajtohet më poshtë.¹⁷⁵³ Në mbështetje të këtij qëndrimi, Millosh Deretiqi, anëtar i Shtabit të MPB-së për Kosovën, përgjegjës për ndërlidhje, dëshmoi se fjala “Brazil” ishte shifra e koduar e Millorad Ulemek Lukoviqit (i njohur si Legija), komandant i JSO-së, dhe se ajo përdorej nga JSO-ja.¹⁷⁵⁴

ii. Drejtoria e Sigurimit Shtetëror (RDB)

680. Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të Drejtorisë së Sigurimit Shtetëror (“Rregullorja e RDB-së”) përcaktonte detyrat dhe mënyrën e punës dhe veprimit të RDB-së. Detyra kryesore e RDB-së ishte të ruante sigurinë e shtetit duke parandaluar veprimtaritë që kishin për qëllim minimin e rendit kushtetues. Rrjedhimisht ajo merrej me mbledhjen e informacioneve dhe me kundërzbulim.¹⁷⁵⁵

¹⁷⁴⁷ Goran Stopariqi, P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 8–9.

¹⁷⁴⁸ Goran Stopariqi, P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 34–35.

¹⁷⁴⁹ Goran Stopariqi, P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 41.

¹⁷⁵⁰ Aleksandar Vasileviqi, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 38.

¹⁷⁵¹ Dragan Zhivanoviqi, T. 20541–20542, 20558 (18 janar 2008).

¹⁷⁵² P1052 (Plan Pune i Stacioneve të Ndërlidhjes), f. 1.

¹⁷⁵³ P1426 (Raport mbi angazhimin e njërive të brigadës), f. 2. (Teksti thotë si në vijim: “Trupat në njësitë e PJP-së, në veçanti Detashmenti i 3-të dhe ai i 7-të i PJP-së, nuk janë mirë të stërvitur, ndërsa JSO, në veçanti Grupi i Brazilit kanë përgatitje shumë të mirë për kryerjen e të gjitha b/d-ve /veprimtarive luftarake/, sidomos për mbrojtjen e b/v-ve /?makina ve luftarake/ tona.”).

¹⁷⁵⁴ Millosh Deretiq, T. 22616 (18 shkurt 2008).

¹⁷⁵⁵ P1192 (Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të RDB-së, prill 1996), f. 1.

681. Veprimtaria zbuluese e RDB-së u shpjegua nga Ratimir Taniqi, ish-“burim” i RDB-së, dhe Zoran Mijatoviqi, ish-ndihmëshefi për Kundërzbulim:¹⁷⁵⁶ pjesë e kësaj veprimtarie ishin edhe negociatat midis RDB-së (asokohe SDB) dhe shqiptarëve kosovarë në vitin 1995,¹⁷⁵⁷ dhe mbledhja e informacionit për planet e NATO-s, nga bashkëpunëtorë dhe burime në Perëndim.¹⁷⁵⁸ Puna operative e RDB-së sidomos në Kosovë, përshkruhet në hollësi të mëtejshme më poshtë.

682. Ratimir Taniqi dhe Aleksandar Vasileviqi dëshmuar se ndonëse zyrtarisht përgjegjës për RDB-në ishte ministri i Brendshëm, në praktikë ishte Presidenti i RFJ-së Slobodan Millosheviq i cili drejtonte dhe kontrollonte operacionet e kësaj drejtorie.¹⁷⁵⁹ Mirëpo Zoran Mijatoviqi tha se si punonjës i RDB-së ai asnjëherë nuk mori urdhra nga politikanë, përfshirë Millosheviqin.¹⁷⁶⁰ Dhoma i pranon dëshmitë e Taniqit dhe Vasileviqit lidhur me rolin e Millosheviqit.

683. RDB-ja përbëhej nga njësi të brendshme organizative që ndodheshin në shtabin e RDB-së dhe jashtë tij, si dhe njësi të posaçme organizative. Sipas neneve 26, 35 dhe 36 të Rregullores së RDB-së, në Kosovë kishte tri qendra të RDB-së: në Gjilan, në Prishtinë dhe në Prizren. Çdo qendër kishte seksionet dhe degët vendore të saj. Për shembull, qendra në Prishtinë kishte zyrat e saj në Lipjan, në Obiliq dhe në Podujevë, si dhe një “ekip operativ pararojë” në Fushë-Kosovë.¹⁷⁶¹

684. Përveç tri qendrave të RDB-së, në Kosovë ekzistonte edhe ekipi i koordinatorëve i cili ishte i vendosur në të njëjtën ndërtesë me qendrën e RDB-së në Prishtinë.¹⁷⁶² Gjatë gjithë vitit 1998, ekipi drejtohej nga David Gajiqi; Lubivoje Joksiqi kryente detyrën e ndihmëskoordinatorit në Kosovë. Gajiqi u largua nga Kosova në fund të vitit 1998 kurse Joksiqi mbeti në Kosovë deri në fund të fushatës së NATO-s në 1999.¹⁷⁶³ Nga 1 janari 1999, Gajiqin e zëvendësoi Millosav (Miqo) Vilotiqi.¹⁷⁶⁴

685. Pas fillimit të bombardimeve të NATO-s, RDB-ja u shpërngul nga vendndodhja zyrtare e saj në Prishtinë në vendndodhje të ndryshme të fshehta në qytet. Për më tepër, bombardimet e NATO-s dëmtuan komunikimin midis tri qendrave të RDB-së në Kosovë. Joksiqi shpjegoi se

¹⁷⁵⁶ Zoran Mijatoviqi, T. 14517-14518 (29 gusht 2007); Ratimir Taniq 1D44 (deklaratë dëshmitari e datës 19 korrik 2000).

¹⁷⁵⁷ Ratimir Taniq, 1D44 (deklaratë dëshmitari e datës 19 korrik 2000), para. 3. Zoran Mijatoviqi nuk u pajtua që përfaqësuesit e RDB-së merrnin pjesë në bisedime të tilla; Zoran Mijatoviqi, T. 14519 (29 gusht 2007).

¹⁷⁵⁸ Zoran Mijatoviqi, T. 14520 (29 gusht 2007).

¹⁷⁵⁹ Ratimir Taniq, T. 6406–6407 (13 nëntor 2006); Aleksandar Vasileviq, T. 9001 (23 janar 2007).

¹⁷⁶⁰ Zoran Mijatoviqi, T. 14554–14555 (29 gusht 2007).

¹⁷⁶¹ Lubivoje Joksiq, T. 21940–21941 (8 shkurt 2008).

¹⁷⁶² Lubivoje Joksiq, T. 21939 (8 shkurt 2008).

¹⁷⁶³ Lubivoje Joksiq, T. 21944 (8 shkurt 2008); 6D302 (dosja e punësimit të David Gajiqit).

¹⁷⁶⁴ Lubivoje Joksiq, T. 21945 (8 shkurt 2008); 6D303 (dosja e punësimit të Millosav Vilotiqit).

komunikimi midis qendrave pothuajse u ndërpre dhe se ato komunikonin kryesisht nëpërmjet vizitave dhe korrierëve.¹⁷⁶⁵

686. Njësia Për Operacione të Posaçme e RDB-së (*Jedinica za Specijalne Operacije*) (“JSO”) u formua në përputhje me nenet 5, 41 dhe 42 të Rregullores së RDB-së.¹⁷⁶⁶ Ishte njësi e armatosur e zgjedhur, e njohur për aftësitë dhe mjaft e stërvitur.¹⁷⁶⁷ Drejtues i saj ishte Franko Simatoviqi, i njohur gjithashtu si “Frenki”, i cili ishte ndihmësshefi i RDB-së.¹⁷⁶⁸ Millorad Ulemek Llukoviqi (i njohur si Legija) ishte komandanti operativ i JSO-së dhe vartës i drejtpërdrejtë i Simatoviqit.¹⁷⁶⁹ Më parë Legija kishte qenë pjesëtar i grupit paraushtarak i njohur si “Tigrat e Arkanit”, me përvojë nga konfliktet e armatosura në Bosnjë dhe Kroaci.¹⁷⁷⁰

687. JSO-në kryesisht e përbënin ish-pjesëtarë të grupit të njohur si “Beretat e Kuqe” formuar në vitin 1991. Pjesëtarët e JSO-së gjithashtu kishin marrë pjesë në luftime në arena të tjera luftimi, sidomos në Bosnjë dhe në Kroaci.¹⁷⁷¹ JSO-ja njihej me nofkën “Beretat e Kuqe”¹⁷⁷² dhe pjesëtarët e saj ndonjëherë i quanin “Frenkët” apo “njerëzit e Frenkit”.¹⁷⁷³ Ish-pjesëtar i “Akrepave” Goran Stopariqi shpjegoi se JSO-ja kishte disa njësi “satelite” si “Akrepat”, “Ujqërit e Përhimët” dhe “Tigrat e Arkanit” që ishin të përfshira në listën e pagesës së RDB-së, së bashku me pjesëtarët kryesorë.¹⁷⁷⁴ Vasileviqi shtoi se pjesëtarët e grupit të njohur si “Tigrat e Arkanit” mbanin letërnjoftime zyrtare të RDB-së së Serbisë dhe se dihej se në radhët e tyre kishte njerëz të cilët më herët kishin kryer krime. Ai më tej tha se këta njerëz ishin dërguar në Fushë-Kosovë¹⁷⁷⁵ ku ishte i vendosur “ekipi operativ pararojë” i RDB-së.¹⁷⁷⁶ JSO-ja kishte edhe efektiv rezervistësh të cilët mund të mobilizoheshin për pjesëmarrje në operacione.¹⁷⁷⁷

¹⁷⁶⁵ Lubivoje Joksiq, T. 21955–21956 (8 shkurt 2008).

¹⁷⁶⁶ P1192 (Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të RDB-së, prill 1996), nenet 5, 41–42.

¹⁷⁶⁷ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 28; Lubinko Cvetiq, T. 8034 (6 dhjetor 2006); K79, T. 9675–9676 (2 shkurt 2007).

¹⁷⁶⁸ Zoran Mijatoviq, T. 14527–14528 (29 gusht 2007); K79, T. 9676 (2 shkurt 2007), 6D1327 (deklaratë dëshmitari e datës 7 maj 2006), para. 28; Dragan Zhivanoviq, T. 20542–20543 (18 janar 2008).

¹⁷⁶⁹ Aleksandar Vasileviq, T. 8703 (19 janar 2007), P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 33; Zoran Mijatoviq, T. 14527–14528 (29 gusht 2007); K79, T. 9676 (2 shkurt 2007).

¹⁷⁷⁰ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 33.

¹⁷⁷¹ Aleksandar Vasileviq, T. 8701 (19 janar 2007); Goran Stopariq, P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 10.

¹⁷⁷² Goran Stopariq, T. 701–702 (12 korrik 2006).

¹⁷⁷³ K25, T. 4666–4667 (11 tetor 2006); K90, T. 9314 (29 janar 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 33.

¹⁷⁷⁴ Goran Stopariq, T. 694 (12 korrik 2006), P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 10–11.

¹⁷⁷⁵ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 40–42.

¹⁷⁷⁶ Lubivoje Joksiq, T. 21941 (8 shkurt 2008).

¹⁷⁷⁷ Goran Stopariq, T. 761–762 (13 korrik 2006); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 33.

688. Vasileviqi dëshmoi se pjesëtarët e JSO-së ishin të pajisur me “pajime speciale më moderne në çdo kategori”.¹⁷⁷⁸ Atasheu britanik i Mbrojtjes, John Crosland, gjithashtu dëshmoi se pjesëtarët e JSO-së dalloheshin nga makinat që përdornin në Kosovë si për shembull Toyota Land Cruiser.¹⁷⁷⁹ Sipas Vasileviqit, JSO madje kishte edhe një helikopter të tipit MiG 124 si dhe armë kundërajrore dhe pushkë automatike.¹⁷⁸⁰ Automjetet moderne të JSO-së shpeshherë kishin mitralozë të rëndë të tipit M2 Browning të kalibrit 12.5 mm të vendosur mbi to.¹⁷⁸¹ Përveç armëve të prodhimit jugosllav që përdornin pjesëtarët e rregullt të UJ-së dhe MPB-së, pjesëtarët e JSO-së mbanin edhe armë moderne të vendeve perëndimore si karabina automatike Heckler dhe Koch të kalibrit 5.56 mm, pushkë automatike MP5 të kalibrit 9 mm, si dhe mitralozë të rëndë M2 Browning të kalibrit 12.5 mm.¹⁷⁸²

iii. Shtabi i MPB-së për Kosovën

689. Më 11 qershor 1997, shefi i RJB-së Vllastimir Gjorgjeviqi lëshoi “Vendim për Ngritjen e Shtabit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Kosovën dhe Metohinë.” Sipas paragrafit 8 të tij, ky vendim “zëvendësonte” atë të datës 15 prill 1994 për ngritjen e Shtabit të MPB-së.¹⁷⁸³ Më 15 janar 1998 Gjorgjeviqi lëshoi “Vendimin për përcaktimin e përgjegjësive dhe detyrave të Shtabit të MPB-së në Prishtinë”.¹⁷⁸⁴

690. Më 15 maj 1998, Gjorgjeviqi lëshoi edhe një “Vendim për Formimin e Shtabit të Ministrisë në Prishtinë”, në bazë të kushteve të të cilit përsëri u zëvendësua vendimi i 15 prillit 1994 për ngritjen e Shtabit të MPB-së. Sipas paragrafit 1 të vendimit të majit 1998, “do të formohet Shtab i Ministrisë me seli në Prishtinë”. Vendimi saktësonte se “përbërja e Shtabit, drejtuesi dhe anëtarët e tij do të përcaktohen me një vendim të veçantë” dhe se “numri dhe struktura e personelit dhe njësisë që do të dërgohen për të kryer detyrat e shtabit, pajisjet dhe burimet e tyre, kohëzgjatja e ndërrimeve dhe kushtet dhe mënyra e kryerjes së misionit do të përcaktohen në një urdhër të veçantë”.¹⁷⁸⁵

691. Më 11 qershor 1998, Gjorgjeviqi lëshoi “Urdhër mbi Përbërjen e Shtabit, Drejtuesit dhe Anëtarët e Shtabit të Ministrisë së Punëve të Brendshme për Krahinën Autonome të Kosovës dhe

¹⁷⁷⁸ Aleksandar Vasileviq, T. 8702 (19 janar 2007), P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 32.

¹⁷⁷⁹ John Crosland, T. 9764–9765 (7 shkurt 2007).

¹⁷⁸⁰ Aleksandar Vasileviq, T. 8702 (19 janar 2007), P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 32.

¹⁷⁸¹ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 9.

¹⁷⁸² John Crosland, T. 9764–9765 (7 shkurt 2007), P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 9.

¹⁷⁸³ 6D1368 (Vendim për Ngritjen e Shtabit të MPB-së në Kosovë, 11 qershor 1997).

¹⁷⁸⁴ 6D1370 (Dekret për Përcaktimin e Përgjegjësive dhe Detyrave të Shtabit të Ministrisë në Prishtinë, 15 janar 1998).

¹⁷⁸⁵ P1251 (Vendim për Formimin e Shtabit të Ministrisë në Prishtinë, 15 maj 1998).

Metohisë”.¹⁷⁸⁶ Vendimi përmend Llukiqin si “drejtues të Shtabit”.¹⁷⁸⁷ Sipas vendimit të qershorit 1998, Shtabi i MPB-së do të “fillonte punën më 1 qershor 1998”.¹⁷⁸⁸

692. Pesë ditë më pas, më 16 qershor 1998, Vllajko Stojilkoviqi, ministri i brendshëm i Serbisë lëshoi “Vendim mbi Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit”. Ky vendim sqaronte se “me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohen [tre vendime]”: vendimi i 21 prillit 1998 për ngritjen e Shtabit Operativ; vendimi i 15 majit 1998 për formimin e Shtabit të Ministrisë në Prishtinë; dhe vendimi i 11 qershorit 1998 për emërimin e anëtarëve të Shtabit të MPB-së. Përbërja e re e Shtabit të MPB-së u përcaktua në paragrafin 1 të vendimit, kurse në paragrafin 4 të vendimit pohohej se Shtabi do të “fillonte punën më 16 qershor 1998”.¹⁷⁸⁹

693. Në vitin që vijoi, më 31 maj 1999, Stojilkoviqi lëshoi “Vendim për Ngritjen e Shtabit të Ministrisë për Shtypjen e Terrorizmit”.¹⁷⁹⁰ Në këtë vendim, ku postet dhe përbërja e Shtabit të MPB-së përshkruhen me gjuhë pothuajse të njëjtë si në vendimet e mëparshme, me përjashtim të disa ndryshimeve të personelit, shkruhej se ky vendim zëvendësonte vendimin e 16 qershorit 1998 dhe se do të hynte në fuqi më 1 qershor 1999.¹⁷⁹¹

694. Roli, përbërja dhe kompetencat e sakta të Shtabit të MPB-së janë ndër çështjet më të kundërshtuara midis Prokurorisë dhe Mbrojtjes së Llukiqit dhe trajtohen me më shumë hollësi në Pjesën VIII.H më poshtë lidhur me përgjegjësinë individuale penale të Llukiqit.

iv. Stacionet e policisë kufitare

695. Kompetencat mbi vendkalimet kufitare dhe brezin kufitar midis Kosovës dhe Shqipërisë dhe Maqedonisë ishin të ndara midis UJ-së dhe MPB-së. Sipas neneve 4 dhe 48 të Ligjit mbi Kalimin e Kufirit Shtetëror dhe Lëvizjes në Zonën Kufitare, MPB-ja kishte kontrollin mbi vendkalimet kufitare dhe zonat e banuara kurse UJ-ja kontrollonte pjesën tjetër të brezit kufitar.¹⁷⁹² Rade Çuçaku, oficer i lartë i UJ-së, përgjegjës për mbrojtjen e kufirit federal, shpjegoi se kushdo që hynte në zonën kufitare mund t’i nënshtrohej kontrollit të UJ-së. Mirëpo vetëm MPB-ja kishte pika

¹⁷⁸⁶ P1252 (Vendim mbi Përbërjen e Shtabit të MPB-së për Kosovën), para. 1; Lubinko Cvetiq, T. 8030 (6 dhjetor 2006).

¹⁷⁸⁷ P1252 (Vendim mbi Përbërjen e Shtabit të MPB-së për Kosovën), para. 1. Ndonëse nuk e kundërshton faktin se Llukiqi me të vërtetë ishte oficeri me grade të lartë në Shtab, Mbrojtja e Llukiqit pretendon se posti i tij ishte ai i “drejtuesit” “*rukovodilac*”, gjegjësisht “përgjegjësit” apo “administratorit” dhe jo “shefit” (“*načelnik*”), Dosja Gjyqësore Përfundimtare, 18 qershor 2008 (versioni publik), para. 1432. Dhoma e trajton këtë çështje më poshtë në Pjesën H të Kapitullit VIII, ku diskuton përgjegjësinë individuale penale të Llukiqit.

¹⁷⁸⁸ P1252 (Vendim për Përcaktimin e Përbërjes së Shtabit të MPB-së për Kosovën), para. 3.

¹⁷⁸⁹ P1505 (Vendim për Ngritjen e Shtabit Ministror për Shtypjen e Terrorizmit, 16 qershor 1998).

¹⁷⁹⁰ P1811 (Vendim për Ngritjen e Shtabit të Ministrisë për Shtypjen e Terrorizmit, 31 maj 1999).

¹⁷⁹¹ P1811 (Vendim për Ngritjen e Shtabit të Ministrisë për Shtypjen e Terrorizmit, 31 maj 1999), para. 4–6.

¹⁷⁹² 3D1122 (Ligji mbi Kalimin e Kufirit Shtetëror dhe Lëvizjen brenda Zonës Kufitare, 17 gusht 2007).

të përhershme kontrolli në vendkalimet kufitare.¹⁷⁹³ Radovan Vuçureviqi, ndihmës në Shtabin e MPB-së në Prishtinë, konfirmoi se MPB-ja ishte përgjegjëse për lëvizjet brenda zonave të banuara të brezit kufitar, kurse UJ-ja për kontrollimin e lëvizjeve jashtë zonave të banuara.¹⁷⁹⁴

696. Petar Dujkoviqi, zëvendës shefi dhe ushtruesi i detyrës së shefit të Administratës së Policisë Kufitare deri në qershor ose korrik 1999, dëshmoi se njësi organizative e MPB-së përgjegjëse për vendkalimet kufitare quhej “Administrata për Policinë Kufitare, Shtetasit e Huaj dhe Çështje Administrative”.¹⁷⁹⁵ Ajo kishte një sërë kompetencash si për shembull lëvizjet e të huajve, kufizimin e migrimit të paligjshëm, dokumentet e udhëtimit dhe lejet e qëndrimit për shtetasit, dhe armët dhe municioni në zotërim të qytetarëve dhe subjekteve të tjera.¹⁷⁹⁶ Ajo përbëhej nga tri degë: Dega për Çështje të Kufirit, Dega për të Huajt dhe Pasaportat dhe Dega për Çështje Administrative.¹⁷⁹⁷

697. Më tej, Dhoma dëgjoi se gjatë periudhës përkatëse, në RFJ kishte 35 stacione të policisë kufitare, nga të cilat pesë në Kosovë.¹⁷⁹⁸ Dy nga stacionet e policisë kufitare ishin të vendosura në kufirin me Maqedoninë (Hani i Elezit dhe Gllloboçica), dy të tjera në kufirin me Shqipërinë (Vërbnica dhe Qafa e Prushit), dhe një në aeroportin e Prishtinës. Hani i Elezit mbulonte dy vendkalime kufitare kurse Gllloboçica, Vërbnica dhe Qafa e Prushit nga një vendkalim kufitar.¹⁷⁹⁹

698. Nebojsa Ognjenoviqi dëshmoi në hollësi lidhur me stacionin e policisë kufitare të Vërbnicës dhe ngjarjet aty gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Ai dëshmoi se stacioni kishte komandantin, zëvendëskomandantin dhe ndihmëskomandantin, katër drejtues ndërrimi dhe 17 policë.¹⁸⁰⁰ Detyrat e personelit ishin të ndara midis shërbimit roje, sigurimit të vendkalimit kufitar dhe kontrollimit të udhëtarëve.¹⁸⁰¹

v. *Administrata e Policisë për Krime*

699. Sipas nenit 14 të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Administrata e Policisë për Krime (*Uprava Kriminalističke Policije*, “UKP”) ishte përgjegjëse për organizimin e detyrave lidhur me parandalimin e krimeve dhe ajo drejtonte dhe

¹⁷⁹³ Rade Çuçak, T. 14874–14876, 14884–14885 (4 shtator 2007).

¹⁷⁹⁴ Radovan Vuçureviq, T. 23122–23123 (25 shkurt 2008).

¹⁷⁹⁵ Petar Dujkoviq, T. 23304–23308 (27 shkurt 2008); Radovan Vuçureviq, T. 23046–23050 (22 shkurt 2008).

¹⁷⁹⁶ Petar Dujkoviq, T. 23338 (27 shkurt 2008).

¹⁷⁹⁷ 6D1305 (Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të MPB-së, 31 dhjetor 1997), neni 18; Petar Dujkoviq, T. 23314 (27 shkurt 2008).

¹⁷⁹⁸ 6D269 (Radiogram dërguar nga Vllastimir Gjorgjeviqi, 18 shkurt 1999); Nebojsa Ognjenoviq, T. 22851–22852 (20 shkurt 2008).

¹⁷⁹⁹ Petar Dujkoviq, T. 23315–23316 (27 shkurt 2008).

¹⁸⁰⁰ Nebojsa Ognjenoviq, T. 22848 (20 shkurt 2008).

koordinonte punën e SPB-ve në parandalimin e krimeve duke iu mundësuar atyre ndihmë eksperte dhe në raste të veçanta duke marrë pjesë drejtpërsëdrejti në zgjidhjen e krimeve më të ndërlikuara. Për më tepër, në përputhje me nenin 37 të Rregullores, çdo SPB duhej të krijonte Degën e Policisë për Krime (*Odelenje Kriminalističke Policije*, “OKP”) që do të merrej me detyra lidhur me parandalimin e krimeve në zonat e përgjegjësisë të SPB-ve përkatëse.¹⁸⁰²

700. Gjatë gjysmës së parë të vitit 1999, shefi i Administratës së Policisë për Krime në Beograd ishte Dragan Iliqi i cili përmendet në Aktakuzë si pjesëmarrës në Ndërmarrjen e Përbashkët Kriminale të pretenduar.¹⁸⁰³

701. Branisllav Debelkoviqi, shefi i OKP-së së Ferizajt, dëshmoi se shefat e OKP-ve i emëronte shefi i RJB-së ose ministri i Brendshëm me rekomandimin e shefit të SPB-së përkatëse dhe UKP-së. Ndryshe, shefi i OKP-së mund të emërohej edhe nga UKP-ja në Beograd.¹⁸⁰⁴

702. Nga dëshmitari 6D2, Dhoma dëgjoi se detyrat e OKP-ve përfshinin parandalimin, kufizimin dhe zbulimin e çdo lloj krimi, si dhe nisjen e procedimit penal kundër autorëve të krimeve. Lidhur me krimet e terrorizmit, në vendngjarje kryheshin hetime në përputhje me urdhrin e gjykatësit hetimor.¹⁸⁰⁵

703. Shefat e OKP-ve ishin në varësinë e shefave të SPB-ve.¹⁸⁰⁶ Vojnoviqi dhe Debelkoviqi shpjeguan se shefat e OKP-ve përgjigjeshin para UKP-së në Beograd “në përputhje me natyrën e punës”. Mirëpo, për sa i përket “kryerjes së detyrës profesionale dhe përmbushjes së detyrimeve ligjore”, ata përgjigjeshin para shefave të SPB-ve ku bënin pjesë.¹⁸⁰⁷ Sipas dëshmitarit 6D2 dhe Debelkoviqit, OKP-të i raportonin UKP-së në Beograd lidhur me “incidente” dhe veprimet e ndërmarra për zgjidhjen e tyre. Raportet i dërgoheshin gjithashtu edhe Shtabit të MPB-së dhe

¹⁸⁰¹ Nebojsa Ognjenović, T. 22861 (20 shkurt 2008).

¹⁸⁰² 6D1305 (Rregullorja e Organizimit të Brendshëm të MPB-së, 31 dhjetor 1997), nenet 14, 37.

¹⁸⁰³ P1996 (Procesverbali i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999).

¹⁸⁰⁴ Branisllav Debelković, 6D1533 (deklaratë dëshmitari e datës 7 mars 2008), para. 25.

¹⁸⁰⁵ 6D2, 6D1631 (deklaratë dëshmitari e datës 12 prill 2008), para. 9 (e mbyllur me vulë).

¹⁸⁰⁶ 6D2, 6D1631 (deklaratë dëshmitari e datës 12 Prill 2008), para. 10–11 (e mbyllur me vulë); Branisllav Debelković, 6D1533 (deklaratë dëshmitari e datës 7 mars 2008), para. 15.

¹⁸⁰⁷ Millosh Vojnoviq, 6D1532 (deklaratë dëshmitari e datës 5 mars 2008), para. 9; Branisllav Debelković, 6D1533 (deklaratë dëshmitari e datës 7 mars 2008), para. 3.

shemit të SPB-së përkatëse me qëllim informimin e tyre.¹⁸⁰⁸ Ndonjëherë OKP-të i kalonin RDB-së edhe informacione lidhur me rreziqe që i kanoseshin shtetit, si për shembull terrorizmi.¹⁸⁰⁹

704. Dhoma dëgjoi se gjatë fushatës së NATO-s puna e OKP-ve u vështirësua për shkak të lëvizjes së kufizuar, sulmeve të UÇK-së mbi ekipet hetimore dhe bombardimeve.¹⁸¹⁰ Pavarësisht nga vështirësitë, OKP-të vazhduan të punonin bazuar në parimet e mëparshme me përjashtim të faktit se personeli filloi të punonte me ndërrime që të sigurohej se në degë do të kishte punonjës 24 orë në ditë.¹⁸¹¹

b. Uniformat e MPB-së

705. Neni 2 i Ligjit mbi Uniformat dhe Emblemat e Policisë i datës mars 1996 (“Ligji mbi Uniformat”) parashikonte katër lloje uniformash të MPB-në: (a) uniforma e rregullt; (b) uniforma ceremoniale, për evenimente zyrtare dhe për përcjellje; (3) uniforma për ndërhyrje dhe (4) uniforma për stërvitje.¹⁸¹² Uniformat dimërore të “rregullta”, “ceremoniale” dhe për “evenimente zyrtare” ishin në ngjyrë të kaltër të errët. Ligji mbi Uniformat gjithashtu përshkruante “uniformën për ndërhyrje në zona urbane” si uniformë kamuflimi me kombinim të ngjyrës së kaltër të errët, të përhimët, të zezë dhe kafe, ndërsa “uniformën për ndërhyrje në terren” si uniformë kamuflimi me kombinim të ngjyrës së zezë, kafe, të gjelbër dhe të verdhë, me disa pjesë në ngjyrë të zezë, të përhimët dhe bardhë.¹⁸¹³

706. Ligji mbi Uniformat më tej përcaktonte që pjesëtarët e MPB-së të mbanin emblemë në kapelë dhe në mëngën e majtë të uniformave të tyre, si dhe emblemën e veçantë që lidhej me njësinë, detyrën dhe gradën e tyre.¹⁸¹⁴ Në emblemat e policisë duhej të figuronte fjala “*milicija*” në shkronja cirilike.¹⁸¹⁵ Më 18 janar 1997 doli udhëzuesi për ndryshimin e emblemeve dhe uniformave të pjesëtarëve të Ministrisë së Punëve të Brendshme ku thuhej se nga ajo datë për forcat e MPB-së do të përdorej fjala “*policija*” dhe jo “*milicija*” dhe se emblemat do të ndryshonin në përputhje me

¹⁸⁰⁸ Branisllav Debelković, 6D1533 (deklaratë dëshmitari e datës 7 mars 2008), para. 17; *shih gjithashtu* Branisllav Debelković, T. 24258–24262, 24266–24267 (13 mars 2008); 6D2, 6D1632 (deklaratë dëshmitari e datës 12 prill 2008), para. 20. *Shih gjithashtu* Radovan Zlatković, 6D1627 (deklaratë dëshmitari e datës 13 prill 2008), para. 3.

¹⁸⁰⁹ Branisllav Debelković, 6D1533 (deklaratë dëshmitari e datës 7 mars 2008), para. 19; 6D2, 6D1631 (deklaratë dëshmitari e datës 12 prill 2008), para. 21 (e mbyllur me vulë).

¹⁸¹⁰ 6D2, 6D1631 (deklaratë dëshmitari e datës 12 prill 2008), para. 39, 40–42 (e mbyllur me vulë); Radovan Zlatković, 6D1627 (deklaratë dëshmitari e datës 13 prill 2008), para. 4.

¹⁸¹¹ 6D2, 6D1631 (deklaratë dëshmitari e datës 12 prill 2008), para. 42 (e mbyllur me vulë).

¹⁸¹² 1D401 (Ligji mbi Uniformat dhe Emblemat e Policisë), neni 2; 1D408 (Udhëzues mbi ndryshimin e udhëzuesit për emblemat dhe uniformat e Ministrisë së Punëve të Brendshme, 18 janar).

¹⁸¹³ 1D401 (Ligji mbi Uniformat dhe Emblemat e Policisë), nenet 2, 26, 28.

¹⁸¹⁴ 1D401 (Ligji mbi Uniformat dhe Emblemat e Policisë), nenet 41–50.

¹⁸¹⁵ 1D401 (Ligji mbi Uniformat dhe Emblemat e Policisë), neni 43.

këtë ndryshim.¹⁸¹⁶ Mirëpo në bazë të analizës së provave fotografike, Dhoma konstatoi se disa pjesëtarë të MPB-së vazhduan të mbanin emblema me mbishkrimin “*milicija*” dhe jo “*policija*” edhe në vitin 1999.¹⁸¹⁷

707. Dëshmitarë të ndryshëm dëshmuar se pjesëtarët e MPB-së, përfshirë dhe njësitë e PJP-së dhe SAJ-së, zbatuan dispozitat e parashtruara më poshtë.

i. Uniformat e policisë së rregullt dhe rezerviste

708. Dëshmitari K86 i cili ishte pjesëtar i PJP-së, dëshmoi se nga 1991 e deri më 1998 uniforma e kamuflimit në ngjyrë të kaltër, ishte uniforma standarde e punës për të gjithë policët.¹⁸¹⁸ Këtë e konfirmoi edhe Sllagjan Pantiqi, shefi i Degës së Sigurimit në stacionin e policisë në Rudnik, i cili dëshmoi se mbante uniformë kamuflimi të kaltër.¹⁸¹⁹ Petar Damjanaci, i cili ishte shefi i DPB-së së Glllogocit, dëshmoi se më 1998 dhe 1999 të gjithë policët që punonin në DPB-në e Glllogocit mbanin uniforma kamuflimi të kaltra.¹⁸²⁰ Për më tepër, Lubinko Cvetiqi dëshmoi se uniforma e punës e pjesëtarëve të SPB-ve ishte e kaltër kamuflimi dhe se çdo polic kishte tre lloje uniformash: “uniformën ceremoniale, uniformën e punës dhe uniformën për ndërhyrje”.¹⁸²¹ K86 gjithashtu tha se nga fundi i vitit 1998 dhe më pas, të gjithë policët u pajisën me uniforma “për evenimente zyrtare” ose “ceremoniale” me ngjyrë të kaltër të errët dhe me kapela të quajtura “šapka”.¹⁸²² Ai shtoi se ai vetë e mbante uniformën me ngjyrë të kaltër të errët, jo gjithmonë.¹⁸²³ Radojica Nikçeviqi, i cili ishte pjesëtar i PJP-së dhe OPG-së, dëshmoi se më 1998 dhe 1999 pjesëtarët e SPB-së së Pejës mbanin uniforma njëngjyreshe të kaltra, të cilat përfshinin këmishë të kaltër të çelët, pantallona me ngjyrë të kaltër të errët dhe xhaketa me ngjyrë të kaltër të errët.¹⁸²⁴ Pasi analizoi fotografitë e uniformave me ngjyrë të kaltër të errët, Dhoma konkludon se mund të thuhet se kjo uniformë ishte me ngjyrë të kaltër shumë të errët, pothuajse të zezë.¹⁸²⁵

¹⁸¹⁶ ID408 (Udhëzuesi mbi ndërrimin e emblemave dhe uniformave të Ministrisë së Punëve të Brendshme, 18 Janar).

¹⁸¹⁷ P2538 (Fotografi të pjesëtarëve të MPB-së të marra në dhjetor 1998 ose janar 1999). *Shih gjithashtu* Karol John Drewienkiewicz, T. 7808–7809 (4 dhjetor 1998).

¹⁸¹⁸ K86, T. 7351 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁸¹⁹ Sllagjan Pantiq, T. 23678 (5 mars 2008).

¹⁸²⁰ Petar Damjanac, T. 23767 (6 mars 2008).

¹⁸²¹ Lubinko Cvetiq, T. 8104, 8108 (7 dhjetor 2006).

¹⁸²² K86, T. 7351, 7354 (24 nëntor 2006).

¹⁸²³ K86, T. 7351 (24 nëntor 2006).

¹⁸²⁴ Radojica Nikçeviq, T. 23235 (26 shkurt 2008).

¹⁸²⁵ *Shih p.sh.*, P2586 (Fotografi të operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 1, 6, 8, 9, 10.

709. Rezervistët e MPB-së mbanin uniforma kamuflimi të kaltra, të ngjashme me uniformat e policisë së rregullt.¹⁸²⁶ Rezervistët i mbanin uniformat në shtëpi, madje edhe gjatë kohës kur nuk ishin në shërbim aktiv.¹⁸²⁷

ii. Uniformat e PJP-së

710. Deri nga gushti apo fillimi i shtatorit 1998, edhe pjesëtarët e PJP-së mbanin uniforma të kaltra kamuflimi. Më pas ata u pajisën me uniforma të gjelbra kamuflimi.¹⁸²⁸ K79, pjesëtar i PJP-së, shpjegoi se ndonëse uniformën e gjelbër të kamuflimit ai filloi ta përdorte nga data 24 mars 1999, këto uniforma ishin shpërndarë dikur në tetor 1998.¹⁸²⁹ Uniforma e re duhej veshur me jelek të zi mbi të, në pjesën e prapme dhe në xhepin e përparmë të djathtë të të cilit shkruante “Policija” në shkronja fluoreshente.¹⁸³⁰ Nikçeviqi dha përshkrim të ngjashëm të jelekëve, mirëpo deklaroi se jelekët ishin me ngjyrë të gjelbër ulliri.¹⁸³¹ K73 shpjegoi se për shkak të mungesës së jelekëve, jo të gjithë pjesëtarët e PJP-së ishin të pajisur me jelekë antiplumb dhe në vend të tyre përdornin jelekët e gjelbër “ushtarakë”.¹⁸³² Dragan Paunoviqi, i cili mori pjesë në veprimet luftarake në Kosovë në vitin 1998 gjithashtu tha se pjesëtarët e PJP-së mbanin jelekë të gjelbër mbi uniformat e kaltra të kamuflimit.¹⁸³³ Zhivaleviq shpjegoi se vetëm pjesëtarët e detashmenteve për manovra të PJP-së ishin të pajisur me helmata dhe jelekë antiplumb dhe se pjesëtarët e detashmenteve territoriale nuk kishin pajisje të tilla.¹⁸³⁴

711. Sipas Ligjit mbi Uniformat, emblema e PJP-së kishte një shpatë të bardhë që tejshponte një mburojë të kuqe me katër shkronja cirilike “S” të rrethuara me dy degë dafine të arta. Mbi emblemën ishte flamuri trengjyresh me shkronjat PJP në mes.¹⁸³⁵ Ligji gjithashtu përcaktonte se emblema e PJP-së duhej mbajtur në mëngën e djathtë dhe këtë e konfirmoi Nikçeviqi dhe

¹⁸²⁶ K25, T. 4664–4665, 4674 (11 tetor 2006); K83, T. 3927 (25 shtator 2006); K86, T. 7354 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur); K90, T. 9297 (29 janar 2007).

¹⁸²⁷ K25, T. 4739 (12 tetor 2006).

¹⁸²⁸ Vladimir Iliq, T. 24323 (17 mars 2008); K86, T. 7350–7351 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur); Radojica Nikçeviq, T. 23236 (26 shkurt 2008); Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklaratë dëshmitari e datës 31 mars 2008), para. 8.

¹⁸²⁹ K79, T. 9588–9590 (1 shkurt 2007).

¹⁸³⁰ K79, T. 9588–9590 (1 shkurt 2007); Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklaratë dëshmitari e datës 31 mars 2008), para. 8.

¹⁸³¹ Radojica Nikçeviq, T. 23236 (26 shkurt 2008).

¹⁸³² K73, T. 3306–3309 (13 shtator 2006); K25, T. 4664–4665 (11 tetor 2006); P1326 (përshkrim), fotografia 6 (PJP), fotografia 4 (policë të rregullt dhe rezervistë). *Shih gjithashtu* P2538 (fotografi policësh serbë me uniformë), në të cilat shihen policë të veshur me jelekë luftarakë apo jelekë antiplumb. K86 mori jelek antiplumb më 1991 të cilin e mbajti deri në tërheqjen nga Kosova. K86, T. 7349–7351 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁸³³ Dragan Paunoviq, T. 21859–21860 (7 shkurt 2008), flet për P1596 (fotografi e forcave serbe).

¹⁸³⁴ Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklaratë dëshmitari e datës 31 mars 2008), para. 8.

¹⁸³⁵ 1D401 (Ligji mbi Uniformat dhe Emblemat e Policisë), neni 47.

dëshmitari K73.¹⁸³⁶ Provat fotografike në mënyrë përputhëse tregojnë se emblema e PJP-së mbahej në një mëngë të uniformës së gjelbër të kamuflimit, kurse ajo e MPB-së në mëngën tjetër të uniformës.¹⁸³⁷

iii. Uniformat e SAJ-së

712. Dhoma dëgjoi dëshmi se pjesëtarët e SAJ-së kishin disa lloje uniformash. Personeli mbështetës joluftarak mbante uniforma të gjelbra njëngjyrëshe, kurse pjesëtarët e grupeve luftarake uniforma të gjelbra kamuflimi.¹⁸³⁸ Stopariqi, i cili iu bashkua SAJ-së në fund të marsit 1999 dhe u dislokua në Kosovë, dëshmoi se uniformat që iu dhanë ishin “me ngjyrë dhe motive si ato të NATO-s”, *me fjalë të tjera.*, e gjelbër kamuflimi.¹⁸³⁹ K86 tha se ndonëse SAJ-ja, midis të tjerash, kishte edhe uniforma të zeza dhe të bardha, por se nuk kishte parë që ata t’i kishin përdorur ato gjatë operacioneve në Kosovë.¹⁸⁴⁰ Pjesëtarët e SAJ-së gjithashtu mbanin të ashtuquajturat kapela “kauboj” ose kapela “xhungël”, të cilat, siç u përshkrua, ishin material i njëjtë si uniforma dhe kishin një strehë kapeleje që mund të lidhej pas saj.¹⁸⁴¹

713. Sipas Ligjit mbi Uniformat, emblema e SAJ-së kishte një shqiponjë dykrerëshe me ngjyrë të bardhë, me gjuhë, sqep dhe këmbë ngjyrë ari, duke mbajtur një gjarpër në kthetra. Në kraharorin e shqiponjës qëndronte një mburojë e kuqe me katër shkronja cirilike “C”. Prapa shqiponjës kishte një shpatë.¹⁸⁴² Në emblemë ishte edhe mbishkrimi “Policia Serbe” dhe shkurtimi “SAJ”.¹⁸⁴³

iv. Uniformat e JSO-së

714. Dhoma dëgjoi dëshmi se pjesëtarët e JSO-së mbanin uniforma kamuflimi të gjelbra, të ashtuquajtura uniforma “NATO”.¹⁸⁴⁴ Modeli i kamuflimit njihej si “Material me motiv të çrregullt, të thyer”, si i ushtrisë britanike dhe holandeze, por me nuancë më të hapët.¹⁸⁴⁵ Disa pjesëtarë të

¹⁸³⁶ Radojica Nikçević, T. 23236–23238 (26 shkurt 2008); K73, T. 3311 (13 shtator 2006), T. 3414 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁸³⁷ P1600; P1602; P1603 (fotografi pjesëtarësh të MPB-së).

¹⁸³⁸ K87, P2756 (deklaratë dëshmitari e datës 3 qershor 2005), para. 5 (e mbyllur me vulë).

¹⁸³⁹ Goran Stopariq, P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 42.

¹⁸⁴⁰ K86, T. 7353 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁸⁴¹ K86, T. 7353–7354 (24 nëntor 2006) (seancë e mbyllur).

¹⁸⁴² 1D401 (Ligji mbi Uniformat dhe Emblemat e Policisë), neni 48.

¹⁸⁴³ Të identifikuar nga K25, K73 dhe K86 në P1323 (Mostra të emblemave të UJ-së/MPB-së), f. 2, nr. 12. K25, T. 4666 (11 tetor 2006); K73, T. 3304–3306 (13 shtator 2006); K86, T. 7359 (27 nëntor 2006) (seancë e mbyllur). *Shih gjithashtu* John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 8.

¹⁸⁴⁴ Aleksandar Vasileviq, T. 8702 (19 janar 2007), P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 32.

¹⁸⁴⁵ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 9–10.

JSO-së mbanin edhe bereta të kuqe.¹⁸⁴⁶ Megjithatë, gjatë operacioneve pjesëtarët e JSO-së shpesh mbanin të ashtuquajturën kapelë “xhungël”, si edhe maska të zeza.¹⁸⁴⁷

v. *Shiritat*

715. Mbrojtja e Llukiqit pretendon se UÇK-ja mundi të shtinte në dorë uniforma të MPB-së dhe se i përdorte ato për veprime të paligjshme.¹⁸⁴⁸ Ka edhe disa dëshmi se uniformat e UJ-së ndonjëherë i vishnin civilë ose pjesëtarë të UÇK-së për të kryer veprime të paligjshme.¹⁸⁴⁹ K25 dëshmoi se kishte dëgjuar për raste të keqpërdorimit të uniformave të MPB-së nga kriminelë në Kosovë si dhe nga UÇK-ja.¹⁸⁵⁰ Për të minimizuar përdorimin e paligjshëm të uniformave policore, herë pas here në pjesën e sipërme të uniformës viheshin shirita si identifikues shtesë. Kjo përmendet në dy urdhra të pranuar si prova. Në korrik 1998, njësitë e MPB-së dhe të UJ-së në Kosovë u udhëzuan për të përdorur shirita të bardhë, të verdhë dhe të kuq apo kombinime të tyre,¹⁸⁵¹ si pasojë e një incidenti kur UÇK-ja përdori paligjshmërisht uniformat e policisë për të kapur një polic.¹⁸⁵² Nga mesi i prillit 1999, të gjithë pjesëtarët e MPB-së me uniforma, u udhëzuan të mbanin kombinime të ndryshme të shiritave të verdhë, të kaltër dhe të kuq në data të ndryshme për t’u dalluar gjatë lëvizjeve të tyre në terren të hapur, gjatë dislokimit të tyre në Kosovë.¹⁸⁵³ Për më tepër, dëshmitarë okularë të operacioneve të ndryshme të MPB-së gjatë fundit të marsit dhe fillimit të prillit 1999 dëshmuuan se kishin parë pjesëtarë të forcave të MPB-së që mbanin shirita me ngjyra të ndryshme në uniformat e tyre.¹⁸⁵⁴

vi. *Përfundim*

716. Dhoma konkludon se para dhe gjatë fushatës së NATO-s në Kosovë, forcat policore që nuk ishin të angazhuara në veprime luftarake, përgjithësisht mbanin uniforma me ngjyrë të kaltër të

¹⁸⁴⁶ Goran Stopariq, P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 11; K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 20; Aleksandar Vasileviq, T. 8702 (19 janar 2007), P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 32.

¹⁸⁴⁷ K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 19, f. 20 dhe T. 4665 (11 tetor 2006), i referohet P1326, fotografia 8, në të cilën shihet pjesëtar i policisë që mban kapelë “xhungël”. K86, T. 7353 (24 nëntor 2006); John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 9–10.

¹⁸⁴⁸ Dosja Përfundimtare Gjyqësore e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 122.

¹⁸⁴⁹ Dushan Gavranic, T. 22730–22731 (19 shkurt 2008); 5D549 (Raport i Brigadës 175 të Këmbëorisë së Lehtë, 27 prill 1999); 4D248 (Radiogram i Komandës së Armatës së 3-të, 12 prill 1999).

¹⁸⁵⁰ K25, T. 4747 (12 tetor 2006).

¹⁸⁵¹ 6D667 (Plani për pajisjen me shenja identifikuese të njëjësive të MPB-së dhe UJ-së, 25–31 korrik 1998).

¹⁸⁵² Radojica Nikçeviq, T. 23237–23238 (26 shkurt 2008); Dragan Paunovic, T. 21856–21857 (7 shkurt 2008).

¹⁸⁵³ Vladimir Iliq, T. 24324–24325 (17 mars 2008); Miroslav Mijatovic, T. 22275–22279 (13 shkurt 2008); Dragan Milenkovic, T. 22950 (21 shkurt 2008); Radojica Nikçeviq, T. 23237–23238 (26 shkurt 2008); Petar Damjanac, T. 23778 (6 mars 2008); 6D579 (Udhëzime lidhur me shiritat identifikues të policisë, maj 1999); 6D237 (Tabelë e shiritave identifikuese që mbanin pjesëtarët e policisë gjatë mesit të vitit 1999).

¹⁸⁵⁴ *Shi, p.sh.*, Isuf Zhuniqi, T. 4126 (27 shtator 2006); K14, T. 10981–10983 (seancë e mbyllur) (2 mars 2007); Abdulhaqim Shaqiri, T. 2789 (5 shtator 2006).

errët ose uniforma kamuflimi të kaltra. Nga 24 marsi 1999 e deri në fund të fushatës së NATO-s pjesëtarët e PJP-së gjatë operacioneve të tyre në Kosovë mbanin uniforma kamuflimi të gjelbra. Mirëpo duke qenë se të gjithë pjesëtarët e PJP-së ishin thjesht pjesëtarë të rregullt të MPB-së, por më të stërvitur dhe me detyra shtesë, ata ishin të pajisur edhe me dy llojet e uniformave të rregullta: uniformën e kaltër të kamuflimit dhe uniformën me ngjyrë të kaltër të errët. Pjesëtarët e SAJ-së dhe JSO-së gjatë dislokimit të tyre në Kosovë, mbanin uniforma të gjelbra kamuflimi. Herë pas here, pjesëtarët me uniforma të MPB-së gjatë operacioneve në terren të hapur, mbanin për identifikim shirita me ngjyra apo “shirita krahu”.

c. Disiplina në MPB

717. Përgjegjësia disiplinore e punonjësve të MPB-së parashtrohej në pjesën 3 të Ligjit për Punë të Brendshme si dhe në Dekretin mbi Përgjegjësinë Disiplinore në Ministrinë e Punëve të Brendshme (“Dekreti mbi Përgjegjësinë Disiplinore”).¹⁸⁵⁵ Sipas këtyre akteve ligjore, shkeljet e kryera nga anëtarë të MPB-së mund të ishin të dy llojeve: të lehta dhe të rënda.¹⁸⁵⁶ Millosh Vojnoviqi, i cili ishte shefi i SPB-së së Prizrenit, shpjegoi se procedimin disiplinor e vinte në lëvizje eprori i drejtpërdrejtë i punonjësit përkatës të MPB-së i cili i dorëzonte një raport eprorit të tij dhe prokurorit disiplinor.¹⁸⁵⁷ Për nisjen e procedimit disiplinor, SPB-ja përkatëse duhej të autorizohet nga selia e MPB-së në Beograd.¹⁸⁵⁸

718. Dushan Gavranqi shpjegoi se para fillimit të fushatës së NATO-s, shefi i SPB-së përkatëse shërbente si institucion i shkallës së parë për shkelje të lehta, kurse me apelimet e këtyre çështjeve merrej gjykata disiplinore e SPB-së e përbërë nga punonjës të SPB-së përkatëse. Me shkelje të rënda merrej gjykata disiplinore e shkallës së parë e SPB-së, kurse apelimet e këtyre çështjeve i shqyrtonte gjykata disiplinore në nivel të SPB-së së Beogradit.¹⁸⁵⁹ Sipas Ligjit për Punë të Brendshme dhe Dekretit mbi Përgjegjësinë Disiplinore, shkeljet e lehta dënoheshin me vërejtje dhe me gjobë prej 10 deri 20 për qind të rrogës mujore, kurse shkeljet e rënda me gjobë prej 20 deri 30 për qind të rrogës mujore për një periudhë prej dy deri në gjashtë muaj, me transferim të

¹⁸⁵⁵ P1737 (Ligji për Punët e Brendshme), nenet 49–58; P1016 (Dekret mbi Përgjegjësinë Disiplinore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, 30 shtator 1992).

¹⁸⁵⁶ P1737 (Ligji për Punët e Brendshme), nenet 49–50; P1016 (Dekret mbi Përgjegjësinë Disiplinore në Ministrinë e Punëve të Brendshme, 30 shtator 1992), pjesët 2–3.

¹⁸⁵⁷ Millosh Vojnoviq, 6D1532 (deklaratë e dëshmitarit e datës 5 mars 2008), para. 23.

¹⁸⁵⁸ Lubinko Cvetiq, T. 8152–8153 (8 dhjetor 2006); 6D1325 (Dosja e pjesëtarit të Detachmentit të 36-të të PJP-së, 23 mars 1999); 6D134 (Parashtrim i SPB-së së Prishtinës, 1 mars 1999).

¹⁸⁵⁹ Dushan Gavranqi, T. 22669–22670 (18 shkurt 2008); *shih gjithashtu* Millosh Vojnoviq, 6D1532 (deklaratë dëshmitari e datës 5 mars 2008), para. 23.

përkohshëm në një vend tjetër pune ose me heqje nga puna në MPB.¹⁸⁶⁰ Procedura disiplinore e MPB-së mund të kryhej paralelisht me procedimin e rregullt penal.¹⁸⁶¹

719. Gavraniqi dhe Vojnoviqi shpjeguan se pas fillimit të fushatës së NATO-s, Vllastimir Gjorgjeviqi lëshoi dekretin për ndryshimin e praktikës disiplinore të RJB-së. Kjo praktikë parashikonte rritjen e ndëshkimeve për shkelje të lehta dhe të rënda të detyrimeve të punës.¹⁸⁶² Për më tepër, u ndryshua edhe procedura disiplinore për raste të shkeljeve të rënda. Sipas praktikës të re, eprori i drejtpërdrejtë kishte për detyrë të ndërmerre veprimet të cilat më parë i kryente gjykata disiplinore. Ai duhej të hartonte një dosje të shkeljeve të detyrës dhe më pas t'i dorëzonte propozimin përkatës shefit të njësisë organizative përkatëse. Vendimi i tij mund të apelohej në gjykatën e lartë disiplinore në Beograd.¹⁸⁶³

720. Petar Damjanaci tha se ndëshkohej çdo thyerje dhe shkelje e kryer nga ndonjë pjesëtar i MPB-së në DPB-në e tij.¹⁸⁶⁴ Nebojsa Bogunoviqi, i cili ishte ndihmëshefi i SPB-së së Mitrovicës, dëshmoi se që nga nëntori 1998 kur ai iu bashkua SPB-së, u procedua çdo krim kundër jetës dhe paprekshmërisë fizike të njeriut. Ai gjithashtu deklaroi se SPB-ja e tij kishte proceduar dhe paraqitur kallëzime penale kundër çdo personi që dyshohej se kishte kryer krime, qoftë civil apo polic.¹⁸⁶⁵ Në kundërshtim me këtë, Cvetiqi, i cili në atë kohë ishte eprori i Bogunoviqit, tha se gjatë kohës që kishte kryer detyrën e shefit të SPB-së së Mitrovicës, ai nuk kishte dijëni që ndonjë polic të ishte akuzuar për vrasje, zjarrvënie apo dëbim të shqiptarëve kosovarë.¹⁸⁶⁶ Dhoma vë në dukje se dy dëshmitarë të Mbrojtjes së Llukiqit, Bogunoviqi dhe Millosh Vojnoviqi, i cili ishte shefi i SPB-së së Prizrenit, dëshmuar se Cvetiqi u largua nga posti i tij më 16 prill 1999 për shkak të paafësisë për të kryer detyrat e tij si shef i SPB-së së Mitrovicës.¹⁸⁶⁷ Dhoma nuk gjykon se largimi i Cvetiqit nga posti i tij zbeh dëshminë e tij të cilën Dhoma e vlerëson si të besueshme dhe të saktë.

¹⁸⁶⁰ P1737 (Ligji për Punë të Brendshme), nenet 51–52.

¹⁸⁶¹ Dushan Gavraniq, T. 22671 (18 shkurt 2008).

¹⁸⁶² Dushan Gavraniq, T. 22661–22663, 22668–22669 (18 shkurt 2008), Millosh Vojnoviq, 6D1532 (deklaratë dëshmitari e datës 5 mars 2008), para. 24.

¹⁸⁶³ 6D133 (Dekreti mbi Punët e Brendshme gjatë Gjendjes së Luftës, 9 prill 1999); 6D1342 (Telegram dërguar nga Petar Zekoviqi, 21 prill 1999), gjithashtu pranuar si provë me numër 6D873; *shih* gjithashtu Dushan Gavraniq, T. 22661–22663, 22668–22669 (18 shkurt 2008).

¹⁸⁶⁴ Petar Damjanac, T. 23768–23769 (6 mars 2008).

¹⁸⁶⁵ Nebojsa Bogunoviqi, 6D1614 (deklaratë dëshmitari e datës 6 prill 2008), para. 54; 6D614 (Pasqyrë e MPB-së e shkeljeve penale të evidentuara, 1 korrik 1998 - 20 qershor 1999), f. 11 para. 26, f. 12, para. 31; 6D139 (Kallëzim Penal, 19 maj 1999).

¹⁸⁶⁶ Lubinko Cvetiq, T. 8112-8113 (7 dhjetor 2006).

¹⁸⁶⁷ Bogunoviqi dëshmoi se “Cvetiqi ... i cili nuk ishte në kontroll të situatës në terren në territorin e SPB-së së Mitrovicës. Ai u ngujua brenda mureve të zyrave të SPB-së së Mitrovicës. Aty ai u fshihej oficerëve të tij duke iu shmangur kryerjes së detyrave të tij.” Nebojsa Bogunoviqi, T. 25119–25120 (10 prill 2008). Lidhur me Cvetiqin, Vojnoviqi tha se “kishte probleme. Mendoj që e larguan nga puna por nuk jam i sigurt”, dhe shtoi se kur u mbajt mbledhja e të gjithë shefave të SPB-ve dhe drejtuesve të PJP-ve, JSO-ve dhe SAJ-së më 4 prill 1999, Cvetiqi ishte i

721. E njëjta procedurë disiplinore vlente edhe për pjesëtarët e PJP-së dhe punonjësit e tjerë të MPB-së.¹⁸⁶⁸ SPB-ja eprorë së cilës i takonte një pjesëtar i caktuar i PJP-së, ishte përgjegjëse për procedurën disiplinore.¹⁸⁶⁹

722. Vladimir Iliqi, zëvendëskomandant i Detashmentit të 21-të të PJP-së, dëshmoi se për mbajtjen e disiplinës në njësinë e tij merreshin dy lloje masash: parandaluese dhe ndëshkuese. Për sa u përket masave parandaluese, çdo komandant paralajmëronte pjesëtarë të njësisë së tij për rëndësinë e veprimit brenda ligjit. Kundër policëve që shpërfillnin paralajmërimin merreshin masa ndëshkuese. Iliqi shpjegoi se Dega për Kontrollimin e Sjelljes së Ligjshme në Detyrë me seli në Beograd atashonte oficerë me pozitën e ndihmëskomandantit në Brigadën e 122-të të Ndërhyrjes të cilët kishin për detyrë të kontrollonin ligjshmërinë e sjelljes së pjesëtarëve të njësisë dhe të merrnin masa në rast të shkeljeve të ligjeve të luftës. Këta oficerë vepronin në mënyrë të pavarur dhe nuk ishin nën varësinë e drejtpërdrejtë të komandantit të detashmentit, por nën varësinë e njësisë së tyre amë në Beograd.¹⁸⁷⁰

723. Iliqi shtoi se gjatë viteve 1998 dhe 1999, 50 deri në 70 pjesëtarë të Brigadës së 122-të të PJP-së për Ndërhyrje e cila numëronte gjithsej 800 pjesëtarë, u proceduan nga ana disiplinore dhe penale kryesisht për vjedhje. Ai më tej tha se me sa i kujtohej, kundër pjesëtarëve të brigadës nuk pati procedime penale dhe disiplinore për keqtrajtim të civilëve.¹⁸⁷¹

d. Forcat e MPB-së të angazhuara në operacione në Kosovë

724. Më 1998 dhe 1999, në Kosovë kishte shumë pjesëtarë të MPB-së, përfshirë policë të rregullt dhe rezervistë nga Kosova si dhe pjesëtarë të PJP-së nga Kosova dhe Serbia, forcat e SAJ-së dhe pjesëtarë të JSO-së.

e. Forcat e PJP-së në Kosovë

725. PJP-ja mbajti peshën më të madhe të operacioneve të MPB-së në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999 dhe u angazhua në veprime në të cilat morën pjesë edhe forcat e UJ-së dhe forca të tjera të MPB-së. Dokumenti i datës 2 tetor 1998 përpiluar nga Postëkomanda Pararojë e Armatës së Tretë vë në dukje se asokohe në Kosovë vepronte një numër i konsiderueshëm formacionesh të

vetmi që nuk kishte se çfarë të raportonte, gjë që ndikoi në marrjen e vendimit për largimin e tij nga puna. Millosh Vojnoviq, T. 24155–24158 (12 mars 2008).

¹⁸⁶⁸ Bozhidar Filiq, T. 23942 (7 mars 2008).

¹⁸⁶⁹ Nebojsa Bogunoviq, 6D1614 (deklaratë dëshmitari e datës 6 prill 2008), para. 54; *shih ,p.sh.*, 6D1325 (Dosja e çështjes së një pjesëtari të Detashmentit 36 të PJP-së, 23 mars 1999).

¹⁸⁷⁰ Vladimir Iliq, T. 24327–24329 (17 mars 2008).

¹⁸⁷¹ Vladimir Iliq, T. 24327–24329, 24390–24391 (17 mars 2008).

PJP-së.¹⁸⁷² Dushko Adamoviqi, pjesëtar i Shtabit të MPB-së, përgjegjës për çështje që kishin të bënin me ndërrimin e njësisve të MPB-së në Kosovë, dëshmoi se dhjetë detashmente të PJP-së ishin angazhuar në veprimtari antiterroriste në Kosovë: pesë të formacionit “A”, gjegjësisht detashmente manovruese; dhe pesë të formacionit “B”, gjegjësisht detashmente territoriale. Për më tepër, në Kosovë ishin dislokuar edhe tetë kompani të Brigadës 124 të PJP-së për Ndërhyrje. Çdo SPB-je në Kosovë i ishte atashuar një nga këto kompani, me përjashtim të SPB-së së Prishtinës të cilës iu atashuan dy kompani të tilla.¹⁸⁷³

726. Duke filluar nga korriku i vitit 1998, në Kosovë u dërguan detashmente të ndryshme të PJP-së nga pjesë të tjerë të Serbisë “për të ndihmuar SPB-të në kryerjen e detyrave të posaçme në lidhje me sigurinë.”¹⁸⁷⁴ Pjesëtarët e detashmenteve të PJP-së nga Serbia dërgoheshin në Kosovë për më së shumti 40 ditë, varësisht nga detyra që kishin.¹⁸⁷⁵ Në telegramet ku urdhërohej dislokimi i detashmenteve të tilla thuhej se pjesëtarët e PJP-së do të dërgoheshin të pajisur me armë të shkurtra dhe të gjata, municione, jelekë mbrojtës dhe pajisje të tjera të nevojshme për veprime luftarake.¹⁸⁷⁶

727. Mirëpo pas nënshkrimit më 25 tetor 1998, të marrëveshjes midis gjeneralëve Wesley Clark dhe Klaus Naumann në emër të NATO-s dhe Shainoviqit dhe Vllastimir Gjorgjeviqit në emër të autoriteteve të RFJ-së/Serbisë, të gjitha njësitë e posaçme policore që ishin dislokuar në Kosovë pas shkurtit 1998, duhej të tërhiqeshin nga Kosova.¹⁸⁷⁷ Marrëveshja kërkonte zvogëlimin e numrit të efektivit të MPB-së në Kosovë nga 14.571 në 10.021, prej të cilëve 8.000 do të ishin nga policët aktivë dhe rezervistë nga Kosova dhe 2.021 nga SPB-të jashtë Kosovës.¹⁸⁷⁸

728. Sipas Lubinko Cvetiqit, në fillim të vitit 1999 kur UÇK-ja intensifikoi veprimtarinë e saj, u bë edhe një mobilizim i policëve të rregullt dhe rezervistë. Disa policë të rregullt ishin pjesëtarë të njësisve të posaçme të policisë që ishin tërhequr nga Kosova më herët. Pas lëshimit të urdhrorit për

¹⁸⁷² 3D697 (Analizë e Detyrave të Kryera në Territorin e Kosovës, 2 tetor 1998), f. 10.

¹⁸⁷³ Dushko Adamoviqi, 6D1613 (deklaratë dëshmitari e datës 30 mars 2008), para. 52

¹⁸⁷⁴ 6D287 (Telegram i Vllastimir Gjorgjeviqit në lidhje me dislokimin e PJP-së, 15 korrik 1998). *Shih gjithashtu* 6D681 (Telegram i Vllastimir Gjorgjeviqit në lidhje me dislokimin e PJP-së, 28 korrik 1998); 6D683 (Telegram i Vllastimir Gjorgjeviqit në lidhje me dislokimin e PJP-së, 30 dhjetor 1998) Dhoma vëren se në përkthimin e këtij dokumenti gabimisht shkruhet se dokumenti u lëshua më 18 mars 1999. 6D684 (Telegram i Vllastimir Gjorgjeviqit në lidhje me dislokimin e PJP-së, 4 shkurt 1999); 6D687 (Telegram i Vllastimir Gjorgjeviqit në lidhje me dislokimin e PJP-së, 16 shkurt 1999); 6D685 (Telegram i Vllastimir Gjorgjeviqit në lidhje me dislokimin e PJP-së, 18 mars 1999); 6D291 (Telegram i Vllastimir Gjorgjeviqit në lidhje me dislokimin e PJP-së, 21 mars 1999).

¹⁸⁷⁵ Dragan Paunoviqi, T. 21850 (7 shkurt 2008); Miroslav Mijatoviqi, T. 23374–23375 (14 shkurt 2008).

¹⁸⁷⁶ 6D685 (Telegram i Vllastimir Gjorgjeviqit në lidhje me dislokimin e PJP-së, 18 mars 1999); 6D683 (Telegram i Vllastimir Gjorgjeviqit në lidhje me dislokimin e PJP-së, 21 mars 1999) Dhoma vëren se në përkthimin e këtij dokumenti gabimisht thuhet se dokumenti u lëshua më 18 mars 1999.

¹⁸⁷⁷ P395 (Marrëveshja Clark-Naumann), f. 2.

¹⁸⁷⁸ Lubinko Cvetiq, T. 8048 (7 dhjetor 2006); 6D800 (Përfundime nga Mbledhja e Shtabit të MPB-së, 26 tetor 1998), f. 1.

mobilizim më 17 mars 1999, numri i policëve në Kosovë u rrit në 14.500–15.000. Mobilizimi mendohej të përfundonte deri më 20 mars 1999.¹⁸⁷⁹

729. Pavarësisht nga numri i saktë i pjesëtarëve të PJP-së që vepronin në Kosovë para bombardimeve të NATO-s, me fillimin e bombardimeve ata përsëri morën rol të rëndësishëm në terren. Një dokument i pranuar si provë i datës 17 prill 1999 vë në dukje se në atë kohë në Kosovë u dislokuan 11 detashmente të PJP-së dhe një brigadë e ndërhyrjes.¹⁸⁸⁰ Për më tepër, disa dëshmitarë që kishin qenë pjesëtarë të PJP-së më 1998 dhe 1999, dëshmuan në lidhje me dislokimin e tyre në vende të ndryshme në Kosovë gjatë bombardimeve të NATO-s.¹⁸⁸¹

f. Forcat e SAJ-së në Kosovë

730. Në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999 ishte dislokuar edhe SAJ-ja. I njëjti dokument i përpiluar prej Postëkomandës Pararojë të Armatës së Tretë më 2 tetor 1998, në të cilin përmendet prania e detashmenteve të PJP-së në Kosovë, gjithashtu përshkruan pjesëmarrjen e forcave të SAJ-së në operacione të ndryshme në atë kohë.¹⁸⁸² Për më tepër, Lubivoje Joksiqi dëshmoi se gjatë 1998 dhe 1999, pjesëtarët e SAJ-së ishin vendosur në objektin e një firme private në Fushë-Kosovë.¹⁸⁸³

731. Siç u tha më lart, Goran Stopariqi dëshmoi se grupi i njohur si “Akrepit”, anëtar i të cilit ishte edhe ai vetë, u përfshi në SAJ në fillim të 1999 dhe u dërgua në Kosovë. Konkretisht, njësia e tij u dislokua në Podujevë,¹⁸⁸⁴ ku disa pjesëtarë të njësisë ekzekutuan një grup civilësh, dhe pas këtij incidenti shefi i SAJ-së, Zhivko Trajkoviqi, e tërhoqi këtë njësi nga Kosova.¹⁸⁸⁵ Rreth 15 ditë pas incidentit, pjesa më e madhe e pjesëtarëve të kësaj njësie u dërguan sërish në Kosovë. Stopariqi dëshmoi se edhe tre apo katër personat që ai i identifikoi si pjesëmarrës në vrasjet në Podujevë u dërguan përsëri në Kosovë.¹⁸⁸⁶ Ai më tej tha se kur u dërguan sërish në Kosovë, detyra e njësisë së tij ishte “pastrimi”, që do të thoshte sulmim i forcave të armikut dhe përpjekje për të kthyer kontrollin mbi territorin dhe objektet e tyre.¹⁸⁸⁷

¹⁸⁷⁹ Lubinko Cvetiq, T. 8048–8049 (7 dhjetor 2006); P1224 (Rishikim i numrit të forcave policore në Kosovë).

¹⁸⁸⁰ 5D1417 (Dislokimi i PJP-së në zonë më 17 prill 1999). Dhoma vëren se dokumenti nuk përmban informacion lidhur me origjinën dhe autorin e tij, megjithatë përmbajtjen e dokumentit e konfirmoi Dushko Adamoviqi.

¹⁸⁸¹ K25, T. 4736–4737 (12 tetor 2006), P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 5–8; Dragan Paunoviq, T. 21875–21881 (7 shkurt 2008). *Shih në përgjithësi* dëshminë e K86 dhe K79.

¹⁸⁸² 3D697 (Analizë e detyrave të kryera në Kosovë, 2 tetor 1998), f. 10.

¹⁸⁸³ Lubivoje Joksiqi, T. 21949–21950, 21954 (8 shkurt 2008).

¹⁸⁸⁴ Goran Stopariqi, P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 45–46.

¹⁸⁸⁵ Goran Stopariqi, T. 724–725 (12 korrik 2006), T. 749–750 (13 korrik 2006), P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 45, 50–53. *Shih gjithashtu* Branko Gajiq, T. 15273–15274 (7 shtator 2007).

¹⁸⁸⁶ Goran Stopariqi, T. 789 (13 korrik 2006).

¹⁸⁸⁷ Goran Stopariqi, T. 725–726 (12 korrik 2006).

g. Forcat e JSO-së në Kosovë

732. Edhe JSO-ja mori pjesë në operacionet në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999. Atasheu i Mbrotjtjes i Mbretërisë së Bashkuar John Crosland i identifikoi forcat e JSO-së në Kosovë gjatë disa vizitave që bëri në krahinë në vitin 1998,¹⁸⁸⁸ dhe dokumenti përpiluar prej Postëkomandës Pararojë të Armatës së Tretë më 2 tetor 1998 përmendur më lart, përmend forcat e JSO-së si pjesëmarrëse në tre operacione të ndryshme në atë kohë.¹⁸⁸⁹

733. Konkretisht, ndihmëskordinatori i qendrave të RDB-së në Kosovë, Lubivoje Joksiqi, dëshmoi se forcat e JSO-së ishin të stacionuara në zonën e Mitrovicës.¹⁸⁹⁰ Për më tepër, shënimet nga mbledhja e Komandës së Përbashkët e datës 27 korrik 1998 sugjerojnë se JSO-ja mori pjesë në operacionet që u kryen në Kotore, një fshat në komunën e Skënderajt, jo larg Mitrovicës.¹⁸⁹¹ John Crosland-i tha se kishte parë forcat e JSO-së menjëherë para sulmit të tyre mbi shtabin e UÇK-së në Malishevë, më 28-29 korrik 1998. Crosland-i gjithashtu pa JSO-në duke kryer detyra ruajtëse në zonat e Drenicës dhe Jabllanicës më 28 gusht 1998.¹⁸⁹² Së fundi, sipas dëshmitarit K25, forcat e JSO-së morën pjesë në operacionin e 25 marsit 1999 në zonën e Krushës së Vogël në komunën e Rahovecit.¹⁸⁹³

734. Crosland-i shpjegoi se forcat e JSO-së në Kosovë ndonjëherë vepronin së bashku me forcat e PJP-së: kur forcat e PJP-së duhej të siguronin një zonë, JSO-ja sulmonte objektivat meqë pjesëtarët e saj ishin më të stërvitur për detyra të tilla.¹⁸⁹⁴ Megjithatë, nga dëshmia e tij nuk kuptohet qartë nëse kjo strategji ishte një procedurë e zakonshme veprimi, K79 dëshmoi se kur forcat e PJP-së nuk ishin në gjendje të përfundonin një operacion, atëherë vinin forcat e JSO-së dhe e bënin këtë.¹⁸⁹⁵ Crosland-i gjithashtu pohoi se kohë pas kohe pjesëtarët e forcave të JSO-së kryenin operacione të veshur si pjesëtarë të PJP-së.¹⁸⁹⁶

735. Në veçanti, K79 dëshmoi se nga fundi i vitit 1998, në Llaushën e Epërme dhe të Poshtme në afërsi të Skënderajt, JSO-ja “pastroi” zonën nga pjesëtarë të UÇK-së dhe se pas kësaj ofensive të

¹⁸⁸⁸ John Crosland, T. 9764 (7 shkurt 2007); P683 (Raport Konfidencial mbi Gjendjen nga Përfaqësuesi Ushtarak i M.B.-së, 3 tetor 1998); P685 (Raport Konfidencial mbi Gjendjen nga Përfaqësuesi Ushtarak i M.B.-së, 30 korrik 1998); P687 (Raport Konfidencial mbi Gjendjen nga Përfaqësuesi Ushtarak i M.B., 28 maj 1998); P688 Raport Konfidencial mbi Gjendjen nga Përfaqësuesi Ushtarak i M.B.-së, 13 maj 1998); P2553 (Raport Konfidencial mbi Gjendjen nga Përfaqësuesi Ushtarak i M.B.-së, 2 tetor 1998).

¹⁸⁸⁹ 3D697 (Analizë e Detyrave të Kryera në Territorin e Kosovës, 2 tetor 1998), f. 10.

¹⁸⁹⁰ Lubivoje Joksiq, T. 21950 (8 shkurt 2008).

¹⁸⁹¹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 20.

¹⁸⁹² John Crosland, T. 9762 (7 shkurt 2007).

¹⁸⁹³ K25, T. 4676 (11 Tetor 2006), P2439 (deklaratë dëshmitarit e datës 12 shtator 2001), f. 19.

¹⁸⁹⁴ John Crosland, T. 9761–9762 (7 shkurt 2007).

¹⁸⁹⁵ K79, T. 9676 (2 shkurt 2007).

¹⁸⁹⁶ John Crosland, T. 9761 (7 shkurt 2007).

JSO-së erdhi PJP-ja.¹⁸⁹⁷ Për më tepër K90 dëshmoi se në prill 1999, në komunën e Gjakovës, pas pritës së organizuar kundër pesë policëve serbë, në zonë mbërriti një kontingjent i madh policësh së bashku me pjesëtarë të PJP-së dhe dy persona të tjerë në një makinë. Një person nga njësia e tij që më parë kishte qenë pjesëtar i JSO-së i kishte thënë K90-ës se këta dy persona ishin të JSO-së. K90 njohu “kapelat e njohura të Frenkit” që mbanin ata, si dhe uniformat e tyre.¹⁸⁹⁸

736. Ka edhe dëshmi të pakta se forcat e JSO-së luftuan përkrah UJ-së në Kosovë. K54, pjesëtar i UJ-së, tha se në gusht 1998 ai kishte parë forca të UJ-së që vepronin në koordinim me JSO-në në Rahovec.¹⁸⁹⁹ Për më tepër, dokumenti i 2 tetorit 1998 vë në dukje se JSO-ja mori pjesë në tre operacione në të cilat u përfshinë UJ-ja dhe PJP-ja, dhe në dy prej të cilave u përfshi edhe SAJ-ja.¹⁹⁰⁰

h. Paraushtarakët/vullnetarët

737. Mbrojtja e Llukiqit pranon se ish-pjesëtarët e Akrepave, njësi kjo që nuk duhej të ekzistonte pas viteve 1998 dhe 1999, u përfshinë në SAJ; megjithatë, këta ish-pjesëtarë të Akrepave, përfshirë dhe vetë Goran Stopariqin, ishin rezervistë të policisë dhe si të tillë u përfshinë në SAJ.¹⁹⁰¹ Përsa u përket Tigrave të Arkanit (*Arkanovci*), Mbrojtja e Llukiqit argumenton se ata nuk kishin lidhje me asnjërin nga forcat e MPB-së mbi të cilat Llukiqi kishte ndikim. Ajo më tej argumenton se nuk ka asnjë provë të besueshme në lidhje me praninë e Tigrave të Arkanit në Kosovë në vitin 1999, aq më pak si pjesëtarë të forcave të MPB-së apo autorë krimesh.¹⁹⁰² Në lidhje me Ujqërit e Drinës, Mbrojtja e Llukiqit deklaroi se asnjë dëshmitar në lidhje me krime apo pjesëtar i brendshëm i policisë nuk ka përmendur praninë e pjesëtarëve të këtij grupi në Kosovë apo implikimin e tyre në kryerjen e krimeve.¹⁹⁰³

738. Ish-zëvendës shefi i Administratës së Sigurimit të UJ-së, Branko Gajiqi, dëshmoi se në MPB ishin përfshirë grupe paraushtarake të cilat vepronin në Kosovë gjatë bombardimeve të NATO-s.¹⁹⁰⁴ Ka të ngjarë që kjo dëshmi t’u referohet “Akrepave” dhe grupeve të tjera që lidhen me JSO-në ose SAJ-në. Në maj 1999, Aleksandar Vasileviqi vizitoi territorin e Kosovës së bashku me Gajiqin dhe shefin e Administratës së Sigurimit të UJ-së Geza Farkashin, në përpyetje për të mbledhur

¹⁸⁹⁷ K79, T. 9677 (2 shkurt 2007), 6D180 (deklaratë dëshmitari e datës 7 maj 2006), para. 28 (i mbyllur me vulë).

¹⁸⁹⁸ K90, T. 9313-9314 (29 janar 2007), P2652 (deklaratë dëshmitari e datës 31 janar 2007), para. 47.

¹⁸⁹⁹ K54, T. 10502-10503 (26 shkurt 2007).

¹⁹⁰⁰ 3D697 (Analizë e Detyrave të Kryera në Territorin e Kosovës, 2 tetor 1998), f. 10.

¹⁹⁰¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 316, 320–321, 327.

¹⁹⁰² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 334–335.

¹⁹⁰³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 353.

¹⁹⁰⁴ Branko Gajiq, T. 15341–15342 (11 shtator 2007).

informacion ushtarak profesional për gjendjen e sigurisë atje.¹⁹⁰⁵ Gjatë kësaj vizite, ai dëgjoi për grupin e quajtur “Legija” të komanduar nga kolonel Kovaçevići i MPB-së, i cili vepronte në zonën e Gjakovës.¹⁹⁰⁶ Ky grup përbëhej prej 15 vetësh dhe pretendohet se kishte kryer një sërë krimesh, ndër të tjera plaçkitje, rrëmbime, përdhunime dhe vrasje.¹⁹⁰⁷ Për shkak të numrit relativisht të vogël të pjesëtarëve të këtij grupi, Vasileviqi kishte përshtypje se grupi Legija ishte një lloj grupi paraushtarak dhe jo pjesë e forcave të rregullta të MPB-së.¹⁹⁰⁸

739. Gajiqi dëshmoi se 30 pjesëtarë të grupit të njohur si Tigrat e Arkanit u dërguan në Kosovë me autorizimin e shefit të atëhershëm të RDB-së, Rade Markoviçit.¹⁹⁰⁹ Stopariqi dhe Vasileviqi më tej dëshmuan se pjesëtarë të Tigrave të Arkanit u përfshinë në JSO;¹⁹¹⁰ për shembull edhe komandanti i JSO-së Millorad Ulemek Llukoviqi (i njohur edhe si Legija), më parë kishte qenë pjesëtar i Tigrave të Arkanit.¹⁹¹¹ Gajiqi tha se gjatë hetimeve që kishte kryer ishte vërtetuar se në Fushë-Kosovë kishte ekzistuar qendra për pranimin dhe stërvitjen e vullnetarëve të Tigrave të Arkanit. Sipas Gajiçit, Tigrat e Arkanit vranë dy persona të moshuar (burrë e grua) gjatë qëndrimit të tyre në Kosovë. Vasileviqi gjithashtu tha se pas kësaj vrasjeje, dikur para datës 17 maj 1999, Rade Markoviçi urdhëroi Tigrat e Arkanit të largoheshin nga Fushë-Kosova.¹⁹¹²

740. Gajiqi dëshmoi se Ujqërit e Drinës vinin nga Bosnjë - Hercegovina dhe mbanin uniforma të SAJ-së.¹⁹¹³ Dhoma gjithashtu dëgjoi se drejtuesi i këtij grupi ishte Nedelko Karashek, ish-komandant i njësisë të posaçme antiterroriste nga Bosnjë-Hercegovina.¹⁹¹⁴ Sipas Gajiçit, Administrata e Sigurimit të UJ-së vërtetoi se Ujqërit e Drinës ishin të vendosur në Fushë-Kosovë por nuk arriti të vërtetonte se cilat ishin veprimtaritë e tyre dhe “nëse kishin shkaktuar probleme”¹⁹¹⁵

741. Pas kthimit të Farkashit nga vizita e tij me Vasileviqin dhe Gajiçin në Kosovë, ai raportoi se ekzistonin probleme serioze me paraushtarakët në Kosovë, ndër të cilat përdhunime, plaçkitje dhe

¹⁹⁰⁵ Aleksandar Vasileviq, T. 8699–8670 (19 janar 2007).

¹⁹⁰⁶ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 30, T. 8698 (19 janar 2007).

¹⁹⁰⁷ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 30, T. 8698 (19 janar 2007), T. 9032 (24 janar 2007).

¹⁹⁰⁸ Aleksandar Vasileviq, T. 9035 (24 janar 2007).

¹⁹⁰⁹ Branko Gajiç, T. 15379 (11 shtator 2007).

¹⁹¹⁰ Goran Stopariq, P2224 (deklaratë dëshmitari e datës 6 korrik 2006), para. 10; Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 42.

¹⁹¹¹ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 33, 40–42.

¹⁹¹² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 40–42.

¹⁹¹³ Branko Gajiç, T. 15274–15275 (7 shtator 2007); T. 15373 (11 shtator 2007).

¹⁹¹⁴ Branko Gajiç, T. 15274 (7 shtator 2007), T. 15364 (11 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 39; Branko Gajiç, T. 15364, 15372, 15376–15377 (11 shtator 2008).

¹⁹¹⁵ Branko Gajiç, T. 15274 (7 shtator 2007), T. 15335–15336 (11 shtator 2007).

vjedhje.¹⁹¹⁶ Si pasojë, Millosheviqi organizoi mbledhjen e datës 17 maj 1999 për t'i diskutuar këto shqetësime.¹⁹¹⁷ Në këtë mbledhje morën pjesë Millosheviqi, Shainoviqi, Ojdaniqi dhe Pavkoviqi, si dhe Markoviqi, Farkashi, Gajiqi dhe Vasileviqi.¹⁹¹⁸ Gjatë mbledhjes, Vasileviqi paraqiti informacionin që dispononte në lidhje me grupet paraushtarake në Kosovë dhe përmendi Akrepat me kreun e tyre Sllobodan Mediqin (i njohur si Boca) dhe Ujqërit e Drinës me komandantin e tyre Nedelko Karashek (i njohur si Legenda).¹⁹¹⁹ Markoviqi më pas konfirmoi se në Kosovë ishin dislokuar 30 pjesëtarë të Tigrave të Arkanit. Markoviqi i kishte quajtur vullnetarët si “e keqe e domosdoshme” dhe kishte thënë se Tigrat e Arkanit po hetoheshin në lidhje me krimet e tyre në Fushë-Kosovë pas pretendimit për vrasjen e çiftit të moshuar. Ai tha se pas kësaj kishte urdhëruar Akrepat dhe Tigrat e Arkanit të tërhiqeshin nga Kosova.¹⁹²⁰ Farkashi dëshmoi se Millosheviqi më pas kishte urdhëruar largimin e forcave paraushtarake ose parapolicore nga Kosova dhe moslejimin e kthimit të tyre si dhe hetimin dhe gjykimin e autorëve të krimeve të lartpërmendura.¹⁹²¹

742. Cvetiqi identifikoi Llukiqin si personi që hapi mbledhjen e mbajtur më 17 shkurt 1999, në të cilën ministri Vllajko Stojilkoviq i udhëzoi të pranishmit që t'i trajtonin dhe përdornin vullnetarët me kujdes, “duke e kushtëzuar pjesëmarrjen e tyre në forcat rezerviste të policisë me domosdoshmërinë”.¹⁹²² Më 18 shkurt 1999, Stojilkoviqi u dërgoi telegram shefave të SPB-ve të Kosovës, Shtabit të MPB-së dhe organeve të tjera të MPB-së, duke i udhëzuar që të kryenin të gjitha kontrollat e nevojshme, të përpilonin listat dhe të vendosnin kontroll të plotë mbi vullnetarët dhe njësitë paraushtarake dhe pjesëtarët e tyre.”¹⁹²³

743. Cvetiqi gjithashtu tha se në një mbledhje tjetër të Shtabit të MPB-së të mbajtur më 17 mars 1999, “shefi i Shtabit të MPB-së në Prishtinë ... ngriti çështjen e vullnetarëve” dhe tha se “në rast se në territorin e Kosovën dhe Metohisë shfaqeshin vullnetarë, ata duheshin mbajtur në ato vende. Dhe sapo të fillonin operacionet luftarake, vullnetarët do të përfshiheshin në sistemin e MPB-së.” Ai shtoi se një gjë e tillë ishte e paligjshme.¹⁹²⁴ I pyetur nga Dhoma që të sqaronte se kush e kishte thënë këtë gjë, Cvetiqi identifikoi Llukiqin si shefi i Shtabit të MPB-së i cili e kishte bërë këtë

¹⁹¹⁶ Geza Farkash, T. 16294 (25 shtator 2007); Branko Gajiq, T. 15282–15283 (7 shtator 2007).

¹⁹¹⁷ Branko Gajiq, T. 15283 (7 shtator 2007).

¹⁹¹⁸ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 63.

¹⁹¹⁹ Branko Gajiq, T.15290–15291 (7 shtator 2007); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 Janar 2007), para. 63–65.

¹⁹²⁰ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 66.

¹⁹²¹ Geza Farkash, T. 16297–16298 (25 shtator 2007).

¹⁹²² Lubinko Cvetiq, T. 8099–8100 (7 dhjetor 2006); P1990 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999).

¹⁹²³ 6D269 (Telegram i RJB-së, 18 shkurt 1999).

¹⁹²⁴ Lubinko Cvetiq, T. 8100 (7 dhjetor 2006).

deklaratë në mbledhjen e 17 marsit 1999.¹⁹²⁵ Cvetiqi më pas shpjegoi natyrën e paligjshme të përdorimit të vullnetarëve të tillë prej MPB-së: “Sipas Ligjit mbi Ushtrinë e Jugosllavisë, mendoj që Neni 15 i këtij ligji parashikonte që në rast të rrezikut të një lufte dhe gjendjes së luftës, në radhët e Ushtrisë së Jugosllavisë mund të përfshiheshin edhe vullnetarë. Si pasojë, ligjvënësit nuk kishin përcaktuar mundësi për përdorimin e vullnetarëve për asnjë strukturë tjetër të mbrojtjes, përfshirë edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme.”¹⁹²⁶

744. Kjo dëshmi e Cvetiqit u sfidua nga Mbrojtja e Llukiqit përmes marrjes në pyetje të Millosh Vojnoviqit. Mbrojtja e Llukiqit e pyeti Vojnoviqin nëse i kujtohej të kishte marrë pjesë në ndonjë takim, në të cilin Llukiqi i kishte udhëzuar të pranishmit që “ta trajtonin këtë çështje me kujdes dhe duke e kushtëzuar angazhimin e tyre nëpërmjet forcave rezerviste të policisë me domosdoshmërinë e një gjëje të tillë.”¹⁹²⁷ Vojnoviqi tha se nuk i kujtohej ndonjë mbledhje apo deklaratë e tillë.¹⁹²⁸ Dushan Gavraniqi gjithashtu dëshmoi se në një mbledhje edhe ministri i Brendshëm Vllajko Stojilkoviç kishte folur për vullnetarë. Megjithatë, sipas tij mbledhja u mbajt më 17 shkurt 1999, dhe jo më 17 mars 1999. Nuk i kujtohej të kishte dëgjuar Llukiqin të thoshte diçka në lidhje me përdorimin e vullnetarëve. Atij iu kujtua se ministri i Brendshëm i kishte thënë se do të vijonin udhëzime të mëtejshme, por nuk i kujtohej të kishte marrë udhëzime të mëtejshme. Ai vuri në dukje se SPB-ja e Gjilanit asnjëherë nuk përdori vullnetarë; kur ndonjë vullnetar paraqitej në SPB, ai dërgohej në UJ.¹⁹²⁹ Ndonëse Mbrojtja e Llukiqit përdori deklaratën në lidhje me përdorimin e vullnetarëve për të zhvlerësuar dëshminë e Cvetiqit, Cvetiqi në fakt gjatë pyetjeve nga pala kundërshtare pranoi se deklaratën e parë e kishte bërë ministri i Brendshëm dhe jo shefi i Shtabit të MPB-së.¹⁹³⁰ Ai më tej dëshmoi se deklaratë të ngjashme bëri edhe shefi i Shtabit të MPB-së, Llukiqi, në mbledhjen në vijim mbajtur më 17 mars 1999.¹⁹³¹ Rrjedhimisht mënyra e parashtrimit të pyetjeve nga Mbrojtja e Llukiqit për të zhvlerësuar deklaratat e Cvetiqit i ngatërruan këto dy deklarata, dhe Dhoma përfundoi se Cvetiqi ishte i besueshëm në lidhje me këtë pikë. Për më tepër, bazuar në dëshminë e Cvetiqit dhe provave të tjera dokumentare, Dhoma konkludon se Vojnoviqi dhe Gajiqi nuk ishin të besueshëm.¹⁹³²

¹⁹²⁵ Lubinko Cvetiq, T. 8103 (7 dhjetor 2006).

¹⁹²⁶ Lubinko Cvetiq, T. 8100 (7 dhjetor 2006).

¹⁹²⁷ Millosh Vojnoviq, T. 24154–24155 (12 mars 2008).

¹⁹²⁸ Millosh Vojnoviq, T. 24154–24155 (12 mars 2008).

¹⁹²⁹ Dushan Gavraniq, T. 22724–22725 (12 shkurt 2008).

¹⁹³⁰ Lubinko Cvetiq, T. 8099–8100 (7 dhjetor 2006). *Shih* P1990 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999).

¹⁹³¹ Lubinko Cvetiq, T. 8100 (7 dhjetor 2006).

¹⁹³² Pavarësisht nëse mbledhja, në të cilën pretendohet se Llukiqi foli për përdorimin e vullnetarëve nga MPB-ja, u mbajt më 17 shkurt 1999 sipas fjalëve të Gavraniqit, ose më 17 mars 1999 sipas fjalëve të Cvetiqit, kjo nuk minon përfundimin e Dhomës lidhur me këtë çështje. Procesverbali i 17 shkurtit 1999 (P1990) evidenton deklaratën e

745. Më 24 mars 1999, Stojilkoviqi u dërgoi telegram shtesë shefave të SPB-ve në Kosovë, Shtabit të MPB-së dhe organeve të tjera të MPB-së, duke i udhëzuar midis të tjerash, të “regjistrojnë të gjithë vullnetarët dhe njësitë paraushtarake dhe pjesëtarët e tyre, dhe t’i mbajnë ata nën kontroll në rast se del nevoja për angazhimin e tyre.”¹⁹³³ Në mbledhjen e Shtabit të MPB-së të mbajtur më 4 prill 1999, Llukiqi edhe një herë iu referua paraushtarakëve kur udhëzoi të pranishmit që të “merrnin masa të rrepta kundër njësive paraushtarake.”¹⁹³⁴

4. Forca të tjera

746. Përveç njësive të UJ-së dhe MPB-së të përshkruara deri tani, gjatë periudhës së Aktakuzës në Kosovë vepronin edhe forca të tjera që ishin nën kontrollin e autoriteteve shtetërore, të cilat me të drejtë mund të konsiderohen si pjesë e “forcave të RFJ-së dhe Serbisë”. Në këto forca përfshiheshin njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile të Ministrisë Federale të Mbrojtjes. Për më tepër, duke filluar nga korriku i vitit 1998, joshqiptarët u armatosën dhe u organizuan në njësi vendore për mbrojtjen e fshatrave të quajtura Detashmente Rezerviste Policore apo Skuadra Rezerviste Policore (RPO). Me fillimin e mobilizimit në fillim të vitit 1999, pjesa më e madhe e pjesëtarëve të këtyre njësive u mobilizuan ose në UJ, ose në MPB; megjithatë, gjatë konfliktit të vitit 1999, në radhët e forcave zyrtare në Kosovë kishte edhe individë të armatosur të cilët nuk kishin detyra të caktuara për kohë lufte. Më tej Dhoma do të shqyrtojë këto struktura dhe në veçanti do të analizojë përbërjen dhe numrin e tyre, si dhe pozitën e tyre në hierarkinë komanduese të UJ-së, MPB-së dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

a. Njësitë e Mbrojtjes dhe Ruajtjes Civile

i. Përbërja

747. Njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile ishin nën juridiksionin dhe komandën e Ministrisë Federale të Mbrojtjes dhe mbuloheshin prej Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen dhe Rregullores mbi Ruajtjen Civile të Ministrisë Federale të Mbrojtjes.¹⁹³⁵

përmendur dhënë prej Stojilkoviqit mbi përdorimin e vullnetarëve por nuk evidenton se Llukiqi deklaroi diçka lidhur me përdorimin e vullnetarëve. Megjithatë, Cvetiqi bëri dallim midis dy rasteve të veçanta ku u dhanë deklarata në lidhje me përdorimin e vullnetarëve nga MPB-ja: një nga Ministri i Brendshëm dhe një nga shefi i Shtabit të MPB-së.

¹⁹³³ 6D238 (Telegram i Vllajko Stojilkoviqit, 24 mars 1999).

¹⁹³⁴ P1989 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999).

¹⁹³⁵ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), nenet 54–63; *shih gjithashtu* Sillobodan Kosovac, T. 15830 (18 shtator 2007); Vladimir Llazareviq, T. 17962 (8 nëntor 2007); Branko Gajiq, T. 15462–15463 (12 shtator 2007); Miodrag Simiq, T. 15612 (13 shtator 2007); Geza Farkash, T. 16331 (25 shtator 2007); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 34; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 57–60.

748. Ligji i RFJ-së mbi Mbrojtjen parashihte që qytetarët e moshës nga 15 deri në 60 vjeç (për meshkujt) apo 55 vjeç (për femrat) t'i nënshtroheshin detyrimit për pjesëmarrje në njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile. Ky rregull i përgjithshëm nuk ishte i zbatueshëm për ata që shërbenin në UJ apo në “organet e brendshme”. Anëtarësia në këto njësi përfshinte detyrimin për pjesëmarrje në njësitë dhe organet e formuara për ruajtjen dhe shpëtimin e popullatës civile dhe pasurive materiale nga shkatërrimet në kohë lufte dhe gjatë katastrofave natyrore dhe rreziqeve të tjera.¹⁹³⁶

749. Dëshmitari ekspert Radovan Radinoviç dëshmoi se njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile dallonin nga njësitë e tjera të armatosura prej veshjes së tyre speciale dhe shenjat civile.¹⁹³⁷ Llazareviç saktësoi se pjesëtarët e ruajtjes civile mbanin uniforma me ngjyrë të kaltër të çelët, në mëngët kishin shenjën me trekëndësh të verdhë brenda një rrethi, kapelë të kaltër dhe jelekë me ngjyrë të verdhë fluoeshente.¹⁹³⁸ Po ashtu edhe Zllatomir Peshiqi në dëshminë e tij tha se punonjësit e ruajtjes civile mbanin rroba të veçanta që nuk i përngjanin aspak uniformës ushtarake; megjithatë, ai deklaroi se këto uniforma ishin “zakonisht me ngjyrë të kaltër të errët”.¹⁹³⁹ Edhe dëshmitarë të tjerë dhanë përshkrim të ngjashëm të uniformave të pjesëtarëve të ruajtjes civile dhe thanë se ato ishin në ngjyrë të kaltër me një emblemë të verdhë.¹⁹⁴⁰ Në veçanti, Velko Odalloviç, i cili gjatë bombardimeve të NATO-s ishte komandant i shtabit të ruajtjes civile në Qarkun e Kosovës, theksoi se në postin që mbante, ai asnjëherë nuk vishte uniformë.¹⁹⁴¹

750. Dhoma mori informacione kundërthënëse në lidhje me numrin e efektivit të njësive të mbrojtjes dhe ruajtjes civile. Parashtrimi i Mbrojtjes së Llukiqit se efektivitë numëronte rreth 40.000 vetë¹⁹⁴² nuk duket të jetë i saktë. Mbrojtja e Llukiqit e mbështeti këtë shifër duke iu referuar dëshmisë së Branko Gajiqit. Mirëpo Gajiqi theksoi se numri prej 40.000 deri në 47.000 që dha ai lidhej me të gjithë *rekrutët*,¹⁹⁴³ do të thotë përfshinte edhe personat e përjashtuar nga shërbimi në njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile në bazë të nenit 22 të Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen i cili i lironte të gjithë personat që shërbenin në UJ dhe në MPB nga detyrimi për t'u vënë në dispozicion të këtyre njësive.¹⁹⁴⁴

¹⁹³⁶ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 22.

¹⁹³⁷ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 34–35.

¹⁹³⁸ Vladimir Llazareviç, T. 18794 (22 nëntor 2007); *shih gjithashtu* P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviçit me Prokurorinë), f. 65.

¹⁹³⁹ Zllatomir Peshiq, T. 7185 (23 nëntor 2006).

¹⁹⁴⁰ Dushan Lonçar, T. 7662 (1 dhjetor 2006); Geza Farkash, T. 16336–16337 (25 shtator 2007).

¹⁹⁴¹ Velko Odalloviç, T. 14473–14474 (27 gusht 2007).

¹⁹⁴² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 469.

¹⁹⁴³ Branko Gajiq, T. 15461 (12 shtator 2007). *Shih gjithashtu* Radovan Radinoviç, T. 17275 (19 tetor 2007).

¹⁹⁴⁴ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 22.

751. Provat që mbeten sugjerojnë një numër prej 6.000 deri në 10.000. Konkretisht, Llazareviqi rikujtoi se gjatë kohës së Aktakuzës, në Kosovë kishte rreth 10.000 pjesëtarë të këtyre njësive.¹⁹⁴⁵ Geza Farkashi tha se, ndonëse duheshin plotësuar 9.000 poste, nuk kishte njerëz të mjaftueshëm dhe në fund u shpërndanë pak më shumë se 6.500 copë armë “strukturave civile të shoqërisë”, përfshirë njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile.¹⁹⁴⁶ Këtë numër e mbështet edhe komunikata e Ministrisë Federale të Mbrojtjes, përpiluar më 2 nëntor 1998, sipas të cilës numri i gjithsejtë i pjesëtarëve të mbrojtjes dhe ruajtjes civile ishte 6.632.¹⁹⁴⁷

752. Njësitë e ruajtjes civile i komandonte Ministria Federale e Mbrojtjes.¹⁹⁴⁸ Sipas Llazareviqit dhe Radovan Radinoviqit, gjatë kohës së luftës, ato në veçanti u angazhuan në detyra të ruajtjes së popullsisë dhe pronës materiale dhe kishin për detyrë të informonin popullsinë për rrezikun e afërt.¹⁹⁴⁹ Miodrag Simiqi dëshmoi se njësitë e ruajtjes civile ishin përgjegjëse për ruajtjen e ndërtesave.¹⁹⁵⁰ Provat sugjerojnë se në disa raste, njësitë e ruajtjes civile u përdorën edhe për “sanitarizimin” e terrenit.¹⁹⁵¹

753. Radinoviqi theksoi se njësitë e ruajtjes civile nuk ishin njësi luftarake dhe nuk mund të përdoreshin si të tilla,¹⁹⁵² por shtoi se pjesëtarët e tyre u pajisën me armë të lehta për mbrojtjen e tyre personale.¹⁹⁵³ Kjo mbështetet edhe nga letra e Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës dërguar Ministrisë së Mbrojtjes me datë 2 nëntor 1998, e cila i referohet kërkesës së Administratës së Mbrojtjes së Prishtinës bërë Komandës së Armatës së tretë “për sigurimin ... e armëve dhe municionit për ... ruajtjen civile — 3.365 pjesëtarë”.¹⁹⁵⁴ Gjithashtu, urdhri i Ministrisë Federale të Mbrojtjes bën thirrje për shpërndarjen e armëve serbëve dhe pjesëtarëve të popullatave të tjera

¹⁹⁴⁵ Vladimir Llazareviq, T. 18425 (16 nëntor 2007); P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 60–61, 391–393.

¹⁹⁴⁶ Geza Farkash, T. 16379–16380 (25 shtator 2007).

¹⁹⁴⁷ P1060 (Letër Sektorit për Mbrojtjen Civile dërguar prej Administratës së Mbrojtjes në Prishtinë, 2 nëntor 1998). *Shih gjithashtu* 3D1116 (Akt ekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 34, e cila i referohet P1061 (Letër Sektorit për Mbrojtjen Civile dërguar prej Administratës së Mbrojtjes në Prishtinë, 2 nëntor 1998), f. 3–4.

¹⁹⁴⁸ Aleksandar Vasileviq, T. 8963 (23 janar 2007). *Shih gjithashtu* P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 60–61; P1294 (Vendim mbi Emërimin e Oficerëve të Mbrojtjes Civile, 19 mars 1999).

¹⁹⁴⁹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 60–61; 3D1116 (Akt ekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 28. Sipas Llazareviqit, njësitë e Ruajtjes Civile ishin të dy llojeve dhe që të dy llojet kishin uniforma të veçanta dhe shenja ndërkombëtare dhe zakonisht nuk ishin të armatosura: 1) Njësitë e Ruajtjes Civile për Funksiione të Përgjithshme, që kishin për detyrë largimin dhe evakuimin e popullsisë dhe pasurive; dhe 2) Njësitë për Funksiione të Posaçme ose Specifike, si për shembull Njësitë e Zjarrfikësve, Njësitë për Mbrojtje nga Zjarri, Njësitë për Dezinfektim, Njësitë për Higjienë Publike, etj.; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 57–61.

¹⁹⁵⁰ Miodrag Simiq, T. 15679 (14 shtator 2007).

¹⁹⁵¹ K83, T. 3957–3958 (26 shtator 2006). Stamenkoviqi shpjegoi se termi “sanitarizimin” ose “*asanacija*” në BKS do të thotë kujdes për të plagosurit pas betejës, gjetja dhe evidentimi i kufomave, armëve dhe sendeve të tjera me gjasë të dëmshme. Novica Stamenkoviq, T. 20118–20120 (12 dhjetor 2007).

¹⁹⁵² 3D1116 (Akt ekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 34; *shih gjithashtu* Lubinko Cvetiq, T. 8171 (8 dhjetor 2006).

¹⁹⁵³ Radovan Radinoviq, T. 17278 (19 tetor 2007). Geza Farkash gjithashtu dëshmoi se njësitë e ruajtjes civile pajiseshin me armë; T. 16379–16380 (25 shtator 2007). *Krahaso* Lubinko Cvetiq, T. 8171 (8 dhjetor 2007).

¹⁹⁵⁴ P1060 (Letër Sektorit për Mbrojtjen Civile dërguar prej Administratës së Mbrojtjes në Prishtinë, 2 nëntor 1998).

“besnike”, por përjashton pjesëtarët e mbrojtjes dhe ruajtjes civile me arsyetimin se ata do të armatoseshin prej “njësive të tyre për kohë lufte”.¹⁹⁵⁵

754. Edhe njësitë e mbrojtjes civile komandoheshin nga Ministria Federale e Mbrojtjes.¹⁹⁵⁶ Këto njësi ishin të armatosura me armë të vogla dhe të organizuara në detashmente.¹⁹⁵⁷ Njësitë e mbrojtjes civile kishin për detyrë “mbrojtjen e popullatës civile dhe pronës nga sulmet, sigurimin e ndërtesave publike (shkollat, spitalet, e të tjerë) dhe të ndërtesave dhe objekteve të tjera civile.”¹⁹⁵⁸ Llazareviqi shtoi se gjatë gjendjes së luftës, mbrojtja civile mori përsipër “detyrimin material” dhe për këtë arsye ishte përgjegjëse për pajisjen me makina, mirëpo njësitë e saj nuk u përfshinë në kryerjen e ndonjë detyre për UJ-në.¹⁹⁵⁹ Radovan Radinoviqi tha se njësitë e mbrojtjes civile, njëlloj si ato të ruajtjes civile, nuk ishin njësi luftarake dhe nuk mund të përdroreshin si të tilla.¹⁹⁶⁰

ii. Struktura Komanduese

755. Prokuroria argumenton se njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile ishin nën varësinë e UJ-së në bazë të një klauzole lejuese në Ligjin e RFJ-së për Mbrojtjen, dhe përmes urdhrave të drejtpërdrejta për vënien në varësi.¹⁹⁶¹

756. Neni 63 i Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen përcaktonte se “të gjitha njësitë e mbrojtjes civile komandohen prej organeve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen dhe ruajtjen civile”,¹⁹⁶² mirëpo më tej vijonte se:

Një oficer i Ushtrisë së Jugosllavisë që mban postin e komandantit të batalionit apo post më të lartë mund t’u japë njësive detyra të posaçme në lidhje me mbrojtjen dhe ruajtjen e popullatës civile dhe burimeve materiale [...] dhe t’i kontrollojë ato në zonën e tij të përgjegjësisë.¹⁹⁶³

757. Pavarësisht nga formulimi i qartë i kësaj dispozite, Millosh Mandiqi nuk pranoi se komandantët e brigadave kishin pushtet mbi njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile.¹⁹⁶⁴ Edhe

¹⁹⁵⁵ P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes në Prishtinë mbi zbatimin e masave për sigurinë dhe mbrojtjen e popullatës, 21 maj 1998).

¹⁹⁵⁶ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), nenet 61–63; 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 34; Sllobodan Kosovac, T. 15829–15830 (18 shtator 2007).

¹⁹⁵⁷ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 61; Lubinko Cvetiq, T. 8171 (8 dhjetor 2007); Vladimir Llazareviq, T. 17966 (9 nëntor 2007).

¹⁹⁵⁸ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 61; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 60–61, 63–65.

¹⁹⁵⁹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 392–393.

¹⁹⁶⁰ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 34–35.

¹⁹⁶¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 106–107.

¹⁹⁶² P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 63; P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 60–63.

¹⁹⁶³ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 63.

¹⁹⁶⁴ Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 8 janar 2008), para. 19.

Radinoviqi dëshmoi se lidhja midis komandantëve të ushtrisë dhe këtyre njësive ishte bashkëpunim dhe e shumta mbikëqyrje në lidhje me kryerjen e detyrave të tyre të posaçme, mirëpo në asnjë mënyrë lidhje varësie.¹⁹⁶⁵ Më pas, kur u përball me tekstin e dispozitës në fjalë, Radinoviqi e zbuti dëshminë e tij duke argumentuar se ai nuk kishte nënkuptuar se njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile mund të përdreshin nga një komandant i UJ-së jashtë funksioneve të tyre, por se atyre mund t'u jepej urdhër për kryerje vetëm të detyrave në lidhje me mbrojtjen e popullsisë dhe pronës materiale për përdorim civil.¹⁹⁶⁶ Rrjedhimisht, sipas tij, nuk kishte vënie të vetvetishme të njësive të mbrojtjes dhe ruajtjes civile nën varësinë e sistemit komandues të UJ-së, dhe ato nuk ishin pjesë e sistemit të njësuar të vendimmarrjes. Mirëpo ekzistojnë dëshmi për bashkëpunim të ngushtë. Sipas Radinoviqit, UJ-ja kishte kompetenca ligjore për përdorimin e njësive të mbrojtjes dhe ruajtjes civile deri në një masë të caktuar; këto forca vepronin në zona të njëjta me UJ-në dhe për këtë arsye sistemi komandues në terren i UJ-së mund të kishte ndikim në veprimet e këtyre grupeve.¹⁹⁶⁷

758. Llazareviqi dëshmoi se njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile ishin nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes por rikujtoi se nga mesi i bombardimeve të NATO-s në 1999, Korpusi i Prishtinës kërkoi ndihmë nga të dyja “për vendosjen e popullsisë dhe për të ndihmuar në çështje civile”.¹⁹⁶⁸ Në lidhje me këto urdhra, disa dëshmitarë theksuan se asnjëherë nuk u lëshua urdhër zyrtar për rivënie në varësi.¹⁹⁶⁹ Më 26 mars 1999, Komanda e Brigadës së Motorizuar 243 urdhëroi disa njësi të saj që të bashkërendonin veprimet me organet dhe njësitë e ruajtjes civile në zonën e përgjegjësisë së Brigadës, për të ndihmuar njëra-tjetrën dhe për angazhimin e kapaciteteve vendore.¹⁹⁷⁰

759. Radovan Radinoviqi iu referua urdhrin të datës 9 prill 1999 i cili i detyronte të gjitha njësitë organizative të Ministrisë Federale të Mbrojtjes në Serbi që urdhrat në lidhje me detyrat mbrojtëse t'i merrnin vetëm nga selia serbe e Ministrisë së Mbrojtjes.¹⁹⁷¹ Urdhri përcaktonte se, pavarësisht nga fakti që “organet e vetëqeverisjes vendore” në territorin e administratave të mbrojtjes bashkëpunonin me “njësitë organizative” të tyre, atyre nuk u lejohej të jepnin urdhra “në zonat e mbrojtjes brenda kompetencave të tyre”. Në urdhër më tej shkruhej se kërkesat e organeve të

¹⁹⁶⁵ Radovan Radinoviq, T. 17286 (19 tetor 2007).

¹⁹⁶⁶ Radovan Radinoviq, T. 17295 (19 tetor 2007). *Shih gjithashtu* 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 35.

¹⁹⁶⁷ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 134–135.

¹⁹⁶⁸ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 61–63; Vladimir Llazareviq, T. 17962 (8 nëntor 2007).

¹⁹⁶⁹ *Shih p.sh.* Bozhidar Deliq, T. 19673 (6 dhjetor 2007), Radojko Stefanoviq, T. 21652 (5 shkurt 2008), T. 21782 (6 shkurt 2008), Vladimir Llazareviq, T. 18730–18731 (21 nëntor 2007).

¹⁹⁷⁰ 5D1284 (Urdhër për Mbrojtje i Brigadës së Mekanizuar 243, 26 mars 1999), f. 12.

¹⁹⁷¹ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 135, i referohet P1339 (Urdhër i Ministrisë Federale të Mbrojtjes, 9 prill 1999).

vetëqeverisjes vendore “që ishin jashtë kompetencave” të administratës së mbrojtjes, duheshin refuzuar.¹⁹⁷²

760. Për më tepër, gjatë ditëve që vijuan menjëherë pas urdhrit të lartpërmendur të Ministrisë së Mbrojtjes, UJ-ja lëshoi dy dokumente, që kishin për qëllim vënien e njësive të mbrojtjes civile në varësinë e komandës së UJ-së.¹⁹⁷³ I pari ishte urdhri i Komandës së Armatës së Tretë i datës 10 prill 1999 i nënshkruar nga Pavkoviqi, në të cilin thuhej se “gjatë operacioneve, forcat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të mbrojtjes civile do të vihen nën komandën e Komandës së Armatës së Tretë”.¹⁹⁷⁴ Dokumenti i dytë u lëshua prej Shtabit të Komandës së Lartë dy ditë më pas si plotësim i një direktive të mëparshme, duke e ndryshuar nëpërmjet përfshirjes së një klauzole të ngjashme: “Gjatë operacionit, forcat e MPB-së dhe të mbrojtjes civile do të vihen nën komandën e Armatës së Tretë dhe do të veprojnë vetëm me vendimin tuaj.”¹⁹⁷⁵ Rrjedhimisht, e shumta që nga data 12 prill 1999, u bënë përpjekje për t’i vënë zyrtarisht njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile në varësinë e UJ-së. Fakti që në prill 1999 UJ-ja po përpiqej të zbatonte rivënien në varësi, tregon se kjo nuk ishte bërë më herët. Për më tepër, Dhoma nuk është e bindur se u provua se njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile në praktikë me të vërtetë u vunë në varësinë e UJ-së.¹⁹⁷⁶

761. Mbetet ende e hapur çështja më e gjerë e natyrës së ndërveprimit apo marrëdhënieve midis hierarkisë komanduese të UJ-së dhe asaj të Ministrisë së Mbrojtjes. Nga ana e tij Radinoviqi pohoi se çdo hierarki komanduese e pranishme në Kosovë në 1999, në parim dhe në praktikë vepronte në mënyrë autonome dhe të pavarur. Po ashtu, Jeliqi dëshmoi se ekzistonin dy hierarki komanduese paralele pa i ndërhyrë njëra-tjetrës. Nga ana tjetër, provat vënë në dukje se ka pasur përkim të pjesshëm midis dy hierarkive komanduese. Pa dyshim që ato bashkëpunonin ngushtë me njëra-tjetrën. Sipas Radinoviqit, UJ-ja kishte kompetenca ligjore për përdorimin e njësive të mbrojtjes dhe ruajtjes civile deri në një masë të caktuar; këto forca vepronin në zona të njëjta me UJ-në dhe për këtë arsye sistemi komandues në terren i UJ-së mund të kishte ndikim në veprimet e këtyre grupeve.¹⁹⁷⁷ Shembull të një bashkëpunimit të tillë përmendi Bozhidar Deliqi i cili pranoi se kishte takuar disa herë komandantin e njësisë së mbrojtjes civile meqë ata kishin përgjegjësi të përbashkët

¹⁹⁷² P1339 (Urdhër i Ministrisë së Mbrojtjes drejtuar administratave të mbrojtjes, 9 prill 1999).

¹⁹⁷³ 4D308 (Urdhër i Armatës së tretë për mbrojtje nga NATO, 10 prill 1999), f. 4; P1483 (Plotësues i Direktivës së 9 prillit 1999, 12 prill 1999), f. 2.

¹⁹⁷⁴ 4D308 (Urdhër i Armatës së tretë për mbrojtje nga NATO, 10 prill 1999), f. 4.

¹⁹⁷⁵ P1483 (Plotësues i Direktivës së 9 prillit 1999, 12 prill 1999), f. 2.

¹⁹⁷⁶ Bozhidar Deliq, T. 19292 (29 nëntor 2007); Dragan Zhivanoviq, T. 20485 (17 janar 2008).

¹⁹⁷⁷ 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 134–135.

për ruajtjen e disa objekteve në Prishtinë për “shmangien e keqkuptimeve apo incidenteve, hapjes së zjarrit kundër forcave të veta aksidentalisht dhe incidenteve të ngjashme.”¹⁹⁷⁸

762. Megjithatë, prova të tjera tregojnë lidhje më të ngushtë. Siç u përshkrua më lart, neni 63 i Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen u jepte komandantëve të UJ-së kompetenca ligjore për t’i përdorur njësitë e Ministrisë së Mbrojtjes në rrethana të caktuara. Duket se përfshirja e UJ-së në hierarkinë komanduese të Ministrisë së Mbrojtjes mbështetet nga dokumente që i referohen armatosjes dhe stërvitjes së popullatës serbe prej UJ-së, si për shembull urdhri i Armatës së Tretë në lidhje me përgatitjet organizative-teknike për pajisjen e rekrutëve me armë dhe municion i datës 26 qershor 1998. Ky urdhër u caktonte komandantëve të UJ-së detyrën e shpërndarjes së armëve fshatarëve dhe formimin dhe stërvitjen e njësive në vendbanime.¹⁹⁷⁹ Mirëpo dëshmitarë të tjerë dëshmuar se kjo kishte të bënte vetëm me rekrutë ushtarakë që ishin nën juridiksionin e UJ-së.¹⁹⁸⁰ Rrjedhimisht kjo provë nuk përbën bazë për të konkluduar se në praktikë UJ-ja ushtronte pushtet mbi këto njësi.

763. Dhoma konstaton se gjatë kohës që mbulon Aktakuza, njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile numëronin 6.000 njerëz të armatosur. Këto njësi kishin për detyrë të mbronin dhe ruanin popullatën civile dhe pronën materiale nga shkatërrimet e luftës dhe sulmet e qëllimshme. Ato u vunë nën varësinë dhe ishin pjesë e hierarkisë komanduese të Ministrisë Federale të Mbrojtjes. Roli i UJ-së në lidhje me këto njësi ishte vetëm për bashkëpunimin dhe mbikëqyrjen e kryerjes së detyrave të tyre. Mirëpo Dhoma gjithashtu nuk është e bindur se vënia e njësive të mbrojtjes dhe ruajtjes civile nën varësinë e UJ-së u zbatua në praktikë apo se hierarkitë komanduese të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të UJ-së, përkonin njëra me tjetrën ose u bashkuan gjatë konfliktit.

b. Popullata e armatosur joshqiptare

i. Përbërja

764. Dhoma dëgjoi dëshmi se deri në korrik 1998 UJ-ja dhe MPB-ja kishin armatosur mbi 54.000 qytetarë nga fshatrat dhe qytetet në Kosovë dhe se ky numër afërsisht deri në 60.000 njerëz

¹⁹⁷⁸ Bozhidar Deliqi, T. 19292 (29 nëntor 2007).

¹⁹⁷⁹ P1415 (Urdhër në lidhje me pajisjen e rekrutëve me armë dhe municione, 26 qershor 1998).

¹⁹⁸⁰ Radovan Radinović, T. 17308 (19 tetor 2007); Momir Stojanović, T. 20076 (7 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 30; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 518.

të armatosur.¹⁹⁸¹ Armët iu shpërndanë njerëzve të përkatësisë kombëtare joshqiptare (“serbë të armatosur”¹⁹⁸² në detyra të ndryshme.

765. Popullsia e armatosur serbe ishte e organizuar në njësi që njiheshin si Detashmente Policore Rezerviste ose Skuadra Policore Rezerviste (RPO) dhe përfshinin rezervistë të UJ-së dhe MPB-së të cilët nuk ishin të angazhuar në mënyrë aktive në njësitë e kohës së luftës.¹⁹⁸³ Detyra kryesore e këtyre njësive ishte mbrojtja e fshatrave dhe qyteteve të tyre.¹⁹⁸⁴ Në paketën e direktivave të quajtura Udhëzime për Mbrojtjen e Vendeve të Banuara, këto “njësi policore” përshkruhen si kryesisht njësi të MPB-së që bashkonin të gjitha forcat në zonat e banuara. Sipas udhëzimeve, shtabet e komandave të këtyre njësive duhej të përfshinin një përfaqësues të vetëqeverisjes vendore, një përfaqësues të UJ-së dhe një të MPB-së.¹⁹⁸⁵ Shtabi i komandës duhej të ishte i vendosur në postëkomandë. Mirëpo Bozhidar Filiqi dëshmoi se pjesëtarët e RPO-ve qëndronin nëpër shtëpitë e tyre.¹⁹⁸⁶ RPO-të kishin për detyrë të organizonin mbrojtjen dhe të mbronin shtëpitë e tyre në rast se fshati i tyre sulmohej nga UÇK-ja.¹⁹⁸⁷ Meqë RPO-të, ndër të tjerë, përbëheshin nga rezervistë të UJ-së dhe MPB-së, këta persona vazhdonin të ishin nën detyrimin kryesor të tyre, që t’i përgjigjeshin thirrjes për mobilizim të UJ-së dhe MPB-së.¹⁹⁸⁸ Gjatë këtij procesi gjyqësor u kundërshtua natyra detyruese e këtyre Udhëzimeve dhe nëse faktikisht MPB-ja i mori këto Udhëzime.¹⁹⁸⁹ Duke marrë parasysh dokumente të tjera që u referohen Udhëzimeve dhe dokumente të MPB-së që tregojnë përfshirjen e MPB-së në këto njësi vendore të mbrojtjes, siç thuhet më poshtë, Dhoma është e bindur se Udhëzimet ishin udhëzime zyrtare dhe u zbatuan në Kosovë.¹⁹⁹⁰

¹⁹⁸¹ P3121 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 7; P2803 (Raport i MPB-së në lidhje me vizitën në RPO-të rajonale), f. 6–7; P928 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 30 dhjetorin 1998), f. 9.

¹⁹⁸² *Shih p.sh.* P931 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 2 shkurt 1999), f. 23.

¹⁹⁸³ Miroslav Mijatović, T. 22343 (13 shkurt 2008); Bozhidar Filiq, T. 24013 (10 mars 2008). *Shih gjithashtu* P1114 (Raport i SPB-së së Mitrovicës dërguar Shtabit të MPB-së, 1 korrik 1998); P2804 (Telegram i Shtabit të MPB-së drejtuar komandantëve të njësive organizative të MPB-së në Kosovë, 10 korrik 1998).

¹⁹⁸⁴ P3121 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 7.

¹⁹⁸⁵ P2086 (Udhëzime për mbrojtjen e zonave të banuara lëshuar prej Komandës së Përbashkët, 1 korrik 1998), f. 7.

¹⁹⁸⁶ P2086 (Udhëzime për mbrojtjen e zonave të banuara lëshuar prej Komandës së Përbashkët, 1 korrik 1998), f. 7; Bozhidar Filiq, T. 24014 (10 mars 2008).

¹⁹⁸⁷ Bozhidar Filiq, T. 24014 (10 mars 2008).

¹⁹⁸⁸ Lubinko Cvetiq, T. 8051 (7 dhjetor 2006).

¹⁹⁸⁹ Milan Gjaković, T. 26416 (19 maj 2008), Dushko Adamović, T. 25111 (10 prill 2008).

¹⁹⁹⁰ P1063 (Fragmente nga udhëzimet për mbrojtjen e zonave të banuara, lëshuar prej Administratës së Mbrojtjes në Prishtinë, 28 korrik 1998); P1064 (Letra përcjellëse e udhëzimeve për mbrojtjen e zonave të banuara lëshuar prej Komandës së Përbashkët, 28 korrik 1998); P1065 (Urdhër/udhëzime në lidhje me mbrojtjen e zonave të banuara, lëshuar prej Administratës së Mbrojtjes në Prishtinë, 28 korrik 1998); P3121 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 7.

766. Rezervistët e UJ-së u organizuan dhe armatosën në kuadër të këtyre njësive të mbrojtjes së fshatit apo RPO në përputhje me urdhrin e Korpusit të Prishtinës të datës 26 qershor 1998.¹⁹⁹¹ Në shkurt 1999, në mbledhjen e kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Samarxhiqi sqaroi se këta serbë ishin armatosur dhe organizuar për të mbrojtur fshatrat vendore, se “komandantë” të armatosur ishin dërguar në fshatrat e tyre me municione dhe se, përveç detyrës së tyre kryesore – mbrojtja e fshatrave të tyre në kuadër të RPO-ve – ata do të merrnin pjesë së bashku me njësitë e UJ-së në çdo operacion që do të kryhej në afërsi të zonave të tyre.¹⁹⁹² Ndonëse ata që kishin detyra të kohës së luftës në UJ, MPB dhe në mbrojtjen dhe ruajtjen civile ishin pajisur me armë përmes njësive të tyre të kohës së luftës dhe ktheheshin nëpër fshatrat e tyre atëherë kur nuk ishin në detyrë, qytetarët që nuk kishin detyra të caktuara për kohë luftime u furnizuan me armë bazuar në urdhrin e Ministrisë së Mbrojtjes të datës 21 maj 1998.¹⁹⁹³ Kombinimi i këtyre përpjekjeve mundësoi që deri në fillimin e bombardimeve të NATO-s në mars 1999 të armatosej pothuajse çdo mashkull i aftë për ushtri, me origjinë joshqiptare dhe që jetonte në Kosovë.¹⁹⁹⁴

767. RPO-të ishin të organizuara në bazë të parimit ushtarak, do të thotë që kishin komandant ose drejtues të skuadrës dhe numrin e nevojshëm të pjesëtarëve.¹⁹⁹⁵ Sipas procesverbalit të mbledhjes së Shtabit të MPB-së të mbajtur në maj 1999, pjesëtarëve të RPO-ve nuk u lejohej të mbanin uniforma të policisë apo ushtrisë, në rast se nuk ishin mobilizuar në njësi rezerviste të UJ-së ose MPB-së.¹⁹⁹⁶ Për më tepër, Cvetiqi dëshmoi se në atë kohë përgjithësisht nuk kishte uniforma të mjaftueshme. Megjithatë, pjesëtarët e RPO-ve kishin pajisjet bazë të një ushtari, si kapelën, xhaketën dhe rripin.¹⁹⁹⁷

768. Me fillimin e mobilizimit në mars 1999, pjesa më e madhe e RPO-ve u shpërndanë meqë pjesëtarët e tyre iu bashkuan ose forcave rezerviste të MPB-së, ose atyre të UJ-së, në përputhje me detyrat e tyre të kohës së luftës.¹⁹⁹⁸ Megjithatë, ka dëshmi se disa nga këto njësi vazhduan të vepronin në territorin e Kosovës gjatë gjithë kohës së bombardimeve të NATO-s, dhe se ato përbëheshin nga serbë të armatosur që nuk kishin marrë thirrje për t’iu bashkuar njësive të kohës së

¹⁹⁹¹ P1415 (Urdhër në lidhje me pajisjen e rekrutëve me armë dhe municione, 26 qershor 1998), f. 1–2; Lubinko Cvetiq, T. 8055, 8091 (7 dhjetor 2006). *Shih gjithashtu* P1114 (Raport i SPB-së së Mitrovicës dërguar Shtabit të MPB-së, 1 korrik 1998); P1115 (Listë e armëve dhënë prej UJ-së njësive rezerviste të MPB-së sipas komunave, 30 korrik 1998).

¹⁹⁹² P931 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 2 shkurt 1999), f. 23.

¹⁹⁹³ P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes në Prishtinë, 21 maj 1998), f. 1–2; Bozhidar Filiq, T. 24013 (10 mars 2008); Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26748–26749 (9 korrik 2008).

¹⁹⁹⁴ Lubinko Cvetiq, T. 8090 (7 dhjetor 2006); Adnan Merovci, T. 8439 (16 janar 2007).

¹⁹⁹⁵ Lubinko Cvetiq, T. 8051 (7 dhjetor 2006).

¹⁹⁹⁶ P1993 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999), f. 8–9; P1996 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 12.

¹⁹⁹⁷ Lubinko Cvetiq, T. 8051–8053 (7 dhjetor 2006).

luftës.¹⁹⁹⁹ Për më tepër, nga janari e deri në maj 1999, në disa urdhra luftarake përmendej “popullata e armatosur joshqiptare”. Detyrat e caktuara për këtë grup në këto urdhra përfshinin përforsimin dhe dhënien ndihmë forcave të UJ-së dhe MPB-së dhe sigurimin dhe mbrojtjen e objekteve civile dhe ushtarake.²⁰⁰⁰

769. Disa komandantë të UJ-së që u paraqitën si dëshmitarë, deklaruan se “forca” apo “njësia” e quajtur “popullatë e armatosur joshqiptare” nuk ekzistonte në zonat që kontrollonin ata. Disa prej tyre dëshmuar se, ndonëse mund të kishte pasur operacione në të cilat të ishte përfshirë popullata e armatosur joshqiptare,²⁰⁰¹ e cila zyrtarisht nuk ishte pjesë e ndonjë grupi të organizuar, ata vetë ose nuk kishin hasur në “forca” të tilla,²⁰⁰² ose forca të tilla nuk ishin pjesë e njësive të tyre.²⁰⁰³ Dëshmitarë të tjerë dëshmuar se nuk e kishin dëgjuar këtë term dhe se nuk kishin dijeni për plane që përfshinin “popullatën e armatosur joshqiptare.”²⁰⁰⁴

770. Dhoma i hedh poshtë këto mohime. Në urdhrat e Komandës së Përbashkët dhe të UJ-së ka referenca të qarta për këtë grup, siç ka edhe në dokumentet e RFJ-së/Serbisë dhe në deklaratat e drejtuesve ushtarakë dhe policorë të përmendur më lartë. Dhoma vë në dukje se që në tezën e diplomës të shkruar në vitin 1997 në temën si të shtypet kryengritja në Kosovë, Bozhidar Deliqi, i cili më pas u bë komandant i Brigadës së 549-të të Motorizuar, kishte propozuar që në rast të kryengritjes, “popullata e armatosur serbe dhe malazeze” duhet të bashkëpunojnë ngushtë me forcat e tjera mbrojtëse në terren dhe madje të vihen nën komandën e njësive përgjegjëse të UJ-së.²⁰⁰⁵ Disa herë gjatë dëshmisë së tij, Deliqi u përpoq ta distancoje veten nga argumentet dhe të dhënat e paraqitura në tezë dhe pohoi se nuk pasqyrore realitetin në Kosovë në vitet 1998 dhe 1999.²⁰⁰⁶ Mirëpo përkimet midis formulimeve të paraqitura në tezën e Deliqit dhe, midis tjerash, udhëzimeve

¹⁹⁹⁸ Nebojsa Bogunović, T. 25123–25124 (10 prill 2008), 6D1614 (deklaratë dëshmitari e datës 6 prill 2008), para. 21; Miroslav Mijatović, T. 22528 (15 shkurt 2008); Bozhidar Filiq, T. 24019–24021 (10 mars 2008); Millosh Vojnoviq, T. 24162–24165 (12 mars 2008).

¹⁹⁹⁹ Bozhidar Filiq, T. 24019–24021 (10 mars 2008); Millosh Vojnoviq, T. 24162–24163 (12 mars 2008); 6D802 (Përfundimet nga Mbledhja e Shtabit të MPB-së e datës 7 dhe 11 maj 1999), para. 19.

²⁰⁰⁰ *Shih p.sh.* 5D245 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë në lidhje me *Grom*, 27 janar 1999), f. 5; P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999), f. 2; P2808 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 shkurt 1999), f. 4; P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 2; P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 1; P1976 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 Prill 1999), p. 2; P2014 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 25 maj 1999), f. 3; P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999), f. 2; 4D332 (Urdhër për Parandalimin e Hyrjes me Forcë të një Brigadë të NATO-s, 27 janar 1999), f. 5; 5D175 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 6 prill 1999), f. 3; 5D1284 (Urdhër i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 26 mars 1999), f. 2.

²⁰⁰¹ Gjorgje Qurçin, T. 17031–17032 (16 tetor 2007).

²⁰⁰² Lubomir Saviq, T. 21006 (24 janar 2008); Bozhidar Deliq, T. 19673 (6 dhjetor 2007).

²⁰⁰³ Millosh Mandiq, T. 20933–20935 (24 janar 2008).

²⁰⁰⁴ Zllatomir Peshiq, T. 7190 (23 nëntor 2006); Mihajlo Gergar, T. 21531 (1 shkurt 2008); Dushko Adamović, T. 25108 (10 prill 2008).

²⁰⁰⁵ P1893 (Teza e Diplomës së Bozhidar Deliqit, “Përgatitja dhe Angazhimi i Forcave Mbrojtëse të RFJ-së për Parandalimin dhe Shtypjen e Kryengritjes së Armatosur në Kosovë dhe Metohi”, 1997), f. 43–44.

²⁰⁰⁶ Bozhidar Deliq, T. 19536 (5 dhjetor 2007), T. 19654 (6 dhjetor 2007).

për formimin e këtyre njësive vendore të mbrojtjes,²⁰⁰⁷ referencat e mëpasme për formimin e këtyre njësive,²⁰⁰⁸ dhe urdhrat për angazhimin e tyre në operacione,²⁰⁰⁹ tregojnë se në këtë drejtim teza e tij jep një pasqyrim jashtëzakonisht përputhës të situatës që u zhvillua më pas. Në të vërtetë, mohimi kategorik prej tij i disa pjesëve të rëndësishme të studimit të tij akademik, i cili u përgatit në një shkollë me procedurë jashtëzakonisht të vështirë pranimit,²⁰¹⁰ minon besueshmërinë e tij në lidhje me këtë çështje. Rrjedhimisht, Dhoma e gjykon jobindës argumentin se popullata e armatosur joshqiptare nuk ishte pjesë e ndonjë grupi të organizuar.

771. Nga ana tjetër, disa dëshmitarë të Mbrojtjes sugjeruan se fraza “popullata e armatosur joshqiptare” në fakt ishte referencë e pavend për njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile në urdhrat e komandës eprorë, referencë kjo që më pas në mënyrë të pamenduar u kopjua në urdhra të tjerë.²⁰¹¹

772. Pretendimi se kjo referencë është thjesht gabim administrativ dhe se në të vërtetë do të thoshte njësi të mbrojtjes dhe ruajtjes civile patjetër, duhet të hidhet poshtë. Dokumente të ndryshme zyrtare vënë në dukje se, ndonëse pjesëtarët e njësive të mbrojtjes dhe ruajtjes civile luajtën rol në RPO-të, ato mbetën strukturë e veçantë.²⁰¹² Për më tepër, eksperti ushtarak Radovan Radinoviç tha qartë se këto ishin struktura të ndryshme.²⁰¹³ Në mënyrë të ngjashme, në tezën e Deliqit bëhet dallim i qartë midis popullatës së armatosur joshqiptare dhe njësive të mbrojtjes dhe ruajtjes civile dhe këto dy struktura trajtohen në dy kapituj të ndarë.²⁰¹⁴ Së fundi, numri i armëve që iu shpërndanë pjesëtarëve të njësive të mbrojtjes dhe ruajtjes civile (rreth 6.000)²⁰¹⁵ është dukshëm më i vogël se numri i armëve që iu shpërndanë popullatës së armatosur joshqiptare në tërësi (rreth 57.000),²⁰¹⁶ siç diskutohet më poshtë.

²⁰⁰⁷ P2086 (Udhëzime për mbrojtjen e zonave të banuara lëshuar prej Komandës së Përbashkët, 1 korrik 1998), f. 7.

²⁰⁰⁸ *Shih p.sh.* P3121 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 7; P928 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 30 dhjetor 1998), f. 9; P2803 (Raport i MPB-së në lidhje me vizitën në RPO-të rajonale), f. 6–7; Bozhidar Filij, T. 24019–24021 (10 mars 2008).

²⁰⁰⁹ *Shih p.sh.*, 5D245 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë në lidhje me *Grom* 3, 27 janar 1999), f. 5; P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999), f. 2.

²⁰¹⁰ *Shih* Bozhidar Deliq, T. 19516 (5 dhjetor 2007).

²⁰¹¹ *Shih p.sh.* Branko Kërça, T. 16875 (4 tetor 2007), Gjorgje Qurçin, T. 17034 (16 tetor 2007), Vladimir Llazareviç, T. 18424 (16 nëntor 2007); Kërsman Jelij, T. 19070 (26 nëntor 2007); Radojko Stefanoviç, T. 21783 (6 shkurt 2008). *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 156–168.

²⁰¹² P1259 (Urdhër i Administratës së Mbrojtjes në Prishtinë, 21 maj 1998); 5D1284 (Urdhër i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 6 shkurt 2008), f. 1–2, 12.

²⁰¹³ Radovan Radinoviç, T. 17269–17270 (18 tetor 2007).

²⁰¹⁴ P1893 (Teza e Diplomës së Bozhidar Deliqit, “Përgatitja dhe Angazhimi i Forcave Mbrojtëse të RFJ-së për Parandalimin dhe Shtypjen e Kryengritjes së Armatosur në Kosovë dhe Metohi”, 1997), f. 20–21 dhe 41–44;

²⁰¹⁵ *Shih, p.sh.*, P1060 (Letër nga Administrata e Mbrojtjes së Prishtinës dërguar Sektorit për mbrojtjen civile, 2 nëntor 1998); Geza Farkash, T. 16379–16380 (25 shtator 2007); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 34–35.

²⁰¹⁶ *Shih gjithashtu, p.sh.*, P3121 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 7; P928 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së i datës 30 dhjetor 1998), f. 9; P2803 (Raport i MPB-së në lidhje me vizitën në RPO-të rajonale), f. 6–7.

773. Për sa i përket cilësimit etnik “joshqiptar”, i vetmi shpjegim që u ofrua ishte ai i Kërsman Jeliqit i cili tha se kjo ishte e domosdoshme meqë “kur terrorizmi u shfaq në Kosovë”, në dallim nga grupet e tjera etnike joshqiptare, shqiptarët kosovarë nuk iu përgjigjën thirrjes për mobilizim.²⁰¹⁷ Çështja e armatimit të popullatës joshqiptare mbi bazë etnike diskutohet më poshtë në Pjesën B të Kapitullit VII. Në këtë pjesë gjithashtu trajtohen përpjekjet në vitin 1998 për ngritjen e njësive vendore të sigurisë të përbëra vetëm nga shqiptarë. Megjithatë këto njësi shqiptare të sigurisë për aq sa u krijuan, ishin të veçanta dhe dallonin prej popullatës së armatosur joshqiptare.²⁰¹⁸

774. Dhoma konstaton se “popullata e armatosur joshqiptare” ishte kategori plotësuese që do të angazhonte joshqiptarë të armatosur të cilët nuk ishin të organizuar në njësi të kohës së luftës të UJ-së apo MPB-së.²⁰¹⁹ Gjatë gjithë konfliktit, popullata e armatosur joshqiptare në Kosovë mbeti e organizuar në RPO-të, të cilat ndonjëherë quheshin njësi vendore të mbrojtjes. Kjo përputhet me dëshmitë përsëritëse të disa dëshmitarëve se joshqiptarët e armatosur nuk u përfshinë në njësitë zyrtare të UJ-së apo MPB-së si luftëtarë, por se detyra e vetme e tyre ishte të mbronin zonat e banuara dhe objektet, ose me fjalë të tjera, “të mbronin vetveten”.²⁰²⁰ Sigurisht që kjo është e ngjashme me detyrat kryesore që u atribuohen RPO-ve apo njësive vendore të mbrojtjes.

775. Numri i përgjithshëm i popullatës së armatosur joshqiptare ishte rreth 60.000. Në mbledhjen e Shtabit të MPB-së, më 28 korrik 1998, zyrtari i MPB-së përgjegjës për organizimin dhe funksionimin e RPO-ve në Kosovë, Bllagoje Peshiq, raportoi se në Kosovë ishin formuar 243 RPO dhe se 54.683 qytetarë që ishin pjesëtarë të RPO-ve ishin pajisur me armë. Ai shtoi se deri në fund të procesit të shpërndarjes së armëve pritej të armatoseshin rreth 60.000 njerëz.²⁰²¹ Gjysmë viti më pas, Aleksandar Dimitrijeviq i sugjeroi Ojdaniqit se numri i serbëve të armatosur që mund të mobilizoheshin jashtë kontrollit të organeve zyrtare kishte arritur në 60.000.²⁰²² Disa javë më pas, më 16 shkurt 1999, në mbledhjen e Shtabit të MPB-së u raportua se pjesëtarëve të këtyre RPO-ve u ishin shpërndarë 64.080 armë.²⁰²³ Ky vlerësim gjithashtu përputhet me atë të Deliqit se, përfshirë

²⁰¹⁷ Kërsman Jeliq, T. 19073–19074 (26 nëntor 2007).

²⁰¹⁸ Zoran Angjalkoviq, T. 14658–14659 (30 gusht 2007).

²⁰¹⁹ Lubinko Cvetiq, T. 8089–8090 (7 dhjetor 2006); Radovan Vuçureviq, T. 23184 (25 shkurt 2008); P2803 (Raport i MPB-së në lidhje me vizitën në RPO-të rajonale) f. 5–6 (raporton mbi rastet e shpeshta kur qytetarët nuk i përgjigjën thirrjes për të kryer detyrat e RPO-së).

²⁰²⁰ Radovan Radinoviq, T. 17288 (19 tetor 2007); Bozhidar Deliq, T. 19531, 19535 (5 dhjetor 2007); Radomir Mlladenoviq, T. 21295–21296 (29 janar 2008); Dragan Zhivanoviq, T. 20560–20561 (18 janar 2008).

²⁰²¹ P3121 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 7.

²⁰²² P928 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 30 dhjetorin 1998), f. 9.

²⁰²³ P2803 (Raport i MPB-së në lidhje me vizitën në RPO-të rajonale, f. 6–7; *shih gjithashtu* P931 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 2 shkurtin 1999), f. 23 (ku Samarxhiqi vlerëson se numri i personave të dërguar nëpër shtëpitë e tyre për të marrë pjesë në mbrojtjen e fshatrave të tyre është 47.000); Momçillo

forcat nga viset e tjera të RFJ-së, forcat mbrojtëse në Kosovë ishin të afta të vinin në veprim 92.500 - 98.500 njerëz për të luftuar kryengritjen e armatosur.²⁰²⁴

776. Provat tregojnë se gjatë fillimit të 1999, pjesa më e madhe e rezervistëve të UJ-së dhe MPB-së u mobilizuan për detyrat e tyre të kohës së luftës.²⁰²⁵ Si rezultat, deri në mars 1999 kishte rreth 6.000 pjesëtarë të RPO-ve.²⁰²⁶ Kjo përputhet me vlerësimin e dëshmitarit ekspert Radovan Radinoviç se bazuar në potencialin demografik të Kosovës, numri i pjesëtarëve të armatosur të popullsisë jashtë strukturave zyrtare të personelit të mobilizuar të UJ-së, MPB-së dhe mbrojtjes dhe ruajtjes civile nuk mund të ketë qenë më shumë se 4.000 - 6.000 vetë.²⁰²⁷

ii. Struktura komanduese

777. MPB-ja emëronte komandantët e RPO-ve dhe vazhdoi të kishte kompetenca të përgjithshme komanduese mbi to.²⁰²⁸ Komandantët e RPO-ve i dorëzonin raport komandantit të stacionit policor që mbulonte fshatin përkatës. Më pas, komandanti i stacionit përkatës të policisë u jepte komandantëve të RPO-ve udhëzime për kryerjen e detyrave. Vendimet për veprimtarinë e RPO-ve i merrte komanda e MPB-së në Beograd, Shtabi i MPB-së në Prishtinë, SPB-të, DPB-të ose stacionet policore, varësisht nga situata e sigurisë.²⁰²⁹ Cvetiqi pohoi se në praktikë, kur duhej kryer ndonjë detyrë, komandanti i policisë së rregullt hartonte planin e misionit dhe u jepte detyra të caktuara RPO-ve përkatëse me të cilat ai mbante kontakte.²⁰³⁰

778. Ndonëse këto njësi ishin kryesisht të organizuara dhe drejtuara nga MPB-ja, edhe UJ-ja luajti rol në komandimin e tyre. Në pjesën “Komandimi”, Udhëzimet për Mbrojtjen e Vendeve të Banuara përcaktojnë se përfaqësuesi i UJ-së duhet të jetë pjesë e shtabit që organizon njësitë mbrojtëse vendore.²⁰³¹ Në Mitrovicë, një rezervist i UJ-së emërohej ndihmëskomandant në pothuajse të gjitha RPO-të e ngritura nga MPB-ja.²⁰³² Për më tepër, Momir Stojanoviç dëshmoi se UJ-ja vazhdoi të ushtronte kontroll deri në prill 1999 mbi njësitë të cilat më herët i kishte

Stojanoviç, T. 20073 (12 dhjetor 2007), (i cili vlerëson se numri i serbëve të kthyer nga UJ-ja për të mbrojtur fshatrat e tyre është rreth 40.000).

²⁰²⁴ P1893 (Teza e Diplomës së Bozhidar Deliqit, “Përgatitja dhe Angazhimi i Forcave Mbrojtëse të RFJ-së për Parandalimin dhe Shtypjen e Kryengritjes së Armatosur në Kosovë dhe Metohi”, 1997), f. 21.

²⁰²⁵ Nebojsa Bogunoviç, T. 25123–25124 (10 prill 2008), 6D1614 (deklaratë dëshmitari e datës 6 prill 2008), para. 21; Miroslav Mijatoviç, T. 22528 (15 shkurt 2008); Bozhidar Filiq, T. 24019–24021 (10 mars 2008); Millosh Vojnoviç, T. 24162–24165 (12 mars 2008).

²⁰²⁶ Lubinko Cvetiq, T. 8050 (7 dhjetor 2006).

²⁰²⁷ Radovan Radinoviç, T. 17270 (18 tetor 2007), T. 17275 (19 tetor 2007).

²⁰²⁸ Lubinko Cvetiq, T. 8050–8053 (7 dhjetor 2006); Tomislav Mitiq, 5D1390 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 32; P1114 (Raport i SPB-së së Mitrovicës dorëzuar Shtabit të MPB-së, 1 korrik 1998).

²⁰²⁹ Lubinko Cvetiq, T. 8052–8053 (7 dhjetor 2006).

²⁰³⁰ Lubinko Cvetiq, T. 8090–8091 (7 dhjetor 2006).

²⁰³¹ P2086 (Udhëzime për mbrojtjen e zonave të banuara, lëshuar nga Komanda e Përbashkët, 1 korrik 1998), f. 7.

armatosur.²⁰³³ Po ashtu Gjorgje Qurçini dhe Mihajllo Gergari dëshmuar se në disa raste të veçanta, komandantët e ushtrisë mund t'u jepnin “joshqiptarëve të armatosur” detyra konkrete, por thanë se kjo ishte e mundur vetëm për sa i përket kryerjes së operacioneve konkrete në kuadër të rolit dhe mundësive të tyre, si për shembull sigurimi i disa zonave, objekteve dhe/ose rrugëve.²⁰³⁴

779. Në tezën e tij që u botua para formimit të këtyre njësive, Deliqi kishte propozuar që në kuadrin e “shtypjes së kryengritjes”, popullata e armatosur do të vihej nën komandën e drejtpërdrejtë të komandës përkatëse ushtarake territoriale ose të njësisë së UJ-së në zonën e të cilës ajo ndodhej.²⁰³⁵ UJ-ja gjithashtu ndikoi në formimin e njësive të popullatës së armatosur joshqiptare, siç konfirmohet në deklaratën e Samarxhiqit të shkurtit 1999 se, për sa i përket armatosjes së joshqiptarëve, “ishte urdhri im dhe ne e organizuam të gjithë këtë”.²⁰³⁶ Para fillimit të konfliktit, UJ-ja gjithashtu mori pjesë në caktimin e posteve të kohës së luftës për rezervistët e UJ-së dhe MPB-së që ishin në këto RPO, përmes Qarqeve Ushtarake.²⁰³⁷ Në fakt, në korrik të 1998, komandanti i Qarkut Ushtarak të Prishtinës qortoi Llukiqin për shkelje kompetencash duke caktuar pjesëtarë të RPO-ve në radhët e MPB-së, pavarësisht nga fakti se ata më parë ishin caktuar me detyrë në struktura të tjera të mbrojtjes.²⁰³⁸

780. Siç u tha më lart, në shumë urdhra luftarakë të UJ-së përmendet se “popullata e armatosur joshqiptare” do të “angazhohej” nga Korpusi i Prishtinës në kryerjen e operacioneve ushtarake në terren. Këto urdhra u japin këtyre formacioneve detyra konkrete: kryesisht përforcimin dhe dhënien ndihmë forcave të UJ-së dhe MPB-së në “shtypjen dhe shkatërrimin e forcave terroriste”, sigurimin e objekteve ushtarake dhe rrugëve dhe mbrojtjen e zonave të banuara me joshqiptarë.²⁰³⁹

781. Shembull i urdhrimit të UJ-së në të cilin përmendet “popullata e armatosur joshqiptare” është ai i komandantit të Brigadës së 243-të të Mekanizuar i datës 26 mars 1999, në të cilin Brigada

²⁰³² P1114 (Raport i SPB-së së Mitrovicës dorëzuar Shtabit të MPB-së, 1 korrik 1998).

²⁰³³ Momir Stojanović, T. 20073–20076 (12 dhjetor 2007) (flet për P1415 (Urdhër lidhur me pajisjen e rekrutëve me armë dhe municione, 26 qershor 1998).

²⁰³⁴ Gjorgje Qurçin, T. 17042 (16 tetor 2007); Mihajllo Gergar, T. 21532 (1 shkurt 2008).

²⁰³⁵ P1893 (Teza e Disertacionit e Bozhidar Deliqit, “Përgatitja dhe Angazhimi i Forcave Mbrojtëse të RFJ-së për Parandalimin dhe Shtypjen e Kryengritjes së Armatosur në Kosovë dhe Metohi, 1997), f. 43.

²⁰³⁶ P931 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 2 shkurtin 1999), f. 23.

²⁰³⁷ K25, T. 4678–4679 (11 tetor 2006); Zllatomir Peshiq, T. 7151, 7168 (22 nëntor 2006)

²⁰³⁸ 4D521 (Komanda e Qarkut Ushtarak të Prishtinës, Kol. Saviq drejtuar SPB-së së Prishtinës, Sreten Llukiqit, lidhur me paralajmërimin për dërgimin e rekrutëve në detyra luftarake në MPB pa pëlqimin e Qarkut Ushtarak Territorial).

²⁰³⁹ *Shih p.sh.* 5D245 (Urdhër i Komandës së Armatës së Tretë lidhur me *Grom* 3, 27 janar 1999), f. 5; P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999), f. 2; P2808 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 shkurt 1999), f. 4; P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 2; P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 1; P1976 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 2; P2014 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 25 maj 1999), f. 3; P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999), f. 2; 4D332 (Urdhër për Parandalimin e Hyrjes me Forcë të një Brigade të NATO-s, 27 janar 1999), f. 5; 5D175 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 6 prill 1999), f. 3; 5D1284 (Urdhër i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 26 mars 1999), f. 2.

udhëzohet që të “parandalojë sulmet e forcave të NATO-s” “me anë të veprimeve të bashkërenduara të brigadës së 175-të të këmbësisë, brigadës së 549-të të motorizuar dhe popullatës së armatosur joshqiptare”.²⁰⁴⁰ Dhoma nuk pranon argumentin se referencat e shumta duhet t’u atribuohen gabimeve administrative ose kopjimit të pakujdesshëm.

782. Disa dëshmitarë të Mbrojtjes vunë në dukje se referencat për “popullatën e armatosur joshqiptare” në urdhrat ushtarakë bëheshin gjithmonë në pjesën “Detyra”, dhe asnjëherë në pjesën “Detyrat e njësisë”. Sipas këtyre dëshmitarëve, vetëm “detyrat e njësisë” jepeshin nga komandantët që i lëshonin urdhrat, kurse pjesa e titulluar “Detyrat” thjesht kopjohej nga teksti i urdhrave që vinin nga komandat eprore. Rrjedhimisht, meqë në pjesën “Detyrat e njësisë” nuk kishte referenca për “popullatën e armatosur joshqiptare”, kjo do të thoshte se komandantët në terren nuk u caktonin detyra grupeve të tilla.²⁰⁴¹

783. Dëshmitari ekspert Radinoviç argumentoi se qëllimi i përfshirjes së referencës “popullata e armatosur joshqiptare” në pjesën “Detyrat” ishte thjesht për t’i vënë në dijeni komandantët e UJ-së se në zonat e tyre të përgjegjësisë kishte individë të tillë të armatosur.²⁰⁴² Radinoviç gjithashtu pohoi se Ministria Federale e Mbrojtjes kishte kompetenca komanduese mbi “popullatën e armatosur joshqiptare”, me përjashtim të rastit kur kishte urdhër për vënien e saj nën varësinë e UJ-së.²⁰⁴³

784. Në dallim nga njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile të diskutuara më lart,²⁰⁴⁴ provat nuk tregojnë ekzistencën e ndonjë urdhri të UJ-së për vënie në varësi në lidhje me “popullatën e armatosur joshqiptare”.²⁰⁴⁵ Dhoma është e mendimit se roli i UJ-në në ngritjen dhe armatosjen e këtyre njësive, dhe përfaqësimi i saj në strukturat e tyre komanduese, shpjegon arsyen pse UJ-ja nuk lëshoi urdhra për vënie në varësi, ndërkohë që përpiqej t’i vinte në varësi njësitë e mbrojtjes dhe ruajtjes civile.

785. Prokuroria argumenton se mungesa e urdhrave me shkrim sugjeron se komandantët në terren i jepnin “popullatës së armatosur joshqiptare” udhëzime gojore.²⁰⁴⁶ Ndonëse urdhrat gojore

²⁰⁴⁰ 5D1284 (Urdhër i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, 26 mars 1999), f. 1–2 (me theks të shtuar).

²⁰⁴¹ Vladimir Llazareviç, T. 17907–17908 (8 nëntor 2007); Bozhidar Deliq, T. 19535 (5 dhjetor 2007); Radojko Stefanoviç, T. 21778–21779 (6 shkurt 2008); Lubomir Saviç, T. 21006–21007 (24 janar 2008).

²⁰⁴² Radovan Radinoviç, T. 17282 (19 tetor 2007); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), f. 36. *Shih gjithashtu* Vladimir Llazareviç, T. 18730–18731 (22 nëntor 2007); Bozhidar Deliq, T. 19653, 19673 (6 dhjetor 2007).

²⁰⁴³ Radovan Radinoviç, T. 17282–17283 (19 tetor 2007); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), para. 77.

²⁰⁴⁴ 4D308 (Urdhër i Armatës së Tretë për mbrojtjen nga NATO, 10 prill 1999), f. 4; P1483 (Shtojcë e Urdhrit të 9 prillit 1999, 12 prill 1999), f. 2.

²⁰⁴⁵ *Shih* Vladimir Llazareviç, T. 18730 (21 nëntor 2007); Radojko Stefanoviç, T. 21652 (5 shkurt 2008), T. 21781 (6 shkurt 2008), T. 21833 (7 shkurt 2008); Millosh Mandiq, T. 20931 (24 janar 2008).

²⁰⁴⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 126.

lejoheshin në UJ gjatë kryerjes së operacioneve në terren,²⁰⁴⁷ në këtë çështje nuk u paraqitën prova konkrete që të tregonin se, bazuar në urdhrat me shkrim të Komandës së Përbashkët, popullatës së armatosur joshqiptare iu dhanë urdhra gojore Megjithatë, urdhrat e Komandës së Përbashkët përcaktonin detyra për këto njësi, si sigurimi i objekteve ushtarake dhe rrugëve dhe mbrojtja e vendeve me popullatë joshqiptare.²⁰⁴⁸ Kjo përputhet me dëshmitë e lartpërmendura se UJ-ja mund t'u jepte detyra joshqiptarëve të armatosur brenda kompetencave dhe rolit të tyre.²⁰⁴⁹

786. Sipas ish-kryetarit të komunës së Suharekës, Halit Berisha, pjesëtarët e RPO-ve që ishin kthyer nëpër fshatrat e tyre por që mbanin uniforma të UJ-së dhe MPB-së, vazhduan të ishin vartës të këtyre hierarkive komanduese.²⁰⁵⁰ Zllatomir Peshiqi dëshmoi se në rast se zbulohet se personat mbanin pjesë të uniformës ushtarake apo policore gjatë kohës që ishin të armatosur, policia apo ushtria mund të merrte masa kundër tyre.²⁰⁵¹ Gjithashtu, Nikë Peraj pranoi se në disa raste kur zbuloi se rezervistë të UJ-së kishin kryer krime të rënda, UJ-ja mori masa ndëshkuese kundër tyre, pavarësisht se ata kishin vepruar jashtë hierarkisë komanduese.²⁰⁵²

787. Dhoma konstaton se midis korrikut 1998 dhe marsit 1999, popullata joshqiptare në Kosovë u armatos dhe organizua në kuadër të të ashtuquajturave RPO apo njësi mbrojtëse vendore, të cilat numëronin rreth 60.000 vetë. Këto njësi ishin nën komandën dhe kontrollin e përgjithshëm të MPB-së, e cila ishte përgjegjëse kryesisht për ngritjen dhe organizimin e tyre. MPB-ja, UJ-ja dhe Ministria e Mbrojtjes ruajtën kompetencat për të mobilizuar rezervistët nga radhët e RPO-ve të cilët kishin detyra në kohë lufte të caktuara në njësitë e tyre përkatëse. Për më tepër, roli i UJ-së në komandimin dhe kontrollimin e RPO-ve parashikonte edhe praninë e përfaqësuesve të UJ-së në shtabin për organizimin e RPO-ve.

788. Dhoma më tej konstaton se deri në mars 1999, pjesa më e madhe e pjesëtarëve të RPO-ve iu përgjigjën mobilizimit dhe iu bashkuan MPB-së ose UJ-së, duke ulur kështu numrin e joshqiptarëve të armatosur pa detyra luftarake në Kosovë në rreth 6.000. Gjatë konfliktit, roli i UJ-së në komandimin dhe kontrollimin e këtyre individëve përfshinte angazhimin e tyre në kryerjen e detyrave, përfshirë detyrat në kohë lufte, në zonat e përgjegjësisë së komandantëve përkatës të UJ-së.

²⁰⁴⁷ Goran Jevtović, T. 20360 (16 janar 2008); Vllatko Vuković, T. 21340 (29 janar 2008).

²⁰⁴⁸ *Shih p.sh.*, P2808 (Urdhër i Korpusit të Prishtinës, 16 shkurt 1999), f. 4; P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 2; P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 2.

²⁰⁴⁹ Gjorgje Qurçin, T. 17942 (16 tetor 2007); Mihajlo Gergar, T. 21532 (1 shkurt 2008).

²⁰⁵⁰ Halit Berisha, T. 3653–3655 (20 shtator 2006).

²⁰⁵¹ Zllatomir Peshiq, T. 7316 (24 nëntor 2006).

²⁰⁵² Nikë Peraj, P2253 (deklaratë dëshmitari e datave 8 dhe 9 gusht 2006), para. 15; T. 1665–1666 (15 gusht 2006).

789. Pas përshkrimit të forcave të ndryshme të RFJ-së dhe Serbisë që ishin në Kosovë gjatë viteve 1998 dhe 1999, më tej Dhoma do të analizojë provat në lidhje me situatën në terren gjatë kësaj periudhe kohore.

B. EKZISTENCA E KONFLIKTIT TË ARMATOSUR NË 1998–1999

790. Keqësimi i situatës në Kosovë gjatë viteve 1990 u përshpejtua në vitet 1998 dhe 1999. Para se të analizojë provat dhe të nxjerrë konkluzione në lidhje me krimet konkrete që pretendohet se janë kryer nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë në periudhën mars-qershor 1999, Dhoma shqyrton pretendimet e përgjithshme në Aktakuzë në lidhje me vitin 1998. Në këtë pjesë, Dhoma shqyrton se a kanë qenë forcat e RFJ-së dhe të Serbisë nën detyrimin e normave të së drejtës humanitare ndërkombëtare në vitin 1998 dhe se a pati akuza të rënda për shkeljen e këtyre normave. Çështja se a kanë pasur dijeni të Akuzuarit për këto akuza dhe çfarë ndikimi mund të ketë ky faktor në përgjegjësinë e tyre për krimet e kryera në vitin 1999 do të shqyrtohet në pjesët më të vonshme që analizojnë përgjegjësinë individuale penale të çdo të Akuzuari.

791. Gjatë vendimit për vërtetimin e ekzistencës së konfliktit të armatosur, ky Tribunal ka aplikuar përherë përkufizimin e formuluar nga Dhoma e Apelit në çështjen *Tadiq* se "Konflikti i armatosur ekziston kurdoherë që përdoret forca e armatosur midis shteteve ose dhuna e armatosur e zgjatur midis autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura ose ndërmjet grupeve të tilla brenda shtetit."²⁰⁵³ Dhoma e Apelit në vazhdim theksoi se,

e drejta humanitare ndërkombëtare është në fuqi që prej fillimit të konfliktit të armatosur dhe vazhdon përtej mbarimit të luftimeve deri në arritjen e përgjithshme të paqes; ose, në rastin a konflikteve të brendshme, derisa të arrihet marrëveshje paqësore. Deri në atë moment, e drejta humanitare ndërkombëtare mbetet në fuqi në tërë territorin e shteteve të përfshira në luftë ose, në rastin e konflikteve të brendshme, në tërë territorin nën kontroll të një pale, pa marrë parasysh se a ka luftime aty.²⁰⁵⁴

Si rrjedhojë në një konflikt të brendshëm, përcaktuese është natyra e dhunës ndërmjet forcave shtetërore dhe grupeve të armatosura joshetërore, ose midis grupeve të tilla. Kur ekzistenca e një konflikti të tillë provohet, ai ekziston deri në arritjen e "marrëveshjes paqësore," që kërkon ndalimin e operacioneve ushtarake.²⁰⁵⁵

²⁰⁵³ *Prokurori kundër Tadiqit*, Lënda Nr. IT-94-1-AR72, Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Apelin e Ndërkohshëm në lidhje me Juridiksionin, 2 tetor 1995, para. 70.

²⁰⁵⁴ *Prokurori kundër Tadiqit*, Lënda Nr. IT-94-1-AR72, Vendim i Dhomës së Apelit në Lidhje me Juridiksionin, 2 tetor 1995, para. 67 dhe 70. *Shih gjithashtu, p.sh., Prokurori kundër Sheshelit*, Lënda Nr. IT-03-67-AR72.1, Vendim i Dhomës së Apelit në Lidhje me Juridiksionin, 31 gusht 2004, para. 8; *Prokurori kundër Haradinajt dhe të tjerëve*, Lënda Nr. IT-04-84-T, Aktgjykim, para. 37.

²⁰⁵⁵ *Prokurori kundër Tadiqit*, Lënda Nr. IT-94-1, Vendimi mbi Mocionin e Mbrojtjes në lidhje me Apelin e Ndërkohshëm në lidhje me Juridiksionin, 2 tetor 1995, para. 67, 70.

792. Në rastin konkret, "autoritetet qeveritare" në fjalë janë ato të RFJ-së dhe të Serbisë dhe forcat nën kontrollin e tyre të përshkruara më lart, u angazhuan në Kosovë kryesisht kundër grupit të quajtur Ushtria Çlirimtare e Kosovës ("UÇK"). Prokuroria dhe Mbrojtja kanë paraqitur një sasi të konsiderueshme provash në lidhje me organizimin dhe veprimet e UÇK-së. Dhoma konkludon se dëshmitarët e përmendur më poshtë ishin të besueshëm në përshkrimin e përgjithshëm të UÇK-së, pa i pranuar të gjitha hollësitë e paraqitura nga ta në lidhje me fuqinë dhe veprimet e saj, duke marrë parasysh mistikën dhe mjegullën që e rrethonte. Ndër këta dëshmitarë, Dhoma bazohet posaçërisht në dëshminë e dhënë nga një ish-komandant në UÇK, Bislim Zyrapi, i cili kishte dijeni nga brenda për funksionimin e UÇK-së, dhe nga atasheu britanik i Mbrojtjes, John Crosland, i cili ishte në Kosovë gjatë vitit 1998, pati kontakte personale me luftëtarët e UÇK-së dhe vëzhgoi ngjarjet në terren.

1. Ushtria Çlirimtare e Kosovës

793. Edhe pse disa dëshmitarë të Mbrojtjes e përcaktuan origjinën e saj në fillim të viteve '90, origjina e saktë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) nuk është paraqitur qartë gjatë këtij procesi.²⁰⁵⁶ Branko Gajiq, ish-zëvendësshefi i Administratës së Sigurimit të UJ-së, dëshmoi se të dhënat e para për ekzistencën e UÇK-së kishte filluar t'i merrte në fund të vitit 1995 dhe në fillim të vitit 1996.²⁰⁵⁷ Pavarësisht nga zanafilla e saj, duket se nga fundi i vitit 1997, UÇK-ja kishte arritur të organizohej në njëfarë dhe merrte përgjegjësinë për sulmet mbi policinë dhe civilët serbë në Kosovë.²⁰⁵⁸ Nga nëntori i atij viti, sipas Gajiqit, Administrata e Sigurimit të UJ-së mendonte se UÇK-ja "kishte të gjitha cilësitë e një organizate terroriste."²⁰⁵⁹ Në atë kohë, rajoni i Drenicës në Kosovën qendrore njihej nga shqiptarët kosovarë si "territor i çliruar," për shkak të pranisë së fortë të UÇK-së atje.²⁰⁶⁰

794. Në vitin 1998, UÇK-ja u konsolidua edhe më shumë nëpërmjet shtimit numerik dhe të aftësive.²⁰⁶¹ Duket se ky evoluim dhe rritje gjatë asaj periudhe lidhej me bindjen gjithnjë e më të madhe të shqiptarëve kosovarë se duhej të mbroheshin nga sulmet e shtuara të forcave të RFJ-së

²⁰⁵⁶ Petar Damjanac, T. 23705 (5 mars 2008); Shaban Fazlia, 6D1629 (deklaratë dëshmitari e datës 6 prill 2008), para. 6.

²⁰⁵⁷ Branko Gajiq, T. 15178–15180 (6 shtator 2007).

²⁰⁵⁸ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari e datës 24 janar 2002), f. 9.

²⁰⁵⁹ Branko Gajiq, 3D1084 (deklaratë dëshmitari e datës 8 gusht 2007), para. 12.

²⁰⁶⁰ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari e datës 24 janar 2002), f. 9.

²⁰⁶¹ John Crosland, T. 9778–9779 (7 shkurt 2007).

dhe Serbisë.²⁰⁶² Sidoqoftë jo e gjithë popullata shqiptare kosovare e përkrahte UÇK-në apo metodat që përdorte.²⁰⁶³

795. Të Akuzuarit kanë argumentuar se shumë nga sulmet e përshkruara në Aktakuzë ishin operacione legjitime kundër UÇK-së, të cilën autoritetet e RFJ/Serbisë e konsideronin organizatë "terroriste" dhe shpesh i referoheshin si pjesë e "Forcave Terroriste Shqiptare". Në kuadër të kësaj çështjeje, nuk ka rëndësi nëse UÇK ishte etiketuar si grup "terrorist" dhe se kush e ka përdorur e kush jo këtë term për t'iu referuar asaj. Dhoma nuk ka dyshim se, për periudhën në lidhje me Aktakuzën, forcat e RFJ-së dhe Serbisë u përdorën për të luftuar UÇK-në dhe luftimet midis tyre kishin natyrë të ndryshueshme, duke u shtrirë në pjesë të ndryshme të Kosovës dhe duke ndryshuar në intensitet dhe në kohë. Drejtimi i përgjithshëm i këtyre luftimeve shënoi rritje graduale të përlëshjeve gjatë gjysmës së parë të vitit 1998 dhe rritje më dramatike në veprimet e UÇK-së në maj, qershor, dhe korrik, që u pasua me zbatimin mjaft të suksesshëm të një plani në fund të verës nga ana e forcave të UJ-së dhe MPB-së për nxjerrjen e UÇK-së jashtë pozicioneve të fortifikuara. Më tej, në fund të tetorit 1998 filloi riorganizimi dhe rikonsolidimi i forcave të UÇK-së. Luftimet sporadike midis UÇK-së dhe UJ-së e MPB-së u intensifikuan në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999 dhe vazhduan edhe gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s që filloi në fund të marsit.

796. Pas kësaj hyrjeje, Dhoma do të shqyrtojë nëse është përmbushur kushti dykahësh për ekzistencën e konflikt të armatosur të brendshëm më 1998, siç është përshkruar më lart.

a. Dhuna e armatosur e zgjatur

i. Veprimet e UÇK-së

797. UÇK-ja filloi të merrte përgjegjësinë për sulmet kundër forcave ushtarake dhe të sigurisë në Kosovë, si dhe kundër civilëve që konsideroheshin se përfaqësonin ose përkrahnin autoritetet shtetërore, në fund të vitit 1996 dhe më 1997.²⁰⁶⁴ Miroslav Mijatoviqi, oficer në MPB-në e Serbisë, theksoi se "incidentet terroriste" u shtuan më 1997 duke u bërë të përditshme.²⁰⁶⁵ Bozhidar Filiqi, gjithashtu oficer i MPB-së, deklaroi se në shkurt 1998 UÇK-ja kishte bllokuar rrugët kryesore dhe

²⁰⁶² Bedri Hyseni, T. 3095 (11 shtator 2006), Hyseni tha se UÇK-ja ishte formuar sepse "nuk kishte rrugëdalje tjetër për popullin shqiptar të Kosovës"; Bedri Hyseni, P2270 (deklarata e dëshmitarit e datës 8 maj 2001) f. 2, (deklarata e dëshmitarit e datës 1 shtator 2001), f. 2. *Shih gjithashtu* Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2002), f. 8, (duke vënë në dukje se, ndërsa vazhdonte shtypja nga ana e autoriteteve shtetërore serbe në mesin e viteve '90, të rinjtë shqiptarë kosovarë kishin filluar të flisnin për nevojën e një lëvizjeje të armatosur.).

²⁰⁶³ John Crosland, T. 9776 (7 shkurt 2007).

²⁰⁶⁴ Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2002), f. 8; 3D1116 (Ekspertizë e Radovan Radinoviqit), para. 5.

²⁰⁶⁵ Miroslav Mijatoviq, T. 22163–22165 (12 shkurt 2008).

kishte marrë fshatin Likoshan (komuna e Glllogocit). Ajo gjithashtu kishte rrëmbyer serbë në Kosovë.²⁰⁶⁶ Bislim Zyrapi, ish oficer i APJ-së i cili u anëtarësua në UÇK në fillim të vitit 1998 dhe u bë shef i Shtabit të Përgjithshëm në nëntor të atij viti, dëshmoi se sulmi i policisë së posaçme serbe kundër shtëpisë së familjes Jashari në fshatin Prekaz i Poshtëm që diskutohet në hollësi më poshtë, shënoi fillimin e "konfliktit" midis forcave të RFJ-së dhe Serbisë dhe forcave të UÇK-së.²⁰⁶⁷ Human Rights Watch raportoi se, në këtë incident, i cili ndodhi më 5 mars 1998, u vranë Adem Jashari, pjesëtar i njohur i UÇK-së, dhe rreth 50 të tjerë, shumica pjesëtarë të familjes së tij, ndër të cilët gra dhe fëmijë.²⁰⁶⁸ Pas kësaj ngjarjeje, UÇK-ja filloi një sërë sulmesh që u shtuan gradualisht në Kosovë në pranverë të vitit 1998, duke përfshirë dhe sulmet kundër patrullave të MPB-së,²⁰⁶⁹ një sulm kundër godinës policore në Prishtinë,²⁰⁷⁰ dhe sulme në Kosovë nga territori i Shqipërisë.²⁰⁷¹

798. Në maj 1998, fuqia e forcave të UÇK-së në Kosovë ishte shtuar dukshëm. Më 9 maj 1998, kryetari i Kuvendit Komunal të Gjakovës, Momçillo Stanojeviq, u shkroi Presidentit dhe Kryeministrit të Serbisë, duke u ankuar për rritjen e veprimtarisë së "bandave terroriste shqiptare" dhe duke iu lutur autoriteteve serbe që të përforconin njësitë e MPB-së në Gjakovë.²⁰⁷² Duke e pranuar ekzistencën e konfliktit me UÇK-në, Komanda e Brigadës së 125-të të Motorizuar të UJ-së i udhëzoi njësitë e saj më 18 maj 1998 të vendosin kontakte me shqiptarët vendës në zonat përkatëse të përgjegjësisë dhe "për t'i paralajmëruar se UJ-ja nuk ka hyrë në zonat e tyre për shkak të tyre, por për të kryer manovra të rregullta luftarake dhe për shkak të luftimeve me grupe sabotatore dhe terroriste."²⁰⁷³

799. Kërsman Jelliqi, komandant i Brigadës së 243-të të Mekanizuar në vitin 1998, tha se UÇK-ja e dendësoi veprimtarinë nga maji deri në korrik 1998, kryesisht grabitje dhe sulme në rrugë.²⁰⁷⁴ Një raport nga komandanti i Korpusit të Prishtinës dërguar Komandantit të Armatës së 3-të i datës 13 maj 1998, vlerësoi se në atë kohë UÇK-ja kishte arritur të vinte nën kontroll 30% të territorit

²⁰⁶⁶ Bozhidar Filiq, T. 23930–23931 (7 mars 2008).

²⁰⁶⁷ Bislim Zyrapi, T. 5933 (6 nëntor 2006).

²⁰⁶⁸ P437 (Raport i Human Rights Watch i titulluar "Shkeljet e të Drejtës Humanitare në Kosovë", tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 34–38. *Shih gjithashtu* Sabit Kadriu, T. 5061–5064 (18 tetor 2006); 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), para. 7 (i cili thotë se veprimet terroriste të UÇK-së "u intensifikuan posaçërisht pas likuidimit të të ashtuquajturit grup terrorist i Drenicës të Adem Jasharit."); 1D553 (Deklaratë për Shtyp e MPB-së, 11 mars 1998).

²⁰⁶⁹ 5D849 (Raport i Komandës së Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1998).

²⁰⁷⁰ 6D1507 (Raport i Hetimit të Vëndit të Ngjarjes, 14 prill 1998).

²⁰⁷¹ 5D849 (Raport i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1998), f. 2; 5D748 (Urdhër i Komandës së Brigadës së 125-të të Motorizuar, 17 prill 1998).

²⁰⁷² 1D483 (Raport mbi Gjendjen Politike dhe të Sigurisë në Komunën e Gjakovës, 9 maj 1998), f. 2.

²⁰⁷³ 5D750 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar, 18 maj 1998), f. 1.

²⁰⁷⁴ Kërsman Jelliq, T. 18838–18839 (22 nëntor 2007).

të Kosovës, duke përfshirë rrugët që lidhin Mitrovicën me Pejën dhe Prishtinën me Pejën.²⁰⁷⁵ Raporti gjithashtu përshkruante operacionet e kryera nga njësitë e Korpusit të Prishtinës për të luftuar UÇK-në, siguruar kufirin, dhe për të mbrojtur objektet dhe parashtronte propozime për dislokimin e forcave në të ardhmen. UÇK-ja i shpeshtoi sulmet kundër forcave ushtarake dhe të sigurisë. Më 23 maj 1998, njësitë e UJ-së u sulmuan nga forcat e UÇK-së në komunat e Deçanit dhe Gjakovës në Kosovën perëndimore.²⁰⁷⁶ Petar Damjanac, shef i policisë në Gllogoc në Kosovën qendrore gjatë periudhës të përfshirë në Aktakuzë, gjithashtu foli për disa sulme të UÇK-së kundër policisë në Gllogoc gjatë vitit 1998.²⁰⁷⁷

800. Në qershor të vitit 1998, epurorë të lartë ushtarakë në RFJ shprehën shqetësime serioze në lidhje me veprimet e UÇK-së. Në mbledhjen e Këshillit të Lartë të Mbrojtjes të mbajtur më 9 qershor 1998, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, Momçillo Perishiq, raportoi se UJ-ja ishte angazhuar në Kosovë "në pajtim me detyrat e saj në kohë paqeje." Sidoqoftë, Perishiqi shtoi se disa forca të UJ-së po vepronin në thellësi të Kosovës për të mbrojtur kazernat. Të gjitha këto forca ishin angazhuar në "konflikte" me "terroristët," në brezin kufitar dhe në përgjigje të sulmeve mbi objektet e UJ-së.²⁰⁷⁸ Dy ditë më vonë, më 11 qershor 1998, shefi i degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës, Momir Stojanović, i shkroi Shtabit të Përgjithshëm, duke theksuar se "gjendja e sigurisë në komunat e Metohisë po keqësohet dhe terroristët shqiptarë po mobilizohen dhe armatosen dhe po bëhen gati për konflikt të armatosur me pjesëtarët e MPB-së dhe UJ-së."²⁰⁷⁹

801. Bozhidar Deliqi dëshmoi se brenda qershorit 1998 territoret afër Gjakovës, Rahovecit, dhe Malishevës ishin nën kontrollin e UÇK-së.²⁰⁸⁰ Më 24 korrik 1998, Komanda e Korpusit të Prishtinës i dërgoi një raport Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm, në të cilin shpjegonte se, sipas të dhënave që dispononte në atë kohë në Kosovë ishin 25.000 "terroristë" të armatosur. Qendrat e grupeve "terroriste" ishin të vendosura në zonën e gjerë të Drenicës, Malishevës, fshatit Gllogjan, fshatit Jabllanicë, dhe fshatit Junik.²⁰⁸¹ Në një direktivë të lëshuar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm më 28 korrik 1998, thuhej se UÇK-ja kishte arritur të vinte nën kontroll rreth 30 për qind të territorit të Kosovës; zonën e përgjithshme të Drenicës, Malishevës në Kosovën qendrore, Studençanin dhe Bllacën në komunën e Suharekës në jug të Kosovës qendrore, Jasiqin në komunën e Gjakovës në jugperëndim; Junikun, Isniqin, dhe Gllogjanin në komunën e

²⁰⁷⁵ P1401 (Raport i PrK-së dërguar Armatës së 3-të, 13 maj 1998), f. 2.

²⁰⁷⁶ P2822 (Raport mbi veprimet e UJ-së në Kosovë, 25 maj 1998), f. 3–4.

²⁰⁷⁷ Petar Damjanac, T. 23718–23725 (5 mars 2008).

²⁰⁷⁸ P1574 (Procesverbal i Sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998), gjithashtu e pranuar si 4D106.

²⁰⁷⁹ 3D995 (Raport i Seksionit të Sigurimit të Komandës së PrK-së, 11 qershor 1998), f. 1. *Shih gjithashtu* 3D997 (Raport i Seksionit të Sigurimit të Komandës së PrK-së, 13 qershor 1998), f. 1.

²⁰⁸⁰ Bozhidar Deliq, T. 19275–19276 (28 nëntor 2007).

²⁰⁸¹ 5D1307 (Raport i PrK-së dërguar Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm, 24 korrik 1998), f. 1.

Deçanit në perëndim; dhe Jabllanicën në komunën e Klinës. Në të gjithashtu thuhej se UÇK-ja kishte zgjeruar ndikimin në rreth 40 për qind të territorit.²⁰⁸² Hulumtuesi i Human Rights Watch-it, Frederick Abrahams, gjithashtu dëshmoi se UÇK-ja kishte marrë nën kontroll "jo të plotë" rreth 40 për qind të Kosovës në qershor të vitit 1998,²⁰⁸³ dhe Bislim Zyrapit theksoi se deri në mes të korrikut 1998, UÇK-ja kishte marrë nën kontroll "pak a shumë" 50 për qind të Kosovës, që përfshinte tri nga katër rrugët kryesore.²⁰⁸⁴ Sipas John Crosland-it, në verën e vitit 1998 UÇK-ja ishte e aftë të ndërmernte sulme kundër forcave të UJ-së dhe MPB-së në të gjithë Kosovën dhe, si rrjedhojë teknikisht kontrollonte 70 për qind të terrenit.²⁰⁸⁵

802. Disa dokumente të MPB-së të korrikut 1998 përmbajnë statistika të viktimave të vrasjeve dhe rrëmbimeve që pretendohet të jenë kryer nga "terroristët shqiptarë" në atë kohë.²⁰⁸⁶ Gjithashtu, më 29 korrik, komandanti i Armatës së 3-të, Dushan Samarxhiq, dha këto shifra për efektivin e UÇK-së: 3.500-4.000 anëtarë në zonën e Drenicës (Kosova qendrore), 1.500- 2.000 në Jabllanicë (Kosova perëndimore), 1.500-2.000 në Malishevë dhe zonat përreth, 500-1.000 në zonën e Ratkocit, Drenocit, dhe Rahovecit, dhe 1.000-1.500 në brezin kufitar me Shqipërinë. Ai gjithashtu vlerësoi se 2.000-3.000 "terroristë të stërvitur" ndodheshin në Shqipëri. Samarxhiqi gjithashtu theksoi se në radhët e UÇK-së kishte edhe mercenarë, shumica prej të cilëve ishin nga vendet islamike. Në fund, ai theksoi se ata "vazhduan si me mobilizimin me forcë, po ashtu edhe vullnetar të popullatës shqiptare dhe i dërgonin në njësi ushtarake."²⁰⁸⁷

803. John Crosland-i dëshmoi se fshatrat Irzniq dhe Prejlep në Kosovën perëndimore ishin zona luftimi midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Serbisë në vitin 1998. Prej 1 korrikut dhe 11 gusht 1998, stacioni policor në Prejlep u sulmua 32 herë nga forcat e UÇK-së.²⁰⁸⁸ Luftime pati edhe në Junik, Prejlep, dhe Irzniq (komuna e Deçanit) dhe Ponoshec (komuna e Gjakovës) në perëndim.

²⁰⁸² 4D137 (Udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm për Dislokimin e UJ-së në Kosovë, 28 korrik 1998), f. 1.

²⁰⁸³ Frederick Abrahams, T. 875–876 (14 korrik 2006), Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 24 janar 2002) f. 10.

²⁰⁸⁴ Bislim Zyrapit, T. 6017–6018 (7 nëntor 2006).

²⁰⁸⁵ John Crosland, T. 9910 (8 shkurt 2007), 3D510 (deklarata e dëshmitarit e datës 30 qershor 2006), para. 23.

²⁰⁸⁶ 1D721 (Listë e MPB Serbe e Qytetarëve të Vrarë në Aktet Terroriste Separatiste në Kosovë nga 1 janari deri më 8 korrik 1998, 9 korrik 1998) (në të cilin thuhet se, gjatë kësaj periudhe ishin vrarë gjithsej 52 civilë "në aktet terroriste të separatistëve shqiptarë", duke përfshirë 19 qytetarë serbë dhe malazezë, 30 shqiptarë kosovarë, dhe 3 qytetarë të kombësive të tjera), f. 9; 1D707 (Listë e MPB-së së Serbisë e Civilëve dhe Pjesëtarëve të MPB-së të Rrëmbyer nga Terroristët Shqiptarë nga 1 janari deri më 7 korrik 1998, 8 korrik 1998) (në të cilën thuhet se "terroristët shqiptarë" tashmë përdornin gjerësisht taktikën e rrëmbimit në tërë Kosovën kundër autoriteteve serbe dhe civilëve, dhe se ishin rrëmbyer 66 persona të kombësisë serbe dhe malazeze, 27 shqiptarë kosovarë, dhe shtatë të kombësive të tjera, dhe pesë pjesëtarë të MPB-së), f. 14; 1D726 (Pasqyrë e Aksioneve Terroriste të Separatistëve Shqiptarë në Territorin e Kosovës në periudhën janar – 7 korrik 1998) (e cila përmbledh "aksionet terroriste të separatistëve shqiptarë" gjatë kësaj periudhe, dhe në të cilën përmenden 387 aksione, me veprimtari të intensifikuar në prill 1998, dhe veçanërisht e ashpër në maj dhe qershor 1998, ku shumica e aksioneve të kësaj periudhe ndodhën në këta dy muaj).

²⁰⁸⁷ 4D140 (Urdhër i Komandës së Armatës së 3-të, 29 korrik 1998), f. 1–2.

²⁰⁸⁸ John Crosland, T. 10017–10018 (9 shkurt 2007).

Luftimet filluan në maj dhe zgjatën rreth tre muaj dhe arsyeja për këtë ishte rëndësia strategjike e zonës për UÇK-në si rrugë furnizimit me armë dhe ushtarë.²⁰⁸⁹ Kjo diskutohet më në hollësi në Pjesën C të Kapitullit VI. Bislim Zyrapi gjithashtu dëshmoi se në qershor dhe korrik të vitit 1998 pati luftime në zonat e Drenicës dhe Dukagjinit.²⁰⁹⁰ Gjatë korrikut, gushtit, dhe shtatorit, luftimet u intensifikuan dhe u përhapën për shkak të një ofensive të ndërmarrë nga forcat e RFJ-së/Serbisë kundër zonave nën kontroll të UÇK-së në atë kohë.²⁰⁹¹

804. Në korrik 1998 UÇK-ja ndërmori një ofensivë të rëndësishme në Rahovec, në Kosovën qendrore. UÇK-ja, e cila kishte një bastion në pjesën veriore të komunës dhe rreth Malishevës, bëri një përpjekje të pasuksesshme për të marrë zonën nën kontroll, duke përfshirë edhe pjesë të qytetit të Rahovecit.²⁰⁹² Hulumtuesi i Human Rights Watch-it, Frederick Abrahams, tha se ky aksion ishte "ofensiva e parë e madhe" e UÇK-së, e cila filloi më 19 korrik dhe zgjati dy ditë. Sipas dokumenteve të UJ-së sulmi filloi më 17 korrik dhe cilësohet ngjarje e madhe. Momir Stojanoviqi, shef i degës së sigurimit në Korpusin e Prishtinës, shënoi më 18 korrik se UÇK-ja kishte sulmuar një ditë më parë nga drejtimi i Drenocit, Malishevës, dhe Opterushës në veri dhe në lindje të qytetit të Rahovecit. Sipas raportit të tij, forcat e UÇK-së "morën nën kontroll pjesën më të madhe të qytetit, hynë në Qendrën Shëndetësore dhe morën një sasi të madhe të furnizimeve mjekësore. Ata gjithashtu morën transformatorin që furnizon me energji elektrike" dhe bllokuan rrugën kryesore Xërxë-Rahovec.²⁰⁹³ RDB-ja raportoi se, si pasojë e kësaj, "Rahoveci dhe rrethina mbetën pa energji elektrike dhe ujë deri më 23 korrik 1998, 56 persona u rrëmbyen, pesë u vranë, dy u plagosën, një grua u përdhunua, dhe një personi iu vu flaka."²⁰⁹⁴ Hollësi në lidhje me reagimin e UJ-së dhe MPB-së ndaj sulmit të UÇK-së dhe luftimeve me të në Rahovec në këtë kohë i dha dëshmitari K79, pjesëtar i PJP-së. Ai dëshmoi se luftimet vazhdonin në qytet dhe se UÇK-ja u tërhoq përballë

²⁰⁸⁹ John Crosland, T. 9918–9919 (8 shkurt 2007).

²⁰⁹⁰ Bislim Zyrapi, T. 5934, 5939–5940 (6 nëntor 2006). Zyrapi shpjegoi se UÇK-ja e kishte ndarë Kosovën në shtatë zona, duke përfshirë Drenicën (në Kosovën qendrore), dhe Dukagjinit (në Kosovën perëndimore). *Shih gjithashtu*, P2469 (Harta e zonave operative të UÇK-së); Sabit Kadriu, T. 5117–5118 (18 tetor 2006).

²⁰⁹¹ Bislim Zyrapi, T. 5940 (6 nëntor 2006).

²⁰⁹² Jan Kickert, T. 11204 (7 mars 2007); Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari e datës 24 janar 2002), f. 11. *Shih gjithashtu*, K79, T. 9590–9591 (1 shkurt 2007); Dragan Millenković, T. 22952–22953 (21 shkurt 2008); Bozhidar Deliq, T. 19460–19461 (4 dhjetor 2007); P922 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 20 korrik 1998), f. 12–13 (Dimitrijeviqi duke komentuar përdorimin e UJ-së në operacionin për çlirimin e Rahovecit).

²⁰⁹³ 5D1305 (Raport i Seksionit të Sigurimit të PrK-së, 18 korrik 1998).

²⁰⁹⁴ 6D1015 (Qendra e RDB-së në Prizren, të dhëna zbulimi mbi UÇK-në, 1 gusht 1998). *Shih gjithashtu* P3120 (Procesverbal i mbledhjes së MPB-së, 23 korrik 1998), f. 3 (në të cilën ishte raportuar se disa njerëz ishin ndaluar për shkak se kishin hapur zjarr gjatë "çlirimit të Rahovecit" dhe se 57 njerëz të kombësisë serbe dhe malazeze ishin rrëmbyer nga qyteti).

aksionit të koordinuar të UJ-së dhe të njërive të policisë së posaçme.²⁰⁹⁵ Këto forca e nxorën UÇK-në jashtë Rahovecit pak kohë pas kësaj.²⁰⁹⁶

ii. Planet për të luftuar UÇK-në dhe ofensiva verore e RFJ-së/Serbisë

805. Siç diskutohet më në hollësi më poshtë, nga mesi i vitit 1998, u bënë përpjekje të përbashkëta për të përmirësuar koordinimin dhe bashkëpunimin ndërmjet forcave të UJ-së dhe të MPB-së në Kosovë në veprimet e tyre kundër UÇK-së. Kjo rezultoi në "Plan Kundër Terrorizmit në Kosovë," i cili fillimisht kishte tri faza dhe më vonë u zgjerua në gjithsej pesë faza, dhe përfshinte forcat e UJ-së dhe të MPB-së.²⁰⁹⁷

806. Provat tregojnë se Plani filloi të zbatohet nga mesi i korrikut, ku disa dokumente përmendin zbatimin e fazave të ndryshme të tij. Për shembull, në procesverbalin e mbledhjes së Shtabit të MPB-së për Kosovën mbajtur më 28 korrik 1998, lexohet se Llukiqi i informoi pjesëmarrësit për masat dhe veprimet e ndërmarra nga njësitë policore në Kosovë nga 25 korriku deri më 28 korrik, që kishin pasur për qëllim heqjen e bllokadës së rrugëve dhe qyteteve të caktuara sipas Planit. Llukiqi më tej pohonte se "faza e dytë e Planit Global ishte zbatuar sipas grafikut të përcaktuar."²⁰⁹⁸ Shënime të marra nga Millan Gjakoviçi në mbledhjet e Komandës së Përbashkët mbajtur nga 22 korriku deri më 30 tetor 1998, përmendin disa herë Planin dhe zbatimin e fazave të tij, si në rend dite të mbledhjeve të veçanta, po ashtu edhe në fjalën e folësve të ndryshëm.²⁰⁹⁹ Plani dhe zbatimi i tij në faza gjithashtu përmendet në komunikimet në mes të komandantëve të Korpusit të Prishtinës (Pavkoviçit) dhe të Armatës së 3-të (Samarxhiçit).²¹⁰⁰

807. Gjakoviçi tha se, duke iu përmbajtur Planit kundër Terrorizmit, UJ-ja hartoi planin e vet të veprimit, i cili përputhej me tri fazat e para të Planit. Ky plan paralel njihej me emrin *Grom 98* (Rrufeja 98) dhe përbëhej nga dy faza, ku vetëm faza e parë u zbatua në vitin 1998.²¹⁰¹ Radovan Radinoviçi konfirmoi se, në korrik 1998, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së Perishiçi, lëshoi një urdhër që përmbante planin *Grom 98*, në pajtim me konkluzionet e miratuara nga KLM-ja në mbledhjen e saj të 9 qershorit 1998.²¹⁰²

²⁰⁹⁵ K79, T. 9591–9593, 9593–9594 (seancë e mbyllur), 9594–9606 (seancë e mbyllur) (1 shkurt 2007).

²⁰⁹⁶ Jan Kickert, T. 11204 (7 mars 2007); Baton Haxhiu, T. 6116 (8 nëntor 2006).

²⁰⁹⁷ Millan Gjakoviçi, T. 26405–26408 (19 maj 2008), T. 26536–26537 (21 maj 2008).

²⁰⁹⁸ P3121 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 3.

²⁰⁹⁹ *Shih gjithashtu*, P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 10, 13, 15, 17, 24, 35, 41, 71, 130, 161.

²¹⁰⁰ P1418 (Kërkesë dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 31 korrik 1998).

²¹⁰¹ Millan Gjakoviçi, T. 26408–26409 (19 maj 2008).

²¹⁰² 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviçit), para. 96; 4D137 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm për Dislokim të UJ-së në Kosovë, 28 korrik 1998).

808. Sipas direktivës në *Grom*, UJ-ja ndërmori masa si sigurimi i kufirit, ofrimi i "sigurisë së thellë" në zonën operative të Korpusit të Prishtinës, dhe ofrimi i ndihmës të drejtpërdrejtë MPB-së së Serbisë. Në të propozohet dislokimi i mëtejshëm i UJ-së në dy faza. Në fazën e parë, UJ-ja duhej që, ndër të tjera, "me veprime të shpejta dhe të koordinuara me forcat e MPB-së së Republikës së Serbisë, të shtypë dhe shkatërrojë forcat sabotatore dhe terroriste" në Kosovë. Faza e dytë parashikohet të zbatohet "në rast të kryengritjes së përgjithshme," dhe përfshinte mobilizimin e pjesshëm të UJ-së dhe veprime për thyerjen e "forcave të kryengritjes së armatosur," marrjen nën kontroll të territorit dhe parandalimin e "përhapjes" së situatës. Në fazën e parë, forcat tashmë të dislokuara në zonën e Korpusit të Prishtinës duhej të mbaheshin në terren dhe të përforcoheshin me njësi të UJ-së nga Armata e 1-rë dhe e 2-të, të cilat do të vireshin në varësi të Komandës së Armatës së 3-të

809. Për zbatimin e direktivës së lëshuar nga Perishiqi, më 29 korrik 1998 Samarxhiqi lëshoi një urdhër për zbatimin e fazës së parë të planit *Grom 98* dhe për të përgatitur fazën e dytë.²¹⁰³ Sipas Radinoviçit, si rezultat i zbatimit të planit *Grom 98*, që zgjati prej fundit të korrikut deri në fund të gushtit 1998, "bastionet kryesore terroriste" u thyen dhe u pengua rritja e UÇK-së dhe marrja prej saj e karakteristikave të një force legjitime të armatosur.²¹⁰⁴ Ky vlerësim është shumë i ngjashëm me atë të dhënë nga Pavkoviçiqi në mbledhjen e 29 tetorit 1998, ku përshkruan sukseset e Planit më të gjerë.

810. Është e qartë se forcat e UJ-së dhe të MPB-së u përdorën në operacione të rëndësishme kundër UÇK-së, të kryera nga korriku deri në tetor 1998. Siç është përmendur më lart, disa dëshmitarë dëshmuan për një aksion konkret kundër UÇK-së të kryer në qytetin e Rahovecit rreth datave 18-20 korrik 1998. Procesverbali i mbledhjes së kolegjiut të UJ-së mbajtur më 20 korrik 1998 gjithashtu përmend aksionin e Rahovecit, duke theksuar se komandanti i Armatës së 3-të përdori një grup luftimi në ndihmë të MPB-së atje.²¹⁰⁵ Vllatko Vukoviçiqi, komandant i Batalionit të 2-të të Motorizuar të Brigadës së 549-të të Motorizuar, dëshmoi se më 2 gusht 1998 forcat e UÇK-së u thyen në Smonicë dhe Nec.²¹⁰⁶ Petar Damjanaci theksoi se Drenica u "çlirua" nga UÇK-ja në shtator 1998.²¹⁰⁷ Deri në fillim të shtatorit, UÇK-ja ishte dobësuar, por nuk ishte shkatërruar, si rezultat i ofensivës së ndërmarrë nga forcat e RFJ-së/Serbisë dhe humbi shumicën e territorit që

²¹⁰³ 4D140 (Urdhër i Komandës së Armatës së 3-të, 29 korrik 1998), f. 5–6.

²¹⁰⁴ 3D1116 (Aktspertizë e Radovan Radinoviçit), para. 92.

²¹⁰⁵ P922 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 20 korrik 1998), f. 3, 12–13.

²¹⁰⁶ Vllatko Vukoviçiq, 5D1401, (deklaratë dëshmitari e datës 5 janar 2008), para. 8. (e mbyllur me vulë)

²¹⁰⁷ Petar Damjanac, T. 23738–23739 (5 mars 2008).

kishte kontrolluar më parë.²¹⁰⁸ Dragan Zhivanoviqi, komandant i Brigadës së 125-të të Motorizuar, diskutoi operacionet e përbashkëta luftarake të UJ-së/MPB-së kundër UÇK-së në rajonin e Abrisë së Epërme dhe Abrisë së Poshtme në fund të shtatorit.²¹⁰⁹ Lazareviqi personalisht dëshmoi se, deri në fund të shtatorit, "boshti i terrorizmit në Kosovë dhe Metohi faktikisht ishte neutralizuar."²¹¹⁰

811. Ish-komandanti në UÇK, Bislim Zyrapi dëshmoi se për shkak të dobësisht të UÇK-së dhe luftimeve të verës, deri në tetor të vitit 1998 MPB-ja dhe UJ-ja kishin rimarrë shumicën e territorit që më herët kontrollohej nga UÇK-ja.²¹¹¹ Pas disa dështimeve të UÇK-së, Zyrapi shkoi në Shqipëri nga shtatori deri në nëntor të vitit 1998 për të riorganizuar formacionet e UÇK-së dhe për të rekrutuar ushtarë të rinj për zëvendësimin e atyre që ishin larguar si pasojë e luftimeve të verës.²¹¹² Sidoqoftë, edhe pse përpjekjet e UJ-së dhe të MPB-së në fund të verës dhe në fillim të vjeshtës ishin plotësisht të suksesshme, veprimtaria e UÇK-së vazhdoi, por me intensitet të zvogëluar.²¹¹³ Frederick Abrahams konfirmoi se UÇK-ja ishte tërhequr në kodrat e rajonit të Drenicës dhe në disa zona në Kosovën perëndimore dhe jugore.²¹¹⁴ Zyrapi dëshmoi se në gusht dhe shtator 1998, luftimet vazhduan në zonat e kontrolluara nga UÇK-ja.²¹¹⁵ Më 27 shtator 1998, Komanda e Korpusit të Prishtinës i dërgoi një raport Armatës së 3-të, ku shkruhej se UÇK-ja kishte bërë "rezistencë të fortë" në disa zona, si afër Nerodimes së Epërme, në segmentin fshati Sujë-Germanska Baila, segmentin Reçan-Budakovë, dhe segmentin Banjicë-Burrnik.²¹¹⁶ Gjithashtu, MPB-ja vazhdoi të dokumentonte rrëmbime të kryera nga forcat e UÇK-së.²¹¹⁷

²¹⁰⁸ P561 (Raport i ambasadës austriake, 8 shtator 1998), f. 1; Bislim Zyrapi, T. 6020–6021 (7 nëntor 2006); Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari e datës 24 janar 2002), f. 11.

²¹⁰⁹ Dragan Zhivanoviqi, T. 20492–20494 (17 janar 2008), që i referohet 6D755 (Raport Luftimi i Komandës PrK-së dërguar Armatës së 3-të, 26 shtator 1998) dhe 6D756 (Raport Luftimi i Komandës së PrK-së dërguar Armatës së 3-të, 27 shtator 1998).

²¹¹⁰ Vladimir Lazareviqi, T. 18561–18563 (19 nëntor 2007).

²¹¹¹ Bislim Zyrapi, T. 6020–6021 (7 nëntor 2006).

²¹¹² Bislim Zyrapi, T. 6178–6180 (9 nëntor 2006).

²¹¹³ 3D1008 (Raport i Seksionit të Sigurimit të Komandës së PrK-së, 15 tetor 1998), f. 1 (në të cilin raportohej se UÇK-ja kishte kryer tetë sulme kundër MPB-së në komunat Suharekë, Rahovec, Glllogoc, Shtime, Lipjan, dhe Mitrovicë); 5D754 (Urdhër për Angazhim të Brigadës së 125-të të Motorizuar, 20 tetor 1998), f. 1 (në të cilin thuhet se UÇK-ja "vazhdonte me sulme dhe aksione terroriste në zonën e përgjithshme të Drenicës, Llapit, dhe Grykës së Rugovës" kundër MPB-së dhe UJ-së dhe se kishte prani të fuqishme të UÇK-së afër kufirit me Shqipërinë, me 4.000–6.000 luftëtarë të vendosur atje.); 3D1013 (Raport i Degës të Sigurimit të Komandës së PrK-së, 28 tetor 1998), f. 1 (në të cilin raportohej edhe për nëntë sulme të tjera kundër MPB-së në fund të tetorit).

²¹¹⁴ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari e datës 24 janar 2002), f. 11.

²¹¹⁵ Bislim Zyrapi, T. 5940–5941 (6 nëntor 2006). Zyrapi tha se ai kishte qenë atje deri në shtator, por besonte se luftimet kishin vazhduar deri në tetor. Gjithashtu, ai tha se kishte pasur "luftime të trepta" në zonat në të cilat serbët kishin zhvilluar një ofensivë, siç ishte Drenica.

²¹¹⁶ 6D756 (Raport Luftimi i PrK-së dërguar Armatës së 3-të, 27 shtator 1998), f. 1–2.

²¹¹⁷ 6D1012 (Qendra e Degës së Sigurimit Shtetëror në Prizren, Raport mbi rrëmbimet nga UÇK-ja, 1 tetor 1998), f. 3. (në cilin raportohej për rrëmbimin e 151 civilëve nga prilli deri në shtator 1998, të gjithë nga Qendra e Degës së Sigurimit Shtetëror në Prizren, dhe thuhej se shumica e tyre ishin serbë dhe malazezë (113), por kishte edhe "shqiptarë (34) të cilët nuk kishin treguar gatishmëri për bashkëpunim të pakushtëzuar me UÇK-në.").

iii. *Periudha midis Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq dhe fushatës ajrore të NATO-s*

812. Në fund të tetorit 1998, forcat e UJ-së dhe të MPB-së duhej të tërhiqeshin pas arritjes së Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq dhe marrëveshjeve të tjera dytësore ("Marrëveshjet e Tetorit"), të cilat janë diskutuar në Kapitullin V më lart.²¹¹⁸ Më tej Misioni Verifikues për Kosovën i OSBE-së filloi mbikëqyrjen e respektimit të Marrëveshjes dhe të Marrëveshjes së mëvonshme Clark-Naumann.²¹¹⁹ UÇK-ja shfrytëzoi kufizimet e vendosura mbi forcat e RFJ-së/Serbisë për t'u rigrupuar gjatë tetorit, nëntorit, dhe dhjetorit 1998.²¹²⁰ Richard Ciaglini, oficer ushtarak britanik, që kishte marrë pjesë në KVM, dëshmoi se UÇK-ja kishte sjellë forca shtesë, pajisje, dhe municion në Kosovë.²¹²¹ Ai tha se, nga fundi i vitit 1998 deri në fillim të vitit 1999, UÇK-ja, si dhe UJ-ja dhe MPB-ja e shfrytëzuan gjendjen e krijuar me praninë e OSBE/KVM-së në Kosovë për t'u riarmatosur dhe për të fuqizuar trupat e tyre.²¹²² Sipas John Crosland-it, gjatë kësaj periudhe, UÇK-ja u fuqizua në njerëz, armë, dhe strukturë.²¹²³ Crosland-i dhe kryetari i atëhershëm i Komitetit Ushtarak të NATO-s, gjenerali Klaus Naumann, dëshmuar se UÇK-ja mori pozicionet të cilat i kishin lëshuar forcat e RFJ-së/Serbisë dhe kjo çoi në përshkallëzimin e dhunës.²¹²⁴ Branko Gajiqi dha dëshmi të ngjashme, duke theksuar se "kjo zbrazëti kohore prej momentit kur u arrit marrëveshja dhe deri në ardhjen e misionit verifikues u shfrytëzua nga UÇK-ja. Ata morën pozicionet e tyre të mëparshme që kishin mbajtur para ndërmarrjes së aksionit antiterrorist."²¹²⁵ Ai shtoi se "nga fundi i nëntorit 1998, terroristët filluan përgatitjet për kryengritje të armatosur në pranverë të vitit 1999."²¹²⁶ Provat tregojnë se Komanda e Korpusit të Prishtinës kishte marrë informata që në fillim të dhjetorit 1998 për përgatitjet e UÇK-së, për një operacion të përmasave të mëdha që do të bëhej në pranverë 1999 në Kosovë.²¹²⁷

²¹¹⁸ Bislim Zyrapi, T. 6020–6022 (7 nëntor 2006).

²¹¹⁹ Klaus Naumann, T. 8379–8384 (14 dhjetor 2006).

²¹²⁰ Bislim Zyrapi, T. 6020–6021, 6033–6034 (7 nëntor 2006); Shaun Byrnes, T. 12243 (17 prill 2007); Sandra Mitchell, T. 618 (11 korrik 2006); Richard Ciaglini, T. 6880 (20 nëntor 2006); Branko Gajiq, 3D1084 (deklaratë dëshmitari e datës 8 gusht 2007), para. 116; P2460 (Procesverbal i UÇK-së i mbledhjes së Shtabit të Përgjithshëm me Komandantët e Zonave Operative, 28 dhjetor 1998); Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari me datë qershor 2000), para. 189; 3D573 (pjesë nga fletorja e Drewienkiewicz-it), f. 32; Michael Phillips, T. 12015–12016 (20 mars 2007); 3D564 (Pjesë nga fletorja e Michael Phillips-it); John Crosland, T. 9912, 9891–9893 (8 shkurt 2007); 3D511 (Shënimet e Jovanoviqit mbi mbledhjen me Crosland-in, 25 qershor 1998), f. 2.

²¹²¹ Richard Ciaglini, T. 6823–6824 (17 nëntor 2006).

²¹²² Richard Ciaglini, T. 7003 (21 nëntor 2006).

²¹²³ John Crosland, T. 9897 (8 shkurt 2007); 3D510 (deklaratë dëshmitari e datës 30 qershor 2006), para. 42.

²¹²⁴ John Crosland, 3D510 (deklaratë dëshmitari e datës 30 qershor 2006), para. 45; Klaus Naumann, T. 8277 (13 dhjetor 2006), 8383–8384 (14 dhjetor 2006).

²¹²⁵ Branko Gajiq, T. 15206 (7 shtator 2007).

²¹²⁶ Branko Gajiq, 3D1084 (deklaratë dëshmitari e datës 8 gusht 2007), para. 129.

²¹²⁷ 3D1035 (Raport i Komandës së PrK-së dërguar Armatës së 3-të dhe Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm të RFJ-së, 24 dhjetor 1998); 3D1038 (Raport i Komandës së PrK-së dërguar Armatës së 3-të dhe Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm të RFJ-së, 29 dhjetor 1998); 5D1241 (filmim i BBC-së, 29 janar 1999).

813. Shaun Byrnes, shef i US KDOM-it, i stacionuar në Prishtinë, dëshmoi se gjatë kësaj kohe kishte parë kampe të stërvitjes të UÇK-së në luginën e Pagarushës në Kosovën qendrore në mes Malishevës dhe Suharekës. Sipas Byrnes-it, UÇK-ja fillimisht i respektoi "marrëveshjet e tetorit" edhe pse nuk ishte palë në to. Ai më tej tha se UÇK-ja e kishte kuptuar "se sjellja e keqe e ushtarëve të saj mund të rrezikonte qëllimin e tyre për të pasur përkrahjen e plotë amerikane dhe angazhimin e plotë të NATO-s në anën e tyre kundër serbëve." Mirëpo, ndërsa në fillim UÇK-ja i pakësoi veprimet, gjithçka mori "tatëpjetën" pak më vonë. Byrnes shprehu mendimin se arsyeja për këtë ishte se UÇK-ja nuk u besonte forcave të RFJ-së/Serbisë dhe besonte se ata do të sulmonin përsëri në pranverë 1999.²¹²⁸

814. Dhoma Gjyqësore është bindur se në fund të vitit 1998 UÇK-ja kishte ripërtërirë një pjesë të kapacitetit të saj të humbur dhe u përfshi në disa sulme dhe incidente gjatë dimrit. Një incident që krijoi përshtypje të keqe ndodhi më 14 dhjetor, kur gjatë një sulmi të kryer në Kafene Panda në Pejë u vranë disa adoleshentë serbë, të cilin autoritetet e RFJ-së/Serbisë ia atribuuan UÇK-së.²¹²⁹ Në fund të dhjetorit, dega e sigurimit të Korpusit të Prishtinës paralajmëronte se "gjendja në territorin e komunës së Gllogocit po përkeqësohet me përpjekje të njëjësive terroriste të së ashtuquajturës UÇK për t'i institucionalizuar veprimet duke marrë nën kontroll autoritetet civile dhe mbi këtë pjesë."²¹³⁰

815. Dhoma ka dëgjuar përshkrime të ndryshme të aksioneve të kryera nga UÇK-ja në fillim të vitit 1999. Sipas Zyrapit, në janar 1999, pati vetëm përleshje të vogla midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së/Serbisë dhe se këto kishin veprime mbrojtëse të UÇK-së. Sidoqoftë UÇK-ja vazhdoi me sulme kundër postbloqeve të UJ-së dhe MPB-së në zonat ku ato përbënin pengesë për lëvizjet e saj.²¹³¹ Në periudhën prej janarit deri në mars 1999, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së organizoi stërvitje në Shqipëri dhe këto stërvitje "u përqendruan në përdorimin e armëve, kualifikimin e komandantëve dhe oficerëve nga niveli më i ulët e deri në nivel batalioni, dhe gjithashtu përgatitjet për operacione dhe aksione luftarake të këtyre niveleve."²¹³²

²¹²⁸ Shaun Byrnes, T. 12242–12243 (17 prill 2007).

²¹²⁹ 3D1030 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 15 dhjetor 1998), f. 2; Branko Gajiq, 3D1084 (deklaratë dëshmitari e datës 8 gusht 2007), para. 50; Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari e datës qershor 2000), para. 89; P407 (Libri i Kaltër i OSBE/KVM-së), f. 4, 7; *shih gjithashtu* P634 (Kronologjia e ngjarjeve kryesore në Kosovë nga 15 tetori deri më 18 prill 1999), f. 3; Michael Phillips, T. 11902–11903 (19 mars 2007) (seancë e mbyllur); Shaun Byrnes, T. 12241 (17 prill 2007); Lubivoje Joksiq, T. 21983 (8 shkurt 2008); Millivoje Mihajllloviq, 6D1530 (deklaratë dëshmitari e datës 6 mars 2008), para. 29; Radojica Nikçeviq, T. 23243 (26 shkurt 2008); Radovan Paponjak, T. 24549 (19 mars 2008).

²¹³⁰ 3D1034 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 22 dhjetor 1998).

²¹³¹ Bislim Zyrapit, T. 5987–5990 (7 nëntor 2006).

²¹³² Bislim Zyrapit, T. 5982, 6030 (7 nëntor 2006).

816. Në një raport të KVM-së, i 2 janarit 1999, lexohet se kishte të dhëna se UÇK-ja po bëhej më e bashkuar nën një strukturë komanduese.²¹³³ Më 28 janar 1999, ndihmësshefi i RDB-së në Kosovë raportoi se UÇK-ja kishte "shtuar aktivitetin në terren me qëllim rritjen e nivelit të organizimit dhe forcimit të moralit, disiplinës, dhe sigurisë në sjelljen e pjesëtarëve të UÇK-së gjatë përgatitjeve për aksione më të gjera terroriste."²¹³⁴ Ai gjithashtu jepte hollësi për disa zona ku UÇK-ja kishte prani të konsiderueshme që nga janari 1999, duke përfshirë zonën e Rahovecit, Suharekës, Pejës, dhe Ferizajt.²¹³⁵

817. John Crosland-i dëshmoi se në muajt e parë të vitit 1999, UÇK-ja kishte shtabe në 24 vende të ndryshme në Kosovë.²¹³⁶ Në veçanti, në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999, Malisheva ishte qendër e rëndësishme e UÇK-së dhe njihej si "kryeqytet i territoreve të lira" të UÇK-së.²¹³⁷ Pak para fillimit të bombardimeve të NATO-s, "vatrat" e veprimeve të UÇK-së, si dhe zonat që forcat e RFJ-së/Serbisë i konsideronin të rëndësishme, ishin zona e Podujevës, sepse ishte në rrugën kryesore që lidh Nishin me Prishtinën, zona e Vushtrrisë, zona rreth Jabllanicës në Kosovën perëndimore, dhe zona e Kaçanikut afër kufirit me Maqedoninë.²¹³⁸

818. Frederick Abrahams konfirmoi se deri në shkurt 1999 UÇK-ja ishte shndërruar në një forcë më të organizuar luftarake.²¹³⁹ MPB-ja gjithashtu kishte shënuar aktivitet të dendur të UÇK-s në periudhën midis 13 tetorit 1998 dhe 9 shkurtit 1999.²¹⁴⁰ Mirëpo ky pohim bie në kundërshtim me rëfimin e Zyrapit se gjatë kësaj periudhe UÇK-ja ishte angazhuar kryesisht në veprime mbrojtëse.

819. Një raport i KVM-së i 12 marsit 1999 përmbante një përmbledhje të gjendjes në Kosovë për periudhën 23 shkurt - 11 mars 1999, duke bërë të ditur se gjendja ishte e tensionuar dhe se "kanë

²¹³³ P407 (Libri i Kaltër i OSBE/KVM-së), f. 100.

²¹³⁴ 6D1017 (Dega e RDB-së në Prishtinë, Informacion mbi UÇK-në, 28 janar 1999), f. 1.

²¹³⁵ 6D1017 (Dega e RDB-së në Prishtinë, Informacion mbi UÇK-në, 28 janar 1999).

²¹³⁶ John Crosland, T. 9898–9899 (8 shkurt 2007), P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor, 2006), para. 26. Këto vende ishin Dobratini, Magura, dhe Sedllari në komunën e Lipjanit; Bradashi në komunën e Podujevës; Likoci në komunën e Skënderajt; Gllanasella në komunën e Glllogocit; Ledovoça; Volljaka, Ujmiri, Dobërdoli, dhe Sverka në komunën e Klinës; Caraleva dhe Reçaku komunën e Shtimes; Duhla dhe Budakova komunën e Suharekës; Dragobili dhe Malisheva në komunën e Rahovecit; Juniku dhe Drenoci në komunën e Deçanit; Nerodimja dhe Starasella në komunën e Ferizajt; Bajgora në komunën e Mitrovicës; dhe në perëndim të Glllogjanit.

²¹³⁷ Jan Kickert, T. 11204 (7 mars 2007).

²¹³⁸ John Crosland, 3D508 (deklaratë dëshmitari e datës 7 dhjetor 2000), para. 23.

²¹³⁹ Frederick Abrahams, T. 955 (7 gusht 2006). Abrahams tha se gjatë kësaj kohe ai mund ta konsideronte UÇK-në "forcë luftarake të organizuar mirë".

²¹⁴⁰ 1D708 (Raport i MPB-së së Serbisë mbi Aksionet Terroriste dhe Provokimet në Kosovë nga 13 tetori 1998 deri më 10 shkurt 1999) në të cilin lexohet se gjatë kësaj periudhe ishin kryer gjithsej 747 "sulme dhe provokime", duke përfshirë 259 kundër civilëve dhe 488 kundër MPB-së, dhe se operacionet përfshinin sulme kundër fshatrave, ndërmarrjeve publike, bazave të MPB-së, dhe policëve; rrëmbimet e civilëve dhe pjesëtarëve të MPB-së; ndalje të makinave në postblloqe dhe konfiskimin me forcë të parave dhe pasurisë.

vazhduar sulmet e paprovokuara të UÇK-së kundër policisë.²¹⁴¹ KVM-ja gjithashtu theksonte shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut nga ana e autoriteteve të RFJ-së/Serbisë dhe UÇK-së, duke përfshirë arrestimet, rrëmbimet dhe vrasjet.²¹⁴² Maisonneuve dëshmoi se i kujtohej se më 13 mars 1999 UÇK-ja kishte kryer sulm me bomba në tregun në Mitrovicë në Kosovën veriore, duke vrarë dhe plagosur disa njerëz.²¹⁴³ Gjithashtu në mars 1999, UJ-ja raportoi se UÇK-ja kishte filluar hapjen e llogoreve, mobilizimin e popullatës vendëse, dhe krijimin e një korridorit për transportimin e armëve, municionit, dhe pajisjeve të tjera ushtarake nga Maqedonia në Kosovë.²¹⁴⁴

iv. Konkluzion në lidhje me dhunën e armatosur të zgjatur

820. Rrjedhimisht Dhoma nuk ka dyshim se dhuna e armatosur që filloi në Kosovë nga mesi i vitit 1998 dhe vazhdoi deri në fillimin e fushatës ajrore të NATO-s më 24 mars 1999, në të cilën u përfshinë forcat e UJ-së dhe MPB-së që luftonin kundër UÇK-së, ka pasur kohëzgjatje dhe ashpërsi të mjaftueshme për t'u cilësuar "dhunë e armatosur e zgjatur", elementi i parë i kushtit të një konflikti të brendshëm të armatosur. Fakti se forcat e UÇK-së kryen sulme të vazhdueshme kundër forcave të MPB-së dhe UJ-së, se autoritetet e RFJ-së miratuan një plan që parashikonte angazhimin e UJ-së në luftime kundër UÇK-së, dhe se UJ-ja dhe MPB-ja, duke përfshirë edhe forcat speciale policore, u angazhuan gjerësisht në operacionet luftarake kundër UÇK-së,²¹⁴⁵ tregon qartë se, deri nga mesi i vitit 1998, niveli i dhunës kishte arritur atë të konfliktit të armatosur, e jo të "trazirave të brendshme që karakterizohen nga akte të veçuara dhe sporadike të dhunës,"²¹⁴⁶ dhe provat e mëtejshme tregojnë për konflikt të vazhdueshëm deri më 24 mars 1999 dhe më pas.

²¹⁴¹ 3D179 (Raport i KVM-së mbi përmbushjen e kushteve nga palët në Kosovë, 12 mars 1999), f. 1, gjithashtu e pranuar si P444.

²¹⁴² 3D179 (Raport i KVM-së mbi përmbushjen e kushteve nga palët në Kosovë, 12 mars 1999), f. 3-4, gjithashtu e pranuar si P444.

²¹⁴³ Joseph Maisonneuve, T. 11142 (7 mars 2007).

²¹⁴⁴ 3D1050 (Raport i Komandës së Armatës së 3-të Dërguar Administratës së Sigurimit të Shtabit të Lartë të RFJ-së, 5 mars 1999); 3D1052 (Raport i Komandës së Armatës së 3-të Dërguar Administratës së Sigurimit të Shtabit të Lartë të RFJ-së, 13 mars 1999); 3D1053 (Raport i Komandës së Armatës së 3-të Dërguar Administratës së Sigurimit të Shtabit të Lartë të RFJ-së, 16 mars 1999); 3D1048 (Raport i Komandës së Armatës së 3-të Dërguar Administratës së Sigurimit të Shtabit të Lartë të RFJ-së, 2 mars 1999).

²¹⁴⁵ Shpjegues i KNKK-së për Nenin 3 të Konventave të Gjenevës, i cili u referohet konflikteve të armatosura jondërkombëtare, thekson si tregues të mundshëm të këtij lloji konflikti "se qeveria e ligjshme është e detyruar të kërkojë ndihmën e ushtrisë së rregullt kundër kryengritësve të organizuar si ushtri dhe që kontrollojnë një pjesë të territorit shtetëror." Jean Pictet – Koment: Konventa e Gjenevës III në Lidhje me Trajtimin e Robërve të Luftës (Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq, 1960). Eksperti ushtarak i Mbrojtjes Radovan Radinoviç, në aktekspertizën e tij deklaroi se, deri nga mesi i vitit 1998, përkrahja e UJ-së për forcat e MPB-së të përfshira në luftimin e terrorizmit në Kosovë kishte qenë sporadike dhe e kufizuar, por nga mesi i vitit 1998, UJ-ja u angazhua më shumë në këto operacione. 3D1116 (Aktekspertiza e Radovan Radinoviçit), para. 8.

²¹⁴⁶ Në shpjeguesin e KNKK-së për Protokollin Shtesë II Konventave të Gjenevës thuhet se "trazirat e brendshme që karakterizohen nga akte të izoluar ose sporadike të dhunës nuk... përbëjnë konflikt të armatosur në kuptimin ligjor."

b. UÇK-ja si grup i armatosur i organizuar

i. *Origjina, struktura, dhe fuqia*

821. Bedri Hyseni, ish-pjesëtar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në komunën e Ferizajt, dëshmoi se UÇK-ja ishte formuar si rezultat i shtimit të dhunës nga ana e forcave të RFJ-së/Serbisë në Kosovë në vitet '90. Kjo dhunë shkaktoi një ndjenjë gjithnjë e më të fortë në mesin e shqiptarëve kosovarë se duhej të ndërmerren hapa për t'u mbrojtur, meqenëse shmangia e sulmeve dukej e pamundshme.²¹⁴⁷ Bislim Zyrapi dëshmoi se qëllimi kryesor i UÇK-së ishte të çlironte "territoret e banuara me shumicë shqiptare," duke përfshirë pjesë të Malit të Zi, Serbisë dhe Maqedonisë.²¹⁴⁸

822. Nga fillimi i vitit 1998, UÇK-ja u zhvillua në organizim dhe kapacitete në atë masë sa John Crosland-i e përshkroi si "organizatë të organizuar dhe të pajisur mirë " në vjeshtë të atij viti.²¹⁴⁹ Dhoma ka dëgjuar dëshmi kontradiktore në lidhje me numrin e saktë të efektivit të UÇK-së, edhe pse disa dëshmitarë thanë se ajo ishte rritur gjatë viteve 1998 dhe 1999. Sipas Crosland-it, në fillim të vitit 1998 ishin rreth 400 luftëtarë të përbetuar të UÇK-së. Ky numër u rrit në fillim të vitit 1999, kur u bë "e qartë" se do të ndodhte ndërhyrja e NATO-s.²¹⁵⁰ Karol Drewienkiewicz-i gjithashtu dëshmoi se në dhjetor 1998 dhe janar 1999 UÇK-ja kishte disa qindra luftëtarë. Ai gjithashtu deklaroi se kishte edhe shumë njerëz të tjerë që mbronin fshatrat e tyre, por nuk luftonin në vendet e tjera.²¹⁵¹

823. Zyrapi deklaroi se gjatë periudhës që kishte qenë shef i Shtabit të UÇK-së, prej nëntorit 1998 deri në mars 1999, anëtarësia ishte vullnetare, por më vonë u bë mobilizimi i përgjithshëm.²¹⁵² Gjatë detyrës së tij si shef i Shtabit, numri i ushtarëve të UÇK-së ishte 17.000-18.000. Ai shpjegoi se jo të gjithë ishin ushtarë të përhershëm për shkak të mungesës së pajisjeve. Shumë njerëz merreshin me çështje të logjistikës dhe furnizimit.²¹⁵³ Këto shifra janë të ngjashme me vlerësimet e dhëna nga ish-shefi i Shtabit të UJ-së, Perishiqi, në direktivën e lëshuar më 28 korrik 1998, në të cilën parashtrohej plani *Grom 98*, ku thuhej se UÇK-ja kishte "15.000 pjesëtarë të armatosur, rreth

²¹⁴⁷ Bedri Hyseni, T. 3095 (11 shtator 2006), P2270 (deklaratë dëshmitari e datës 1 shtator 2001), f. 4.

²¹⁴⁸ Bislim Zyrapi, T. 6171–6172 (9 nëntor 2006).

²¹⁴⁹ John Crosland, T. 9779 (7 shkurt 2007).

²¹⁵⁰ John Crosland, T. 9777 (7 shkurt 2007). Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja dëshmitari tha se ky numër mund të jetë rritur për shkak të mundësisë së suksesit të UÇK-së. Ai gjithashtu e pranoi sugjerimin se "përkrahësit oportunistë" ishin deri në 3.000. John Crosland, T. 9896–9897 (8 shkurt 2007).

²¹⁵¹ Karol John Drewienkiewicz, T. 7790–7791 (4 dhjetor 2006).

²¹⁵² Bislim Zyrapi, T. 6031 (7 nëntor 2006), 6260–6261 (10 nëntor 2006). Zyrapi tha më 10 nëntor se nuk kishte pasur mobilizim të përgjithshëm derisa ai ishte në funksion, por kishte pasur "në fazë më të vonshme."

²¹⁵³ Bislim Zyrapi, T. 5959 (6 nëntor 2006).

5.000 pjesëtarë për forma të ndryshme të përkrahjes logjistike dhe rreth 2.500 terroristë të stërvitur në Republikën e Shqipërisë."²¹⁵⁴

824. Gjithashtu me kalimin e kohës u zhvillua edhe struktura e UÇK-së. Sipas Ibrahim Rugovës, fillimisht UÇK-ja përbëhej nga grupe të veçanta, por më vonë këto grupe u bashkuan nën një komandë të përbashkët.²¹⁵⁵ Stërvitja dhe organizimi i UÇK-së u fuqizuan edhe më shumë gjatë vitit 1998.²¹⁵⁶ Për shembull, Zyrapi tha se, kur hyri në Kosovë më 28 maj 1998, ai kishte qenë i ngarkuar me detyrë që të vazhdonte stërvitjen e ushtarëve të UÇK-së në përdorimin e armëve për operacione taktike si dhe të vlerësonte kapacitetet e "komandantëve të atëhershëm të shtabeve të zonave."²¹⁵⁷ John Crosland-i dëshmoi se, deri në fund të vjeshtës 1998, UÇK-ja ishte bërë një organizatë e organizuar dhe e pajisur mirë.²¹⁵⁸ Nga ana tjetër, Joseph Maisonneuve nga KVM-ja dëshmoi se gjatë kohës që kishte qenë në Kosovë, nga dhjetori 1998 deri në mes të marsit 1999, hierarkia komanduese e saj nuk kishte qenë "edhe aq e mirorganizuar." Ai dëshmoi se UÇK-ja kishte qenë e armatosur lehtë, i mungonte përvoja, dhe ishte e paaftë për veprime strategjike dhe aksione të koordinuara.²¹⁵⁹

825. Zyrapi përshkroi zhvillimin e një strukture mjaft të sofistikuar të UÇK-së gjatë vitit 1998. Ai dëshmoi se "nga këndvështrimi i UÇK-së, [në qershor 1998] UÇK-ja nuk ishte në nivelin e duhur të zhvillimit dhe organizimit, as në nivel të shtabeve vendore, as në nivel të shtabit të përgjithshëm."²¹⁶⁰ Fillimisht nuk ekzistonte një seli e vetme e Shtabit të Përgjithshëm, meqenëse disa nga anëtarët ishin në Shqipëri e disa në Kosovë. Në Kosovë, UÇK-ja ishte e organizuar në shtabe vendore në nivel fshati dhe lagjeje dhe në zona.²¹⁶¹ Urdhrat për veprime luftarake përgjithësisht lëshoheshin nga komandantët ose shtabet e zonave, për shkak të vështirësive të komunikimit me Shtabin e Përgjithshëm.²¹⁶² Nga pranvera e vitit 1998 e deri në fund të vitit, roli i Shtabit të Përgjithshëm ndryshoi me intensifikimin e luftimeve me forcat e RFJ-së/Serbisë deri në atë masë sa filloi të funksiononte si Shtab i Përgjithshëm i mirëfilltë në Kosovë.²¹⁶³ Gjatë periudhës së Zyrapit si shef i Shtabit, nga nëntori 1998 deri në mars 1999, Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së ishte i vendosur në Malet e Berishës, afër Malishevës në Kosovën qendrore.

²¹⁵⁴ 4D137 (Direktivë e Shtabit të Përgjithshëm për Dislokimin e UJ-së në Kosovë, 28 korrik 1998), f. 1.

²¹⁵⁵ Ibrahim Rugova, P2612 (transkript nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 4263–4264.

²¹⁵⁶ Bislim Zyrapi, T. 5932–5934 (6 nëntor 2006).

²¹⁵⁷ Bislim Zyrapi, T. 5932–5934 (6 nëntor 2006).

²¹⁵⁸ John Crosland, T. 9779 (7 shkurt 2007).

²¹⁵⁹ Joseph Maisonneuve, T. 11044–11045 (6 mars 2007), P2772 (deklaratë dëshmitari e datës 10 mars 2000), para. 53.

²¹⁶⁰ Bislim Zyrapi, T. 5939 (6 nëntor 2006).

²¹⁶¹ Bislim Zyrapi, T. 5934 (6 nëntor 2006).

²¹⁶² Bislim Zyrapi, T. 5935 (6 nëntor 2006).

²¹⁶³ Bislim Zyrapi, T. 5941–5943 (6 nëntor 2006).

826. Deri në fund të vitit 1998, UÇK-ja kishte lëshuar rregullore të përkohshme për organizimin e punëve të brendshme, të cilat u aktualizuan më vonë. Këto u shpërndareshin komandantëve të zonave dhe vartësve të tyre.²¹⁶⁴ Gjithashtu ekzistonte edhe sistemi i raportimit i komandantëve të zonave në Shtabin e Përgjithshëm,²¹⁶⁵ për garantimin e disiplinës ushtarake,²¹⁶⁶ dhe për emërimin e komandantëve në nivele të ndryshme.²¹⁶⁷ Deri në atë kohë, zonat e UÇK-së ishin organizuar në brigada, batalione, kompani, toga, dhe skuadra.²¹⁶⁸

827. Kosova ishte ndarë në shtatë zona operative të UÇK-së në nivel brigadash: zona dhe brigadat e Drenicës; zona dhe brigadat e Pashtrikut; zona dhe brigadat e Dukagjinit; zona dhe brigadat e Shalës; zona dhe brigadat e Llapit; zona dhe brigadat e Nerodimes; zona dhe brigadat e Karadakut.²¹⁶⁹ Secila zonë kishte një numër nga një deri në shtatë.²¹⁷⁰ Brenda secilës zonë, territori nën kontrollin e UÇK-së ndryshonte kohë pas kohe.²¹⁷¹

828. Zyrapi dëshmoi se komandantët e UÇK-së komunikonin me radio Motorola, telefona satelitorë, dhe me korrierë.²¹⁷² Gjithashtu, në territorin kontrolluar prej saj UÇK-ja kishte konfiskuar nga popullata civile makina si Niva, Suzuki, dhe Land Rover për përdorim në operacionet e UÇK-së.²¹⁷³ Zyrapi shtoi se UÇK-ja nuk kishte kazerma; por në vend të tyre ushtarët ishin vendosur në shkolla, objekte kolektive, dhe shtëpi.²¹⁷⁴

829. Zyrapi dëshmoi gjithashtu në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e operacioneve luftarake. Ai tha se Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së diskutonte me komandantin e zonës përkatëse çdo operacion të planifikuar për t'u kryer në atë zonë. Më tej komandanti i zonës vepronte sipas

²¹⁶⁴ Bislim Zyrapi, T. 5945–5946 (6 nëntor 2006); P2449 (Rregullore e Përkohshme e UÇK-së për Organizimin e Punëve të Brendshme në Ushtri, 1998).

²¹⁶⁵ P2461 (Urdhër i UÇK-së për Zonat Operative ku u kërkohe të përpilojnë raporte ditore luftimi në lidhje me ngjarjet e jashtëzakonshme, 12 janar 1999), f. 1; P2460 (Procesverbal i UÇK-së i mbledhjes së Shtabit të Përgjithshëm me Komandantët e Zonave Operative, 28 dhjetor 1998).

²¹⁶⁶ P2448 (Urdhër që nxit marrjen e masave të nevojshme për të përmirësuar disiplinën luftarake, 28 nëntor 1998); P2463 (Urdhër i Bislim Zyrapi, 13 shkurt 1999); P2464 (Urdhër i UÇK-së për masat disiplinore, 1 shkurt 1999).

²¹⁶⁷ P2465 (Propozim i UÇK-së i komandantit të Zonës Operative për emërimin e komandantit të brigadës, 7 mars 1999).

²¹⁶⁸ Bislim Zyrapi, T. 5960–5962 (6 nëntor 2006).

²¹⁶⁹ Bislim Zyrapi, T. 6258–6260 (10 nëntor 2006). Sipas Z. Zyrapi, brigadat e 111-të, 112-të, 113-të dhe 114-të ishin në Zonën e Drenicës. Brigadat 121, 122, 123, 124 dhe 125 ishin në Zonën e Pashtrikut. Brigadat 131, 132, 133, 134, 136, 137 dhe 138 ishin në Zonën e Dukagjinit. Brigadat 141 dhe 142 ishin në Zonën e Shalës dhe vepronin në pjesën perëndimore të komunës së Vushtrrisë në Kosovën veriore. Brigadat 151, 152, dhe 153 ishin në Zonën e Llapit dhe vepronin në pjesën lindore të Vushtrrisë në Kosovën veriore. Brigadat 161 dhe 162 ishin në Zonën e Nerodimes, dhe Brigada e 171-të ishte në Zonën e Karadakut. *Shih gjithashtu* P2469 (Hartë që tregon zonat operative të UÇK-së sipas përcaktimit të Bislim Zyrapi).

²¹⁷⁰ Bislim Zyrapi, T. 5933–5934 (6 nëntor 2006). *Shih gjithashtu* P2469 (Hartë që tregon zonat operative të UÇK-së sipas përcaktimit të Bislim Zyrapi).

²¹⁷¹ Bislim Zyrapi, T. 5967–5969 (6 nëntor 2006).

²¹⁷² Bislim Zyrapi, T. 5966 (6 nëntor 2006), 5981–5982 (7 nëntor 2006).

²¹⁷³ Bislim Zyrapi, T. 6190 (9 nëntor 2006).

udhëzimeve në urdhrin për operacionin. Ai ishte i autorizuar të lëshonte urdhrat e veta vetëm në rast sulmi të drejtpërdrejtë të forcave të RFJ-së/Serbisë në zonën e tij.²¹⁷⁵

830. Zyrapi më tej tha se, kur u inkuadrua në UÇK, drejtori për Çështje Ushtarake, Rexhep Selimi, e informoi se zonave operative dhe komandantëve në zona më të vogla u ishin shpërndarë broshurat e Kryqit të Kuq. Këto broshura përmbanin të gjitha rregullat e luftës. Gjithashtu, ushtarët e UÇK-së kryen "kurse të shkurtra" mbi ligjet e luftës dhe Konventat e Gjenevës.²¹⁷⁶ Rrjedhimisht, çdo komandanti zone i ishte dhënë libri i rregullores së UÇK-së dhe ata ishin përgjegjës për t'ia bërë të njohur përmbajtjen njësisive vartëse.²¹⁷⁷

831. Zyrapi gjithashtu dëshmoi se kur u emërua shef i Shtabit të Përgjithshëm në nëntor 1998,²¹⁷⁸ UÇK-ja zbatonte dënime me burg për të disiplinuar pjesëtarët e saj.²¹⁷⁹ Dënimet jepeshin nga një gjykatë ushtarake, me në krye një gjykatës ushtarak i emëruar në dhjetor 1998.²¹⁸⁰ Selia e kësaj gjykate ishte kryesisht në Malet e Berishës, por ajo mblidhej edhe në vende të tjera varësisht nga rrethanat. Detyra e gjykatës ishte hetimi i shkeljeve të rënda të ligjit.²¹⁸¹ Gjithashtu, nga dhjetori 1998 e deri në mars 1999, UÇK-ja kishte dy spitale ushtarake në Pashtrik dhe Drenicë, dhe secila zonë kishte nga një klinikë.²¹⁸²

ii. Furnizimet dhe përkrahja nga Shqipëria

832. Është fakt i pakundërshtuar se UÇK-ja transportoi furnizime në Kosovë nga Shqipëria fqinje dhe se Shqipëria u përdor si bazë për stërvitjen e luftëtarëve të UÇK-së.²¹⁸³ Gjithashtu, UJ-ja pretendoi se autoritetet shtetërore shqiptare e kishin përkrahur UÇK-në.²¹⁸⁴ Shefi i Degës së Çështjeve Kufitare në Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së në atë kohë, Rade Çuçak, dëshmoi se autoritetet e RFJ-së "konstatuan se në Shqipëri stërviteshin dhe armatoseshin kuadrot dhe se shumë

²¹⁷⁴ Bislim Zyrapi, T. 6181–6183 (9 nëntor 2006).

²¹⁷⁵ Bislim Zyrapi, T. 5958–5959 (6 nëntor 2006).

²¹⁷⁶ Bislim Zyrapi, T. 5955 (6 nëntor 2006).

²¹⁷⁷ Bislim Zyrapi, T. 5945–5947 (6 nëntor 2006).

²¹⁷⁸ Bislim Zyrapi, T. 5932 (6 nëntor 2006), 6021, 6049 (7 nëntor 2006), 6267–6268 (10 nëntor 2006).

²¹⁷⁹ Bislim Zyrapi, T. 6260 (10 nëntor 2006).

²¹⁸⁰ Bislim Zyrapi, T. 6060–6063 (7 nëntor 2006).

²¹⁸¹ Bislim Zyrapi, T. 5951–5952 (6 nëntor 2006). Zyrapi asnjëherë nuk ka thënë çfarë ligji ishte hetuar në këtë gjykatë.

²¹⁸² Bislim Zyrapi, T. 5975 (6 nëntor 2006).

²¹⁸³ Aktakuza, para. 93; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 15 korrik 2008, para. 297 (versioni publik); Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 15 korrik 2008, para. 25, 63, 90, 153; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 15 korrik 2008, para. 363 (versioni publik); Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 79, 162, 166, 230; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 15 korrik 2008, para. 20, 25–26 (versioni publik).

²¹⁸⁴ *Shih gjithashtu*, 3D738 (Letër e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dërguar Ministrisë Federale të Punëve të Jashtme, 16 korrik 1998).

armë që përdoreshin nga ata ishin të njëjta me armët e ushtrisë shqiptare."²¹⁸⁵ Bozhidar Deliqi gjithashtu pretendoi se qeveria dhe ushtria shqiptare kishin pasur dijeni të drejtpërdrejtë për stërvitjet e UÇK-së të kryera në territorin shqiptar.²¹⁸⁶ Më 16 dhjetor 1998, Stojanoviqi i dërgoi një telegram Administratës së Sigurimit të UJ-së, duke i bërë të ditur se luftëtarët e zënë rob të UÇK-së kishin pranuar se ekzistonin katër kampe të tilla në Shqipëri.²¹⁸⁷ Në telegram raportohej se stërvitja e UÇK-së përfshinte 10 deri 15 ditë stërvitje fizike, përdorim të armëve dhe qitje me armë, stërvitje taktike, dhe edukim politik.²¹⁸⁸ Stojanoviqi gjithashtu tha se kishte pasur raporte të rregullta të zbulimit për kontrabandë të armëve nga Shqipëria.²¹⁸⁹ Lubivoje Joksiqi, i cili ishte ndihmëskoordinator i RDB-së në Kosovë, gjithashtu tha se raportet e zbulimit tregonin se sigurimi shqiptar stërviste pjesëtarët e UÇK-së.²¹⁹⁰

833. Afërsia e kufirit shqiptar ishte vendimtare për rrugët e furnizimit të UÇK-së. Sipas Degës së Sigurimit të Komandës së Armatës së 3-të, kontrabanda e armëve nga Shqipëria ishte tashmë fakt në prill 1998.²¹⁹¹ Bislim Zyrapi konfirmoi se UÇK-ja merrte furnizime përmes rrugëve nga Shqipëria në Kosovë, disa prej të cilave kalonin nëpër Gjakovë dhe Malet e Junikut.²¹⁹² Dhe vërtet, sipas John Crosland-it, Juniku konsiderohej zonë strategjike për furnizime për shkak të vendndodhjes së tij dhe kontrollohej nga UÇK-ja më 1998.²¹⁹³ Ai shtoi se kufiri me Shqipërinë ishte i depërtueshëm dhe kështu rrugët e furnizimit të UÇK-së funksiononin mirë.²¹⁹⁴ Zyrapi gjithashtu tha se UÇK-ja kontrollonte rrugët nga Maqedonia për në Kaçanik, në Kosovën juglindore.²¹⁹⁵ Branko Gajiqi dëshmoi se UJ-ja kishte identifikuar "shtatë kanale" nëpërmjet të cilave vinin armë dhe pajisje për UÇK-në nga Maqedonia.²¹⁹⁶ Nga fillimi i vitit 1999, edhe MPB-ja filloi të deklaronte se nëpërmjet kufirit me Maqedoninë po vinin armë dhe pajisje.²¹⁹⁷

²¹⁸⁵ Rade Çuçak, T. 14824–14825 (31 gusht 2007).

²¹⁸⁶ Bozhidar Deliq, T. 19434 (4 dhjetor 2007).

²¹⁸⁷ 5D1308 (Raportet të Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 16 dhjetor 1998), f. 1.

²¹⁸⁸ 5D1308 (Raportet të Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 16 dhjetor 1998), f. 2.

²¹⁸⁹ Momir Stojanoviç, T. 19693 (6 dhjetor 2007).

²¹⁹⁰ Lubivoje Joksiqi, T. 21982–21984 (11 shkurt 2008).

²¹⁹¹ 5D1304 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së Armatës së 3-të, 18 prill 1998), f. 1; 3D991 (Raport luftimi i PrK-së dërguar Armatës së 3-të dhe Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 17 prill 1998).

²¹⁹² Bislim Zyrapi, T. 6226–6230 (9 nëntor 2006).

²¹⁹³ John Crosland, T. 9917–9918 (8 shkurt 2007).

²¹⁹⁴ John Crosland, T. 10037 (9 shkurt 2007).

²¹⁹⁵ Bislim Zyrapi, T. 6226–6229 (9 nëntor 2006).

²¹⁹⁶ Branko Gajiq, T. 15204 (7 shtator 2007); *shih gjithashtu* 3D738 (Letër nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së, 16 korrik 1998), f. 3.

²¹⁹⁷ 6D1018 (Raport i RDB-së për Aktivitetet e Terroristëve Shqiptarë për të Krijuar Kanale Ilegale përmes Kufirit Maqedoni-Jugosllavi, 15 shkurt 1999).

834. Ndihma financiare për UÇK-në vinte nga shumë shqiptarë të Kosovës që jetonin jashtë, shumë prej të cilëve ishin në Zvicër, Shqipëri, Itali, dhe Britani të Madhe.²¹⁹⁸ Fondi i quajtur *Vendlindja Thërret* për mbështetje të përgjithshme për veprimet e UÇK-së "e kishte bazën në diasporë." Kontributet vullnetare gjithashtu vinin edhe nga brenda Kosovës.²¹⁹⁹

iii. Armët dhe furnizimet

835. UÇK-ja i përdori paratë për të blerë armë jashtë vendit.²²⁰⁰ Frederick Abrahams dëshmoi se pas rënies së strukturave shtetërore në Shqipëri në mars 1997, sasi të mëdha armësh u transferuan në Kosovë.²²⁰¹ Sipas Crosland-it, nga fillimi i vitit 1998 UÇK-ja kishte depo të konsiderueshme armësh.²²⁰² Duke filluar nga fundi i vitit 1998, u shënuar "ngritje sasiore" të furnizimeve dhe armëve që e shtoi aftësinë e UÇK-së për të përballuar dhe sulmuar forcat e UJ-së dhe MPB-së.²²⁰³ Rreth tetorit 1998, ata përdornin armë të vogla moderne, duke përfshirë pushkë të reja, automatikë, autoblanda, mina kundërtanke dhe uniforma.²²⁰⁴ Bozhidar Deliqi bëri të ditur se UÇK-ja kishte "armët më moderne snajper."²²⁰⁵ Në dhjetor 1998, njësitë e tij gjetën dy stoqe armësh dhe pajisjesh ushtarake pas përleshjeve me UÇK-në. Aty përfshiheshin bomba dore, granata për granatahedhës, disa pushkë kallashnikov, pushkë gjysmëautomatike PAP, granatahedhës dore, predha mortaje dhe TNT.²²⁰⁶ Mirëpo, Karol Drewienkiewicz dëshmoi se në dhjetor 1998 UÇK-ja nuk kishte armatime të rënda si tanke dhe kjo u konfirmua nga Maisonneuve, i cili tha se nga dhjetori 1998 deri në mes të marsit 1999 UÇK-ja kishte qenë e armatosur lehtë, pa automjete të rënda.²²⁰⁷

836. Zyrapi, Ciaglini, dhe Crosland-i përshkruan lloje të ndryshme të armëve të përdorura nga UÇK-ja, që kryesisht ishin revole, kallashnikovë, dhe pushkë gjysmëautomatike. Ata dëshmuan se ajo kishte disa mitraloza të lehtë dhe të rëndë, disa topa pa dridhje, mina kundërtanke, dy deri në tri bomba për çdo ushtar, RPG (granatahedhës dore) me rreze 150 - 500 metra, disa Zola, pushkë snajper, dhe mortaja 82 dhe 120-milimetërshe.²²⁰⁸

²¹⁹⁸ John Crosland, 3D510 (deklaratë dëshmitari e datës 30 qershor 2006), para. 29.

²¹⁹⁹ Bislim Zyrapi, T. 6016 (7 nëntor 2006).

²²⁰⁰ Michael Phillips, T. 11879–11883 (19 mars 2007); 2D18 (Pjesë nga fletorja e Michael Phillips-it), f. 4; Klaus Naumann, T. 8364–8365 (14 dhjetor 2006); Bislim Zyrapi, T. 5920 (6 nëntor 2006).

²²⁰¹ Frederick Abrahams, T. 954 (7 gusht 2006), P2228 (deklaratë dëshmitari e datës 24 janar 2002), f. 9.

²²⁰² John Crosland, T. 9898 (8 shkurt 2007).

²²⁰³ John Crosland, T. 10005 (9 shkurt 2007).

²²⁰⁴ John Crosland, 3D505 (deklaratë dëshmitari e datës 15 korrik 2002), f. 72.

²²⁰⁵ Bozhidar Deliq, T. 19425 (4 dhjetor 2007).

²²⁰⁶ 5D876 (Analizë e Komandës së Brigadës së 549-të të Motorizuar të Operacioneve të Kryera Luftarake, 17 dhjetor 1998), f. 1–3.

²²⁰⁷ Karol John Drewienkiewicz, T. 7901 (5 dhjetor 2006); Joseph Maisonneuve, T. 11044–11045 (6 mars 2007).

²²⁰⁸ Bislim Zyrapi, T. 5979–5981 (7 nëntor 2006); Richard Ciaglini, T. 6923 (20 nëntor 2006); John Crosland, T. 9863 (8 shkurt 2007).

iv. Uniformat

837. Dhoma dëgjoi rrëfime të ndryshme nga dëshmitarët në lidhje me dukjen e uniformave të UÇK-së dhe shpeshësinë e përdorimit të tyre. Sipas Zyrarit, rreth marsit 1999, 85-90% e ushtarëve të UÇK-së kishin uniforma të UÇK-së, kurse të tjerët kishin uniforma të improvizuara me emblema të UÇK-së.²²⁰⁹ Këto uniforma ishin të ngjyrave të ndryshme, por të gjithë kishin të njëjtën emblemë të UÇK-së në krahun e majtë, që ishte e kuqe me shqiponjën e zezë në qendër dhe mbishkrimin "UÇK, Ushtria Çlirimtare e Kosovës,"²²¹⁰ dhe kjo vlente "pa marrë parasysh se a ishte uniformë standarde apo e improvizuar."²²¹¹ K14 dëshmoi se disa pjesëtarë të UÇK-së që ishin me rroba civile, gjithashtu kishin edhe "kapela."²²¹² Sipas Zyrarit, e njëjta emblemë e UÇK-së ishte edhe në kapela. Ai konfirmoi se UÇK-ja nuk kishte pasur uniforma të mjaftueshme për shkak të furnizimit të kufizuar.²²¹³

838. Disa dëshmitarë thanë se jo të gjithë pjesëtarët e UÇK-së kishin pasur uniforma.²²¹⁴ Për shembull, mjeku i UÇK-së, Liri Loshi, dëshmoi se ushtarët e plagosur të UÇK-së që ai i kishte mjekuar shpesh, kishin uniformë, edhe pse për shembull disa pjesëtarë si ai, vishnin rroba civile.²²¹⁵

839. Zyrapi dëshmoi se UÇK-ja kishte pasur uniforma kamuflimi dhe jokamuflimi. Këto uniforma ishin të ngjyrave të ndryshme, meqenëse vinin nga vende dhe ushtri të ndryshme.²²¹⁶ Dëshmitari K73, pjesëtar i UJ-së i cili ishte dislokuar në Kosovë, dëshmoi se kur kishte parë pjesëtarë të UÇK-së, ata mbanin uniforma gjermane me emblemën "UÇK" në to.²²¹⁷ Sipas K79-ës, pjesëtar i PJP-së në vitet 1998 dhe 1999, pjesëtarët e UÇK-së kishin ose uniforma të kaltra punëtorësh, ose uniforma kamuflimi ngjyrë të gjelbër ose ngjyrë kafe.²²¹⁸ Provat e paraqitura nga Mbrojtja gjithashtu përforcojnë bindjen se uniformat e UÇK-së ishin të ndryshme. Shaban Fazlia dëshmoi se UÇK-ja mbante tri lloje të ndryshme uniformash – në fillim të zeza me maska të zeza, më pas uniforma të policisë serbe, dhe më vonë "gjithfarëlloj uniformash."²²¹⁹ Dëshmitarë e tjerë

²²⁰⁹ Bislim Zyrapi, T. 6269–6270 (10 nëntor 2006).

²²¹⁰ Bislim Zyrapi, T. 5975–5976 (6 nëntor 2006).

²²¹¹ Bislim Zyrapi, T. 6270 (10 nëntor 2006).

²²¹² K14, T. 10969 (2 mars 2007) (seancë e mbyllur); Bislim Zyrapi, T. 5975–5976 (6 nëntor 2006).

²²¹³ Bislim Zyrapi, T. 5975–5977 (6 nëntor 2006).

²²¹⁴ Frederick Abrahams, T. 952 (7 gusht 2006); K73, T. 3366–3367 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur); Liri Loshi, T. 5374 (26 tetor 2006).

²²¹⁵ Liri Loshi, T. 5374 (26 tetor 2006). Loshi tha se ai mbante rroba civile kur punonte, por pas punës nganjëherë "vishte uniformë."

²²¹⁶ Bislim Zyrapi, T. 5975–5977 (6 nëntor 2006). Bislim Zyrapi, T. 6215 (9 nëntor 2006); Sipas Bislim Zyrarit, Shqiponjat e Zeza, që udhëhiqeshin nga Idriz Balaj, vishnin uniforma të zeza. Shqiponjat e Zeza nuk janë përmendur në transkripte.

²²¹⁷ K73, T. 3366–3367 (14 shtator 2006) (seancë e mbyllur).

²²¹⁸ K79, T. 9588, 9604 (1 shkurt 2007).

²²¹⁹ Shaban Fazlia, T. 25204–25205 (11 prill 2008).

gjithashtu dëshmuar se UÇK-ja kishte përdorur uniforma të policisë.²²²⁰ Vladimir Marinkoviç, shef i zbulimit për Brigadën e 15-të të Blinduar, dëshmoi se UÇK-ja mbante uniforma ngjyrë ulliri në të gjelbër M-77, që ishin përdorur më parë nga Armata Popullore Jugosllave (APJ) dhe mbrojtja territoriale.²²²¹ Dragan Millenkoviç, pjesëtarë i PJP-së në Pejë, tregoi se ata kishin hasur në uniforma të hedhura të UÇK-së të prodhimit kinez dhe gjerman.²²²²

v. Konkluzion për UÇK-në si grup i organizuar i armatosur

840. Të gjitha këto prova në lidhje me strukturën dhe aktivitetet e UÇK-së tregojnë se, së paku duke filluar nga mesi i vitit 1998, ajo ishte "grup i organizuar i armatosur," në kuptimin e kushtit të paraqitur më lart. Megjithëse aspekte të ndryshme të organizimit dhe aktiviteteve të UÇK-së u zhvilluan me ritëm të ndryshëm gjatë kësaj periudhe, provat tregojnë për një tendencë graduale drejt centralizimit të pushtetit dhe koordinimit të përpjekjeve kundër forcave të RFJ-së/Serbisë. Gjatë vitit 1998, UÇK-ja formoi Shtabin e Përgjithshëm dhe shtatë shtabe të zonave në varësi të tij, përpiloi rregullore që përcaktonin strukturën e trupave dhe disiplinën ushtarake, kreu sulme të koordinuara kundër forcave të RFJ-së/Serbisë, krijoi një veprimtari financiare, kontrabandoi apo bleu stoqe të mëdha armësh, futi në përdorim emblemën e UÇK-së, dhe zbatoi plane strategjike për arritjen e qëllimeve të veta.

c. Konkluzionet

841. Duke u bazuar në provat e përmendura më lart, Dhoma konkludon se, duke filluar në vitin 1998 dhe jo më vonë se vera e atij viti, forcat e UJ-së dhe MPB-së, dhe UÇK-ja si grup i organizuar i armatosur, u përfshinë në dhunë të vazhdueshme të armatosur në tërë Kosovën, e cila vazhdoi deri në fillim të fushatës ajrore të NATO-së, që filloi më 24 mars 1999, dhe gjatë saj.²²²³ Siç diskutohet në hollësi më poshtë, me gjithë arritjen e Marrëveshjeve të Tetorit, midis dy palëve nuk pati "marrëveshje paqësore" dhe dhuna e armatosur vazhdoi edhe në vitin 1999. Rrjedhimisht midis RFJ-së dhe UÇK-së kishte konflikt të armatosur para dhe gjatë fushatës ajrore të NATO-s. Më tej Dhoma analizon provat në lidhje me aksionet e forcave të RFJ-së/Serbisë gjatë konfliktit të armatosur, në lidhje me akuzat në paragrafët 94 - 96 të Aktakuzës.

²²²⁰ Radojica Nikçeviq, T. 23239–23241 (26 shkurt 2008).

²²²¹ Vladimir Marinkoviç, T. 20265 (14 dhjetor 2007); 5D947 (Raport Luftimi i Brigadës së 15-të të Blinduar dërguar PrK-së, 2 maj 1999).

²²²² Dragan Millenkoviç, T. 22959 (21 shkurt 2008).

²²²³ Radovan Radinoviç, T. 17279 (19 tetor 2007). Radinoviç i referohet konfliktit si "luftë e brendshme etnike në çdo moment." Në 2001, në një raport të UJ-së dhe në një përmbledhje të dokumenteve pranohet se në vitin 1998 luftimet midis RFJ-së dhe UÇK-së u përshkallëzuan nga "kryengritje e hapur e armatosur në konflikt të brendshëm të armatosur." *Shih* P1011 (Ivan Markoviç, ed., *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* (2001)), f. 15, 41–73. Raporti gjithashtu përmban një diskutim të gjatë për përdorimin e të drejtës dhe standardeve

C. PËRDORIMI I FORCËS NGA FORCAT E RFJ-SË/SERBISË MË 1998

1. Akuzat për përdorim të tepruar dhe pa dallim të forcës nga forcat e RFJ-së/Serbisë

842. Përgjithësisht Aktakuza pretendon se të gjithë të Akuzuarit ishin në dijeni, dhe shumica prej tyre ndihmuan ose miratuan veprimtarinë kriminale të forcave të RFJ-së dhe të Serbisë në Kosovë në vitin 1998, siç është përshkruar në paragrafët 94 - 95 të Aktakuzës. Këta paragrafë mbulojnë një hapësirë mjaft të madhe gjeografike dhe kohore, duke identifikuar disa vende të ndryshme ku thuhet se kanë ndodhur incidentet nga shkurti deri në shtator 1998.

843. Paragrafi 96 i Aktakuzës pretendon se këto incidente, dhe operacionet gjatë të cilave ndodhën, u karakterizuan nga përdorim i tepruar dhe pa dallim i forcës kundër popullatës civile shqiptare kosovare, deri në atë masë sa deri në fund të vitit 1998 u shpërngulën 349.000 shqiptarë kosovarë. Paragrafi 97 pretendon se Kombet e Bashkuara, organizatat e të drejtave të njeriut, diplomatët e huaj, OSBE-ja, mediat e vendit dhe ndërkombëtare, dhe udhëheqësit e shqiptarëve të Kosovës në takime me udhëheqjen civile dhe ushtarake të RFJ-së dhe të Serbisë ishin ankuar për përdorimin e tepruar dhe pa dallim të forcës.

844. Paraprakisht, Dhoma vë në dukje se asnjë nga të Akuzuarit nuk ngarkohet me përgjegjësi për krimet e kryera në vitin 1998. Prokuroria i thekson veprimet kriminale në vitin 1998 nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë si provë se të Akuzuarit ishin pjesëtarë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale dhe se ata kishin synimin e nevojshëm kriminal të nevojshëm për kryerjen e krimeve të akuzuara dhe " gjithashtu për qëllime të tjera, për të provuar dijeninë, qëllimin, mundësitë komanduese, apo vetë si pjesë e ngjarjeve që ndodhën në Kosovë dhe që rezultuan në krimet e kryera në kohën që mbulon aktakuza."²²²⁴ Incidentet konkrete të përshkruara në paragrafët 94 dhe 95 të Aktakuzës u shtjelluan në hollësi nga Prokuroria me urdhër të Dhomës Gjyqësore në fazën paragjyqësore, e cila i konsideroi ato "fakte materiale që duhet të argumentohen bindshëm."²²²⁵ Dhoma Gjyqësore gjithashtu konkludoi se, që Prokuroria të mund të mbështetej në krimet e mundshme të kryera në vitin 1998, ajo duhej të provonte se ato krime ishin kryer.²²²⁶

ndërkombëtare nga ana e forcave të RFJ-së/Serbisë gjatë konfliktit, duke vënë në dukje posaçërisht theksimin nga ana e të Akuzuarit Pavkoviç të nevojës për t'u përmbajtur ligjeve ndërkombëtare për luftën.

²²²⁴ Përgjigje e Prokurorisë ndaj Përgjigjes së Millutinoviçit në lidhje me Mocionin e Prokurorisë për Ndryshimin e Aktakuzës dhe Kundërshtimin e Aktakuzës së Ndryshuar të Përbashkët, 17 tetor 2005, para. 5, note 10.

²²²⁵ Vendim në lidhje me Mocionet e Mbrojtjes që Pretendon Mangësi në Formën e Propozuar të Aktakuzës së Ndryshuar të Përbashkët, 22 mars 2006, para. 15.

²²²⁶ Vendim në lidhje me Mocionet e Mbrojtjes që Pretendon Mangësi në Formën e Propozuar të Aktakuzës së Ndryshuar të Përbashkët, 22 mars 2006, para. 17.

2. Argumentet e palëve

845. Nuk kundërshtohet fakti se më 1998 forcat e RFJ-së dhe të Serbisë kryen operacione ushtarake anembanë Kosovës. Sidoqoftë palët nuk pajtohen në lidhje me natyrën e këtyre operacioneve, dëmet dhe shkatërrimin e shkaktuar në zonat civile, dhe përgjegjësinë për incidentet konkrete.

846. Prokuroria pretendon se UJ-ja dhe MPB-ja kryen operacione të përmasave të mëdha kundër popullatës civile në Kosovë në vitin 1998 me qëllim dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga shtëpitë e tyre. Bashkësia ndërkombëtare i dënoi këto veprime (si dhe krimet e UÇK-së), dhe Komisari i Lartë për Refugjatë i Kombeve të Bashkuar vlerësoi se nga marsi deri në tetor 1998, rreth 285.000 njerëz – afërsisht 15% e popullatës në Kosovë – ishin shpërngulur brenda Kosovës ose ishin larguar nga krahina.²²²⁷

847. Nga ana e saj, Mbrojtja e Millutinoviçit thekson se gjatë pranverës dhe verës së vitit 1998, një e treta e Kosovës ishte nën kontrollin e UÇK-së, siç është përmendur më lart. Më shumë se 4.500 njerëz ishin dëbuar nga shtëpitë e tyre nga UÇK-ja, dhe më shumë se 80 fshatra të banuara me serbë, malazezë, dhe joshqiptarë të tjerë ishin spastruar etnikisht. Pati thirrje drejtuar organeve shtetërore "për të mbrojtur popullin... sepse operacionet e kryera nga këto banda terroriste rrezikonin gjithçka."²²²⁸ Mbrojtja e Pavkoviçit thotë se të gjitha aksionet e ndërmarra nga UJ-ja në vitin 1998 ishin të ligjshme, legjitime dhe në pajtim të plotë me të drejtën humanitare ndërkombëtare.²²²⁹ Mbrojtja e Llazareviçit thotë se dëshmitë e dëshmitarëve të ftuar nga vetë Prokuroria tregojnë se nuk kishte ankese në lidhje me UJ-në në përgjithësi, se ata kishin vepruar pa përdorur forcë të tepruar, dhe se UJ-ja nuk kishte marrë pjesë në djegien e fshatrave, shkatërrimin e të mbjellave, vrasjen e bagëtive, dhe krime të tjera gjatë gushtit dhe shtatorit 1998.²²³⁰ Pretendohet se dëshmitë tregojnë se Llazareviçi i kishte zëvendësuar komandantët e njësive në të cilat disiplina ishte përkeqësuar.²²³¹ Mbrojtja e Llukiqit thotë se që prej fillimit të vitit 1998 UÇK-ja e shtoi intensitetin dhe numrin e sulmeve në Kosovë dhe se ajo kontrollonte pjesë të mëdha të territorit. Rrjedhimisht autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë kishin arsye legjitime që të kryenin operacione kundërterroriste kundër saj.²²³²

²²²⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 51–69.

²²²⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviçit, 15 korrik 2008, para. 164.

²²²⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 124.

²²³⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 571–575.

²²³¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 644.

²²³² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 17–38.

3. Incidentet konkrete të pretenduara

848. Prokuroria është bazuar shumë në dëshminë e atashut britanik të mbrojtjes, John Crosland, në lidhje me situatën në Kosovë në vitin 1998 dhe veprimet e UJ-së dhe MPB-së gjatë asaj kohe. Crosland-i e vizitoi disa herë Kosovën në vitin 1998, së bashku me atashetë e tjerë dhe grupe të ndryshme të diplomatëve të huaj dhe drejtuesve politikë. Gjatë këtyre udhëtimeve ai përgatiti raporte me vëzhgimet e tij të asaj kohe për qeverinë britanike. Disa nga këto raporte janë pranuar si prova. Dhoma Gjyqësore e konsideron Crosland-in profesionist të vërtetë, me shume përvojë dhe dije, që i kanë mundësuar të hartojë raporte të hollësishme dhe të bazuara në informacion për gjendjen në Kosovë në vitin 1998. Dëshmia e tij me gojë dhe deklaratat me shkrim ishin të hollësishme, të paanshme, dhe bindëse. Dhoma e konsideron dëshminë e tij për gjërat që i kishte parë të besueshme, me gjithë kundërshtimet e bëra nga Mbrojtja në lidhje me përdorimin nga ana e tij të shprehjes "të rrafshuara" për të përshkruar gjendjen e fshatrave të caktuara.

849. Mirëpo pas paraqitjes nga ana e saj të akuzave të rënda në lidhje me ngjarjet e vitit 1998, disa prej të cilave mund të përbëjnë veprime kriminale të kryera nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, Prokuroria paraqiti shumë pak prova shtesë në lidhje me disa nga këto "krime." Si rrjedhojë, edhe pse Dhoma ka krijuar përshtypjen e përgjithshme për dhunë të konsiderueshme dhe shkatërrim në vitin 1998, Prokuroria nuk ka provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se UJ-ja ose MPB-ja kanë kryer krimet konkrete në shumicën e vendeve të përmendura në paragrafët 94 dhe 95 të Aktakuzës.

a. Drenicë – shkurt dhe mars

850. Sipas paragrafit 94 të Aktakuzës, në shkurt dhe mars 1998, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë u përleshën me UÇK-në në zonën e Drenicës, ku ato granatuan qytetet dhe fshatrat të banuara kryesisht me shqiptarë dhe i dëbuan banorët nga shtëpitë e tyre. Kjo zonë përfshin komunat e Skënderajt, Glllogocit, dhe Klinës.

851. Sabit Kadriu, ish-kryetar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (organizatë që mblodhi fakte për shkeljet e të drejtave të njeriut në Kosovë), tha se më 28 shkurt 1998, kishte dëgjuar nga shtëpia e tij në fshatin Brusnik në komunën e Vushtrisë zjarr artilerie në Qirez dhe Likoshan. Pas kësaj, ai dhe vëllai i tij folën me një grup njerëzish në dalje të fshatit Duboc, të cilët u kishin thënë se "forcat serbe" i kishin rrethuar fshatrat Likoshan, Qirez, Baks, dhe Gradicë. "Forcat serbe" kishin luftuar me UÇK-në dhe dy policë ishin vrarë në Qirez një ditë më herët.²²³³ Kadriu mbërriti në Qirez më 1 mars 1998 dhe në hyrje të fshatit u takua me një grup

²²³³ Sabit Kadriu, T. 5106–5108 (18 tetor 2006). Kadriu dëshmoi se ai nuk e kishte verifikuar vetë vrasjen e policëve, por për këtë gjë i kishin treguar më vonë; Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë dëshmitari e datës 10 dhjetor 2000), f. 5.

njerëzish, të cilët i treguan për vrasjet aty.²²³⁴ Ai më vonë u takua me familjarët e familjes Sejdiu, të cilët i treguan se njësitë policore dhe ushtarake e kishin rrethuar fshatin. Ata i thanë se katër vëllezër nga familja e tyre ishin vrarë nga "forcat serbe," një grua ishte vrarë në shtëpinë e saj,²²³⁵ dhe dy njerëz ishin vrarë në rrugë. Më tej Kadriu mësoi se "forcat serbe" kishin vrarë 11 anëtarë të familjes Ahmeti, duke përfshirë edhe fëmijë, kurse mendohej se gratë ishin përdhunuar.²²³⁶ Të nesërmen, ai pa kufomat e masakruara të 24 vetëve që ishin vrarë në sulmin e 28 shkurtit.²²³⁷ Ai dëshmoi se as familja Sejdiu, e as familja Ahmeti nuk kishin qenë pjesëtarë të UÇK-së. Një çift nga Qirezit që u vranë, kishin qenë të armatosur për të mbrojtur shtëpinë e tyre, por edhe ata nuk kishin pasur lidhje me UÇK-në.²²³⁸

852. Hulumtuesi i Human Rights Watch, Frederick Abrahams, i cili bëri rreth pesë udhëtime në Kosovë nga shkurti 1998 deri në mars 1999, tha se forcat e policisë speciale e sulmuan Qirezit më 28 shkurt dhe Likoshanin më 1 mars 1998. Ai tha se ndërsa UÇK-ja po luftonte, forcat e policisë shtinë pa dallim në gra, fëmijë, dhe joluftëtarë të tjerë. Ai tha se në këto sulme ishin vrarë 83 njerëz, ndër të cilët 24 gra dhe fëmijë, duke marrë në konsideratë edhe sulmin në shtëpinë e familjes Jashari përmendur më poshtë.²²³⁹ Mirëpo vizita e tij e parë në zonën e Drenicës për hetimin e këtyre incidenteve ishte më 24 maj 1998, dy muaj më vonë.²²⁴⁰ Gjatë hetimeve të tij, ai foli me dëshmitarë okularë, ndër të cilët edhe një burrë i cili i tregoi se kishte parë kur policia kishte qëlluar me armë zjarri në fytyrë dhëndrin e tij dhe Abide Sejdiun, djemtë e së cilës ishin ekzekutuar.²²⁴¹

853. Dhoma nuk ka marrë prova të tjera në lidhje me vrasjet që ndodhën gjatë operacionit më 28 shkurt dhe 1 mars 1998, në Qirez dhe Likoshan, apo për granatimin dhe dëbimin e shqiptarëve kosovarë nga qytetet dhe fshatrat në zonën e gjerë të Drenicës gjatë këtyre muajve. Pa prova të tjera të drejtpërdrejta në lidhje me veprimet e UÇK-së në atë zonë, të cilat shkaktuan operacionet konkrete të forcave të RFJ-së/Serbisë në atë kohë ose hollësitë e ngjarjeve, Dhoma nuk është në gjendje të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se forca e përdorur ka qenë e tepruar apo pa dallim, edhe pse vrasja e grave dhe fëmijëve tregon se duhet të ketë ndodhur kështu.

²²³⁴ Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë dëshmitari e datës 10 dhjetor 2000), f. 5–6.

²²³⁵ Sabit Kadriu, T. 5107–5109 (18 tetor 2006).

²²³⁶ Sabit Kadriu, T. 5110–5111 (18 tetor 2006), P2377 (deklaratë dëshmitari e datës 10 dhjetor 2000), f. 6. Sidoqoftë, gratë nuk janë intervistuar asnjëherë në lidhje me këto thashetheme.

²²³⁷ Sabit Kadriu, P2377 (deklaratë dëshmitari e datës 10 dhjetor 2000), f. 6.

²²³⁸ Sabit Kadriu, T. 5108–5109 (19 tetor 2006).

²²³⁹ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari e datës 24 janar 2002), f. 10.

²²⁴⁰ Frederick Abrahams, T. 919 (14 korrik 2006).

²²⁴¹ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari e datës 11 mars 1999), f. 3; P437 (Raport i Human Rights Watch i titulluar Humanitarian Law Violations in Kosovo).

b. Prekaz i Poshtëm – fillimi i marsit

854. Në Aktakuzë gjithashtu thuhet se në fillim të marsit 1998 forcat e RFJ-së dhe të Serbisë nisën një sulm kundër fshatit Prekaz i Poshtëm (komuna e Skënderajt) gjatë të cilit u vranë rreth 50 njerëz, duke përfshirë shumicën e anëtarëve të familjes Jashari.

855. Më 3 mars 1998 Sabit Kadriu përsëri dëgjoji zjarr pushkësh dhe artilerie, këtë herë nga drejtimi i fshatit Prekaz i Poshtëm. Ai foli me fshatarë nga Duboci, i cili gjendet afër Prekazit të Poshtëm,²²⁴² të cilët i treguan se ishte rrethuar shtëpia e Adem Jasharit dhe se kishte qenë një operacion i përbashkët i UJ-së dhe MPB-së.²²⁴³ Ai tha se këto forca kishin vazhduar ta granatonin shtëpinë brenda të cilës ishte familja, për tri ditë.²²⁴⁴

856. Frederick Abrahams tha se forcat e policisë speciale e sulmuan shtëpinë e Adem Jasharit më 5 mars 1998. Ai mendonte se sulmi kishte qenë pa dallim, edhe pse ai nuk kishte qenë i pranishëm si dëshmitar i incidentit dhe as nuk e kishte vizituar vendin më vonë.²²⁴⁵ John Crosland-i ishte në Kosovë më 5 mars 1998 dhe kishte parë forca të MPB-së prej 200 vetësh në postbllokun e Komoranit (komuna e Gllogocit), të cilat ai besonte se kishin pasur lidhje me sulmin në shtëpinë e familjes Jashari.²²⁴⁶

857. Velko Odalloviqi, i cili ishte Kryetar i Qarkut të Kosovës, një nga pesë qarqet administrative të Kosovës në atë kohë, dëshmoi se ai kishte dijeni për operacionin e MPB-së kundër familjes Jashari.²²⁴⁷ Ai tha se "organet e sigurimit" kishin provuar të arrestonin Jasharin, i cili ishte udhëheqës i njohur i UÇK-së, dhe gjatë kësaj orvatjeje ishin vranë civilë.²²⁴⁸ Në deklaratën për shtyp të MPB-së thuhej se "terroristët" kishin luftuar me policinë duke përdorur mitraloza, granatahedhës dore, pushkë automatike, dhe bomba dore.²²⁴⁹ Në një deklaratë tjetër për shtyp të MPB-së thuhej se "terroristët" kishin hapur zjarr kundër policisë, të cilët ishin përgjigjur me zjarr dhe se pjesëtarët e policisë u kishin dhënë anëtarëve të familjes afat prej dy orësh të largoheshin

²²⁴² Sabit Kadriu, T. 5059–5061 (18 tetor 2006). Kadriu ishte takuar me fshatarët e Dubocit (Skënderaj) në fshatin Brusnik (Vushtri).

²²⁴³ Sabit Kadriu, T. 5061 (18 tetor 2006).

²²⁴⁴ Sabit Kadriu, T. 5113–5114 (18 tetor 2006). Sidoqoftë, Kadriu pranoi se nuk kishte qenë aty në atë kohë.

²²⁴⁵ Frederick Abrahams, P2228 (deklaratë dëshmitari e datës 24 janar 2002), f. 10; P437 (Raport i Human Rights Watch i titulluar Humanitarian Law Violations in Kosovo), f. 26–31.

²²⁴⁶ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 28.

²²⁴⁷ Velko Odalloviq, T. 14397–14398 (24 gusht 2007).

²²⁴⁸ Velko Odalloviq, T. 14397 (24 gusht 2007).

²²⁴⁹ 1D551 (Deklaratë për Shtyp e MPB-së, 5 mars 1998), f. 1; 1D552 (Deklaratë për Shtyp e MPB-së, 6 mars 1998), f. 1.

nga shtëpia para se të hapnin zjarr. Beteja zgjati 72 orë dhe rezultoi në 51 të vdekur. Jashari u konsiderua përgjegjës për këto viktima.²²⁵⁰

858. Human Rights Watch raportoi se ishin vrarë Adem Jashari dhe me shumë pjesëtarë të familjes së tij, ndër të cilët gra dhe fëmijë.²²⁵¹ Në ditët pas vrasjeve, Sabit Kadriu kishte shkuar në një magazinë në periferi të qytetit të Skënderajt dhe kishte parë 50 kufoma të familjes Jashari dhe 11 kufoma të fshatarëve të tjerë, ndër të cilët gra dhe fëmijë, dhe i kishin thënë se aty i kishte sjellë MPB-ja.²²⁵² Crosland-i tha se në atë kohë në Prekaz të Poshtëm u vranë 54 vetë, ndër të cilët edhe 19 anëtarë të familjes Jashari, kufomat e të cilëve i fotografoi.²²⁵³

859. Megjithëse nuk vihet në dyshim se MPB-ja ndërmori një operacion kundër Adem Jasharit në mars 1998, rrethanat në të cilat ai dhe shumë anëtarë të familjes së tij u vranë, mbeten të diskutueshme. Dhoma Gjyqësore vëren se gazetari i njohur shqiptar kosovar, Veton Surroi, tregoi për një mbledhje në të cilën ai kishte marrë pjesë midis Presidentit të RFJ-së, Millosheviq dhe udhëheqësit të LDK-së, Ibrahim Rugova, më 15 maj 1998, në të cilën ai i kishte thënë Millosheviqit se incidenti i familjes Jashari ishte rast i pastër i brutalitetit policor dhe dhunës së tepruar kundër civilëve. Millosheviqi ishte përgjigjur se policia i pati dhënë familje disa orë afat për t'u dorëzuar, por Jashari i kishte mbajtur brenda dhe "i vrau vetë." Millosheviqi gjithashtu i kishte thënë se policia kishte urdhra të prera që të mos përdorte forcë të tepruar.²²⁵⁴

860. Pa prova të tjera të drejtpërdrejta në lidhje me mënyrën në të cilën u krye operacioni i MPB-së dhe kush kishte qenë përgjegjës për vrasjen e grave dhe fëmijëve në shtëpi, Dhoma nuk është në gjendje të konkludojë jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se incidenti përbënte përdorim të tepruar dhe pa dallim të forcës nga ana e forcave serbe.

c. Qyteti i Deçanit – prill

861. Në aktakuzë pretendohet se një pjesë e qytetit të Deçanit u shkatërrua nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë rreth Pashkëve të vitit 1998.

862. Siç është theksuar në Pjesën B të Kapitullit VI më lart, në vitin 1998 zona kufitare midis Shqipërisë dhe Kosovës, sidomos rreth Junikut në komunën e Deçanit, ishte zonë me veprimtari të konsiderueshme të UÇK-së. Rrjedhimisht në atë kohë forcat e RFJ-së dhe Serbisë kryen shumë operacione në zonën e Deçanit. John Crosland-i dëshmoi se "në zonën e Junikut, Ponoshecit,

²²⁵⁰ 1D553 (Deklaratë për Shtyp e MPB-së, 11 mars 1998), f. 1.

²²⁵¹ P437 (Raport i Human Rights Watch i titulluar "Humanitarian Law Violations in Kosovo," 1 tetor 1998), f. 26–34.

²²⁵² Sabit Kadriu, T. 5061–5062 (18 tetor 2006), P2377 (deklaratë dëshmitari e datës 10 dhjetor 2000), f. 6–7.

²²⁵³ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 28.

Prejlepit dhe Irzniqit pati luftime të vazhdueshme për rreth tre muaj [nga prilli deri në korrik] dhe veprimtari intensive nga të dy palët.²²⁵⁵ Ai tha se, si rezultat, shumica e fshatrave në atë rajon, përfshirë dhe Junikun, ishin "rrafshuar" në pranverën e vitit 1998.²²⁵⁶ Mbrojtja e Llazareviqit e kundërshtoi këtë pretendim të tij, konkretisht në lidhje me Junikun, duke thënë se një filmim i vizitës së ambasadorit të Shteteve të Bashkuara, Richard Holbrooke, në fund të qershorit 1998, tregonte se fshati ishte dëmtuar pak ose aspak, edhe pse Crosland-it nuk ia treguan filmimin.²²⁵⁷ Crosland-i këmbënguli në qëndrimin e tij. Dhoma e ka analizuar këtë filmim, por duke mos pasur dëshmi të tjera në lidhje me pjesët e Junikut të treguara në të, nuk është në gjendje të nxjerrë ndonjë konkluzion në lidhje me të.

863. Crosland-i dëshmoi se zona e Deçanit ishte me rëndësi strategjike për UÇK-në dhe se Juniku dhe Glllogjani ishin bastione të UÇK-së gjatë tërë vitit 1998.²²⁵⁸ Dragan Zhivanoviqi, i cili në atë periudhë ishte shef i Shtabit në Komandën e Brigadës së 125-të të Motorizuar, tha se disa fshatra në atë zonë ishin "plotësisht të armatosura" nga UÇK-ja, kurse të tjerat "pjesërisht të armatosura."²²⁵⁹

864. Crosland-i tha se më 24 mars 1998 pa "forcat serbe" duke u përgatitur për të kryer "sulm të përbashkët" në Deçan.²²⁶⁰ Konkretisht ai pa grumbullimin e forcave të UJ-së në atë zonë dhe vërejti se UJ-ja kishte filluar të jepte mbështetje me zjarr gjatë operacioneve nga pozicionet e artilerisë të cilat i mbante së bashku me JSO-në.²²⁶¹ Në deklaratën e tij me shkrim, Zhivanoviqi ka përshkruar dislokimin e Brigadës së 125-të të Motorizuar në Deçan nga prilli 1998. Ai tha se postëkomanda pararojë e brigadës u ngrit në Pejë,²²⁶² kurse Grupi i Luftimit 2 i saj, i formuar që "të ndihmonte MPB-në në kontrollimin e rrugës Pejë-Deçan-Gjakovë," ishte dislokuar me 10 tanke.²²⁶³ Zhivanoviqi tregoi se si më 27 prill 1998 urdhëroi Grupet e Luftimit 2 dhe 3 dhe Batalionin e 2-të Artilerik të Obusëve për të mbyllur vijën nga kufiri në drejtim të Pejës dhe Deçanit në "koordinim

²²⁵⁴ Veton Surroi, P2361 (deklaratë dëshmitari e datës 27 gusht 2001), f. 5.

²²⁵⁵ John Crosland, T. 9918–9919 (8 shkurt 2007).

²²⁵⁶ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 12.

²²⁵⁷ John Crosland, T. 9918–9921 (8 shkurt 2007); 5D1240 (filmim).

²²⁵⁸ John Crosland, T. 9917–9919 (8 shkurt 2007).

²²⁵⁹ Dragan Zhivanoviqi, P3062 (deklaratë dëshmitari në *Prokurori kundër Haradinajt, Balajt, dhe Brahimajt*, IT-04-84-T, 9 gusht 2007), para. 66.

²²⁶⁰ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 29.

²²⁶¹ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 30.

²²⁶² Dragan Zhivanoviqi, P3062 (deklaratë dëshmitari në *Prokurori kundër Haradinajt, Balajt, dhe Brahimajt*, IT-04-84-T, 9 gusht 2007), para. 18.

²²⁶³ Dragan Zhivanoviqi, P3062 (deklaratë dëshmitari në *Prokurori kundër Haradinajt, Balajt, dhe Brahimajt*, IT-04-84-T, 9 gusht 2007), para. 16.

me MPB-në dhe njësitë shoqëruese."²²⁶⁴ Ai pastaj tha se JSO-ja kishte qenë aktive në zonën e Deçanit dhe se njësitë e tij i kishin dhënë mbështetje JSO-së në dy raste.²²⁶⁵

865. Në një raport të datës 13 maj 1998, Crosland-i raportonte se PJP-ja dhe JSO-ja e patrullonin Kosovën perëndimore, duke përfshirë Deçanin, "në mënyrë shumë të ashpër."²²⁶⁶ Dy javë më vonë, kolegë të Crosland-it e shëtitën Kosovën perëndimore për të vëzhguar gjendjen dhe raportuan se MPB-ja nuk i kishte lejuar të hynin në Gjakovë dhe Deçan.²²⁶⁷ Më 26 maj, grupi pa një kolonë të policisë ushtarake duke lëvizur në drejtim të Deçanit, por në Xërxë nuk i kishin lejuar të përcillnin kolonën më tutje në drejtim të veriperëndimit. Pasi i kishte rënë rrotull për në Pejë, ku e kishte kaluar natën, grupi kishte provuar përsëri të shkonte në Deçan nga veriu. Në rrugën kryesore nga Peja për në Deçan ata kishin parë gëzhoja fishekësh dhe predhash, dhe kishin parë shtëpi të djegura në Strellc të Epërm dhe fshatrat e afërta, të cilët dukeshin të braktisura. Shqiptarët kosovarë vendës që kishin takuar, u kishin thënë se fshatrat ishin sulmuar më 25 maj dhe ishin vrarë 11 njerëz.²²⁶⁸ MPB-ja përsëri nuk e kishte lejuar grupin të hynte në Deçan.

866. Pjesëtari i PJP-së, K25, dëshmoi se në maj 1998, detashmenti i tij i PJP-së kishte marrë detyrë për të çliruar rrugën nga Peja në Deçan,²²⁶⁹ dhe për të kontrolluar postbolloqet në fshatrat Strellc i Epërm dhe Strellc i Poshtëm, për të ruajtur vijat e komunikimit.²²⁷⁰ Gjatë fazës së pyetjeve nga pala kundërshtare, ai tha ky operacion kishte qenë i nevojshëm sepse UÇK-ja e kishte pasur rrugën nën kontroll dhe bënte bastisje në postbolloqe, duke hapur zjarr kundër civilëve dhe duke plaçkitur pasuritë.²²⁷¹

867. Mehmet Mazrekaj, shqiptar kosovar nga Drenoci, fshat afër qytetit të Deçanit, përshkroi një ofensivë në atë zonë e cila kishte filluar më 29 maj 1998.²²⁷² Ai tha se "forcat serbe" i kishin granatuar fshatrat me topa të cilët ishin vendosur në një kodër që njihej me emrin "Te Podi i Gështenjave,"²²⁷³ duke shkaktuar ikjen e banorëve për në Irzniq ose në Shqipëri.²²⁷⁴ Gjatë fazës së pyetjeve nga pala kundërshtare, Mazrekaj pranoi se para se të fillonte ofensiva, UÇK-ja kishte

²²⁶⁴ Dragan Zhivanoviq, P3062 (deklaratë dëshmitari në *Prokurori kundër Haradinajt, Balajt, dhe Brahimajt*, IT-04-84-T, 9 gusht 2007), para. 65.

²²⁶⁵ Dragan Zhivanoviq, T. 20543 (18 janar 2008).

²²⁶⁶ P688 (Raport Konfidencial i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 13 maj 1998), f. 1.

²²⁶⁷ P687 (Raport Konfidencial i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 28 maj 1998), f. 1.

²²⁶⁸ P687 (Raport Konfidencial i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 28 maj 1998), f. 2–3.

²²⁶⁹ K25, T. 4734 (12 tetor 2006), P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 12 shtator 2001), f. 5. Sidoqoftë, *shih gjithashtu*, K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 6 shtator 2001), para. 15.

²²⁷⁰ K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 6 shtator 2001), f. 5.

²²⁷¹ K25, T. 4734 (12 tetor 2006).

²²⁷² Mehmet Mazrekaj, T. 5795 (2 nëntor 2006).

²²⁷³ Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklaratë dëshmitari e datës 4 shkurt 2000), f. 2–3. Gjatë dëshmisë, Mazrekaj iu referua zonës si "Podi i Gështenjave". Mehmet Mazrekaj T. 5816 (3 nëntor 2006).

ndërmarrë sulme kundër forcave të RFJ-së/Serbisë në komunë.²²⁷⁵ Fuat Haxhibeqiri, shqiptar kosovar, banor i Gjakovës dhe anëtar i Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, gjithashtu dëshmoi se "forcat serbe" kishin pasur topa të mëdhenj në komunën e Deçanit.²²⁷⁶

868. E vetmja dëshmi konkrete e paraqitur nga Prokuroria në lidhje me shkatërrimin e disa pjesëve të qytetit të Deçanit në atë kohë ishte ajo e diplomatit austriak Jan Kickert, i cili mori pjesë në një vizitë diplomatike në Deçan në fillim të qershorit 1998.²²⁷⁷ Ai dëshmoi se më 7 qershor qyteti ishte "mjaf i boshatisur" nga civilët.²²⁷⁸ Kickert vuri re "prani të madhe të policisë dhe fortifikime në qytet," kurse tanket e blinduara ishin dislokuar në zonën përreth.²²⁷⁹ Ai tha se shumë shtëpi ishin djegur dhe të shkatërruar, që tregonte se në qytet kishte pasur luftime.²²⁸⁰ Në një raport të shkruar nga Kickert-i më 8 qershor 1998 lexohet se, megjithëse dëmtimet në Deçan ishin të "konsiderueshme," ato nuk ishin aq të rënda sa kishte sugjeruar LDK-ja.²²⁸¹ Sidoqoftë, Kickert-i tha se gjurmët e "goditjeve të drejtpërdrejta" kishin qenë të dukshme dhe se këshilltarët e tij ushtarakë i kishin thënë se qenë përdorur predha të municionit të rëndë, por në masën më të madhe dëmet ishin shkaktuar nga zjarri i mitralozave. Ai më tej tha se kishte pasur dëme të konsiderueshme nga zjarri, që atashetë ushtarak kishin konkluduar se qenë shkaktuar nga zjarrvënia.²²⁸² Kickert-i tregoi për dëmtime të ngjashme në fshatin Prejlep, i cili gjithashtu kishte qenë pak a shumë i zbrazur nga banorët.²²⁸³

869. Dhoma është bindur se nga fillimi i prillit deri në fillim të qershorit 1998 forcat e UJ-së dhe të MPB-së morën pjesë në operacionet e ndërmarra në Kosovën perëndimore, duke përfshirë komunën e Deçanit. Si rezultat, shtëpitë në fshatrat në veri të qytetit të Deçanit dhe në vetë qytetin u dëmtuan ose shkatërruan si nga zjarri i armëve, po ashtu edhe nga djegia. Dhoma thekson se operacionet e forcave të RFJ-së/Serbisë mund të kenë qenë përgjigje legjitime kundër sulmeve dhe veprimeve të UÇK-së, megjithëse, nëse shtëpitë janë djegur qëllimisht, kjo tregon për veprime hakmarrëse kundër banorëve vendës shqiptarë kosovarë nga ana e forcave të UJ-së ose të MPB-së, përtej kufijve të pranueshëm të sjelljes. Mirëpo e vetmja dëshmi e këtyre djegieve ishte dëshmia e dorës së dytë e Kickert-it e vlerësimit të shprehur nga atashetë ushtarakë me të cilët kishte udhëtuar,

²²⁷⁴ Mehmet Mazrekaj, P2374 (deklarata dëshmitari e datës 4 shkurt 2000), f. 3.

²²⁷⁵ Mehmet Mazrekaj, T. 5816 (3 nëntor 2006).

²²⁷⁶ Fuat Haxhibeqiri, P2308 (deklarata dëshmitari e datës 28 gusht 2001), f. 4.

²²⁷⁷ Jan Kickert, 5D123 (deklarata dëshmitari e datës 14 maj 1999), f. 2.

²²⁷⁸ Jan Kickert, T. 11195 (7 mars 2007).

²²⁷⁹ P2666 (Mesazh i ambasadës austriake, 8 qershor 1998), f. 2.

²²⁸⁰ Jan Kickert, 5D123 (deklarata dëshmitari e datës 14 maj 1999), f. 2, para. 4; P2666 (Mesazh i ambasadës austriake, 8 qershor 1998), f. 2.

²²⁸¹ P2666 (Mesazh i ambasadës austriake, 8 qershor 1998), f. 2.

²²⁸² Jan Kickert, T. 11196 (7 mars 2007); P2666 (Mesazh i ambasadës austriake, 8 qershor 1998), f. 2.

²²⁸³ P2666 (Mesazh i ambasadës austriake, 8 qershor 1998), f. 2.

të cilën duke marrë parasysh rrethanat, Dhoma Gjyqësore nuk e konsideron të mjaftueshme për nxjerrjen e një përfundimi jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm.

d. Ofensiva e verës

870. Në paragrafin 95 të Aktakuzës, Prokuroria pretendon se nga mesi i korrikut 1998 forcat e RFJ-së dhe të Serbisë ndërmorën një ofensive të përmasave të mëdha anembanë Kosovës. Dhoma e ka shqyrtuar në nënpjesën 1, Pjesa B, Kapitulli VI. më lart hartimin dhe zbatimin e Planit kundër Terrorizmit në Kosovë, si dhe planin *Grom*, në të cilin morën pjesë si njësitë e UJ-së, po ashtu edhe të MPB-së. Megjithëse përpilimi dhe zbatimi i planeve të tilla në vetvete nuk janë të kundërligjshme, mënyra e zbatimit *do të* kishte qenë e kundërligjshme nëse do të ishin shkelur normat e të drejtës humanitare ndërkombëtare. Si rrjedhojë, në pjesën e mbetur të kësaj ndarjeje janë shqyrtuar pretendimet konkrete në paragrafin 95 të Aktakuzës në lidhje me zbatimin e ofensivës së verës.

i. *Duhël dhe Bllacë – fundi i korrikut*

871. Duhla dhe Bllaca janë fshatra në komunën e Suharekës, që gjenden afër rrugës kryesore Prizren-Prishtinë, në një zonë me rëndësi strategjike, me male në të dyja anët dhe me një qafë mali që njihet si Qafa e Duhlës. Prokuroria pretendon se granatimet e rënda në fund të korrikut 1998 shkaktuan "shkatërrime të papërligjura" në këtë zonë.

872. Dhoma Gjyqësore ka shqyrtuar disa dokumente që tregojnë se operacionet e MPB-së dhe UJ-së në zonën e Duhlës dhe Bllacës në korrik 1998 u kryen sipas Planit kundër Terrorizmit.²²⁸⁴ Nga disa prej këtyre dokumenteve del se këto operacione ishin të domosdoshme për parandalimin e marrjes ose mbajtjes nën kontroll nga UÇK-ja, të rrugës Suharekë - Shtime.²²⁸⁵ Gjithashtu, gjatë korrikut 1998, John Crosland-i vizitoi pjesë të ndryshme të Kosovës dhe shkroi raporte mbi lëvizjet dhe veprimet e forcave të UÇK-së dhe të UJ-së e MPB-së që kishte parë. Gjatë një vizite që bëri

²²⁸⁴ 4D129 (Raport i Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm, 20 qershor 1998); 3D999 (Raport i PrK-së dërguar Administratës së Sigurimit të Shtabit të Përgjithshëm, 17 korrik 1998), f. 1–2; 4D100 (Raport i PrK-së dërguar Armatës së 3-të në lidhje me angazhimin e njërive, 22 korrik 1998); 4D101 (Plan i PrK-së për angazhimin e njërive në Kosovë, 23 korrik 1998); 4D102 (Përgjigje Planit të PrK-së për angazhimin e njërive, 23 korrik 1998); P1418 (Kërkesë e PrK-së dërguar Armatës së 3-të, 31 korrik 1998); P1537 (Mesazh i PrK-së dërguar Komandantit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 7 gusht 1998); P1424 (Mesazh nga Komanda e Brigadës së 243-të dërguar PrK-së, 8 gusht 1998).

²²⁸⁵ 4D129 (Raport i Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm, 20 qershor 1998), f. 2; 4D100 (Raport i PrK-së dërguar Armatës së 3-të në lidhje me angazhimin e njërive, 22 korrik 1998); 4D101 (Plan i PrK-së për angazhimin e njërive në Kosovë, 23 korrik 1998).

më 28 dhe 29 korrik 1998, Crosland-i shkroi se kishte dëgjuar zhurmën e zjarrit të artilerisë në zonën e Duhlës dhe Bllacës dhe kishte parë tym që ngrihej andej.²²⁸⁶

873. Dëshmitë në lidhje me kryerjen e operacioneve të UJ-së dhe MPB-së në zonën e përgjithshme të Suharekës dhe sidomos në zonën e Duhlës dhe Bllacës, nuk provojnë se këto forca shkaktuan "shkatërrim të papërligjur" përmes granatimit të rëndë të zonës.

ii. Fshatrat në Kosovën perëndimore, përfshirë Junikun, Jabllanicën, dhe Prejlepin.

874. Dhoma ka marrë një sasi të konsiderueshme provash në lidhje me operacionet e MPB-së dhe UJ-së të kryera në Kosovën perëndimore në korrik, gusht, dhe shtator 1998, gjatë zbatimit të Planit kundër Terrorizmit, veçanërisht në Junik, Gllogjan, dhe Jabllanicë, të cilët ishin bastione të UÇK-së. Nuk është e nevojshme të përmenden të gjitha provat që kanë të bëjnë me këto operacione. Mjafton të thuhet se ato përmbajnë urdhra ushtarake dhe raporte luftarake, vëzhgime të asaj kohe të Crosland-it, deklarata të regjistruara gjatë mbledhjeve të Komandës së Përbashkët, dhe dëshmi të policëve dhe ushtarëve që morën pjesë në këto operacione.²²⁸⁷

875. Në lidhje me pretendimet në paragrafin 95 se deri në shtator 1998 fshati Prejlep ishte "rrafshuar" dhe se rreth gjysma e fshatrave në komunën e Deçanit ishin granatuar dhe djegur, Dragan Zhivanoviç tha se njësitë e tij e kishin mbështetur MPB-në në operacionin e përbashkët të kryer në rrugën Deçan-Gjakovë në fillim të gushtit 1998, gjatë të cilit u morën Prejlepi dhe Irzniqi në verilindje të Junikut. Grupi Luftarak 3 i Brigadës së 125-të të Motorizuar "së pari bllokoi rrugën në mes Drenocit dhe Rastavicës për t'u mundësuar njësitë të MPB-së që të hynin në Prejlep e

²²⁸⁶ P685 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 30 korrik 1998), f. 1–2.

²²⁸⁷ *Shih gjithashtu*, 4D102 (Përgjigje Planit të PrK-së për angazhimin e njësitë, 23 korrik 1998), f. 1; Zharko Kostiq, T. 17518–17519 (23 tetor 2007), 4D501 (deklaratë dëshmitari e datës 28 shtator 2001), para. 25; 6D1318 (Urdhër i Komandës së PrK-së, Postëkomanda Pararojë, 24 korrik 1998), f. 1; P685 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 30 korrik 1998), f. 2; P1146 (Raport Ditor i Qarkut Ushtarak të Pejës dërguar Qarkut Ushtarak të Prishtinës, 30 korrik 1998), para. 1; K25, P2439 (deklaratë dëshmitari e datës 6 shtator 2001), f. 5–6, T. 4662–4663 (11 tetor 2006), T. 4751–4752 (12 tetor 2006); IC79 (Shënime në P615, atlasin e Kosovës, nga dëshmitari K25, 11 tetor 2006); P1419 (Kërkesë e Komandës së PrK-së për Miratim dërguar Komandantit të Armatës së 3-të, 1 gusht 1998); 4D311 (Urdhër i Komandantit të Armatës së 3-të dërguar Komandës së PrK-së, 3 gusht 1998); 4D97 (Procesverbal i mbledhjes me komandantët e PrK-së dhe të Armatës së 3-të, 7 gusht 1998); 6D692 (Urdhër Paralajmëruar për të mbështetur forcat e MPB-së, 7 gusht 1998); P1427 (Vendim i PrK-së, 10 gusht 1998); P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 49; 4D433 (Raport Luftarak i Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 14 gusht 1998); P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998); 5D99 (Procesverbal i mbledhjes së organeve të Komandës Ushtarake me komandantët e njësitë vartëse, 17 gusht 1998); John Crosland, T. 9928–9931 (8 shkurt 2007); Dragan Zhivanoviç, P3062 (deklaratë dëshmitari e datës 9 gusht 2007), para. 98–138; P1101 (Urdhër i PrK-së, 5 shtator 1998), gjithashtu i pranuar si 6D698; Tomisllav Milladenoviç, T. 17589–17590 (25 tetor 2007); 4D495 (Hartë e Ratishës – Samarxhiq); P1429 (Urdhër i PrK-së, 9 shtator 1998).

pastaj në Irzniq. Më pas i njëjti grup luftarak "e ndihmoi MPB-së për ta marrë Prejlepin."²²⁸⁸ Forcat e përbashkëta kishin hasur "në rezistencë shumë të fortë të UÇK-së."²²⁸⁹

876. Zhivanoviqi deklaroi se në Prejlep nuk kishte pasur civilë në kohën kur MPB-ja dhe UJ-ja kishin luftuar me UÇK-në. Ai fajësoi UÇK-në për shumë dëme të shkaktuara në fshat. Ai tha se 10 shtëpi kishin marrë zjarr për shkak se UÇK-ja kishte përdorur granatahedhësa dore dhe municion zjarrvënës. Ai gjithashtu tha se UÇK-ja i kishte minuar shtëpitë, godinat e tjera, dhe pjesë të oborreve me mina kundër këmbësores dhe mjete shpërthyes të improvizuara.²²⁹⁰

877. Velko Odaloviqit iu tregua një pamje filmike e Junikut, i cili sipas tij ishte filmuar më 16 gusht 1998 kur e kishte vizituar fshatin me një grup gazetarësh dhe diplomatësh të huaj.²²⁹¹ Odaloviqi tha se, edhe pse dukej qartë se godinat ishin dëmtuar, Juniku nuk ishte "rrafshuar përtokë."²²⁹² Bozhidar Filiqi dëshmoi në lidhje me të njëjtin filmim se, kur i kishte çuar gazetarët në Junik, kishte pasur vetëm "dëmtime të vogla në fasadat e godinave." Ai gjithashtu mohoi se Juniku ishte "rrafshuar përtokë." Për më tepër, ai dëshmoi se grupi i kishte parë llogoret, bunkerët, dhe pengesat e lëna nga UÇK-ja.²²⁹³

878. Crosland-i dëshmoi se më 28 gusht 1998 kishte parë forca duke djegur dhe plaçkitur fshatrat rrugës për në Gllogjan.²²⁹⁴ Ai kishte kaluar pranë forcave të UJ-së, SAJ-së, JSO-së, dhe PJP-së të cilat gjatë kryerjes së operacioneve "po u vinin zjarrin, djegur, dhe po shtinin kundër shtëpive të ndryshme."²²⁹⁵ Veçanërisht, ai deklaroi se fshati Prejlep ishte "rrafshuar me buldozer."²²⁹⁶ Atë ditë, Crosland-i u shoqërua nga MPB-ja për në Gllogjan, ku pa pasojat e një sulmi dhe gjeti gjashtë deri tetë kufoma në një kanal. MPB-ja i tha se ishin serbë të vdekur, viktimat e UÇK-së.²²⁹⁷

879. Jan Kickert-i përshkroi një udhëtim që kishte bërë me një diplomat tjetër në fillim të shtatorit 1998, duke udhëtuar nga Prishtina për në Pejë, Deçan, dhe Junik. Menjëherë pas udhëtimit ai përpiloi një raport për Ministrinë Austriake të Punëve të Jashtme, ku shkruante se "fshatrat përgjatë rrugës Prishtinë-Pejë, përveç atyre serbe, nuk janë më të banuara."²²⁹⁸ Ai gjithashtu vuri në

²²⁸⁸ Dragan Zhivanoviq, P3062 (deklaratë dëshmitari e datës 9 gusht 2007), para. 99–102.

²²⁸⁹ Dragan Zhivanoviq, P3062 (deklaratë dëshmitari e datës 9 gusht 2007), para. 102–103.

²²⁹⁰ Dragan Zhivanoviq, P3062 (deklaratë dëshmitari e datës 9 gusht 2007), para. 103–104.

²²⁹¹ Velko Odaloviq, T. 14431 (27 gusht 2007); 5D1239 (Filmim i Junikut).

²²⁹² Velko Odaloviq, T. 14430–14433; John Crosland, T. 9920 (8 shkurt 2007).

²²⁹³ Bozhidar Filiqi, T. 23906–23907 (7 mars 2008).

²²⁹⁴ John Crosland, T. 9811–9812 (7 shkurt 2007).

²²⁹⁵ John Crosland, T. 9811–9812 (7 shkurt 2007); John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 41.

²²⁹⁶ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 42.

²²⁹⁷ John Crosland, T. 9811–9814 (7 shkurt 2007).

²²⁹⁸ Jan Kickert, T. 11211 (7 mars 2007); P564 (Mesazh i ambasadës austriake, 11 shtator 1998), f. 1.

dukje se popullata shqiptare kosovare nuk ishte kthyer në qytetin e Deçanit.²²⁹⁹ Gjatë dëshmisë së tij me gojë, Kickert tha se në atë kohë në Deçan kishte pasur disa të shpërngulur të cilët lëviznin nga një vend në tjetrin për t'iu ikur luftimeve.²³⁰⁰

880. Më 21 tetor 1998, Karol John Drewienkiewicz pa gjurmë të plaçkitjeve dhe shtëpi që ishin djegur qëllimisht në fshatra në lindje të Deçanit. Në fshatra në jug të Pejës, ai vuri re se "dyert ishin shkëmbuar dhe dritaret ishin thyer, muret ishin rrëzuar, ... sikur aty të kishte shkëlur një turmë e tërbuar."²³⁰¹ Ai raportoi se "shtëpitë në fshatra gjithashtu kishin shenja se ishin plaçkitur. ... Shumë shtëpi kishin shenja të djegies."²³⁰² Drewienkiewicz tha se ai mendonte se ndaj shtëpive ishte hapur zjarr qëllimisht dhe nuk ishin dëmtuar rastësisht gjatë luftimeve.²³⁰³ Dhoma Gjyqësore vë në dukje se Drewienkiewicz është oficer i lartë në forcat e armatosura britanike dhe është i kualifikuar të bëjë vlerësime të tilla.

881. Dhoma është bindur se zona midis qytetit të Pejës dhe qytetit të Gjakovës në Kosovën perëndimore, që mbulon fshatrat e komunës së Deçanit dhe më tej në lindje deri në Jabllanicë dhe Glllogjan, nga korriku deri në shtator 1998 ishte vend i operacioneve luftarake të rëndësishme midis UJ-së dhe MPB-së nga njëra anë dhe UÇK-së nga ana tjetër. Gjendja në vendndodhje konkrete ishte e ndryshueshme, kur forcat e RFJ-së dhe Serbisë përparonin kundër UÇK-së në ndonjë vend dhe pastaj UÇK-ja e merrte atë territor përsëri më vonë. Dhoma nuk është bindur se përdorimi i shprehjes "i rrafshuar" përshkruan ndonjë fshat të caktuar në atë kohë, meqenëse nuk u paraqitën dëshmi të hollësishme për të treguar shkatërrimin e plotë apo rrafshimin e godinave. Sidoqoftë, Crosland-i dhe Drewienkiewicz-i janë oficerë ushtarakë me përvojë në vëzhgimin e pasojave shkatërruese të veprimeve luftarake dhe dëshmia okulare e të parit mbi zjarrvënien e qëllimshme nga UJ-ja dhe MPB-ja të shtëpive në fshatrat afër Glllogjanit në fund të gushtit 1998 si dhe konstatimet e të dytitt në të njëjtën zonë nga tetori 1998, e kanë bindur Dhomën se gjatë operacioneve të tyre kundër UÇK-së, forcat e MPB-së dhe UJ-së kryen veprime që shkelin të drejtën humanitare ndërkombëtare.

²²⁹⁹ Jan Kickert, T. 11283 (8 mars 2007); P564 (Mesazh i Ambasadës Austriake, 11 shtator 1998), f. 1.

²³⁰⁰ Jan Kickert, T. 11284 (8 mars 2007).

²³⁰¹ Karol John Drewienkiewicz, T. 7732–7733 (4 dhjetor 2006).

²³⁰² Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklaratë dëshmitari e datës qershor 2000), para. 28.

²³⁰³ Karol John Drewienkiewicz, T. 7733 (4 dhjetor 2006).

iii. *Malishevë – fundi i korrikut*

882. Më 28 korrik 1998, MPB-ja dhe UJ-ja kryen një aksion të përbashkët në zonën e Malishevës.²³⁰⁴ Në raportin e vizitës që bëri më 28 dhe 29 korrik 1998, John Crosland-i përshkruan se si hyri në qytetin e Malishevës, ku jeta dukej "normale," dhe ku pa vetëm rreth 30 pjesëtarë të UÇK-së. Kur ai dhe kolegët e tij u larguan nga qyteti dhe u nisën në drejtim të veriut, panë gjashtë tanke të UJ-së të pozicionuar drejt qytetit dhe një "forcë sulmuese" prej rreth 150 pjesëtarësh të SAJ-së, PJP-së, dhe UJ-së, të gatshëm për sulm. Kur mbërritën në Kijevë, panë rreth 300 pjesëtarë të JSO-së, UJ-së, dhe forcave të tjera të MPB-së me autobllinda, tanke, dhe kamionë, të gjithë të gatshëm për të përparuar në drejtim të Malishevës. Të nesërmen, Crosland-i u kthye në Malishevë dhe raportoi: "dëmtime të papërligjura. Çdo fshat pranë të dy rrugëve që çojnë në Malishevë kishte pësuar dëmtime të rënda. Shtëpitë digjeshin ende, kurse bizneset dhe garazhet ishin shkatërruar qëllimisht." Ai gjithashtu pa të mbjella të shkatërruara dhe bagëti të vrara dhe tha se, ndërsa shtëpitë në periferi të qytetit ishin dëmtuar rëndë, qendra dhe jugu i tij kishin mbetur të paprekura. Popullata civile ishte zhdukur dhe pjesëtarët e MPB-së që ishin aty nuk e dinin se ku ishte.²³⁰⁵ Crosland-i përlllogariti se rreth 30.000 njerëz ishin zhdukur nga Malisheva dhe dëshmoi se më vonë kishte zbuluar se ishin strehuar në luginën e Pagarushës.²³⁰⁶ Në një raport për vëzhgimet e tij të mëvonshme më 5 dhe 6 gusht, Crosland-i shkroi se Malisheva ishte "rrënuar" nga zjarret dhe plaçkitjet që kishin ndodhur në atë kohë.²³⁰⁷

883. Sidoqoftë, kur u pyet gjatë dëshmisë së tij me gojë për dallimin midis dëmtimeve të shkaktuara nga "zjarri i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë," Crosland-i mori shembull Malishevën, duke thënë se ajo ishte "rrafshuar përtokë nga forcat e përbashkëta të UJ-së/MPB-së." Ai shprehu mendimin se, megjithëse shkatërrimi i shtabit të UÇK-së, mund të kishte qenë veprim i justifikuar, forca e përdorur në këtë rast kishte qenë "mjaft e tepruar."²³⁰⁸ Gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, ai tha se "pjesa e tregut dhe shumica e shtëpive ishin shkatërruar plotësisht."²³⁰⁹

²³⁰⁴ Radojica Nikçeviq, T. 23282–23283 (27 shkurt 2008); P1423 (Raport Luftarak i Brigadës së 15-të të Blinduar dërguar PrK-së, 7 gusht 1998); P685 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 30 korrik 1998), f. 2; John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 37–38; P1425 (Analizë e Operacioneve Luftarake të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 8 gusht 1998); P1426 (Brigada e 125-të e Motorizuar, Raport mbi Angazhimin e Njësive, 8 gusht 1998), f. 2; *Shih gjithashtu* 4D101 (Plan i PrK-së për angazhimin e njësive në Kosovë, 23 korrik 1998), para. 2; 4D102 (Përgjigje Planit të PrK-së për angazhimin e njësive, 23 korrik 1998), f. 1.

²³⁰⁵ P685 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 30 korrik 1998), f. 2–3.

²³⁰⁶ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 37.

²³⁰⁷ P686 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 7 gusht 1998).

²³⁰⁸ John Crosland, T. 9807–9809 (7 shkurt 2007).

²³⁰⁹ John Crosland, T. 9926–9927 (8 shkurt 2007).

884. Mbrojtja paraqiti dy dëshmitarë për të mohuar përkrahimin që Crosland-i i bëri gjendjes në Malishevë në fund të korrikut 1998. Andreja Millosavleviq, koordinator i atëhershëm i aktiviteteve të organeve shtetërore të Republikës së Serbisë në Kosovë, dëshmoi në lidhje me një filmim të Malishevës që është pranuar si provë.²³¹⁰ Ai tha se ajo pjesë përmbante filmimin e vizitës së tij në Malishevë së bashku me një grup për të vlerësuar gjendjen e ndihmave humanitare në qytet në mes të gushtit 1998. Ndërsa pranoi se kishte pasur "dëme të vogla," ai tha se nuk kishte qenë në atë shkallë sa të mund të përshkruhej saktësisht se ishte "rrafshuar përtokë."²³¹¹ Bozhidar Filiqi, zëvendës-shef i atëhershëm i SPB-së së Prishtinës, dëshmoi në lidhje me të njëjtin filmim. Ai tha se kishte të bënte me një aksion antiterrorist që ishte zhvilluar në rrugën për në Malishevë më 28 dhe 29 korrik 1998. Pas kësaj, ai i kishte shoqëruar politikanët vendës dhe gazetarët e huaj për në atë zonë. Edhe ai mohoi se qyteti ishte "rrafshuar."²³¹² Dhoma vëren se në filmimin në fjalë me të vërtetë shihen godina të pashembura në Malishevë që kishin mbetur të padëmtuara në kohën kur ishin filmuar. Mirëpo, raporti i Crosland-it përshkruante periferinë e qytetit si të goditur më rëndë dhe qendrën dhe jugun si kryesisht të paprekura, që nuk bie në kundërshtim me filmimin, në të cilën shihet një pjesë e paidentifikuar e qytetit, duke përfshirë edhe njëfarë qendre mjekësore.

885. Nuk kundërshtohet fakti se në vitin 1998 Malisheva shërbente si shtab i UÇK-së.²³¹³ Filiqi tha se objektiv i këtij aksioni ishin vetëm pjesëtarët e UÇK-së dhe se "normalizimi i gjendjes ishte i pamundshëm pa një aksion serioz antiterrorist."²³¹⁴ Siç është përmendur më lart, më 7 gusht Pavkoviqi urdhëroi të gjitha njësitë e Korpusit të Prishtinës që të raportnin për operacionet e kryera nga 25 korriku deri më 6 gusht 1998, duke përfshirë edhe atë të Malishevës.²³¹⁵ Komandantët e tij i thanë se MPB-ja dhe UJ-ja nuk kishin përdorur forcë të tepruar.²³¹⁶

886. Pavarësisht nga reagimi që shkaktoi përdorimi në gjyq i fjalës "rrafshim" nga Crosland-i për të përshkruar Malishevën pas aksionit të kryer atje në fund të korrikut 1998, dhe dëshmime se nuk

²³¹⁰ 5D1239 (filmim i Malishevës).

²³¹¹ Andreja Millosavleviq, T. 14313–14315 (23 gusht 2007).

²³¹² Bozhidar Filiqi, T. 23903–23904 (7 mars 2008).

²³¹³ John Crosland, T. 9926–9928 (8 shkurt 2007); Jan Kickert, T. 11201–11205 (7 mars 2007).

²³¹⁴ Bozhidar Filiqi, T. 23930–23933 (7 mars 2008).

²³¹⁵ P1537 (Komanda e PrK-së, Pavkoviqi, Urdhër Komandantëve të Shtabeve të Brigadës së 243-të, 125-të, dhe 549-të, dhe të brigadës së 52-të të policisë ushtarake dhe të brigadës së 15-të të blinduar, 7 gusht 1998), f. 2, para. 2–3.

²³¹⁶ Komandanti i Brigadës së 15-të të Blinduar, Mlladen Çirkoviqi, tha se nuk ishte përdorur forcë e tepruar as nga UJ-ja e as nga MPB-ja gjatë operacionit. P1423 (Raport Luftarake i Brigadës së 15-të të Blinduar dërguar PrK-së, 7 gusht 1998), f. 1, para. 2. Po ashtu, Komandanti i Brigadës së 549-të të Motorizuar, Bozhidar Deliq, raportoi se njësitë kishin hasur në "një numër të vogël civilësh" gjatë operacioneve të cilët u trajtuan mirë. Sidoqoftë, "ka pasur incidente të vjedhjeve dhe shkatërrimit të panevojshëm të pronave nga ana e MPB-së që mbanin pozicionet, që siguronin zonat e çliruara, dhe nga ana e civilëve nga këto zona (në shenjë hakmarrjeje)." P1425 (Analizë e Operacioneve Luftarake të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 8 gusht 1998), f. 2, para. 3. Komandanti i Brigadës së 125-të të Motorizuar, Dragan Zhivanoviqi, tha se nuk kishte pasur përdorim të tepruar të forcës, por pranoi se, gjatë operacioneve luftarake, "mullarët e sanës, gruri, dhe ndërtesat dytësore të drurit u kapluan nga flakët." P1426 (Raport i Angazhimit të Njësisë të Brigadës së 125-të të Motorizuar, 8 gusht 1998), f. 2, para. 2.

ishte shkatërruar plotësisht i tërë qyteti, nga dëshmia e Crosland-it dhe nga raportet e tij të asaj kohe Dhoma Gjyqësore është bindur se forcat e UJ-së dhe të MPB-së kanë përdorur forcë të tepruar për të luftuar UÇK-në atje në atë kohë, që rezultoi në shkatërrimin e objekteve civile dhe shpërnguljen nga qyteti të një numri të madh të shqiptarëve kosovarë. Faktikisht vlerësimet e Crosland-it se në korrik 1998 pjesë të qytetit u dëmtuan rëndë, por nuk u shkatërruan plotësisht siç kuptohet nga fjala "rrafshuar," përputhen me përshkrimin e tij të mëvonshëm se qyteti ishte "rrënuar" nga zjarret dhe plaçkitjet.

iv. Drenicë – fillimi i gushtit

887. Në Aktakuzë pretendohet se, veç Kosovës perëndimore, më 5 dhe 6 gusht 1998 forcat e RFJ-së dhe Serbisë kryen operacione edhe në Drenicë, në Kosovën qendrore. Aty pretendohet se, si rezultat i kësaj, shumica e fshatrave përgjatë rrugës Pejë-Prishtinë dhe rrugës Klinë e Epërme-Runik-Rakosh u "shkatërruan pa shkak."

888. Faza e dytë e Planit kundër Terrorizmit parashikonte angazhimin e njësisve të UJ-së në zhbllokimin e pjesëve të rrugës Prishtinë-Pejë.²³¹⁷ Mirëpo, komandanti i Armatës së 3-të, Samarxhiqi, refuzoi përdorimin e njësisve të Korpusit të Prishtinës në këtë operacion.²³¹⁸ Dragan Zhivanoviqi dëshmoi se, sidoqoftë Brigada e 125-të e Motorizuar i dha ndihmë MPB-së nga fundi i korrikut deri në fillim të gushtit 1998, në "një operacion për të hapur" rrugën.²³¹⁹

889. Më 28 korrik, David Gajiqi i RDB-së informoi Komandën e Përbashkët se "sot njësitë e posaçme kanë pastruar zonën përgjatë vijës së komunikimit përmes Runikut."²³²⁰ Të nesërmen, Pavkoviqi i raportoi Komandës së Përbashkët se "është bërë zhbllokimi i rrugës Klinë e Epërme-Runik."²³²¹ Në të njëjtën mbledhje, një përfaqësues i RDB-së bëri të ditur se "pastrimi i fshatit Kotor ka mbaruar sot dhe ne kemi mbërritur në Runik."²³²² Më 30 korrik, Llukiqi informoi Komandën e Përbashkët se "janë krijuar kushtet për lëvizje më efektive në drejtim të Runikut."²³²³

890. Jan Kickert-i tregoi se në fund të korrikut 1998 kishte qenë pjesë e një kolone diplomatike që ishte ndaluar në një postbllok policor në rrugën Prishtinë-Pejë dhe ishte penguar përkohësisht që

²³¹⁷ 4D100 (Raport i PrK-së dërguar Armatës së 3-të në lidhje me angazhimin e njësisve, 22 korrik 1998), f. 1; 4D101 (Plan i PrK-së për angazhimin e njësisve në Kosovë, 23 korrik 1998), f. 1.

²³¹⁸ 4D102 (Përgjigje Planit të PrK për angazhimin e njësisve, 23 korrik 1998)

²³¹⁹ Dragan Zhivanoviq, P3062 (deklaratë dëshmitari e datës 9 gusht 2007), para. 96.

²³²⁰ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 21; *Shih gjithashtu* Millan Gjakoviq, T. 26370 (19 maj 2008).

²³²¹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 25.

²³²² P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 26.

²³²³ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 30.

të vazhdonte më tej.²³²⁴ Pa dhënë hollësi për vendin, Kickert-i tha se kishte parë shtëpi dhe ara të pakorrura duke u djegur.²³²⁵

891. Më 1 gusht 1998, Pavkoviqi informoi Samarxhiqin se në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të 31 korrikut ishte vendosur që më 2 gusht të fillonte faza e tretë e Planit kundër Terrorizmit.²³²⁶ Pavkoviqi saktësoi se ishte vendosur që, ndër të tjera, të ndërmerreshin operacione të koordinuara në zonat e Drenicës dhe Jabllanicës.²³²⁷

892. Nga 25 korriku deri më 6 gusht 1998, disa njësi të MPB-së, duke përfshirë edhe JSO-në, SAJ-në, dhe PJP-në, së bashku me grupet e luftimit të Korpusit të Prishtinës, u angazhuan në zonën e Drenicës përgjatë disa vijave.²³²⁸ Në të njëjtën periudhë, Crosland-i tregoi se kishte parë PJP-në, SAJ-in, dhe JSO-së "në detyra mbrojtëse, sidomos në zonat e Drenicës dhe Jabllanicës." Ai theksoi se roli i PJP-së ishte të "siguronte zonat dhe vendoste kontaktin e parë e pastaj ndërhyenin forcat e specializuara" që kryenin sulmet. Kontakti i parë "dallonte shumë, që nga... rrethimi i zonës dhe... frikësimi i banorëve për t'i detyruar të iknin, deri te të shtënat me predha artilerie si paralajmërim për t'u larguar para se të fillonte operacioni i madh."²³²⁹ Në raportin e tij të 30 korrikut 1998 shkruhet se "çdo fshat prej Llapushnikut në drejtim të perëndimit ishte dëmtuar qëllimshëm me nga të shtënat e topave mitralozave të rëndë." Konkretisht, ai pa shtëpi të djegura dhe dyqane të dëmtuara.²³³⁰ Në raportin e tij për gjendjen në Kosovë më 5 dhe 6 gusht 1998, Crosland-i theksonte se "shumica e fshatrave në veri/jug të rrugës Pejë-Prishtinë dhe rrugës Klinë e Epërme-Runik-Rakosh ishin shkatërruar pa shkak. Infrastruktura, të mbjellat, dhe bizneset ishin shkatërruar edhe më shumë." Crosland-i përshkroi se si në atë kohë kishte hasur në një kolonë të gjatë të MPB-së duke u kthyer nga Prishtina, që mbanin flamuj të Serbisë dhe dukej se festonin njëfarë "fitore madhështore."²³³¹

893. Pas këtyre operacioneve, komandanti i Brigadës së 15-të të Blinduar raportoi se forcat e UJ-së dhe të MPB-së nuk kishin përdorur forcë të tepruar dhe se nuk kishin hapur zjarr kundër terroristëve kur në zonën e dislokimit kishin qenë të pranishëm civilë, përfaqësues diplomatikë, ose

²³²⁴ Jan Kickert, T. 11269 (7 mars 2007).

²³²⁵ Jan Kickert, T. 11202 (7 mars 2007).

²³²⁶ P1419 (Kërkesë e PrK-së dërguar Armatës së 3-të, 1 gusht 1998).

²³²⁷ P1419 (Kërkesë e PrK-së dërguar Armatës së 3-të, 1 gusht 1998).

²³²⁸ Dragan Zhivanoviq, T. 20499–20501 (17 janar 2008); Radojica Nikçeviq, T. 23282–23283 (27 shkurt 2008); P1423 (Raport i Brigadës së 15-të mbi Detyrat Luftarake, 7 gusht 1998); P1425 (Analizë e Operacioneve Luftarake të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 7 gusht 1998), f. 1–2; P1426 (Raport Luftarak i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 8 gusht 1998), f. 1. *Shih gjithashtu*, P686 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 7 gusht 1998), f. 1.

²³²⁹ John Crosland, T. 9761–9763 (7 shkurt 2007).

²³³⁰ P685 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 30 korrik 1998), f. 2.

²³³¹ P686 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 7 gusht 1998), f. 1–2.

punonjës humanitarë. Forcat e UÇK-së, siç raportohej, kishin përdorur armë këmbësorie, mortaja, dhe granatahedhës dore.²³³² Komandanti i Brigadës së 125-të të Motorizuar raportoi se JSO-ja kishte përdorur raketahedhës shumëtytësh dhe se njësitë e UJ-së kishin pasur tanke, topa vetëlëvizës, topa kundërajrorë vetëlëvizës, dhe obusë 122-milimetërsh. Ai më tej raportoi se nuk ishte përdorur forcë e tepruar, nuk kishte pasur plaçkitje, dhe nuk ishin arrestuar civilë. Mirëpo gjatë operacioneve, mullarët e sanës, gruri, dhe kabinat prej druri u kapluan nga zjarri.²³³³

894. Është e qartë se në fund të korrikut dhe në fillim të gushtit 1998, UJ-ja dhe MPB-ja kryen operacione të mëdha në zonën e Drenicës, duke përfshirë fshatrat përgjatë rrugëve Pejë-Prishtinë dhe Klinë e Epërme-Runik-Rakosh. Përshkrimi prej Crosland-it i dëmeve të shkaktuara mbi objektet civile nuk është shpjeguar mirë në raportin e komandantit të Brigadës së 125-të të Motorizuar dhe Dhoma nuk i pranon shpjegimet në të. Rrjedhimisht ajo konkludon se gjatë këtyre operacioneve është përdorur forcë e tepruar dhe pa dallim nga ana e forcave të RFJ-së dhe Serbisë kundër fshatrave në këtë zonë.

v. Lugina e Suharekës – shtator

895. Në Paragrafin 95 të Aktakuzës pretendohet se rreth shtatorit 1998 forcat e RFJ-së dhe Serbisë granatuan dhe dogjën në mënyrë të vazhdueshme fshatrat në luginën e Suharekës. Dhoma Gjyqësore është bindur se UJ-ja dhe MPB-ja kryen operacione në këtë zonë në fund të gushtit 1998.²³³⁴ Pretendimi se gjatë këtyre operacioneve u granatuan dhe u dogjën pjesërisht fshatra mbështetet pak a shumë edhe nga John Crosland-i, i cili dëshmoi se kishte parë granatime në zonën përreth Suharekës, Duhlës, dhe Bllacës në sè paku dy raste në vitin 1998. Crosland-i tha se UÇK-ja nuk kishte armatime për t'iu rezistuar armëve të rënda, si tanke, sisteme raketahedhëse, dhe artileria që u përdorën kundër fshatrave në këtë zonë.²³³⁵ Ai më tej tha se filmimet e këtyre granatimeve dhe të granatimeve të tjera në zona të ndryshme iu dhanë Ojdaniqit më 28 gusht 1998, por kjo u kundërshtua nga Mbrojtja e Ojdaniqit.²³³⁶ Sidoqoftë, ky filmim nuk është paraqitur si provë.

896. Crosland-i dëshmoi se në fund të shtatorit 1998 kishte shoqëruar politikanin e dikurshëm britanik, Paddy Ashdown, gjatë një vizite në Kosovë, ku udhëtuan nëpër tërë zonën e Suharekës të

²³³² P1423 (Raport Luftarak i Brigadës së 15-të të Blinduar dërguar PrK-së, 7 gusht 1998), f. 2.

²³³³ P1426 (Raport Luftarak i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 8 gusht 1998), f. 2.

²³³⁴ *Shih gjithashtu*, Vladimir Liliq, T. 24343–24345 (17 mars 2008), Iliqi tha se aksioni ishte kryer me pjesëmarrjen edhe të PJP-së edhe të njësisë të posaçme antiterroriste të MPB-së, dhe "disa forcave të armatosura," duke përfshirë edhe "njësitë e mekanizuara të blinduara." Sidoqoftë, Iliqi tha se ushtria "lëvizte në rrugë të tjera dhe ne ishim të pavarur." P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 77–78.

²³³⁵ John Crosland, T. 9790 (7 shkurt 2007).

²³³⁶ John Crosland, T. 9801-9802 (7 shkurt 2007), T. 9889–9893 (8 shkurt 2007).

shoqëruar nga një ekip i BBC-së, të cilët filmuan granatimet e atjeshme.²³³⁷ Dy filmime të bëra në atë kohë janë paraqitur si prova.²³³⁸ Në filmimin e parë shihet Ashdown-i duke vrojtuar me dylbi nga një vend afër Studençanit, në perëndim të qytetit të Suharekës, në drejtim të fshatrave në veri dhe në lindje.²³³⁹ Crosland-i tha se kishin qenë në gjendje të dëgjonin zjarrin e pushkëve dhe të granatimit nga pozicionet e artilerisë së UJ-së në Billacë dhe Duhël dhe rënien e predhave në një fshat dhe pastaj i kishin parë shtëpitë e fshatit duke u djegur.²³⁴⁰ Në filmim shihen qartë tymi nga fshati dhe një shtëpi duke u djegur. Crosland-i tha se në qytetin e Suharekës kishte pasur prani të madhe të MPB-së dhe UJ-së në atë kohë.²³⁴¹ Sidoqoftë, gjatë fazës së pyetjeve nga Mbrojtja, Crosland-i pranoi se nuk ishte i sigurt nëse filmimi ishte bërë në shtator ose dhjetor 1998.

897. Në mbështetje të pretendimeve për angazhimin e forcave në operacionet në zonën e Suharekës në fund të shtatorit, Frederick Abrahams tha se më 28 shtator ai dhe punonjës të tjerë të Human Rights Watch-it provuan të hynin në atë zonë nga tri drejtime të ndryshme, por u bllokuan nga policia. Abrahams tha se "më vonë kuptuam se në atë zonë po kryheshin ofensiva."²³⁴²

898. Me gjithë dëshminë e përgjithshme të Crosland-it në lidhje me përdorimin e tepruar të forcës nga ana e forcave të UJ-së dhe MPB-së në verë të vitit 1998, duke përfshirë dhe zonën e Suharekës, dhe filmimin në të cilin shihet granatimi dhe një shtëpi duke u djegur, përshtjellimi në lidhje me datat e vrojtimit dhe vizitave të Crosland-it në Suharekë me Ashdown-in dhe paqartësitë në lidhje me realizimin e filmimit bëjnë që Dhoma të mos jetë në gjendje të nxjerrë konkluzion jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se në shtator 1998 fshatrat e asaj zone u granatuan dhe u dogjën, siç pretendohet në Aktakuzë.

vi. Abri e Epërme – shtator

899. Në paragrafin 95 to Aktakuzës pretendohet se, gjatë operacionit antiterrorist në Abri të Epërme (komuna e Gllogocit) më 26 shtator 1998, forcat e RFJ-së dhe të Serbisë vranë 21 pjesëtarë të familjes Deliaj, ndër të cilët gra dhe fëmijë.

900. Në shkurt 1999, Human Rights Watch publikoi një raport të hollësishëm me konkluzione në lidhje me ngjarjet në Drenicë në javën e fundit të shtatorit 1998, i cili iu shpërnda gjerësisht

²³³⁷ John Crosland, T. 9796–9799 (7 shkurt 2007), T. 9942–9943 (8 shkurt 2007).

²³³⁸ P611 (filmim i bërë nga Paddy Ashdown, 27 shtator 1998)

²³³⁹ John Crosland, T. 10047–10049 (9 shkurt 2007).

²³⁴⁰ John Crosland, T. 10049 (9 shkurt 2007).

²³⁴¹ John Crosland, T. 10050–10051 (9 shkurt 2007).

²³⁴² Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 mars 1999), f. 7.

mediave dhe organizatave qeveritare.²³⁴³ Frederick Abrahams tha se ky raport iu dërgua Presidencës së Serbisë, Presidencës Federale të Jugosllavisë, ministrive të brendshme republikane dhe federale, dhe Ushtrisë Jugosllave. Ai iu shpërnda edhe mediave në gjuhën serbe dhe gjuhën shqipe në Kosovë.²³⁴⁴

901. Abrahams, i cili ishte bashkautor i raportit,²³⁴⁵ deklaroi se më 26 shtator 1998 dëgjoi granatime dhe pa zjarre në zonën e Abrisë së Epërme nga Plloçica. Predhat vinin nga një vend ku kishte parë një helikopter të shënuar me kryq të kuq.²³⁴⁶ Dëshmitarët me të cilët foli i thanë se "forcat serbe të sigurisë" kishin vrarë një familje shqiptare kosovare afër shtëpisë së kësaj familjeje në fshatin Abri e Epërme.²³⁴⁷ Më 29 shtator, ai mori konfirmim nga US-KDOM-i i pranishëm në Abri të Epërme një ditë më parë, se atje ishte kryer një aksion.²³⁴⁸ Atë ditë ai vizitoi shtëpinë e familjes Hysenaj, ku ishin vrarë tre pleq.²³⁴⁹

902. Më pas, i shoqëruar nga dy gazetarë dhe një koleg nga Human Rights Watch, Abrahams-i vizitoi një vend në pyll në Abri të Epërme ku ishin gjetur të vdekur disa anëtarë të familjes Deliaj, ndër të cilët gra e fëmijë të vegjël.²³⁵⁰ Pesë anëtarë meshkuj të familjes u gjetën në një vend tjetër në fshat²³⁵¹ dhe kryeplaku i familjes ishte djegur në shtëpi, kurse një burrë tjetër ishte vrarë dhe kufoma e tij ishte u gjet në pusin e fshatit.²³⁵² Dy vajza ishin zhdukur, por u gjetën më vonë të vdekura.²³⁵³ Abrahams-i mësoi për këto kufoma me të mbërritur në fshat. Fshatarët që hasi atje

²³⁴³ Frederick Abrahams, T. 811, T. 818 (13 korrik 2006); P441 (Raport i Human Rights Watch, "A week of terror in Drenica – Humanitarian Law Violations in Kosovo /Javë terrori në Drenicë – Shkeljet e të Drejtës Humanitare në Kosovë/," 1 shkurt 1999).

²³⁴⁴ Frederick Abrahams, T. 818 (13 korrik 2006)

²³⁴⁵ Frederick Abrahams, P2227 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 korrik 2006), para. 19.

²³⁴⁶ Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 mars 1999), f. 7.

²³⁴⁷ Frederick Abrahams, T. 805–807, 811 (13 korrik 2006).

²³⁴⁸ Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 mars 1999), f. 7.

²³⁴⁹ Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 mars 1999), f. 7; P441 (Raport i Human Rights Watch, "A week of terror in Drenica – Humanitarian Law Violations in Kosovo," 1 shkurt 1999), f. 35–39. Këta ishin Rustem Hysenaj, nga Abria e Epërme; dhe Ali Kolludra dhe Hyrda Kolludra, një çift i shpërngulur nga fshati Gremnik.

²³⁵⁰ Frederick Abrahams, T. 805–809 (13 korrik 2006), Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 mars 1999), f. 8; P441 (Raport i Human Rights Watch, "A week of terror in Drenica – Humanitarian Law Violations in Kosovo," 1 shkurt 1999), f. 16–47; P679 (Fotografi të Peter Bouckaert-it, Human Rights Watch, e viktimave Deliaj në Abri të Epërme, 29 shtator 1998); P653 (Fotografi të Peter Bouckaert-it, Human Rights Watch, e viktimave Deliaj në Abri të Epërme, 29 shtator 1998); P642 (Fotografi të Peter Bouckaert-it, Human Rights Watch, e viktimave Deliaj, Gentiona dhe Donjeta, në Abri të Epërme, 29 shtator 1998).

²³⁵¹ P441 (Raport i Human Rights Watch, "A week of terror in Drenica – Humanitarian Law Violations in Kosovo," 1 shkurt 1999), f. 22–24, 30–33.

²³⁵² P441 (Raport i Human Rights Watch, "A week of terror in Drenica – Humanitarian Law Violations in Kosovo," 1 shkurt 1999), f. 22–24, 30–33.

²³⁵³ Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 mars 1999), f. 8; P441 (Raport i Human Rights Watch, "A week of terror in Drenica – Humanitarian Law Violations in Kosovo," 1 shkurt 1999), f. 35. Gjithashtu, në publikimin e Human Rights Watch thuhet se Sherif Deliaj ishte ende i zhdukur në 1999. *Shih gjithashtu*, P441 (Raport i Human Rights Watch, "A week of terror in Drenica – Humanitarian Law Violations in Kosovo," 1 shkurt 1999), f. 28–29, 31, Foshnja Diturie Deliaj u gjet e gjallë në pyll nën trupin e nënës së saj, por vdiq më vonë.

kishin qenë duke varrosur të vdekurit dhe po sillnin kufomat e tre fëmijëve nga një pyll i afërt në një fushë aty pranë. Shtatë kufoma të tjera mbetën të pavarrosura në pyll, shumica gra e fëmijë, më i vogli nga të cilët vetëm 18-muajsh.²³⁵⁴ Abrahams-i i intervistoi pjesëtarët e familjes Deliaj që kishin shpëtuar dhe fshatarët e tjerë që kishin ikur nga Abria e Epërme kur pati mbërritur policia dhe ata i treguan çfarë mendonin se kishte ndodhur.²³⁵⁵ Gratë dhe fëmijët kishin ikur në pyll për shkak të luftimeve midis UÇK-së dhe "forcave serbe të sigurisë" në fshat dhe, sipas fshatarëve të cilët i kishin gjetur kufomat e tyre të parët, qenë vrarë ndërsa qëndronin të fshehura atje.²³⁵⁶ Të gjitha kufomat e gjetura në pyll kishin rroba civile dhe kishin pësuar "plagë nga armë zjarri, prerje me thikë, dhe gjymtime."²³⁵⁷

903. Nga intervistat që Abrahams-i i bëri në lidhje me këtë incident, Human Rights Watch mundi të konfirmonte se kishte pasur luftime midis "forcave serbe të sigurisë" dhe UÇK-së.²³⁵⁸ Konkluzioni i Abrahams-it ishte se civilët kishin qenë të fshehur në pyll për shkak të luftimeve në fshat midis UÇK-së dhe forcave serbe.²³⁵⁹ Ai tha se kishte pasur plaçkitje të madhe dhe se vetëm 10% e fshatit kishte mbetur më këmbë më 29 shtator 1998.²³⁶⁰ Megjithëse pranoi se kishte pasur aktivitet të UÇK-së në zonën e Abrisë së Epërme në shtator 1998, ai hodhi poshtë mundësinë që UÇK-ja të ishte përgjegjëse për këto vrasje.²³⁶¹ Diplomati austriak, Jan Kickert, dëshmoi se incidenti në Abri të Epërme ndodhi pas vrasjes së disa oficerëve të MPB-së nga një minë tokësore dhe sugjeroi se kjo mund të ketë shkaktuar "tërbimin" e kolegëve të tyre."²³⁶²

904. Në një raport luftarak të Korpusit të Prishtinës të datës 26 shtator 1998 flitet për rezistencë të fortë të UÇK-së në zonën e Abrisë së Epërme dhe Abrisë së Poshtme. Në të thuhej se UÇK-ja kishte përdorur armë këmbësorie, granatahedhës dore, topa pa dridhje, dhe mortaja për t'iu përgjigjur zjarrit, kurse rrugët për në fshat ishin minuar.²³⁶³ Mirëpo në raport theksohej se për shkak të humbjeve, UÇK-ja ishte "thyer," ku ishin zënë rob disa qindra "terroristë" dhe ishin vrarë rreth 80-100 të tjerë. Në të raportohet gjithashtu për disa viktima midis anëtarëve të MPB-së.²³⁶⁴ Korpusi i Prishtinës "vazhdoi të ndihmonte forcat e MPB-së në thyerjen dhe shkatërrimin" e UÇK-së në

²³⁵⁴ Frederick Abrahams, T. 806 (13 korrik 2006).

²³⁵⁵ Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 mars 1999), f. 8.

²³⁵⁶ Frederick Abrahams, T. 807, 811 (13 korrik 2006).

²³⁵⁷ P441 (Raport i Human Rights Watch, "A week of terror in Drenica – Humanitarian Law Violations in Kosovo," 1 shkurt 1999), f. 24.

²³⁵⁸ Frederick Abrahams, T. 810–811 (13 korrik 2006).

²³⁵⁹ Frederick Abrahams, T. 807 (13 korrik 2006).

²³⁶⁰ Frederick Abrahams, P2228 (deklarata e dëshmitarit e datës 11 mars 1999), f. 7.

²³⁶¹ Frederick Abrahams, T. 997–998 (7 gusht 2006).

²³⁶² Jan Kickert, T. 11281 (8 mars 2007).

²³⁶³ 6D755 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 26 shtator 1998), f. 1.

²³⁶⁴ 6D755 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 26 shtator 1998), f. 2.

këtë zonë.²³⁶⁵ Në një raport tjetër luftarak të Korpusit të Prishtinës konfirmohej se më 26 shtator 1998 UÇK-ja ishte rrethuar plotësisht në "sektorin në lindje të Abrisë së Epërme," dhe se më 27 shtator ishte "thyer plotësisht." Në të njëjtin raport theksohej se UÇK-ja kishte vrarë tre policë në sulmin e 26 shtatorit afër Abrisë së Epërme.²³⁶⁶

905. Më 26 shtator 1998, Pavkoviqi i raportoi Komandës së Përbashkët se "operacioni në zonën e Abrisë së Poshtme dhe Abrisë së Epërme ka përfunduar. Rezistenca ishte e fortë, por ky grup ishte izoluar në një hapësirë më të vogël.²³⁶⁷ Ai deklaroi se armikut i ishin shkakuar 200 "humbje në njerëz" dhe afër fshatit Tërdec ishin parë "refugjatë"; për më tepër, "pastrimi" do të vazhdonte më 27 shtator. Në lidhje me MPB-në, Llukiqi raportoi se në Abri të Poshtme kishte përfunduar një operacion dhe se "njësitë ishin bashkuar."²³⁶⁸

906. Dragan Zhivanoviqi tha se Abria e Poshtme dhe Abria e Epërme ishin baza të forta për forcat "terroriste" në 1998. Ai gjithashtu dëshmoi në lidhje me operacionet e përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së kundër këtyre "forcave terroriste" në rajonin e gjerë rreth këtyre fshatrave nga 26 shtatori deri më 29 ose 30 shtator 1998.²³⁶⁹

907. Më 2 tetor 1998, Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së kërkoi informata për "masakrën" e Abrisë së Epërme.²³⁷⁰ Më 3 tetor, në vijim të kësaj kërkesë Korpusi i Prishtinës kërkoi më shumë informata.²³⁷¹ Më pas, Llazareviqi i raportoi Pavkoviqit se njësitë e Korpusit të Prishtinës nuk kishin kryer masakër, por nuk kishte informata të sakta për MPB-në.²³⁷² Në një raport të Pavkoviqit, të 5 tetorit 1998, dërguar Komandës së Armatës së 3-të, thuhej se Korpusi i Prishtinës nuk kishte asnjë informatë në lidhje me "masakrën" e pretenduar në Abri të Epërme apo ndonjë incident të tillë gjatë periudhës së zbatimit të Planit Kundër Terrorizmit.²³⁷³ Sidoqoftë, në të njëjtin dokument shkruhej se Pavkoviqi ishte informuar në lidhje me informacionin që dega e sigurimit të Korpusit të Prishtinës ia kishte dërguar Administratës së Sigurimit të UJ-së, ku deklarohet se

²³⁶⁵ 6D755 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 26 shtator 1998), f. 3.

²³⁶⁶ 6D756 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 27 shtator 1998).

²³⁶⁷ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 128–129.

²³⁶⁸ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 129.

²³⁶⁹ Dragan Zhivanoviq, T. 20492–T. 20495 (17 janar 2008).

²³⁷⁰ 4D403 (Kërkesë e Shtabit të Përgjithshëm për deklaratë me shkrim, 2 tetor 1998).

²³⁷¹ 4D199 (Hetim i PrK-së në lidhje me përmbushjen e urdhrave, 3 tetor 1998). Në përgjigje të këtyre kërkesave, Batalioni i 57-të i Rojeve Kufitare u përgjig duke thënë se nuk kishin të dhëna. 4D387 (GB i 57-të për PrK-në: Kryerja e Operacioneve Luftarake, 4 tetor 1998). Brigada e 243-të e Motorizuar raportoi se kishte marrë pjesë në pajtim me urdhrat e PrK-së, por nuk kishte ndodhur ndonjë masakër. 4D389 (MBR e 243-të për PrK-në: Raport mbi Kryerjen e Operacioneve Luftarake, 4 tetor 1998). *Shih gjithashtu* 4D390 (ARBR e 52-të për PrK-në: Raport mbi Kryerjen e Operacioneve Luftarake, 4 tetor 1998); 4D391 (OKBR e 15-të për PrK-në: Raport mbi Kryerjen e Operacioneve Luftarake, 5 tetor 1998); 4D407 (Raport i MTBR 549-të për Armatën e 3-të, re: Aktivitetet e Brigadës, 5 tetor 1998).

²³⁷² 4D401 (Raport mbi Operacionet Luftarake për Komandën e PrK-së, 5 tetor 1998).

²³⁷³ P1440 (Raport i PrK-së mbi incidentet që rezultuan në vdekje, 5 tetor 1998), f. 4.

pjesëtarë të paignifikuar të njësive të MPB-së kishin kryer një operacion në Abri të Epërme dhe kishin ekzekutuar civilët e zënë rob.²³⁷⁴

908. Petar Damjanac, shëf i atëhershëm i DPB-së në Glllogoc, mohoi dijeninë për operacionin e MPB-së në Abri të Epërme në shtator 1998, gjatë të cilët persona të zënë rob ishin ekzekutuar.²³⁷⁵

Ai tha se për incidentin kishte dëgjuar për herë të parë kur një grup patologësh finlandezë dhe SPB-ja e Prishtinës i kishin thënë se një gjykatës hetues duhej të dërgohej në Abri të Epërme. Ai gjithashtu tha se policia nuk hyri në atë zonë nga korriku deri në shtator 1998, sepse ajo zonë kishte qenë nën kontrollin e UÇK-së dhe se ata mund të ishin gjendur në mes të zjarrit të shkëmbyer midis MPB-së dhe UÇK-së.²³⁷⁶

909. Në procesverbalin e mbledhjes së 4 tetorit 1998 të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes janë shënuar fjalët e Presidentit malazez Gjukanoviq, se "ka dyshime serioze se Abria mund të përsëritet dhe do të përsëritet nga dita në ditë," dhe se ky problem duhej të shqyrtohej.²³⁷⁷ Në lidhje me këtë, Momir Bullatoviqi tha se Gjukanoviqi u ishte referuar dyshimeve ndërkombëtare në lidhje me Abrinë e Epërme dhe jo incidentit që kishte ndodhur.²³⁷⁸ Më 1 tetor 1998, Komanda e Përbashkët u vu në dijeni për një artikull gazete në lidhje me Abrinë e Epërme.²³⁷⁹

910. Bashkësia ndërkombëtare e nxitit RFJ-në që të lejonte ekipin mjeko-ligjor finlandez të hetonte Abrinë e Epërme. Diku rreth 20-25 tetorit 1998, ekipi finlandez u lejua të shkonte në Kosovë, si alternativë e këmbënguljes së diplomatëve për vajtjen e hetuesve nga ky Tribunal.²³⁸⁰ Kickert-i tha se ekipit iu la "dorë e lirë" për kryerjen e hetimeve.²³⁸¹ Mirëpo ata nuk kishin qenë "në gjendje të bënin punën e tyre ashtu siç ishte menduar," dhe Kickert-i dha shembuj të problemeve në lidhje me vizitimin e vendit të ngjarjes dhe sigurinë gjatë zhvarrimeve në Abri të Epërme. Në dhjetor 1998, ekipi finlandez shkoi në atë zonë për të bërë zhvarrimet, në një kolonë të përbërë nga Kickert-i, gjykatësja hetimore, Danica Marinkoviq, dhe një grup i madh shoqërimi i MPB-së.²³⁸² Ai tha se nuk do të ishte pajtuar të shkonte në Abri të Epërme me Marinkoviqin dhe ekipin për të kryer

²³⁷⁴ P1440 (Raport i PrK-së mbi incidentet që rezultuan në vdekje, 5 tetor 1998), f. 4.

²³⁷⁵ Petar Damjanac, T. 23813 (6 mars 2008).

²³⁷⁶ Petar Damjanac, T. 23813–23814 (6 mars 2008).

²³⁷⁷ P2831 (Procesverbal i sesionit të 6-të të KLM-së, 4 tetor 1998), f. 30.

²³⁷⁸ Momir Bullatoviq, T. 13939–13943 (17 gusht 2007).

²³⁷⁹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 134.

²³⁸⁰ Jan Kickert, T. 11223–11225 (7 mars 2007).

²³⁸¹ Jan Kickert, T. 11225 (7 mars 2007).

²³⁸² Jan Kickert, T. 11226–11227 (7 mars 2007).

zhvarrimin sikur ta kishte ditur se do të shoqëroheshin nga "20 automjete të blinduara, autoblanda, dhe makina policore", sepse në atë kohë zona ishte nën kontrollin e UÇK-së.²³⁸³

911. Danica Marinkoviqi konfirmoi se kishte kryer hetime në vendin e ngjarjes në lidhje me pretendimet për vrasjet e civilëve në Abri të Epërme.²³⁸⁴ Ajo tha se, gjatë hetimeve në vendin e ngjarjes, zona ishte nën kontrollin e UÇK-së.²³⁸⁵ Kryetari i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, Prokurori Publik i Qarkut, Instituti i Mjekësisë Ligjore, dhe misioni i OSBE-së kishin bërë një marrëveshje për të kryer hetime më 10 dhjetor 1998, siç është shënuar në një mesazh të SPB-së së Prishtinës.²³⁸⁶ Me ta shkuan edhe patologët nga Finlanda të kryesuar nga Helena Ranta dhe disa policë me uniforma.²³⁸⁷ Duke udhëtuar në kolonë për në Abri të Epërme, ata ndaluan jashtë fshatit para se të mbërrinin te një postbllok i UÇK-së dhe nuk vazhduan më tej, sepse drejtuesi i ekipit finlandez kishte refuzuar të shkonte më tej me shpurë policore.²³⁸⁸ Marinkoviqi tha se, meqenëse askush, as familjet e viktimave, as OSBE-ja, dhe as ekipi mjeko-ligjor nuk kishte këmbëngulur në rastin, zhvarrimi nuk u krye asnjëherë.²³⁸⁹

912. Dhoma Gjyqësore është bindur se gjatë operacioneve të UJ-së dhe MPB-së në Abri të Epërme dhe rreth saj në fund të shtatorit 1998, u vranë disa civilë, ndër të cilët gra dhe fëmijë,. Fakti se Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së kishte kërkuar të dhëna për "masakrën" e pretenduar tregon se së paku në fillim, kanë ekzistuar shqetësime për implikimin e mundshëm të forcave të UJ-së. Mirëpo, pas hetimeve të brendshme u raportua se nuk ishte kryer asnjë "masakër" nga pjesëtarët e UJ-së dhe dega e sigurimit të Korpusit të Prishtinës raportoi se pjesëtarët e MPB-së ishin përgjegjës. Pa qenë në gjendje për të përcaktuar se a ishte përgjegjëse UJ-ja apo MPB-ja, Dhoma konkludon se vrasjet u kryen nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë.

e. Personat e shpërngulur

913. Paragrafi 96 i Aktakuzës pretendon se, si pasojë e përdorimit të forcës së tepruar dhe pa dallim nga forcat e RFJ-së dhe të Serbisë, shumë banorë shqiptarë të Kosovës u detyruan të shpërnguleshin në vende të tjera brenda Kosovës, ose të largoheshin nga krahina. Aty thuhet se

²³⁸³ Jan Kickert, T. 11278 (8 mars 2007).

²³⁸⁴ Danica Marinkoviqi, T. 23523–23525 (29 shkurt 2008); 6D1506 (Raport hetimor i vendit të ngjarjes i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës për incidentin në Abri të Epërme, 13 shkurt 1998).

²³⁸⁵ Danica Marinkoviqi, T. 23523 (29 shkurt 2008).

²³⁸⁶ Danica Marinkoviqi, T. 23526 (29 shkurt 2008); 6D197 (SPB Prishtinë, kërkesë për ndihmë të MPB-së nga Gjykata e Qarkut të Prishtinës, 10 dhjetor 1998).

²³⁸⁷ Danica Marinkoviqi, T. 23525–23526 (29 shkurt 2008).

²³⁸⁸ Danica Marinkoviqi, T. 23527 (29 shkurt 2008).

²³⁸⁹ Danica Marinkoviqi, T. 23528–23529 (29 shkurt 2008).

sipas përlllogaritjes së Kombeve të Bashkuara deri në mes të tetorit brenda Kosovës ishin shpërngulur 285.000 njerëz.

914. Gazetari shqiptar i Kosovës Veton Surroi dëshmoi se pas ofensivës së MPB-së dhe UJ-së në Deçan në pranverë të vitit 1998, nga fundi i majit, në malet e kësaj komune ishin 5.000 të shpërngulur.²³⁹⁰ Kishte raporte kontradiktore në lidhje me personat e shpërngulur në Junik, por Andreja Millosavleviq, ministër i Vetëqeverisjes Vendore dhe koordinator i organeve shtetërore për Kosovën i Republikës së Serbisë, dëshmoi se grupi i personave të shpërngulur në malet mbi Junik në qershor 1998 përbëhej nga rreth 300 vetë.²³⁹¹

915. Dhoma gjithashtu dëgjoi dëshmi në lidhje me civilët e shpërngulur pas operacionit në Rahovec në korrik 1998, edhe pse numri i saktë i tyre nuk është i qartë.²³⁹² John Crosland-i dëshmoi në lidhje me largimin e 30.000 civilëve nga Malisheva pas operacionit të përbashkët të MPB-së dhe UJ-së atje atë muaj.²³⁹³ Pati gjithashtu edhe dëshmi se operacionet e RFJ-së/Serbisë shkaktuan shpërnguljen e një numri të madh civilësh në zonën e Drenicës. Siç është thënë më herët, në një raport të John Crosland-it i fillimit të gushtit thuhet se nuk kishte shenja të pranisë së civilëve në shumicën e fshatrave në jug dhe në veri të rrugës Pejë-Prishtinë dhe rrugës Klinë e Epërme-Runik-Rakosh.²³⁹⁴ Në fund të gushtit, Jan Kickert-i shoqëroi për në Qirez ambasadorin Wolfgang Petritsch dhe Emma Bonino-n, komisionerja evropiane për ndihmë humanitare. Ata panë një numër të madh personash të shpërngulur brenda vendit.²³⁹⁵

916. Nga shtatori, popullata e shpërngulur në Kosovë ishte rritur dukshëm. Më 23 shtator 1998, Këshilli i Sigurimit i OKB-së theksoi se ishte "shumë i shqetësuar" për "përdorimin e tepruar dhe pa dallim të forcës nga forcat serbe të sigurisë dhe ushtria jugosllave," që, sipas vlerësimeve të Sekretarit të Përgjithshëm, kishte shkaktuar "shpërnguljen nga shtëpitë e tyre të mbi 230.000 personave."²³⁹⁶

²³⁹⁰ Veton Surroi, T. 4583 (10 tetor 2006).

²³⁹¹ Andreja Millosavleviq, T. 14283 (23 gusht 2007).

²³⁹² Baton Haxhiu, T. 6083 (8 nëntor 2006). Në lidhje me këtë, Baton Haxhiu dëshmoi se, pas ofensivës, ai vizitoi zonën në Malet e Berishës së bashku me dy diplomatë, David Slinn-in dhe Jan Kickert-in, ku ishin shpërngulur rreth 100.000 refugjatë. Sidoqoftë, ndërsa ka dëshmi të tërthorta se civilët ishin shpërngulur, nuk ka të dhëna që konfirmojnë numër aq të lartë të tyre në një periudhë kaq të hershme më 1998.

²³⁹³ P685 (Raport Konfidencial mbi Situatën në Kosovë i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 30 korrik 1998), f. 3.

²³⁹⁴ P686 (Raport Konfidencial mbi Situatën i Përfaqësuesit Ushtarak të Mbretërisë së Bashkuar, 7 gusht 1998), f. 1.

²³⁹⁵ Jan Kickert, T. 11210 (7 mars 2007); Jan Kickert, 5D123 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 maj 1999), f. 4.

²³⁹⁶ P456 (Rezoluta 1199 e UNSC-së, 23 shtator 1998), f. 1.

917. Abdullah Salihu, shqiptar kosovar nga fshati Baks në komunën e Skënderajt, dëshmoi se në shtator 1998 atje u krye një ofensivë, që shkaktoi shpërnguljen e 20.000 njerëzve.²³⁹⁷ Jan Kickert-i mendonte se brenda vendit ishin shpërngulur 1.000 persona "gjatë tërë verës" në një kamp në Kërzharekë (komuna e Gllogocit), të cilin e vizitoi më 29 shtator 1998.²³⁹⁸

918. Së fundi, sipas Komisionerit të Lartë për Refugjatë të OKB-së, deri në fund të tetorit 1998 numri i personave të shpërngulur nga Kosova kishte arritur 285.500 vetë.²³⁹⁹

919. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se deri në fund të tetorit 1998 një numër i madh njerëzish nga Kosova, ishin shpërngulur nga shtëpitë e tyre. Megjithëse arsyet konkrete për lëvizjen e tyre mund të kenë qenë të ndryshme, përdorimi i tepruar i forcës nga ana e MPB-së dhe UJ-së në disa zona, i shoqëruar me operacionet e vazhdueshme luftarake midis UÇK-së dhe forcave të RFJ-së dhe Serbisë, ishin një faktor i rëndësishëm që ndikoi në këtë lëvizje njerëzish.

4. Konkluzione

920. Me disa përjashtime, provat e paraqitura nga Prokuroria në lidhje me paragrafët 94 dhe 95 të Aktakuzës nuk kanë qenë të tilla që të provojnë veprime konkrete kriminale të kryera në vitin 1998 nga grupe konkrete të forcave të UJ-së dhe/ose të MPB-së. Provat e paraqitura tregojnë se UJ-ja dhe MPB-ja u angazhuan në operacione kundër UÇK-së nga pranvera e vitit 1998, të cilat u intensifikuan gjatë verës e deri në tetor, sidomos afër kufirit me Shqipërinë dhe në Kosovën qendrore. Në disa raste gjatë këtyre operacioneve u përdor forcë e tepruar dhe pa dallim, që shihet nga dëmet e qëllimshme, shkatërrimi i shtëpive, dhe vrasja e grave dhe fëmijëve. Vëzhguesit dhe organizatat ndërkombëtare shprehën shqetësim për këtë gjendje dhe sidomos për numrin e civilëve të shpërngulur dhe pretendimet për përdorim të tepruar të forcës. Në Kapitullin VIII më poshtë do të shqyrtohet shkalla e dijenisë së secilit prej të Akuzuarve për gjendjen dhe për pretendimet.

D. SHKELJET E MARRËVESHJEVE TË TETORIT

921. Marrëveshjet e arritura në tetor 1998 përfshijnë Marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq, Marrëveshjen e MVK-së (Jovanoviq-Geremek), Marrëveshjen NATO-RFJ (Clark-Perishiq), dhe Marrëveshjen Clark-Naumann, të diskutuara hollësisht në Kapitullin V më lart. Aspektet kryesore për të cilat ishte arritur marrëveshje ishin respektimi i Rezolutës 1199 të Këshillit të Sigurimit të

²³⁹⁷ Abdullah Salihu, T. 1985 (21 gusht 2006), P2255 (deklarata e dëshmitarit e datës 12 mars 2002), f. 2.

²³⁹⁸ Jan Kickert, T. 11222 (7 mars 2007); *shih gjithashtu* P557 (Mesazh i Ambasadës Austriake, 30 shtator 1998), f. 2.

²³⁹⁹ P736 (Pasqyrë statistike e UNHCR-së e refugjatëve dhe azilkërkuesve kosovarë, nga fundi i tetorit 1998 deri më 24 mars 1999).

OKB-së, pakësimi i numrit të forcave të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, dhe vendosja e një misioni verifikues në Kosovë dhe vëzhgimit ajror për të ndihmuar misionin verifikues. Më pas u formua Komisioni Federal për Bashkëpunim për të ndihmuar zbatimin e marrëveshjes.

1. Komisioni Federal për Bashkëpunim

922. Më 19 tetor 1998, qeveria e RFJ-së formoi "Komisionin Federal për Bashkëpunim me Misionin e OSBE-së për Verifikim në Kosovë," të kryesuar nga zëvendëskryeministri i RFJ-së Nikolla Shainoviq.²⁴⁰⁰ Anëtarët e tjerë ishin Zhivadin Jovanoviq, Pavlle Bullatoviq, Momçillo Perishiq, Mihal Kertes, Zoran Angjelkoviq, Vllajko Stojilkoviq, dhe Dushan Llonçar.²⁴⁰¹ Detyra zyrtare e Komisionit ishte "të shqyrtojë dhe koordinojë aspektet politike, të sigurisë, dhe logjistike të funksionimit të Misionit të OSBE-së për verifikim në Kosovë."²⁴⁰²

923. Më 5 nëntor 1998, Presidenti serb Millutinoviq bëri një deklaratë publike duke konfirmuar angazhimin e Serbisë për zgjidhjen e konfliktit në Kosovë me mjete politike dhe përkrahjen për misionin e OSBE-së. Millutinoviqi deklaroi se misioni i OSBE-së ishte pranuar për të verifikuar të vërtetën dhe për të eliminuar thashethemet, spekulimet, dhe nxitjet e organizuara në media.²⁴⁰³ Zhivadin Jovanoviqi, Ratko Markoviqi, Momir Bullatoviqi, dhe Millan Jovanoviqi dëshmuan se synimi i misionit të OSBE-së ishte për t'i treguar botës "të vërtetën" për çfarë po ndodhte në Kosovë.²⁴⁰⁴ Sipas Bullatoviqit, autoritetet e RFJ-së/Serbisë e mbështetën këtë përpjekje përmes investimeve të mëdha në njerëz dhe materiale gjatë mandatit të KVM-së për të ndihmuar verifikuesit.²⁴⁰⁵

924. Komisioni Federal hapi një zyrë në terren në Prishtinë për të mbikëqyrur bashkëpunimin në terren me misionin e OSBE-së. Zyra drejtohej nga Dushan Llonçari, i cili ishte gjenerallejtënant i UJ-së në pension. Pjesëtarë të saj ishin edhe Millan Koturi që përfaqësonte UJ-në, dhe Miroslav

²⁴⁰⁰ Zhivadin Jovanoviq, T. 14026–14029 (20 gusht 2007); 2D8 (Vendim i Qeverisë së RFJ-së për formimin e Komisionit Federal për Bashkëpunim me KVM-në, 19 tetor 1998); 2D9 (Shtesë e vendimit të Qeverisë së RFJ-së për formimin e Komisionit Federal për Bashkëpunim me KVM-në, 29 tetor 1998); 2D81 (Korrespondencë e Qeverisë së RFJ-së në lidhje me tekstin e marrëveshjes midis RFJ-së dhe OSBE-së). *Shih gjithashtu* Velko Odallovic, T. 14423–14424 (27 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14757 (31 gusht 2007).

²⁴⁰¹ 2D8 (Vendim i Qeverisë së RFJ-së për formimin e Komisionit Federal për Bashkëpunim me KVM-në, 19 tetor 1998), para. 3; 2D9 (Plotësues i vendimit të Qeverisë së RFJ-së për formimin e Komisionit Federal për Bashkëpunim me KVM-në, 29 tetor 1998), para. 1.

²⁴⁰² 2D8 (Vendim i Qeverisë së RFJ-së për formimin e Komisionit Federal për Bashkëpunim me KVM-në, 19 tetor 1998), para. 2.

²⁴⁰³ Ratko Markoviq, T. 13171–13172 (8 gusht 2007); 1D45 (Deklaratë e bërë nga Millutinoviqi, 5 nëntor 1998).

²⁴⁰⁴ Zhivadin Jovanoviq, T. 14008 (20 gusht 2007); Ratko Markoviq, T. 13171 (8 gusht 2007); Momir Bullatoviq, T. 13816–13817, 13834 (16 gusht 2007). *Shih gjithashtu* 2D67 (Konkluzionet e Kuvendit Federal të RFJ-së), para. 11; Millan Jovanoviq, T. 14168 (22 gusht 2007); 2D77 (Procesverbal i Sesionit të 90-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së).

²⁴⁰⁵ Momir Bullatoviq, T. 13816–13819 (16 gusht 2007).

Mijatoviqi, që përfaqësonte MPB-në.²⁴⁰⁶ Pjesëtarët e zyrës takoheshin me përfaqësuesit e KVM-së gati çdo ditë nga dhjetori 1998 deri në mars 1999.²⁴⁰⁷ Në këto takime shkëmbeheshin informata për veprimet e UJ-së dhe UÇK-së në Kosovë dhe reagimet e njerëzve në terren.²⁴⁰⁸ Në tetor 1998, Perishiqi krijoi brenda Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së një "Ekip për Bashkëpunim me Misionet e OSBE-së dhe NATO-s," i cili kryesohej nga Obradoviqi.²⁴⁰⁹ Brenda UJ-së, ishin caktuar oficerë si pika kontakti me misionin e KVM-së dhe ishin ngarkuar që të vëzhgonin aktivitetet dhe kontaktet e tyre me UJ-në.²⁴¹⁰

925. Kur Llonçari merrte kërkesa nga KVM-ja për të organizuar mbledhje me organizata të ndryshme, ai i telefononte Mijatoviqit dhe Koturit. Më tej, Velo Sllana, përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së, i informonte për rendin e ditës për t'iu dhënë kohë të përgatiteshin para mbledhjes me përfaqësuesit e KVM-së. Roli i Llonçarit ishte koordinimi i mbledhjes. Nëse kishte çështje që i përkisnin UJ-së, Koturi merrej me to, kurse Mijatoviqi bënte të njëjtën gjë për ato që i përkisnin MPB-së. Në fund, Llonçari bënte një përmbledhje të asaj që kishin thënë të dy, duke theksuar pikat kryesore.²⁴¹¹ Para ardhjes së KVM-së në Kosovë dhe ndërsa KDOM-i ishte ende atje, Shainoviqi takohej me Shaun Byrnes-in çdo dy-tri ditë.²⁴¹² Pas krijimit të Komisionit dhe hapjes së zyrës në Prishtinë, Llonçari kishte për detyrë organizimin e takimeve të Shainoviqit me KVM-në.²⁴¹³

926. Sipas Llonçarit, Komisioni nuk kishte pushtet komandues mbi UJ-në apo MPB-në.²⁴¹⁴ Si rrjedhojë, ai nuk kishte pushtet që t'u jepte urdhra Kotorit apo Mijatoviqit. Ata ishin caktuar në detyrë të përkohshme në ekipin e Llonçarit, por eprorët e tyre ishin në UJ dhe MPB, ku kishin detyrat e tyre të rregullta.²⁴¹⁵ Richard Ciaglinski, shef i Qendrës Rajonale të KVM-së në Prizren me të cilin Llonçari kishte pasur shumë kontakt, kishte përshtypjen se Mijatoviqi, zëvendësi i Llukiqit, ishte në hierarkinë komanduese të MPB-së, mirëpo Llonçari dhe Koturi nuk ishin pjesë e ndonjë

²⁴⁰⁶ Richard Ciaglinski, P2488 (deklarata e dëshmitarit e datës 1 nëntor 2006), f. 6.

²⁴⁰⁷ Richard Ciaglinski, T. 6816, 6859 (17 nëntor 2006).

²⁴⁰⁸ ²⁴⁰⁸ Richard Ciaglinski, T. 6860–6861 (17 nëntor 2006). *Shih* P635 (Pikat kyçe nga mbledhja e KVM/MPB-së, 29 dhjetor 1998); P647 (Pikat kyçe nga mbledhja e KVM/MPB/UJ-së, 19 shkurt 1999); Dushan Llonçar, P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 24.

²⁴⁰⁹ 3D409 (Urdhër drejtuar Ekipit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për Bashkëpunim me Misionet e OSBE-së dhe NATO-së e datës 22 tetor 1998).

²⁴¹⁰ Dushan Llonçar, T. 7675–7677 (1 dhjetor 2006).

²⁴¹¹ Dushan Llonçar, P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 22.

²⁴¹² Dushan Llonçar, P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 25, P2530 (fletë shtesë me të dhënë e datës 28 nëntor 2006), para. 6.

²⁴¹³ Dushan Llonçar, P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 25.

²⁴¹⁴ Dushan Llonçar, T. 7604 (30 nëntor 2006).

²⁴¹⁵ Dushan Llonçar, P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 32. *Shih gjithashtu* Richard Ciaglinski, T. 6815–6816 (17 nëntor 2006).

hierarkie.²⁴¹⁶ Fakti se Llonçari nuk kishte pasur pushtet komandues mbi UJ-në gjithashtu u konfirmua nga Millorad Obradoviç, si dhe nga procesverbali i Kolegjiumit të UJ-së i 27 nëntorit 1998, ku Obradoviç i informoi anëtarët e tjerë të kolegjiumit, përfshirë edhe Ojdaniqin, se për të gjitha kërkesat në lidhje me ushtrinë do të duhej të vendoste Shtabi i Përgjithshëm në përputhje me hierarkinë e rregullt komanduese.²⁴¹⁷

927. Zyra e Llonçarit në Prishtinë gjendej në ndërtesën e KEP-it, ku kishin zyrat edhe Angjelkoviç dhe ministrat krahinorë të KEP-it. Të gjitha mbledhjet me OSBE/KVM-në mbaheshin në këto zyra, përveç takimeve të William Walker-i, shef i misionit, me Shainoviçin, të cilat mbaheshin në sallën e konferencave në katin më të lartë.²⁴¹⁸

928. Në fillim, Llonçari dhe kolegët e tij takoheshin me përfaqësuesit e KVM-së gati çdo ditë për të përcaktuar kanalet dhe mënyrat e komunikimit me ta dhe për të diskutuar çështjet e banimit, lëvizjes, dokumenteve, dhe statusit diplomatik të vëzhguesve. Më vonë, ata takoheshin tri deri katër herë në javë, edhe pse kishte periudha që takoheshin një herë apo edhe dy herë në ditë.²⁴¹⁹ Koturi, Mijatoviç, Sllana, dhe Rapajiç (sekretari i Llonçarit dhe personi i autorizuar për të mbajtur procesverbalin) ishin gjithmonë të pranishëm në këto mbledhje si përfaqësues të autoriteteve të RFJ-së/Serbisë.²⁴²⁰ Walker-i mernte pjesë në emër të KVM-së vetëm nëse kishte çështje që i interesonin atij. Drewienkiewicz-i dhe Ciaglini ishin gjithmonë të pranishëm, së bashku me të tjerët që duheshin në ditën e caktuar. Mbledhjet i kryesonte gjithmonë Llonçari.²⁴²¹ Pas çdo mbledhjeje, Sllana bënte pesë kopje të procesverbalit, të cilat nënshkruheshin nga të pranishmit. Më tej kopjet i dërgoheshin qeverisë së RFJ-së, qeverisë së Serbisë, Ministrisë së Punëve të Jashtme, arkivit, dhe Shainoviçit. Procesverbali gjithashtu vulosej dhe regjistrohej në regjistrin e mbajtur në arkivin e Ministrisë së Punëve të Jashtme.²⁴²²

929. Drewienkiewicz-i dëshmoi se në fazën fillestare të misionit, KVM-ja nuk mori shumë ndihmë nga KEP-i, sepse Zoran Angjelkoviç nuk kishte ndonjë pushtet të vërtetë në Kosovë. Drewienkiewicz-i shpjegoi se shkëmbim më të mirë informacioni pati në nëntor 1998, kur Llonçari

²⁴¹⁶ Sidoqoftë, Ciaglini nuk ishte në gjendje të thoshte nëse anëtarët e rinj të Komisionit, konkretisht gjeneral Brankoviç dhe të tjerët, ishin pjesë e hierarkinë komanduese. Richard Ciaglini, T. 6815, 6862–6864 (17 nëntor 2006); *shih gjithashtu* P489 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviçit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 3271.

²⁴¹⁷ Millorad Obradoviç, T. 15036 (5 shtator 2007); P925 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm, 27 nëntor 1998), f. 17.

²⁴¹⁸ Dushan Llonçar, P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 44.

²⁴¹⁹ Dushan Llonçar, T. 7578–7579 (30 nëntor 2006).

²⁴²⁰ Sipas Llonçarit, Angjelkoviç, i cili ishte kryetar i KEP-it dhe anëtar i Komisionit, nuk mori pjesë asnjëherë në këto mbledhje e as nuk trajtoi çështjet për të cilat ishte përgjegjës Llonçari, megjithëse ishte i pranishëm në Kosovë dhe ishte në të njëjtën ndërtesë. Dushan Llonçar, T. 7580 (30 nëntor 2006).

²⁴²¹ Dushan Llonçar, T. 7579–7580 (30 nëntor 2006).

zëvendësoi Angjelkoviçin në rolin e koordinatorit të qeverisë së RFJ-së në Komision për kontakte.²⁴²³ Pas ardhjes së Llonçarit në Kosovë, vendimet merreshin më shpejt dhe shkëmbimi i informatave ishte më i lehtë;²⁴²⁴ sidoqoftë, Ciaglinski dëshmoi se me kalimin e kohës pushteti i Llonçarit u dobësua.²⁴²⁵

930. Rrjedhimisht, Dhoma konkludon se Komisioni nuk kishte pushtet komandues as mbi UJ-në, as mbi MPB-në, por ishte vetëm një kanal përcjellës i informacionit ndërmjet autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë dhe KVM-së, së paku në fillim.

2. Shkeljet e pretenduara

a. "Incidenti i Podujevës"

i. Rrethanat

931. Komuna e Podujevës ndodhet pikërisht në veri të Prishtinës dhe kishte rëndësi të madhe strategjike sepse vijat më të rëndësishme të furnizimit që lidhin Prishtinën me Nishin kryqëzohen aty. Sidoqoftë, boshti Prishtinë-Podujevë-Nish nuk ishte një nga tri vijat strategjike të furnizimit të përfshira në Marrëveshjen Clark-Naumann, e cila mund të patrullohej nga UJ-ja.²⁴²⁶ Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, UJ-ja ishte e detyruar të largonte kompaninë e vendosur afër Batllavës, gjashtë kilometra në jugperëndim të qytetit të Podujevës,²⁴²⁷ dhe UÇK-ja e shfrytëzoi këtë tërheqje duke i marrë pozicionet e braktisura nga UJ-ja dhe fortifikuar ato. Në dhjetor 1998, UÇK-ja kishte 2.000 luftëtarë në atë zonë.²⁴²⁸

²⁴²² Dushan Llonçar, T. 7593–7596 (30 nëntor 2006); P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 26; P2530 (faqe shtesë informacioni e datës 28 nëntor 2006), para. 7.

²⁴²³ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 20–22, 59; Dushan Llonçar, P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 12–15.

²⁴²⁴ Karol John Drewienkiewicz, T. 7731 (4 dhjetor 2006); P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 59; *shih gjithashtu* Richard Ciaglinski, T. 6816 (17 nëntor 2006); Dushan Llonçar, T. 7578–7579 (30 nëntor 2006).

²⁴²⁵ Richard Ciaglinski, T. 6821 (17 nëntor 2006).

²⁴²⁶ Shaun Byrnes, T. 12164 (16 prill 2007); Richard Ciaglinski, T. 6823 (17 nëntor 2006); Millan Kotur, T. 20636 (18 janar 2008); Michael Phillips, T. 11904 (19 mars 2007); 3D645 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 23 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2; P395 (Shënime të Mbledhjes në Beograd 25 tetor 1998), para. II. *Por shih* Millorad Obradović, T. 14933 (4 shtator 2007), T. 14958–14960 (5 shtator 2007); 3D645 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 23 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2; P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 13, 17.

²⁴²⁷ 3D646 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 26 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

²⁴²⁸ Shaun Byrnes, T. 12193–12194, 12238 (16 prill 2007); Richard Ciaglinski, T. 6823, 6911, 6925 (20 nëntor 2006); Karol John Drewienkiewicz, T. 7915–7916, 7866–7867 (5 dhjetor 2006); Bozhidar Filiq, T. 23936 (7 mars 2008); Branko Gajiq, T. 15206–15208 (7 shtator 2007); Millan Kotur, T. 20776 (22 janar 2008); Vladimir Marinković, T. 20252 (13 dhjetor 2007); Millorad Obradović, T. 14948 (4 shtator 2007); Michael Phillips, T. 11904 (19 mars 2007);

932. Me shtimin e pranisë së UÇK-së në komunë, gjendja e banorëve serbë të Podujevës u përkeqësua dhe shumë civilë u larguan ose u dëbuan nga fshatrat e tyre në pjesën perëndimore të komunës. Serbët e Podujevës protestuan, dhe më 11 dhjetor 1998 iu dërguan një letër autoriteteve të RFJ-së dhe Serbisë ku përshkruanin problemet e tyre dhe kërkonin ndihmë.²⁴²⁹ Në mes të dhjetorit u rrëmbye një oficer i MPB-së dhe KDOM-i negocioi lirim të tij.²⁴³⁰

933. Disa nga ngjarjet në këtë komunë gjatë kësaj periudhe janë shqyrtuar me hollësi në pjesën kushtuar përgjegjësisë së Shainoviqit.

ii. "Stërviija" rezultoi në prishjen e armëpushimit dhe u shndërrua në dislokim

934. Gjatë datave 18-19 dhjetor 1998, UJ-ja e ktheu kompaninë e cila ishte larguar nga aerodromi afër Batllavës. Kjo lëvizje e trupave i befasoi verifikuesit e KVM-së. Ata mësuan për këtë vetëm pasi panë një kolonë ushtarësh dhe automjetesh ushtarake duke dalë nga kazerma e UJ-së. Kur pyetën për këtë, përgjigja ishte se bëhej fjalë për një "stërviije" të zakonshme. Drewienkiewicz-i i sugjeroi UJ-së të bënte stërviije në ndonjë vend tjetër, duke theksuar se kishte të ngjarë që prania e UJ-së në Podujevë të shkaktonte reagimin e UÇK-së. UJ-ja e injoroi këtë protestë. UÇK-ja u përgjigj duke përforcuar pozicionet e veta përgjatë rrugës Podujevë-Prishtinë.²⁴³¹

935. Edhe pse stërviija parashikohej të përfundonte më 22 dhjetor, kompania nuk u largua në atë kohë; Përkundrazi, atë ditë forcat e UJ-së u përforcuan. Millorad Obradoviqi dëshmoi se transformimi nga stërviija në dislokim u bë për shkak të sulmeve të vazhdueshme të UÇK-së në komunë. Një raport bën të ditur se Ojdaniqi e miratoi mbajtjen e forcave në Batllavë.²⁴³²

3D1025 (Komunikim i Armatës së 3-të me Shtabin e Përgjithshëm të UJ-së, 6 dhjetor 1998), f. 1; P414 (Letër e Kuvendit Komunal të Podujevës dërguar Sllobodan Millosheviqit dhe të tjerëve, 11 dhjetor 1998), f. 2.

²⁴²⁹ Karol John Drewienkiewicz, T. 7938 (5 dhjetor 2006); Richard Ciaglini, T. 6911 (20 nëntor 2006); Bozhidar Filiq, T. 23935–23936 (7 mars 2008); Lubivoje Joksiq, T. 21984 (8 shkurt 2008); Vladimir Marinkoviq, T. 20252 (13 dhjetor 2007); Michael Phillips, T. 11904 (19 mars 2007) (duke theksuar se popullata shqiptare po dëbohej); P414 (Letër e Kuvendit Komunal të Podujevës dërguar Sllobodan Millosheviqit dhe të tjerëve, 11 dhjetor 1998), f. 1, 3–6.

²⁴³⁰ *Shih* Shaun Byrnes, T. 12232 (17 prill 2007).

²⁴³¹ Shaun Byrnes, T. 12165–12166 (16 prill 2007), 12233 (17 prill 2007); Richard Ciaglini, T. 6822, 6842 (17 nëntor 2006); Karol John Drewienkiewicz, T. 7782–7783 (4 dhjetor 2006), P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 96; Millan Kotur, T. 20636 (18 janar 2008); Dushan Llonçar, T. 7623 (1 dhjetor 2006); Vladimir Marinkoviq, T. 20253 (13 dhjetor 2007); Millorad Obradoviq, T. 14944–14945, 15053–15055 (4 shtator 2007); Michael Phillips, T. 11847 (19 mars 2007); P506 (Raport i Zyrës së Ministrisë së Jashtme të RFJ-së në Prishtinë, 20 dhjetor 1998), f. 1–2; 3D785 (Raport i Ekipit të Armatës së 3-të për Bashkëpunim me OSBE-në dhe NATO-n, 18–24 dhjetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 1; 3D1033 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 19 dhjetor 1998), f. 2–3; P924 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 24 dhjetor 1998), f. 14. *Gjithsesi shih*. 4D423 (Raport i Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm, 21 dhjetor 1998), f. 4 ("Periudha e përshtatjes së rekrutëve të dhjetorit ... ka filluar dhe do të vazhdojë deri më 23 dhjetor 1998.").

²⁴³² Millorad Obradoviq, T. 14948 (4 shtator 2007); 3D785 (Raport i Ekipit të Armatës së 3-të për Bashkëpunim me OSBE-në dhe NATO-n, 18–24 dhjetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 1; 4D423 (Raport: Armata e 3-

936. Ridislokimi shkaktoi prishjen e armëpushimit. Më 21 dhjetor, një togë e dërguar në fshatin Bajçinë, nga aerodromi në Batllavë, hasi në një postbllok të UÇK-së nga i cili u hap zjarr kundër saj. UJ-ja iu përgjigj zjarrit dhe më në fund të dy palët u tërhoqën. Gjatë kthimit të togës në Batllavë pati shkëmbime sporadike zjarri.²⁴³³ Të nesërmen pati luftime të ashpra në "Tank Hill," pozicion i fortifikuar i UÇK-së mbi rrugën Podujevë-Prishtinë.²⁴³⁴ Luftimet më të ashpra ndodhën pas dy ditësh, më 24 dhjetor 1998, që filluan në fshatin Obrancë, pak më në perëndim të Podujevës. Së paku dy ushtarë të UJ-së u plagosën rëndë dhe disa dhjetëra pjesëtarë të UÇK-së u vranë. Verifikuesit e KVM-së u takuan me të dyja palët për të rivendosur armëpushimin, por pa sukses.²⁴³⁵ Tri ditët e ardhshme pati shumë luftime të ashpra pasi UÇK-ja u hakmor duke sulmuar civilët serbë në atë zonë.²⁴³⁶ Armëpushimi u rivendos më 28 dhjetor dhe KVM-së iu dha mundësia të evakuonte të plagosurit.²⁴³⁷

iii. Pasojat e stërvitjes në mbledhjen e 30 dhjetorit 1998 e Kolegjiut të UJ-së

937. Në mbledhjen e Kolegjiut të UJ-së më 30 dhjetor 1999, u diskutua gjerësisht gjendja në Podujevë. Në raportin mbi gjendjen të gjeneral Sllobodan Kovaçevićit përmendeshin dy ushtarë të plagosur në luftimet e 24 dhjetorit në Obrancë, situata e mjerueshme e popullatës serbe të

të për Qendrën e Operacioneve të Shtabit të Përgjithshëm, 21 dhjetor 1998), f. 3; P924 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 24 dhjetor 1998), f. 14. Ndërsa prova materiale 4D423 përmend zonën "Malo Kosovo," ky term është një emër tjetër për rajonin e Podujevës. *Shih* Stefanoviq, T. 21654 (5 shkurt 2008).

²⁴³³ 3D785 (Raport i Ekipit të Armatës së 3-të për Bashkëpunim me OSBE-në dhe NATO-n, 18–24 dhjetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 1–2; 3D1035 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 24 dhjetor 1998), f. 2; 4D423 (Raport: Armata e 3-të për Qendrën e Operacioneve të Shtabit të Përgjithshëm, 21 dhjetor 1998), f. 2; *shih gjithashtu* Millorad Obradoviq, T. 14945 (4 shtator 2007).

²⁴³⁴ Karol John Drewienkiewicz, T. 7783 (4 dhjetor 2006); Dushan Llonçar, T. 7625–7627 (1 dhjetor 2006); *shih gjithashtu* Shaun Byrnes, T. 12238 (16 prill 2007); Michael Phillips, T. 11851–11852 (19 mars 2007); P2586 (Fotografi të operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe të MPB-së në Kosovë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6.

²⁴³⁵ 3D785 (Raport i Ekipit të Armatës së 3-të për Bashkëpunim me OSBE-në dhe NATO-n, 18–24 dhjetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2; 3D1035 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 24 dhjetor 1998), f. 5; 3D1036 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 26 dhjetor 1998), f. 1; P634 (Kronologji e ngjarjeve kryesore në Kosovë nga 15 tetori deri më 18 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 4; P928 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 3; P2544 (Pikat kryesore të takimit midis Llukiqit dhe Drewienkiewicz-it, 24 dhjetor 1998), f. 1.

²⁴³⁶ Vladimir Marinkoviq, kapiten i UJ-së, u qëllua nga forcat e UÇK-së kur po udhëtonte me makinë dhe rroba civile. Vladimir Marinkoviq, T. 20254 (13 dhjetor 2007); 3D785 (Raport i Ekipit të Armatës së 3-të për Bashkëpunim me OSBE-në dhe NATO-n, 18–24 dhjetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2; 3D1035 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 24 dhjetor 1998), f. 2, 4; P928 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 3 Millan Radojeviq, kryefamiljari i familjes së fundit serbe në Obrancë është vrarë në prag të shtëpisë. Richard Ciaglini, T. 6893–6894 (20 nëntor 2006); Lubivoje Joksiq, T. 21984 (8 shkurt 2008); Dushan Llonçar, T. 7618–7619 (30 nëntor 2006); 3D1036 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 26 dhjetor 1998), f. 1; *shih gjithashtu* 6D1016 (MPB Prizren, të dhëna për gjendjen aktuale në zonën e Podujevës, 28 dhjetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 1; P2586 (Fotografi që tregojnë operacionet e përbashkëta të UJ-së dhe të MPB-së në Kosovë), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3–4. UÇK-a rrëmbeu një bujk serb, i cili u lirua pas një orvatjeve fillestare të dështuar të MPB-së për ta liruar që nxiti ndërhyrjen e KVM-së e cila negocioi lirin e tij. Richard Ciaglini, T. 6822–6826 (17 nëntor 2006).

²⁴³⁷ P634 (Kronologji e ngjarjeve kryesore në Kosovë nga 15 tetori deri më 18 prill 1999), f. B-3; *shih* 3D1037 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 28 dhjetor 1998), f. 1 (raport i luftimeve midis MPB-së dhe UÇK-së më 27 dhjetor 1998).

Podujevës dhe presioni i KVM-së për largimin e forcave të UJ-së nga fusha e aviacionit në Batllavë.²⁴³⁸ Aleksandar Dimitrijeviqi shprehu dyshime në lidhje me zhvillimin e stërvitjeve në komunë, por pranoi se vetëm prania e asaj kompanie në fushën e aviacionit në Batllavë kishte parandaluar daljen e kësaj komune nga kontrolli shtetëror.²⁴³⁹

938. Gjeneral Millan Bojoviqi u ankua se Marrëveshja e Tetorit e kufizonte mundësinë e ushtrisë për të vepruar. Dimitrijeviqi u përgjigj se kjo nuk ishte e vërtetë dhe se ushtrisë i lejohej të ndërhynte: mirëpo Dimitrijeviqi u ankua se "të ashtuquajturat stërvitje të rreme ose të vërteta" në terren kishin pasojë shkatërruese, se "shpjegimi se kjo ishte stërvitje e planifikuar nuk ishte i vërtetë," dhe se në fakt ishte "planifikuar që njësi do të provokonte terroristët kështu që MPB-ja të ishte në gjendje të bënte atë që duhej të bëhej." Ai ishte i pakënaqur që "MPB-ja nuk kishte bërë atë që duhej më pas."²⁴⁴⁰ Në gjyq, Millan Koturi deklaroi se nuk pajtohej me thëniet e Dimitrijeviqit dhe hamendësoi se komentet e Dimitrijeviqit ishin rezultat i luftës së brendshme politike në UJ.²⁴⁴¹

939. Disa deklarata të tjera të bëra në mbledhjen e Kolegjiumit mbështesin përfundimin se "stërvitja" ishte vetëm mashtrim. Obradoviqi komentoi mbi mënyrën sesi UJ-ja kishte "arritur që të mos e regjistronte si grup luftarak" duke e quajtur stërvitje.²⁴⁴² Ndërsa Ojdaniqi vuri në dyshim "nëse ishin përzgjedhur saktë rrugët e marshimit dhe vendi i kampit," ai gjithashtu shprehu dyshimet në lidhje me motivin e stërvitjes, duke aluduar se prania e kompanisë në Podujevë justifikohet me veprimet e UÇK-së në atë zonë.²⁴⁴³

iv. Rifortifikimi dhe tensionet e vazhdueshme në Podujevë

940. Periudha pas këtij incidenti u karakterizua nga tensione të shtuara dhe shpërthime të herëpashershme të dhunës në komunë.²⁴⁴⁴ Fshatrat në Podujevë ishin ndarë kryesisht në baza etnike, sidomos në zonat nën kontrollin e UÇK-së.²⁴⁴⁵ Forcat e armatosura të të dyja palëve në konflikt shfrytëzuan armëpushimin për të sjellë përforcime dhe për të forcuar fortifikimet përgjatë segmentit Podujevë-Lluzhan të rrugës, që realisht ishte vija ndarëse midis territoreve të kontrolluara

²⁴³⁸ P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 3–4.

²⁴³⁹ P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 7, 10.

²⁴⁴⁰ P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 12, 14.

²⁴⁴¹ Millan Kotur, T. 20776 (22 janar 2008).

²⁴⁴² P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 14–15.

²⁴⁴³ P928 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 dhjetor 1998), f. 17.

²⁴⁴⁴ 3D359 (Qendra e Bashkimit e KVM-së, 2 janar 1999), f. 4; 3D363 (Qendra e Bashkimit e KVM-së, 8 janar 1999), f. 5; 3D1039 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 9 janar 1999), f. 2; 3D1041 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 19 janar 1999), f. 4; 3D1050 (Raport i Degës së Sigurimit të Armatës së 3-të, 5 mars 1999), f. 1–2.

²⁴⁴⁵ Karol John Drewienkiewicz, T. 7797 (4 dhjetor 2006); 3D359 (Qendra e Bashkimit e MVK-së, 2 janar 1999), f. 5–6; 3D1037 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 28 dhjetor 1998), f. 1; P1228 (Raport mbi Gjendjen i Shtabit të MPB-së, 3 janar 1999), f. 4.

nga UÇK-ja dhe RFJ-ja/Serbia.²⁴⁴⁶ Periudha 28 dhjetor 1998 - 20 mars 1999 u karakterizua nga kërkesa të vazhdueshme të KVM-së, që UJ-ja t'i tërhiqte forcat e saj nga komuna. Nga ana e tyre, përfaqësuesit e forcave të RFJ-së dhe Serbisë deklarorin rregullisht se forcat në fushën e aviacionit në Batllavë po tërhiqeshin, edhe pse kompania nuk u largua asnjëherë.²⁴⁴⁷

941. Më 27 janar 1999, kompania e UJ-së në Batllavë shkaktoi sërish luftime kur kreu "stërvitjen" e quajtur "Sigurimi i Rrugëve dhe Kapja e Objekteve të Përcaktuara." Luftimet u zhvilluan gjatë tërë ditës në fshatrat përgjatë vijës ndarëse.²⁴⁴⁸

942. Kompania e UJ-së qëndroi në Batllavë deri në fillim të fushatës së NATO-s.²⁴⁴⁹ Në fakt, asaj iu dha rol i madh në urdhrin për thyerjen dhe shkatërrimin e UÇK-së në Podujevë pak para fillimit të fushatës së bombardimeve të NATO-s.²⁴⁵⁰ MPB-ja raportoi luftime të ashpra në dhjetëra vende në komunë në ditën në të cilën ishte caktuar kryerja e operacionit.²⁴⁵¹

v. Konkluzionet

943. Duke u bazuar në të gjitha provat e paraqitura në lidhje me këtë çështje, Dhoma konkludon se dislokimi i kompanisë së UJ-së në fushën e aviacionit në Batllavë në dhjetor 1998 përbënte shkelje të Marrëveshjeve të Tetorit. Dhoma nuk është e bindur nga shpjegimet se dislokimi ishte stërvitje dhe konkludon se ka qenë provokim i planifikuar. UJ-ja këmbënguli se dislokimi ishte stërvitje sepse e dinte se prania e kompanisë së UJ-së në Batllavë ishte shkelje dhe provokim. Po të kishte qenë ndryshe, do të ishte kërkuar mbështetje në të drejtën e sanksionuar në Marrëveshjen Clark-Naumann se "si opion i fundit dhe në pajtim me të drejtën për vetëmbrojtje, autoritetet shtetërore rezervojnë të drejtën që t'i përgjigjen në mënyrë adekuate dhe proporcionale çdo forme të veprimtarisë terroriste ose shkeljeje të ligjit që do të mund të rrezikonte jetën dhe sigurinë e qytetarëve dhe përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore."²⁴⁵² Dhoma gjithashtu konkludon se dislokimi dhe stërvitjet synonin që të nxitnin hapjen e zjarrit nga ana e UÇK-së dhe të shërbenin si

²⁴⁴⁶ 3D174 (Raport ditor i OSBE/KVM-së, 12 janar 1999), f. 3; 3D1038 (Raport i Degës së Sigurimit të Komandës së PrK-së, 29 dhjetor 1998), f. 1; 6D1016 (MPB Prizren, të dhëna për gjendjen aktual në zonën e Podujevës, 28 dhjetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2; P662 (Raport paraprak i OSBE/MVK-së, 10 janar 1999), f. 1.

²⁴⁴⁷ 2D20 (Pjesë nga fletoret e Phillips-it, 14 janar 1999); P651 (Shtojcë DZ-18, Shënime të Mbledhjes Midis KVM-së dhe Dushan Llonçarit, 16 janar 1998), f. 1. Dhoma vëren se P651 shënon në disa vende "1998" si datë të dokumentit, por gjykon se kjo duhet të jetë gabim sepse KVM-ja nuk ishte formuar në janar 1998. Shih Klaus Naumann, T. 8269–82670 (13 dhjetor 2006).

²⁴⁴⁸ 5D648 (Raport i Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 28 janar 1999), f. 1; 5D978 (Raport i Rregullt Operativ i Komandës së Qarkut Ushtarak, 28 janar 1999), f. 1.

²⁴⁴⁹ P932 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 shkurt 1999), f. 7; shih 6D1416 (Plan veprimi i PrK-së, 18 mars 1999), f. 1; P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999), f. 2–4.

²⁴⁵⁰ 6D1416 (Plan veprimi i PrK-së, 18 mars 1999), f. 1–2; P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999), f. 1–4.

²⁴⁵¹ 6D1229 (Pasqyrë e Ngjarjeve të Sigurisë, 21 mars 1999), f. 1–4.

²⁴⁵² P395 (Marrëveshja Clark-Naumann, 25 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 4.

shkas për të sjellë më shumë forca në Kosovë. Këto forca ishin sjellë për të ruajtur kontrollin mbi rrugën Prishtinë-Podujevë-Nish, gjë që mundësoi dislokime të tjera të paligjshme në Kosovë në 1999.

b. Mbledhjet javore dhe shkëputja e komunikimit

944. Michael Philips, i cili ishte shef i kabinetit të shefit të KVM-së, dhe William Walker i transmetuan Millosheviqit dhe Shainoviqit ankesat në lidhje me përdorimin brutal të forcave të RFJ-së/Serbisë në Kosovë në fund të vitit 1998 dhe në fillim të vitit 1999. Shainoviqit iu shprehën këto shqetësime gjatë mbledhjeve javore me KVM-në dhe në prani të Llukiqit.²⁴⁵³ Sipas Phillips-it, kur ballafaqoheshin me ankesat, të dy ata justifikoheshin duke thënë se iu duhej të mbronin popullin serb sepse KVM-ja nuk i mbronte dhe se ata po bënin diçka që ishte krejtësisht e logjikshme, u përgjigjeshin veprimeve të UÇK-së.²⁴⁵⁴

945. Phillips-i gjithashtu dëshmoi për një mbledhje me Millosheviqin të mbajtur rreth 24 nëntorit 1998, qëllimi i të cilës ishte diskutimi i problemeve të bashkëpunimit midis KVM-së dhe autoriteteve të RFJ-së/Serbisë. Në mbledhje ishte i pranishëm edhe Shainoviqi. Sipas Phillips-it, Walker-i kishte menduar se ishte e nevojshme që Millosheviqit t'i dorëzohej një letër në atë moment në të cilën duhej të përshkruhej bashkëpunimi që misioni priste nga autoritetet e RFJ-së/Serbisë dhe të numëroheshin problemet që kishte përjetuar në Kosovë.²⁴⁵⁵ Phillips-i shpjegoi se kjo u bë sepse nuk po merrnin rezultate nga Shainoviqi.²⁴⁵⁶ Kur dëgjoi për problemet, Millosheviqi u shqetësua, sepse mendonte se kishte ofruar një nivel të lartë bashkëpunimi. Kjo çështje kishte lidhje kryesisht me sigurinë që kërkonte KVM-ja. Sipas Phillips-it, Millosheviqi mendonte se me të gjitha problemet rreth sigurisë do të merrej MPB-ja ose forcat serbe të sigurisë.²⁴⁵⁷ Përshtypja e Phillips-it nga kjo mbledhje kishte qenë se Millosheviqi ishte përgjegjës për vendimet në lidhje me forcat e sigurisë, të cilat Shainoviqi i zbatonte në Kosovë.²⁴⁵⁸

946. Phillips-i dëshmoi se natyra e mbledhjeve me autoritetet e RFJ-së/Serbisë ndryshoi në periudhën prej 25 dhjetorit 1998 e deri në incidentin e Reçakut në janar 1999. Në ditët para këtij incidenti, mbledhjet ishin armiqësore dhe më vonë u ndërpre në krejtësisht. Shainoviqi ishte i pranishëm në të gjitha mbledhjet javore me përjashtim të mbledhjes së fundit pak pas incidentit të

²⁴⁵³ Michael Phillips, T. 11845 (19 mars 2007).

²⁴⁵⁴ Michael Phillips, T. 11845–11846 (19 mars 2007).

²⁴⁵⁵ Michael Phillips, T. 11841–11842, 11944–11945 (19 mars 2007); P396 (Letër e William Walker-it dërguar Sllobodan Millosheviqit, 23 nëntor 1998).

²⁴⁵⁶ Michael Phillips, T. 11872–11873 (19 mars 2007).

²⁴⁵⁷ Michael Phillips, T. 11842–11843 (19 mars 2007).

²⁴⁵⁸ Michael Phillips, T. 11843–11844 (19 mars 2007).

Reçakut, në të cilin ata provuan ta ftonin, por nuk mundën ta kontaktonin.²⁴⁵⁹ Në mbledhjen e mbrëmjes së 15 janarit 1999 në vend të tij erdhi Llonçari.²⁴⁶⁰ Edhe Llukiqi gjithashtu mori pjesë në të gjitha mbledhjet përveç asaj të 15 janarit 1999.²⁴⁶¹

947. Dhoma Gjyqësore ka dëgjuar se, më 27 nëntor 1998, Drewienkiewicz-i takoi Ojdaniqin menjëherë pas emërimit të të dytit.²⁴⁶² Sipas Drewienkiewicz-it, Ojdaniqi premtoi se UJ-ja do t'i plotësonte detyrimet që dilnin nga Marrëveshja Jovanoviq-Geremek dhe se ai do të ishte transparent në lidhje me ndërrimin e trupave në Kosovë.²⁴⁶³ Ojdaniqi gjithashtu tha se UJ-ja do të bënte stërvitje jashtë kazermave; por, kur iu kërkua që të jepte hollësi të vendeve të stërvitjeve, ai nuk i dha.²⁴⁶⁴ Pak pas takimit, Drewienkiewicz-i mori informata në lidhje numrin e forcave të UJ-së në Kosovë.²⁴⁶⁵ Meqenëse këto shifra nuk përfshinin të gjitha informatat e kërkuara, më 2 dhjetor Drewienkiewicz-i i dërgoi letër Ojdaniqit duke i kërkuar hollësitë që mungonin.²⁴⁶⁶ Gjithashtu, Drewienkiewicz-i kërkoi të organizonte një takim tjetër me komandantin e Korpusit të Prishtinës, Pavkoviqin, për të diskutuar rotacionin e trupave në Kosovë, por nuk mundi ta realizonte.²⁴⁶⁷ Mbrojtja e Ojdaniqit pretendon se UJ-ja nuk ishte e lirë që të interpretonte detyrimet që dilnin nga Marrëveshja e Tetorit, sepse kjo u takonte autoriteteve politike.²⁴⁶⁸ Sidoqoftë, Mbrojtja e Ojdaniqit nuk e sqaron këtë argument dhe nuk i referohet asnjë burimi në lidhje me faktin që Ojdaniqi mund të jetë penguar për dhënien e informatave të kërkuara.

948. Phillips-i dëshmoi se autoritetet e RFJ-së/Serbisë nuk iu përmbajtën zotimeve të tyre. Ata nuk e hapën "zyrën konsullore" në Prishtinë, faktor që ngadalësoi ardhjen e verifikuesve në Kosovë; nuk dhanë informata për fushat e minuara për të ndihmuar lëvizjen e KVM-së dhe kthimin e të shpërngulurve në shtëpitë e tyre; dhe gjithashtu nuk dhanë informacion fillestar në lidhje me

²⁴⁵⁹ Michael Phillips, T. 11830–11831 (19 mars 2007).

²⁴⁶⁰ Phillips-i konfirmoi se Llonçari dhe Walker-i kishin punuar së bashku në Sllavinë Lindore në 1991 dhe, në fillim, Walker-i kishte qenë i lumtur se do të punonte përsëri me një mik të vjetër. Sidoqoftë, sipas Phillips-it, natyra e marrëdhënieve të tyre ndryshoi gjatë misionit në Kosovë dhe u bë jobashkëpunuese. Michael Phillips, T. 11831–11833 (19 mars 2007).

²⁴⁶¹ Michael Phillips, T. 11830–11831 (19 mars 2007).

²⁴⁶² Karol John Drewienkiewicz, T. 7918 (5 dhjetor 2006); P2535 (Shënime nga Mbledhja me Ojdaniqin 27 nëntor 1998); Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës qershor 2000), para. 66.

²⁴⁶³ Karol John Drewienkiewicz, T. 7918 (5 dhjetor 2006); P2535 (Shënime nga Mbledhja me Ojdaniqin 27 nëntor 1998).

²⁴⁶⁴ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës qershor 2000), para. 64.

²⁴⁶⁵ P2543 (Letër e Drewienkiewicz-it dërguar Ojdaniqit, 2 dhjetor 1998); Karol John Drewienkiewicz, T. 7919–7926 (5 dhjetor 2006).

²⁴⁶⁶ P2543 (Letër e Drewienkiewicz-it dërguar Ojdaniqit 2 dhjetor 1998); Karol John Drewienkiewicz, T. 7768–7769 (4 dhjetor 2006).

²⁴⁶⁷ Karol John Drewienkiewicz, T. 7768–7769 (4 dhjetor 2006); P418 (Mesazh nga Dushan Llonçari dërguar Karol John Drewienkiewicz-it, 7 dhjetor 1998).

²⁴⁶⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 175.

numrin e trupave dhe të armëve.²⁴⁶⁹ Phillips-i mendonte se këto refuzime ishin rezultat i mungesës së vullnetit e jo pamundësia materiale për plotësimin e zotimeve dhe qëllimi ishte që të ngadalësohej misioni i KVM-së.²⁴⁷⁰

949. Phillips-i gjithashtu dëshmoi se Shainoviqi nuk dha informacion për fushat e minuara, i nevojshëm për të ndihmuar lëvizjen e KVM-së dhe për kthimin e të shpërngulurve në shtëpitë e tyre, me gjithë premtimet e tij se do të shikonte problemin e lokalizimit dhe/ose pastrimit të fushave të minuara.²⁴⁷¹ Megjithatë, menjëherë mbas nënshkrimit të marrëveshjes për KVM-së, në një mbledhje të Komandës së Përbashkët më 22 tetor 1998 Shainoviqi tha se "duhet të bëhen gati të dhënat për vendin e minave në terren," që tregon se së paku ishin ndërmarrë hapat fillestarë për mbledhjen e këtyre informatave.²⁴⁷²

950. Ciaglinski tregoi se si u provua pushteti i Shainoviqit mbi ngjarjet në Kosovë gjatë dy takime që pati me Llonçarin më 24 dhjetor 1998, ku u diskutua lëvizja e trupave. Në takimin e parë, Ciaglinski u ankua se KVM-së nuk i jepeshin informata për lëvizjen e trupave. Në të dytin, i cili u mbajt rreth dy orë më vonë, Llonçari tha se kishte folur me Pavkoviqin dhe se kalimi i informatave do të rregullohej. Sidoqoftë, Llonçari tha se kjo duhej të konfirmohej në një mbledhje tjetër të mëvonshme atë mbrëmje me William Walker-in, Shainoviqin, dhe komandantin e MPB-së. Sipas Ciaglinski-t, ky episod tregonte se Llonçari mund kishte ndikim vetëm në çështjet vendore, por Shainoviqi mund të fliste në emër të "Beogradit" dhe se të gjitha çështjet politike duhej të shkonin përmes Shainoviqit.²⁴⁷³

951. Phillips-i deklaroi se nuk mund të thoshte nëse trupat e MPB-së dhe UJ-së u pakësuan siç ishte kërkuar, sepse KVM-ja asnjëherë nuk e mori numrin fillestar të trupave.²⁴⁷⁴ Mirëpo, Maisonneuve dëshmoi se, edhe pse ai nuk e dinte numrin e efektivave të UJ-së dhe MPB-së të lejuar me Marrëveshjet, ai besonte se ishte negociuar dhe ishte arritur marrëveshje për një numër të përcaktuar dhe se "do të ishte e logjikshme" që ky numër t'i ishte përcjellë KVM-së nga KDOM-i.²⁴⁷⁵ Mbrojtja e Shainoviqit e mori në pyetje Drewienkiewicz-it duke e marrë të mirëqenë se numri fillestar i trupave i ishte dhënë KDOM-it, por nuk iu kalua KVM-së. Kur Dhoma e pyeti Mbrojtjen

²⁴⁶⁹ Michael Phillips, T. 11833–11835 (19 mars 2007).

²⁴⁷⁰ Michael Phillips, T. 11835 (19 mars 2007). *Por shih* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 156 (këtu Shainoviqi deklaroi se "artileria e rëndë nuk duhet të përdoret gjatë operacioneve të MPB-së. Duhet të përgatiten të dhëna për vendin e minave në terren. Qëndrimi ynë është se ne nuk kemi vënë mina në thellësi të arës. Po ta kishim ditur se kishte mina aty, do ta kishim raportuar.").

²⁴⁷¹ Michael Phillips, T. 11833–11835 (19 mars 2007).

²⁴⁷² P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 156.

²⁴⁷³ Richard Ciaglinski, P2488 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 mars 2000), f. 5–6.

²⁴⁷⁴ Michael Phillips, T. 11896–11898 (19 mars 2007); P395 (Marrëveshja Clark-Naumann).

²⁴⁷⁵ Joseph Maisonneuve, T. 11166–11167 (7 mars 2007).

e Shainoviçit se ku e bazonte pretendimin se numri fillestar i ishte kaluar KDOM-it, ajo nuk qe në gjendje të identifikonte asnjë provë (përveç supozimit se, meqenëse KVM-ja kishte thënë se policia dhe ushtria i ishin përmbajtur përgjithësisht marrëveshjes, ata me siguri e dinin numrin). Si rrjedhojë Dhoma gjykon se kjo pistë pyetjesh ishte e pabazë.²⁴⁷⁶ Çuditërisht, Shaun Byrnes, përfaqësues i KDOM-it amerikan, nuk u pyet nga Mbrojtja se a i ishte dhënë KDOM-it numri fillestar. Dhoma konkludon se dëshmia e Maisonneuve-it është e saktë në lidhje me këtë çështje, konkretisht se "do të ishte e logjikshme" që numri të ishte fiksuar dhe që KDOM-i t'ia kishte dhënë këtë numër KVM-së.²⁴⁷⁷ Gjithashtu, më 24 - 25 tetor 1998 në Beograd u mbajtën mbledhje teknike; ndërmjet pjesëmarrësve ishin Shainoviçi, Millutinoviçi, Gjorgjeviçi, oficerë të ndryshëm policorë dhe ushtarakë, Naumann, Clark, dhe Byrnes. Naumann-i tha se në këto mbledhje u pranua numri prej 10.000 pjesëtarësh të MPB-së në Kosovë si numër në kohë paqeje dhe se numri i aktual i pranuar i pjesëtarëve të MPB-së në Kosovë në atë kohë ishte 14.000-15.000.²⁴⁷⁸

c. Inspektimi i kazermave dhe liria e lëvizjes në tërë Kosovën

952. Sipas kushteve të Marrëveshjes me KVM-në, qeveria e RFJ-së duhej të pranonte Misionin Verifikues të OSBE-së si entitet diplomatik me privilegjet dhe imunitetin përkatës; në Marrëveshje më tej përcaktohej shprehimisht se "pjesëtarët e misionit do të kenë lirinë e plotë të lëvizjes dhe të kalimit nëpër tërë Kosovën në çdo kohë."²⁴⁷⁹ Michael Phillips-i dëshmoi se, kur KVM-ja mbërriti për herë të parë në Kosovë pas Marrëveshjes së KVM-së, misioni kishte përgjithësisht liri lëvizjeje me kufizime të vogla. Në muajt dhjetor 1998 dhe janar 1999, lëvizja për misionin u bë më i vështirë nga postbllloqet: policia thoshte se nuk mund t'i garantonte siguri pjesëtarëve të KVM-së dhe refuzonte t'i linte të kalonin.²⁴⁸⁰ Në përpjekje për zgjidhjen e problemeve të lëvizjes, KVM-ja zakonisht mbante mbledhje javore me përfaqësuesit e RFJ-së/Serbisë në ndërtesën e qeverisë në Prishtinë. Ata takoheshin me Shainoviçin, Llonçarin, Lluqiçin, dhe disa përkthyes për të diskutuar problemet me të cilat ballafaqohej KVM-ja për kryerjen e misionit të saj në Kosovë. Sipas Phillips-it, ndër problemet ishin lëvizja e kufizuar në rajon, vështirësi me regjistrimin e makinave për verifikuesit dhe zvarritja e pastrimit të fushave të minuara për të lejuar vajtjen e verifikuesve në "vende të ndryshme në Kosovë dhe rreth saj."²⁴⁸¹

²⁴⁷⁶ Karol John Drewienkiewicz, T. 7886–7894 (5 dhjetor 2006).

²⁴⁷⁷ Joseph Maisonneuve, T. 11166–11167 (7 mars 2007).

²⁴⁷⁸ Klaus Naumann P1767 (shënime të intervistave të Prokuroria), para. 16.

²⁴⁷⁹ P658 (Marrëveshja e MVK-së e datës 16 tetor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 2–3.

²⁴⁸⁰ Michael Phillips, T. 11829 (19 mars 2007). *Shih gjithashtu* 2D19 (Pjesë nga fletorja e Michael Phillips-it re: Mbledhje me Shainoviçin, 18 dhjetor 1998), duke iu referuar një mbledhjeje në të cilën Shaun Byrnes kishte shprehur kënaqësinë për informatat në lidhje me MPB-në, por gjithashtu kishte kërkuar sqarime për refuzimin e lëvizjes për Drewienkiewicz-in.

²⁴⁸¹ Michael Phillips, T. 11829–11835 (19 mars 2007).

953. Llonçari dëshmoi se Shainoviçi ishte i vetmi person që mund të autorizonte ose të lejonte KVM-në për inspektimin e objekteve. Llonçari ia përcillte kërkesat për inspektim të Drewienkiewicz-it Shainoviçit, i cili i refuzonte gjithmonë, duke thënë se inspektime të tilla nuk ishin pjesë e Marrëveshjeve të Tetorit.²⁴⁸² Sidoqoftë, Llonçari sqaroi se prej anëtarëve të tjerë të Komisionit dëgjoi se "[për këtë ishte marrë] një vendim nga kabineti federal sepse askush, e as Shainoviçi, nuk kishin të drejtë të tejkalonin kushtet e marrëveshjes."²⁴⁸³ Refuzimi i Shainoviçit për lejimin e inspektimeve gjithashtu u konfirmua nga Millorad Obradoviçi.²⁴⁸⁴

954. Njëri nga nënshkruesit e Marrëveshjes së KVM-së, Zhivadin Jovanoviçi, shpjegoi se marrëveshja nuk parashikonte inspektime të tilla: ajo vetëm i jepte KVM-së liri lëvizjeje dhe kalimi përmes territorit, jo kontrollim të armatimit. Jovanoviçi tha se kontrollimi i armatimit rregullohet me marrëveshje ndërkombëtare dhe procedura më të hollësishme dhe nuk përfshihet në konceptin e përgjithshëm të "lirisë së lëvizjes."²⁴⁸⁵ Jovanoviçi shtoi se ai dhe nënshkruesi Bronislaw Geremek²⁴⁸⁶ nuk diskutuan asnjëherë kontrollin e armatimeve ose inspektimin e kazermave; "liria e lëvizjes" në Marrëveshje i referohej të drejtës së KVM-së që të verifikonte kushtet e armëpushimit.²⁴⁸⁷ Obradoviçi dëshmoi se, sipas Marrëveshjes së KVM-së dhe Nenit 4 të Marrëveshjes së Vjenës mbi Kontrollin Nënrajonal të Armëve, KVM-ja kishte të drejtë të inspektonte pajisjet e UJ-së, por jo të hynte në kazermat e saj.²⁴⁸⁸ Ai shpjegoi se madhësia numerike e UJ-së dhe të dhënat për madhësinë e secilës njësi, armatimin, dhe pajisjet i ishte dhënë KVM-së më herët; kështu që nuk kishte nevojë që dikush të hynte në kazerma.²⁴⁸⁹ Obradoviçi

²⁴⁸² Dushan Llonçar, P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 33; 3D438 (Shënime në lidhje me mbledhjen midis Drewienkiewicz-it dhe Ojdaniqit, 15 dhjetor 1998), f. 2. Millorad Obradoviçi, i cili në atë kohë ishte ndihmës-shef i Shtabit të Përgjithshëm në Sektorin për Operacione dhe Personel, dëshmoi se Shainoviçi, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, e informoi se verifikuesit e KVM-së nuk duhej të lejoheshin të inspektonin kazermat. Millorad Obradoviçi, T. 14986–14987 (5 shtator 2007). *Shih gjithashtu* 3D787 (Raport i Grupit të Punës të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, pa datë), para. 2 në të cilin pjesëtarët e Grupit të Punës të UJ-së raportojnë se verifikuesit kishin tentuar të inspektonin pajisjet dhe trupat e UJ-së pa paralajmërim, por këto inspektime ishin refuzuar sepse ishin në kundërshtim me udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm. Sipas Spasoje Smilaniqit, i cili ishte shef i Administratës së Parë në Shtabin e Përgjithshëm në atë kohë, si rezultat i këtyre ankesave, Shainoviçi thirri një mbledhje të jashtëzakonshme me ambasadorët e Evropës Perëndimore të akredituar në Beograd, tema e të cilës ishte sjellja e verifikuesve dhe e UÇK-së. Spasoje Smilaniq, T. 15740 (17 shtator 2007).

²⁴⁸³ Dushan Llonçar, T. 7601 (30 nëntor 2006). *Shih gjithashtu* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 161.

²⁴⁸⁴ Millorad Obradoviçi, i cili në atë kohë ishte ndihmës-shef i Shtabit të Përgjithshëm në Sektorin për Operacione dhe Personel, dëshmoi se Shainoviçi, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit, e informoi se verifikuesit e KVM-së nuk duhej të lejoheshin të inspektonin kazermat. Millorad Obradoviçi, T. 14986–14987 (5 shtator 2007). *Shih gjithashtu* 3D787 (Raport i Grupit të Punës të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, pa datë), para. 2, në të cilin pjesëtarët e Grupit të Punës të UJ-së raportojnë se verifikuesit kishin tentuar të inspektonin pajisjet dhe trupat e UJ-së pa paralajmërim, por këto inspektime ishin refuzuar sepse ishin në kundërshtim me udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm.

²⁴⁸⁵ Zhivadin Jovanoviçi, T. 14012–14013 (20 gusht 2007). *Shih gjithashtu* P685 (Marrëveshja e KVM-së), Pjesa III, para. 1; 2D11 (Marrëveshja e OSBE-së për Kontrollin Nënrajonal të Armëve në Bosnjë dhe Hercegovinë), neni IV f. 5–6.

²⁴⁸⁶ Zhivadin Jovanoviçi, T. 14014 (20 gusht 2007).

²⁴⁸⁷ Zhivadin Jovanoviçi, T. 14019 (20 gusht 2007).

²⁴⁸⁸ Millorad Obradoviçi, T. 15116–15118 (6 shtator 2007).

²⁴⁸⁹ Millorad Obradoviçi, T. 15032 (5 shtator 2007).

gjithashtu tha se, në pajtim me një urdhër të lëshuar nga Perishiqi më 16 nëntor 1998, nuk lejoheshin inspektimet e kazermave të UJ-së.²⁴⁹⁰ Mirëpo Dhoma vëren se teksti i këtij urdhri nuk ndalonte inspektimin e kazermave të UJ-së, por vetëm kërkonte që inspektimet të refuzoheshin nëse nuk ishte marrë paraprakisht leje. Në kundërshtim me thëniet e Obradoviçit, Ciaglinski dëshmoi se KVM-ja e kishte kuptuar mandatin e saj sipas Marrëveshjes për KVM-në se i mundësonte kryerjen e inspektimeve në tërë territorin e Kosovës, duke përfshirë dhe kazernat. Ciaglinski pranoi se "qeveria" e kishte kundërshtuar kompetencën e KVM-së për të hyrë në kazerna.²⁴⁹¹

955. Drewienkiewicz-i dëshmoi se më 9 dhjetor 1998 kishte në plan të bënte inspektimin e parë të "Kazermës së Brigadës së Prishtinës," por nuk e lejua të hynte.²⁴⁹² Atë natë u mbajt një mbledhje në ndërtesën e shtabit të KVM-së në Prishtinë, në të cilën morën pjesë Walker-i, Drewienkiewicz-i, Shainoviçi, Llonçari, Ojdaniçi, dhe Pavkoviçi. Shainoviçi kishte ardhur në Prishtinë posaçërisht për këtë mbledhje. Shainoviçi së pari u ankua se KVM-ja po përkrahte UÇK-në dhe se bashkësia ndërkombëtare po e ndihmonte UÇK-në me mjete financiare. Më tej ai refuzoi të gjitha kërkesat e KVM-së, konkretisht refuzoi hyrjen e helikopterit të KVM-së për evakuime mjekësore në Kosovë, dhe tha se nuk do të kishte inspektime të paparalajmëruara, se prania e policisë në Malishevë nuk do të zvogëlohej,²⁴⁹³ dhe se nuk do të hapej zyrë në Prishtinë për të shpejtuar lëshimin e vizave.²⁴⁹⁴ Ai i kërkoi KVM-në të ndërpriste mbështetjen e UÇK-në dhe shprehu nevojën që bashkësia ndërkombëtare të ndalte mbështetjen financiare për UÇK-në nëpërmjet bankave perëndimore. Drewienkiewicz-i vërejti se Llonçari dukej i befusuar me refuzimin e inspektimeve nga Shainoviçi.²⁴⁹⁵ Sipas Drewienkiewicz-it, këto inspektime ishin të rëndësishme për misionin meqë qëllimi ishte që të përcaktohej numri bazë i forcave dhe pajisjeve të UJ-së në Kosovë.²⁴⁹⁶ Më 11 dhjetor, Drewienkiewicz-i shkoi në Prizren për të inspektuar kazernën,

²⁴⁹⁰ Millorad Obradoviç, T. 14982 (5 shtator 2007); 3D458 (Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së, 16 nëntor 1998).

²⁴⁹¹ Richard Ciaglinski, T. 6922–6923 (20 nëntor 2006).

²⁴⁹² Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 80.

²⁴⁹³ Sipas Drewienkiewicz-it, në këtë qytet të pjesës perëndimore të Kosovës po zhvilloheshin luftime të ashpra në atë kohë. I gjithë qyteti ishte shqiptar dhe UÇK-ja ishte aktive në rajon. Kishte probleme veçanërisht me policinë që frikësonte dhe keqtrajtonte popullatën. Dëshmitari tentoi që t'i zbuste tensionet në atë zonë duke ofruar ardhjen e një ekipi ndërkombëtar për kryerjen e detyrave policore në zonë nëse policia serbe në rajon do të reduktohej. Karol John Drewienkiewicz, T. 7779–7781 (4 dhjetor 2006).

²⁴⁹⁴ Karol John Drewienkiewicz, T. 7779–7782 (4 dhjetor 2006); P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 81; P634 (Kronologji e ngjarjeve kryesore në Kosovë nga 15 tetori deri më 18 prill 1999), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 3 (shënimi 39). Një tjetër zyrtar i KVM-së, Richard Ciaglinski, gjithashtu dëshmoi për mbledhjen. Sipas Ciaglinski-t, gjatë mbledhjes, Shainoviçi e akuzoi KVM-në për raportim të padrejtë. Richard Ciaglinski, T. 6829–6830, 6862 (17 nëntor 2006), T. 6890 (20 nëntor 2006); P2488 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 mars 2000), f. 5.

²⁴⁹⁵ Karol John Drewienkiewicz, T. 8008 (6 dhjetor 2006); P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 81.

²⁴⁹⁶ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës qershor 2000), para. 63. Drewienkiewicz-i dëshmoi se i kujtohej që Dushan Llonçari i kishte thënë se refuzimi i inspektimeve kishte ardhur nga Shtabi i Përgjithshëm, por nuk kishte dëshmi të drejtpërdrejta për qëndrimin e Ojdaniçit apo Pavkoviçit në lidhje me inspektimet. Karol John Drewienkiewicz, T. 8008 (6 dhjetor 2006).

por iu refuzua hyrja. Pasi këmbënguli, iu dha "mundësia të inspektojë pozicionet e njërës nga tri kompanitë e UJ-së jashtë kazermës."²⁴⁹⁷

956. Në lidhje me helikopterin, Llonçari dëshmoi se Shainoviqi bëri një propozim alternativ, duke ofruar përdorimin e helikopterëve të UJ-së, të cilët do të ngjyroseshin për t'iu përshtatur nevojave të KVM-së. Walker-i e refuzoi propozimin.²⁴⁹⁸ Këtë e konfirmoi Michael Phillips-i, i cili mendonte se oferta e Shainoviqit ishte e sigurtë.²⁴⁹⁹ Gjithashtu, sipas Llonçarit, nuk kishte nevojë për të kërkuar helikopter sepse qeveria e Serbisë ishte e gatshme t'i jepte KVM-së një helikopter të saj, i cili do të kryente të njëjtat detyra sikurse ai që kërkohet.²⁵⁰⁰ Gjatë rimarrjes në pyetje, Llonçari përsëriti se vendimi për helikopterin kishte ardhur nga nivelet më të larta dhe kur u pyet se cila ishte instanca kompetente që duhej të merrte vendim për atë çështje, ai u përgjigj se ishte qeveria e RFJ-së, e cila udhëhiqej nga Kryeministri Bullatoviç.²⁵⁰¹ Millorad Obradoviç dëshmoi se UJ-ja nuk kishte helikopterë të mjaftueshëm në dispozicion dhe ishte kundër dhënies së njërit prej tyre KVM-së.²⁵⁰² Dhoma nuk e konsideron vendimin në lidhje me helikopterin shkelje të detyrimit për t'i mundësuar KVM-së liri lëvizjeje anembanë Kosovës.

957. Dhoma dëgjoi se në qarqet e UJ-së kishte pakënaqësi në lidhje me veprimtarinë e KVM-së. Për shembull, Obradoviç dëshmoi se që më 30 tetor 1998, Perishiqi shprehu shqetësim për orvatjet e inspektimit të kazermave prej KVM-së dhe i kundërshtoi këto veprime, duke insistuar se Marrëveshja nuk e autorizonte KVM-në për një gjë të tillë.²⁵⁰³ Rrjedhimisht, ai i urdhëroi njësitë e UJ-së që "kontaktet me KVM-në të mbahen nëpërmjet organeve shtetërore përkatëse vetëm me 'njoftim paraprak.'"²⁵⁰⁴ Gjithashtu, në mbledhjen e Kolegjiut të shefit të Shtabit të UJ-së, që u mbajt më 25 shkurt 1999, Aleksandar Dimitrijeviç u ankua për orvatjet e vazhdueshme të KVM-së në marrjen e të dhënave në lidhje me UJ-në që ishin jashtë mandatit të vet. Ai më tej kërkoi që

²⁴⁹⁷ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës 23 qershor 2000), para. 84.

²⁴⁹⁸ Dushan Llonçar, P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 25.

²⁴⁹⁹ Michael Phillips, i cili punonte drejtpërdrejtë për Walker-in, gjithashtu dëshmoi se më 9 dhjetor 1998 pati një takim me Shainoviçin ku kishin diskutuar çështjen e helikopterit të ndihmës mjekësore për t'u përdorur nga OSBE-ja në Kosovë. Sidoqoftë, Phillips-i konfirmoi se Shainoviç i kishte ofruar përdorimin e helikopterëve serbë për ndihmë mjekësore për anëtarët e OSBE-së dhe gjithashtu u kishte ofruar përcjellje të MPB-së serbe. Phillips-i gjithashtu u pajtua me Mbrojtjen se oferta e Shainoviqit në lidhje me përkujdesjen mjekësore dhe sigurinë kishte qenë e sigurtë dhe e njëmendtë. Michael Phillips, T. 11868–11872, 11879–11880 (19 mars 2007); 2D18 (Pjesë nga fletoret e Michael Phillips-it).

²⁵⁰⁰ Dushan Llonçar, T. 7597–7598, 7600 (30 nëntor 2006); P2521 (deklarata e dëshmitarit e datës 3 mars 2004), para. 25.

²⁵⁰¹ Dushan Llonçar, T. 7692, 7693 (1 dhjetor 2006).

²⁵⁰² Millorad Obradoviç, T. 15036–15038 (5 shtator 2007).

²⁵⁰³ Millorad Obradoviç, T. 15033–15034 (5 shtator 2007). *Shih gjithashtu* 2D389 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 30 tetor 1998), f. 2.

²⁵⁰⁴ 3D458 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm, 16 nëntor 1998).

Komisioni t'i përcillte KVM-së mesazhin se UJ-ja nuk do ta toleronte këtë sjellje dhe t'i tërhiqte vërejtjen që t'i përmbahej rreptësisht mandatit të vet.²⁵⁰⁵

958. Sidoqoftë, verifikuesit këmbëngulën në orvatjet që të hynin në kazerma për të numëruar trupat dhe armët e UJ-së.²⁵⁰⁶ Mirëpo, kazerma e Prishtinës nuk u inspektua asnjëherë.²⁵⁰⁷ Ciaglinski dha dëshmi në mbështetje të këtij rrëfimi, duke thënë në lidhje me inspektimin e kazermave:

Ne provuam të bënim inspektime të paparalajmëruara të atypëratyshme, por mundësia ishte zero. Nuk na u lejua që të kryenim inspektime. Na mbajtën jashtë kazermave dhe nuk na lanë të hynim: në fakt, na kërcënuan -- na thanë se nëse nuk i largonim makinat tona dhe nuk largoheshim vetë, kjo do të shkaktonte incident mjaft serioz.²⁵⁰⁸

959. Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se, pavarësisht se a ishte apo nuk ishte i saktë interpretimi që RFJ-ja u kishte bërë marrëveshjeve, Ojdaniqi ishte i detyruar që ta pranonte këtë interpretim dhe ta zbatonte.²⁵⁰⁹ Në mbledhjen e Kolegjiumit më 10 dhjetor 1998, Ojdaniqi bëri një deklaratë me përmbajtje të ngjashme, duke e informuar Shtabin e Përgjithshëm se puna e tyre ishte të zbatonin interpretimin e marrëveshjeve sipas Komisionit Federal për Bashkëpunim.²⁵¹⁰ Për të demonstruar përpjekjet e Ojdaniqit për bashkëpunim me KVM-në, Obradoviqi dëshmoi se KVM-ja u informua për ndërrimin e ushtarëve që shkonin në Kosovë në dhjetor 1998, kur ishin rekrutuar ushtarët e rinj kurse të tjerë u larguan nga ushtria, duke përfshirë dhe Korpusin e Prishtinës.²⁵¹¹ Për më tepër, ai dëshmoi se Ojdaniqi dërgoi një grup pune nga Shtabi i Përgjithshëm për të vizituar Armatën e 3-të dhe Korpusin e Prishtinës nga 13 deri më 16 dhjetor 1998 për të analizuar gjendjen e përgjithshme në lidhje me bashkëpunimin me KVM-në dhe për t'u dhënë ndihmë komandave vartëse në kontakte me KVM-në.²⁵¹² Grupi i punës i paraqiti Obradoviqit një raport, në të cilën thuhej se kishte mbikëqyrur kontaktet midis oficerëve kontaktues të UJ-së dhe verifikuesve të KVM-së.²⁵¹³ Mirëpo UJ-ja vazhdoi të ndalonte hyrjen e KVM-së në kazerma.²⁵¹⁴

²⁵⁰⁵ P941 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 25 shkurt 1999), f. 9; *shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 331–343 (duke e ngatërruar Marrëveshjen Perishiq-Clark me Marrëveshjen Clark-Naumann); 6D1669 (Raport i ambasadës së SHBA-së në Beograd në lidhje me respektimin e Marrëveshjeve të tetorit nga ana e RFJ/Serbisë, 1 nëntor 1998), f. 2.

²⁵⁰⁶ Millorad Obradoviq, T. 14982 (5 shtator 2007).

²⁵⁰⁷ Karol John Drewienkiewicz, T. 7948 (6 dhjetor 2006). Drewienkiewicz-i mundi ta vizitonte kazermën në mes të marsit 1999, por jo me verifikues.

²⁵⁰⁸ Richard Ciaglinski, T. 6819 (17 nëntor 2006).

²⁵⁰⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 30 korrik 2008 (versioni publik), para. 183.

²⁵¹⁰ 3D484 (Mbledhja e Kolegjiumit të UJ-së, 10 dhjetor 1998), f. 16.

²⁵¹¹ Millorad Obradoviq, T. 14973 (5 shtator 2007).

²⁵¹² Millorad Obradoviq, T. 14979 (5 shtator 2007).

²⁵¹³ Millorad Obradoviq, T. 14979 (5 shtator 2007); 3D787 (Raport i kolonel Kosta Novakoviqit, Grupi Punues i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 11 dhjetor 1998).

²⁵¹⁴ 3D787 (Raport i kolonel Kosta Novakoviqit, Grupi i Punës i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 11 dhjetor 1998), f. 2.

960. Mbrojtja e Ojdaniqit gjithashtu argumenton se procesverbali i mbledhjes së Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së mbështet pretendimin se Ojdaniqi mori masa për të mundësuar bashkëpunimin e Shtabit të Përgjithshëm me KVM-në. Për shembull, në mbledhjen e kolegjiut të datës 27 nëntor 1998, pas marrjes së postit të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, Ojdaniqi deklaroi:

Personalisht mendoj se ne mund dhe duhet t'u raportojmë verifikuesve çdo ndërrim të njërive, të trupave dhe kjo nuk duhet të shkaktojë asnjë problem. Kaq del, kaq hyn, e jo t'u japim shkas të na akuzojnë se po sjellim përforsime, duke marrë parasysh gjendjen në të cilën jemi vënë.²⁵¹⁵

Ojdaniqi gjithashtu i inkurajoi kolegët e tij të studionin Marrëveshjen Clark-Naumann dhe t'i përmbaheshin asaj. Në mbledhjen e kolegjiut të datës 17 dhjetor 1998, Ojdaniqi tha se të gjithë pjesëtarët e KVM-së kishin status diplomatik dhe se duhej edhe të trajtoheshin si të tillë; se nuk duhej të kishte "sjellje vulgare;" se duhej të gjendej forma "më pak e dhimbshme" e ndërhyrjes; dhe "ne" nuk duhet t'u japim shkas të tërhiqen.²⁵¹⁶ Në mbledhjen e kolegjiut, më 24 dhjetor 1998, Ojdaniqi iu ritheksoi kolegëve të tij që t'u përmbaheshin rreptësisht detyrimeve të tyre sipas marrëveshjeve ndërkombëtare.²⁵¹⁷

961. Gjithashtu, më 23 dhjetor 1998, Ojdaniqi nënshkroi një urdhër për zbatimin e detyrimeve sipas Marrëveshjes Clark-Naumann, ku shkruhej se, për shtimin e bashkëpunimit të UJ-së me KVM-në, oficerët ndërlidhës të UJ-së duhet të shkëmbejnë çdo ditë raporte me verifikuesit në lidhje me aktivitetet e UJ-së në Kosovë. Sipas urdhrit, inspektimi i trupave dhe aktiviteteve të UJ-së nga verifikuesit lejohej vetëm jashtë kazermave, brenda kufizimeve të vendosura nga Perishiçi.²⁵¹⁸ Ky urdhër ishte në vijim të urdhrave dhe rregulloreve për bashkëpunim me KVM-në që kishin ekzistuar para emërimit të Ojdaniqit në Shtabin e Përgjithshëm.²⁵¹⁹ Sipas këtij urdhri, oficerët ndërlidhës të UJ-së duhej t'i raportonin "Ekipit për Bashkëpunim me Misionet e OSBE-së dhe

²⁵¹⁵ P925 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 27 nëntor 1998), f. 8–9, 16.

²⁵¹⁶ 3D494 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 17 dhjetor 1998), f. 21.

²⁵¹⁷ P924 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 24 dhjetor 1998), f. 27. *Shih gjithashtu*, P936 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 14 janar 1999), f. 6–9; P934 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 14 janar 1999), f. 24–25.

²⁵¹⁸ 3D408 (Urdhër Plotësues i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për Zbatimin e Detyrimeve të UJ-së, 23 dhjetor 1998); Dushan Llonçar, T. 7676–7677 (1 dhjetor 2006).

²⁵¹⁹ 3D409 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për Kontaktet me Misionet e OSBE-së dhe NATO-s, 22 tetor 1998); 3D405 (Përmbledhje e Detyrimeve, Detyrave, Zbatimit, dhe Metodologjisë së Punës me OSBE-në, 16 tetor 1998); 3D411 (Udhëzime mbi Marrëdhëniet e UJ-së me OSBE-në, tetor 1998). Prova materiale është një përshkrim i procedurave për marrëdhënie me misionet. Dokumenti përcakton organet ndërlidhëse në nivele të ndryshme të UJ-së, mënyrën e ndërlidhjes, përgjegjësitë e pjesëtarëve të UJ-së ndaj pjesëtarëve të misionit në terren, dhe bashkëpunimin e UJ-së me organet shtetërore me qëllim përmbushjen e detyrimeve të misionit.

NATO-s" të Shtabit të Përgjithshëm për aktivitetet dhe komunikimet që kishin lidhje me verifikuesit.²⁵²⁰

d. Shtimi i pranisë së UJ-së në Kosovë

962. Prokuroria pretendon se nga nëntori 1998 deri në mars 1999, niveli i trupave dhe pajisjeve të UJ-së në Kosovë u rrit duke e shkelur Marrëveshjen Clark-Naumann.²⁵²¹ Mbrojtja e Ojdaniqit e mohon se Marrëveshja u shkel në këtë mënyrë dhe e fton Dhomës Gjyqësore që të marrë parasysh kërcënimin me të cilin ballafaqohej Ojdaniqi në formën e një "kryengritjeje të brendshme të përmasave të mëdha" dhe fushatës intensive të bombardimeve të NATO-s.²⁵²² Mbrojtja e Shainoviqit vë në dukje se kushtet e Marrëveshjeve të Tetorit fillimisht u respektuan,²⁵²³ duke cituar dëshminë e John Crosland-it ku ai i raportoi Ministrisë së Mbrojtjes dhe Kryekomandantit të Aleancës në Evropë se "tri grupet e luftimit në fjalë u kthyen në kazermë."²⁵²⁴

963. Siç është diskutuar më lart, sipas Naumann-it, RFJ-ja iu përmbajt Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq deri në mes të nëntorit 1998. Sidoqoftë, në gjysmën e dytë të nëntorit dhe dhjetor 1998, NATO-ja vuri re rritje të numrit të incidenteve në Kosovë, shumica prej tyre të shkaktuara nga UÇK-ja. Në fakt, Naumann-i pranoi se mungesa e një marrëveshjeje me UÇK-në ishte gabimi më i madh i NATO-s. Shumë shpejt, NATO-ja filloi të merrte raporte për përkeqësimin e gjendjes në Kosovë, ndër të tjera ridislokimi i trupave të RFJ-së, postbllloqet shtesë, dhe përdorimi i forcës së tepruar.²⁵²⁵ Ngjarjet në Podujevë të treguara më lart janë shembull i qartë.

964. Drewienkiewicz-i dëshmoi se, me sa kishte kuptuar njësitë e UJ-së nga jashtë Kosovës ishin tërhequr, se njësitë brenda Kosovës ishin në kazerma, dhe se policët shtesë ishin tërhequr, por pa shifrat fillestare dhe informatat e kërkuara, ishte e pamundshme të verifikohet se a ishte me të vërtetë ashtu.²⁵²⁶ Në janar dhe shkurt 1999, UJ-ja zbatoi një politikë në Kosovë të lënies së një grupi ushtarësh në madhësinë e një toge, ose "një këmbë në terren," pas çdo operacioni ushtarak.²⁵²⁷ KVM-ja konstatoi 1.500 – 2.000 ushtarë të UJ-së jashtë kazermave, edhe pse duhej të

²⁵²⁰ 3D408 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për Zbatimin e Detyrimeve të UJ-së, 23 dhjetor 1998). Një raport i tillë i paraqitur si provë, 1 janar 1999, nga ekipi ndërlidhës i komandës së Armatës së 3-të, dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së përshkruan aktivitetet e PrK-së, aktivitetet e verifikuesve, dhe përshkruante mbledhjen me Richard Ciaglinski-n; 3D459 (Raport Ditor i Komandës së Armatës së 3-të, 1 janar 1999).

²⁵²¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008, para. 776.

²⁵²² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 30 korrik 2008 (versioni publik), para. 7, 85.

²⁵²³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008, para. 313.

²⁵²⁴ John Crosland, T. 9868 (8 shkurt 2007). Crosland-i nuk mbante mend datën e saktë.

²⁵²⁵ Klaus Naumann, T. 8263–8266, 8277–8280 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Prokurorisë), para. 28.

²⁵²⁶ Karol John Drewienkiewicz, T. 7885 (5 dhjetor 2006).

²⁵²⁷ Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës qershor 2000), para. 187.

ishin vetëm tri kompani,²⁵²⁸ ose rreth 400 veta gjithsej të dislokuar jashtë kazermave në Kosovë. Drewienkiewicz-i tha se, deri më 3 mars 1999, kjo rezultoi në rritjen e pranisë së UJ-së në Kosovë afërsisht deri në 15 kompani me ushtarë, shumë më tepër se sa lejohej në Marrëveshjen Clark-Naumann.²⁵²⁹ Në një raport të shkruar në mars 1999, një oficer i zbulimit britanik që punonte me KVM-në raportoi se 15 kompani të UJ-së ishin jashtë kazermave në Kosovë.²⁵³⁰

965. Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se Drewienkiewicz-i nuk mori parasysh njësitë e UJ-së që u lejuan të qëndronin në kufi dhe në zonat e stërvitjes. Ajo gjithashtu argumenton se njësitë e UJ-së, veç tri kompanive të dislokuara dhe njësite kufitare, u lejuan të qëndronin në vendet e stërvitjes në Kosovë, jashtë kazermave,²⁵³¹ duke u mbështetur në një letër që William Walker-i i kishte dërguar Millosheviqit, në të cilën përmenden informatat e dhëna për zonat e stërvitjes në të cilat nuk kishte njësi të UJ-së.²⁵³² Mirëpo Dhoma vëren se fjalja e cituar e Walker-it në fakt vë në dukje të kundërtën: se nuk duhej të kishte njësi në këto vende dhe se duhej të jepeshin informata për të konfirmuar këtë fakt. Për më tepër, kushtet e marrëveshjes përmendin shprehimisht tri kompani dhe njësitë kufitare, pa lënë asnjë mundësi të hapur për trupa shtesë të dislokuara në Kosovë.²⁵³³

966. Dëshmitarë të tjerë dëshmuar se UJ-ja nuk i shkeli Marrëveshjet e Tetorit duke mbajtur më shumë ushtarë në Kosovë se numri i lejuar i kompanive. Millan Koturi fillimisht dëshmoi se UJ-ja asnjëherë nuk dislokoj kurrë më shumë kompani në Kosovë se sa lejoheshin në Marrëveshje.²⁵³⁴ Mirëpo më vonë ai tha se në Kosovë ishin dislokuar më shumë njësi se sa lejoheshin shprehimisht në Marrëveshjen Clark-Naumann, por këmbënguli se njësitë shtesë ishin angazhuar në operacione mbrojtëse dhe si pasojë nuk e shkelnin marrëveshjen.²⁵³⁵ Dushan Llonçari shpjegoi se Marrëveshja Clark-Naumann lejonte dislokimin e katër grupeve luftarake dhe se asnjëherë nuk duhej të kishte më shumë se këto katër grupe luftarake (katër kompani të përforcuara) jashtë ambienteve të kazermave.²⁵³⁶ Në mbledhjen e Kolegjiumit të UJ-së më 2 shkurt 1999, Ojdaniqi theksoi se "një

²⁵²⁸ Termat "kompani", "grup luftarak", edhe "ekipe luftarake" janë përdorur me të njëjtin kuptim nga dëshmitarët që kanë folur për këtë çështje: P680 (Dokumentet Operative të Bashkimit OSBE/MVK); Dushan Llonçari, T. 7686–7687 (1 dhjetor 2006); Karol John Drewienkiewicz P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës qershor 2000), para. 187. Shaun Byrnes dëshmoi se në Kosovë u përdorën grupet luftarake, e jo kompanitë e formuara paraprakisht, të cilat ishin të gjitha të një madhësie. Shaun Byrnes T. 12163, 12168 (16 prill 2007).

²⁵²⁹ Karol John Drewienkiewicz, T. 7944 (6 dhjetor 2006); P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës qershor 2000), para. 187.

²⁵³⁰ P641 (Vlerësim i Qëndrimeve të UÇK, 15 mars 1999), f. 3.

²⁵³¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 72, 94.

²⁵³² P396 (Letra e William Walker-it dërguar Slllobodan Millosheviqit, 23 tetor 1998), f. 1.

²⁵³³ P395 (Marrëveshja Clark-Naumann, 25 tetor 1998), f. 3.

²⁵³⁴ Millan Kotur, T. 20635 (18 janar 2008). Ai përdori termin "ekipe" në vend të grupeve luftarake.

²⁵³⁵ Millan Kotur, T. 20636 (18 janar 2008).

²⁵³⁶ Kur Mbrojtja e Llazareviqit e ballafaqoi me pretendimin se në Duhël, Llapushnik, dhe Volljakë kishin qenë të dislokuara vetëm tri kompani, Llonçari pranoi se nuk e mbante mend numrin e saktë dhe pranoi se, përveç këtyre tri ose katër kompanive, ishin edhe nëntë kompani të tjera në vende të caktuara, të cilat do të angazhoheshin vetëm nëse do të ishte e domosdoshme, siç ishte vendosur nga komandanti i PrK-së. Dushan Llonçari, T. 7684–7687 (1 dhjetor

grup" i forcave të UJ-së në Kosovë kishte shkelur Marrëveshjen Clark-Naumann, edhe pse nuk saktësohej se në çfarë mënyre.²⁵³⁷

967. Drewienkiewicz-i dëshmoi se, më 16 mars 1999, në Kosovë erdhi një njësi e re e UJ-së e shoqëruar nga tanket T-72, por ai nuk saktësoi cila njësi ishte. Të gjitha njësitë në Kosovë deri në atë moment kishin pasur tanke T-55, të cilat kishin ekuipazh dhe stërvitje tjetër.²⁵³⁸ Sipas tij, në Marrëveshjen Clark-Naumann, trupat dhe pajisjet e UJ-së duhej të pakësoheshin në nivelet e pranverës së vitit 1998; dhe, meqenëse tanket T-72 nuk ishin deklaruar në dokumentet e mëhershme të kontrollit të armëve, kjo përbënte shkelje të këtij kushti.²⁵³⁹

968. Branko Kërگا dëshmoi se NATO-ja e kishte rritur numrin e forcave të saj tokësore në Maqedoni nga 1.850 në fillim të vitit 1999, në 12.500 në mars të vitit 1999.²⁵⁴⁰ Me intensifikimin e kërcënimeve dhe përgatitjeve të NATO-s gjatë shkurtit dhe marsit 1999, Ojdaniqi dhe Shtabi i Përgjithshëm ishin gjithnjë e më shumë të shqetësuar nga një sulm i mundshëm tokësor.²⁵⁴¹ Më 18 shkurt 1998, kolonel Antiqi nga Administrata e Zbulimit raportoi se numri i forcave të NATO-s pritej të rritej në 8.000 në fund të muajit. Ojdaniqi tha se trupat duhej të dislokoheshin në zonat afër kufirit me Kosovën, në mënyrë që të mund të vepronin shpejt në atë zonë.²⁵⁴² Duke e justifikuar vendimin për të dërguar më shumë trupa në Kosovë, Ojdaniqi bëri të ditur se kjo ishte bërë në kundërpërgjigje ndaj sulmit të pritshëm të NATO-s, duke thënë se "ne duhet të mbrojmë vendin nëse sulmohemi. Politika dhe diplomacia do të bëjnë çdo gjë që t'a zgjidhin me mjete paqësore nëse është e mundshme."²⁵⁴³

969. Rritja e numrit të njësive të UJ-së të destinuara për Korpusin e Prishtinës u raportuan nga Gjorgje Qurçin, i cili ishte shëf i Administratës së Parë në Sektorin për Çështje Operative dhe të Personelit, në mbledhjet e Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së më 25 shkurt 1999 dhe 11 mars 1999.²⁵⁴⁴ Këto ridislokime Branko Kërگا, shëf i Administratës së Zbulimit, i shpjegoi si

2006). Millan Koturi konfirmoi se këto ishin vendet ku njësitë e UJ-së ishin lejuar të mbeteshin sipas Marrëveshjes Clark-Naumann. Millan Kotur, T. 20636 (18 janar 2008).

²⁵³⁷ P931 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 2 shkurt 1999), f. 20–21.

²⁵³⁸ Karol John Drewienkiewicz, T. 7809–7812 (4 dhjetor 2006), P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës qershor 2000), para. 188.

²⁵³⁹ Karol John Drewienkiewicz, T. 7809–7812 (4 dhjetor 2006), P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës qershor 2000), para. 188.

²⁵⁴⁰ Branko Kërگا, T. 16921 (4 tetor 1999).

²⁵⁴¹ P932 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 4 shkurt 1999), f. 10–11.

²⁵⁴² P937 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 18 shkurt 1999), f. 4, 16.

²⁵⁴³ P937 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 18 shkurt 1999), f. 18; P938 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 18 mars 1999), f. 7.

²⁵⁴⁴ Përforcimet për Korpusin e Prishtinës që u përmendën në këtë mbledhje përfshinin Brigadën e 2-të Speciale dhe një batalion antiterrorist të Batalionit të Policisë Ushtarake dërguar në Batalion e 52-të të Policisë Ushtarake të PrK-së, dhe një grup nga Batalioni i Policisë Ushtarake për në Brigadën e 243-të të Mekanizuar të PrK-së. P941 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 25 shkurt 1999), f. 12; P935 (Procesverbali i

kundërpërgjigje ndaj provokimeve të UÇK-së,²⁵⁴⁵ duke lënë të kuptohej se shtimi ishte veprim legjitim bazuar në rastin e vetëmbrojtjes përfshirë në dispozitën e fundit të Marrëveshjes Clark-Naumann. Mirëpo, në mbledhjen e 11 marsit 1999, Ojdaniqi bëri të ditur se sjellja e trupave të reja përbënte shkelje të Marrëveshjes, duke thënë se të pranishmit në mbledhje e dinin "mirë se pse duhej ta shkelnim."²⁵⁴⁶ Ai tregoi bisedën e tij me gjeneralin Clark, gjatë së cilës ai kishte pranuar se përforcimet përbënin shkelje të marrëveshjes; kur Clark-u e kishte pyetur se pse ishin 25.000 trupa në kufi, ai nuk e kishte kundërshtuar numrin, por kishte thënë se ishte kundërmasë e nevojshme ndaj grumbullimit të forcave të NATO-s.²⁵⁴⁷

970. Në mbledhjen e kolegjiut më 25 shkurt 1999, Dimitrijeviqi shprehu mospajtim me dërgimin në Kosovë të një njësie të policisë ushtarake nga Brigada e 72-të Speciale.²⁵⁴⁸ Ai e kundërshtoi dërgimin e njësisë atje, sepse Brigada e 72-të Speciale ishte njësi e fuqishme e policisë ushtarake dhe ai kishte frikë se nuk do të përdorej si duhej dhe se do të ndahej në njësi më të vogla.²⁵⁴⁹ Komentet e Ojdaniqit në kolegjiut tregojnë se ai nuk kishte dijeni për dërgimin e njësisë në Kosovë, duke qenë se ai kishte urdhëruar vetëm dërgimin e saj në kufi me Kosovën.²⁵⁵⁰

971. Në të njëjtën mbledhje, u diskutua edhe propozimi për zgjatjen e shërbimit për rekrutët e UJ-së në Kosovë të cilët kishin filluar shërbimin në mars 1998, më gjatë se 12 muajt e rregullt. Samarxhiqi, i cili në atë kohë ishte në Inspektoratin e UJ-së, propozoi që, duke marrë parasysh mundësinë e sulmit të NATO-s, forcat e UJ-së në Kosovë nuk duhej të lejoheshin të shkonin me pushim dhe duhej t'i kërkohej Kryekomandantit dhe Kuvendit të RFJ-së, që rekrutëve që ishin në Kosovë, t'u zgjatej shërbimi me 40 ditë. Shefi i Seksionit për Çështje të Mobilizimit, Rekrutimit, dhe Personelit, Risto Matoviq, nuk gjeti bazë ligjore për këtë hap.²⁵⁵¹ Shefi i Seksionit për Çështje Operative dhe të Personelit, Millorad Obradoviqi, shprehu shqetësimin se dërgimi i ushtarëve

Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 11 mars 1999), f. 11. Këto përfshinin 637 trupa të reja në njësitë në Kosovë, kalimin e varësisë së Brigadës së 37-të të Motorizuar të PrK-ja; dhe kalimin e varësisë së Korpusit të 21-të të Nishit të PrK-ja; këto veprime u kryen në pajtim me 3D680 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm për ndërrimin e varësisë së Brigadës së 37-të të Motorizuar të Armatës së 2-të, 6 mars 1999) edhe P1473 (Kalimi i varësisë së Brigadës së 37-të të Motorizuar të PrK-ja e datës 1 prill 1999); Lubisha Dikoviq, T. 19873 (10 dhjetor 2007); Lubisha Stojimirovqi, T. 17702 (26 tetor 2007). Kjo gjithashtu përfshinte edhe kalimin e varësisë së Brigadës së 252-të të Blinduar të Armata e 3-të, dhe shtimin e Brigadës së 211-të të Blinduar. 5D261 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm i UJ-së, 13 mars 1999).

²⁵⁴⁵ Branko Kërqa, T. 16852 (4 tetor 1999).

²⁵⁴⁶ P935 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së UJ për 11 mars 1999), f. 21.

²⁵⁴⁷ P935 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 11 mars 1999), f. 21. Qurçini dëshmoi se Ojdaniqi nuk e pranonte shkeljen, sepse përforcimi i UJ-së ishte veprim paraprak vetëmbrojtjes për shkak të grumbullimit të forcave të NATO-s në kufi. Qurçini gjithashtu dëshmoi se Ojdaniqi nuk pranonte se ishin 25.000 trupa të UJ-së në kufi; sipas Qurçinit, 25.000 trupa nuk ishin në tërë Kosovën. Gjorgje Qurçin, T. 17009–17012 (5 tetor 2007).

²⁵⁴⁸ P941 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 25 shkurt 1999), f. 24.

²⁵⁴⁹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26648–26649 (8 korrik 2008).

²⁵⁵⁰ P941 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 25 shkurt 1999), f. 16–17.

²⁵⁵¹ P941 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 25 shkurt 1999), f. 17–19.

shtesë në Kosovë mund të merrej si shkelje e Marrëveshjes. Ojdaniqi preferonte opsionin e mobilizimit të rekrutëve që ishin liruar nga ushtria mbasi e kishin mbaruar shërbimin dhe ishin bërë rezervistë, sepse pranoi se nuk kishte bazë ligjore për zgjatjen e shërbimit ushtarak të rekrutëve.²⁵⁵² Sidoqoftë, ai kërkoi që zgjatja e shërbimit të rekrutëve të mbetet si opsion dhe theksoi se ishte përgatitur një dokument për këtë çështje. Ai theksoi se, në atë rast, Presidenti do të urdhëronte që ushtarët të mbaheshin si rekrutë në njësitë e tyre fillestare.²⁵⁵³

972. Ky opsion alternativ për zgjatjen e periudhës së shërbimit u zbatua më 15 mars 1999 me vendimin e Presidentit të RFJ-së, dhe rezultoi në mbajtjen e 2.500 – 2.800 ushtarëve në radhët e Korpusit të Prishtinës.²⁵⁵⁴ Ojdaniqi urdhëroi zbatimin e kësaj mase, duke thënë se ishte e nevojshme si masë mbrojtëse për shkak të "rritjes së presionit të jashtëm mbi vendin tonë dhe grumbullimit të trupave të huaja në kufijtë tanë."²⁵⁵⁵

973. Në mbështetje të pretendimit se prania dhe aktiviteti i UÇK-së në Kosovë u përshkallëzuan në muajt pas nënshkrimit të Marrëveshjes Clark-Naumann, Mbrojtja e Ojdaniqit vuri në dukje disa prova, ndër të tjera deklaratën e shefit të Shtabit të UÇK-së Bislim Zyrapit se "pas ofensivës së armikut, në të gjitha zonat operative u bë rivendosja e trupave dhe mund të themi lirisht se territori i kontrolluar nga ne është në përqindje më i madh se para ofensivës së armikut,"²⁵⁵⁶ dhe dëshminë e Klaus Naumann-it, se UÇK-ja e përshkallëzoi aktivitetin pas Marrëveshjeve të Tetorit dhe se në fund të vitit 1998, as NATO-ja, as OSBE-ja nuk ishin në gjendje të kontrollonin UÇK-në.²⁵⁵⁷ Mbrojtja e Ojdaniqit gjithashtu u referohet raporteve të KVM-së për aktivitet të shtuar të UÇK-së në atë kohë.²⁵⁵⁸ Michael Phillips-i dëshmoi se sulmet e UÇK-së rrezikonin jetën e qytetarëve serbë

²⁵⁵² P984 (Ligji i RFJ-së për UJ-në), Neni 315.

²⁵⁵³ P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 25 shkurt 1999), f. 24.

²⁵⁵⁴ Vladimir Llazareviq, T. 17877–17880 (7 nëntor 2007); 3D750 (Urdhër i shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Armatës Ojdaniq - Mbajtja e Pjesëtarëve të UJ-së Pas Mbarimit të Afatit të Rregullt të Shërbimit Ushtarak, 15 mars 1999). Vendimi i Presidentit në të cilin ishte bazuar ky urdhër nuk është provë në këtë rast. Llazareviqi shpjegoi se ky urdhër pasoi vendimin e Presidentit të RFJ-së, i cili ishte i autorizuar me ligj të merrte një vendim të tillë. Vladimir Llazareviq, T. 17878 (7 nëntor 2007). Radinoviqi konfirmoi këtë deklaratë dhe shpjegoi se urdhri ishte dhënë ligjërisht në përputhje me Nenet 316(4) dhe 318(2) të Ligjit për UJ-në. 3D1116 (Aktekspertizë e Radovan Radinoviqit), f. 64; *shih gjithashtu* P984 (Ligji i RFJ për UJ-në), nenet 316(4) dhe 318(3).

²⁵⁵⁵ 3D750 (Urdhër për Mbajtjen e Pjesëtarëve të UJ-së Pas Mbarimit të Afatit të Rregullt të Shërbimit Ushtarak, 15 mars 1999), f. 1.

²⁵⁵⁶ P2460 (Procesverbal i UÇK-së i Mbledhjes së shefit të Shtabit me komandantët e Zonave Operative, 28 dhjetor 1998), f. 3.

²⁵⁵⁷ Klaus Naumann, T. 8277–8284 (13 dhjetor 2006), T. 8383–8384 (14 dhjetor 2006). Mbrojtja gjithashtu thekson burime të tjera në mbështetje të këtij pretendim: 3D564 (Pjesë nga Fletorja e Michael Phillips-it, f. 2932); Karol John Drewienkiewicz, P2508 (deklarata e dëshmitarit e datës qershor 2000), para. 189; 3D573 (Pjesë nga Fletorja e Drewienkiewicz-it), f. 32.

²⁵⁵⁸ *Shih, p.sh.*, 3D179 (Raport i KVMM-së mbi respektimin e marrëveshjes nga palët në Kosovë, 12 mars 1999), gjithashtu e pranuar si P444.

dhe se UÇK-ja kishte baza në zonat e banuara me civilë.²⁵⁵⁹ Në një raport mbi sigurinë dërguar Shtabit të Përgjithshëm nga Korpusi i Prishtinës më 18 nëntor 1998 theksohet se UÇK-ja ishte jashtëzakonisht aktive në komunën e Deçanit, sidomos në fshatin Gllogjan dhe se ata planifikonin një ofensivë të madhe në pranverë të vitit 1999.²⁵⁶⁰

974. Më 9 janar 1999, Shtabi i Përgjithshëm u informua nëpërmjet një raporti nga dega e sigurimit e Korpusit të Prishtinës, se UÇK-ja synonte të ndërmerre një sulm në të gjithë territorin e Kosovës.²⁵⁶¹ Në të njëjtën kohë, shtimi i numrit të efektivit të UÇK-së në Kosovë përmendej mes të tjerash edhe në një raport të 13 janarit 1999 të degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës.²⁵⁶² Gjatë takimit të Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm më 18 shkurt 1999, Dimitrijeviqi raportoi se UÇK-ja vazhdonte shtrirjen në territorin nën kontrollin e saj dhe se planifikonte bllokimin e rrugëve dhe kryerjen e sulmeve në tërë Kosovën.²⁵⁶³ Një raport nga Seksioni për Çështje Operative dhe të Personelit në shkurt 1999, bënte të ditur se UÇK-ja kishte 12.000-15.000 pjesëtarë të armatosur dhe 5.000-6.000 të tjerë të gatshëm në Shqipëri.²⁵⁶⁴ Më vonë, në mars 1999, raportet e tjera nga dega e sigurimit e Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm bënë të ditur se UÇK-ja po rritej numerikisht dhe, në mbledhjen e Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të 18 marsit u raportua se numri i sulmeve të UÇK-së kundër UJ-së ishte rritur dukshëm.²⁵⁶⁵

975. Mbrojtja e Ojdaniqit thekson se, para konfliktit në mars 1999, një oficer britanik i zbulimit ushtarak i dha KVM-së një raport në të cilin theksohej se numri i incidenteve të provokuara nga UÇK-ja gjatë raundit të dytë të bisedimeve në Paris ishte shqetësues. Sipas raportit të tij, këto incidente përfshinin përdorimin e civilëve si mburoja njerëzore, mbajtjen peng të ushtarëve të UJ-së, dhe pritrat kundër automjeteve të UJ-së. Gjithashtu duhet theksuar se incidenti me mburojat njerëzore u raportua si përgjigje ndaj shtimit të veprimtarisë së UJ-së në rajon, se një ushtar i rrëmbyer i UJ-së kishte qenë i dehur kur kishte kaluar në territorin e kontrolluar nga UÇK-ja, se njëra nga dy pritrat ishte raportuar si e para në atë zonë për më shumë se një muaj, dhe se prita tjetër, siç është raportuar, kishte rezultuar në përgjigje "skajshmërisht të fortë" sigurie.²⁵⁶⁶ Në vigjilje të

²⁵⁵⁹ Michael Phillips, T. 12015–12016 (20 mars 2007); John Crosland, T. 9912 (8 shkurt 2007); 3D511 (Shënime të Mbledhjes me Crosland-in, 25 qershor 1998), f. 2.

²⁵⁶⁰ 3D1021 (Raport i Degës së Sigurimit së Komandës së PrK-së, 18 nëntor 1998), f. 1; 3D1037 (Raport i Degës së Sigurimit së Komandës së PrK-së, 28 dhjetor 1998).

²⁵⁶¹ 3D1039 (Raport i Degës së Sigurimit së Komandës së PrK-së, 9 janar 1999), f. 3.

²⁵⁶² 3D1040 (Raport i Degës së Sigurimit së Komandës së PrK-së, 13 janar 1999).

²⁵⁶³ P937 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 18 shkurt 1999), f. 8.

²⁵⁶⁴ 3D685 (Vlerësim i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së i Informatave të Sigurimit dhe Kërcënimeve ndaj Sigurisë së RFJ-së me Shtojca, shkurt 1999), f. 14.

²⁵⁶⁵ 3D1052 (Komanda e Armatës së 3-të, Raport i Degës së Sigurimit, 13 mars 1999), para. 2.2; 3D1053 (Komanda e Armatës së 3-të, Raport i Degës së Sigurimit, 16 mars 1999), para. 2.1; P938 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 18 mars 1999), f. 11.

²⁵⁶⁶ P641 (Vlerësim i Qëndrimeve të UÇK-së, 15 mars 1999), f. 3–4.

fushatës ajrore të NATO-s, raportet e KVM-së theksonin se UÇK-ja kishte zënë një pritë në Prishtinë dhe se sulmet e UÇK-së kishin filluar të përfshinin edhe zonat urbane.²⁵⁶⁷

976. Gjatë javës nga 26 shkurti deri më 4 mars 1999, vëzhguesit e KVM-së në zonën e Kaçanikut raportuan se "autoritetet serbe" kishin kryer stërvitje në vende që mund të ndiznin konflikt, i kishin shtuar patrullat në zonat me ndikim të fortë të UÇK-së, dhe kishin filluar të "impononin autoritetin e tyre ndaj pjesëtarëve të KVM-së." Ata gjithashtu theksonin se dukej se UÇK-ja "kishte kaluar në ofensivë kundër serbëve" me disa prita dhe sulme, konkretisht në zonën e Hanit të Elezit e cila me herët kishte qenë e qetë. Para këtyre luftimeve, prania e UÇK-së atje kishte qenë e kufizuar në një "milici" të vogël dhe pasive, edhe pse përkrahja mund të vinte në çdo moment nga ana tjetër e kufirit në Tetovë. Raporti theksonte se pjesëtarët e UÇK-së e kishin kaluar sërish kufirin dhe ishin bashkuar me milicinë, duke i nxitur vendësit të largoheshin.²⁵⁶⁸ Në mbledhjen e Kolegjiumit të 4 marsit 1999, Dimitrijeviqi ia raportoi këto incidente Shtabit të Përgjithshëm, duke thënë se Armata e 3-të ishte duke e gënjyer Shtabin e Përgjithshëm në lidhje me veprimtarinë e saj në Kosovë dhe se këto ishin veprime të planifikuara e jo reagime mbrojtëse kundër sulmeve.²⁵⁶⁹

977. Mbrojtja e Ojdaniqit pretendon se pikëpamja e Shtabit të Përgjithshëm/Shtabit të Komandës së Lartë ishte se rreziku që vinte nga UÇK-ja dhe ai që vinte nga NATO-ja ishin të ndërthurura. Më 24 dhjetor 1998, Shtabi i Përgjithshëm mori një raport nga Korpusi i Prishtinës, në të cilin shkruhej se UÇK-ja donte të siguronte zona në Kosovë për të mundësuar furnizimin me armë nga NATO-ja.²⁵⁷⁰ Më tej, më 26 janar 1999, dega e sigurimit të Korpusit të Prishtinës i dërgoi një raport Shtabit të Përgjithshëm në të cilin shkruhej se në Maqedoni ishte stacionuar një forcë e NATO-s për ndërhyrje të shpejtë.²⁵⁷¹ Në raporte të tjera thuhej se forcat e NATO-s dhe UÇK-së po luftonin dhe stërviteshin së bashku, megjithëse këto raporte u morën pas fillimit të fushatës së NATO-s dhe si pasojë nuk kanë të bëjnë me periudhën para saj.²⁵⁷²

978. Disa dëshmitarë nga Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së dëshmuar se kishin pritur një sulm të përbashkët të NATO-s/UÇK-së në pranverë të vitit 1999.²⁵⁷³ Dimitrijeviqi dëshmoi se Administrata e Sigurimit të UJ-së kishte të dhëna se në shtabin e NATO-s/OSBE-së në Zvicër ishte marrë një

²⁵⁶⁷ P407 (Libri i Kaltër i OSBE/MVK-së), f. 820.

²⁵⁶⁸ P680 (Dokumentet Operative të Bashkimit të OSBE/MVK-së), f. 1, 5; *shih gjithashtu* Karol John Drewienkiewicz, T. 7932–7933 (5 dhjetor 2006).

²⁵⁶⁹ P933 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 4 mars 1999), f. 9, 15; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26627 (8 korrik 2008), T. 26653–26654 (8 korrik 2008); *shih gjithashtu* P938 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 18 mars 1999), f. 21.

²⁵⁷⁰ 3D1035 (Komanda e PrK-së - Raport i Degës së Sigurimit, 24 dhjetor 1998).

²⁵⁷¹ 3D1044 (Komanda e PrK-së - Raport i Degës së Sigurimit, 26 janar 1999), f. 1.

²⁵⁷² 3D783 (Informatë e Degës së Zbulimit, 29 mars 1999); 3D584 (Raport i shefit të Shtabit të Komandës së Lartë, 31 mars 1999).

²⁵⁷³ Branko Kërگا, T. 16786 (3 tetor 2007); Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26606 (8 korrik 2008).

vendim që të pritej deri në pranverë 1999 për të nxitur kryengritje të përgjithshme në Kosovë. Ai gjithashtu tha se të gjitha shenjat gjatë periudhës në mes të Marrëveshjeve të Tetorit dhe fillimit të fushatës ajrore të NATO-s, duke përfshirë stërvitjen dhe furnizimin e armëve për UÇK-në, e konfirmonin këtë.²⁵⁷⁴ Në mbledhjen e Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm. më 11 mars 1999, Ojdaniqi përsëriti një bisedë që kishte pasur me Clark-un, ku Clark-u kishte thënë se "NATO-ja nuk do ta sulmonte Jugosllavinë," por ai nuk mund të garantonte se UÇK-ja do t'i ndalte "sulmet masive kundër ushtrisë jugosllave, MPB-së, popullatës serbe dhe qytetarëve shqiptarë besnikë."²⁵⁷⁵

e. Rritja e pranisë së MPB-së në Kosovë dhe moskthimi i armëve

979. Siç është diskutuar më lart, pas nënshkrimit të Marrëveshjes Clark-Naumann, MPB-ja ishte e detyruar të ulte numrin e pjesëtarëve në terren në Kosovë. Prokuroria pretendon se MPB-ja e shkeli këtë marrëveshje sepse nuk e pakësoi numrin e efektivit në Kosovë dhe vazhdoi të përdorte armatimin e rëndë.²⁵⁷⁶ Mbrojtja e Llukiqit pretendon se MPB-ja iu përmbajt kushteve të marrëveshjes dhe i pakësoi forcat në Kosovë.²⁵⁷⁷

980. Në mbledhjen e Kolegjiumit të UJ-së më 28 tetor, Perishiqi raportoi se MPB-ja i kishte pakësuar forcat në nivelin e marsit ose fundit të shkurtit 1998, ashtu siç i ishte kërkuar të bënte.²⁵⁷⁸ Miroslav Mijatoviqi dhe Lubinko Cvetiqi thanë se, pas marrëveshjes, MPB-ja e uli numrin e policëve të pranishëm në Kosovë në 10.021.²⁵⁷⁹ Naumann-i e konfirmoi këtë, duke thënë se pas Marrëveshjeve të Tetorit, MPB-ja tërhoqi 5.000-6.000 forca policore.²⁵⁸⁰ Sipas mendimit të tij, Millosheviqi fillimisht e përmbushi zotimin e tij duke tërhequr nga Kosova të gjithë pjesëtarët e MPB-së përveç 10.000 sish.²⁵⁸¹

981. Mirëpo, Naumann-i shtoi se të dhënat nga KVM-ja dhe KDOM-i tregonin se në rajon kishin mbetur rreth 500 policë më shumë se sa duhej të ishin.²⁵⁸² Në nëntor 1998, dolën raporte për përdorim të tepruar të forcës, vendosje të postblloqeve shtesë, dhe ridislokime të reja të policisë.²⁵⁸³ Prej dhjetorit 1998 e deri në janar 1999 ndodhën rreth 10 incidente, të cilat, sipas Naumann-it ishin

²⁵⁷⁴ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26606 (8 korrik 2008).

²⁵⁷⁵ P935 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 11 mars 1999), f. 21.

²⁵⁷⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 15 korrik 2008 (versioni), f. 18, 252.

²⁵⁷⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), f. 16–18.

²⁵⁷⁸ P926 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 28 tetor 1998, f. 12.

²⁵⁷⁹ Miroslav Mijatoviq, T. 22278 (13 shkurt 2008); Lubinko Cvetiq, T. 8198 (8 dhjetor 2006).

²⁵⁸⁰ Klaus Naumann, T. 8263-8264 (13 dhjetor 2006), P2512 (transkript i *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6994, 6969–6970, 7056–7059.

²⁵⁸¹ Klaus Naumann, T. 8277 (13 dhjetor 2006; T. 8376–8378 (14 dhjetor 2006); 3D377 (Artikull i David Morrison-it ku citohet Naumann-i).

²⁵⁸² Klaus Naumann, T. 8380–8382 (14 dhjetor 2006).

²⁵⁸³ Klaus Naumann, T. 8263–8264 (13 dhjetor 2006).

shembuj shkeljesh të hapëta të Marrëveshjeve të Tetorit.²⁵⁸⁴ Naumann-i raportoi se më 19 janar 1999 ai mbajti një mbledhje shtatorëshe me Millosheviqin, Millutinoviqin, Shainoviqin, dhe dy persona të tjerë. Gjatë kësaj mbledhjeje, Naumann-i theksoi se, bazuar në vëzhgimet e KVM-së dhe KDOM-it, asnjë incident nuk ishte shkaktuar nga MPB-ja ose UJ-ja që nga 25 tetori 1998.²⁵⁸⁵ Nga shënimet e marra nga Naumann-i gjatë mbledhjes del se sa i përket numrit të forcave në terren, MPB-ja dhe UJ-ja nuk iu ishin përmbajtur Marrëveshjeve të Tetorit, por ishte shprehur dëshira që të arrihej gradualisht.²⁵⁸⁶ Mirëpo në shënimet nga mbledhja e Komandës së Përbashkët, më 26 tetor 1998, shkruhet se Shainoviqi kishte sugjeruar që numri i policëve serbë në vendbanimet serbe duhej të rritej paralelisht me tërheqjen e policisë dhe se policët duhej të vendoseshin në pika vrojtimi, dhe jo të ruanin rrugët.²⁵⁸⁷

982. Prokuroria gjithashtu argumenton se, duke e armatosur popullatën vendëse joshqiptare dhe sidomos pjesëtarët e RPO-ve, MPB-ja i kishte shmangur kufizimet e imponuara nga marrëveshja. Gjithashtu pretendohet se në këtë mënyrë Llukiqi kishte dashur të mashtronte KVM-në për forcën e vërtetë të policisë.²⁵⁸⁸ Prokuroria e mbështet pretendimin e saj duke iu referuar procesverbalit të mbledhjes së mbajtur në Shtabin e MPB-së më 2 nëntor 1998, në të cilën morën pjesë krerët e SPB-ve të Kosovës dhe komandantët e njësisë të PJP-së. Në këtë mbledhje, e cila u kryesua nga Llukiqi, doli ky konkluzion:

Të kihet kujdes që serbët dhe pjesëtarët e RPO-së të mos i keqpërdorin armët, shkrepin armët në dasma, festa, ose *sllava*, bankete lamtumirëse, e kështu me radhë, të mos i mbajnë apo tregojnë armët në publik në prani të pjesëtarëve të Misionit. Në detyrat e rojës të përdoret vetëm një armë dhe individët të mos lejohen që të sjellin armët të cilat u janë dhënë. Thuajuni të mos tregojnë që serbët janë të armatosur dhe të shpjegojnë këtë, nëse është e nevojshme, duke u arsyetuar se vetëm rojet janë të armatosur.²⁵⁸⁹

983. Në mbledhjen e Kolegjiut të UJ-së të mbajtur më 3 dhjetor 1998, gjenerali Obradoviç raportoi se, me gjithë kërkesën me shkrim të UJ-së dhe në kundërshtim me detyrimet e tyre sipas Marrëveshjeve të Tetorit, MPB-ja refuzoi që t'i kthente UJ-së 20 autobllinda dhe 23 mortaja.²⁵⁹⁰

²⁵⁸⁴ Klaus Naumann, T. 8269–8270 (13 dhjetor 2006).

²⁵⁸⁵ Klaus Naumann, T. 8270–8274 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Zyrës së Prokurorit), f. 9.

²⁵⁸⁶ Klaus Naumann, T. 8269–8274 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime të intervistave të Zyrës së Prokurorit), f. 9.

²⁵⁸⁷ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 158.

²⁵⁸⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 1022. Llukiqi nuk i përgjigjet konkretisht argumenteve të Prokurorisë në këtë pikë.

²⁵⁸⁹ P3130 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB, 3 nëntor 1998), para. 8.

²⁵⁹⁰ 3D557 (Procesverbali i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 3 dhjetor 1998), f. 19.

3. Kontaktet e KVM-së me NATO-n dhe UÇK-në

984. Përveçse theksoi se pjesëtarët e UJ-së ishin përgjithësisht të pakënaqur me veprimtarinë e KVM-së, Mbrojtja e Shainoviqit gjithashtu pretendon se bashkëpunimi i ngushtë në dukje midis NATO-s dhe KVM-së i bëri autoritetet e RFJ-së të dyshonin në statusin civil dhe paanësinë e KVM-së.²⁵⁹¹ Mbrojtja i referohet një dokumenti të datës 7 nëntor 1998 të ambasadës së RFJ-së në Vjenë, i cili iu dërgua, në mes të tjerëve, edhe Shainoviqit, që përmbante korrespondencën ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Javier Solana dhe Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE-së Giancarlo Aragona. Kjo korrespondencë tregon se ekzistonte një marrëveshje midis dy organizatave, sipas të cilës ata do të shkëmbenin të dhëna dhe do të bashkëpunonin dhe bashkërendisnin veprimet në lidhje me aktivitetet verifikuese. Sipas kësaj marrëveshjeje, OSBE-ja do t'a mbështeste Misionin e NATO-s duke e këshilluar në lidhje me "përparësitë e aktiviteteve verifikuese ajrore," bazuar në informatat e mbledhura përmes aktiviteteve verifikuese në terren.²⁵⁹² Mirëpo kjo është në përputhje me dispozitat e Marrëveshjes Clark-Perishiq në lidhje me vëzhgimin ajror. Para një takimi me Drewienkiewicz-in më 9 dhjetor 1998, Shainoviqi gjithashtu ishte ankuar disa herë te përfaqësuesit e huaj se UÇK-ja e kishte shtuar aktivitetin pas tërheqjes së forcave të RFJ/Serbisë dhe se KVM-ja dhe NATO po tregoheshin tolerante ndaj këtyre aktiviteteve, duke e trimëruar në këtë mënyrë UÇK-në për vazhdimin e këtyre veprimeve.²⁵⁹³

985. Mbrojtja e Ojdaniqit paraqiti dëshmi që tregojnë se marrëdhëniet midis UJ-së dhe KVM-së ndryshuan në mes të dhjetorit 1998 dhe janarit 1999, kryesisht për shkak të mendimit të UJ-së për veprimet e KVM-së.²⁵⁹⁴ Millorad Obradoviqi iu referua rasteve kur vëzhguesit kishin kërkuar informata shtesë ose kur kishin vizituar njësitë e UJ-së pa paralajmërim. Shtabi i Përgjithshëm kishte informata se vendasit e punësuar nga KVM-ja ishin kryesisht shqiptarë të Kosovës dhe kishin kontakte të shpeshta me "forcat terroriste." Obradoviqi tha se ishte raportuar se pjesëtarët e misionit verifikues po i jepnin informata "palës tjetër" në lidhje me lëvizjet e UJ-së.²⁵⁹⁵ Në mbledhjen e Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së më 14 janar 1999, Dimitrijeviqi u shpreh se veprimet e verifikuesve po favorizonin UÇK-në, ndër të tjera nëpërmjet furnizimit me

²⁵⁹¹ Dosja Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 394–398.

²⁵⁹² 2D392 (Korrespondencë e ambasadës së RFJ-së, 7 nëntor 1998), dokumentacioni gjyqësor elektronik f. 6. Dhoma gjithashtu ka marrë parasysh këto prova materiale: 6D1635, 6D1637, 6D1638, 6D1639, 6D1640, 6D1668, 6D1669, 6D1671 (e mbyllur me vulë). *Shih gjithashtu* 6D1617.

²⁵⁹³ Zhivadin Jovanoviq, T. 14034–14036 (20 gusht 2007); 2D363 (Raport i Tanjug-ut mbi takimin midis Shainoviqit dhe Hill-it, 27 nëntor 1999); 2D323 (Raport i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për takimin midis Shainoviqit dhe Bo Pellnas-it, 20 nëntor 1998); 2D16 (Memorandum i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për takimin midis Wolfgang Petritsch-it dhe Shainoviqit, 7 tetor 1998); 2D15 (Memorandum i Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së për bisedimet midis Shainoviqit dhe përfaqësuesve austriakë, 15 janar 1999). I njëjti mesazh iu përcoll Knut Vollebaek-ut nga Zhivadin Jovanoviqi; 2D181 (Korrespondencë e Ministrisë së Punëve të Jashtme të RFJ-së në lidhje me bisedimet midis Zhivadin Jovanoviqit dhe Knut Vollebaek-ut, 13 janar 1999).

²⁵⁹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniqit, 30 korrik 2008 (versioni publik), para. 184.

ushqime dhe me armë të "bandave të UÇK-së" dhe planeve për çmilitarizimin e komunës së Malishevës.²⁵⁹⁶ Richard Ciaglinski dëshmoi se hartat e marra nga KVM-ja përdoreshin nga NATO-ja,²⁵⁹⁷ por këmbënguli se pretendimet për bashkëpunim midis UÇK-së dhe NATO-s dhe sugjerimet për përfshirjen e tij të drejtpërdrejtë në shkëmbimin e informatave midis OSBE/NATO-s dhe UÇK-së ishin të pavërteta.²⁵⁹⁸

986. Në lidhje me akuzën e furnizimit të UÇK-së me armë, Obradoviçi shpjegoi se kjo nuk donte të thoshte se pjesëtarët e KVM-së po e furnizonin aktivisht me armë UÇK-në, por se ata qëndronin pasivë ndaj sjelljes së armëve nga Shqipëria dhe si pasojë i mundësonin UÇK-së të importonte armë. Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së gjykonte se kjo ishte e papranueshme bazuar në Marrëveshjen Clark-Naumann dhe tregonte anësinë e KVM-së ndaj UÇK-së.²⁵⁹⁹ Në mbledhjen e Kolegjiut të datës 25 shkurt 1999, Dimitrijeviçi tërhoqi vëmendjen në lidhje me anësinë e KVM-së, duke thënë se KVM-ja do të përqendrohej në aktivitetet e "forcave tona të sigurisë" për të mbledhur të dhëna që tregonin përdorimin e forcës së tepruar dhe se një pjesë e këtyre informatave mund t'i jepej UÇK-së. Ai sugjeroi se KVM-së duhej t'i bëhej vërejtje përmes Komisionit për Bashkëpunim, duke iu thënë që t'i përmbaheshin mandatit dhe të mos përqendroheshin vetëm mbi UJ-në dhe MPB-në.²⁶⁰⁰

987. Me gjithë këto shqetësime të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së në lidhje me KVM-në, Ojdaniçi vazhdoi të lëshonte urdhra duke nxitur bashkëpunimin me verifikuesit. Për shembull, një urdhër i datës 8 mars 1999, kërkonte përshtatjen e sistemit të bashkëpunimit të përcaktuar më herët nga Perishiçi duke vënë, në mes tjerash, oficerë ndërlidhës në njësi të ndryshme në kazerma në Kosovë dhe duke nxitur edhe më shumë zbatimin e detyrimeve sipas Marrëveshjeve të Tetorit dhe marrëveshjeve shtesë.²⁶⁰¹ Ndër këto detyrime ishte edhe respektimi prej UJ-së i imunitetit akorduar pjesëtarëve të KVM-së dhe krijimi prej saj i ekipeve ndërlidhëse shtesë në forcat ajrore (RV),

²⁵⁹⁵ Millorad Obradoviç, T. 15001 (5 shtator 2007). Ai nuk saktësoi se cilat vende kishte kërkuar të vizitonte KVM-ja.

²⁵⁹⁶ P936 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 14 janar 1999), f. 9–10.

²⁵⁹⁷ Richard Ciaglinski, T. 6992–6992 (21 nëntor 2006). *Shih gjithashtu* 2D392, një seri letrash midis Giancarla Aragona-s, kreu i OSBE-së, dhe Javier Solana-s, kreu i NATO-s, kur përshkruhet një marrëveshje për shkëmbim informatash midis KVM-së dhe NATO-s; dhe P440, Marrëveshje mbi KVM-në midis NATO-s dhe RFJ-së (Marrëveshja Clark-Perishiçi) e nënshkruar nga Wesley Clark dhe Momçillo Perishiçi, 23 tetor 1998, që është marrëveshja midis UJ-së dhe NATO-s e cila i lejonte NATO-s të organizonte operacionet monitoruese të KVM-së dhe të shkëmbente informata për zbatimin e tyre.

²⁵⁹⁸ Richard Ciaglinski, T. 6993–7000 (21 nëntor 2006).

²⁵⁹⁹ Millorad Obradoviç, T. 15001 (5 shtator 2007), T. 15114–15116 (6 shtator 2007).

²⁶⁰⁰ P941 (Procesverbal i Kolegjiut të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për 25 shkurt 1999), f. 7, 9.

²⁶⁰¹ 3D407 (Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së – Urdhër për Organizimin e Punës dhe Marrëdhëniet UJ-OSBE, 8 mars 1999); *shih gjithashtu* Dushan Llonçar, T. 7677–7680 (1 dhjetor 2006). Ky urdhër zëvendësoi atë të datës 22 tetor 1998. 3D409 (Urdhër drejtuar Ekipit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për Kontakte me misionet e OSBE-së dhe NATO-s, 22 tetor 1998).

mbrojtjen kundërajrore (PVO) dhe në Armatën e 3-të. Para kësaj periudhe, kishin qenë vetëm dy ekipe të tilla, një në Korpusin e Prishtinës dhe një në Armatën e 3-të.²⁶⁰²

4. Konkluzion

988. Është e kuptueshme që Sllobodan Millosheviqi dhe udhëheqja ushtarake dhe politike e RFJ-së dhe Serbisë hezitonin të lejonin prani ndërkombëtare në Kosovë dhe kjo u pasqyrua në vështirësitë për arritjen e marrëveshjes dhe hezitimin fillestar për tërheqjen e forcave. Sidoqoftë, Marrëveshja për KVM-në u nënshkrua brenda 16 tetorit 1998, Komisioni Federal për Bashkëpunim u krijua brenda 19 tetorit, dhe marrëveshjet përgjithësisht u respektuan deri në mes të nëntorit 1998, kur u raportuan shtimi i veprimtarisë së UÇK-së dhe përdorimi i forcës së tepruar nga ana e forcave të RFJ-së dhe Serbisë.

989. “Incidenti i Podujevës” ishte shkelje e hapët dhe e qëllimshme e Marrëveshjeve të Tetorit. Mirëpo provat nuk tregojnë se refuzimi i UJ-së për të lejuar inspektimin e kazermave ishte në kundërshtim me detyrimet sipas Marrëveshjes Jovanoviq-Geremek. Me gjithë hezitimin e palës së RFJ/Serbisë për pakësimin e forcave në Kosovë, për shkak të veprimeve të UÇK-së dhe NATO-s, gjithsesi është treguar se pati rritje të numrit të efektivave të UJ-së dhe MPB-së, gjë që ishte në kundërshtim me Marrëveshjet e Tetorit. Për më tepër, MPB-ja mbajti armatimin dhe pajisjet e rënda që duhej t’ia kthente UJ-së. Shtimi i efektivit të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, u bë në mënyra të ndryshme, ndër të tjera nëpërmjet zvarritjes së largimit të disa njësive dhe dhënies së urdhrave për dislokimin e të tjerave, nganjëherë duke përdorur vetëmbrojtjen si shkas. Megjithëse bashkëpunimi midis KVM-së, NATO-s, dhe UÇK-së nuk ishte asgjë tjetër veçse përshtypje dhe nuk e justifikon refuzimin e autoriteteve të RFJ/Serbisë për respektimin e detyrimeve të tyre sipas Marrëveshjeve të Tetorit, shqetësimet e tyre se trupat e NATO-s mund të kryenin sulm tokësor dhe se kjo mund t’i ndihmonte aktivitetet e dhunshme të UÇK-së, ishin të bazuara dhe shpjegojnë hapat e marra në mes të marsit, së paku për të forcuar aftësinë kundërpërgjigjëse të UJ-së. Nga ana tjetër, nuk duket se ka shpjegim bindës për shtimin e mëhershëm të trupave dhe fshehjen nga ana e MPB-së të numrit të vërtetë të forcave të policisë dhe mbajtjen e pajisjeve që duhej t’i ishin kthyer UJ-së.

990. Veprimet dhe sjellja e Shainoviqit, Ojdaniqit, Pavkoviqit, dhe Llukiqit do të analizohen në hollësi në pjesët kushtuar përgjegjësisë së tyre individuale penale. Siç do të shihet, dëshmitë e

²⁶⁰² Radomir Çuçak, T. 14951–14952 (4 shtator 2007). Urdhri gjithashtu bënte ndërrime në personel duke emëruar Millovan Bojoviqin, i cili ishte këshilltar i shefit të Shtabit të Përgjithshëm, në postin e koordinatorit të ekipit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për kontakte me KVM-në dhe e bënte anëtar të Komisionit Federal për Bashkëpunim me KVM-në, dhe duke e shkrirë ekipin e punës të Shtabit të Përgjithshëm në një ekip prej 10 anëtarësh të vendosur në godinën e komandës së PrK-së në Prishtinë. Vladimir Llazareviq, T. 17838 (7 nëntor 2007); Millan Kotur, T. 20707–20708 (21 janar 2008).

diskutuara në ato pjesë mbështesin konkluzionet e Dhomës Gjyqësore se udhëheqja politike dhe ushtarake e RFJ-së dhe Serbisë i shkelën qëllimisht Marrëveshjet e Tetorit.

E. KONTROLLIMI I OPERACIONEVE TË UJ-SË DHE MPB-SË NË KOSOVË

991. Pasi ka përshkruar forcat e ndryshme që u përfshinë në konfliktin e armatosur të Kosovës më 1998 dhe që vazhdoi më 1999, si dhe disa nga aktivitetet e tyre në periudhën para fushatës ajrore të NATO-s, Dhoma Gjyqësore do të analizojë mënyrën e planifikimit, kontrollimit, dhe kryerjes së operacioneve me pjesëmarrjen e forcave të UJ-së dhe MPB-së. Për këtë qëllim, Dhoma ka shqyrtuar një sasi të madhe provash që kanë të bëjnë me operacionet ushtarake pa pasur në dispozicion analiza të shumanshme prej palëve të urdhrave, raporteve, dhe dëshmimeve të paraqitura në gjykim.

1. Mbledhjet në Beograd

a. Mbledhjet në vitin 1998

i. Plani Kundër Terrorizmit në Kosovë

992. Më 13 maj 1998, Momir Stojanoviqi, shef i degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës, me kërkesë të "komandantit të ushtrisë," konkretisht të komandantit të Armatës së 3-të, hartoi një analizë të gjendjes së sigurisë në Kosovë, duke përshkruar në hollësi numrin e forcave në kufi dhe grupimin e tyre. Raporti konkludonte se bashkërendimi nuk ishte në nivel të kënaqshëm dhe kërkonte nga komandanti i ushtrisë që të ndërhynte. Në përgjigje të kërkesës së Stojanoviqit, komandanti i Armatës së 3-të, Samarxhiqi, autorizoi Pavkoviqin që të bashkërendonte aktivitetet me MPB-në në zonën e Kosovës.²⁶⁰³

993. Në fund të majit 1998, Pavkoviqi dhe Samarxhiqi shkuan në Beograd me një plan për "zhbllokimin" e rrugëve të cilin ia treguan Perishiqt, shef i atëhershëm i Shtabit të Përgjithshëm, i cili i bëri disa korrigjime. Më pas Pavkoviqi, Samarxhiqi, dhe Perishiqi takuan Millosheviqin për t'ia dorëzuar planin.²⁶⁰⁴ Në rrëfimin e tij të këtyre ngjarjeve, Millan Gjakoviqi iu referua një mbledhjeje të mbajtur më 30 maj 1998 në Beograd, në të cilën ishin të pranishëm Pavkoviqi, Perishiqi, Aleksandar Dimitrijeviqi, Samarxhiqi, Stojanoviqi, Jovica Stanishiqi,, dhe Llukiqi.²⁶⁰⁵ Gjakoviqi nuk saktësoi nëse kishte qenë i pranishëm edhe Millosheviqi. Si pasojë nuk është e qartë se a ishte kjo mbledhje e mbajtur më 30 maj 1998, mbledhja në të cilën Pavkoviqi dhe Samarxhiqi i

²⁶⁰³ Millan Gjakoviqi, T. 26387, 26411 (19 maj 2008).

²⁶⁰⁴ Millan Gjakoviqi, T. 26411 (19 maj 2008).

paraqitën planin Millosheviqit. Sidoqoftë, nga dëshmia e Gjakoviqit është e qartë se Pavkoviqi dhe Samarxhiqi kishin marrë urdhër që të "përcaktonin elementët themelorë" të planit gjatë qëndrimit në Beograd. Në fund ky plan përbëhej prej pesë fazash.²⁶⁰⁶ Me gjithë paqartësinë rreth datës së mbledhjes, Dhoma konkludon se, së paku Pavkoviqi, Samarxhiqi, Stojanoviqi, Perishiqi, Gjakoviqi, dhe Llukiqi ishin në dijeni të planit për "zhbllokimin" e rrugëve.

994. Pas kthimit nga Beogradi, Pavkoviqi i kërkoi Gjakoviqit që të fillonte të përgatiste "idetë e zgjidhjes së atij plani." Pavkoviqi gjithashtu i tha Gjakoviqit se Këshilli i Lartë i Mbrojtjes kishte përcaktuar politikat që do të zbatoheshin nëpërmjet këtij plani.²⁶⁰⁷ Sipas procesverbalit të mbledhjes së "Shtabit Operativ Ndërdikasterial për Shtypjen e Terrorizmit në Kosovë" të mbajtur më 29 tetor 1998, vendimi për të përpiluar Planin Kundër Terrorizmit në Kosovë ishte marrë në sesionin e 5-të të Këshillit të Lartë të Mbrojtjes, më 9 qershor 1998.²⁶⁰⁸ Procesverbali i sesionit të 5-të të KLM-së nuk përmend një plan të tillë. Sidoqoftë, një nga konkluzionet e propozuara dhe të miratuara nga Millosheviqi gjatë kësaj mbledhjeje ishte se, "nëse aktivitetet terroriste të separatistëve shqiptarë përshkallëzohen, UJ-ja do të ndërhyjë në mënyrën dhe masën e duhur."²⁶⁰⁹ Gjithashtu u konkludua se "UJ-ja do të jetë e gatshme për t'iu kundërvënë çfarëdo ndërhyrjeje të huaj që mund të rrezikojë sovranitetin dhe tërësinë territoriale të RFJ-së."²⁶¹⁰ Më tej Gjakoviqi shpjegoi se, pas hartimit të, projektplanit, ai u verifikua nga komandanti i Armatës së 3-të dhe rreth 15 korrikut 1998 iu dorëzua Shtabit të Përgjithshëm.²⁶¹¹ Një raport nga Komanda e Korpusit të Prishtinës dërguar Komandës së Armatës së 3-të më 23 korrik 1998, konfirmon se më 15 korrik 1998 "një kopje e planit (direktiva dhe katër harta)" i ishte dërguar Spasoje Smilaniqit, shef i Administratës së Parë të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së.²⁶¹²

995. Më 21 korrik 1998 u mbajt një mbledhje tjetër e thirrur nga Millosheviqi në zyrën e tij në Beograd dhe në të morën pjesë Millutinoviqi, Shainoviqi, Dimitrijeviqi, Matkoviqi, Samarxhiqi, Perishiqi, Pavkoviqi, Stojilkoviqi, Gjorgjeviqi, dhe Llukiqi.²⁶¹³ Gjatë mbledhjes, Millosheviqi

²⁶⁰⁵ Millan Gjakoviq, T. 26410 (19 maj 2008).

²⁶⁰⁶ Millan Gjakoviq, T. 26409 (19 maj 2008).

²⁶⁰⁷ Millan Gjakoviq, T. 26409 (19 maj 2008).

²⁶⁰⁸ P2166 (Procesverbal i mbledhjes në Belli Dvor të mbajtur më 29 tetor 1998), f. 2-4.

²⁶⁰⁹ P1574 (Procesverbal i sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998); 1D760 (shënimet stenografike të sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 10.

²⁶¹⁰ 1D760 (shënimet stenografike të sesionit të 5-të të KLM-së, 9 qershor 1998), f. 10.

²⁶¹¹ Millan Gjakoviq, T. 26409 (19 maj 2008).

²⁶¹² 4D101 (Plani i PrK-së për angazhimin e njësive në Kosovë, 23 korrik 1998), f. 1.

²⁶¹³ Dushko Matkoviq, T. 14634-14635 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 9. Dushko Matkoviq tha se Millosheviqi kishte thirrur një mbledhje "rreth 20 korrikut 1998." Raporti i dërguar nga Komanda e PrK-së Armatës së 3-të më 22 korrik 1998 i referohet një "takimi me Presidentin e RFJ-së të mbajtur në zyrën e tij më 21 korrik 1998". 4D100 (Raport i PrK-së dërguar Armatës së 3-të për angazhimin e njësive, 22 korrik 1998). Dhe në fund, raporti i Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të më 23 korrik 1998 përmend "takimin me Presidentin e RFJ-së më 21 korrik 1998". 4D101 (Plani i PrK-së për angazhimin e njësive në Kosovë,

deklaroi se do të miratoheshin plane për "antiterrorizëm" dhe se policia, ushtria, dhe politikanët do të kishin rolet e tyre.²⁶¹⁴ Më pas Pavkoviqi paraqiti planin për luftën kundër "terrorizmit" në disa faza, që parashihte edhe përdorimin e forcave ushtarake dhe policore shtesë në Kosovë.²⁶¹⁵ Për realizimin e këtij plani ishin ndërmarrë që më parë disa veprime.²⁶¹⁶ Matkoviqi shpjegoi se gjatë mbledhjes Millosheviqi kishte thënë se plani ("Plani") ishte miratuar dhe nuk kishte kërkuar nga pjesëmarrësit që të votonin për apo kundër tij. Qëllimi i mbledhjes në fakt ishte që të informoheshin pjesëmarrësit për Planin.²⁶¹⁷ Sidoqoftë, në raportin dërguar Komandës së Armatës së 3-të nga Komanda e Korpusit të Prishtinës më 23 korrik 1998 thuhej se gjatë kësaj mbledhjeje "ishte dhënë urdhri për fillimin e zbatimit të planit."²⁶¹⁸

996. Në një dokument të Komandës së Armatës së 3-të i datës 22 korrik 1998 bëhet e ditur se Komanda e Korpusit të Prishtinës u ngarkua me përgatitjen e propozimit për angazhimin e drejtpërdrejtë dhe të tërthortë të njërive të Korpusit të Prishtinës për zbatimin e planit.²⁶¹⁹ Më 23 korrik 1998, Komanda e Korpusit të Prishtinës i kërkoi Komandës së Armatës së 3-të miratimin për përdorimin e njërive sipas Planit "në frymën e urdhrat të Presidentit të Republikës Federale të Jugosllavisë."²⁶²⁰ Në të njëjtën ditë, Samarxhiqi nuk pranoi të miratonte disa nga veprimet e parashikuara në Plan, sepse mendonte se Millosheviqi nuk ishte informuar për to. Ai posaçërisht theksoi se Pavkoviqi "nuk e kishte informuar Millosheviqin gojarisht ... se forcat e Korpusit do të angazhoheshin në zhbllokimin e rrugëve" dhe, si pasojë nuk autorizoi përdorimin e njërive të Korpusit në zhbllokimin e rrugëve të caktuara.²⁶²¹

997. Sipas procesverbalit të mbledhjes së 29 tetorit 1998, Plani për "shtypjen dhe luftimin e terrorizmit në Kosovë," i miratuar më 20 korrik 1998, përfshinte këto detyra: (a) marrjen e masave në përf forcimin e sigurisë së kufirit shtetëror në brezin kufitar dhe në thellësi; (b) organizimin, pajisjen, dhe koordinimin e operacioneve të forcave të MPB-së dhe UJ-së për të luftuar forcat "terroriste" më me sukses; (c) marrjen nën kontroll të territorit të Kosovës nga forcat e MPB-së dhe UJ-së dhe krijimin e kushteve për zhbllokimin e rrugëve dhe territorit të pushtuar; (d) armatimin e popullatës serbe dhe malazeze dhe krijimin e njërive policore rezervë për të mbrojtur fshatrat serbe;

23 korrik 1998), f. 1. Rrjedhimisht Dhoma mendon se mbledhja në të cilin Millosheviqi kishte miratuar planin e paraqitur nga Pavkoviqi u mbajt më 21 korrik 1998.

²⁶¹⁴ Dushko Matkoviq, T. 14636 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 9.

²⁶¹⁵ Dushko Matkoviq, P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 9.

²⁶¹⁶ Dushko Matkoviq, T. 14636–14637 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 9.

²⁶¹⁷ Dushko Matkoviq, T. 14637 (30 gusht 2007).

²⁶¹⁸ 4D101 (Plani i PrK-së për angazhimin e njërive në Kosovë, 23 korrik 1998), f. 1; 4D100 (Raport i PrK-së dërguar Armatës së 3-të në lidhje me angazhimin e njërive, 22 korrik 1998).

²⁶¹⁹ 4D119 (Kërkesë e Armatës së 3-të dërguar PrK-së, 22 korrik 1998).

²⁶²⁰ 4D101 (Plani i PrK-së për angazhimin e njërive në Kosovë, 23 korrik 1998), f. 1.

²⁶²¹ 4D102 (Përgjigje për Planin e PrK-së për angazhimin e njërive, 23 korrik 1998).

(e) strehimin dhe përkujdesjen për popullatën shqiptare të shpërngulur përkohësisht; (f) mbajtjen nën kontroll dhe mbrojtjen e territorit dhe rrugëve të çliruara; dhe (g) çarmatosjen e të gjitha fshatrave shqiptare që dihej se ishin të armatosura.²⁶²² Besueshmëria e këtij procesverbalit u vu në dyshim gjatë gjykimit dhe kjo çështje është diskutuar në më shumë hollësi më poshtë. Sidoqoftë, është e qartë se Plani parashikonte pjesëmarrjen e njësisve të MPB-së si dhe të UJ-së.²⁶²³ Provat tregojnë se MPB-ja duhej të përbënte shtyllën kryesore të operacioneve luftarake dhe UJ-ja duhej t'i jepte mbështetje MPB-së.²⁶²⁴

998. Në mbledhjen e zyrtarëve të lartë të MPB-së në Shtabin e MPB-së në Prishtinë më 22 korrik 1998, u shpjegua se, për shkak të gjendjes shumë të vështirë në Kosovë, "udhëheqja shtetërore" kishte miratuar një plan kundër "terrorizmit."²⁶²⁵ Dushko Adamoviçi, i cili kishte qenë i pranishëm në mbledhje, konfirmoi se plani që ishte diskutuar gjatë mbledhjes ishte miratuar paraprakisht "në nivel të Presidentit të vendit" dhe se duhej të zbatohet nga MPB-ja dhe UJ-ja.²⁶²⁶ Njëra nga pikat e rendit të ditës ishte përcaktimi i "detyrave për zbatimin" e Planit.²⁶²⁷ Sipas procesverbalit të mbledhjes së 28 korrikut 1998 në Shtabin e MPB-së, pasi Llukiqi shpjegoi se ishte zbatuar faza e dytë e Planit, ministri i Brendshëm Vllajko Stojilkoviçi i udhëzoi të pranishmit "planifikoni aktivitetet e PJP-së paraprakisht me shefat e SPB-së dhe mbani mbledhje për këtë."²⁶²⁸ Në mbledhje në mes të tjerëve ishin të pranishëm edhe Stojilkoviçi, Llukiqi, Markoviçi, dhe shefat e SPB-ve të Kosovës.²⁶²⁹

999. Sipas procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29 tetor 1998, zbatimi i Planit filloi më 25 korrik 1998.²⁶³⁰ Më 28 korrik, Shtabi i Përgjithshëm i UJ-së lëshoi urdhrin *Grom 98* për dislokimin e UJ-së për të siguruar kufirin shtetëror me Shqipërinë dhe për të eliminuar forcat "terroriste" shqiptare, siç është diskutuar më lart. Angazhimi i UJ-së duhej të bëhej në dy faza dhe këto aksione

²⁶²² P2166 (Procesverbal i mbledhjes në Belli Dvor të mbajtur më 29 tetor 1998), f. 2–4.

²⁶²³ *Shih, p.sh.*, 4D100 (Raport i PrK-së dërguar Armatës së 3-të në lidhje me angazhimin e njësisve, 22 korrik 1998).

²⁶²⁴ 4D119 (Kërkesë e Armatës së 3-të dërguar PrK-së, 22 korrik 1998); Millan Gjakoviçi, T. 26409–26410 (19 maj 2008).

²⁶²⁵ Radovan Vuçureviçi, T. 23061–23063 (22 shkurt 2008); 6D798 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 22 korrik 1998). Vuçureviçi dëshmoi se "Plani Global" që përmendet në procesverbalin e mbledhjes të mbajtur më shtabin e MPB-së më 22 korrik 1998 ishte plani të cilin "udhëheqja shtetërore" e kishte miratuar për të parandaluar "terrorizmin."

²⁶²⁶ Dushko Adamoviçi, T. 25059–25060 (9 prill 2008).

²⁶²⁷ 6D798 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 22 korrik 1998), f. 1.

²⁶²⁸ P3121 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998), f. 8.

²⁶²⁹ P3121 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 29 korrik 1998). Procesverbalit i referohet "fazës së dytë të Planit Global." Bazuar në dëshminë e Vuçureviçit, Dhoma Gjyqësore konkludon se "Plani Global" ishte Plani i miratuar nga Millosheviçi më 21 korrik 1998. Radovan Vuçureviçi, T. 23061–23063 (22 shkurt 2008).

²⁶³⁰ P2166 (Procesverbalit i mbledhjes në Belli Dvor të mbajtur më 29 tetor 1998), f. 2.

duhej të koordinoheshin me forcat e MPB-së.²⁶³¹ Gjakoviqi dëshmoi se plani i përcaktuar në urdhrin *Grom 98* "përputhej plotësisht" me tri fazat e para të Planit.²⁶³²

1000. Një urdhër i Komandës së Armatës së 3-të dërguar Komandës së Korpusit të Prishtinës më 1 gusht 1998 bënte të ditur se më 3 gusht 1998 duhej të mbahej një mbledhje në zyrën e Presidentit të RFJ-së për të diskutuar planin mbi zbatimin e fazës së tretë të Planit.²⁶³³

1001. Sipas Matkoviqit, më 5 gusht 1998 u mbajt një mbledhje me pjesëmarrjen e Millosheviqit, Miniqit, Angelkoviqit, Shainoviqit, Perishiqit, Pavkoviqit, Dimitrijeviqit, Samarxhiqit, Lluqi, Gjorgjeviqit, Stevanoviqit, dhe të tij. Në mbledhje u paraqitën raporte për ngjarjet që kishin ndodhur në Kosovë. Një mbledhje tjetër me të njëjtët pjesëmarrës u mbajt në fund të gushtit 1998, në të cilën pjesëmarrësit raportuan për "realizimin e planit fillestar."²⁶³⁴

1002. Në një mbledhje të mbajtur në Beograd më 31 gusht 1998, kryesuar nga Millosheviqi dhe e cila mund të jetë një nga mbledhjet të cilave iu referua Matkoviqi, u ra dakord për një "plan për zbatimin e fazës së pestë të luftës kundër terrorizmit në Kosovë."²⁶³⁵ Nga një dokument i Komandës së Korpusit të Prishtinës dërguar Komandës së Armatës së 3-të i datës 22 shtator 1998 shihet se Komanda e Korpusit të Prishtinës kishte bërë disa kërkesa për zbatimin e kësaj faze. Sidoqoftë, ajo nuk ishte zbatuar që nga 22 shtatori 1998.²⁶³⁶

1003. Zbatimi i planit u shqyrtua në mbledhjen e datës 29 tetor 1998 të përmendur më lart.²⁶³⁷ Pavkoviqi raportoi në emër të "Komandës së Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë." Kjo çështje do të shqyrtohet më në hollësi në Ndarjen e mëposhtme VI.E.2.b. Në këtë mbledhje morën pjesë Millosheviqi, Millutinoviqi, Miniqi, Shainoviqi, Matkoviqi, Stojilkoviqi, Angelkoviqi, Perishiqi, Dimitrijeviqi, Samarxhiqi, Pavkoviqi, Gjorgjeviqi, Markoviqi, Stevanoviqi, Lluqi, dhe Shushiqi.²⁶³⁸ Pavkoviqi përmendi disa rezultate të arritura në Kosovë përmes zbatimit të Planit: (a) ishte ndaluar përshkallëzimi i "terrorizmit" në Kosovë; (b) ishte rivendosur kontrolli mbi të gjitha rrugët; (c) ishte ndaluar "largimi i joshqiptarëve" dhe ishin mbrojtur qytetet dhe objektet e rëndësishme ekonomike; dhe (d) ishte organizuar "kthimi... i shqiptarëve të shpërngulur përkohësisht nga fshatrat e tyre për shkak të operacioneve luftarake të forcave terroriste."²⁶³⁹

²⁶³¹ 4D137 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm për Dislokimin e UJ-së në Kosovë, 28 korrik 1998).

²⁶³² Millan Gjakoviqi, T. 26408–26409 (19 maj 2008). Ai shtoi se faza e dytë e planit *Grom 98* nuk ishte zbatuar.

²⁶³³ 4D125 (Urdhër i Armatës së 3-të për të Ndaluar Përdorimin e Njësive të PrK-së, 1 gusht 1998).

²⁶³⁴ Dushko Matkoviqi, P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 13.

²⁶³⁵ P1435 (Raport mbi Zbatimin e Fazës së 5-të të Planit Kundër Terrorizmit, 22 shtator 1998), f. 1.

²⁶³⁶ P1435 (Raport mbi Zbatimin e Fazës së 5-të të Planit Kundër Terrorizmit, 22 shtator 1998), f. 1–2.

²⁶³⁷ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor të mbajtur më 29 tetor 1998), f. 2–4.

²⁶³⁸ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 1.

²⁶³⁹ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 4.

Pavkoviqi gjithashtu përmendi disa detyra që duhej të kryheshin gjatë periudhës vijuese për të eliminuar plotësisht forcat "terroriste."²⁶⁴⁰ Perishiqi u shpreh se gjendja në Kosovë e përshkruar nga Pavkoviqi nuk i përgjigjej realitetit: ai theksoi se nuk duhej lejuar që ata të kontrolloheshin nga ngjarjet, por të ishin ata në kontrollin e rrethanave.²⁶⁴¹

1004. Siç është diskutuar në Pjesën VI.C më lart, gjatë periudhës prej 29 korrikut deri më 29 tetor 1998, në Kosovë u kryen operacione të përbashkëta sipas Planit. Për shembull, një operacion i përbashkët u krye në sektorin e fshatrave Sllup dhe Voksh nga mesi i gushtit 1998 dhe Dhoma do ta shqyrtojë më poshtë planifikimin dhe kryerjen e këtij operacioni të përbashkët. Urdhrat për operacionet e përbashkëta të kryera gjatë kësaj periudhe përmendnin "Komandën e Përbashkët" dhe gjithashtu do të shqyrtohen më poshtë.²⁶⁴²

ii. Zanafilla e Komandës së Përbashkët

1005. Në maj ose qershor 1998, afërsisht në kohën kur Plani po evoluonte dhe kur po bëheshin përpjekje për të përmirësuar sistemin e koordinimit midis MPB-së dhe UJ-së, shefi i atëhershëm i Administratës së Sigurimit të UJ-së, Aleksandar Dimitrijeviq, mori pjesë në një mbledhje me Millosheviqin dhe Perishiqin. Në mbledhje Millosheviqi propozoi emërimin e Pavkoviqit, komandant i atëhershëm i Korpusit të Prishtinës, "komandant të të gjitha forcave në Kosovë dhe Metohi."²⁶⁴³ Dimitrijeviqi dhe Perishiqi e kundërshtuan këtë ide, sepse, sipas tyre, ata dyshonin se MPB-ja do t'i vinte njësitë e saj nën varësinë e Pavkoviqit.²⁶⁴⁴ Gjatë dëshmisë së tij, Dimitrijeviqi tha se kishte pasur përshtypjen se shprehja "Komandë e Përbashkët" ishte krijuar më vonë për t'i shërbyer Pavkoviqit si "mbulesë për disa veprime të tij në mënyrë që ai të mund të thoshte, 'Prapa meje qëndron Komanda e Përbashkët.'"²⁶⁴⁵ Gjatë pyetjeve nga Prokuroria në ditën e dytë të dëshmisë së tij, ai shpjegoi se Pavkoviqi mund ta ketë përdorur shprehjen për t'iu përgjigjur pyetjeve.

nga hierarkia komanduese pse ishte përdorur një njësi ose pse një element i njësisë ishte përdorur nga komandanti i ushtrisë, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, me fjalë të tjera, me gjasë ka qenë më lehtë të thuhet se dikush më ka thënë ashtu ose ndonjë justifikim tjetër i ngjashëm, por pa saktësuar se kush ka thënë.²⁶⁴⁶

²⁶⁴⁰ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 9–10.

²⁶⁴¹ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 12.

²⁶⁴² *Shih* Nënndarjen VI.E.2.b.i.

²⁶⁴³ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26592–26594 (8 korrik 2008).

²⁶⁴⁴ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26593–26594 (8 korrik 2008).

²⁶⁴⁵ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26595 (8 korrik 2008).

²⁶⁴⁶ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26713 (9 korrik 2008).

Dhoma interpretoi se kjo përfshinte arritjen e koordinimit midis forcave të UJ-së dhe MPB-së. Sidoqoftë, Dimitrijeviqi pranoi se ky ishte vetëm hamendësim i tij.²⁶⁴⁷ Në dosjen e saj përfundimtare Mbrojtja e Pavkoviqit thekson se nuk ka prova që dëshmojnë këtë dhe theksohet natyrën spekulative e dëshmisë së Dimitrijeviqit lidhur me këtë pikë.²⁶⁴⁸ Dhoma vëren se, megjithëse Dimitrijeviqi e pati vështirë të shpjegonte plotësisht arsyet se pse i duhej "mbulesa" Pavkoviqit, ai dëshmoi se sigurisht një "mbulesë" e tillë do t'a ndihmonte Pavkoviqin për të pasur kontrollin e UJ-në në Kosovë. Dimitrijeviqi nuk ishte i sigurt nëse kishte pasur lidhje midis mbledhjes në të cilën kishte marrë pjesë ai dhe mbledhjeve të mëpasme të një grupi më të madh për të diskutuar gjendjen në Kosovë që u përshkruan më lart. Ai supozoi se mbledhjet e mëvonshme u mbajtën për të inkurajuar koordinimin midis hierarkive komanduese të UJ-së dhe MPB-së në Kosovë në vitin 1998 sepse " në atë kohë ishte fakt se do të ishte shumë e vështirë për çdokënd [përveç ministrit të Brendshëm] që t'i ngarkonte detyra MPB-së."²⁶⁴⁹ Momir Stojanoviqi gjithashtu dëshmoi ngjashëm, duke thënë se kishte "pasur disa probleme në lidhje me koordinimin, bashkëpunimin, dhe veprimet e koordinuara midis MPB-së dhe ushtrisë në nivelet e ulëta."²⁶⁵⁰ Sidoqoftë, gjatë pyetjeve nga Mbrojtja e Shainoviqit ditën e nesërme, Dimitrijeviqi tentoi t'i mohonte fjalët e thëna gjatë dëshmisë së drejtpërdrejtë. Këtë herë ai tha se nuk e dinte çfarë kishte ndodhur në mbledhjen në Prishtinë sepse, kur e kishte pyetur Stojanoviqin, ai i kishte thënë se nuk ishte "asgjë."²⁶⁵¹

1006. Dhoma e pranon dëshminë e Dimitrijeviqit si argumentim të qartë të nevojës për krijimin e Komandës së Përbashkët, konkretisht, nevojën për të gjetur mekanizma efektivë për të mundësuar bashkërendim më të mirë të aktiviteteve të forcave shtetërore në Kosovë. Dhoma është e prirur të hedhë poshtë orvatjen e Dimitrijeviqit për tërheqjen nga dëshmia e tij gjatë pyetjeve nga Mbrojtja; ai dha shpjegim bindës pse duhej Komanda e Përbashkët, edhe pse më vonë e ndryshoi atë.

1007. Siç është theksuar në Kapitullin IV më lart, më 10 qershor 1998, në një mbledhje tjetër të Partisë Socialiste të Serbisë, u mor vendim për të dërguar një ekip në Prishtinë në ndihmë të organeve shtetërore të atjeshme dhe për koordinimin e veprimtarive politike për stabilizimin e Kosovës.²⁶⁵² Ky ekip, i njohur si "Grupi i Punës," u propozua nga Millosheviqi dhe përbëhej nga Millomir Miniqi, Dushan Matkoviqi, dhe Zoran Angjelkoviqi.²⁶⁵³ Pas vajtjes në Kosovë, Grupi i

²⁶⁴⁷ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26712–26713 (9 korrik 2008).

²⁶⁴⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 244.

²⁶⁴⁹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26596, 26619–26621 (8 korrik 2008).

²⁶⁵⁰ Momir Stojanoviq, T. 19765 (7 dhjetor 2007).

²⁶⁵¹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26720–26721 (9 korrik 2008).

²⁶⁵² P1012 (Procesverbali i Sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998), f. 6–8.

²⁶⁵³ P1012 (Procesverbali i Sesionit të 16-të të Këshillit Kryesor të SPS-së, 10 qershor 1998), f. 6–8; Dushko Matkoviq, P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 6.

Punës mbajti mbledhje me përfaqësues të organeve të ndryshme shtetërore, përfshirë edhe sektorin civil si dhe ushtrinë e policinë, për t'i informuar pjesëtarët e tyre mbi gjendjen, si dhe për të filluar shkëmbimin e informatave dhe koordinimin.²⁶⁵⁴

1008. Në të njëjtën kohë, Shainoviçin e dërguan në Kosovë si përfaqësues i qeverisë federale për të mbrojtur pozicionin e saj politik dhe për të ndërmarrë veprime diplomatike.²⁶⁵⁵ Kjo çështje është shqyrtuar në hollësi në Pjesën VIII.D më poshtë.

1009. Më 25 qershor 1998 në Belli Dvor në Beograd u mbajt një mbledhje ku ndër të tjerë morën pjesë edhe Millosheviçiqi, Angjelkoviçiqi, Miniçiqi, Matkoviçiqi, Millutinoviçiqi, dhe Shainoviçiqi. Grupi i Punës i raportuan gojarisht Millosheviçiqit për çfarë kishin dëgjuar dhe parë gjatë vizitës së fundit në Kosovë.²⁶⁵⁶ Sipas Matkoviçiqit, fakti se Shainoviçiqi ishte ftuar në këtë mbledhje tregonte se "ai do të përfshihej në këtë çështje në njëfarë mënyre, edhe pse kjo nuk iu tha në këtë mbledhje."²⁶⁵⁷

1010. Matkoviçiqi iu referua një mbledhjeje të mbajtur më 10 shtator 1998, në të cilën Millosheviçiqi iu propozua formimi i një këshilli ekzekutiv të përkohshëm në Kosovë.²⁶⁵⁸ Millosheviçiqi e pranoi propozimin.²⁶⁵⁹ Siç është shpjeguar më lart, më 22 shtator 1998, Komiteti Ekzekutiv i SPS-së mbajti një mbledhje në Beograd, ku mori pjesë edhe Millutinoviçiqi si President i Serbisë, ku u konkludua se gjendja në Kosovë po normalizohej.²⁶⁶⁰ Kjo mbledhje mori në shqyrtim çfarë ishte bërë pas konkluzioneve të nxjerra nga Këshilli Kryesor më 10 qershor 1998. Aktivitetet e Grupit të Punës në Kosovë u rralluan paskëta.²⁶⁶¹ Më 29 tetor 1998, pas mbledhjes me Këshillin Krahinor të SPS-së në Kosovë dhe një mbledhjeje tjetër me Millosheviçiqin, Grupi i Punës e ndërpreu plotësisht punën e tij.²⁶⁶² Angjelkoviçiqi mbeti në Kosovë në funksionin e ri si Kryetar i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm.²⁶⁶³ Sidoqoftë, Dhoma nuk mendon se puna e Komandës së Përbashkët apo ndikimi i saj mbi veprimet e MPB-së dhe UJ-së në Kosovë u ndërpreu, siç del nga

²⁶⁵⁴ Dushko Matkoviçiq, T. 14591–14594 (29 gusht 2007); Zoran Angjelkoviçiq, T. 14653–14654 (30 gusht 2007); Millomir Miniçiq, T. 14744–14748 (31 gusht 2007).

²⁶⁵⁵ Momir Bullatoviçiq, T. 13819–13821 (16 gusht 2007); *shih gjithashtu* Dushko Matkoviçiq, T. 14589 (29 gusht 2007); Zoran Angjelkoviçiq, T. 14652 (30 gusht 2007); Millomir Miniçiq, T. 14743–14744 (31 gusht 2007).

²⁶⁵⁶ Dushko Matkoviçiq, P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 7.

²⁶⁵⁷ Dushko Matkoviçiq, P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 8.

²⁶⁵⁸ Dushko Matkoviçiq, P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 13.

²⁶⁵⁹ Dushko Matkoviçiq, T. 14638–14639 (30 gusht 2007).

²⁶⁶⁰ Millan Jovanoviçiq, T. 14163–14165 (22 gusht 2007); 2D56 (Procesverbali i Sesionit të 88-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 22 shtator 1998).

²⁶⁶¹ Millan Jovanoviçiq, T. 14166–14167 (22 gusht 2007).

²⁶⁶² Millomir Miniçiq, T. 14787–14794 (31 gusht 2007); Millan Jovanoviçiq, T. 14152 (21 gusht 2007), T. 14219–14221 (22 gusht 2007). Më 14 tetor 1998, u mbledh Komiteti Ekzekutiv i cili konkludoi se grupi i punës do të vazhdonte punën me këshillin krahinor të SPS-së për t'i shpjeguar kushtet e Marrëveshjes Millosheviçiq-Holbrooke. Kjo mbledhje u mbajt në fund të tetorit dhe ishte hera e fundit që ata të tre vepruan si grup. Millan Jovanoviçiq, T. 14168–14169 (22 gusht 2007); 2D77 (Procesverbali i Sesionit të 89-të të Komitetit Ekzekutiv të SPS-së, 14 tetor 1998), f. 3.

²⁶⁶³ Millan Jovanoviçiq, T. 14152 (21 gusht 2007).

provat e shqyrtuara më vonë në këtë pjesë, konkretisht, përmendja e Komandës së Përbashkët nga zyrtarë të lartë, urdhrat e Komandës së Përbashkët dhe së paku një mbledhje e Komandës së Përbashkët më 1999.

1011. Ministria e Drejtësisë e RFJ-së ka konfirmuar se një organ i njohur si "Komanda e Përbashkët" u formua në qershor 1998. Në një letër në përgjigje të kërkesës së Prokurorisë për të gjithë dokumentacionin në lidhje me formimin, krijimin, mandatin, përbërjen, dhe procesverbalet e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët, Ministria e Drejtësisë së RFJ-së bëri të ditur se "Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë" u formua me urdhër gojor të Presidentit të RFJ-së në vitin 1998 pa ndonjë dokument të veçantë, se funksionoi deri në tetor të atij viti, dhe se dokumentacioni në lidhje me të ishte arkivuar dhe më vonë ishte shkatërruar gjatë bombardimeve të NATO-së.²⁶⁶⁴ Dimitrijeviqi e vuri në dyshim besueshmërinë e këtij dokumenti²⁶⁶⁵ dhe Dhoma gjykon se nuk është provë e mjaftueshme në bazë të të cilës mund të nxirren konkluzione: qeveria nuk jep arsyet për konkluzionet në të dhe informatat në dokument nuk përputhen me shume prova të tjera në këtë çështje, nga të cilat Dhoma ka nxjerrë konkluzionet e saj përfundimtare në lidhje me Komandën e Përbashkët në vitet 1998 dhe 1999.

b. Mbledhjet në vitin 1999 dhe përpilimi i planeve të përmasave të mëdha

1012. Ka shumë pak prova për mbledhjet në Beograd në vitin 1999 për diskutimin e planeve për shtypjen e "terrorizmit." Dy plane të përmasave të mëdha -- *Grom 3* dhe *Grom 4* -- u përgatitën brenda UJ-së në fillim të vitit dhe në prill 1999. Sidoqoftë, nga këto plane del se "armiku" i UJ-së në atë kohë ka qenë NATO e jo forcat "terroriste".

1013. Më 16 janar 1999, Ojdaniqi lëshoi direktivën *Grom 3* për "angazhimin e UJ-së në parandalimin e hyrjes me forcë të një brigade shumëkombëshe të NATO-s në Kosovë." Në paragrafin e parë të direktivës shkruhet si vijon: "Përkeqësimi i gjendjes politike dhe ushtarake në Kosovë, akuzat kundër RFJ-së se nuk po i përmbush detyrimet në pajtim me marrëveshjet e arritura, pretendimet shpifëse për rrezikun që i kanoset verifikuesve, dhe njëkohësisht sulmet e shtuara të forcave terroriste në Kosovë kundër njësisive të UJ-së dhe të MPB-së mund të bëhen motiv që NATO-ja të fusë një brigadë shumëkombëshe me forcë nga Maqedonia në Kosovë." Në direktivë parashtroheshin detyrat që duhej të zbatoheshin në dy faza: qëllimi i fazës së parë ishte të parandalohej hyrja e NATO-s në Kosovë, kurse objektivi i fazës së dytë ishte eliminimi i NATO-s

²⁶⁶⁴ P1317 (Përgjigje e Ministrisë së Drejtësisë së RFJ-së ndaj Kërkesës së Prokurorit të Tribunalit (KPN) nr. RFJ-174, 12 korrik 2002).

²⁶⁶⁵ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26618–26619 (8 korrik 2008).

dhe forcave "terroriste." Forcat e UJ-së duhej të vepronin në bashkëpunim me forcat e MPB-së gjatë zbatimit të këtyre detyrave.²⁶⁶⁶

1014. Më 27 janar 1999, Pavkoviqi lëshoi urdhrin *Grom 3* të Armatës së 3-të për përdorimin e Armatës së 3-të në parandalimin e hyrjes së brigadës së NATO-s nga Maqedonia në Kosovë në sektorin e Duhlës, Drenicës, dhe Llapit. Dy fazat e përmendura në direktivën e Ojdaniqit ishin të detajuara.²⁶⁶⁷ Më 1 shkurt 1999, Pavkoviqi lëshoi një urdhër që përmbante "masat për parandalimin e sulmeve të befasishme dhe për mbajtjen e nivelit të urdhëruar të gatishmërisë luftarake." Për shembull, Komandat e Korpusit të Prishtinës kishin marrë udhëzim të përgatisnin plane për mbylljen e rrugëve nga Shqipëria në Kosovë, "përmes të cilave mund të hyjnë forcat sabotatore dhe terroriste." Një nga masat konkrete që duhej të merrej nga Komanda e Korpusit ishte që të "hartonte një plan për bllokimin dhe shkatërrimin e forcave terroriste shqiptare në sektorët e Drenicës, Llapit, dhe Malishevës."²⁶⁶⁸ Plani ishte që të "sigurohej bashkërendimi i plotë me njësitë e MPB-së."²⁶⁶⁹ Afati i fundit për zbatimin e këtij urdhri ishte 15 shkurt 1999.²⁶⁷⁰

1015. Më 7 shkurt 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës lëshoi urdhrin e saj *Grom 3* për të gjitha njësitë e Korpusit.²⁶⁷¹ Llazareviqi shpjegoi se plani *Grom 3* ishte "plan për mbrojtjen e integritetit të vendit."²⁶⁷² Më 16 shkurt 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës lëshoi një urdhër për eliminimin e forcave "terroriste" shqiptare në sektorët e Llapit, Drenicës, dhe Malishevës.²⁶⁷³ Urdhri rendiste detyrat që duhej të kryheshin nga njësitë e Korpusit të Prishtinës në bashkërendim me forcat e MPB-së.²⁶⁷⁴ Aty nuk përcaktohej "gatishmëria" për operacione.²⁶⁷⁵ Llazareviqi dëshmoi se kur ishte përgatitur urdhri i shkurtit në Komandën e Korpusit të Prishtinës, "organet operative të Komandës

²⁶⁶⁶ 3D690 (Urdhër i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së për angazhimin e UJ-së, Urdhri *Grom 3*, 16 janar 1999).

²⁶⁶⁷ 5D245 (Urdhri *Grom 3* i Komandës së Armatës së 3-të, 27 janar 1999), f. 3, 5–7. Urdhri përfshinte detyra për PrK-në, duke saktësuar, në mes të tjerash, se në fazën e parë, PrK-ja duhej të "vazhdonte forcimin në thellësi të kufirit shtetëror me Shqipërinë dhe Maqedoninë, të parandalonte hyrjen e brigadës së NATO-s nga sektorët e Shkupit, Kumanovës, dhe Tetovës në sektorët e Duhlës, Drenicës, dhe Llapit," dhe në fazën e dytë duhej të "parandalonte infiltrimin e forcave sabotatore dhe terroriste nga Republika e Shqipërisë, të thyente dhe shkatërronte brigadën e NATO-s dhe forcat terroriste shqiptare në Kosovë " në bashkëpunim me forcat e MPB-së.

²⁶⁶⁸ 5D249 (Urdhër i Armatës së 3-të, 1 shkurt 1999), f. 1–2. *Shih gjithashtu* Vladimir Llazareviq, T. 17901–17902, 17905–17906 (8 nëntor 2007).

²⁶⁶⁹ 5D249 (Urdhër i Armatës së 3-të, 1 shkurt 1999), f. 2.

²⁶⁷⁰ 5D249 (Urdhër i Armatës së 3-të, 1 shkurt 1999), f. 2. Llazareviqi dëshmoi se Komanda e Korpusit kishte marrë në fakt urdhër që të "hartojë plane të përgjithshme pa dhënë datat se kur do të kryheshin këto aksione." Vladimir Llazareviq, T. 18200 (13 nëntor 2007).

²⁶⁷¹ Vladimir Llazareviq, T. 17905 (8 nëntor 2007).

²⁶⁷² Vladimir Llazareviq, T. 17905 (8 nëntor 2007).

²⁶⁷³ P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999).

²⁶⁷⁴ P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999), f. 4; Vladimir Llazareviq, T. 17907 (8 nëntor 2007).

²⁶⁷⁵ P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999), f. 6. Llazareviqi konfirmoi se, në këtë urdhër të 16 shkurtit 1999, Komanda e PrK-së urdhërohej që të shtypte dhe shkatërronte forcat terroriste shqiptar në vendet e saktësuar, por "duke mos saktësuar kohen kur duhet të hyjë në veprim plani." Sipas Llazareviqit, plani "duhej të hynte në veprim pas marrjes së sinjalit dhe urdhrin të posaçëm." Vladimir Llazareviq, T. 18558 (19 nëntor 2007); T. 17908–17909 (8 nëntor 2007).

së Korpusit ia arritën të koordinonin me personat në MPB të përfshirë në planifikim për të pasur koordinim dhe veprime të koordinuara."²⁶⁷⁶ Në lidhje me këtë Dhoma Gjyqësore thekson se më 17 shkurt 1999, një ditë pasi Komanda e Korpusit të Prishtinës kishte lëshuar urdhrin *Grom 3*, Llukiqi deklaroi në një mbledhje të Shtabit të MPB-së se Shtabi i MPB-së kishte "planifikuar ... të kryente tri operacione spastrimi në zonat e Podujevës, Dragobilit, dhe Drenicës," por priste urdhër për zbatimin.²⁶⁷⁷ Tri zonat e përmendura nga Llukiqi ishin në thelb të njëjtat të cilat përmenden në urdhrin e Korpusit të Prishtinës *Grom 3*. Për më tepër, Dhoma thekson se në urdhrin *Grom 3* Korpusi i Prishtinës udhëzonte njësitë vartëse të vepronin në bashkërendim me njësi të caktuara të MPB-së, konkretisht me PJP-në e 22-të, PJP-në e 35-të, PJP-në e 37-të, SAJ-në, dhe JSO-në.²⁶⁷⁸ Dhoma Gjyqësore gjykon se këto prova tregojnë se UJ-ja dhe MPB-ja komunikuan dhe shkëmbyen informata gjatë përpilimit të planit, në bazë të të cilit do të kryeshin tri operacione të mëdha në zonat e Llapit, Drenicës, dhe Malishevës.

1016. Gjithashtu, provat tregojnë se gjithashtu MPB-ja kishte përgatitur plane për aksione "antiterroriste" në fillim të vitit 1999. Në një mbledhje të Shtabit të MPB-së më 21 dhjetor 1998, Obrad Stevanoviqi deklaroi se duhej të planifikoheshin "aksione më të gjera kundër bazave terroriste" nga Shtabi i MPB-së.²⁶⁷⁹ Gjithsesi ai theksoi se iniciativa duhej t'i lihej SPB-ve, të cilat duhej të "bënin përgatitje dhe të përpilonin rekomandime për Planin e Veprimit."²⁶⁸⁰ Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së mbajtur më 17 shkurt 1999 në Prishtinë tregon se "detyrat dhe veprimet" në lidhje me aksionet antiterroriste ishin përcaktuar në "mbledhjet vjetore."²⁶⁸¹

1017. Rrjedhimisht periudha nga janari deri në fillim të marsit 1999 iu dedikua planifikimit të operacioneve të mëdha të përbashkëta të UJ /MPB-së që u kryen duke filluar nga fundi i marsit 1999.²⁶⁸² Operacionet kryesore të përbashkëta që u kryen ishin në zonat e Podujevës,²⁶⁸³ Llapit,²⁶⁸⁴

²⁶⁷⁶ Vladimir Llazareviq, T. 17917 (8 nëntor 2007). Sipas Llazareviqit, ka pasur "bashkërendim në përgatitjet për kryerjen e detyrës së shkatërrimit të forcave kryengritëse të armatosura në tri vendet e përmendura në urdhrin *Grom 3*", T. 17918–17919.

²⁶⁷⁷ P1990 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999), f. 1. Në këtë mbledhje ndër të tjerë morën pjesë, edhe Llukiqi, Vllajko Stojilkoviqi, Vlastimir Gjorgjeviqi, Rade Markoviqi, Obrad Stevanoviqi, anëtarët e Shtabit të MPB-së në Prishtinë, të gjithë shefat e SPB-së, si dhe komandantët e PJP-ve dhe të SAJ-it.

²⁶⁷⁸ P2808 (Urdhër i PrK-së, 16 shkurt 1999).

²⁶⁷⁹ P1991 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 21 dhjetor 1998), f. 10.

²⁶⁸⁰ P1991 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 21 dhjetor 1998), f. 10.

²⁶⁸¹ P1990 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999), f. 1.

²⁶⁸² P2067 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 9 mars 1999); P2072 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 16 mars 1999); 6D1465 (Urdhër i Brigadës së 243-të të Motorizuar, 21 mars 1999); 6D1466 (Raport Luftarak i Brigadës së 243-të të Mekanizuar dërguar PrK-së, 24 mars 1999). Në lidhje me operacionin në Jeshkovë, Deliqi dëshmoi se e kishte lëshuar urdhrin e 9 marsit 1999 duke u bazuar në një urdhër që kishte marrë nga Llazareviqi po atë ditë. Bozhidar Deliq, T. 19541–2, 19550 (5 dhjetor 2007). *Shih gjithashtu* K54, P2676 (deklaratë dëshmitari e datës 26 prill 2002) f. 5 (e mbyllur me vulë), T. 10504–10505 (seancë private) (26 shkurt 2007); K82, P2315 (deklaratë dëshmitari e datës 14 shtator 2006), para. 6 (e mbyllur me vulë), T. 11747 (15 mars 2007).

²⁶⁸³ P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999); 5D1357 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 25 mars 1999).

Drenicës së Poshtme,²⁶⁸⁵ Rahovecit, Suharekës, Krushës së Madhe,²⁶⁸⁶ Drenicës,²⁶⁸⁷ dhe në zonën e përgjithshme të Malishevës.²⁶⁸⁸ Më 2 prill 1999, njësitë e Korpusit të Prishtinës u urdhëruan që t'i mbështesnin forcat e MPB-së në thyerjen dhe shkatërrimin e forcave "terroriste" shqiptare në sektorin e Jabllanicës.²⁶⁸⁹ Këto zona përkrijnë me tre sektorë më të mëdhenj të përmendur në urdhrin e Komandës së Korpusit të Prishtinës të 16 shkurtit 1999, si dhe atyre të përmendura nga Llukiqi gjatë mbledhjes së 17 shkurtit 1999. Urdhrat për këto operacione të përbashkëta mbanin emërtimin e Komandës së Përbashkët dhe ishin të panëshkruara. Planifikimi i disa prej këtyre urdhrave si dhe çështja e Komandës së Përbashkët do të diskutohen më vonë.²⁶⁹⁰

1018. Në prill 1999, u hartua një tjetër plan i përmasave të mëdha. Më 9 prill 1999, Shtabi i Komandës së Lartë lëshoi një urdhër "për angazhimin e UJ-së në mbrojtje kundër agresionit të NATO-s."²⁶⁹¹ Më 10 prill 1999, Komanda e Armatës së 3-të lëshoi urdhrin *Grom 4*.²⁶⁹² Duket se urdhri i lëshuar nga Ojdaniqi më 9 prill 1999 ishte direktiva *Grom 4*, sepse urdhri i Komandës së Armatës së 3-të reflektonte formulimin e direktivës. Më 12 prill 1999, Shtabi i Komandës së Lartë e ndryshoi direktivën *Grom 4*. Një nga ndryshimet e bëra ishte përfshirja e një paragrafi ku përcaktohej se forcat e MPB-së dhe mbrojtjes civile do të viheshin nën komandën e Armatës së 3-të.²⁶⁹³ Çështja e ndërrimit të varësisë do të shqyrtohet në më shumë hollësi në Nënpjesën VI.E.3 më poshtë.

²⁶⁸⁴ P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999).

²⁶⁸⁵ P2031 (Vendim i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999); P2042 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 23 mars 1999), f. 1.

²⁶⁸⁶ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999); P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999); P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999); 5D1357 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 25 mars 1999).

²⁶⁸⁷ P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999); P2043 (Raport Luftarak i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 25 mars 1999). *Shih gjithashtu* P2045 (Raport Operativ i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 27 mars 1999); P2046 (Raport Luftarak i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 28 mars 1999); P2616 (Ditari i Luftës i Brigadës së 125-të të Motorizuar), f. 1-9; P2042 (Raport Luftarak i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 23 mars 1999); 5D343 (Urdhër i PrK-së që kërkon raporte luftarake nga njësitë e UJ-së, 29 mars 1999), f. 1; 5D1357 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 25 mars 1999); 5D1358 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 26 mars 1999).

²⁶⁸⁸ P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999). *Shih* P1446 (Dokument i Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Komandës së Lartë, 30 mars 1999); P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 29 mars 1999); P2035 (Raport Luftarak i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 30 mars 1999); 4D371 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 1 prill 1999); P2002 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999).

²⁶⁸⁹ P2003 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 2 prill 1999), f. 1; 5D84 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 3 prill 1999); 5D85 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 4 prill 1999).

²⁶⁹⁰ *Shih* Nënpjesën VI.E.2.

²⁶⁹¹ P1481 (Urdhër i Komandës së Lartë për angazhimin e UJ-së në mbrojtje kundër NATO-s, 9 prill 1999).

²⁶⁹² 4D308 (Urdhër i Armatës së 3-të për mbrojtje nga NATO, 10 prill 1999).

²⁶⁹³ P1483 (Plotësues i direktivës së 9 prillit 1999, 12 prill 1999), f. 1.

1019. Mirëpo Komanda e Korpusit të Prishtinës e kishte lëshuar urdhrin *Grom 4* tri ditë para direktivës *Grom 4* të Ojdaniqit.²⁶⁹⁴ Më 3 prill, Komanda e Armatës së 3-të urdhëroi komandantët e Korpuseve dhe disa komandantë të tjerë të përpilonin dhe lëshonin një vendim "për angazhimin e forcave kryesore dhe dytësore për mbrojtje nga agresioni kundër RFJ-së në zonat e tyre të përgjegjësisë."²⁶⁹⁵ Qëllimi i këtij urdhri ishte që masat "për organizimin e mbrojtjes të merreshin menjëherë" duke pasur parasysh "rrezikun e agresionit të afërt kundër RFJ-së nga forcat tokësore të NATO-s."²⁶⁹⁶ Pavkoviqi shpjegoi se do t'i miratonte vendimet e komandantëve më 5 prill "pasi të informohej për to."²⁶⁹⁷ Komanda e Korpusit të Prishtinës e përgatiti vendimin e saj dhe e informoi komandantin e Armatës së 3-të në mbledhjen e mbajtur më 5 prill.²⁶⁹⁸ Gjatë mbledhjes u caktuan disa detyra.²⁶⁹⁹ Të nesërmen, duke u bazuar në çfarë ishte vendosur gjatë mbledhjes, komandanti i Korpusit të Prishtinës lëshoi urdhrin *Grom 4*.²⁷⁰⁰ Duket sikur Korpusi i Prishtinës e ka lëshuar urdhrin e tij para se të merrte urdhrin nga Komanda e Armatës së 3-të sepse gjatë mbledhjes së 5 prillit ishte shpjeguar se kryerja e detyrave duhej "të fillonte menjëherë."²⁷⁰¹ Sipas urdhrin *Grom 4* të Komandës së Korpusit të Prishtinës, njësitë e UJ-së në bashkëpunim me njësitë e MPB-së duhej t'i "shkaktojnë dëme forcave agresore të NATO-s," "parandalojnë depërtimin e tyre të shpejtë në thellësi të Kosovës," "të kalojnë në kundërsulm," dhe "t'i dëbojnë nga territori i Kosovës."²⁷⁰² Llazareviqi shpjegoi se plani *Grom 4* ishte "një tjetër plan i ndërlikuar për operacione mbrojtëse i kryer nga Korpusi,"²⁷⁰³ me fjalë të tjera, "Korpusi i Prishtinës në kohë lufte u ndodh në qendër të strategjisë për mbrojtjen e vendit."²⁷⁰⁴

1020. Disa orë para lëshimit të direktivës së 9 prillit, Ojdaniqi kishte udhëzuar Komandën e Armatës së 3-të që të përgatiste një propozim për të marrë vendim për parandalimin e agresionit me dy "opsione" konkrete dhe t'ia paraqiste këtë propozim Shtabit të Komandës së Lartë deri më 10

²⁶⁹⁴ 5D175 (Urdhër i PrK-së, 6 prill 1999).

²⁶⁹⁵ 4D360 (Urdhër i Postëkomandës Pararojë të Armatës së 3-të, 3 prill 1999), f. 1, gjithashtu e pranuar si 5D361.

²⁶⁹⁶ 4D360 (Urdhër i Postëkomandës Pararojë të Armatës së 3-të, 3 prill 1999), f. 1, gjithashtu e pranuar si 5D361.

²⁶⁹⁷ 4D360 (Urdhër i Postëkomandës Pararojë të Armatës së 3-të, 3 prill 1999), f. 1, gjithashtu e pranuar si 5D361. Pavkoviqi saktësoi se mbledhja duhej të fillonte në mëngjes por nuk ishte caktuar vendi i takimit. Komandantët duhej të përpilonin vendimin dhe hartën dhe t'i jepnin një kopje të dy dokumenteve Postëkomandës Pararojë të Armatës pas takimit.

²⁶⁹⁸ 5D366 (Urdhër i PrK-së në lidhje me detyrat e organizimit të mbrojtjes, 5 prill 1999); 4D254 (Urdhër i PrK-së në lidhje me masat për mbrojtjen e RFJ-së nga agresioni, 10 prill 1999). Urdhri i 5 prillit 1999 i referohej konkretisht "takimit me Komandantin e Armatës së 3-të për organizimin e mbrojtjes."

²⁶⁹⁹ 5D366 (Urdhër i PrK-së në lidhje me detyrat e organizimit të mbrojtjes, 5 prill 1999).

²⁷⁰⁰ 5D175 (Urdhër i PrK-së, 6 prill 1999).

²⁷⁰¹ 5D366 (Urdhër i PrK-së në lidhje me detyrat për organizimin e mbrojtjes, 5 prill 1999); Vladimir Llazareviq, T. 17986–17987 (9 nëntor 2007).

²⁷⁰² 5D175 (Urdhër i PrK-së, 6 prill 1999), f. 4.

²⁷⁰³ Vladimir Llazareviq, T. 17957 (8 nëntor 2007).

²⁷⁰⁴ Vladimir Llazareviq, T. 17957 (8 nëntor 2007).

prill 1999.²⁷⁰⁵ Komanda a Armatës së 3-të duhej të propozonte një vendim për dy situata: (a) "agresionin e forcave terroriste shqiptare të cilat momentalisht janë në vendet fqinje dhe të cilat shfrytëzojnë refugjatët dhe mbështetjen e forcave të NATO-s, në bashkëpunim me forcat terroriste brenda në Kosovë;" dhe (b) "agresionin e NATO-s me aktivizimin e kryengritjes së armatosur të forcave terroriste shqiptare të mbetura dhe të infiltuara, gjithashtu duke shfrytëzuar refugjatët." Urdhri i Ojdaniqit bënte të ditur se raporti mbi propozimin do të paraqitej më 11 prill 1999 në Shtabin e Komandës së Lartë, në prani të Kryekomandantit.²⁷⁰⁶ Ojdaniqi tha se, pasi kishte studiuar propozimin, Shtabi i Komandës së Lartë kishte vërejtur disa mangësi në të. Rrjedhimisht, Komanda a Armatës së 3-të u udhëzua që të ndryshonte propozimin në pajtim me rekomandimet e bëra dhe të paraqiste "projektplanin për studim" ditën e nesërme. Ojdaniqi shtoi se do të mbahej një takim në orën 09:00 me "Komandën e Lartë."²⁷⁰⁷ Në mbledhjen e Shtabit të Komandës së Lartë më 12 prill, Millosheviqi dha "një detyrë konkrete në lidhje me thyerjen e grupeve të mbetura të forcave terroriste shqiptare" dhe udhëzoi që "në shtatë ditës e ardhshme, në kryerjen e këtyre detyrave duhet të angazhohen vetëm JSO dhe SAJ."²⁷⁰⁸

1021. Provat tregojnë se edhe MPB-ja hartoi plane të aksioneve në fillim të prillit 1999. Më 4 prill 1999, u mbajt një mbledhje në të cilën morën pjesë Obrad Stevanoviqi, Llukiqi, të gjithë shefat e SPB-ve të Kosovës, komandantët e PJP-ve, dhe komandantët e SAJ-së dhe JSO-së. Stevanoviqi urdhëroi që të përgatiteshin "planet mbi mënyrën e kontrollimit të territorit." Gjithashtu ai udhëzoi për "bashkëpunim me UJ-në nëpërmjet komandantëve në terren."²⁷⁰⁹ Për më tepër, sipas një dokumenti të lëshuar nga Komanda e Korpusit të Prishtinës më 9 prill 1999, Shtabi i MPB-së "u dërgoi një urdhër të gjitha Sekretariateve të Brendshme të fillonin planifikimin e aksioneve për thyerjen e grupeve terroriste që kishin mbetur në zonat e tyre përkatëse të përgjegjësisë."²⁷¹⁰

1022. Në zonën e Kosmaçit,²⁷¹¹ sektorët e Zhegofcit,²⁷¹² Drenicës,²⁷¹³ Orllanit-Zllasit,²⁷¹⁴ Çiçavicës,²⁷¹⁵ Jezercës,²⁷¹⁶ Rugovës,²⁷¹⁷ zonën e Bajgorës-Bares,²⁷¹⁸ dhe sektorit të Zatriqit²⁷¹⁹ u

²⁷⁰⁵ P1480 (Urdhër për përgatitjen e planeve për mbrojtje nga agresioni terrorist, 9 prill 1999).

²⁷⁰⁶ P1480 (Urdhër për përgatitjen e planeve për mbrojtje nga agresioni terrorist, 9 prill 1999).

²⁷⁰⁷ 3D728 (Informim i Shtabit të Komandës së Lartë, 11 prill 1999), f. 3.

²⁷⁰⁸ 4D420 (Raport i Pavkoviqit dërguar Shtabit të Komandës së Lartë në lidhje me ndryshimin e varësisë së MPB-së, 20 prill 1999), f. 1.

²⁷⁰⁹ P1989 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 4 prill 1999), f. 4.

²⁷¹⁰ 5D476 (Urdhër i Komandës së PrK-së, 9 prill 1999), f. 1. *Shih* Vladimir Llazareviq, T. 18007 (9 nëntor 2007); Radojko Stefanoviq, T. 21702–21771 (5 shkurt 2008).

²⁷¹¹ P1970 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 9 prill 1999).

²⁷¹² P1971 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 13 prill 1999).

²⁷¹³ P1972 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 14 prill 1999).

²⁷¹⁴ P1973 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 14 prill 1999).

²⁷¹⁵ P1974 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); 5D1023 (Raport Luftarak i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 19 prill 1999).

kryen disa operacione të përbashkëta nga mesi i prillit 1999. Duket se këto operacione të përbashkëta u kryen në zbatim të planeve të përpiluara nga MPB-ja dhe UJ-ja në fillim të prillit 1999. Urdhrat për këto operacione të përbashkëta mbanin emërtimin “Komanda e Përbashkët” dhe ishin të panëshkruara.

1023. Nën pjesa vijuese tregon se gjatë planifikimit dhe zbatimit të operacioneve të përbashkëta të kryera në fund të marsit dhe në fillim të prillit 1999, ekzistonte një nivel i lartë bashkërendimi dhe bashkëpunimi midis UJ-së dhe MPB-së.

2. Bashkërendimi midis UJ-së dhe MPB-së në lidhje me operacionet luftarake

a. Sistemi i bashkërendimit në përgjithësi

1024. Disa dëshmitarë dëshmuar në gjyq mbi sistemin e bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis UJ-së dhe MPB-së, që u krijua për planifikimin dhe zbatimin e operacioneve të përbashkëta në 1998. Sistemi i bashkërendimit dhe bashkëpunimit funksionoi deri në vitin 1999.

i. Bashkërendimi i planifikimit të operacioneve të përbashkëta të UJ/MPB-së

(A) Bashkërendimi në vitin 1998

1025. Bashkërendimi dhe bashkëpunimi midis UJ-së dhe MPB-së filloi që në prill dhe maj të vitit 1998.²⁷²⁰ Gjithsesi, nuk funksiononte mirë: siç është shpjeguar më lart, më 13 maj 1998, Samarxhiqin e informuan për problemet gjatë veprimeve luftarake për shkak të mungesës së bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis UJ-së dhe MPB-së. Pasi marrjes së këtyre të dhënave, Samarxhiqi "autorizoi gjeneral Simiqin dhe gjeneral Pavkoviqin si protagonistë të bashkërendimit dhe bashkëpunimit në Kosovë."²⁷²¹ Pas kësaj, u bënë përpjekje për të përmirësuar sistemin e bashkërendimit gjatë planifikimit dhe zbatimit të operacioneve të përbashkëta.²⁷²²

²⁷¹⁶ P1976 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999).

²⁷¹⁷ P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); 5D194 (Informacion i Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 15 prill 1999); 5D1411 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të dhe Shtabit të Komandës së Lartë, 19 prill 1999); P2016 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të dhe Shtabit të Komandës së Lartë, 25 prill 1999).

²⁷¹⁸ P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); P2619 (Pjesë nga Ditari i Luftës i Brigadës së 15-të të Blinduar), f. 10, 13–15; P2572 (Pjesë nga Ditari i Luftës së Brigadës së 15-të të Blinduar), f. 57, 61–62; 5D220 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të dhe Shtabit të Komandës së Lartë, 1 maj 1999); P1977 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 16 prill 1999).

²⁷¹⁹ P1977 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 16 prill 1999).

²⁷²⁰ Millan Gjakoviq, T. 26373 (19 maj 2008).

²⁷²¹ Millan Gjakoviq, T. 26411 (19 maj 2008).

²⁷²² Millan Gjakoviq, T. 26388 (19 maj 2008).

1026. Gjakoviqi ishte personi brenda Komandës së Korpusit të Prishtinës i cili ishte përgjegjës për mundësimin e bashkërendimit midis UJ-së dhe MPB-së gjatë operacioneve luftarake. Më 20 janar 1999, ai u zëvendësua nga Radojko Stefanoviqi.²⁷²³ Gjakoviqi mori pjesë në mbledhjet bashkërenduese me organet e MPB-së në vitin 1998, të zhvilluara në ndërtesën e Komandës së Korpusit dhe në "ndërtesën e MPB-së."²⁷²⁴ Më së shpeshti Gjakoviqi u takua me Dushko Adamoviqin, oficer i shtabit të MPB-së i cili nga korriku 1998 deri më 29 mars 1999 punoi si ndihmës i Llukiqit.²⁷²⁵ Gjakoviqi dëshmoi se, gjatë mbledhjeve mbi bashkërendimin, Adamoviqi dhe Obrad Stevanoviqi kishin marrë pjesë në përpilimin e planeve për operacione të përbashkëta duke bërë të ditur, në mes të tjerash, se cilat njësi do të përdoreshin gjatë operacioneve.²⁷²⁶ Jo vetëm që Adamoviqi i dha Gjakoviqit informata mbi madhësinë numerike dhe vendndodhjen e forcave të MPB-së, por gjithashtu roli i tij dhe i organeve të MPB-së ishin vendimtarë në planifikimin dhe bashkërendimin e operacioneve.²⁷²⁷

1027. Adamoviqi konfirmoi dëshminë e Gjakoviqit duke shpjeguar se kishte luajtur rol në vendosjen e komunikimit midis MPB-së dhe UJ-së kur kishte punuar në Shtabin e MPB-së.²⁷²⁸ Konkretisht, ai dëshmoi se i kishte dhënë informata UJ-së për njësitë që do të merrnin pjesë në operacione; gjithsesi ai e konsideronte rolin e vet në zbatimin e këtyre detyrave "dytësor."²⁷²⁹ Ai gjithashtu theksoi se shtabi i MPB-së nuk kishte marrë pjesë në planifikimin dhe zbatimin e aksioneve antiterroriste. Sipas mendimit të tij, këtë e kishte bërë Korpusi i Prishtinës.²⁷³⁰ Dhoma Gjyqësore nuk e pranon këtë thënie dhe gjykon se duke i dhënë Komandës së Korpusit të Prishtinës informata për njësitë e MPB-së që do të merrnin pjesë në operacionet e përbashkëta, Shtabi i MPB-së ka marrë pjesë në planifikimin e këtyre operacioneve. Për më tepër, Dhoma Gjyqësore vë në

²⁷²³ Millan Gjakoviq, T. 26388 (19 maj 2008).

²⁷²⁴ Millan Gjakoviq, T. 26383; T. 26394 (19 maj 2008). Gjatë dëshmisë së tij në gjykatë, Gjakoviqi bëri dallimin midis këtyre mbledhjeve bashkërenduese dhe mbledhjeve të cilat ai i quajti "Mbledhje të Komandës së Përbashkët për Kosovën", të mbajtura nga 22 korriku deri më 30 tetor 1999. Millan Gjakoviq, T. 26383 (19 maj 2008).

²⁷²⁵ Dushko Adamoviq, T. 24967–24968 (8 prill 2008). Adamoviqi dëshmoi se e kishte lënë postin në Shtabin e MPB-së sepse ishte plagosur.

²⁷²⁶ Millan Gjakoviq, T. 26397 (19 maj 2008). Dhoma konkludon se, edhe pse Gjakoviqi përmendi "Obrad Stojanoviqin" në këtë pikë të dëshmisë së tij (T. 26397), ai e kishte fjalën për "Obrad Stevanoviqin", meqenëse më vonë e përmendi Obrad Stevanoviqin kur fliste për të njëjtën çështje (T. 26394). Për më tepër, Stevanoviqi, i cili e zëvendësoi Gjakoviqin në janar 1999, dëshmoi se një nga personat me të cilët kishte punuar në vitin 1999 ishte Obrad Stevanoviqi, Radojko Stefanoviqi. T. 21684–T. 21689 (5 shkurt 2008).

²⁷²⁷ Millan Gjakoviq, T. 26397 (19 maj 2008).

²⁷²⁸ Dushko Adamoviq, T. 24978 (8 prill 2008). Ai kujtoi se ishte "emëruar si përfaqësues i Shtabit që të mbante kontakte me Korpusin e Prishtinës para se të fillonin aksionet". Konkretisht ai dëshmoi se udhëzimet e dhëna nga Llukiqi ishin që "ai të shkojë kohë pas kohe te kolonel Gjakoviqi dhe të dorëzojë informata për njësitë që ishin në territorin e Kosovës me qëllim planifikimin e zbatimit të aksioneve antiterroriste." T. 25065 (9 prill 2008).

²⁷²⁹ Dushko Adamoviq, T. 25063, T. 25067, T. 25071, T. 25077, T. 25087 (9 prill 2008), T. 25097 (10 prill 2008), T. 24979–24980 (8 prill 2008). Mijatoviqi i përshkroi detyrat e Adamoviqit thjesht si dhënie informatash për vendndodhjen e njërive të caktuara sipas mesazheve të lëshuara pas çdo mobilizimi. Miroslav Mijatoviq, T. 22326–22330 (13 shkurt 2008), T. 22439–22442; T. 22446 (14 shkurt 2008).

²⁷³⁰ Dushko Adamoviq, T. 24981 (8 prill 2008), 6D1613 (deklaratë dëshmitari e datës 30 mars 2008), para. 17, 31.

dukje dëshminë e Adamoviçit se, para se të kryheshin operacionet, ishin mbajtur mbledhje në Shtabin e MPB-së, gjatë të cilave UJ-ja dhe MPB-ja kishin diskutuar planin për kryerjen e aksioneve "antiterroriste." Ai shtoi se kjo kishte qenë "bazë për aksione të mëtejshme të oficerëve të cilët ishin në terren dhe të cilët kishin qenë të angazhuar për këtë."²⁷³¹ Rrjedhimisht dëshmia e Adamoviçit tregon se Shtabi i MPB-së u përfshi në planifikimin e operacioneve të përbashkëta. Gjithashtu, megjithëse Adamoviçi këmbënguli se Shtabi i MPB-së nuk kishte qenë i përfshirë në planifikimin e operacioneve të përbashkëta, ai nuk iu përgjigj pyetjes se a kishin qenë organet e MPB-së të përfshira në këtë planifikim. Në lidhje me këtë, Dhoma Gjyqësore merr parasysh dëshminë e Gjakoviçit se gjatë përgatitjes së planeve ai bashkëpunoi jo vetëm me Adamoviçin, por gjithashtu edhe me Stevanoviçin.

1028. Gjakoviçi shpjegoi se në korrik 1998, pasi kishte marrë pjesë në një mbledhje bashkërenduese me përfaqësuesit e MPB-së, ai u ngarkua me detyrën e përpilimit të një urdhri për kodifikimin e marrëdhënieve midis MPB-së dhe UJ-së. Meqenëse e kishte të paqartë kryerjen e kësaj detyrë, ai pyeti Pavkoviçin, i cili i tha që në urdhër të përdorte shprehjen "Komanda e Përbashkët."²⁷³² Ky urdhër u lëshua më 6 korrik 1998 dhe mbante emërtimin "Komanda e Përbashkët".²⁷³³ Gjakoviçi tha se përmendja e Komandës së Përbashkët në urdhrin e 6 korrikut duhej të kuptohej si "autorizim për njësitë vartëse të UJ-së që të bashkërendojnë disa veprime me MPB-në."²⁷³⁴ Gjithashtu, Gjakoviçi dëshmoi se urdhri i 6 korrikut nuk iu dërgua MPB-së, por ia merrte mendja se "Llukiçi duhej ta kishte standardizuar disi mënyrën e informimit të organeve të tij mbi planet për operacione të përbashkëta ... ishin bashkërenduar nga ndihmësit e tij."²⁷³⁵ MPB-ja dhe njësitë vartëse të UJ-së duhej të informoheshin se "të dy komandat ishin pajtuar për detyrat e dy segmenteve" para se të fillonin zbatimin e operacioneve të përbashkëta.²⁷³⁶ Sipas Gjakoviçit, shprehja "Komanda e Përbashkët" ishte "term i brendshëm fiktiv" që përdorej nga Pavkoviçi dhe ai vetë për "krijimin e dokumenteve të bashkërendimit me MPB-në, sepse MPB-ja nuk mundte dhe nuk donte të pranonte asnjë dokument nëse përmbante shprehjen 'Komanda e Korpusit të

²⁷³¹ Dushko Adamoviç, T. 24974–24975 (8 prill 2008).

²⁷³² Millan Gjakoviçi, T. 26381 (19 maj 2008).

²⁷³³ *Shih* P2113 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar në Lidhje me Ndalimin e Operacioneve pa Dijeninë dhe Miratimin e Komandës së Përbashkët për Kosovën, 7 korrik 1998) (i referohet "Urdhrit të Komandës së Përbashkët për Kosovën" i 6 korrikut 1998).

²⁷³⁴ Millan Gjakoviçi, T. 26434 (19 maj 2008). Ai shtoi se "pa këtë urdhër për bashkërendim, njësitë vartëse të UJ-së nuk mund të kryenin aksione luftarake në atë mënyrë." Gjakoviçi gjithashtu i kishte shpjeguar komandantëve në njësitë vartëse të UJ-së se dokumentet që përmbanin referenca të tilla përdorëshin në vend të planeve bashkërenduese. T. 26435 (19 maj 2008).

²⁷³⁵ Millan Gjakoviçi, T. 26435, 26380 (19 maj 2008); Bozhidar Deliq, T. 19499 (4 dhjetor 2007). Deliqi dëshmoi se e kishte ditur se homologu i tij në operacionet e përbashkëta në MPB kishte marrë të njëjtin dokument që kishte marrë edhe ai. Mirëpo më vonë në dëshminë e tij ai tha se, edhe pse kishin marrë të njëjtën pjesë të hartës, ai nuk e dinte se "çfarë dokumenti" kishte MPB-ja. Bozhidar Deliq, T. 19659–19660 (6 dhjetor 2007).

²⁷³⁶ Millan Gjakoviçi, T. 26436 (19 maj 2008).

Prishtinës."²⁷³⁷ Ai shpjegoi se këto dokumente ku përmendej Komanda e Përbashkët ishin përdorur si alternativë e frazës "plane bashkërenduese".²⁷³⁸ Lazareviqi dëshmoi se Komanda e Përbashkët ishte në fakt shprehje e menduar nga Korpusi i Prishtinës dhe ishte përdorur si formulim për të siguruar bashkëpunimin midis UJ-së dhe MPB-së.²⁷³⁹

1029. Megjithëse Gjakoviqi dëshmoi se urdhri i Komandës së Përbashkët i 6 korrikut 1998 nuk iu dërgua njërive të MPB-së, ai shpjegoi se pjesë të urdhrave të tjera të Komandës së Përbashkët iu dhanë MPB-së përmes Adamoviqit "për t'iu mundësuar atyre që të hartojnë dokumentet e tyre."²⁷⁴⁰ Këto pjesë u përdorën në MPB "si bazë për bashkërendim."²⁷⁴¹ Ato u përdorën nga komandantët e PJP-ve për të "bërë vlerësimet e tyre dhe për të marrë vendimet në pajtim me gjendjen e vërtetë."²⁷⁴² Një nga detyrat e Adamoviqit ishte të "shpërndante pjesë të hartave në terren."²⁷⁴³ Adamoviqi pretendoi se nuk kishte marrë nga Gjakoviqi pjesët me shkrim të urdhrave të shoqëruar me harta.²⁷⁴⁴ Gjithashtu, njërive të MPB-së u ishin dhënë vetëm pjesët që u përkisnin zonave të tyre.²⁷⁴⁵ Kur u pyet se kush i kishte lëshuar urdhrat për PJP-në apo njësitë e tjera të MPB-së që të dinin saktësisht çfarë duhej të bënin gjatë operacioneve të përbashkëta pasi i merrnin hartat, Adamoviqi u përgjigj se "nuk lëshoheshin urdhra të posaçme; jepeshin vetëm pjesët e hartave që ishin përpiluar nga Korpusi i Prishtinës."²⁷⁴⁶ Mirëpo më tej ai shpjegoi se nuk dinte se a përgatisnin urdhra organet e tjera të MPB-së, sepse detyra e tij ishte thjesht t'ua shpërndante hartat njërive të

²⁷³⁷ Millan Gjakoviqi, T. 26444–26445 (20 maj 2008). Bozhidar Deliq, T. 19422–19423, 19495 (4 dhjetor 2007). Sipas Deliqit, shprehja "Komandë e Përbashkët" përdorej për ta bërë dokumentin të pranueshëm për të dyja palët.

²⁷³⁸ Millan Gjakoviqi, T. 26435 (19 maj 2008).

²⁷³⁹ Vladimir Lazareviqi, T. 17795 (6 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* Millan Kotur, T. 20675, 20724–20725 (21 janar 2008); Mihajlo Gergar, T. 21528 (1 shkurt 2008); Millosh Mandiq, T. 20925–20926 (23 janar 2008); Lubisha Dikoviqi, T. 19881 (10 dhjetor 2007); Millan Gjakoviqi, T. 26453 (20 maj 2008). Millan Koturi tha se ajo përdorej gjithmonë ku "forcat e MPB-së dhe UJ-së vepronin së bashku duke i bashkërenduar aksionet dhe duke e mbështetur njëra-tjetrën. Në raste të tilla, në këto dokumente gjithmonë shkruhej Komanda e Përbashkët. Kjo kishte kuptimin se edhe ushtria edhe MPB-ja merrnin pjesë dhe se veprimet e tyre ishin të bashkërenduara dhe kryheshin së bashku." Mihajlo Gergari tha, megjithëse në lidhje me një urdhër të vitit 1999, se Lazareviqi i kishte shpjeguar se "Komanda e Përbashkët" ishte shprehje "që përdorej nga viti 1998 e këtej dhe u referohej aksioneve të bashkërenduara ... që kryheshin nga njësitë e ushtrisë jugosllave dhe MPB-së". Millosh Mandiq dëshmoi se Stefanoviqi i kishte thënë se Komanda e Përbashkët ishte shprehje që përdorej sa herë që UJ-ja mbështeste MPB-në: ishte thjesht frazë dhe në realitet Komanda e Përbashkët nuk ekzistonte.

²⁷⁴⁰ Millan Gjakoviqi, T. 26393–26394 (19 maj 2008).

²⁷⁴¹ Millan Gjakoviqi, T. 26505 (20 maj 2008).

²⁷⁴² Millan Gjakoviqi, T. 26398 (19 maj 2008).

²⁷⁴³ Dushko Adamoviqi, T. 24978 (8 prill 2008), 6D1613 (deklaratë dëshmitari e datës 30 mars 2008), para. 25. Sipas Mijatoviqit, PrK-ja kishte paraqitur pjesë të hartave. Këto harta ishin baza për aksionet e detashmenteve të PJP-së. Miroslav Mijatoviqi, T. 22309 (13 shkurt 2008), T. 22443–22444 (14 shkurt 2008). Zhivaleviqi, komandant i Brigadës së 122-të Ndërhyrëse të PJP-së, gjithashtu dëshmoi se Adamoviqi kishte qenë ndërlidhësi midis MPB-së dhe UJ-së dhe ishte personi në Shtabin e MPB-së që ia jepte zarfet me pjesë të hartave ose urdhra me shkrim të përpiluar nga UJ-ja. Dragan Zhivaleviqi, T. 24903–24905 (3 prill 2008).

²⁷⁴⁴ Dushko Adamoviqi, T. 25063 (9 prill 2008).

²⁷⁴⁵ Dushko Adamoviqi, T. 25068 (9 prill 2008).

²⁷⁴⁶ Dushko Adamoviqi, T. 24970–24971 (9 prill 2008).

MPB-së.²⁷⁴⁷ Dhoma gjithashtu thekson se, sipas Miroslav Mijatoviqit, Shtabi i MPB-së nuk kishte lëshuar asnjë vendim "sepse detashmentet ... përfshiheshin duke u bazuar në pjesët e hartave të marra nga Korpusi i Prishtinës. Mirëpo ai deklaroi se komandantët e detashmentit të PJP-së lëshonin urdhra për vartësit.²⁷⁴⁸ Ndërsa janë paraqitur shumë pak prova shkresore që tregojnë se MPB-ja lëshoi urdhra për kryerjen e aksioneve të ndryshme që duhej të zbatoheshin nga ajo gjatë operacioneve të përbashkëta, Dhoma konkludon se MPB-ja ka lëshuar urdhra të tilla, meqenëse pjesët e hartave të dhëna nga UJ-ja nuk përmbanin udhëzime konkrete se si sulme apo aksione të ndryshme duhej të kryheshin në praktikë.

1030. Momir Stojanoviqi dëshmoi se ai "e njihte mirë metodologjinë e punës së Komandës së Korpusit të Prishtinës." Ai shpjegoi se gjatë luftës Komanda e Korpusit të Prishtinës mbledhje në grupe të vogla çdo ditë.²⁷⁴⁹ Në këto mbledhje paraqiteshin informacione nga organet e Komandës. Pas mbledhjeve – të cilat zakonisht mbaronin në orën 18:00 – komandanti i Korpusit të Prishtinës vizitonte komandantin e Armatës së 3-të për ta informuar për çfarë ishte diskutuar: ai i paraqiste eprorit propozime konkrete se si të përdroreshin njësi të caktuara, i raportonte për problemet me të cilat ballafaqoheshin njësitë e caktuara, dhe propozonte vendimet që duhej të merreshin.²⁷⁵⁰ Kur komandanti i Armatës së 3-të jepte miratimin, komandanti i Korpusit të Prishtinës vizitonte organet e MPB-së "për bashkërendim mbi vendimet e marra." Më pas kjo verifikohet nga komandanti i Armatës së 3-të.²⁷⁵¹ Stojanoviqi gjithashtu dëshmoi se shprehjen "Komanda e Përbashkët" e kishte dëgjuar gjatë takimeve ditore me Gjakoviqin, në të cilat raportonte për gjendjen e sigurisë. Gjakoviqi i kishte thënë se kjo shprehje u referohej "mbledhjeve të përbashkëta të përfaqësuesve të Komandës së Korpusit të Prishtinës dhe Ministrisë së Brendshme për shkëmbimin e informatave dhe për të bashkërenduar dhe bashkëpunuar, si dhe për aksione të bashkërenduara midis ushtrisë dhe MPB-së në prapavijë."²⁷⁵² Sidoqoftë, sipas Stojanoviqit, Gjakoviqi shpesh theksonte se ishte problematik fakti që urdhrat e marra nga Komanda e Korpusit të Prishtinës përmes hierarkisë vertikale komanduese, si dhe urdhrat e marra nga MPB-ja përmes hierarkisë së vet komanduese, "asnjëherë nuk ishin marrë me problemin në terren të bashkërendimit të mirëfilltë të veprimeve të

²⁷⁴⁷ Dushko Adamoviq, T. 25066 (9 prill 2008). Dhoma Gjyqësore gjithashtu vëren se Adamoviqi nuk e dinte se pse Gjorgjeviqi dhe Stevanoviqi ishin "në terren" gjatë kryerjes së aksioneve "antiterroriste." Dushko Adamoviq, T. 25069, 25081–25082 (9 prill 2008).

²⁷⁴⁸ Miroslav Mijatoviq, T. 22335 (13 shkurt 2008).

²⁷⁴⁹ Momir Stojanoviq, T. 20047 (11 dhjetor 2007).

²⁷⁵⁰ Dhoma vëren se, megjithëse duket se mbledhjet e Komandës së PrK-së përfundonin brenda orës 18:00, provat tregojnë se mbledhjet e Komandës së Përbashkët fillonin në 19:30. Millomir Miniq, T. 14748 (31 gusht 2007); Zoran Angelkoviq, T. 14656 (30 gusht 2007).

²⁷⁵¹ Momir Stojanoviq, T. 20047–20048 (11 dhjetor 2007).

²⁷⁵² Momir Stojanoviq, T. 19761–19762 (7 dhjetor 2007). Stojanoviqi dëshmoi se shprehjen e kishte dëgjuar për herë të parë nga Gjakoviqi, T. 19761 (7 dhjetor 2007), por më vonë tha se e kishte dëgjuar nga Pavkoviqi. T. 20033 (11 dhjetor 2007).

ushtrisë dhe të MPB-së gjatë një operacioni të caktuar.²⁷⁵³ Stojanoviçi tha se ishte "mëse e qartë ... se Komanda e Përbashkët nuk kishte asnjë kompetencë të një komande të mirëfilltë në kuptimin e marrjes së vendimeve dhe lëshimit të urdhrave." Ai tha se "në praktikë nuk funksiononte në këtë mënyrë."²⁷⁵⁴

1031. Dhoma ka analizuar dy vendime që kanë lidhje me operacionet e përbashkëta të kryera në vitin 1998. I pari, i datës 10 gusht 1998, titullohet "Vendim për angazhimin e përbashkët të forcave të MPB-së dhe UJ-së."²⁷⁵⁵ I dyti, i datës 14 gusht 1998, bënte fjalë për një operacion të përbashkët në sektorin e Sllupit dhe Vokshit.²⁷⁵⁶ Emërtimet e të dy vendimeve tregojnë se ishin lëshuar nga Komanda e Korpusit të Prishtinës. Në të dy vendimet, njësitë e UJ-së udhëzoheshin që të ndihmonin njësitë e MPB-së ose të bashkërendonin aksionet me to në zbatimin e disa detyrave. Sidoqoftë, nuk përcaktoheshin hollësitë se si duhej të kryheshin sulmet. Për shembull, në vendimin e 14 gushtit, Grupi Luftarak 15/3 i Korpusit të Prishtinës urdhërohej që të mbështeste sulmin e Detashmentit të 8-të të MPB-së dhe të Kompanisë së PJP-së së Gjakovës përgjatë një vije të caktuar, por nuk kishte të dhëna se si duhej të kryhej ky sulm.²⁷⁵⁷ Nga të dy vendimet është e qartë se duhej planifikim shtesë për të dy operacionet. Sipas fjalisë së fundit të vendimit të 10 gushtit 1998, njësitë vartëse të Korpusit të Prishtinës duhej të "organizojnë dhe koordinojnë aksionet me forcat e MPB-së gjatë përgatitjeve dhe operacioneve luftarake."²⁷⁵⁸ Sa i përket operacioneve në Sllup dhe Voksh, komandanti i Brigadës së 15-të të Blinduar nxori një urdhër më 14 gusht 1998, duke e urdhëruar komandantin e Grupit Luftarak 15/3 që të organizonte "një aksion të bashkërenduar me organet e Detashmentit të 8-të të MPB-së në përgatitjen dhe zbatimin e operacioneve luftarake ... para dhe gjatë operacioneve luftarake."²⁷⁵⁹ Duket se vendimet e Korpusit të Prishtinës të datave 10 dhe 14 gusht 1998 u janë dërguar njësisive të UJ-së si plane bashkërenduese, bazuar në të cilat ata duhej të planifikonin sulmet dhe aksionet. Fakti se këto vendime u referoheshin njësisive konkrete të MPB-së me të cilat Korpusi i Prishtinës duhej të vepronte në bashkërendim gjatë aksioneve të caktuara tregon se ekzistonte një nivel bashkërendimi dhe shkëmbimi informatash midis MPB-së dhe UJ-së para marrjes së vendimeve.

²⁷⁵³ Momir Stojanoviç, T. 19762 (7 dhjetor 2007).

²⁷⁵⁴ Momir Stojanoviç, T. 19765 (7 dhjetor 2007).

²⁷⁵⁵ P1427 (Vendim i PrK-së, 10 gusht 1998).

²⁷⁵⁶ P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998).

²⁷⁵⁷ P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998), f. 1.

²⁷⁵⁸ P1427 (Vendim i PrK-së, 10 gusht 1998), f. 4.

²⁷⁵⁹ 6D731 (Urdhër i Brigadës së 15-të të Blinduar dërguar Komandantit të grupit luftarak 15/3, 14 gusht 1998), f. 5; Vladimir Llazareviç, T. 17804 (6 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* P2113 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar në Lidhje me Ndalimin e Operacioneve pa Dijeninë e Komandës së Përbashkët për Kosovën, 7 korrik 1998). Dhoma gjithashtu vëren se në urdhrin e Brigadës së 125-të të Motorizuar të datës 7 korrik 1998, Komanda e brigadës udhëzonte Komandën e Grupit Luftarak 4 të "përgatiste dhe planifikonte çdo operacion ..., duke përcaktuar qartë objektivin, detyrat, dhe kohëzgjatjen e operacionit. "

1032. Dhoma vëren se vendimi i 10 gushtit iu dërgua, ndër të tjera, edhe "Komandës së PJP-së të MPB-së së Republikës së Serbisë," e cila zakonisht planifikonte aksionet e njërive të PJP-së.²⁷⁶⁰ Të dy vendimet përmbanin një klauzolë në fund e cila përcaktonte se operacionet luftarake duhej të "komandohen nga Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë."²⁷⁶¹ Sipas Gjakoviçit, kjo klauzolë nënkuptonte se komandat e UJ-së dhe MPB-së kishin arritur marrëveshje për detyrat që do të kryeshin nga njësitë e UJ-së dhe MPB-së gjatë operacionit të përbashkët. Rrjedhimisht para lëshimit të këtyre vendimeve të Komandës së Korpusit të Prishtinës, MPB-ja kishte pranuar që të kryente sulmet e ndryshme që përmendeshin në to.

(B) Bashkërendimi në vitin 1999

1033. Radojko Stefanoviçiqi, pasardhësi i Gjakoviçit që nga janari 1999, dëshmoi se në vitin 1999 asnjë aksion i përbashkët nuk u krye pa u mbajtur mbledhje bashkërenduese paraprakisht. Forcat të cilat do të merrnin pjesë në këto operacione dhe koha e kryerjes së tyre duhej të diskutoheshin midis UJ-së dhe MPB-së.²⁷⁶² Llazareviçiqi dëshmoi se në vitin 1999 bashkërendimi u realizua në nivel të Komandës së Korpusit të Prishtinës midis "oficerëve operativë në Komandën e Korpusit dhe homologëve të tyre në MPB."²⁷⁶³ Grupi i oficerëve operativë në Komandën e Korpusit përbëhej nga Stefanoviçiqi, Tesheviçiqi, dhe nganjëherë nga kolonel Paprika.²⁷⁶⁴ Stefanoviçiqi dhe zëvendësi i tij, Tesheviçiqi, kishin kontakte personale me individë nga MPB-ja, bashkëpunonin dhe bashkërendonin veprimet me individë, ndër të cilët pasardhësi i Adamoviçit në Shtabin e MPB-së, kolonel Arsenijeviçiqi, i cili ishte përgjegjës për planifikim, si dhe Obrad Stevanoviçiqi, dhe më vonë kolonel Brakoviçiqi, komandanti i Brigadës së 124-të Ndërhyrëse të PJP-së.²⁷⁶⁵ Nga dëshmitë duket se, megjithëse nuk kishte punuar më në Komandën e Korpusit të Prishtinës më 1999, Gjakoviçiqi kishte marrë pjesë në planifikimin e operacioneve së bashku me organet operative të Komandës së Korpusit të Prishtinës.²⁷⁶⁶

1034. Stefanoviçiqi dëshmoi se, për planifikimin e operacioneve të përbashkëta, oficerët e UJ-së i ftonin "përfaqësuesit e MPB-së që ishin përgjegjës për planifikimin" ose i vizitonin që të

²⁷⁶⁰ P1427 (Vendim i PrK-së, 10 gusht 1998), f. 4.

²⁷⁶¹ P1427 (Vendim i PrK-së, 10 gusht 1998), f. 3; P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998), f. 3.

²⁷⁶² Radojko Stefanoviçiq, T. 21684–T. 21689 (5 shkurt 2008).

²⁷⁶³ Vladimir Llazareviçiq, T. 17926–17927 (8 nëntor 2007). Llazareviçiqi theksoi se oficerët e UJ-së nuk i bashkërendonin veprimet me Shtabin e MPB-së të vetëm: disa zëvendës ose ndihmës të Ministrit të Brendshëm "gjithashtu merrnin pjesë në këtë." Vladimir Llazareviçiq, T. 17926 (8 nëntor 2007).

²⁷⁶⁴ Vladimir Llazareviçiq, T. 18371–18372 (15 nëntor 2007).

²⁷⁶⁵ Radojko Stefanoviçiq, T. 21684–21689 (5 shkurt 2008).

²⁷⁶⁶ Millan Gjakoviçiq, T. 26390 (19 maj 2008). Gjakoviçiqi dëshmoi se i kishte dhënë Adamoviçit "modelin" për urdhra në shkurt 1999. Stefanoviçiqi gjithashtu shpjegoi se "Gjakoviçiqi dhe operativët e Komandës së Armatës së 3-të ishin aty gjatë gjithë kohës dhe ne i planifikonim ato aksione së bashku." T. 21796 (6 shkurt 2008).

shkëmbenin "të dhëna dhe informata për bashkërendimin e aksioneve të përbashkëta."²⁷⁶⁷ Më tej, ai shpjegoi se, gjatë këtyre "mbledhjeve të punës" ose "diskutimeve të punës," përfaqësuesit e UJ-së dhe të MPB-së vendosnin për kohën e kryerjes së këtyre aksioneve, detyrat e ndryshme, dhe forcat që do të përfshiheshin.²⁷⁶⁸ Ata gjithashtu bënë marrëveshje për detyrat që njësitë e UJ-së dhe MPB-së do të kryenin gjatë operacioneve të përbashkëta. Stefanoviçi shtoi se, "duke u bazuar në këtë," Komanda e Korpusit hartonte vendimet dhe hartat. Ai supozoi se, pas të gjitha këtyre mbledhjeve bashkërenduese, edhe MPB-ja hartonte vendimet e veta.²⁷⁶⁹ Me fjalë të tjera, pas mbledhjeve bashkërenduese, përfaqësuesit e UJ-së dhe MPB-së ktheheshin në komandat e tyre dhe raportnin për çfarë ishin marrë vesh.²⁷⁷⁰ Stefanoviçi këmbënguli posaçërisht që të bëhej dallim midis "bashkërendimit" dhe "planifikimit": "bashkërendimi" ishte faza gjatë së cilës arriheshin "marrëveshje për angazhimin e forcave policore në njërën anë dhe njërive ushtarake në anën tjetër," kurse "planifikimi" ishte faza gjatë së cilës "të gjithë hartonin sipas nivelit të tyre hierarkik," pasi kishte përfunduar faza e bashkërendimit.²⁷⁷¹ Sipas tij, në nivelin taktik, vazhdonte "bashkërendimi dhe zhvillimi i hollësishëm ... i mënyrës në të cilën do të kryheshin aksionet."²⁷⁷²

1035. Kur Stefanoviçi mori postin e Gjakoviçit në Komandën e Korpusit të Prishtinës, Gjakoviçi i tha se në vitin 1998 dokumentet luftarake të përgatitura për operacionet e përbashkëta kishin emërtimin "Komanda e Përbashkët" dhe një klauzolë ku përcaktohej se të gjitha forcat do të komandoheshin nga Komanda e Përbashkët.²⁷⁷³ Gjithashtu Stefanoviçi u informua se dokumentet me emërtimin "Komanda e Përbashkët" i kishte lëshuar Pavkoviçi në vitin 1998.²⁷⁷⁴ Ai pa disa urdhra me emërtimin "Komanda e Përbashkët" në vitin 1999.²⁷⁷⁵ Kur e pyetën se a ishte praktikë e rregullt në vitin 1999 që Korpusi i Prishtinës t'i jepte MPB-së pjesë të hartave të përgatitura nga UJ-ja, Stefanoviçi shpjegoi se kjo gjë vendosej rast pas rasti. Për shembull, Korpusi i Prishtinës i jepte pjesë të hartave MPB-së për aksionet që kishin rëndësi të veçantë. Ai theksoi se, kur MPB-së i jepeshin pjesët e hartave, ato nuk duhej të përdoreshin për asgjë tjetër veçse si plane bashkërenduese ose si bazë mbi të cilën MPB-ja bënte gati planet, vendimet, dhe urdhrat e veta.²⁷⁷⁶

1036. Dragan Zhivaleviçi, komandant i Brigadës së 122-të Ndërhyrëse të PJP-së, dëshmoi se para çdo aksioni antiterrorist merrte një dokument që përmbante planin, të përpiluar nga UJ-ja dhe ai

²⁷⁶⁷ Radojko Stefanoviçi, T. 21685 (5 shkurt 2008).

²⁷⁶⁸ Radojko Stefanoviçi, T. 21751–21752 (6 shkurt 2008).

²⁷⁶⁹ Radojko Stefanoviçi, T. 21752 (6 shkurt 2008).

²⁷⁷⁰ Radojko Stefanoviçi, T. 21685 (5 shkurt 2008).

²⁷⁷¹ Radojko Stefanoviçi, T. 21751 (6 shkurt 2008).

²⁷⁷² Radojko Stefanoviçi, T. 21685 (5 shkurt 2008).

²⁷⁷³ Radojko Stefanoviçi, T. 21661–21662, 21793–21794 (6 shkurt 2008).

²⁷⁷⁴ Radojko Stefanoviçi, T. 21795 (6 shkurt 2008).

²⁷⁷⁵ Radojko Stefanoviçi, T. 21794 (6 shkurt 2008).

dhe komandantët e UJ-së takoheshin dhe merreshin vesh se si të vepronin. Kishte pasur raste kur planit i duheshin bërë ndryshime të vogla.²⁷⁷⁷ Zhivanoviqi, komandant i Brigadës së 125-të të Motorizuar, gjithashtu dha hollësi se si bëhej bashkërendimi me MPB-në në Brigadën e 125-të të Motorizuar. Pasi merrte urdhrin për t'i dhënë mbështetje forcave të MPB-së në zonën e tij, ai takohej ose me shefin e SPB-së, ose me komandantin e grupit të luftimit dhe të detashmentit në vartësi të tij dhe përcaktonin hollësitë e bashkërendimit.²⁷⁷⁸

1037. Dhoma ka pranuar si prova 16 urdhra me emërtimin “Komanda e Përbashkët”. Një nga këto urdhra, i datës 19 mars 1999, ka të bëjë me operacionin e përbashkët që duhej të kryhej në zonën e Podujevës.²⁷⁷⁹ Një dokument i lëshuar nga Komanda e Korpusit të Prishtinës më 18 mars 1999 tregon se ky operacion ishte planifikuar nga Komanda e Korpusit të Prishtinës në përputhje me urdhrat e Komandës së Armatës së 3-të. Ai gjithashtu tregon se procesi i planifikimit të këtij operacioni përfshinte bashkërendimin me MPB-në. Më 18 mars 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës i sugjeronte komandantit të Armatës së 3-të idenë "për kryerjen e një operacioni për shpartallimin e forcat terroriste shqiptare në sektorin e Drenicës veriore dhe Podujevës."²⁷⁸⁰ Ajo shpjegonte se procesi i planifikimit ishte kryer "në përputhje me idenë e përgjithshme të Komandës së Armatës së 3-të dhe planet konkrete" dhe bënte të ditur se Komanda e Korpusit të Prishtinës kishte organizuar "një aksion bashkërendues konkret" me MPB-në për këtë operacion të përbashkët.²⁷⁸¹ Komandanti i Armatës së 3-të e miratoi "idenë" e Llazareviqit më 19 mars 1999.²⁷⁸²

1038. Po ashtu, operacionet e përbashkëta të kryera në zonën e Llapit dhe në sektorin e Drenicës së Poshtme – për të cilat Komanda e Përbashkët i nxori urdhrat më 22 mars 1999 – u planifikuan nga Komanda e Korpusit të Prishtinës në pajtim me urdhrat e Komandës së Armatës së 3-të.²⁷⁸³ Një dokument i lëshuar nga Komanda e Korpusit të Prishtinës më 22 mars 1999 gjithashtu tregon se procesi i planifikimit përfshinte bashkërendimin me MPB-në. Më 22 mars, Korpusi i Prishtinës i sugjeroi komandantit të Armatës së 3-të "planin e vet për kryerjen e operacionit për shpartallimin e Forcave Terroriste Shqiptare në sektorin e Drenicës së Poshtme dhe Llapit të Epërm." Ai shpjegonte se procesi i planifikimit ishte kryer "në pajtim me propozimin e përgjithshëm të

²⁷⁷⁶ Radojko Stefanoviç, T. 21759–21760 (6 shkurt 2008).

²⁷⁷⁷ Dragan Zhivaleviç, T. 24820–24821 (3 prill 2008).

²⁷⁷⁸ Dragan Zhivanoviç, T. 20524 (17 janar 2008).

²⁷⁷⁹ *Shih* P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999).

²⁷⁸⁰ 6D1416 (Plani i veprimt i PrK-së, 18 mars 1999).

²⁷⁸¹ 6D1416 (Plani i veprimt i PrK-së, 18 mars 1999), f. 1–2.

²⁷⁸² 5D273 (Miratim i planit nga Komanda e Armatës së 3-të, 19 mars 1999). Stefanoviç konfirmoi se ky dokument i ishte dhënë Komandantit të Armatës së 3-të për miratim dhe verifikim. Radojko Stefanoviç, T. 21657 (5 shkurt 2008).

²⁷⁸³ P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999); P2031 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999).

Komandës së Armatës së 3-të dhe planet konkrete" dhe se "ishte organizuar një aksion i bashkërenduar me MPB-në" nga Komanda e Korpusit të Prishtinës për këtë operacion të përbashkët.²⁷⁸⁴ Llazareviqi shpjegoi në gjykatë se Pavkoviqi kishte qenë në postëkomandën e Komandës së Korpusit të Prishtinës në kohën kur ishte përgatitur ky dokument. Pavkoviqi ia paraqitën planin dhe ai e miratoi.²⁷⁸⁵

1039. Sipas Llazareviqit, këto dokumente të Komandës së Korpusit të Prishtinës të 18 dhe 19 marsit 1999 tregojnë se MPB-ja e kishte bërë planifikimin e vet për operacionet që do të kryheshin në mars 1999 dhe se, para se të lëshoheshin urdhrat për kryerjen e këtyre operacioneve, UJ-ja dhe MPB-ja kishin bërë "bashkërendim konkret."²⁷⁸⁶ Procesverbal i një mbledhjeje të Shtabit të MPB-së të mbajtur më 17 shkurt 1999 tregon se Shtabi i MPB-së "planifikoi .. të kryente tri operacione spastrimi në zonat e Podujevës, Dragobilit, dhe Drenicës," por priste urdhra që ta bënte këtë. Ndërkaq, shtabi dëshironte të takohej me të gjithë komandantët e PJP-ve "për konsultime të mëtejshme në lidhje me angazhimin e tyre."²⁷⁸⁷ Sipas Llazareviqit, ky procesverbal tregon se "MPB-ja planifikonte aksione paralelisht dhe pavarësisht nga Komanda e Armatës së 3-të dhe Komanda e Korpusit."²⁷⁸⁸ Dhoma gjithashtu vëren se Komanda e Korpusit të Prishtinës kishte përgatitur një urdhër-shabllon "për thyerjen dhe shkatërrimin e Forcave Terroriste Shqiptare në sektorin e Llapit, Drenicës, dhe Malishevës" për të ndihmuar pjesëtarët e MPB-së në "hartimin e dokumenteve që pak a shumë do të përputheshin me dokumentet e hartuara nga ushtria."²⁷⁸⁹ Gjakoviqi ia dha këtë dokument Adamoviqit.²⁷⁹⁰ Ky "shabllon" kishte emërtimin "Shtabi i MPB-së" dhe kishte datën 19 shkurt 1999. Kjo provë tregon se planet për aksionet në të cilat përfshiheshin njësitë e UJ-së dhe MPB-së, përgatiteshin në UJ dhe në MPB para kryerjes së operacioneve të mëdha të përbashkëta në fund të marsit 1999. Para kryerjes së operacioneve konkrete të përbashkëta, UJ-ja dhe MPB-ja takoheshin gjatë mbledhjeve bashkërenduese për bashkërendimin e planeve të tyre përkatëse.

²⁷⁸⁴ 5D276 (Komunikim i Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 22 mars 1999). Sipas Llazareviqit, MPB-ja i kishte planet e saj në të cilat parashikohej asgjësimi i "terroristëve" në vende të ndryshme. Në "planin për zbatim" të lëshuar më 22 mars 1999, ai njoftonte komandantin e Armatës së 3-të se ishte bërë bashkërendimi i planeve të UJ-së me planet e MPB-së. Vladimir Llazareviq, T. 17923 (8 nëntor 2007).

²⁷⁸⁵ Vladimir Llazareviq, T. 17923, 17924 (8 nëntor 2007).

²⁷⁸⁶ Vladimir Llazareviq, T. 18200 (13 nëntor 2007).

²⁷⁸⁷ P1990 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 17 shkurt 1999), f. 1. Në këtë mbledhje, midis të tjerëve morën pjesë edhe Llukiqi, Vllajko Stojilkoviqi, Vllastimir Gjorgjeviqi, Rade Markoviqi, Obrad Stevanoviqi, anëtarët e Shtabit të MPB-së së Prishtinës, Millosav Villotiqi, të gjithë shefat e SPB-ve, si dhe komandantët e PJP-së dhe SAJ-it.

²⁷⁸⁸ Vladimir Llazareviq, T. 17923 (8 nëntor 2007).

²⁷⁸⁹ Millan Gjakoviq, T. 26390 (19 maj 2008); 6D716 (Urdhër i përgatitur nga Millan Gjakoviqi, 19 shkurt 1999). Gjakoviqi theksoi se ky dokument nuk ishte regjistruar. Ai gjithashtu theksoi se pjesëtarët e MPB-së mund të refuzonin disa nga informatat e këtij dokumenti.

²⁷⁹⁰ Millan Gjakoviq, T. 26390 (19 maj 2008).

1040. MPB-ja dhe UJ-ja gjithashtu bashkërenduan planet para operacioneve të përbashkëta të kryera nga mesi i prillit 1999. Më 9 prill, Komanda e Korpusit të Prishtinës i udhëzoi njësitë në varësi të saj që të "bashkërendojnë veprimet me njësitë e MPB-së në thyerjen e forcave terroriste shqiptare," dhe të "vendosin kontakt të menjëhershëm me shefat e SPB-ve" në lidhje me disa aksione konkrete.²⁷⁹¹ Korpusi i Prishtinës udhëzoi që komandantët e njërive "të planifikojnë aksionet" pasi të kenë vendosur kontakt. Për shembull, komandantët e njërive të Korpusit të Prishtinës duhej të bashkërendonin operacionin *Bajgora* me SPB-në e Mitrovicës.²⁷⁹² Dhoma vëren se një operacion i përbashkët u krye në sektorin e Bajgorës rreth 25 prillit 1999 në pajtim me urdhrin e Komandës së Përbashkët të lëshuar më 15 prill 1999.²⁷⁹³ Kjo provë tregon se para lëshimit të urdhrave të Komandës së Përbashkët në mes të prillit 1999, UJ-ja dhe MPB-ja kishin bashkërenduar aksionet që duhej të kryheshin nga njësitë e tyre gjatë operacionit të përbashkët.

1041. Rrjedhimisht Dhoma konkludon se, para kryerjes së operacioneve të mëdha të përbashkëta të UJ/MPB-së në fund të marsit dhe deri në mes të prillit 1999, këto dy organe i bashkërenduan planet dhe veprimtarinë e tyre. Varësisht nga operacioni, merrte përparësi ose plani i MPB-së, ose i UJ-së. Kur mbaronte faza e bashkërendimit, mbetej planifikimi i veprimeve në nivelin taktik. Dhoma vëren se të 16 urdhrat e Komandës së Përbashkët të lëshuara në vitin 1999 kishin një klauzolë që përcaktonte se njësitë e Korpusit të Prishtinës duhej të "organizonin aksione të bashkërenduara me forcat e MPB-së në lidhje me përgatitjen dhe kryerjen e operacioneve luftarake, para dhe gjatë operacioneve luftarake."²⁷⁹⁴ Një dokument i lëshuar nga Komanda e Brigadës së 549-të të Motorizuar më 29 mars 1999 gjithashtu tregon se planifikimi dhe bashkërendimi i aksioneve vazhdon në nivelin taktik.²⁷⁹⁵ Gjithashtu, komandanti i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, Kërsman Jelliqi shpjegoi se, pasi merrte një detyrë, ai takohej me shefin e SPB-së në Ferizaj "për të shkëmbyer mendimet" dhe "për t'u pajtuar në parim se si duhej të kryhej detyra."²⁷⁹⁶ Ai shpjegoi në veçanti se në fund të marsit 1999 u planifikua një operacion antiterrorist "në

²⁷⁹¹ 5D476 (Urdhër i Komandës së PrK-së, 9 prill 1999), f. 1. Radojko Stefanoviqi konfirmoi se urdhri në fjalë e udhëzonte komandantët e brigadave që të kontaktonin me krerët përkatës të SPB-së në territoret e tyre dhe të fillonin planifikimin e aksioneve të parashtruara në urdhër. Radojko Stefanoviq, T. 21702–21771 (5 shkurt 2008).

²⁷⁹² 5D476 (Urdhër i Komandës së PrK-së, 9 prill 1999), f. 2; Vladimir Llazareviq, T. 18007 (9 nëntor 2007).

²⁷⁹³ P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999).

²⁷⁹⁴ *Shih p.sh.* P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999), f. 5; P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999), f. 8; P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999), f. 12; P2003 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 2 prill 1999), f. 6.

²⁷⁹⁵ P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 29 mars 1999), f. 8. Pjesa e fundit e këtij urdhri merrej me "aksionet e bashkërenduara dhe bashkëpunimin." Në këtë pjesë, Deliçi, komandanti i Brigadës së 549-të të Motorizuar, i urdhëronte vartësit e tij të "organizojnë përgatitjet për operacione luftarake me forcat e MPB-së, para dhe gjatë operacioneve luftarake."

²⁷⁹⁶ Kërsman Jelliq, T. 19081–19082 (26 nëntor 2007) (ata u përpoqën të "mësonin se si mund t'i zbatonin më së miri urdhrat që kishin marrë"). Jelliqi dëshmoi se bashkëpunimi i tij me shefin e SPB-së në Ferizaj ishte "jashtëzakonisht korrekt dhe profesional." Kërsman Jelliq, T. 19037.

bashkërendim me MPB-në.²⁷⁹⁷ Ai planifikoi detyra për njësitë e tij dhe u dha "pjesë të urdhrave dhe harta, në bazë të të cilave ata bënë planet e veta."²⁷⁹⁸ Ai gjithashtu saktësoi se "planet për MPB-në ishin bërë nga eprorët e tyre," të cilët ai supozoi se ishin SPB-të e atyre zonave.²⁷⁹⁹ Vendimet të cilat ua transmetoi vartësve të vet ishin "dokumente fillestare për kryerjen e aksioneve luftarake," dhe "gjatë angazhimeve konkrete" komandanti i cili kryente një pjesë konkrete të aksionit luftarak kishte të drejtë të ndryshonte vendimet "varësisht nga zhvillimet konkrete në terren."²⁸⁰⁰ Më përgjithësisht, Llazareviqi dëshmoi se bashkërendimi në nivel të komandantëve të brigadave përfshinte "shkëmbimin e informatave për angazhimin e njërive, kryerjen e detyrës, komunikimin, marrëveshjet për dërgimin e oficerëve ndërlihdës, dhe planifikimin që në një vend dhe kohë të caktuar përfaqësuesit e policisë dhe ushtrisë të mblidheshin në ... postëkomandën e përbashkët."²⁸⁰¹

1042. Megjithëse në gjyq janë paraqitur shumë pak prova shkresore që tregojnë se organet e MPB-së kanë dhënë urdhra për kryerjen e veprimeve të ndryshme gjatë operacioneve të përbashkëta, Dhoma konkludon se, sikurse edhe në vitin 1998, edhe MPB-ja lëshoi urdhra në një formë a tjetër, meqenëse urdhrat e Komandës së Përbashkët nuk përmbanin udhëzime konkrete se si duhej të kryheshin në praktikë aksionet apo sulmet konkrete.²⁸⁰²

1043. Pasi ka shqyrtuar përgjithësisht se si funksionoi sistemi i bashkërendimit dhe bashkëpunimit midis UJ-së dhe MPB-së në vitin 1998 dhe 1999, Dhoma Gjyqësore më tej do të shqyrtojë aspektin e debatueshëm se çfarë vendi zinte Komanda e Përbashkët në këtë sistem.

b. Komanda e Përbashkët

1044. Paragrafi 24 i Aktakuzës pretendon si vijon:

Sllobodan Millosheviqi, MILLAN MILLUTINOVIQI dhe NIKOLLA SHAINOVIQI, gjithashtu ushtronin komandë mbi forcat e RFJ-së dhe Serbisë, nëpërmjet organizmave të tjera, përfshirë edhe Komandën e Përbashkët kryesuar prej NIKOLLA SHAINOVIQIT, e cila ishte e autorizuar të bashkërendonte punën e organeve për çështje civile me veprimtaritë e organizatave në përbërje të forcave të RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë dhe të sigurohej që ata t'i kryenin operacionet në pajtim me objektivat politike. Gjithashtu Komanda e Përbashkët ushtroi komandë *de facto* mbi këto organe. Ky autoritet komandues plotësonte hierarkitë e brendshme komanduese të UJ-së dhe MPB-së për të siguruar bashkëpunimin dhe bashkërendimin. Në Komandën e Përbashkët bënë pjesë anëtarë të lartë të udhëheqjes civile, politike dhe ushtarake ndër të tjerë, NEBOJSHA PAVKOVIQI, komandant i Armatës së Tretë; VLADIMIR LLAZAREVIQI, komandant

²⁷⁹⁷ Kërsman Jelliq, T. 18989 (26 nëntor 2007).

²⁷⁹⁸ Kërsman Jelliq, T. 18991 (26 nëntor 2007).

²⁷⁹⁹ Kërsman Jelliq, T. 18991 (26 nëntor 2007).

²⁸⁰⁰ Kërsman Jelliq, T. 19008–19009 (26 nëntor 2007).

²⁸⁰¹ Vladimir Llazareviq, T. 17926 (8 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* T. 17794–17795 (6 nëntor 2007).

²⁸⁰² *Shih gjithashtu* 5D1418 (Mesazh nga Shtabi i MPB-së, 26 maj 1999).

i Korpusit të Prishtinës, SRETEN LLUKIQI, shef i Shtabit të MPB-së, shefi i Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm ("KEP") dhe udhëheqës të tjerë të UJ-së dhe MPB-së.

1045. Në dosjen e saj përfundimtare, Prokuroria argumenton se Komanda e Përbashkët ka qenë organ bashkërendues me pushtet që buronte nga Presidenti i RFJ-së me qëllim që të kontrollonte organizatat civile, ushtarake, dhe policore që vepronin në Kosovë. Ajo u formua në qershor 1998 dhe funksionoi deri në qershor 1999. Anëtarësia përbëhej nga politikanë civilë dhe drejtuesit e UJ-së dhe MPB-së në Kosovë, me Shainoviçin si kreu i saj. Hierarkitë komanduese të UJ-së dhe MPB-së mbetën të paprekura, por Komanda e Përbashkët i bashkoi nëpërmjet mbledhjeve në Prishtinë dhe mundësoi që ato të vepronin në mënyrë të bashkërenduar dhe në përputhje me qëllimet politike të Millosheviçit dhe rrethit të tij të ngushtë në Beograd.²⁸⁰³ Prokuroria gjithashtu pretendon se rëndësia e Komandës së Përbashkët në një kohë që operacionet e përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së u bënë më të shpeshta dhe më të ndërlikuara në verën e vitit 1998 dhe pas kalimit të MPB-së në varësinë e UJ-së gjatë gjendjes së luftës në verën e vitit 1999.²⁸⁰⁴ Prokuroria gjithashtu argumenton se, përkundër mungesës së bazës formale ligjore për ekzistencën e këtij organi, anëtarët e ndërmarrjes së përbashkët kriminale e pranuan Komandën e Përbashkët si pjesë e sistemit i cili mund t'i urdhëronte forcat e RFJ-së dhe Serbisë të kryenin operacione në Kosovë dhe anëtarët e ndërmarrjes e përdorën Komandën e Përbashkët për të arritur qëllimet e tyre.²⁸⁰⁵

1046. Mbrojtja e Shainoviçit argumenton se mbledhjet të cilave Prokuroria iu referohet si mbledhje të "Komandës së Përbashkët", nuk ishin mbledhje të "Komandës së Përbashkët," por "seanca" jozyrtare të udhëheqjes politike me MPB-në dhe UJ-në, si dhe me përfaqësues të autoriteteve të tjera shtetërore. Shprehja "Komandë e Përbashkët" u krijua nga Pavkoviçiqi dhe Millan Gjakoviçiqi para ardhjes së Shainoviçit dhe Miniçiqit në Kosovë. Mbrojtja pretendon se mbledhjet nuk kishin të bënin aspak me pjesëmarrjen e Shainoviçit apo të Miniçiqit, po me bashkërendimin e veprimeve të MPB-së dhe UJ-së.²⁸⁰⁶ Shainoviçiqi, si përfaqësues i Partisë Socialiste të Serbisë (SPS) dhe zëvendëskryeministër i RFJ-së, duhej t'u raportonte eprorëve të tij në Beograd dhe të negocionte me bashkëbiseduesit ndërkombëtarë. Rrjedhimisht atij i duheshin informata të sakta dhe më të fundit për ngjarjet në terren në Kosovë; dhe, për shkak të gjendjes së sigurisë atje, ishte më se e natyrshme që ai t'i drejtohej UJ-së dhe MPB-së për informata.²⁸⁰⁷ Këto mbledhje *ad hoc* ku merrnin pjesë njerëz të ndryshëm, shërbenin kryesisht për shkëmbim informatash, dhe nuk kishin ndikim në aksionet e MPB-së dhe të UJ-së. Edhe nëse dikush i quante

²⁸⁰³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 154–155.

²⁸⁰⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 206.

²⁸⁰⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 165, 205.

²⁸⁰⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 69, 175–187, 216–244.

²⁸⁰⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 68–85.

mbledhje të "Komandës së Përbashkët," anëtarët e SPS-së nuk i quanin ashtu: hierarkitë komanduese të UJ-së dhe MPB-së mbetën të paprekura.²⁸⁰⁸ Në këto mbledhje nuk u morën vendime dhe Shainoviçi nuk u dha, dhe as nuk mund t'u jepte urdhra UJ-së, apo MPB-së.²⁸⁰⁹

1047. Mbrojtja e Shainoviçit gjithashtu pretendon se, sido që të jetë, pas Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviq, organi i njohur si "Komanda e Përbashkët" pushoi së ekzistuari dhe drejtuesit civilë u riemëruan në organe të tjera si Këshilli i Përkohshëm Ekzekutiv dhe Komisioni i Qeverisë Federale për Bashkëpunim me KVM-në.²⁸¹⁰ Pretendohet se pas tetorit 1998, asnjë pjesëtar i udhëheqjes civile nuk ka marrë pjesë në mbledhjet që kanë pasur të bëjnë me bashkërendimin në mes të MPB-së dhe UJ-së dhe Shainoviçi nuk është konsultuar për çështje të tilla gjatë kësaj periudhe.²⁸¹¹ Shkurt, Mbrojtja e Shainoviçit pretendon se ai nuk ka qenë Kryetar i ndonjë Komande të Lartë dhe nuk komandoi, kontrolloi, apo ushtroi kontroll mbi UJ-në dhe MPB-në dhe forca të tjera të RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë, as përmes Komandës së Përbashkët, as në mënyrë të drejtpërdrejtë.²⁸¹²

1048. Mbrojtja e Ojdaniçit pretendon se nuk ka dëshmi se Komanda e Përbashkët ka ekzistuar për të zbatuar planin për dëbimin e shqiptarëve të Kosovës nga Kosova dhe se, më së shumti, dëshmitë tregojnë vetëm se Komanda e Përbashkët ka ekzistuar për bashkërendimin e operacioneve legjitime të UJ-së dhe MPB-së kundër UÇK-së. Hierarkia komanduese e UJ-së mbeti e paprekur.²⁸¹³ Mbrojtja e Ojdaniçit thekson se Prokuroria nuk pretendon se ai ka qenë anëtar i Komandës së Përbashkët ose se ka marrë pjesë ndonjëherë në mbledhjet e saj, nëse janë mbajtur mbledhje të tilla në vitin 1999. Për më tepër, pretendimi i Prokurorisë se Komanda e Përbashkët ishte e nevojshme për kryerjen e krimeve tregon se Ojdaniçi nuk do të kishte lejuar përdorimin e hierarkisë së rregullt komanduese për qëllime të tilla.²⁸¹⁴

1049. Mbrojtja e Pavkoviçit nuk e mohon ekzistencën e organit të quajtur "Komanda e Përbashkët," por pretendon se ky organ nuk i komandoi forcat e UJ-së apo të MPB-së. Përkundrazi, mbledhjet e Komandës së Përbashkët shërbyen për të bashkërenduar aksionet e këtyre subjekteve.²⁸¹⁵ Pas fillimit të mbajtjes së mbledhjeve të Komandës së Përbashkët, hierarkia komanduese në UJ mbeti e paprekur dhe Shtabi i Përgjithshëm i Armatës së 3-të kishte kontroll të

²⁸⁰⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 75, 79, 85, 87–93, 570–594, 655–665, 713–722, 732, 743–755, 757–760, 765, 905.

²⁸⁰⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 91, 220, 237, 147–174, 907.

²⁸¹⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 94–102.

²⁸¹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 648–654.

²⁸¹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 147–174, 907.

²⁸¹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 55–60.

²⁸¹⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 208–214.

²⁸¹⁵ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 242–243, 257–261.

plotë mbi veprimet e UJ-së në Kosovë.²⁸¹⁶ Mbrojtja e Pavkoviqit thekson mungesën e provave që normalisht duhej të ishin krijuar (për shembull, nuk ka vulë apo logo të Komandës së Përbashkët, nuk ka urdhër për krijimin e Komandës së Përbashkët apo strukturës së saj, dhe nuk ka urdhër për emërimin e komandantit të Komandës së Përbashkët) në mbështetje të këtij pretendimi.²⁸¹⁷ Dhe në fund, Mbrojtja e Pavkoviqit thekson disa karakteristika të pazakonta të urdhrave të Komandës së Përbashkët të lëshuara në vitin 1999.²⁸¹⁸

1050. Mbrojtja e Llazareviqit pretendon se bashkëpunimi midis MPB-së dhe UJ-së kishte ekzistuar edhe para ardhjes së përfaqësuesve politikë të Serbisë dhe RFJ-së në Kosovë dhe pjesëmarrjes të tyre në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, e cila nuk ka qenë organ vendimmarrës, por forum për shkëmbim informatash në lidhje me gjendjen aktuale të sigurisë. "Vendimet" e përmendura në mbledhjet e Komandës së Përbashkët ishin vendime të marra më parë nga eprorët e Pavkoviqit dhe Llukiqit. Asnjë vendim nuk u mor në mbledhjet e Komandës së Përbashkët dhe hierarkitë komanduese të MPB-së dhe UJ-së mbetën të paprekura. Llazareviqi mori pjesë vetëm në pesë nga 70 mbledhjet e Komandës së Përbashkët dhe nuk luajti asnjë rol në to; shumicën e kohës në vitin 1998 ai e kaloi në Postëkomandën Pararojë në Gjakovë, e jo në Prishtinë, ku mbaheshin mbledhjet e Komandës së Përbashkët. Komanda e Përbashkët nuk kishte as seli e as sistem të rregullt informacioni përmes raporteve operative dhe luftarake.²⁸¹⁹

1051. Mbrojtja e Llazareviqit gjithashtu argumenton se Komanda e Përbashkët nuk ekzistonte në vitin 1999 dhe, edhe po të ekzistonte, ajo nuk kishte as kompetenca komanduese, as nuk u dha urdhra MPB-së dhe UJ-së që rezultuan në krimet e pretenduara në Aktakuzë. Ekzistenca e shprehjes "Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë" në urdhrat e UJ-së në vitin 1999 nuk ishte asgjë më shumë se një tregues se operacioni duhej të kryhej bashkërisht nga MPB-ja dhe UJ-ja: ajo nuk duhej kuptuar tekstualisht se ekzistonte një Komandë e Përbashkët që urdhëronte dikë të bënte ndonjë gjë.²⁸²⁰ Së fundi, Mbrojtja e Llazareviqit argumenton se kërkesa e Llazareviqit që të lirohej nga detyra në vitin 2001, duke u bazuar në vënien e pashembullt të Armatës së 3-të nën varësinë e "Komandës së Përkohshme të Përbashkët", tregon se Komanda e Përbashkët nuk kishte ekzistuar më parë.²⁸²¹

²⁸¹⁶ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 247–256.

²⁸¹⁷ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 262.

²⁸¹⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 263.

²⁸¹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 522–541.

²⁸²⁰ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 808–842.

²⁸²¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 843; 5D475 (Kërkesë për Lirimin nga Detyra të komandantit të Armatës së 3-të, 12 mars 2001).

1052. Nga ana e saj, Mbrojtja e Llukiqit argumenton se Komanda e Përbashkët ishte përpjekje legjitime e MPB-së dhe UJ-së për të shkëmbyer informata, e jo organ komandues, pushteti i të cilit buronte prej strukturave ekzistuese të MPB-së dhe UJ-së. Shprehja "Komanda e Përbashkët" ishte shkurtesë e UJ-së për të përshkruar bashkërendimin midis ushtrisë dhe policisë para ndërrimit të varësisë. Nuk ka asnjë urdhër apo mesazh nga Komanda e Përbashkët për MPB-në dhe ky organ pushoi së ekzistuari pas vitit 1998. Roli i Llukiqit në MPB në lidhje me Komandën e Përbashkët nuk bartte më shumë pushtet se roli i tij si "administrator i Shtabit të MPB-së," korrier që përcillte informatat.²⁸²²

1053. Duke marrë parasysh të gjitha këto shpjegime të paraqitura nga palët, dhe rëndësinë e kësaj pike të debatueshme, Dhoma duhet të përcaktojë nëse ka ekzistuar organi i njohur si Komanda e Përbashkët dhe se a ka pasur pushtet komandues *de facto* mbi njësitë e UJ-së dhe MPB-së, si dhe forcat e tjera që vepronin në Kosovë, në vitin 1998 dhe 1999.

1054. Paraprakisht Dhoma pranon se pjesëmarrja e civilëve në mbledhje me drejtues ushtarakë dhe policorë gjatë kohës së luftës ose emergjencave është përgjithësisht aktivitet legjitim dhe nuk ka domosdoshmërisht asgjë të dyshimtë në natyrën e mbledhjeve që quhen Komanda e Përbashkët. Nga ana tjetër, dëshmitarët e ftuar gjatë gjykimit u treguan jashtë mase të ndjeshëm ndaj sugjerimit se ishin mbajtur mbledhje të Komandës së Përbashkët ose se mbledhjet e mbajtura ishin të organit të quajtur "Komanda e Përbashkët." Dhoma do të mundohet të davarisë mjegullën e mistershme rreth Komandës së Përbashkët me të cilën janë munduar ta mbështjellin disa gjatë gjykimit.

i. Komanda e Përbashkët në vitin 1998

(A) Mbledhjet e Komandës së Përbashkët

1055. Nga korriku 1998, Shainoviçi dhe anëtarët e Grupit të Punës të SPS-së – Miniçi, Matkoviçi, dhe Angjelkoviçi – takoheshin thujse çdo ditë me përfaqësues të organeve të ndryshme në Prishtinë, duke përfshirë edhe mbledhjet e përbashkëta me UJ-në dhe MPB-në.²⁸²³ Mbledhjet ditore me përfaqësues të UJ-së dhe MPB-së përmenden si mbledhje të "Komandës së Përbashkët."²⁸²⁴

1056. Anëtarët e Grupit të Punës dëshmuuan se, para se të vendosnin që të mbanin mbledhje të përditshme në Këshillin e Përkohshëm Ekzekutiv, ata kishin folur mes vete në telefon dhe kishin mbajtur takime të kohëpaskohshme, por me intensifikimin e sulmeve të UÇK-së, u shtua edhe

²⁸²² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llukiqit, 7 gusht 2008 (versioni publik), para. 786–799.

²⁸²³ Dushko Matkoviçi, T. 14644–14645 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 9.

²⁸²⁴ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët). *Shih përgjithësisht* Urdhri i Dytë në lidhje me Provat Materiale P1468 dhe IC199, 13 qershor 2008 (ku pranohet prova materiale IC199 si plotësues për pjesët e palexueshme të provës materiale P1468).

nevoja për komunikim dhe shkëmbim informacioni.²⁸²⁵ Matkoviqi dëshmoi se, kur kishin mbërritur në Kosovë, kishin kuptuar se gjendja ishte "jashtëzakonisht e rëndë:" çdo ditë ata merrnin informata për bllokimin e rrugëve, sulmet kundër shtëpive, përdhunime dhe vrasje, dhe fabrika që dilnin jashtë përdorimit.²⁸²⁶ Matkoviqi dhe Miniqi shpjeguan se një nga problemet e para me të cilin ishin ballafaquar kishte të bënte me minierën e Bellaqevcit: ajo ishte sulmuar nga UÇK-ja dhe disa punëtorë ishin rrëmbyer. Ata u kërkuan gjeneralëve Gjorgjeviq dhe Llukiq të MPB-së dhe gjeneralit Pavkoviq të UJ-së, ndihmë për zgjidhjen e këtij problemi.²⁸²⁷ Miniqi gjithashtu deklaroi se ekzistonte "nevoja për mbledhje më të shpeshta të anëtarëve të Grupit të Punës me pjesëtarët e ushtrisë dhe policisë për të shkëmbyer informata," sepse ushtria dhe policia "kishin mjaft njohuri" për problemet me të cilat ballafaqohej Grupi i Punës.²⁸²⁸ Për këto arsye, mbledhjet u bënë të përditshme dhe mbaheshin në ndërtesën që më parë kishte qenë për Kuvendin e Kosovës dhe ku më vonë u vendos Këshilli Ekzekutiv i Përkohshëm. U bë praktikë që pjesëmarrësit të mblidheshin në orën 19:30 për të shikuar lajmet e mbrëmjes në televizionin serb dhe për të shkëmbyer informata.²⁸²⁹ Në një moment të dëshmisë së tij, Angjelkoviqi sugjeroi se Miniqi kishte qenë nismëtari i disa prej këtyre mbledhjeve, por më vonë këmbënguli se as Miniqi, as ndonjë person tjetër nuk kishte organizuar mbledhjet për bashkërendimin, të cilat mbaheshin vetëm kur e kërkonte situata.²⁸³⁰ Mirëpo Dhoma e ka të vështirë të pranojë thëniet e Matkoviqit, Miniqit, dhe Angjelkoviqit se nuk dinin apo nuk ishin në gjendje të shpjegojnë se si ishin organizuar këto mbledhje.

1057. Anëtarët e Grupit të Punës i cilësuan këto mbledhje si "mbledhje me ushtrinë dhe policinë" ose si "mbledhje me forcat e sigurisë," duke këmbëngulur që atyre ose tërësisë së individëve që morën pjesë mos t'u atribuohet emërtim formal.²⁸³¹ Megjithëse Matkoviqi dhe Miniqi pranuan se kishin dëgjuar shprehjen "Komanda e Përbashkët" të përdorej për t'iu referuar mbledhjeve ditore në Prishtinë, ata këmbëngulën se ishte përdorur shumë rrallë dhe vetëm nga pjesëtarët e ushtrisë dhe policisë.²⁸³² Ndërsa Matkoviqi dhe Angjelkoviqi mohuan kategorikisht ekzistencën e ndonjë organi

²⁸²⁵ Dushko Matkoviq, T. 14644–14645 (30 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14748 (31 gusht 2007).

²⁸²⁶ Dushko Matkoviq, T. 14644 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 9.

²⁸²⁷ Dushko Matkoviq, T. 14643 (30 gusht 2007), P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 8 (Matkoviqi shpjegoi se "fshatarët ishin frikësuar dhe kërkuan që ushtria dhe policia të merrnin masa për t'i mbrojtur"); Millomir Miniq, T. 14747–14748 (31 gusht 2007).

²⁸²⁸ Millomir Miniq, T. 14748 (31 gusht 2007).

²⁸²⁹ Dushko Matkoviq, T. 14644 (30 gusht 2007); Zoran Angjelkoviq, T. 14656 (30 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14748 (31 gusht 2007).

²⁸³⁰ Zoran Angjelkoviq, T. 14686 (30 gusht 2007).

²⁸³¹ Dushko Matkoviq, T. 14614–14615 (29 gusht 2007); Zoran Angjelkoviq, T. 14684 (30 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14756 (31 gusht 2007).

²⁸³² Dushko Matkoviq, T. 14628–14632 (30 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14755 (31 gusht 2007). Më vonë në dëshminë e tij, Miniqi kundërshtoi thënien e tij të mëhershme se i kishte dëgjuar Pavkoviqin dhe Llukiqin duke përdorur shprehjen "Komanda e Përbashkët" in 1998. Ai këmbënguli se mund ta ketë parë të shkruar, por nuk e

i njohur si "Komanda e Përbashkët,"²⁸³³ Miniqi nuk e mohoi ekzistencën e saj tërësisht, por dëshmoi se anëtarët e Grupit të Punës, si dhe Shainoviqi, nuk kishin qenë pjesë e ndonjë Komande të Përbashkët në Kosovë, në vitin 1998.²⁸³⁴ Gjakoviqi gjithashtu dëshmoi se Miniqi, Shainoviqi, Llukiqi, dhe Pavkoviqi asnjëherë nuk i ishin referuar grupit që kishte marrë pjesë në mbledhje si "Komanda e Përbashkët."²⁸³⁵ Sidoqoftë, shënimet e tij me shkrim dore të mbledhjeve të mbajtura në Prishtinë gjatë periudhës 22 korrik - 30 tetor 1998 ("Shënimet") tregojnë se këto mbledhje të përditshme cilësoheshin "mbledhjet e Komandës së Përbashkët."²⁸³⁶

1058. Gjakoviqi dëshmoi se Shënimet ishin "kopje e një fletoreje që ai e kishte mbajtur kur kishte marrë pjesë në mbledhjet me organet e MPB-së."²⁸³⁷ Shënimet titullohen "Mbledhjet e Komandës së Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë." Më 22 korrik 1998, një ditë pas kthimit të Pavkoviqit nga një vizitë në Beograd, Pavkoviqi kishte shkuar te ai dhe e kishte ftuar në "këtë mbledhje në MPB." Gjakoviqi e kishte pyetur se çfarë do të bënte në mbledhje dhe Pavkoviqi ia kishte kthyer se nuk donte të "ishte vetëm atje" dhe i kishte thënë që të merrte një fletore dhe të shënonte gjithçka që mund t'i duhej.²⁸³⁸ Gjakoviqi dëshmoi se Shënimet u mbajtën vetëm nga ai deri më 21 tetor 1998, kur ia dorëzoi fletoren ndihmësit të tij, Ratko Tesheviqit, i cili paskëtaj kishte vazhduar të mbante shënime.²⁸³⁹

1059. Sipas Shënimeve, ata që kanë marrë pjesë në mbledhje nga korriku deri në tetor 1998 kanë qenë Gjakoviqi; Miniqi; Shainoviqi; Angjelkoviqi; Matkoviqi; Pavkoviqi; Llukiqi; zëvendësministri i Brendshëm Vllastimir Gjorgjeviq, dhe ndihmësshefi i Drejtorisë së Sigurimit Shtetëror (RDB) David Gajiq.²⁸⁴⁰ Kohë pas kohe, ndër të tjerë morën pjesë edhe Samarxhiqi,

kishte dëgjuar shprehjen të përdorej. Millomir Miniq, T. 14774–14778 (31 gusht 2007). *Shih gjithashtu* Velimir Obradoviq, T. 17414–17417 (22 tetor 2007) (ku thotë se shprehja përdorej në bisedë të lirë, por kishte kuptim disi përçmues në mesin e pjesëtarëve të ushtrisë).

²⁸³³ Dushko Matkoviq, T. 14614–14615 (29 gusht 2007), P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 10; Zoran Angjelkoviq, T. 14662–14663 (30 gusht 2007).

²⁸³⁴ Millomir Miniq, T. 14780 (31 gusht 2007).

²⁸³⁵ Millan Gjakoviq, T. 26445 (20 maj 2008).

²⁸³⁶ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët); *shih* Urdhri i Dytë në lidhje me Provat Materiale P1468 dhe IC199, 13 qershor 2008.

²⁸³⁷ Millan Gjakoviq, T. 26366 (19 maj 2008); *shih* Urdhri i Dytë në lidhje me Provat Materiale P1468 dhe IC199, 13 qershor 2008, para. 2 (ku shkruhet se "palët të deklarojnë bashkërisht (a) që prova materiale P1468 është kopje e fletore me shënime të shkruara me dorë nga Millan Gjakoviqi gjatë mbledhjeve në të cilat kishte marrë pjesë nga korriku deri në tetor 1998 dhe (b) se Gjakoviqi konfirmonte se ishte autor i shënimeve në P1468 deri më 21 tetor 1998").

²⁸³⁸ Millan Gjakoviq, T. 26373 (19 maj 2008).

²⁸³⁹ Millan Gjakoviq, T. 26366 (19 maj 2008).

²⁸⁴⁰ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët). Në procesverbal është shënuar sa herë që ndonjëri prej pjesëmarrësve nuk ka qenë i pranishëm dhe në një rast, më 23 korrik 1998, thuhet "të gjithë anëtarët e pranishëm," që sugjeron se anëtarësia e ngushtë përbëhej nga personat në listë. *Shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 532–533; Lubinko Cvetiq, T. 8077 (7 dhjetor 2006); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 78; Velimir Obradoviq, T. 17403 (22 tetor 2007)

Stevanoviqi, Stanishiçi, dhe Llazareviçi.²⁸⁴¹ Nga Shënime del se Miniçi dhe Shainoviçi kanë luajtur rol drejtues, duke mbikëqyrur mbledhjet dhe shpesh duke e drejtuar grupin.²⁸⁴² Gjakoviçi dëshmoi se pse i kishte titulluar shënime "Komanda e Përbashkët" dhe çfarë kuptimi kishte kjo shprehje. Atij nuk i kishte thënë askush shprehimisht në mbledhjen e parë se ishte mbledhje e Komandës së Përbashkët. Sidoqoftë, ai ia vuri këtë titull një ditë pas mbledhjes së parë pasi e kishte pyetur Pavkoviçin se si ta quante. Ai i tha që të vepronte në të njëjtën mënyrë siç kishte vepruar deri atëherë. Meqenëse tashmë e kishte përdorur shprehjen Komanda e Përbashkët në lidhje me bashkëpunimin midis ushtrisë dhe MPB-së, ai e përdori përsëri. Dhe vërtetë, siç është shpjeguar më lart, herën e parë që Gjakoviçi e përdori shprehjen Komanda e Përbashkët kishte qenë për një urdhër të lëshuar më 6 korrik 1998, i cili rregullonte marrëdhëniet midis MPB-së dhe UJ-së gjatë operacioneve luftarake. Ai gjithashtu deklaroi se shprehja "Komanda e Përbashkët" ishte përdorur para ardhjes dhe angazhimit të cilitdo prej organeve politike në Kosovë.²⁸⁴³

1060. Në mbledhjet në të cilat mori pjesë, Gjakoviçi shënonte "gjëra të cilat mendonte se do t'i vlenin si informacion dhe të dhëna që do t'a ndihmonin në kryerjen e detyrës në postin e tij, meqenëse në komandë ishte përgjegjës për zbatimin e bashkërendimit midis ... forcave të ndryshme në terren." Ai shënonte kryesisht "pyetjet ose çështjet që kishin të bënin me sigurinë, raportet e shkurtra të gjeneralëve Pavkoviçi dhe Llukiq në lidhje me gjendjen në njësitë e Korpusit të Prishtinës dhe në njësitë e Ministrisë së Brendshme, dhe komentet e bëra nga pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje." Ai tha se kishte qenë përzgjedhës në mbajtjen e shënimeve, përveç të dhënave të paraqitura nga RDB-ja.²⁸⁴⁴ Gjatë pyetjeve nga Prokuroria, Gjakoviçi tha se asnjëherë nuk i kishte rishikuar Shënime dhe asnjëherë nuk kishte kërkuar nga folësit që të sqaronin ndonjë gjë, megjithëse herë pas here i kishte kërkuar një folësi që të përsëriste diçka që nuk kishte qenë i sigurt nëse e kishte dëgjuar mirë.²⁸⁴⁵ Në përgjigje të pyetjeve të Dhomës, Gjakoviçi dëshmoi se "nuk ishte shkruar as gjysma e atyre që ishin thënë në të vërtetë në lidhje me temat politike."²⁸⁴⁶ Pas një kohe të shkurtër pasi Gjakoviçi ia kishte dorëzuar fletoren Tesheviçit për të vazhduar marrjen e shënimeve në mbledhje, u lëshua një urdhër për krijimin e arkivave me të gjitha dokumentet që

(duke dëshmuar që Miniçi, Shainoviçi, përfaqësues i MPB-së, dhe një person përgjegjës për operacione nga PrK-ja ishin të pranishëm).

²⁸⁴¹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët); *shih* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 532–533.

²⁸⁴² *Shih* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët).

²⁸⁴³ Millan Gjakoviçi, T. 26378–26381 (19 maj 2008), 26443–26444 (20 maj 2008).

²⁸⁴⁴ Millan Gjakoviçi, T. 26372–26375 (19 maj 2008).

²⁸⁴⁵ Millan Gjakoviçi, T. 26425–26426 (19 maj 2008).

²⁸⁴⁶ Millan Gjakoviçi, T. 26483–26484 (20 maj 2008).

kishin lidhje me operacionet luftarake të vitit 1998. Për këtë arsye Gjakoviçi e urdhëroi Tesheviçin që t'a dorëzonte fletoren në arkiv dhe nuk e kishte parë më origjinalin.²⁸⁴⁷

1061. Edhe pse palët kanë saktësuar se (a) prova materiale P1468 është kopje e fletores me shënimet e shkruara me dorë të Millan Gjakoviçit gjatë mbledhjeve në të cilat mori pjesë nga korriku deri në tetor 1998 dhe (b) se Gjakoviçi ka konfirmuar se ai është autor i shënimeve në P1468 deri më 21 tetor 1998,²⁸⁴⁸ në dosjen e vet përfundimtare, Mbrojtja e Shainoviçit argumenton se Shënimet nuk janë burim i besueshëm informacioni për çfarë është thënë në mbledhje.²⁸⁴⁹ Ka pasur shumë kundërshtime në lidhje me pranimin e Shënimeve si provë dhe Dhoma kishte konkluduar më herët se ato ofronin shumë elementë besueshmërie edhe para se Gjakoviçi të paraqitej për të dëshmuar se si ishin krijuar.²⁸⁵⁰ Për këtë arsye, pyetja është se sa rëndësi duhet t'u kushtojë Dhoma shënimeve.

1062. Meqenëse Shënimet nuk janë procesverbal zyrtar i mbledhjeve të Komandës së Përbashkët, por janë shënime të njërit nga pjesëmarrësit, ato nuk janë dokument gjithëpërfshirës i gjithçkaje të diskutuar nga pjesëmarrësit dhe nuk japin pasqyrë të plotë të këtij organi. Gjakoviçi dëshmoi se kishte marrë shënime aq sa kishte qenë e mundshme në lidhje me çështjet e sigurisë dhe se kishte mbajtur shënime kryesisht për gjërat që mund të ishin të rëndësishme për punën e tij. Për këtë arsye, ai shpesh nuk i përfshinte komentet politike: ai tha për veten se kishte qenë përzgjedhës në mbajtjen e shënimeve dhe, meqenëse nuk e njihte mirë terminologjinë politike, mund të ketë tentuar ta "përkthente atë në zhargon ushtarak."²⁸⁵¹ Shënimet përfshijnë lajmet e fundit për negociatat politike dhe zhvillime të tjera, por kryesisht përqendrohen në operacionet ushtarake dhe policore në lidhje me zbatimin e Planit. Dhoma konkludon se Shënimet – edhe pse nuk regjistrojnë gjithçka fjalë për fjalë dhe nuk janë gjithëpërfshirëse – mund të konsiderohen dokument mjaft i besueshëm i pjesëve të mbledhjeve të Komandës së Përbashkët, sidomos të veprimtarisë së MPB-së dhe UJ-së dhe të komenteve të bëra në lidhje me veprimtarinë e UJ-së dhe MPB-së, duke përfshirë edhe ato të pjesëmarrësve që nuk ishin pjesëtarë të UJ-së apo të MPB-së.

1063. Përmbajtja e Shënimeve është konfirmuar përmes dokumenteve të tjera të pranuar si prova. Për shembull, nga Shënimet del se angazhimi i njëjësive të UJ-së në përkrahje të forcave të MPB-së afër fshatrave Sllup dhe Voksh u diskutua në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të mbajtur më

²⁸⁴⁷ Millan Gjakoviçi, T. 26366–26368 (19 maj 2008).

²⁸⁴⁸ Urdhri i Dytë në lidhje me Provat Materiale P1468 dhe IC199, 13 qershor 2008, para. 2.

²⁸⁴⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 189–204.

²⁸⁵⁰ Vendim mbi Pranimin e Provave Materiale P1000, P1249, P1418, P1460, P1468, P1503, P1898, P1966, P1967, P2031, P2113, dhe P2166, 15 shkurt 2007; Vendim mbi Mocionet e Shainoviçit në lidhje me Provën Materiale P1468, 21 nëntor 2007; Vendim mbi Mocionin e Dytë të Shainoviçit për Pranimin e Provave Shkresore në Sallën Gjyqësore, 28 nëntor 2007.

13 gusht 1998. Kjo konfirmohet nga fakti se më 14 gusht 1998 Komanda e Korpusit të Prishtinës lëshoi një vendim me të cilin i udhëzonte njësitë në varësi të saj që të angazhoheshin në një operacion të përbashkët në sektorin e fshatrave Sllup dhe Voksh, siç është diskutuar më lart.²⁸⁵² Një shembull tjetër është raporti i datës 22 shtator 1998 i Komandës së Korpusit të Prishtinës dërguar Komandës së Armatës së 3-të, në të cilin thuhej se në një mbledhje në Beograd më 31 gusht 1998 e kryesuar nga Presidenti i RFJ-së, ishte arritur marrëveshje për një plan për zbatimin e fazës së pestë të luftës kundër terrorizmit në Kosovë. Në raportin e tij, Pavkoviqi informonte se, në vazhdim të diskutimit në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të 10 shtatorit 1998, ku ishte raportuar se disa detyra të fazës së pestë të Planit nuk ishin përfunduar, Komanda e Përbashkët mori vendim që të bënte kërkesë për kryerjen e këtyre detyrave, konkretisht, që të formoheshin njësi të helikopterëve për ndërhyrje të shpejtë dhe të bëhej mobilizimi i dy grupeve të luftimit për në Kosovë.²⁸⁵³ Në Shënime, por për datën 11 shtator 1998, jo 10 shtator, Pavkoviqi raportonte se "do të përsërisim kërkesën për 'GL' dhe 'njësitë'" duke konfirmuar sërish përmbajtjen e fletores.²⁸⁵⁴ Ka edhe shembuj të tjerë të ngjashëm.²⁸⁵⁵

1064. Gjatë dëshmisë gojore të Gjakoviqit, Prokuroria propozoi që atij t'i kërkohej që të sqaronte disa pjesë të palexueshme të Shënimeve. Dhoma dëgjoi mendimet e palëve në lidhje me mënyrën më efikase për ta bërë këtë, për shkak të shumë pjesëve të palexueshme që ishin përmendur nga Mbrojtja e Shainoviqit. Zgjidhja e gjetur ishte që Gjakoviqi brenda natës të shqyrtonte disa pjesë të palexueshme të identifikuara nga palët dhe t'i shkruante qartë në një dokument të ri ato që kishte shkruar në Shënime. Dhoma e bëri të qartë se ishte interesuar të merrte sa më shumë sqarime, por ishte thjesht e pamundshme që të shqyrtoheshin një për një të gjitha pjesët e identifikuara nga Mbrojtja e Shainoviqit.²⁸⁵⁶ Pas përcaktimit të kësaj zgjidhjeje në konsultim me palët, avokati i Shainoviqit deklaroi:

Siç e dini, janë mbi 1.600 gabime në dokumentin të cilin ne e kemi shkruar në përkthim, nëse mbetet ashtu me aq shumë – aq shumë përkthime në dokument ose jo. Unë me të vërtetë nuk kam problem me këtë, por ato janë gabime, kështu që varet nga ju se a do të korrigjohen apo jo. Dua të them se nuk dua të këmbëngul. Nuk dua ta zgjas procesin. Kjo është shkruar në nëntor, kurse aktualisht jemi në maj, por ju do të kenë dokument jo të

²⁸⁵¹ Millan Gjakoviç, T. 26375 (19 maj 2008).

²⁸⁵² *Krahaso* P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998), *me* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 52, 54. Në lidhje me fshatrat e përmendura në aksion, në përkthimin anglisht të Shënimeve thuhet "Vonsa dhe Stanpo"; sidoqoftë, Lazareviqi e lexoi pjesën në fjalë nga versioni BKS si "Vokshi dhe Sllupi." Vladimir Lazareviq, T. 18298 (14 nëntor 2007).

²⁸⁵³ P1435 (Raport mbi Zbatimin e Fazës së 5-të të Planit Kundër Terrorizmit, 22 shtator 1998), f. 2.

²⁸⁵⁴ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 102–104.

²⁸⁵⁵ *Krahaso* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 94, *me* 4D230 (Armata e 3-të i drejtohet PrK-së, Refuzim i kërkesës për përdorimin e helikopterëve, 12 shtator 1998). *Krahaso* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 124, *me* P1439 (Përgjigje nga Komanda e PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 5 tetor 1998).

²⁸⁵⁶ T. 26476–26477, 26511–26512 (20 maj 2008), T. 26531 (21 maj 2008).

plotë, dhe kjo më shqetëson sepse, vërtetë, secili nga këto gabime që tregova është aty, dhe varet nga ju se si do të vendosni, dhe unë nuk do të kem kundërshtim.²⁸⁵⁷

Pas kësaj, Mbrojtja e Shainoviqit nuk këmbënguli në kundërshtimet e veta mbi pjesët e palexueshme të Shënimeve dhe madje u pajtua që korrigjimet të pranoheshin si prova dhe të bëheshin pjesë e provës materiale.²⁸⁵⁸ Me gjithë qëndrimin e saj të mëparshëm, Mbrojtja e Shainoviqit në dosjen e saj përfundimtare i ringre 1,572 kundërshtimet e veta në lidhje me provën materiale dhe ankohet se Dhoma nuk i kërkoi Gjakoviqit që t'i sqaronte të gjitha këto pjesë.²⁸⁵⁹ Duke u bazuar në sa më sipër, Dhoma gjykon se është hequr dorë nga kundërshtimet e mëtejshme në lidhje me këtë çështje sepse Mbrojtja e Shainoviqit e ka pasur rrugën e hapur që t'i sqarojë këto pjesë me interes të posaçëm gjatë dëshmisë së Gjakoviqit, dhe asnjë shënim konkret në të cilin mbështetet Prokuroria nuk është identifikuar nga Mbrojtja e Shainoviqit. Sidoqoftë, Dhoma ka marrë parasysh gjatë shqyrtimit faktin se disa pjesë të Shënimeve janë të palexueshme dhe i ka peshuar provat si tërësi në lidhje me këtë çështje gjatë nxjerrjes së konkluzioneve nga Shënimet. Edhe nëse Dhoma do t'i kishte konsideruar të vlefshme kundërshtimet, ajo do të vepronte në të njëjtën mënyrë dhe do të arrinte në përfundime të njëjta.

(B) Natyra e Komandës së Përbashkët

1065. Të gjithë anëtarët e Grupit të Punës këmbëngulën se mbledhjet e përditshme në Prishtinë ishin joformale: nuk mbaheshin procesverbale, pjesëmarrësit shpesh ishin të ndryshëm, dhe nuk kishte sistem hierarkie as midis pjesëmarrësve, as ndaj organeve shtetërore të tjera.²⁸⁶⁰ Matkoviqi dëshmoi se mbledhjet e Komandës së Përbashkët i "kushtoheshin informimit dhe bashkërendimit të veprimeve për normalizimin e jetës."²⁸⁶¹ Angjelkoviqi gjithashtu shpjegoi se anëtarët e Grupit të Punës ishin emëruar dhe dërguar në Kosovë "që të ndihmonin para së gjithash në stabilizimin e gjendjes politike në Kosovë."²⁸⁶² Sipas Matkoviqit, mbledhjet ishin "thjesht mbledhje ditore politike me Shainoviqin, policinë, dhe ushtrinë." Ato ishin "më shumë të karakterit informativ." Ai shtoi se këto mbledhje ishin "mundësi e shkëlqyer për informimin e ushtrisë dhe policisë ... për çfarë kishte dëgjuar dhe parë" nga popullata civile. Për më tepër, Matkoviqi ishte i interesuar për

²⁸⁵⁷ T. 26511 (20 maj 2008).

²⁸⁵⁸ Urdhri i Dytë në lidhje me Provat Materiale P1468 dhe IC199, 13 qershor 2008, para. 2 (që thotë se "palët deklarojnë së bashku (a) se prova materiale P1468 është kopje e fletores që përmban shënimet të shkruara me dorë nga Millan Gjakoviqi gjatë mbledhjeve në të cilat kishte marrë pjesë nga korriku deri në tetor 1998 dhe (b) se Gjakoviqi ka konfirmuar se është autor i shënimeve në P1468 deri më 21 tetor 1998").

²⁸⁵⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 204.

²⁸⁶⁰ Dushko Matkoviqi, T. 14588 (29 gusht 2007), P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 10; Zoran Angjelkoviqi, T. 14687–14690 (30 gusht 2007); Millomir Miniq, T. 14749–14752 (31 gusht 2007).

²⁸⁶¹ Dushko Matkoviqi, T. 14588, T. 14644–14645 (30 gusht 2007) (sipas Matkoviqit, qëllimi i Grupit të Punës ishte "të normalizonte jetën"), P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 9 (anëtarët e Grupit të Punës mbledheshin "për të shkëmbyer informata midis pjesëmarrësve të rëndësishëm").

²⁸⁶² Zoran Angjelkoviqi, T. 14687 (30 gusht 2007).

marrjen e informatave nga policia dhe ushtria për çështjet e sigurisë që kishin ndikim në "fabrika dhe gjëra për të cilat ai ishte përgjegjës."²⁸⁶³ Miniqi konfirmoi dëshminë e Matkoviqit duke thënë se mbledhjet e Komandës së Përbashkët ishin "joformale": këto mbledhje ishin të dobishme, sepse në një anë anëtarët e Grupit të Punës merrnin informata nga MPB-ja dhe UJ-ja dhe në anën tjetër anëtarët e UJ-së dhe MPB-së merrnin informata nga anëtarët e Grupit të Punës "për ndjenjat e popullatës."²⁸⁶⁴ Matkoviqi gjithashtu theksoi se mbledhjet e Komandës së Përbashkët "nuk kishin kompetencë për vendime të formës së prerë që do të ishin të detyrueshme për t'u zbatuar."²⁸⁶⁵

1066. Matkoviqi shpjegoi se pas mbledhjeve të përditshme, ai nuk dërgonte raporte në Beograd. Gjithashtu, ai nuk pati kontakte me udhëheqjen politike gjatë qëndrimit të tij në Kosovë. As Grupi i Punës nuk dërgonte raporte me shkrim në Beograd. Ai kujtoi se anëtarët e Grupit të Punës e kontaktuan Millosheviqin dy ose tri herë, por vetëm kur gjendja ishte shumë e rëndësishme. Sipas mendimit të tij, mbledhjet kishin "pasur rol pozitiv në kryerjen e aksioneve."²⁸⁶⁶

1067. Gjakoviqi dëshmoi se mbledhjet e Komandës së Përbashkët zakonisht ishin mbajtur në ndërtesën e Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm, por e para mbledhje në të cilën mori pjesë ishte mbajtur në ndërtesën e MPB-së. Rreth 35 deri 60% e kohës në mbledhje i kushtohej çështjeve të sigurisë dhe pjesa tjetër raportimeve të Pavkoviqit dhe Llukiqit mbi veprimet e njëjësive të UJ-së dhe MPB-së gjatë asaj dite. Më tej pjesëmarrësit politikë flisnin për aspekte të ndryshme brenda përgjegjësisë të veta. Shainoviqi diskutonte politikën e jashtme, Miniqi autoritetet vendore, Angjelkoviqi njësitë e mbrojtjes civile, dhe Matkoviqi ekonominë. Shpjegimi i Gjakoviqit për këto mbledhje ishte se ato zhvilloheshin kryesisht për shkëmbimin e informatave me qëllim bashkërendimin e veprimeve midis MPB-së dhe UJ-së.²⁸⁶⁷ Këto mbledhje gjithashtu i mundësuan marrje informatash nga RDB-ja, gjë që kishte qenë shumë e vështirë para se të mbaheshin mbledhjet.²⁸⁶⁸ Gjatë dëshmisë së tij në gjykatë, Gjakoviqi theksoi se i kishte lexuar Shënime të përsëri dhe se në to nuk përmendej asnjë vendim apo urdhër i marrë nga Komanda e Përbashkët. Ai shpjegoi se të vetmet urdhra në Shënime ishin ato që përmendeshin nga Llukiqi dhe Pavkoviqi: këta urdhra, sipas tij, ishin miratuar më parë nga eprorët e tyre.²⁸⁶⁹

²⁸⁶³ P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 10–12.

²⁸⁶⁴ Millomir Miniqi, T. 14749 (31 gusht 2007). Miniqi gjithashtu tha se, gjatë mbledhjeve, ata "vetëm kishin shkëmbyer informata."

²⁸⁶⁵ P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 10.

²⁸⁶⁶ P2913 (deklaratë dëshmitari e datës 10 shkurt 2003), f. 10–11.

²⁸⁶⁷ Millan Gjakoviqi, T. 26380, 26383 (19 maj 2008).

²⁸⁶⁸ Millan Gjakoviqi, T. 26375 (19 maj 2008); Millomir Miniqi, T. 14750–14751 (31 gusht 2007).

²⁸⁶⁹ Millan Gjakoviqi, T. 26379–26380 (19 maj 2008).

1068. Ish-shefi i degës së sigurimit të Korpusit të Prishtinës, Momir Stojanović, konfirmoi se mbledhjet e përditshme të Komandës së Përbashkët ishin mbajtur në vitin 1998, por theksoi se ai personalisht nuk kishte marrë pjesë në asnjë prej tyre. Ai pranoi se kishte marrë informata për këto mbledhje nga Gjakoviçi. Sidoqoftë, me gjithë dëshminë e kundërt të Aleksandar Vasileviçit, Stojanović mohoi t'i kishte raportuar Aleksandar Dimitrijeviçit për mbledhjet e Komandës së Përbashkët.²⁸⁷⁰ Dimitrijeviçi dëshmoi se Stojanović i kishte thënë se në Prishtinë mbaheshin mbledhje joformale në mbrëmje midis Komandës së Korpusit të Prishtinës dhe disa civilëve gjatë lajmeve të mbrëmjes. Stojanović, i cili nuk kishte marrë pjesë në mbledhje, gjithashtu i kishte thënë se ndër pjesëmarrësit e mbledhjeve ishin Shainović, Matković, Angjelković, Miniçi, dhe Pavković.²⁸⁷¹ Dimitrijeviçi krijoi përshtypjen se mbledhjet kishin qenë në lidhje me "një lloj bashkërendimi," dhe supozoi se kishte qenë midis MPB-së dhe ushtrisë.²⁸⁷² Asnjë raport nga këto mbledhje nuk i ishte dorëzuar Administratës së Sigurimit të UJ-së.²⁸⁷³

1069. Branko Gajiçi dëshmoi se Dimitrijeviçi i kishte thënë dikur në fund të qershorit ose në fillim të korrikut 1998 se Komanda e Përbashkët ishte një lloj organi bashkërendues. Gajiçi gjithashtu dëshmoi se Shainović dhe Miniçi ishin dërguar posaçërisht në Kosovë që të bashkërendonin veprime të caktuara politike dhe ekonomike dhe veprimet midis UJ-së dhe MPB-së në luftë kundër terrorizmit.²⁸⁷⁴ Kjo dëshmi përputhet me deklaratën e Dimitrijeviçit se Stojanović i kishte thënë se në Prishtinë mbaheshin mbledhjet bashkërenduese.²⁸⁷⁵ Sidoqoftë, kur u pyet nga Mbrojtja e Shainovićit, ai ndërroi qëndrimin në lidhje me Komandën e Përbashkët, duke thënë se Dimitrijeviçi nuk e kishte përdorur asnjëherë shprehjen "Komanda e Përbashkët" dhe se nuk e kishte dëgjuar këtë shprehje para përgatitjeve për dhënien e dëshmisë. Ai gjithashtu pati të njëjtin mendim me Mbrojtjen e Shainovićit se gjatë mbledhjeve në fjalë nuk kishte pasur ndërhyrje në komandën e MPB-së dhe UJ-së.²⁸⁷⁶

1070. Velimir Obradović, ish-shef i kabinetit të Komandës së Armatës së 3-të, gjithashtu dëshmoi se kishte marrë pjesë në një mbledhje të Komandës së Përbashkët në korrik 1998, dhe se Miniçi e kishte hapur dhe mbyllur mbledhjen dhe se kishte marrë kërkesa, duke përfshirë edhe një nga Pavković, i cili kishte këmbëngulur në pajisje speciale dhe në jelekë antiplumb. Kjo kishte

²⁸⁷⁰ Momir Stojanović, T. 20047–20048, 20053, 20055 (11 dhjetor 2007).

²⁸⁷¹ Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26619–26620 (8 korrik 2008).

²⁸⁷² Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26620 (8 korrik 2008). Dhoma qartësoi me dëshmitarin se ai kishte dashur të thoshte se kishte menduar njëherazi se qëllimi i mbledhjeve ishte bashkërendimi me MPB-në, dhe se MPB-ja nuk përfaqësohej rregullisht.

²⁸⁷³ Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26621 (8 korrik 2008).

²⁸⁷⁴ Branko Gajiçi, T. 15412 (11 shtator 2007).

²⁸⁷⁵ Aleksandar Dimitrijeviçi, T. 26619–26620 (8 korrik 2008).

²⁸⁷⁶ Branko Gajiçi, T. 15439–15446 (12 shtator 2007).

krijuar përshtypjen e rolit civil në administrimin e burimeve ushtarake.²⁸⁷⁷ Obradoviqi gjithashtu tha se në mbledhje Shainoviqi vetëm kishte dëgjuar në mënyrë që të ishte në gjendje t'i përcillte informatat te personat e tjerë.²⁸⁷⁸

1071. Ka dëshmi se organi i quajtur Komanda e Përbashkët u krijua e se nuk lindi spontanisht. Lubinko Cvetiqi, ish-shef i SPB-së së Mitrovicës, dëshmoi se në mbledhjen e Shtabit të MPB-së në Prishtinë më 10 korrik 1998, të gjithë shefat e SPB-ve të Kosovës u informuan për krijimin e një komande në nivelin më të lartë me mision që të integronte veprimet e ushtrisë dhe policisë në zbatimin e operacioneve antiterroriste.²⁸⁷⁹ Cvetiqi gjithashtu dëshmoi se, në një mbledhje të mbajtur në sallën e konferencave të MPB-së në Prishtinë më 22 korrik 1998, Gjorgjeviqi kishte ritheksuar krijimin e "Komandës së Përbashkët" të përbërë nga Shainoviqi, Matkoviqi, Miniqi, Llukiqi, Pavkoviqi, Angjelkoviqi, dhe Gajiqi.²⁸⁸⁰ Sa për rolet e ndryshme të pjesëmarrësve, ai dha një shembull se Matkoviqit i ishin besuar aktivitetet ekonomike, kurse Shainoviqit i ishte besuar bashkërendimi midis ushtrisë dhe policisë.²⁸⁸¹ Sidoqoftë, Miroslav Mijatoviqi, zëvendës-shef i Shtabit të MPB-së, Radovan Vuçureviqi, anëtar i Shtabit të MPB-së, dhe Dushko Adamoviqi, ndihmës i Llukiqit, hodhën poshtë dëshminë e Cvetiqit dhe thanë se në mbledhjen e 22 korrikut nuk ishte diskutuar mundësia e krijimit të Komandës së Përbashkët dhe Shainoviqi nuk kishte qenë kryesues i një organi të tillë.²⁸⁸² Në gjykim u paraqit procesverbali i një mbledhjeje të pjesëtarëve të lartë të MPB-së që ishte mbajtur në Shtabin e MPB-së në Prishtinë në atë datë.²⁸⁸³ Ky dokument nuk është i plotë dhe rrjedhimisht nuk e ndihmon Dhomën për ta zgjidhur konfliktin. Sidoqoftë, është veçanërisht domethënëse se mbledhja e parë e regjistruar në Shënime është mbledhja e Komandës së Përbashkët e datës 22 korrik 1998.²⁸⁸⁴ Edhe pse Gjakoviqi ishte këmbëngulës se ai do ta kishte shënuar nëse në atë mbledhje do të ishte krijuar ndonjë komandë,²⁸⁸⁵ kjo është e parëndësishme për Dhomën sepse dëshmia e Cvetiqit bën fjalë për krijimin e mëhershëm të këtij organi dhe konfirmon mbledhjen e MPB-së të 22 korrikut.

1072. Zllatomir Peshiqi, komandant i Qarkut Ushtarak të Prishtinës, tha se e dinte se Komanda e Përbashkët u krijua në vitin 1998 për të bashkërenduar UJ-në me MPB-në. Peshiqi dinte se

²⁸⁷⁷ Velimir Obradoviq, T. 17403 (22 tetor 2007).

²⁸⁷⁸ Velimir Obradoviq, T. 17420–17421 (22 tetor 2007).

²⁸⁷⁹ Lubinko Cvetiq, T. 8051–8052 (7 dhjetor 2006).

²⁸⁸⁰ Lubinko Cvetiq, T. 8077 (7 dhjetor 2006), 8123 (8 dhjetor 2006).

²⁸⁸¹ Lubinko Cvetiq, T. 8124 (8 dhjetor 2006).

²⁸⁸² Miroslav Mijatoviq, T. 22284 (13 shkurt 2008); Radovan Vuçureviq, T. 23130–23131 (25 shkurt 2008); Dushko Adamoviq, T. 24967–24968 (8 prill 2008).

²⁸⁸³ 6D798 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 22 korrik 1998).

²⁸⁸⁴ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 2.

²⁸⁸⁵ Millan Gjakoviq, T. 26413 (19 maj 2008), T. 26539 (21 maj 2008).

Pavkoviqi, Llazareviqi, dhe Stojanoviqi merrnin pjesë në këto mbledhje.²⁸⁸⁶ Gjithsesi Dhoma Gjyqësore vëren se në Shënime nuk përmendet prania e Momir Stojanoviqit në ndonjë nga mbledhjet, nga korriku deri në tetor 1998. Në fakt, nga dëshmia e Peshiqit nuk është e qartë nëse mbledhjet në të cilat kishin marrë pjesë Pavkoviqi, Llazareviqi, dhe Momir Stojanoviqi ishin mbledhje të Komandës së Përbashkët të mbajtur në Këshillin Ekzekutiv të Përkohshëm ose mbledhje bashkërenduese midis përfaqësuesve të UJ-së dhe MPB-së për të bashkërenduar aktivitetet e UJ-së dhe MPB-së gjatë operacioneve të përbashkëta. Miodrag Simiqi dëshmoi se për herë të parë kishte dëgjuar për Komandën e Përbashkët kur gjeneral Samarxhiqi kishte lëshuar një urdhër për Pavkoviqin që të merrte pjesë në këto mbledhje dhe t'i raportonte Simiqit.²⁸⁸⁷

1073. Disa dëshmitarë mohuan kategorikisht ekzistencën e ndonjë organi të quajtur Komanda e Përbashkët. Disa politikanë të Serbisë dhe të RFJ-së që dëshmuuan thanë se jo vetëm se nuk kishin dëgjuar për një organ të tillë, por edhe se ekzistenca e tij nuk lejohej me Kushtetutë.²⁸⁸⁸ Për më tepër, shumë nga ushtarakët që dëshmuuan, thanë se në organigramën e UJ-së nuk kishte ekzistuar një institucion i tillë.²⁸⁸⁹ Dhomës nuk i bën përshtypje ky teknokratizëm ligjor. Kjo nuk është e vetmja temë për të cilën u demonstrua një qëndrim i tillë. Dhoma e konsideron detyrë të saj të përcaktojë se çfarë ka ndodhur në të vërtetë, duke marrë parasysh të gjitha provat e rëndësishme që kanë pasur ndikim në ngjarjet në terren dhe të gjitha dispozitat ligjore në fuqi. Në këtë linjë duhet të theksohet se Andreja Millosavleviqi dëshmoi se, edhe pse nuk kishte dëgjuar për ndonjë organ të quajtur Komanda e Përbashkët, ai ishte në dijeni për mbledhjet e përbashkëta të strukturave shtetërore dhe politike në verë të vitit 1998 në Kosovë.²⁸⁹⁰ Llazareviqi gjithashtu pranoi se kishte marrë pjesë së paku në katër mbledhje në Prishtinë në vitin 1998 së bashku me Pavkoviqin, në të cilat kishin marrë pjesë pjesëtarët e UJ-së dhe MPB-së si dhe disa politikanë dhe zyrtarë

²⁸⁸⁶ Zllatomir Peshiq, P2502 (deklaratë dëshmitari e datës 30 janar 2004), para. 32.

²⁸⁸⁷ Miodrag Simiq, T. 15683–15684 (14 shtator 2007); *shih gjithashtu* 4D91 (Urdhër i Dushan Samarxhiqit në lidhje me Organizimin e Punës së Ushtrisë, 30 korrik 1998).

²⁸⁸⁸ Momir Bullatoviq, T. 13856 (17 gusht 2007); Ratko Markoviq, T. 13424 (13 gusht 2007); Zhivadin Jovanoviq, T. 14069–14070 (20 gusht 2007); Velko Odalloviq, T. 14417 (27 gusht 2007); Zoran Mijatoviq, T. 14569–14570 (29 gusht 2007).

²⁸⁸⁹ Millorad Obradoviq, T. 15091, 15095–15096 (6 shtator 2007); Zllatoje Terziq, T. 15921 (19 shtator 2007); Millovan Vllajkoviq, T. 16100–16101 (20 shtator 2007); Stanisha Ivkoviq, T. 16532, 16540–16542 (27 shtator 2007); Spasoje Smilaniq, T. 15782 (17 shtator 2007); Lubomir Angjelkoviq, T. 16431 (26 shtator 2007) (dëshmoi se kishte dëgjuar të flitej për Komandën e Përbashkët, po më vonë gjithashtu tha se, po të kishte ekzistuar një komandë e tillë, ai do ta kishte vërejtur); Lubisha Stojimiroviq, T. 17708–17710 (26 tetor 2007); Millosh Mandiq, T. 20926–20929 (23 janar 2008); Vladimir Marinkoviq, T. 20298 (13 dhjetor 2007); Goran Jevtoviq, T. 20395 (16 janar 2007); *Krahaso*: Dragan Zhivanoviq, T. 20508 (17 janar 2008) (i cili kishte kërkuar shpjegime për shprehjen kur e kishte dëgjuar për herë të parë sepse ishte e "palogjikshme"); Bozhidar Deliq, T. 19490 (4 dhjetor 2007) (i cili dëshmoi se, edhe pse i shkruante urdhrat për vartësit e tij duke u bazuar në ato që kishte marrë nga komandanti i tij, ai "zakonisht nuk lejonte" të përdorej emërtimi "Komanda e Përbashkët" sepse do të shkaktonte huti të oficerët e tij); Millan Kotur, T. 20715 (21 janar 2008); Radojko Stefanoviq, T. 21795–21796 (6 shkurt 2008); Branko Kërğa, T. 16858 (4 tetor 1998). *Shih gjithashtu* Andreja Millosavleviq, T. 14377–14378 (24 gusht 2007).

²⁸⁹⁰ Andreja Millosavleviq, T. 14306–14307 (23 gusht 2007).

shtetërorë.²⁸⁹¹ Sipas Bozhidar Deliqit, drejtues ushtarakë dhe civilë ishin të pranishëm në Kosovë, por jo për bashkërendimin e aksioneve midis UJ-së dhe MPB-së; ata ishin atje si përfaqësues të qeverisë për mbajtjen e kontakteve midis organizatave ndërkombëtare në Kosovë dhe përfaqësuesve të qeverisjes vendore.²⁸⁹² Ai gjithashtu tha se kishte qenë pothuajse përditë në kontakt me Pavkoviqin në vitin 1998 dhe se Pavkoviqi nuk e kishte përmendur asnjëherë Komandën e Përbashkët.²⁸⁹³ Disa nga pjesëtarët e tjerë të UJ-së dëshmuuan se kishin dëgjuar për Komandën e Përbashkët. Sidoqoftë, për shkak të faktit se ajo nuk ishte pjesë përbërëse e hierarkisë komanduese, ata shprehen shumë pak interes për pushtetin komandues që i atribuohet apo për ndikimin e saj mbi njëjtesinë e komandës së UJ-së.²⁸⁹⁴ Gjithsesi Dhoma nuk është e bindur nga ky qëndrim i oficerëve me përvojë të UJ-së dhe gjykon se ata nuk ishin krejtësisht të sinqertë në këtë pikë konkrete.

1074. Miroslav Mijatoviqi dëshmoi se shprehjen "Komanda e Përbashkët" e kishte dëgjuar në vitin 1998 dhe dinte se Llukiqi merrte pjesë në mbledhje mbrëmjeve. Sidoqoftë, ai nuk e kishte ditur asnjëherë saktësisht çfarë kuptimi kishte "Komanda e Përbashkët" dhe asnjëherë nuk hasi personalisht një organ të tillë, dhe për këtë arsye asnjëherë nuk i konsideroi këto mbledhje në mbrëmje si mbledhje të Komandës së Përbashkët.²⁸⁹⁵ Ai mori pjesë në një nga këto mbledhje më 22

²⁸⁹¹ Vladimir Llazareviq, T. 18139–18141 (12 nëntor 2007), 18459–18464 (16 nëntor 2007).

²⁸⁹² Bozhidar Deliq, T. 19576–19577 (5 dhjetor 2007).

²⁸⁹³ Bozhidar Deliq, T. 19494 (4 dhjetor 2007).

²⁸⁹⁴ Gjorgje Qurçin, T. 16972 (5 tetor 2007), 17043–17046 (16 tetor 2007); Sillobodan Kosovac, T. 15870–15873 (18 shtator 2007); Tomisllav Mlladenoviç, T. 17600, 17603–17604 (25 tetor 2007); Momir Stojanoviç, T. 19765 (7 dhjetor 2007). Radovan Radinoviç pranoi se nuk do të kishte kuptim që një oficer i lartë UJ-së të mos pyeste për shprehjen, përveç nëse e dinte kuptimin e saj. Radovan Radinoviç, T. 17332–17333 (19 tetor 2007). Sidoqoftë, Dragan Zhivanoviç dhe Radojko Stefanoviç dëshmuuan se në fakt kishin kërkuar shpjegim për shprehjen Komanda e Përbashkët nga Komanda e Korpusit herën e parë që e kishin dëgjuar dhe kishin marrë përgjigje se ajo i referohej bashkërendimit midis MPB-së dhe UJ-së. Dragan Zhivanoviç, T. 20508 (17 janar 2008); Radojko Stefanoviç, T. 21793–21794 (6 shkurt 2008). Disa dëshmitarë të UJ-së pranuan se kishin dëgjuar për një organ bashkërendues në Kosovë, por theksuan se ai nuk kishte ndonjë kompetencë komanduese mbi UJ-në apo MPB-në. Velimir Obradoviç tha se Komanda e Përbashkët ishte një grup civilësh të cilët kishin ardhur për të krijuar bashkërendim më të mirë midis komandave të ushtrisë dhe personelit komandues të MPB-së, por ata nuk kishin kompetenca komanduese e as pushte komandues real. Velimir Obradoviç, T. 17417–17418 (22 tetor 2007). Momir Stojanoviç dëshmoi se Komanda e Përbashkët kishte qenë organ bashkërendues, por nuk kishte marrë vendime për përdorimin e njësive të PrK-së. Momir Stojanoviç, T. 19763 (7 dhjetor 2007). Tomisllav Mlladenoviç dëshmoi se, ndërsa do të kishte qenë shumë më e thjeshtë po të kishte ekzistuar vetëm një komandë për UJ-në dhe MPB-në në Kosovë, në realitet kishte pasur bashkërendim "në nivel të barabartë". Tomisllav Mlladenoviç, T. 17616 (25 tetor 2007). Ai gjithashtu tha se bashkërendimi kishte ndodhur në nivelin operativ — kryesisht si shkëmbim informatash — dhe se nuk kishte pasur nevojë për një palë të tretë për mbikëqyrjen e procesit apo bashkërendimin e veprimeve të UJ-së dhe MPB-së. Tomisllav Mlladenoviç, T. 17603, 17621–17622 (25 tetor 2007). Bozhidar Deliq dëshmoi po ashtu se, me sa dinte ai, bashkërendimi ishte bërë në nivel të PrK-së. Bozhidar Deliq, T. 19496–19497 (4 dhjetor 2007). Në anën tjetër, Zhivanoviç dëshmoi se Gjakoviç i kishte thënë se bashkërendimi midis MPB-së dhe UJ-së ishte bërë "në nivelin më të lartë," frazë që Zhivanoviç e interpretoi ose se ishte fjala për një organ më të lartë në hierarki ose se ministri i Brendshëm dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm lëshonin urdhra për MPB-në dhe UJ-në. Dragan Zhivanoviç, T. 20513–20514 (17 janar 2008). Gjakoviç nuk e mohoi se mund të kishte përdorur shprehjen "në nivelin më të lartë," por këmbënguli se Komanda e Përbashkët përbëhej vetëm nga Shtabi i MPB-së dhe Komanda e PrK-së. Millan Gjakoviç, T. 26434–26435 (19 maj 2008).

²⁸⁹⁵ Miroslav Mijatoviç, T. 22408 (14 shkurt 2008).

tetor 1998, por në atë kohë nuk mendoi se kishte marrë pjesë në një mbledhje të Komandës së Përbashkët.²⁸⁹⁶

1075. Disa punonjës të tjerë të MPB-së të ftuar nga Mbrojtja e Llukiqit, deklaruan se nuk kishin dëgjuar e as nuk dinin gjë për ekzistencën e organit të quajtur Komanda e Përbashkët në vitin 1998. Lubivoje Joksiqi, ndihmëskoordinator i RDB-së në Kosovë në vitin 1998, dëshmoi se në vitin 1998 ishin mbajtur mbledhje midis pjesëtarëve të MPB-së dhe UJ-së, por këto nuk ishin të ndryshme nga bashkëpunimi dhe shkëmbimi i rregullt i informatave midis ushtrisë dhe sigurimit publik, që kishte ndodhur gjithmonë. Ai kishte marrë pjesë në disa mbledhje bashkërenduese të mbajtura në Komandën e Korpusit të Prishtinës ose në ndërtesën e SPB-së në Prishtinë,²⁸⁹⁷ por në Shënimet e mbledhjeve të Komandës së Përbashkët që është pranuar si provë nuk përmendet prania e tij në ndonjë nga mbledhjet e shënuara aty nga korriku deri në tetor 1998. Duket se mbledhjet të cilave u referohet Joksiqi gjatë dëshmisë së tij, nuk kanë qenë mbledhje të Komandës së Përbashkët të mbajtura në Këshillin Ekzekutiv të Përkohshëm, por mbledhje bashkërenduese të mbajtura midis përfaqësuesve të UJ-së dhe MPB-së për bashkërendimin e veprimeve të UJ-së dhe MPB-së gjatë operacioneve të përbashkëta.

1076. Gjithashtu është pranuar si provë edhe një intervistë e Momir Stojanoviçit për gazetën *Nedelni Telegraph* e cila pasqyron një raport zbulimi dërguar Komandës së Përbashkët. Ky raport mban datën 11 nëntor 1998 dhe është nënshkruar nga Stojanoviçi. Ai përmbante një përmbledhje të informatave për veprimet aktuale dhe madhësinë numerike të UÇK-së.²⁸⁹⁸ Stojanoviçi dëshmoi se, për shkak se titulli, "Për Komandën e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë," është në qendër të faqes, mund të duket se dokumenti nuk i është dërguar askujt: sipas rregullave për korrespondencën zyrtare ushtarake, adresat duhej të shkruheshin në kënd të faqes.²⁸⁹⁹ Ai tha se ishte vetëm një përmbledhje informatash dhënë një oficeri operativ.²⁹⁰⁰ Millan Gjukiçi dëshmoi se të gjitha raportet në lidhje me funksionimin e bashkërendimit duhej të shkonin përmes tij. Mirëpo ai nuk foli për çështjen e marrësit ose qëllimit të këtij raporti konkret.²⁹⁰¹ Ai as nuk shpjegoi se pse ishte zgjedhur titulli që i referohej Komandës së Përbashkët.

1077. Ndër dokumentet e tjera të pranuar si prova që i referohen Komandës së Përbashkët është edhe një numër i gazetës *Vojska* e vitit 2001. Në *Vojska* bëhej e ditur se në fillim të vitit 1998, me iniciativë të Shtabit të Përgjithshëm u botua një "Udhëzues për efektivin e forcave të dislokuara në

²⁸⁹⁶ Miroslav Mijatoviç, T. 22232 (12 shkurt 2008).

²⁸⁹⁷ Lubivoje Joksiqi, T. 22007–22008 (8 shkurt 2008).

²⁸⁹⁸ P2945 (intervistë e Momir Stojanoviçit në *Nedelni Telegraph*, 22 nëntor 2000), f. 10–11.

²⁸⁹⁹ Shprehja "Komanda e Korpusit të Prishtinës" shënohej në kënd të faqes.

²⁹⁰⁰ Momir Stojanoviç, T. 20094 (12 dhjetor 2007).

zonat e prekura nga veprimet sabotatore-terroriste". Sipas *Vojskas* ky udhëzues u shtyp dhe iu shpërnda efektivit të UJ-së në korrik 1998 nga "Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë." Botimi i *Vojskas* pohonte konkretisht se më 2 korrik 1998 Komanda e Përbashkët e kishte arkivuar udhëzuesin si "dokument nr. 1104-5".²⁹⁰² Dhoma vëren se numri 1104 ishte numri i regjistrit i Komandës së Korpusit të Prishtinës në vitin 1998.²⁹⁰³ Për shembull, urdhri i 6 korrikut 1998, me emërtimin "Komanda e Përbashkët" lëshuar nga Komanda e Korpusit të Prishtinës kishte numrin 1104-6.²⁹⁰⁴ Procesverbal i një mbledhjeje informative të 7 gushtit 1998, mbajtur nga komandantët e Korpusit të Prishtinës dhe Qarku Ushtarak i Prishtinës, gjithashtu përmendte Komandën e Përbashkët.²⁹⁰⁵ Gjatë mbledhjes, Gjakoviqi shpjegoi se vendimi për asgjësimin e forcave "terroriste" në zonën e fshatit Glllogjan ishte përmbyllur. Pasi Samarxhiqi kishte pranuar marrjen e masave për pastrimin e fushëbetejës, Gjakoviqi shpjegoi se Komanda e Përbashkët ishte duke shqyrtuar me organet komunale çështjen e "pastrimit të terrenit."²⁹⁰⁶

(C) Pushteti i Komandës së Përbashkët mbi MPB-në dhe UJ-në

1078. Megjithëse nga provat del qartë se nga 22 korriku deri më 30 tetor 1998 u mbajtën mbledhje midis anëtarëve të Grupit të Punës të SPS-së, Shainoviqit, dhe oficerëve të MPB-së dhe UJ-së dhe se këto mbledhje njiheshin si mbledhje të Komandës së Përbashkët, mbetet për t'u përcaktuar pushteti i Komandës së Përbashkët mbi MPB-në dhe UJ-në -- sidomos mbi njësitë e MPB-së dhe UJ-së gjatë operacioneve luftarake.

1079. Në Shënime lexohet se në mbledhjet e mbajtura në vitin 1998 kishte raporte aktualizuese dhe diskutime për gjendjen në Kosovë; konkretisht, raportohej gojarisht për statusin e sulmeve të UÇK-së dhe mobilizimet, për operacionet luftarake të kryera nga njësitë e UJ-së dhe MPB-së, dhe për çështje të lidhura me sigurinë dhe zbulimin.²⁹⁰⁷ Përmendja e Planit, sidomos zhvillimi dhe zbatimi i fazave të veçanta, ishin të zakonshme në shumicën e mbledhjeve. Në Shënime tregohet se rendi i ditës së mbledhjeve të hershme përmbante referenca mbi fazën e dytë të Planit, si p.sh zhvillimi i përparësive të fazës së dytë,²⁹⁰⁸ planifikimet për zbatimin e fazës së dytë,²⁹⁰⁹ dhe

²⁹⁰¹ Millan Gjakoviqi, T. 26428 (19 maj 2008).

²⁹⁰² P1011 (Ivan Markoviqi, ed., *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* (2001))Zbatimi i *Rregullave të së Drejtës Ndërkombëtare për Konfliktet të Armatosura* (2001)), f. 49.

²⁹⁰³ Vladimir Llazareviqi, T. 18638 (20 nëntor 2007); Dragan Zhivanoviqi, T. 20506 (17 janar 2008); Bozhidar Deliq, T. 19489 (4 dhjetor 2007).

²⁹⁰⁴ *Shih* P2113 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar në lidhje me ndalimin e operacioneve pa dijeninë dhe miratimin e Komandës së Përbashkët, 7 korrik 1998), që i referohet Urdhrit të Komandës së Përbashkët të 6 korrikut 1998. *Shih gjithashtu* Millan Gjakoviqi, T. 26381 (19 maj 2008).

²⁹⁰⁵ 4D97 (Procesverbal i informimit të komandantëve të PrK-së dhe të Armatës së 3-të, 7 gusht 1998).

²⁹⁰⁶ 4D97 (Procesverbal i informimit të komandantëve të PrK-së dhe të Armatës së 3-të, 7 gusht 1998).

²⁹⁰⁷ *Shih* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët).

²⁹⁰⁸ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 2.

vlerësimi i fazës së dytë të Planit.²⁹¹⁰ Nga 29 korriku deri më 3 gusht 1998 u diskutuan edhe planifikimi dhe zbatimi i fazës së tretë, duke përfshirë edhe rrëfimet e hollësishme të angazhimeve të UJ-së dhe MPB-së dhe vendndodhjeve të tyre.²⁹¹¹ Në Shënime lexohet se, më 5 shtator 1998, Miniqi raportoi gjerësisht në lidhje me fazën e katërt, duke thënë se do të merreshin një nga një të gjitha bastionet "terroriste", edhe pse kjo fazë duhej të përpunohej më tutje.²⁹¹² Më 21 tetor 1998, Shainoviqi raportoi se, pas një takimi me Wesley Clark-un e NATO-s, duhej të zbatohet një plan për tërheqjen e trupave të UJ-së nga territori i Podujevës dhe tërheqjen e policisë nga territori midis Malishevës dhe Suharekës, që nuk nënkuptonte largimin e plotë nga territori, por vetëm kthim në pozicionet në kohë paqeje.²⁹¹³ Më 26 tetor 1998, Shainoviqi i informoi të pranishmit në mbledhje se kjo fazë e operacioneve do të mbyllet.²⁹¹⁴ Duke u bazuar në tërë përmbajtjen e Shënimeve, Dhoma gjykon se mbledhjet e Komandës së Përbashkët ishin më shumë se shkëmbim i përditshëm informacioni, sepse nuk ka dyshim se ka pasur raste kur politikanët janë shprehur se çfarë duhej të bëhej nga ana e UJ-së dhe MPB-së.

1080. Sidoqoftë, ka prova të cilat tregojnë se propozimet e diskutuara në mbledhjet e Komandës së Përbashkët duhej të miratoheshin paraprakisht nga organet e UJ-së dhe se kërkesat e bëra gjatë mbledhjeve të Komandës së Përbashkët duhej të autorizoheshin më pas nga UJ-ja. Në pjesën përkatëse të një urdhri të dërguar nga Armata e 3-të më 31 korrik 1998 lexohet si vijon:

Komandanti i Korpusit të Prishtinës, si anëtar i Komandës së Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë, duhet të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet; para se të shkojë në mbledhje, duhet të njoftojë shefin e Shtabit të Armatës për të gjitha kërkesat e mundshme dhe duhet t'i shpjegojë propozimet për angazhimin e forcave me përforcime, dhe, pas marrjes së pëlqimit, duhet të shkojë në mbledhje.

Pas mbledhjes, komandanti i Korpusit të Prishtinës duhet t'i raportojë shefit të Shtabit të Armatës për propozimet të cilat janë pranuar ose kërkesat e tjera që nuk përputhen me propozimin dhe duhet të kërkojë pëlqim për këto kërkesa. Ai duhet gjithashtu të informojë Komandën e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë për të gjitha vendimet në lidhje me këto kërkesa.²⁹¹⁵

1081. Disa dëshmitarë dëshmuan për marrëdhëniet midis Komandës së Përbashkët në njërën anë dhe Komandës së Korpusit të Prishtinës, Komandës së Armatës së 3-të, dhe organeve të UJ-së, duke përfshirë edhe Presidentin e UJ-së në anën tjetër. Tomisllav Mlladenoviqi konfirmoi se Pavkoviqi merrte pjesë në mbledhjet e Komandës së Përbashkët vetëm pasi kishte marrë pëlqimin

²⁹⁰⁹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 6.

²⁹¹⁰ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 24.

²⁹¹¹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 24–41.

²⁹¹² P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 44–45.

²⁹¹³ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 151–153.

²⁹¹⁴ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 161.

²⁹¹⁵ 4D91 (Urdhër i Dushan Samarxhiqit në Lidhje me Organizimin e Punës së Ushtrisë, 30 korrik 1998).

nga Samarxhiqi ose Simiqi mbi vendimet për dhënien e mbështetjes forcave të MPB-së, për bashkërendim me MPB-në. Nëse MPB-ja shprehte nevojën për më shumë mbështetje, Pavkoviqi shkonte te komandanti i tij me kërkesa shtesë.²⁹¹⁶ Simiqi tha se komandanti i Korpusit kishte për detyrë që t'i raportonte Postëkomandës Pararojë idetë për angazhimin e njërive, për marrje pëlqimi, ndryshimi, ose refuzimi nga ana e tyre dhe ai mund shkonte në mbledhjet e Komandës së Përbashkët, vetëm pas miratimit, ndryshimit apo refuzimit të vendimit.²⁹¹⁷ Simiqi shpjegoi se, nëse Komanda e Përbashkët kishte kërkesa që ishin qenësisht të ndryshme nga vendimet që i kishte miratuar fillimisht, komandantit të Korpusit i duhej të kërkonte sërish miratimin e tyre. Pra, nëse Pavkoviqi kërkonte ndryshimin e ndonjë vendimi të miratuar, miratimi ose mosmiratimi i ndryshimit varej nga Simiqi dhe më pas Pavkoviqi shkonte përsëri në Komandën e Përbashkët për ta informuar për vendimin përfundimtar.²⁹¹⁸ Gjakoviqi dëshmoi se duhej miratim për kërkesat e MPB-së për ndihmë nga UJ-ja. Si shembull, ai përshkroi një incident kur Llukiqi i kishte kërkuar Pavkoviqit një helikopter për të evakuuar një grua shtatzënë dhe një polic të lënduar nga Kosova. Pavkoviqit i ishte dashur të konsultohej me komandantin e Armatës së 3-të. Kërkesa u refuzua, gjë të cilën Llukiqi e kishte pranuar dhe Shainoviqi nuk kishte bërë ndonjë koment apo ndërhyrje në shkëmbimin midis Llukiqit dhe Pavkoviqit.²⁹¹⁹ Gjithashtu, eksperti ushtarak, Radovan Radinoviqi, dëshmoi se hierarkia komanduese e UJ-së kishte funksionuar ashtu siç parashkruhej.²⁹²⁰ Radimir Llukiqi, ekspert i së drejtës kushtetuese i thirrur si dëshmitar nga Mbrojtja e Shainoviqit, një pyetjeje të Dhomës lidhur me formimin e Komandës së Përbashkët iu përgjigj se, nëse ajo kishte lëshuar dokumente me fuqi ligjore, atëherë do t'i ishte dashur bazë ligjore për këtë, por edhe nëse nuk kishte pasur bazë ligjore, do të kishte qenë një forum i pranueshëm për mbledhje, konsultime, dhe shkëmbim të informatave midis organeve të ndryshme të qeverisë.²⁹²¹ Miroslav Mijatoviqi konfirmoi se nuk ishte e mundur që ndonjë organ jashtë strukturave të MPB-së dhe UJ-së të lëshonte urdhra për njësitë brenda këtyre entiteteve.²⁹²² Në fakt një sasi e konsiderueshme provash

²⁹¹⁶ Tomisllav Mlladenoviq, T. 17602, 17606, 17620 (25 tetor 2007).

²⁹¹⁷ Miodrag Simiq, T. 15531–15532 (13 shtator 2007).

²⁹¹⁸ Miodrag Simiq, T. 15532 (13 shtator 2007).

²⁹¹⁹ Millan Gjakoviq, T. 26413–26414 (19 maj 2008).

²⁹²⁰ *Shih* Radovan Radinoviqi, T. 17340 (19 tetor 2007) (aludohet për "qindra dokumente" në lidhje me aktivitetet e komandantëve të Armatës së 3-të dhe të PrK-së).

²⁹²¹ Radimir Llukiqi, T. 26277–26278 (15 maj 2008); *shih gjithashtu* Michael Phillips, T. 11841 (19 mars 2007); John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 73, ku pohohet se "ekzistenca e një organi të tillë, tingëllonte mjaft logjike pa të cilin bashkërendimi i operacioneve të përbashkëta do të kishte qenë shumë problematik."

²⁹²² Miroslav Mijatoviqi, T. 22235 (12 shkurt 2008).

tregojnë se strukturat formale të komandimit, si dhe sistemet e raportimit të UJ-së dhe MPB-së mbetën të paprekura gjatë periudhës së funksionimit të Komandës së Përbashkët.²⁹²³

1082. Janë disa dokumente që përmbajnë shembuj të kërkesave që i janë paraqitur Komandës së Armatës së 3-të nga Komanda e Korpusit të Prishtinës pas diskutimeve në mbledhjet e Komandës së Përbashkët. Për shembull, më 6 shtator 1998, Shainoviçi raportoi se një helikopter Mi-8 duhej të ngjyrorej me ngjyrë të bardhë dhe me një kryq të kuq për t'u përdorur në ndihmë të civilëve dhe se kërkesa duhej t'i dërgohej Komandës së Forcave Ajrore dhe Mbrojtjes Kundërajrore.²⁹²⁴ Më pas Pavkoviçi i dërgoi kërkesë Komandës së Armatës së 3-të për t'ia përcjellë kërkesën për helikopter Komandës së Forcave Ajrore.²⁹²⁵ Më 12 shtator, Komanda e Armatës së 3-të u përgjigj se kërkesa ishte kaluar Shtabit të Përgjithshëm dhe se nuk ishte miratuar. Në përgjigjen e tij, komandanti i Armatës së 3-të, shpjegonte se kërkesa për përdorimin e helikopterëve duhej të saktësonte disa elemente, si "misioni që do të kryhej, sektori i misionit, qëllimi, për nevojat e kujt, koha, dhe numri i përgjithshëm i fluturimeve."²⁹²⁶ Në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të 13 shtatorit 1998, Pavkoviçi raportoi se kërkesa për helikopterët nuk ishte miratuar as nga Komanda e Armatës së 3-të, as nga Shtabi i Përgjithshëm.²⁹²⁷ Më 14 shtator, Pavkoviçi bëri një kërkesë tjetër duke e bazuar në kërkesën e dytë të Komandës së Përbashkët gjatë mbledhjes së 13 shtatorit. Këtë herë, Pavkoviçi i kishte saktësuar elementet e ndryshme të përmendura në përgjigjen e Armatës së 3-të të 12 shtatorit. Kjo tregon efektin e kërkesave të bëra gjatë mbledhjeve të Komandës së Përbashkët në vendimet e marra brenda UJ-së. Sidoqoftë, Dhoma vëren se kërkesa e bërë në mbledhjet e Komandës së Përbashkët të 6 dhe 13 shtatorit 1998 nuk kishte të bënte me angazhimin e forcave të UJ-së dhe MPB-së në operacione luftarake, por me përdorimin e helikopterëve për ndërhyrje humanitare.²⁹²⁸

1083. Shënime tregojnë se në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të 13 gushtit u diskutua një operacion konkret i përbashkët. Ky operacion duhej të kryhej në sektorin e fshatrave Sllup dhe

²⁹²³ 4D91 (Urdhër i Dushan Samarxhiqit në Lidhje me Organizimin e Punës së Ushtrisë, 30 korrik 1998); P1419 (Kërkesë e Pavkoviçit dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 1 gusht 1998); Lubinko Cvetiq, T. 8123 (8 dhjetor 2006); Miodrag Simiq, T. 15687 (14 shtator 2007).

²⁹²⁴ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 94.

²⁹²⁵ *Shih* 4D230 (Nga Armata e 3-të dërguar PrK-së, Refuzim i kërkesës për përdorimin e helikopterëve, 12 shtator 1998) (që tregon se, më 6 shtator 1998, Pavkoviçi i kishte bërë kërkesë Armatës së 3-të për përdorimin e helikopterëve në operacione luftarake, misione mbështetëse, dhe ndërhyrje humanitare).

²⁹²⁶ 4D230 (Nga Armata e 3-të dërguar PrK-së, Refuzim i kërkesës për përdorimin e helikopterëve, 12 shtator 1998).

²⁹²⁷ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 108–109.

²⁹²⁸ P1011 (Ivan Markoviç, ed., *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts/Zbatimi i Rregullave të së Drejtës Ndërkombëtare të Konfliktëve të Armatosura* (2001)), f. 64–65. Kjo kërkesë u ripasqyrua dhe u përfshi tërësisht në këtë botim.

Voksh.²⁹²⁹ Dhoma vëren se plani për këtë operacion ishte përgatitur nga Komanda e Korpusit të Prishtinës, siç është diskutuar në Nënpjesën VI.E.2: sipas Gjakoviqit, Pavkoviqi e informoi Samarxhiqin se ishte përgatitur një plan për operacionin në Sllup dhe Voksh, por se ai nuk ishte në gjendje të vinte dhe t'ia shpjegonte. Më pas Pavkoviqi i kërkoi Gjakoviqit që t'i sillte Samarxhiqit hartën e planit dhe t'ia shpjegonte. Gjakoviqi saktësoi se kishte shpenzuar "një orë e gjysmë duke ia shpjeguar Samarxhiqit çdo element nga paragrafi i parë deri në të fundit." Samarxhiqi kishte qenë i kënaqur me vendimin dhe e kishte miratuar duke e nënshkruar.²⁹³⁰ Gjatë mbledhjes së 13 gushtit 1998 të Komandës së Përbashkët, Pavkoviqi tha se shefi i Shtabit (Llazareviqi) do të komandonte operacionin rreth Sllupit dhe Vokshit, i cili mund "të fillonte pothuajse menjëherë."²⁹³¹ Kjo deklaratë tregon se operacioni ishte planifikuar para mbledhjes së Komandës së Përbashkët të mbajtur më 13 gusht 1998. Në fakt, duket se Pavkoviqi donte ta informonte Komandën e Përbashkët për operacionin e përbashkët gjatë kësaj mbledhjeje.

1084. Një dokument i Komandës së Korpusit të Prishtinës dërguar Komandës së Armatës së 3-të me datë 22 shtator 1998 tregon lidhjen midis një diskutimi nga një mbledhje e Komandës së Përbashkët dhe kërkesës së mëvonshme të bërë brenda UJ-së.²⁹³² Në këtë dokument, Pavkoviqi e informonte Komandantin e Armatës së 3-të se më 1 dhe 7 shtator 1998 kishte kërkuar që të zbatohet faza e pestë e Planit. Ai gjithashtu vërente se, në mbledhjen e Komandës së Përbashkët të 10 shtatorit 1998, "organet e tjera komanduese theksuan se UJ-ja nuk i kishte kryer dy detyra në përputhje me Planin."²⁹³³ Rrjedhimisht, ishte marrë vendimi që të kërkohej zbatimi i fazës së pestë. Si rezultat, më 11 shtator 1998 Pavkoviqi i dërgoi kërkesë me shkrim komandantit të Armatës së 3-të. Gjithashtu Pavkoviqi e lajmëroi gojarisht komandantin e Armatës së 3-të për këtë vendim menjëherë pas mbledhjes dhe i sugjeroi se si duhej të zbatohet faza e pestë. Komandanti i Armatës së 3-të iu përgjigj kërkesës së Pavkoviqit duke lëshuar tri urdhra më 12, 15, dhe 18 shtator 1998.

²⁹²⁹ *Krahaso* P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998), *me* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 52, 54. Në lidhje me fshatrat e përmendura në operacion, në përkthimin anglisht të Shënimeve shkruhet "Vonsa dhe Stanpo"; sidoqoftë, Llazareviqi e lexoi pjesën në fjalë nga versioni BKS si "Vokshi dhe Sllupi." Vladimir Llazareviq, T. 18298 (14 nëntor 2007).

²⁹³⁰ Millan Gjakoviq, T. 26458–26459 (20 maj 2008). Llazareviqi dëshmoi se, para se Komanda e PrK-së të lëshonte vendimin e 14 gushtit 1998, Samarxhiqi kishte miratuar operacionin në Sllup dhe Voksh. Vladimir Llazareviq, T. 17796 (6 nëntor 2007); T. 18331–18332 (15 nëntor 2007). Raporti i rregullt i Komandës së Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm më 14 gusht 1998 gjithashtu konfirmon se Samarxhiqi e kishte miratuar operacionin. 5D1174 (Raport Luftarak i Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 14 gusht 1998).

²⁹³¹ *Krahaso* P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998), *me* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 52, 54. Në lidhje me fshatrat e përmendura në operacion, në përkthimin anglisht të Shënimeve shkruhet "Vonsa dhe Stanpo"; sidoqoftë, Llazareviqi e lexoi pjesën në fjalë nga versioni BKS si "Vokshi dhe Sllupi." Vladimir Llazareviq, T. 18298 (14 nëntor 2007).

²⁹³² P1435 (Raport mbi Zbatimin e Fazës së 5-të të Planit Kundër Terrorizmit, 22 shtator 1998).

²⁹³³ P1439 (Përgjigje e Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 5 tetor 1998), f. 2.

Komandanti i Armatës së 3-të miratoi një nga planet e sugjeruara dhe i modifikoi dy të tjerët.²⁹³⁴ Në dokumentin e 22 shtatorit 1998, Pavkoviqi shprehte shqetësimet e veta në lidhje me njërin nga planet: sipas tij, plani ishte vënë në rrezik për shkak të ndryshimeve të bëra nga Komanda e Armatës së 3-të. Për këtë arsye, ai parashtrroi dy sugjerime për të zgjidhur këtë çështje. Në fund të dokumentit, Pavkoviqi gjithashtu pohonte se anëtarëve të Komandës së Përbashkët u ishte dhënë mundësia që t'i raportonin Millosheviqit se UJ-ja nuk i kishte kryer detyrat e saj sipas Planit.

1085. Në një dokument të datës 5 tetor 1998 dërguar komandantit të Armatës së 3-të, Pavkoviqi shpjegonte se gjatë mbledhjeve të Komandës së Përbashkët të mbajtura më 19 dhe 20 shtator 1998,²⁹³⁵ ishte marrë vendim që të formoheshin forcat e ndërhyrjes së shpejtë. Ai gjithashtu pohonte se plani i miratuar më herët nga President i RFJ-së parashikonte formimin e forcave të tilla që do të ishin në gatishmëri të plotë. Pavkoviqi kujtoi se, me t'u kthyer nga mbledhjet e Komandës së Përbashkët, ai kishte informuar komandantin e Armatës së 3-të personalisht me telefon për këtë vendim. Mirëpo më 3 tetor 1998 komandanti i Armatës së 3-të e ndaloi formimin e forcave të ndërhyrjes së shpejtë.²⁹³⁶ Duket se komandanti i Armatës së 3-të urdhëroi formimin e grupeve të reja për luftim. Në komunikimin me të më 5 tetor 1998, Pavkoviqi e informoi konkretisht komandantin e Armatës së 3-të se, në kundërshtim me urdhrin e tij të 3 tetorit 1998 Komanda e Korpusit të Prishtinës nuk kishte formuar grupet e reja për luftime dhe kishte kërkuar që Samarxhiqi të përcaktonte përbërjen e forcave për ndërhyrje. Në Shënime thuhet se në mbledhjen e 20 shtatorit Shainoviqi udhëzoi "që të përgatiten njësi për ndërhyrje më të shpejta," duke e përforcuar edhe më tej besueshmërinë e Shënimeve.²⁹³⁷ Sipas Radinoviqit, jo domosdoshmërisht Pavkoviqi kishte kapërcyer urdhrin e Samarxhiqit për krijimin e grupeve për luftim, por vetëm kishte analizuar gjendjen dhe e kishte ngritur çështjen edhe një herë për t'u shqyrtuar nga Samarxhiqi.²⁹³⁸ Vasileviqi shpjegoi se, bazuar në këtë dokument, dukej se "Korpusi i Prishtinës nuk i kishte formuar këto grupe luftarake."²⁹³⁹ Nga provat nuk është e qartë se cila ishte përgjigja e komandantit të Armatës së 3-të ndaj kërkesës së dytë të Pavkoviqit për krijimin e forcave të ndërhyrjes së shpejtë.

²⁹³⁴ P1439 (Përgjigje e Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 5 tetor 1998). Komandanti i Armatës së 3-të urdhëroi Komandën e PrK-së të "rishqyrtonte forcën reale të formacionit të saj dhe si ishte angazhuar në Kosovë dhe të shpjegonte angazhimin e dy grupeve luftarake. "

²⁹³⁵ P1439 (Përgjigje e Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 5 tetor 1998). Shprehja "Komisioni i Përbashkët", që është në përkthimin anglisht të dokumentit, është sugjerim i përkthyesit për shkurtesën, "ZK". Radovan Radinoviqi e lexoi pjesën në fjalë dhe e përktheu shkurtesën si "Komanda e Përbashkët." Radovan Radinoviqi, T. 17340–17342 (19 tetor 2007). Raporti bën të ditur se, sikurse është përcaktuar në "planin për asgjësimin e forcave terroriste shqiptare në territorin e KiM-it," kur forcat terroriste shqiptare të shkatërrheshin nga MPB-ja dhe UJ-ja, do të formoheshin forcat për ndërhyrje të shpejtë, në përputhje me urdhrin e Presidentit.

²⁹³⁶ *Shih* P1439 (Përgjigje e Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 5 tetor 1998).

²⁹³⁷ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 124.

²⁹³⁸ Radovan Radinoviqi, T. 17340–17342 (19 tetor 2007).

²⁹³⁹ Aleksandar Vasileviqi, T. 9094 (24 janar 2007).

1086. Një shembull tjetër i tensioneve midis Komandës së Përbashkët dhe Komandës së Armatës së 3-të është edhe kërkesa e Pavkoviqit e datës 1 gusht 1998 dërguar Postëkomandës Pararojë të Armatës së 3-të për miratimin e fillimit të fazës së tretë të Planit. Në kërkesën e tij ai saktëson se në mbledhjen e mbajtur më 31 korrik 1998, Komanda e Përbashkët kishte vendosur të fillonte fazën e tretë të Planit më 2 gusht 1998.²⁹⁴⁰ Megjithëse në Shënime nuk bëhet e qartë se a ishte marrë një vendim i tillë më 31 korrik, mbledhja e 30 korrikut bënte të ditur se faza e tretë e planit do të realizohej me operacione në Drenicë dhe Jabllanicë. Në Shënime gjithashtu shkruhet se më 2 gusht 1998, Pavkoviqi raportoi se njësitë kishin filluar operacionet luftarake në ato vende.²⁹⁴¹ Mirëpo kërkesa e Pavkoviqit dërguar Postëkomandës së Armatës së 3-të në fakt ishte refuzuar nga Samarxhiqi, i cili në të njëjtën ditë lëshoi një urdhër që ndalonte angazhimin e njësive të Korpusit të Prishtinës derisa ai dhe President i RFJ-së të miratonin planin për zbatimin e fazës së tretë të Planit në mbledhjen e cila ishte caktuar për 3 gusht 1998.²⁹⁴² Në përgjigje të kësaj mosbindjeje, më 3 gusht 1998 Samarxhiqi lëshoi një urdhër që ndalonte përdorimin e paautorizuar të njësive të UJ-së dhe udhëzoi dërgimin e njësive të angazhuara në mbështetje të MPB-së në vendet e ridislokimit.²⁹⁴³ Dhoma gjykon se këta dy shembuj tregojnë se herë pas here hierarkia e rregullt komanduese e UJ-së u anashkalua ose u injorua nga Pavkoviqi dhe Komanda e Përbashkët.

1087. Gjakoviqi dëshmoi se në mbledhjet e Komandës së Përbashkët nuk ishin marrë vendime në lidhje me përdorimin e forcës gjatë operacioneve luftarake. Sipas tij, vendimet e përmendura gjatë këtyre mbledhjeve "tashmë ishin marrë në nivel të gjeneral Samarxhiqit."²⁹⁴⁴ Vendimet e marra në mbledhjet e Komandës së Përbashkët ndikuan në urdhrat e lëshuara nga UJ-ja "vetëm në një rast": anëtarët e Komandës së Përbashkët duhej t'i bënin kërkesë Pavkoviqit, kurse ky ia kalonte kërkesën komandantit të Armatës së 3-të. Nga ana e tij, komandanti i Armatës së 3-të vendoste a të korrigjonte apo të mos e korrigjonte urdhrin.²⁹⁴⁵ Gjakoviqi konkludoi se ndikimi i anëtarëve të Komandës së Përbashkët "në të vërtetë nuk ishte i madh."²⁹⁴⁶ Gjithashtu, asnjë nga vendimet e raportuara nga komandantët në mbledhje nuk ishte vënë në dyshim nga pjesëmarrësit.²⁹⁴⁷ Ai gjithashtu theksoi se Shainoviqi dhe Miniqi përfaqësonin funksionet e tyre politike dhe se ai nuk i pa asnjëherë të kërkonin që ndonjë dokument të përgatitej për ta "për t'u nënshkruar dhe për t'u

²⁹⁴⁰ P1419 (Kërkesë e Pavkoviqit dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 1 gusht 1998).

²⁹⁴¹ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 33, 36.

²⁹⁴² 4D125 (Urdhër i Armatës së 3-të për ndalimin e përdorimit të njësive të PrK-së, 1 gusht 1998).

²⁹⁴³ 4D458 (Urdhër i Komandës së Armatës së 3-të K dërguar Postëkomandës Pararojë të Armatës së 3-të, 3 gusht 1998).

²⁹⁴⁴ Millan Gjakoviq, T. 26380 (19 maj 2008).

²⁹⁴⁵ Millan Gjakoviq, T. 26485 (20 maj 2008).

²⁹⁴⁶ Millan Gjakoviq, T. 26486 (20 maj 2008).

²⁹⁴⁷ Millan Gjakoviq, T. 26479 (20 maj 2008).

dërguar në ndonjë nivel tjetër komandues.²⁹⁴⁸ Sidoqoftë, ai pranoi se në një raport të Komandës së Korpusit të Prishtinës dërguar Komandës së Armatës së 3-të në lidhje me zbatimin e fazës së pestë të Planit, i datës 22 shtator 1998, shprehja "organet e tjera të Komandës" në mbledhjet e Komandës së Përbashkët ka të ngjarë t'u referohej anëtarëve civilë të saj.²⁹⁴⁹ Dhoma e gjykon të tepruar minimizimin e ndikimit të Komandës së Përbashkët në vendimet e marra brenda UJ-së nga Gjakoviçi.

1088. Në lidhje me këtë aspekt, Dhoma vëren se në një letër dërguar Presidentit të RFJ-së, Millosheviq, e datës 23 korrik 1998, Perishiçi shprehte shqetësim për përdorimin e njësisve të UJ-së jashtë institucioneve të rregullta të sistemit, tentimet nga persona të paautorizuar për t'i komanduar, dhe për anashkalimin e niveleve të hierarkisë komanduese.²⁹⁵⁰ Perishiçi ishte konkretisht i shqetësuar për faktin se komandanti i Korpusit të Prishtinës planifikonte operacione "me kërkesë të Shainoviçit, Miniçit, dhe MPB-së," duke e shndërruar UJ-në në "shërbim të tyre për planifikim dhe zbatim."²⁹⁵¹ John Crosland-i gjithashtu dëshmoi se Pavkoviçi punonte "jashtë hierarkisë komanduese" në vitin 1998.²⁹⁵² Dimitrijeviçi i kishte thënë më 5 tetor 1998 se Perishiçi dhe Dimitrijeviçi "nuk ishin plotësisht të informuar se çfarë ndodhte në terren në Kosovë." Sipas Dimitrijeviçit, "ata ishin përjashtuar nga hierarkia operative komanduese që kalonte drejtpërdrejtë nga gjeneral Pavkoviçi te Z. Millosheviq dhe Shainoviçi, i cili ishte njeriu i tij për operacionet e përditshme."²⁹⁵³ Më 6 nëntor 1998, Dimitrijeviçi përsëri i tha Crosland-it se Pavkoviçi "mund ... të reagojë pa lejen e Shtabit të Përgjithshëm dhe jashtë hierarkisë komanduese të ushtrisë." Dimitrijeviçi aludoi se Pavkoviçi "ishte i vendosur që të zbatonte urdhrat e Millosheviçit, të cilat jepeshin përmes Shainoviçit, për t'u ballafaquar vendosmërisht me rrethanat."²⁹⁵⁴ Crosland-i gjithashtu tha se ishte "fakt i ditur në mesin e atasheve të jashtëm se Shainoviçi ishte njeriu që ishte drejtpërsëdrejti përgjegjës për ngjarjet në Kosovë."²⁹⁵⁵

1089. Si prova janë pranuar edhe disa Udhëzime të lëshuara nga Komanda e Përbashkët në korrik 1998 mbi Mbrojtjen e Zonave të Populluara.²⁹⁵⁶ Gjakoviçi dëshmoi se këto udhëzime nuk kishin fuqinë e urdhrat dhe në të vërtetë përbënin një dokument bazë për kualifikim ose referencë që duhet

²⁹⁴⁸ Millan Gjakoviçi, T. 26443–26444 (20 maj 2008).

²⁹⁴⁹ Millan Gjakoviçi, T. 26542 (21 maj 2008).

²⁹⁵⁰ P717 (Letër e Momçillo Perishiçit dërguar Sllobodan Millosheviçit, 23 korrik 1998).

²⁹⁵¹ P717 (Letër e Momçillo Perishiçit dërguar Sllobodan Millosheviçit, 23 korrik 1998), f. 2–3; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 170–171.

²⁹⁵² John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 54, 56. Dhoma vëren se Crosland-i e quan Pavkoviçin komandant i Armatës së 3-të në vitin 1998, edhe pse në atë kohë Pavkoviçi ishte komandant i PrK –së.

²⁹⁵³ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 54.

²⁹⁵⁴ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 56.

²⁹⁵⁵ John Crosland, P2645 (deklaratë dëshmitari e datës 31 tetor 2006), para. 58.

të ketë ekzistuar që para vitit 1998.²⁹⁵⁷ Ai sugjeroi se "Komanda e Përbashkët" mund të jetë shtuar si simbol i një farë "pushteti fiktiv" dhe për të garantuar që detyra për mbrojtjen e qyteteve të merrej seriozisht.²⁹⁵⁸ Një letër përcjellëse, të cilën Petar Iliqi ua dërgoi institucioneve të ndryshme të mbrojtjes më 28 korrik 1998, duket se i ishte bashkëngjitur këtyre udhëzimeve. Në letër thuhej se Komanda e Përbashkët kishte lëshuar udhëzimet dhe se gjithashtu " kishte përcaktuar përbërjen e re të shtabeve komunale të mbrojtjes."²⁹⁵⁹ Më tej, në Shënime thuhet se mbrojtja e qyteteve ishte pikë e rendit të ditës në mbledhjen e parë më 22 korrik 1998 dhe për të diskutuan Miniqi dhe Gajiqi, ku pohohet se Miniqi u shpreh se Pavkoviqi do të jepte udhëzime. Mirëpo Gjakoviqi mohoi se këto udhëzime kishin dalë nga një mbledhje e Komandës së Përbashkët. Sipas tij, ato ishin përgatitur nga organet operative të Korpusit të Prishtinës. Ai shpjegoi se udhëzimet do të shërbenin vetëm si ndihmesë për personat të cilëve u ishin dërguar.²⁹⁶⁰

1090. Si prova janë pranuar gjithashtu edhe gjashtë Raporte Operative të Komandës së Përbashkët, me datë nga 15 tetori deri më 23 nëntor 1998, në të cilat raportohet për çështje të ndryshme në lidhje me zbulimin dhe sigurinë në Kosovë, angazhimin e forcave të MPB-së dhe UJ-së, propozimet për angazhime të mëtejshme, dhe negociatat politike.²⁹⁶¹ Në këto raporte gjithashtu përmendet edhe Plani për Mbrojtjen e Qyteteve në Kosovë dhe shprehja "Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë" është e shtypur në fund të çdo dokumenti në hapësirën për nënshkrim.²⁹⁶² Veçanërisht, dy nga këto dokumente, me datë 20 nëntor dhe 23 nëntor 1998, janë pranuar si prova me letrën përcjellëse me shkrim dore ku lexohet, "Për Millomir Miniqin personalisht."²⁹⁶³ Kur u ballafaqua në gjykatë me Raportin Operativ të 20 nëntorit, Miniqi dëshmoi se ai merrte kohë pas kohe dokumente të tilla nga UJ-ja, edhe pse jo dokumentin konkret.²⁹⁶⁴ Edhe

²⁹⁵⁶ P2086 (Udhëzimet për mbrojtjen e zonave të populluara, të lëshuara nga Komanda e Përbashkët, të datës korrik 1998).

²⁹⁵⁷ Millan Gjakoviq, T. 26416 (19 maj 2008).

²⁹⁵⁸ Millan Gjakoviq, T. 26417 (19 maj 2008).

²⁹⁵⁹ P1064 (Udhëzimet për Mbrojtjen e Zonave të Banuara, 28 korrik 1998).

²⁹⁶⁰ Millan Gjakoviq, T. 26414 (19 maj 2008).

²⁹⁶¹ Raportet Operative të Komandës së Përbashkët 15 tetor–23 nëntor 1998: P1203 (Raport operativ i Komandës së Përbashkët në lidhje me gjendjen e sigurisë në Kosovë, 15 tetor 1998); P1204 (Raport operativ i Komandës së Përbashkët në lidhje me gjendjen e sigurisë në Kosovë, 28 tetor 1998); P1206 (Raport operativ i Komandës së Përbashkët në lidhje me gjendjen e sigurisë në Kosovë, duke përfshirë sulmet e UÇK-së kundër UJ-së dhe MPB-së dhe kundërmasat e tyre, 17 tetor 1998); P1197 (Raport Operativ i Komandës së Përbashkët me një zarf të bashkëngjitur për Millomir Miniqin, 20 nëntor 1998); P1198 (Raport Operativ i Komandës së Përbashkët me emrat dhe pozicionet e UÇK-së, 23 nëntor 1998); P2623 (Raport Operativ i Komandës së Përbashkët, 23 nëntor 1998).

²⁹⁶² *Shih, p.sh.*, P1197 (Raport Operativ i Komandës së Përbashkët, 20 nëntor 1998), f. 7; P1198 (Raport Operativ i Komandës së Përbashkët, 23 nëntor 1998); P2623 (Raport Operativ i Komandës së Përbashkët, 23 nëntor 1998), f. 14.

²⁹⁶³ Edhe pse Miniqi pranoi se kishte marrë dokumente si ky nga UJ-ja (por jo dokumentin konkret), ai këmbënguli se nuk e kishte ditur se çfarë ishte Komanda e Përbashkët dhe kishte supozuar se ishte shprehje ushtarake. Millomir Miniq, T. 14787–14888 (31 gusht 2007).

²⁹⁶⁴ Millomir Miniq, T. 14787–14788 (31 gusht 2007); *shih* P1197 (Raport Operativ i Komandës së Përbashkët, 20 nëntor 1998).

pse kjo mund të sugjerojë se këto dokumente kanë buruar nga UJ-ja, përmbajtja e tyre – që përfshinte analiza të hollësishme politike si dhe shqyrtime të hollësishme dhe propozime të angazhimeve të kaluara dhe të ardhshme të MPB-së – flet për përfshirjen e njerëzve jashtë ushtrisë në përpilimin e tyre, si dhe rolin e këtij organi në bashkërendimin e veprimeve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së. Mirëpo, Gjakoviçi dëshmoi se këto raporte ishin shkruar në Komandën e Korpusit të Prishtinës në bazë të informatave që Pavkoviçi kishte marrë nga Llukiqi dhe David Gajiqi, të cilat më vonë ia kaluan Gjakoviçit. Në shkëmbim, Gjakoviçi i jepte RDB-së informata nga UJ-ja.²⁹⁶⁵ Gjakoviçi dëshmoi se raportet ishin thjesht kopje fjalë për fjalë të raporteve të MPB-së, RJB-së, dhe RDB-së, me një raport ushtarak të shtuar në fund.²⁹⁶⁶ Ato i dërgoheshin RJB-së, RDB-së, dhe UJ-së. Pjesëmarrësit në mbledhje, si Shainoviçi, dhe Angjelkoviçi, nuk i merrnin këto raporte sepse zakonisht ata ishin të pranishëm dhe i njihnin problemet e përshkruara në këto raporte. Sidoqoftë më vonë Tesheviçi, zëvendësuesi i Gjakoviçit, i tha Gjakoviçit se Miniçit i ishin dërguar kopjet e disa prej këtyre dokumenteve për shkak të mungesës së tij të gjatë nga Kosova.²⁹⁶⁷ Gjakoviçi tha se kishte qenë ideja e tij që raportet operative të titulloheshin "Komanda e Përbashkët" sepse të njëjtën gjë kishte bërë me dokumentet e mëparshme që kishte përpiluar për bashkërendimin, si p.sh urdhri i 6 korrikut i cili ndalonte operacione pa miratimin e Komandës së Përbashkët.²⁹⁶⁸

1091. Disa prova sugjerojnë se Komanda e Përbashkët luajti rol të rëndësishëm gjatë zbatimit të operacioneve të përbashkëta në terren. Siç është shpjeguar më lart në Nënpjesën VI.E.2, më 10 gusht 1998, Korpusi i Prishtinës lëshoi një vendim për angazhim të përbashkët të forcave të MPB-së dhe UJ-së në disa zona të përgjithshme në Kosovë që do të ndodhte më 11 gusht 1998.²⁹⁶⁹ Gjithashtu, më 14 gusht 1998, Korpusi i Prishtinës lëshoi një vendim, duke i urdhëruar njësitë e UJ-së që të mbështesnin njësitë e MPB-së në një operacion të caktuar në sektorin e fshatrave Sllup dhe Voksh.²⁹⁷⁰ Në të dy vendimet theksohej shprehimisht se këto operacione luftarake do të "komandoheshin nga Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë."²⁹⁷¹ Gjakoviçi dëshmoi se

²⁹⁶⁵ Millan Gjakoviçi, T. 26428–26429 (19 maj 2008).

²⁹⁶⁶ Millan Gjakoviçi, T. 26429–26430 (19 maj 2008).

²⁹⁶⁷ Millan Gjakoviçi, T. 26431 (19 maj 2008).

²⁹⁶⁸ Millan Gjakoviçi, T. 26432 (19 maj 2008).

²⁹⁶⁹ P1427 (Vendim i PrK-së, 10 gusht 1998). Zëvendësuesi i Administratës së Sigurimit, Aleksandar Vasileviçi, dëshmoi se ky dokument urdhëronte një grup luftimi të UJ-së të Brigadës së 15-të të Blinduar të sulmonte së bashku me detashmentin e 7-të të MPB-së dhe se ka shumë të ngjarë të jenë përdorur tanket e UJ-së. Aleksandar Vasileviçi, T. 8681–8682 (18 janar 2007).

²⁹⁷⁰ P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998).

²⁹⁷¹ Dhoma kërkoi verifikimin e përkthimit të fjalisë së fundit të një vendimi të Komandës së Korpusit të Prishtinës: P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998). CLSS-ja tha se mund të kishte kuptimin ose "Operacionet Luftarake për Kosovën dhe Metohinë do të komandohen me Postëkomandën Pararojë të PrK-së në Gjakovë," ose " Operacionet Luftarake për Kosovën dhe Metohinë do të komandohen nga Postëkomanda Pararojë e PrK-së në Gjakovë." CLSS

në këtë rast përdorimi i shprehjes "Komanda e Përbashkët" i referohet "Shtabit të MPB-së dhe komandës ushtarake," dhe nuk mund të përfshinte askënd tjetër, si Shainoviqin apo Miniqin, sepse ata nuk ishin në Postëkomandën Pararojë në Gjakovë.²⁹⁷² Sipas tij, ishte "për të ardhur keq" që shprehja e përdorur ishte "Komanda e Përbashkët."²⁹⁷³ Gjakoviqi theksoi se Komanda e Përbashkët thjesht nënkuptonte Komandën e Korpusit të Prishtinës dhe Shtabin e MPB-së dhe jo ndonjë entitet te veçantë.²⁹⁷⁴

1092. Llazareviqi mohoi se ndonjë organ i quajtur "Komandë e Përbashkët" kishte komanduar operacionin në Sllup dhe Voksh, pavarësisht nga formulimi në urdhrin e 14 gushtit.²⁹⁷⁵ Sipas tij, "strumbullari i komandës ishte Postëkomanda Pararojë e Korpusit të Prishtinës."²⁹⁷⁶ Grupi Luftarak 15/3, i cili sipas Llazareviqit ishte "strumbullari i të gjitha aksioneve" gjatë operacionit,²⁹⁷⁷ kishte marrë një urdhër nga Mlladen Cirkoviqi, komandant i Brigadës së 15-të të Blinduar, më 14 gusht 1998. Në urdhër thuhej se forcat e angazhuara në veprime luftarake do të viheshin "nën komandën dhe kontrollin e Postëkomandës Pararojë të Komandës së Korpusit të Prishtinës."²⁹⁷⁸ Sipas Llazareviqit, kjo tregon se personi që e kishte përgatitur urdhrin e kishte "kopjuar fjalinë nga vendimi i lëshuar nga Komanda e Korpusit dhe e kishte përkthyer me... fjalë të tij": për këtë person, Komanda e Përbashkët ishte "Komanda e Korpusit të Prishtinës, e cila ishte në Postëkomandën Pararojë."²⁹⁷⁹ Saviqi tha se "komandimi i forcave" ishte bërë nga Komanda e Korpusit të Prishtinës në Postëkomandën Pararojë në Gjakovë "për shkak se ishin disa grupe luftarake të UJ-së në atë zonë, detyra e të cilave ishte të ruanin kufijtë shtetërorë."²⁹⁸⁰ Ai shpjegoi se kishte ekzistuar "vetëm një hierarki komanduese": ai ishte në varësi të Mlladen Cirkoviqit dhe Mlladen Cirkoviqi ishte në varësi të komandantit të Korpusit.²⁹⁸¹ Rrjedhimisht Dhoma gjykon se operacioni në Sllup dhe Voksh ishte nën kontrollin e Komandës së Korpusit të Prishtinës nga Postëkomanda Pararojë dhe se

tha se, në këtë kontekst, përkthimi i dytë është më i saktë. P1427 përdor frazën "komanduar nga Komanda e Përbashkët".

²⁹⁷² Millan Gjakoviq, T. 26455–26456 (20 maj 2008).

²⁹⁷³ Millan Gjakoviq, T. 26455 (20 maj 2008).

²⁹⁷⁴ Millan Gjakoviq, T. 26382, T. 26379–26382 (19 maj 2008).

²⁹⁷⁵ P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998), f. 3. Në përkthimin origjinal të dokumenteve thuhet: "Operacionet luftarake për Kosovën dhe Metohinë do të komandohen me Postëkomandën Pararojë në Gjakovë." Sidoqoftë, mbasi Dhoma kërkoi sqarime, CLSS tha se shprehja në të zezë të theksuarë ka kuptimin ose "nga" ose "me," por në kontekst të frazës konkrete, përkthimi më i saktë ishte "nga."

²⁹⁷⁶ Vladimir Llazareviq, T. 18308 (14 nëntor 2007).

²⁹⁷⁷ Vladimir Llazareviq, T. 18309 (14 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* P1428 (Vendim i PrK-së, 14 gusht 1998) (që tregon se Grupi Luftarak 15/3 duhej të mbështeste forcat e MPB-së gjatë sulmit, kurse Grupi Luftarak 125/2 duhej të kryente sulm diversant në një vijë tjetër).

²⁹⁷⁸ 6D731 (Urdhër i Brigadës së 15-të të Blinduar dërguar Komandantit të Grupit Luftarak 15/3, 14 gusht 1998), f. 5.

²⁹⁷⁹ Vladimir Llazareviq, T. 18312–18313 (14 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* T. 17803–17804 (6 nëntor 2007).

²⁹⁸⁰ Lubomir Saviq, 5D1392 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 4.

²⁹⁸¹ Lubomir Saviq, T. 20962 (24 janar 2008). *Shih gjithashtu* Vladimir Llazareviq, T. 18329 (15 nëntor 2007).

qëllimi i urdhrat të Komandës së Përbashkët në lidhje me operacionin ishte bashkërendimi i veprimeve.

1093. Oficerët e UJ-së të cilët dëshmuar para Dhomës ishin njëzëri këmbëngulës se hierarkitë e tyre komanduese kishin mbetur të pandryshuara. Raportet i dërgoheshin gjithmonë Korpusit të Prishtinës, jo Komandës së Përbashkët, dhe të gjithë ishin të bindur se urdhrat vinin nga Korpusi i Prishtinës.²⁹⁸² Millan Koturi tha se "me sa dinte ai Komanda e Korpusit të Prishtinës i komandonte forcat e veta, si gjithmonë."²⁹⁸³ Shefi i Shërbimit të Kufirit Shtetëror, koloneli i UJ-së, Rade Çuçak, gjithashtu dëshmoi se hierarkia komanduese brenda UJ-së ishte ruajtur gjatë tërë kohës më 1998 dhe 1999.²⁹⁸⁴ Lubisha Stojimiroviq nga Korpusi i Njësive të Posaçme të UJ-së, tha se nuk kishte pasur pengesa apo ndërhyrje në hierarkinë komanduese e as hierarki paralele komanduese në të cilat të ishte përfshirë ndonjë oficer i UJ-së.²⁹⁸⁵

1094. Gjatë intervistës me Prokurorinë, Llazareviq theksoi se hierarkitë komanduese të MPB-së dhe UJ-së kishin qenë të ndara.²⁹⁸⁶ Llazareviq shpjegoi se, gjatë operacioneve luftarake, kishte "oficerë për komunikim ose ndërlidhje" të pranishëm në postëkomandat e UJ-së në terren. Ata komunikonin me njësitë e tyre të MPB-së dhe i përcillnin informatat nga MPB-ja në UJ.²⁹⁸⁷ Informata nga UJ-ja në MPB përcilleshin në të njëjtën mënyrë. Në gjyq Llazareviq theksoi se UJ-ja dhe MPB-ja shkëmbejnë "informata për komunikimet dhe pajisjet për komunikim që ato të ishin të përputhshme."²⁹⁸⁸ Gjithashtu, ishin caktuar edhe oficerët ndërlidhës.²⁹⁸⁹ Stefanoviç dhe Deliq gjithashtu dëshmuar për ekzistencën e "postëkomandave të përbashkëta."²⁹⁹⁰ Stefanoviç shpjegoi

²⁹⁸² Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 20 janar 2008), para. 27; Lubisha Dikoviç, T. 19882, 19941 (10 dhjetor 2007); Kërsman Jelliq, T. 18877 (23 nëntor 2007); Lubomir Saviq, T. 21017 (24 janar 2008). Sidoqoftë gjatë fazës së pyetjeve nga pala kundërshtare, Saviq faktikisht pranoi se ishte e mundshme që Komanda e Përbashkët të kishte planifikuar dhe urdhëruar operacionet të cilat pastaj ishin përcjellë përmes hierarkisë komanduese të UJ-së. Lubomir Saviq, T. 21017 (24 janar 2008).

²⁹⁸³ Millan Kotur, T. 20745 (21 janar 2008).

²⁹⁸⁴ Rade Çuçak, T. 14867 (4 shtator 2007).

²⁹⁸⁵ Lubisha Stojimiroviq, T. 17656–17662 (26 tetor 2007).

²⁹⁸⁶ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 230; *shih gjithashtu* Vladimir Llazareviq, T. 18154 (13 nëntor 2007) (ku këmbëngul se Komanda e Përbashkët si entitet komandues nuk ka ekzistuar kurrë).

²⁹⁸⁷ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 230.

²⁹⁸⁸ Vladimir Llazareviq, T. 17795 (6 nëntor 2007). *Shih gjithashtu* P2113 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar në lidhje me ndalimin e operacioneve pa dijeninë dhe miratimin e Komandës së Përbashkët, 7 korrik 1998). Dhoma Gjyqësore gjithashtu thekson urdhrin e Brigadës së 125-të të Motorizuar i datës 7 korrik 1998, Komanda e brigadës e udhëzon Komandën e Grupit Luftarak 4 që të "marrë masa për organizimin e komunikimit të sigurt dhe të pandërprerë në kuadër të njësisë dhe me fqinjët."

²⁹⁸⁹ Vladimir Llazareviq, T. 17795 (6 nëntor 2007).

²⁹⁹⁰ Radojko Stefanoviç, T. 21664, 21666 (5 shkurt 2008), T. 21813 (6 shkurt 2008). Bozhidar Deliq, T. 19342–T. 19344 (29 nëntor 2007). Deliq konfirmoi se në territorin e Prizrenit, homologu i tij në MPB në vitin 1999 kishte qenë shefi i SPB-së së Prizrenit, Millosh Vojinoviç. Deliq gjithashtu tha se, në përgjithësi, pothuaj në të gjitha aksionet në të cilat kishte bashkëpunuar me MPB-në, ai dhe komanda e MPB-së kishin qenë së bashku në të njëjtin vend, dhe se, kur kjo nuk kishte qenë e mundshme, kishin formuar "postëkomandë të kombinuar." Konkretisht, ai dhe zëvendëskomandanti i MPB-së kishin qëndruar në njëren pikë, kurse zëvendësi i tij kishte shkuar në pikën tjetër me komandantin e MPB-së.

se, nga postëkomandat e përbashkëta, UJ-ja dhe MPB-ja "komandonin në mënyrë të pavarur forcat e veta."²⁹⁹¹ Ai shpjegoi se nëse sulmohej një njësi e MPB-së, komandanti i saj i dërgonte kërkesë për mbështetje komandantit të njësisë së UJ-së dhe ata merreshin me problemin konkret që lindte gjatë aksionit.²⁹⁹²

1095. Dhoma pranon se struktura komanduese e UJ-së vazhdoi të funksiononte gjatë operacioneve të kryera në vitin 1998 dhe se raportet e rregullta luftarake të njërive vartëse i dërgoheshin Korpusit të Prishtinës e jo Komandës së Përbashkët.

1096. Disa prova mund të sugjerojnë se Komanda e Përbashkët luajti njëfarë roli në miratimin e operacioneve luftarake. Bazuar në urdhrin e Komandës së Përbashkët të datës 6 korrik 1998, komandanti i Brigadës së 125-të të Motorizuar, Dragan Zhivanoviq, i ndaloi njësitë në varësi të tij të kryenin ndonjë aksion pa "miratimin e Komandës së Përbashkët" dhe të tij.²⁹⁹³ Sidoqoftë, në urdhër Zhivanoviqi saktëson se operacionet e kryera nga njësitë e MPB-së dhe UJ-së duhej të "miratoheshin nga Komanda e MPB-së dhe UJ-së, të cilat janë përgjegjëse për kryerjen e sigurt të detyrave."²⁹⁹⁴ Ai shtoi se dokumentet për angazhimin e Grupeve Luftarake 1 dhe 4 miratoheshin nga ai vetë, kurse dokumentet për angazhimin e Grupeve Luftarake 2 dhe 3 miratoheshin nga Komanda e Korpusit të Prishtinës. Bozhidar Deliqi lëshoi një urdhër duke u bazuar në të njëjtin urdhër të Komandës së Përbashkët. Sidoqoftë, urdhri i tij ishte i ndryshëm nga ai i komandantit të Brigadës së 125-të të Motorizuar sepse, kur përmendte urdhrin e Komandës së Përbashkët, ai ndalonte aksione pa "dijeninë dhe autorizimin e Komandës së Brigadës së 549-të të Motorizuar." Sikurse edhe në urdhrin e Komandës së Brigadës së 125-të të Motorizuar, Deliqi saktëson se "të gjitha operacionet e kryera nga njësitë e MPB-së dhe UJ-së autorizohen nga komandat e MPB-së dhe UJ-së që janë përgjegjëse për kryerjen e sigurt të detyrave."²⁹⁹⁵ Duke pasur parasysh përmbajtjen e urdhrin të Brigadës së 125-të të Motorizuar, si dhe faktin që në urdhrin e komandantit të Brigadës së 549-të të Motorizuar nuk përmendet "miratimi nga Komanda e Përbashkët", Dhoma Gjyqësore gjykon se, edhe pse urdhri i komandantit të Brigadës së 125-të të Motorizuar përmend

²⁹⁹¹ Radojko Stefanoviq, T. 21664, 21666 (5 shkurt 2008), T. 21813 (6 shkurt 2008).

²⁹⁹² Radojko Stefanoviq, T. 21811 (6 shkurt 2008).

²⁹⁹³ P2113 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar në lidhje me procedurat për ndërmarrjen e operacioneve luftarake, 7 korrik 1998). Zhivanoviqi nuk u pyet për këtë ndalesë në dukje të aksioneve pa miratimin e Komandës së Përbashkët, por ai tha se kishte qenë i detyruar të përdorte shprehjen, "Bazuar në urdhrin e Komandës së Përbashkët," sepse nuk i lejohej që të ndërronte titullin e urdhrave prej komandës më të lartë. Dragan Zhivanoviq, T. 20507 (17 janar 2008). *Shih gjithashu* P1423 (Raport luftimi në lidhje me vendet në të cilat ishin angazhuar njësitë e MPB-së, 7 gusht 1998).

²⁹⁹⁴ P2113 (Urdhër i Brigadës së 125-të të Motorizuar në lidhje me procedurat për ndërmarrjen e operacioneve luftarake, 7 korrik 1998). Zhivanoviqi nuk u pyet për këtë ndalesë në dukje të aksioneve pa miratimin e Komandës së Përbashkët, por ai tha se kishte qenë i detyruar të përdorte shprehjen, "Bazuar në urdhrin e Komandës së Përbashkët," sepse nuk i lejohej që të ndërronte titullin e urdhrave prej komandës më të lartë. Dragan Zhivanoviq, T. 20507 (17 janar 2008).

²⁹⁹⁵ 5D841 (Urdhër i Komandës së Brigadës së 549-të të Motorizuar, 7 korrik 1998).

"miratimin e Komandës së Përbashkët," në realitet ai kërkonte që operacionet të miratoheshin nga Komanda e Korpusit të Prishtinës dhe Komanda e MPB-së, jo nga Komanda e Përbashkët.

1097. Së fundi, më 29 tetor 1998, në një mbledhje të mbajtur në Belli Dvor në Beograd, njëra nga çështjet e diskutuara ishte se a duhej të vazhdonte të ekzistonte Komanda e Përbashkët. Në këtë mbledhje morën pjesë, Millosheviqi, Millutinoviqi, Miniqi, Shainoviqi, Matkoviqi, Stojilkoviqi, Angjelkoviqi, Perishiqi, Dimitrijeviqi, Samarxhiqi, Pavkoviqi, Gjorgjeviqi, Markoviqi, Stevanoviqi, Llukiqi, dhe Shushiqi.²⁹⁹⁶ Siç është shpjeguar më lart, besueshmëria e dokumentit 16-faqësh me titull "Procesverbali i Mbledhjes së Shtabit Operativ Ndërdikasterial Kundër Terrorizmit në Kosovë" (prova materiale P2166) është vënë në dyshim gjatë gjykimit dhe Dhoma e gjykon të përshtatshme që të diskutojë peshën që i ka dhënë këtij dokumenti dhe arsyet përkatëse.²⁹⁹⁷ Prokuroria mbështetet në P2166 në lidhje me disa çështje.²⁹⁹⁸ Mbrojtjet e Millutinoviqit dhe Shainoviqit e filluan sulmin kryesor kundër dokumentit dhe kërkojnë nga Dhoma të mos mbështetet në saktësinë e tij.²⁹⁹⁹

1098. Aty raportohet se Pavkoviqi paraqiti një raport të shkurtër "në emër të Komandës së Përbashkët" për "zbatimin e Planit kundër Terrorizmit në Kosovë," ku përshkruheshin detyrat e parashtruara në planin fillestar dhe hollësitë e rezultateve.³⁰⁰⁰ Raportohet se Llukiqi paraqiti një raport për punën e Komandës së Përbashkët dhe i "informoi anëtarët e Shtabit" për zbatimin e Marrëveshjes Holbrooke-Millosheviq.³⁰⁰¹ Në raportin e tij, Llukiqi i kushton vëmendje të posaçme bashkëpunimit shumë të suksesshëm dhe profesional midis MPB-së dhe UJ-së. Raportohet se Millomir Miniqi, i prezantuar si "Kryetar i Dhomës së Qytetarëve të Kuvendit Federal," kishte "paraqitur një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zbatimit të Planit Kundër Terrorizmit në Kosovë," dhe kishte kërkuar që "Shtabi Operativ" të paraqiste një vlerësim se sa suksesshëm i kishte "përmbushur autorizimet e dhëna" Komanda e Përbashkët.³⁰⁰² Perishiqi gjithashtu kishte paraqitur pikëpamjet e

²⁹⁹⁶ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor të mbajtur më 29 tetor 1998), f. 1; *shih gjithashtu* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 161. Prova materiale është e datës 2 nëntor 1998 dhe është e nënshkruar nga Shushiqi dhe Presidenti i RFJ-së Millosheviq.

²⁹⁹⁷ Pasi i dëgjoi palët, Dhoma e pranoi si provë, duke konkluduar se përmbante mjaft tregues të besueshmërisë dhe duke thënë se do të vendoste me vonë për peshën që do t'i jepte. T. 8611 (18 janar 2007), 8731 (19 janar 2007). Më 14 janar 2008, Dhoma pranoi si provë përkthimin e korrigjuar të dokumentit. Urdhër në lidhje me Provat Materiale P2166 dhe P1506, 14 janar 2008.

²⁹⁹⁸ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Prokurorisë, 28 korrik 2008 (versioni publik) para. 49, 63, 101, 134, 156–157, 171, 181–184, 570, 582, 660, 858, 863, 872, 1019–1020, 1026.

²⁹⁹⁹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Millutinoviqit, 15 korrik 2008, para. 177–178; Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 218–221, 224–244; *shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkoviqit, 28 korrik 2008 (versioni publik) para. 135, 258.

³⁰⁰⁰ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor të mbajtur më 29 tetor 1998), f. 2–7.

³⁰⁰¹ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor të mbajtur më 29 tetor 1998), f. 7.

³⁰⁰² P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 8–9. I pyetur për këtë nga pala kundërshtare, Miniqi dëshmoi se kishte bërë një propozim të ngjashëm, por nuk e kishte ditur se ekzistonte ndonjë

veta për zbatimin e Planit. Sipas tij, tabloja e paraqitur nga disa anëtarë të Komandës së Përbashkët nuk i përgjigjej realitetit. Këto vlerësime u pasuan me diskutime nga të pranishmit në tema si zgjerimi i brezit kufitar, bashkëpunimi me KVM-në, dhe çështjen se a duhet të vazhdojë të ekzistojë Komanda e Përbashkët.³⁰⁰³

1099. Në lidhje me këtë çështje, raportohet se Millutinoviçi ka thënë se "Komanda e Përbashkët duhet të vazhdojë të funksionojë edhe për një kohë, edhe pse duhet të mendohet se a duhet të jenë të njëjtit anëtarë apo duhen të bëhen ndryshime."³⁰⁰⁴ Shainoviçi "u pajtua me mendimin se duhet të rivlerësohet arsyeshmëria e vazhdimit të veprimtarisë së Komandës së Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë në përbërjen aktuale" dhe "tha se duhet të zvogëlohet numri i personave të angazhuar dhe duhet t'i përgatisim më mirë për veprime më efektive në rrethana të reja."³⁰⁰⁵ Millosheviçi theksoi "nevojën për vazhdimin e funksionimit të Komandës së Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë dhe të Shtabit Bashkërendues."³⁰⁰⁶

1100. Disa dëshmitarë bënë komente në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e dokumentit. Aleksandar Vasileviçi e njohu vulën e përdorur në të duke thënë se ishte e Zyrës Ushtarake të Presidentit të RFJ-së dhe konfirmoi se Shushiçi kishte qenë shef i Zyrës Ushtarake të Presidentit.³⁰⁰⁷ Vetëm pas kësaj Dhoma e pranoi dokumentin si provë.

1101. John Crosland-i shfaqti mendimin se dokumenti tregonte nivelin e përfshirjes së Pavkoviçit në Planin Kundër Terrorizmit në Kosovë, por nuk u pajtua me saktësinë e dokumentit në lidhje me numrin e shqiptarëve të vrarë, numrin e gjithsejtë të luftëtarëve të UÇK-së që kishin vepruar në Kosovë, dhe sigurimin e strehimit dhe kujdesit për shqiptarët kosovarë të shpërngulur përkohësisht.³⁰⁰⁸

1102. Millomir Miniçi, për të cilin është shënuar se kishte paraqitur një pasqyrë gjithëpërfshirëse të zbatimit të Planit Kundër Terrorizmit në Kosovë, dëshmoi se nuk e kishte parë këtë dokument para se të vinte në Hagë dhe nuk e kishte ditur çfarë ishte "Shtabi Operativ Ndërdikasterial," kush kishin qenë anëtarët, dhe cili kishte qenë roli i tij. Ai nuk u pajtua me shënimet në procesverbal në lidhje me çfarë kishte thënë Llukiçi dhe dëshmoi se nuk kishte pasur dijeni për ekzistencën e

"shtabi operativ" dhe se nuk kishte përdorur shprehjet "Komanda e Përbashkët" apo "shtabi operativ" kur kishte folur në këtë mbledhje. Millomir Miniçi, T. 14767 (31 gusht 2007). P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 161.

³⁰⁰³ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 9–16.

³⁰⁰⁴ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 12.

³⁰⁰⁵ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 13.

³⁰⁰⁶ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 15.

³⁰⁰⁷ Aleksandar Vasileviçi, T. 8729–8731 (19 janar 2007).

³⁰⁰⁸ John Crosland, T. 9834, 9837 (7 shkurt 2007), T. 10034 (9 shkurt 2007).

"Shtabit Operativ" dhe kurrë nuk e kishte përdorur shprehjen "Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë."³⁰⁰⁹

1103. Dushan Matkoviqi dëshmoi se i kujtohej që ishte mbajtur kjo mbledhje dhe se ishin mbajtur edhe tri të tilla "të këtij niveli në shtëpinë e Millosheviqit;" sidoqoftë, fakti se në dokument përmendet se Pavkoviqi kishte folur në emër të Komandës së Përbashkët ishte i pasaktë dhe "i pakuptimtë," sepse Pavkoviqi gjithmonë kishte folur në emër të Korpusit të Prishtinës.³⁰¹⁰ Zoran Angjelkoviqi konfirmoi se dokumenti pasqyronte ato që ishin thënë në lidhje me bashkëpunimin midis UJ-së dhe MPB-së.³⁰¹¹ Llazareviqi dëshmoi se dokumenti ishte autentik, por se ai nuk kishte dijeni për ekzistencën e organit të quajtur "Shtabi Operativ Ndërdikasterial" në nivel të lartë shtetëror.³⁰¹² Bozhidar Deliqi kritikoi saktësinë e disa të dhënave që thuhet se i kishte paraqitur Pavkoviqi në mbledhje.³⁰¹³ Dëshmitari ekspert i ftuar nga Mbrojtja e Shainoviqit, Radomir Llukiqi, nuk ishte në gjendje të konfirmonte ekzistencën a entitetit të quajtur "Shtabi Operativ Ndërdikasterial" dhe, pas njëfarë hutimi, shpjegoi se procesverbali ishte i mbledhjes në të cilën ishin shkëmbyer informata dhe ishin bërë konsultime, e jo të mbledhjes në të cilën ishin dhënë urdhra.³⁰¹⁴

1104. Millan Gjakoviqi (a) ishte i vetëdijshëm për përmbajtjen e dokumentit, meqë ai kishte "përgatitur disa nga informatat me organin operativ që kishin të bënin me operacionet luftarake"; (b) dinte se mbledhja ishte mbajtur në Beograd në shtëpinë e Presidentit Millosheviq; dhe (c) nuk e kishte parë personalisht dokumentin më parë.³⁰¹⁵ Së fundi, Aleksandar Dimitrijeviqi (a) dëshmoi se nuk kishte dëgjuar për ndonjë "Shtab Operativ Ndërdikasterial Kundër Terrorizmit"; (b) e kundërshtoi saktësinë e procesverbalit ku thuhet se Millosheviqi "propozoi dhe Shtabi i pranoi njëzëri konkluzionet në vijim"; (c) konfirmoi autenticitetin e dokumentit, por vërejti se vetë dokumenti tregonte se në mbledhje nuk ishin mbajtur shënime stenografike dhe kundërshtoi saktësinë e përmbajtjes duke pyetur se si Shushiqi kishte qenë në gjendje të mbante mend të gjitha hollësitë e dokumentit pa marrë shënime të njëkohshme; (d) vuri në dyshim deklaratën që i atribuohet Pavkoviqit se "plani ynë nuk është që të vrasim të gjithë shqiptarët"; dhe (e) komentoi se kurrë nuk kishte ndodhur që njerëzit të flisnin para Millosheviqit për "fshatrat që ishin çarmatosur,

³⁰⁰⁹ Millomir Miniq, T. 14764, 14766 (31 gusht 2007).

³⁰¹⁰ Dushan Matkoviq, T. 14609–14611, 14612–14615 (29 gusht 2007), T. 14627 (30 gusht 2007).

³⁰¹¹ Zoran Angjelkoviq, T. 14713–14715 (30 gusht 2007).

³⁰¹² Vladimir Lazareviq, T. 18691 (21 nëntor 2007).

³⁰¹³ Bozhidar Deliq, T. 19587–19590 (5 dhjetor 2007).

³⁰¹⁴ Radomir Llukiq, T. 26271–26274 (15 maj 2008), T. 26338–26339 (16 maj 2008); shih gjithashtu Momir Bullatoviq, T. 13916 (17 gusht 2007); Lubivoje Joksiq, T. 22038 (11 shkurt 2008); Miroslav Mijatoviq, T. 22386 (14 shkurt 2008).

³⁰¹⁵ Millan Gjakoviq, T. 26446–26448 (20 maj 2008).

municionin e harxhuar, dhe hollësi të tilla."³⁰¹⁶ Dimitrijeviqi gjithashtu tha se dokumenti i dukej "si dokument që ishte bërë sipas ndonjë plani dhe që duhej të përdorej për të fshehur diçka," dhe se mendonte se dokumenti "thjesht ishte shkruar më vonë për kushedi çfarë arsyesh."³⁰¹⁷

1105. Më 5 nëntor 1998 në godinën e MPB-së në Prishtinë u mbajt një takim me figurat politike dhe të biznesit në Kosovë, Shainoviçin, Llukiqin, Pavkoviçin, Stojilkoviçin, Gjorgjeviçin, Rade Markoviçin, Miroslav Mijatoviçin, anëtarët e Grupit të Punës për Kosovën, shefat e SPB-ve dhe DPB-ve, dhe komandantët e PJP-ve. Gjatë kësaj mbledhjeje, Millutinoviçi iu referua mbledhjes së mbajtur më 29 tetor 1998: ai shpjegoi se ishte diskutuar gjendja në ushtri dhe polici. Millutinoviçi posaçërisht theksoi si vijon: "Sa i përket ushtrisë dhe policisë jugosllave, gjithçka do të mbetet ashtu siç ka qenë deri tani (komanda e përbashkët, njësitë e UJ-së nuk do të tërhiqen, dhe forcat policore janë zvogëluar në përputhje me numrin e policëve të tërhequr më parë)."³⁰¹⁸ Dhoma gjykon se kjo dëshmi konfirmon ato të paragrafëve të mësipërm.

1106. Dhoma vëren se komentet që i janë atribuar Pavkoviçit në faqet 5-6 të procesverbalit – ku jepet numri i shqiptarëve të Kosovës të cilëve u është ofruar strehim gjatë zbatimit të Planit – janë të ngjashëm me një dokument pjesë të të cilit janë botuar në një numër të *Vojskas* të vitit 2001 me titull, "Zbatimi i Rregullave të së Drejtës Ndërkombëtare për Konflike të Armatosur."³⁰¹⁹ Fragmenti në *Vojska* është përshkruar si "Raport dhe Konkluzione mbi Zbatimin e Planit për Zhdukjen e Terrorizmit në Kosovë dhe Metohi," që është nënshkruar nga Komanda e Përbashkët dhe është shkruar në tetor 1998; shifrat e dhëna në fragmentin nga raporti janë të njëjta me shifrat që sipas procesverbalit (P2166) raportoi Pavkoviçi në mbledhjen e 29 tetorit 1998, ku thuhet se ai foli në emër të Komandës së Përbashkët. Ky fakt, së bashku me komentet e bëra nga Miniqi në mbledhjet e Komandës së Përbashkët,³⁰²⁰ tregojnë se ishte përgatitur një raport për zbatimin e Planit Kundër Terrorizmit në Kosovë për t'u miratuar nga Komanda e Përbashkët dhe se Pavkoviçi lexoi nga ai raport kur bëri komentet në mbledhjen e 29 tetorit 1998.

1107. Duke marrë parasysh të gjitha provat në lidhje me këtë dokument, Dhoma konfirmon konkluzionet e veta të nxjerra gjatë procesit gjyqësor se dokumenti është pasqyrim autentik i mbledhjes që u mbajt më 29 tetor 1998 në Belli Dvor së bashku me personat e shënuar aty si të

³⁰¹⁶ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26598, 26610–26612 (8 korrik 2008).

³⁰¹⁷ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26612–26615 (8 korrik 2008).

³⁰¹⁸ P2805 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së në Prishtinë, 5 nëntor 1998), f. 4.

³⁰¹⁹ *Krahaso* P2166 (Procesverbal i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998), f. 5–6, *me* P1011 (Ivan Markoviç, ed., *The Application of Rules of the International Law of Armed Conflicts* (2001)), f. 72.

³⁰²⁰ P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 130, 161.

pranishëm.³⁰²¹ Nuk ka arsye që të dyshohet se në mbledhje me të vërtetë janë diskutuar temat e përgjithshme që në dokument thuhet se janë diskutuar. Mbledhja ishte thirrur thjesht për të rishikuar veprimet e ndërmarra sipas Planit dhe në emër të Komandës së Përbashkët dhe për vlerësimin e përgjithshëm të gjendjes pas zbatimit të Planit dhe Marrëveshjeve të tetorit. Dhoma gjykon se, edhe pse dokumenti është përmbledhje dhe jo pasqyrim i fjalëpërfjalshëm, atij mund t'i jepet rëndësi e konsiderueshme duke marrë parasysh autenticitetin e tij, faktin që mbledhja është mbajtur padryshim, dhe përputhshmërinë e procesverbalit me materialet e tjera. Rrjedhimisht Dhoma bazohet në këtë dokument, nëse konfirmohet, dhe e përdor për të konfirmuar dëshmitë dhe provat shkresore të tjera që kanë të bëjnë me mbledhjen.

(D) Konkluzionet në lidhje me Komandën e Përbashkët në vitin 1998

1108. Dëshmitë e disa dëshmitarëve se Komanda e Përbashkët nuk ka ekzistuar ose se nuk ka pasur ndikim mbi asgjë, duhen gjykuar kundrejt një sasive të konsiderueshme provash që tregojnë se në vitin 1998 u mbajtën rregullisht mbledhje dhe se pjesëtarë të rëndësishëm të UJ-së, MPB-së, dhe udhëheqjes civile morën pjesë në këto mbledhje, në të cilat u diskutuan çështje në lidhje me operacionet luftarake të kryera në Kosovë në atë kohë dhe u shkëmbyen informata.

1109. Dhoma është e bindur se entiteti i njohur si "Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë" ka ekzistuar në vitin 1998. Ajo u krijua me autorizimin *de facto* të Presidentit të RFJ-së, Sllobodan Millosheviq, rreth qershorit 1998 për t'iu përgjigjur nevojës më të madhe për bashkërendim midis forcave të MPB-së dhe UJ-së në Kosovë. Anëtarësia e saj përbëhej nga individë të strukturave politike të RFJ-së dhe Serbisë, të ushtrisë, dhe policisë. Anëtarësia ishte çështje joformale, pa kërkesa teknike, dhe përbërja e Komandës së Përbashkët ndryshonte në periudha të ndryshme.

1110. Entiteti i quajtur Komanda e Përbashkët luajti rol në bashkërendimin dhe shkëmbimin e informatave dhe të dhënave të zbulimit midis MPB-së dhe UJ-së në gjysmën e dytë të vitit 1998. Vendimet dhe urdhrat për operacione të përbashkëta u zbatuan përmes hierarkisë ekzistuese

³⁰²¹ Vendimi i Dhomës se dokumenti përmbante tregues të mjaftueshëm të besueshmërisë për t'u konsideruar autentik mbështetet nga dëshmitë e Vasileviqit, Bullatoviqit, Gjakoviqit, Llazareviqit, dhe — deri diku — Matkoviqit. Sa i përket besueshmërisë së përmbajtjes së dokumentit, Miniqi, Matkoviqi, Angjelkoviqi, dhe Dimitrijeviqi janë dëshmitarë që ishin të pranishëm në mbledhje. Miniqi tha se prova materiale është e pasaktë kur përmendet Komanda e Përbashkët dhe se ishte caktuar që Llukiqi të raportonte mbi Komandën e Përbashkët dhe Shtabin Ndërdikasterial Kundër Terrorizmit në Kosovë; ai ishte i sigurt se nuk i kishte përdorur ato shprehje, edhe pse në provën materiale thuhet se i kishte përdorur. Matkoviqi u pajtua me Miniqin se shprehja "Komanda e Përbashkët" nuk ishte përdorur në mbledhje. Angjelkoviqi nuk ishte i sigurt se a ishte përdorur shprehja "Komanda e Përbashkët," por konfirmoi se ato që thuheshin në provën materiale për bashkëpunimin midis MPB-së dhe UJ-së ishin të sakta. Kundërshtimi kryesor i saktësisë së dokumentit vjen nga dëshmia e Dimitrijeviqit, kurse Gjakoviqi kishte më pak dyshime në lidhje me përmbajtjen e tij: edhe pse kishte pasur dijeni për ekzistencën e dokumentit, ai nuk e kishte parë para se të

komanduese; dhe si në mënyrë të drejtpërdrejtë, po ashtu edhe të tërthortë, Komanda e Përbashkët pati ndikim mbi MPB-në dhe UJ-në sa i përket zbatimit të fazave të ndryshme të Planit Kundër Terrorizmit. Edhe nëse disa anëtarë të Komandës së Përbashkët mund të mos kenë pasur pushtet *de jure* për dhënien drejtpërsëdrejti të urdhrave njësisive të MPB-së ose UJ-së, *anëtarë të veçantë të Komandës së Përbashkët* e ushtruan ndikimin e vet në mënyrën se si u zbatua plani, duke përdorur sistemet ekzistuese komanduese dhe kontrolluese brenda UJ-së dhe MPB-së. Për shembull, provat tregojnë se Pavkoviqi i bëri disa kërkesa Komandës së Armatës së 3-të duke u bazuar në diskutimet e mbajtura në mbledhjet e Komandës së Përbashkët. Gjithashtu, Shënimet tregojnë se vendimet në lidhje me mënyrën dhe kohën e zbatimit të planit u diskutuan në mbledhjet e Komandës së Përbashkët dhe se, me raste, Miniqi dhe Shainoviqi luajtën rol udhëheqës në këto diskutime dhe në fakt kërkuan që të bëheshin gjëra konkrete.³⁰²²

1111. Komanda e Përbashkët ishte pjesë e sistemit të bashkërendimit që filloi funksionimin që në maj 1998, përmes të cilit UJ-ja dhe MPB-ja ishin në gjendje të bashkëpunonin në Kosovë. Ajo mundësoi që komandantët e MPB-së "të ruanin namin" duke mos qenë të detyruar të merrnin urdhra nga UJ-ja para dhe gjatë gjendjes së jashtëzakonshme. Gjithashtu Slllobodan Millosheviqit iu dha mundësia që përmes Pavkoviqit, t'i drejtonte veprimet e MPB-së në rrethana të një legjitimiteti të dyshimtë dhe që MPB-ja të gëzonte përkrahjen e UJ-së. Kjo gjë ishte e rëndësishme për Millosheviqin sepse disa ushtarakë nuk pajtoheshin me dislokimin e ushtrisë në Kosovë, përveçse për ruajtjen e kufirit, dhe ankoheshin për sjelljen e MPB-së në Kosovë dhe për faktin se ajo nuk i bashkërendonte veprimet me UJ-në dhe nuk ishte vënë nën varësinë e komandës së UJ-së.

ii. Komanda e Përbashkët në vitin 1999

(A) Ekzistenca dhe pushteti i Komandës së Përbashkët në vitin 1999

1112. Ekzistenca e Komandës së Përbashkët si entitet gjatë vitit 1999 është më pak e dukshme se në vitin 1998. Provat janë më të mjegullta dhe nuk ka procesverbale të mbledhjeve; ose, në rast se janë mbajtur procesverbale të tilla, ato nuk i janë vënë në dispozicion Dhomës. Sidoqoftë ka prova të konsiderueshme në lidhje me përpjekjet e bashkërenduara të UJ-së dhe MPB-së për t'u marrë me "gjendjen terroriste" në Kosovë, si dhe me kërcënimin nga pushtimi tokësor i NATO-s në vitin 1999; por ka prova të pakta që konkretisht tregojnë ekzistencën e Komandës së Përbashkët në vitin 1999. Gjithashtu nuk ka prova për ndonjë mandat të qartë të Komandës së Përbashkët në vitin

dëshmonte para Dhomës. Deliqi, edhe pse nuk kishte qenë i pranishëm në mbledhje, gjykoi se disa pjesë të tij ishin të pasakta, përse i përket operacioneve luftarake të zbatuara sipas Planit.

³⁰²² *Shih përgjithësisht* P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët).

1999, edhe pse pjesëmarrësit në mbledhjen e 29 tetorit 1998 ranë dakord që Komanda e Përbashkët duhej të vazhdonte të funksiononte – ndonëse në përbërje tjetër.³⁰²³

1113. Sipas Millan Gjakoviçit, pas tetorit 1998 nuk u mbajtën mbledhje të Komandës së Përbashkët. Ai gjithashtu dëshmoi se nuk dinte a u mbajtën mbledhje të Komandës së Përbashkët në vitin 1999, sepse në janar të atij viti ai u emërua në një post të ri në Nish. Sidoqoftë ai dëgjoi nga anëtarët e organeve operative në Komandën e Korpusit të Prishtinës, të cilat në fakt ishin vartës të tij meqenëse ai ishte shef i Degës për Operacione dhe Stërvitje në Komandën e Armatës së 3-të, se ata kishin vazhduar të mbanin mbledhje me MPB-në.³⁰²⁴

1114. Ka dëshmi të ndryshme për vijimin e ekzistencës së Komandës së Përbashkët gjatë vitit 1999. Sllobodan Kosovaci, shef i Administratës së Organizimit të UJ-së, dëshmoi se gjatë "luftës" kishte dëgjuar gjatë bisedave joformale të përmendur shprehja "Komanda e Përbashkët," por tha se meqenëse ai e dinte se nuk ishte organizuar në pajtim me rregullat e organizimit të UJ-së, ai nuk kishte pyetur për të.³⁰²⁵ Kosovaci gjithashtu theksoi se detyra e këtij organi ishte diktuar nga fakti se nuk ekzistonte sistem që u mundësonte të gjithë pjesëmarrësve në luftë që të organizoheshin nën një komandë apo udhëheqje dhe se për mbushjen e kësaj zbrastëtie u formua një organ bashkërendues.³⁰²⁶ Gjorgje Qurçini gjithashtu tha se kishte dëgjuar për Komandën e Përbashkët një herë gjatë mbledhjes së Kolegjiumit në fillim të vitit 1999.³⁰²⁷ Vasileviçi e karakterizoi Komandën e Përbashkët të vitit 1999 se kishte pushtetin e një "Minikomande të Lartë," duke e shpejguar funksionin e saj si organi në komandë të operacioneve të përbashkëta të forcave të UJ-së dhe MPB-së meqenëse MPB-ja nuk ishte zyrtarisht në varësi të UJ-së.³⁰²⁸

1115. Dëshmitarë të tjerë dëshmuan se Komanda e Përbashkët nuk kishte funksionuar në vitin 1999. Branko Gajiçi dëshmoi se Komanda e Përbashkët pushoi së ekzistuari pas Marrëveshjes Holbrooke-Milloshëviçi. Tomislav Mlladenoviçi tha se mbledhjet midis UJ-së dhe MPB-së përfunduan me përfundimin e aksionit të fundit në tetor 1998. Velimir Obradoviçi dëshmoi se mbledhjet e Komandës së Përbashkët u mbajtën nga korriku deri në fund të tetorit 1998, por nuk

³⁰²³ P2166 (Procesverbali i mbledhjes në Belli Dvor mbajtur më 29 tetor 1998); P1468 (Shënime të Komandës së Përbashkët), f. 163. *Shih gjithashtu* P2805 (Procesverbal i mbledhjes së Shtabit të MPB-së për Kosovë në Prishtinë, 5 nëntor 1998), f. 4.

³⁰²⁴ Millan Gjakoviçi, T. 26388–26389 (19 maj 2008).

³⁰²⁵ Sllobodan Kosovaci, T. 15870–15871 (18 shtator 2007).

³⁰²⁶ Sllobodan Kosovaci, T. 15883 (18 shtator 2007).

³⁰²⁷ Gjorgje Qurçini, T. 16972 (5 tetor 2007). Konkretisht, Qurçini kishte qenë i pranishëm në mbledhjen e 21 janarit 1999 të Kolegjiumit të UJ-së, ku thuhet se Ojdaniçi kishte përmendur Komandën e Përbashkët disa herë. *Shih* P939 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999).

³⁰²⁸ Aleksandar Vasileviçi, P2600 (deklarata e dëshmitarit e datës 14 janar 2007), para. 46.

kishte dëgjuar për to në vitin 1999.³⁰²⁹ Momir Stojanoviçi nuk kishte dëgjuar të përdorej shprehja Komanda e Përbashkët në vitin 1999, përveç në disa dokumente që i kishte parë në Komandën e Korpusit të Prishtinës që kishin pasur atë emërtim.³⁰³⁰ Gjithashtu, ai pretendoi se nuk kishte pasur dijeni për mbledhje të Komandës së Përbashkët në vitin 1999; dhe, duke pasur parasysh pozitën dhe detyrat e tij, sidomos raportimet ditore mbi sigurinë për komandantin e Korpusit të Prishtinës, ai ishte i bindur se do të ishte në dijeni nëse do të ishin mbajtur.³⁰³¹ Gjithashtu, edhe oficeri i RDB-së Lubivoje Joksiçi nuk e kishte dëgjuar shprehjen "Komanda e Përbashkët" deri pas luftës dhe u befusua tërësisht kur dëgjoji për të në lidhje me vitin 1999; ai tha se e kishte kaluar "pothuaj tërë luftën" me Llukiqin dhe mohoi kategorikisht ekzistencën e Komandës së Përbashkët.³⁰³² Miroslav Mijatoviçi, zëvendëseshë i Shtabit të MPB-së për Kosovë, tha se ishte i bindur që Komanda e Përbashkët nuk kishte ekzistuar.³⁰³³ Pjesëtarë të tjerë të MPB-së gjithashtu mohuan se kishin dëgjuar ose se kishin qenë në dijeni të Komandës së Përbashkët në vitin 1999 dhe në vitin 1998.³⁰³⁴

1116. Sidoqoftë, ekzistojnë dokumente ushtarake zyrtare të vitit 1999 që përmendin "Komandën e Përbashkët për KiM-in."³⁰³⁵ Për shembull, në përkrahimin e veprimeve të njëjësive të UJ-së, në një raport luftarak të Komandës së Armatës së 3-të dërguar Qendrës Operative të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, të datës 29 prill 1999, saktësohet se ishin ndërmarrë masa për bllokimin e sektorëve të caktuar dhe kryerjen e detyrave në pajtim me "vendimet e komandës së përbashkët për Kosovën dhe Metohinë."³⁰³⁶ Gjithashtu, në një raport luftarak të Komandës së Korpusit të Prishtinës thuhet se operacionet vazhdonin në pajtim me vendimin e Komandës së Përbashkët.³⁰³⁷

1117. Një shembull tjetër është një lajmërim publik i Pavkoviçit në faqen e internetit të UJ-së në qershor 2001 në lidhje me kamionin-frigorifer të gjetur në lumin Danub në vitin 1999, që është diskutuar më gjatë në Pjesën VII.P më poshtë. Në lidhje me policinë Pavkoviçi thotë se:

Bashkëpunimi me ushtrinë koordinohej përmes aktorëve politikë në komandën e përbashkët, që ishte formuar për këtë qëllim. Si rezultat, informacioni për veprimet e

³⁰²⁹ Branko Gajiq, T. 15413 (11 shtator 2007); Tomislav Mladenoviçi, T. 17619 (25 tetor 2007); Velimir Obradoviçi, T. 17419 (22 tetor 2007).

³⁰³⁰ Momir Stojanoviçi, T. 20058 (11 dhjetor 2007).

³⁰³¹ Momir Stojanoviçi, T. 19766 (7 dhjetor 2007).

³⁰³² Lubivoje Joksiçi, T. 22005–22006 (8 shkurt 2008).

³⁰³³ Miroslav Mijatoviçi, T. 22412–22413 (14 shkurt 2008).

³⁰³⁴ Millosh Deretiçi, T. 22589 (18 shkurt 2008); Dushan Gavraniçi, T. 22723 (19 shkurt 2008); Radovan Vuçureviçi, T. 23131 (25 shkurt 2008); Bozhidar Filiçi, T. 24008, 24010 (10 mars 2008); Millosh Vojnoviçi, T. 24190 (12 mars 2008); Vladimir Liliçi, T. 24345 (17 mars 2008).

³⁰³⁵ P1487 (Sugjerimet e Ojdaniqit dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 17 prill 1999), f. 1; P2016 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të dhe Shtabit të Komandës së Lartë, 25 prill 1999), f. 2; P1459 (Raport i Armatës së 3-të për mosrespektim nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999), f. 2.

³⁰³⁶ P2017 (Raport luftarak i Armatës së 3-të dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 29 prill 1999), f. 2.

³⁰³⁷ P2016 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të dhe Shtabit të Komandës së Lartë, 25 prill 1999), f. 2.

njësive të forcave të policisë mund të merret më së miri nga komandantët e policisë dhe anëtarët e Komandës së Përbashkët që i komandonin.³⁰³⁸

Millan Gjakoviçi e komentoi këtë lajmërim dhe tha se ai vetëm pjesërisht pajtohej me këtë përshkrim, për aq sa Komanda e Përbashkët kishte kuptimin e një komande të përbashkët që bashkërendonte aktivitetet midis shtabeve të UJ-së dhe MPB-së dhe se konkretisht kishte të bënte me bashkëpunimin midis Pavkoviçit dhe Llukiqit.³⁰³⁹

1118. Për më tepër, më 17 prill 1999, Ojdaniçi i dërgoi një dokument Komandës së Armatës së 3-të në të cilin "sugjeronte" që të ndryshohej një urdhër konkret i Komandës së Përbashkët i lëshuar më 15 prill 1999.³⁰⁴⁰ Meqenëse Ojdaniçi kishte kompetencë që t'i jepte urdhra Komandës së Armatës së 3-të, "sugjerimi" i tij, në të cilin i thotë komandës që të "konsiderojë mundësinë që forcat të ...", duket si anomali. Siç dëshmoi Simiqi, sugjerimet zakonisht vijnë nga nivelet më të ulëta komanduese drejtuar niveleve më të larta, jo e kundërta.³⁰⁴¹ Shefi i Komunikimeve i UJ-së, gjeneral Lubomir Angjelkoviçi, shpjegoi se sugjerimet e Ojdaniçit si oficeri më i lartë në UJ në lidhje me një urdhër të lëshuar nga një organ tjetër i quajtur Komanda e Përbashkët tregon se ky organ nuk ishte as epror, as vartës i Ojdaniçit dhe, rrjedhimisht nuk mund të ishte pjesë e komandës së UJ-së.³⁰⁴² Radinoviçi dëshmoi se, edhe pse "sugjerimet" nuk ishin formë e zakonshme komunikimi në ushtri, ato nuk ishin gjë e padëgjuar, dhe se ndoshta sugjerimet i ishin bërë ndonjë organi bashkërendues, të cilin ai e përshkroi si organ që kishte bashkërenduar veprimtaritë e MPB-së dhe UJ-së përmes marrëveshjes. Sidoqoftë, është e qartë se ai mendonte se "sugjerimet" ishin anomali në strukturën komanduese.³⁰⁴³ Dhoma ka parasysh fjalinë e fundit të dokumentit dërguar Pavkoviçit, në të cilën shkruhet: "Mendimi ynë është se do të ishte e dobishme që të merrni plotësisht në konsideratë sugjerimet tona dhe të korrigjoni vendimet *tuaja* dhe dislokimin e forcave për të parandaluar edhe përhapjen e gjendjes dhe kështu të arrihet qëllimi juaj themelor – shkatërrimi."³⁰⁴⁴

³⁰³⁸ P1281 (Lajmërim Publik i Pavkoviçit nga faqja e internetit e UJ-së, 14 qershor 2001), f. 2.

³⁰³⁹ Millan Gjakoviçi, T. 26473–26474 (20 maj 2008).

³⁰⁴⁰ P1487 (Sugjerime dërguar Armatës së 3-të nga Shtabi i Komandës së Lartë, 17 prill 1999). Edhe pse dëshmoi se nuk kishte dëgjuar kurrë për Komandën e Përbashkët, gjeneralkoloneli i UJ-së Spasoje Smilaniq, shef i Administratës së Parë, ishte në gjendje të konfirmonte autenticitetin e këtij dokumenti pasi verifikoi nënshkrimin e Ojdaniçit. Spasoje Smilaniq, T. 15781 (17 shtator 2007); *shih gjithashtu* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Ojdaniçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 210–214.

³⁰⁴¹ Miodrag Simiq, T. 15691 (14 shtator 2007).

³⁰⁴² Lubomir Angjelkoviçi, T. 16432 (26 shtator 2007). Ky dëshmitar gjithashtu dëshmoi se ishte e mundshme që Millosheviçi të kishte formuar një organ të tillë dhe t'i kishte akorduar kompetenca. Lubomir Angjelkoviçi, T. 16433 (26 shtator 2007).

³⁰⁴³ Radovan Radinoviçi, T. 17328–17336 (19 tetor 2007); *shih gjithashtu* Gjorgje Qurçini, T. 16970–16974 (5 tetor 2007) (ku dëshmon se shprehja "sugjerime" ishte përdorur edhe në dokumente të tjera të krijuara nga Ojdaniçi).

³⁰⁴⁴ P1487 (Sugjerime dërguar Armatës së 3-të nga Shtabi i Komandës së Lartë, 17 prill 1999) (theksimet janë shtuar).

1119. Rrethanat në lidhje me "sugjerimet" e Ojdaniqit tregojnë se hierarkia komanduese e UJ-së në vitin 1999 funksiononte me njëfarë fleksibiliteti. Sipas Qurçinit, para se Ojdaniqi të bënte "sugjerimet," ai ishte takuar me Pavkoviqin dhe më vonë edhe me të. Gjatë takimit midis Pavkoviqit dhe Ojdaniqit, Pavkoviqi i tha Ojdaniqit se kishte ardhur nga zyra e Millosheviqit. Gjithashtu Pavkoviqi i tregoi Ojdaniqit një hartë me numër 455-148 e cila ishte lëshuar më 15 prill 1999.³⁰⁴⁵ Ojdaniqi e mori hartën dhe ia tregoi Qurçinit për të dëgjuar mendimin e tij në lidhje me operacionin e paraqitur në hartë. Duke marrë parasysh shqetësimet e shprehura nga Qurçini në lidhje me operacionet e përbashkëta që ishin planifikuar në këtë hartë, Ojdaniqi hartoi "sugjerimet" e tij për Armatën e 3-të. Qurçini dëshmoi se Ojdaniqi i kishte hartuar sugjerimet vetëm në bazë të hartës së marrë nga Pavkoviqi dhe pa e parë urdhrin e Komandës së Përbashkët me të cilin kishte të bënte dokumenti.³⁰⁴⁶ Dëshmia e Qurçinit nuk shpjegon pikësëpari arsyen se pse Pavkoviqi kishte takuar Millosheviqin. Sidoqoftë, dëshmia tregon se ekzistonte lidhje e drejtpërdrejtë nga Pavkoviqi te Millosheviqi. Megjithëse kjo nuk përbënte domosdoshmërisht shkelje të hierarkisë komanduese, ai në thelb anashkaloi eprorin e tij të drejtpërdrejtë kur kishte takuar Millosheviqin.³⁰⁴⁷ Lidhja e drejtpërdrejtë e Pavkoviqit me Millosheviqin është diskutuar më tej në pjesën kushtuar përgjegjësisë individuale penale të Pavkoviqit.

1120. Komanda e Përbashkët u përmend gjithashtu gjatë mbledhjes së Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së të mbajtur më 21 janar 1999. Aty u shprehën shqetësime, posaçërisht nga Dimitrijeviqi, në lidhje me faktin se, përkundër raporteve të shumta se edhe MPB-ja, edhe UJ-ja kishin marrë pjesë në operacionin e Reçakut, askush në mbledhjen e Kolegjiumit nuk ishte në gjendje të konfirmonte se ky operacion kishte ndodhur.³⁰⁴⁸ Në këtë mbledhje Ojdaniqi reagoi duke i qetësuar shqetësimet e ngritura dhe duke i kujtuar shtabit "metodologjinë e bashkërenduar mirë për përdorimin e forcave dhe për marrjen e vendimeve."³⁰⁴⁹ Konkretisht, ai e përshkroi metodologjinë si "mjaf të rrezikshme dhe jo plotësisht të arsyetuar nga pikëpamja ushtarake."³⁰⁵⁰ Dimitrijeviqi kujtoi se, gjatë mbledhjes kishte insistuar më tej në këtë pikë duke sugjeruar që Ojdaniqi t'i kërkonte Pavkoviqit që të deklarohej qartë nëse ishte përfshirë apo nuk ishte përfshirë UJ-ja. Më së fundi përgjigjja ishte se ushtria nuk kishte marrë pjesë në Reçak.³⁰⁵¹ Më 21 janar 1999, Pavkoviqi i dërgoi një raport Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së ku shkruhej se, edhe pse ishte angazhuar në

³⁰⁴⁵ Gjorgje Qurçini, T. 16966–16968 (5 tetor 2007).

³⁰⁴⁶ Gjorgje Qurçini, T. 16976–16977 (5 tetor 2007).

³⁰⁴⁷ Qurçini shpjegoi se kryekomandanti mund të takohej me kë dëshironte, por ishte zakon që pas takimeve të tilla vartësi t'i raportonte eprorit për zhvillimin e një takimi të tillë. Gjorgje Qurçini, T. 17025 (16 tetor 2007).

³⁰⁴⁸ P939 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999), f. 9; Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26636–26637 (8 korrik 2008).

³⁰⁴⁹ P939 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999), f. 11.

³⁰⁵⁰ P939 (Procesverbali i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999), f. 11.

³⁰⁵¹ Aleksandar Dimitrijeviq, T. 26636–26637 (8 korrik 2008).

luftime rreth Reçakut, ushtria nuk kishte hyrë në fshat.³⁰⁵² Ojdaniqi gjithashtu bëri një koment të mjegullt se, nëse "shtabi ose komanda e përbashkët ose sido që quhej" kishte vendosur se operacioni në Reçak nuk mund të kryhej pa ndihmën e UJ-së, ata duhej të kërkonin miratimin e Presidentit të RFJ-së.³⁰⁵³ Si alternativë u duk se Ojdaniqi sugjeroi se "komanda e përbashkët atje" mund të merrte urdhra drejtpërsëdrejti nga Presidenti i RFJ-së, të cilat pastaj duhej t'ia kalonte atij me shënimin se ishin "urdhra të Presidentit të RFJ-së."³⁰⁵⁴ Sidoqoftë, interpretimi që i bëri Kërga këtij procesverbalit ishte se komanda e përbashkët mund të mos kishte ekzistuar dhe se Ojdaniqi vetëm se e kishte paraqitur krijimin e Komandës së Përbashkët si opsion.³⁰⁵⁵

1121. Hapat e ndërmarra në prill në përpjekje për të vendosur MPB-në nën komandën e UJ-së diskutohen më poshtë. Në kontekst të këtyre përpjekjeve, më 25 maj 1999 Pavkoviqi i dërgoi Shtabit të Komandës së Lartë një raport ku kërkonte që të zbatohet urdhri për vendosjen e MPB-së nën komandën e UJ-së, i lëshuar në prill 1999, ose përndryshe të anulohet, duke e kthyer komandën mbi MPB-në "në duart e Ministrisë së Brendshme – Shtabit të MPB-së të Republikës së Serbisë për Kosovën dhe Metohinë përmes Komandës së Përbashkët, ashtu siç ka qenë deri tani."³⁰⁵⁶ Llazareviqi dëshmoi se urdhri i fundit i Komandës së Përbashkët ishte lëshuar më 16 prill 1999, që përputhet me thirrjen për vendosjen nën varësinë komanduese.³⁰⁵⁷ Asnjë nga urdhrat dhe udhëzimet e mëvonshme lëshuar nga UJ-ja nuk pati më titullin "Komanda e Përbashkët."

1122. Si prova gjithashtu janë pranuar edhe 16 urdhra me emërtimin "Komanda e Përbashkët", të lëshuara nga marsi deri në prill 1999,³⁰⁵⁸ në të cilat njësitë e UJ-së urdhëroheshin që të kryenin disa aksione në bashkërendim me njësitë e MPB-së. Secili urdhër përmbante edhe një variant të fjalisë në vijim: "Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë në Sektorin e Prishtinës komandon të gjitha forcat gjatë operacioneve luftarake." Radojko Stefanoviqi dëshmoi se në vitin 1999 urdhrat

³⁰⁵² 3D672 (Raport i Pavkoviqit dërguar Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1995). Është e qartë se raporti e ka datën gabim dhe duhet të jetë dërguar në vitin 1999, e jo në vitin 1995. Dokumenti e ka vulën që tregon se është marrë më 22 janar 1999. Kjo konfirmohet më tej nga fakti se raporti i Pavkoviqit është në dukje përgjigje e kërkesës së zëvendësimit të Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Svetozar Marjanoviqi, 21 janar 1999. 3D671 (Kërkesë për raport paraprak mbi angazhimin e forcave në Reçak).

³⁰⁵³ P939 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999), f. 11.

³⁰⁵⁴ P939 (Procesverbal i Kolegjiumit të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 21 janar 1999), f. 12.

³⁰⁵⁵ Branko Kërga, T. 16858–16860 (4 tetor 2007).

³⁰⁵⁶ P1459 (Raport i Armatës së 3-të për mosbindje nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999), f. 2.

³⁰⁵⁷ Vladimir Llazareviq, T. 18018–18020 (9 nëntor 2007).

³⁰⁵⁸ Urdhër i Komandës së Përbashkët 19 mars–6 prill 1999: P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1998); P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999); P2031 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999); P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999); P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999); P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999); P2003 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 2 prill 1999); P1970 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 9 prill 1999); P1971 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 13 prill 1999); P1972 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 14 prill 1999); P1973 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 14 prill 1999); P1974 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); P1975 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); P1976 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); P1878 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 15 prill 1999); P1977 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 16 prill 1999).

me emërtimin "Komanda e Përbashkët" ishin më të shpeshta se urdhrat e Korpusit të Prishtinës, që ishte e kundërta e situatës që kishte qenë në vitin 1998.³⁰⁵⁹ Sidoqoftë, asnjëri nga këto dokumente nuk përmban emrat e anëtarëve të Komandës së Përbashkët në vitin 1999. Gjithashtu, dokumentet zyrtare të UJ-së të nënshkruara nga komandantët dhe që përmendin Komandën e Përbashkët, nuk përmbajnë informata për anëtarët e saj.

1123. Në disa nga këto urdhra identifikohen forcat e angazhuara në operacione luftarake në zonat dhe në datat që përputhen me vendet e krimit në Aktakuzë. Për shembull, Aktakuza pretendon se nga 25 marsi deri më 2 prill 1999, forcat e RFJ-së dhe Serbisë granatuan dhe sulmuan fshatrat, shkatërruan shtëpitë, dyqanet, dhe monumentet kulturore, dhe dëbuan me dhunë shumë shqiptarë të Kosovës përtej kufirit shqiptar, ndër të tjera edhe në fshatrat Bellacërkë, Krushë e Vogël, Krushë e Madhe, Celinë, Piranë, dhe Landovicë. Në lidhje me këto aksione, ekziston një urdhër i Komandës së Përbashkët i datës 23 mars 1999 për "mbështetjen e forcave të MPB-së në bllokimin, shtypjen, dhe shkatërrimin e Forcave Terroriste Shqiptare në zonën e përgjithshme të Rahovecit, Suharekës, dhe Krushës së Madhe."³⁰⁶⁰ Në këtë urdhër theksohej se detyra më urgjente ishte që Brigada e 549-të e Motorizuar të "shpartallojë dhe të shkatërrojë Forcat Terroriste Shqiptare" në disa fshatra, ndër të cilat Celina, Krusha e Madhe, Krusha e Vogël, dhe Pirana. Në urdhër gjithashtu brigadës i jepej detyrë që të vendoste bllokadë përgjatë këtyre fshatrave, duke përfshirë edhe Bellacërkën, si dhe të ndihmonte MPB-në në një aksion të përbashkët sulmi përgjatë vijës së fshatrave, duke përfshirë Bellacërkën, dhe Krushën e Madhe. Një urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar përmban të njëjtin vend dhe detyrat e përgjithshme sikurse edhe një urdhër i Komandës së Përbashkët, por gjithashtu përcaktonte edhe bashkërendimin me detashmentin e 37-të të PJP-së dhe dy toga të MPB-së.³⁰⁶¹ Një raport pas aksionit i Brigadës së 549-të të Motorizuar jep hollësi të zbatimit të operacionit nga 25 deri më 29 mars 1999. Në raport gjithashtu thuhej se bashkërendimi midis UJ-së dhe MPB-së kishte funksionuar mirë dhe se komanda e forcave kishte qenë "nën komandën e përbashkët të UJ-së dhe MPB-së."³⁰⁶² K25, oficer i PJP-së, konfirmoi se në raport përmendej njësi e tij si pjesëmarrëse në këtë operacion, se aty përshkruhej saktësisht operacioni në të cilin kishte marrë pjesë, dhe se në të kishin marrë pjesë edhe forcat e rregullta të MPB-së, dhe të PJP-së.³⁰⁶³ Lidhja midis këtij urdhri konkret dhe provave në lidhje me ngjarjet e pretenduara në Aktakuzë tregon se urdhrat e Komandës së Përbashkët faktikisht u zbatuan si nga forcat e MPB-së, po ashtu edhe të UJ-së.

³⁰⁵⁹ Radojko Stefanoviq, T. 21661–21662 (5 shkurt 2008).

³⁰⁶⁰ P2015 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 23 mars 1999). Urdhër i Komandës së Përbashkët i lëshuar më 23 mars 1999 kishte numrin e protokollit 455-63.

³⁰⁶¹ P1981 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 23 mars 1999).

³⁰⁶² P1995 (Analizë e operacionit të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars 1999).

³⁰⁶³ K25, T. 4706–4708 (12 tetor 2006).

1124. Më 28 mars 1999, njësitë e Korpusit të Prishtinës morën urdhër që të mbështesnin forcat e MPB-së në "shkatërrimin e Forcave Terroriste Shqiptare në zonën e përgjithshme të Malishevës."³⁰⁶⁴ Ky urdhër mbante emërtimin "Komanda e Përbashkët" dhe kërkonte që Brigada e 125-të e Motorizuar, Brigada e 243-të e Mekanizuar, dhe Brigada e 549-të e Motorizuar të formonin bllokadë përgjatë një vijë të caktuar. Më 29 mars, Deliqi, komandant i Brigadës së 549-të të Motorizuar, i urdhëroi njësitë e tij që të thyenin forcat "terroriste" përgjatë vijës së përmendur në urdhrin e Komandës së Përbashkët.³⁰⁶⁵ Në raportin luftarak të Deliqit thuhej se Brigada e 549-të e Motorizuar e kishte kryer me sukses aksionin në Malishevë, në pajtim me urdhrin e Korpusit të Prishtinës, të datës 28 mars 1999.³⁰⁶⁶ Ai raportonte se operacioni kishte zgjatur nga 30 marsi deri më 3 prill. Në raportin luftarak të Brigadës së 125-të të Motorizuar të datës 30 mars thuhej se Grupet Luftarake 5 dhe 6 ishin dislokuar "sipas vendimit të komandantit të PrK-së për shkatërrimin e Forcave Terroriste Shqiptare në sektorin e Malishevës."³⁰⁶⁷ Më 28 mars 1999, Korpusi i Prishtinës lëshoi "një urdhër paralajmërues" për njësitë që të përgatiteshin "për detyrën e ardhshme në zonën e përgjithshme të Malishevës."³⁰⁶⁸ Ky urdhër paralajmërues i udhëzonte Brigadën e 125-të të Motorizuar, Brigadën e 243-të të Mekanizuar, dhe Brigadën e 549-të të Motorizuar që të kryenin të njëjtat detyra përgjatë vijës që përmbante urdhri i Komandës së Përbashkët i të njëjtës ditë. Llazareviqi dëshmoi se ky urdhër paralajmërues kishte qenë "urdhër përgatitor."³⁰⁶⁹ Dhoma vëren se një "urdhër përgatitor" i ngjashëm ishte lëshuar nga Korpusi i Prishtinës për një operacion të përbashkët të kryer në sektorin e Jabllanicës më 1 prill 1999, para se të lëshohej urdhri i Komandës së Përbashkët për atë operacion më 2 prill 1999.³⁰⁷⁰

1125. Udhëzimet që Korpusi i Prishtinës të mbështeste MPB-në në sektorin e Drenicës, të lëshuara në urdhrin e Komandës së Përbashkët të 24 marsit 1999, ofrojnë një shembull më shumë të pushtetit të Komandës së Përbashkët mbi operacionet e kryera përmes hierarkisë komanduese të UJ-së.³⁰⁷¹ Në urdhër i jepej detyrë Brigadës së 37-të të Motorizuar që të ndihmonte MPB-në përgjatë vijës së fshatrave Rudnik-Vitak-Klladernicë-Vojnikë-Burojë dhe e udhëzonte që të "shpartallohen dhe shkatërrohen Forcat Terroriste Shqiptare" në sektorin e fshatrave Leqinë-Kosterc-Klladernicë. Brigada e 125-të e Motorizuar duhej të mbështeste MPB-në nga vija e fshatrave Klinë e Epërme-Llaushë-Turiqec-Krushec-Rezallë. Të nesërmen, më 25 mars, Brigada e

³⁰⁶⁴ P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999), f. 3.

³⁰⁶⁵ P2000 (Urdhër i Brigadës së 549-të të Motorizuar, 29 mars 1999), f. 2.

³⁰⁶⁶ P2002 (Analizë e Operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999), f. 1.

³⁰⁶⁷ P2035 (Raport Luftarak i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 30 mars 1999), f. 2.

³⁰⁶⁸ 5D339 (Urdhër i Komandës së PrK-së, 28 mars 1999).

³⁰⁶⁹ Vladimir Lazareviq, T. 17988 (9 nëntor 2007).

³⁰⁷⁰ P2029 (Urdhër i PrK-së, 1 prill 1999); P2003 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 2 prill 1999), f. 1; Vladimir Lazareviq, T. 18000 (9 nëntor 2007).

³⁰⁷¹ P1968 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 24 mars 1999).

37-të e Motorizuar, "në pajtim me urdhrin" nr. 455-73 të Komandës së Përbashkët, raportonte se njësia e saj kishte hyrë përgjatë vijës së fshatrave Pantinë-Klinë e Epërme-Runik dhe Pantinë-Zubin Potok-Runik.³⁰⁷² Më 27 mars, Komanda e Korpusit të Prishtinës i dërgoi një raport luftarak Armatës së 3-të, në të cilin raportonte se forcat kishin shkatërruar "terroristët" në drejtim të fshatrave Vitak-Broqinë-Klinë e Epërme-Turiqec.³⁰⁷³ Në një raport tjetër luftarak të Korpusit të Prishtinës dërguar Armatës së 3-të të datës 30 mars thuhej se Korpusi ishte i angazhuar ende në operacione në Drenicë.³⁰⁷⁴

1126. Ekziston një lidhje midis raportit luftarak të Brigadës së 37-të të Motorizuar të 3 prillit 1999 dhe urdhrin të Komandës së Përbashkët të 28 marsit 1999.³⁰⁷⁵ Në pjesën e fundit të raportit përcaktohen detyrat për ditën e ardhshme, konkretisht, sigurimi i rrugëve siç është përcaktuar në "vendimin e Komandës së Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë." Kjo përputhet me urdhrin e Komandës së Përbashkët, në të cilin përshkruhen detyrat konkrete për njësitë e veçanta, duke përfshirë edhe Brigadën e 37-të, për sigurimin e rrugëve të caktuara dhe për vendosjen e kontrollit të plotë luftarak mbi të njëjtin territor. Sipas Zhivanoviqit dhe Koturit, komandantët vartës nuk kishin të drejtë të ndërronin siglën e dokumenteve të marra nga komanda më e lartë, kështu që, kur lëshonin urdhra ose raporte të bazuara në dokumente të Komandës së Përbashkët, ishin të detyruar të përdornin frazën "urdhër i Komandës së Përbashkët."³⁰⁷⁶

1127. Dëshmitarët e UJ-së të ftuar nga Llazareviqi deklaruan se urdhrat e Komandës së Përbashkët ishin lëshuar nga Korpusi i Prishtinës e jo nga ndonjë "Komandë e Përbashkët." Vetë Llazareviqi shpjegoi se vartësit të cilët merrnin urdhra nga Komanda e Përbashkët ishin të vetëdijshëm se instanca komanduese për aksionet e urdhëruara ishte Korpusi i Prishtinës në postëkomandën e caktuar.³⁰⁷⁷ Llazareviqi dëshmoi se urdhrat ishin krijuar dhe protokolluar nga Korpusi i Prishtinës. Ai gjithashtu shpjegoi se urdhrat dërgoheshin me postë zyrtare dhe zarfi tregonte se vinin nga Korpusi i Prishtinës.³⁰⁷⁸ Llazareviqi u shpreh se urdhrat e Komandës së Përbashkët u ishin dërguar vetëm brigadave vartëse si dokumente udhëzuese dhe se komandantët e brigadave gjithashtu merrnin "hartën e vendimeve" nga Korpusi i Prishtinës, të nënshkruar nga komandanti i Korpusit.³⁰⁷⁹ Eksperti ushtarak Radovan Radinoviqi dhe Branko Kërگا deklaruan se

³⁰⁷² P2043 (Raport i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 25 mars 1999).

³⁰⁷³ P2810 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 26/27 mars 1999), f. 2.

³⁰⁷⁴ P2811 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 30 mars 1999), f. 2.

³⁰⁷⁵ P2807 (Raport Luftarak i Brigadës së 37-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 3 prill 1999); P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999).

³⁰⁷⁶ Dragan Zhivanoviq, T. 20506 (17 janar 2008); Millan Kotur, T. 20753 (21 janar 2008).

³⁰⁷⁷ Vladimir Llazareviq, T. 18149-18150 (13 nëntor 2007).

³⁰⁷⁸ Vladimir Llazareviq, T. 17934 (8 nëntor 2007).

³⁰⁷⁹ Vladimir Llazareviq, T. 17932, 17934 (8 nëntor 2007).

përmbajtja dhe formati i dokumenteve përputheshin me dokumentet e krijuara nga UJ-ja në atë kohë.³⁰⁸⁰

1128. Radojko Stefanoviqi, i cili e zëvendësoi Gjakoviqin në vitin 1999 si shef i Sektorit të Operacioneve dhe Stërvitjes në Komandën e Korpusit të Prishtinës, dëshmoi se një shabllon i urdhrave të Komandës së Përbashkët kishte qenë në sistemin kompjuterik të Korpusit të Prishtinës në fillim të vitit 1998.³⁰⁸¹ Ai shpjegoi se sistemi kishte dy forma të dokumenteve që përdorreshin brenda Korpusit, njëri me emërtimin "Korpusi i Prishtinës" të nënshkruar nga komandanti dhe një me emërtimin "Komanda e Përbashkët" pa nënshkrim, që ishte forma më e shpeshtë. Forma e dytë, e cila ishte krijuar në vitin 1998, përdorej vetëm kur forcat e MPB-së dhe të UJ-së vepronin së bashku.³⁰⁸² Kërsman Jelliqi, komandant i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, dëshmoi se atij i vinin dy dokumente në lidhje me një operacion të planifikuar, njëri ishte urdhri me emërtimin "Komanda e Përbashkët" dhe tjetri ishte pjesë e hartës në të cilën ishte shkruar vendimi i komandantit të Korpusit të Prishtinës. Ai dëshmoi se "dokumenti bazë" ishte vendimi i Korpusit të Prishtinës.³⁰⁸³ Millosh Mandiqit i kishin thënë drejtpërsëdrejti se dokumentet me emërtimin "Komanda e Përbashkët" ishin në të vërtetë dokumente të Korpusit të Prishtinës.³⁰⁸⁴ Momir Stojanoviqi dëshmoi se të gjitha urdhrat gjatë vitit 1999 ishin lëshuar nga komandanti i Korpusit të Prishtinës.³⁰⁸⁵ Deliqi dëshmoi se zakonisht atij i thuhej paraprakisht se kur mund të priste urdhra me shkrim, si ato me emërtimin "Komanda e Përbashkët," dhe njëra prej arsyeve pse nuk i kishte vënë në dyshim urdhrat me emërtimin "Komanda e Përbashkët", ishte se e dinte se ato i kishte lëshuar komandanti i tij.³⁰⁸⁶

1129. Dëshmitarë nga UJ-ja gjithashtu dëshmuan se urdhrat e Komandës së Përbashkët merreshin në të njëjtën mënyrë sikurse edhe dokumentet e Korpusit të Prishtinës dhe, përveç emërtimit në krye të dokumentit, ishin të padallueshme nga dokumentet standarde ushtarake.³⁰⁸⁷ Gjithashtu, Deliqi tha se numrat rreptësisht konfidentiale, të njëjtë në urdhër dhe zarf të shënuar me vulën e

³⁰⁸⁰ Vladimir Llazareviq, T. 17935 (8 nëntor 2007); Branko Kërğa, T. 16873 (4 tetor 2007); Radovan Radinoviq, T. 17338–17339 (19 tetor 2007).

³⁰⁸¹ Radojko Stefanoviq, T. 21662 (5 shkurt 2008).

³⁰⁸² Radojko Stefanoviq, T. 21661 (5 shkurt 2008).

³⁰⁸³ Kërsman Jelliq, T. 18864–18865 (23 nëntor 2007).

³⁰⁸⁴ Millosh Mandiq, 5D1391 (deklarata e dëshmitarit e datës 20 janar 2008), para. 27.

³⁰⁸⁵ Momir Stojanoviq, T. 20055 (11 dhjetor 2007).

³⁰⁸⁶ Bozhidar Deliq, T. 19353 (29 nëntor 2007), 19571 (5 dhjetor 2007).

³⁰⁸⁷ Aleksandar Vasileviq tha se urdhrat e Komandës së Përbashkët përpiloheshin në të njëjtën mënyrë sikurse dokumentet zyrtare të UJ-së. Aleksandar Vasileviq, T. 8733–8734 (19 janar 2007). *Shih gjithashtu* Bozhidar Deliq, T. 19416 (4 dhjetor 2007). Deliqi gjithashtu dëshmoi se urdhrat e Komandës së Përbashkët i merrte duke dërguar korrierin në Korpusin e Prishtinës, i cili kthehej me dokumentet. Bozhidar Deliq, T. 19349 (29 nëntor 2007). Kërsman Jelliqi tha se të gjitha dokumentet merreshin në zarfe të Korpusit të Prishtinës, dhe se urdhrat e Komandës së Përbashkët shoqëroheshin gjithmonë me një fragment nga urdhri i Korpusi i Prishtinës. Kërsman Jelliq, T. 18869–18870 (23 nëntor 2007).

Korpusit të Prishtinës, dëshmonin se urdhri ishte dorëzuar në atë zarf dhe rrjedhimisht vinte nga Korpusi i Prishtinës.³⁰⁸⁸

1130. Aleksandar Vasileviqi përcaktoi lidhjen midis një urdhri të Komandës së Përbashkët që iu tregua gjatë dëshmisë dhe një urdhri të Korpusit të Prishtinës, duke u bazuar në numrin e referencës "455," që ishte i përbashkët për të dy dokumentet dhe konkludoi se kishte të ngjarë që ky numër të ishte regjistruar në protokollin e Korpusit të Prishtinës si referencë për "terrorizmin shqiptar" në Kosovë.³⁰⁸⁹ Eksperti ushtarak Radovan Radinoviqi dëshmoi se numri i referencës "455" tregonte se urdhri vinte nga Korpusi i Prishtinës.³⁰⁹⁰ Rrjedhimisht, të gjithë urdhrat përfshijnë qëllimin e përbashkët të "çrrënjësjes, thyerjes, dhe shkatërrimit të forcave të Forcave Terroriste Shqiptare," demonstrojnë dijeni të hollësishme për dislokimin e forcave të MPB-së në tërë Kosovën, dhe i përdorin këto informata për t'u dhënë urdhra konkrete njësisive të UJ-së të ngarkuara për mbështetjen e MPB-në.

1131. Në mbështetje të pretendimit se këto ishin urdhra të komandantit të Korpusit të Prishtinës ekziston një seri raportesh të Komandës së Korpusit të Prishtinës ku përmenden vendimet e Komandës së Korpusit të Prishtinës në rastet kur vendimet origjinale ishin në fakt urdhra të Komandës së Përbashkët. Për shembull, një raport luftarak i Komandës së Korpusit të Prishtinës dërguar Komandës së Armatës së 3-të i datës 3 prill 1999 përmban frazën "bazuar në vendimin e komandantit të Korpusit të Prishtinës," edhe pse urdhri për operacionin e përbashkët në sektorin e Jabllanicës ishte urdhër me emërtimin "Komanda e Përbashkët."³⁰⁹¹ Gjithashtu, Stefanoviqi dëshmoi se një raport i Komandës së Korpusit të Prishtinës dërguar Komandës së Armatës së 3-të i datës 4 prill 1999, i cili përmban frazën "në zbatim të vendimit të komandantit të Korpusit të Prishtinës," ishte shkruar si përgjigje ndaj të njëjtit urdhër të Komandës së Përbashkët. Një raport i Komandës së Korpusit të Prishtinës i datës 1 prill 1999, i cili përmban frazën "në përputhje me idenë e përgjithshme dhe vendimin e komandantit të Korpusit të Prishtinës," ishte në përgjigje të një urdhri të Komandës së Përbashkët për mbështetjen e forcave të MPB-së në shkatërrimin e terroristëve në sektorin e Malishevës i datës 28 mars 1999.³⁰⁹²

³⁰⁸⁸ Bozhidar Deliq, T. 19350–19351 (29 nëntor 2007).

³⁰⁸⁹ Aleksandar Vasileviqi, T. 8738, 8741–8742 (19 janar 2007).

³⁰⁹⁰ Radovan Radinoviqi, T. 17333–17334 (19 tetor 2007).

³⁰⁹¹ 5D84 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 3 prill 1999); P2003 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 2 prill 1999). Radojko Stefanoviqi dëshmoi se ky raport ishte lëshuar në përgjigje të një urdhri të Komandës së Përbashkët për shkatërrimin e terroristëve në sektorin e Jabllanicës, 2 prill 1999. Radojko Stefanoviqi, T. 21669 (5 shkurt 2008).

³⁰⁹² 5D85 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 4 prill 1999); 4D371 (Raport Luftarak dërguar Armatës së 3-të, 1 prill 1999); P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999); Radojko Stefanoviqi, T. 21669–21671 (5 shkurt 2008).

1132. Dhoma vëren se në secilin nga 16 urdhrat e Komandës së Përbashkët të pranuar si dëshmi, gjatë përcaktimit të detyrave për njësinë përkatëse është përdorur fraza "Kam vendosur si vijon," e nuk përmendet ndonjë vendim i përbashkët.

1133. Një faktor tjetër që sugjeron se Korpusi i Prishtinës ishte burimi i urdhrave të Komandës së Përbashkët është ndryshimi i datës 22 mars 1999 i urdhrit të Komandës së Përbashkët, për të cilin, edhe pse i nënshkruar nga Llazareviqi, pretendohet se vinte nga Korpusi i Prishtinës.³⁰⁹³ Kërگا dëshmoi se ndryshimi i vendimit mund të jetë përpiluar vetëm nga e njëjta komandë që ka përpiluar origjinalin dhe se komandanti i Korpusit vetëm mund t'a zbatojë, por jo t'a ndryshojë vendimin e komandës më të lartë.³⁰⁹⁴ Meqenëse Llazareviqi ishte komandant i Korpusit të Prishtinës në atë kohë dhe meqenëse dy dokumentet kanë të njëjtin karakter dhe numër reference, Kërگا konkludoi se të dy dokumentet, urdhri origjinal dhe ndryshimi, kishin ardhur nga Komanda e Korpusit të Prishtinës.³⁰⁹⁵ Gergari dëshmoi se me të marrë urdhrin origjinal kishte folur personalisht me Llazareviqin dhe në atë moment Llazareviqi i kishte shpjeguar se urdhra të tillë në fakt lëshoheshin nga Korpusi i Prishtinës.³⁰⁹⁶

1134. Më në fund, Dhoma vëren, siç është shpjeguar më lart,³⁰⁹⁷ se operacioni i përbashkët i kryer në zonën e Podujevës, si dhe operacioni i përbashkët i kryer në zonën e Llapit dhe sektorin e Drenicës së Poshtme – për të cilat Komanda e Përbashkët i kishte lëshuar urdhrat përkatësisht më 19 mars 1999 dhe më 22 mars 1999 – ishin planifikuar nga Komanda e Korpusit të Prishtinës në përputhje me urdhrat nga Komanda e Armatës së 3-të.³⁰⁹⁸ Veçanërisht, Dhoma thekson se "ideja" e Komandës së Korpusit të Prishtinës "për kryerjen e një operacioni për mposhtjen e Forcave Terroriste Shqiptare në sektorin e Drenicës së veriut dhe Podujevës" kishte numër protokollit 455-43, kurse urdhri i Komandës së Përbashkët i datës 19 mars 1999 kishte numrin vijues, 455-44.³⁰⁹⁹

³⁰⁹³ P1967 (Ndryshim i vendimit mbi mbështetjen e MPB-së në Thyerjen dhe Shkatërrimin në zonën e Llapit, 22 mars 1999); *shih gjithashtu* P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999). Ka pasur debate se a ka qenë ky dokument ndryshim i Urdhrit të Komandës së Përbashkët, apo vetëm urdhër për zbatimin e tij. Kërگا dëshmoi se dokumenti ishte ndryshim sepse nuk përmban dispozitat përsëritëse nga origjinali; për shembull, në ndryshim përcaktohej që postekomanda të ishte në fshatin Llaushë. Branko Kërگا, T. 16880 (4 tetor 2007). Gergari gjithashtu dëshmoi në mbështetje të kësaj. Mihajlo Gergar, T. 21528 (1 shkurt 2008).

³⁰⁹⁴ Branko Kërگا, T. 16918–16919 (4 tetor 2007).

³⁰⁹⁵ Branko Kërگا, T. 16877, 16918–16919 (4 tetor 2007).

³⁰⁹⁶ Mihajlo Gergar, T. 21528 (1 shkurt 2008).

³⁰⁹⁷ *Shih* nënpjesën e mësipërme VI.E.2.

³⁰⁹⁸ P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999); P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999). P2031 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999). Më 18 mars 1999, Komanda e PrK-së i sugjeroi komandantit të Armatës së 3-të "idenë e saj për kryerjen e një operacioni për mposhtjen e Forcave Terroriste Shqiptare në sektorin e Drenicës veriore dhe Podujevës", 6D1416 (Plan Veprimi i PrK-së, 18 mars 1999). Më 22 mars 1999, PrK-ja i sugjeroi Komandës së Armatës së 3-të "planin për kryerjen e një operacioni për çrrënjosjen e Forcave Terroriste Shqiptare në sektorin e Drenicës së Poshtme dhe Llapit të Epërm," 5D276 (Mesazh i Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 22 mars 1999).

³⁰⁹⁹ 6D1416 (Plan Veprimi i PrK-së, 18 mars 1999); P3049 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 19 mars 1999). Po ashtu Dhoma thekson se, megjithëse "plani i Komandës së PrK-së për kryerjen e operacionit për çrrënjosjen e

Llazareviqi dëshmoi se urdhri i Komandës së Përbashkët për operacionin në zonën e Llapit ishte "dokumenti i Komandës së Korpusit të Prishtinës për kryerje të përbashkët të detyrave me forcat e MPB-së."³¹⁰⁰

1135. Bazuar në analizën e mësipërme, Dhoma pranon se numri i protokollit 455 kishte të bënte me Korpusin e Prishtinës dhe konkludon se Korpusi i Prishtinës ishte burim i këtyre 16 urdhrave.

1136. Përveç emërimit "Komanda e Përbashkët," këto 16 urdhra përmbanin një dispozitë në të cilën kushtëzohet se operacionet do të "komandohen nga Komanda e Përbashkët."³¹⁰¹ Disa komandantë të UJ-së dëshmuar se kishin kërkuar shpjegime nga Llazareviqi kur i kishin marrë këto urdhra për herë të parë. Atyre iu tha se Llazareviqi mbetej komandanti i tyre dhe Korpusi i Prishtinës njësisia e tyre eprore.³¹⁰² Disa oficerë të UJ-së të ftuar si dëshmitarë nga Mbrojtja, sugjeruan se shumicën e herëve shprehjet për aksione "të komanduara nga Komanda e Përbashkët", kishin kuptimin thjesht se ekzistonte një postëkomandë e përbashkët ku ishin vendosur komandantët përkatës të UJ-së dhe MPB-së dhe prej aty komandonin forcat e tyre përmes hierarkisë së rregullt komanduese. Simiqi tha se kjo frazë kishte kuptimin se struktura të ndryshme të përfshira në një aksion – UJ-ja dhe MPB-ja – do të komandoheshin nga hierarkitë e tyre komanduese, por se komandat e ndryshme duhej të harmonizoheshin.³¹⁰³ Zhivanoviqi dëshmoi se Gjakoviqi dhe Pavkoviqi ia kishin shpjeguar Komandën e Përbashkët si mbështetje për MPB-në në rastet kur edhe komandantët e UJ-së, edhe të MPB-së ishin në të njëjtën postëkomandë. Secili do të komandonte njësitë e veta dhe "ne e quajmë atë postëkomandë e përbashkët dhe aksioni i kryer nga postëkomanda e përbashkët quhet komandim i përbashkët."³¹⁰⁴ Komanda e Përbashkët në fakt nuk

Forcave Terroriste Shqiptare në sektorin e Drenicës së Poshtme dhe Llapit të Epërm" që iu dorëzua komandantit të Armatës së 3-të më 22 mars 1999 kishte numrin e protokollit 455-55, Urdhri i Komandës së Përbashkët për çrrënjosjen dhe shkatërrimin e forcave "terroriste" shqiptare në zonën e Llapit kishte numrin e protokollit vijues, konkretisht 455-56, 5D276 (Mesazh i Komandës së PrK-së dërguar Komandës së Armatës së 3-të, 22 mars 1999); P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999). Urdhri i Komandës së Përbashkët "për thyerjen dhe shkatërrimin e Forcave Terroriste Shqiptare në sektorin e Drenicës së Poshtme kishte numrin e protokollit 455-54. Llazareviqi u pyet se pse urdhri i Komandës së Përbashkët kishte numër më të vonshëm se plani për zbatim. Ai shpjegoi se të dy dokumentet ishin krijuar në të njëjtën ditë. Për më tepër, ai tha se këto dokumente si dhe urdhri për çrrënjosjen dhe shkatërrimin e forcave "terroriste" shqiptare në zonën e Llapit "ishin në tavolinën e komandantit të Armatës, kur po ia shpjegonte së bashku me oficerin operativ konceptin, idenë, për kryerjen e detyrës". Së fundi, ai tha se kishte mjaft të ngjarë që personi në sekretari t'a kishte protokolluar urdhrin "për thyerjen dhe shkatërrimin e Forcave Terroriste Shqiptare në sektorin e Drenicës së Poshtme" para se të protokollonte planin për zbatimin. Vladimir Llazareviq, T. 18622 (20 nëntor 2007).

³¹⁰⁰ Vladimir Llazareviq, T. 17928 (8 nëntor 2007).

³¹⁰¹ *Shih gjithashtu* P2002 (Analizë e operacioneve të Brigadës së 549-të të Motorizuar, 30 mars [sic] 1999); P1969 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 28 mars 1999). Analiza e operacioneve që lidhen me "urdhrin paralajmërues" të PrK-së përfshin edhe këtë deklaratë: "Komandimi i forcave të parashikuara e bashkoi komandën e përbashkët të MPB-së dhe UJ-së."

³¹⁰² Lubisha Dikoviq, T. 19880–19881 (10 dhjetor 2007); Millosh Mandiq, 5D1391 (deklaratë dëshmitari e datës 20 janar 2008), para. 27; Mihajlo Gergar, T. 21528 (1 shkurt 2008).

³¹⁰³ Miodrag Simiq, T. 15572 (13 shtator 2007).

³¹⁰⁴ Dragan Zhivanoviq, T. 20509 (17 janar 2008).

ishite organ komandues, por "një lloj plani bashkërendues."³¹⁰⁵ Stefanoviçi gjithashtu dëshmoi se fraza "Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë komandon dhe drejton të gjitha forcat gjatë operacioneve luftarake në zonën e Prishtinës" në një urdhër, bënte fjalë për ekzistencën e "postëkomandës së përbashkët nga e cila secili komandon forcat e veta në mënyrë të pavarur."³¹⁰⁶ Vladimir Marinkoviçi shpjegoi se postëkomandat e përbashkëta ishin ngritur gjatë veprimeve antiterroriste, ku komandantët e MPB-së dhe UJ-së komandonin aksionet.³¹⁰⁷ Saviçi gjithashtu e interpretoi frazën "Komanda e Përbashkët" si diçka që tregon "komandim të kombinuar ose të përbashkët të njëjësive" në aksionet në të cilat morën pjesë si MPB-ja, po ashtu edhe UJ-ja.³¹⁰⁸

1137. Siç është shpjeguar më lart në paragrafin 1029, Gjakoviçi dëshmoi se, në operacionet ku kishte veprime të përbashkëta të MPB-së dhe UJ-së, urdhrat ishin në formën e urdhrave të Komandës së Përbashkët, me frazën "Komanda e Përbashkët" në krye të dokumentit dhe në vendin e nënshkrimit; këto nuk ishin urdhra për MPB-në, por ishin bazë për komandantët e MPB-së për përpilimin e urdhrave të tyre.³¹⁰⁹ Për çdo aksion që nuk përfshinte veprime të përbashkëta ose mbështetje të MPB-së, përdorej urdhër i zakonshëm i Korpusit të Prishtinës, i nënshkruar nga komandanti.³¹¹⁰ Gjakoviçi gjithashtu dëshmoi se zëvendësuesi i tij në vitin 1999 ndoshta e kishte përdorur këtë titull për të treguar se duhej të bëhej bashkërendimi midis MPB-së dhe ushtrisë.³¹¹¹ Edhe pse në vitin 1999, Gjakoviçi nuk ishte më në postin e shefit të Operacioneve në Korpusin e Prishtinës, ai i komentoi urdhrat duke u bazuar në njohuritë e tij të praktikave të vitit 1998. Ai shqyrtoi një urdhër dhe dëshmoi se duhej t'i ishte dërguar njësisë përkatëse të UJ-së dhe Ministrisë së Brendshme si element i bashkërendimit me forcat e MPB-së të caktuara për kryerjen e operacionit të atjeshëm.³¹¹² Më tej fragmente që kishin të bënin me organet e MPB-së u dërgoheshin njësisë përkatëse të MPB-së për të bërë bashkërendimin.³¹¹³

1138. Në përputhje me këtë shpjegim, Llazareviçi dëshmoi se shprehja "Komanda e Përbashkët" ishte përdorur "duke pasur parasysh përvojën e kaluar nga viti 1998 në planifikimin e aksioneve të bashkërenduara me forcat e MPB-së ose për të ndihmuar forcat e MPB-së."³¹¹⁴ Si rrjedhojë, termi përdorej vetëm nga oficerët operativë për të treguar se në çfarë rastesh ishin thelbësore veprimet e bashkërenduara dhe bashkëpunimi. Llazareviçi u shpreh se shprehjet në fund të çdo urdhri të

³¹⁰⁵ Dragan Zhivanoviç, T. 20464 (17 janar 2008).

³¹⁰⁶ Radojko Stefanoviç, T. 21663–21664 (5 shkurt 2008); P1966 (Urdhër i Komandës së Përbashkët, 22 mars 1999).

³¹⁰⁷ Vladimir Marinkoviç, T. 20257–20258 (13 dhjetor 2007).

³¹⁰⁸ Lubomir Saviç, T. 20996 (24 janar 2008).

³¹⁰⁹ Millan Gjakoviç, T. 26393–26398 (19 maj 2008).

³¹¹⁰ Millan Gjakoviç, T. 26452–26453 (20 maj 2008).

³¹¹¹ Millan Gjakoviç, T. 26389 (19 maj 2008).

³¹¹² Millan Gjakoviç, T. 26395 (19 maj 2008).

³¹¹³ Millan Gjakoviç, T. 26393–26394 (19 maj 2008).

Komandës së Përbashkët – "Komanda e Përbashkët për Kosovën komandon dhe drejton të gjitha forcat" – në të vërtetë tregon se MPB-ja do të komandonte forcat e veta dhe UJ-ja forcat e saj, si komandë e "kombinuar."³¹¹⁵

1139. Kërگا dëshmoi se, megjithëse ishte e qartë se kishte pasur njëfarë lloj bashkëpunimi midis ushtrisë dhe policisë, asnjë entitet i jashtëm nuk kishte pasur të drejtë t'u jepte urdhra atyre njësive dhe urdhrat duhej të komunikoheshin përmes hierarkive komanduese ekzistuese. Ai argumentoi se një komandë përgjithësisht u jepte urdhra njësive vartëse dhe, meqenëse urdhrat e Komandës së Përbashkët nuk u kishin caktuar detyra konkrete njësive të MPB-së të përmendura në to, Komanda e Përbashkët nuk ka qenë organ me pushtet komandues mbi MPB-në.³¹¹⁶ Sidoqoftë, Kërگا nuk e hodhi poshtë idenë se këto urdhra ishin dhënë së pari në nivel ekzekutiv në mënyrë që të pasoheshin me dokumente të ngjashme përmes hierarkisë komanduese të zakonshme të MPB-së.³¹¹⁷

1140. Gjorgje Qurçini dëshmoi se hierarkitë komanduese përkatëse të UJ-së dhe MPB-së kishin mbetur në fuqi dhe se, gjatë kryerjes së "operacioneve të përbashkëta," ata u ishin bindur hierarkive komanduese përkatëse.³¹¹⁸ Gjithashtu Tomisllav Mlladenoviqi pranoi se ishte e logjikshme që MPB-ja të kishte pasur dokumente dhe harta identike me ato të UJ-së, të cilat lëshoheshin përmes hierarkisë së tyre komanduese.³¹¹⁹

1141. Kërsman Jelliqi dëshmoi se gjatë një operacioni të përbashkët të kryer në Kotlinë në fund të marsit 1999, detyrat e kryera nga forcat e MPB-së ishin lëshuar nga shefi i SPB-së përkatëse.³¹²⁰ Ai gjithashtu shpjegoi se, gjatë operacioneve, MPB-ja dhe UJ-ja shkëmbejnë të gjitha informatat e marra.³¹²¹ Për shembull, MPB-ja e informonte gjithmonë UJ-në për pajisjet dhe armët e gjetura dhe anasjelltas.³¹²² Edhe pse gjatë fushatës së NATO-s komunikimi ishte ndonjëherë i vështirë, "shumicën e kohës komunikimi në distanca të shkurtra kishte funksionuar mirë, sidomos midis tij dhe shefit të SPB-së."³¹²³ Ai saktësoi se ata kishin shkëmbim të vazhdueshëm përmes pajisjeve Motorola, shkëmbejnë frekuencat, dhe komunikonin disa herë në ditë sa herë që dilnin probleme në

³¹¹⁴ Vladimir Llazareviq, T. 17924–17925 (8 nëntor 2007).

³¹¹⁵ Vladimir Llazareviq, T. 17929–17930 (8 nëntor 2007).

³¹¹⁶ Branko Kërگا, T. 16862–16863, 16873–16875 (4 tetor 2007).

³¹¹⁷ *Shih* Branko Kërگا, T. 16871–16873 (4 tetor 2007) (ku dëshmon se, po të kishte ekzistuar Komanda e Përbashkët, ajo do të jepte "detyra të përbashkëta" për të gjitha forcat vartëse).

³¹¹⁸ Gjorgje Qurçini, T. 17036–17037 (16 tetor 2007).

³¹¹⁹ Tomisllav Mlladenoviqi, T. 17613–17617 (25 tetor 2007).

³¹²⁰ Kërsman Jelliq, T. 18996–18997, 19009 (26 nëntor 2007).

³¹²¹ Kërsman Jelliq, T. 19011 (26 nëntor 2007).

³¹²² Kërsman Jelliq, T. 18998 (26 nëntor 2007).

³¹²³ Kërsman Jelliq, T. 19018 (26 nëntor 2007).

terren. Kishte raste kur Jelliqi i kërkonte ndihmë shefit të SPB-së dhe në raste të tjera ishte shefi i SPB-së që kërkonte ndihmë.³¹²⁴

1142. Disa dëshmitarë të tjerë dëshmuar se komandat e UJ-së dhe MPB-së kishin qenë të ndara gjatë kryerjes së operacioneve të përbashkëta.³¹²⁵ Gergari dëshmoi se, duke u bazuar në urdhrin e Komandës së Përbashkët në lidhje me operacionin në zonën e Bajgorës, dhe hartës së bashkëngjitur këtij urdhri, ai kishte përpiluar një urdhër në të cilin kishte "caktuar detyrat vetëm për forcat në Brigadën e tij," "gjë që kishte ndodhur gjatë tërë luftës."³¹²⁶ Sipas tij, "komanda ishte e ndarë."³¹²⁷ Gjithashtu Gergari dëshmoi se në një aksion konkret që ishte pjesë e operacionit më të madh të kryer në sektorin e Llapit në fund të marsit 1999, "një grup i oficerëve të Korpusit të Prishtinës" kishte ushtruar "kontroll mbi këtë aksion nga sektori i Llaushës."³¹²⁸ Postëkomanda "përbëhej nga kolonel Nikoliqi, major Gjorgjeviqi, dhe dy oficerë të tjerë emrat e të cilëve nuk i mbante në mend."³¹²⁹ Këta njerëz "komandonin forcat e UJ-së, kurse oficerët e MPB-së komandonin kontingjentet e tyre."³¹³⁰ Sipas Mijatoviqit, edhe pse policia dhe UJ-ja bashkërendoheshin, komandantët e policisë komandonin njësitë e tyre dhe komandantët ushtarakë, të tyre.³¹³¹

1143. Në kundërshtim me pikëpamjen e Gjakoviqit dhe Deliqit se "Komanda e Përbashkët" ishte përdorur si emërtim në urdhrat e Korpusit të Prishtinës për t'i bërë ato më të pranueshme për MPB-në,³¹³² oficerët e MPB-së dëshmuar se ata nuk morën asnjëherë në vitin 1999 ndonjë urdhër apo dokument me emërtimin "Komanda e Përbashkët." Millosh Vojnoviqi, shef i SPB-së së Prizrenit, tha se fragmentet e hartave që kishte marrë gjatë aksioneve nga komandanti i kompanisë së PJP-së në Prizren ose nga kolonel Mitroviqi, komandant i detashmentit të PJP-së, nuk kishin mbishkrimin "Komanda e Përbashkët."³¹³³ Dushan Gavranqi, shef i SPB-së së Gjilanit, gjithashtu dëshmoi se nuk kishte marrë asnjëherë urdhra nga Komanda e Përbashkët përmes MPB-së në vitin 1999.³¹³⁴ Vladimir Iliqi, ndihmëskomandant i Detashmentit të 22-të të PJP-së, tha se gjatë gjithë kohës në

³¹²⁴ Kërsman Jelliq, T. 19018 (26 nëntor 2007).

³¹²⁵ Bozhidar Deliq, T. 19293, T. 19338–19339 (29 nëntor 2007); T. 19403 (4 dhjetor 2007); T. 19546 (5 dhjetor 2007), T. 19680 (6 dhjetor 2007).

³¹²⁶ Mihajlo Gergar, 5D1400 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 31; *shih gjithashtu* 5D1329 (Vendimi–Hartë i Brigadës së 211-të të Blinduar).

³¹²⁷ Mihajlo Gergar, 5D1400 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 29.

³¹²⁸ Mihajlo Gergar, T. 21530 (1 shkurt 2008); Mihajlo Gergar, 5D1400 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007) (Në deklaratën e tij me shkrim, ai shprehej se "gjatë aksionit, një grup i oficerëve nga Komanda e PrK-së e kishte komanduar aksionin nga pika e Llaushës, ku ishte postëkomanda e tyre, që ishte postëkomanda e Brigadës së 354-të").

³¹²⁹ Mihajlo Gergar, 5D1400 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 32.

³¹³⁰ Mihajlo Gergar, 5D1400 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 32.

³¹³¹ Miroslav Mijatoviq, T. 22309–22310 (13 shkurt 2008).

³¹³² *Shih* Millan Gjakoviq, T. 26444–26445 (20 maj 2008); Bozhidar Deliq, T. 19422–19423, 19495 (4 dhjetor 2007).

³¹³³ Millosh Vojnoviq, T. 24204 (12 mars 2008).

³¹³⁴ Dushan Gavranqi, T. 22723 (19 shkurt 2008).

Kosovë nuk kishte kryer asnjë aksion bazuar në urdhra me shkrim ose harta me emërtimin "Komanda e Përbashkët për Kosovën dhe Metohinë."³¹³⁵ Miroslav Mijatoviqi sugjeroi se "Komanda e Përbashkët" kishte qenë shprehje unike ushtarake sepse në ushtri "ata e quajnë çdo gjë komandë."³¹³⁶ Mijatoviqi dëshmoi se Shtabi i MPB-së asnjëherë nuk kishte marrë urdhër nga Komanda e Përbashkët, e as nuk kishte pasur detyrime apo detyra në lidhje me Komandën e Përbashkët.³¹³⁷

1144. Bazuar në tërësinë e këtyre provave, Dhoma konkludon se, edhe pse këta 16 urdhra përmbanin dispozitën se operacionet luftarake duhej "të komandoheshin nga Komanda e Përbashkët," hierarkitë komanduese të UJ-së dhe të MPB-së mbetën të ndara dhe të paprekura, dhe njësitë e MPB-së dhe të UJ-së u komanduan nga komandat e tyre përkatëse. Më së shumti, komandat e tyre të ndara mund të kenë qenë të vendosura në postëkomanda të përbashkëta.

(B) Mbledhja e mbajtur më 1 qershor 1999

1145. Më 1 qershor 1999, gjatë vizitës në Kosovë, Pavkoviqi e ftoi Vasileviqin në një mbledhje në të cilën morën pjesë Stojanoviqi, Angjelkoviqi, Gjorgjeviqi, Stevanoviqi, Llukiqi, Pavkoviqi, Llazareviqi, dhe Shainoviqi, të cilën më vonë Pavkoviqi e cilësoi si mbledhje e Komandës së Përbashkët.³¹³⁸ Sipas Vasileviqit, kjo mbledhje u mbajt në bodrumin e Hotel Grandit në Prishtinë, në një dhomë plot me kthina pune të Armatës së 3-të dhe Korpusit të Prishtinës, si dhe me harta pune, saqë dukej si qendër operative. Raportimet e Llukiqit, Llazareviqit, dhe Pavkoviqit përmbanin hollësi shumë teknike për aktivitetet e UJ-së dhe MPB-së. Raportet e tyre u përqendruan në aktivitetet e asaj dite, duke i lënë Vasileviqit përshtypjen se mbledhjet ishin të përditshme.³¹³⁹ Shainoviqi foli në mbledhje dhe shprehu miratim që gjërat duhej të bëheshin siç ishin planifikuar nga gjeneralët e UJ-së dhe MPB-së.³¹⁴⁰ Vasileviqi qartësoi pohimin e fundit duke thënë se Shainoviqi nuk kishte lëshuar urdhra, por kishte thënë se puna në spastrimin e terrenit duhej të vazhdonte sipas planit.³¹⁴¹ Kur Shainoviqi kishte hyrë në dhomë, të gjithë ishin çuar në këmbë dhe e kishin trajtuar me respekt gjatë tërë kohës, duke i krijuar Vasileviqit përshtypjen se ai ishte shefi i

³¹³⁵ Vladimir Iliq, T. 24345 (17 mars 2008).

³¹³⁶ Miroslav Mijatoviqi, T. 22412 (14 shkurt 2008).

³¹³⁷ Miroslav Mijatoviqi, T. 22234–22235 (12 shkurt 2008).

³¹³⁸ Vasileviqi konfirmoi se shprehja "Komanda e Përbashkët" ishte përdorur, por shprehu bindjen se nuk kishte dallim midis përshkrimit të mbledhjes si mbledhje e "Shtabit të Përbashkët" apo e "Komandës së Përbashkët" dhe se kjo ishte vetëm një hollësi gjuhësore. Aleksandar Vasileviq, T. 14504–14505 (29 gusht 2007). *Shih* Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 813. Cvetiqi dëshmoi se Shainoviqi kishte qenë gjithashtu i pranishëm në bodrumin e Hotel Grandit në Prishtinë më 29 mars 1999 ku kishte parë lajmet për bombardimet e NATO-s. Lubinko Cvetiq, T. 8086–8087 (7 dhjetor 2006), T. 8135 (8 dhjetor 2006).

³¹³⁹ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 79, 81–82.

³¹⁴⁰ Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 81, 2D387 (deklaratë dëshmitari e datës 25 korrik 2007), para. 4.

Komandës së Përbashkët;³¹⁴² sidoqoftë më vonë ai i tërhoqi fjalët duke thënë se nuk e dinte se çfarë funksioni zyrtar kishte pasur Shainoviqi dhe se nuk kishte pasur përshtypjen se ai ishte komandanti i ndonjë komande të përbashkët.³¹⁴³

1146. Mbrojtja e Llazareviqit e kundërshton saktësinë e versionit të Vasileviqit të këtyre ngjarjeve,³¹⁴⁴ por Dhoma konkludon se përshkrimet e mbledhjes nga dëshmitarët e tjerë ishin të ngjashme në shumicën e aspekteve materiale. Angjelkoviqi dëshmoi se kishte marrë pjesë në mbledhjen e 1 qershorit 1999. Ai tha se Shainoviqi e kishte vizituar në godinën e Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm dhe në atë mbrëmje e kishte ftuar në një mbledhje me përfaqësuesit e ushtrisë.³¹⁴⁵ Në mbledhje, përfaqësuesit e UJ-së, ndër të cilët Llazareviqi, përshkruan çfarë po ndodhte në terren dhe Shainoviqi foli për bisedimet në Beograd midis Ahtisaari-t, Çernomërdinit, dhe Millosheviqit.³¹⁴⁶ Gjithsesi Angjelkoviqi theksoi, se këto raporte nuk ishin zyrtare, por vetëm shkëmbim joformal informacioni.³¹⁴⁷

1147. Momir Stojanoviqi dëshmoi për mbledhjen në Hotel Grand në fillim të qershorit 1999, në të cilën mori pjesë së bashku me shumë nga të njëjtët pjesëmarrës. Sidoqoftë, ajo asnjëherë nuk u cilësua nga askush si mbledhje e Komandës së Përbashkët, as para, as pas mbledhjes. Për më tepër, meqenëse nuk u paraqitën raporte apo u lëshuan urdhra, ai nuk mendonte se kishte qenë mbledhje e Komandës së Përbashkët. Stojanoviqi ishte ftuar nga Pavkoviqi. Të pranishëm ishin zyrtarë të MPB-së dhe UJ-së. Në atë kohë gjeneral Vasileviqi kishte qenë në vizitë dhe gjithashtu ishte ftuar. Të tjerët të pranishëm ishin Pavkoviqi, Llazareviqi, Misha Villotiqi, i cili ishte shef i RDB-së për Kosovën, Llukiqi, gjeneral Kovaçeviqi, i cili ishte shef i njërive të blinduara dhe të mekanizuara në Shtabin e Komandës së Lartë, Shainoviqi, dhe Angjelkoviqi. Mbledhja u mbajt në Qendrën Informative të Korpusit të Prishtinës, e cila ishte e vetmja pjesë e Komandës së Korpusit e vendosur në Hotel Grand. Të gjithë u ulën rreth tavolinës pa rang protokollar. Mbledhja ishte e shkurtër, vetëm 10 ose 15 minuta. Stojanoviqi dëshmoi se kishte krijuar përshtypjen e përgjithshme të një atmosfere të tendosur dhe të pakëndshme. Pavkoviqi iu drejtua grupit dhe tha se Shainoviqi kishte ardhur nga Beogradi dhe donte t'i informonte për negociatat aktuale në të cilat ishte përfshirë Millosheviqi.³¹⁴⁸

³¹⁴¹ Aleksandar Vasileviq, T. 14509 (29 gusht 2007).

³¹⁴² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 80.

³¹⁴³ Aleksandar Vasileviq, 2D387 (deklaratë dëshmitari e datës 25 korrik 2007), para. 4, T. 14506 (29 gusht 2007).

³¹⁴⁴ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 811–824.

³¹⁴⁵ Zoran Angjelkoviq, T. 14663 (30 gusht 2007). Vasileviqi theksoi se dukej se Angjelkoviqi i shkante pas Shainoviqit. Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 80.

³¹⁴⁶ Zoran Angjelkoviq, T. 14663, 14715–14716 (30 gusht 2007).

³¹⁴⁷ Zoran Angjelkoviq, T. 14664 (30 gusht 2007).

³¹⁴⁸ Momir Stojanoviq, T. 19773–19775, 19777 (7 dhjetor 2007).

1148. Stojanoviqi konfirmoi se më tej Shainoviqi kishte marrë fjalën, duke thënë se shumë shpejt do të nënshkruhej një marrëveshje midis RFJ-së dhe bashkësisë ndërkombëtare. Sipas marrëveshjes, do të arrihej armëpushim dhe do të bëhej tërheqja e menjëhershme e UJ-së dhe MPB-së nga Kosova. Atyre iu tha se tërheqja do të fillonte shumë shpejt dhe se të gjitha aktivitetet duhej të ndaleshin sa më shpejt që ishte e mundur. Stojanoviqi dëshmoi se të gjithë ishin befasuar nga kjo. Atij iu kujtua se Llazareviqi kishte pyetur se çfarë duhej të bënte ai, meqenëse tashmë kishte ndërmarrë veprime kundërterroriste në disa sektorë. Llukiqi gjithashtu tha se kishte veprimtari që po vazhdonin. Shainoviqi tha se nuk e dinte se çfarë do të ndodhte me veprimet aktuale dhe se gjithçka duhej të përmyllet, sepse marrëveshja do të nënshkruhej menjëherë. Stojanoviqi e interpretoi komentit e Shainoviqit vetëm si pohim të fakteve e jo urdhër.³¹⁴⁹ Ai deduktoi se Shainoviqi ishte i pranishëm në cilësinë e tij si zyrtar i lartë shtetëror i cili ishte në gjendje t'i informonte për rezultatet e negociatave.³¹⁵⁰

1149. Dhoma konkludon se kjo mbledhje e mbajtur më 1 qershor 1999 në të cilën morën pjesë, ndër të tjerë, Stojanoviqi, Angjelkoviqi, Gjorgjeviqi, Stevanoviqi, Llukiqi, Pavkoviqi, Llazareviqi, dhe Shainoviqi, ishte mbledhje e ngjashme me mbledhjet e Komandës së Përbashkët të mbajtura në vitin 1998.

(C) Përfundime në lidhje me Komandën e Përbashkët në 1999

1150. Ka më pak prova në lidhje me ekzistencën e Komandës së Përbashkët si organ në vitin 1999. Dhoma vëren mungesën e dëshmive për organizimin e mbledhjeve të përditshme në ndërtesat e Këshillit Ekzekutiv të Përkohshëm në Prishtinë si në vitin 1998. Ka prova vetëm për një mbledhje të mbajtur më 1 qershor 1999.

1151. Gjithsesi, Dhoma konstaton se figura të rëndësishme duke përfshirë edhe disa prej të Akuzuarve, iu referuan “Komandës së Përbashkët” në 1999 që duhej ta merrnin parasysht gjatë detyrave të tyre. Kur iu referuan “Komandës së Përbashkët” në 1999, ata kishin parasysht gjithë sistemin e bashkërendimit midis UJ-së dhe MPB-së të ngritur në vitin 1998. Siç u tha më lart, në vitin 1998 organi i njohur si Komandë e Përbashkët ishte pjesë e këtij sistemi. Në vitin 1999, sistemi i bashkërendimit vazhdoi të funksiononte. Ishte bërë praktikë standarde që përfaqësuesit e MPB-së dhe UJ-së të mbanin mbledhje koordinuese para finalizimit të planeve për operacione të përbashkëta dhe kryerjes së tyre. Dhoma më tej konkludon se megjithëse Komanda e Korpusit të Prishtinës ishte burimi i 16 urdhrave të lëshuara në vitin 1999, urdhrave iu shtua nëntitulli “Komanda e Përbashkët” për të siguruar pranimin e tyre nga hierarkia komanduese e MPB-së, siç

³¹⁴⁹ Momir Stojanoviqi, T. 19773–19776 (7 dhjetor 2007).

sugjeroi Gjakoviqi, për të informuar njësitë e UJ-në se operacionet do të përfshinin edhe MPB-në; dhe për t'u dhënë më shumë autoritet. Për mendimin e Dhomës, referimet për “Komandën e Përbashkët” përbënin faktor të rëndësishëm në planifikimin dhe zbatimin e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së, duke qenë se ato vinin në dukje autoritetin e organit që në vitin 1998 quhej “Komanda e Përbashkët”.³¹⁵¹

1152. Pavarësisht nga bashkëpunimi dhe koordinimi i ngushtë midis UJ-së dhe MPB-së në planifikimin dhe kryerjen e veprimeve luftarake në Kosovë në vitin 1998 dhe në fillim të vitit 1999, ky bashkëpunim ishte i kufizuar dhe në disa raste dështoi.³¹⁵² Pjesa në vijim do të shqyrtojë çështjen e vënies së njësive të MPB-së në varësinë e UJ-së nga mesi i prillit 1999.

3. Vënia e njësive dhe organeve të MPB-së në varësinë e UJ-së nga prilli 1999

a. Argumentet e palëve

1153. Në Aktakuzë, Prokuroria deklaroi se pas datës 23 mars 1999, në bazë të Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen, MPB-ja u vu nën varësinë e UJ-së. Prokuroria pretendon se Ojdaniqi si shef i Shtabit të Komandës së Lartë “ushtronte pushtet komandues mbi njësitë e MPB-së dhe njësitë ushtarake-territoriale, dhe grupet e tjera të armatosura që ishin nën varësinë e UJ-së gjatë rrezikut të luftës së afërt ose gjendjes së luftës”.³¹⁵³ Për më tepër, Prokuroria argumenton se Pavkoviqi, si komandant i Armatës së Tretë, dhe Llazareviqi, si komandant i Korpusit të Prishtinës, “ushtruan pushtet ose kontroll komandues mbi njësitë e MPB-së që ishin nën varësinë ose që vepronin në bashkëpunim dhe koordinim me [Armatën e Tretë të UJ-së ose Korpusin e Prishtinës të Armatës së Tretë të UJ-së], si dhe mbi njësitë ushtarake-territoriale, njësitë e mbrojtjes civile dhe grupe të tjera të armatosura, në bazë të Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen dhe nëpërmjet komandës së përbashkët dhe strukturave dhe mekanizmave koordinuese”.³¹⁵⁴

1154. Mbrojtjet e Ojdaniqit, Pavkoviqit, dhe Llazareviqit pohojnë se teza e Prokurorisë është rrjedhojë e një interpretimi të gabuar gjuhësor të Nenit 17 të Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen.

1155. Neni 17, i përkthyer nga Shërbimi i Përkthimit të Tribunalit në anglisht, parashtron:

³¹⁵⁰ Momir Stojanović, T. 19802–19803 (7 dhjetor 2007).

³¹⁵¹ Dhoma hedh poshtë argumentin e Mbrojtjes së Llazareviqit në paragrafin 1051 meqë veprimet e Llazareviqit në vitin 2001 nuk mposhtin provat e shumta që venë në dukje ekzistencën e Komandës së Përbashkët dhe ndikimin e saj në veprimet e UJ-së dhe MPB-së.

³¹⁵² *Shih*, p.sh., P1993 (Procesverbal i Mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999); Vladimir Llazareviq, T. 18017 (9 nëntor 2007); 5D376 (Letër e nënshkruar nga Sreten Llukiqi, 13 maj 1999); Radojko Stefanović, T. 21687 (5 shkurt 2008).

³¹⁵³ Aktakuza, para. 11(vi), 41(b); Fjala hyrëse e Prokurorisë, T. 436 (10 korrik 2006).

³¹⁵⁴ Aktakuza, para. 12(ii), 53, 13(ii), 58.

Në rast të rrezikut të luftës së afërt, gjendjes së luftës ose gjendjes së jashtëzakonshme, njësitë dhe organet e Punëve të Brendshme mund të përdoren për të kryer detyra luftarake, si për shembull, pjesëmarrje në luftime, ose për rezistencë të armatosur. Gjatë kryerjes së detyrave të tyre luftarake, këto njësi dhe organe *do të* vihen nën varësinë e oficerit të Forcave të Armatosura të Jugosllavisë që komandon operacionet luftarake.³¹⁵⁵

1156. Sipas këtyre tre të Akuzuarve, teksti origjinal përcakton se njësitë dhe organet e Ministrisë së Brendshme *mund* të përdoren për kryerjen e detyrave luftarake ose të përfshihen në luftime, ose të bëjnë rezistencë të armatosur, dhe për këtë arsye kjo klauzolë është lejuese dhe jo detyruese.³¹⁵⁶ Më 8 korrik 2008, Dhoma urdhëroi Shërbimin e Përkthimit të Tribunalit të përkthente edhe njëherë nenin 17 në anglisht, dhe përkthimi i ri që u bë ishte i njëjtë me përkthimin e parë – “do të” dhe jo “mund”.³¹⁵⁷

1157. Në dosjen përfundimtare, Mbrojtja e Ojdaniqit argumenton se kuptimi i “*do të* vihen nën varësinë e” nuk i mundësonte Ojdaniqit kontroll *de jure* mbi MPB-në. Kjo shprehje mund t’i ofronte një komandanti ushtarak vetëm mbikëqyrje të kufizuar të njërive të MPB-së gjatë një operacioni luftarak.³¹⁵⁸ Mirëpo Mbrojtja e Pavkoviçit dhe ajo e Llazareviçit ende këmbëngulin se ligji duhet përkthyer me “*mund*” të vihen nën vartësi. Për këtë arsye, komandantët e UJ-së nuk kishin automatikisht kontroll *de jure* mbi MPB-në; që të mund të zbatohet, rivartësimi duhet të hynte në fuqi.³¹⁵⁹ Mbrojtja e Llazareviçit më tej argumenton se vetë fakti që Presidenti i RFJ-së, Millosheviç, përveç shpalljes së luftës lëshoi urdhër për rivartësim, vërteton se neni 17 nuk ishte automatikisht i zbatueshëm.³¹⁶⁰

1158. Gjithashtu Mbrojtjet e Ojdaniqit, Pavkoviçit dhe Llazareviçit shprehen se sido që të jetë, rivartësimi formal nuk u realizua asnjëherë në fillim të vitit 1999, dhe se provat lidhur më ndonjë bashkëpunim ose koordinim midis UJ-së dhe MPB-së gjatës disa operacioneve në Kosovë nuk janë prova të vënies së MPB-së në varësi të UJ-së.³¹⁶¹ Ata deklarojnë se si UJ-ja, po ashtu edhe MPB ruajtën hierarkitë e tyre komanduese dhe planifikuese.³¹⁶² Mbrojtja e Pavkoviçit pretendon

³¹⁵⁵ P985 (Ligji i RFJ-së për Mbrojtjen), neni 17 (me theks të shtuar).

³¹⁵⁶ Seancë e mbajtur sipas Rregullës 98 *bis*, T. 12516–12517 (3 maj 2007).

³¹⁵⁷ Urdhër lidhur me provat P985 dhe 3D670, 8 korrik 2008.

³¹⁵⁸ Dosja Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 457.

³¹⁵⁹ Dosja Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 184; Dosja Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 807.

³¹⁶⁰ Dosja Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 807.

³¹⁶¹ Dosja Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para.177; Dosja Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 462; Dosja Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 76. Mbrojtja e Llazareviçit përdori P1981 (Urdhër i Brigadës 549 të Motorizuar, 23 mars 1999) për të treguar se “detyrat i jepeshin vetëm njërive të UJ-së dhe se detyra të tilla duheshin realizuar me mbështetjen e njërive të PJP-së”.

³¹⁶² Dosja Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para.195; Dosja Përfundimtare e Llazareviçit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 77, 782.

konkretisht se midis këtyre dy organeve kishte koordinim, por se ai u realizua vetëm në kryerjen e veprimeve luftarake dhe jo në nivelet më të larta shtetërore.³¹⁶³

1159. Për më tepër, Mbrojtja e Llazareviqit nuk e mohon që gjatë disa operacioneve dhe veprimeve në terren pati bashkëpunim dhe koordinim midis MPB-së dhe UJ-së, mirëpo këmbëngul se në kuadër të këtyre operacioneve nuk pati rivartësim.³¹⁶⁴

1160. Lidhur me pretendimin e Prokurorisë se Shainoviçi si kreu i Komandës së Përbashkët komandoi, kontrolloi ose ushtroi kontroll efektiv mbi forcat e RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë,³¹⁶⁵ Mbrojtja e Shainoviqit argumenton se fakti që Millosheviçi lëshoi urdhra për rivartësim tregon se në atë kohë nuk kishte një komandë të vetme mbi këto dy forca. Për më tepër, përpjekjet e vazhdueshme të UJ-së për t'i vënë në varësi njësitë e MPB-së në përputhje me nenin 17 dhe raportet mbi vazhdimësinë e mosvënies së MPB-së në varësi të UJ-së, sipas Mbrojtjes së Shainoviqit vërtetojnë që Shainoviçi nuk kishte kontroll efektiv mbi koordinimin e MPB-së dhe UJ-së më 1999.³¹⁶⁶

b. Procesi i rivartësimit

1161. Dhomës Gjyqësore i janë paraqitur një sasi e konsiderueshme provash lidhur me mënyrën se si duhej të funksiononte rivartësimi sipas Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen.

1162. Sipas ekspertit ushtarak Radovan Radinoviçi, edhe pse nenet 16 dhe 17 të Ligjit për Mbrojtjen ishin automatikisht të zbatueshëm me shpalljen e gjendjes së luftës, për t'u bërë rivartësimi ishte i nevojshëm një urdhër për zbatimin e tij, dhe njësitë e MPB-së duhej të merrnin një urdhër të tillë nëpërmjet hierarkisë së tyre komanduese. Radinoviçi shpjegoi se sipas procedurës së zakonshme për rivartësim, ministri i Brendshëm i drejtonte Shtabit të MPB-së ose organit epror të tij një urdhër me shkrim për vënien e forcave vendore nën varësinë e komandantët ushtarak përkatës.³¹⁶⁷ Dëshmia e Radinoviqit u mbështet nga Radomir Mlladenoviçi, gjykatës në Gjykatën Ushtarake të Nishit, i cili tha se vetëm vendimi i Këshillit të Lartë të Mbrojtjes për rivartësim në vetvete nuk ishte i mjaftueshëm. Ai shpjegoi se në vendim përfshiheshin edhe institucione republikane dhe federale dhe se “në rast se ato nuk arrinin marrëveshje midis tyre, nuk mund të diskutohej fare asnjë lloj rivartësimi.”³¹⁶⁸

³¹⁶³ Dosja Përfundimtare e Pavkoviçit, 28 korrik 2008 (versioni publik), para. 197.

³¹⁶⁴ Dosja Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 76, 780.

³¹⁶⁵ Aktakuza, para. 46(c).

³¹⁶⁶ Dosja Përfundimtare e Shainoviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 612, 617.

³¹⁶⁷ Radovan Radinoviçi, T. 17174–17175 (17 tetor 2007).

³¹⁶⁸ Radomir Mlladenoviçi, T. 21298 (29 janar 2008).

1163. Aleksandar Dimitrijeviq bëri një interpretim tjetër dhe tha se:

... në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, ushtrisë i jepet një detyrë. Ajo është organizatore dhe protagoniste e të gjitha veprimeve në territorin ku është shpallur gjendja e jashtëzakonshme, duke filluar nga vendosja e ndalim-qarkullimit, e duke përfshirë të gjitha veprimet e tjera në të cilat merr pjesë edhe MPB-ja, por të gjitha këto janë nën komandën e ushtrinë, pra civilët, autoritetet shtetërore – kryejnë detyra.³¹⁶⁹

1164. Radojko Stefanoviç deklaroi se rivartësimi ishte punë e ndërlikuar.³¹⁷⁰ Po ashtu, edhe Llazareviç dëshmoi gjerësisht lidhur me hollësitë e procesit të rivartësimit, të cilin ai e përshkroi si proces tejet të ndërlikuar dhe “detyrë të pamundshme”.³¹⁷¹ I pyetur më tej nga Dhoma, Stefanoviç qartësoi se në fund të fundit ishte “thjesht e pamundshme” që të viheshin të gjitha organet dhe shërbimet e policisë nën vartësinë e UJ-së, dhe se ai nuk dinte nëse pamundësia e zbatimit të urdhrin u diskutua në ndonjë rang më të lartë se komandantët e njësive të MPB-së.³¹⁷²

1165. Sipas Sllobodan Kosovacit, neni 17 zbatohet vetëm në rast operacionesh të caktuara luftarake kur ato urdhëroheshin ose ndërmerreshin; mbasi bëhej kjo kishte “bashkëpunim ose veprime të përbashkëta” midis MPB- së dhe UJ-së.³¹⁷³ Kjo dëshmi u mbështet edhe nga dëshmia e Llazareviçit i cili tha se procesi i rivartësimit kërkonte urdhra tejet të hollësishme me shkrim për përcaktimin e çështjeve, përfshirë mënyrën e rivartësimit të një njësie, si dhe komandimin dhe përdorimin e asaj njësie. Ai shpjegoi se rivartësimi nuk mund të bëhej mbi bazë *ad hoc*; edhe sikur të ekzistonte ndonjë plan paraprak, rivartësimi nuk mund të bëhej automatikisht sepse duhej të bëhej rivartësimi formal i një njësie për një detyrë të caktuar dhe të lëshoheshin urdhra konkrete për rivartësimin.³¹⁷⁴ Llazareviç e përshkroi procesin e rivartësimit si vijon:

[Një] njësi përkohësisht, për një kohë më të shkurtër ose më të gjatë, largohet nga njësia e saj amë dhe bëhet pjesë e një njësie të re. Ajo vihet në varësi të asaj njësie në kuptimin e komandës, dhe ...përdorimit të mëtejshëm të saj në kryerjen e detyrave. Ajo nuk ka të bëjë fare me njësinë e vet amë, dhe njësia amë nuk ka mundësi t'a komandojë ose kontrollojë. Mund të mbeten disa kompetenca përsa i përket personelit dhe aspekteve të logjistikës, por përsa i përket përdorimit të asaj njësie, ndërpritet çdo lidhje midis njësisë së rivartësuar dhe njësisë amë.³¹⁷⁵

Stefanoviç shpjegoi se me hyrjen në fuqi të rivartësimit, ekzistonte një “komandë e vetme” në kryerjen e detyrave luftarake.³¹⁷⁶ Në këtë drejtim, Radomir Mlladenoviç shpjegoi se sikur të ishte

³¹⁶⁹ Aleksandar Dimitrijeviç, T. 26651 (8 korrik 2008).

³¹⁷⁰ Radojko Stefanoviç, T. 21821–21824 (7 shkurt 2008).

³¹⁷¹ Vladimir Llazareviç, T. 18024, T. 18037–18040 (9 nëntor 2007).

³¹⁷² Radojko Stefanoviç, T. 21684–21688 (5 shkurt 2008); T. 21826–21828 (7 shkurt 2008).

³¹⁷³ Sllobodan Kosovac, T. 15841–15842 (18 shtator 2007).

³¹⁷⁴ Vladimir Llazareviç, T. 17826 (7 nëntor 2007).

³¹⁷⁵ Vladimir Llazareviç, T. 17826 (7 nëntor 2007).

³¹⁷⁶ Radojko Stefanoviç, T. 21821–21824 (7 shkurt 2008).

zbatuar rivartësimi, Ligji për Gjykatat Ushtarake në atë kohë do të zbatohet edhe ndaj oficerëve të policisë në njësitë e MPB-së sepse në kuadrin e rivartësimit, ata do të kishin kryer detyra ushtarake.³¹⁷⁷

1166. Miroslav Mijatović dëshmoi se kishte mosmarrëveshje lidhur me interpretimin ligjor të dispozitës mbi rivartësimin.³¹⁷⁸ Policia kishte pikëpamjen se do të rivartësoheshin vetëm njësitë e përfshira në veprime luftarake, kurse të gjithë të tjerët në MPB duhej të vazhdonin me veprimtaritë e tyre të zakonshme. Mirëpo, “disa oficerë të UJ-së” besonin se e gjithë MPB-ja duhej të vihej nën varësinë e UJ-së. Sipas Mijatovićit, kjo çështje “më në fund u trajtua dhe kjo në asnjë mënyrë nuk ndikoi në veprimet antiterroriste ose në mbrojtjen e vendit.” Edhe pse u pyet gjerësisht nga Dhoma, Mijatović nuk ishte në gjendje të thoshte se cili person nga UJ-ja parashtroi interpretimin alternativ dhe as të jepte ndonjë arsye se pse UJ donte vartësimin e gjithë MPB-së, por vetëm tha: “Unë nuk po them që ata me të vërtetë e donin këtë...ky ishte vetëm interpretimi i tyre” i dispozitës për rivartësim. Mijatović gjithashtu nuk ishte në gjendje të thoshte nëse u mbajtën mbledhje midis MPB-së dhe UJ-së lidhur me çështjen e interpretimit.³¹⁷⁹

c. Urdhrat për rivartësim

1167. Më 23 mars 1999, në RFJ zyrtarisht u shpall zyrtarisht gjendja e rrezikut të luftës së afërt dhe një ditë më pas u shpall gjendje lufte, që dha shkas për zbatimin e nenit 17 të Ligjit të RFJ-së për Mbrojtjen.³¹⁸⁰ Më 18 prill, Presidenti i atëhershëm i RFJ-së, Millosheviq lëshoi një urdhër me shkrim për vënien e MPB-së në vartësinë e UJ-së në Kosovë.³¹⁸¹

1168. Vlen të theksohet se Gjorgje Qurçini dëshmoi se një skenar, sipas të cilit MPB-ja dhe forcat e mbrojtjes civile do të viheshin nën komandën e Armatës së Tretë, ishte menduar që nga 12 prilli 1999,³¹⁸² gjashtë ditë përpara se Millosheviq të lëshonte urdhrin e tij. Shefi i Shtabit të Komandës së Lartë kishte shqyrtuar mundësinë për [ri]vartësim edhe më herët, disa ditë përpara mbledhjes së

³¹⁷⁷ Radomir Mladenović, T. 21320–21321 (29 janar 2008). Mladenović gjithashtu konfirmoi që asnjëherë nuk kishte marrë ndonjë informacion që tregonte se njësitë e MPB-së ishin vënë nën vartësinë e UJ-së, faktor që rrjedhimisht do të zgjeronte juridiksionin e gjykatave ushtarake.

³¹⁷⁸ Miroslav Mijatović, T. 22265–6 (13 shkurt 2008).

³¹⁷⁹ Miroslav Mijatović, T. 22265–22267, 22272–22274 (13 shkurt 2008).

³¹⁸⁰ P992 (Vendimi për Shpalljen e Gjendjes së Rrezikut të Luftës së Afërt, 23 mars 1999); P991 (Vendimi për Shpalljen e Gjendjes së Luftës, 25 mars 1999).

³¹⁸¹ 3D670 (Urdhër i Sllobodan Millosheviqit për vënien e forcave të MPB-së në vartësinë e UJ-së, 18 prill 1999).

³¹⁸² Gjorgje Qurçin, T. 17017–17018 (16 tetor 2007). *Shih* P1483 (Plotësues i Direktivës së 9 prillit 1999 nga Shtabi i Komandës së Lartë, 12 prill 1999), para. 6, që plotëson direktivën origjinale, 4D107 (Direktivë e Shtabit të Komandës së Lartë për Angazhimin e UJ-së Kundër Agresionit të NATO-s).

kolegijumit të UJ-së të datës 12 prill.³¹⁸³ Qurçini shpjegoi se, edhe pse Ministria e Brendshme nuk u përfshi në këto diskutime, Ministria Federale e Mbrojtjes në vijim i dërgoi Ministrisë së Drejtësisë një memorandum në të cilën kërkonte mendim lidhur me ligjshmërinë e vartësimit të MPB-së. Mirëpo Ministria nuk e dha këshillën që iu kërkua, duke qenë e mendimit se nuk kishte juridiksion mbi këtë çështje.³¹⁸⁴ Dhoma gjithashtu vë në dukje se që më 10 prill 1999, në urdhrin *Grom 4*, Komanda e Armatës së Tretë udhëzonte që “forcat e Ministrisë së Brendshme” të “viheshin nën Komandën e Armatës së Tretë dhe të përdoren vetëm në përputhje me vendimet e komandantit të Armatës”.³¹⁸⁵

1169. Më 18 prill, në zbatim të urdhrin të Millosheviqit, Ojdaniqi, si shef i Shtabit të Komandës së Lartë të UJ-së, u drejtoi Komandave të Armatës së Parë, së Dytë dhe së Tretë si dhe Marinës urdhrin përkatës për rivartësim.³¹⁸⁶ Dy ditë më pas, më 20 prill 1999, komandanti i Armatës së Tretë, Pavkoviqi, urdhëroi vënien e të gjitha njërive dhe shërbimeve të MPB-së në vartësinë e Korpusit të Prishtinës dhe Korpusit të Nishit për të mbështetur kryerjen e misionëve luftarake.³¹⁸⁷ Komandanti i Korpusit të Prishtinës, Llazareviqi, u dërgoi njëherazi një urdhër disa detashmenteve të ushtrisë dhe Shtabit të MPB-së në Prishtinë, duke urdhëruar që të gjitha njësitë dhe organet e MPB-së të viheshin nën vartësinë e komandave të brigadave të Korpusit të Prishtinës, më qëllim kryerjen e operacioneve luftarake; ai caktoi datën 25 prill 1999 si afat kohor për zbatimin e rivartësimit.³¹⁸⁸ Sipas këtij urdhri, të gjitha njësitë e MPB-së që kryenin operacione luftarake, do të rivartësoheshin vetëm gjatë kryerjes së operacioneve të tilla. Të gjithë formacionet e tjera të policisë do të mbeteshin nën vartësinë e MPB-së.³¹⁸⁹

1170. Llazareviqi dëshmoi lidhur me mbledhjen dhe procedurën që rezultuan në urdhrin e tij të datës 20 prill 1999.³¹⁹⁰ Duke qenë se mendonte se zbatimi i urdhrin për rivartësim thjesht ishte i pamundshëm, atij iu desh shumë kohë për të hartuar këtë urdhër. Në vijim, ai tha se kishte shkruar disa projekt-urdhra dhe i kishte grisur duke u përpjekur që t’i shmangej dilemës se cilat njësi duhej të vazhdonin me detyrat e tyre të rregullta, dhe cilat duhej të viheshin nën vartësinë e brigadave. Ai

³¹⁸³ Gjorgje Qurçin, T. 17018–17019 (16 tetor 2007). Nuk është e qartë nëse Qurçini e ka fjalën për mbledhjen e kolegijumit në mbrëmjen e 9 prillit 1999. Gjithsesi procesverbal i saj tregon se ai ishte i pranishëm në këtë mbledhje. P929 (Procesverbal i Kolegijumit të Shefit të Shtabit të Komandës së Lartë, 9 prill 1999), f. 11.

³¹⁸⁴ Gjorgje Qurçin, T. 17019 (16 tetor 2007).

³¹⁸⁵ 4D308 (Urdhër i Armatës së Tretë për mbrojtje nga NATO, 10 prill 1999), f. 4.

³¹⁸⁶ P1488 (Urdhër për vënien e forcave të MPB-së në varësinë e ushtrisë dhe komandantëve të marinës, 18 prill 1999). Prova materiale P1460 është kopje e të njëjtit urdhër dhe mban vulën “Komanda e Armatës së Tretë”, dhe me sa duket vjen nga arkiva e Armatës së Tretë.

³¹⁸⁷ P1457 (Urdhër për vënien e forcave të MPB-së në varësinë e UJ-së, 20 prill 1999); P1722 (Urdhër për vënien e njërive të MPB-së në varësinë e PrK-së dhe NK-së, 20 prill 1999).

³¹⁸⁸ P1267 (Urdhër i PrK -së lidhur me një komandë të vetme gjatë operacioneve luftarake, 20 prill 1999). Këtë urdhër Llazareviqi ua dërgoi njërive vartëse të PrK-së dhe Shtabit të MPB-së në Prishtinë.

³¹⁸⁹ P950 (Intervistë e Vladimir Llazareviqit me Prokurorinë), f. 235.

caktoi 25 prillin si afat të fundit kohor, mbasi mendonte se kjo detyrë nuk do të ishte e lehtë duke marrë parasysh natyrën e ndërlikuar të procesit të rivartësimit.³¹⁹¹ Gjatë pyetjeve të Prokurorisë, Llazareviqi tha se më 19 prill ose rreth kësaj date, Pavkoviqi e kishte urdhëruar që të merrte pjesë në një mbledhje në të cilin ai, Pavkoviqi dhe Obrad Stevanoviqi diskutuan mundësitë e vartësimit të MPB-së në “kuptim të plotë luftarak” - gjegjësisht se cilat njësi të përshiheshin në luftime dhe cilat të mos përfshiheshin, sipas rregullave të luftimit të ushtrisë përkundrejt kushteve ligjore të përcaktuara në Ligjin për Mbrojtjen.³¹⁹² Llazareviqi nuk ishte i qartë nëse Vllastimir Gjorgjeviq dhe Gjakoviqi morën pjesë në takim, dhe nuk i kujtohej nëse gjatë takimit u mbajtën shënime. Ai përmbledhi përfundimin e nxjerrë nga “njëri nga këta dy ndihmësministra të brendshëm, i cili tha, ‘Nuk mund t’u zbatojmë këtë sepse nuk kemi urdhër nga ministri ynë.’” Llazareviqi kujtoi se ishte detyra e Pavkoviqit që t’i raportonte Shtabit të Komandës së Lartë se njësitë e policisë në Kosovë nuk kishin marrë urdhra për rivartësim nga MPB-ja, dhe se ky raport u dërgua të nesërmen, më 20 prill.³¹⁹³ Lubisha Stojimiroviq, ish-shef i Shtabit të Armatës së Tretë, kishte dijeni për një kërkesë të komandantit të Armatës së Tretë dërguar Shtabit të Komandës së Lartë që urdhri për rivartësim t’i dërgohej ministrit të Brendshëm të Serbisë, në mënyrë që vendimi t’u kalohej formacioneve më të ulëta në MPB-në e Serbisë.³¹⁹⁴

1171. Megjithëse vartësimi nuk u realizua brenda afatit të 25 prillit, Llazareviqi më pas u dërgoi edhe një urdhër Shtabit të MBP-së dhe të gjitha komandave vartëse të Korpusit të Prishtinës, në të cilin urdhëroi që të gjitha komandat vartëse të angazhonin MPB-në e Serbisë, përfshirë detashmentet manovruese të PJP-së dhe njësitë territoriale të MPB-së, me qëllim kryerjen e detyrave luftarake në zonën e Korpusit të Prishtinës. Llazareviqi gjithashtu i urdhëroi njësitë e tij vartëse “që në sistemin e mbrojtjes dhe kontrollit të territorit në zonën e përgjegjësisë, përveç njërive të formacionit, njërive plotësuese dhe forcave të MPB-së, të përfshinin edhe detashmentet e reja territoriale-ushtarake dhe civilët e armatosur në zonë,” duke thënë se “komandantët e brigadave mund të lëviznin kompani të caktuara të detashmenteve të MPB-së.” Më tej ai udhëzoi të gjithë komandantët e brigadave që t’i raportonin atij lidhur me zbatimin e urdhrit dhe t’i dërgonin Komandës së Korpusit të Prishtinës plane të hollësishme të angazhimit të njërive të MPB-së dhe detashmenteve ushtarake-territoriale për rishikim dhe miratim deri më 30 prill 1999.³¹⁹⁵

³¹⁹⁰ P1267 (Urdhër i PrK-së lidhur me një komandë të vetme gjatë operacioneve luftarake, 20 prill 1999).

³¹⁹¹ Vladimir Llazareviq, T. 18037–18038 (9 nëntor 2007).

³¹⁹² Vladimir Llazareviq, T. 18277–18278 (14 nëntor 2007).

³¹⁹³ Vladimir Llazareviq, T. 18260–18263, T. 18274–18278 (14 nëntor 2007).

³¹⁹⁴ Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari e datës 2 tetor 2007), para. 66.

³¹⁹⁵ P2809 (Urdhër i PrK-së për angazhimin e forcave të MPB-së në zonën e PrK-së, 25 prill 1999), para. 3, 7, 10.

1172. Llazareviqi dëshmoi lidhur me urdhrin e dytë, duke shprehur mendimin e tij se përpjekjet e tij të sinqerta për zbatimin e urdhrin të rivartësimit, u pasqyruan mjaftueshmërisht nëpërmjet lëshimit të urdhrin të dytë. Ai konfirmoi se nëpërmjet angazhimit të PJP-së dhe njësive territoriale të MPB-së si dhe detashmenteve të tjera të UJ-së, kishte paraparë që njësitë e tij vartëse të komandonin PJP-të dhe njësitë territoriale të MPB-së.³¹⁹⁶ Llazareviqi nuk shpjegoi qartë se pse nuk u përpoq të lidhej me një homolog të nivelit të tij në MPB lidhur me zbatimin e rivartësimit, por përsëriti se urdhri për rivartësim i komandantit të Armatës së Tretë, i datës 20 prill 1999, ishte i paqartë në shumë aspekte, si për shembull kujt i drejtohej dhe kush duhej t'a zbatonte.³¹⁹⁷ Kjo u mbështet dhe nga dëshmia e Stefanoviçit.³¹⁹⁸

1173. Për më tepër, më 8 maj 1999, Pavkoviçi lëshoi një urdhër në të cilin udhëzonte që njësitë e MPB-së të viheshin nën vartësinë e UJ-së:

Komandanti i Korpusit të Prishtinës vë (në varësi të brigadave) të gjitha njësitë ushtarake-territoriale dhe të kombinuara taktike të MPB-së, në përputhje me përbërjen e efektivit të njësive të MPB-së ... në mënyrë që një kompani e MPB-së ose një detashment ushtarak territorial të përbëjë një tërësi, dhe që kryerja e detyrave të tyre luftarake të mund të kontrollohet.³¹⁹⁹

Gjakoviçi dëshmoi se Pavkoviçi e kishte udhëzuar të hartonte këtë dokument mbas një bisede midis Pavkoviçit dhe Llukiqit lidhur pikërisht me këtë temë. Një kopje iu dërgua më pas Llukiqit.³²⁰⁰

1174. Ka aspekte lidhur me të cilat Dhoma nuk ka marrë prova të mjaftueshme për procesin e rivartësimit. Mbetet e paqartë se çfarë ndodhi midis MPB-së dhe UJ-së në prill 1999, dhe Dhoma nuk dëgjoi dëshmi që do të shpjegonin arsyen e mosmarrjes së masave nga Millosheviçi për të garantuar zbatimin e urdhrin të tij për rivartësim nga Ministri i Brendshëm i Serbisë. Për më tepër, ndonëse provat tregojnë se rivartësimi sipas urdhrin të Millosheviçit u kundërshtua nga MPB-ja, Dhoma nuk mori prova se faktikisht Stojilkoviçi mori udhëzime nga Millosheviçi, ose më vonë nga Ojdaniçi, lidhur me vënien e MPB-së në varësinë e UJ-së. Sidoqoftë, provat mbështesin përfundimin se u urdhërua vënia e MPB-së në varësinë e UJ-së. Më tej Dhoma analizon nëse u respektuan urdhrat përkatës.

³¹⁹⁶ Vladimir Llazareviq, T. 18735–18744 (21 nëntor 2007). Llazareviçi gjithashtu konfirmoi se ky urdhër ishte dërguar me korrier dhe për këtë arsye dokumenti nuk mbante vulën me informacion për dërgimin, si urdhrat e tjerë.

³¹⁹⁷ Vladimir Llazareviq, T. 18269–18274 (14 nëntor 2007).

³¹⁹⁸ Radojko Stefanoviç, T. 21684–21688 (5 shkurt 2008); T. 21826–21828 (7 shkurt 2008).

³¹⁹⁹ P1269 (Urdhër i Armatës së Tretë, 8 maj 1999).

³²⁰⁰ Millan Gjakoviç, T. 26417–T. 26418 (19 maj 2008).

d. Respektimi i urdhrave për rivartësim

i. *Mosrespektim i përgjithshëm i urdhrave për rivartësim*

1175. Sipas disa dëshmitarëve që kishin qenë oficerë aktivë të UJ-së në 1999, vënia e MPB-së në varësi të UJ-së nuk ndodhi asnjëherë.³²⁰¹ Për shembull, Qurçini dëshmoi se, edhe pse urdhri i parë për rivartësim i lëshuar Millosheviqi shkaktoi ditë të tëra debatesh, në fund të fundit nuk u zbatua asnjëherë.³²⁰² Llazareviqi deklaroi se arsyeja kryesore se pse nuk u bë rivartësimi ishte se udhëheqja e MPB-së pretendonte se nuk kishte një urdhër përkatës nga Ministria e Brendshme për vënien në varësinë e UJ-së në Kosovë. MPB-ja thjesht nuk mund të vepronte sipas urdhrave të UJ-së sepse sipas Ligjit për Punë të Brendshme, vetëm ministri i Brendshëm ishte i autorizuar të përcaktonte përdorimin e forcave të saj.³²⁰³ Në fakt, mosndjekja e kanaleve të duhura zyrtare u përmend nga shumë dëshmitarë si pengesa më e madhe.³²⁰⁴

1176. Mijatoviqi dëshmoi se nuk kishte marrë asnjëherë urdhër nga MPB-ja për vënie në varësi të UJ-së.³²⁰⁵ Ai konfirmoi se Shtabi i MPB-së nuk lëshoi asnjë lloj urdhri për rivartësim dhe se nuk mund të bënte një gjë të tillë pa e anashkalluar ministrin e Brendshëm; ai gjithashtu pohoi se nuk i kishte parë urdhrat përkatës të UJ-së për rivartësim deri pak para se të dëshmonte.³²⁰⁶ Shefi i SPB-së të Prizrenit, Millosh Vojnoviq, gjithashtu dëshmoi se asnjëherë nuk kishte parë urdhër për rivartësim, ndonëse kishte dëgjuar për to.³²⁰⁷

1177. Komandanti i Brigadës së 243-të të Mekanizuar, Kërsman Jeliq, u përpoq të zgjidhte problemet lidhur me rivartësimin me homologun e tij në MPB, shefin e SPB-së së Ferizajt, Bogolub Janiqiçeviq. Megjithatë, meqë nuk kishte urdhrin përkatës nga eprorët e tij, Janiqiçeviqi e informoi se nuk mund të zbatonte urdhrat e UJ-së.³²⁰⁸ Po ashtu, gjenerali Radojko Stefanoviq u

³²⁰¹ Gjorgje Qurçin 16974–16975 (5 tetor 2007); Kërsman Jeliq, T. 18850 (22 nëntor 2007); Momir Stojanoviq, T. 19755 (7 dhjetor 2007); Lubisha Dikoviç, T. 19894 (10 dhjetor 2007); Mihajlo Gërgar, T. 21484 (31 janar 2008); Dragan Zhivanoviq, T. 20485 (17 janar 2008), T. 20583 (18 janar 2008); Nebojsa Bogunoviq, T. 25133 (10 prill 2008); Radojko Stefanoviq, T. 21682–21686 (5 shkurt 2008); Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 26 tetor 2006), para. 45; Lubisha Stojimiroviq, 4D506 (deklaratë dëshmitari e datës 2 tetor 2007), para. 66.

³²⁰² 3D670 (Urdhër i Sllobodan Millosheviqit për vënien e forcave të MPB-së në varësinë e UJ-së, 18 prill 1999).

³²⁰³ Vladimir Llazareviq, T. 18020–18022 (9 nëntor 2007); P950 (Intervistë e Llazareviqit me Prokurorinë), f. 238–239, 242.

³²⁰⁴ Radovan Radinoviç, T. 17134 (17 tetor 2007); Mihajlo Gërgar, T. 21484 (31 janar 2008); Kërsman Jeliq, T. 18850 (22 nëntor 2007); T. 19034–19036 (26 nëntor 2007); Radojko Stefanoviq, T. 21684–21688 (5 shkurt 2008), T. 21690 (5 shkurt 2008); Millorad Obradoviç, T. 15026–15027 (5 shtator 2007); Dragan Zhivanoviq, T. 20583–20584 (18 janar 2008); Petar Damjanac, T. 23763–23764; T. 23780–23781 (6 mars 2008); P1458 (Raport i Korpusit të Prishtinës lidhur me mosrespektimin e Urdhrit për Rivartësim, 24 maj 1999).

³²⁰⁵ Miroslav Mijatoviç, T. 22339–22340 (13 shkurt 2008).

³²⁰⁶ Miroslav Mijatoviç, T. 22364 (14 shkurt 2008).

³²⁰⁷ Millosh Vojnoviq, T. 24235–24236 (13 mars 2008).

³²⁰⁸ Kërsman Jeliq, T. 18850 (22 nëntor 2007); T. 19034–19036 (26 nëntor 2007). Kur u pyet se çfarë priste ai nga rivartësimi, Jeliqi tha: “Mua më duhej një skuadër që mund të kryente aksion në terren. Nuk më duheshin nëpunës.”

përpoq të zgjidhte çështjet e rivartësimit në një mbledhje në Gjakovë ku morën pjesë kolonel Novak Paprika i Komandës së Korpusit të Prishtinës, dhe komandanti i Brigadës së 37-të të Motorizuar, Lubisha Diković; megjithatë, ai pranoi që në fund nuk patën sukses.³²⁰⁹ Dragan Zhivanović, komandanti i atëhershëm i Brigadës së 125-të të Motorizuar, dëshmoi se pas marrjes së urdhrin për rivartësim, ai u telefonoi shefave të MPB-së dhe komandantëve të detashmenteve dhe i informoi për parashikimet e tij.³²¹⁰

1178. Mbrojtja e Pavkovićit argumenton se asnjëherë nuk u bënë bisedime për vënien e MPB-së në varësinë e UJ-së. Në mbledhjet midis Shtabit të MPB-së dhe komandantëve të PJP-së, dhe midis shefave të SPB-ve dhe UJ-së, e vetmja gjë që u diskutua ishte “bashkëpunimi dhe mosbashkëpunimi me UJ-në. Askush nuk diskutoi vënien në varësi të UJ-së”.³²¹¹ Dhoma e hedh poshtë këtë argument sepse ai nuk përputhet me provat. Edhe Mbrojtja e Llazareviqit thekson shkallën e bashkëpunimit dhe jo të vartësimit, midis MPB-së dhe UJ-së.³²¹² Duke iu referuar mbledhjes të Shtabit të MPB-së të datës 11 maj 1999, Mbrojtja e Llazareviqit vë në dukje se ishte “e dukshme që të gjithë komandantët e skuadrave të PJP-së faktikisht flasin për bashkëpunimin që kanë me UJ-në...por që askund nuk janë vënë në vartësi të UJ-së”.³²¹³

1179. Shumë dëshmitarë dëshmuar dhe gjithashtu raportuan lidhur me mosvartësimin nga ana e MPB-së.³²¹⁴ Me kërkesë të Llazareviqit, Stefanović formoi disa ekipe në përpjekje për t'i zgjidhur

Ai më vonë shpjegoi kuptimin e kësaj deklarate duke thënë se qëllimi ishte të vartësoheshin njësi luftarake e jo punonjës zyrash.

³²⁰⁹ Radojko Stefanović, T. 21690 (5 shkurt 2008).

³²¹⁰ Dragan Zhivanović, T. 20583–20584 (18 janar 2008).

³²¹¹ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Pavkovićit, 28 korrik 2008 (versioni publik) para. 202. *Shih* P1993 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999); P1996 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999).

³²¹² Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 798.

³²¹³ Dosja Gjyqësore Përfundimtare e Llazareviqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 801.

³²¹⁴ Kërsman Jeliq, T. 18850 (22 nëntor 2007), T. 19034–19036 (26 nëntor 2007). Më 21 prill 1999, Zhivanović i dërgoi Komandës së PrK-së një raport luftimi, në të cilin kërkonte që t'i kërkohej Shtabit të MPB-së të dërgonte urdhrin përkatës për rivartësim. P2023 (Raport i Brigadës së 125-të të Motorizuar dërguar PrK-së, 25 prill 1999), f. 3. Zhivanović dëshmoi se komandanti i PrK-së i kishte thënë që ia kishte kaluar kërkesën komandantit të Armatës së Tretë, dhe çështja më pas ishte jashtë kompetencave të Zhivanovićit. Dragan Zhivanović, T. 20583–20584 (18 janar 2008). Më 25 prill, komandanti i Brigadës së 7-të të Këmbëorisë gjithashtu i raportoi Komandës së PrK-së që, sipas urdhrin të Llazareviqit të datës 20 prill, njësitë e MPB-së nga Klina dhe Istogu duhej të viheshin nën vartësinë e tij dhe se më 21 prill, ai kishte dhënë urdhër ku i udhëzonte këto njësi të MPB-së që t'i raportonin mbi “forcat dhe mjetet në dispozicion”. Megjithatë, deri më 25 prill, njësitë përkatëse të MPB-së nuk vepruan në përputhje me udhëzimet dhe refuzuan të bashkëpunonin duke thënë se nuk kishin marrë urdhër nga organet e tyre eprore. 4D252 (Raport i Brigadës së 7-të të Këmbëorisë dërguar PrK-së, 25 prill 1999), f. 3. Komandanti i atëhershëm i Brigadës së 211-të të Blinduar, Mihajlo Gergar, më tej shpjegoi se pas moszbatimit të urdhrin për rivartësim, ai e ndjeu të nevojshme të informonte komandantin e PrK-së, gjë që e bëri në një raport luftimi më 26 prill 1999 ku shkruhej: “ka patur shumë mosbindje dhe ata nuk e kanë të qartë që janë nën vartësinë e komandantit të Brigadës”. 5D615 (Raporti Luftarak i Brigadës së 211-të të Blinduar dërguar PrK-së, 26 prill 1999), para. 5.2(B). Kosovaci dëshmoi se asnjë njësi e MPB-së nuk u bë asnjëherë pjesë e formacionit të UJ-së, dhe se MPB-ja dhe UJ-ja ishin dy sisteme krejtësisht të ndryshme me sistem të ndryshëm rekrutimi, me qëllime, objektiva, logjistikë dhe kushte dislokimi të ndryshme, të cilat asnjëherë nuk mund të bashkoheshin nën një flamur të vetëm. Radovan Radinović, T. 17168–17171 (17 tetor 2007); Sillobodan Kosovac, T. 15816–15817 (17 shtator 2007). Oficeri i UJ-së, Dushan Lonçar gjithashtu dëshmoi se MPB-ja asnjëherë nuk

këto çështje, por kjo nuk pati sukses.³²¹⁵ Stefanoviqi konkludoi se “marrëdhëniet funksionale midis ushtrisë dhe MPB-së mbetën [të njëjta si] para lëshimit të urdhrin për rivartësim”, gjegjësisht, “në kuadër të aksioneve të koordinuara, aksioneve të përbashkëta, mbështetjes dhe bashkëpunimit”.³²¹⁶ Stefanoviqi mori disa raporte nga brigadat e tij vartëse se njësitë e MPB-së në këto nivele më të ulëta nuk dëshironin të viheshin nën vartësi.³²¹⁷ Millomir Pantiqi konfirmoi se, si shef i DPB-së në Istog gjatë gjithë periudhës së përfshirë në Aktakuzë, ai refuzoi të vihej nën komandën e Princip Millosavleviqit nga Detashmenti Ushtarak Territorial i 69-të i UJ-së, përkundër përpjekjeve të vazhdueshme të Millosavleviqit dhe urdhrave të tij lidhur me këtë.³²¹⁸ Pantiqi sqaroi në hollësi se si ai, po ashtu dhe Principi kishin mosmarrëveshje të mëdha lidhur me praninë e UJ-së në çështje që mund t’i zgjidhte policia dhe përmendi një rast konkret kur u formua patrullë e përbashkët ushtarake. Pantiqi u ankua se efektivitë i caktuar nga Principi në një nga këto patrulla të përbashkëta ushtarake kishin precedentë penalë dhe atyre nuk mund t’u besohej se do të vepronin në përputhje me ligjin.³²¹⁹ Për më tepër, ish-shefi i DPB-së në Glllogoc, Petar Damjanaci, dëshmoi se, meqë ai asnjëherë nuk kishte marrë urdhër nga eprorët e tij në MPB, kur, dikur në pranverë të vitit 1999 mori urdhër nga një patrullë ushtarake për të shkuar në postëkomandën në Tërstenik dhe për t’i raportuar komandantit të Brigadës së 37-të të Motorizuar, Lubisha Dikoviq, si përfundim atij iu desh t’u thoshte Dikoviqit dhe kolegëve të tij se ai vetë nuk mund të merrte kurrfarë vendimesh lidhur me rivartësimin, dhe se kjo duhej bërë në nivel më të lartë.³²²⁰

1180. Më 7 maj 1999, gjatë një mbledhjeje të mbajtur në Shtabin e MPB-së, Shainoviqi tha se, “pas operacionit *Jezerce*”, të gjitha detashmentet e PJP-së duhej të punonin për shkatërrimin e grupeve të mbetura “terroriste” “në bashkëpunim me UJ-në”. Ai shtoi se “marrëdhëniet midis UJ-së dhe policisë janë përcaktuar dhe rregulluar dhe po funksionojnë siç duhet”.³²²¹ Për më tepër, në të njëjtën mbledhje të datës 11 maj, të cituar nga Mbrojtja e Pavkoviqit dhe ajo e Llazareviciqit, për të treguar se MPB-ja vetëm ka bashkëpunuar me UJ dhe nuk ishte në vartësi të saj, është dokumentuar se një komandant i PJP-së ka thënë se “bashkëpunimi me UJ-në është mjaft i mirë, ndonëse ata kanë kërkuar vënie në vartësi dhe mënyra se si po veprojnë tregon se ata duan t’i ngarkojnë forcat tona maksimalisht”. Një komandant tjetër i PJP-së deklaroi se:

komandoi ushtrinë dhe se UJ-ja asnjëherë nuk komandoi MPB-në, dhe se këto struktura kishin hierarkitë e tyre komanduese të përcaktuara. Dushan Lonçar, T. 7609–7611 (30 nëntor 2006).

³²¹⁵ Radojko Stefanoviq, T. 21684 (5 shkurt 2008).

³²¹⁶ Radojko Stefanoviq, T. 21685–21686 (5 shkurt 2008). Stefanoviqi shtoi se procesi i koordinimit që funksiononte para nxjerrjes së urdhrin për rivartësim u zbatua “gjatë gjithë luftës, deri në fund, pa marrë parasysh urdhrin për vartësim, sepse ky urdhër nuk u zbatua”.

³²¹⁷ Radojko Stefanoviq, T. 21688 (5 shkurt 2008).

³²¹⁸ Momir Pantiq, T. 24774–24775 (2 prill 2008).

³²¹⁹ Momir Pantiq, 6D1604 (deklaratë dëshmitari e datës 26 mars 2008), para. 51–53.

³²²⁰ Petar Damjanac, T. 23763–23764; T. 23780–23781 (6 mars 2008).

Kalimi në varësi të UJ-së duhet të jetë pjesë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të mirëfilltë të informacionit në interes të mbrojtjes së vendit dhe luftës antiterroriste, me kusht që ne ta dimë se cilët persona bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në territoret e SPB-së dhe PJP-së, sepse një brigadë mund të mbulojë territorin e tri SPB-ve.³²²²

Këto komente sugjerojnë se çështja e rivartësimit në fakt ishte temë diskutimi brenda MPB-së dhe se UJ-ja përpiquej aktivisht për vënien e njërive të MPB-së në varësi të saj, në terren në Kosovë. Së bashku me komente nga mbledhje të tjera të cilave iu referuan Mbrojtja e Pavkoviqit dhe ajo e Llazareviqit, ato gjithashtu ilustrojnë shkallën e bashkëpunimit dhe koordinimit midis MPB-së dhe UJ-së.

1181. Millorad Obradoviç pranoi se, sikur të ishte zbatuar urdhri për rivartësim, ai si komandant i Armatës së Dytë do të ishte personi që do t'i jepte MPB-së urdhra për operacione luftarake, por theksoi se vartësimi nuk u realizua.³²²³ Për më tepër, K25, i cili gjatë vitit 1998 dhe vitit 1999 kishte shërbyer në PJP në Kosovë, tha se:

Gjatë përvojës sime, nuk pati asnjë rast të vetëm kur UJ-ja i dha urdhra MPB-së, dhe, ndonëse unë jam në dijeni që sipas ligjeve tona, gjatë gjendjes së luftës MPB-ja mund të vihet nën vartësinë e UJ-së, me sa di unë, kjo nuk ndodhi...kishte shumë rivalitet dhe mosbesim ndërorganizativ që përbënte pengesë.³²²⁴

Komandanti i Brigadës së 37-të të Motorizuar, Lubisha Dikoviç, shpesh kishte kërkuar që MPB të vihej nën vartësinë e UJ-së, në mënyrë që ata [MPB] të ndihmonin në mbrojtjen e njësive të tij, mirëpo dëshmoi se kjo nuk ndodhi asnjëherë. Si pasojë, njësitë e tij pësuan humbje më të mëdha nga çfarë do të kishin pësuar sikur ai të kishte mundur të komandonte MPB-në.³²²⁵

1182. Veçanërisht raporti i Llazareviqit i datës 24 maj 1999 dërguar komandantit të Armatës së Tretë përshkruante në hollësi mosvënien e forcave të MPB-së në varësi të Komandës së Korpusit të Prishtinës, pavarësisht nga urdhri i Ojdaniqit i datës 18 prill 1999, dhe ai i Pavkoviqit i datës 20 prill 1999.³²²⁶ Gjithashtu Llazareviqi raportoi se, ndonëse ishin mbajtur disa mbledhje pune, komandantët dhe drejtuesit e njësive të MPB-së po “rezistonin dhe kundërshtonin haptazi vartësimin” mbasi nuk kishin urdhrin përkatës nga komanda e tyre. Llazareviqi tha se kjo do të rezultonte në nivel më të ulët koordinimi gjatë aksioneve të përbashkëta antiterroriste të UJ-së dhe MPB-së, që sipas mendimit të tij do të kërcënonte rendin luftarak, dhe do të rezultonte në humbje të

³²²¹ P1996 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 7 maj 1999), f. 2–3.

³²²² P1993 (Procesverbali i mbledhjes së Shtabit të MPB-së, 11 maj 1999), f. 6–8.

³²²³ Millorad Obradoviç, T. 15026–15027 (5 shtator 2007).

³²²⁴ K25, P2365 (deklaratë dëshmitari e datës 6 shtator 2001), f. 21 (e mbyllur me vulë).

³²²⁵ Lubisha Dikoviç, T. 19895–19896 (10 dhjetor 2007).

³²²⁶ P1458 (Raport i Korpusit të Prishtinës lidhur me mosrespektimin e Urdhrit për Rivartësim, 24 maj 1999), e pranuar gjithashtu me numrin 4D192 dhe P1723. Ky raport është bazë për raportin e Armatës së Tretë dërguar Shtabit të Komandës së Lartë (P1459). P950 (Intervistë e Llazareviqit me Prokurorinë), f. 238–239, 242.

panevojshme në njerëz, humbje në teknikë dhe në zgjatjen e misioneve. Për më tepër, Llazareviqi komentoi se “puna e postblloqeve të përziera të MPB-së dhe njërive të Policisë Ushtarake është e ngarkuar me probleme pasi njësitë dhe organet e MPB-së nuk po i kryejnë detyrat lidhur me kontrollin e territorit dhe komunikimit, çështjet e strehimit të refugjatëve dhe veprimtaritë e tjera, pikërisht për arsyen e lartpërmendur –sepse ata nuk janë vënë nën vartësi”.³²²⁷ Së fundi, Llazareviqi kërkonte që të merreshin masa të rrepta dhe konkrete për vënien e njërive dhe organeve të MPB-së të Serbisë në varësinë e Komandës së Korpusit të Prishtinës me qëllim që “të mos përballeshin me përgjegjësi për pasojat që kishin ndodhur dhe që mund të ndodhnin në të ardhmen për shkak të angazhimit të tyre jokushtetues dhe të paligjshëm”.³²²⁸

1183. Në përgjigje të këtij raporti, të nesërmen, komandanti i Armatës së Tretë, Pavkoviqi, i raportoi Shtabit të Komandës së Lartë se vënia e forcave të MPB-së në varësi të UJ-së nuk ishte zbatuar sipas urdhrave të Ojdaniqit ose të Pavkoviqit, dhe se përpjekjet për zgjidhjen e kësaj çështjeje nuk kishin dhënë rezultate të dukshme. Në këtë raport, ai informoi për problemet që mund të lindnin si pasojë e operacioneve të përbashkëta të UJ-së dhe MPB-së në luftime, dhe përshkroi grindjet e shpeshta midis dy subjekteve, që pjesërisht kishin të bënin me faktin se pjesëtarët e MPB-së nuk i dënonin ose lejonin haptas veprimtaritë kriminale të civilëve dhe pjesëtarëve të MPB-së. Pavkoviqi gjithashtu propozoi që Shtabi i Komandës së Lartë, ose të merrte masa urgjente për vartësimin e MPB-së së Serbisë në përputhje me gjendjen e shpallur të luftës, ose të anulonte urdhrin origjinal dhe të linte komandimin e njërive të MPB-së në duar të Shtabit të MPB-së për Kosovën “nëpërmjet Komandës së Përbashkët, siç është bërë deri tani”.³²²⁹

1184. Më 2 qershor 1999, në një raport dërguar Shtabit të Komandës së Lartë, Lubisha Veliçkoviqi, shënoi se nuk kishte “unitet të komandës mbi të gjitha forcat” dhe se marrëdhëniet me njësitë e MPB-së “mbaheshin nëpërmjet marrëveshjeve të cilat shpeshherë nuk respektoheshin, sidomos në nivelet më të ulëta”.³²³⁰ Qurçini dëshmoi se dy ditë më pas, Pavkoviqi i kishte dërguar edhe një raport Shtabit të Komandës së Lartë, ku shpjegonte problemet e hasura në punën me MPB-në.³²³¹ Në këtë raport, Pavkoviqi kërkonte që të zgjidheshin disa nga problemet që kishte konstatuar gjatë vizitës që kishte bërë në disa njësi midis 23 dhe 26 majit 1999, njëri nga të cilët ishte mungesa e urdhrin përkatës të MPB-së për vartësim. Më tej, Pavkoviqi u ankua lidhur me pozitën e

³²²⁷ P1458 (Raport i Korpusit të Prishtinës lidhur me mosrespektimin e Urdhrit për Rivartësim, 24 maj 1999).

³²²⁸ P1458 (Raport i Korpusit të Prishtinës lidhur me mosrespektimin e Urdhrit për Rivartësim, 24 maj 1999).

³²²⁹ P1459 (Raport i Armatës së Tretë lidhur me mosbindjen nga ana e organeve të MPB-së, 25 maj 1999), f. 2. Gjithashtu kësaj, P1724 dhe 3D1106 janë kopje të të njëjtit raport. Mbrojtja e Ojdaniqit mohon marrjen e raportit të Pavkoviqit të datës 25 maj, duke pohuar se “Shtabi i Komandës së Lartë nuk e mori asnjëherë raportin”. Dosja Përfundimtare e Ojdaniqit, 29 korrik 2008 (versioni publik), para. 246 (f). Përfundimisht, dokumenti është autentik dhe i besueshëm, dhe diskutohet në Pjesën VIII.E.

³²³⁰ 5D434 (Raport i Shtabit të Komandës së Lartë, 2 qershor 1999), f. 4.

“privilegjuar” të pjesëtarëve të MPB-së krahasuar me pjesëtarët e UJ-së për sa i përket pagesës së mëditjeve dhe rrogave, furnizimit me uniforma dhe pajisje për komunikim, dhe sistemit të mangët të komunikimit, sidomos në njësitë e niveleve më të ulëta.³²³² Kur u pyet se a ishte në dijeni të marrjes së ndonjë mase për zgjidhjen e problemeve të parashtruara në raportin e Pavkoviçit, Qurçini u përgjigj se Millosheviçi dhe Ojdaniçi u takuan për të diskutuar këtë çështje, por se përfundimisht MPB-ja nuk u vu asnjëherë në varësinë e UJ-së, dhe për këtë arsye këto probleme nuk mund të zgjidheshin.³²³³

1185. Millan Gjakoviçi dëshmoi për mbledhjen e datës 19 prill 1999, në të cilin morën pjesë oficerë të MPB-së: shefi i RJB-së Vllastimir Gjorgjeviçi; komandanti i PJP-ve Obrad Stevanoviçi; shefi i Shtabit të MPB-së Llukiq; dhe oficerë të UJ-së: Llazareviçi dhe Pavkoviçi. Gjorgjeviçi vuri në dyshim përmbajtjen e një telegrami që i dha Pavkoviçi, në të cilin urdhërohej vartësimi i MPB-së, që sipas Gjakoviçit përputhej me mosbindjen e përgjithshme të MPB-së asokohe që të pranonte komandën e UJ-së në të gjithë territorin e Kosovës.³²³⁴

1186. Ish-shefi i Departamentit të UJ-së për Organizim, Mobilizim dhe Rekrutim, Slllobodan Kosovaci, dëshmoi se sipas tij, vartësimi nënkuptonte se ministri i Brendshëm nuk do të vihej kurrë nën vartësinë e drejtpërdrejtë të Shtabit të Përgjithshëm ose Shtabit të Komandës së Lartë.³²³⁵ Këtë e konfirmoi edhe dëshmia e Qurçinit se urdhri i Millosheviçit për vartësimin e MPB-së parashihte vartësim vetëm për veprimtari luftarake, dhe jo vënien e ministrit të Brendshëm të Serbisë, Vllajko Stojilkoviçi në varësinë e UJ-së, e as vartësimin e pjesës tjetër të MPB-së ndaj Shtabit të Komandës së Lartë.³²³⁶ Qurçini deklaroi se, pavarësisht nga urdhri i Millosheviçit i datës 18 prill 1999, dhe faktit që ai udhëzoi Ojdaniçin që “t’u dërgonte [kërkesa] organeve shtetërore civile dhe pjesëtarëve të tjerë në mbrojtje” pas aktivizimit të nenit 17, Shtabi i Komandës së Lartë dhe Ojdaniçi nuk komunikuan me Stojilkoviçin lidhur me këtë çështje.³²³⁷ Qurçini nuk kishte dijeni nëse Ojdaniçi dhe Stojilkoviçi kishin diskutuar vartësimin, ose nëse ndonjë dokument që urdhëronte vartësimin i ishte dërguar Ministrisë së Brendshme të Serbisë ose Ministrisë Federale të Brendshme, por tha se, për mendimin e tij, Ojdaniçi dhe Stojilkoviçi nuk kishin komunikuar lidhur me vartësimin sepse në atë rast, Ojdaniçi do të kishte raportuar për këtë gjë. Kur u pyet se pse urdhri për vartësim nuk iu

³²³¹ P1725 (Kërkesë e Armatës së Tretë dërguar Shtabit të Komandës së Lartë, 4 qershor 1999).

³²³² P1725 (Kërkesë e Armatës së Tretë dërguar Shtabit të Komandës së Lartë, 4 qershor 1999).

³²³³ Gjorgje Qurçin, T. 16990 (16 tetor 2007).

³²³⁴ Millan Gjakoviçi, T. 26495–26496 (20 maj 2008).

³²³⁵ Slllobodan Kosovaci, T. 15846 (18 shtator 2007).

³²³⁶ Gjorgje Qurçin, T. 16984–16990 (5 tetor 2007).

³²³⁷ Gjorgje Qurçin, T. 17063 (16 tetor 2007); Slllobodan Kosovaci, T. 15876 (18 shtator 2007); Miodrag Simiq, T. 15582–15583 (13 shtator 2007); *shih* 3D670 (Urdhër i Slllobodan Millosheviçit për vënien e forcave të MPB-së në varësinë e UJ-së, 18 prill 1999).

dërgua organit shtetëror më të rëndësishëm civil, gjegjësisht vetë MPB-së, Qurçini tha se nuk do të ishte me vend që shefi i Shtabit të Komandës së Lartë të informonte Ministrinë e Brendshme për një urdhër që kishte dhënë Millosheviqi.³²³⁸ Ojdaniqi nuk mund t'i dërgonte urdhër, madje as kërkesë MPB-së për t'u vënë nën vartësinë e UJ-së, sepse kjo do të ishte tejkallim i kompetencave të tij si shef i Shtabit të Përgjithshëm, meqë ishte jashtë hierarkisë së tij komanduese.³²³⁹ Qurçini tha se si grup, Shtabi i Komandës së Lartë nuk mori asnjë informacion të veçantë lidhur me vartësimin ose dështimin e tij.³²⁴⁰

1187. Qurçini nuk shpjegoi se pse Millosheviqi nuk i dërgoi një urdhër drejtpërsëdrejti ministrit të Brendshëm. Atij i kujtohej se në fillim të majit 1999, Ojdaniqi e informoi Millosheviqin së paku një herë lidhur me mosvënien e MPB-së në varësinë e UJ-së, por nuk e dinte se çfarë ndodhi më pas.³²⁴¹ Mirëpo Vasileviqi deklaroi se Ojdaniqi i kishte treguar se Millosheviqi i pati thënë që “ai [Ojdaniqi] të mos shqetësohej, për arsye se urdhri për rivartësim nuk ishte lëshuar jo për shkak të problemeve në bashkëpunimin midis MPB-së dhe ushtrisë në Kosovë, por për shkak të problemeve me MPB-në në Mal të Zi.”³²⁴²

1188. Nuk pati prova që Stojilkoviqi ose Ministria e Brendshme t'i kishin dërguar Shtabit të Komandës së Lartë ndonjë raport lidhur me moszbatimin e urdhrin për vartësim.³²⁴³ Për më tepër, nuk pati prova të qarta që të tregonin se pse Stojilkoviqi do të kishte vendosur që mos t'i bindej urdhrin të Millosheviqit për rivartësim të datës 18 prill, sikur në të vërtetë t'a ketë marrë [urdhrin]. Simiqi dëshmoi se urdhri i Ojdaniqit për vartësim nuk u zbatua për shkak të pengesave nga organet më të larta komanduese të MPB-së së Serbisë dhe MPB-së së Malit të Zi.³²⁴⁴ Mirëpo më vonë ai u orvat që t'a tërhiqte këtë deklaratë dhe më pas dëshmoi se nuk e dinte arsyen se pse përfundimisht nuk u respektua urdhri për vartësim.³²⁴⁵ Qurçini tha se nuk kishte dijeni për ndonjë raport luftarak të njëjsteve të UJ-së në të cilin ishte raportuar për probleme që kishin dalë si rezultat i mosbindjes prej MPB-së ndaj urdhrave për vartësim.³²⁴⁶

1189. Për këtë arsye, Dhoma përfundon se nuk është provuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm se urdhrat për vartësim lëshuar nga mesi i prillit 1999 nga Millosheviqi, Ojdaniqi, Pavkoviqi dhe

³²³⁸ Gjorgje Qurçin, T. 16985 (5 tetor 2007), T. 17061–17062 (16 tetor 2007).

³²³⁹ Gjorgje Qurçin, T. 17059–17062 (16 tetor 2007); Miodrag Simiq, T. 15582–15583 (13 shtator 2007).

³²⁴⁰ Gjorgje Qurçin, T. 17059–17060 (16 tetor 2007).

³²⁴¹ Gjorgje Qurçin, T. 17059–17060 (16 tetor 2007).

³²⁴² Aleksandar Vasileviq, P2600 (deklaratë dëshmitari e datës 14 janar 2007), para. 45.

³²⁴³ Sllobodan Kosovac, T. 15845 (18 shtator 2007); Gjorgje Qurçin, T. 17059–17062 (16 tetor 2007); Miodrag Simiq, T. 15583 (13 shtator 2007)

³²⁴⁴ Miodrag Simiq, T. 15577 (13 shtator 2007).

³²⁴⁵ Miodrag Simiq, T. 15584 (13 shtator 2007). Dhoma u përgjigj se nuk do të hiqte asnjë deklaratë nga dosja dhe do të shqyrtonte të gjitha provat e paraqitura në çështjen për të nxjerrë përfundimet e saj.

Llazareviqi, u zbatuan. Në të vërtetë, një pjesë e madhe e provave tregojnë se kalimi i MPB-së në varësi të UJ-së, në fakt nuk ndodhi.

ii. Rastet kur UJ-ja drejtoi forcat e MPB-së

1190. Pavarësisht nga mungesa e provave bindëse lidhur me kalimin e forcave të MPB-së në varësinë e UJ-së në Kosovë, Dhomës i janë paraqitur prova që sugjerojnë se që para daljes së urdhrave për vartësim, UJ-ja drejtoi forcat e MPB-së në disa operacione luftarake.³²⁴⁷

1191. Vladimir Iliqi, ndihmëskomandant i Detashmentit të 121-të të PJP-së,³²⁴⁸ dëshmoi se në gusht 1998, komandanti kishte urdhëruar njësinë e tij që të vihej nën vartësinë e oficerit të UJ-së, Millan Kotur. Iliqi shpjegoi se një ditë para fillimit të aksionit, ai u takua me Koturin dhe se Koturi i caktoi detyrat gojarisht, duke i plotësuar ato me një pjesë të hartë-vendimit për veprim në zonën e Duhlës. Iliqi konfirmoi se detyrat e tij i mori drejtpërsëdrejti nga Koturi dhe se aksionin e kreu njësia e tij, disa forca të UJ-së dhe SAJ-ja.³²⁴⁹ Gjatë pyetjeve të Mbrojtjes së Pavkoviqit dhe të Llazareviqit, Iliqi tha përsëri se njësia e tij u vu nën vartësinë e UJ-së, dhe se kjo u bë nëpërmjet një urdhri të Dragan Zhivaleviqit ose paraardhësit të tij.³²⁵⁰ Ai theksoi sërish se për zbatimin e vartësimit, ai kishte marrë urdhra gojore nga Koturi, dhe jo urdhra me shkrim.³²⁵¹ Iliqi shpjegoi se lidhur me zbatimin e detyrës, ai komunikonte drejtpërsëdrejti me Koturin përfshirë radiokomunikimin gjatë aksionit. Megjithatë, ai sqaroi se “gjatë procesit të rivartësimit, unë personalisht mbaja përgjegjësi të plotë për sjelljen e policëve të mi, me fjalë të tjera, kolonel Koturi nuk kishte kurrfarë lidhje me këtë.” Iliqi nuk dha përgjigje të qarta në pyetjet për hierarkinë komanduese midis UJ-së dhe policisë, por konfirmoi se përpara se të zbatonte urdhrat e cilitdo prej këtyre dy institucioneve, ai do të kishte sqaruar me eporin e tij në MPB nëse ishte në fuqi urdhri për vartësim që kishte marrë nga Zhivaleviqi. Sikur të ishte në fuqi ky urdhër, ai do të zbatonte urdhrat e Koturit; sikur të mos ishte në fuqi ky urdhër, ai do të zbatonte urdhrat e policisë. Gjithsesi ai pohoi se kishte marrë urdhra nga Koturi dhe se kishte komunikuar me të gjatë gjithë kohës së aksionit.³²⁵²

³²⁴⁶ Gjorgje Qurçin, T. 17059–17060 (16 tetor 2007).

³²⁴⁷ *Shih gjithashtu* Nënjesën VI.E.2.

³²⁴⁸ Në tetor 1998, Detashmentet 21 dhe 22 të PJP-së formuan Brigadën 122 për Ndërhyrje. Vladimir Iliqi, T. 24347–24349 (17 mars 2008); Dragan Zhivaleviq, 6D1606 (deklaratë dëshmitari e datës 31 mars 2008), para. 6. Iliqi sqaroi se termi “Detashmenti 121” shpesh përdorej në vend të “Brigada 122 për Ndërhyrje” dhe se të dy emërtimet janë sinonime. Me formimin e Brigadës 122 për Ndërhyrje, Dragan Zhivaleviqi u emërua komandant. Ivan Maksimoviqi ishte komandanti i kësaj njësie para shtatorit 1998. Vladimir Iliqi, T. 24347–24349 (17 mars 2008)

³²⁴⁹ Vladimir Iliqi, T. 24343–24344 (17 mars 2008).

³²⁵⁰ Dragan Zhivaleviq, T. 20439 (17 janar 2008).

³²⁵¹ Vladimir Iliqi, T. 24350–24353 (17 mars 2008).

³²⁵² Vladimir Iliqi, T. 24350–24352 (17 mars 2008).

1192. Zhivaleviqi, komandant i Brigadës së 122-të të PJP-së për Ndërhyrje, u pyet për çështje të ndryshme lidhur me Detashmentin e 122-të të PJP-së, dhe gjithashtu për vartësimin.³²⁵³ Ai dëshmoi se kishte bashkëpunuar me UJ-në gjatë aksioneve të përbashkëta antiterroriste të UJ-së dhe MPB-së, por nuk u pyet për rastin konkret të gushtit 1998 të përshkruar nga Iliqi. As Koturi nuk u pyet për këtë çështje. Gjithsesi gjatë dëshmisë së tij Zhivaleviqi tha se dikur nga mesi i prillit 1999, ai ishte vënë nën vartësinë e UJ-së, dhe se “çdo gjë që urdhëronte ushtria, unë e zbatoja menjëherë.”³²⁵⁴ Kur u pyet lidhur me këtë deklaratë, nëse arsyeja ishte se kishte marrë urdhër për vartësim, Zhivaleviqi sqaroi se e kishin dërguar në Podujevë për të zbatuar detyrat e parapara në fragmentet e hartave të hartuara nga UJ-ja.³²⁵⁵

1193. Ndonëse disa dokumente nga provat tregojnë se gjatë disa operacioneve, disa komandantë të UJ-së u dhanë urdhra njësisive të MPB-së, mbetet e paqartë nëse njësitë përkatëse të MPB-së iu bindën këtyre urdhrave në praktikë. Një raport luftarak i datës 25 prill 1999, dërguar nga Zhivanoviqi, sugjeron se gjatë një aksioni në zonën e Grykës së Rugovës, Detashmenti i 73-të Territorial i MPB-së të PJP-së ishte nën komandën e Brigadës së 125-të të Motorizuar. Konkretisht, raporti thotë se “pesë kompani të Detashmentit të 73-të Territorial të MPB-së i janë atashuar brigadës”, dhe përshkruan mënyrën e dislokimit të këtyre pesë kompanive.³²⁵⁶ Kur u pyet nëse këto njësi u vunë nën vartësinë e brigadës së tij, Zhivanoviqi dëshmoi se “Ky dokument është rezultat i dembelizmit, si të thuash. Ai u hartua automatikisht, bazuar në një urdhër të Korpusit të Prishtinës për vënien e njësisive të MPB-së në varësinë e një njësie të kombinuar taktiko-luftarake. Këto forca në realitet nuk u vunë në varësinë time”.³²⁵⁷

1194. Edhe zëvendës shefi i SPB-së së Mitrovicës, Nebojsa Bogunoviq, tha se më 8 maj 1999, mori urdhër për aksion nga një departament ushtarak.³²⁵⁸ Ai zbatoi aksionet e përmendura në këtë urdhër, por dëshmoi se kishte vepruar sipas urdhrit vetëm për shkak se veprimtaritë e përmendura në urdhër ishin pjesë e veprimtarive të rregullta të njësisë së tij. Ai e gjykoi si një “iniciativë drejt përforcimit të ligjshmërisë së sjelljes së UJ-së dhe policisë.”³²⁵⁹

³²⁵³ Dragan Zhivaleviq, T. 24894 (3 prill 2008).

³²⁵⁴ Dragan Zhivaleviq, T. 24919–24920 (8 prill 2008).

³²⁵⁵ Dragan Zhivaleviq, T. 24921 (8 prill 2008).

³²⁵⁶ P2023 (Raport Luftarak i Brigadës 125 të Motorizuar dërguar PrK-së, 25 prill 1999), para. 2.

³²⁵⁷ Dragan Zhivanoviq, T. 20621 (18 janar 2008).

³²⁵⁸ 6D1098 (Urdhër i Komandës së Garnizonit në Mitrovicë lidhur me respektimin e rregullave për rend dhe disiplinë nga pjesëtarët e UJ-së dhe MPB-së, 8 maj 1999).

³²⁵⁹ Nebojsa Bogunoviq, 6D1614 (deklaratë dëshmitari e datës 2 prill 2008), para. 92.

iii. *Operacionet e kryera pas urdhrave për vartësim*

1195. Provat tregojnë se më 2 maj 1999 Brigada e 211-të e Blinduar po ndihmonte MPB-në në bllokimin e forcave “terroriste” shqiptare në segmentin Velikorekë-Lluzhan.³²⁶⁰ Zhivaleviqi këmbënguli se gjatë këtij operacioni, ai nuk ishte vënë në varësi të UJ-së, por se kishte vepruar në koordinim me kolonel Gërgarin, dhe ishte në gjendje të kërkonte nga ai mbështetje me artileri ose mbështetje me armë të tjera.³²⁶¹

1196. Më 4 maj 1999, u urdhërua operacioni i dytë në zonën e Bajgorës. Ky urdhër u nënshkrua nga Llazareviqi dhe nuk përfshinte emërtimin “Komanda e Përbashkët”.³²⁶² Detashmenti i 35-të i PJP-së ishte njëra nga njësitë që mori detyra. Në urdhër bëhej e ditur se para dhe gjatë operacioneve luftarake, duhej organizuar “aksion i koordinuar midis elementëve të formacionit luftarak lidhur me përgatitjen dhe kryerjen e operacioneve luftarake”. Saviqi tha se gjatë këtij aksioni, “çdo strukturë kishte kryer në mënyrë të pavarur detyrat e veta në drejtimet përkatëse” dhe theksoi se ata patën “bashkëpunimin e Detashmentit të 35-të të PJP-së me të cilin [ata] kishin krijuar një bashkëpunim të mirë”. Për më tepër, ai theksoi se, “siç u veprua gjatë gjithë aksioneve të tjera, çdokush mori detyrat e veta nga komanda e vet gjatë aksioneve në fjalë, dhe nuk u bë vënie në varësi”.³²⁶³ Raporti i Saviqit i datës 10 maj 1999 dërguar Komandës së Korpusit të Prishtinës, si dhe raporti luftarak i Komandës së Korpusit të Prishtinës dërguar Komandës së Armatës së Tretë dhe Shtabit të Komandës së Lartë më 12 maj 1999, tregojnë se operacioni i dytë në zonën e Bajgorës u zbatua përmes hierarkisë komanduese.³²⁶⁴ Llazareviqi dëshmoi se gjatë këtij operacioni, marrëdhëniet midis MPB-së dhe UJ-së “mbetën në kuadrin e koordinimit [dhe] bashkëpunimit”. Ai theksoi se hierarkia komanduese e MPB-së ishte e pavarur nga UJ-ja.³²⁶⁵

1197. Më 20 maj 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës lëshoi një urdhër për aksion të përbashkët të UJ-së dhe MPB-së në sektorin e Liqenit të Radoniqit, aksion ky i njohur si “Operacioni *Sekaç*”.³²⁶⁶ Urdhri e nënshkroi Millan Koturi, me autorizimin e shefit të Shtabit të Korpusit të Prishtinës, dhe në të [urdhër] nuk figuronte emërtimi “Komanda e Përbashkët”. Aty përfshiheshin detyrat për njësitë e UJ-së, si dhe detyrat për Detashmentin e 3-të, 73-të dhe 122-të të PJP-së, dhe për Kompaninë e 4-t të Brigadës së 124-të të MPB-së. Koturi dëshmoi lidhur me rolin e MPB-së në këtë aksion; konkretisht ai tha se, pavarësisht nga fakti që disa njësitë të MPB-së iu

³²⁶⁰ 5D618 (Raport Luftarak i Brigadës 211 të Blinduar dërguar PrK-së, 2 maj 1999), f. 2.

³²⁶¹ Dragan Zhivaleviq, T. 24855 ; T. 24910-T. 24911 (3 prill 2008).

³²⁶² 6D704 (Urdhër i PrK-së, 4 maj 1999), f. 1, 6.

³²⁶³ Lubomir Saviq, 5D1392 (deklaratë dëshmitari e datës 27 dhjetor 2007), para. 19.

³²⁶⁴ 5D1132 (Raport i Komandës së Brigadës 58 të Këmbëorisë së Lehtë dërguar Komandës së PrK-së maj 1999); P2007 (Raport Luftarak i PrK-së dërguar Armatës së Tretë dhe Shtabit të Komandës së Lartë, 12 maj 1999).

³²⁶⁵ Vladimir Llazareviq, T. 18218 (13 nëntor 2007).

³²⁶⁶ P2011 (Urdhër i PrK-së, “Operacioni *Sekaç*” 20 maj 1999).

dhanë detyra, ato nuk u vunë nën vartësinë e UJ-së. Ai u shpreh se gjatë këtij aksioni, forcat e MPB-së dhe UJ-së duhej të koordinonin me njëra-tjetrën. Koturi gjithashtu konfirmoi se më 19 maj 1999, në postëkomandën pararojë të Korpusit të Prishtinës u mbajt një mbledhje për koordinim midis UJ-së dhe MPB-së, me qëllim planifikimin e këtij aksioni.³²⁶⁷ Ai theksoi se gjatë këtij aksioni, ai komandoi njësitë e UJ-së, kurse njësitë e MPB-së i komandoi kolonel Kovaçeviqi, shef i SPB-së së Gjakovës.³²⁶⁸ Ndonëse Iliqi nuk ishte në gjendje të thoshte me siguri të plotë nëse ishte nën vartësinë e Koturit, ai deklaroi se zbatonte vetëm urdhrat e komandantit të tij, Boshko Buha. Me plagosjen e Buhës, Iliqi mori postin e tij dhe më pas, urdhrat i merrte nga komandanti i Detashmentit të 23-të të PJP-së, Boris Josipoviq.³²⁶⁹ Për më tepër, Iliqi asnjëherë nuk kishte parë urdhrin e Koturit lidhur me operacionin *Sekaç*; lidhur me këtë aksion, ai u dha urdhra kompanive vartëse të tij në bazë të disa fragmenteve të hartë-vendimeve që i kishte marrë nga Buha.³²⁷⁰

1198. Më 22 maj 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës urdhëroi një operacion të përbashkët në sektorin e Pollatës. Në këtë urdhër nuk figuronte emërtimi “Komanda e Përbashkët”. Brigada e 211-të e Blinduar u urdhërua që të vepronte së bashku me njësitë e tjera, si Brigada e 122-të e MPB-së për Ndërhyrje dhe JSO. Në fund të urdhrin thuhej se “Komanda e Brigadës së 211-të të Blinduar, e cila ishte përgjegjëse për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e veprimeve luftarake, kishte për detyrë të organizonte aksion të kombinuar midis elementëve të formacionit luftarak gjatë planifikimit, organizimit, përgatitjes dhe kryerjes së operacioneve luftarake në sektorin e fshatit Pollatë”.³²⁷¹ Lidhur me këtë operacion të përbashkët, Dragan Zhivaleviqi shpjegoi ai nuk i raportonte UJ-së për punën e tij sepse ata kishin hierarkinë e tyre komanduese.³²⁷²

1199. Një operacion tjetër i përbashkët u urdhërua më 25 maj 1999 në zonën e Malit të Drenicës”. Komanda e Korpusit të Prishtinës udhëzoi njësitë vartëse të saj që të kryenin një sulm “me Detashmentin e PJP-së dhe me JSO-në”.³²⁷³ Ky urdhër iu dërgua edhe “Komandës së MPB-së”. Llazareviqi dëshmoi se, pavarësisht nga fakti që termi “MPB” ishte shkurtesë për Ministrinë e Punëve të Brendshme, urdhri “sigurisht që nuk” iu dërgua MPB-së në Beograd. Sipas Llazareviqit, “ka shumë të ngjarë” që urdhri t’i jetë dërguar “njërit prej detashmenteve të përfshira në këtë aksion, ose ndoshta Shtabit të MPB-së në Prishtinë”.³²⁷⁴ Më tej, ai shpjegoi se pas lëshimit të

³²⁶⁷ Millan Kotur, T. 20691–20695 (21 janar 2008). *Shih* 5D227 (Raport Luftarak i PrK-së dërguar Armatës së Tretë dhe Shtabit të Komandës së Lartë, 20 maj 1999).

³²⁶⁸ Millan Kotur, T. 20695 (21 janar 2008). *Shih* 5D1382 (Raport Luftarak i IKM-së /Postëkomanda Pararojë/ dërguar PrK-së, 22 maj 1999).

³²⁶⁹ Vladimir Iliqi, T. 24353–24356 (17 mars 2008).

³²⁷⁰ Vladimir Iliqi, T. 24358–24359 (17 mars 2008).

³²⁷¹ 6D709 (Urdhër i PrK-së lidhur me aksionin në Pollatë, 22 maj 1999), f. 6.

³²⁷² Dragan Zhivaleviqi, T. 24877–24878 (3 prill 2008).

³²⁷³ P2014 (Urdhër i PrK-së, 25 maj 1999).

³²⁷⁴ Vladimir Llazareviqi, T. 18414 (16 nëntor 2007).

urdhrave për vartësim, urdhrat për operacione të përbashkëta nuk përcaktonin se UJ-ja do të “mbështeste” MPB-në dhe nuk përmendnin termin “Komanda e Përbashkët”. Urdhrat jepeshin që UJ-ja të kryente detyra “së bashku me” njësitë e policisë.³²⁷⁵ Ky urdhër konkret parashtronte “koordinim midis elementëve të formacionit luftarak gjatë planifikimit, organizimit dhe kryerjes së operacioneve luftarake në sektorin e Drenicës [do të] zbatohet nga Komanda e Brigadës së 252-të të Blinduar, e cila [do të] ishte përgjegjëse për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e operacioneve luftarake”.³²⁷⁶ Për sa i përket këtij operacioni, Stefanoviçi dëshmoi se Komanda e Brigadës së 252-të të Blinduar duhej të kishte rolin udhëheqës. Ai shpjegoi se në atë kohë vartësimi ishte ende në fuqi. Ky aksion ishte planifikuar pikërisht mbi bazë të urdhrit për vartësim. Mirëpo gjatë operacionit, njësitë e MPB-së nuk u vunë në varësinë e Komandës së Brigadës së 252-të të Blinduar.³²⁷⁷ Faktikisht, njësitë e MPB-së as nuk denjuan të vinin. Për këtë arsye, në këtë zonë do të planifikohej aksion i ri, gjegjësisht aksioni Drenica-1.

1200. Aksioni Drenica-1 u krye në përputhje me urdhrin e Komandës së Korpusit të Prishtinës të datës 28 maj 1999, me qëllim shkatërrimin e forcave “terroriste” shqiptare në “sektorin e Malit Drenica-1”. Në këtë urdhër, Komanda e Korpusit urdhëroi njësitë vartëse të saj dhe disa njësi të MPB-së, përfshirë Detachmentin e 36-të të PJP-së, Batalionin e 6-të të Brigadës së 124-t Intendente të MPB-së, dhe Batalionin e Parë dhe të Dytë të Brigadës së 122-të Intendente të MPB-së, të kryenin disa sulme. Urdhri iu dërgua “Komandës së MPB-së (për të gjitha njësitë)”. Në të thuhej se “ekipi i Komandës së Korpusit të Prishtinës i udhëhequr nga shefi i Organit për Çështje Operative dhe Stërvitje, përgjegjës për planifikimin, organizimin dhe kryerjen e operacioneve luftarake, [do të] organizonte aksione të kombinuara midis elementëve të formacionit luftarak gjatë planifikimit, organizimit, përgatitjes dhe kryerjes së operacioneve luftarake në sektorin e Drenicës”.³²⁷⁸ Stefanoviçi konfirmoi se kishte marrë pjesë në hartimin e këtij urdhri, dhe se ishte i destinuar për Llukiqin ose anëtarë të tjerë të Shtabit të MPB-së.³²⁷⁹ Kur u pyet nga Dhoma lidhur me natyrën në dukje kontradiktore të urdhrave për vënien e MPB-së në varësi duke ditur se urdhrat nuk do të zbatoheshin, Stefanoviçi tha se ndonëse urdhri për vartësim nuk u zbatua, ai asnjëherë nuk u anulua.³²⁸⁰ Llazareviçi konfirmoi se urdhri për vartësim mbeti në fuqi dhe se nga eprori i tij, ai nuk mori ndonjë “urdhër për anulim”.³²⁸¹ Lidhur me këtë, Dhoma kujton se më 8 maj 1999, Komanda e Armatës së Tretë lëshoi përsëri një urdhër ku udhëzohej vënia e njësive të MPB-së në varësi të UJ-

³²⁷⁵ Vladimir Llazareviçi, T. 18437 (16 nëntor 2007).

³²⁷⁶ P2014 (Urdhër i PrK-së, 25 maj 1999), f. 13.

³²⁷⁷ Radojko Stefanoviçi, T. 21755 (6 shkurt 2008).

³²⁷⁸ 6D712 (Urdhër i PrK-së, 28 maj 1999), f. 8.

³²⁷⁹ Radojko Stefanoviçi, T. 21809–21810 (7 shkurt 2008).

³²⁸⁰ Radojko Stefanoviçi, T. 21696–21698 (5 shkurt 2008).

³²⁸¹ Vladimir Llazareviçi, T. 18416 (16 nëntor 2007).

së.³²⁸² Stefanoviçi shpjegoi se gjatë kryerjes së operacionit, njësitë e MPB-së nuk u vunë në varësinë e UJ-së, por luftuan në një drejtim tjetër nga ai i UJ-së.³²⁸³

1201. Më 27 maj 1999, Komanda e Korpusit të Prishtinës i drejtoi MPB-së një urdhër tjetër. Qëllimi i këtij urdhri ishte shpartallimi dhe shkatërrimi i forcave “terroriste” shqiptare në zonën e Prekazit. Ai përmbante detyra për tri brigadat e Korpusit të Prishtinës dhe saktësonte se ato duhej të bashkëvepronin me kompaninë e 35-të dhe 36-të të PJP-së. Urdhri thoshte se komanda e Brigadës së 37-të të Motorizuar do të ishte përgjegjëse “për bashkëpunimin midis elementëve të formacionit luftarak gjatë planifikimit, organizimit, përgatitjes dhe kryerjes së operacioneve luftarake në zonën e Prekazit si dhe për “planifikimin, organizimin dhe kryerjen e operacioneve luftarake”.³²⁸⁴ Kur komandanti i Brigadës së 37-të të Motorizuar, Dikoviçi, u pyet lidhur me rezultatet e këtij aksioni, ai shpjegoi se përfundimisht brigada e tij nuk e kreu aksionin së bashku me MPB-në pasi MPB-ja “thjesht nuk erdhën aty ku duhej të vinin.”³²⁸⁵

1202. Në terma më të përgjithshme, disa dëshmitarë dëshmuan se, meqë vartësimi nuk u realizua asnjëherë, marrëdhëniet midis MPB-së dhe UJ-së mbetën në kuadër të koordinimit dhe bashkëpunimit gjatë operacioneve që u kryen pas mesit të prillit 1999.³²⁸⁶ Për shembull, Gjakoviçi tha se marrëdhëniet midis MPB-së dhe UJ-së mbetën të njëjta marrëdhënie koordinimi “si më parë”: “Çdokush i kryente detyrat e veta në mënyrë të pavarur, si të thuash.”³²⁸⁷ Për më tepër, Llazareviçi shpjegoi se pas pjesëmarrjes së tij në mbledhjen e 19 prillit 1999 në të cilin ai, Pavkoviçi dhe Stevanoviçi diskutuan aspektin praktik të vartësimit të MPB-së me Vllastimir Gjorgjeviçin, Obrad Stevanoviçin, dhe Llukiçin,³²⁸⁸ ai “dërgoi në terren ekipet e tij në nivel të Sekretariatit të Brendshëm dhe në nivel të detashmenteve të policisë, për të parë nëse ekzistonte mundësia për ndonjë lloj koordinimi, në rast se vartësimi do të ishte i pamundshëm.”³²⁸⁹ Për më tepër, Llazareviçi ishte në dijeni se në përgjigje të urdhrit që u lëshua pas kësaj mbledhjeje, Stevanoviçi shkoi disa herë në Gjakovë së bashku me shefin e SPB-së, në përpjekje për “zgjidhjen e problemit të vartësimit dhe ruajtjen e koordinimit dhe bashkëpunimit.”³²⁹⁰ Së fundi, Llazareviçi shpjegoi se gjatë gjithë kohës së luftës, “pavarësisht nga çfarë shkruhej gjetiu, [marrëdhëniet midis

³²⁸² P1269 (Urdhër i Armatës së Tretë, 8 maj 1999).

³²⁸³ Radojko Stefanoviçi, T. 21700 (6 shkurt 2008).

³²⁸⁴ P1503 (Urdhër i PrK-së, 27 maj 1999), f. 1, 4–5, 9–10.

³²⁸⁵ Lubisha Dikoviçi, T. 19893–19894 (10 dhjetor 2007).

³²⁸⁶ Millorad Obradoviçi, T. 15026–15027 (5 shtator 2007); Momir Pantiq, T. 24774–24775 (3 prill 2008).

³²⁸⁷ Millan Gjakoviçi, T. 26496 (20 maj 2008).

³²⁸⁸ Vladimir Llazareviçi, T. 18207–18208 (13 nëntor 2007), T. 18260 (14 nëntor 2007).

³²⁸⁹ Vladimir Llazareviçi, T. 18269–18274 (14 nëntor 2007).

³²⁹⁰ Vladimir Llazareviçi, T. 18450 (16 nëntor 2007).

MPB-së dhe UJ-së] ishin vetëm në kuadër të koordinimit dhe bashkëpunimit, me dy hierarki komanduese plotësisht të ndara”.³²⁹¹

e. Përfundim

1203. Provat tregojnë se pas lëshimit të urdhrave të prillit 1999 për vartësim, marrëdhëniet midis UJ-së dhe MPB-së nuk u shndërruan në një lidhje varësie, por mbetën marrëdhënie bashkëpunimi dhe koordinimi. Ndonëse njësitë e MPB-së nuk u vunë në varësinë e UJ-së, gjithsesi, gjatë periudhës së Aktakuzës ekzistonte një nivel i lartë bashkëpunimi dhe koordinimi midis forcave të RFJ-së dhe Serbisë në kryerjen e operacioneve të përbashkëta në Kosovë.

1204. Pas shtjellimit të mënyrës së bashkëpunimit midis forcave të ndryshme të RFJ-së dhe Serbisë gjatë vitit 1998 dhe 1999, Dhoma më tej do të përvijojë fillimin dhe zhvillimin e fushatës ajrore të NATO-s, e cila filloi më 24 mars 1999, para se të analizojë provat lidhur me krimet të cilat pretendohen të jenë kryer nga forcat e RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë gjatë kësaj fushate.

F. BOMBARDIMET E NATO-S

1. Preludi i bombardimeve të NATO-s

1205. Më 31 mars dhe 23 shtator 1998, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi rezoluta lidhur me situatën në Kosovë, dhe në rezolutën e dytë paralajmëroi ndërmarrjen e veprimeve të mëtejshme në rast të mosplotësimit të kushteve të parashtruara.³²⁹² Ambasadori i Shteteve të Bashkuara, Richard Holbrooke u dërgua në Beograd për të siguruar se autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë do të respektonin të dy rezolutat. Holbrooke më pas i raportoi Këshillit të NATO-s se për mendimin e tij, një marrëveshje mund të arrihej nëse ai do të kërcënonte me veprim ushtarak të NATO-s.³²⁹³ Për këtë arsye, më 12–13 tetor 1998, Këshilli i NATO-s lëshoi një urdhër aktivizues (ACTORD). Duke pasur në dorë kërcënimin me ACTORD, Holbrooke-u arriti të negocionte marrëveshjen Holbrooke-Milloshëviq, siç është shpjeguar më lart.³²⁹⁴ Pas nënshkrimit në vijim të marrëveshjes Clark-Naumann, komandanti i NATO-s, Wesley Clark, dhe kryetari i komitetit ushtarak të NATO-s, Klaus Naumann, i raportuan Këshillit të NATO-s, i cili konkludoi se në qoftë se do të kryhej tërheqja sipas marrëveshjes e forcave të sigurisë të RFJ-së

³²⁹¹ Vladimir Llazareviq, T. 18223 (13 nëntor 2007).

³²⁹² P455 (Rezoluta 1160 e KSKB-së, 31 mars 1998); P456 (Rezoluta 1199 e KSKB-së, 23 shtator 1998).

³²⁹³ Klaus Naumann, P2512 (transkripti nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6968.

³²⁹⁴ Klaus Naumann, T. 8246–8247 (2 mars 2007), P1767 (shënime nga intervistat me Prokurorinë), para. 9–10.

dhe Serbisë dhe do të konfirmohet nga vëzhguesit ndërkombëtarë në Kosovë, ACTORD-i nuk do të zbatohet.³²⁹⁵

1206. Ndonëse fillimisht u tërhoqën forca të policisë nga Kosova, në nëntor 1998 dolën raporte për shkelje të marrëveshjes lidhur me numrin e forcave të RFJ-së dhe Serbisë në Kosovë dhe forcën e tepruar që përdornin, siç u diskutua në Pjesën VI.D më sipër.³²⁹⁶ Sidoqoftë, gjatë dëshmisë së tij, Naumann-i theksoi se shumë incidente, si torturimi dhe vrasja e policëve të rinj serbë, u shkaktuan nga UÇK-ja, e cila u orvat të përfitonte nga tërheqja e forcave të RFJ-së/Serbisë. Gjithsesi, NATO-ja u alarmua nga “metoda e dorës së fortë” e shtetit në zgjidhjen e situatës.³²⁹⁷ Në fund të një takimi me Millosheviqin më 19 janar 1999, Clark-u dhe Naumann-i dhanë një ultimatum duke thënë se në rast se gjërat nuk do të ndryshonin, NATO-ja do të detyrohej të vepronte.³²⁹⁸

1207. Me dështimin e bisedimeve në Rambuje dhe Paris, Kryetari në detyrë i OSBE-së, Knut Vollebaek, urdhëroi tërheqjen e menjëhershme të misionit verifikues të OSBE-së (KVM) nga Kosova, e cila përfundoi më 20 mars 1999.³²⁹⁹ Naumann-i dëshmoi se dështimi i fundit i negociatave ndodhi më 23 mars 1999, kur Holbrooke-u u takua përsëri me Millosheviqin dhe i raportoi Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s për kokëfortësinë e tij. Me kërkesë të Naumann-it, Sekretari i Përgjithshëm më pas i dha Clark-ut urdhër me shkrim për fillimin e fushatës ajrore.³³⁰⁰

1208. Në të njëjtën ditë, qeveria e RFJ-së shpalli gjendjen e rrezikut të luftës së afërt për shkak të “rrezikut nga agresioni.”³³⁰¹ Më 24 mars, Kryeministri Federal, Momir Bullatoviq, shpalli zyrtarisht gjendjen e luftës në RFJ.³³⁰² Branko Kërگا konfirmoi se takimi i fundit midis Ojdaniqit dhe Clark-ut u mbajt në të njëjtën ditë.³³⁰³ Ai gjithashtu tha se NATO-ja dha dy arsye kryesore për të përligjur fushatën e saj ajrore: parandalimin e një katastrofe humanitare dhe të detyronte RFJ-në që të pranonte kushtet e parashtruara më parë.³³⁰⁴

³²⁹⁵ Klaus Naumann, P1767 (shënime nga intervistat me Prokurorinë), para. 27, P2512 (transkripti nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6994.

³²⁹⁶ Klaus Naumann, P1767 (shënime nga intervistat me Prokurorinë), para. 28, P2512 (transkripti nga *Prokurori kundër Millosheviqit*, Lënda Nr. IT-02-54-T), T. 6994-6995.

³²⁹⁷ Klaus Naumann T. 8263-8264 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime nga intervistat me Prokurorinë), para. 28.

³²⁹⁸ Klaus Naumann, P1767 (shënime nga intervistat me Prokurorinë), para. 38.

³²⁹⁹ P635 (Pikat kryesore nga takimi midis KVM-së dhe MPB-së, 29 dhjetor 1998), f. 7.

³³⁰⁰ Klaus Naumann, T. 8274 (13 dhjetor 2006), P1767 (shënime nga intervistat me Prokurorinë), para. 47.

³³⁰¹ P992 (Vendim për Shpalljen e Rrezikut të Luftës së Afërt, 23 mars 1999).

³³⁰² 2D294 (Raport i Sekretariatit të RFJ-së për Informim, 24 mars 1999).

³³⁰³ Branko Kërگا, T. 16798-16799 (3 tetor 2007).

³³⁰⁴ Branko Kërگا, 3D1120 (deklaratë dëshmitari e datës 13 gusht 2007), para. 18.

2. Pasqyrë e fushatës së NATO-s

1209. Fushata e NATO-s ishte një operacion ajror që zgjati nga mbrëmja e 24 marsit e deri më 10 qershor 1999. Gjatë kësaj fushate, aeroplanët e NATO-s bënë fluturime nga baza të ndryshme ajrore në Evropë dhe bombarduan objektiva në të gjithë territorin e RFJ-së. Ndonëse Dhoma nuk mori asnjë provë nga burimet zyrtare të NATO-s lidhur me fushatën ajrore dhe objektivat e sulmuara, ajo dëgjoi dëshmitarë dhe mori dokumente që mundësojnë një pasqyrë të përgjithshme të zhvillimit të kësaj fushate.

1210. Spasoje Smilaniq, shef i Administratës së Parë të UJ-së dhe komandant i Forcave Ajrore dhe Mbrojtjes Kundërajrore gjatë periudhës së Aktakuzës, dëshmoi në hollësi lidhur me shkallën e fushatës së NATO-s, përfshirë praninë e 2.030 aeroplanëve të NATO-s në ditë në hapësirën ajrore të RFJ-së, dhe 26.000 fluturimeve të NATO-s gjatë gjithë fushatës. Ndonëse dha dëshmi të hollësishme për sa u përket shifrave, Smilaniq nuk shpjegoi burimin e shifrave të tij dhe Dhoma nuk mund të nxjerrë kurrfarë përfundimi lidhur me saktësinë e tyre. Në fakt, nuk ka nevojë që Dhoma të nxjerrë ndonjë përfundim lidhur me numrin e saktë të fluturimeve ose bombave të hedhura gjatë kësaj fushate. Dhoma nuk ka kurrfarë dyshimi, dhe palët nuk kundërshtuan se, fushata e NATO-s ishte një operacion i madh ushtarak që shkaktoi dëmtimin dhe shkatërrimin e shumë objektivave në RFJ.

1211. Një raport i hartuar për Prokurorinë nga komiteti për shqyrtimin e veprimeve të NATO-s i formuar më 14 maj 1999, u pranua si provë në bazë të një vendimi me shkrim.³³⁰⁵ Komiteti kishte për detyrë të shqyrtonte pretendimet dhe provat lidhur me veprimet e NATO-s që të këshillonte Prokurorinë nëse duhej kryer hetim i plotë i ndonjë incidenti ose incidenteve të veçanta që përfshinin shkelje të rënda të së drejtës humanitare ndërkombëtare.³³⁰⁶ Ndonëse raporti nuk i bën publik emrat e anëtarëve të komitetit, aty përmenden dokumentet që janë shqyrtuar duke theksuar se pjesa më e madhe e këtij materiali ishte publik. Këto dokumente përfshijnë një raport të Human Rights Watch me titull “Civilian Deaths in the NATO Air Campaign /Vdekjet e Civilëve gjatë Fushatës Ajrore të NATO-s/”; dokumente publike të mundësuar nga NATO-ja, Ministria e Mbrojtjes e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dhe Ministria britanike e Mbrojtjes; dokumente të dorëzuara Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë nga Ministria e Jashtme e RFJ-së; dhe dokumente të tjerë të RFJ-së, përfshirë raportin e Ministrisë së Jashtme të RFJ-së me titull

³³⁰⁵ 4D90 (Raporti përfundimtar i Komitetit për shqyrtimin e fushatës së NATO-s dërguar Prokurorit, 13 qershor 2000); Vendim lidhur me Mocionin e Përsëritur të Pavkoviqit për Pranimin e Dokumenteve në Sallën Gjyqësore, 27 shtator 2007.

³³⁰⁶ 4D90 (Raporti përfundimtar i Komitetit për shqyrtimin e fushatës së NATO-s dërguar Prokurorit, 13 qershor 2000), para. 2-3.

“Krimet e NATO-s në Jugosllavi (Libri i Bardhë).”³³⁰⁷ Në fund, komiteti nxori përfundimin se nuk kishte incidente që do të kërkonin një hetim zyrtar nga Prokuroria.³³⁰⁸

1212. Një analizë e 75 raporteve luftarake të përgatitura në Shtabin e Përgjithshëm /Shtabit të Komandës së Lartë të UJ-së në bazë të raporteve të marra nga njësitë vartëse, që mbulojnë periudhën 24 mars - 9 qershor 1999, tregon se gjatë bombardimeve të NATO-s, përveç Kosovës, u godit edhe një pjesë e madhe e Serbisë, përfshirë Beogradin dhe Novi Sadin.³³⁰⁹ Gjithashtu, në fund të prillit 1999 u goditën objektiva edhe në Podgoricë, Mal i Zi.³³¹⁰ Raportet tregojnë se disa pjesë të Beogradit në veçanti u goditën disa herë. Kjo përputhet me dëshminë e Spasoje Smilaniqit i cila tha se Beogradi me rrethinë ishte zona ku u përdor fuqi zjarri e intensitetit më të lartë.³³¹¹

1213. Llazareviqi dëshmoi se 2.000 sulme ajrore të NATO-s goditën territorin e Kosovës dhe se 37 për qind e këtyre goditjeve kishin si objektiva objektet civile.³³¹² Ai tha se objektivat kryesore të NATO-s ishin në zonën kufitare në drejtim të Maqedonisë dhe Shqipërisë, në një gjatësi prej 250 kilometrash dhe thellësi prej 20–25 kilometrash.³³¹³ Smilaniqi konfirmoi pohimin e Llazareviqit se goditjet më të mëdha u bënë në zonën kufitare. Ai gjithashtu tha se një numër i konsiderueshëm i goditjeve u bënë përgjatë boshtit Hani i Elezit-Kaçanik-Ferizaj-Prishtinë. Rreth 80 për qind e të gjitha sulmeve në Kosovë u kryen aty, dhe 75 për qind e objekteve të shkatërruara në Kosovë ishin pikërisht në këtë zonë.³³¹⁴

1214. Dhoma dëgjoji dëshmi që sugjerojnë se gjatë fushatës ajrore, nga NATO-ja u goditën ndërtesa dhe objekte që ishin pjesë e infrastrukturës civile serbe, përfshirë bombardimin e ambasadës kineze në Beograd më 7 maj,³³¹⁵ e trenit të udhëtarëve në grykën e Gërdelicës në Serbinë lindore më 12 prill 1999,³³¹⁶ i një kolone refugjatësh në afërsi të Gjakovës më 14 prill 1999,³³¹⁷ i fshatit Korishë (komuna e Gjakovës) më 14 maj 1999,³³¹⁸ dhe i një autobusi që po

³³⁰⁷ Nga këto, raporti i Human Rights Watch është pranuar si provë në këtë proces gjyqësor me numër P703.

³³⁰⁸ (Raporti përfundimtar i Komitetit për shqyrtimin e fushatës së NATO-s dërguar Prokurorit, 13 qershor 2000), para. 3, 91.

³³⁰⁹ *Shih* 3D800–3D875 (Raporte Luftarake të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 26 mars 1999–9 qershor 1999).

³³¹⁰ *Shih* 3D834–3D835 (Raporte Luftarake të Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 29 prill 1999–30 prill 1999).

³³¹¹ Spasoje Smilaniq, T. 15750 (17 shtator 2007).

³³¹² Vladimir Llazareviq, T. 17949 (8 nëntor 2007).

³³¹³ Vladimir Llazareviq, T. 17948 (8 nëntor 2007).

³³¹⁴ Spasoje Smilaniq, T. 15750–15751 (17 shtator 2007).

³³¹⁵ 4D90 (Raporti përfundimtar i Komitetit për shqyrtimin e fushatës së NATO-s dërguar Prokurorit, 13 qershor 2000), para. 80–85; 3D844 (Raport Luftarak i Shtabit të Përgjithshëm të UJ-së, 9 maj 1999), f. 1.

³³¹⁶ Klaus Naumann, T. 8331–8332 (14 dhjetor 2006); 4D90 (Raporti përfundimtar i Komitetit për shqyrtimin e fushatës së NATO-s dërguar Prokurorit, 13 qershor 2000), para. 58–62.

³³¹⁷ 4D90 (Raporti përfundimtar i Komitetit për shqyrtimin e fushatës së NATO-s dërguar Prokurorit, 13 qershor 2000), para. 65; Sadik Januzi, P2524 (deklaratë dëshmitari e datës 21 tetor 2001), f. 3; Bozhidar Deliq, T. 19314 (29 nëntor 2007); 5D1158 (Raport Luftarak i Brigadës 52 të Blinduar dërguar PrK-së, 14 prill 1999); Zdravko Vintar, T. 21042–21043 (24 janar 2008).

udhëtonte nga Nishi për në Prishtinë, në afërsi të fshatit Lluzhan (komuna e Podujevës) më 1 maj 1999.³³¹⁹ Këto janë ngjarje tragjike. Dhoma nuk ka për detyrë të nxjerrë përfundime lidhur me përgjegjësinë e NATO-s për këto çështje, dhe palët me të drejtë nuk i kërkuan një gjë të tillë. Dhoma ka për detyrë që t'i marrë parasysh këto ngjarje vetëm nëse ato lidhen me çështjet mbi të cilat përqëndrohet Aktakuza. Për këtë arsye, ato janë të rëndësishme për argumentin e Mbrojtjes se zhvendosja masive e popullatës civile në Kosovë u shkaktua nga bombardimet e NATO-s. Kjo çështje trajtohet më poshtë në lidhje me çdo komunë ku pretendohet të jetë kryer dëbimi dhe zhvendosja e dhunshme.

3. Marrëveshja e Kumanovës

1215. Gjatë fushatës ajrore të NATO-s, vazhduan përpjekjet diplomatike për të bindur Presidentin e RFJ-së Millosheviq që t'i jepte fund krizës dhe të pranonte prani ushtarake ndërkombëtare në Kosovë. Ish-Kryeministri rus Viktor Çernomërdin dhe Presidenti finlandez Martti Ahtisaari u bënë ndërmjetësuesit kryesorë në këtë proces.³³²⁰ Më 3 qershor 1999, qeveria dhe Kuvendi Kombëtar i RFJ-së, si dhe Kuvendi Kombëtar i Serbisë, miratuan propozimin për paqe të Çernomërdinit dhe Ahtisaari-t, dhe pas kësaj, shefi i Shtabit të Komandës së Lartë, Ojdaniq, autorizoi një ekip oficerësh të lartë të UJ-së të kryenin negociatave me përfaqësues të NATO-s dhe forcave të armatosura të Rusisë lidhur me zbatimin e planit për paqe dhe tërheqjes së forcave nga Kosova.³³²¹ Kërگا, i cili ishte anëtar i ekipit, tha se qëllimi i negociatave ishte që “të arrihej një Marrëveshje Tekniko-Ushtarake me përfaqësuesit e NATO-s, në bazë të dokumentit Ahtisaari- Çernomërdin që tanimë ishte pranuar, dhe të krijoheshin kushtet për rezolutën e Këshillit të Sigurimit.”³³²² Si rezultat, më 9 qershor 1999 u nënshkrua dhe hyri në fuqi Marrëveshja Tekniko-Ushtarake midis Forcave Ndërkombëtare të Sigurisë (“KFOR”) dhe qeverive të RFJ-së dhe Serbisë.³³²³ Sipas Marrëveshjes, pas miratimit të një rezolute të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, autoritetet e RFJ-së dhe Serbisë do të lejonin dislokimin e KFOR-it, dhe gjithashtu do të lejonin KFOR-in të vepronte pa pengesa.

³³¹⁸ 4D90 (Raporti përfundimtar i Komitetit për shqyrtimin e fushatës së NATO-s dërguar Prokurorit, 13 qershor 2000), para. 86; Bozhidar Deliq, T.19316 (29 nëntor 2007); 5D914 (Raport Luftarak i Brigadës 549 të Motorizuar dërguar PrK-së, 14 maj 1999).

³³¹⁹ Millosh Deretiç, T.22586–22587 (18 shkurt 2008); 6D998 (Dosja A/I-181), p. 7; 5D617 (Raport Luftarak i Brigadës 211 të Blinduar dërguar PrK-së, 1 maj 1999).

³³²⁰ P472 (Marrëveshja Ahtisaari-Çernomërdin, 4 qershor 1999).

³³²¹ 2D313 (Raport i Sekretariatit të RFJ-së për Informim); 1D170 (Vendim i Kuvendit Kombëtar të Republikës së Serbisë, 3 qershor 1999); P1748 (Vendim i Ojdaniqit për formimin e ekipit negociues të UJ-së, 4 qershor 1999).

³³²² Branko Kërگا, T. 16817 (3 tetor 2007).

³³²³ 6D611 (Marrëveshja Tekniko-Ushtarake në Kumanovë, 9 qershor 1999).

1216. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit miratoi Rezolutën 1244, në të cilën thuhej se ndër përgjegjësitë e pranisë ndërkombëtare për siguri përfshihej mundësimi i tërheqjes së ushtrisë, çmilitarizimi i UÇK-së, dhe krijimi i një mjedisi të sigurt për kthimin e refugjatëve dhe personave të shpërngulur.³³²⁴ Rezoluta gjithashtu autorizonte krijimin e një pranije ndërkombëtare civile me qëllim mundësimin e administrimit të përkohshëm të Kosovës.³³²⁵ Një raport i nënshkruar nga komandanti i Armatës së Tretë të UJ-së, Pavkoviç, komandanti i Forcave Ajrore të UJ-së, Smilaniç, dhe nga Obrad Stevanoviç në emër të MPB-së së Serbisë, më 20 qershor 1999 iu dërgua komandantit të KFOR-it, gjenerallejtënant Michael Jackson, në të cilin konfirmohej tërheqja e forcave nga Kosova dhe premtahej bashkëpunim nëpërmjet të Komisionit të porsakrijuar për Bashkëpunim me Misionin e Kombeve të Bashkuara, dhe Komisionin për Zbatim të Përbashkët.³³²⁶

G. PËRFUNDIME

1217. Në këtë pjesë, Dhoma ka nxjerrë përfundime lidhur me rolet dhe marrëdhëniet brenda rrjetit të ndërlikuar të aktorëve gjatë ngjarjeve të 1998 dhe 1999 të pretenduara në Aktakuzë, përkatësisht udhëheqja politike dhe ushtarake e RFJ-së dhe Serbisë, UJ-ja, MPB-ja, Komanda e Përbashkët, UÇK-ja, dhe NATO-ja. Këto role dhe marrëdhënie ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në krimet e pretenduara në Aktakuzë dhe në përgjegjësinë e pretenduar penale të secilit nga të Akuzuarit. Rëndësi ka që është vërtetuar jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm ekzistenca e një konflikti të armatosur në territorin e Kosovës gjatë gjithë kohës që lidhet me periudhën kohore të Aktakuzës, duke filluar nga viti 1998 dhe duke vijuar gjatë vitit 1999, i cili përfundoi me ndërprerjen e bombardimeve të NATO-s.³³²⁷

³³²⁴ P433 (Rezoluta 1244 e KSKB-së, 10 qershor 1999), f. 2–3.

³³²⁵ P433 (Rezoluta 1244 e KSKB-së, 10 qershor 1999), f. 3.

³³²⁶ 4D225 (Raport i Armatës së Tretë dërguar gjenerallejtënant Michael Jackson, 20 qershor 1999).

³³²⁷ Meqë në Aktakuzë nuk pretendohen shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës, Dhoma nuk ka nevojë të përcaktojë nëse konflikti i armatosur ishte i brendshëm ose ndërkombëtar.